XHAFER DURMISHI

L Ë V I Z J A
E
JUSUF GËRVALLËS



© Xhafer Durmishi

Ngjarjet që shqyrtohen në këtë libër kanë të bëjnë me Lëvizjen e Jusuf Gërvallës kryesisht gjatë periudhës tetor 1979 – korrik 1985

PARAFJALË

Me emrin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" nuk e nënkuptoj krejt historinë e LNÇKVSHJ të cilën nuk e ka formuar Jusufi, ai Jusuf i cili është vrarë dhe është varrosë si anëtar i saj. Me emrin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" nuk e nënkuptoj as krejt historinë e Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, pasi ajo ka vepruar edhe pas vitit

1985. Me emrin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" kam parasysh peshën vendimtare të Jusufit në LNÇKVSHJ, kam parasysh peshën vendimtare të Jusufit në Lëvizjen për Republikë pas vrasjes së tij. Unë kam respekt për veprimtarinë çlirimtare të LNÇKVSHJ-së para vitit 1979 dhe për punën e rëndësishme pas vitit 1985 që është bërë në emrin e Lëvizjes për Republikë, të asaj Lëvizjeje konkrete, për të cilën data të rëndësishme të historisë së saj konsiderohen 17 shkurti dhe 15 maji 1982.

Duke pasur parasysh ngjyrimet ideologjike, të cilave u ka dalë boja, dhe sidomos EPILOGUN e LUFTËS SË YJEVE, emërtimi "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" më duket shumë më i gjerë, më i thellë dhe i qëllueshëm, meqë ky emërtim ofron mbështetje, mbrojtje dhe strehë të sigurt, sa e kam vështirë ta paramendoj ndokënd që do të hezitonte ta imitoj, respektivisht në një mënyrë apo tjetër ta identifikoj veten apo të kërkoj ngjashmëri për veprën e vet me veprën e një YLLI të PASHUAR të QIELLIT SHQIPTAR i cili e ka fituar LUFTËN E YJEVE.

Autori

***Adem Demaçi**: "Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur."*

PËRMBAJTJA

LOKOMOTIVA E LËVIZJES
JUSUF GËRVALLA NË VITIN 1980
"PROGRAMI I FRONTIT TË KUQ" i Ibrahim Kelmendit
PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR i Jusuf Gërvallës
JE I PASTËR SI LOTI
Ibrahim Kelmendi ka ardhur rastësisht
KËSHTU E PATA KUPTUAR Historinë e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Lëvizjes sonë në vitin 1980
1. Nuk do të anëtarësohem
-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkas qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim
2. Vuajmë
-1. Vuajmë nga mungesa
-2. Vuajmë nga teprica
3. Admirime
-1. Nuk duhet admiruar
-2. Duhet admiruar
4. Atentatet e mveshura
-1 FJALE PËR LIDHJEN FISNORE ME RAMË NIKQIN
-2. Ç'do të thotë fjala vojvodë?
-3. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?
-4. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan
-5. UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara

-6. Keqardhja për gjynahet e mveshura
-7. Profesioni i mësuesit dhe i pjesëtarit të shërbimeve sekrete
-8. Nuhi Sylejmani është njësoj si Riza Salihu

5. Rasti është mbreti i botës

-1. Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës
-2. Duke më provokuar të humb durimin
-3. Vazhdimi i gjendjes deri në festën e 28 Nëntorit 1980

6. Lajmëtari i lirisë

-1. Në këtë gjendje
-2. Porosia e Jusufit për Hysen Gegën
-3. Ilegale e botuar në Zvicër
-4. E pa definuar dhe e paidentifikuar

7. Gazeta "Bashkimi" dhe Fronti i Kuq

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkak qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Madje në gjendje të keqe
-4. M'u afrua e më ofroi bashkëpunim
-5. Kishte vendosur të mos kontribuonte
-6. Deri në sqarim dhe rikthim të marrëdhënieve të mëparshme
-7. Artikulli "Bashkimi bënë fuqinë" i Jusuf Gërvallës
-8. Me gjasë ky do të jetë numri i fundit i Bashkimit
-9. Nga ky numër gazeta jonë do të dalë rregullisht
-10. Me gjasë të lazdrova kur ta lavdërova
-11. Bakshishi për Jusufin

8. Keqkuptimet dhe bashkëjetesa familjare

-1. Hidhërimi i pakontrolluar
-2. Interesi i vazhdimit të bashkëjetesës familjare

9. Biseda pune

-1. Superioriteti i Luanit të inferioriteteve vandale
-2. Simpatizantët e Frontit e dinë se nuk jam i organizuar në Front
-3. Proletari dhe Xhahili
-4. Luani superior i inferioriteteve vandale është informator i UDB-së

10. Ibrahim Kelmendi në lëkurën e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës

Ibrahim Kelmendi në mes Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës
-1. Ke ndonjë lidhje në Turqi?
-2. Nuk po më paraqitet edhe pse e ka numrin e telefonit
-3. Mbase ke harruar
-4. Ti më kishe thënë se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë
-5. Një Zë që nuk tingëllonte aq bindës
-6. Vazhdonte ta fshihte dëshpërimin
-7. Porosinë ta kam përcjellë
-8. Po deshe ta siguroj adresën dhe telefonin e tij
-9. Do të më bëje nder
-10. Ndihej i zhgënjyer - do të zhgënjehesh siç janë zhgënjyer
-11. Intelektuali poliedrik dhe fisnikëria e vërtetë
-12. Ca shpjegime për udhëheqësin tënd
-13. Më ke folur për të si për një idhull
-14. Mos prit kot
-15. Për këtë organizatë nuk dihet gjë në Kosovë
-16. Me nënkuptim prej të pakënaquri
-17. Ka manipuluar me ty
-18. Është koha të vendosësh
-19. Të pengon të gjykosh drejt - Ai po të mban peng
-20. Ne jemi të bllokuar

11. Skenderi - kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

-1. Ka vënë kontakt pa e njohur ju atë përpara
-2. Ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

12. Jusuf Gërvalla si manipulues

-1. Hedhja e Nuhi Sylejmanit kundër Hysen Gegës
-2. Hedhja e Hysen Gegës kundër intelektualëve dhe fundi i "Frontit tonë"

Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore

1. Jusufi e Ibrahim Kelmendi u takuan menjëherë
2. Nuk do të bëjmë asgjë pa marrë kontakt me shokët e *Lirisë*
3. Më është dhënë adresa kontaktuese
4. Atëherë po shkoj që sot në Zvicër
5. Jusufi po hezitonte të merrte vendime
6. Ne vendosëm të mos e botojmë më *Bashkimin* pa e bashkuar organizimin tonë
7. Ti do të shkosh në Zvicër - tha Jusufi
8. Jusufi thotë se ti duhet të presësh
9. Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë
10. Jusufi më ka autorizuar ta përfaqësoj edhe atë
11. Është koha e fundit që ne të bashkohemi në një organizatë
12. Ti tani duhet të shkosh në Vjenë në Ambasadën Shqiptare

13. Skenderin e pengon afirmimi i babait dhe të birit
14. Një pjesë të madhe të kohës e kishte kaluar në shtëpi të Jusufit

Në KALANË e JUSUF GËRVALLËS

1. Je duke marrë postën me rregull?
2. I. Kelmendi shkoi te Jusufi e Bardhi
3. Vuajtjet për gazetën Bashkimi
4. Tek unë ishte policia - tha Jusufi
5. Nuriu ua ka bërë çorape rrethin tuaj
6. Shtëpia jote është bërë si të ishte stacion treni - tha Kadriu
7. Pjesërisht ke të drejtë – tha Jusufi
8. Në hierarkinë e UDB–së në Kosovë kemi njeriun që na informon
10. Tani unë po dyshoj në Skenderin
11. Ti Kadri nuk ke anëtarësuar askend
12. Nuk duhet të filloni me anëtarësime
13. Na duhet të ngutemi që t'i bashkojmë radhët në një organizim të vetëm
14. Nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë pasi e kemi shok
15. Bashkimi po vonohet
16. Jusufit nuk i erdhi mirë dhe u befasua nga sqarimi i Kadriut
17. Bisedimet për bashkim në parim i kemi bërë
18. Platforma e organizatës që do të dalë nga bashkimi ynë
19. Marrëveshja e bashkimit më 15 gusht 1981 në Habichthöhe
20. Jusufi e Kadriu radhisin tekstin e platformës finale për bashkim
21. Lëvizja do të përfaqësohet nga Sabri Novosella dhe Jusufi
22. Fronti e ka ngrirë organizimin
23. Ne jemi të autorizuar për ta konkretizuar bashkimin
24. Vazhdoj të të mos kuptoj por kurrsesi të të keqkuptoj
25. Më vjen keq që injoranti të luaj me intelektualizmin tënd
26. E kemi pa teklif e nuk mundem pa te
27. U ngritën në këmbë duke u përqafuar e uruar për bashkimin e arritur
28. Shtëpia që meremetohet

QARTËSIA E PERSPEKTIVËS SË EMËRTIMEVE TË PAPRANUESHME

1. Jusufi ka qenë i lidhur me ne
2. "Jusufin e ka edukuar ...."
3. Përmes ngjyrimit ideologjik të cilit i ka dalë boja
4. Bashkë me Jusufin kundër pushtetit komunist jugosllav
5. Kurrsesi nuk donte çfarëdo kompromisi me komunistët
6. Nuk janë të afërta as të pranueshme
7. Regjimi socialist po luftohej me socializëm
8. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste
9. Nuk u për-puthet ideologjia - E kujtoj atë takim
10. Krimet e kuqe

TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

K O M U N I K A T E

PROGRAMI I JUSUF GËRVALLËS

I shprehur

1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....
2. Në *Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Populllor*
3. Në gazetën *Bashkimi*
4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*
5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës
6. Në artikuj teorik ende të pabotuar
7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës
8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

KOMUNISTËT RUANIN ROLIN HEGJEMON

Relacioni i LËVIZJES së JUSUF GËRVALLËS dhe ORGANIZATËS MARKSISTE LENINISTE TË KOSOVËS (OMLK) gjatë periudhës prill-tetor të vitit 1981

1. Komunistët **RUANIN** rolin hegjemon
2. Tash së fundi jam në kontakt
2. Ka një mirëkuptim midis nesh
3. Ndërprerja e daljes së Lajmëtarit të lirisë
4. Menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit
5. Bashkëpunim apo ndihmë e njëanshme për OMLK-në
6. I kam dhënë vetes të drejtë
7. Dy degë të të njejtit trung
8. Ai ka një propozim konkret
9. Sugjerime nga instanca të rëndësishme
10. Titulli duhet ndërruar
11. Kur lindi Partia
12. Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa
13. Ndoshta pikërisht nga radhët e tyre
14. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë
15. Pse ke ardhur?
16. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?
17. As rastësisht nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur

18. Janë si buka prej një brumi
19. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste
20. Patentimi i formulës sekrete të lirisë dhe përralla e Crvenkapës
KJO NUK DO TË NDODHË KURRË
1. Kërkesa e Jusufit rreth Kongresit VIII të PPSH
2. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
3. Asnjëherë nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur
4. QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM
5. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË
6. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E TYRE
7. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi dhe Besniku
8. Unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime
9. Në numrin e parë të Zërit të Kosovës Jusufi e fajëson Kadriun
10 Koncert në Sindelfingen për Nëntorin e Jugosllavisë
11. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Höpfigheim
12. **Fjala e Jusuf Gërvallës në Stuttgart, në ditën e Flamurit, 28 Nëntor 1981**
13. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA
14. Mos u habitni nëse ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave
15. Jusufi e Kadriu fillojnë të anëtarësojnë në organizatat e veta
16. Kadriu i propozon anëtarësim Ibrahim Kelmendit por ai nuk pranoi
17. Jusufi nuk i bëri Ibrahim Kelmendit asnjë propozim
18. Bojkotimi i Zërit të Jusufit nga Kadri Zeka
19. Dasma e Kadri Zekës dhe Saime Isufit
20 Dy ftesa të Kadri Zekës
21. Ibrahim Kelmendi në mes Jusufit e Kadri Zekës
22. Dilemat e Jusufit
23. Thirr cilët të duash dhe pyeti vetë!
24. Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!
25. Rrobaqepësi anadollak po e manipulonte Jusufin
26. Të kam pasur krah të djathtë çdo herë dhe vazhdoj të të kem
27. Iu drejtua Jusufit me dashamirësi e dhembshuri
28. Lëvizja jonë e bashkimi ynë morën përmasa të mëdha
29. Të dëshiroj forcë që të mos thyhesh shpirtërisht e moralisht
30. Më ndihmoi të këndellem
31. Të kërkoj falje për shkrimin në gazetë
32. Së shpejti të gjithë do të përfshiheshin në Front
Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi
Abusus not tollit usum
Simultanka dhe shah-mati i Jusuf Gërvallës
Do ta sjellë shqiptarin në POTEZ për të zgjedhur
I. Kasparovi dhe Simultanka e Jusuf Gërvallës në vitin 1980
-1. Rregulla themelore të lojës së shahut
-2. Kasparovi për rëndësinë e figurave të bardha dhe të zeza
-3. Tabela e parë - Letër e hapur satrapit Josip Broz Tito
-4. Tabela e dytë - Letër renegatit Fadil Hoxha
-5. Tabela e tretë - Letër Enver Hoxhës
II. Shah - mati kundër UDB-së dhe TANJUG-ut në vitin 1981
-1. Drejt leximi dhe drejtshkrimi i bibliotekistit
-2. Internacionalizmi proletar i Frontit të Kuq
-3. Ma bëre shah-mat, - tha Jusufi duke qeshur
-4. GJITHSESI NUK TË KAM KEQKUPTUAR
-5. Jusuf Gërvalla si përkthyes i kulturës
-6. Rezignacioni i UDB-së dhe TANJUG-ut

NE TANI KEMI SHTYPIN TONË
I. ÇËSHTJE TË BRENDSHME
1. Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë
2. Kështu e pata kuptuar më në fund
3. Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë
4. Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna
5. Marku dhe Kola
6. Ndoshta mund të gjeni ndonjë shofer shqiptar nga Turqia
7. Me presionin dhe insistimin e Shpendit
8. Themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë
9. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"
II. ÇËSHTJE TË JASHTME
1. Pesë filma e drama shqiptare të shkëlqyeshme

2. Të përgëzoj për martesën
3. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë
4. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq
5. Lojë e pamirë me personin tim dhe Organizatën time
6. Ti mund dhe besoj se je i painformuar
7. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë
8. Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar
9. Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste
10. Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e **famshme** "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"
11. Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta
12. Po të nxori rruga këndej ndonjë ditë

NË QOFSH GJALLË

1. DARKA E FUNDIT
2. Po vijmë bash qysh kemi pas qejf
3. As njeri nuk besonte se do të kthehej ai
4. Të gjithë kanë qenë të një mendimi
5. MË NË FUND U MORËN VESH
6. VETË JUSUFI KISHTE KËRKUAR
7. TË MBAHEJ SI ARTIKULLUES I FUQISHËM ATDHETARIE
8. SIPAS TË GJITHA GJASAVE NË NATËN E VRASJES
9. TRI NGJARJE HISTORIKE PËR KOSOVËN
10. SIPAS DËSHMISË SË BASHKËVEPRIMTARIT TË TYRE
11. Ju kam thirrur që të rifillojmë bisedimet për bashkim
12. Jemi informuar se kush hyn e del te ti
13. NËSE BASHKOHEMI DO TË RREZIKOHEMI
14. Vendet tona t'i zënë njerëzit e saj
15. Vetëdija e Jusufit për peshën e punës së vet
16. Rrjedha e bisedimeve më 17 janar 1982 nga ora 03.00-05.00
17. TASHMË JEMI SQARUAR SE KUSH NA E BLLOKOI VENDIMIN TONË
18. Tani m'u duk momenti i duhur
19. E kishte njohur mjaftë mirë - Unë nuk e kam njohur
20. Të shkuara e të harruara, siç thotë populli
21. Gëzim i madh që propozimin po e bënte vetë Jusufi
22. E HARTOJMË VENDIMIN TË CILIN PROPOZOJ TA NËNSHKRUAJMË
23. TANI E TUTJE NUK JANË MË TEZA POR PROGRAM
24. Sy të mbushur me lot - Je i pastër si loti
25. Nuk e kishte plotësuar stazhin e kandidatit
26. ATENTATET BASHKË ME SHOKËT MA VRANË EDHE KËTË PROPOZIM
27. SI DUHET TË BASHKËPUNOJMË ASHTU SIÇ ISHTE BASHKËPUNUAR PËRPARA
28. MË DUKET NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE

TELEFONI NDODHEJ NË RRUGËN MATANË SHTËPISË

1. Telefoni nuk punon - Lëshoja telefonin
2. I kujt është faji?
3. Telefoni në rrugën matanë shtëpisë
4. Kujt i takon merita?

SI MË NJOFTOI UDB'a PËR VRASJEN E JUSUF GËRVALLËS?! AMANETI I JUSUF GËRVALLËS

1. A e pe vrasësin? - E pashë por nuk e njofta.
2. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Jusufit në orët e para pas atentatit
3. Interesimi i Peter Platzmanit
4. Siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë
5. Ishte njeriu të cilin me padurim po e prisnin
6. Udhëheqjen e organizatës e mori në mënyrë misterioze
7. Suzana ma prezantoi si "zëvendës" të Jusufit
8. Sirtari im
9. Skedari im
10. Që më se paku i shkonte një trashëgimtari të Jusufit
11. Që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit
12. Ishte përcaktuar t'i përmbahej hierarkisë organizative
13. Ne kemi marrë vendime me rëndësi
14. Të rrahurat e makinës së shkrimit dëgjoheshin përgjatë gjithë korridorit
15. Letra e Jusufit nuk ka përmbajtje aktuale
16. Midis jush nuk kam si hyj
17. Edhe më shumë neveriteshin
18. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha
19. Ajkuna e thërriste Miranin pranë saj
20. Ajo i merrte duart e Miranit në duart e saja

21. Varrimi i Yjeve të pashuara të qiellit shqiptar
22. Shkolla e UDB-së dhe amaneti i Jusufit
23. Varrim madhështor
24. Trajtimi i OMLK-së në shtëpinë e Jusufit
INSPEKTORI DHE NIPI
1. Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë
2. Sabri Novosella e përzgjodhi Nuhi Sylejmanin
3. Inferioriteti vandal i burrit të papërkulshëm
4. Ishte i angazhuar në përgatitjen e Zërit të Kosovës
5. Ai nuk përfillte askënd
6. Po ta dija se do të afirmohesha
7. Internacionalizmi proletar i udbashit "komunist" dhe hienat sllave
8. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla
9. E kemi dëshminë se si u bë trashëgimtarë
10. Uzurpuesit e zotshpillakut u imponuan si trashëgimtarë
BUJARI DHE BUJARIA E LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS
1. Udhëtim në Vjenë për t'u konsultuar me Ambasadën Shqiptare
2. Cicërimë më të ëmbël nuk kish
3. Bujar Hoxha dhe bujaria e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës
4. "Komunistët" nuk i dalin në takim njëri-tjetrit
5. Bazat teorike të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës për për-puthjen ideologjike me Partinë "Komuniste"
6. PËRDORIMI ME ZGJUARËSI I KËRBAÇIT
7. Sakrifica e Lëvizjes dhe Zërit të Jusuf Gërvallës për hir të Partisë "Komuniste"
8. Formimi i "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"
9. MBLEDHJA E KOMITETIT "VËLLEZËRIT GËRVALLA" MË 11 KORRIK 1982
10. OXHAKU I TIJ I LARTË, QË I MBETI NË KËMBË
RËNDËSIA E GODITJES SË PARË
Shkolla e UDB-së kundër Jusuf Gërvallës
1. Çështja e Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ
2. GJENEZA E EMRIT "ZËRI I KOSOVËS", SIPAS GJENAZEVE
3. GJENEZA E EMRIT "LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE VISEVE TJERA SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI" SIPAS GJENAZEVE
4. Jusufi nuk ishte mbret!
5. Propozimi për t'ia nisur nga zeroja
6. Nuk ishte pajtuar - Ishte pajtuar
7. Mohimi i Zërit të përgjakur nga gjaku i Jusufit dhe të të vrarëve
8. Shkrirja - Ngrirja dhe Shuarja totale e Partisë "Komuniste"
9. Vazhdimi i punës nga aty ku e kishte lënë Jusufi dhe vazhdimi i punës nga aty ku e kishte lënë UDB-a Serbe
10. Faqosja e Zërit të Jusufit sipas falsifikatorëve të pa faqe d.m.th. të pafytyrë
11. Shkolla e UDB-së si hotelieriste e pronare çelësash në Kështjellën e pamposhtur të Jusuf Gërvallës
12. Shkolla e UDB-së e shpëton familjen e Jusuf Gërvallës prej hamendjeve
PORTRETE FEMRASH
I Kurva, kurvarë dhe kurvërime
1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre
2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar
3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri
4. U tërbova duke i thënë kurvar
5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër
6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat
7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve
8. Shkrimtari harton fabula
9. Qenke njeri i poshtër
10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike
11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim
12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën
13. Që të mos flinin me gratë e tyre
14. Cipërcullakosje
15. Epitete
16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp
II Serbet e maskuara si kroate e boshnjake
III PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË
Shkolla e UDB-së Serbe si hetuese e Atentatit të 17 Janarit 1982
1. Qërim tipik hesapesh
2. Kush ka shfaqur dyshime?
3. Kush është I.K. (Ikaja)? - Derisa po çuditesha u çuditë ai me mua!
4. *KUSH E VRAU JUSUF GËRVALLËN?*
5. Dyshimi në Bulen më tronditi
6. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla
7. Zoti Gynter nuk më la të çuditesha!

8. Suzana i tha se më së miri do ta mbronte një avokat
9. Ujku e shikon Luanin e inferioriteteve vandale si prenë e tij
10. Na befasoi dhe krijoi të çara në mesin e familjeve të dëshmorëve
11. Dyshimet çorientuan mbarëvajtjen e hetimeve
12. Nga "dëshmitë" e Xhafer Durmishit u arrestua Riza Salihu
MVESHJET E MIRANIT DHE CIPËRCULLAKOSJET E MJERANËVE
1. E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës-nuk kam bërë denoncim
2. Shokë të veprave dhe jo fjalëve
3. Forumistët në www.kosova.de
4. Riza Salihu sajon
5. Blatuar hyjneshës së tij
6. I tillë është djali
7. I tillë është Babai
8. Qelepirxhinj e komunistë
9. Defektet e ndërgjegjes
10. Mik i autorit dhe njohës i shpirtit të tij
11. Vonesa e mbarë 25 vjeçare e njeriut të hazërxhevapeve
12. BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN TË TREMBË PËRHERË
13. Arkivi më i saktë është vetë populli
14. Unë do ta zbardhi rastin Gërvalla
15. Dimensioni i mendimit pozitiv
16. Koloseku i Frontit të Kuq
17. Sahati i Sinanit
18. Më ke gëzuar
19. Poema e Bedës - Shumë u gëzova që u gabova
20. Përgojuesit, lakmitarët dhe intrigantët
FLAKA E PASHUAR E LËVIZJES në Untergruppenbach
FAKTE rreth Lëvizjes së Jusuf Gërvallës Raporti Jusuf Gërvalla - Xhafer Durmishi
ZËRI I LËVIZJES DHE INFERIORITETI I PARTISË "KOMUNISTE"
1. Inferioriteti i "Luanit" të Partisë "Komuniste"
2. Partia "Komuniste" gjithmonë na e garanton nisjen prej zeros
3. Inferioriteti i Partisë "Komuniste"
4. Misioni i sekretarit të Partisë "Komuniste"
5. Definimi i rebelimit sipas "komunistëve" të Shkollës së UDB-së Serbe
6. Gjatë një kohe, kam qenë anëtar i vetëm një Organizate
7. Pse LNÇKVSHJ një muaj pas 17 shkurtit 1982?
8. Partia "Komuniste" kundër hienave sllave para proletariatit gjerman
MËSUESI DHE I BURGOSURI I PARË TË NISEMI PREJ ZEROS
1. Si mori kontakt me mua Xhafer Shatri?
2. Përjashtimi im nga Zvicra për periudhën 20 prill 1982 - 20 prill 1984
3. Prapa shpinës së Prapashticës
4. Nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti
5. Ndryshimi i emrit "Zëri i Kosovës" është shumë i nevojshëm
6. Tri kushtrime dhe ndikimi i kulloshtrës
Stilografat e Jusuf Gërvallës
BYTYÇËT E BOTËS
STILOGRAFA TË MBUSHUR ME QUMËSHT
1. Në banesë të Hakanit e Sarandës më 29 maj 1982
2. Organizime e vështirësi të verës 1982
3. Mbledhja po mbahej në banesë të Hakanit dhe Sarandës
4. Mos e shprush se i vjen era
5. Stilografa të mbushur me qumësht
6. Formimi i Qendrës Ekzekutive në Ludwigsburg
VËLLEZËR E SHOKË BURGJESH
1. Bartja e makinës së Jusufit në Gjenevë
2. "Pengesat teknike" të një telefoni
3. Mbledhja e parë e Qendrës Ekzekutive
4. Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve
5. Frymëmarrja artificiale e sindikatave të pa zemër
6. Kërkesa ime për dorëheqje nga Qendra Ekzekutive
7. Formimi i Bashkësisë së Klubeve
8. Vëllezër e shokë burgjesh
9. Mbledhja e parealizuar e natës së Vitit të Ri 1984
10. Formimi i Klubit "Isa Buletini" në Sindelfingen
11. Shkuarja ime nga Gjermania në Francë
12. Mbledhja në Gjenevë më 3 mars 1984

NË DUSSELDORF MË 7 PRILL 1984
DOKUMENTE RRETH MBRËMJES SË 7 PRILLIT 1984
I. Teknika e shkëputjes së mikrofonave
1. Xhafer Durmishi: Programi dhe Statuti i Bashkësisë së klubeve

2. Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve
3. Ibrahim Kelmendi: Pjesë nga Letra kryesisë së Lëvizjes për Republikë
4. Xhafer Durmishi: Letër delegatëve të Bashkësisë së Klubeve
5. Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve
6. Raport i komisionit të mbrëmjes së 7 prillit 1984
7. Letër e Bacalokut dërguar shokëve të Shtutgartit
8. Letër e Xhafer Shatrit dërguar Ibrahim Kelmendit
9. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet
10. Xhafer Shatri: Letër Qendrës Ekzekutive
11. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet
12. Pjesë nga letra e mbyllur e Xhafer Durmishit dërguar shokëve të Shtutgartit
13. Xhafer Durmishi: Tubimi i 7 prillit 1984 në Düsseldorf
II. Teknika e ngjitjes së mikrofonave
14. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" i vitit 1992
15. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" më 1992 dhe disa relacione me mbrëmjen e 7 prillit 1984
Deus ex machina
1. Thirrjen për takim e dua me shkrim
2. Dekonspirime pozitive dhe negative
3. *Zëri i Kosovës* në Suedi
4. Vendosja ime në Suedi
5. Distancimi i Sabri Novosellës nga "Zëri i Suedisë'
6. Deus ex machina
DISA VEPRIMTARI VAMPIRE
1. Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtaria e saj
2. Shkolla "komuniste" e UDB-së Serbe
-Përfaqësuesit e Partisë "Komuniste" (PKMLSHJ) në LRSSHJ
-SHOKËT E PARTISË "KOMUNISTE" NË LRSSHJ
3. LNÇKVSHJ-ja nuk do të bashkohet kurrë me platformën e LPRK-së
LËVIZJA E JUSUF GËRVALLËS dhe **SHTETI SHQIPTAR** 1979-1984
1. KUNDËRHELMI I HELMIT
2. Regjistrimi i Stazhit në Kafé Moska
3. Ai që hyn në lojë duhet lojën ta duroj
4. Në dobi të revolucionit e të socializmit
5. Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë
6.Takimet tek Tefiku
7. Puna e parë që bëra
8. Këshilla për Jusufin të diplomatëve shqiptarë në Vjenë
9. Jusuf Gërvalla dhe sugjerimet e ardhura nga atdheu
10. Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!
11. Ju keni ku merrni mendime
12. Sa mund të më ndihmoni ju së andejmi?
13. Porosia për Jusufin nga Kongresi VIII i PPSH
14. Formimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë
15. Kosovës po i vriten djemtë nga serbomëdhenjtë
16. Shkuarja në Vjenë për të gjetur ngushëllime
17. Tek Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982
18. Përcjellja e familjes së Jusufit në Shqipëri
19. Pritja e Familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri
20. Kërkesa për njohje dhe mosnjohja
21. E din serbët kend e lëshojnë nga burgu!
22. Refer të njëanshëm, dyanshëm apo neutral
23. Qëndrime të kosovarëve në Shqipëri
24. Nuk jam për ate që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët
- Ai që hynë në lojë duhet lojën ta duroj
25. Udhëzime inspiruese nga Ambasada Shqiptare në Vjenë
26. Propozime për ndërtim raportesh me Partinë e Punës së Shqipërisë
27. PPSH dhe organizatat e majta të Kosovës
28. Hoxha engjëjt dhe xharrahët
Shkurtesat
Lista e burimeve
Literaturë tjetër për Jusuf Gërvallën

Faridin Tafallari: "*Jusufi kur fliste për shokët e vet, i ngrinte ata shumë dhe për veten e vetë fliste shumë i përmbajtur. Shumë herë në të tilla*

momente, e kam kundërshtuar duke i thënë: ***"Ne derisa të kemi ty, nuk po na lypen të tjerë."*** *Por ai ngulte këmbë në mendimin e vet, duke lartësuar shokët e vet në Kosovë." (Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 28)*

'Vdekja e ndërpret një jetë por jo një relacion.'

Jusuf Gërvalla: *"E kujtoi Troshin e ndjerë, të cilin e mbuluan një orë e më parë, para se të errej. Dhe kërthirin e vet atje lart në qiler.* ***Zëri që sapo ishte shuar dhe tjetri sapo i ishte qepur qiellit të ulët e të zi të asaj mbrëmjeje, kishin sjellë një mbushullimë të re, që Keta s'ia kishte ndier turrin më parë.*** *Tani rrinte si dru te cungu i drurëve dhe s'dinte ç'të bënte me duart, me trupin e vet. Pas një çasti të shkurtër, ai do të merrte sëpatën e batallisur me mote, do ta mprehte sa t'i shkëlqenin në reflekset e borës të dy anët e tehut.*

Pastaj iu afrua gardhit, e ngriti me rrëmbim në ajër sëpatën... "

LOKOMOTIVA E LËVIZJES

Jusuf Gërvalla: "*Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.*

(...) Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina (Sabri Novosella - shën i Xh. D.), qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata.

(...) Bardhi s'kishte sjellë me vete ndonjë dokument të vyer për mua, mirëpo, me ardhjen e tij, unë u çlirova shumë. Para dreke bëmë ca plane, më në fund vendosëm që për Austri të ikja më këmbë, nëpër tunelin që shpie nga Hrushica (4-5 km larg Jesenice) deri në Rosenbah të Austrisë.

Në orën 17,30 u ndalëm me veturë në rrugën automobilistike të Hrushicës, 30-40 km nga tuneli. U nisa. Bardhin e porosita që po s'iu ktheva për 10 minuta, të nisej edhe ai me veturë për në Austri, nëpër kalesën kufitare në Podkoren të Kranjska Gorës. Afër

hyrjes në tunel, pasi përgjova mirë e s'diktova njeri ndër oborret e ndër shtëpitë pranë, m'u ndërsye një qen. Ia lëshova dritën e baterisë së dorës dhe hyra me vrap në tunel.

Tunelin, 8100 m, e kalova, së paku 70% të gjatësisë, me vrap. Ishte aksioni im i parë në jetë në të cilin kisha hyrë me rrezik 100% që ose të shpëtoj, ose të bie në burg, ose, madje, edhe të vritem." (Jusuf Gërvalla, Vepra -vëllimi 4, Prishtinë 2010, f.245-247)

Jusuf Gërvalla, lokomotiva e qëndresës shqiptare, ka kaluar nëpër këtë tunel të trenit - për në Austri

TUNELI I KARAVANKEVE

Në ditarin e tij - Jusuf Gërvalla thotë se ka kaluar nëpër tunelin e Karavankeve, që lidhë Sllovenínë me Austrinë. Tuneli i Karavankeve (gjermanisht: Karawankentunnel, sllovenisht: Predor Karavanke**)** është tuneli i katërt për nga gjatësia i Austrisë dhe më i gjati i Sllovenisë me një gjatësi prej 7976 m. Rruga hekurudhore kalon në mes Rosenbachut në Austrinë jugore dhe Jesenicës në Sllovenínë veriore. Tuneli është pjesë e rëndësishme e Hekurudhës të Karavankeve, e cila së bashku me Hekurudhën e Bohinjit është ndërtuar që të lidhë portin e Trieshtës me Klagenfurtin, kryeqytetin federal të Carinthia në Austri.

Në mes viteve 1867-1918, Trieshta ka qenë pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze. Ajo (Trieshta) ka qenë porti kryesor për tregti tej oqeanike i mbretërisë së dyfishtë, por i mungonte lidhja adekuate e komunikacionit me Austrinë e brendshme. Për t'i dhënë një shtytje tregtisë së Trieshtës dhe Austrisë në përgjithësi, më 1901 vendoset të ndërtohet Hekurudha e Karavankeve e cila do të lidhte Trieshtën me Klagenfurtin. Hekurudha ndërtohet përmes Alpeve Karavanke, më e gjata hekurudhë malore në Evropë (120 km) në kufirin e sotshëm të Austrisë dhe Sllovenisë.

Tuneli i Karavankeve është inauguruar në 1 tetor 1906, nga Kryeprinci Franc Ferdinand, pra më 1 tetor, në ditën e cila në kalendarin shqiptar njihet si dita, kur Jusuf Gërvalla në 1 tetorin e vitit 1945 lindi në fshatin Dubovik të komunës së Deçanit.

Tuneli edhe sot ka rëndësi në qarkullimin e trenave ndërkombëtar. Nëpër te kalojnë më shumë se 80 trena në ditë.

Tuneli hekurudhor i Karavankeve nga bota do të vazhdoj të quhet Tuneli i Karavankeve, por për popullin shqiptar ky Tunel ka një simbolikë më të fuqishme se sa ajo që ka të bëj me tregtinë. Ky Tunel ia zgjati jetën Jusuf Gërvallës për 25 muaj rresht, deri në vrasjen e tij më 17 janar 1982, dhe gjatë kësaj kohe Jusufi me bashkëveprimtarët e tij veproi pa u lodhur në mobilizimin e shqiptarëve në shtetet perëndimore për çlirimin e Kosovës së robëruar si dhe shkroi Programin kombëtar, dhe atë program e nisi për Kosovë përmes shokëve të tij, të cilët kaluan shumë herë pikërisht nëpër këtë tunel të shpëtimit.

http://www.youtube.com/watch?v=Aj6J4WXQGSo&feature=related

Në videolinkun e mësipërm i cili është 9,59 minuta, nga minuta 3,14-3,50 është tuneli i Karavankeve, ashtu edhe si gjithë rruga, e parë nga perspektiva e drejtuesit të lokomotivës, nëpër të cilin ka kaluar **Jusuf Gërvalla, LOKOMOTIVA E QËNDRESËS SHQIPTARE** më 1980 dhe 1981.

JUSUF GËRVALLA NË VITIN 1980

Ibrahim Kelmendi ia tregon Hysen Gegës historinë e formimit dhe pagëzimit të "Frontit të Kuq" respektivisht "Frontit të Kuq Popullor"

I. Kelmendi: *"- Organizimi ynë fillimisht, në shtator të viti 1978, zuri fill si tepër konspirativ. Tubimin themelues e mbajtëm në dhomën time në konvikt. Ndërkohë e shndërruam në organizim popullor, siç do ta karakterizoja. Ishim katër veta kur themeluam* ***Frontin e Kuq Popullor.***

Kështu duket koka e Bashkimit nga vera 1979 si Organ i Frontit të Kuq (pa mbaresën "Populor")

*Miratuam **Program e Statut**. Asnjëri nga ne nuk e njihte anën teorike të këtij organizimi, **prandaj unë e luta një profesor gjerman** që të na ndihmonte për përpilimin e këtyre materialeve."(Atentatet, f.39)*

***I. Kelmendi**: "Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar **Xhavitin**, meqë për te krijova përshtypje se **ishte informator i UDB-së**, i urdhëruar për t'u anëtarësuar në PKGj/M-L, që të informonte për veprimtarinë e kësaj partie komuniste sigurimet e fshehta jugosllave dhe gjermane. Kurse për Proletarin formova përshtypjen se ishte një dogmat primitiv." f.40*

*"Meqë u përcaktova për organizim ndryshe, siç ta thashë, një si organizim popullor, u interesova të gjejë bashkatdhetarë patriotë, të cilët do të ndihmonin për nxjerrjen e gazetës Bashkimi. Këta të interesuar duhej se pari të mësonin që të lexonin, meqë ishin **gjysmanalfabetë**. Doemos duhej një ngritje për organizim më vonë.*

Nëse nuk je mërzitur, po të tregoj edhe gjëra të tjera.

- Të lutem, vazhdoje!-u përgjigj Vasili me një përqendrimin maksimal për të dëgjuar.

- ... sa për emërtimin, në tubimin themelues, unë pata propozuar ta quanim "Fronti Popullor Demokratik", meqë më pëlqente emërtimi i përafërt i organizimit të masave në Republikën e Shqipërisë, i cili, siç e di edhe ti, quhet Fronti Demokratik.

Unë i shtova "popullor" vetëm sa për të bërë dallim me atë emërtim." (Atentatet, f.41)

Xhahili (Xhaviti), informatori i UDB-së propozon emërtimin "Fronti i Kuq"

*I. Kelmendi:" **Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion",** etj. Proletari propozonte ta quanim "Partia Komuniste e Kosovës /Marksiste-Leniniste", duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. Isa ishte çdo herë për ato që thosha unë, meqë thuaja përditë pas pune vinte tek unë për të kaluar kohën e lirë. Kur votuam ishim dy me dy. Meqë Proletari hoqi dorë nga propozimi i tij dhe përkrahu propozimin e Xhahilit, duke ia shtuar atij mbiemrin 'populor'.*

*Për të fituar varianti i tyre, Proletari përdori demagogjinë, duke thënë se ju intelektualët nënçmoni proletariatin. Them demagogjinë, sepse më drejtohej mua, e unë isha vetëm një student. Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë **avullnetshëm** u dakordova me propozimin e tyre. **Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues." (**Atentatet , f.41-42)*

Është interesant si e shpjegon Ibrahim Kelmendi historinë, gjenezën e organizatës së vetë. Sipas Ibrahimit, në mbledhjen themeluese ka qenë e pranishme UDB-a, përmes Xhahilit (Xhavitit), dhe është UDB-a, ajo që (përmes Xhavitit) e ka pagëzuar (ia ka ngjitë emrin) "Fronti i Kuq", ndërsa Proletari, një dogmat primitiv apo Ibrahim Kelmendi ia kanë dhënë mbaresën "Populor". Pra që në mbledhjen themeluese organizata e Ibrahim Kelmendit ka marrë emrin tepër bombastik dhe tepër provokues "Fronti i Kuq Populor".

Për Një Shqipëri Socialiste të të gjithë shqiptarëve!

Bashkimi

ORGANI I FRONTIT TE KUQ

Letër e hapur satrapit J. B. TITO

Kështu duket koka e numrit të dytë ë gazetës Bashkimi, nga fillimi i shkurtit 1980, si Organ i Frontit të Kuq (pa mbaresën "Populllor") i përgatitur nga Jusuf Gërvalla. Risia në kokën e gazetës është se Jusufi mbi titullin Bashkimi e vendosë parullën "Për një Shqipëri Socialiste të të gjithë shqiptarëve!"

Jusufi, si anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), pas konsultimit me *Bashkim Prishtinën* (Sabri Novosellën) arratiset nga Kosova më 14 dhjetor dhe mbërrin në Ludwigsburg, pas një jave, më 21 dhjetor 1979. Nuk vonon shumë dhe Ibrahim Kelmendi merr vesh për arratisjen e Jusufit. Ai (I. Kelmendi) i ofron bashkëpunim Jusufit dhe "**shpreson se Jusufi do të pranoj**" të merret, me përgatitjen e gazetës Bashkimi. Jusufi pranon që me mundin dhe dijeninë e tij ta bëjë të mundshme daljen e gazetës Bashkimi. Jusuf Gërvalla e gjen gazetën Bashkimi, si Organ të Frontit të Kuq. Ai (Jusufi) nuk e din atë që e di I. Kelmendi, se emri "Fronti i Kuq" është i zgjedhur nga UDB-a, "*përmes dikujt*" apo **pa kurrfarë ndërmjetësi**. Pa ia ndryshuar emrin, por vetëm duke ia shtuar një parullë ("Për një Shqipëri Socialiste të të gjithë shqiptarëve!"), Jusufi e përgatitë numrin e dytë të Bashkimit.

Tri ditë pas arritjes së Jusufit në Ludwigsburg, më 24 dhjetor 1979 Bashkimi Sovjetik ndërhyn ushtarakisht në Afganistan. Pas një kohe gazeta shqiptare "Zëri i Populllit" shkruan një artikull kundër invadimit të Afganistanit, ku në mes tjerash thuhet diçka në stilin: Nëse Bashkimi Sovjetik e sulmon Jugosllavinë ashtu siç ka bërë me Afganistanin, populli shqiptar së bashku me popujt jugosllav do të luftojnë kundër agresorit. Pas daljes së numrit të numrit të dytë të Bashkimit nga shtypi (të parit të përgatitur nga Jusufi), në klubin Emin Duraku në Dussledorf, bëhet një fushatë kundër Shqipërisë, me një arsyetim, që i përmbledhur mund të shprehet kështu: Shqipëria na tradhtoi e u mashtrua nga jugosllavët gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe të njëjtin gabim, të njëjtën gjë është e gatshme ta përsëritë prapë. Jusufi thirret në Dusseldorf për ta sqaruar artikullin e "Zërit të Populllit".

Si pasojë e kësaj rruge Jusufi, kah fundi i shkurtit shkruan kryeartikullin "Zëri i Populllit - zë i të gjithë shqiptarëve" që botohet në numrin vijues të Bashkimit, në prill 1980. E kësaj kohe është edhe kjo letër që Jusufi ia dërgon Ibrahim Kelmendit, prej të cilës është marrë ky citat:

Për Një Shqipëri Socialiste të të gjithë shqiptarëve!

Bashkimi

ORGANI I FRONTIT TE KUQ

ERIPOPULLIT — ZË I TË

Kështu duket koka e numrit të tretë të gazetës Bashkimi, të përgatitur nga Jusuf Gërvalla, nga prilli i vitit 1980, si Organ i Frontit të Kuq (pa mbaresën "Populor").

Jusuf Gërvalla: *"Jam mirënjohës që të bie ndër mend edhe të më shkruash letër. Unë sa për letra jam shumë dembel. Mirëpo, në letrën e fundit ti kërkon ndonjë mendim prej meje lidhur me vargjet që ke shkruar. Prandaj, më duhet të të përgjigjem pa tjetër. S'ka dyshim se, sikur të mos kisha diktuar tek ti një shpirt që energjinë e vet mund ta zbrazë* ***për së mbari*** *duke shkruar vargje (kjo është një nga mënyrat më fisnike të shfrytëzimit të energjisë së njeriut në përgjithësi), do t'i bija shkurt dhe të të thosha të mos lodhesh më. Po realiteti, fatbardhësisht, po flet ndryshe: me një përkushtim më të madh dhe me konsultim pak më të ngulmët edhe të teorisë së artit, për sa kam arritur unë të vërej, ti mund të na dhurosh vjersha shumë të qëlluara.*

Ja se, pse i zura ngoje angazhimin më të madh dhe konsultimin e teorisë.

Së pari, në art, gjatë procesit të krijimit, është e domosdoshme që, pos të tjerash, të kemi një besim të madh në vete dhe një bindje të fortë, një sugjestion se jemi duke bërë punë shumë fisnike. Më duket se ti kemi diçka tjetër: një provë që, krahas punëve të tjera, të merresh edhe me diçka joserioze! Ky është një mëkat ndaj artit dhe deri sa të mbash qëndrim të tillë ndaj tij, edhe ai do të mbajë qëndrim adekuat ndaj teje, do të të përbuzë, dhe kështu mendimi i vërtetë artistik kurrë nuk do të zhveshet i tëri përpara teje në gjithë bukurinë e vet të fuqishme." (Letër Ibrahim Kelmendit, rreth prillit 1980. Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 280-281)

RRETH PROGRAMIT E STATUTIT TË FRONTIT TË KUQ POPULLOR

Ibrahim Kelmendi: *"- Organizimi ynë fillimisht, në shtator të viti 1978, zuri fill si tepër konspirativ. Tubimin themelues e mbajtëm në dhomën time në konvikt. Ndërkohë e shndërruam në organizim populor, siç do ta karakterizoja. Ishim katër veta kur themeluam Frontin e Kuq Populor.* ***Miratuam Program e Statut****. Asnjëri nga ne nuk e njihte anën teorike të këtij organizimi,* ***prandaj unë e luta një profesor gjerman*** *që të na ndihmonte për përpilimin e këtyre materialeve."(Atentatet, f.39)*

Ibrahim Kelmendi: "Shokë!

Mendojmë se kaloi një kohë e mjaftuar që kur morët në duart tuaja Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Populor *me material përcjellës. Ai që ka dashur ka mundur të vendosë nëse është dakord që të jetë i organizuar në radhët e Frontit. Dhe ende nuk është hasur në të atillë që nuk janë të gatshëm të japin kontributin e tyre në radhët e Frontit, pasi kanë studiuar programin e punës dhe Statutin."* (*Letër dërguar Faridin Tafallarit* ***më 4 qershor 1980****. Marrë nga Faridin Tafallari, Dhimbje krenare,*

1998 Tiranë, f.154)

Letra e I. Kelmendit, e datës **4 qershor 1980** është dokumenti i parë që flet për ekzistencën e Programit dhe Statutit të Frontit të Kuq Populllor. Është dokumenti i parë që Ibrahim Kelmendi përmend emrin "Fronti i Kuq Populllor".



PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLLOR

LOGOJA - ME PUSHKË E PENË

Kështu duket kopertina e Programit të Frontit të Kuq Populllor, i shkruar nga Jusuf Gërvalla në maj të vitit 1980. Për herë të parë emrit Fronti i Kuq, nga Jusufi, respektivisht në këtë dokument të përgatitur tërësisht nga Jusufi, i shtohet mbaresa Populllor. Pas shkrimit të këtij Programi, për shkak të dyshimeve të veta në Ibrahim Kelmendin, Jusufi nuk ka kurrfarë angazhimi në Frontin e Kuq Populllor deri në muajin nëntor 1980.

E kësaj kohe është ngjarja e hidhur e një takimi të Jusufit me Riza Salihun në Shtutgart. Xhafer Durmishi: "*Në fillim të vitit 1980 në Kosovë ka qarkulluar një fletushkë e "Grupi komunist Zëri i Kosovës" që është nxjerrë nga Riza Salihu në Shtutgart. Në verën e vitit 1980 Sabri Novosella lajmërohet në Stamboll për fletushkën e Grupit Komunist "Zëri i Kosovës" për çka ai dëshiron t'i sigurohet shpejt një kopje që ta dërgoj në konsullatën shqiptare të Stambollit dhe t'ua dëshmojë atyre tetekëve se shokët e Sabrisë dhe Komiteti Qendror me Kryetarin e vetë nuk hanë bukë badihava. Po në verën e 1980 Jusuf Gërvalla takohet me Riza Salihun. Në bisedë e sipër Rizahu e pyet Jusufin se çfarë organi nxjerr organiza-ta e juaj. Kur Jusufi i përgjigjet se organ i LNÇKVSHJ është "Zëri i Kosovës", Riza Salihu dëshpërohet e revoltohet shumë dhe e prishë bisedën me Jusufin. Më vonë kur Jusufi merr kontakt me Sabriun, në një ndër letrat e para i thotë se emri "Zëri i Kosovës" nuk është i përshtatshëm për organizatën tonë pasi të njëjtin emër e përdorë Riza Salihu për grupin e tij."* (*Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985, maj 1992, www.pashtriku.org*)

Riza Salihu, pas bisedës me Jusufin, ia shpreh inatin e vetë në mënyrën e vetë Hysen Gegës. Hysen Gega, shok i Riza Salihut, por edhe i Ibrahim Kelmendit, me të cilin në verën e vitit 1979 ilegalisht, në Pejë, e kanë takuar veprimtarin e njohur Nezir Gashin, thotë se është i gatshëm me krye detyrën, vrasjen e Jusufit e Bardhoshit, por kurrsesi pa e takuar Jusufin. Jusufi nuk ka qenë njeri paranoid që e ka ekzagjeruar rëndësinë e punës së tij, apo rrezikimit të tij. Se kjo punë nuk ka qenë punë mahie e ka dëshmuar vetë Jusufi. Hysen Gega me iniciativën e vetë takohet me Jusufin, dhe që në takimin e parë personal, pa praninë e askujt tjetër ia tregon të vërtetën Jusufit. Pas atij takimi, raporti i Jusufit me Hysen Gegën është i përjetësuar në shkrimet e Jusufit në letra dhe në

Lajmëtarin e lirisë. Shpifjet dhe insinuatat kundër Hysen Gegës janë pesha që do të rëndoj mbi ata të cilët janë marrë e ushqyer me to për vite e dekada. Në pranverë të këtij viti, në kohën kur lufta shantazhuese kundër Jusufit në Shtutgart intensifikohet përmes provokatorëve të UDB-së, të cilët kurdisnin edhe atentate e kërcënime të ndryshme, duke shpresuar se Jusufi do të izolohet, më **4 qershor 1980**, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (në bazë të aktakuzës PP.nr.180/79 datë 9 maj 1980**)** në ”emër të popullit” i dënoi tetë anëtarë të **Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ)**.

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË
P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980:
"*Prandaj gjykata në bazë të neneve të lartcituara si dhe neneve 5, 33, 38, 41 dhe 50 të LPJ si dhe nenit 351 të LPP i*

GJ Y K O N

Të akuzuarin Shefqet Jasharin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vjetësh.
Të akuzuarin Ramadan Pllanën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh.
Të akuzuarin Avdi Kelmendin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh.
Të akuzuarin Avdyl Lahun me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Skender Jasharin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh.
Të akuzuarin Isa Demaj me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Sylejman Qyqallën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.
Të akuzuarin Hysen Gërvallën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh."

Atmosferën e asaj kohe e shohim shumë mirë edhe në letrën e Ibrahim Kelmendit dërguar Faridin Tafallarit më **4 qershor 1980**, pikërisht në ditën e gjykimit të anëtarëve të Lëvizjes-LNÇKVSHJ.

*I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit**, 4 qershor 1980**; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)*

Çka tregon letra e mësipërme?

Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet.

Ibrahim Kelmendi shpreson se rasti me Riza Salihun do ta frikësoj, pa e kuptuar përkrahjen e besimin e paluhatshëm që ia jep Hysen Gega - Jusufit, qysh në takimin e parë. *ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete*

Fjalia e mësipërme tregon se edhe përkundër faktit se Jusufi i nxjerr dy numra të Bashkimit, e shkruan Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor, me asnjë fjalë të vetme nuk i tregon Ibrahim Kelmendit se a është i organizuar në ndonjë organizatë apo jo, e lere më të bisedoj për ndonjë person të rëndësishëm apo më pak të rëndësishëm të saj. Fjalia e mësipërme e I. Kelmendit rrezaton dyshime e pasiguri ashtu siç rrezaton qartësi e vendosmëri çdo fjalë e shkruar nga Jusufi. Citati i mësipërm është krejtësisht i mjaftueshëm për të hetuar dhe rrënuar të gjitha gënjeshtrat e falsifikimet e gjysmës së librit Atentatet. *I. Kelmendi: ”Kjo gjendje vazhdoi derisa Jusufi e Mirani u takuan në festën e 28 Nëntorit, në Nürnberg. Në manifestim Jusufi bëri një diskutim, jo fjalim, por shumë përmbajtësor. Që të dy kishin presion nga Vasili e Maksi për të rivendosur*

bashkëpunimin. Ata me të dy mbanin lidhje dhe iu bënin përherë lutje që të pajtoheshin e të bashkëvepronin." (Atentatet, f.174-175)

Pikërisht në këtë ditë, (më **4 qershor 1980**) Jusuf Gërvalla kishte nisur përgatitjet për botimin e "Lajmëtarit të lirisë", një revistë Kombëtare që solli, shpresë, guxim e vetëbesim tek shqiptarët në mërgim dhe në gjithë etnikumin kombëtar në ish-Jugosllavi.

Kadri Rexha: *"Gjatë kësaj kohe, pra në muajt e parë të vitit 1980, në jetën politike të Jusuf Gërvallës hyn edhe një ngjarje tjetër shumë me rëndësi, e cila në*

aktivitetin e tij të palodhshëm do t'ia plotësojë një boshllëk, do ta angazhojë edhe më tepër, sidomos kur të kihet parasysh se në mes Jusuf Gërvallës dhe organizatës së tij LNÇKVSHJ ende nuk ishin vënë kontaktet e pritura. ***Ismail Haradinaj****, arsimtar i edukatës fizike, nga fshati Glloxhan, KK i Deçanit, përndryshe burrë i ndershëm nga një derë e njohur për tradita të larta patriotike, me anë të një letre, të cilën ia dërgon përmes një studenti, e njofton Jusuf Gërvallën se në rrethin e Deçanit ekziston një grup patriotik revolucionar mjaft aktiv. Ai përmes letrës shpreh gatishmërinë e vet dhe të shokëve të tij për luftë të pakompromis për atdhe. Prandaj, në mes tjerash, e lut Jusufin që të jetë në kontakt të vazhdueshëm me ta, në mënyrë që t'u gjendet sa më pranë me këshilla dhe udhëzime. Kësaj lutje dhe kërkesave që i erdhën nga ky grup, Jusuf Gërvalla u përgjigjet pozitivisht dhe menjëherë fillon nga puna. Sa për fillim ai atyre ua ofron Statutin, materialet e LNÇKVSHJ dhe mënyrën e organizimit të saj, të cilat ata i pranojnë me entuziazëm të madh. Pas përqafimit të Statutit, ky grup, më parë gjysmë i organizuar, i riorganizon radhët e veta dhe fillon një aktivitet me hov të ri. Tash e tutje ky krah i ri i LNÇKVSHJ do të quhet 'Komiteti i Deçanit' dhe pothuajse të gjitha territoret e Rrafshit të Dukagjinit si dhe Universiteti i Prishtinës pikërisht nga kjo degë do të mbulohen me trakte, si dhe me materiale të tjera patriotike. Nga puna dhe aktiviteti i suksesshëm i këtij krahu, Jusuf Gërvalla do të marrë impulse të reja, edhe pse me vështirësi të mëdha materiale dhe pa bashkëpunëtorë, do t'i hyjë punës individualisht dhe gjatë verës së atij viti do të fillojë me nxjerrjen e revistës së përdymuajshme 'Lajmëtari i lirisë'."* (*Fati i luleve, Prishtinë, 1993, f. 162*)

Kadri Rexha: *"Në burg kam rënë me 22 shkurt 1982, në valën e burgosjes së intelektualëve shqiptarë. Duke lënë përshtypjen e përgjithshme se me çdo kusht po kërkonte të zbulonte folenë e shtabit të "kundërrevolucionit dhe të irredentizmit shqiptar", UDB-a, respektivisht Serbia, asokohe po fillonte fushatën e egër inkuizicionale kundër inteligjencës shqiptare, fushatë kjo që do të rezultojë deri në mbylljen edhe të shkollës së fundit në gjuhën shqipe në Kosovë. Në aktakuzën që na e ngriti UDB-a figuronim tre persona. Unë akuzohesha për shpërndarje dhe ruajtje të materialit propagandistik antijugosllav, për lidhje me emigracionin politik shqiptar dhe për takimin tim me Jusuf Gërvallën në gusht të vitit 1980. Ndonëse nuk kemi qenë grup i mirëfilltë i formuar me betime e me grushta të ngritur, veprimtarinë e kemi zhvilluar*

në kuadër të grupit. Si tresh edhe na dënuan me burg: mua me 3 vjet, Dr. Muhamet Tërnavën me 2 vjet, ndërsa Dr. Shaqir Shaqirin me 1 vit e gjysmë. Vlen të theksohet këtu se vetëm në saje të qëndresës së Nazmi Selmanaj dhe të Islam Mustafaj kemi shpëtuar të mos lidhemi me Komitetin e Deçanit, njërën ndër degët më aktive të LNÇKVSHJ-së, ku do të merrnim dënime shumë më të larta. Por edhe kësi soji kjo ishte një hakmarrje ndaj miqve të Jusuf Gërvallës dhe një kërcënim paralajmërues kundër inteligjencës së pambrojtur shqiptare." (Qëndresa 8/9-janar/shkurt 1994, f. 14)

Në gusht 1980 del numri i parë i Lajmëtarit të lirisë.

Diku në këtë kohë, Riza Salihu, përmes metodave të tij, dhe padjallëzisë së punëtorëve të Postës Gjermane, regjistron disa emra personash, posta e të cilëve duhet t'u vij në një (apo disa) kutia postale (Postfach) në qendër të Shtutgartit. Në këtë mënyrë ai vjen në posedim të dërgesave postale të Jusuf Gërvallës. Në këtë ngjarje palë e dëmtuar na del edhe Ibrahim Kelmendi. Riza Salihu, ashtu siç më ka tregua Jusufi, e paguan kuti të vogël apo mesatare postale. Në te vijnë paketa e libra e dërgesa të ndryshme. Pas disa ditësh, në Kutinë postale (Postfachun) e Rizahut vijnë dërgesa më shumë se sa ajo i zenë. Kur e njëjta gjë përsëritet disa herë, punëtorët e postës dyshojnë dhe e kontaktojnë policinë. Policia e heton këtë rast, dhe ia bënë një pyetje direkte Jusufit:

Policia gjermane: *A mundeni me thënë se ai këtë punë e ka bërë si agjent jugosllav, a mund ta akuzosh ti për këtë punë?*

Jusuf Gërvalla: *Jo nuk mundem. Për këtë punë që e ka bërë nuk mund ta akuzoj se e ka bërë i nxitur nga shteti jugosllav!*

Interesante është letra e Ibrahim Kelmendit dërguar Jusufit për këtë punë.

I. Kelmendi: "Do të kishte qenë mirë të më ndihmoni, pasi jeni më afër ngjarjes, për rastin e arrogantit Rizah. Sigurisht që Bardhi ka mundur të mësoj më shumë gjëra se unë, pasi unë pos çfarë më thanë të KRIPO-s, nuk di tjetër. Një gjë di se jam i revoltuar shumë me Rizahun për konfiskimin e postës që më ka bërë. Është kjo vepër prej udbashi. I poshtri! Sigurisht që më ka munguar posta. Për këtë kam bërë sa herë fjalë me udhëheqësit e konviktit." (Letër Jusuf Gërvallës, ***16 shtator 1980****, botuar në: Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 117)*

(Çështjet rreth Riza Salihut janë të shpjeguara tërësisht nga vet Jusufi në një Raport të korrikut 1981 dhe gjenden në kapitullin "Në Kalanë e Jusuf Gërvallës". Kur unë e kam përgatitë këtë punim për www.pashtriku.org, Raportin e Jusufit të korrikut 1981 nuk e kam pasur.)

Në tetor 1980 përgatitet numri i dytë i Lajmëtarit të lirisë.

Në fund të tetorit apo në fillim të nëntorit Jusuf Gërvalla i përgjigjet në këtë formë ofendimit më të madh të Ibrahim Kelmendit.

Jusuf Gërvalla: "*E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde)* ***ç'mundime*** *(e* ***vuajtje****-shën ynë) ke pasur të më shkruash në "nivelin" tim, sikur thua se vetëm në "nivelin" tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?!* ***Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit!*** *(Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)* (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980, Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 282)

Gjatë një ndeje me Jusufin, Hysen Gega dhe shokët e Shtutgartit, në bisedë e sipër në

kohën kur bëhet planifikimi i organizimit të festës së 28 Nëntorit 1980, ia kërkojnë Jusufit një dramë. Jusufi, i gatshëm si çdo herë për t'iu dalë në përgjigje bashkëluftëtarëve të vet, ulet dhe brenda tri-katër ditësh e kryen këtë punë. E përfundon dramën "PROCESI" që e ka si **personazh kryesor** Sabri Novosellën, shokët e tij dhe gjeneratën e tij. Në këtë dramë përshkruhet qëndrimi superior i Sabri Novosellës dhe shokëve të tij në burgjet e UDB-së Serbe. Në mesin e **aktorëve** të kësaj drame është edhe Nuhi Sylejmani, luftëtari i pathyeshëm dhe më superior në rrethin e Jusufit. Rrethanat do të sillen më vonë që Nuhi Sylejmani, Luani superior, në mënyrë të mahnitshme e njofton Dezertorin apo Dordolecin superior të UDB-së Serbe dhe Vëzhguesin superior të Dezertorit të UDB-së Serbe, se ai ka qenë i angazhuar në dramën kushtuar Sabri Novosellës dhe superioritetit të tij në burgjet e UDB-së. Edhe më mahnitëse do të del tabloja apo skena, kur Dezertori apo Dordoleci i UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica dhe Vëzhguesi superior i Dordolecit të UDB-së Serbe, Osman Osmani, do ta njoftojnë Luanin e tyre superior, se si edhe ata janë takuar me Sabri Novosellën në Turqi, dhe ai nuk është askush tjetër por pikërisht postieri më inferior i cili kulmin e karrierës së tij e ka arritur kur i është dhënë rasti me i shpërnda pozifat e Dezertorit, apo Dinastisë Dordolece-Kim il Sungiste të shkolluar nga UDB-a Serbe.

Kjo dramë nuk vihet në skenë atë vit. Kjo punë bëhet më vonë.

Për Një Shqipëri Socialiste të të gjithë shqiptarëve!

Bashkimi

ORGAN I FRONTIT TE KUQ POPULLOR | Viti i 3-të i botimit Nr. 1 | JANAR 1981

Kështu duket koka e numrit të katërt të gazetës Bashkimi. Risia në kokën e këtij numri është se për herë të parë në kokën e gazetës, nën emrin Bashkimi shkruhet emri i Organizatës "Fronti i Kuq Popullor", pra emrit 'Fronti i Kuq', në këtë gazetë të përgatitur tërësisht nga Jusufi, i shtohet mbaresa 'Popullor'.

Ky numër dorëzohet në shtyp para **19 dhjetorit 1980**, pra para ditës kur Ibrahim Kelmendi e nisë Hysen Gegën në Kosovë së bashku me Sadik Blakajn. Ky është numri i fundit i Bashkimit. Jusufi përfundimisht e përjetësisht heq dorë nga përpjekja për ndreqjen e stilizimin e kokës dhe përmbajtjes së gazetës Bashkimi pasi dyshon me baza të forta se në kokën e Frontit të Kuq qëndron vetë UDB-a dhe filiala e saj TANJUG-u.

Ibrahim Kelmendi: *"Sa për dezinformatën se unë dhe Hysen Gega i paskeshim premtuar Jusufit për ta financuar shtypjen e "Bashkimit", por nuk e kemi realizuar premtimin, nuk qëndron, meqë atë nuk e ka shtypur Jusufi, por e kam shtypur unë në shtypshkronjën e Lidhjes se Studentëve te Universitetit ku studioja. Ai është marrë me shkrimin e disa artikujve, me redaktimin e kryeartikujve ideopolitik që i shkruaja unë, lekturën dhe faqosjen."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f. 110)

Xhafer Shatri: "*Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 1 maj 1984; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 418))

Ibrahim Kelmendi: *"Tani, nëse keni tubuar përpara, do të ishte e mira së mirës, por nëse jo, atëherë bëje këtë me urgjencë, pse "Bashkimi" do të dalë më rregullisht se përpara.* ***Po ashtu, deri sa të del edhe "Lajmëtari i lirisë", jemi dakorduar që ta ndihmojmë në financim dhe shpërndarje."*** (Letër Faridin Tafallarit, 21 janar 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 408-409)

Rreth çështjes së Lajmëtarit të lirisë, fakte mjaftë të plota dhe informative gjenden në dy letra të Jusufit dërguar Nuhi Sylejmanit, në fund të janarit dhe më 10 shkurt 1981.

Jusuf Gërvalla: *"Me I. (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) dhe H. (Hysen Gegën-shën i Xh. D.) kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin",* ***t'i përpunoj*** *(do me thënë* ***jo redaktoj*** *por ndryshoj e rishkruaj për 90 për qind-shën i Xh. D.) materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo. Deri më tash, ata më kanë dhënë vetëm 200 DM për shtypjen në shtypshkronjë* ***të "Lajmëtarit të Lirisë", kurse marrëveshja ka qenë që të hollat për shtyp (për Lajmëtarin e lirisë-shën i Xh. D)*** *t'i sigurojnë ata, meqë unë nuk jam në gjendje të paguaj nga xhepi im. (Deri më tash, dy numrat e revistës i kam paguar me të hollat e mia, sikurse edhe makinën e shtypit, gjithsejtë mbi 9.000 DM, kurse kontribute nga shokët kam marrë gjithsejtë 1.300 DM.) Për këtë arsye, numri i parë (për këtë vit) më ka ndenjur qe më se dy javë i gatshëm, sepse nuk kisha të holla ta dërgoja në shtyp. (...)*

P. S. Po të dërgoj edhe numrin më të ri të "Bashkimit", nëse nuk e keni marrë ende. Por, ju lutem të ma ruani, sepse është e vetmja kopje që e kam." (*Letër Nuhi Sylejmanit, kah fundi i janarit 1981, faqe 30-32)*

Marrëveshja të cilën e përmend Jusufi më poshtë me Ibrahim Kelmendin dhe Hysen Gegën duhet të jetë e muajit nëntor 1980, sepse Jusufi e fillon angazhimin në gazetën Bashkimi pa ndonjë kusht, në shkurt, prill e maj 1980, në kohën kur Lajmëtari i lirisë nuk ka ekzistua, dhe fillon me botimin e Lajmëtarit e lirisë pa marrëveshje me Ibrahim Kelmendin. *"Me I. (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) dhe H. (Hysen Gegën-shën i Xh. D.) kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin",* ***t'i përpunoj*** *(do me thënë* ***jo redaktoj*** *por ndryshoj e rishkruaj për 90 për qind-shën i Xh. D.) materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo."*

Burgosja e Hysen Gegës i prishë të gjitha planet në këtë drejtim.

Jusuf Gërvalla: *"Po kështu, ka qenë e parashikuar që brenda ditës së sotme të dalë edhe numri i ri i "Lajmëtarit", kështu që, nëse del, do ta marrim me vete edhe atë."* (*Letër Nuhi Sylejmanit, 10 shkurt 1981, Vrasja e trefishtë, faqe 32*)

Përveç përpjekjeve për njollosjen e Hysen Gegës, në mënyrë të paturpshme janë bërë përpjekje edhe për degradimin e burgosjes së tij, me arsyetimin se të gjitha vuajtjet çka i ka bërë për Kosovën në burgjet serbe i kanë shkua huq, dhe nuk i bahen kabull, sepse ai në Kosovë paska shkuar pa e pyetur Jusufin. Nëqoftëse na lejohet me bërë dallime në mesin e atyre që kanë vuajtur në burgjet serbe, për çështjen tonë të përbashkët, atëherë janë shumë të pakt ata që munden me qenë më krenar se Hysen Gega në këtë pikë. Është merita e Hysen Gegës dhe askujt tjetër ajo që ka bërë që e gjithë propaganda e UDB-së Serbe rreth Frontit të Kuq, gjatë vitit historik 1981, ka qenë sa e kot aq edhe qesharake. Mullinjtë propagandistik të UDB-së dhe filialës së saj TANJUG-ut, gjatë gjithë këtij viti historik kanë bluar në guri të thatë. Në mos asgjë tjetër vetëm kjo karikaturë e aventurave të UDB-së do të ishte e mjaftueshme me e përcaktue diagnozën e shëndetit të bivshe Jugosllavisë. Le të del dikush nëse mundet me thënë se atij i ka shkua përdore ajo çka i ka shkua Hysen Gegës. Ajo çka vlen të theksohet si përfundim është se Jusufi e fillon dhe e përfundon angazhimin e tij në gazetën Bashkimi, dhe bashkëpunimin e organizuar me Ibrahim Kelmendin brenda vitit 1980, pa asnjë ndërhyrje të Sabri Novosellës, Kadri Zekës e për të mos folur për mua.

"PROGRAMI I FRONTIT TË KUQ"

i Ibrahim Kelmendit

I. Kelmendi: *"Këto organizime i udhëhiqnin kryesisht njerëz që dikur i kishin shërbyer UDB-së, pasi ishin arratisur nga Republika e Shqipërisë në RSFJ-në,* ***gjithashtu komuniste****. Ata nuk i kishte penguar* ***terrori komunist*** *i serbomadhit* ***Aleksandër Rankoviç*** *mbi shqiptarët e pushtuar, meqë e kishin pasur atë si një lloj punëdhënësi."* (Epoka e Re, 7 janar 2007)

> **Ibrahim Kelmendi:** *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (*Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

Adem Gashi: *"Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë* ***mistreci komunist****..."* (Dyndalla e mendimeve, Hotel Viktoria, 5 shkurt 2007)

Prend Buzhala: *"...parakalojnë revolucionarë, politikanë kafenesh,.. mashtrues e qelepirxhinj të ndryshëm, ...ambasadorë, diplomatë,* ***komunistë e pseudo-ideologji*** *të të gjitha tarafeve...*" (Hotel Viktoria, 5 shkurt 2007)

Salih Kabashi: *"...Miku im, më një nuhatje fantastike, më pat thënë e më vonë edhe e pat shkruar në shtypin slloven, se lider i ardhshëm i Kosovës se re* ***paskomuniste*** *do të ishte Ibrahim Kelmendi."* (Revista Republika nr.3, 2007)

Mustafë Xhemaili: "*Romani "SY" është një tronditje. Apo më mirë të thuhet një ritronditje. Sepse autori do të sjellë Shqipërinë* ***nën diktaturën komuniste*** *nga një këndvështrim i veçantë.*
...Ai aq larg shkon në ëndërrimin e lirisë nën regjimin ***e diktaturës komuniste*** *sa këmbëngulë vazhdimisht se duhej të gjendje një rrugëdalje, një shteg e të dilet në dritën e lirisë.*" (Vlerësime për romanin "SY" të Ardian Kyçykut, 2004)

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë* ***Komuniste*** *të Kosovës, që udhëhiqej nga* ***Mustafë Xhemaili*** *e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. Një tentim për kontakt kishte edhe me PKMLSHJ, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim*." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

Daut Demaku: "***Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..."***

Nga libri Atentatet i Ibrahim Kelmendit

Të gjitha citatet nga libri Atentatet janë të Ibrahim Kelmendit.



”– Tani po e kuptoj egon tënde. Jusufi është detyruar të arratiset. Tani ai do të angazhohet, mendon ti, bashkë me ju, ***kundër pushtetit komunist*** *jugosllav?*

– Dhe kundër pushtimit të Kosovës! – plotësoi Mirani.

– Po, vetëkuptohet! – u përgjigj Renata, duke u ndjerë paksa e bezdisur, përse po i rrinte kaq gati Mirani, kur ajo harronte të saktësonte, se atij i interesonte po aq çlirimi i Kosovës sa edhe luftimi i ***diktaturës komuniste*** *jugosllave.”* (Atentatet, f.11*)*

"Shumicën e nëpunësve shqiptarë në Kosovë e gjetiu në Jugosllavi i njoh si atdhetarë, sado që janë të indoktrinuar nga ideologjia ***komuniste*** *jugosllave, e njohur si “titizëm”.* (Atentatet, f.28)

"Kështu na është sajuar një shtresë e privilegjuar, një Lidhje Komuniste e organizuar mirë, që ka bërë monopol vetëqeverisjen, ose vetadministrimin, siç i thonë në fjalorin ideologjik ***ala titist****, por, në fakt, Lidhja e Komunistëve ushtron pushtet monist."* (Atentatet, f.28)

"Mirani kishte marrë fjalën në debatin me Ministrin. Ndër të tjera ai kishte thënë: “Më mirë e kishim ne studentët nën ***diktaturën komuniste*** *në Jugosllavi... Ky, Zotëri Ministër, ndoshta duhet të jetë njëri nga dallimet midis të demokracisë tuaj këtu dhe* ***diktaturës komuniste*** *atje!”* (Atentatet, f.72)

"– Të atyre ***dy komunistëve*** *sllavë nuk i dua, të Shokut Enver po." (*Atentatet*,* f. 149*)*

"– Atëherë po të sqaroj, unë ***nuk i dua komunistët****, për të mos thënë jam kundërkomunist,"* (Atentatet, f. 150)

"– I thua vetes ***komunist*** *dhe betohesh në zot!? – e ndërpreu Mirani."* (Atentatet, f.165)

"Para sa kohe ishte për një blic-vizitë tek unë në Bochum një ilegal, siç po u thuhet, një thatim që me tangarllëk më kritikoi se ***nuk qenkam komunist****, se Fronti nuk ka organizim të rrebtë revolucionar, nuk është konspirativ e të tjera." (*Atentatet*, f.201)*

"Nuk më tregoi se cili ishte, sado thoshte se më njihte, m’i njihte vëllezërit e shokët në Kosovë. Në fund më tha: “Po të vrojtojmë për të ndikuar që të bëhesh ***komunist*** *i disiplinuar. Pastaj do të të pranojmë në radhët e organizimit tonë”.*
Pandeha se mos ishte i OMLK–së*." (*Atentatet*, f.201)*

" – Kështu ***flasin komunistët****, – ndërhyri Renata, e pakënaqur me shpjegimet e tij.* (Atentatet, f. 221)

"– Luftë klasash do të bëjmë ne tani? – pyeti Renata me të qeshur. – Ta thashë, kështu ***flasin komunistët****."* (Atentatet, f. 222)

"Sa për gjuhën ***e komunistëve****, sikur kemi biseduar dhe jemi dakorduar se nuk jam i tillë." (Atentatet, f.222)*

"Varfëria dhe papunësia në këto shtete janë të mëdha, sepse borgjezia e kuqe e ***drejtuesve komunistë*** *dhe e pushtetarëve,* ***po ashtu komunistë****, nuk di të menaxhojë prodhimin."* (Atentatet, f. 222)

"*Shefat e kuq të firmave* ***janë komunistë*** *të dëgjueshëm, ndaj janë kaq të*

prapambetur." (Atentatet, f.223)

*"– Qenkan të vërteta ato që kam dëgjuar për ty, **se nuk je komunist** i disiplinuar,– tha Kadriu, i pakënaqur me këtë shaka të Miranit."* (Atentatet, f.239*)*

*"– Më fal! Vërtet nuk jam komunist dhe aq më pak komunist i disiplinuar, siç kërkoni **ju komunistët**, sepse atë lloj disipline nuk e pëlqej dhe nuk mund t'i përmbahem.*

*Këtë përcaktim, siç e kam, e kam me qejf dhe prandaj me qejfi shoqëroj bisedat ndonjëherë me shaka. Them se edhe në front përballë armikut luftëtarët bëjnë ndonjë shaka, prandaj jeta nuk duhet të jetë kaq serioze sa e merrni **ju marksistë-leninistët**..."* (Atentatet, f. 239)

*"– Sa shumë ndryshoni! Ai kishte natyrë fodulle dhe gati sa nuk e pata përzënë nga banesa. Nga ai qenke informuar se unë **nuk jam komunist** dhe i disiplinuar.*
Miranit kishte merakun të dinte se cili ishte ai njeri që i kishte folur me kompetenca të mëdha, por me fodullëk edhe më të madh duke pozuar klasikun e marksizëm-leninizmit." (Atentatet, f.241)

*"– Po, kemi biseduar. Lëvizja dhe Fronti kishin përcaktime ideore e politike pluraliste, duke inkuadruar në radhë të tyre çdo emigrant shqiptar, pavarësisht bindjeve ideore, politike e fetare. Pas demonstratave të marsit e prillit të vitit të kaluar, ne pranuam tkurrjen e përcaktimit tonë politik në kërkesë për Republikë të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë. **OMLK-ja kishte përcaktim komunist**. **Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës**, ndërsa sa u përket simpatizantëve, ai ka afruar edhe bashkatdhetarë që nuk kanë qenë komunistë." (Atentatet, f. 330)*

*"Sigurisht as ai. Keqkuptimet e rastit dhe ndërprerjet e bashkëpunimit kanë qenë në natyrë të punës, pasi ne nuk kemi pasur mendësi moniste, që njëri-tjetrit vetëm t'ia miratonim mendimet, propozimet e veprimet, siç ndodh në organizimet homogjene, njëmendësore, që është **karakteristikë e sekteve dhe e partive komuniste**, të cilat ndrydhin pluralizmin e mendimit."* (Atentatet, f.365-366)

*"– I tillë është. Na arratisi nga Malësia e Tropojës në Kosovë sepse nuk i pëlqente regjimi komunist shqiptar. I manipuluar, mendonte se **regjimi komunist serb** ishte më i mirë."* (Atentatet, f.406)

"Ai më arsyetohet se ka dalë për të luftuar komunistët e Enver Hoxhës." (Atentatet, f.406)

*"Por, kur i kundërvihem se a nuk ishte **komunist edhe krimineli** Rankoviç, atëherë ministër i brendshëm i Jugosllavisë, ai hesht i zënë në faj, duke u arsyetuar se nuk dinte shumëçka në atë kohë." (Atentatet, f. 406)*

*"Malësorja e Gostivarit, Hana, me shami të havalesë në kokë, gjatë vitit 1981, mblodhi ndihma simbolike në tubimet e gjermanëve, pasi u kishte folur atyre për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për domosdoshmërinë e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb dhe nga **diktatura komuniste**."* (Atentatet, f. 410)

*"– **Komunistë** janë edhe ..., Xhafari...".* f.449

*"– Por, Jusufi nuk ka qenë **komunist.**"* (Atentatet, f.449)

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..."* (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

Nga libri LEVIZJA, i Bedri Islamit

Përplasja me Strukturat komuniste

Ibrahim Kelmendi: *"Gjatë përplasjeve me strukturat komuniste dhe me pushtetin, unë dhe Abaz Mustafa, nga Sukobina e Ulqinit, u fajësuam si organizatorë të protestës. Asaj proteste të njëanshmërisht iu dha karakter politik, nacionalist e armiqësor, siç ishte gjuha e atëhershme zyrtare komuniste. Gjatë hetimeve u fajësova unë si organizatori kryesor.*

Ky ishte ballafaqimi i parë serioz me pushtetin komunist dhe e pashë se mund të ishte një rrugëtim i vështirë.

Praktikë e atëhershme ishte që strukturat komuniste, lidhja e rinisë socialiste dhe lidhja komuniste në fakultet merrnin qëndrim politik, pastaj i kalohej rasti policisë hetimore. Paralelisht angazhohej UDB-ja si hetuese dhe si koordinatore e vendimeve politike të strukturave komuniste." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f. 18)

Ibrahim Kelmendi: "*Ndonjëherë disa pseudoanalistë fajësonin përcaktimin tonë majtist, si shkak të mospërkrahjes nga Perëndimi. Kjo nuk qëndronte. Së pari, sepse në thelbin dhe në programin e saj Lëvizja nuk kishte asgjë të përbashkët me konceptet marksiste, aq më pak komuniste. ...*

Këtë politikë të Perëndimit, pra, nuk e pengonte fare sistemi socialist-komunist dhe monist i Jugosllavisë, sepse përparësi kishin interesat e tyre shtetërore." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f. 172-173)

PROGRAMI DHE STATUTI
I
FRONTIT TE KUQ POPULLOR

Nga Jusuf Gërvalla

Si anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), të dhënat që përmenden në këtë hyrje i kam mësuar nga Jusuf Gërvalla, shoku dhe ideologu i LNÇKVSHJ, në fund të korrikut 1981. Ato ngjarje të aktivitetit të tij, si anëtarë i LNÇKVSHJ, që m'i ka treguar e shpjeguar me kujdes e vëmendje, e quaj të drejtë dhe të arsyeshme t'i tregoj. Ata që janë të interesuar për historinë e kësaj periudhe kanë mundësi me i kontrollua faktet.

Diku në verën e hershme të vitit 1979 del nga shtypi numri i parë i gazetës "Bashkimi". Ky numër del si Organ i Frontit të Kuq. Pas arratisjes së Jusufit në Gjermani, rrethanat sillen në atë mënyrë që Jusufi ia fillon ta ndihmoj gazetën Bashkimi. Në saje të punës së Jusuf Gërvallës bëhet e mundshme dalja e numrit të dytë të Bashkimit, diku në shkurt 1980. Kah fundi i prillit 1980 del numri i tretë i Bashkimit. Edhe këta dy numra ashtu sikurse i pari dalin si Organe të Frontit të Kuq (pa mbaresën *Populloro*). Në maj 1980, Jusuf Gërvalla autorizohet ta shkruaj këtë Program dhe Statut të Frontit të Kuq Populloro. Ky dokument është i pari në të cilin e ndeshim mbaresën "Populloro", dokument i përgatitur tërësisht nga Jusufi.

Kur Hysen Gega niset për Kosovë, nga banesa e Nami Ramadanit, ai merr me vete numra të shumtë të Bashkimit dhe këtë Program. Ky është programi i Jusuf Gërvallës e i Hysen Gegës, i pafalsifikuar. I armatosur me idetë e me qartësinë e Jusuf Gërvallës, Hysen Gega bëhet një nga militantët më të fuqishëm që ka pasur Kosova. Është koha që pas 30 vitesh ta sjellim në dritë këtë Program të pafalsifikuar të asaj kohe të lavdishme.

Në historinë e lëvizjes punëtore ndërkombëtare janë të njohura programe si p.sh. ai i Eisenach-ut, më 1869 (August Bebel), Gotha-s, 1875 (Ferdinand Lassalle), apo ai i Erfurt-it, 1891 (Karl Kautsky).

Në historinë e luftës për çlirim nacional e social të shqiptarëve nën Jugosllavi, vend të veçantë zen ky Program që mund të quhet Programi i Esslingenit-Sallagrazhdës-Lumthatit të Hysen Gegës.

Merita për kopjen e siguruar të këtij Programi i takon Faridin Tafallarit.

Qëllimi i botimit të këtij Programi ka të bëjë vetëm me ndriçimin e fakteve historike. Por është edhe një e vërtetë tjetër, se fatin dhe efektin e vërtetë të fjalës së shkruar, fillimisht, askush nuk mund ta dijë.

Xhafer Durmishi, tetor 2010



Simboli i Rilindjes kombëtare "Me pushkë e penë" i përdorur më vonë edhe si simbol i LNÇKVSHJ

Jusuf Gërvalla: "*Më vjen një ditë, (vitin e kaluar), në derë me disa shkresurina që vetëm titullin e kishin të qartë: Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, dhe më lutet t'ia korrigjoj në pikëpamje drejtshkrimore. Më pastaj më autorizon që të preki, po e pashë unë të arsyeshme, „si njeri me përvojë", edhe në anën materiale të pikave të përfshira në program e statut. Mirë, them, dhe meqë përmbajtja e shkresurinave ishte pa kokë pa bisht, i hy unë punës me gjithë seriozitetin dhe ato pak njohuri që kisha. Gjithmonë kisha parasysh, pas punës sime, ai do t'ua kthente shokëve për diskutim Programin dhe Statutin e Organizatës së tyre. Por, doli ndryshe. Doli se I. K. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një program dhe statut të një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare" menjëherë pas „korrigjimeve" që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s'ishte punë korrigjimi."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

"Ka ardhur koha që komunistët të shtrojnë haptazi përpara gjithë botës pikëpamjet e veta, qëllimet e veta, aspiratat e veta dhe përrallave për fantazmën e komunizmit t'u vënë përball një manifest të vetë partisë." Marksi dhe Engelsi

"Pika qendrore e edukimit internacionalist të punëtorëve në vendet shtypëse duhet patjetër të jetë propaganda dhe mbrojtja nga ana e tyre e lirisë së shkëputjes së kombeve të shtypura. Pa këtë nuk ka internacionalizëm. Ne kemi të drejtë dhe duhet ta trajtojmë çdo socialdemokrat (kupto komunist) të një kombi shtypës, i cili nuk e bënë këtë propagandë si imperialist dhe maskara." Lenini

"Formimi i një fronti revolucionar të përbashkët është i pamundshëm, nëqoftëse proletariati i kombeve shtypëse nuk përkrah drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vendosur lëvizjen çlirimtare të popujve të shtypur kundër imperializmit të "atdheut" të vet, sepse 'nuk mund të jetë i lirë një popull që shtyp popuj të tjerë'. Engelsi"

(...)

”Bota ndodhet në një fazë ku çështja e revolucionit dhe çlirimit kombëtar të popujve nuk është vetëm një aspiratë e një perspektivë, por edhe një problem i shtruar për zgjidhje.”

”PPSH mbështet dhe përkrah me të gjitha forcat luftërat e drejta të popujve liridashës...” Enver Hoxha

PER NJE SHQIPËRI SOCIALISTE TE TE GJITHE SHQIPTAREVE!
ME PUSHKE DHE PENE PER LIRI E PAVARESI!

”MA MIRE NJE PUSHKE NE MAL SE NJE THES FJALE NE PARLAMENTIN E BELIGRADIT”. AZEM GALICA

PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR

PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR është hartuar nga një grup shokësh, të cilët **qenë të autorizuar**. Për shkak të pamundësive, që janë evidente gjatë ilegalitetit të plotë, nuk qe e mundur që PROGRAMI DHE STATUTI të aprovohen në një konferencë të rregullt, ku do të merrshin pjesë përfaqësuesit.

Si i tillë, është i plotfuqishëm gjer sa ta krijojmë mundësinë për ta thirrur tubimin përkatës, i cili do analizojë edhe materialet e grumbulluara, që kanë të bëjnë me analizat rreth PROGRAMIT DHE STATUTIT tonë, analiza të bëra këto nga çdo militantë i Organizatës!

PROGRAMI

Populli shqiptar, për të çarë me sukses frontin në luftë kundër pushtuesve të egër fashistë gjermanë e italianë, ishte bashkuar dendur rreth organizatës së vet masive, FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR, Organizatë që qe formuar dhe udhëhiqej nga PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE, tani PARTIA E PUNES SE SHQIPERISE.

FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR është formuar në prag të Luftës së Dytë Botërore. I formuar nga PKSH (Partia Komuniste Shqiptare) FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR luftoi me heroizëm armikun.

FRONTI NACIONAL ÇLIRIMTAR dhe PKSH, të frymëzuara thellë nga internacionalizmi proletar dhe nga Revolucioni i Tetorit, bashkuan armët me forcat e Partisë ”Komuniste” të Jugosllavisë. Në bazë të luftës së përbashkët ishte marrëveshja që, pas ngadhënjimit mbi fashizmin, gjithkush të bëhej zot në shtëpinë e vet.

Parimi i Luftës Nacional Çlirimtare dhe antifashiste, pas së cilës do të fillonte një etapë e re e jetës dhe ndërtimi i socializmit, në njërën anë, si dhe mendimi se do të gjenin zgjedhje të drejt gabimet e pafalshme që ishin bërë ndaj shqiptarëve gjer atëherë, në anën tjetër, i shtynë shqiptarët të bëjnë sfidë në luftën e pakompromis kundër fashizmit. Në bazë të parimeve të tilla, populli shqiptar, që deri më atëherë jetonte në tokat e veta në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Serbi, i jepej mundësia e ligjshme për dalje nga robëria e rëndë jugosllave, e paraluftës, dhe për bashkim me vendin amë, SHQIPERINE. Prandaj populli ynë nuk e kurseu gjakun e vet të shtrenjtë.

Në ndjekje të fashistëve të egër ai vajti heroikisht deri në viset më të largëta të Jugosllavisë.

Por, në çastin e ngadhënjimit mbi fashizmin, kur populli ynë po bëhej gati t'i gëzohej realizimit të aspiratave shekullore, bashkimit të përgjithshëm kombëtar e shtetëror të shqiptarëve, piku një nga tradhtitë më të mëdha. P"K"J, me dredhi të papara, manovroi fuqishëm nën rrogoz dhe ia doli me sukses të siguroj për vete në mënyrë arbitrare kufijtë shtetërorë, brenda të cilëve sërish përfshihej më se gjysma e tokave dhe e popullit shqiptar. Kështu, robëria e vjetër e kralëve serbë u zëvendësua me robërinë e re serbomadhe, në krye me klikën revizioniste të Titos.

P"K"J, në bashkëpunim me çetnikët, të cilët ishin siguruar se në Jugosllavi nuk do të vendosej rendi shoqëror socialist, ripushtuan tradhtisht viset shqiptare dhe ia filluan këngës së vjetër – shfarosjes dhe asimilimit të popullit shqiptar. Madje, P"K"J nuk u mjaftua me kaq. Ajo duhej të çonte në vend edhe aspiratat e vjetra të borgjezisë serbomadhe për dalje të lirë në Adriatik. Prandaj me manovrime të reja, të ndihmuar nga disa tradhtarë shqiptarë, si Koçi Xoxe e Pandi Kristo, ia hyri edhe aksionit për pushtimin e Shqipërisë.

Vëllezërit tanë, në saje të vigjilencës së PPSH, e shpëtuan Shqipërinë nga ky rrezik i lig. Ata ishin tradhtuar njëherë nga P"K"J dhe nuk tradhtoheshin më. Por në kushtet konkrete që u krijuan pas Luftës së Dytë Botërore, kur në nivel të politikës ndërkombëtare, ne vend që të korrigjohej, u përforcua padrejtësia ndaj tokave dhe ndaj popullit shqiptar. RPS e Shqipërisë u gjend në aso situate që të mos mund të intervenojë për vëllezërit e vet të mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar, sado që dihej se Jugosllavia i ripushtoi tokat shqiptare që i kishin pushtuar përpara kralët dhe tani po ushtronte terror të egër. Në këto kushte, çdo intervenim ushtarak i RPS të Shqipërisë në viset shqiptare në Jugosllavi konsiderohet përzierje në punët e brendshme të Jugosllavisë dhe tërheq me vete pasoja të rrezikshme, po të nivelit ndërkombëtar.

Megjithatë, mbetën mundësi tjera, me anën e të cilave RPS e Shqipërisë ndikoi shumë në qëndresën tonë. Duke fituar për vete (në saje të kultivimit të marksizëm-leninizmit të kulluar dhe të luftës së pakompromis kundër imperializmit, kapitalizmit, kolonializmit, neokolonializmit dhe revizionizmit modern) atributin e zërit më të fuqishëm në Evropë, Partia e Punës e Shqipërisë ndoqi me interes jetësor dhe me indinjatë të thellë edhe politikën diskriminuese jugosllave të gjenocidit mbi popullin shqiptar; e luftoi me ngulm këtë politikë, duke e denoncuar para forcave përparimtare të gjithë botës. Në këtë mënyrë për popullin shqiptar në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi u bë e qartë se ai nuk është i vetmuar në luftën për çlirimin social e nacional nga revizionizmi i egër titist.

* * *

Bazuar në domosdoshmërinë e Luftës Nacional Çlirimtare, si të vetmen për sigurimin e pavarësisë së plotë kombëtare, bazuar në domosdoshmërinë e përgatitjes së masave për revolucion dhe vet revolucionit, i cili pos pavarësisë dhe bashkimit kombëtar, në pushtet sjell popullin, bazuar në diskriminimin klika revizioniste që po ushtron klika revizioniste e Beogradit, të cilit diskriminim duhet t'i ndajvehemi përkatësisht, bazuar në shfrytëzimin e paskrupullt që u bëhet viseve shqiptare në Jugosllavi nga ana e klikës në pushtet, bazuar në të drejtat elementare njerëzore, se edhe populli shqiptar (i tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia) ka të drejtë të gëzojë dhe rrojë i lirë, i pavarur, i lumtur dhe, duke përkrahur pa rezervë luftën e drejtë dhe politikën parimore, vigjilencën e PPSH dhe të Qeverisë Shqiptare, në krye me shokun

Enver Hoxha, punëtorët, fshatarët, mërgimtarët, të papunët, intelektualët revolucionar e patriot, e sidomos femra shqiptare, me një fjalë, të gjithë shqiptarët (e tokave të robëruara dhe në mërgim) e vetëdijshëm, që janë për çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare të pushtuara, të cilët nuk dyshojnë në përkrahjen e motrave dhe vëllezërve të Shqipërisë , morën këtë

V E N D I M

Nga radhët e të lartpërmendurve, që dalin nga gjiri i popullit shqiptar, të robëruar nga Jugosllavia, të formohet Organizata **FRONTI I KUQ POPULLOR** e cila do të bashkojë punëtorët, mërgimtarët, komunistët, intelektualët dhe gjithë popullin patriot e revolucionar shqiptar të robëruar – në luftë për LIRI dhe PAVARESI, në luftë për BASHKIMIN e popullit shqiptar në një shtet të vetëm, SHQIPËRINË SOCIALISTE.

Kundër kujt do të luftojë FRONTI I KUQ POPULLOR?

Për FRONTIN e KP (Kuq Popullor) është i huaj çdo aksion jashtë tokave arbërore. Çdo akt i kundërt me këtë do të konsiderohet akt agresiv dhe do të dënohet nga vet FRONTI I KP.

Lufta kryesore dhe e vetme do të jetë lufta kundër robëruesit jugosllav, në krye me klikën titiste dhe shovinizmin sllavomadh (serb, malazez e maqedon) me qëllim të çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe të bashkimit shoqëror e kombëtar me vendin amë, Shqipërinë Socialiste. Kjo është e drejtë legjitime e popullit shqiptar, i cili, megjithëse derdhi pa kursim gjakun e vet të shtrenjtë për tokat e veta të shenjta, u bë pre e apetiteve pushtuese jugosllave dhe e politikës diskriminuese të fuqive të mëdha.

Për viset tona derdhën gjakun gjyshërit dhe baballarët tanë, nga gjaku i të cilëve mbinë pipat që sot arritën të formojnë FRONTIN E KUQ POPULLOR.

Nga FRONTI I KUQ POPULLOR do të jetë i luftuar çdo individ, grup a organizatë, që provon të bëhet pengesë në realizimin e vullnetit të popullit shqiptar. Do të luftohet hegjemonizmi, shovinizmi, borgjezia e burokracia e çdo lloji, pa marrë parasysh a gjenden në radhët e tyre serbi apo shqiptari. Do të luftohen të gjithë renegatët dhe tradhtarët shqiptarë, sahanlëpirësit e mashtruar nga klika titiste, që ushqehet tradhtisht me gjakun dhe djersën e popullit të robëruar shqiptar. Do të luftohet ”inteligjenca” që shiti idealet e veta, duke lidhur fatin e vet me pushtuesit apo me borgjezinë, dhe jo me popullin. Me një fjalë, lufta jonë do të ketë tiparet e një revolucioni të përgjithshëm socialist.

FRONTI I KUQ POPULLOR, duke studiuar kushtet aktuale dhe duke shfrytëzuar edhe mendimin e çmueshëm të PPSH lidhur me gjendjen e përgjithshme në Jugosllavi, ka nxjerrë përfundimin e drejtë se në Jugosllavi dominon një atmosferë e volitshme (pasi gjendja e vështirë ekonomike dhe politika pa principe e shfrytëzimi klasor kanë bërë të pakënaqur të gjithë popujt e Jugosllavisë) për shpërthimin e revolucionit. Të mbërthyer ndërmjet shfrytëzimit të egër të Perëndimit e Lindjes dhe politikës antipopullore të udhëheqjes titiste, e cila interesat e vendit i ka shitur fare lirë te imperializmi e socialimperializmi, popujt e Jugosllavisë ndodhen në prag të një revolucioni popullor. Duke përfituar nga kjo situatë, si dhe nga niveli i lartë i vetëdijes shoqërore e kombëtare të shqiptarëve që lëngojnë nën thundrën jugosllave, FRONTI I KUQ POPULLOR, duke u bërë pararojë e luftës për LIRINE E PAVARESINE e

shqiptarëve dhe për bashkimin e tyre me vendin amë, do të luftojë pa kompromis për të vjelë frytet e revolucionit, të cilat janë në pjekjen përfundimtare.

Klika e Beogradit po i gërmon me të madhe varrin vetvetes. Por, po ajo nuk do të bjerë do në të, në qoftë se nuk e shtynë forcat revolucionare. Këtë detyrë i ka caktuar vetes FRONTI I KUQ POPULLOR.

Cilat janë metodat e luftës që bën FRONTI I KUQ POPULLOR?

Nën thundrën e klikës revizioniste të Beogradit, pos shqiptarëve, u merret fryma edhe popujve tjerë, të përfshirë brenda kufijve politik të Jugosllavisë, të cilët i shtrohen politikës në favor të borgjezisë titiste. Shfrytëzimi, burokracia, korrupsioni dhe dominimi i kapitalit të huaj, i kanë shtrirë përdhe interesat e këtyre popujve dhe sidomos të klasës punëtore e fshatarësisë. Në këtë kontekst, lufta do të ketë shumë pika të përbashkëta me luftën e ardhshme të punëtorëve dhe fshatarëve të të gjithë popujve që rrojnë në Jugosllavi. Solidariteti ynë në këtë drejtim nuk do të mungojë. Mirëpo nëqoftëse popujt e Jugosllavisë, kur të ketë shpërthyer revolucioni ynë në tokat shqiptare, i përgjigjen prapë ndërsimit të klikës titiste dhe borgjezisë shoviniste të atyre popujve për të na i ndaluar ne shqiptarëve të drejtat legjitime për çlirimin social e nacional, atëherë ne do të shtrëngohemi t'ua kthejmë grykat e armëve tona edhe këtyre popujve.

Meqë interesat tona klasore e kombëtare përputhen me interesat klasore e kombëtare të popujve të Jugosllavisë, ne nuk dëshirojmë luftë me këta popuj, pos me klikën revizioniste të Beogradit. Prandaj në kohë "paqeje", FRONTI I KUQ POPULLOR ka për detyrë që me propagandë të shëndosh patriotike dhe marksiste-leniniste, t'i çjerrë maskën përgjithësisht klikës së egër të Beogradit dhe të thërras në luftë kundër saj edhe forcat përparimtare të popujve tjerë të Jugosllavisë. Mbi të gjitha, forca e propagandës i drejtohet popullit shqiptar, në mënyrë që ai të përgatitet në baza sa më të shëndosha e më të forta për revolucionin e ardhshëm.

Kjo është etapa e parë, e përgatitjes së revolucionit tonë popullor. Nëpërmjet Organit të FRONTI I KUQ POPULLOR, gazetës "BASHKIMI", si dhe nëpërmjet literaturës marksiste-leniniste dhe literaturës tjetër revolucionare, që botohet me bollëk në RPS të Shqipërisë e që ne do ta shpërndajmë në mënyrë ilegale dhe ta popullarizojmë në radhët e popullit tonë (dhe të tjerëve, po që se ata shfaqin interesim), ne do ta shpiem përpara idenë e çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe kështu do ta shtrojmë terrenin për revolucion. Popullit tonë do t'i bëhet me dije se lufta jonë është luftë e drejtë dhe se një luftë e tillë, kur të jenë bashkuar të gjitha forcat, nuk ka si të mos ngadhënjejë, pa marrë parasysh se me çfarë armiku kemi të bëjmë.

Detyrë e jonë e parë, pra, është që në kushtet e tashme të luftës jo të drejtpërdrejtë, të mësojmë si të sheshojmë dhe t'i mbrojmë interesat e revolucionit të ardhshëm dhe ta mbledhim rreth vetes popullin tonë të shumëvuajtur, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të organizuar.

Kjo punë nuk është aspak e lehtë. Ne kemi të bëjmë me një armik të majmur me gjakun dhe djersën e punëtorëve dhe të nxitur e të ndihmuar nga forcat e errëta imperialiste, kapitaliste, kolonialiste, neokolonialiste e revizioniste. Prandaj, në luftën tonë lypset mjeshtri e hollë dhe guxim shqiptar. E FRONTI I KUQ POPULLOR konsideron se mjeshtëria nuk do të mungojë, nëse lufta jonë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shqiptarëve për të mbrojtur tërësinë e vet territoriale dhe kombëtare dhe në ndjekjen e rrugës përparimtare të klasës punëtore dhe të fshatarësisë, të vizatuar dhe zbatuar me konsekuencë të pashoqe nga PP e Shqipërisë. FRONTI I KUQ

POPULLOR e di se nëpër këtë rrugë të pagabueshme mund të na udhëheq vetëm ideologjia e shëndosh marksiste-leniniste, prandaj shembulli i Partisë së Punës dhe i rezultateve të mëdha të ndërtimit socialist në Shqipëri, do të jenë për ne busulla e vetme.

Ai që mohon nevojën e pjesëmarrjes së femrës shqiptare në revolucion, e kështu në radhët e dendura të FRONTIT TE KUQ POPULLOR ai nuk është me FRONTIN... Gatishmëria e femrës shqiptare që, bashkë me forcat e përgjithshme revolucionare, të përforcojë radhët e luftës për liri, jo vetëm që konsiderohet e drejtë dhe detyrë e saj, por edhe do të çmohet lartë nga revolucioni. Kësaj detyre dhe këtij obligimi, femra shqiptare ka ditur t'i dalë zot edhe në periudha të tjera shumë më të errëta historike, duke dhënë kontributin e vet të pazëvendësueshëm. Ajo paraqet gjysmën aktive të popullit tonë dhe revolucioni ynë nuk mund të merret me mend pa pjesëmarrjen e saj, për cilëndo etapë që të jetë fjala.

Etapa e dytë, përfundimtare, e revolucionit tonë do të jetë lufta drejtpërdrejtë me armë; barrën kryesore të saj do ta ketë prapë FRONTI..., si Organizata më masive që grumbullon në radhët e veta të gjitha strukturat shoqërore të popullit tonë, të udhëhequra nga forcat komuniste (Partia Komuniste, po të qe e formuar.).

Pas bashkimit të tokave shqiptare dhe të popullit shqiptar me Shqipërinë edhe Organizata jonë do të shkrihet me FRONTIN DEMOKRATIK që sot vepron në RPS të Shqipërisë.

FRONTI I KUQ POPULLOR thërret të gjithë shqiptarët e robëruar në luftë për LIRI e PAVARESI, për shpartallimin e armikut shekullor, borgjezisë dhe pasardhësve e ithtarëve të saj, revizionistëve jugosllavë, në krye me klikën titiste.

STATUTI

FRONTI I KUQ POPULLOR është organizatë masive revolucionare, që tubon të gjithë luftëtarët e lirisë dhe të pavarësisë së popullit shqiptar në luftë kundër robëruesit jugosllav dhe kundër çdo armiku tjetër që do të bëhet prag për realizimin e të drejtave të patjetërsueshme të shqiptarëve për të jetuar në LIRI e PAVARESI.

FRONTI I KUQ POPULLOR tubon në radhët e veta të gjitha strukturat e tashme shoqërore në viset shqiptare të robëruara nga Jugosllavia titiste: punëtorët, fshatarët, komunistët, intelektualët revolucionarë, me një fjalë të gjithë popullin liridashës, që është i gatshëm për luftë çlirimtare kundër robërisë shekullore. Në gji të kësaj Organizate ushtrojnë veprimtarinë e tyre revolucionare të gjitha forcat e ndërgjegjshme, që s'e kursejnë as jetën kur këtë e kërkon liria kombëtare dhe klasore.

Detyrat dhe të drejtat e çdo anëtari të FRONTI I KUQ POPULLOR përcaktohen në përputhmëni me aksionet që shkojnë në interes të Lirisë Kombëtare dhe Klasore të popullit shqiptar. Prandaj lidhur me ato detyra dhe të drejta, çdo anëtarë i FRONTI I KUQ POPULLOR duhet të ndihet krenar dhe t'i qoj ato në vend, edhe kur realizimi i tyre bëhet në kushte të vështira që kërkojnë të flijohet edhe jeta.

Busullë e vetme për të gjithë anëtarët e FRONTI I KUQ POPULLOR do të jetë lufta analoge e FRONTIT NÇ, i krijuar nga PKSH në prag të Luftës së Dytë Botërore (prill 1942.) dhe historia e zhvillimit të PPSH, si pararojë. (FRONTI NÇ i udhëhequr nga PKSH, sot PPSH, luftuan për çlirimin e tokave shqiptare dhe për ndërtimin e Socializmit të vërtetë në atë pjesë të tokave që përfshinë brenda kufijtë e Shtetit Shqiptar të sotëm, të cilit Fuqitë e Mëdha ia shkëputën arbitrarisht më se gjysmën e tokave shqiptare.)

Te revolucionari i FRONTI I KUQ POPULLOR nuk duhet të ketë asnjë pikë dyshimi lidhur me ndihmën që do të na japin vëllezërit tanë në Shqipërinë e lirë, posa ne të kemi krijuar kushte të shëndosha për shpërthimin e revolucionit. Ata kanë detyrë dhe nder ta bëjnë këtë punë. Historia e popullit shqiptar nuk i ka parë kurrë të shkëputura interesat e popullit në pikëpamje regjionale. Kështu do të bëhet edhe në të ardhmen.

Militantët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR janë militantë të ngritjes së vetëdijes shoqërore e kombëtare të popullit të robëruar shqiptar; militantë të aksionit dhe të luftës së armatosur për LIRI dhe PAVARESI, posa të piqen kushtet për shpërthimin e revolucionit të përgjithshëm popullor.

Strategjia e punës dhe e luftës së FRONTIT TE KUQ POPULLOR do të jetë strategjia e PPSH, e cila e ka demaskuar dhe demaskon me ngulm revizionizmin dhe politikën e egër jugosllave të gjenocidit mbi shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Lufta e shokut Enver Hoxha kundër revizionizmit, strategjia e hollë dhe trimëria e pashembullt e Tij në mbrojtjen e interesave jetike të popullit dhe të Shtetit Shqiptar, do të jenë mësimet bazë për të gjithë anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe do të studiohen me kujdes në mënyrë kreative, duke iu përshtatur kushteve konkrete.

Për FRONTIN E KUQ POPULLOR, do të thotë për gjithë popullin shqiptar të robëruar nga Jugosllavia, armiku kryesor është socialshovinizmi serb, malazez, maqedonas, i ndërsyer nga shovinizmi sllavomadh i Kremlinit. Poashtu edhe shovinizmi grek është armiku ynë, pasi ai ushtroj një politikë diskriminuese dhe të egër e barbare mbi vëllezërit tanë në Çamëri. Meqë ky shovinizëm duhet të jetë i huaj edhe për popujt sllavë, sidomos për ata të Ballkanit, që janë gjithashtu të shtypur nga krerët e Moskës dhe të Beogradit, ne i ftojmë edhe këta popuj t'i bashkohen luftës sonë kundër revizionizmit dhe shovinizmit të egër.

Lufta jonë është e vështirë por e drejtë. Këtë e kanë kuptua edhe armiqtë tanë, revizionistët e Beogradit. Ata e dinë se fitorja do të jetë në anën tonë, prandaj përditë e më shumë po na shtrëngojnë me dhunë e me tortura. Për militantin e FRONTIT TE KUQ POPULLOR duhet të bëhet shembull qëndrimi i patundshëm dhe vetëmohues i revolucionarëve shqiptarë, me të cilët janë mbushur përplot burgjet anembanë Jugosllavisë. Ideali i këtyre revolucionarëve: Liria shoqërore dhe kombëtare, është njëherazi ideali i çdo anëtari të FRONTIT TE KUQ POPULLOR.

Pjesëmarrjen e vet aktive në FRONTIN E KUQ POPULLOR, militanti i kësaj Organizate duhet ta kuptoj si detyrë, të drejtë dhe nevojë për ngritjen e revolucionit. Revolucioni do t'i sjellë popullit LIRI dhe PAVARESI, do ta zhdukë shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, shfrytëzimin e një kombi nga një komb tjetër. Për këtë arsye, çdo anëtar i FRONTIT TE KUQ POPULLOR brenda mundësive të veta, duhet t'i begatoj njohurit e veta sa më shumë për revolucionet dhe për luftërat çlirimtare.

Sjellja e çdo militanti do të jetë pasqyrë e FRONTIT TE KUQ POPULLOR, i cili është vepër kolektive e të gjithë militantëve të tij. Suksesi i FRONTIT TE KUQ POPULLOR, varet nga vetëdija, guximi dhe disiplina e militantit, dhe anasjelltas, suksesi i përgjithshëm i Frontit të KP e bënë më të vetëdijshëm, më të guximshëm dhe më të disiplinuar militantin e FRONTIT TE KUQ POPULLOR!

Meqë FRONTI i KP është organizatë ilegale, që punon në kushte shumë të vështira dhe rrezikohet vazhdimisht nga zbulimi dhe kapja e anëtarëve të tij nga ana e policisë fashiste jugosllave, militantët e Organizatës sonë masive, duhet të kenë kujdes edhe si marrin frymë. (Natyrisht, me kohë duke u pjekur kushtet, FRONTI i KP do ta legalizoj dalëngadalë punën e propagandën e vet, në mënyrë që i tërë populli të mund të përgatitet sa më fuqishëm për luftën e ardhshme Nacional Çlirimtare të armatosur.

Militanti duhet të ketë cilësi të caktuara.

- Në cilin do mes shoqëror që të gjendet, ai duhet të bëhet shembull për të tjerët me sjelljen e vet; kështu ai do të bëjë për vete një numër sa më të madh të njerëzve.
- Në çdo aksion ai duhet të hyj me bindje të fortë dhe me disiplinë të hekurt.
- Urdhëratë që merr nga baza, do t'i përfillë në tërësinë e tyre dhe pa vërejtje. Nuk do të bëjë asgjë në kokë të vetë dhe aksionin do ta kryej me përpikmërinë më të madhe.
- Lidhur me pakënaqësinë e vetë sa i përket ideologjisë, politikës, aksionit apo urdhrit të caktuar, ai do ta sqaroj FRONTIN E KUQ POPULLOR pasi ta ketë çuar në vend urdhrin dhe pasi ta ketë kryer aksionin.
- Këshillat, sugjerimet, urdhëratë, militanti i merr nga baza. Por, edhe baza është e obliguar t'i përfillë këshillat, vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet që vinë nga anëtarët e Organizatës.
- Militanti duhet të jetë kritik dhe autokritik. Kritika dhe autokritika duhet të jenë të shëndosha, joformale, dhe të sqarohen në varshmëri me gabimet, me natyrën dhe pasojat e gabimit të bërë. E drejta për kritikë ndjek rrugët lartë – poshtë (nga baza drejt lidhjeve më të largëta të militantëve.) dhe poshtë – lartë (nga anëtari i fundmë drejtë bazës.), natyrisht pas kryerjes së detyrës.

Vendimet bazë dalin nga komunistët, pasi të jenë analizuar në mënyrë kritike dhe pasi të jetë konstatuar se sjellin kontribut të padyshimtë për revolucionin. Me formimin e Partisë Komuniste Shqiptare (në viset e robëruara) FRONTI I KUQ POPULLOR do t'i organizojë masat rreth sajë, pasi PK do të jetë prezantuesja më e denjë e klasës punëtore.

Propaganda duhet të kryhet në çdo vend dhe në çdo rast e kohë; ajo duhet të jetë propagandë e shëndosh, që demanton dhe demaskon plotësisht realitetin revizionist jugosllav dhe sidomos politikën antishqiptare të Jugosllavisë.

Çdo rivalizim ndërmjet anëtarëve, duhet të jetë i huaj për FRONTIN E KUQ POPULLOR. Rivalizimi e shtynë "militantin" të punojë në kokë të vetë, gjë që ka për pasojë individualizmin dhe kështu humbjen e besimit te njëri – tjetri. Pasoja më e rëndë e kësaj do të kish qenë krijimi i grupacioneve, që shpien në fraksion. Këto janë të dënuara nga FRONTI I KUQ POPULLOR.

Militanti duhet të dijë t'i dallojë armiqtë e ngjyrave të ndryshme dhe t'u jap atyre përgjigjen e duhur, atë përgjigje që do t'u jepte vetë populli, sikur të kishte një gojë dhe sikur ta lejonin të fliste.

Militanti duhet të jetë vigjilent; ta njoftoj organizatën për dyshimin më të vogël që ka hetuar në infiltrimin e armikut; të mësojë t'i dallojë sa më lehtë armiqtë dhe agjentët e UDB-së.

Çdo akt spiunazhi çmohet si tradhti ndaj popullit. Tradhtia e shokut dhe e çështjes është tradhti ndaj popullit dhe tërheq me vete dënimin e merituar.

Sabotimi i punëve të FRONTIT TE KUQ POPULLOR tërheq dënim të rëndë.

Renegatët shqiptarë, që janë lidhur pas qerres së revizionizmit jugosllav, konsiderohen tradhtarë dhe luftohen njësoj si vetë titistët.

Borgjezia shqiptare; kuaziintelektualët dhe të gjithë ata që nuk përcaktohen për rrugën e revolucionit, qoftë edhe pa dashur i çojnë ujë në mulli armikut, konsiderohen armiq dhe do të marrin dënimin e merituar kur të bëhet gjyqi i popullit.

Puna propagandistike dhe materialet e ndryshme që hyjnë në këtë punë, implikojnë shpenzime materiale, që duhet të përballohen nga të gjithë anëtarët e

FRONTIT TE KUQ POPULLOR. Për këtë qëllim, çdo anëtar duhet të jap kontribute të rregullta, sipas mundësive. Shpenzimet implikohen edhe për ndihmën që duhet t'u jepet familjeve të të dënuarve në aksionet e FRONTIT TE KUQ POPULLOR, të cilët hyjnë drejtpërdrejt nën kujdesin e Organizatës sonë.

Çdo keqpërdorim i kontributeve materiale të mbledhura nga anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe nga ndonjë tjetër aksion më i gjerë, dënohet rreptë.

- TE RROJE POPULLI SHQIPTAR, I LIRE DHE I BASHKUAR!
- TE RROJE SHOKU ENVER HOXHA, QE PO NA NDRIQON RRUGEN E VEPRIMIT!

(...)

- RROFTE FRONTI I KUQ POPULLOR!

Jo – atyre që janë trima
me ngreh gishtin e krimit
por - atyre që janë trima
me shtri dorën e pajtimit!

Adem Demaçi
(romani: "Gjarpit e gjakut")

Luftë vëllavrasjes – Plagës së shëmtuar!

Qëndresa heroike dhe veprimtaria revolucionare e Shokut Adem Demaçi, duhet të jetë shembull veprimi i qëndrimi për të gjithë militantët shqiptarë!

FRONTI I KUQ POPULLOR

* * *

Nga fundi i dhjetorit 1922 në Junik u mbajt mbledhja e komandantëve më të njohur të çetave të Kosovës dhe të malësive, ku u vendos të përgatitej një sulm tjetër kundër forcave qeveritare në prefekturën e Kosovës (Kukësit) dhe, më vonë, të ngriheshin edhe krahinat tjera të Shqipërisë.

Përpara nisjes për veprim, tek vendi i quajtur "Verrat e Gjocës", Hasan Prishtina u mbajti një fjalim të zjarrtë 1200 kryengritësve, ku ndër të tjera tha:

"- Vllazën! Kërkojnë prej nesh që atdheun ta trajtojmë si mall tregu. Jo kurrë! Si dje, sot, nesër e përherë atdheu ka qenë dhe ashtu gjaja më e shejtë për ne. Të gjithë ta dinë se na nuk jena tue luftue kundër Shqipnisë e shqiptarëve, por për një Shqipni të lirë e të bashkueme. Nuk kemi dalë maleve me shpëtua vetëm një shtëpi, katund apo fis, po të tanë Kosovën, e cila mbështjell në gjinin e vet krejt vllaznit, qytetet e katundet tona. Ideja dhe parulla jonë ka qenë dhe asht: çlirimi e bashkimi i tanë Kosovës me atdheun tonë të përbashkët Shqipninë. Dhe për ta realizue këtë duhet veprim e jo fjalë, bashkim e jo përçamje, trimni e jo frikë.

Na kurrë s'kemi kujtue se lirinë ka me na e sjellë dikush së jashtmi. Jo, një mijë herë jo! Atë e kemi fitue dhe do ta fitojmë me gjakun tonë, sepse vetëm kështu ajo mund të jetë liri e vërtetë. Vetëm pushka jonë e jo dikush tjetër ka detyrua e do të detyroj armiqtë të lëshojnë nga duart gërshanët, me të cilat duen të qethin copa të tjera nga trupi i atdheut tonë. E dijmë se anmiku është më i shumtë në numër, më i armatosur me

armë dhe më i pasun me pare. Kështu ka qenë dje, kështu asht edhe sot. Por kjo as nuk na tremb, as nuk na përkul, përkundrazi kjo kërkon që na të jemi ma të fortë. Të peshojmë mundësitë tona me guxim e mendje të kthjellët. Ne nuk e zvoglojmë rrezikun, në të kundërt ne u themi luftëtarëve se rreziku është i madh, prandaj bashkoni radhët, tregoni vendosmëni e guxim, flakni tutje burracakët, që mbjellin përçamje e frikë, përbuzni ata që çirren tue na këshillue të dorëzohemi sepse gjoja do të shuhemi.

Vllazën! Asht e vërtetë se një gabim taktik gjatë luftës mund të sjellë që kjo apo ajo çetë të thyhet përkohësisht, por kjo s'ka aq rëndësi për fundin e luftës. Politika e dorëzimit, e pritjes apo e kundërshtimit të aksionit kurrë nuk të çonë në fitore. Kush ka frikë ka me vete humbjen, kush qëndron i patundun ka me vete fitoren. Liri pa gjak nuk ka."

JE I PASTËR SI LOTI

Sadik Blakaj sipas Ibrahim Kelmendit

Daut Demaku: "***Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..."*** (Prishtinë, 26 gusht 2007, www.pashtriku.org)

Mirani-	Ibrahim Kelmendi	Vasili -	Hysen Gega
Sadi Bakaj -	Sadik Blakaj	Demushi-	Demë Demaj
Nesim Guri-	Nezir Gashi	Nazim Ramazani-Nami Ramadani	
Fahriu-	Faridin Tafallari		

Banesa dhe adresa e Nami Ramadanit, prej të cilës Hysen Gega niset drejt e në kurthën e UDB-së Serbe:

Nami Ramadani
Karlsbaderstr. 12
7300 Esslingen

Citati, në kornizë, nga letra e Ibrahim Kelmendit dërguar Sadik Blakajt është marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407.
Citatet tjera janë nga libri Ibrahim Kelmendit, Atentatet, Prishtinë, 2007.

"Në prag të Vitit të Ri 1981 Vasili i telefonoi Miranit që të shkonte tek ai në Esslingen. Nuk ia tregoi arsyen konkrete, por i tha se e pret te Nazimi. Vasili kishte vendosur të shkonte në Kosovë. Para se të nisej donte të takohej me Miranin.
Të premten pasdite, sapo Mirani arriti në Esslingen, shkoi në banesë të Nazim Ramazanit, që vinte nga rrethi i Tetovës. Aty Mirani, pos mikpritësve, gjeti Sadi Bakajn. Përballimi fizik me të e hutoi, sepse vazhdimisht e kishte refuzuar kërkesën e njerëzve për ta takuar.

Mirani e mbante mend vëllanë e Sadiut, Ramën, si patriot të devotshëm. Ai ishte njëri nga bashkorganizatorët kryesorë të demonstratës në Pejë, në nëntor të vitit 1968. Atëherë Mirani ishte katërmbëdhjetë vjeçar dhe dallimi në moshë nuk e kishte penguar të njihej mirë me Ramën. Në vitet e pastajme edhe Sadi Bakaj kishte bërë emër si student i mirë në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, në drejtimin për gjuhë dhe letërsi shqipe. Njëherit përflitej si për një qejflinj. Pastaj ishte hedhur edhe në aventura të tjera, në bixhoz, degjenerim e pija, që rëndom çonin drejt koketimit me struktura të UDB–së. Edhe të afërmit kishin filluar ta përflisnin.

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

Para daljes se Sadiut në Perëndim ishte sajuar një arratisje e tij nga burgu i Gjilanit. Patrioti veteran Nesim Guri, nga fshati Gërkoc i Pejës, i cili ishte në farefisni me Miranin, ishte informuar për daljen e tij nga burgu i Gjilanit dhe prej andej në Perëndim. Këtë informim Nesimi e kishte nga Rama, me të cilin ruante marrëdhënie e miqësi prej vitesh." Atentatet, f.175-176

"**Nesimi** menjëherë ishte shqetësuar se mos Sadiu po dërgohej nga UDB–ja për t'i bërë ndonjë paudhësi Miranit. Ai dinte për veprimtarinë e Miranit, sepse mbante lidhje të fshehta me te. **Por, më përafër ishte informuar nga një vizitë befasuese që Mirani ia kishte bërë atij në fshat, në vitin 1979, shoqëruar nga Vasili."** f.176

> *"Gjatë vitit 1979 hyri ilegalisht në Kosovë... ...Ibrahim Kelmendi ishte takuar me Hysen Gegën, njërin ndër militantët më të fuqishëm që kishte patur Kosova, pastaj ishte takuar edhe në Pejë me veprimtarin e dalluar Nezir Gashi."* (Mr. Ethem Çeku, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, f. 201).

"Kur Nesimi mori vesh për dalje të Sadiut në Perëndim, u angazhua të gjente mundësinë sa më të shpejtë për ta informuar Miranin. Në këtë përpjekje ai gjeti

Zymerin, një farefis i tij dhe i Miranit. Meqë kishte besim tek ai, e porositi të shkonte urgjentisht te Mirani.

Kur Zymeri e gjeti Miranin në banesën e tij në Bochum, e bëri me dije se e kishte dërguar Nesim Guri me një porosi konkrete: "Andej do dalë Sadi Bakaj. Ruaju nga ai! Kam frikë mos po të shkakton ndonjë të keqe. Mos u tako me të! Kam dro që UDB–ja po e dërgon me mision konkret...". f.176

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Mirani e kishte marrë seriozisht këtë porosi. Nuk kishte pranuar ta takonte, sado që Sadiu një herë i kishte shkuar te banesa, por nuk e kishte gjetur aty. **Dhe mirë që nuk e kishte gjetur sepse do të ziheshin fizikisht."** f.176

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Vasili ishte takuar me Sadiun para disa muajve, përkundër porosisë se Miranit." f.177 "Sadiu ishte vendosur përkohësisht në qytetin e Sant Gallen–it të Zvicrës. Atje jetonte, punonte dhe vepronte Kadri Zeka, si i strehuar politik. Sadiu kishte shkuar atje me detyrë, ta survejonte Kadriun, siç do ta merrte vesh më vonë Mirani. Megjithatë, ai nuk po i shpëtonte syrit të mprehtë të emigrantëve, të cilët i kishte porositur Mirani." f.177

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Sa e pa Sadiun në banesë te Nazimit, ia njohu surratin, sado që kishte më shumë se dhjetë vjet që nuk e ishin takuar." f.177 "U përshëndetën tepër ftohtë e tepër formalisht. Mirani shtirej sikur nuk po e njihte. Po i vinte keq nga familja e Nazimit që i kishte rënë hise ta kishte brenda një **imoral dhe spiun** të UDB–së." f.177

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Po bashkatdhetarët e asaj ane i kishin thënë Miranit se UDB–ja e kishte rekrutuar Sadiun gjatë vuajtjes së dënimit dhe pastaj e kishin përdorur atë për t'i hetuar të burgosurit për veprimtari patriotike. Për këtë qëllim UDB–ja e kishte transferuar nga qelia në qeli, ku mbaheshin të mbyllur patriotët. E kishin lënë me secilin nga disa ditë që t'ua nxirrte informatat për veprimtarinë e tyre të fshehtë. UDB–ja, e kishte hetuar talentin e tij prej aktori." f.178

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Mjaftonte vetëm krimi që ai kishte bërë ndaj nxënëses se tij katërmbëdhjetë vjeçare që ta urrente skajshmërisht." f.178

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija... " (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)
>
> **"Të përgëzoj nga zemra!...** Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen..." (Saime Isufi për Ibrahim Kelmendin më 5 mars 2007)

"Gjatë përpunimit të të dhënave për Sadiun, sado që s'e kishte të nevojshme, Miranit iu kujtua takimi i paradokohshëm i këtij Sadiut me Jusufin.

Jusufi, përkundër paralajmërimit që i kishte bërë Mirani, kishte pranuar të takohej me të në prani të dy bashkatdhetarëve të tjerë. Njëri nga ata kishte qenë Fahriu, që e thërrisnin Taksisti." f.178

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Kur ishin takuar më vonë Jusufi e Mirani, i pari kishte shprehur mëdyshjen:" Mos po i hyjmë në hak Sadi Bakajt që nuk po e qasim në radhët tona? E takova përkundër rekomandimit tënd. Gjatë bisedës atij i rrodhën lotët nga keqardhja që nuk po e qasnim. Bile më recitoi poezi aq mrekullueshëm, saqë më emocionoi me zërin dhe talentin e tij brilant. "Mirani nuk kishte ndryshuar mendje. I kishte thënë Jusufit se nuk kishte bërë mirë që e kishte takuar dhe i kishte thënë se vetë nuk do ta ndërronte qëndrimin ndaj

Sadiut..." f.178

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

Hysen Gega

Pas disa çasteve Vasili e luti Miranin të shkonin për një punë deri të një bashkatdhetar. Pasi dolën nga banesa, Vasili shpjegoi se nuk do të shkonte gjëkundi, por kishte nevojë të bisedonte pa prani të Sadiut. Mirani po mundohej ta përmbante hidhërimin, ndërkohë që Vasili ndihej i zënë ngushtë.

– Miran, më fal që të krijova situatë të papërshtatshme!

– Domethënë paske harruar se të kam paralajmëruar për rrezikshmërinë e atij krimineli dhe kujdesin që duhet të kemi ndaj tij!?

– Më lejo njëherë të të sqaroj se si e kam marrë këtë vendim. Isha para dy javësh te Demushi, i cili më thirri urgjentisht. Baca Nesim i kishte telefonuar nga Kosova dhe e kishte urdhëruar të më gjente mua se pas pesë orësh do të më telefononte. Shkova për telefonatën. Ti e di se sa e çmoj unë Bacën Nesim. Dhe vërtet erdhi telefonata. Ai më foli shkurt: "Pas dy ditëve do të vijë shoku për të cilin dikur ju kemi informuar se është i rrezikshëm. Duhet ta mirëpritni dhe ta angazhoni pasi është i aftë dhe i besueshëm. Kemi qenë të dezinformuar kur ju kemi çuar fjalë që të ruheni nga ai. Kaq. Mirupafshim!". Ma mbylli telefonin pa pasur mundësi t'i bëja ndonjë pyetje.

– E paske hëngër, more pus. Nuk ke biseduar me Nesimin, por me Sadiun. Ai të ka telefonuar nga Brukseli, ku gjendet për momentin, siç na kanë informuar shokët atje. Meqë i shkon aktrimi dhe e njeh mirë Nesimin, të ka folur duke e interpretuar atë.

– Nuk është e mundur, unë ia njoh zërin Bacës Nesim. Të kujtohet kur ishim fshehurazi tek ai vitin e kaluar?

– Të betohem se e paske hëngër tunxh. Qind për qind të ka folur Sadiu. Prandaj nuk e ka zgjatur se mos rrezikonte të identifikohej.

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

– Tani mos u lodh kot, – e ndërpreu Vasili, – unë jam i bindur se kam biseduar me të madhin, Bacën Nesim.

Vasili dukej më tepër se i bindur. Mirani ia njihte tashmë karakterin dhe nuk e vazhdoi bisedën rreth telefonatës së improvizuar. Po mendonte me vete: "Sa lehtë mashtrohen njerëzit nga ata që i **madhërojnë**! Kjo po i ndodh edhe këtij të shkretit. E

ka madhëruar deri në **idhull** Nesimin, ka ndjerë lumturi që ai po i telefononte dhe s'kishte si t'i shkonte ndërmend të dyshonte në ishte vërtet zëri i tij.
– Pse nuk po flet? – ia ndërpreu Vasili mendimet.
– Po atëherë çfarë ndodhi?
– Vërtet, Sadiu erdhi pas dy ditëve. Ndenjëm ca ditë bashkë te Demushi në Nagold. Atje u fascinova nga shkathtësitë dhe patriotizmi i tij. Kishte shkathtësi të falsifikonte dokumente të të gjitha llojeve. Madje edhe bileta të trenit. Kishte shkathtësi për të qenë gueril i përkryer...
– A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri, sepse kohën më të madhe e kalon me to? " f.179-180

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"– Njëherë u fjalosa me të duke i thënë se vazhdojmë të kemi dyshim ndaj tij. Ai emocionalisht dhe bindshëm me tha: "Urdhëroni, më sprovoni!". Unë, i zënë ngushtë, ia ktheva me inat: "Po, do të të sprovoj duke shkuar së bashku në Kosovë për aksione!". Ai më tha: "Mate veten se mua nuk më mat dot!" Ia ktheva: "Nuk jam nga ata burra që frikësohen, prandaj sa të bëhem gati, për pak ditë, para Vitit të Ri do të shkojmë!". Dhe kështu me vrull e me inat mora vendimin për të shkuar me të në Kosovë.
– Tani mendon se po të cenohet burrëria ndaj atij udbashi nëse bëhesh pishman?

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

– Nuk është udbash. Më ka siguruar Baca Nesim, – u përgjigj me kryeneçësi Vasili." f.181 "– Domethënë, shkon për të rënë **në kurthin e UDB–së**? Shkon si cjapi të kasapi, siç thotë populli?

> "Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

– Unë nuk bie në kurth, e shpaguaj veten. Sadiun e kam peng garantues. Pastaj, më mirë të dëmtohem unë se sa ti dhe Baca Jusuf. Kështu do të bindeni nëse ai vërtet është njeri i UDB–së... " f.181 "– Po bëhem kurban,– ndërhyri Vasili.– Më mirë unë se ti dhe Baca Jusuf.
– Çfarë rëndësie ka kjo sprovë naive e shoqëruar me rrezik të qind për qindtë!? Në fakt, përse po na duhet ky farë Sadiu!? Ti vetë duhej të ishe bindur të paktën se ai është **kurvarë**, bixhozxhinj, rrugaç! – i foli rrebtë Mirani." f.182

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Kur tjetri e pa se nuk i mbushte mendjen shokut vendosi të përqendrohej në këshilla. I tha se duhej të përpiqej të kontaktonte vetë Nesimin sapo të arrinte në Kosovë. Nga ai të informohej nëse i kishte telefonuar. Ta pyeste çka duhej të bënte. Pastaj biseduan se cilat aksione do të ishin më domethënëse. Në fund të kësaj bisede të gjatë, Mirani e pyeti:
– A je konsultuar me Jusufin për këtë vendim?
– Jo. Pashë Flamurin mos i trego!
– Përse?
– Sepse edhe ai do të mundohet të ma thyejë mendjen dhe nuk kam dëshirë të shkoj me brengën se nuk e kam dëgjuar edhe atë. Ty po të kërkoj falje që nuk po të dëgjoj kësaj radhe. E kam më të lehtë të të mos dëgjoj ty se sa Bacën Jusuf.
– Mirë, të daltë për mbarë dhe u kthefsh faqebardhë!,– i tha në fund Mirani." f.182

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Gjatë kthimit në banesë të Nazimit, Mirani po mendonte me vete:
"Përse është **katandisur** në këtë gjendje Vasili? Sa po më vjen keq për të!
Ka pësuar demoralizime të rënda muajve e fundit, që kur u zbulua se kush ishte Rezil Mejtepi dhe që kur u shpërbë *Grupi Komunist Zëri i Kosovës.* Po ndihet i detyruar që të bëjë diç të madhe për të shpaguar goditjet. Nuk ka përse ta ndiejë veten fajtor. Mos tani ka ndikuar edhe roli i Nuriut. Ai po imponohet si udhëheqës i bashkatdhetarëve në rreth të Shtutgartit, duke e spostuar Vasilin në plan të dytë. Kështu ndoshta po hatërohet se përse Jusufi po e **afirmonte** gjithnjë e më shumë Nuriun në rolin që e kishte Vasili deri kur i ndodhën gjithë ato paudhësi!?" f.182-183

"Prandaj Vasili duhet të jetë **katandisur** në këtë gjendje pa rrugëdalje sa të pranojë edhe mashtrimin e Sadi Bakajt. Ai sigurisht ka në plan t'i bëjë kurth këtij veprimtari të palodhshëm, ka në plan të hakmerret për moszbatim të urdhrit për atentat ndaj Jusufit..." f. 183

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Pasi u kthye në banesë, siç u mor vesh me Vasilin, **Mirani u soll pothuajse normalisht ndaj Sadiut.**

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

Të nesërmen në mëngjes ata u nisën. Me vete po merrnin materiale të shumta: ekzemplarë të Programit e të Statutit të Frontit të Kuq Popullor, të *Bashkimit* e të *Lajmëtarit të lirisë,* etiketa të vogla vetëngjitëse për t'u afishuar më lehtë në Kosovë, të shtypura nga Fronti e të tjera materiale të ngjashme." f.183

"Kur u ndanë, Mirani shkoi te Jusufi e Bardhi. Ata ndërkohë ishin vendosur me banim në Untergruppenbach, një fshat i madh në afërsi të Hajlbronit dhe Shtutgartit. Aty kishin zënë me qira një shtëpi të re, dy katshe e gjysmë, përkatësisht dy kate dhe çati. Shtëpia e sapondërtuar po pranonte banuesit e parë. Në katin e dytë, të cilit gjermanët i thonë kat i parë, përballë përfundimit të shkallëve, ishte një dhomë e vogël rreth dhjetë metra katrore. Këtë dhomë Jusufi e kishte caktuar vetëm për Miranin. Fëmijët kishin filluar të parët t'i thoshin dhoma e Axhit Miran. Pastaj kështu kishin filluar t'i thoshin të gjithë anëtarët e Familjes Gërvalla. Kur Mirani nuk ishte aty nuk hynte njeri, meqë kështu kishte urdhëruar Jusufi." f.184

"Mirani tani po shkonte i gëzuar te Jusufi e Bardhi. Kishin pasur shkëputje të bashkëpunimit e shoqërimit të tyre, por ishin pajtuar në festat e nëntorit. Jusufi kishte dyshuar se mos Mirani po e survejonte. Për këtë e kishin dezinformuar ca pseudopatriotë dhe informatorë të UDB–së.
Si më të dalluar në këto shpifje ishin shquar Nuriu, Xhahili, Proletari e ndonjë tjetër, që Mirani nuk e dinte ende." f.184

"Këtu Mirani Mori frymë, meqë pati dilema nëse duhej t'i tregonte Jusufit se Sadi Bakaj tashmë e kishte mashtruar Vasilin dhe ishin në rrugëtim për në Kosovë. Megjithatë vendosi të mos i tregonte, meqë i ishte përbetuar Vasili." f.197

"Posa arriti Mirani në shtëpi të Jusufit, ai e drejtoi menjëherë në dhomën e punës, pa i lënë kohë të pinte gjë dhe të përshëndetej me familjarët e tjerë.
– Përse nuk më ke treguar para shkuarjes dhe për shkuarjen e Vasilit në Kosovë?
– Sepse Vasili e kishte bërë fakt të kryer shkuarjen kur unë u njoftova. Pastaj ai m'u lut me betim: "Pashë Flamurin nuk i tregon Bacit Jusuf!" Janë tre bashkëveprimtarë të rrethit tuaj që e kanë ditur para meje, që e kanë ndihmuar edhe me financa dhe ata duhet të kenë qenë njësoj të detyruar të të tregojnë. Mbase ata nuk i ka përbe si mua!
– Megjithatë, ti është dashur të më tregosh,– tha preras Jusufi.
– Ja që s'e kam gjykuar se jam i detyruar.
– Them se ke bërë faj, madje faj të rëndë." f.228

"– Kësaj radhe ai e kishte bërë fakt të kryer dhe nuk e kishte ndër mend të më dëgjonte. Në fund të fundit, siç e tha, kishte vendosur të bëhej kurban, që ne të dinim se kush ishte në të vërtetë Sadi Bakaj, që ai të mos na rrezikonte ty dhe mua. Edhe këtë arsyetim e dha Vasili kur u përpoqa ta bindi që të mos udhëtonte me të. I pata thënë se nuk kishte përse të rrezikonte, meqë unë dija se kush ishte Sadiu.

Këtë sqarim me nënkuptim e bëri që **t'ia rikujtonte Jusufit se ishte ai që kishte shfaqur dilema për Sadiun pas takimit me të**." f.229-230

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Nga mesi i janarit në Gjermani u kthye Sadi Bakaj. Po atë ditë në banesë të Fahriut takohen Jusufi, Demushi e Sadiu për të diskutuar se si kishte ndodhur arrestimi i Vasilit. Në fund të kuvendimit që kishte zgjatur rreth tetë orë, deri në ora tre të mëngjesit, Jusufin e kthejnë në shtëpi me automobil Demushi e Sadiu.

Sadiu u mbrojt gjatë marrjes në pyetje duke fajësuar vetëm Vasilin, se gjoja ishte i pakujdesshëm, i padisiplinuar dhe i papërvojë. Sadiun e mori në pyetje kryesisht Jusufi.

Mirani nuk pranoi të takohej me Sadiun, përkundër faktit se këtë ia kërkonin shokët. Ai vendosi t'i shkruante letër Fahriut për t'i kërkuar Sadiut që të jepte llogari me shkrim." f. 230-231

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

"Takimi për të gjykuar rastin nuk u mbajt gjatë ditëve të pastajme, edhe pse u grumbulluan informata të bollshme. Mirani,

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

Fahriu e Nazimi ishin të bindur se Sadiu e kishte tradhtuar Vasilin, kurse Jusufi kishte dilema." f.231 "Davaritje e dyshimit të Jusufit bëri që ai të mos ketë frikë më nga Sadiu, prandaj pikërisht Demushi me Sadiun po e vozisnin Jusufin mbi njëqind kilometra rrugë, sa ishin larg Nagoldi me Untergrupenbahun, pas orës tre të mesnatës, duke ia mësuar kështu vendbanimin e Jusufit edhe Sadi Bakajt." f.231

"Mirani nuk këmbënguli që të mbahej takimi ku do të sqarohej arrestimi i Vasilit dhe të ndaheshin fajet, sepse gjykoi që në ato rrethana nuk ishte momenti. Sadiu ia kishte arritur që në vend se të jepte llogari për atë tradhti ndaj Vasilit, t'i bënte të mendonin të tjerët për te se ishte patriot.

"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21

janar 1981)

Pavarësisht kësaj rrjedhe, ditëve në vijim, sipas rastit e konjukturave, po shfaqeshin gjykime që e fajësonin Miranin më shumë sesa vetë Sadiun për arrestimin e Vasilit..." Atentatet, f.231

"dhe mbetemi shokë të mirë"

"Të përgëzoj nga zemra!... Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen..". (Saime Isufi për Ibrahim Kelmendin, më 5 mars 2007)

"dhe mbetemi shokë të mirë"

Përveç Daut Demakut e Saime Isufit, Ibrahim Kelmendi është përgëzuar si dëshmitarë i besueshëm i asaj kohe edhe nga Hysen Gërvalla, Taip Zeka, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Xhafer Shatri, Ismet Rashiti etj., dhe

"mbetemi shokë të mirë."

Ibrahim Kelmendi ka ardhur rastësisht

Rasti i Hysen Gegës sipas Faridin Tafallarit

Sadik Blakaj, Hysen Gega dhe vizita e **rastësishme** e Ibrahim Kelmendit

Banesa dhe adresa e Nami Ramadanit, prej të cilës Hysen Gega niset drejt e në kurthën e UDB-së Serbe, më **19 dhjetor 1980**. (Foto: Faridin Tafallari)

Nami Ramadani
Karlsbaderstr. 12
7300 Esslingen

Të gjitha citatet jashtë kornizave janë marrë nga libri "Terror Dhimbje Qëndresë" i Faridin Tafallarit në mes faqeve 20-26

"Ndërkohë, ndërsa po përgatitnim dramën (Procesi të Jusuf Gërvallës-shën. i Xh. D.), na erdhi një shok i Demës, i cili në kontakte me ne përdorte pseudonim. Por mua Dema më tregoi se ky ishte Sadik Blakaj. Një mbasdite Dema erdhi në shtëpinë time dhe më tha se ka ardhur një shokë nga Kosova, i cili është shumë i aftë. "Për të të kam folur dhe tani ke rastin ta takosh", por mua nuk më kujtohej që Dema të më kishte folur më parë për Sadikun. Dema më kishte folur shpesh vetëm për dajën e vet, të quajtur Nezir Gashi. Për të më kishte thënë se ishte njeri i mirë." f. 20

Ibrahim Kelmendi: *"Nesimi menjëherë ishte shqetësuar se mos Sadiu po dërgohej nga UDB–ja për t'i bërë ndonjë paudhësi Miranit. Ai dinte për veprimtarinë e Miranit, sepse mbante lidhje të fshehta me te.* ***Por, më përafër ishte informuar nga një vizitë befasuese që Mirani ia kishte bërë atij në fshat, në vitin 1979, shoqëruar nga Vasili."*** (Atentatet f.176)

Ethem Çeku: *"Gjatë vitit 1979 hyri ilegalisht në Kosovë... ...Ibrahim Kelmendi ishte takuar me Hysen Gegën, njërin ndër militantët më të fuqishëm që kishte patur Kosova, pastaj ishte takuar edhe në Pejë me veprimtarin e dalluar Nezir Gashi."* (Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, f. 201).

"Hyseni ashtu siç e kishte zakon, lëvizi kapelën nga koka dhe më tha: 'Faridin ne kemi besim tek ti dhe prandaj po të drejtohem. Unë me Sadik Blakën kemi vendosur të shkojmë në Kosovë, por na duhen ca të holla. Aq sa ke mundësi të na japësh, se këto do të të kthehen prapë. Ne po t'i kërkojmë ty si shok, që udhëtimi ynë të mos merret vesh. Kemi vendosur që askush të mos e dijë.'

"Mirë Hysen, - i thash. Nuk është problemi tek të hollat, ato do t'i jap. Por mua më habit shkuarja jote me Sadikun. Unë, për veten time, tek ai nuk kam aspak besim. Me të kurrë nuk kisha për t'u nisur për të marrë një rrugë, sidomos për Kosovë. Unë pata rastin ta njoh pak e veçanërisht biografinë e tij. Për mua veprimtaria e tij nuk ka vlerë."

Hyseni m'u përgjigj: "Unë i besoj Demës, se ky po më garanton që Sadiku nuk mund të tradhtoj. Unë e njoh Demën, se Sadikun nuk e njoh." Dema përsëriti ato që i kishte thënë Hysenit: "Sadiku nuk është tradhtar dhe mos e ruaj shpinën kurrë prej tij, se ai nuk të pretë në besë. Sadiku ka të meta tjera, por sa për patriotizëm është patriot; unë prej tij e kam marrë për herë të parë flamurin kombëtar." Dhe Dema vazhdoi me lavdërimet për Sadiku siç e kishte zakon.

"Mirë", - i thash unë, megjithëse nuk po më vinte aspak mirë. "E keni bërë planin dhe e keni vendosur, po Sokolit a nuk do t'i tregoni për këtë punë? Do të bënit shumë mirë po të njoftonit edhe Sokolin"..

... Por kur përmenda Sokolin, ndërhyri Hyseni dhe tha: "Jo nuk do t'i rrëfejmë Sokolit. Po ta marrë vesh Sokoli, nuk do të na lejojë dhe kështu për këtë punë përveç teje, Demës dhe Sadikut nuk ka për ta ditur askush tjetër."

Duke parë se kjo punë kishte mbaruar e ishte vendosur, unë i thash: "Po t'i jap 2000 marka gjermane dhe po që se janë të pamjaftueshme, më thuaj Hysen, do të jap edhe më."

"Jo më tha Hyseni, bile janë shumë dhe të faleminderit për gatishmërinë tënde."

...Pastaj Hyseni i telefonoi një shoku të cilit i besonte shumë (ky ishte Nami Ramadani nga Tenova e Tetovës). I tha: "Kam një shok me të shoqen, a pranon që ajo të qëndrojë tek ti një javë apo dhjetë ditë."

"Po si nuk e pranojmë shokun tënd, jo një e dy javë po sa të dojë." Dhe kështu u bë. Sadiku me Dianën u vendosën te Nami Ramadani në Esslingen. Hyseni kishte shumë besim te shokët...

Pa u nisur për Kosovë, Sadiku një mbrëmje udhëtoi për diku. Dema nuk më tregoi se për ku. Unë dhe Dema e përcollëm Sadikun deri te stacioni i trenit në Nagold. Para se të nisej Sadiku i tha Demës: "Shikoi duart e mia; këto nuk punojnë si duart e tua e të Faridinit, por fitojnë, ja kështu të paprishura." Kur treni u nis, Sadiku i tha: "Demë, për atë bisedë mos ta dijë askush veç ti dhe unë."

"Dema nuk më tregoi se përse e kishte fjalën Sadiku....

...Ditët po kalonin dhe unë nuk pata rastin të takohesha më as me Sokolin (Jusufin), as me Besnikun (Bardhoshin). Dhe ja më **19 dhjetor 1980** Sadiku u kthye nga udhëtimi i tij, unë dhe Dema u nisëm për Esslingen për ta takuar dhe përshëndetur atë dhe Hysenin...

Arritëm në Esslingen, lamë makinën jashtë dhe hymë në banesën qëndronin Hyseni dhe Sadiku. U përshëndetëm të gjithë, edhe me "Rrustemin" (pseudonimin e Sadik Blakajt në banesën e Nami Ramadanit-shën ynë). Ajo që më habiti më së tepërmi qe se aty pash edhe Ibrahim Kelmendin. Më pas e pyeta veçmas Hysenin se si kishte mundësi që Ibrahimi ta dinte punën e udhëtimit për Kosovë, kur fjalët ishin që as ky të mos e merrte vesh nisjen. **Hyseni më tha: "Po as Ibrahimit nuk i kam treguar; ai ka ardhur rastësisht."**

Unë i besova.

Ishte nata e fundit; koha për t'u përshëndetur erdhi. Unë dhe Hyseni i zgjatëm dorën njëri-tjetrit dhe duke i shtrënguar u përqafuam. Na u lagën sytë na lotët, tani po ndaheshim dhe nuk e dinim se kur dhe ku do të mund të takoheshim përsëri. Hyseni ma la mua makinën e vetë, një makinë e vjetër, që pas një kohe të shkurtër m'u desh ta braktisja; m'u dhimbs shumë kur e hoqa nga dora makinën e Hysenit, nga e cila mora librat e shumta që kishte aty. Hyseni na la porosi që sa më parë të lajmëronim Sokolin dhe Besnikun për nisjen e tij në Kosovë.

Bashkë me Demën shkuam te Sokoli dhe i treguam për udhëtimin e Hysenit. Sokolit i erdhi shumë keq dhe e quajti atë një veprim të gabuar dhe kurrsesi nuk po mund ta besonte. Por kjo ishte një gjë e vërtetë." f. 24-26

"Aktgjykim
***...Nezir Gashi**, mësues nga Grabovci, KK-ës së Pejës, i lindun më 1938 në Mamurras-Shqipëri, e ka krye Shkollën Normale, në burgun hetues gjendet prej 13 korrikut 1964*
...c) I pandehuni Neziri:
Mbas bisedave me të pand., Ramadan Shalën, e cili e ka njoftue për ekzistimin e grupi armiqësor ilegal të Pejës dhe me qëllimet e tij, në prill të vj. 1964, ka hy në atë grup dhe e ka pranue statutin e tij, si dhe detyrën e masovizimit të grupit dhe mbledhjen e armëve, qëllim për të cilin ka marrë pjesë në mbledhjen e grupit në Pejë më 24 maj 1964, në

të cilin simbas propozimit të të pand., Ramadanit, asht zgjedhë për sekretarë të udhëheqësisë lokale të Pejës.
...DËNON
...6) Të pandehunin, Nezir Gashin, me 5 (pesë vjet) burgim të randë, porse në dënimin e dhanun ja llogaritë kohën e kalueme në burgun hetues prej 31 korrikut të vj. 1964.
...Gjyqi i Qarkut të Pejës, 21 gusht 1964." (Nga aktgjykimi i LRBSH-Dega në Pejë. Marrë nga Ethem Çeku, Shekulli i ilegales, Prishtinë 2004, faqe 336-348)

KËSHTU E PATA KUPTUAR

Historinë e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Lëvizjes sonë në vitin 1980

Shqyrtim i veprës së Jusuf Gërvallës dhe rrethit të tij në vitin 1980 me vëmendje të përqendruar në përmbajtjen e librit të Ibrahim Kelmendit, *Atentatet*, Focus - Prishtinë 2007 dhe www.pashtriku.org

1. Nuk do të anëtarësohem
-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkas qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim
2. Vuajmë
-1. Vuajmë nga mungesa
-2. Vuajmë nga teprica
3. Admirime
-1. Nuk duhet admiruar
-2. Duhet admiruar
4. Atentatet e mveshura
-1 FJALE PËR LIDHJEN FISNORE ME RAMË NIKQIN
-2. Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?
-3. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?
-4. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan
-5. UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara
-6. Keqardhja për gjynahet e mveshura
-7. Profesioni i mësuesit dhe i pjesëtarit të shërbimeve sekrete
-8. Nuhi Sylejmani është njësoj si Riza Salihu
5. Rasti është mbreti i botës
-1. Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës
-2. Duke më provokuar të humb durimin
-3. Vazhdimi i gjendjes deri në festën e 28 Nëntorit 1980
6. Lajmëtari i lirisë
-1. Në këtë gjendje

-2. Porosia e Jusufit për Hysen Gegën
-3. Ilegale e botuar në Zvicër
-4. E pa definuar dhe e paidentifikuar

7. Gazeta "Bashkimi" dhe Fronti i Kuq

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkak qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Madje në gjendje të keqe
-4. M'u afrua e më ofroi bashkëpunim
-5. Kishte vendosur të mos kontribuonte
-6. Deri në sqarim dhe rikthim të marrëdhënieve të mëparshme
-7. Artikulli "Bashkimi bënë fuqinë" i Jusuf Gërvallës
-8. Me gjasë ky do të jetë numri i fundit i Bashkimit
-9. Nga ky numër gazeta jonë do të dalë rregullisht
-10. Me gjasë të lazdrova kur ta lavdërova
-11. Bakshishi për Jusufin

8. Keqkuptimet dhe bashkëjetesa familjare

-1. Hidhërimi i pakontrolluar
-2. Interesi i vazhdimit të bashkëjetesës familjare

9. Biseda pune

-1. Superioriteti i Luanit të inferioriteteve vandale
-2. Simpatizantët e Frontit e dinë se nuk jam i organizuar në Front
-3. Proletari dhe Xhahili
-4. Luani superior i inferioriteteve vandale është informator i UDB-së

10. Ibrahim Kelmendi në lëkurën e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës

Ibrahim Kelmendi në mes Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës
-1. Ke ndonjë lidhje në Turqi?
-2. Nuk po më paraqitet edhe pse e ka numrin e telefonit
-3. Mbase ke harruar
-4. Ti më kishe thënë se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë
-5. Një Zë që nuk tingëllonte aq bindës
-6. Vazhdonte ta fshihte dëshpërimin
-7. Porosinë ta kam përcjellë
-8. Po deshe ta siguroj adresën dhe telefonin e tij
-9. Do të më bëje nder
-10. Ndihej i zhgënjyer - do të zhgënjehesh siç janë zhgënjyer
-11. Intelektuali poliedrik dhe fisnikëria e vërtetë
-12. Ca shpjegime për udhëheqësin tënd
-13. Më ke folur për të si për një idhull
-14. Mos prit kot
-15. Për këtë organizatë nuk dihet gjë në Kosovë
-16. Me nënkuptim prej të pakënaquri
-17. Ka manipuluar me ty
-18. Është koha të vendosësh
-19. Të pengon të gjykosh drejt - Ai po të mban peng
-20. Ne jemi të bllokuar

11. Skënderi - kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

-1. Ka vënë kontakt pa e njohur ju atë përpara
-2. Ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

12. Jusuf Gërvalla si manipulues

-1. Hedhja e Nuhi Sylejmanit kundër Hysen Gegës
-2. Hedhja e Hysen Gegës kundër intelektualëve dhe fundi i "Frontit tonë"

1. Nuk do të anëtarësohem

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkas qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi

Ibrahim Kelmendi*: "Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar* ***Xhavitin****, meqë për te krijova përshtypje se* ***ishte informator i UDB-së****, i urdhëruar për t'u anëtarësuar në PKGj/M-L, që të informonte për veprimtarinë e kësaj partie komuniste sigurimet e fshehta jugosllave dhe gjermane. Kurse për Proletarin formova përshtypjen se ishte një dogmat primitiv."(*Atentatet, f.40)

Xhahili (Xhaviti), informatori i UDB-së propozon emërtimin "Fronti i Kuq"

I. Kelmendi*:" **Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion",** etj. Proletari propozonte ta quanim "Partia Komuniste e Kosovës /Marksiste-Leniniste", duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. ...Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë* ***avullnetshëm*** *u dakordova me propozimin e tyre.* ***Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues."*** **(**Atentatet , f.41-42)

I. Kelmendi*: "Jusufi: Me gjasë sigurimi famëkeq jugosllav, që ende po e quajmë UDB, na kishte rënë në gjurmë të organizimit tonë ilegal. Shkas për të qe ardhja fshehtë e gazetës* Bashkimi*, shpërndarja gjithashtu e fshehtë dhe ideja që na lindi se mund e duhet të organizohemi për t'u çliruar nga pushtuesi."* (Atentatet, f.53)

Shumë fakt interesant e vërejtje interesante. Ideja për t'u organizuar në luftë për çlirim e kundër UDB-së, Jusufit i paska ardhë nga organizata e bashkëthemeluar dhe tërësisht e pagëzuar prej Xhahilit. Se pa i ra në dorë Jusufit gazeta "Bashkimi" si organ i organizatës me emrin tepër provokues "Fronti i Kuq" të caktuar nga informatori i UDB-së Xhahili, Jusufit i paska mungua ideja se mund dhe duhet të organizohet për t'u çliruar nga pushtuesi, d.m.th. nga UDB-a.

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin,* ***jam njohur në janar të vitit 1980****. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit,* ***bile në një gjendje jo të lakmueshme*** *e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. (Bashkëpunimi im fillon me atë numrin, që ia kam dërguar Mërgimit, ku në faqen e parë është një vizatim që paraqet grushtet e të burgosurve tanë që shpërthejnë grilat e dritares së burgut.)"* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Shoku Bashkim-Sabri Novosella

-2. Shkas qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim

Xhafer Durmishi: *"Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ.* ***Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe****. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi."* (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 326)

Jusuf Gërvalla: "*E diel, 30 dhjetor, 1979, ora 00.45 Ludwigsburg*

Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.

Aty nga ora 16, erdhën në "Rilindje" Suzana me Kadri Rexhën dhe më prunë lajme të hidhura.

Atë ditë heret në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën.... ***Shoku i Lëvizjes, Bashkim*** *Prishtina (Sabri Novosella-shën. i Xh. D.), qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata." (Pjesë nga ditari i Jusufit, i shpërndarë nga familja e Jusufit-shën i Xh. D.)*

-3. Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim

Nuk do të anëtarësohem e bashkohem me askend pa ju pa të gjithë juve të bashkuar.

Ibrahim Kelmendi*: "Mirani i tha këto pa asnjë stepje.* ***Ai shquhej për modesti të tepruar dhe transparencë, ndonjëherë deri në naivitet****. Kështu veproi edhe kësaj radhe, sikur me Jusufin të ishte shok prej vitesh.*
– E po, Miran, dëshironi të na e merrni Bacën Jusuf vetëm ju të Frontit? Po ne të Grupit? – foli papritur Vasili, i cili, si duket nuk foli vetëm sa për ta bërë radhën, por pse u merakos se mos Grupi do të injorohej fare.
– Mos u merakos, Vasil. ***Nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim****, deri sa ju të mos bashkoheni dhe deri atëherë gjithandej do të angazhohem për të ndihmuar veprimtarinë patriotike, – tha Jusufi*". (Atentatet, f.63)

> Jusuf Gërvalla: *"Më vonë Ibrahimi ka ardhur bashkë me e Maksut Saramatin dhe kanë kërkuar prej meje që të vihem në krye të tyre e t'i udhëheq (tashmë Hyseni e Maksuti e paskëshin braktisur Rizain dhe kishin kaluar në anën e Ibrahimit). Unë e refuzova kërkesën e tyre, se s'bënte të jem njëkohësisht në dy organizata."* (Raporti i korrikut 1981)

Nga kjo rrjedhë se Jusufi në Kosovë nuk paska qenë anëtarë i ndonjë organizate, përveç frymëzimit që e ka marrë nga "Fronti i Kuq" të emërtuar nga Xhahili gjegjësisht

UDB-a. Se në muajt e parë të vitit 1980 në Gjermani nuk paska qenë apo nuk e paska pasë të qartë se ka qenë anëtarë i ndonjë organizate, apo edhe nëse ka qenë, pasi ka dalë në Gjermani dhe pasi është kontaktuar nga ”Fronti i Kuq” paska pushuar të jetë anëtarë i organizatës në Kosovë dhe e gjithë kjo padijeni e konfuzion e arrin kulmin kur ai deklaron se ’nuk do të anëtarësohem në asnjë organizim, deri sa ju të mos bashkoheni dhe deri atëherë gjithandej do të angazhohem për të ndihmuar veprimtarinë patriotike. Me fjalë tjera Jusufi nuk do të organizohet (nuk donë t'i takoj asnjë organizate) derisa I. Kelmendi (figura frontale e Frontit të emërtuar nga UDB-a), Riza Salihu e Hysen Gega të mos bashkohen.

Do te ishte shumë interesant ta dinim, sikur të kishim fakte të mjaftueshme në dorë se kjo taktikë e rikonstruktuar më 2007 ('nuk bashkohem unë pa ju pa ju të gjithëve të bashkuar') a është e Jusufit apo e disa të tjerëve.

Xhafer Durmishi: *"Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ.* ***Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe****. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi."* (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 326)

2.Vuajmë

-1. Vuajmë nga mungesa
-2. Vuajmë nga teprica

-1. Vuajmë nga mungesa

Vuajtjet nga mungesa e intelektualëve. I. Kelmendi (personi që nuk vuan nga komplekset) i tregon Jusufit vuajtjet e veta.

Ibrahim Kelmendi*: ”****Vuajmë*** *nga mungesa e njerëzve të përgatitur intelektualisht.”* (Atentatet, f.58)

"Gazeta Express: Pse ishte Jusuf Gërvalla cak i UDB-së, dhe pse ai ishte i rrezikshëm për te?

Ibrahim Kelmendi: *Emigrantet e paarsimuar në atë kohë kanë pasur një* ***kult ndaj intelektualit****,... Këta emigrantë që kishin shkuar atje për të punuar, kanë marrë atë gjendje sociale me veti, d.m.th. edhe kultin për intelektualin dhe atë gjendje e kanë* ***konservuar****....* " (Gazeta “Express”, Prishtinë, më 11 e 12 mars 2007)

Jusuf Gërvalla: "*E mora me mend (e spikat edhe në letrën tënde)* ***ç’mundime*** *(e* ***vuajtje****-shën ynë) ke pasur të më shkruash në “nivelin” tim, sikur thua se vetëm në “nivelin” tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë “niveli” im, sikur t’u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?!* ***Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit!*** *(Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)* (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Bujaria e Ibrahim Kelmendit në komplimente dhënë Jusufit.

I. Kelmendi: *”Mbi të gjitha e ka mirësinë e modestinë.* ***Nuk të imponohet fare me***

***gjithë atë bagazh intelektual që ka**."* (Atentatet, f.99)

"Ai nuk po e shpërdoron për asnjë rast epërsinë e tij intelektuale, po angazhohet me tërë qenien për çlirimin e Kosovës."(Atentatet, f.106)

Nëse Jusufi ka qenë modest e nuk ka shpërdorua epërsinë intelektuale e njerëzore ndaj I. K., atëherë sipas I. K. ky është kulmi i mirësisë së Jusufit. Nëse këtë veti universale Jusufi e aplikon edhe ndaj Sabri Novosellës dhe të gjithë atyre me të cilët ka pas punë, nga pozita e shokëve, atëherë është naiv e viktimë që manipulohet lehtë dhe që shndërrohet në një person për keqardhje.

-2. Vuajmë nga teprica

I. Kelmendi: "*Për të heshtur, nuk i heshtte, meqë ishte gojëtar. Brenda ngurimit të tij hyri Mirani:*
– Si i keni hallet në Grupin tuaj?
Vasili mezi kishte pritur këtë pyetje, pasi aty e kishte pasur hallin, por
bëri një parahyrje.
*– Do të të tregoj vetëm nëse nuk më ndërhyn. Po e bëjmë një bander unë, (kështu i thoshte ai shtyllës se telefonit), një ti, pasi ju të shkolluarit nuk keni durim të na dëgjoni ne **analfabetëve**.*
– Fol! – ndërhyri padurueshëm Mirani. (Atentatet, f.35)

*I. Kelmendi: "Meqë u përcaktova për organizim ndryshe, siç ta thashë, një si organizim popullor, u interesova të gjejë bashkatdhetarë patriotë, të cilët do të ndihmonin për nxjerrjen e gazetës Bashkimi. Këta të interesuar duhej se pari të mësonin që të lexonin, meqë ishin **gjysmanalfabetë**.* (Atentatet, f. 41)

*I. Kelmendi: "Ky farë Fekir Dalena, që kishte nivel më të ulët se një **gjysmanalfabet**.* (Atentatet , f. 74)

I. Kelmendi: Ata janë dhënë pas ngritjeve të shtëpive të mëdha në Kosovë, pas blerjes së tokave. Sikur janë në garë midis tyre. Për këto unë nuk i fajësoj.
Atë nivel të vetëdijes se ulët sociale e kombëtare kanë. Po t'ua analizosh
*prejardhjen, sheh se janë individët më të varfër në Kosovë, **gjysmanalfabetë** e **analfabetë**. (Atentatet*, f. 155)

*I. Kelmendi: Mirani sapo e pa dorëshkrimin e Rezilit, iu kujtua **gjysmanalfabetizmi** i tij. Pastaj nisi ta lexonte tekstin. Hasi në vështirësi për të lexuar atë dorëshkrim të shëmtuar. U kërkoi falje policëve, me shpjegimin se është dorëshkrim i **gjysmanalfabetit**. (Atentatet , f. 286)*

*I. Kelmendi: Pastaj, mos vallë Jusufin po e shtynte të dyshonte se ne po e sabotojmë veprimtarinë e tij, meqë ai në numrin e parë të Zërit të Kosovës ka shkruar rrebtë kundër Kadriut!? Jo more, atë shkrim mund ta kishte bërë vetë Rrobaqepësi **gjysmanalfabet** dhe t'ia kishte redaktuar Jusufi...!" (Atentatet, f. 310)*

I. Kelmendi: "Pastaj Jusufi qiti e tha:
– Ju lutem, më tregoni si është pritur Zëri i Kosovës në Klubin tuaj?
*– Shumë mirë,– nisi të përgjigjej Hajzeri,– e kemi lexuar e diskutuar disa herë publikisht në Klub, meqë shumica e bashkatdhetarëve janë **gjysmanalfabetë**." (Atentatet, f.312)*

*I. Kelmendi: "Hakani, bashkëvendës dhe ithtar i Kadriut, që kishte statusin e kandidatit në OMLK, **me profesion traktoristi** në Kosovë, ndërsa në Zvicër **punëtor**."*
(Atentatet, f. 370-371)

*I. Kelmendi: "Apo ndoshta burgosjet e kanë goditur aq rëndë, saqë ka humbur funksionalitetin e saj për të reaguar. Tani vjen ti, shpërdoron Hakanin, një ish– **traktorist, punëtor krahu** këtu. Ai të legjitimoi ty shpërdorueshëm si të dërguar të*

organizatës." (Atentatet, f.383)

I. Kelmendi: "Për herë të parë po shihte dorëshkrimin e ***gjysmanalfabetit*** *Sabit." (Atentatet, f.399)*

I. Kelmendi: "Ai jeton në Turqi dhe nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet që bën Komiteti ynë në Zvicër e në Gjermani. Për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në mbledhje, ai, si ***gjysmanalfabet*** *që është, dhe këtë ju duhet ta keni parë nga shkrimi i tij, Komitetin Qendror e quan kryesi, sado që Lëvizja nuk ka organ me këtë emër." (Atentatet, f. 414)*

I. Kelmendi: "Fahriu ndoshta do të mbante qëndrim neutral ose në anën time, por çfarë suksesi do kisha me këtë ***gjysmanalfabet****, pavarësisht se është i ndershëm dhe patriot i angazhuar." (Atentatet, f. 441)*

Sabri Hamiti: "*Isa (Jusufi); Donë gazeta e janë* ***gjysmanalfabetë.*** *Shih çfarë shkruajnë! Ia nxjerrë parasysh një letër. Parulla, propagandë qesharake. Këngë për traktorin, vaje për Kosovën, himne për Shqipërinë, këngë për Të Madhin. Më duhet të ndreq diçka."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 24)

Jusuf Gërvalla: "*E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?!* ***Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit!"***

3. ADMIRIME

-1. Nuk duhet admiruar
-2. Duhet admiruar

-1. Nuk duhet admiruar

Ibrahim Kelmendi: *"Në atë analizë kisha idenë të bëjë vështrim kritikë, kuptohet në hallin tim, dhe mbi kontinuitetin e "këthimet" e mëdha; para shpërthimit të demonstratave, pas shpërthimit dhe pas bashkimit. Mendoja se ndonjë ide që mund të më lindte, sidomos mendimet në formë të citateve të klasikëve të marksizëm-leninizmi (për mendimin tim edhe shoku Enver hynë në radhën e tyre!), do na ndihmonin për propagandën në të ardhmen."* (Letër Qendrës Ekzekutive, 10 tetor 1983)

I. Kelmendi e mëson dhe përpiqet ta shpëtoj nga konfuzioni Jusufin lidhur me qëndrimet e tij (Jusufit) ndaj Enver Hoxhës.

Ibrahim Kelmendi: *"Prandaj, mendoj, as Enveri nuk duhet* ***admiruar*** *vetëm pse është shqiptar…" (Atentatet, 2007, f.149)*

Në numrin e parë të Bashkimit, si organ i Frontit të Kuq, artikuj e fjalë 'origjinale' janë vetëm 26%. Në te gjendet artikulli i nënshkruar nga Skender Osumi, artikull i cili nuk ka mund të botohet e propagandohet në atë formë pa kaluar nëpër censurën e penës së Enver Hoxhës. Përveç këtij artikulli në këtë numër është botuar parathënia dhe kapitulli i parë i librit të Enver Hoxhës "Vetadministrimi jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste" me rreth 4000 fjalë. Raporti i Enver Hoxhës, në numrin e fjalëve të gazetës Bashkimi (Organ i Frontit të Kuq) me Ibrahim Kelmendin, në numrin e parë të Bashkimit është 73%:27%. Këtë raport, këtë huazim, këtë varshmëri Jusufi nuk e ka pasë kurrë. Në numrin e parë të Bashkimit, në moshën **25** vjeçare, fitohet përshtypja sikur I. Kelmendi e ka atë qartësi ideologjike sa, edhe pse me ndihmën e veprës së

lartpërmendur të Enver Hoxhës, e cilëson Jugosllavinë e atëhershme si vend kapitalist. Por kjo nuk mund të jetë në asnjë mënyrë e vërtetë pasi ai më 2006 e 2007, në moshën **52** vjeçare e definon Jugosllavinë e Titos si sistem komunist dhe si diktaturë komuniste, kundër të cilave ai e ka filluar luftën me Bashkimin e tij të Frontit të Kuq, të emërtuar me emrin bombastik dhe provokativ nga UDB-a. Nga kjo rrjedhë se dikush tjetër, dhe jo ai vetë, ia ka zgjedhur artikujt e Skender Osumit dhe të Enver Hoxhës, pasi ai vetë e lufton sistemin komunist dhe diktaturën komuniste dhe me këtë e lufton edhe Enver Hoxhën. Kush mund të jetë ai, që ia zgjedhë shkrimin e Enver Hoxhës, të cilin I. Kelmendi nuk e donë dhe nuk e *idhullon*, as si komunist (sepse e lufton sistemin dhe diktaturën komuniste) e as si shqiptarë (pasi në këtë mënyrë do të rrëshqiste në nazizëm), të kësaj Organizate të emërtuar nga UDB-a, mund ta marrim me mend nga letra e Jusufit dërguar Sabri Novosellës, më 13 maj 1981. Jusufi *rrëfehet* para I. Kelmendit jo vetëm për problemet e brendshme të Lëvizjes së vet, por edhe për 'idhujt' e vet

I. Kelmendi: *"– Për Shokun Enver mos më fol keq, sepse e kam idhull! Edhe herave të tjera të kam dëgjuar se bënë ca ironira të tërthorta për Shokun Enver, por, që të mbetemi shokë duhet të përmbahesh, të mos e kritikosh dhe aq më pak ta ironizosh Shokun Enver!"* (Atentatet, f.149*)*

I. Kelmendi, përndryshe shembës i miteve e i idhujve, për shkak të respektit e ndjenjave nuk dëshiron t'ia ironizoj idhujt Jusufit.

I. Kelmendi: "Mirani nuk iu përgjigj sepse e kishte vërejtur që Jusufi e adhuronte Enverin dhe idhulli tjetrit nuk i ironizohet, nëse dëshiron të mos ia cenosh ndjenjat. Idhulli është si profeti për besimtarët." (Atentatet, f.150)

Pas përfundimit të punës së Jusufit me numrin e fundit të gazetës Bashkimi, në dhjetor 1980, Jusufi vazhdon kontaktet me I. Kelmendin dhe i rrëfehet për mendimet e tij që ka ndaj diplomatëve të Shqipërisë në Vjenë dhe Enver Hoxhës dhe ka aq besim në I. Kelmendin sa ky (I. K.) i krijon dilema në këto drejtime.

I. Kelmendi: "Besoj po më kupton se çfarë po mundohem të të ***sqaroj****.*

Mirani u ndal për një çast për të hetuar përshtypjet e Jusufit. Vazhdonte të kishte drojë të thoshte gjithçka që ia diktonte truri. Vazhdonte të frikësohej se mos po ***keqkuptohej*** *dhe pastaj do të hidhërohej tjetri. Prishjen me Jusufin e kishte përjetuar shumë rënd.*

– Thënë të drejtën, edhe kur më ke treguar herën e kaluar, më pate krijuar dilema e iritime, – ia pati Jusufi. – Edhe atëherë kam menduar se kritikat e Simonit duhet të jenë personale dhe jo të Shokut Enver dhe të PPSH-së. Bile, gati i pata shkruar letër Shokut Enver për ato kritika, që ta informoja se çfarë na thoshte një diplomat i shtetit tonë dhe ta pyesja se çfarë do të na këshillonte ai." (Atentatet, f. 187-188)

Do të shohim se besimi e fortësia e karakterit të Jusufit para fjalëve e ndikimit të I. K. është si puhiza, se si i lindë dyshimi në idhullin e vetë Sabri Novosellën. Tani po nën ndikimin e I. K. kemi lëkundjen e dilemat e Jusufit në idhullin e dytë, Enver Hoxhën. Kështu pra vepron me shkathtësi e me shpejtësinë e vetimës në përmbysjen e mitit të Jusufit, shembësi i miteve I. Kelmendi. Para se të shembet idhulli Jusuf duhet që me dyshimin e me gojën e Jusufit të shemben 'idhujt' e tij (të J. G.). Dhe me këtë mbyllet cikli, një i pabesë që nuk beson në histori, në mite, e në legjenda me dimensione të vërtetës nuk mund të bëhet vet mit.

Citati i letrës së mëposhtme fletë pikërisht për sqarime e mirëkuptime përfundimtare.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën.*

i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.* ***Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë..****" (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

-2. Duhet admiruar

Jusufi e ka 'admirua' dhe 'admiron' Ibrahim Kelmendin.

I. Kelmendi: "Jusufi theu heshtjen:

– Të kam ***admiruar*** *dhe të* ***admiroj****, sidomos për faktin që je i hapur karshi meje dhe flet pa vetëcensurë. Në dukje i rreptë, por pikërisht kështu të dua unë."* (Atentatet, f. 159)

Edhe Hysen Gërvalla e **admiron** I. Kelmendin në mënyrën e vetë.

*Gazeta Express: "****Hysen Gërvalla****, vëllai i Jusufit, pas publikimit të intervistës së Ibrahim Kelmendit, të botuar në gazetën Express, ka treguar se e* ***admiron*** *këtë njëri për guximin se i ka hyrë një pune shumë të madhe." (13 mars 2007)*

Salih Kabashi: "*Duke qenë se libri "Atentatet" është një arenë e gjerë ku zbulohen e demaskohen prapaskena të ngjarjeve të ndryshme brenda gjirit të mërgatës sonë, duke qenë se në atë arenë defilojnë rezilë e katilë përballë një mase shqiptarësh të vuajtur dhe* ***të djegur për Atdhe****, duke qenë se në librin e tij e shohim cipërcullak të zhveshur edhe UDB-në gjakatare, edhe mjeranët shqiptarë, të cilët pa ia ditur mirë hallin vetit, ishin futur atje ku e kanë vendin vetëm të mençurit, të ndershmit dhe trimat, duke parë, në fund, se me librin "Atentatet", pothuajse është hequr misteri i atentatit më të bujshëm të UDB-së mbi tre shqiptarë të mëdhenj, duke e nxjerrë në kokër ledine vetë vrasësin, ne, autorit të librit, z. Ibrahim Kelmendi, i jemi drejtuar për një intervistë."* (Republika, prill 2007)

Gruaja e Kadri Zekës, Saime Isufi, e përshëndetë edhe me këto fjalë:

Saime Isufi: "I nderuar Ibrahim, Ka kohë (vite) që nuk jemi parë, por ja që bota është e vogël dhe për të gjallët krijohen mundësi kontakti. Në këtë rast kontakti elektronik. Këtë e bëj, pas leximit të ***veprës*** *tënde* ***historike*** *"Atentatet", për të cilën të* ***përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime****!"* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

Adem Gashi, redaktori i librit Atentatet, tallësi e përbuzësi i mistrecave komunist, si shijues e studiues i stërholluar i estetikës, Ibrahim Kelmendin, armikun më të formuar e më të pjekur të sistemit komunist, të diktaturës komuniste dhe të mistrecave komunistë, shokun organizativ të komunistit Kadri Zeka e **admiron** nga një prizëm krejt tjetër.

Adem Gashi*: "**Jemi goxha burra tashti dhe besoj nuk ma merr për keq. Ç'është kjo shenja në faqe?"*** *(*Epoka e Re, 8 janar 2007)

Jusufi me shijen e estetikës së vet në letrat dërguar Sabri Novosellës dhe Ibrahim Kelmendit, i ka dhënë mendimet përjetësisht aktuale për I. Kelmendin. Edukata e tij nuk e ka lejuar Atë që kurrë të komentoj apo t'i bëjë vërejtje pamjes fizike, fytyrës fizike, të studentit të fizikës Ibrahim Kelmendi. Fizika nuk është ajo lëndë që Jusufit i ka shkuar më së miri. Estetika është ajo me të cilën Jusufi është marrë më së shumti dhe e ka ***admiruar*** më së shumti duke përfshirë në këtë rast sidomos estetikën e shpirtit.

4. Atentatet e mveshura

-1 FJALE PËR LIDHJEN FISNORE ME RAMË NIKQIN
-2. Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?
-3. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?
-4. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan

-5. UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara
-6. Keqardhja për gjynahet e mveshura
-7. Profesioni i mësuesit dhe i pjesëtarit të shërbimeve sekrete
-8. Nuhi Sylejmani është njësoj si Riza Salihu

-1. FJALE PËR LIDHJEN FISNORE ME RAMË NIKQIN

Bedri Islami: - *Pas botimit të romanit "Atentatet" ju u ndodhët edhe një herë në dy kahe: në përgëzimin e shumë prej atyre që i kishin përjetuar ngjarjet bashkë me ju, si Saime Isufi apo Mustafë Xhemajli, por edhe në ciklimin e radhës së sulmit ndaj jush, nëse mund ta quaj kështu. Mes të tjerave, në një material, i cili po përhapet tashti, nuk e di nëse është i saktë, bëhet* ***fjalë për lidhjen fisnore me Ramë Nikqin ose Ibërdemaj****, i cili, siç e cilëson Xhafer Durmishi, me siguri "analisti" më i zellshëm i romanit tuaj, ishte agjent i UDB-së.*

Ibrahim Kelmendi: - *Pas botimit të romanit "Atentatet" ka pasur vërtet reagime të llojllojshme dhe, me thënë të drejtën, më kanë gëzuar. Ato ishin një dëshmi se nuk e kisha shkruar vetëm sa për ta shkruar. Pas dy muajve romani u shit dhe shpesh ndihem keq kur të interesuarit e tjerë e kërkojnë dhe unë nuk kam asnjë kopje. Shtëpia botuese "Toena" e Tiranës ka premtuar ta ribotojë.*

Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohësisht ish-kundërshtar i imi. Sa për shembullin që sollët ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant.

... Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Ibërdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendesohej nëse ishte Ramë Ibërdemaj apo Ramë Nikqi.

...Dihet, dajën nuk e zgjedh dot. Jusufit nuk do t'i kishte shpëtuar kjo lajthitje, edhe po të kishte qenë i pabesë dhe intrigant dhe të kishte përpiluar të tillë "raport" kaq diskreditues, së pari për veten e tij. Pra, kjo lajthitje është prodhuar nga falsifikuesi, i cili ngjan të jetë vetë Xhafer Durmishi, meqë e citon rreth 100 here atë "raport" në "librin" e tij, me titull hileqar e intrigues: "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

...Po ta kishte publikuar këtë "libër" Xhafer Durmishi para se ta kisha shkruar romanin "Atentatet", sigurisht, unë do ta kisha mënjanuar Ramë Ibërdemajn si personazh te romanit, për inat të Xhaferit. Prandaj, edhe për inat të Xhaferit, me këtë rast dua t'u kërkoj falje fëmijëve të respektuar të dajës Ramë, pse e kam diskredituar atë në roman si të dyshimtë për bashkëpunëtor të UDB-së. Vetëm për Haki (Ramë) Ibërdemajn, të cilin një spiun i UDB-se e vrau ne Bruksel, sigurisht qe kisha dhënë një tren me xhafera që të mos e vrisnin, sepse e kishte dëshmuar veten në demonstratat e vitit 1981 ne Prishtinë dhe gjate angazhimit të tij patriotik në Bruksel si trim e patriot i devotshëm!" (Bedri Islami, LËVIZJA, Tetovë 2012, faqe 114-117)

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull " KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim"

-2. Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë histerike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëj vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.
"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)
Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

-3. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të kompromituarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vraçena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shef i shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Pleqësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda: "... Çka u duhet këtyre demonstruesve që kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tëndë, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku. U ka penguar (menohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka ruajtur (nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e dëri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe luga me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i dua (nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtare serbe", "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thën se rugovasit nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrifica për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën...

Nëntitujt dhe përmbajtja e njësive "Çdo të thotë fjala vojvodë?" dhe "Kush është vojvoda Ramë Nikçi?" janë marrë nga shkrimi i Ibrahim Kelmendit me titull " KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim"

-4. Prej gjyshit Ibush deri te djali i Dajës Ramadan

Gjyshi Ibush, Daja Ramadan, dhe Garipi djali i Dajës Ramadan

Ibrahim Kelmendi: *"– Ju kërkoj juve, Zotëri Fekir Dalana, – iu përgjigj sërish me qetësi të madhe*
Mirani.

– Unë nuk jam Fekir Dalana dhe juve nuk po ju njoh fare! – foli ai pa mundur ta fshihte gënjeshtrën e tij naive.

*– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan. Tani sigurisht po të kujtohem. Sa herë ju kam bërë kafe kur vinit te gjyshi **IBUSH** dhe ju me lavdëronit për kafet e mira.*

– O, po, më fal, urdhëro nipash, tani po më kujtohesh, – tha Fekiri duke hapur derën dhe duke u munduar të zgërdhihej sikur po i bëhej qejfi që po e vizitonte Mirani.

Mirani u fut brënda duke u bërë se ishte i gëzuar që po takonte pas shumë vjetëve kolegun e shokun e Dajës Ramadan. U përqafuan dhe Mirani zuri vend aty ku e drejtoi mikpritësi. Ndërruan fjalët përshëndetëse duke pyetur për hallet, jetën etj. Pastaj Mirani hapi bisedën për qëllimin e ardhjes.

– Zotëri Fekir Dalana, të përgëzoj që je zgjedhur kryeredaktor i Organit "Besa Shqiptare". Më është bërë qejfi që jeni zgjedhur pikërisht Ju, meqë ju njoh që moti për patriot. Për ju më ka folur shumë Daja Ramadan dhe bile, kur fola para dy ditëve me të në telefon, më porositi t'ju përshëndes, meqë i tregova se do të vija në Vjenë." (Atentatet, f. 75)

Ibrahim Kelmendi: "*Në Mynhen jemi duke u përpjekur të marrim Klubin "Rilindja". Ai vazhdon të jetë nën tutelën e konsullatës jugosllave. Aty ka qëlluar djali i Dajës Ramadan, Garipi, kryetar, për të cilin ke dëgjuar."* (Atentatet, f.191)

Ibrahim Kelmendi: *"Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "**raport**" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do te ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

Jusuf Gërvalla (raport): "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...*

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen." (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

Jusuf Gërvalla flet, e cilëson Ramë Nikçin si agjent me zile të UDB-së. Ibrahim Kelmendi e demaskon në gjuhën shqipe Ramë Nikçin si Vojvodë e bir Vojvode të kralëve të Serbisë. Unë këtu nuk e di nëse Daja Ramë, si agjent me zile i UDB-së, i Jusufit, a është në të njejtën kohë edhe Daja Vojovodë i Ibrahim Kelmendit, apo Vojvoda dhe agjenti me zile janë dy Ramë Nikça të ndryshëm.

-5. UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara

”UDB-së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara, sepse atëherë mediat do t’ia mvishnin asaj”. Bisedë në mes Jusufit, Hysen Gegës e I. Kelmendit.

*I. Kelmendi: ”– Nga bisedat që kemi bërë me Miranin në Bochum dhe gjatë rrugës, – mori fjalën Vasili, – kam krijuar një version: UDB–ja ka dashur të të zhdukë ty fizikisht dhe të fusë grindje pastaj midis nesh. Jam më se i bindur se urdhërdhënësi do të më kishte **dekonspiruar në ndonjë mënyrë perfide** mua si vrasës. Pastaj mediat këtu do të flisnin për qërim hesapesh midis grupacioneve shqiptare dhe ne do të vazhdonim të vriteshim në emër të hakmarrjes.*

*– Duhet të ketë të drejtë Vasili, – shtoi Mirani. **UDB–së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara, sepse atëherë mediat do t’ia mvishnin asaj**. Pra, asaj më shumë i intereson të organizojë vrasje që do të zbuloheshin dhe pastaj do të komentoheshin si vrasje ndërmjet grupacioneve shqiptare, në mënyrë që dëmtimet dhe përçarjet të ishin të mëdha dhe të vazhdonin për shumë kohë.” (Atentatet, f.120)*

Është befasi shumë e madhe që personi konkret, naivi e i sinqerti I. Kelmendi të flet për plane kaq **perfide** e punë **perfide**, duke na treguar se çfarë atentatesh i interesojnë UDB-së e çfarë nuk i interesojnë.

"**Salih Kabashi**: Në librin tënd ka lloj-lloj personazhesh, disa prej të cilëve, pavarësisht kamuflazhit të hollë që u ke bërë, disa nga ne nuk e kemi aq vështirë t’i identifikojmë. Ndërkohë që edhe më lehtë do ta kenë që aty ta gjejnë veten ata që të mbuluar e gjysmëmbuluar shfaqen gjatë rrëfimit tënd artistik-memoaristik. Cilat janë reagimet e tyre, pasi që, supozoj, nuk do ta kenë lehtë gjatë asaj cope jetë që atyre u ka mbetur?

KELMENDI: Edhe Miranit mund t’i vijë keq për shumë (mos)angazhime të tij, edhe atij i duhet të merret me të kaluarën në pjesën e jetës që i ka mbetur, që do të thotë, edhe Mirani do të më japë llogari mua. Po kështu, edhe personazhet tjera do duhej të ballafaqoheshin me veprimtarinë e tyre. Uroj që t’u ketë mbetur njerëzi e mjaftueshme, që ta përpunojnë njerëzishëm të kaluarën e tyre. Edhe për Rezilin ndjej keqardhje, pasi edhe ai nuk do të ishte i tillë, sikur të mos jetonte në atë hapësirë e kohë, gjegjësisht në ato rrethana. Sigurisht, sikur Kosova të mos kishte qenë e robëruar, sikur të mos kishin qenë ato struktura e mekanizma, që i krijon çdo pushtues, edhe ai do të mund të ishte

njeri pa këto gjynahe që i **mvishen në roman."** (Republika, prill 2007)

Ibrahim Kelmendi*: **"Babai i Kadriut** mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*

*– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu **do të afirmohesha**, **do ta kisha vrarë vetë djalin tim** dhe do t'ia kisha **lënë fajin UDB-së**...." (Atentatet, f.350)*

Saime Isufi*:* "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." *(Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)*

-6. Keqardhja për gjynahet e mveshura

Kështu e pata kuptuar mveshjen e gjynaheve. Atentatet me specialistë të UDB-së do të mbeteshin të pazbuluara derisa të hapeshin arkivat përkatëse.

I. Kelmendi (naiv e i sinqertë)*: "Vetëm në rastet kur nuk mund të kurdisin vrasje me ekzekutues shqiptar, siç kanë planifikuar në këtë rast, atëherë do të bëjnë edhe atentate me specialistë tyre, që do të mbeteshin të pazbuluara, **derisa të hapeshin arkivat përkatëse**." (Atentatet, f.120)*

Shtrohet pyetja: libri *Atentatet* cilën detyrë apo mision e ka? Kush përpiqet të lirohet nga krimi dhe kujt bëhet përpjekja e kot t'i mvishet krimi i vrasjes së trefishtë të 17 janarit 1982? A duhet t'u besojmë arkivave apo jo? Për kend duhet t'u besojmë arkivave shtetërore e për kend duhet t'i besojmë vetëm *arkivit popull*?

I. Kelmendi: "Edhe për Rezilin ndjej keqardhje, pasi ..., edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen në roman."** (Republika, prill 2007)

"Salih Kabashi: Një ditë do të hapen dosjet, ku secili do të ketë mundësi, si në Slloveni, bie fjala, që të ketë qasje në dosjen që ka mundur ta ketë mbajtur për të Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, apo ndryshe policia politike komuniste e njohur si UDB. Kur kihet parasysh se dosje të tilla janë bartur në Beograd, a mund të imagjinosh rrëmujën që do të shkaktonte kthimi i tyre në Kosovë dhe hapja e tyre për publikun?

KELMENDI: Nëse Beogradi nuk do të demokratizohet, atëherë duhet pritur se dosjet do të manipulohen e do të sajohen, varësisht nga nevojat politike ditore, për t'i shërbyer politikës se tyre nacionaliste. E vetmja mundësi për t'ju kundërvënë spekulimeve hileqare është trajtimi i tyre nga ekspertët. Zhvillimi i shkencës ka shkuar deri atje, sa të konstatojë saktësisht se kur është përpiluar një shkresë, gjegjësisht një dosje. Prandaj dhe duhet të shfaqim rezerva, kur ata do t'i servirin. **Kurse arkivi më i saktë është vetë populli, pasi secilit individ ai ia di veprimtarinë konkrete, që do thotë se rrethi ku jam angazhuar unë e di se cili kam qenë dhe çfarë kam bërë....** "(Republika, prill 2007)

Ja se çfarë dokumenti të saktë ka ruajtur arkivi popull dhe rrethi, për veprimtarinë konkrete të I. Kelmendit.

*I. Kelmendi: "Sadik ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë**. Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija...*"(Letër dërguar Sadik Blakajt, 21 janar 1981, botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

Jusuf Gërvalla (për Ibrahim Kelmendin): "*Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport për Komitetin e Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Me fjalë tjera hapja e arkivave përkatëse mund të zbuloj operacionin e vrasjes së Jusufit e Bardhit, por këtyre arkivave nuk duhet t'u besojmë nëse sjellin të vërtetën për rolin e Ibrahim Kelmendit në këtë operacion.

Testimi i opinionit me anë të mveshjeve.

Mendime të "papjekura e naive" të I. Kelmendit për përpunimin e të tjerëve.

I. Kelmendi: "Gjërat nuk thuhen vetëm sa për t'i thënë, por thuhen për të arritur qëllimin. Nëse i thua të gjitha pa metodikë e takt, papërshtatshëm në hapësirë e kohë, mund të arrish të kundërtën e asaj që synon. Duhet vlerësuar gjendjen e disponimin e atij që dëshiron t'i flasësh." (Atentatet, f.160)

Ilustrim konkret i mendimeve më lartë janë fjalët më poshtë:

Ibrahim Kelmendi: 'Obligimi im moral është që të ***testoj opinionin****...' (Gazeta Express, 11 mars 2007).* Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman...' (Republika, prill 2007)

Është interesant se I. K. ka arritur ta shpëtoj Jusufin prej atentatit të Hysen Gegës e nuk ka mbërri ta shpëtoj prej atij të Rezilit. " UDB–së më pak i interesojnë atentatet e pazbuluara, sepse atëherë mediat do t'ia mvishnin asaj."

-7 Profesioni i mësuesit dhe i pjesëtarit të shërbimeve sekrete

"Është pothuajse njësoj të jesh mësues ose pjesëtar i strukturave policore dhe shërbimeve sekrete"

I. Kelmendi*: "Do të thotë, është pothuajse* ***njësoj*** *të jesh* ***mësues*** *ose pjesëtar i* ***strukturave policore dhe shërbimeve sekrete.*** *Mësuesi u mëson fëmijëve, ta zëmë këngën për Titon ose për Enverin, polici kujdeset të kontrollojë fëmijët kur të rriten, nëse mësuesit nuk i kanë edukuar në frymë të sistemit përkatës. Në rastin konkret, të mos u kundërvihen Titos ose Enverit." (Atentatet, f.126)*

Saime Isufi*: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen..." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)*

Mehmet Hajrizi*: "Saime Isufi: Ka mbaruar Fakultetin e Histori-Filologjisë, dega Gjuhë e Letërsi Shqipe. Ka punuar si mësuese e mësimit plotësues në Zvicër dhe*

sekretare e Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Zvicër..." (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 378)

Banesa e Murat Kryeziut në Nord-West-Ring 30, në Bernhausen ku në dy orët e para të 17 janarit u shikua filmi "Mësonjëtorja" (Fotografoi Faridin Tafallari)

Këtu vlen të theksohet se në mesnatë, në dy orët e para të 17 janarit 1982 (nga 00-02), në Bernhausen, në banesën e Murat Kryeziut në Nord-West-Ring 30, 70794 Filderstadt, Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi dhe 15-16 aktivistë tjerë, në kohën kur operacioni i UDB-së ka qenë në kulmin e veprimit, kanë shikuar filmin "Mësonjëtorja", ku përshkruhet heroizmi i një mësueseje, Dafinës - Roza Anagnosti, dhe atyre që e kanë mbajtur gjuhën shqipe të gjallë. Çfarë tereni tentohet të përgatitet me barazimin e misionit të Dafinës me misionin e pjesëtarëve të strukturave të UDB-së.?

-8. Nuhi Sylejmani është njësoj si Riza Salihu

I. Kelmendi (modest e naiv) tregon për mospërvojën e Jusufit ndaj luftës speciale të shërbimeve sekrete.

I. Kelmendi: "Jusufi ende nuk kishte informata të mjaftueshme sesi bëhet lufta speciale e shërbimeve sekrete dhe nuk kishte bërë as përvojë praktike sesi duhet mbrojtur nga ato."(Atentatet, f.151)

*I. Kelmendi: "E treta, përgojimet nga të apostrofuarit janë shumë të ngjashme me shpifjet e Rezilit për ty. Në rastin tim tani ata nuk janë aq brutal sa në rastin tënd, sepse nuk jam intelektual i nivelit tënd. Për **Xhahilin e Qerosin** mendoj se janë si **Rezili**, por aktualisht me role të tjera. Proletari, që mban publikisht pseudonimin e Enver Hoxhës, Shpati, është një demagog maniak. Ti mund të dëgjosh shpifjet që përhapin ata, por nuk të ka hije që të ndikohesh nga ato. Ne do të duhej t'i diskutonim shpifjet e tyre*

menjëherë dhe të gjenim metodat praktike, sesi t'i përballojmë ato dhe si t'i izolojmë ata." (Atentatet, f.154)

I. Kelmendi (modest e naiv) i mban ligjëratë Jusufit, për atë se çka i ka hije dhe çka nuk i ka hije Jusufit: "*Ti mund të dëgjosh shpifjet që përhapin ata, por nuk të ka hije që të ndikohesh nga ato.*"

Nga kjo rrjedhë se Jusufi, përveç ndihmës vendimtare që ka dhënë në nxjerrjen e "Bashkimit" vazhdimisht ka diskutua për gjëra nga më të llojllojshmet me I. Kelmendin. Se Jusufi me I. K. ka diskutuar gjëra që kanë të bëjnë me Gjermaninë veriore ku ka qëndrua I. K.

Jusufi nuk ka diskutua kurrë gjëra organizative për rrethin e Shtutgartit dhe për asnjë rreth tjetër pasi ai nuk ka qenë kurrë në një organizatë me Ibrahim Kelmendin. Jusufi nuk ka bisedua e bërë kompromise me I. Kelmendin për asnjë fjalë të vetme të tre numrave të fundit të botuar në revistën Bashkimi, pasi Ibrahim Kelmendi nuk e ka pas kapacitetin teorik e intelektual për të diskutuar vijën politike. Por kjo nuk do të thotë se I. Kelmendi (si dhe shumë të tjerë) mangësitë e veta teorike, ideore e intelektuale të mos i kompensojnë shumëfish me dinakëri praktike.

I. K. përveç Rezilit e Xhahilit (Xhavitit-pagëzuesit të Frontit të Kuq) e quan udbash Nuhi Sylejmanin-Nuriun person që ka qenë afër Jusufit deri në vdekjen fizike të tij.

I. Kelmendi: "Prandaj po ndërmerr masa preventive duke organizuar rrjet të dendur të udbashëve dhe informatorëve të tyre. Shumë nga këta janë të kamufluar si mësues, si diplomatë, si gazetarë dhe si kategoria e Rezilit, Xhahilit, Nuriut, gjegjësisht Qerosit." (Atentatet, f.159)

5. Rasti është mbreti i botës

-1. Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës
-2. Duke më provokuar të humb durimin
-3. Vazhdimi i gjendjes deri në festën e 28 Nëntorit 1980

-1. Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës

Ibrahim Kelmendi, 'rastësisht' takohet me Jusufin dhe Bardhin në një parking të një bashkatdhetari në Munchen. Është tepër çudi se si Jusufi në vend që të fluturojë nga gëzimi se e sheh 'shokun më të ngushtë', të cilit ia ka treguar gjithë historinë e gjërat më të imëta të Lëvizjes së vet, e para të cilët shumë herë (sa ai ka harruar edhe sa herë) është rrëfyer për raportin e tij me 'idhujt' e vetë, në fjalët e para të I. K. i cili pas fjalisë, 'Nuk thuhet kot se rasti është mbret i botës' mendon dhe e pyet Jusufin se mos ia kanë mësy tek një bashkatdhetarë me emrin Bardhec, Jusufi i përgjigjet:

I. Kelmendi: *" – Mirëmbrëma! Nuk thuhet kot se* ***rasti është mbret i botës****. Ja ku u takuam. A kemi ndonjë të re? Mos edhe ju jeni mysafirë te Bardheci?*
– Nuk e njoh këtë farë Bardhecin, – tha Jusufi i nevrikosur, – paskan të drejtë ata që më kanë thënë se ti po më survejon intensivisht." (Atentatet, f.172)

> Jusuf Gërvalla (për Ibrahim Kelmendin): "*Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen."* (Raport për Komitetin e Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Ky takim në Munchen, mund të ketë qenë fare i rastësishëm. Çdo kujt i ndodhin rastësi. E pse nuk duhet t'i lejohet edhe I. Kelmendit ndonjë rastësi. Ne e kemi pa edhe më lartë se si sipas I.K , Xhahilit-Xhavitit, informatorit të UDB-së i ka rastisë të angazhohet në 'Frontin e Kuq' dhe jo vetëm kaq por edhe i ka rastisë t'ia ngjet pikërisht ai organizatës së Ibrahim Kelmendit emrin tepër bombastik dhe tepër provokativ "Fronti i Kuq", dhe I. Kelmendit i ka rastisë të mos e ndryshoj këtë emër provokativ e të distancohet nga ai gjer më 5 shkurt 2007. Ibrahim Kelmendi rastësisht ndodhet në Esslingen kur Hysen Gega e Sadik Blakaj nisen për në Kosovë më 19 dhjetor 1980.

-2. Duke më provokuar të humb durimin

I. Kelmendi (naiv e i sinqertë) i jep këshilla dhe ia tërheq vërejtjen Jusufit.

I. Kelmendi: "Miranin e hidhëroi kjo sjellje dhe ky fajësim që i bëri Jusufi:

– E ke gabim dhe nuk po të ka aspak hije të sillesh kështu ***përçudshëm****,* ***duke më provokuar të humb durimin." (****Atentatet, f.172)*

Jusufi ia ndërprenë ndihmën Ibrahim Kelmendit.

I. Kelmendi: "Pas dy ditësh Jusufi i shkroi letër Miranit ku i komunikonte ndërprerjen e bashkëpunimit. Ndër arsyet kryesore përmendte survejimin dhe aventurat e përpjekjes për blerje të armëve." (Atentatet, f.174)

Jusufi ia ndërprenë ndihmën dhe nuk ka kontakte me Ibrahim Kelmendin nga maji gjer në fund të nëntorit 1980. I. K. edhe pse i provokuar nga sjellja e përçudshme e Jusufit deri në kufirin e humbjes së durimit i shkruan atij se është i interesuar për rivendosjen e bashkëpunimit.

I. Kelmendi: "Mirani i shkroi sërish duke ia rikujtuar se ai ishte i interesuar të rivendosej bashkëpunimi. ***Prapë nuk mori përgjigje****."(Atentatet, f.174)*

Është çudi e madhe se pse nuk ju ka përgjigj Jusufi kur ai veç e ka pa se I. Kelmendi është afër humbjes së durimit, se durimi i tij nuk është i pakufi.

-3. Vazhdimi i gjendjes deri në festën e 28 Nëntorit 1980

I. Kelmendi: "Kjo gjendje vazhdoi derisa Jusufi e Mirani u takuan në festën e 28 Nëntorit, në Nürnberg. Në manifestim Jusufi bëri një diskutim, jo fjalim, por shumë përmbajtësor. Që të dy kishin presion nga Vasili e Maksi për të rivendosur bashkëpunimin. Ata me të dy mbanin lidhje dhe iu bënin përherë lutje që të pajtoheshin e të bashkëvepronin." (Atentatet, f.174-175)

Këta rreshta dëshmojnë se Jusufi, prej fundit të majit 1980 gjer kah fundi i nëntorit 1980 nuk ka asnjë lidhje me I. Kelmendin. Gjatë kësaj periudhe kemi fakte të publikuara se I. Kelmendi i dërgon një letër Jusufit, në të cilën Jusufi përgjigjet. Ky këmbim letrash është i muajit tetor 1980. Disa fjalë nga kjo letër:

Jusuf Gërvalla: "Po ashtu, ,,përkundrazi", i nderuar shok Ibrahim!

Kështu duket titulli-pasthirrmë i letrës sime, që i përgjigjet besnikërisht tëndes. Edhe sa e sa gjëra të tjera të çuditshme do të kishim, sikur unë t'i përgjigjesha pikë për pikë gjithë përmbajtjes së letrës sate. Ndoshta para teje me edhe s'do të kish pasur gjë të keqe, por të na çuditej bota për rasat nëpër të cilat ditka të lakohet mendimi i sotëm i revolucionarit shqiptar.

Megjithatë, për mua që më drejtohet ai titull dhe ajo letër, ka fare pak paqartësi, sepse ne u takuam dhe u njohëm dhe është punë e kotë dhe ndoshta absurde ta injorojmë këtë njohje.

E mora me mend (e spikat edhe në letrën tënde) ç'mundime ke pasur të më shkruash në "nivelin" tim, sikur. thua se vetëm në "nivelin" tim të shkrimit paska për mua afrim,

respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)" (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Deri më sot, me aq sa dihet, kjo letër e Jusufit e muajit tetor 1980 është letra e parafundit që Jusufi ia dërgon I. Kelmendit. Letra tjetër e radhës, është ajo e fundit, e ditës së premte, më 15 janar 1982. Siç shihet, në vitin historik 1981, të Pranverës 81, Jusufi nuk këmben asnjë letër të vetme me I. Kelmendin. Fjalët e dëshmitë më interesante të kësaj kohe, (pra të vitit 1981) i kemi të shkruara në letrat që Jusufi ia dërgon shokut të Lëvizjes së vet, Sabri Novosellës.

6. Lajmëtari i lirisë

-1. Në këtë gjendje
-2. Porosia e Jusufit për Hysen Gegën
-3. Ilegale e botuar në Zvicër
-4. E pa definuar dhe e paidentifikuar

-1. Në këtë gjendje

Jusufi në një gjendje afekti e izolimi prej I. Kelmendit, në një gjendje "që nuk i ka aspak hije të sillet kështu përçudshëm" nisë botimin e revistës 'Lajmëtari i lirisë'.

I. Kelmendi: "Në këtë gjendje Jusufi nisi botimin e revistës Lajmëtari i lirisë." (Atentatet, f.174)

Ja si mundohet ta prezantoi I. Kelmendi prishjen e Jusufit me te.

I. Kelmendi: "Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Ka qenë plani i UDB-së të kërcënohet Jusufi deri në heshtje e vetizolim. Ka qenë dëshira e figurës frontale të Frontit të Kuq që Jusufi të mbyllet në lëkurën e vetë. Pikërisht në këto momente ai shkruan ndër artikujt më të fuqishëm e më të mirë kundër pushtetit të UDB-së dhe mashave të saj.

-2. Porosia e Jusufit për Hysen Gegën

Jusufi kërkon nga Hysen Gega që të mos i tregoj I. Kelmendit se ai (J.G.) e boton 'Lajmëtarin e lirisë'

I. Kelmendi: "Jusufi e kishte porositur Vasilin që të bënte shpërndarjen e Lajmëtarit të lirisë, por të mos i tregonte Miranit (Ibrahim Kelmendit-shën. Xh. D.) se kush po e botonte." (Atentatet, f.175)

Lajmëtari i lirisë ka qenë dhe ka mbetur revistë personale e Jusufit. Në këtë revistë, përveç një shkrimi të Hasan Ukëhaxhajt dhe një apo dy shkrimeve tjera të LNÇKVSHJ, me përjashtim të artikujve me nënshkrime të vërteta të autorëve nga Shqipëria, të gjithë artikujt (me pseudonime të shpikura apo të panënshkruar) janë të Jusufit. Me këtë

revistë nuk ka pasë të bëjë në asnjë mënyrë të vetme as Ibrahim Kelmendi dhe askush tjetër.

-3. Ilegale e botuar në Zvicër

Është për t'u çuditur se pse Ethem Çeku i cili ka shkruar në shumë pika mirë e saktë për Jusufin, të bëjë një gabim kaq trashanik kur shkruan rreshtin si më poshtë:

Ethem Çeku: *"Lajmëtari i lirisë, nr. 3 1980**, ilegale e botuar në Zvicër**." (Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë, 1945-1981, Prishtinë 2003, f. 207)*

Jusuf Gërvalla: *"Më ke pyetur si qëndrojmë me çështjen financiare, lidhur me nxjerrjen e gazetës. Numri i parë (i Lajmëtarit të lirisë, gusht 1980-shën. i Xh. D.), i cili është radhitur e shtypur krejtësisht në një shtypshkronjë, e që është e natyrshme që ka dalë teknikisht më së miri, ka kushtuar 2540 mark. Ky ishte një çmim shumë i lartë sa të mund ta përballoja, madje edhe me pjesëmarrjen modeste të disa njerëzve që u treguan të gatshëm të ndihmojnë (pa e ditur për çka është fjala). Prandaj, bashkë me vëllaun vendosëm **ta marrim me kredi një makinë shkrimi të përshtatshme** (është kjo, me të cilën po ta shkruaj letrën dhe me të cilën **janë radhitur dy numrat e fundit të "Lajmëtarit të lirisë**"). **Makina kushtonte relativisht pak (5080 mark)** dhe, me disa funksione elektronike që kryente, jepte mundësi të nxirrej disi revista, sado që mua më ngarkonte shumë, sepse, pos që i shkruaja të gjithë artikujt, më duhej edhe t'i radhitja e t'i përgatisja teknikisht të gjitha faqet. Por, shpenzimet që mbeteshin për t'iu paguar shtypshkronjës në procesin e mëtejshëm të shtypjes e të shumëzimit të revistës, ishin shumë të vogla, vetëm 600 mark." (Letër Sabri Novosellës, më 13 maj 1981. Marrë nga* Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 264*).*

Jusuf Gërvalla: "*Deri më tash, dy numrat e revistës i kam paguar me të hollat e mia, sikurse edhe makinën e shtypit, gjithsejtë mbi 9.000 DM, kurse kontribute nga shokët kam marrë gjithsejtë 1.300 DM.) Për këtë arsye, numri i parë (për këtë vit) më ka ndenjur qe më se dy javë i gatshëm, sepse nuk kisha të holla ta dërgoja në shtyp."* (Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasje e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30)

Se kjo gënjeshtër skandaloze e Ethem Çekut në faljen e vjedhjen e punës së Jusuf Gërvallës, se gjoja 'Lajmëtari i lirisë' ka dalë në Zvicër, nuk është e rastit tregon 'zbulimi' i tij ku në faqe 233 të të njëjtit libër thotë:

Ethem Çeku: *"E kësaj natyre është edhe përmbledhja e kritikave me mbititull Perditio tua, Israel ex te, e cila botohet tek Liria e më pastaj u botua edhe në Zërin e Kosovës. - Liria, tetor 1980, nr. 1, faqe 1-3, 13-14." (Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, f. 233)*

Perditio tua, Israel ex te, është kryeartikulli i numrit të parë të Lajmëtarit të lirisë, të Jusuf Gërvallës, i botuar në Shtutgart të Gjermanisë, në gusht 1980. Ky artikull nuk është ribotuar kurrë as në revistën Liria e as në Zërin e Kosovës.

-4. E pa definuar dhe e paidentifikuar

I. Kelmendi: "Megjithatë kishte vendosur ta nxirrte revistën Lajmëtari i lirisë, e cila ishte e padefinuar dhe e paidentifikuar. Nuk kishte të evidentuar botuesin, qoftë ai subjekt, qoftë ndonjë individ." (Atentatet, f.185)

Vërejtje shumë interesante. Ky fakt mund t'i ketë mërzitur më së shumti agjentët e UDB-së, si në Kosovë ashtu edhe në Gjermani, por jo edhe lexuesit e Lajmëtarit. Ky fakt jo që nuk i ka mërzitë por edhe i ka kënaq disa që janë munduar të thonë se kanë hise në revistën personale të Jusufit apo që janë munduar ta plasojnë botimin e saj në

Zvicër dhe të vjedhin artikuj të Lajmëtarit.

Jusufi ia jep bakshish I. Kelmendit gjysmën e punës së tij në *Lajmëtarin e lirisë*. Nuk thuhet kotë se kur ta ngrënësh pulën e huaj lidhe tënden për këmbë të magjes apo të shporetit.

I. Kelmendi:(fjalë të atribuara Jusufit) "Nxorëm dy numra të Lajmëtarit të lirisë, të cilët janë shpërndarë e mirëpritur." (Atentatet, f.190)

Edhe një herë na shfaqet harresa e famshme e Jusufit. Më herët kemi pa se Jusufi e porosit Hysen Gegën dhe shokë tjerë në Shtutgart që të mos i tregojnë I. Kelmendit se ai qëndron pas Lajmëtarit të lirisë.

I. Kelmendi: "Jusufi e kishte porositur Vasilin që të bënte shpërndarjen e Lajmëtarit të lirisë, por të mos i tregonte Miranit se kush po e botonte." (Atentatet, f. 175)

Jusuf Gërvalla: *"Me I. (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) dhe H. (Hysen Gegën-shën i Xh. D.) kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin", **t'i përpunoj** (do me thënë **jo redaktoj** por ndryshoj e rishkruaj për 90 për qind-shën i Xh. D.) materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo."* (Letër Nuhi Sylejmanit kah fundi i janarit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30)

Ibrahim Kelmendi: *"Tani, nëse keni tubuar përpara, do të ishte e mira së mirës, por nëse jo, atëherë bëje këtë me urgjencë, pse "Bashkimi" do të dalë më rregullisht se përpara. **Po ashtu, deri sa të del edhe "Lajmëtari i lirisë", jemi dakorduar që ta ndihmojmë në financim dhe shpërndarje."*** (Letër Faridin Tafallarit, 21 janar 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 408-409)

Marrëveshja të cilën e përmend Jusufi më poshtë me Ibrahim Kelmendin dhe Hysen Gegën duhet të jetë e muajit nëntor 1980, sepse Jusufi e fillon angazhimin në gazetën Bashkimi pa ndonjë kusht, në shkurt, prill e maj 1980, në kohën kur Lajmëtari i lirisë nuk ka ekzistua, dhe fillon me botimin e Lajmëtarit e lirisë pa marrëveshje me Ibrahim Kelmendin. Burgosja e Hysen Gegës i prishë të gjitha planet në këtë drejtim. Fati i Hysenit e vulosë fatin e "Frontit të Kuq".

7. Gazeta "Bashkimi" dhe Fronti i Kuq

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi
-2. Shkak qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim
-3. Madje në gjendje të keqe
-4. M'u afrua e më ofroi bashkëpunim
-5. Kishte vendosur të mos kontribuonte
-6. Deri në sqarim dhe rikthim të marrëdhënieve të mëparshme
-7. Artikulli "Bashkimi bënë fuqinë" i Jusuf Gërvallës
-8. Me gjasë ky do të jetë numri i fundit i Bashkimit
-9. Nga ky numër gazeta jonë do të dalë rregullisht
-10. Me gjasë të lazdrova kur ta lavdërova
-11. Bakshishi për Jusufin

-1. Shkas qe ardhja e fshehtë e gazetës Bashkimi

Ibrahim Kelmendi*: "Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar **Xhavitin**, meqë për te krijova përshtypje se **ishte informator i UDB-së**, i urdhëruar për t'u anëtarësuar në PKGj/M-L, që të informonte për veprimtarinë e kësaj partie komuniste sigurimet e fshehta jugosllave dhe gjermane.*

Kurse për Proletarin formova përshtypjen se ishte një dogmat primitiv."(Atentatet, f.40

Xhahili (Xhaviti), informatori i UDB-së propozon emërtimin "Fronti i Kuq"

I. Kelmendi:" ***Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion",*** *etj. Proletari propozonte ta quanim "Partia Komuniste e Kosovës /Marksiste-Leniniste", duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. ...Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë* ***avullnetshëm*** *u dakordova me propozimin e tyre.* ***Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues." (****Atentatet , f.41-42)*

I. Kelmendi*: "Jusufi: Me gjasë sigurimi famëkeq jugosllav, që ende po e quajmë UDB, na kishte rënë në gjurmë të organizimit tonë ilegal. Shkas për të qe ardhja fshehtë e gazetës* Bashkimi*, shpërndarja gjithashtu e fshehtë dhe ideja që na lindi se mund e duhet të organizohemi për t'u çliruar nga pushtuesi." (Atentatet, f.53)*

Shumë fakt interesant e vërejtje interesante. Ideja për t'u organizuar në luftë për çlirim e kundër UDB-së, Jusufit i paska ardhë nga organizata e bashkëthemeluar dhe tërësisht e pagëzuar prej Xhahilit. Se pa i ra në dorë Jusufit gazeta "Bashkimi" si organ i organizatës me emrin tepër provokues "Fronti i Kuq" të caktuar nga informatori i UDB-së Xhahili, Jusufit i paska mungua ideja se mund dhe duhet të organizohet për t'u çliruar nga pushtuesi, d.m.th. nga UDB-a.

-2. Shkas qe angazhimi i fshehtë i shokut Bashkim

Jusuf Gërvalla: "*E diel, 30 dhjetor, 1979*
ora 00.45 Ludwigsburg

Pardje dy javë, më 14 dhjetor, natën vonë e braktisa Prishtinën dhe Kosovën.

Aty nga ora 16, erdhën në "Rilindje" Suzana me Kadri Rexhën dhe më prunë lajme të hidhura.

Atë ditë herët në mëngjes, e paskëshin burgosur Hysenin; i kishin gjetur materiale të shtypura të Lëvizjes. Dina, i cili e kishte sjellë lajmin për Hysenin, i gjen punëtorët e SPB-së duke ma bastisur banesën.

... Shoku i Lëvizjes, Bashkim Prishtina (Sabri Novosella-shën. i Xh. D.), qe i mendimit se është shumë më mirë të arratisem, se sa të bie në burg: edhe dënimi do të kish qenë i rëndë, edhe do të rrezikohej eventualisht organizata." (Pjesë nga ditari i Jusufit, i shpërndarë nëpër shokë nga familja e Jusufit-shën i Xh. D.)

-3. Madje në gjendje të keqe

I. Kelmendi*: "Për mua kjo gazetë, e shpërndarë në përmasa si asnjëherë tjetër deri tani, ka qenë motiv i fuqishëm që të angazhohem konkretisht dhe të mos rri në pritje, siç është bërë shprehi e shumicës se intelektualëve."* (Atentatet, f.58)

Sa i përket përshtypjes që Jusufi ka për numrin e parë të Bashkimit, të verës 1979, me 73% të përmbajtjes të huazuar nga Enver Hoxha apo të dalur nga censura e tij, Jusufi shprehet kështu:

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin."* (Raport për Sabri Novosellën, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Në fillim të qëndrimit tim këtu,* ***më ofroi*** *bashkëpunim me gazetën "Bashkimi", organ i Frontit te Kuq Populllor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull,* ***madje në një gjendje të keqe,*** *unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra (të cilët po t'i dërgoj menjëherë – te artikujt e shkruar prej meje po e vë nga një shenjë)."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981)

Mos me pas qenë gazeta Bashkimi e "Frontit të Kuq" i emërtuar me emrin tepër bombastik e provokativ, nga UDB-a, ka qenë tepër rrezik që Jusufit t'i mungoj motivi për t'u angazhuar në organizatën Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi apo ta harroj grabitjen e tokës së babës e gjyshit të vetë nga kolonët serbo-malazez.

-4. M'u afrua e më ofroi bashkëpunim

Është me rëndësi të shohim se si ka ndihmuar Jusufi në përgatitjen për botim të Bashkimit?

Ibrahim Kelmendi, në verën e vitit 1979 e ka botuar numrin e parë të Bashkimit, si organ i Frontit të Kuq, me rreth 73 për qind të fjalëve të huazuara nga Enver Hoxha drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte, të botuara pasi e kanë kaluar censurën e penës së tij, dhe me 27 për qind fjalë 'origjinale' të Frontit të Kuq.

Pas daljes së Jusufit, I. Kelmendi e kërkon Jusufin përmes Bardhit, i ***afrohet*** dhe i **ofron** bashkëpunim me gazetën 'Bashkimi'. Për këtë farë ***afrimi e ofrimi*** i shkruan Jusufi Sabri Novosellës në letrën e tij të parë më 14 prill 1981.

Jusuf Gërvalla: "Në fillim të qëndrimit tim këtu, ***më ofroi*** *bashkëpunim me gazetën "Bashkimi", organ i Frontit te Kuq Populllor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull,* ***madje në një gjendje të keqe****, unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra (të cilët po t'i dërgoj menjëherë – te artikujt e shkruar prej meje po e vë nga një shenjë)." (Letër S. Novosellës, 14 prill 1981)*

I. Kelmendi para planifikimit të ndonjë numri i ka marrë disa shkrime të veta, i ka futë në çantën e krahut dhe ia ka sjellë Jusufit në Ludwigsburg. Jusufi i ka marrë shkrimet e tij (se çfarë gjendje ideore e strukture mendimesh mund të kenë pasur, mund ta marrim me mend nga libri Atentatet përkundër redaktimit nga Adem Gashi dhe leximit në dorëshkrim prej Mustafë Xhemailit, Bedri Islamit e Shaban Sinanit), i ka ndryshua deri mbi 80-90 % sa që prej shkrimeve origjinale nuk ka mbetur asgjë përveç ideve e koncepteve fillestare për shkrimet e tilla. Përveç kësaj pune 'redaktuese' të rishkrimit e përpunimit të artikujve të I. Kelmendit duke i ndryshuar për 80-90 %, Jusufi i ka shkruar kryeartikujt dhe artikuj tjerë vendimtarë që ia kanë dhënë formën Bashkimit. Këtë punë ai e ka bërë vetëm në Ludwigsburg, apo për numrin e fundit në dhjetor 1980 në Untergruppenbach. Në këtë punë I. Kelmendi nuk ka mund t'i ndihmojë. Jusufi nuk i ka diskutua formulimet e veta me shkrim me I. Kelmendin. Ai i ka bërë të gjitha të gatshme dhe I. Kelmendi i ka pranuar. Ndonjë artikull, si artikullin për Renegatin (të botuar në Lajmëtarin e lirisë në gusht 1980) I. Kelmendi nuk ka dashtë ta ketë në Bashkimin, dhe Jusufi nuk ia ka imponuar asnjë shkrim, por gjithashtu shkrimeve të tij, qoftë si "redaktime", përpunime d.m.th. ndryshime 80-90 %-she qoftë të vetave që nga fillimi, nuk ka lejuar t'u ndryshohet asnjë germë. Kjo është pra forma me të cilën Jusufi ka "bashkëpunuar" në botimin e Bashkimit.

Nga shkurti deri në prill 1980, Jusufi e përgatitë për shtyp numrin 2 e 3 të gazetës Bashkimi si organ i Frontit të Kuq. Në mesin e majit Jusufi autorizohet ta shkruaj "Programin dhe Statutin e Fronit të Kuq Populllor".

Nga mesi i majit deri më 28 nëntor 1980 Jusufi nuk ka kurrfarë bashkëpunimi me Ibrahim Kelmendin. Nga fillimi deri në mesin e dhjetorit 1980 Jusufi e përgatit numrin e fundit të gazetës 'Bashkimi'.

I. Kelmendi*: "Gjatë festës Jusufi e Mirani u pajtuan dhe u morën vesh që të botonin numrin tjetër të Bashkimit.* ***Gjatë dhjetorit*** *e përgatitën bashkërisht dhe e dorëzuan në shtyp, duke i vënë në ballinë njoftimin: 'Viti i 3–të i botimit, nr. 1, janar 1981'"* (Atentatet, f.175)

-5. Kishte vendosur të mos kontribuonte

Jusufi vendosë të mos kontribuoj në nxjerrjen e gazetës Bashkimi për shkak të mungesës së lidhjeve me shokët e Lëvizjes së vet në Kosovë.

I. Kelmendi*: "Kështu kishte vepruar ai për shkak të shkëputjes se çdo lidhjeje me organizatën në të cilën ishte anëtarësuar në Kosovë dhe për shkak se kishte vendosur* ***të mos kontribuonte për në nxjerrjen e gazetës Bashkimi****."* (Atentatet, f.185)

Jusufi nuk i ka marrë leje askujt kur ka vendosur me e ndihmua gazetën Bashkimi dhe Ibrahim Kelmendin kur ky ia ka kërkua ndihmën, iu ka afrua dhe i ka ofrua bashkëpunim me gazetën Bashkimi. Edhe kur ka ardhur koha, kur Jusufi, vjen në përfundim se Ibrahim Kelmendi nuk e meriton ndihmën e tij, dhe nën dyshimin e bazuar se në qendër të Frontit të Kuq qëndron UDB-a, e ka ndërpre në mënyrë të njëanshme ndihmën për Bashkimin, që ka rezultuar në mosdaljen e Bashkimit.

Shkaku vendimtar që ka ndikuar në atë që Jusufi ta kuptoj se çka fshihet pas Frontit të Kuq, dhe kush mund të jetë I. Kelmendi, është dorëzimi i Hysen Gegës në duart e UDB-së, përmes agjentit Sadik Blakaj.

Jusuf Gërvalla: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha marrëdhëniet*** *me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë. Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë.."(Letër Sabri Novosellës më 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

-6. Deri në sqarim dhe rikthim të marrëdhënieve të mëparshme

I. Kelmendi nuk përpiqet ta nxjerrë *Bashkimin* derisa të sqarohet me Jusufin.

I. Kelmendi: "Edhe Mirani nuk ishte përpjekur ta nxirrte Bashkimin, derisa të sqarohej me Jusufin dhe t'i rikthenin marrëdhëniet e mëparme." (Atentatet, f.185)

Të shohim se si është 'sqaruar' I. Kelmendi me Jusufin dhe se i ka 'rikthyer' marrëdhëniet e mëparshme nën ndikimin e demonstratave të vitit 1981 të cilat e çuan në këmbë gjithë kombin shqiptar dhe opinionin botëror.

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit"(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari,*

Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Shtrohet pyetja: Në cilën datë, në cilin vend dhe në cilën mënyrë u sqarua Jusufi me I. Kelmendin dhe i riktheu marrëdhëniet e mëparme?

Jusufi pas këtij vlerësimi për Frontin e Kuq Popullor, pas dorëzimit të Hysen Gegës në duart e UDB-së, u sqarua përfundimisht në këtë pikë dhe me Ibrahim Kelmendin nuk i riktheu marrëdhëniet e veta të mëparshme me te as për së gjalli e as për së vdekuri.

-7. Artikulli "Bashkimi bënë fuqinë" i Jusuf Gërvallës

Që në fillim e potencoj se ata që duan ta kenë një pasqyrë të qartë rreth artikullit të Jusuf Gërvallës "Bashkimi bënë fuqinë" të botuar në numrin e fundit të gazetës "Bashkimi" organ i Frontit të Kuq Popullor dhe tentimit për vjedhje të këtij artikulli programatik nga ana e Ibrahim Kelmendit, për ta kuptuar të vërtetën mund ta lexojnë këtë artikull dhe krahasojnë me "Programin e Frontit të Kuq - të bazuar në librin Atentatet" që gjenden në faqen www.pashtriku.org.

Jusufi e lavdëron I. Kelmendin për kryeartikullin e numrit të fundit të gazetës Bashkimi me titull ”Bashkimi bënë fuqinë” i cili është i shkruar në nivel të shkëlqyeshëm.

*I. Kelmendi: ”– Miran, kryeartikullin e këtij Bashkimi e kishe shkruar në nivel të shkëlqyeshëm. Më ka pëlqyer jashtë mase, – kishte nisur **bisedën e punës** Jusufi. – Nuk e kisha të vështirë ta redaktoja si herave të tjera.*

– Po ma bënë qejfin? – pyeti tjetri (I. Kelmendi-shën ynë).” (Atentatet, f.185)

Jusuf Gërvalla: "*Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të **çoroditura** për numrin e ri të "Bashkimit". Ndërsa ishim duke punuar në këtë numër (që Mërgimi e ka veçuar si më të mirin), ai në ndërkohë e kishte lejuar Hysen Gegën të shkonte për kryerjen e një aksioni në Kosovë."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusufi jo vetëm që bënë biseda pune por bënë edhe mbledhje vjetore me Ibrahim Kelmendin, ku bëhet analiza e punëve të vitit 1980 dhe planifikohet aktiviteti për vitin 1981.

I. Kelmendi: ”– Qenke i disponuar për të folur për gjera që i kemi diskutuar përciptazi dikur, por që unë më me ëndja nuk do t’i kisha diskutuar tani! – ndërhyri Jusufi, pa pritur përfundimin e Miranit.

– Nuk është se jam i disponuar, por është fundi i vitit dhe ne, në njëfarë mënyre, duhet të bëjmë një si bilanc dhe duhet të mendojmë se si duhet të punojmë vitin e ardhshëm.

– Atëherë po të dëgjoj, ndoshta ma mbush mendjen, se të tilla gjëra u diskutuakan në kuadër të bilancit vjetor. Mund që pastaj do të inspirohem edhe unë të shfaq mendimet.

*– Ta zëmë, ti lavdërove kryeartikullin që **kemi** shkruar për Bashkimin.”(Atentatet, f.187)*

*J.G.: Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të **çoroditura** për numrin e ri të "Bashkimit"*

I. Kelmendi e përsërit bakshishin e vetë dhe tregon se Jusufi e lavdëron ”kryeartikullin që **kemi** shkruar për Bashkimin.”

Ibrahim Kelmendi, si njeri tepër modest dhe i sinqertë mendon se përkundër të gjitha varianteve që i ka shkrua gjatë përpunimit të kryeartikullit ”Bashkimi bënë fuqinë”, përkundër asaj që Jusufi e quan të shkëlqyeshëm, mendim që ia ka bërë qejfin I. K.-së, në stilin e modestit të madh deklaron se në këtë kryeartikull (të shkëlqyeshëm) nuk

kemi pothuajse asgjë origjinale, e të përshtatur për rrethanat tona konkrete. Çka do të thotë se ky kryeartikull 'i I. K. që për 50% i epet bakshish Jusufit' qenka i shkëlqyeshëm pikërisht për atë se në te nuk ka asgjë origjinale apo të përshtatur për rrethanat konkrete të Kosovës.

I. Kelmendi: "Sikur t'i kisha sjellë të gjitha variantet që kam shkruar gjatë përpunimit të kryeartikullit të këtij Bashkimi do t'i kishe konstatuar dilemat dhe vështirësitë që kisha për këto çështje. Sa i përket mënyrës se organizimit tonë, në këtë kryeartikull nuk kemi pothuajse asgjë origjinale, të përshtatur për rrethanat tona konkrete, por duket se është vetëm një si kopjim i mënyrës së organizimit në Republikën e Shqipërisë gjatë Luftës se Dytë Botërore." (Atentatet, f. 188)

Jusuf Gërvalla: "*Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të* ***çoroditura*** *për numrin e ri të 'Bashkimit'" (korrik 1981)*

-8. Me gjasë ky do të jetë numri i fundit i Bashkimit

I. Kelmendi i tregon Jusufit se numri i *Bashkimit*, janar 1981, me gjasë do të jetë i fundit në pritje të bashkimit të "organizimeve tona" apo të organizatave tona

I. Kelmendi*: "Kanë shkuar aq larg, sa disa bashkatdhetarë që janë të lidhur ngushtë me botimin e Bashkimit, kanë propozuar që të ndalet botimi i tij, derisa të merremi vesh për një gazetë të vetme. Prandaj,* ***me gjasë****, ky do jetë numri i fundit që botuam, për të pritur* ***bashkimin e organizimeve tona*** *dhe botimin e një gazetë të vetme, që të mos krijohen këto huti." (Atentatet, f.194)*

Citati i mësipërm i Ibrahim Kelmendit tregon faktin themelor se ai nuk ka pasur as ndikimin më të vogël në përgatitjen e numrit të fundit të Bashkimit në mesin e dhjetorit 1980.

Ibrahim Kelmendi: *"Pra, ndihmat tuaja, detyrimet tuaja t'i kuptoni si duhet, pse edhe nga ana materiale kushtëzohen shumë sukseset. Ne mendojmë se ju andej do të keni grumbulluar rregullisht dhe jeni duke i bërë të gatshme për nevojat dhe kërkesat.* ***Tani, nëse keni tubuar përpara, do të ishte e mira së mirës, por nëse jo, atëherë bëje këtë me urgjencë, pse "Bashkimi" do të dalë më rregullisht se përpara."*** (Letër Faridin Tafallarit, 21 janar 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 408)

Ja se çka shkruan tërësisht Jusufi për Bashkimin, për planet e ardhshme e gjasat e kësaj gazete në faqet e Bashkimit:

Jusuf Gërvalla: "Bashkimi"- gazetë e popullit

"Organizata jonë masive, Fronti i Kuq Popullor, dhe organi i saj " Bashkimi" kanë marrë përsipër detyrën e vështirë po të ndershme e të domosdoshme: grumbullimin dhe përgatitjen e forcave tona patriotike e revolucionare për luftën nacionalçlirimtare dhe bashkimin e tokave dhe të popullit shqiptarë të viseve të robëruara me Atdheun e përbashkët, Shqipërinë socialiste." (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 1, shtylla 1)

Këto fjalë të Jusufit tregojnë se nuk ka ekzistua as ideja më e vogël për ndërprerjen e Bashkimit, për asnjëfarë arsye, as për hatër të Lajmëtarit të lirisë e as për hatër të revistës Liria, organit të komunistëve që i kanë kuptua problemet në tërë kompleksitetin e tyre.

Jusuf Gërvalla: "Dhe punës nuk do t'ia ndajmë deri në fitoren e plotë. Prandaj edhe ju mblidhni forcat, mos u bëni "amin" burgosjeve, ndjekjeve, frikësimeve e shantazheve. Kjo le të jetë përgjigja e popullit për terrorin e armikut. Ne, po na e dhatë

të drejtën dhe mundësinë, jemi të gatshëm të vdesim në ballë të radhëve tuaja." (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 1, shtylla 1)

Citati nga shkrimi i Jusufit nuk jep shenjën më të vogël për ndonjë krizë a dobësi në revistën Bashkimi. Përkundrazi fjalët *Dhe punës nuk do t´ia ndajmë deri në fitoren e plotë* flasin për vazhdimin e luftës në emër të Bashkimit dhe jo të ndërprerjes.

*Jusuf Gërvalla: "Një nga detyrat e ngutshme të patriotëve dhe të revolucionarëve shqiptarë në kushtet aktuale, është që t´u bashkangjiten radhëve tona të organizuara**, Frontit të Kuq Popullor dhe organizatave e grupeve të tjera revolucionare."*** (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 1, shtylla 3)

Fjalët e mësipërme tregojnë edhe njëherë qartë për planet e Jusufit për vazhdimin e Bashkimit.

-9. Nga ky numër gazeta jonë do të dalë rregullisht

Daljen e rregullt të Bashkimit do ta mundësoj Fronti i Kuq Popullor.

Jusuf Gërvalla: *"Korrespondenti popullor*

Në kushtet e sotme, "para çdo gjëje, neve na duhet një gazetë. 'Pa atë, siç ka thënë në kohën e vetë Lenini, është i pamundur zhvillimi sistematik i një propagande dhe agjitacioni parimor dhe të gjithanshëm.'

Gazeta jonë, "Bashkimi", e cila do të zëvendësojë agjitacionin e shkëputur që bëhet me trakte e organe grupesh lokale, ***tash e tutje do të dalë rregullisht. Daljen e rregullt të "Bashkimit" (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), do ta mundësoj Fronti i Kuq Popullor, i cili po përpiqet me të gjitha forcat për konsolidimin e radhëve të veta."*** (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 3)

Jusuf Gërvalla*: "Njoftim*

Lexuesit e ndershëm të "Bashkimit" i njoftojmë se, duke filluar nga ky numër, gazeta jonë do të dalë rregullisht, për ndryshim nga praktika jonë e deritashme që "Bashkimin" ta nxjerrim vetëm kohë pas kohe. Kjo gjë është bërë në saje të konsolidimit të dukshëm të forcave të Frontit të Kuq Popullor dhe të forcave krijuese të mbledhura rreth kësaj organizate.

I ftojmë gjithë ata lexues, që mund të kontribuojnë në krijimin e kësaj gazete të popullit, të paraqiten me artikujt e tyre, pasi ta kenë gjetur mënyrën, sipas këshillave që dalin nga disa artikuj të botuar në këtë numër.

Po kështu shpresojmë se në të ardhmen do të jemi edhe më efektin në shpërndarjen dhe propagandimin në popull të gazetës 'Bashkimi'." (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 8)

Citati nga artikulli Korrespondenti popullor, dhe lajmërimi me titullin ***Njoftim*** tregojnë aq qartë për planin e vazhdimit të Bashkimit në mënyrë edhe më të rregullt sa nuk ka si thuhet më mirë.

Tani shtrohet pyetja e pashmangshme se pse Jusufi vendosi ta ndërpresë punën e vetë për nxjerrjen e Bashkimit, përkundër këtyre paralajmërimeve dhe t'i ndërpresë të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin, pas botimit të këtij numri kah fundi i dhjetorit 1980?

Është interesant se deri më tani, në vend të Jusufit janë munduar të përgjigjen të tjerët, disa me qëllime të mira e disa me qëllime djallëzore, por që rezultati i tyre, cilido qoftë të ketë qenë qëllimi apo pikënisja, është se nuk e kanë thënë të vërtetën.

Ibrahim Kelmendi thotë se ai me 'shokët' e vetë të Frontit ka vendosë ta ndërpresë Bashkimin, në 'pritje të bashkimit të organizimeve tona'.

Të tjerë thonë se kjo punë është bërë bashkërisht në mes Jusufit e I. Kelmendit, që të mos dalin shumë gazeta, e disa në këto spekulime e arrijnë kulmin duke thënë se Jusufi e ka ndërpre Bashkimin për hatër të revistës Liria, dhe nuk ka dashtë ta ndihmojë më shumë Frontin e Kuq për hatër të një Fronti shumë të madh, të Popullit që do të formohej nga komunistët e kuq më vonë e që do ta zëvendësonte Frontin e Kuq.

Është koha që në vend të spekulimeve e rrenave të pa fijen e krypës t'ua qesim përpara fjalët e shkruara nga dora e Jusufit.

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. *Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë.* ***Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit",*** *(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.),* ***të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.*** *Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

Këtë letër Jusufi e shkruan vetëm e vetëm pasi dyshon se I. Kelmendi ka lidhje të mira dhe mund të jetë shok i mirë i Sadik Blakajt. Se Fronti i Kuq është krijesë e UDB-së Jusufi dyshon pasi I. Kelmendi e dërgon Hysen Gegën në dorën e UDB-së përmes Sadik Blakajt. Kjo është e vërteta e shkakut të ndërprerjes së Bashkimit.

Kjo letër dëshmon edhe një të vërtetë tjetër duke na treguar se a thua mos është përpjekur Jusufi që ta bashkoj organizimin e vetë, apo konkretisht Lëvizjen e vetë Nacionalçlirimtare me një Front në qendër të të cilit gjendet UDB-a. A do të kishte më vdekje për Jusufin dhe për historinë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi sikur Jusufi ta kishte bashkuar Lëvizjen e vetë, edhe pasi ka dyshuar në atë shkallë, me një Front, në qendër të të cilit ka qenë UDB-ja. Fatmirësisht për historinë e Jusufit dhe të Lëvizjes së tij, këtë punë nuk e ka bërë për së gjalli dhe as për së vdekuri dhe është i vetmi që na ka lënë dëshmi të qarta si drita e diellit se si qëndron puna në këtë pikë.

-10. Me gjasë të lazdrova kur ta lavdërova

Jusufi e lazdron I. Kelmendin duke ia lavdëruar kryeartikullin e Bashkimit

I. Kelmendi: "– Miran, me gjasë ***të lazdrova*** *në fillim kur ta lavdërova kryeartikullin e Bashkimit." (Atentatet, f.194)*

Jusuf Gërvalla: "*Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të* ***çoroditura*** *për numrin e ri të "Bashkimit"."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Është çudi se si Mirani (i urti) i lejon vetes të jetë i lazdruar nga një kompliment, si autor i kryeartikullit të Bashkimit. Nuk thonë rastësisht 'dita e mirë njihet në sabah'.

Faktet e mbledhura prej meje në shkrimin "Programi i Frontit të Kuq-i bazuar në librin Atentatet, vërtetojnë në mënyrën më të qartë se Ibrahim Kelmendi nuk e ka

shkrua asnjë germë të vetme në artikullin ""Bashkimi" bën fuqinë". Letra e mëposhtme dëshmon se ka qenë se a i ka diskutuar e ridiskutua Jusufi shkrimet e veta me I. Kelmendin dhe sa është në gjendje t'ua falë të tjerëve punën e vetë.

Jusuf Gërvalla: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm (Ibrahim Kelmendin - shën. ynë) i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

I. Kelmendi e komenton kryeartikullin e 'shkëlqyeshëm' të Bashkimit pa harruar bujarinë e vetë, kur 50% të artikullit ia 'dhuron' Jusufit, artikull i cili edhe pse i shkëlqyeshëm nuk ka asgjë origjinale për rrethanat e Kosovës

I. Kelmendi: ***"Ne kemi*** *shkruar në kryeartikull të* ***Bashkimit*** *se organizata që do ta udhëheq revoltën duhet të jetë e formuar përpara se të ndodh shpërthimi i saj. Pas shpërthimit të revoltës do të jetë e pamundur për të formuar një organizim të suksesshëm që do ta udhëhiqte popullin. Në këtë drejtim jemi mbrapa." (Atentatet, f.201)*

Jusuf Gërvalla: "*Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të* ***çoroditura*** *për numrin e ri të "Bashkimit"."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Të gjitha këto biseda pune e komente, sipas I. Kelmendit zhvillohen në Untergruppenbach, në shtëpinë e Jusufit, një kohë pas punës në numrin e fundit të Bashkimit.

Jusuf Gërvalla: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

-11. Bakshishi për Jusufin

*I. Kelmendi (fjalë të atribuara Jusufit): "****Kemi*** *bërë punë të mirë që i* ***kemi*** *shtruar gjërat në kryeartikull dhe tani duhet të* ***mendojmë*** *për anën praktike. Sigurisht, shokët e Lirisë (kështu i quajti* ***anëtarët*** *e OMLK-së), do ta lexojnë dhe do të na paraqiten. Të* ***shpresojmë*** *se mendimet tona do t'u pëlqejnë edhe atyre." (Atentatet, f.202)*

Jusuf Gërvalla: "*Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të* ***çoroditura*** *për numrin e ri të "Bashkimit"."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Gjysma e artikullit programatik "Bashkimi bënë fuqinë" nuk mund t'i jepet bakshish Jusufit, pasi ai që nga germa e parë gjer tek e fundit është vetëm e vetëm i Jusufit. Se sa është në gjendje e i gatshëm Jusufi për t'ia falur punën e vetë I. Kelmendit e dëshmojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta... ...Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për

njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit" (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

8. Keqkuptimet dhe bashkëjetesa familjare

-1. Hidhërimi i pakontrolluar
-2. Interesi i vazhdimit të bashkëjetesës familjare

-1. Hidhërimi i pakontrolluar

Pas botimit të numrit të fundit të Bashkimit, Jusufi ka aq kontakte të mira me I. Kelmendin sa nuk dëshiron t'i rikujtoj keqkuptimet që me fajin e vetë (të J.G.) i ka pasë ndaj I. K. në të kaluarën.

Ibrahim Kelmendi: *"–* ***Mos ma rikujto kohën keqkuptimeve ndaj teje****! – i tha Jusufi, me ndjenjë keqardhjeje. –* ***Ti u bërë burrë dhe nuk shfaqe hidhërimin të pakontrolluar.*** *Kjo quhet vlerë njerëzore, sepse shoku shokun duhet ta ruaj edhe në kohë keqkuptimesh e hidhërimesh." (Atentatet, f.186)*

Më parë e kemi pa se I. K. ndien keqardhje për Jusufin. Pra jo vetëm të tjerët kanë nevojë të ndiejnë keqardhje për Jusufin por edhe ai vetë (J.G.) ndien keqardhje për veten, **keqkuptimet** e veta. Këtu e shohim se Jusufi e **keqkupton** I. K. dhe këtë fakt, se ai kupton keq e pranon me një ndjenjë keqardhje. Ndërsa me lartë e kemi pa se tek I. Kelmendi e kemi të kundërtën. I. K. mund të të mos kuptoj, gjë që i ndodhë çdo kujt, por ai nuk të keqkupton, pra Mirani kurrë nuk i kupton gjërat nga këndi i keq, por si **Miran** ai mundet vetëm t'i kuptoj **mirë**, pra të të **mirëkupton**. Jusufi gëzohet që I. K. u bë burrë dhe nuk e ka shfaq hidhërimin e pakontrolluar.

Jusuf Gërvalla: *"Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje,* ***në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë****. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

Kjo letër e këto fjalë të Jusufit kanë vlerë të përjetshme dhe nuk na lejojnë të harrojmë se si e ka përkufizuar ai Frontin e Kuq qysh në dhjetor të vitit 1980.

– ***Mos ma rikujto kohën keqkuptimeve ndaj teje****! – i tha Jusufi*

Mos ma harro kohën e sqarimeve e të mirëkuptimeve në letrën e 13 majit 1981- tha Jusufi.

-2. Interesi i vazhdimit të bashkëjetesës familjare

Pas botimit të numrit të fundit të Bashkimit, I. Kelmendi na tregon se afërsia e tij, e veprimtarisë së tij me Jusufin është edhe më e mirë e shkon drejtë përsosjes. Keqkuptimet e Jusufit i konsideron (duke iu falënderuar mosshfaqjes së hidhërimit të vetë të pakontrolluar) të njëjta si me keqkuptimet në familje dhe e sqaron Jusufin se nuk duhet të sillemi si në shoqëritë moniste e njëpartiake.

I. Kelmendi: "– Nuk prish punë, ishte një përvojë e mirë drejt përsosjes së veprimtarisë sonë. Ne nuk kemi pse hezitojmë të bisedojmë për gjithçka dhe është në natyrën e njerëzve që ndonjëherë të keqkuptohen, të hidhërohen e të prishen... ...Në ato

shoqëri mbisundon sistemi njëpartiak, prandaj divergjencat e keqkuptimet çmohen si tepër tragjike dhe kanë pasoja të rënda. Edhe ne në atë sistem jemi rritur e edukuar, prandaj divergjencat e keqkuptimet i përjetojmë rënd. Gjykojmë se duhet të mendojmë e të sillemi njësoj. Keqkuptime e zënka ndodhin shpesh edhe në familje, por familjet nuk shpërbëhen aq kollaj për shkak të hidhërimeve e zënkave të çastit. Gjykohet se më i madh është ***interesi që të vazhdohet bashkëjetesa familjare****. Edhe në organizimet tona kanë ndodhur dhe do të ndodhin* ***keqkuptime****, hidhërime e zënka." (Atentatet, f. 186-187)*

Se sa *'i madh është* ***interesi që të vazhdohet bashkëjetesa familjare'*** mund të shihet edhe nga fjalët e Hysen Gërvallës të bëra në emër të familjes.

Hysen Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi, autor i librit "Atentatet", i cili ka tentuar të zbulojë vrasësin e Jusuf Gërvallës përmes këtij libri, sipas* ***familjes*** *Gërvalla, është njeriu i parë i cili ka drejtuar gisht në një njëri të dyshuar për vrasjen e Bardhosh dhe Jusuf Gërvallës dhe për këtë ka prapa këtë* ***familje."*** *(Express, 13 mars 2007)*

Si është e mundur me të ndodh keqkuptime me Miranin e mirë i cili vetëm të mirëkupton, mund të të mos kuptoj por kurrë nuk të keqkupton.

Po i përsërisim fjalët e Jusufit me të cilat dëshmohet se ai nuk ka kurrfarë kontakti e as bashkëpunimi me Ibrahim Kelmendin si individ apo me Frontin e Kuq (krijesën e UDB-së) prej fundit të dhjetorit 1980 e deri më 13 maj 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha marrëdhëniet*** *me përfaqësuesin e tij të këtushëm* ***i kam ndërprerë****." (*Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

9. Biseda pune

-1. Superioriteti i Luanit të inferioriteteve vandale
-2. Simpatizantët e Frontit e dinë se nuk jam i organizuar në Front
-3. Proletari dhe Xhahili
-4. Luani superior i inferioriteteve vandale është informator i UDB-së

Jusufi pas përfundimit të punës me numrin e fundit të Bashkimit (dhjetor 1980) e dorëzimit të Hysen Gegës në duar të Sadik Blakajt, vazhdon jo vetëm të zhvilloj biseda pune por bënë edhe mbledhje vjetore dhe planifikon aktivitete organizative me I. Kelmendin për vitin 1981.

-1. Superioriteti i Luanit të inferioriteteve vandale

Kështu e pata kuptuar superioritetin e Luanit të inferioriteteve vandale.

Ibrahim Kelmendi: "Jusufi:-Në Shtutgart me rrethinë kemi krijuar një bërthamë të bashkatdhetarëve që e përbëjnë Nuriu, që ti po i thua Qeros, Fahriu, Vasili, Nazimi, Sheremeti dhe disa të tjerë rreth tyre. ***Nuriu po tregohet më superior****, prandaj po mendojmë ta bëjmë atë udhëheqës të kësaj bërthame." (Atentatet, f.189)*

Muharrem Blakaj: *"Sesa kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla që bëri një përzgjedhje*

të tillë, flet vetë Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, të përjetuara nga një ***inferioritet vandal****, por gjithsesi të mbështetura me fakte e dokumente autentike të kohës."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 8)

Jusufi pra vazhdon të ketë aso afërsie me I. Kelmendin sa bisedon çështje organizative për persona që jetojnë në Shtutgart e rrethinë me emër e mbiemër, dhe i thotë I. Kelmendit se pasi Nuriu (Qerosi), pra Nuhi Sylejmani po tregohet më superior mendojmë ta bëjmë udhëheqës të kësaj bërthame. Ne e kemi pa më lartë se I. K. e vendos në rrafsh të njëjtë, e barazon Nuhi Sylejmanin me 'vrasësin' e Jusufit, Rezilin dhe pagëzuesin e "Frontit të Kuq" dhe njëkohësisht "informatorin e UDB-së" Xhahilin. Sipas I. K. përkundër faktit se Jusufi është i informuar nga I. K. se Nuhi Sylejmani është informator i UDB-së, prapë se prapë Jusufi e favorizon atë në kurriz të aktivistëve tjerë që nuk kanë lidhje me UDB-në. Vetëm ky fakt do të mjaftonte për shembjen e mitit të Jusufit. Mund të themi se shembësi i idhujve, I. Kelmendi ia ka arrit qëllimit në mënyrë sa bindëse aq edhe të shkëlqyeshme.

Se çfarë bisedash e planesh për punë të përbashkët me I. Kelmendin bënë Jusufi në këtë kohë e sqarojnë këto fjalë të tij të paharrueshme.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë.* ***Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit",*** *(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.),* ***të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë****." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

2. Simpatizantët e Frontit e dinë se nuk jam i organizuar në Front

Edhe pse e kemi pa se Jusufi në verë 1980, për shkak të incidenteve të 'rastësishme' (rasti është mbreti i botës) i ndërprenë marrëdhëniet me I. Kelmendin deri në festën e 28 Nëntorit 1980), po ky Jusuf vetëm disa muaj më vonë, pra pas janarit 1981 harron (një harresë senile e kemi pa tek Jusufi edhe në rastin kur ai 'J. G.' harron se sa herë i ka kërkuar ndihmë I. Kelmendit ta vendosë në kontakt me Sabri Novosellën) se çka i ka ndodhë e se si e ka përjetuar 'rastësinë' në Munchen dhe diskuton për organizimin e personave pikërisht në Munchen.

I. Kelmendi*: (Fjalë të atribuara Jusufit gjatë 'bisedës punuese'):"Në Mynhen po mundohemi të depërtojmë përmes Minushit. Interesimi është rritur, por ende nuk kemi filluar të anëtarësojmë. Një pjesë e tyre janë simpatizantë të Frontit, kurse për mua e dinë se nuk jam i organizuar në Front." (Atentatet, f.190)*

> Jusuf Gërvalla (për Ibrahim Kelmendin): "*Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen."* (Raport për Komitetin e Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Del se Jusufi ende nuk ka anëtarësua në Munchen por posa ta bëjë këtë, listën me emra do t'i dorëzojë shefit të "Fronit të Kuq" të pagëzuar nga UDB-a. Edhe ata të interesuar janë simpatizantë të 'Frontit' krejt krejt rastësisht të pagëzuar nga UDB-a, e të cilët Jusufi e ka ndërmend t'ia marrë 'Frontit'. Jusufi të gjithëve që u ka besua në

Munchen u paska tregua se ai (J. G.) nuk është i organizuar në Front. Se çfarë "bisedash pune" ka zhvilluar Jusufi me Ibrahim Kelmendin pas 19 dhjetorit 1980 e tregon më së miri letra e mëposhtme.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate (Frontit të Kuq-shën i Xh. D), apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër S. N., 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

-3. Proletari dhe Xhahili

Gjatë kësaj bisede pune të Jusufit me I. Kelmendin, Jusufi nga jugu i Gjermanisë, Muncheni kalon në veri atje ku është I. Kelmendi dhe bahçja e tij.

I. Kelmendi (për Jusufin): "Në pjesën Perëndimore, atje ku je ti, po bashkëpunoj me Proletarin e Xhahilin, të cilët po më shkruajnë e po më vizitojnë." (Atentatet, f. 190)

Të shohim në këtë pikë se si 'naivi e tepër i sinqerti' Ibrahim Kelmendi e ka paramenduar shembjen e mitit të Jusufit.

E kemi pa nga pikat më lartë se Proletari është një dogmat primitiv ndërsa Xhahili, një informator i UDB-së, të cilit i ka rastisë t'ia ngjet emrin tepër bombastik e tepër provokativ organizatës së I. Kelmendit "Fronti i Kuq".

Kështu e pata kuptuar këtë fjali. Këtu i shohë tri mundësi të leximit të fjalisë së cituar më lartë.

1) Proletari është dogmat primitiv dhe Xhahili informator i UDB-së i cili ka marrë detyrë nga UDB-a t'ia ngjesë emrin "Frontit të Kuq".

Nga kjo rrjedh se përkundër informatave të sakta që I.K. ia jep Jusufit për këta dy persona, Jusufi mban vazhdimisht kontakte me letra dhe i pret në shtëpinë e vetë, dogmatin primitiv dhe informatorin e UDB-së. Me këto veti e me këto kontakte jo Jusufi por kush është ai që mund të quhet udhëheqës i popullit, mit inspirues, udhëheqës i rrethit të vetë dhe i gjeneratave pas tij.

2) Proletari nuk është dogmat primitiv dhe Xhahili nuk është informator i UDB-së por të dy janë njerëz me gabime e vese të këqija që i bëjnë krejtësisht të papërshtatshëm për punë çlirimtare e patriotike dhe për këtë arsye I.K. i ka largua nga organizata që rastësisht e ka marrë emrin "Fronti i Kuq." Pra kemi të bëjmë me dy molla të krymta e të papjekura që kanë ra nga pema e Kuqe apo me dy gërdhaja të cilat pas kafshimit të parë i ka hedhur në tokë Ibrahim Kelmendi.

Nga kjo del se Jusufi nuk ka mund me e gjetë asnjë filiz, asnjë fryt nga asnjë pemë, të pakafshuar, as në Shtutgart, as në Munchen e as në veri të Gjermanisë, si në Velbert e Bielefeld pa e pasë më parë në dorë e pa e kafshuar I. Kelmendi i 'Frontit' që rastësisht është pagëzuar nga UDB-a. Pra nëse Jusufi nuk ka pas punë me dogmat primitiv e informator të UDB-së atëherë, është jashtë çdo dyshimi se ai të vetmin ushqim, të vetmen dietë, i ka pasë gërdhajat apo pemët e krymta e të papjekura që kanë ra nga pema e kuqe e "Frontit të Kuq." Kush është ai mit që mund të quhet udhëheqës e inspirues i cili kurrë nuk ka bërë asgjë tjetër pos që është ushqye me gërdhajat e I. Kelmendit.

3) Proletari nga Velberti dhe Xhahili-Xhaviti nga Bielefeldi nuk janë dogmat primitiv apo informatorë të UDB-së. Ata nuk janë pemë të krymta e të papjekura që kanë ra në tokë, ende pa u pjekë e ende pa u kuq, nga trungu i 'Frontit të Kuq'. Ata nuk janë as gërdhaja që i ka hedhë për toke Ibrahim Kelmendi pas kafshimit të parë. Nëse nuk janë

asnjë një nga këto atëherë çka mund të jenë? Ata janë aktivist të dalluar në Gjermaninë veriore, pra atje ku jeton Ibrahim Kelmendi, ku e ka bahçen I. Kelmendi. Çka rrjedhë nga kjo? Se Jusufi preokupimin e vetë kryesor nga Gjermani e ka pas me ia marrë shokët më të mirë I. Kelmendit, me i mbajtur në kontakt me letra e me i ftua në shtëpi të vetë në mënyrë që në stilin e urithit me ia dëmtua bahçen, t'ia rrëmihë dheun Ibrahim Kelmendit nën këmbë, e t'ia bëjë gropën. Cili mund të pretendojë se është mit inspirues për një popull të tërë nëse krejt veprimtaria e tij mund të përshkruhet vetëm si punë urithi që përpiqet t'u hap gropa të tjerëve.

Do të ishte shumë interesant sikur një historian i mirë të kishte fakte të dokumentuara përpara dhe jo gënjeshtra, për të parë se mos dikush tjetër, e kurrë Jusufi, ka pasë punë me dogmat primitiv, informator të UDB-së, kush është ushqye me pemë të krymta, të papjekura e gërdhaja dhe kush janë ata që qëllim kryesor të jetës e kanë me ju bërë gropa të tjerëve dhe të cilët edhe sot propozojnë se ku është dashtë me iu hap gropa Jusufit.

Shtrohet pyetja se si është e mundur që të ndërtohet miti, apo cili spomenik mund të qëndroj në këmbë, të qëndroj **mbi dhe** kur miti i rrejshëm të cilit i ndërtohet spomeniku, të vetmin ideal e ka pas hapjen e gropave, të gropave **nën dhe**.

Fjalët e përjetshme të Jusufit të shënuara më poshtë tregojnë të vërtetën e periudhës që e kemi në shqyrtim dhe gënjeshtrat e paskrupullta të Ibrahim Kelmendit.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj,*** *që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (*Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Ankesa e I. Kelmendit ndaj Jusufit lidhur me Proletarin e Xhahilin (Besim Rexhën e Xhavit Ramabajën)

I. Kelmendi - Jusufit: "Pastaj, pengesa serioze kemi nga Proletari, Xhahili dhe ndonjë i ngjashëm me ta." (Atentatet, f.190)

E pamë si qëndron çështja e Jusufit me Proletarin e Xhahilin, me të cilët Jusufi mban kontakte dhe i pret në shtëpinë e vetë në Habichthöhe 40, në Untergruppenbach. Nga kjo del se Jusufi i përkrahë ata që t'i bëjnë pengesa serioze çdo aktiviteti të mirë në veri të Gjermanisë. E vërteta lidhur me këto gënjeshtra gjendet në fjalët e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-4. Luani superior i inferioriteteve vandale është informator i UDB-së

I. Kelmendi në bisedë pune, i mban Jusufit ligjëratë për persona në rrethin e Shtutgartit dhe i tregon se kush është informatorë i UDB-së.

I. Kelmendi: "Ju në rrethin e Shtutgartit nuk do të mund të përparoni derisa t'ju imponohet ***Nuriu*** *si udhëheqës i rrethit. Ai është element turbullues dhe për mendim timin* ***është informator i UDB****–së." (Atentatet, f. 192)*

Kjo do të thotë se Nuhi Sylejmani ka siguruar një pozitë udhëheqëse e me ndikim jo

vetëm ndaj aktivistëve të ndryshëm por këtë pozitë udhëheqëse e ka edhe në raport me Jusufin dhe siç do ta shohim më vonë, sipas I. Kelmendit, Nuhi Sylejmani ka pasur ndikim të rëndësishëm në disa vendime të Jusufit. Se kush mund të ketë e kush nuk mund të ketë lidhje me UDB-në në këtë kohë, Jusufi ka mendime krejt tjera që mund të shihet nga fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)*

Jo vetëm artikuj për Bashkimin, por Jusufi e I. Kelmendi në luftën e tyre të përbashkët kundër pushtetit komunist jugosllav dhe kundër diktaturës komuniste jugosllave, shkruajnë bashkërisht trakt për 1 Majin 1981.

I. Kelmendi: "Traktin e 1 Majit, që e patëm shkruar bashkarisht në gjuhën gjermane, e kemi shumëzuar në tridhjetë mijë copë dhe e kemi e shpërndarë në demonstrata, marshe e protesta, pothuajse në të gjitha metropolet e Evropës Perëndimore." (Atentatet, f.193)

Kur jemi tek traktet e 1 Majit 1981, a nuk është shumë më mirë ta lexojmë letrën e 13 Majit 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

10. Ibrahim Kelmendi në lëkurën e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës

Ibrahim Kelmendi në mes Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës

-1. Ke ndonjë lidhje në Turqi?
-2. Nuk po më paraqitet edhe pse e ka numrin e telefonit
-3. Mbase ke harruar
-4. Ti më kishe thënë se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë
-5. Një Zë që nuk tingëllonte aq bindës
-6. Vazhdonte ta fshihte dëshpërimin
-7. Porosinë ta kam përcjellë
-8. Po deshe ta siguroj adresën dhe telefonin e tij
-9. Do të më bëje nder
-10. Ndihej i zhgënjyer - do të zhgënjehesh siç janë zhgënjyer
-11. Intelektuali poliedrik dhe fisnikëria e vërtetë
-12. Ca shpjegime për udhëheqësin tënd
-13. Më ke folur për të si për një idhull
-14. Mos prit kot
-15. Për këtë organizatë nuk dihet gjë në Kosovë
-16. Me nënkuptim prej të pakënaquri
-17. Ka manipuluar me ty

-18. Është koha të vendosësh
-19. Të pengon të gjykosh drejt - Ai po të mban peng
-20. Ne jemi të bllokuar

Kur të kemi parasysh raportin e Jusufit me Sabri Novosellën dhe ndërhyrjet e Ibrahim Kelmendit në çështjet e brendshme të Lëvizjes së Jusufit, në librin e tij *Atentatet* duhet hetuar dy periudha:

-E para, ajo para përfundimit të daljes së gazetës *Bashkimi* (shkurt-maj 1980). Këtë periudhë e kam shqyrtuar në nëntitujt 1-15. Për këtë kohë, për ta dokumentuar të vërtetën e kam përdorë më së shumti letrën e Ibrahim Kelmendit dërguar Faridin Tafallarit më 4 qershor 1980.

-E dyta, ajo pas përfundimit të daljes së gazetës *Bashkimi* (janar-shkurt 1981). Këtë periudhë e kam shqyrtuar në nëntitujt 16-20. Për këtë kohë, për ta dokumentuar të vërtetën e kam përdorë më së shumti letrën e Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës më 13 maj 1981.

Për të dy periudhat dhe për të gjithë kohën e jetës së tij në Gjermani letra më e rëndësishme që e vërteton se Jusuf Gërvalla nuk ka diskutuar kurrë me Ibrahim Kelmendin për Sabri Novosellën është letra e Jusufit që ia dërgon Ibrahim Kelmendit dy ditë para atentatit, më 15 janar 1982. Për ta dokumentuar të vërtetën nga kjo letër e kam marrë një citat prej katër rreshtave.

-1. Ke ndonjë lidhje në Turqi?

Jusufi në shkurt, mars e prill të vitit 1980 i kërkon ndihmë I. Kelmendit që t'ia gjejë Sabri Novosellën në Turqi, me të cilin iu kanë shkëputur kontaktet që nga 14 dhjetori 1979.

I. Kelmendi: "Pastaj Jusufi pyeti:
– Ke ndonjë lidhje në Turqi se ende nuk kam vënë kontakt me Sabitin, me Sabit Katunriun, i cili në ilegalitet e ka pasur pseudonimin "Rrobaqepësi"?" (Atentatet, f.147)

Jusufi, pra në bisedë me I. Kelmendin vetëm pas disa javësh, krijon aso aferisie me te sa ia tregon I. K. emrin e vërtetë të shokut të vetë prej të cilit është anëtarësua në organizatën *Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi*, Sabri Novosellës, dhe jo vetëm kaq por ia tregon edhe pseudonimin e tij "Rrobaqepësi".

E kemi pa në fillim se sa mirë I. K. na e ka shpjegua historinë e formimit të "Frontit të Kuq" dhe se si ju ka **rastisë** që t'ia ngjesin emrin organizatës së vetë. Por I. K. me talentin e tij nuk është mjaftuar me kaq. Ai na tregon në mënyrë shumë bindëse edhe shumë çështje të organizatës së Jusufit, e raporte të brendshme të Jusufit me shokët e vet të Lëvizjes së vet. Është shumë interesant të konstatojmë se po të kishim një rend të rëndomtë të rrjedhave atëherë për relacionet e Jusufit me shokët e vet të Lëvizjes (në vazhdim për ta konkretizuar më mirë këtë fjalë dhe për t'iu shmangë përzierjeve, emërtimeve të gjata e shkurtesave, do ta quaj "Lëvizja e Jusufit") do të duhej të mësonim nga Jusufi apo nga shokë të tjerë të Lëvizjes së tij. Por kjo nuk ka ndodhur deri më sot. Pra ai që donë të dijë se si kanë shkuar punët në Lëvizjen e Jusufit, se çfarë raportesh ka pasur Jusufi me Sabri Novosellën, me Bardhin apo me Skenderin, këtë nuk mund ta mësoj nga shkrimet e Jusufit, nuk mund ta mësoj nga Sabri Novosella e për të mos folur për Skenderin, por pikërisht nga figura frontale e "Frontit të Kuq", Ibrahim Kelmendi. Duket qartë se kemi të bëjmë me një bujari të jashtëzakonshme dhe në vend të ndonjë kritike negative, ne shokët e Lëvizjes së Jusufit duhet t'i jemi

mirënjohës I.K. për shkak se ai me kaq durim e kujdes ka sakrifikuar kohë e mund që të na e shkruaj historinë e Lëvizjes së Jusufit, histori të cilën ne vetë nuk kemi qenë dhe as sot nuk jemi në gjendje ta shkruajmë.

Të shohim çka i shkruan Ibrahim Kelmendi, Faridin Tafallarit më 4 qershor 1980.

I. Kelmendi: *"Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin."* (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Jusufi është kontaktuar nga I. Kelmendi diku në mbarim të janarit 1980. Në shkurt 1980 Jusufi nxjerrë numrin e dytë të Bashkimit si organ i Frontit të Kuq. Në prill nxjerrë numrin e tretë të Bashkimit si organ i Frontit të Kuq. Në maj 1980 Jusufi shkruan dhe boton në formë të fletores së vogël, të formatit A6, në 24 faqe, Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor. Në këtë dokument, të majit 1980 për herë të parë përmendet emri "Fronti i Kuq Popullor". Më parë e kemi vetëm emrin e caktuar nga UDB-a, "Fronti i Kuq". Jusufi bënë çdo gjë që është e mundur që këtë krijesë të pagëzuar nga UDB-a (fakt të cilin nuk e din në fillim të vitit 1980 por ka dyshime fort të bazuara në mesin e dhjetorit 1980) kundër popullit tonë ta kthej në anën e popullit e kundër saj.

Gjatë tërë kësaj kohe Jusufi nuk ia fletë asnjë fjalë të vetme I. Kelmendit për çështjet e tij të brendshme e për Lëvizjen e vetë. Pikërisht për këtë arsye, për shkak të këtij fakti, I. Kelmendi deklaron;

Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete.

Kjo do të thotë se as pas 7 muajve të daljes së Jusufit në Gjermani, I. Kelmendi nuk e din se a është Jusufi anëtar i ndonjë organizate politike apo jo e lere më të dijë për ndonjë shokë konkret të saj e aq më pak për atë kush e ka anëtarësua në Lëvizjen e tij. Faktin se Sabri Novosella e ka anëtarësuar Jusufin në 'Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi', e kam përmend unë i pari. Këtë fakt ma ka tregua mua Jusufi në gusht të vitit 1981. Këtë fakt e kam përmend unë me shkrim në vitin 1992, në punimin Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985, i cili në mënyrë të plotë për herë të parë është botuar në librin Terror Dhimbje Qëndresë të Faridin Tafallarit, më 1997. Më 1997, I. Kelmendi nga ky libër e ka marrë (vjedhë) këtë fakt (si edhe shumë e shumë vjedhje tjera nga i njëjti libër) dhe në mënyrë dinake për këshilltarët e tij, mundohet që këtë fakt publik e të njohur të paktën prej të gjithë atyre që u intereson shumë puna e Jusufit, nga viti 1997, tek 10 jetë më vonë, më 2007 me e paraqitë se e ka mësua nga Jusufi menjëherë pas daljes së tij në Gjermani në janar apo shkurt 1980. Letra e tij e 4 qershorit këtë gënjeshtër të paskrupullt, këtë hajni e këtë farë lloj "afërsie e besimi" e hedhë poshtë.

Xhafer Durmishi*: "Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ. Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi."* (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 326)

Për kohën e sotme me parti të lira ky fakt mund të duket vogëlsi por do ta shohim më tutje se ka një rëndësi shumë parimore.

Deri më sot i vetmi dokument që tregon se Jusufi ia përmend shkëputjen nga shokët e tij për herë të parë, është një letër e Jusufit dërguar Ibrahim Kelmendit (pa datë fikse, por nga teksti del së është shkruar në) fund të tetorit apo fillim të nëntorit 1980, e cila për herë të parë është botuar në faqen www.albaniapress.com (05 qershor, 2009) nga Faridin Tafallari.

Jusuf Gërvalla*: "Dhe kështu, për kaq kohë sa njihemi- e nuk është pak po më* ***se dhjetë muaj****-ne të shumtën i kemi rënë kush thumbit e kush patkoit. Mendoj se kjo e ka arsyen e vet objektive. Ti ke njerëzit e tu, me të cilët, sipas mendjes sime, ke vështërsi në realizimin e kontakteve për shkak të largësisë. Kam përshtypjen se, pos kësaj, edhe me ta ke mospajtime dhe sygjerime e urdhrave të tyre s'të fle në hatër tu përmbahesh gjithmonë.* ***Unë nga ana tjetër i kam humbur të gjitha lidhjet me njerëzit e mi dhe për çdo hap që bëj kam stërngarkime, sepse nuk e di në mos bej gjësend, që nuk përputhet me luftën aktuale, që bëjnë ata në vendlindje****. Kjo është një tragjedi vetvetiu. Kurse tragjedia tjetër është se edhe unë edhe ti, në këto kushte, ndiejmë pasiguri në një pikë: kë përfaqësojmë..." (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Shtrohet pyetja se prej ditës që ka dalë Jusufi në Gjermani e deri në vdekje, a e ka përmend ndonjëherë Jusufi emrin e Sabri Novosellës me I. Kelmendin? Kurrë. Asnjëherë, qoftë edhe një herë të vetme Jusufi nuk e ka përmend emrin e Sabri Novosellës dhe as ndonjë pseudonim të tij për I. Kelmendin.

A ekziston ndonjë fakt se Jusufi ka diskutuar me I. Kelmendin për çështjen e Sabri Novosellës, pa ia përmendur emrin por vetëm duke aluduar në te. Këtë Jusufi e ka bërë vetëm një herë në jetën e tij, në letrën e tij të fundit që ia dërgon I. Kelmendit më 15 janar 1982, d.m.th. dy ditë para vrasjes.

Jusuf Gërvalla: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se ***si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes (Sabri Novosella-shën. i Xh. D.)*** *na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne."(*Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Këta katër rreshta të shkruar në pasditën e 15 janarit 1982 janë të vetmet fjalë që në jetën e tij Jusufi i ka ndërrua me I. Kelmendin, duke aluduar në Sabri Novosellën (e pa ia përmendë emrin kurrë). Kush dhe kur i ka folë I. Kelmendit për Sabri Novosellën është çështje që e ka vendin të shqyrtohet gjerësisht më vonë. Por që tani po përmendim se këtë informatë, se Jusufi e ka një shok në Stamboll, që është 'antikomunist', Ibrahim Kelmendi, figura frontale e Frontit të emërtuar nga UDB-a, e ka marrë vesh nga Kadri Zeka, pasi ky (Kadri Zeka) është kthye nga Stambolli në mesin e tetorit 1981.

-2. Nuk po më paraqitet edhe pse e ka numrin e telefonit

Jusufi i tregon dhe i ankohet I. Kelmendit se Sabri Novosella nuk po do me iu paraqitë edhe pse e ka numrin e telefonit (+49714126091) të zyrës së Bardhit në Solitudestrasse 44, në Ludwigsburg.

I. Kelmendi*: "Ai është arratisur atje, por nuk po më paraqitet edhe pse e ka pasur numrin e telefonit zyrtar të Bardhit." (Atentatet, f.147)*

I. Kelmendi*: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin."(*Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980 FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159*)*

Jusuf Gërvalla: *"Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se* ***si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes (Sabri Novosella-shën. i Xh. D.)*** *na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne."(*Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

-3. Mbase ke harruar

Jusufi jo vetëm që ia ka treguar I. K. emrin e Sabri Novosellës disa herë por edhe ka harruar se e ka bërë këtë. I. Kelmendi me memorie të fuqishme që nuk harron asgjë tallet me harresën e Jusufit.

I. Kelmendi: "– ***Më ke pyetur edhe më herët. Mbase ke harruar****. Kam angazhuar ca të njohur atje, të cilët nëse e gjejnë t'i thonë se po e kërkon. Më kanë informuar se ai i është kthyer me përkushtim vetëm shërbimeve fetare dhe nuk do t'ia di më për çështje kombëtare."(Atentatet, f.147-148)*

Mbase ka harruar I. Kelmendi se çka i ka shkruar më 4 qershor 1980, Faridin Tafallarit. Nëse I. K. ka harruar këtë nuk e ka harruar shoku i vërtet i Jusufit, Faridin Tafallari.

I. Kelmendi: *"Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin."* (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Jusuf Gërvalla: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se ***si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes (Sabri Novosella-shën. i Xh. D.)*** *na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Ibrahim Kelmendi ndien keqardhje për Jusufin për shkak të shkëputjes së lidhjes së Jusufit me Sabri Novosellën. Jusufi bien deri në atë shkallë që bëhet për keqardhje para I. Kelmendit.

I. Kelmendi: "Më ka ardhur keq, prandaj nuk të kam informuar, – tha Mirani pa ia treguar të tëra." (Atentatet, f.148)

Fjalët e thëna harrohen por të shkruarat nuk harrohen.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159*)*

-4. Ti më kishe thënë se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë

Jusufi i paska treguar Ibrahim Kelmendit në prill të vitit 1980 se Sabri Novosella është njëri i madh, udhëheqës i Lëvizjes së Jusufit, se ai (S.N.) e ka anëtarësuar (J.G.-në) në organizatë.

I. Kelmendi: "– Paske gabuar, – ia ktheu i qetë Jusufi.
– Më fal, por vërtet më erdhi keq. ***Ti më kishe thënë*** *se ai është njeri i madh, udhëheqës i organizatës suaj, Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare*

në Jugosllavi, ***se ai të kishte anëtarësuar në atë organizatë.” (****Atentatet, f.148)*

Jusufi i paska tregua I. K. (figurës frontale të ’Frontit të Kuq’ të bashkëformuar, 100% të pagëzuar dhe të popullarizuar nga UDB-a) se kush e ka anëtarësua në Lëvizjen e tij.

I. Kelmendi: ”Nga ato që më ke treguar se të ka anëtarësuar Rrobaqepësi dhe se ai të ka bindur se Lëvizja është organizatë e madhe, për këtë të dytën nuk më është mbushur mendja.” (Atentatet, f. 161)

Shahisti duhet të ketë memorie të fortë. Mbase ke harruar!

Xhafer Durmishi*: "Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ. Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi."* (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 326)

Se Jusufi nuk e ka ndërruar asnjë fjalë të vetme me I. Kelmendin, rreth Sabri Novosellës e dëshmojnë rreshtat e mëposhtëm:

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159*)*

-5. Një Zë që nuk tingëllonte aq bindës

Nën ndikimin dhe sqarimet e I. K., Jusufi tregohet aq mendjelehtë sa fillon t’i lëkundet besimi në Sabri Novosellën.

I. Kelmendi: "– I tillë ka qenë dhe nuk më mbushet mendja se mund të ketë ndryshuar,– tha Jusufi me ***një zë që nuk tingëllonte edhe aq bindës****." (Atentatet, f.148)*

Shtrohet pyetja se mos ka mundësi që UDB-a e ka vra fizikisht Jusufin vetëm e vetëm pse ai paska qenë kaq mendjelehtë para figurës frontale të Frontit të Kuq, të emërtuar po nga UDB-a? Natyrisht se besimi i Jusufit, si dhe morali i tij në çdo pikëpamje ka qenë i pathyeshëm, dhe pikërisht këtë pathyeshmëri është munduar ta thyej UDB-a, kur ka bërë atentat fizik në te. Atentatet morale dhe ato të llojeve tjera do ta kenë po atë fund që e pati Jugosllavia e UDB-së, fatin dhe fundin e të cilës e tregoi dhe shfaqi me aq mjeshtëri, Jusufi.

Të shohim fjalët shumë bindëse të kohës së shkruara nga I. Kelmendi.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-6. Vazhdonte ta fshihte dëshpërimin

Në prill 1980 Jusufi është i dëshpëruar në Sabri Novosellën për shkak se ai (S.N.) nuk i lajmërohet, edhe pse e ka telefonin e zyrës së Bardhit, por dëshpërimin mundohet ta fshehë para Ibrahim Kelmendit.

I. Kelmendi: ”Dukej i dëshpëruar për faktin se edhe pas ***pesë muajve*** *nuk i ishte lajmëruar dhe vetë nuk kishte numër telefoni e adresë që ta kontaktonte. Por* ***dëshpërimin vazhdonte ta fshihte*** *para Miranit.” (Atentatet, f.148)*

Letra e mëposhtme e Ibrahim Kelmendit është shkruar pas **shtatë muajve** të arratisjes

së Jusufit.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Komenti është i tepërt.

-7. Porosinë ta kam përcjellë

Jusufi, në pamundësi që të kontaktoj vetë, ia jep porosinë I. K. që të kontaktoj me Sabri Novosellën.

I. Kelmendi: "– Nuk e di, ***porosinë ta kam përcjellë****. Ndoshta do të të lajmërohet." (Atentatet, f.148)*

Letra e mëposhtme e vetë I. Kelmendit tregon se Jusufi kurrë nuk i ka dhënë kurrfarë porosie praktike të çfarëdo lloji Ibrahim Kelmendit, figurës frontale të Frontit të bashkëthemeluar e emërtuar nga UDB-a.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-8. Po deshe ta siguroj adresën dhe telefonin e tij

I. K. shprehë gatishmërinë për t'ia siguruar Jusufit adresën dhe numrin e telefonit të Sabri Novosellës.

I. Kelmendi: "Po deshe mund të të siguroj adresë dhe telefon të tij." (Atentatet, f.148)

Kjo shpikje artistike sa dinake aq edhe djallëzore demantohet nga dokumenti i shkruar nga I. Kelmendi.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-9. Do të më bëje nder

Jusufi ndihet i nderuar nga ndihma që ia ofron Ibrahim Kelmendi.

I. Kelmendi: "(Jusufi)– ***Do të më bëje nder****, meqë dëshiroj të kontaktoj drejtpërdrejt dhe të dëgjoj nga goja e tij, se cilin qëndrim mban." (Atentatet, f.148)*

Asnjë shkrim, asnjë germë e vetme nuk tregon se Jusufi ka kërkuar ndonjëherë ndonjë ndihmë të çfarëdo lloji në jetën e tij nga Ibrahim Kelmendit.

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." ." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-10. Ndihej i zhgënjyer - do të zhgënjehesh siç janë zhgënjyer

I. K. e din se Jusufi do të zhgënjehet nga udhëheqësi i Lëvizjes së tij Sabri Novosella.

I. Kelmendi: "– Punë fare e lehtë, – u përgjigj Mirani, duke u munduar ta marrë me mend se sa do të ***ndihej i zhgënjyer*** *Jusufi." (Atentatet, f.148)*

I. K. rezervohet dhe e kursen Jusufin prej lajmeve të këqija e zhgënjimet që ka shkaktuar Sabri Novosella në Turqi.

I. Kelmendi: "Ai po rezervohej t'ia thoshte të gjitha që kishte dëgjuar, për ***zhgënjimin*** *që kishin pësuar bashkatdhetarët, që e kishin mirëpritur Sabitin në Turqi. Dikur kishin pasur respekt të madh për të. Kishte qenë shpesh atje, ishte marrë me organizime e lidhjembajtje patriotike. Pastaj kishte rënë në burg për qepje të flamujve, që qenë ngritur guximshëm nëpër Kosovë." (Atentatet, f.148)*

Informatat e I. K. rreth Sabri Novosellës të thëna Jusufit janë nga ata që nuk merren me përfolje.

I. Kelmendi: "Më kanë folur ata që nuk merren me thashetheme, me ***përfolje****. Janë emigrantë pothuajse të natyralizuar në Turqi dhe do t'ua thosha emrat sikur ti t'i njihje. Ata ishin* ***zhgënjyer*** *dëshpërueshëm." (Atentatet, f.161)*

Ideja themelore e figurës frontale të Frontit të UDB-së është, se pas 'zhgënjimit në shokët e vet' e vetmja shpresë për Jusufin mbetet Fronti i krijuar nga UDB-a.

I. K. parandien se Jusufi do të zhgënjehet nga Sabri Novosella.

I. Kelmendi: "Parandiej se ***do të zhgënjehesh*** *një ditë,* ***siç janë zhgënjyer*** *bashkatdhetarët tanë në Turqi. Për këto zhgënjime të tyre më konkretisht do të flasin ca bashkëveprimtarë tanë të mrekullueshëm në Bruksel, të cilët vijnë nga Turqia. Ata do të kesh rastin t'i takosh së shpejti." (Atentatet, f.161)*

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." ." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-11. Intelektuali poliedrik dhe fisnikëria e vërtetë

"To be humble to superiors is duty, to equals courtesy, to inferiors nobleness."
Të jesh modest ndaj atyre që kanë epërsi - superiorëve është detyrë, ndaj të barabartëve mirësjellje, ndaj inferiorëve madhështi apo fisnikëri. (Benjamin Franklin, i lindur më **17 janar** 1706-1790)

I. K. nuk e merr me mend se si Jusufi, si intelektual poliedrik, pranon ta ketë udhëheqës të organizatës një rrobaqepës.

I. Kelmendi: "Mirani nuk e merrte me mend, sesi një rrobaqepës mund të bëhej udhëheqës i Jusufit, këtij ***intelektuali*** *poliedrik..." (Atentatet, f.148)*

I. Kelmendi ndien keqardhje për Jusufin dhe habitet se si ai mund të udhëhiqet nga një diletant me paraqitje skizofrenike.

I. Kelmendi: "Sa keq më erdhi kur i dëgjova gjithë ato gjëra. Pata menduar se si mundet që ***një intelektual*** *i kalibrit tënd, të udhëhiqet nga një diletant, me paraqitje skizofrenike." (Atentatet, f.161)*

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të

dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Nëse Jusufi ka qenë modest e nuk ka shpërdorua epërsinë intelektuale e njerëzore ndaj I. K., atëherë sipas I. K. ky është kulmi i mirësisë së Jusufit. Nëse këtë veti universale Jusufi e aplikon edhe ndaj Sabri Novosellës dhe të gjithë atyre me të cilët ka pas punë, nga pozita e shokëve, atëherë është naiv e viktimë që manipulohet lehtë dhe që shndërrohet në një person për keqardhje.

Se sa ndihet i 'nderuar' intelektuali Jusuf prej komplimenteve të I. Kelmendit e tregojnë rreshtat e mëposhtëm. Se si ndihet i zhgënjyer nga Sabri Novosella apo saktësisht se sa ndihet i 'nderuar' Jusufi prej komplimenteve të I. Kelmendit e tregojnë edhe këta rreshta të Jusufit, të shkruar në tetor 1980.

Jusuf Gërvalla: "E mora me mend (e spikat edhe në letrën tënde) ç'mundime ke pasur të më shkruash në "nivelin" tim, sikur. thua se vetëm në "nivelin" tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e të shkruarit?! ***Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit! (Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.)"*** *(Letër I. Kelmendit, nëntor 1980* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

-12. Ca shpjegime për udhëheqësin tënd

Jusufi është shumë kureshtar të dëgjoj se çka ka për t'i thënë I. Kelmendi për shokun e tij udhëheqës të Lëvizjes së tij, Sabri Novosellën.

I. Kelmendi: "Sa për ilustrim konkret, meqë nuk po i gjej shprehjet dhe mënyrën për t'i shpjeguar këto që po mundohem t'i shpjegoj, po sjell vetëpërmbajtjen time për të t'i thënë të gjitha për Sabitin, alias Rrobaqepësin. Të fola shumë shkurt për të. U frikësova se do të të hidhëroja po t'i thosha të gjitha njëherësh.

Që të mos e zgjas deri në monotoni e bezdi, po shtoj konkretisht edhe ca shpjegime për udhëheqësin tënd. Për të bashkatdhetarët në Stamboll më kanë folur shumë keq." (Atentatet, f.160-161)

Mbase I. K. ka harruar dokumentin e vetë të shkruar më 4 qershor 1980:

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-13. Më ke folur për të si për një idhull

Jusufi e paska paraqitur Sabri Novosellën para I. K. si një idhull. Pra përveç Enver Hoxhës, shembësi i miteve e i idhujve, na e zbuloi edhe një idhull të Jusufit.

I. Kelmendi: "Ndërkaq ti më ke folur për të si për një idhull." (Atentatet, f.161)

Mbase ke harrua jo çka ke thënë por çka ke shkruar. E shkruara nuk harrohet:

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. ***Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete****. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të*

dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

-14. Mos prit kot

I. Kelmendit i vjen keq për pritjen e kotë të Jusufit, se Sabri Novosella do t'i lajmërohet për ta udhëheqë atë (J.G-në).

I. Kelmendi: "Akoma më keq do të më vinte po qe se ti do të prisje edhe më gjatë që ai të të lajmërohet për të të udhëhequr."(Atentatet, f.161)

Mbase ke harruar!

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Jusufi do të ishte shumë më i lavdishëm e më heroik sikur të kishte pranuar të udhëhiqej nga figura frontale e Frontit të pagëzuar nga UDB-a.

-15. Për këtë organizatë nuk dihet gjë në Kosovë

I. Kelmendi shprehë kënaqësinë para Jusufit se TANJUG-u fletë më shumë për organizatën me emrin tepër provokativ "Frontin e Kuq" të pagëzuar nga UDB-a, se sa për çdo organizatë tjetër, apo për të gjitha të tjerat marrë së bashku.

I. Kelmendi: "Për këtë organizatë ende nuk dihet gjë në Kosovë dhe nuk mendoj se është themeluar për ta mbajtur konspirativ emrin dhe veprimtarinë, por për të bërë punën që do të duhej të ndihej nga të tjerët. Nuk besoj se një organizatë e madhe duhet dhe mund ta fsheh emrin e saj." (Atentatet f. 161)

Mbase ke harruar!

I. Kelmendi: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, **4 qershor 1980**; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159

-16. Me nënkuptim prej të pakënaquri

Jusufi, pas përfundimit të punës së tij me numrin e fundit të gazetës Bashkimi, në dhjetor 1980, vazhdon të dëgjoj me vëmendjen më të madhe këshillat shumë bujare e dashamirëse të I. Kelmendit për punët e brendshme të Lëvizjes së vetë.

*I. Kelmendi: "Ju të Lëvizjes ende nuk keni vendosur asgjë konkrete. Po më habit durimi yt për të pritur kontaktimin me Sabitin dhe udhëzimet nga ai për të cilin më the me nënkuptim **prej të pakënaquri** se ende nuk të ka kontaktuar." (Atentatet, f.194)*

Në dhjetor 1980 Jusufi vazhdon t'ia shpreh I. Kelmendit pakënaqësinë e vetë që e ka ndaj Sabri Novosellës për shkak se ai ende nuk e ka kontaktuar dhe habitet me durimin e Jusufit. Është e arsyeshme që I. Kelmendi habitet me durimin e Jusufit pasi ai e di se durimin e vetë e humb më lehtë, se durimi i tij mund të bëhet i pakontrolluar, siç e kemi pa në rastin e rastësishëm të Munchenit.

Se sa i **pakënaqur e i lëkundur** është Jusufi në Sabri Novosellën e sa i palëkundur është në shokun e mirë të Sadik Blakajt e dëshmojnë fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e*

*kësaj organizate, apo ndoshta **në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj**, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-17. Ka manipuluar me ty

I. Kelmendi edhe pse vetë anëtarë i 'Frontit të Kuq' të pagëzuar dhe popullarizuar nga UDB-a, ia jep vetes të drejtën, për shkak se është bujar i madh, t'i mbaj ligjëratë Jusufit për punët e brendshme të Lëvizjes së tij.

*I. Kelmendi: "Mua po më duket se diç nuk është në rregull me qëndrimin e tij, por as tëndin. Kam filluar të dyshoj se **ai të ka manipuluar ty** edhe në Kosovë. Atje asgjëkundi nuk duken gjurmët e veprimtarisë se Organizatës suaj." (Atentatet, f.194)*

Pra I. Kelmendit nuk i duket në rregull jo vetëm qëndrimi i Sabri Novosellës por as i Jusufit. Në vazhdim merr rolin e avokatit të Jusufit, i cili na del vetë naiv e i papjekur, dhe se krejt puna në Lëvizjen e tij është rezultat i manipulimeve të Sabri Novosellës. I. Kelmendit i vjen keq pse Jusufi lejon të manipulohet nga Sabri Novosella kur ka mund të manipulohet nga një person shumë më i mirë, siç është Mirani - I. Kelmendi, figura frontale e Frontit të bashkëthemeluar dhe pagëzuar nga UDB-a. Ai çuditet se pse TANJUG-u nuk e përshkruan asgjëkundi veprimtarinë e Lëvizjes së Jusufit. Ndoshta çudia e pakënaqësia e I. Kelmendit ka të bëjë edhe me faktin se pse në pagëzimin e Lëvizjes së Jusufit nuk ka marrë pjesë UDB-a, e cila me siguri Lëvizjes së Jusufit do t'ia zgjidhte një emër më pak provokativ e më pak bombastik dhe shumë më të këndshëm për TANJUG-un.

Se Jusufi me të vërtetë ka pranuar t'i mbahen ligjërata për punën e brendshme të Lëvizjes së tij e dëshmojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta **në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj**, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-18. Është koha të vendosësh

I. Kelmendi i kërkon Jusufit të vendosë diç konkretisht, pra të zgjedhë në mes "Frontit të Kuq" dhe Lëvizjes së vetë.

*I. Kelmendi: "Besoj **është koha që të vendosësh diç konkretisht**, sepse bashkatdhetarët e angazhuar po fillojnë të flasin për njëfarë konkurrence midis nesh. Kjo ka ndodhur sidomos kur ju nxorët Lajmëtarin e lirisë. Edhe pse revista ose buletini, nuk e di si duhet t'i them konkretisht, u ka pëlqyer shumë, nuk kanë hezituar të pyesin me habi se a duhet të shkojnë pas Bashkimit apo pas Lajmëtarit të lirisë." (Atentatet, f. 194)*

Se me të vërtetë Ibrahim Kelmendi, shoku i mirë i Sadik Blakajt ka qenë në gjendje, ka pasur kapacitet ta vendosë Jusufin para alternativës që të zgjedhë në mes Lëvizjes së vetë Nacionalçlirimtare dhe Frontit të formuar, pagëzuar nga UDB-a e vërtetojnë edhe rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-19. Të pengon të gjykosh drejt - Ai po të mban peng

I. Kelmendi (vetë naiv e i sinqertë) vazhdon rolin e avokatit të Jusufit e i vjen keq për te dhe e lutë të shkundet nga adhurimi për Sabri Novosellën.

I. Kelmendi: "Për Sabitin nuk do të flas më, por vetëm të kisha lutur të shkundesh nga adhurimi për të. Nuk të shkon, të pengon të gjykosh e të vendosësh drejt lidhur me moskontaktimin e tij. Ai po të mban peng tash një vit." (Atentatet, f.197)

Na del se sikur mos të ishin pengimet e Sabri Novosellës në gjykimet e Jusufit, me siguri Jusufi menjëherë ishte anëtarësua në 'Frontin' e pagëzuar dhe popullarizuar nga UDB-a. Se çfarë bisedash, e çfarë këshillash merr Jusufi prej I. Kelmendit nga tregon letra e Jusufit dërguar askujt tjetër pos Sabri Novosellës.

Jusuf Gërvalla: *"Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë* ***Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë.* ***Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit",*** *(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.),* ***të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (***Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-20. Ne jemi të bllokuar

I. Kelmendi vazhdon të komentoj manipulimet që Sabri Novosella ia bënë Jusufit, dhe Jusufi e dëgjon me vëmendje I. Kelmendin.

I. Kelmendi: "Por, ***ne jemi*** *bllokuar, sepse ti po vazhdon të mbahesh peng nga udhëheqësi yt, Sabiti." (Atentatet, f.202)*

Jusuf Gërvalla: *"Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se* ***si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes*** *na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne."(*Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Ta zëmë se Jusufi qenka bllokuar nga Sabri Novosella. Këtë mund ta pranojmë, dhe kjo është çështje e brendshme e Lëvizjes së Jusufit. Por mua nuk mundet në asnjë mënyrë me ma përthekua mendja se si është e mundur që Sabri Novosella pa pasur asnjë kontakt me Gjermaninë, me Jusufin apo me këdo tjetër ta bllokoj punën e 'Frontit të Kuq'?!

Se sa i bllokuar është Jusufi nga Sabri Novosella e dëshmon letra e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla*: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë.* ***Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit",*** *(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.),* ***të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.*** " (Letër S. N., 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Pyetja e domosdoshme që shtrohet në këtë rast është: - A është duke e bllokuar Sabri Novosella nga Adapazari i Turqisë afrimin e Lëvizjes së Jusufit me Frontin e Kuq apo është pikërisht Jusufi që e bllokon përjetësisht afrimin e Lëvizjes së tij me Frontin e Kuq, të vërtetën e të cilit Jusufi e ka marrë vesh pas përcjelljes për në Kosovë të Hysen Gegës nga Ibrahim Kelmendi?

Është pikërisht Jusufi ai që bllokon. Dhe kur e ka bllokua Jusufi një punë, ajo ka qenë vulë e përjetshme që as plumbat e UDB-së nuk kanë mundur ta ndryshojnë.

Ibrahim Kelmendi ka dashtë me thënë se ai që donë të dijë raportet e brendshme të Jusufit me Sabri Novosellën këtë mund ta bëjë vetëm duke lexuar fjalët e I. Kelmendit. Në realitet është pikërisht e kundërta dhe është ashtu siç duhet të jetë. Të vërtetën e raportit të Jusufit me Ibrahim Kelmendin dhe Frontin e Kuq pra me një person jashtë organizatës – jashtë LNÇKVSHJ, i kemi të paraqitura vetëm e vetëm në letrat dokumentare të Jusufit dërguar Sabri Novosellës, personit e shokut brenda Lëvizjes sonë.

11. Skënderi - kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

-1. Ka vënë kontakt pa e njohur ju atë përpara
-2. Ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i Lëvizjes sonë

Pas zbulimeve të I. Kelmendit se Jusufi i fton në shtëpi 'informatorët e UDB-së', Nuhi Sylejmanin dhe Xhahilin-Xhavitin, se Jusufi udhëhiqet e manipulohet nga "rrobaqepësi" Sabri Novosella, në kuadrin e shembjes së mitit të Jusufit, radhën e ka të prezantohet Xhafer Durmishi - Skënderi i Shtutgartit.

-1. Ka vënë kontakt pa e njohur ju atë përpara

I. Kelmendi: "Përshtypje të hidhur më ka lënë edhe ai studenti që po e prezantoni me emrin ***Skënderi****. Nuk e kuptova se si ka ardhur të punojë këtu për pushime verore dhe ka vënë kontakt të ngushtë me ju, pa e pas njohur ju atë përpara?" (Atentatet, f.201)*

Veni re se jemi në kohën pas përfundimit të Jusufit me numrin e fundit të Bashkimit, të dorëzuar në shtyp në dhjetor 1980, por që datohet Janar 1981. Shtrohet pyetja se a më ka takuar I. Kelmendi mua gjatë vitit 1980? A ka dëgjuar ai për mua gjatë vitit 1980 apo 1981? Kur më ka takuar për herë të parë I. Kelmendi? Kur jam takuar për herë të parë

me Bardhin dhe Jusufin? A ka dhe sa dëshmitarë të gjallë sot mund ta vërtetojnë këtë fakt?

Më vjen shumë keq se i paskam lënë përshtypje të keqe I. Kelmendit, figurës frontale të 'Frontit' të bashkëthemeluar dhe 100% të emërtuar nga UDB-a. Është shumë interesante në këtë rast habia e I. Kelmendit e shprehur në fjalinë: *'Nuk e kuptova se si ka ardhur të punojë këtu për pushime verore dhe ka vënë kontakt të ngushtë me ju, pa e pas njohur ju atë përpara?'*

Si është e mundur që Bardhi e njofton I. Kelmendin posa Jusufi shkelë në tokën gjermane, dhe se Jusufi i tregon në hollësi raportet e veta me kryetarin e Lëvizjes së vetë, Sabri Novosellën, e të mos ia japin atij (I. K.) një raport të hollësishëm se si kam ardhë unë në Ludwigsburg e Untergruppenbach? Me të vërtetë çudi dhe unë mendoj se faji është i Jusufit i cili nuk ka tregua vëmendje të mjaftueshme dhe ta informoj I. Kelmendin për mua. Po të më kishte prezantua Jusufi hollësisht para I. Kelmendit, jam i bindur se shumë keqkuptime do të evitoheshin, sidomos kur ta kemi parasysh faktin se I. Kelmendi është një person që mund të të mos kuptoj por nuk të keqkupton.

E dhënë tjetër interesante në këtë rast është kjo, se unë i njohur me emrin Skënderi, gjatë pushimeve verore të vitit 1980, me ndihmën e Bardhit paskam punua në Shtutgart.

Shtrohet pyetja se a më ka takuar I. Kelmendi mua gjatë vitit 1980?

Për herë të parë në jetë Ibrahim Kelmendi më ka takuar në shtëpinë e Jusufit në Untergruppenbach, ditën e shikimit të kufomave që i kishte sjellë firma e varrimit, e kjo ditë e sjelljes së kufomave, të enjten, më 21 janar 1982.

A ka dëgjuar ai për mua gjatë vitit 1980 apo 1981?

As për emrin dhe as për pseudonimin tim I. Kelmendi nuk ka dëgjuar asnjë fjalë të vetme gjatë vitit 1980 apo 1981. Ç'është e vërteta gjatë vitit 1980 për mua jo që nuk ka ditur asgjë I. Kelmendi, por e njëjta vlen edhe për Jusufin e Bardhoshin, familjet e tyre dhe rrethin e tyre të ngushtë.

Kur jam takuar për herë të parë me Bardhin dhe Jusufin?

Jusufin, Bardhin, familjet e tyre dhe Naim Haradinajn për herë të parë i kam takuar më 17 korrik 1981.

Shtrohet pyetja se pse I. Kelmendi, shembësi i miteve, na servon gënjeshtra kaq të tejdukshme?

Qëllimi i tij është të na e mbush mendjen se Jusufi ka zhvilluar biseda më intime me te që nuk ka qenë në një organizatë, se sa me shokët e vetë të organizatës siç janë Sabri Novosella dhe unë Xhafer Durmishi. A do të kishte më vdekje, e shembje më të madhe të historisë së Lëvizjes së Jusufit sikur të ishte vërtetuar se Jusufi ka pasur biseda më të afërta, më intime e më të besueshme me figurën e Frontit të pagëzuar nga UDB-ja (Front të cilin pikërisht kështu e definon në këtë kohë askush tjetër pos vet Jusufit) se sa me shokët e organizatës së vet? Sikur kjo të kishte qenë e vërtetë, kjo kishte me qenë me të vërtetë më vdekje për Te dhe historinë e Lëvizjes e tij, dhe në këtë rast atentati i UDB-së në Jusufin do të na dilte absurd, sepse rrjedhim i gjithë kësaj do të ishte se profesionistët e UDB-së e kanë vrarë njeriun i cili bisedat më të ngushta e më të besueshme i ka pasur me figurat e Organizatës së pagëzuar prej saj.

Fatmirësisht për historinë e pavdekshme të Jusufit dhe Lëvizjes së tij, (pikërisht me meritën e Jusufit) gjërat nuk qëndrojnë kështu por është pikërisht e kundërta. Pikërisht ashtu siç e donë rendi i çdo organizate që bënë vepër të përjetshme, Jusufi, bisedat më të ngushta e më të besueshme i bënë vetëm e vetëm me shokët e organizatës së vetë. Se sa janë shokët e tij në nivel të Jusufit është krejtësisht çështje tjetër. Parimi mbetet parim. Ajo organizatë që pretendon të bëjë punë të përjetshme të gjitha çështjet në radhë të parë duhet t'i sqaroj brenda kuadrit të vetë. Për këtë princip Jusufi ka qenë tepër i vetëdijshëm andaj edhe na ka lënë dokumente historike për këtë.

Letra dërguar Sabri Novosellës, na tregon besueshmërinë e afrinë e tij me shokun e organizatës së vetë dhe jo vetëm kaq. Kjo letër na tregon edhe "besueshmërinë e afërsinë" që e ka Jusufi në I. Kelmendin dhe Frontin e Kuq pas dhjetorit 1980.

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta* ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj****, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar****, të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

-2. Ti po shpreson se do të bëhet kuadër i mirë i lëvizjes sonë

Komente tjera të I. Kelmendit për Skenderin të thëna Jusufit e të cilat ai (J. G.) i dëgjon me vëmendje

I. Kelmendi*: "Tani ai ka shkuar në Kosovë dhe nuk i ka ndodhur gjë, edhe pse takimet me të i kishim gjysmëpublike dhe në prani të shumë vetave. Dy tre takime që kishim me ata studentë që patën ardhur për punë gjatë pushimeve verore, meqë Bardhi ua kishte gjetur punën, ma tërhoqi vëmendjen pikërisht surrati i Skënderit, për të cilin ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i* ***lëvizjes sonë*** *çlirimtare." (Atentatet, f. 201)*

I. Kelmendi vazhdon të sjellë fakte për Xhafer Durmishin-Skenderin (në vazhdim do të përmendi vetëm emrin Skender, pasi me këtë emër jam njohur atëherë dhe për emrin 'Skënderi i Shtutgartit' ka ekzistue një respekt i veçantë në disa qytete të Gjermanisë veriore me qendër në Dusseldorf dhe të Zvicrës me qendër në Gjenevë, në vitet 1982-1985.

Çka rrjedhë nga dy fjalitë e mësipërme?

1. Se Ibrahim Kelmendi e ka takua Skenderin e Shtutgartit gjatë pushimeve verore të vitit 1980 në Shtutgart/Ludwigsburg;

2. Jo një herë por dy tri herë.

3. "Takimet me te i kishim gjysmëpublike dhe në prani të shumë vetave." Takimet me Skenderin pra i paska bërë në prani të Jusufit e Bardhit dhe në prani të shumë vetave.

4. "Tani ai ka shkuar në Kosovë dhe nuk i ka ndodhur gjë"

Ta zëmë se jam takuar me Ibrahim Kelmendin në prani të shumë vetave e në prani të Jusufit e Bardhit. Tani kryetari i "Frontit të Kuq" të emërtuar nga UDB-a befasohet se pse nuk më ka ndodhë asgjë në Kosovë.

5. Jusufi i tregon I. Kelmendit se ai (J.G.) shpreson se Skënderi do të bëhet kuadër i mirë i "lëvizjes sonë çlirimtare", (këtu vetëm do të bëjë precizimin "kuadër i Lëvizjes çlirimtare të Jusufit apo mos Jusufi ka mendua se unë në rrethana mirëkuptuese kisha mund me qenë person me vlerë edhe për "Frontin" e emërtuar nga UDB-a. Nëse Jusufi ka menduar se unë mund të jem kuadër i Frontit të pagëzuar nga UDB-a atëherë del se unë ia kam kthye fjalën Jusufit dhe e kam zhgënjye atë, dhe në mos asgjë tjetër vetëm ky gjest, vetëm ky fakt duhet të mjaftojë për ta treguar karakterin tim të vërtetë.

Absurditeti i gënjeshtrave djallëzore është zbërthyer më lart. Pos të tjerëve, Suzana

(gruaja e Jusufit), Tusha (gruaja e Bardhoshit), Naim Haradinaj nga Gllogjani dhe Haxhi Berisha nga Prapaqani e din, se unë Xhafer Durmishi, për herë të par jam gjetur në shtëpinë e në rrethin e Jusufit, në mes të korrikut 1981 (ata nuk e kanë për obligim me i mbajtur në mend datat më të rëndësishme për mua, sepse u mjaftojnë të vetat) pikërisht më 17 korrik 1981.

Se çfarë bisedash mund të ketë zhvilluar Jusufi për mua me I. Kelmendin rrjedh edhe nga letra e tij dërguar Sabri Novosellës:

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar**, të gjitha marrëdhëniet** me përfaqësuesin e tij të këtushëm **i kam ndërprerë**."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

12. Jusuf Gërvalla si manipulues

-1. Hedhja e Nuhi Sylejmanit kundër Hysen Gegës
-2. Hedhja e Hysen Gegës kundër intelektualëve dhe fundi i "Frontit tonë"

-1. Hedhja e Nuhi Sylejmanit kundër Hysen Gegës

Jusuf Gërvalla si manipulues, përbuzës i intelektualëve për llogari të analfabetëve.

Ibrahim Kelmendi na e shpjegon rrugën pa shtegdalje në të cilën gjendet Hysen Gegaj, situatë të cilës i ka kontribuar Jusufi, dhe në atë situatë pa krye bien viktimë e Sadik Blakajt.

I. Kelmendi*: "Mos tani ka ndikuar edhe roli i Nuriut. Ai po imponohet si udhëheqës i bashkatdhetarëve në rreth të Shtutgartit, duke e spostuar Vasilin në plan të dytë. Kështu ndoshta po hatërohet se përse Jusufi po e **afirmonte** gjithnjë e më shumë Nuriun në rolin që e kishte Vasili deri kur i ndodhën gjithë ato paudhësi!? Prandaj Vasili duhet të jetë katandisur në këtë gjendje pa rrugëdalje sa të pranojë edhe mashtrimin e Sadi Bakajt."(Atentatet, f.183)*

"**Express (Nebih Maxhuni)***: Kush është Vasili, ngase lexuesit tanë nuk e dinë?*

Ibrahim Kelmendi*: Vasili është njëri nga personazhet e romanit. Ai ka pasur një urdhër për të bërë atentat ndaj Jusuf Gërvallës, por trimërisht ka refuzuar ta zbatojë. Për këtë ai duhej të ndëshkohej nga UDB-ja."* (Express, 11 mars 2007, www.pashtriku.org)

Sipas I. Kelmendit, fajin për rrugën pa shtegdalje të Hysen Gegës e sheh tek Jusufi për shkak se ai (Jusufi) e afron më shumë Nuhi Sylejmanin se sa 'atentatorin e planifikuar' Hysen Gegën. Nga kjo del, se me fjalët e I.K., Vasili - Hysen Gega është njëri ndër krijesat më të ulëta që gjenden në historinë faktike e në vepra artistike. Na del se ai (Hysen Gega) në fillim mendon se 'Jusufi e ka hak plumbin' e vetëm pas një kohe shndërrohet, sipas Ibrahim Kelmendit, në një karrierist më të sëmurë e më të ulët sa nuk pranon askënd tjetër të jetë më afër Jusufit se sa ai. Po që se ai nuk trajtohet nga Jusufi si personi më i afërt, atëherë kjo për te është rrugë pa shtegdalje, pra aq pa shtegdalje sa edhe mbështetja tek njeriu i dyshimtë e agjenti i UDB-së, siç është Sadik Blakaj, i duket si shpëtim prej situate.

Hysen Gega: *"Ndërkaq, Jusufit as që kam guxuar t'ia përmend këtë fakt, sepse nuk do të mund ta kundërshtoja kundërshtimin e tij për shkuarjen time në Kosovë."* (Kam refuzuar ta vras Jusuf Gërvallën, www.kosova-sot.info, 29 mars 2012)

Është interesant të analizohet në bazë të dokumenteve më të plota e të shohim se kush është ai, dhe jo Hysen Gega, i cili në të vërtetë nuk len shpifje, insinuata, etiketime, gënjeshtra e sa e sa punë nga më të ndyrat vetëm e vetëm që, pos tjerash, pas operacionit të UDB-së së janarit 1982, për t'u paraqitur si shoku më i afërt i Jusufit.

Jusufi kurrë nuk e ka manipuluar as Hysen Gegën e as Nuhi Sylejmanin, as nuk e ka favorizuar ndonjërin në kurriz të tjetrit. Njerëzit e ndyrë e të paautoritet e pa pozitë solide e me etje djallëzore që me çdo çmim përpiqen të bëhen dikushi, kanë nevojë konstante të mbjellin grindje e konflikte në mes mashave të veta. Jusufi, me një autoritet e pozitë të padiskutueshme, autoritet e pozitë të cilën nuk e ka lakmuar kurrë por që vetë natyra ia kishte dhënë, këtë nevojë nuk e ka pas dhe nuk e ka përdorë kurrë as ndaj Hysen Gegës, as ndaj Nuhi Sylejmanit e as ndaj askujt tjetër.

-2. Hedhja e Hysen Gegës kundër intelektualëve dhe fundi i "Frontit tonë"

Jusufi që në të shumtën e rasteve është për keqardhje se manipulohet lehtë, na del si manipulues në mes punëtorëve fizik të mërgimit që nuk janë anëtarë të Lëvizjes së tij dhe intelektualëve të Kosovës që janë anëtarë të Lëvizjes së tij.

I. Kelmendi*: "Ditë më parë Jusufi ishte informuar për arrestimin e disa patriotëve në Kosovë, ndër të cilët ishte edhe magjistër* ***Hasan Ukhaxha****, mësimdhënës i gjuhës shqipe në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan,* ***Ibish Neziri****, student i letërsisë e të tjerë, emrat e të cilëve vendosi t'i botonte në një fletë të titulluar Shtojcë e Lajmëtarit.* ***Për këdo do të ishte e rendit që arrestimet në Kosovë të radhiteshin para arrestimit të Vasilit****, qoftë duke marrë për bazë arrestimin më të hershëm të tyre, qoftë për shkak të përmbajtjes. Arrestimi i Mr. Hasan Ukhaxhës, i cili ishte i organizuar në Kosovë, ishte goditje shumë më e rëndë për radhët e organizuara dhe për Kosovën, se sa arrestimi i mërgimtarit Vasil. Kjo s'vlente për Jusufin, sepse ai e njihte Vasilin personalisht. Me të kishte lidhje të veçanta shpirtërore."* (Atentatet, f.227)

Më lart kemi parë se si I. K. na tregon kur Jusufi ia bënë Hysen Gegës jetën të pamundur në Gjermani duke e hedhur Nuhi Sylejmanin kundër tij (H. Gegës).

Kurse tani po ky I.K. harron se çka ka thënë dhe na del se Jusufi e hedhë Hysen Gegën kundër anëtarëve të Lëvizjes së vetë në Kosovë, dhe se pikërisht ai që e ka dorëzuar Hysen Gegën te UDB-a përmes Sadik Blakajt na u bëhet avokatë anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit, të cilët J.G. i paska lenë anash.

I. Kelmendi, figura përfaqësuese e "Frontit të Kuq", është aq bujar sa vazhdimisht preokupohet me punët e brendshme të Lëvizjes së Jusufit.

Në shumë pika më lartë e kemi pa se si I. K. i bëhet avokat Jusufit dhe përpiqet ta shpëtoj nga manipulimet e Sabri Novosellës. Nga rreshtat më lartë del se Jusufi (nga vetë i manipuluar prej Sabri Novosellës) shndërrohet në manipulues në mes të burgosurve të Lëvizjes së vetë në rrethin e Deçanit dhe Hysen Gegës. Dhe prapë I. K. (përndryshe naiv e shumë i sinqertë) e ndien veten të thirrur që ta luaj rolin e avokatit, por në këtë rast jo si avokat i Jusufit, por si avokat i anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit në rrethin e Deçanit, të cilët Jusufi i klasifikon, i vendos në rend të dytë, edhe pse janë intelektual në krahasim me analfabetin apo gjysmanalfabetin Hysen Gega, si punëtor fizik. E kush **vuan** më shumë për mungesën e tyre, e kush ua di vlerën intelektualëve më shumë se I. Kelmendi?!

I. K. i bënë këto komente për numrin e fundit të Lajmëtarit të lirisë që u përgatit në janar 1981. I. Kelmendi i servon këto intriga e shpifje duke menduar se shokët e Jusufit nuk e kanë apo kanë harruar ta ruajnë për përjetësinë, Lajmëtarin e lirisë. Të shohim se si qëndron puna në këtë pikë.

Ja se çka shkruan në faqen e parë të Lajmëtarit të lirisë të janarit 1981, në të njëjtën

faqe ku është edhe artikulli për Hysen Gegën:

Jusuf Gërvalla: *"Tani mund të thuhet se është i rrallë ai fshat, ajo lagje qyteti, apo ajo shtëpi shqiptare ku UDB-a të mos ketë burgosur së paku nga një njeri, ose të mos ketë bastisur egërsisht. Me një tentim shtazarak, që i kalon edhe kufijtë e terrorit të aksionit famëkeq të armëve të vitit 1956, revizionistët jugosllavë po orvaten të zhbijnë çdo filiz të rezistencës shqiptare ndaj shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kapitalist e kolonialist nga ana e shovinistëve të Beogradit.*

*Me indinjatë të thellë i bëjmë me dije forcat tona revolucionare dhe mbarë popullin se, përveç vëllezërve Hysen dhe Danush Gegaj, kohëve të fundit u arrestuan për veprimtari "armiqësore kundër popullit e shtetit", do të thotë për veprimtari patriotike, edhe këta persona: Hasan Ukëhaxhaj, magjistër i gjuhës shqipe, profesor në gjimnazin e Deçanit, Musa Berisha nga Duboviku, student i letërsisë shqipe, momentalisht në shërbimin ushtarak në Ptuj, si dhe një milic, të cilit ende s'ia dimë emrin etj." (*Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981, faqe 1*)*

Në shtojcën e Lajmëtarit Jusufi e jep lajmin e burgosjeve tjera me këto fjalë:

Jusuf Gërvalla: *"SHTOJCË E 'LAJMËTARIT'*

Revista jonë ishte në përfundim e sipër kur ne siguruam të dhënat për ngjarjet e mëposhtme. Ç'është e vërteta pjesën më të madhe e dinim edhe më parë. Por prisnim ndonjë listë konkrete, që do të paraqitte, në mënyrë më të afërme, sidomos gjendjen tonë sa u përket burgosjeve të egra, që UDB-ja po zbaton masivisht në viset shqiptare, gjithnjë më intensivisht prej më se dy vjetësh e këtej, duke u përpjekur të na trembë e të na qes pengesë pas pengese në rrugën e lëvizjes sonë patriotike e revolucionare. Kështu na shënimet relativisht të bollshme që mblodhëm tani, u detyruam ta zgjerojmë gjithë numrin e revistës sonë me këtë shtojcë, dy faqesh, që i kapërcen shpenzimet tona edhe ashtu të mëdha për shtypjen e revistës. ***Qëllimi kryesor ishte që të mos presim t'i botojmë ato në numrin e ardhshëm, nga i cili do të na ndaj shumë kohë, kurse nga materialet e përgatitura më parë për këtë numër nuk gjenim asnjë të tepërt, që të hiqnim dorë prej tij kësaj radhe.*** *Prandaj, në qoftë se materialet e shtojcës nuk do të jenë të përpunuara në nivelin e shkrimeve tjera, nga lexuesi ynë i ndershëm kërkojmë ndjesë.*

Ja që u krye lista e një pjese shqiptarësh të ndershëm, që UDB-ja jugosllave i burgosi - me dorën e veglave të fëlliqura kosovare - vetëm në periudhën prej 21 nëntorit 1980 deri në të aguar të 1 janarit 1981:

1. Hasan Ukëhaxhaj, nga Carrabregu, magjistër i gjuhës shqipe, arsimtar në QAMO "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit.

2. Ibish Neziri, nga Bardhaniqi, student i gjuhës shqipe, i burgosur më 21 nëntor 1980." (Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981).

Vlerën njerëzore të luftëtarëve të lirisë Jusufi nuk e ka klasifikuar kurrë në bazë të përgatitjeve të tyre shkollore e profesionale. Është tjetër çështje se përgatitjet e tyre të ndryshme ndikojnë që ata të japin kontribute të ndryshme. Klasifikimi e hedhja e njërit patriot kundër tjetrit ka qenë projekt i UDB-së, mashave të saja apo i ndonjë megalomani sa të verbët aq edhe të egër për pushtet dhe asnjëherë i Jusufit.

Megjithatë, komenti i I. Kelmendit e ka një domethënie të madhe. Është shumë e vërtetë se Jusufi e çmon më shumë Hysen Gegën se sa një Organizatë të tërë për të cilën është menduar se është Organizatë. Jusufi e çmon Hysen Gegën më shumë se sa Frontin e Kuq dhe Ibrahim Kelmendin. Burgosja e Hysen Gegës është fundi i Frontit të Kuq, i "Frontit tonë". Në dritën e këtij fakti kuptohet shumë më lehtë avokatura e Ibrahim Kelmendit për intelektualët e Lëvizjes sonë.

"Ti po shpreson, se do të bëhet kuadër i mirë i lëvizjes sonë"

Jusuf Gërvalla*: "**Kështu e pata kuptuar** më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ (Komitetin Qendror të **Lëvizjes sonë**-shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, **14 janar 1982**. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

Jusuf Gërvalla dhe demonstratat

e vitit 1981 në Evropën Perëndimore

Çështje të parashtruara në librin e Ibrahim Kelmendit, Atentatet, Focus - Prishtinë 2007 dhe www.pashtriku.org

1. Jusufi e Ibrahim Kelmendi u takuan menjëherë
2. Nuk do të bëjmë asgjë pa marrë kontakt me shokët e *Lirisë*
3. Më është dhënë adresa kontaktuese
4. Atëherë po shkoj që sot në Zvicër
5. Jusufi po hezitonte të merrte vendime
6. Ne vendosëm të mos e botojmë më *Bashkimin* pa e bashkuar organizimin tonë
7. Ti do të shkosh në Zvicër - tha Jusufi
8. Jusufi thotë se ti duhet të presësh
9. Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë
10. Jusufi më ka autorizuar ta përfaqësoj edhe atë
11. Është koha e fundit që ne të bashkohemi në një organizatë
12. Ti tani duhet të shkosh në Vjenë në Ambasadën Shqiptare
13. Skenderin e pengon afirmimi i babait dhe të birit
14. Një pjesë të madhe të kohës e kishte kaluar në shtëpi të Jusufit

Emin Lati, Tahir dhe Nebi Meha

Për të treguar të vërtetën e asaj kohe është kujdesur më së miri Jusuf Gërvalla. Në këtë shqyrtim si vërtetim, më së shumti e përdori një citat të Jusufit nga letra e tij dërguar Sabri Novosellës në Turqi më 13 maj 1981. Citatin nga kjo letër e kam marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116. Për t'ua dhënë përgjigjen të gjitha çështjeve të parashtruara këtu kanë qenë krejtësisht të mjaftueshëm vetëm disa rreshta nga letra e Jusufit e 13 majit 1981.

Ajo çka është shumë interesant të hetohet është fakti se si e ka pritur Jusufi dërgimin e Hysen Gegës në Kosovë së bashku me Sadik Blakajn. Aq e thellë ka qenë shkëputja e të **gjitha** marrëdhënieve të Jusufit me

Ibrahim Kelmendin pas përgatitjes së numrit të fundit të Bashkimit, sa as demonstratat e fuqishme të vitit 1981, për të cilat foli gjithë bota, nuk kanë as efektin më të vogël për të ndikuar tek ndonjë afrim. Letra e Jusufit, e 13 majit 1981, e 13 majit - festës apo praznikut të UDB-së, ditë e cila që nga viti 1981 në kalendarin shqiptar njihet si Dita e Nebih dhe Tahir Mehës, e dëshmon më së miri këtë fakt.

1. Jusufi e Ibrahim Kelmendi u takuan menjëherë

Pas 11 marsit 1981, Jusufi e I. Kelmendi takohen menjëherë në shtëpinë e Jusufit, në Untergruppenbach.

I. Kelmendi: *"Jusufi e Mirani u takuan menjëherë pas kësaj ngjarjeje historike për të biseduar se çfarë duhej e mund të bënin." (Atentatet, f.232)*

Fjalët e Ibrahim Kelmendit përputhen pikë për pikë me planet e Shkollës së UDB-së Serbe, të përfaqësuar në këtë rast nga Abdullah Prapashtica.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi **në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.** ... **në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzënë nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

(Kështjella e pamposhtur e Vëllezërve Gërvalla, e pa njollosur përveç flluskave të bardha të borës, e fotografuar nga Remzi Ademi në dhjetor 1984 me kërkesën e Xhafer Durmishit)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në **dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Abdullah Prapashtica: *"Ajo që sjell Nuhi Sylejmani në librin e vet është **dëshmia e ti personale** si njëri nga bashkëpunëtorët e rrethit të ngushtë të Jusuf Gërvallës në Gjermani, mbi atë bashkëpunim që kanë pas ata së bashku në kuadër të ish LNÇKVSHJ dhe **dëshmi autentike** e zhvillimeve të pastajshme... (...)Nuhi Sylejmani shkruan me kompetencë..."* (MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT“ TË NUHI SYLEJMANIT, www.albaniapress.com, 14 tetor 2010)

Osman Osmani: ***"Kujtimet dhe dokumentet përcjellëse brenda librit sjellin fakte historike të pakundërshtueshme dhe të panjohura gjer më tani**. **Në mënyrën më të përpiktë**, paraqitet gjendja dhe zhvillimi i tri organizatave shqiptare të asaj kohe, që vepronin kryesisht në botën e jashtme si Fronti i Kuq Popullor, GMLK/OMLK dhe LNÇK/LNÇKVSHJ, si dhe për proceset organizative dhe ideologjike nëpër të cilat kalojnë këto organizata para dhe pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.*

*Autori ndër të tjera, **në mënyrën më besnike**, përshkruan peripecitë dhe ballafaqimet me sfida të shumta të familjeve Gërvalla dhe Zeka pas atentatit të 17 janarit të vitit1982."* (Kopertina e mbrapme e librit të quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010)

Në dritën e fakteve historike për të cilat është kujdesur që të na i lej Jusufi, fjalia e mësipërme e Ibrahim Kelmendit jo vetëm që është gënjeshtër e paskrupullt, por duket edhe një tentim sa i mjerë aq edhe qesharak për të na e mbushur mendjen se Jusufi ka pasur ndonjë kontakt e bashkëpunim me te në këtë kohë. Letra e Jusufit duket se ka teha të panumërt për t'iu kundërvu falsifikimeve e njollosjeve.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. **Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (**19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), **të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.**" (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

Shokët e Jusufit nuk mund të mashtrohen me këto rrena e falsifikime, por prapëseprapë nuk mund të thuhet se testimi i opinionit që I. Kelmendi e bënë në këtë pikë i ka shkuar krejtësisht huq në disa drejtime tjera. Fjalët e Jusufit janë projektile të drejtuara kundër të gjithë falsifikatorëve, çka do të thotë se në këtë rast ato janë të drejtuara edhe kundër Shkollës së UDB-së Serbe të shfaqur në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010.

2. Nuk do të bëjmë asgjë pa marrë kontakt me shokët e *Lirisë*

Jusufi bisedon me I. Kelmendin se si me ra në kontakt me OMLK-në në Zvicër.

*I. Kelmendi: "– Nuk do të bëjmë asgjë pa marrë kontakt me shokët e Lirisë, – shfaqi pozicionim Jusufi. Kështu e kishte **më të përzemërt t'i quante ai njerëzit e OMLK**–së, meqë qysh në tetor të vitit paraprak ata kishin nxjerrë numrin e parë të këtij Organi. Atij i kishte pëlqyer shumë përmbajtja, por jo forma, faqosja, letra e shtypja.*
– Mirë, po ku t'i kontaktojmë? – pyeti Mirani." (Atentatet, f.232)

Shoku i mirë i Sadik Blakajt vazhdon me testimin e opinionit duke na e përgatitur terrenin për të na thënë se është Jusufi ai i cili figurën e Frontit të UDB-së e ka qitë në gjurmët e Kadri Zekës. Letrat e Jusufit tregojnë se Jusufi është njohur me Kadri Zekën pa ndihmën e shokut të Sadik Blakajt, Ibrahim Kelmendit. Ato tregojnë gjithashtu se Kadri Zeka në anën tjetër, (ashtu si Hydajet Hyseni më parë) është takuar apo ka ra në kontakt me Ibrahim Kelmendin pa ndihmën e Jusufit.

Se sa i **përzemërt** është raporti i Jusufit me Ibrahim Kelmendin e vërtetojnë fjalët e mëposhtme.

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

3. Më është dhënë adresa kontaktuese

Jusufi i tregon I. Kelmendit se 'i është dhënë një adresë kontaktuese në një librari në Zvicër" për të kontaktuar me OMLK-në.

I. Kelmendi: "– Më është dhënë një adresë kontaktuese në një librari në Zvicër." (Atentatet, f. 232)

Rrena qesharake e personit që mundohet me e plasue veten në **qendrën** e ngjarjeve historike shkatërrohet nga fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla*: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në* ***qendër të saj****, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar****, të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

4. Atëherë po shkoj që sot në Zvicër

Jusufi është i pajtimit që I. Kelmendi të udhëtoj në Zvicër për të marrë kontakt me OMLK-në

I. Kelmendi: "– Atëherë po shkoj që sot në Zvicër, meqë ty akoma nuk të kanë dhënë dokument udhëtimi jashtë shtetit, – tha tjetri. (I. K. - shënimi ynë).

– Edhe unë (Jusuf Gërvalla - shën i Xh. D.) them ashtu, por po presim mos po më paraqitet në telefon te Bardhi ndonjëri nga shokët e Lirisë, meqë numrin ia dhashë atij që ma solli adresën." (Atentatet, f. 232)

Letra e Jusufit është si drita e diellit dhe e demanton këtë falsifikim.

Jusuf Gërvalla: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Ndoshta shokëve të Kadri Zekës do t'u pëlqente ky version, për të thënë se është Jusufi që e ka qitur Ibrahim Kelmendin në gjurmët e Kadri Zekës. Ndoshta ky version do të ishte një lloj ngushëllimi për ta, përderisa edhe pse i dinë disa të vërteta shumë mirë, pa dallim Ibrahim Kelmendin e marrin si dëshmitarë shumë të besueshëm në përshkrimin e ngjarjeve të asaj kohe. Aq më keq e aq më turp për ta.

Jusufi kurrë nuk e ka dërgua Ibrahim Kelmendin në Zvicër, pasi ai pas dhjetorit 1980, pas rastit të Hysen Gegës nuk ka asnjë lidhje me te sepse "***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* Se kush është Fronti i Kuq në këtë kohë, Jusufi është i qartë përfundimisht, se kush mund të jetë Ibrahim Kelmendi si individ Jusufi në këtë kohë ka aq dyshime të bazuara, sa nuk munden me ia lëkundë apo hequr as krejt demonstratat e Kosovës të Pranverës 1981.

A do të kishte shkatërrim më të madh të mitit e të historisë së Lëvizjes, e të historisë personale të Jusufit sikur ai në këtë kohë t'ia kishte dërguar Kadri Zekës çfarëdo porosie përmes personit të një Fronti në qendër të të cilit gjendet UDB-a. Asgjësim më i madh për historinë e Jusufit nuk do të ekzistonte. Jusuf është ai Jusuf që e njeh i gjithë kombi vetëm e vetëm pse ai gabime të tilla nuk ka bërë kurrë.

5. Jusufi po hezitonte të merrte vendime

Jusufi, është aq naiv sa edhe në këtë situatë e ndien veten peng të Sabri Novosellës.

I. Kelmendi*: "Jusufi po* ***hezitonte*** *të merrte vendime, meqë vazhdonte ta ndiente vetën peng të Sabit Katunriut, kurse ky ende nuk e kishte kontaktuar për t'i dhënë udhëzime, siç po priste me padurim deri në naivitet i pari."* (Atentatet, f. 232)

Jusufi ka dalë në skenën e hapur të luftës në janar 1980 dhe nuk ka ekzistua ajo forcë që ta mbaj atë peng apo ta detyroi të bëjë negociata bashkimi me organizata të cilat i ka emërtuar UDB-a. Posa del në Gjermani, I. Kelmendi i afrohet dhe i ofron bashkëpunim me revistën "Bashkimi" dhe Jusufi duke e ditur se ajo revistë bien në duart e popullit ka pranuar ta ndihmoj, pa e pyetur askënd e pa qenë peng i askujt në këtë pikë, dhe këtë, kur në Kosovë gjendja është "e qetë". Natyrisht se ai do të ishte konsultuar me Sabri Novosellën apo me ndonjë shokë përgjegjës të Lëvizjes së tij, sikur të kishte pasur kontakt. Përkundër faktit se ai nuk ka kurrfarë kontakti me shokët e Lëvizjes së vetë që nga 14 dhjetori 1979 gjer më 14 prill 1981, është aktiv e me iniciativa të pashtershme. Jusufi pa **hezituar** merr vendim për ta ndihmuar në mënyrë vendimtare përgatitjen për shtyp të revistës Bashkimi në shkurt 1980, numrin vijues në maj 1980 dhe numrin e fundit në dhjetor 1980. Jusufi nuk ishte peng për gjithë këtë punë në këtë kohë, por kishte gjithë ato iniciativa si njeri i veprimit. Shoku i mirë i Sadik Blakajt mundohet me na e mbush mendjen se në kohën kur puna e Jusufit në mënyrë të mahnitshme ka treguar aq suksese, kur krejt Kosova është në këmbë dhe e gjithë bota fletë për te, Jusufi e paska ndier veten të paralizuar nga veprimet praktike pasi paska qenë peng i Sabri Novosellës.

Jusuf Gërvalla, pas 11 marsit është në veprim si kurrë më parë, por të gjitha veprimet i bënë me shokë besnik të Shtutgartit, e edhe me Kadri Zekën në Zvicër pa pasur punën e as kontaktin më të vogël me I. Kelmendin. Këtë e dëshmon letra tanimë e njohur që përkundër ndonjë vërejtje duhet të pajtohemi se i meriton gjithë ato përsëritje që i bëhen:

Jusuf Gërvalla*: ''Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë,* ***pas numrit të fundit të "Bashkimit"****, të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë****.''* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

6. Ne vendosëm të mos e botojmë më *Bashkimin* pa e bashkuar organizimin tonë

I. Kelmendi i tregon Jusufit se 'Ne' (Fronti i Kuq Popullor) vendosëm të mos e botojmë Bashkimin pa e bashkuar **organizimin tonë** (d.m.th. më konkretisht organizatat tona).

I. Kelmendi: "– Jusuf, tani u pa puna. Ne vendosëm të mos e botojmë më Bashkimin *pa e* ***bashkuar organizimin tonë****. Arsyetuam se nuk kishte më kuptim që ta botojmë, meqë tani po botohen Lajmëtari i lirisë dhe Liria dhe nuk kemi nevojë e energji për tri botime." (*Atentatet, faqe 232)

Shkaqet e vërteta të ndërprerjes së Bashkimit janë shpjeguar hollësisht në disa punime tjera e sidomos në atë me titull "Kështu e pata kuptuar historinë e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Lëvizjes sonë në vitin 1980" (www.pashtriku.org).

Është interesant se sa në mënyrë të thellë shtrohet çështja nga I. K. Jusufi dhe I. Kelmendi bëjnë luftë të ashpër kundër një pushteti komunist e një diktature komuniste dhe në të njëjtën kohë duan të bashkohen me komunistët.

Çështje që shtron I. K., personi më me përvojë organizative në atë kohë është se Jusufi, Kadriu e I. Kelmendi u takojnë **organizatave të ndryshme të të njëjtit organizim.** A ka frazë apo fjali më konkrete e më e qartë, e më transparente se kjo.

Selatin Novosella: *"Duke qenë ndër udhëheqësit e nivelit më të lartë të LNÇKVSHJ-së, duke mbajtur lidhjet me Metush Krasniqin në Kosovë e Sabri*

Novosellën në Turqi, nga njëra anë:. .. duke qenë në bashkëpunim me udhëheqësit e Frontit të Kuq Populllor kryetarin e tij Ibrahim Kelmendin ... Jusuf Gërvalla, kështu do të shndërrohet në faktor koheziv dhe të pazëvendësueshëm." (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 147-148)

Se sa ka qenë i gatshëm Jusufi ta përziej **organizatën e organizimin** e vetë me Frontin e bashkëthemeluar dhe emërtuar nga UDB-a shihet nga letra e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër S. N., 13 maj 1981*)*

Nga përmbajtja e kësaj letre duket se Sabri Novosella i kërkon Jusufit (qoftë përmes ndonjë letre që ende nuk është bërë publike qoftë përmes telefonit) që të nisë ndonjëfarë procedure për bashkimin e Lëvizjes së Jusufit me Frontin e Kuq. Edhe në këtë kuptim mund ta lexojmë këtë pjesë të letrës. Jusufi i tregon Sabriut se si qëndron puna me Frontin e Kuq, por megjithatë, si person që rigorozisht e respekton disiplinën dhe hierarkinë e organizatës, ai (Jusufi) nuk i mbyllë të gjitha dyert për bashkim me Frontin e Kuq. Por ai në këtë pikë donë të jetë i pastër duke i thënë se biseda eventuale për bashkim me Frontin e Kuq, përmes tij (Jusufit) për të gjallë të tij me te nuk mund të bëhen. Por megjithatë Jusufi nuk ka dëshirë ta lenë Sabriun në gjysmë të rrugës, prandaj i ndihmon që ta qetë në gjurmë të vërteta duke i thënë se nëse me të vërtetë ke dëshirë me u bashkua me Frontin e Kuq atëherë ke mundësi që shokëve tu në Kosovë t'u thuash që të marrin kontakt me qendrën e këtij Fronti, me personin e UDB-së, me Blakajn, që punon në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë.

7. Ti do të shkosh në Zvicër - tha Jusufi

Jusufi i jep detyrë I. Kelmendit që të shkoj në Zvicër për të kontaktua me OMLK-në.

I. Kelmendi*: "– Miran, shokët e Lirisë nuk na kontaktuan ende, prandaj ti do të shkosh në Zvicër, – tha Jusufi. – Diskuto me ta se çfarë duhet të bëjmë, meqë ata janë më të ngritur e më të organizuar se ne." (*Atentatet, f. 233-234)

Se çfarë gënjeshtrash janë fjalët e mësipërme tregon letra e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër S.N., 13 maj 1981)

Më 26 mars 1981, I. Kelmendi në marrëveshje dhe me porosi të Jusufit udhëton në Zvicër, me adresën Badhaus strasse 35, Biel-Bienne, të cilën ia ka dhënë Jusufi.

I. Kelmendi: *"Ditën e enjte të 26 marsit, Mirani udhëtoi në qytetin Bil/Bien (Biel-Bienne) të Zvicrës. Duhej të gjente adresën kontaktuese të OMLK–së, të cilën ia dha Jusufi." (Atentatet, f. 235)*

Për shokët e Jusufit ky trillim është i lehtë për t'u zbuluar falë dokumenteve që Jusufi ia ka lënë Lëvizjes së tij Nacionalçlirimtare.

Jusuf Gërvalla: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Por megjithatë nuk mund të thuhet se I. Kelmendit i ka shkuar mundi krejtësisht kot, pasi nga 'komunistët' konsiderohet sot e kësaj dite si dëshmitar i besueshëm i një kohe shumë të rëndësishme për popullin tonë. Ndoshta atyre me të vërtetë do t'u pëlqente sikur Jusufi ta kishte qitur I. Kelmendin në gjurmët e Kadri Zekës. E vërteta historike është se Kadri Zeka e I. Kelmendi kanë ra në kontakt me njëri-tjetrin pa ndihmën më të vogël të Jusufit.

Përveç Renatës, I. Kelmendi i tregon edhe zviceranit, pronarit të librarisë në Badhaus strasse 35, se nuk është komunist, apo marksist-leninist.

I. Kelmendi: – Ju në Gjermani botoni gazeta të mira, – tha Bendickti pasi i kreu bisedat për informim personal. – Por Liria ka linjë më të qartë marksiste-leniniste.
– Sepse është Organizatë marksiste-leniniste, kurse ne nuk jemi." (Atentatet, f. 236)

8. Jusufi thotë se ti duhet të presësh

Përkundër pritjes së gjatë në Biel-Bienne, Bardhi e thërret I. Kelmendin në telefonin e librarisë dhe ia përcjellë porosinë e Jusufit.

I. Kelmendi: *"Bardhi e informoi Miranin: "Jusufi thotë se ti duhet të presësh deri sa t'i kontaktosh shokët!"". (Atentatet, f. 238)*

Mjafton edhe një fjali e vetme e Jusufit për t'i dhënë përgjigje gati gjysmës së librit të I. Kelmendit.

Jusuf Gërvalla: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

9. Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë

Takimi i parë i I. Kelmendit me Kadri Zekën. I. K. i tregon K. Zekës se është i dërguar nga Jusufi.

I. Kelmendi: *"– Kam ardhur të enjtën. – filloi Mirani. – Biseduam me Jusufin se çfarë duhet të bëjmë në këtë situatë kaq dramatike e alarmante. Ai më tha se duhet të bisedojmë me shokët e Lirisë, që të koordinohen aktivitetet në të gjitha shtetet ku gjendet emigracioni ynë. Erdha t'ju kontaktoj dhe të bisedojmë se cili është mendimi juaj?" (Atentatet, f. 238-239)*

Jusuf Gërvalla: *"Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

Kadri Zeka në takimin e parë ia tregon I. Kelmendit emrin e tij të vërtetë dhe i lutet të mos e dekonspiroj.

I. Kelmendi: "– Unë t'u prezantova në prani të Benediktit me emrin Zeqë, por unë në të vërtetë e kam emrin e mbiemrin Kadri Zeka. Jam nga Gjilani, i strehuar politik këtu në Zvicër. Je ndër pak veta që po ta tregoj emrin e vërtetë, por të lutem mos më dekonspiro!" (Atentatet, f.239)

Pas Renatës, Benediktit (pronarit të librarisë) I. K. i tregon edhe Kadri Zekës se ai (I. K.) nuk është komunist.

I. Kelmendi: "Në fillim Kadriu paraqiti gjendjen në Kosovë, siç e kishin informuar shokët e organizatës se tij, pastaj bëri një analizë të përmbledhur: – Ne duhet të fillojmë me demonstrata. Të parën duhet ta bëjmë pas nja dy javësh, meqë më një prill planifikohen demonstrata të mëdha në Prishtinë...
– Domethënë për ditën e rrenëve… – ndërhyri me shaka Mirani.
– Qenkan të vërteta ato që kam dëgjuar për ty, se nuk je komunist i disiplinuar, – tha Kadriu, i pakënaqur me këtë shaka të Miranit. – Tani jemi duke biseduar gjëra serioze...
– Më fal! Vërtet nuk jam komunist dhe aq më pak komunist i disiplinuar, siç kërkoni ju komunistët, sepse atë lloj disipline nuk e pëlqej dhe nuk mund t'i përmbahem." f. 239

Kontaktet e I. Kelmendit me Kadri Zekën dhe përmbajtja e bisedave të tyre, në këtë rast nuk paraqesin interes të veçantë për mua si shok i Jusufit. E vetmja çështje që më intereson është implikimi e mosimplikimi i Jusufit dhe Lëvizjes së tij në këto kontakte.

Jusuf Gërvalla*: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha*** *marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

10. Jusufi më ka autorizuar ta përfaqësoj edhe atë

I. Kelmendi pajtohet me planet e Kadri Zekës për demonstratën e parë në Zvicër dhe i tregon atij (K .Z.) se ka autorizim që në atë bisedë ta përfaqësoj apo të flasë edhe në emër të Jusufit.

I. Kelmendi: *"– Unë për vete po****. Besoj se edhe Jusufi pajtohet, meqë më ka autorizuar ta përfaqësoj edhe atë****. Ne të Frontit kemi vendosur të ndërpresim botimin e Bashkimit pasi ju keni filluar ta nxirrni Lirinë, kurse Jusufi Lajmëtarin qysh vitin e kaluar. Duke shpërndarë tri gazeta në të njëjtat mjedise vetëm sa po i iritojmë bashkatdhetarët." (Atentatet, f. 240-241)*

A do të kishte më turp e ulje më të madhe për Jusufin dhe Lëvizjen e tij Nacionalçlirimtare sikur ai ta kishte autorizuar shokun e Sadik Blakajt dhe Frontin e emërtuar nga UDB-a që të flasë në emrin e tyre e t'i përfaqësoj ata. Natyrisht se nuk do të kishte.

Jusufi Gërvalla: *"Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

11. Është koha e fundit që ne të bashkohemi në një organizatë

I. Kelmendi edhe pse vetë armik i sistemit dhe diktaturës komuniste mendon se është koha e fundit të bashkohet në një organizatë me komunistët dhe në këtë organizatë ta kenë edhe Jusufin i cili nuk i donë komunistët.

I. Kelmendi: "Njëherit edhe organizimin e Frontit do ta ngrijmë, meqë mendojmë se është koha e fundit që ne të bashkohemi në një organizatë."(Atentatet, f. 241)

Edhe Jusufi është i mendimit *se është koha e fundit që të bashkohemi në një organizatë.*

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

12. Ti tani duhet të shkosh në Vjenë në Ambasadën Shqiptare

Ibrahim Kelmendi: *"- Mbase e keni fjalën për një "letër" që Jusuf Gërvalla i paskësh dërguar Sabri Novosellës në tetor të vitit 1981 publikuar si "dokument" nga Fahredin Tafallari dhe Xhafer Durmishi. Unë besoj se kjo letër do të rezultojë si falsifikim flagrant, për qëllime goxha hileqare. Nuk besoj të ketë dezinformuar Jusufi, qoftë edhe "udhëheqesin" e tij" Sabri Novosella. Bashkë me Jusufin nuk kam qenë asnjëherë ne Vjenë. Pra vetëkuptohet, as në ambasadën shqiptare. Ai nuk kishte dokument udhëtimi dhe ilegalisht nuk rrezikonte për të dalë jashtë Gjermanisë. Vetëm, në fund të vitit 1981 organet gjermane ia njohën të drejtën e azilit, prandaj i dhanë pasaportë refugjati (traveldokument/Reiseausweis). Për herë të parë jashtë Gjermanisë Perëndimore Jusufi udhëtoi për në Zvicër në dasmën e Kadri Zekës dhe Saime Isufit, më 2 janar 1982."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.158)

Faridin Tafallari: *"28 Nëntori po afrohej; dramën e kishim përgatitur dhe ishim ushtruar mirë. Kishim bërë provat dhe salla ishte siguruar. Por para se të kremtonim ne mërgimtarët kosovarë, vendosëm që ta festonim në Ambasadën e shtetit amë në Vjenë. Ambasada na kishte dërguar disa ftesa dhe ne menduam që të shkonim në Vjenë dhe ne menduam që të shkonim në Vjenë e mandej të ktheheshim në Gjermani. Sokoli (Jusufi) nuk kishte pasaportë dhe ai e kaloi kufirin për në Austri me pasaportën e një shoku I. D.*

Në Vjenë punonjësit e Ambasadës na pritën shumë mirë. Ne kosovarët ishin një grup: Jusufi, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi, Dema, unë e disa të tjerë. Kishim marrë me vete edhe gratë." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 22)

Ibrahim Kelmendi*: "Vetëm, në fund të vitit 1981 organet gjermane ia njohën të drejtën e azilit, prandaj i dhanë pasaportë refugjati (traveldokument/ Reiseausweis)."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.158)

Jusuf Gërvalla: ***"Dje**, bashkë me letrën tënde, më arriti edhe njoftimi se më është dhënë strehimi politik në RFGJ, në bazë të kërkesës së paraqitur para 16 muajsh."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 259)

Jusufi e dërgon I. Kelmendin me porosi në Ambasadën Shqiptare të Vjenës për të marrë pëlqimin për organizimin e demonstratave nëpër metropolet evropiane.

Në shumë pika deri më tani i kemi pa "argumentet" e I. Kelmendit se si atë Jusufi e ka dërguar me mision tek Kadri Zeka në Zvicër. Por e mira e kësaj pune nuk përfundon me

kaq. Pas kthimit nga Zvicra, Jusufi e dërgon I. Kelmendin, përfaqësuesin e Frontit të emërtuar nga UDB-a, me mision në Ambasadën Shqiptare në Vjenë.

I. Kelmendi: "Mirani gjeti lidhjen e parë të trenit dhe u kthye në Shtutgart. Aty po e prisnin Fahriu e Nazimi. Bashkë shkuan te Jusufi. Ai informoi për bisedat me Kadriun. Jusufi u pajtua duke saktësuar se demonstratat do t'i thërrasin në emër të organizatave sipas radhës. E para le të thirret në emër të OMLK–së, pastaj në emër të Frontit dhe e treta në emër të Lëvizjes. Mirani i tregoi se të Frontit nuk do të lëshojnë thirrje dhe e arsyetoi këtë vendim.

***– Miran, ti tani do të shkosh në Vjenë t'i takosh shokët në Ambasadën Shqiptare,– tha Jusufi**.– Ata do t'i pyesësh çfarë mendojnë, nëse e kemi mirë me këto që kemi planifikuar. Mbase mund të gabojmë dhe në vend që të ngjesim vetulla, nxjerrim sy, siç thotë proverbi popullor.*

– Unë mendoj se nuk është e nevojshme. Edhe po të shkoj nuk do të marrë përgjigje konkrete, sepse do të thonë se nuk na përzihen në punët tona dhe se çfarëdo që bëjmë ne, atyre nuk ju intereson...

– Patjetër do të shkosh, pasi unë nuk pranoj të fillojmë demonstratat pa e ditur mendimin e tyre! – këmbënguli Jusufi." (Atentatet, f. 242)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*

Shokët e Vjenës (të Ambasadës Shqiptare -shën i Xh. D.) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

*Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (*Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Se Jusufi ka qenë tepër i interesuar ta dijë se si po pritet veprimtaria e tij nga autoritetet e Shqipërisë në atë kohë është jashtë çdo dyshimi. Fjalët e diplomatëve të Shqipërisë kanë qenë të rëndësishme për te dhe ai, edhe pse disa herë në mënyrë kritike, i ka marrë shumë seriozisht qëndrimet e tyre. Është krejt tjetër çështje se a kanë merituar dhe a e kanë përdorë në mënyrë të drejtë atë besim që ua ka falë Jusufi apo jo. Shqyrtimi i raportit të Jusufit dhe Lëvizjes në përgjithësi për atë kohë, me Shqipërinë dhe përfaqësuesit e saj jashtë është temë e gjerë për t'u shqyrtuar në këtë rast. Por këtu, sa

për ilustrim të këtij besimi, po e marrim një citat nga letra e parë e Jusufit të cilën ia dërgon Sabri Novosellës, më 14 prill 1981.

Jusuf Gërvalla: "I dashuri shok, Bashkim!

Tani më lejo të të bëj një raport të shkurtër për punën time nga dita e arratisjes sime e këndej.

***Puna e parë që bëra, u bëra një telefon shokëve të ambasadës shqiptare në Vjenë**. I njoftova për çështjen time dhe i luta të më ndihmojnë me ndonjë këshillë për të mos bërë ndonjë gabim ideologjik a taktik gjatë strehimit tim në këtë vend kapitalist. Ata, si zakonisht, u treguan të kursyer, po megjithatë patën njëfarë mirëkuptimi."* (Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 258)

Kjo letër tregon se Jusufi ka ngurruar edhe të bëjë deklaratën e vetë personale të azilit pa i shkëmbyer mendimet me diplomatët e Shqipërisë. Përderisa sa ai nuk ka dashtë ta jap deklaratën e vetë të azilit pa e bërë një bisedë me këta diplomatë atëherë del shumë e qartë se Jusufi nuk ia ka filluar organizimit të demonstratave pa u siguruar se qëndrimi i Shqipërisë, të paktën do të jetë neutral në këtë çështje. Mendimin e tyre për demonstrata ashtu si edhe mendimin për çështjen private të azilit Jusufi e ka marrë pa e involvuar Frontin e emërtuar nga UDB-a si organizatë fikse apo Ibrahim Kelmendin si person.

*Jusuf Gërvalla: "Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë. **Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë.**"* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Faktet e lëna nga dora e Jusufit tregojnë pikërisht të kundërtën. Janë vetë diplomatët shqiptarë në Vjenë që e këshillojnë Jusufin që të mos ketë kurrfarë marrëdhëniesh me Ibrahim Kelmendin. Duke pasur parasysh respektin e Jusufit për përfaqësuesit e Shqipërisë, dëshmohet se Jusufi nuk e ka dërguar Ibrahim Kelmendin si emisar të vetin as në Zvicër e aq më pak në Vjenë. Çështjet me diplomatët e Shqipërisë e marrjen e mendimit të tyre Jusufi e ka krye pa ndihmën e I. Kelmendit.

13. Skenderin e pengon afirmimi i babait dhe të birit

I. Kelmendi tregon se përveç Nuhi Sylejmanit, Xhafer Durmishi, i njohur si Skënderi i Shtutgartit është kundër **afirmimit** të Kadri Zekës qysh në demonstratën e 25 prillit 1981 në Shtutgart.

I. Kelmendi*: "Pas demonstratës disa aktivist të rrethit të Shtutgartit ishin mbledhur për të analizuar rrjedhën e demonstratës. Kishte nga ata, si Nuriu e Xhafari, që kishin shprehur pakënaqësi nxitëse, se vetëm ai i Lirisë po **afirmohej** me fjalimet që mbante, kurse Jusufi po vazhdonte të mbetej anonim. Kadriut nuk kishin denjuar t'ia përmendnin as emrin, por thoshin**: "ai i Lirisë**". Vetë Jusufi ishte detyruar të ndërhynte që të ndalonte pëshpërimat e tilla, duke sqaruar se në ndarje të punëve ishte ai që kishte bashkëvendosur."* (Atentatet, f.251)

Në faqen 251 të librit 'Atentatet', I. Kelmendi (personi naiv, i sinqertë **që kurrë nuk të keqkupton**) e vazhdon prezantimin e tij rreth meje "Skënderit të Shtutgartit" në një drejtim të ri. Këtu ai tregon se si unë, Skënderi qysh më 25 prill 1981 kam qenë kundër Kadri Zekës, kundër **afirmimit** të tij dhe organizatës së tij. Në vazhdim të librit ai na tregon se unë kam qenë kundër Kadri Zekës, si person sa ai ka qenë gjallë, se kam qenë

kundër tij si person edhe pas vdekjes, se kam qenë kundër organizatës së tij sa ai ka qenë gjallë, se kam qenë kundër organizatës së tij pas vdekjes së tij, se si pas vdekjes së tij jam sjellë keq ndaj gruas së tij, se jam sjellë shumë keq ndaj **qëllimeve afirmuese** të babës së tij. Dhe në të gjithë këtë proces është I. Kelmendi ai që është kalorës, gjentelmen, kavalier, "The Flower of Chivalry", zogu i atit të Rexhë Avdisë, që e mbron Kadri Zekën për së gjalli e për së vdekuri, e mbron dhe nderon organizatën e Kadri Zekës, e mbron e nderon babën e tij Pajazitin dhe dëshirën e tij për **afirmim**, dhe e mbron në mënyrën më të fuqishme gruan e tij Saime Isufin.

Ibrahim Kelmendi: *"**Babai i Kadriut** mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*
*– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu **do të afirmohesha**, **do ta kisha vrarë vetë djalin tim** dhe do t'ia kisha **lënë fajin UDB-së**...." (Atentatet, f.350)*
Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

E vërteta është se unë më 25 prill 1981, kam qenë në Kosovë dhe në këtë kohë jo që nuk e kam njohur Kadri Zekën por nuk e kam njohur personalisht as Jusufin.

*Jusuf Gërvalla: "Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Letra e Jusufit tregon se ai (Jusufi) nuk ka kurrfarë marrëdhëniesh me I. Kelmendin prej fundit të dhjetorit 1980. Pra Jusufi e rrethi i tij nuk kanë bërë kurrfarë mbledhjeje për ta analizuar demonstratën së bashku me I. Kelmendin. Kjo është njëra anë e të vërtetës. Ana tjetër është se unë, Xhafer Durmishi, siç kam treguar më herët, por edhe në artikullin "Si më njoftoj UDB-a për vrasjen e Jusuf Gërvallës?" në këtë kohë (më 25 prill 1981) nuk kam qenë fare në Gjermani dhe as që e kam njoft Jusufin e lere më figurën frontale të Frontit, se unë për herë të parë në jetë e kam takuar Jusufin, Bardhin e familjet e tyre në mesin e korrikut 1981, d.m.th. pas përfundimit të të gjitha demonstratave shqiptare në Evropë gjatë vitit 1981.

Me gënjeshtrën e mësipërme I. Kelmendi e ka dëshmuar se ai nuk më ka takuar para 21 janarit 1982. Taktika e tij e ulët për të më hedhur kundër Kadri Zekës, në thelb, me ndonjë përjashtim nuk ka pasur sukses tek bërthama e autorëve të historisë së OMLK-së.

14. Një pjesë të madhe të kohës e kishte kaluar në shtëpi të Jusufit

Pas demonstratës së 11 marsit 1981, I. Kelmendi një pjesë të madhe të kohën e kalon në shtëpinë e Jusufit në Habichthöhe str. 40, në Untergruppenbach.

I. Kelmendi: *"Që kurë kishin ndodhur demonstratat e marsit.., Mirani (I. Kelmendi-shën im) një pjesë të madhe të kohës e kishte kaluar në shtëpi të Jusufit." (Atentatet, f.268)*

Fjalët e Ibrahim Kelmendit përputhen pikë për pikë me planet e Shkollës së UDB-së Serbe, të përfaqësuar në këtë rast nga Abdullah Prapashtica.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi* ***në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.*** *...* ***në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Kulla e pamposhtur e Tahir Mehës ashtu si edhe Historia e Jusuf Gërvallës e vulosur pos tjerash pikërisht më 13 maj 1981

Shkolla e UDB-së Serbe*: "... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në* ***dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzënë nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

Abdullah Prapashtica: *"Ajo që sjell Nuhi Sylejmani në librin e vet është* ***dëshmia e ti personale*** *si njëri nga bashkëpunëtorët e rrethit të ngushtë të Jusuf Gërvallës në Gjermani, mbi atë bashkëpunim që kanë pas ata së bashku në kuadër të ish LNÇKVSHJ dhe* ***dëshmi autentike*** *e zhvillimeve të pastajshme... (...)Nuhi Sylejmani shkruan me kompetencë..."* (MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT“ TË NUHI SYLEJMANIT, www.albaniapress.com, 14 tetor 2010)

Osman Osmani: ***"Kujtimet dhe dokumentet përcjellëse brenda librit sjellin fakte historike të pakundërshtueshme dhe të panjohura gjer më tani****.* ***Në mënyrën më të përpiktë****, paraqitet gjendja dhe zhvillimi i tri organizatave shqiptare të asaj kohe, që vepronin kryesisht në botën e jashtme si Fronti i Kuq Popullor, GMLK/OMLK dhe LNÇK/LNÇKVSHJ, si dhe për proceset organizative dhe ideologjike nëpër të cilat kalojnë këto organizata para dhe pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.*

Autori ndër të tjera, ***në mënyrën më besnike****, përshkruan peripecitë dhe ballafaqimet me sfida të shumta të familjeve Gërvalla dhe Zeka pas atentatit të 17 janarit të vitit1982."* (Kopertina e mbrapme e librit që quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010)

Fjalët e Jusufit janë projektile të drejtuara kundër të gjithë falsifikatorëve, çka do të thotë se në këtë rast ato janë të drejtuara edhe kundër Shkollës së UDB-së Serbe të shfaqur në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010.

Se sa ka qëndruar I. Kelmendi në shtëpinë e Jusufit dhe sa ka pasur punë me te prej majit 1980 deri më 28 nëntor 1980 e shohim nga këto fjalë:

I. Kelmendi: *"Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)*

Ibrahim Kelmendi: *"**Kjo gjendje vazhdoi** derisa Jusufi e Mirani u takuan në festën e **28 Nëntorit** (1980-shën i Xh. D.), në Nürnberg. Në manifestim Jusufi bëri një diskutim, jo fjalim, por shumë përmbajtësor. Që të dy kishin presion nga Vasili e Maksi për të rivendosur bashkëpunimin. Ata me të dy mbanin lidhje dhe iu bënin përherë lutje që të pajtoheshin e të bashkëvepronin."* (Atentatet, Prishtinë 2007, f.174-175)

Se sa ka pasur punë Jusufi me I. Kelmendin pas 19 dhjetorit 1980 e deri në vrasjen e tij, sa është pajtuar dhe sa ka bashkëvepruar, e vërtetojnë të gjitha letrat e Jusufit të vitit 1981 e 1982. Në këtë shqyrtim më kanë mjaftuar vetëm disa rreshta të letrës së 13 majit 1981.

Jusuf Gërvalla: *"Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, **të gjitha** marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër e SN 13 maj 1981)*

Se sa ka qëndruar Ibrahim Kelmendi në shtëpi të Jusufit pas 13 majit 1981, tregon shumë vetë përmbajtja e letrës së 13 majit e cila e ka një rreze të fuqishme dhe shumë precize të veprimit edhe pas 13 majit, ditës kur Abdullah Prapashtica e ka festuar ditën e UDB-së, dhe m'u për këtë arsye nuk ka mundur t'i lexoj këta rreshta të Jusufit, që janë pronë publike apo javna-tajna prej vitit 1998 domethënë 12 vjet para gatimit të çorbës së kuzhinës së Shkollës së UDB-së Serbe. Tani për tani, për këtë, mjafton të na tregoj më së miri gruaja e Jusufit, Suzana Gërvalla, burimi i brumit të dramës Misioni të Sabri Hamitit. Skena IV e pjesës së parë të dramës Misioni i përshkruan disa ngjarje në mesditën e 17 janarit 1982 në shtëpinë e Jusufit, në mes **Lulit** (Kadri Zekës), **Keqës** (Ibrahim Kelmendit) dhe **Isës** (Jusuf Gërvallës). Citati i mëposhtëm paraqet hyrjen sqaruese të kësaj skene.

Sabri Hamiti: *"**Për herë të parë (më 17 janar 1982-shën. im) janë bashkë** në shtëpinë e Isës: **Luli** (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) thatak, **Keqa** (Ibrahim Kelmendi - shën i Xh. D.) barkalosh dhe **Isa** i imët. Janë të ulur rreth tryezës. **Ata shihen sy më sy për herë të parë,** mbas turbullimeve të mëdha në Prishtinë e në Kosovë. Mbas vrasjeve, arrestimeve e mundimeve të studentëve, të njerëzve të zakonshëm, të fëmijëve. **Keqa** shikon orën.* (Misioni, Prishtinë 1997, pjesa e parë, skena IV, faqe 38)

Në KALANË e JUSUF GËRVALLËS

Çështje të parashtruara në librin e Ibrahim Kelmendit, Atentatet, Focus - Prishtinë 2007.

1. Je duke marrë postën me rregull?
2. I. Kelmendi shkoi te Jusufi e Bardhi
3. Vuajtjet për gazetën Bashkimi
4. Tek unë ishte policia - tha Jusufi
5. Nuriu ua ka bërë çorape rrethin tuaj
6. Shtëpia jote është bërë si të ishte stacion treni - tha Kadriu
7. Pjesërisht ke të drejtë – tha Jusufi
8. Në hierarkinë e UDB–së në Kosovë kemi njeriun që na informon
10. Tani unë po dyshoj në Skenderin
11. Ti Kadri nuk ke anëtarësuar askënd
12. Nuk duhet të filloni me anëtarësime
13. Na duhet të ngutemi që t'i bashkojmë radhët në një organizim të vetëm
14. Nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë pasi e kemi shok
15. Bashkimi po vonohet
16. Jusufit nuk i erdhi mirë dhe u befasua nga sqarimi i Kadriut
17. Bisedimet për bashkim në parim i kemi bërë
18. Platforma e organizatës që do të dalë nga bashkimi ynë
19. Marrëveshja e bashkimit më 15 gusht 1981 në Habichthöhe
20. Jusufi e Kadriu radhisin tekstin e platformës finale për bashkim
21. Lëvizja do të përfaqësohet nga Sabri Novosella dhe Jusufi
22. Fronti e ka ngrirë organizimin
23. Ne jemi të autorizuar për ta konkretizuar bashkimin
24. Vazhdoj të të mos kuptoj por kurrsesi të të keqkuptoj
25. Më vjen keq që injoranti të luaj me intelektualizmin tënd
26. E kemi pa teklif e nuk mundem pa te
27. U ngritën në këmbë duke u përqafuar e uruar për bashkimin e arritur
28. Shtëpia që meremetohet

Në këtë punim, i cili për herë të parë u botua në faqen www.pashtriku.org, më 20 shkurt 2011 shqyrtohen çështje që kanë të bëjnë me Vëllezërit Gërvalla në Shtëpinë e tyre në Habichthöhe 40, në Untergruppenbach prej fundit të korrikut e deri më 20 gusht 1981. Në punën time për vërtetimin e ngjarjeve të asaj kohe jam shërbyer më së shumti me pjesë të dy letrave të Jusufit: 1. Letrën e 13 majit 1981, dërguar Sabri Novosellës, të cilën unë disa herë e quaj edhe letra e Tahir e Nebih Mehës, pjesë e cila gjendet në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116 dhe 2. Letrën e 20 gushtit 1981 dërguar Sabri Novosellës, e cila gjendet në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451-452. Përveç dy letrave të përmendura, Faridin Tafallari, më 2 tetor 2001 në www.albaniapress.com, publikoi një Raport të Jusufit dërguar Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" në Turqi, që besoj se është i korrikut 1981. Faktet prej këtij Raporti i kam përdor si plotësim dhe i kam integruar në këtë botim.

1. Je duke marrë postën me rregull?

Në mbarim të korrikut 1981, policia gjermane zhvillon hetime kundër Riza Salihut, lidhur me kontrollimit (vjedhjen) e postës së Jusufit.

I. Kelmendi: "Në mbarim të korrikut (korrikut 1981 - shënim i Xh. D. - Skënderit) dy policë të kriminalistikës erdhën në konvikt te Mirani, pasi e paralajmëruan në telefon, duke i kërkuar leje për një bisedë.
– Je duke marrë postën me rregull? – e pyeti njëri nga policët.
– Domethënë, ju ma merrkeni postën, meqë nuk po më vijnë dërgesat për gati një muaj?
– u përgjigj me pyetje Mirani.
– Tash sa ditë nuk merrni postë?
– Them po bëhet muaji, sado që në fillim nuk qeshë i vëmendshëm.
– Jeni interesuar për të pyetur të paktën në postë?" (Atentatet, f. 283)

Nga mesi i korrikut 1981 kam qenë në Shtutgart dhe ngjarjet e periudhës në vijim i di shumë mirë si pjesëmarrës i drejtpërdrejt.

> Sabri Novosella: *"Xhafer Durmishi, i cili vinte nga krahu i Shefqet Jasharit, nëpërmjet Sheremet Saraçit, pasi u rrezikua që të burgosej kaloi në Gjermani. Unë e njoftova dhe e vura në kontakt me Jusufin. Jusufi ishte shumë i kënaqur me punën e Xhaferit."* (Rezistenca kosovare në mes dy zjarresh, Prishtinë 2010)
> Faridin Tafallari: *"Xhafer Durmishi erdhi tek Jusufi dhe Jusufi e donte, se ai ishte besnik."*

Çështje e kontrollimit të postës së Jusufit nga Riza Salihu, në korrik të vitit 1981, për Jusufin ka qenë punë e harruar dhe me mua as që u lodhë ta përmendi më shumë se një herë të vetme. Në ato ditë Jusufi ka pasë shumë punë më të rëndësishme se sa të merret me komentet e kontrollimit të postës së tij. Lidhur me këtë rast familja e Jusufit duhet të ketë dokumente të vërteta që nuk lënë hapësirë për gënjeshtra. Riza Salihu me metodat e tij ka kontrolluar postën jo vetëm të Jusufit por edhe të disa të tjerëve. Në postfachun e tij kanë ardhë letra të shumta që e kanë tërheq vëmendjen e personelit të postës së caktuar të Shtutgartit. Personeli i postës ka kontaktuar policinë, dhe policia ka zhvilluar hetime për këtë rast.

Jusuf Gërvalla: "*Nga gjysma e **GUSHTIT TË VJEMË** (pra të gushtit 1980-shën i Xh. D.) te unë erdhi në banesë policia kriminalistike gjermane (po atë orë Bardhi ndodhej në qendrën e kësaj policie në Shtutgart, ku e kishin marrë nga puna). Ata na morën në pyetje veç e veç. Çështja kishte të bënte me Riza Salihun. Ai kishte hapur në postën e Shtutgartit 14 fah-postale në emër të 14 njerëzve të ndryshëm, ku ndalte letrat e këtyre dhe i lexonte për nevojat e veta. Mes të 14, kishim qenë unë e vëllau, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi etj. Policia e kishte zënë, e kish hedhur në burg dhe dyshonte se është agjent i UDB-së. Ndërkohë që Rizai kishte shpallur ndër punëtorë sesi ka kërkuar azil politik në Gjermani, ai kishte qenë pesë herë, në prag të burgimit, në konsullatën jugosllave në Shtutgart. Këto i kishte të shënuara në bllokun e shënimeve. Për mua, vëllaun dhe Ibrahim Kelmendin kishte dhënë te policia deklarata shumë të liga me shkrim, me plot gënjeshtra edhe për dy takimet që kishim pasur e ku kishim shumë dëshmitarë. Policia në fjalë kërkonte prej nesh: të thoshim edhe ne se Rizai është spiun jugosllav. Natyrisht, ne s'bënim dot një gjë të tillë pa qenë të sigurt, dhe insistimet e policisë, të bazuara nga ana e saj në disa fakte që ne s'na e mbushnin mendjen, i kthenim mbrapshtë me arsyetimin se UDB-ja ka mundësi të mëdha të kurdisë gracka, e*

kështu ka mundur të veproj edhe me R. S." (Raport për Degën e LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Se manipulimi e regjistrimi i një Kutie Postale (Postfach) në emër të Jusufit, nga ana e Riza Salihut është punë "e harruar" në fund të korrikut 1981 e vërteton askush tjetër pos I. Kelmendi (dëshmitari i OMLK-së) i cili ka harruar se çka ka shkruar me dorën e vetë.

Ibrahim Kelmendi*: "Do të kishte qenë mirë të më ndihmoni, pasi jeni më afër ngjarjes, për rastin e arrogantit Rizah. Sigurisht që Bardhi ka mundur të mësoj më shumë gjëra se unë, pasi unë pos çfarë më thanë të KRIPO-s, nuk di tjetër. Një gjë di se jam i revoltuar shumë me Rizahun për konfiskimin e postës që më ka bërë. Është kjo vepër prej udbashi. I poshtri! Sigurisht që më ka munguar posta. Për këtë kam bërë sa herë fjalë me udhëheqësit e konviktit."* (Letër Jusuf Gërvallës, **16 shtator 1980**, botuar në: Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare**, Tiranë 1998**, faqe 117)

Edhe shtypi gjerman që ka raportuar për ditët pas atentatit e përmend rastin e vjedhjes së postës së Jusufit.

Südwestdeutsche Zeitung*: "Policia e kërkon jugosllavin Riza Salihu, i **cili në vitin 1980** kishte sjellë në pronësinë e tij postën e bashkatdhetarëve të tij dhe kundër së cilit ekziston edhe fletarresti edhe për delikte tjera."* (30 janar 1982; Marrë nga Xhafer Leci e Kadri Mani, U vranë tre emigrantë jugosllavë, www.zemrashqiptare.net, 17 janar 2009)

Policia gjermane i ka bërë këtë pyetje direkte Jusufit:

- A mendon ti se Riza Salihu e ka bërë këtë punë i nxitur nga UDB-a dhe a mund ta akuzosh t'i si agjent të UDB-së?

Jusufi: Nuk e di pse e ka bërë këtë dhe unë nuk e akuzoj atë për agjent të UDB-së!

Para leximit të Raportit të Jusufit, të korrikut 1981, unë kam menduar se Jusufi e ka takuar vetëm një herë Riza Salihun. Pse? Sepse Jusufi vetë më ka folur vetëm për takimin e parë.

Unë mundem me e marrë me mend se I. Kelmendit i nevojitet një motiv për të ardhur tek Jusufi, më të cilin Jusufi i ka shkëputë të gjitha marrëdhëniet që nga dhjetori 1980. Por edhe në këtë rast ai e ka zie një gënjeshtër aq të paskrupullt sa edhe qesharake.

Kur unë kam mbërri në Shtutgart në mesin e korrikut 1981 gjendja në relacionet e Jusufit nuk ka qenë aq e thjeshtë siç mundohet ta paraqet I. Kelmendi, shokët e tij dhe aleatët e Frontit të tij. Marrëdhëniet e Jusufit në këtë kohë me Kadri Zekën kanë qenë në kulm kurse me I. Kelmendin nuk kanë ekzistue fare.

Emrin e Ibrahim Kelmendit për herë të parë e kam ndie dhe lexuar në faqet e *Ilustrovana Politikës* së Beogradit dhe atë të përmendur e lidhur së bashku me emrin e Jusufit, me sa më kujtohet në maj të vitit 1981. Duke pasur parasysh këtë lansim të emrit të Ibrahim Kelmendit të lidhur me emrin e Jusufit, pa i ditur shkaqet e vërteta të lansimit dhe planet e UDB-së në këtë drejtim, kam pasur paramendime të mira. Jusufi më ka treguar numrat e revistës Bashkimi të cilat i ka përgatitur ai dhe mua më janë dukur aq të mirë sa që pyetjen e parë që ia kam bërë ka qenë:

Xhafer Durmishi: - Ku janë numrat tjerë pas janarit 1981?

Jusuf Gërvalla: - Revista Bashkimi nuk del më!

Xhafer Durmishi: - Pse?

Jusuf Gërvalla: - Ibrahim Kelmendi, personi që formalisht ka qëndruar pas Bashkimit nuk mundet me e nxjerrë në atë nivel në të cilin e kam ngritur unë, prandaj si duket **ai** apo **ata** kanë parapëlqyer më parë

ta ndërpresin se sa të zbresin apo të përfundojnë në nivelin në të cilin i kam gjetur.

Unë nuk kam vazhduar me e pyet Jusufin për shkaqet e ndërprerjes së këtij bashkëpunimi duke e ditur se i ka arsyet e veta dhe do të më tregoj me kohë. Në muajt e parë, gjatë korrikut e gushtit Jusufi nuk ma ka thënë asnjë fjalë të keqe për I. Kelmendin por çka është edhe më interesante, nuk ma ka thënë as edhe ndonjë fjalë të mirë për te. Pjesë të letrës së Jusufit të 13 majit 1981, dërguar Sabri Novosellës për herë të parë i kam lexuar në vitin 2000, ndërsa të plotë kam pasur rastin ta lexoj në dhjetor 2009.

Siç u vërtetua nga letra e Ibrahim Kelmendit e 16 shtatorit 1980, ai nuk ka ardhur në Shtutgart në fund të korrikut 1981 për të sqaruar së bashku me Jusufin çështjen e postës, dhe zhvillimin e hetimeve të policisë gjermane në këtë pikë dhe për as ndonjë çështje tjetër. Rrjedhimisht, I. Kelmendi, në fund të korrikut 1981 nuk ka qenë tek Jusufi fare, as për ndonjë shkak dhe as pa asnjë shkak.

2. I. Kelmendi shkoi te Jusufi e Bardhi

Shkolla e UDB-së Serbe, e përfaqësuar jo nga TANJUG-u apo Ilustrovana Politika, por në këtë rast nga Abdullah Prapashtica.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi **në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.** ... **në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzënë nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në **dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Abdullah Prapashtica: *"Ajo që sjell Nuhi Sylejmani në librin e vet është **dëshmia e ti personale** si njëri nga bashkëpunëtorët e rrethit të ngushtë të Jusuf Gërvallës në Gjermani, mbi atë bashkëpunim që kanë pas ata së bashku në kuadër të ish LNÇKVSHJ dhe **dëshmi autentike** e zhvillimeve të pastajshme... (...)Nuhi Sylejmani shkruan me kompetencë..."* (MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT“ TË NUHI SYLEJMANIT, www.albaniapress.com, 14 tetor 2010)

Osman Osmani: ***"Kujtimet dhe dokumentet përcjellëse brenda librit sjellin fakte historike të pakundërshtueshme dhe të panjohura gjer më tani**. **Në mënyrën më të përpiktë**, paraqitet gjendja dhe zhvillimi i tri organizatave shqiptare të asaj kohe, që vepronin kryesisht në botën e jashtme si Fronti i Kuq Popullor, GMLK/OMLK dhe LNÇK/LNÇKVSHJ, si dhe për proceset organizative dhe ideologjike nëpër të cilat kalojnë këto organizata para dhe pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.*

*Autori ndër të tjera, **në mënyrën më besnike**, përshkruan peripecitë dhe ballafaqimet me sfida të shumta të familjeve Gërvalla dhe Zeka pas atentatit të 17 janarit të vitit1982."* (Kopertina e mbrapme e librit të quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010)

I. Kelmendi: *"Të nesërmen Mirani udhëtoi për Shtutgart. Shkoi të Jusufi e Bardhi. Aty gjeti edhe Kadriun."* (Atentatet, f.288)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha*

lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Këtu vlen të konstatojmë një fakt. Jusufi nuk ka pas telefon në shtëpi në vitin 1981 dhe 1982. Shkaqet për këtë do t'i shqyrtoi në një rast tjetër. Në vitin heroik 1981, të ngjarjeve për të cilat foli gjithë bota, Jusuf Gërvalla nuk i shkruan asnjë letër të vetme Ibrahim Kelmendit. Sa i përket Kadri Zekës, deri më sot kemi vetëm një letër të Jusufit, të cilën ia dërgon më 7 dhjetor 1981 dhe një më 15 janar 1982. Burimi kryesor për ta studiuar veprimtarinë e Jusufit në vitin 1981 e gjer në vdekje janë letrat që ia dërgon pikërisht atij që duhet, shokut të vet, shokut të organizatës së vetë Sabri Novosellës. Në mos asgjë tjetër, pikërisht në këto letra duket madhështia e Jusufit, besnikëria e tij ndaj shokëve, respekti për krijimin e një force apo forcave të organizuara në përgjithësi. Me këto letra Jusufi e ka vulosë historinë e Lëvizjes dhe me këtë ka asgjësuar çdo përpjekje udbeske të të tjerëve për ta shkruar historinë e rrejshme të Lëvizjes së Tij duke treguar se jo të tjerët por është pikërisht ai vetë Jusufi që është zot i historisë së vet.

Nga letra e Jusufit e 13 majit 1981 dhe Raporti i korrikut 1981, del se distancimi i Jusufit prej Ibrahim Kelmendit ka qenë i asaj natyre sa demonstratat e Pranverës 1981 në Kosovë dhe ato në Evropë gjer më 13 maj, gjer në këtë ditë të festës UDB-së, gjer në këtë ditë të Tahir e Nebih Mehës nuk kanë mundur t'ia ndryshojnë.

Krejt shpresat tona kanë qenë të mvaruna në mundësinë se athua mos festa e UDB-së e 13 majit, apo vepra e Tahir e Nebih Mehës ia ka zbutur qëndrimin Jusufit që ai "*t'i rikthej marrëdhëniet e mëparshme*" me I. Kelmendin. Raporti i korrikut 1981 i Jusufit vërteton se festa e UDB-së e 13 majit nuk ka ndikuar në asnjë mënyrë në qëndrimin e Jusufit ndaj nipit të Dajës Ramë. Se si qëndrojnë punët në këtë pikë na e vërteton definitivisht letra e Jusufit dërguar Sabri Novosellës më 20 gusht 1981.

3. Vuajtjet për gazetën *Bashkimi*

I. Kelmendi mirëpritet nga Jusufi e Kadriu, i vjen mirë që nuk kanë nevojë për ndihmën e tij në përgatitjen e gazetës së OMLK-së Liria dhe njëkohësisht **vuan** se nuk ka aftësi ta botoj gazetën e "Frontit të Kuq Popullor" Bashkimin.

*I. Kelmendi: "U mirëprit dhe i erdhi mirë që Jusufi e Kadriu nuk po e angazhonin për t'i ndihmuar në përgatitje të gazetës Liria. Përpara e **VUANTE** përgjegjësinë për botim të* Bashkimit*, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, f.288)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për*

t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Para se të shqyrtojmë çështjet e falsifikimet e I. Kelmendit, duhet të mos harrojmë se qëllimi im është në këtë rast që pjesërisht t'u jap përgjigje edhe të tjerëve që kanë apo kanë pasur të bëjnë me Jusufin.

Jusuf Gërvalla: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me një shok të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim midis nesh dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërenditim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981)

Në këtë letrën e 14 prillit 1981 që është letra e parë që Jusufi ia dërgon Sabriut pas daljes në Gjermani, për herë të parë e kemi të vërtetuar se Jusufi ka marrë kontakt me Kadri Zekën, pikërisht në kohën kur ai nuk ka asnjë lidhje me I. Kelmendin. Por jo vetëm kaq. Krahasojeni se çfarë përshkrimi i bënë në këtë letër OMLK-së dhe çfarë është definimi e përkufizimi i Frontit të Kuq. A mundohet Jusufi të vejë shenjën e barazimit në mes Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit apo jo? Mos është pikërisht e kundërta!

Siç e kam thënë më lartë kur jam gjet në Shtutgart, marrëdhëniet e Jusufit me Ibrahim Kelmendin nuk kanë ekzistua, ndërsa ato me Kadri Zekën kanë qenë në zenit. Në bazë të letrave të Jusufit shihet qartë se kur Sabri Novosella merr vesh se si Jusufi i ka kushtuar aq shumë kohë revistës Bashkimi (me një fjalë organizatave tjera) ndihet një lloj pakënaqësie se pse Jusufi nuk iu ka përvesh punës dhe të publikoj punime vetëm e vetëm në emër të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Kur Jusufi më ka treguar se si e ka botuar me mundin, talentin e dijeninë e tij Bashkimin, dhe numrin e tretë të Lirisë, unë si shokë i Organizatës së Jusufit kam ndier kënaqësi dhe krenari të madhe. E kam ndier veten kështu pasi kam menduar se nëse ndonjëherë do të ketë ndonjë gjest mirënjohjeje për punën e Jusufit për organizatat tjera, atëherë, edhe pse kjo ndihmë u është dhënë nga Jusufi si individ i LNÇKVSHJ, prapë se prapë ndoshta një pjesë e vogël e nderit do t'i bien hise jo vetëm Lëvizjes së tij por edhe mua si anëtar i saj. Ia kam pasur lakmi Jusufit në këtë punë, dhe sikur organizatat tjera

do të më drejtoheshin mua për ndihmë në atë kohë dhe sikur t'i kisha pasur dhuntitë që natyra ia kishte dhënë Jusufit, ndoshta edhe unë do të kisha vepruar si ai. Por gjërat nuk janë zhvilluar në këtë formë për mua, dhe përveç Lëvizjes së Jusufit askush tjetër nuk ka pasur nevojë për punën time. Përkundër lakmive të mia të mëdha, jam detyruar të kënaqem me atë që natyra ma ka caktuar.

Disa ditë pas vendosjes sime në Ludwigsburg ka ardhë Kadri Zeka tek Jusufi dhe i ka sjellë materialet e Lirisë për numrin 4-5, të cilat pastaj vetë Jusufi e ka ditur se si duhet ta përfundojë. Unë nuk e kam takuar atë në këtë rast, por se i ka sjellë materialet më ka tregue Bardhi në banesën, ku banoja me Haxhi Berishën e Naim Haradinajn, në Ludwigsburg. Pas daljes nga shtypi, (e botuar në Shtutgart) Haxhi Berisha dhe Hasan Mala janë ngarkuar ta dërgojnë në Kosovë. Këta janë nisë nga shtëpia e Jusufit. Për këtë punë ka qenë në dijeni të plotë Suzana e cila është marrë me paketimin e ushqimeve për rrugë për Hasanin e Haxhiun. Por ajo çka është më interesantja që dua të them është se e tërë kjo punë është bërë në distancë të sigurt prej I. Kelmendit.

Mund të bëj para Lëvizjes ndonjë RAPORT më të gjerë

Jusuf Gërvalla*: "Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajturi Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë* ***RAPORT*** *të gjerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 264)

Se çfarë mendimesh e çfarë afërsie ka pasur Jusufi me I. Kelmendin në fund të korrikut 1981 e vërteton më së miri **RAPORTI** i tij dërguar Sabri Novosellës, më korrik 1981, raport të cilin Jusufi ia premton në letrën e 13 majit 1981.

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, **korrik 1981)**

Ibrahim Kelmendi nuk ka qenë tek Jusufi në fund të korrikut 1981 as "me arsye të vjedhjes së postës" e as "pa arsye" për shkakun e thjeshtë se në këtë kohë, pas përfundimit të të gjitha demonstratave në Evropë, mendimi i Jusufit për I. Kelmendin përveç rreshtave të mësipërm është si vijon:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** **(**Letër Sabri Novosellës, **20 gusht 1981).**

Shtrohet pyetja pse Jusufi brenda këtij citati e përdorë fjalën ***'mercenar'*** katër herë. Përgjigja epet nga vet Jusufi dhe Faridin Tafallari.

Jusuf Gërvalla*: "Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. Madje në atë kohë, Ibrahimi kërkonte një njeri "të ndershëm e trim", që për një kundërshpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist."* (Raport për Degën e LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Faridin Tafallari: "Më kujtohet një takim ku kam qenë edhe unë i pranishëm. Jusufi e pyeti Ibrahimin që t'i tregonte se sa të holla kishte marrë nga një organizatë kroate (emrin e saj nuk e di). Sipas fjalëve të Ibrahimit ka qenë puna për një shumë prej ***50 mijë markash gjermane****, që do të përdoreshin për të blerë armë. Këtë shumë e kanë marrë njerëzit e Ibrahimit, mandej si i përdori ato për të rregulluar një lokal kafeneje në Pejë. Jusufit kjo gjë nuk i pëlqeu dhe e kundërshtoi veprimin e Ibrahimit si jo të mirë. Ibrahimi përgjigjej se kur gjen budallenj pse të mos përfitosh. Jusufi ia ktheu: "Ato para janë marrë për diçka tjetër dhe për një çështje tjetër, dhe janë përdorur për interesat tua. Për tjetër janë kërkuar dhe për tjetër janë shfrytëzuar."* (Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 57)

Jusufi, pas rastit të Hysen Gegës me Sadik Blakajn, ka qenë shumë i vetëdijshëm se Ibrahim Kelmendi **meriton kujdes**. Thelbi i çështjes ka qenë se a meriton ai (I. Kelmendi) kujdes **për së mbari** apo të kihet kujdes për të **këqijat që mund** të vijnë nga ai.

Një rrjedhim tjetër që del nga kjo letër është se Sabri Novosella, prej fillimit të marrjes së kontaktit me Jusufin (në prill 1981) e gjer më tani, në gusht, e qorton Jusufin dhe kërkon nga ai që të ketë kujdes të mirë dhe ta afroj I. Kelmendin. Por përpjekjet e Sabriut nga Turqia, për ta afruar Jusufin me I. Kelmendin në Gjermani dështojnë plotësisht.

4. Tek unë ishte policia - tha Jusufi

Mund të bëj para Lëvizjes ndonjë RAPORT më të gjerë

Jusuf Gërvalla*: "Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajturi Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë* ***RAPORT*** *të gjerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 264)

Në fund të korrikut 1981, Jusufi i tregon I. Kelmendit se Riza Salihu ia ka vjedhë, kontrollua postën atij (pra J. G.).

I. Kelmendi: "– Tek unë ishte policia kriminalistike e Hailbronit, – nisi Jusufi. – Më informuan që Rezil Mejtepi kishte vjedhur postën time dhe tënden. Besoj edhe te ti, Miran, duhet të kenë qenë.

– Po, – miratoi shkurt Mirani." (Atentatet, f.290)

> Jusuf Gërvalla: "*Nga gjysma e **GUSHTIT TË VJEMË** (pra të gushtit 1980-shën i Xh. D.) te unë erdhi në banesë policia kriminalistike gjermane (po atë orë Bardhi ndodhej në qendrën e kësaj policie në Shtutgart, ku e kishin marrë nga puna). Ata na morën në pyetje veç e veç. Çështja kishte të bënte me Riza Salihun. Ai kishte hapur në postën e Shtutgartit 14 fah-postale në emër të 14 njerëzve të ndryshëm, ku ndalte letrat e këtyre dhe i lexonte për nevojat e veta. Mes të 14, kishim qenë unë e vëllau, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi etj. Policia e kishte zënë, e kish hedhur në burg dhe dyshonte se është agjent i UDB-së."* (Raport për Degën e Lëvizjes në Turqi, **korrik 1981**)

Si duket I. Kelmendi ka harruar se çka ka shkruar më 16 shtator 1980.

*I. Kelmendi: "Do të kishte qenë mirë të më ndihmoni, pasi jeni më afër ngjarjes, për rastin e arrogantit Rizah. Sigurisht që Bardhi ka mundur të mësoj më shumë gjëra se unë, pasi unë pos çfarë më thanë të KRIPO-s, nuk di tjetër. Një gjë di se jam i revoltuar shumë me Rizahun për konfiskimin e postës që më ka bërë. Është kjo vepër prej udbashi. I poshtri! Sigurisht që më ka munguar posta. Për këtë kam bërë sa herë fjalë me udhëheqësit e konviktit." (Letër Jusuf Gërvallës, **16 shtator 1980;** Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 117)*

Gënjeshtra skandaloze demantohet nga shtypi gjerman që ka raportuar në Atentatin e 17 janarit 1982:

Südwestdeutsche Zeitung: *"Policia e kërkon jugosllavin Riza Salihu, i **cili në vitin 1980** kishte sjellë në pronësinë e tij postën e bashkatdhetarëve të tij dhe kundër së cilit ekziston edhe fletarresti edhe për delikte tjera."* (*30 janar 1982*; Marrë nga Xhafer Leci e Kadri Mani, U vranë tre emigrantë jugosllavë, www.zemrashqiptare.net, 17 janar 2009)

Se a është vizituar kështjella e Jusufit nga Ibrahim Kelmendi, në fund të korrikut 1981 e vërteton Raporti i korrikut 1981.

> Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*
>
> *Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka*

shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, **korrik 1981)**

Si dhe letra e 20 gushtit 1981.

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

5. Nuhi Sylejmani ua ka bërë çorape rrethin tuaj

I. Kelmendi i jep mendime Jusufit për Nuhi Sylejmanin, e të cilat Jusufi i dëgjon me vëmendje.

I. Kelmendi: "Kurse Nuriu ua ka bërë çorape rrethin tuaj këndej dhe angazhimi i mëhershëm i rrethit tuaj është dëmtuar." (Atentatet, f.290)

Se a ka marrë Jusufi ndonjë këshillë në Kështjellën e vetë në fund të korrikut 1981, prej I. Kelmendit e vërteton Raporti i korrikut 1981:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... ËSHTË NIP I NJË AGJENTI ME ZILE TË UDB-SË, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

-si dhe letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,***

atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër S. Novosellës, 20 gusht 1981)*

6. Shtëpia jote është bërë si të ishte stacion treni - tha Kadriu

Sipas I. K., Kadri Zeka e krahason shtëpinë e Jusufit me një stacion trenash, në të cilën shtëpi bashkatdhetarët e vizitojnë Jusufin për t'ia humbur kohën dhe konsumuar ushqimin e familjes.

I. Kelmendi: "– Shokë ju këndej nuk po ruheni, nuk jeni konspirativë, – mori fjalën Kadriu. – Sidomos ti, Shoku Jusuf, vigjilencën e ke lëshuar përtoke.

Shtëpia jote është bërë si të ishte stacion treni. *Vijnë njerëz vetëm për të kaluar kohën, sepse mërziten për të ndenjur në banesat e tyre. Te ti ata kanë gjetur mirëpritje bujare dhe nuk duan t'ia dinë se kështu po konsumojnë ushqimin e familjes sate. Ti, me bujarinë e tepruar, e mirëpret secilin, sikur të të vinin si miq. Duke ardhur kaq shumë, të pengojnë në punë, në pushim, lexim e ndejë me familje." (Atentatet, f.290)*

Se a e ka krahasuar Kadri Zeka, Kalanë e Jusufit me një stacion treni apo jo, e vërteton më së miri Raporti i korrikut 1981:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

-dhe letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

A do të kishte ma vdekje për Jusufin sikur personi i përkufizuar nga ai si "**mercenar i mercenarit**" të luante e të tallej me te e me Kadri Zekën në shtëpinë e tij, në Kalanë e tij dhe të luaj si maca me minin me ta. I. Kelmendi ka pasur sukses në planin e tij për t'ua mbush mendjen shokëve të organizatës së vetë, pra shokëve të Kadri Zekës, por jo edhe të Jusufit. Historia e Jusufit dhe e Lëvizjes së tij janë shkruar në radhë të parë nga Jusufi dhe shokët e Organizatës së tij të cilët janë pronarët dhe zotët e vërtetë të saj.

7. Pjesërisht ke të drejtë – tha Jusufi

Jusufi i jep të drejtë Kadri Zekës se e ka shndërruar shtëpinë në stacion treni.

I. Kelmendi: "– Pjesërisht ke të drejtë, – tha Jusufi, – por këtë mënyrë po e shfrytëzoj për të edukuar disa të rinj dhe për të ndërgjegjësuar punëtorët e interesuar për veprimtari patriotike." (Atentatet, f.291)

Se a ka bërë Jusufi ndonjë bisedë e takim me Kadri Zekën në Kalanë e vet, në prani të I. Kelmendit e vërteton më së miri Raporti i korrikut 1981:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ...* ***Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës.*** *... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, **korrik 1981)**

Këtë e vërteton edhe letra e 20 gushtit 1981

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

8. Në hierarkinë e UDB–së në Kosovë kemi njeriun që na informon

Sipas I. Kelmendit dhe projektit të tij për shembjen e mitit të Jusufit, ai (Jusufi) ka kontakte me hierarkinë e UDB-së në Kosovë dhe informohet nga një njeri i UDB-së për çdo javë se kush del jashtë nga Kosova.

I. Kelmendi: "Sikur të ishte ndonjëri informatorë e spiun i UDB–së, do të na tregonin nga Prishtina, sepse në hierarkinë e UDB–së në Kosovë kemi njeri që na informon se cilët njerëz këtej punojnë për UDB–në. Kështu, ne dimë pothuajse për çdo vikend, se cili udbash do të vijë nga Kosova në Mynhen, Shtutgart e gjetiu, të cilët mbledhin informata, dezinformojnë bashkatdhetarët, udhëzojnë dhe u japin detyra informatorëve dhe kthehen." (Atentatet, f.291)

Qëllimi i kësaj insinuate djallëzore, dhe mllefi hakmarrës ndaj Jusufit gjendet në këta rreshta, që I. Kelmendi nuk i ka ditur më 1981 por i ka marrë vesh nga librat e Faridin Tafallarit pas vitit 1998:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa

shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Pra Jusufi kurrë nuk ka ditë se kush është udbash që dërgohet nga UDB-a në Evropë. Por ai e ka ditë vetëm një çështje, se ka pasur dyshime solide se "Fronti i Kuq" është krijesë e UDB-së dhe për këtë e ka ndërpre ndihmën në nxjerrjen e gazetës Bashkimi, dhe me Ibrahim Kelmendin nuk ka bashkëpunua në këtë kohë kur ëndrra e jetës së tij është realizuar, pasi ka arrit me e pa tërë Kosovën në këmbë, e për të cilën ka folur e gjithë bota me muaj rresht.

Se I. Kelmendi nuk ka qenë tek Jusufi në korrik 1981 e tregon Raporti i mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës.*** *... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

- dhe letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër S.N., 20 gusht 1981)*

9. Jemi informuar ne se kush hyn e del te ti

Për të mos e hidhëruar e mbetur borxh as Kadri Zekës, sipas projektit të shembjes së mitit të Jusufit, del se edhe Kadri Zeka paska aso burimesh prej nga informohet se kush hyn e kush del në stacionin e trenit të Jusufit, pra në shtëpinë e Jusufit.

I. Kelmendi: "– Domethënë njeriu juaj nuk paska informata të bollshme. Por, nga të tjera burime ***jemi informuar ne*** *se* ***kush hyn e del te ti****, –* ***ndërhyri Kadriu****, pa pritur nëse Jusufi kishte përfunduar përgjigjen e tij." (Atentatet, f.291)*

Janë këto fjalë shumë nderuese për Kadri Zekën që i kanë kënaq disa persona të afërm të tij. Se a ka pasur gjasa që Jusufi të lejojë të tjerët të tallen me te e me mysafirët e tij në Kalanë e tij e vërteton Raporti i mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës.*** *... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

-dhe letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër S.N., 20 gusht 1981)*

10. Tani unë po dyshoj në Skenderin

Në mbarim të korrikut 1981, I. Kelmendi, në prani të Kadri Zekës diskuton me Jusufin për dyshimet dhe argumentet kundër "Skënderit të Shtutgartit" dhe Jusufi e dëgjon me vëmendje.

I. Kelmendi: "Tani, unë po dyshoj në njëfarë Xhafarin, të cilin ju e thërrisni me pseudonim "Skander". Erdhi verën e vitit të kaluar i kamufluar si student dhe u punësua pikërisht në afërsi të Ludwigsburgut. Rrinte haptazi, në prani të shumë vetave, me ty Jusuf dhe me Bardhin. U kthye dhe s'i ndodhi gjë. Prapë erdhi e shkoi dhe tani është këtu. Pra, ka ardhur disa herë, është kthyer dhe asnjëherë nuk i ndodhi gjë. E habitshme. Bile, nuk po pyesim se ku i merr të hollat për gjithë këto udhëtime, meqë thotë se është student." (Atentatet, f. 291-292)

Të vërtetën time se kur kam ardhur në Shtutgart për herë në parë në prani të shumë dëshmitarëve që sot janë gjallë e kam thënë në disa raste. Ne verën e vitit 1980 nuk kam qenë fare as nuk punuar në Gjermani. Për herë të parë me Vëllezërit Gërvalla në Untergruppenbach jam njohur në mesin e korrikut 1981. Fjalët e mësipërme me trillimet e falsifikimin e vetë tregojnë se I. Kelmendi nuk ka qenë tek Jusufi në korrik 1981. Se çfarë gjasash ka pasur I. Kelmendi të jetë në Kalanë e Jusufit në këtë kohë e vërtetojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*** *Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të*

përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër S. Novosellës, 20 gusht 1981)*

Se çfarë afërsie e besimi ka Jusufi në Ibrahim Kelmendin në gusht 1981 e tregojnë rreshtat e mësipërm. Se çfarë besimi e afërsie ka Jusufi në Xhafer Durmishin-Skenderin e tregojnë rreshtat më poshtë të cilët janë marrë poashtu nga letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: *"Mbrëmë ishim me Besnikun te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë.* ***Unë, Shpendi (Xhafer Durmishi*** *- shën ynë) e* ***Besniku (Bardhi*** *- shën ynë), duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

I. Kelmendi ka harruar se çka ka thënë e çka ka shkrua me dorën e vetë kur i ka komentuar udhëtimet e mia dhe sidomos aspektin ekonomik të tyre. Ja se çka shkruan ai për udhëtimet e (Salihut) mosudhëtimet e mia.

Ibrahim Kelmendi: "-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI! Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 11 janar 1984"...Sikur më ka rënë të dëgjoj nga shoku Salih,(Xhafer Durmishi-shën ynë) se tani


Sikur me ka rene te degjoj nga shoku Salih, se tani per tani eshte perqendruar vetem ne ceshtje te formimeve te klubeve. Kurse sa i perkete formimit te celulave, krijimit te komiteteve ne rrethe, pergatitjes se ndonje ndihmsi, asgje, se paku nuk ka mundesi te verehet dhe as qe jemi njoftuar. I kuptoj veshtiresite me te cilat eshte i ballafaquar, si kufizimi i levizjeve, ndoshta edhe mungesa e mjeteve elementare, bile sa per udhetim. Por nuk besoj qe mossuksesi ne kete fushe te jete kushtezuar vetem nga ky faktor. Mendoj se autoriteti i LRSHJ-se te bashkatdhetaret ka qene i madh, nga rrjedh se shume jane qe do deshironin te gjenin format e menyrat per te kontribuar me shu-

për tani është përqendruar vetëm në çështje të formimeve të klubeve. Kurse sa i përket formimit të celulave, krijimit të komiteteve në rrethe, përgatitjes së ndonjë ndihmësi, asgjë, së paku nuk ka mundësi të vërehet dhe aq sa jemi njoftuar. ***I kuptoj vështirësitë me të cilat është i ballafaquar, si kufizimi i lëvizjeve, ndoshta edhe mungesa e mjeteve***

elementare, bile sa për udhëtim." *(Letër dërguar Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit (Salihut-shën im), më 11 janar 1984, faqe 14)*

Përderisa shoku i mirë i Sadik Blakajt shprehet kështu për (mos)udhëtimet e mia, atëherë e vërteta e plotë mundet vetëm me u marrë me mend.

Jusufi e ndien veten të obliguar t'i jap llogari I. Kelmendit për punët e Lëvizjes së tij, në korrik 1981, se ekziston një Skender, anëtarë i Lëvizjes së Jusufit, në Shtutgart dhe përmes kujt ka ardhë tek Jusufi. Në fund të korrikut 1981, I. Kelmendi e merr vesh se Jusufi ka marrë kontakt me Sabri Novosellën.

I. Kelmendi: *" – Për Xhafarin garantoj unë, pasi atë ma ka sugjeruar Shoku Sabit, njëri nga udhëheqësit kryesor të organizatës sonë... – sqaroi Jusufi.*
– Më në fund, të paska kontaktuar! – ndërhyri Mirani." (Atentatet, f. 292)

Se si Jusufi me të vërtetë e sqaron I. Kelmendin për Skenderin e Sabri Novosellën duket nga rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."(****Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

11. Ti Kadri nuk ke anëtarësuar askënd

Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me Lëvizjen e Jusufit, I. Kelmendi del se i dinë në hollësi punët e OMLK-së, se sa lugë i ka në shportë gjegjësisht sa anëtarë i ka, qysh në fund të korrikut 1981.

I. Kelmendi: "Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende ***nuk ke anëtarësuar njeri*** *vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni." (Atentatet, f.293)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

Mehmet Hajrizi: "*Deri në bashkimin e saj në Lëvizje, aty nga mesi i vitit 1982, Organizata ka pasur në gjirin e saj mbi 300 anëtarë dhe po kaq simpatizantë që po përgatiteshin për anëtarësim."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 169-170)

12. Nuk duhet të filloni me anëtarësime

Kadri Zeka në mbarim të korrikut 1981, në prani të Jusufit e I. Kelmendit fletë për marrëveshjen për bashkim e cila pret për formalizim apo shpallje.

I. Kelmendi: (fjalë të atribuara Kadri Zekës) *"Unë mendoj se ju ende* ***nuk duhet të filloni me anëtarësime****, sepse do të keni fërkime të simpatizantëve tuaj. Them, derisa të* ***formalizohet marrëveshja për bashkim, meqë përmbajtësisht jemi dakorduar****, të presim me anëtarësime. Kur bashkimi të shpallet, riorganizimi do të nis në Kosovë,*

pastaj do të bëjmë riorganizim të përbashkët edhe në mërgatë, përshtatshëm me riorganizimin në Kosovë." (Atentatet, f.293-294)

Mehmet Hajrizi: "Deri në bashkimin e saj në Lëvizje, aty nga mesi i vitit 1982, Organizata ka pasur në gjirin e saj mbi 300 anëtarë dhe po kaq simpatizantë që po përgatiteshin për anëtarësim." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 169-170)

Se çfarë formalizimi të marrëveshjes për bashkim dhe çfarë dakordimi përmbajtësor është i gatshëm Jusufi të bëjë me Frontin e emërtuar nga UDB-a e tregon letra e Jusufit e shkruar në ditën e festës së UDB-së apo më konkretisht në ditën e Tahir dhe Nebih Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Ju mund të thoni se në kohëra dinamike qëndrimet e taktikat mund të ndryshojnë shpejt, se Tahir Meha mund t'ia ketë ndërruar mendjen Jusufit sa i përket çështjes së Frontit të Kuq. Ja se çka shkruan Jusufi për I. Kelmendin dy dhe tre muaj pas Ditës së Tahir Mehës:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*** *Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

13. Na duhet të ngutemi që t'i bashkojmë radhët në një organizim të vetëm

Jusufi e pranon para I. Kelmendit se jo vetëm ndihmon në nxjerrjen e Lirisë, por donë të bëhet hisedarë i barabartë së bashku me I. Kelmendin dhe vuajtjet (ndoshta pikërisht për t'ia zvogëlua vuajtjet) e tij për Bashkimin, në te (revistën Liria), ashtu siç ka pranua më parë të bëhet hisedarë 50% i kryeartikullit të Bashkimit, duke u shprehur se Lirinë "po e nxjerrim bashkarisht". Gjithashtu Jusufi e ndien veten të obliguar t'u tregoj I. Kelmendit e Kadri Zekës punët e brendshme të Lëvizjes së vetë, t'u tregoj se çka pret Sabri Novosella prej tij.

I. Kelmendi: (Fjalë të atribuara Jusufit) "– Sikur po vonohemi, sepse ky nivel i ***organizimit të tanishëm*** *nuk mund të japë rendiment më të lartë se sa kemi arritur. Për hir të përpjekjeve që po bëjmë për bashkim, unë shtyva për më vonë nxjerrjen e një organi të organizatës sonë. Këtë ma kërkoi para ca kohe Shoku Sabit. Pastaj, them se tani* ***nevojat tona*** *po na i plotëson Liria që* ***po e nxjerrim bashkarisht****, por na duhet, gjithsesi, të ngutemi që t'i bashkojmë radhët në një* ***organizim të vetëm,*** *të disiplinuar dhe mirë të koordinuar e me udhëheqje të centralizuar." (Atentatet, f. 294)*

Se sa i shqetësuar është Jusufi nga vonesa e bashkimit me Frontin e Kuq e vërteton letra e Jusufit dërguar Tahir dhe Nebih Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(13 maj 1981)

Kadri Zeka harron çka ka thënë dy minuta më parë për arritjen e marrëveshjes për bashkim, marrëveshje e cila pret të formalizohet e shpallet dhe i tregon Jusufit se ai K. Z. nuk i beson I. Kelmendit dhe nuk do që I. Kelmendi të dijë se çfarë punësh bëjnë Kadri Zeka e Jusufi.

I. Kelmendi: "Kadriu e shikoi Jusufin për ta sinjalizuar se nuk bëri mirë që tregoi se po e nxjerrnin bashkarisht Lirinë." (Atentatet, f.294)

Se cilat kanë qenë gjasat që I. Kelmendi me u gjetë në Kalanë e Jusufit në fund të korrikut 1981, se çfarë gjasash ka pasur shoku i Sadik Blakajt me u tallë me Jusufin dhe mysafirët e tij e vërtetojnë përveç letrës së Tahir Mehës edhe rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*** *Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po

edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

14. Nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë pasi e kemi shok

Jusufi, i cili është po ky Jusuf që ia ka dhënë I. Kelmendit adresën e librarisë në Biel-Bienne, në Badhaus str.35, pra që e ka dërguar për herë të parë ta kontaktoj Kadri Zekën, ngutet ta qetësojë Kadriun duke i thënë se nuk kemi nevojë të kemi fshehtësira prej I. Kelmendit.

I. Kelmendi: "– Shoku Kadri, – u ngut Jusufi, – nga Mirani nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë këtë bashkëveprimtari, pasi e kemi shok dhe përfaqëson organizatën e Frontit, pavarësisht se veprimtarinë e asaj organizate e kanë ngrirë për ***të pritur bashkimin dhe bashkorganizimin tonë****." (Atentatet, f.294)*

Jusufi jo vetëm që ngutet me e qetësue Kadri Zekën, se nuk kemi nevojë të kemi fshehtësira prej I. Kelmendit por i tregon atij edhe risi, se ai (I.K.) e përfaqëson 'Frontin e Kuq' (sepse ky fakt paska qenë i panjohur për Kadri Zekën gjer në fund të korrikut 1981). Dhe jo vetëm kaq, por vetë Jusufi ia jep vetes të drejtën të fletë në emër të Frontit para Kadri Zekës dhe t'i tregoj atij, se "Fronti e ka ngrirë veprimtarinë për të pritur **bashkimin dhe bashkorganizimin tonë."**

Se çfarë **bashkimi e bashkorganizimi** ka ndërmend të bëjë Jusufi na tregon letra e Tahir Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Se sa ka mundur që rrethimi i Tahir Mehës me mercenarë t'ia lëkund qëndrimet Jusufit e tregojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

15. Bashkimi po vonohet

Kadri Zeka, ende pa dalë numri 4-5 i Lirisë, tregon padurim duke iu ankuar Jusufit se 'Bashkimi po vonohet', dhe pasi Jusufi, (ky Jusuf që ia ka dërgua I. Kelmendin atij, (K. Z), në Zvicër, në Badhaus str. 35, në Biel-Bienne), i ka thënë se para I. Kelmendit të 'Frontit' të bashkëthemeluar dhe të pagëzuar nga UDB-a nuk kemi nevojë të kemi fshehtësi, në prani të I. Kelmendit e përmend Metush Krasniqin e Sabri Novosellën dhe raportet në mes tyre.

I. Kelmendi:" – ***Bashkimi po vonohet****, Shoku Jusuf, sepse shokët tanë nuk po gjejnë kontakt me Lëvizjen tuaj. Te Metush Krasniqi kanë shkuar shokët, meqë ua pata dërguar informatën që morëm nga ti, por ai nuk ka pranuar të jetë udhëheqës i organizatës suaj, bile ka thënë se me Rrobaqepësin, siç e quante ai Shokun Sabit, nuk dëshiron të ketë kurrfarë pune e lidhje. Për këtë shkak po ndodh vonesa dhe do të lutesha të kontaktosh Shokun Sabit që të na e mundësojë ndonjë kontakt të ri në Kosovë." (Atentatet, f.294-295)*

Se sa është mërzitur Lëvizja e Jusufit për bashkim me Frontin e emërtuar nga UDB-a flet letra e Jusufit dërguar Tahir Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Tahir e Nebih Mehës, 13 maj 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare*

të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

16. Jusufit nuk i erdhi mirë dhe u befasua nga sqarimi i Kadriut

Jusufi befasohet për zbulime sekretesh të Lëvizjes së vetë, nga ana e Kadri Zekës në prani të I. Kelmendit, duke harruar çka ka thënë dy minuta më parë se para I. Kelmendit të Frontit nuk kemi nevojë të mbajmë fshehtësira.

I. Kelmendi: "Jusufi u befasua nga sqarimi i Kadriut dhe nuk i erdhi mirë përse foli në mënyrë aq konkrete në prani të Miranit, pasi ai i kishte thënë disa herë se Sabitit nuk po i duket gjëkundi organizata e tij në Kosovë.

– Shoku Kadri, nuk bërë mirë që përmende emra konkretë në Kosovë, – iu drejtua Jusufi.

– Pak më parë the se nga Mirani nuk kemi asgjë të fshehtë dhe unë u ndjeva i detyruar të shpjegoj për vonesën që po ndodh në Kosovë, – u përgjigj Kadriu.

– Nuk e kisha për arsye të pranisë se Miranit, – filloi të mbrohet Jusufi, – por jemi përcaktuar që në prani të të tretit të mos përmenden emra konkretë në Kosovë. Njësoj do të kisha reaguar edhe po të ishte i pranishëm Bardhi.

– Të kuptoj, – miratoi Kadriu." (Atentatet, f.295)

Se sa ka mundur të tallet me Jusufin e me punët e brendshme të Lëvizjes së vet, shoku i Sadik Blakajt e vërtetojnë më së mirë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Sipas projektit të shembjes së mitit të Jusufit, vetë Jusufi donë të ruaj sekretet e organizatës së vet prej I. Kelmendit ndërsa është më dorëlirë kur janë në pyetje sekretet e OMLK-së. Të njëjtën gjë në mënyrë analoge e bënë Kadri Zeka, për gëzimin dhe talljet e naivit, konkretit, të sinqertit dhe transparentit I. Kelmendi.

Çka do të thotë se Jusufi ka pasë aftësi me mbajtur emra sekret të shokëve në Kosovë prej Bardhit, por në këtë drejtim nuk ka pas sukses që këta emra t'i mbaj sekret prej I. Kelmendit, përfaqësuesit të Frontit, të bashkëthemeluar dhe pagëzuar nga UDB-a. A ka fakt më kuptimplotë se ky për shembjen e mitit të Jusufit.

Se me të vërtetë mund të ketë qenë kështu e vërtetojnë edhe këto fjalë:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

17. Bisedimet për bashkim në parim i kemi bërë

I. Kelmendi na tregon se në mbarim të korrikut 1981, dy policë gjerman bisedojnë me te për vjedhjen e postës së tij e të Jusufit nga ana e Riza Salihut. Në ditën e nesërme niset tek Jusufi në Untergruppenbach dhe aty e gjen Kadri Zekën (për të cilin nuk di se do ta gjej aty). Nga Donika mëson se ata (J. G. e K. Z.) janë duke e përgatitur numrin 4-5 të gazetës së OMLK-së, Liria). Tallet me fshehtësitë e konspiracionin naiv herë të Kadriut e herë të Jusufit, duke i hedhur njërin kundër tjetrit, dhe ajo që përbën kulmin e kësaj rruge është se Jusufi, Kadriu e I. Kelmendi bëjnë bisedime për bashkim, bile edhe i kryejnë këto bisedime me sukses, duke pasë për bazë "Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës" të OMLK-së.

I. Kelmendi: "Bisedimet për bashkim, në parim, i kemi bërë duke marrë për bazë Tezat e Frontit që na i ofrove ti." (Atentatet, f.296)

Tezat e OMLK-së rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës as në korrik e as në gusht 1981, në Shtutgart as që janë përmendë. Kjo nuk do të thotë se ato nuk kanë ekzistua në Kosovë. Mehmet Hajrizi tregon se ato janë përpilua në maj 1981. Kur kanë ardhë tek Kadri Zeka në Zvicër është çështje që nuk më takon mua të merrem me te. Në librin e Ethem Çekut, Shekulli i ilegales, në faqe 498, titulli i aktakuzës kundër Hydajet Hysenit, Mehmet Hajrizit, Berat Luzhës e të tjerëve është "Fronti Popullor për Republikën e Kosovës". Se a ka pasur ndonjë gjasë që I. Kelmendi të jetë në Kalanë e Jusufit dhe të tallet me te e me mysafirët e tij e vërteton letra e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të*

përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton.*****"** (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)

18. Platforma e organizatës që do të dalë nga bashkimi ynë

Jusufi kërkon nga Kadri Zeka që ai ta mbështetë platformën politike të shtruar në kryeartikullin e Bashkimit, i cili është i shkëlqyeshëm dhe që nuk ka asgjë origjinale për rrethanat e Kosovës. Jusufi gjithashtu konstaton se "Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës" janë të bazuara në kryeartikullin "e I. Kelmendit" e që atij (Jusufit) i ka rastisë ta redaktoi.

I. Kelmendi: "Edhe përpara, Shoku Kadri, të kam thënë që mbështete platformën politike të shtruar në kryeartikull të Bashkimit*, jo për faktin se e kam redaktuar vetë dhe kam shtuar edhe unë ndonjë gjë, por se më pat pëlqyer, prandaj u dakordova që ta botonim. Edhe Tezat tuaja i pata vlerësuar se ishin të bazuara në atë kryeartikull, prandaj nuk patëm vështirësi të mirëkuptohemi kur e diskutuam platformën që duhet të* ***ketë organizata që do të dalë nga bashkimi ynë****." (Atentatet, f.296)*

Se sa është Jusufi i interesuar të bëjë bisedime me Frontin e emërtuar nga UDB-a, në bazë të artikullit "Bashkimi bënë fuqinë" e tregon fuqia e fjalëve të Jusufit.

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Se sa ka pasur gjasa që I. Kelmendi të gjendet në këtë kohë në Kalanë e Jusufit në Untergruppenbach e tregon fuqia e fjalëve të Jusufit:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i*

kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

19. Marrëveshja e bashkimit më 15 gusht 1981 në Habichthöhe

Në shkrimin "Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore" (www.pashtiku.org) e kemi parë se si Jusufi e dërgon me porosi I. Kelmendin tek Kadri Zeka. Tani e kemi një cilësi më lartë të bashkëpunimit kur Kadriu e fton I. Kelmendin, në odën e axhës, pra në Kalanë e Jusufit për t'u takuar aty në fundjavën e tretë të gushtit 1981, pra të shtunën, më 15 gusht 1981.

E Hane	E Marte	E Mërk.	E Enjte	E Premte	E Shtune	E Diele
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	**15**	16
17	18	19	**20**	21	22	23
24	25	26	26	28	29	30
31						

Kalendari i javës së fundit të korrikut dhe i muajit gusht 1981

*I. Kelmendi: "****NË FUNDJAVËN E TRETË TË GUSHTIT*** *Kadriu i telefonoi Miranit për ta njoftuar se do të takoheshin të* ***SHTUNËN*** *te Jusufi. Kur Mirani arriti te shtëpia e Jusufit, aty gjeti Kadriun." (Atentatet, f.297)*

Pra herën e kaluar, në fund të korrikut I. Kelmendi rastësisht e gjen Kadriun tek Jusufi. Kur tani takimi është veç i organizuar me kohë. 'Vërtetësia' e organizimit të këtij takimi vërtetohet me fjalët e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës ***14 gusht****, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët* ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai***

e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** (Letër Sabri Novosellës, **20 gusht 1981**)

20. Jusufi e Kadriu radhisin tekstin e platformës finale për bashkim

I. Kelmendi: "Tani po e radhisnin tekstin e platformës finale për bashkim me Jusufin. Në fund Jusufi shtypi tri kopje që ta kishin secili nga një gjatë diskutimit. Të gjithë ndiheshin të gëzuar se më në fund po bëhej diç konkrete për bashkim. Kadriu informoi se bisedimet për bashkim në Kosovë nuk kishin mund të përfundonin me bashkim, pasi këtë e kishte penguar burgosja e drejtuesve të OMLK-së dhe burgosjet e anëtarëve të organizimeve të tjera." (Atentatet, f. 297)

Kadri Zeka informon Jusufin e I. Kelmendin se ai është i autorizuar të flas e vendos në emër të OMLK-së.

I. Kelmendi: "Ai informoi Jusufin e Miranin se OMLK-ja e kishte autorizuar atë për të vazhduar bisedat në emigracion." (Atentatet, f.297)

Se çfarë efekti mund të ketë pasur "autorizimi i OMLK-së" që Kadri Zeka të bisedoj me Lëvizjen e Jusufit dhe me Frontin e emërtuar nga UDB-a, më 15 gusht, dhe çfarë gjasash kanë ekzistue me u gjetë përfaqësuesi i këtij Fronti në Kalanë e Jusufit e vërteton vetë Jusufi. A ka fjalë më të mira se sa këto më poshtë për të treguar se si është *radhitur teksti i platformës finale për bashkim:*

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

21. Lëvizja do të përfaqësohet nga Sabri Novosella dhe Jusufi

Jusufi u tregon K. Zekës e I. Kelmendit se Lëvizja e tij, do të përfaqësohet nga ai J.G. dhe Sabri Novosella.

I. Kelmendi: "Jusufi shfaqi qëndrimin se Lëvizja do të përfaqësohet nga Shoku Sabit dhe vetë ai." (Atentatet, f. 297)

Ndoshta Sabri Novosella nuk ka pasur kundër që ta përfaqësoj Lëvizjen, por është letra e Jusufit ajo që e vulosë fatin e përfaqësimit dhe këtyre gënjeshtrave sa të tejdukshme aq edhe primitive:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të***

Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit*). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

22. Fronti e ka ngrirë organizimin

I. Kelmendi përsëritë se Fronti, njëanshëm e ka ngrirë organizimin dhe do ta shkrijë atë vetëm kur të bëhet bashkimi i këtyre dy organizimeve

I. Kelmendi: "Mirani ***përsëriti*** *qëndrimin se Fronti ka ngrirë* ***organizimin*** *dhe është dakord me vendimet që do të marrin përfaqësuesit e këtyre* ***dy organizimeve.****" (Atentatet, f.297)*

Se sa i interesuar ka qenë Jusufi për përsëritjet e Frontit në qendrën e të cilit ka qenë UDB-a e vërteton më së miri letra e Tahir Mehës:

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së - shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

Tezat për Front të OMLK-së janë identike me kryeartikullin e shkëlqyeshëm dhe që nuk ka asgjë origjinale "të I. Kelmendit", të cilin Jusufit i ka rastisë ta redaktoi.

*I. Kelmendi: "Meqë Tezat ishin identike me idenë e shtruar në kryeartikull të B*ashkimit*, ato u* ***miratuan*** *si të tilla,..." (Atentatet, f.297)*

Ky "**miratim**" i 15 gushtit vërtetohet dhe i komunikohet Sabri Novosellës 5 ditë më vonë me këto fjalë:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."****(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

23. Ne jemi të autorizuar për ta konkretizuar bashkimin

Jusufi jo vetëm që i jep vetes të drejtë të flasë jo vetëm në emër të Lëvizjes së vetë, por flet edhe në emër të K. Zekës e I. Kelmendit.

I. Kelmendi: "– Megjithatë, – mori fjalën Jusufi, – unë mendoj se tani Tezat i kemi, duhet t'i diskutojmë seriozisht. Ne tani jemi të autorizuar për ta ***konkretizuar*** *bashkimin e organizatave tona." (Atentatet, f .303)*

Se për çfarë ***konkretizimi*** *të bashkimit* është fjala duket në fjalët shumë konkrete të letrës së Tahir Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. ***Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë****. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)*

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981). **Konkretizimi** vazhdon në formën:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

24. Vazhdoj të të mos kuptoj por kurrsesi të të keqkuptoj

I. Kelmendi, në Kalanë e Jusufit, i mban ligjëratë Jusufit për punët e brendshme të Lëvizjes së tij, dhe ai (Jusufi) i dëgjon me vëmendje e kujdes ndërhyrjet **neveritëse** të I. Kelmendit.

I. Kelmendi: "...ndërhyri Mirani, duke mos e përmbajtur ***neverinë*** *që kishte krijuar për Sabitin. – Lëre Rrobaqepësin ta vazhdojë jetën e tij prej anadollaku, sepse ai nuk kupton gjë nga këto që janë të shkruara këtu, pos nëse ti do ta këshillosh.* ***Vazhdoj të të mos të kuptoj****, – iu drejtua Jusufit, – si nuk po mund të* ***lirohesh*** *nga Sabiti, i cili nuk t'u paraqit gati një vit e gjysmë dhe tani që t'u ka lajmëruar, do ta lejosh të të udhëheqë, gjë që nuk e meriton." (Atentatet, f.304)*

Edhe njëherë I. Kelmendi, "**vazhdon të të mos e kuptoj**" Jusufin por ai kurrë nuk e **keqkupton** atë. Si mund të jetë Jusufi mit, kur lejon në Kalanë e vet t'i komentohen punët e brendshme të Lëvizjes së tij, në mënyrë neveritëse nga persona që nuk kanë të bëjnë dhe që kurrë nuk kanë pas të bëjnë me Lëvizjen e tij. A nuk është i mjaftueshëm vetëm e vetëm ky 'fakt' për shembjen e mitit të Jusufit?!

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Se sa është në gjendje dhe sa e madhe është dëshira e Jusufit për t'u **liruar** nga Sabri Novosella e tregon letra dërguar Sabri Novosellës në të cilën Jusufi pas dërgimit të Hysen Gegës në burg e shpreh mendimin e vet për Frontin e Kuq, në qendër të të cilit Jusufi ka dyshim të bazuar se gjendet UDB-a. Përderisa Ibrahim Kelmendi neveritet, mendimet e Sabri Novosellës për Ibrahim Kelmendin, sipas fjalëve të Jusufit "***janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme***."

*Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person****, JANË JO VETËM TË URTA, PO EDHE SHUMË TË NJERËZISHME****. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët* ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)

Siç mund të merret me mend nga rreshtat e mësipërm është Sabri Novosella ai i cili vazhdimisht i thotë Jusufit që të afrohet me I. Kelmendin, por Sabriu është në Turqi, ndërsa Jusufi është në Gjermani dhe e njeh shumë më mirë I. Kelmendin, andaj edhe këshillat e tij mbesin pa efekt.

25. Më vjen keq që injoranti të luaj me intelektualizmin tënd

I. Kelmendit i vjen keq për Jusufin, pasi ai (Jusufi) e lejon Sabri Novosellën të luaj me intelektualizmin e tij. *I. Kelmendi: "– Sepse po më vjen keq,* ***që ai injorant*** *të luajë me intelektualizmin tënd, për të cilin kam shumë respekt. Pastaj nuk po dëshiroj ta presim miratimin e tij për bashkim..." (Atentatet, f.305)* I. Kelmendi, shembësi i mitit të Jusufit si njeri, ka shumë respekt për intelektualizmin e tij (Jusufit). Se çfarë bisedimesh mund

të ketë zhvilluar Jusufi me Ibrahim Kelmendin, në Kalanë e tij më 15 gusht e tregon letra e 20 gushtit 1981:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. ***Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme.*** *(Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët* ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** *(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)*

26. E kemi pa teklif e nuk mundem pa te

Përkundër ndërhyrjeve neveritëse të I. Kelmendit ndaj Sabri Novosellës dhe nervozimit të Kadriut, Jusufi i ngritë në nivelin më superlativ konsideratat pozitive për naivin dhe të sinqertin I. Kelmendi.

I. Kelmendi: "– Mos u shqetëso, Shoku Kadri, – iu drejtua Jusufi, – me Miranin e kemi ***pa teklif*** *dhe pa tarifë. Sa herë i jam hidhëruar,* ***por nuk mundem pa të, sepse e dua si ta kisha vëlla.*** *Këtë ka të mirë, çfarë mendon, ta thotë, pastaj* ***nuk përflet pas shpine, por respekton vendimet që marrim****." (Atentatet, f. 305)*

Shtrohet pyetja se a kanë dalë ndonjë herë këto fjalë prej gojës së Jusufit? Se sa pa teklif flet Jusufi me Sabri Novosellën për I. Kelmendin e vërtetojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: *"Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980* ***... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. ... Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."*** **(**Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, **korrik 1981**)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)

27. U ngritën në këmbë duke u përqafuar e uruar për bashkimin e arritur

Të shtunën e tretë të gushtit, pra më 15 gusht 1981, Jusufi, Kadriu e I. Kelmendi arrijnë marrëveshjen për bashkim duke pasur si bazë "Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës" të OMLK-së.

I. Kelmendi: "Kurse sa për Tezat, jam dakord me këtë përmbajtje që kemi në duar, por këmbëngul që miratimin përfundimtar ta japë Shoku Sabit, edhe për shkak se është veteran i veprimtarisë së organizuar patriotike.

– Atëherë, meqë dashke të na marrësh në qafë, që bashkimi të varët nga Zotëri Katunriu, edhe unë po miratoj propozimin e Jusufit, – u shpreh Mirani.

– Mirë, edhe unë po e miratoj propozimin tuaj, – u prononcua gëzueshëm Kadriu.

Të katërt u ngritën në këmbë, ia dhanë dorën njëri-tjetrit duke u përqafuar e duke uruar për mirëkuptimin që u arrit, të bindur se ishte arritur edhe bashkimi, *por që duhej bërë një takim formal me Sabitin." (Atentatet, f.305-306)*

Të shohim si e përshkruan afrinë e Jusufit me Ibrahim Kelmendin, Shkolla e UDB-së Serbe, e përfaqësuar jo nga TANJUG-u apo Ilustrovana Politika, por në këtë rast nga Abdullah Prapashtica.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi **në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.** ... **në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzënë nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në **dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Abdullah Prapashtica: *"Ajo që sjell Nuhi Sylejmani në librin e vet është **dëshmia e ti personale** si njëri nga bashkëpunëtorët e rrethit të ngushtë të Jusuf Gërvallës në Gjermani, mbi atë bashkëpunim që kanë pas ata së bashku në kuadër të ish LNÇKVSHJ dhe **dëshmi autentike** e zhvillimeve të pastajshme... (...)Nuhi Sylejmani shkruan me kompetencë..."* (MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT" TË NUHI SYLEJMANIT, www.albaniapress.com, 14 tetor 2010)

Osman Osmani: ***"Kujtimet dhe dokumentet përcjellëse brenda librit sjellin fakte historike të pakundërshtueshme dhe të panjohura gjer më tani**. **Në mënyrën më të përpiktë**, paraqitet gjendja dhe zhvillimi i tri organizatave shqiptare të asaj kohe, që vepronin kryesisht në botën e jashtme si Fronti i Kuq Popullor, GMLK/OMLK dhe LNÇK/LNÇKVSHJ, si dhe për proceset organizative dhe ideologjike nëpër të cilat kalojnë këto organizata para dhe pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.*

*Autori ndër të tjera, **në mënyrën më besnike**, përshkruan peripecitë dhe ballafaqimet me sfida të shumta të familjeve Gërvalla dhe Zeka pas atentatit të 17 janarit të vitit1982."* (Kopertina e mbrapme e librit të quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010)

Të katërt ia dhanë dorën njëri-tjetrit duke u përqafuar e duke uruar për mirëkuptimin që u arrit, të bindur se ishte arritur edhe bashkimi. Është çudi se pse nuk qenka arritur bashkimi i vërtetë. A do të ishte shumë më e kënaqshme të ishte arritur bashkimi se sa mirëkuptimi. Por edhe arritja e vetëm mirëkuptimit në këtë rast e ka peshën e vetë të jashtëzakonshme pasi kjo arritje mirëkuptimi na servohet nga një person i cili kurrë nuk të **keqkupton** por vetëm të **mirëkupton**. ***Mirëkuptimi i arritur*** në fantazinë falsifikuese të I. Kelmendit vërtetohet më së miri me dokumentin e Jusufit:

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."*** (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)

Është pikërisht Sabri Novosella që i thotë tërë kohën Jusufit që ta afroj atë (Ibrahim Kelmendin) e ta rrëmbej këtë farë thesari nga dora e OMLK-së dhe Kadri Zekës. Por Jusufi kurrë nuk do të ishte Jusuf dhe UDB-a nuk do ta kishte vra, sikur ai të kishte vepruar vetëm në bazë të mësimeve të Sabri Novosellës dhe jo të ndërgjegjes së vet, përvojës së vet dhe konkluzioneve të nxjerruna në bazë të fakteve që i ka pasë. Faktet na e japin të drejtën të themi se Jusufi është zot i Kalasë, Lëvizjes dhe Historisë së Tij.

28. Jusuf Gërvalla: *"SHTËPIA QË MEREMETOHET*

tani vetëm pluhuri del prej dritareve dhe ftohtësia
tjegullat që lëshonin shiun në vjeshtë janë ndërruar
një tra i lakuar e i nxirë me merimanga mbuluar
dhe era e mykut me krimbat në dysheme të zgjuar
në kthinën tjetër kanë mbetur truq të gjitha arkat
mbi resho të përlyer zihet kafja me ngadalë
nga parandjenja e rrëzimit minjtë prej vrimash kanë dalë
tash goditen me sy e shpagë lartësitë
nga dritaret e vogla do të lihet më shumë hapësirë
pastaj për çdo skutë do të ketë më shumë dritë
do t'i lihet rrugë diellit më shpesh të vijë për drekë
në dysheme tek rrinë këmbët e gjyshes s'do të ketë më lagshti
shkallët tash do të shpien drejt në kopshtin e blertë
gjatë rrugës për në gjumë s'do të zërë në thua gjyshi."
(Marrë nga përmbledhja "Fluturojnë e bien", 1975)

QARTËSIA E PERSPEKTIVËS SË EMËRTIMEVE TË PAPRANUESHME

1. Jusufi ka qenë i lidhur me ne
2. "Jusufin e ka edukuar ...."
3. Përmes ngjyrimit ideologjik të cilit i ka dalë boja
4. Bashkë me Jusufin kundër pushtetit komunist jugosllav
5. Kurrsesi nuk donte çfarëdo kompromisi me komunistët
6. Nuk janë të afërta as të pranueshme
7. Regjimi socialist po luftohej me socializëm
8. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste
9. Nuk u për-puthet ideologjia - E kujtoj atë takim
10. Krimet e kuqe

1. Jusufi ka qenë i lidhur me ne

"Demaçi: *Unë nuk kam qenë as enverist ose komunist.*
A. Duka:- I keni njohur në atë kohë Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën?
Adem Demaçi**: **Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur, ndërsa Kadri Zekën jo." *(Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 150-156)*

2. "Jusufin e ka edukuar ...."

***Hysen Gërvalla**: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"
"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto **emërtime** të Organizatës, që për brezin aktual **nuk janë të afërta as të pranueshme**."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

Mehmet Hajrizi: *"Filozofia politike, mendimi i ri politik, analizat e thella të gjendjes dhe të situatave, **qartësia e perspektivës**, ndërtimi i strategjisë dhe taktikave në shërbim*

të saj, ishin shprehje e një pjekurie dhe kulture të lartë politike e kombëtare të radhëve të Organizatës (Marksiste Leniniste të Kosovës -shën. ynë)." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 318)

3. Përmes ngjyrimit ideologjik të cilit i ka dalë boja

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

*...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik ...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

***Hysen Gërvalla**: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Populllore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

Kadrush Sylejmani: *"Metush Krasniqi me Jusuf Gërvallën, me atë rast, thanë se ishin të gatshëm të pranonin bashkëpunimin e organizatës së tyre me "Ballin Kombëtar" dhe "Legalitetin" në Gjermani. Ata përgatitën një raport të gjerë mbi situatën aktuale politike në Kosovë, në Serbi dhe përgjithësisht në Jugosllavinë e atëhershme dhe, së bashku me Programin e Statutin e Partisë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë, ia dhanë Saqip Sylejmanit, që ta dërgonte në Gjermani." (Metush Krasniqi, Prishtinë 1999, f.166)*

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"

"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual **nuk janë të afërta as të pranueshme**."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

4. Bashkë me Jusufin kundër pushtetit komunist jugosllav

Ibrahim Kelmendi: *"– Tani po e kuptoj egon tënde. Jusufi është detyruar të arratiset. Tani*
*ai do të angazhohet, mendon ti, bashkë me ju, **kundër pushtetit komunist** jugosllav?*
– Dhe kundër pushtimit të Kosovës! – plotësoi Mirani.
*– Po, vetëkuptohet! – u përgjigj Renata, duke u ndjerë paksa e bezdisur, përse po i rrinte kaq gati Mirani, kur ajo harronte të saktësonte, se atij i interesonte po aq çlirimi i Kosovës sa edhe luftimi i **diktaturës***
***komuniste** jugosllave."(Atentatet, f. 11)*

Nga fjalët e mësipërme del se Ibrahim Kelmendi ka luftuar kundër pushtetit komunist jugosllav dhe kundër diktaturës komuniste jugosllave. Por në këtë rast ai nuk është mjaftuar për të shfaqur vetëm orientimin e tij politik por ai na tregon se edhe ideja themelore e Jusufit ka qenë e njëjtë me të I. Kelmendit, pra luftimi i pushtetit komunist jugosllav dhe i diktaturës komuniste jugosllave.

Me fjalë tjera, këtë hyrje, këtë prezantim të mrekullueshëm në faqen 11 të librit *Atentatet* nuk mund të shprehet me asnjë mënyrë më të mirë se sa me fjalën popullore 'Dita e mirë doket në sabah'. Në gjermanisht kjo fjalë popullore është shumë më e fuqishme dhe më pa shibla se sa në shqip.

Man muss den Baum biegen, weil er noch jung ist.

Einen Baum soll man biegen, so lange er jung ist, sepse *'Alte Bäume lassen sich nicht biegen'.*

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

*...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

***Hysen Gërvalla**: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

5. Kurrsesi nuk donte çfarëdo kompromisi me komunistët

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte*

*demokrat i vërtetë dhe mbi të **gjitha ideologjinë komuniste** e konsideronte si **ideologji ruse** dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste."* (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt*

me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.

Mirëpo, ***kurrsesi*** *nuk gjente fuqi për të bërë* ***çfarëdo kompromisi me komunistët****, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Hysen Gërvalla*: "****Jusufi*** *kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Popullore,* ***kurrë nuk ka qenë komunist****. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Berat Luzha*: "Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

...Përmes ***ngjyrimit ideologjik****, kemi tentuar t'i* ***kundërvihemi ideologjisë komuniste*** *titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

Sabri Novosella (Për diplomatët shqiptarë): "*Këta mua, personalisht, në mënyrë kontinuitive, më sillnin libra të Enver Hoxhës, që unë të gjeja mënyrë për t´i dërguar në Kosovë. Ata, thjeshtë e loznin lojën e tyre, por më duhet t´a pranojë se edhe unë e lozja lojën time. Unë të gjitha ato libra që m´i dhanë i futa në stufë dhe i dogja, që të mos u binin në duar të rinjve kosovarë, ngase prej tyre nuk fitohej asgjë e mirë, sepse atyre që u gjendeshin ato libra, dënoheshin me burg të rëndë dhe të gjatë, e madje edhe akuzoheshin si marksist-leninistë, kështu që, në vend që t´i shërbehej çështjes së Atdheut dhe kombit, në fakt krijoheshin kundërefekte."* (Intervistë në Zëri e ribotuar në Drita nr. 10/1997)

Hysen Gërvalla: *"Dhe kur e panë se pak kush ishte i gatshëm të kacafytet me përbindëshat (Shqipëri e Enverit e Jugosllavi e Rankoviqit) që natën bashkëpunonin e ditën shaheshin, i përvolën mangët dhe u futen të gjallë në zjarrin që përvëlonte. Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar....*

...Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtare, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hydajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

*...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Hysen GËRVALLA: "*Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës."* (Bota Sot, 12 mars 2003)

"Bota sot: *Ju e thatë edhe më lart se pas vrasjes së Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ka patur interpretime për personalitetin e Jusufit, është folur se ka qenë "marksist, komunist..." etj. Sa ju kanë lënduar juve si familje këto etiketime?*

***Hysen Gërvalla**: Sigurisht se na kanë prekur. Jusufi kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Populllore, kurrë nuk ka qenë komunist. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Shefqet Jashari-Strofci: "*Ta zëmë rastin kur është futur në kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla. Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetarë i mirëfilltë, d.m.th. i painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik." (Drita, Trelleborg, Suedi, nr. 15, 1997, f. 15)*

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

*...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Mehmet Hajrizi (Betimi i OMLK, pjesë): "*Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të mi.*" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 95)

Kadrush Sylejmani: *"Një vit e gjysmë pas ardhjes dhe qëndrimit të Saqip Sylejmanit në Kosovë, me të njëjtën detyrë dhe me porosinë e Hajrullah e Ahmet Tërpezës dhe të Mefail Emërllahut në emër të "Ballit Kombëtar" dhe të "Legalitetit" erdhi nga Gjermania në Kosovë edhe Avdyl Kikaj, nga Lupçi Ulët i Podujevës. Edhe ky menjëherë u vu në kontakt me Metush Krasniqin, Jusuf Gërvallën e udhëheqës të tjerë të partive politike shqiptare në Kosovë dhe me një raport të shkoqitur mbi gjendjen politike në Kosovë e në trojet e tjera etnike shqiptare në Jugosllavi, u kthye në Gjermani." (Metush Krasniqi, Prishtinë 1999, f.167)*

Ismail Kadare: "*Terrori i përditshëm, sistematik, monoton ishte shumë më i keq se dhuna spektakolare. Ishte dispozita e veçantë e komunizmit. I krahasuar, për shembull, me terrorin fashist, terrori komunist ishte shumë më diskret, i fshehtë, i heshtur dhe i maskuar".*

"Nëse dënimi ishte kërkuar nga lart dhe nëse mbledhja ishte publike, mbrojtja ishte e pamundur, ndoshta fatale për viktimën. Mbrojtja haptazi merrej si sfidë haptazi ndaj partisë". ("La Republica", www.balkanforum.info, nëntor 2009)

Ismail Kadare: "*Është hipokrizi, është dyfytyrësi të thuash se ne jemi evropianë, por mos na pyesni më shumë për të kaluarën. Prandaj diskutimi duhet të bëhet. Nëse kemi*

këtë dilemë, ne e vëmë veten në skizofreni morale, që është gjëja më e pamoralshme e një kombi" -ka thënë ai. "Ka gjëra që për arsye të ndryshme munden që për një kohë t'i refuzohen publikut, çdo shoqëri e ka këtë, ka arkiva që nuk hapen për vjet të caktuara për arsye të ndryshme, por shoqëritë demokratike duhet të shpjegojnë ato që ndodhin në strategji të zhvillimit të shtetit, në politikë, në ekonomi, në të gjitha." (http://lajme.dervina.com, nëntor 2009)

6. Nuk janë të afërta as të pranueshme

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"
"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual* ***nuk janë të afërta as të pranueshme****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

Dr. Muhamet Pirraku: "*Terrori komunist kominternist në Kosovë e viset e tjera të Shqipërisë, jashtë territorit të Shqipërisë londineze, nuk pati rezultate të mëdha në përgjakjen vëllavrasëse të popullit shqiptar."* (**Për kauzën shqiptare 1997-1999**, Prishtinë, 2000, f. 147-164)

Hysen Gërvalla*: "**Jusufi** kurrë nuk ka qenë në Lëvizje Populllore, **kurrë nuk ka qenë komunist**. Jusufin e ka edukuar nëna, familja, rrethi i tij në frymën kombëtare e jo ideologjike.*" (Bota Sot, 1dhjetor 2006)

Hashim Thaçi: "*Komunizmi në Kosovë është instaluar dhunshëm dhe është larguar dhunshëm, por shqiptarët kurrë nuk kanë qenë komunistë.*"(Bota Sot, 14 shtator 2009)

Mehmet Hajrizi: *"Organizata përjashtonte çdo tendencë të instalimit të ideologjive reaksionare e fashiste."* f.69 (M. Hajrizi 2008)

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"
"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual* ***nuk janë të afërta as të pranueshme****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***ruante rolin hegjemon****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

*...Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Mehmet Hajrizi: "*Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste, që ishte në **modë** atëherë, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim, prandaj pjesëtarët e saj nuk duhen ngatërruar me pushtetarët që e përdornin apo keqpërdornin për diktat dhe sundim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 98)

Mehmet Hajrizi: "*Së pesti, kritika kundër sistemit socialist shtypës e shfrytëzues të vetadministrimit jugosllav, që pretendonte të paraqitej me fytyrë njeriu, bëhej më përshtatshëm dhe më bindshëm pikërisht nga pozitat e së majtës, por gjithashtu e majta politike, e cila presupozonte një shtet social për shqiptarët e asaj kohe, dukej gjerësisht më e përshtatshme, duke pasur parasysh varfërinë e theksuar të shqiptarëve."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 99)

7. Regjimi socialist po luftohej me socializëm

*"**A. Duka**: Thatë se e ndërruat emrin e Grupit tuaj Revolucionar. Më lejoni t'ju pyes: E ndërruat sepse bindjet tuaja ideologjike ishin marksiste-leniniste, e ndërruat sepse duhej ndërruar, apo e bëtë këtë gjë për të qenë të ngjashëm me veprimtarinë politike e ideologjike të shtetit-amë?*

Mehmet Hajrizi: *E kuptoj këtë pyetje me ngut. Sot, pas kaq vitesh, duhen sqaruar këto emërtime të Organizatës, që për brezin **aktual duken demode** dhe të largëta, edhe pse nuk e cënojnë aspak karakterin nacionalçlirimtar dhe rëndësinë historike të saj... Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ideologjinë marksiste **që ishte në modë atëherë**, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim.*

...Po të shikohen dokumentet e Organizatës, bëhet e qartë si drita e diellit se veprimtarët e Lëvizjes së Kosovës, pavarësisht emërtimeve dhe literaturës që lexonin, luftonin për të drejtat dhe çlirimin e popullit shqiptar dhe jo për triumfin e ndonjë ideologjie në atdheun e tyre apo në botë.

*...**M. Hajrizi**: Ndikimi nuk mund të mohohet, por ne fokusoheshim tek shkelja nga udhëheqja jugosllave e parimit të vetëvendosjes së popujve, e cila ishte pjesë përbërëse e doktrinës leniniste dhe premtim demagogjik i Titos e partisë së tij komuniste.*

...Së katërti regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm edhe për një arsye që e diktonin rrethanat historike.

...A. Duka: Ky është trajtimi dhe shpjegimi më i plotë që kam dëgjuar deri tani dhe juve jo më kot paskeni qenë udhëheqësi i asaj organizate. (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, f.163-167)

8. Komunistët të cilët ia bënë varrin shoqërisë socialiste

Sabilja thotë se Marksistë-Leninistët e OMLK-së janë ata që më së shumti luftuan kundër shoqërisë socialiste dhe mu për këtë kishin tepër jehonë në popullatën shqiptare. Me fjalët e saj pajtohet plotësisht ideologu i OMLK-së Mehmet Hajrizi.

prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha: "*Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-**socialiste** në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e*

*'Grupit Revolucionar" që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata **Marksiste-Leniniste** e Kosovës.*" (Mehmet Hajrizi, Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 316)

Në mënyrë aq fenomenale dhe bindëse është zbërthyer kjo çështje sa nuk më ka rënë të gjej tekst më të kthjellët. I vetmi person që mund të ketë mendime më të sinqerta dhe inteligjente për 'komunistët' në fjalë është Vasil Stanilov i cili thotë se është e pamundur që në të njëjtën kohë të jesh inteligjent, i sinqertë dhe komunist.

Pse?
Sepse:

Nëse je inteligjent dhe komunist, nuk je i sinqertë
Nëse je i sinqertë dhe komunist, nuk je inteligjent.
Nëse je inteligjent dhe i sinqertë, nuk je komunist.

9. Nuk u për-puthet ideologjia – E kujtoj atë takim

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. **Një tentim për kontakt kishte edhe me (Partinë Komuniste - shën im) PKMLSHJ**, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

"Një fantazmë sillet nëpër Evropë"

Pse nuk i ka dal në takim Abdullah Prapashtica, Berat Luzhës?

Sepse *"Martin Quni (...) Prej Hamzë Morinës e ka marrë 'Liria nr.1' të cilën ia ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon materiale të tilla, ngase siç deklaron ky i akuzuar, **nuk u për-puthet ideologjia**."* (Aktgjykimi i PKMLSHJ, P-K nr. 167/72; Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 678)

"Një fantazmë sillet nëpër Evropë"

Xhafer Shatri: *"Kemi insistuar për një takim, sepse e pamë se veç ia kanë nisur t'i përçajnë radhët tona, të organizojnë edhe njerëzit e organizuar, duke u shërbyer me shpifje dhe dinakëri krijuan konfuzion të madh sidomos në rrethin e Shtutgardit. Kjo reflektohej keq te punëtorët. U përpoqëm të bisedojmë bashkarisht për këto probleme, por u iknin takimeve. Njëherë udhtuam me mija kilometra për t'u takuar, por ai burri i botës i iku takimit, vetë shoku i tij më i ngushtë ikjen e tij e çmoj si tradhti... Ky rast pati pasoja të mëdha. Herën e dytë i shkruam letër urgjente që të propozojnë se ku po shihemi dhe kur, bile morëm përsipër që të udhëtojmë 5000 kilometra, me rreziqe të shumta, por përgjegje morëm vetëm pas dy muajsh, kuptohet përgjegje negative."* (Qarkore, qershor 1983)

Nga fryma e fjalëve të Mehmet Hajrizit dhe mënyra se si ai ***e kujton atë takim***, duket se është hidhëruar për shkakun se Abdullah Prapashtica nuk i ka dalë në takim Berat Luzhës. Mendimi im prej një vrojtuesi të jashtëm është se komunisti Mehmet edhe përkundër hidhërimit, megjithatë duhet ta ndiej veten të ngushëlluar. Dihet se

klouni komunist, Abdullah Prapashtica e ka thirrur në takim për bisedime nga pozita të barabarta edhe Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë dhe as atyre nuk u ka dalë në takim. Përderisa Lidhja Komuniste e Jugosllavisë nuk është ankuar deri më sot për atë se pse klouni komunist i ka ikur takimit të propozuar nga ai vetë, shtrohet pyetja se prej nga i vjen e drejta Mehmet Hajrizit të ndihet keq, t'i fajësoj të tjerët në mënyrë kaq të pamëshirshme e ta ***kujtoj atë takim*** në mënyrën si e ka shtruar më lartë. Çështje tjetër që flet kundër Mehmet Hajrizit është fakti se komunisti i zyrave të UDB-së megjithatë i ka në dalë në takim, në minutën e caktuar, nën dritën e hanës apo për të qenë më ekzakt nën dritën e gjysmëhanës, Sabri Novosellës, armikut më të madh të sllavo-komunistëve dhe bizantinëve.

Mustafë Xhemaili: "*Romani "SY" është një tronditje. Apo më mirë të thuhet një ritronditje. Sepse autori do të sjellë Shqipërinë nën diktaturën komuniste nga një këndvështrim i veçantë.*
...Ai aq larg shkon në ëndërrimin e lirisë nën regjimin e diktaturës komuniste sa këmbëngulë vazhdimisht se duhej të gjendje një rrugëdalje, një shteg e të dilet në dritën e lirisë." (Sytë e jetës, vlerësime për romanin "SY" të Ardian Kyçykut, 2004, www.mustafe-xhemaili.com)

Jusuf Gërvalla: "*Edhe publiku ynë, kemi përshtypjen, ka zënë të lidhet me ndonjë këngëtar a kompozitor të caktuar, prej të cilit nuk po do të ndahet dot, pa marrë parasysh kualitetin që i ofron këngëtari a kompozitori që e ka zgjedhur për vete. Kështu, simpatitë e veta edhe sivjet (në mbrëmjen popullore), publiku ia fali kompozitores Pranvera Badivuku (për melodinë e saj "E kujtoj atë takim")"* (Rreth Akordeve të Kosovës '74, Vepra, vëllimi 3, Prishtinë 2010, f. 255)

10. KRIMET E KUQE

Prof. Abdyl Kadolli: "*Lëvizja kombëtare shqiptare kurrë nuk ka pasur karakter ideologjik. Nëse ndonjëherë hapen dosjet e krimeve komuniste, numri i spiunëve e bashkëpunëtorëve të paguar e të papaguar do të dilte shumë i madh. Një Rezolutë e miratuar nga Kuvendi i Kosovës do t'i përkufizonte mirë këto krime antikombëtare e antinjerëzore, ndërsa një ligj nuk do të lejonte më në pushtet personat e kompromentuar.*
Kështu, ne do të çliroheshin njëkohësisht edhe nga mendësia komuniste, edhe nga mendësia sllave.
Krimet e fashizmit dhe të komunizmit nuk qëndrojnë shumë larg njëra-tjetrës...
Ideologjia komuniste pati reflektime të thella në fatin tonë kombëtar. Komunistët shqiptarë kontribuan shumë në mbetjen me sllavët dhe nën sllavët.
Janë të tmerrshme krimet komuniste të periudhës së pasluftës, kur gjatë Kryengritjes shqiptare u masakruan e ekzekutuan rreth 50 mijë shqiptarë." (KRIMET E KUQE, Zëri i Kosovës, 20 janar 2009, www.lpk-kosova.com)

Komiteti Drejtues i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës, në maj 1981 hartoi dokumentin me titull:

TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

Teksti i *Tezave*, është marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 208-213

Mehmet Hajrizi: *"Filozofia politike, mendimi i ri politik, analizat e thella të gjendjes dhe të situatave,* ***qartësia e perspektivës****, ndërtimi i strategjisë dhe taktikave në shërbim të saj, ishin shprehje e një pjekurie dhe kulture të lartë politike e kombëtare të radhëve të Organizatës (Marksiste Leniniste të Kosovës - shën. ynë)."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 318)

Berat Luzha*: "Faktikisht,* ***ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë****, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*

... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.

... Përmes ***ngjyrimit ideologjik****, kemi tentuar t'i* ***kundërvihemi ideologjisë komuniste*** *titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

Mehmet Hajrizi: "*Prandaj u vendos të ndërrohej emri i Organizatës, nga "Grup Revolucionar", në "Grup Marksist-Leninist të Kosovës" (GMLK).*"

"*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual* ***nuk janë të afërta as të pranueshme****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)

I

Kriza e rëndë që ka mbërthyer Jugosllavinë ***revizioniste (****d.m.th.* ***jokomuniste****-shën i Xhafer Durmishit), i ka sjellë masat punonjëse kudo në Jugosllavi në një gjendje shumë të vështirë. Por, veçanërisht e rëndë dhe e padurueshme është kjo gjendje në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, ku mbi masat punonjëse po ushtrohet një shtypje e shfrytëzim i egër e i shumëfishtë kolonial e kapitalist.*

Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi ka luftuar në shekuj për lirinë, të cilën nuk e fitoi kurrë. Megjithë gjakun e shumtë që derdhi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai nuk fitoi të drejtën e tij të ligjshme dhe të premtuar që të vendosë vetë për fatin e tij. Këtë të drejtë, që më parë e kishin proklamuar vetë shovinistët e rinj jugosllavë, pas përfundimit të luftës, e mbytën me gjak. Me anë të forcës e të tradhtisë, ata bënë që Kosova dhe tokat e tjera shqiptare, që fuqitë e mëdha i kishin shkëputur padrejtësisht nga shteti shqiptar, të pushtohen përsëri dhe të copëtohen në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Mali të Zi. Populli i robëruar shqiptar u bë objekt i një politike të egër shoviniste të shtypjes e shfrytëzimit të pamëshirshëm, objekt i dhunës dhe terrorit, shkombëtarizimit dhe gjenocidit të paparë. Çështja

kombëtare e popullit tonë mbeti një problem i pazgjidhur, një plagë që kërkon shërim. Popullit shqiptar në Jugosllavi dhe sidomos atij në Maqedoni e Mal të Zi i janë mohuar e shkelur të drejtat më elementare kombëtare.

Përveç marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, gjendjen e masave punonjëse dhe të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi e rëndon edhe shfrytëzimi i egër kolonial që ushtrohet mbi të. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi janë shndërruar në koloni të vërteta të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në burim të tyre, thjesht të lëndëve të para dhe të krahut të lirë të punës. Mbi supet e klasës sonë punëtore dhe masave të tjera punonjëse po hidhen jo vetëm pasojat e krizës që ka mbërthyer ekonominë kosovare, por edhe ato të krizës së ekonomisë të të gjithë Jugosllavisë. Kjo ka bërë, që megjithë pasuritë e shumta që kanë Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi jo vetëm të jenë pjesa më e pazhvilluar në Jugosllavi, por që edhe prapambetja e tyre në krahasim me viset e tjera të Jugosllavisë të shtohet vazhdimisht. Kjo ka bërë që Kosova jonë e begatshme të mbetet " shtëpia e varfër e Evropës ", vendi i prapambetjes, papunësisë, kurbetit, analfabetizmit, errësirës, sëmundjeve, skamjes dhe mjerimit.

I I

Populli ynë heroik ka luftuar në shekuj për lirinë dhe të drejtat e tij. Ashtu si dhe më parë, ai nuk u pajtua kurrë me zgjedhën e re të robërisë ***revizioniste (****d.m.th.* ***jokomuniste****-shën i Xhafer Durmishit). Luftën e pandërprerë të popullit tonë kundër zaptuesve të rinj shovinistë nuk kanë mundur ta shuajnë as gjenocidi, dhuna e terrori i egër fashist dhe as premtimet, demagogjia, feja, shthurja e degjenerimi. Krahas ngritjes së vazhdueshme të ndërgjegjes kombëtare e klasore të popullit tonë të robëruar, u rrit dhe u intensifikua edhe lufta e tij për të drejta e liri.*

Lëvizja revolucionare e pranverës së këtij vitit është vazhdim i drejtpërdrejtë i luftës së pandërprerë të popullit tonë për liri, dëshmi e ngritjes së saj në një shkallë akoma më të lartë.

Grevat dhe demonstratat e mëdha të pranverës nuk kishin aspak karakter shovinist, irredentist, reaksionar e kundërrevolucionar, siç po për piqet t'i paraqesë ato propaganda jugosllave. Ato ishin pasojë e gjendjes së padurueshme, në të cilën ndodhet populli ynë, e shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kolonial e kapitalist që ushtrohet mbi masat tona punonjëse. Me anë të këtyre demonstratave dhe grevave, populli ynë kërkoi kushte më të mira jetese, kërkoi lirinë dhe të drejtat e mohuara kombëtare e demokratike; dhe në mënyrë të veçantë kërkoi që Krahinës Autonome të Kosovës t'i jepet statusi i Republikës brenda Federatës Jugosllave. Këto kërkesa qenë paqësore; të përgjakshme ato i bënë shovinistët serbomëdhenj dhe tradhtarët shqiptarë, që urdhëruan shuarjen e tyre me armë dhe me gjak, me milici speciale, tanke dhe ushtri. Ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh në këto demonstrata popullore dhe për të gjitha dëmet që u shkaktuan.

Suksesi i demonstratave dhe grevave të këtij viti është i jashtëzakonshëm.

** U arrit një politizim, mobilizim dhe bashkim i paparë i popullit tonë.*

** U ngrit në një shkallë akoma më të lartë fryma e tij, luftarake, patriotike e klasore, u shtua edhe më shumë besimi i tij në forcat e veta të pashtershme.*

** Politika antipopullore e udhëheqjes shoviniste të Jugosllavisë u demaskua e u diskreditua edhe më shumë jo vetëm në sytë e popullit tonë, por edhe në sytë e popujve jugosllavë dhe të atyre të botës. Doli në shesh jo vetëm politika e shovinistëve serbomëdhenj për fashistizimin dhe rankoviçizimin e mëtejshëm të Jugosllavisë, por edhe plani i rrezikshëm që ata po kurdisin në bashkëpunim me socialimperialistët sovjetikë – kundër popujve të Jugosllavisë dhe të Ballkanit*

** Çështja e Kosovës u popullarizua edhe më shumë në të gjithë botën. Lufta jonë e drejtë fitoi simpatinë dhe përkrahjen e të gjitha forcave përparimtare në të gjithë botën...*

I I I

Të tmerruar nga goditjet dërmuese që morën nga grushti i ngritur i popullit, shovinistët serbomëdhenj kanë shpërthyer tani një fushatë të tërbuar antishqiptare. Ata po përdorin të gjitha mjetet dhe metodat, me qëllim që

> **Berat Luzha**: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*
>
> *... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *... Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

***të shkatërrojnë lëvizjen komuniste** e patriotike, që po rritet e forcohet vazhdimisht, ta nënshtrojnë popullin tonë të pamposhtur, ta mbysin luftën e tij çlirimtare, e madje edhe të na i rrëmbejnë ato pak liri e të drejta që i kemi fituar me gjak e sakrifica. Por, siç ka treguar historia jonë e lavdishme dhe siç po e tregon edhe lufta e gjithnjë në rritje që po bën populli ynë edhe në këto kushte, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtë popullin tonë të paepur, që të ndalë marshimin e tij të pandalshëm drejt lirisë e socializmit.*

** Në këto kushte, **para gjithë lëvizjes komuniste**, patriotike e revolucionare në Kosovë del detyrë e ngutshme bashkimi dhe organizimi më i mirë i gjithë popullit tonë dhe luftës së tij të drejtë.*

> **Berat Luzha**: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*
>
> *... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *... Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

** **Organizata Marksiste – Leniniste** e Kosovës mendon se në kushtet e tanishme kjo mund të arrihet më së miri duke organizuar **FRONTIN POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**.*

I V

** Qëllimi i Frontit për Republikën e Kosovës është që Krahina e Kosovës të çlirohet nga sundimi i Serbisë dhe të fitojë statusin e republikës brenda federatës jugosllave*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës është e drejtë dhe përkrahet nga i gjithë populli shqiptar*

** Populli i Kosovës kurrë nuk ka vendosur për fatin e vet. Tokat e tij janë pushtuar me forcë, janë copëtuar dhe në kundërshtim me vullnetin e tij, i janë aneksuar Serbisë. Në mbledhjen e AVNOJ –it ku u vunë themelet e pushtetit të sotëm jugosllav, nuk u fol fare për çështjen e popullit shqiptar në Jugosllavi dhe më të nuk morri pjesë asnjë delegat shqiptar.*

** Populli shqiptar jeton në tokën e tij, ku ka jetuar brez pas brezi.*

** Populli shqiptar në Kosovë i ka të gjitha karakteristikat që përbëjnë një popull dhe një komb. Ai nuk është" pakicë kombëtare", nuk është" kombësi" dhe as "populsi" ("*

narodnost"), siç e kanë cilësuar shovinistët jugosllavë. Ai përbën mbi 80 për qind të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

** Për nga numri i banorëve, Krahina e Kosovës është rreth tri herë më e madhe se Mali i Zi, që ka republikën e vet.*

** Republika e Kosovës do ta bëjë të mundshëm zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik dhe kulturor të Kosovës si dhe afirmimin e mëtejshëm kombëtar të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi.*

** Republika e Kosovës do të jetë fitore e madhe edhe për popullin shqiptar në Maqedoni, në "Serbinë e ngushtë" dhe në Mal të Zi, prandaj edhe përkrahet prej tij.*

** Republika e Kosovës nuk u sjell asnjë të keqe popujve jugosllavë dhe federatës së tyre; përkundrazi ajo është dhe në interes të tyre dhe e forcon Federatën jugosllave.*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës është një e drejtë që buron edhe nga Kushtetuta e Jugosllavisë, një e drejtë që e gëzojnë të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi. Dënimet që u jepen përkrahësve të kërkesës për Republikën janë të paligjshme.*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës nuk është kërkesë për ndryshimin e kufijve në Jugosllavi e Ballkan. Ajo nuk është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara as me vendimin e Helsinkit dhe nuk sjell kurrfarë rreziku për paqen në Ballkan.*

V

** Për t'ia arritur këtij qëllimi, Fronti duhet të bashkojë në luftë për Republikën të gjitha masat popullore, punëtorët, fshatarët, zejtarët, rininë, gratë, inteligjencën revolucionare dhe elementë përparimtarë nga radhët e borgjezisë;* ***të gjithë komunistët****, patriotët dhe revolucionarët e vërtetë, pavarësisht nga bindjet politike e nga dallimet klasore, fetare e krahinore.*

* ***Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë e sipër; jo qëllim në vete, por një levë e rëndësishme për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e masave popullore në luftë për të drejta e liri.***

> **Berat Luzha***: "Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*
>
> *... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *... Përmes* ***ngjyrimit ideologjik****, kemi tentuar t'i* ***kundërvihemi ideologjisë komuniste*** *titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

* ***Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë****.*

** Në Frontin për Republikën* ***do të bëjnë pjesë të gjitha organizatat dhe grupet ilegale komuniste****, patriotike e revolucionare, pavarësisht nëse janë ose jo për socializmin e vërtetë. Republika e Kosovës është në interes të të gjithë popullit të Kosovës, në interes të të sotmes dhe të së ardhmes së tij, prandaj në Front duhet të bëjnë pjesë të gjithë ata që janë për lirinë e Kosovës, për Republikën e saj.*

** Në Frontin për Republikën mund të bëjnë pjesë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë Kosovës, në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, në viset e tjera të Jugosllavisë apo kudo në botë. Fronti do të luftojë për lirinë dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi.*

** Republika e Kosovës është në interes edhe të popujve joshqiptarë në Kosovë, prandaj edhe ata duhet ta përkrahin kërkesën për Republikë dhe të përfshihen në radhët e Frontit.*

** Fronti Popullor për Republikën e Kosovës nuk do të ketë asgjë të përbashkët, por do të jetë kundër LKJ-së dhe organizatave tradhtare të masave si LSPP, LRS, LS, KKASHG etj., që janë vegla të shovinizmit serbomadh. Fronti do të luftojë për demaskimin dhe izolimin e udhëheqjeve të tyre tradhtare dhe për tërheqjen në anën e tij të masave të mashtruara e të manipuluara prej tyre.*

** Në Frontin për Republikën nuk mund të bëjnë pjesë gjithashtu as grupet e organizatat fashiste e terroriste dhe agjenturat e ndryshme, që organizon reaksioni i jashtëm apo i brendshëm.*

V I

** Krahas luftës për Republikën, Fronti do të punojë edhe për organizimin e luftës në çdo ndërmarrje, fshat, shkollë e fakultet, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, politike, ekonomike e shoqërore të klasës punëtore, fshatarësisë, rinisë, gruas, inteligjencës etj., për organizimin e rezistencës kundër plaçkitjes së pasurive të Kosovës, të luftës për mbrojtjen e kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë etj.*

** Për realizimin e qëllimeve të tij, Fronti do të përdorë të gjitha format e luftës dhe organizimit, do t'i kombinojë e zëvendësojë ato në përputhje me kërkesat e situatës dhe të strategjisë së tij.*

** Në veprimtarinë e tij, Fronti do t'i japë përparësi organizimit dhe luftës ilegale, por krahas kësaj ai do t'i shfrytëzojë gjerësisht edhe të gjitha format e mundshme legale.*

** Fronti është kundër reformizmit dhe legalizmit borgjez dhe, nga ana tjetër, lufton kundër pikëpamjeve dhe metodave anarkiste e terroriste të luftës, të cilat e dëmtojnë rëndë dhe e kompromet ojnë luftën tonë të drejtë.*

** Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për përçarjen e popullit tonë me anë të fesë, hakmarrjes, vëllavrasjes etj.*

** Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për armiqësimin e popullit shqiptar në Jugosllavi me Shqipërinë socialiste. Ai do t'i popullarizojë sukseset madhështore që po arrin në të gjitha fushat Shqipëria socialiste nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver Hoxha. Fronti do të përpiqet për zhvillimin e marrëdhënieve sa më të ngushta e të gjithanshme mes popullit shqiptar në Jugosllavi dhe atij në Shqipëri.*

** Fronti Popullor për Republikën e Kosovës do të luftojë gjithashtu edhe kundër përpjekjeve të shovinistëve serbomëdhenj për ta armiqësuar popullin shqiptar me popujt jugosllavë në Kosovë dhe në Jugosllavi. Fronti nuk i ngatërron popujt jugosllavë me krerët e tyre shovinistë. Luftën e tij ai jo vetëm që nuk e drejton kundër proletariatit dhe popujve jugosllavë, por përkundrazi, ai i konsideron ata si aleatë të tij në luftën për të drejta e liri.*

** Duke ndjekur një politikë konsekuente internacionaliste, Fronti do ta lidhë luftën e tij me luftën që bëjnë popujt dhe proletariati i të gjithë botës për liri e socializëm dhe do të luftojë kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër fashizmit dhe reaksionit të të gjitha ngjyrave.*

* * *

*Këto janë tezat kryesore që **Organizata Marksiste-Leniniste** e Kosovës i propozon si bazë për organizimin e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Gjatë diskutimit ato*

me siguri që do të plotësohen, të përsosen e kristalizohen më tej dhe mbi këtë bazë do të përcaktohet vija politike, ideologjike e organizative e Frontit.

> **Berat Luzha**: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*
>
> *... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *... Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)

***Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës** u bën thirrje të gjithë **komunistëve**, patriotëve e revolucionarëve të organizuar e të paorganizuar që t'i përgjigjen ashtu si duhet thirrjes së Atdheut për bashkimin e Frontit të përbashkët të luftës për të drejtat dhe lirinë tonë – për Republikën tonë.*

Forca jonë qëndron në unitetin tonë. Sa herë që populli ynë ka bashkuar armët dhe zemrat në një front të vetëm, ai ka arritur të mposhtë dhe të mbulojë me turp armiq shumë më të mëdhenj e më të armatosur. Këtë e dëshmojnë luftërat legjendare të Skënderbeut, e dëshmon lufta e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e dëshmon epopeja e lavdishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e dëshmojnë edhe grevat e demonstratat tona heroike.

*Në luftë për të drejtat tona, ne, gjatë kësaj pranvere, pavarësisht se cilës organizate i takonim, u lidhëm sup më sup dhe, si shokë e vëllezër të vërtetë, luftuam, u përleshëm e u gjakosëm me armiqtë dhe tradhtarët e urryer të popullit tonë. Tani para nesh shtrohen detyra që këtë bashkim të paparë që arritëm në luftën tonë, ta ruajmë e forcojmë më te, ta bëjmë të organizuar, të qëndrueshëm, të pathyeshëm, të përjetshëm. Bashkimi bën fuqinë. Bashkimi është imperativ i kohës. Të bashkuar e të lidhur si vëllau me vëllanë, ne jemi më të fuqishëm se të gjithë armiqtë tanë, të bashkuar ne jemi të pamposhtur. Vetëm të bashkuar si grusht i vetëm në **Frontin** Populllor për Republikën e Kosovës, ne do të arrijmë fitoren tonë, lirinë tonë.*

*Rroftë **Fronti** Populllor për Republikën e Kosovës*

Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës (Maj 1981)

> **Mehmet Hajrizi**: "*Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual **nuk janë të afërta as të pranueshme**."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 96)
>
> **Berat Luzha**: "*Faktikisht, **ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë**, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia.*
>
> *... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*
>
> *... Përmes **ngjyrimit ideologjik**, kemi tentuar t'i **kundërvihemi ideologjisë komuniste** titiste."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, faqe 220)
>
> **Mehmet Hajrizi**: *"Filozofia politike, mendimi i ri politik, analizat e thella të gjendjes dhe të situatave, **qartësia e perspektivës**, ndërtimi i strategjisë dhe taktikave në shërbim të saj, ishin shprehje e një pjekurie dhe kulture të lartë politike e kombëtare të radhëve të Organizatës (Marksiste - Leniniste të Kosovës -shën. ynë)."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 318)

Këto Teza, jashtë Kosovës, për herë të parë u shtypën nga Jusuf Gërvalla dhe u shpërndan në rrethin e Shtutgartit, në mesin e shtatorit 1981. Jusuf Gërvalla i shtyp këto Teza duke besuar se autorët e tyre mendojnë dhe qëndrojnë prapa fjalëve të shkruara, dhe janë për socializëm të vërtetë, pa ngjyrime dhe jo të rrejshëm, se luftojnë për socializëm e jo kundër socializmit. Një muaj më vonë (në mesin e tetorit 1981) Jusufi i ndryshon mendimet për këto Teza, 27 vjet përpara se ta bëjnë të njëjtën gjë autorët e tyre. Thelbi i këtyre Tezave, i këtij Programi, nëse shikohet me ***qartësinë e perspektivës*** së autorëve të tij del ky:

-**Në vitin 1981**, Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës (OMLK) e ka konsideruar Jugosllavinë si revizioniste d.m.th. komunizmin e saj (Jugosllavisë) e ka quajtur fals, të rrejshëm dhe si të tillë e ka luftuar ashtu siç luftohet në përgjithësi e në mënyrë universale çdo gjë e rrejshme dhe lufta kundër gjërave të rrejshme është e përafërt, e afërme, e kuptueshme, e pranueshme dhe inspiruese për çdo brez e për çdo gjeneratë. Ndërsa socializmin e idetë veta OMLK-ja i ka quajtur të vërteta dhe jo vetetiketime e ngjyrime..

-**Në vitin 2008**, falë ***qartësisë së perspektivës*** 27 vjeçare, autorët e Tezave deklarojnë të kundërtën dhe pësojnë disfatë katastrofale para armikut të tyre. Nga ***qartësia e perspektivës*** del se komunizmi titist i Jugosllavisë ka qenë komunizëm e socializëm i vërtetë i cili është luftuar nga idetë e rrejshme, false, me ngjyrime e vetetiketime komuniste të OMLK-së, dhe si të tilla nuk janë të afërta e as të pranueshme për brezin tonë dhe jo vetëm kaq, por si ide të rrejshme dhe ngjyrime të cilave me kohë u del boja, në ***qartësinë e perspektivës*** do të jenë të huaja dhe të papranueshme për çdo brez, për çdo kohë. Kjo është kështu sepse asnjë brez nuk do ta prananote katastrofën që në hapin e parë që me ide e me ngjyrime të rrejshme të luftojë idetë e vërteta, me fjalë tjera, me ndihmën e gënjeshtrës ta luftojë të vërtetën.

Fakti se Jusuf Gërvalla ka qenë në gjendje, me shpejtësi të rrufeshme t'i analizoj me themel gjërat para të tjerëve, në këtë rast këto Teza, dhe t'u jap trajtimin e duhur, 27 vjet para autorëve të tyre tregon më së miri pse UDB-ja e kishte në shënjestër atë dhe Shtëpinë e tij.

Duke u bazuar në këto Teza, në javën e parë të dhjetorit 1981, OMLK-ja, përmes Kadri Zekës ia dërgon Jusuf Gërvallës një dokument, të quajtur: "***Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!***" me shpresë se edhe kjo ***Thirrje*** do të aprovohet nga Jusufi dhe do të shtypet e shpërndahet së pari në Shtutgart. Në të njëjtën ditë Jusuf Gërvalla, në praninë time (Xhafer Durmishit) ua kthen përgjigjen.

Jusuf Gërvalla: "*Ju po deshët mund të delni me atë **thirrje**. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të **pavërteta**. ... Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të **pavërtetave**.*" (Letër Kadri Zekës, rreth 7 dhjetorit 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 277)

K O M U N I K A T E

e Komitetit Qendror të LEVIZJES NACINALÇLIRIMTARE TE KOSOVËS

Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si ”romantizëm nacional” dhe ”nacionalizëm e shovinizëm shqiptar” si dhe për të gjetur ”organizatorin” e demonstratave, duke fajësuar herë një ”grup huliganësh”, herë ”ekstremistët” shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Leninistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t’ia ngarkoj fajin kryesor Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndër ”organizatorët” e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë ”vepra” që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.

E kemi parë të udhës që pasi, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan ”informatat” e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t’ju drejtohemi me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkohen askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

Donika Gërvalla: *"Jusuf Gërvalla luftoi me penë për Republikën e Kosovës."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 1.05.13-1.05.19)

2. Kërkesa për t’iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet ”Zëri i Kosovës” dhe ”Lajmëtari i lirisë”, si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të inteligjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më herët, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë.

3. Nga Statuti, Programi dhe të gjitha dokumentet e LNÇK del qartë se ne nuk e aprovojmë dhe nuk e aplikojmë asnjë formë terrori dhe anarkie. As sot LNÇK nuk merr përsipër as përgjegjësinë më të vogël për aktet e ”terrorit” e të ”anarkisë”, që i

trumbeton me të madhe policia sekrete jugosllave, siç është djegia e ndonjë fabrike a ndërmarrjeje, përdhunimi i monumenteve kulturo-historike, i varrezave serbo-malazeze etj. Madje, sipas bindjes sonë, janë as më shumë e as më pak se aksione subversive të njerëzve të UDB-së. Qëllimi i tyre është justifikimi i vrasjeve, plagosjeve, arrestimeve, burgosjeve dhe terrorit të paparë mbi popullsinë tonë. Në këtë drejtim Jugosllavia, si para ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore, ka pasur një traditë të gjatë. Lidhur me inskenimin e akteve të terrorit e të anarkisë nga ana e qeverive jugosllave, akte që pastaj i janë mveshur popullsisë shqiptare, mjafton të shikohet elaborati i serbomadhit Vasa Çubriloviç "Shpërngulja e shqiptarëve", i cili përmban një arsenal të pasur udhëzimesh për aplikimin e metodave më barbare, nga të cilat do të duhej të rezultonte çrrënjosja e shqiptarëve nga tokat e tyre brenda kufirit administrativo-politik të Jugosllavisë. S'ka dyshim se në kontekst të kësaj "vepre" duhet të shihen edhe brengosja e Jugosllavisë për shpërnguljen nga Kosova të elementit serbo-malazez, edhe zhurma e madhe rreth prishjes së varrezave dhe të përmendoreve kulturo-historike në Kosovë.

Këto metoda nuk janë në traditën dhe në mënyrën burrërore të luftës ballë për ballë që kanë bërë me shekuj shqiptarët edhe atëherë kur armiku ka qenë dhjetë fish më i përgatitur, numerikisht e teknikisht. Përkundrazi, për 500 vjet të sundimit turk, ishin pikërisht shqiptarët ata që mbrojtën tradicionalisht përmendoret kulturo-historike në territorin e tyre, pa marrë parasysh se cilit popull i takonin ato. Deri më dje serbët nuk kurseheshin në lavdatat e tyre për popullsinë shqiptare të Rrafshit të Dukagjinit, që mbrojtën Patrikanën e Pejës dhe Manastirin e Deçanit nga të gjitha stuhitë dhe luftërat e shumta të zhvilluara në këtë terren.

Shqiptarët e Jugosllavisë, kur ka qenë nevoja, e kanë mbrojtur edhe me armë elementin e këtushëm serbo-malazez. Por qeverisë shoviniste të Beogradit nuk i leverdisë ta pohoj këtë në momentin aktual, edhe pse me siguri, asgjë nga e kaluara nuk do të ketë harruar. (Neve na indinjon thellë fakti se as kryepolici Herleviç as ndonjë tjetër nga udhëheqja jugosllave, derisa hakërrohen mbi shqiptarët, nuk u kujtuan të përmendnin së paku një herë problemin e shpërnguljeve të mëdha të shqiptarëve nga Kosova dhe viset tjera shqiptare, por kanë marrë në dorë kamxhikun e kërcënimeve për shkaktarët e shpërnguljes së serbo-malazezëve; "çudi", si nuk e publikuan asnjë rast të të prishjes së varrezave të serbomalazezëve, kur hetimet treguan se këso veprash ishin kryer pikërisht nga bandat e aktivizuara çetnike dhe nga vetë njerëzit e porositur të UDB-së!)

Në fund ju njoftojmë se Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës është një organizatë patriotiko-revolucionare që lufton me mjetet më demokratike që janë përdorur ndonjëherë në Evropë. Terrori, anarkia e revanshizmi kanë qenë dhe mbeten metoda, jo vetëm të huaja por edhe të urryera e rreptësishtë të ndaluara për çdo anëtar dhe simpatizant të Lëvizjes sonë. /Gusht 1981, Untergruppenbach

Kjo komunikatë u përpilua nga Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi dhe u nënshkrua
Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës

PROGRAMI I JUSUF GËRVALLËS

I shprehur

1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....
2. Në *Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Populllor*
3. Në gazetën *Bashkimi*
4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*
5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës
6. Në artikuj teorik ende të pabotuar
7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës
8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

Selatin Novosella: *"Më tutje do të flitet për veprimtarinë e organizatës patriotike Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi, e formuar në vitin 1978 nga Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Shefqet Jashari, Jusuf Gërvalla etj."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 18)

1. Në Aktgjykimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare....

Aktgjykim*: "I akuzuari Isa Demaj*

Sepse me shkrim dhe gojarisht nxiti ndërrimin antikushtetutar të rregullimit shoqëror-socialist e vetëqeverisës dhe shkatërrimin e bashkim – vëllazërimit e barazisë së kombeve e kombësive të RSFJ, e po ashtu me qëllim të keq dhe rrejshëm i paraqiti rrethanat politiko-shoqërore në RSFJ, kështu që gjatë viteve 1975 deri në 1979 në Lipjan dhe vendet tjera gjatë bisedave me të akuzuarin Avdi Kelmendi, e pastaj me ***Ismajl Gashin, Beqir Lecin, Ekrem Llugiqin*** *dhe persona tjerë ka deklaruar se në* ***Jugosllavi nuk ekziston socializmi i vërtetë po vetëm politika revizioniste,*** *se shoku* ***Tito është antikomunist*** *dhe se politika e tij të cilën e udhëheqë shkon në favor të* ***kapitalizmit****, se Beogradi udhëheqë politikë shfrytëzuese ndaj Kosovës, se RSFJ i shfrytëzon pasuritë natyrore të KSA të Kosovës. Poashtu ka kritikuar sistemin socialist vetëqeverisës dhe ka deklaruar se duhet punuar me rininë shqiptare në mënyrë që e njëjta të ngritet ideologjikisht për veprimtari armiqësore ndaj RSFJ, e pastaj në banesën e Ismajl Gashit në Lipjan ka deklaruar se situata politike e Kosovës nuk ka ndryshuar pas Plenumit të Katërt, kurse para nxënësve të QAMO në Lipjan, ku ka qenë i inkuadruar në veti të profesorit të gjuhës shqipe ka recituar vargje nga "Lahuta e Malësisë" dhe shumë herë është shprehur armiqësisht ndaj sistemit socialist në RSFJ, dhe gjatë bastisjes në shtëpinë e tij më 27 dhjetor 1979 janë gjetur shtatë ekzemplarë të revistës "Ylli", vjersha "Kosovës" e materiale tjera me përmbajtje armiqësore, - me çka ka kryer veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al. 1 të LPJ."* (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si*

ideologji ruse *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Aktgjykim: *"I akuzuari Avdi Kelmendi, si në hetime ashtu edhe në seancë kryesore, pohon se me veprimtari armiqësore ka filluar të merret nën ndikimin e të akuzuarit Isa Demaj i cili e ka frymëzuar me ideologji të huaj. Për Jugosllavinë i ka folur se është larguar shumë nga socializmi duke shkuar rrugës së revizionizmit modern, se* ***Titoja është antikomunist dhe se politika që e udhëheq ai është në kundërshtim me parimet marksiste-leniniste dhe shkon në favor të imperializmit,*** *se Jugosllavia ka politikë shfrytëzuese ndaj Kosovës dhe popullatës së saj, duke ia grabitur pasuritë nëntokësore e mbitokësore."* (Aktgjykimi i Shefqet Jasharit me shokë. Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-nr. 248/80, 10 nëntor 1980. faqe 8)

Aktgjykim: *"**Sipas mendimit të Jusuf Gërvallës në komitet** duhet të marrin pjesë të akuzuarit **Ismajl Haradinaj**, Nimon Mustafaj, Nazmi Selmani dhe dy **hoxhallarë, imami i fshatit Drenofc dhe një hoxhë nga Gjakova**. ... Sipas porosisë së **Jusufit** bëjnë bisedë edhe me të akuzuarin Nimon Mustafaj, e njoftojnë me "Statut" dhe "Programin" e "Lëvizjes nacionalçlirimtare të Kosovës", i **përcjellin porositë e Jusuf Gërvallës dhe i shtrojnë për detyrë që të kontakton dhe angazhoj Hafizin - hoxhë**, të cilën detyrë e pranon, kështuqë pas 3-4 ditësh shkon në Gjakovë, gjen momentin e përshtatshëm për bisedë me Hafizin, i parashtron qëllimin e ardhjes së tij, mirëpo nuk arrin me e angazhuar pasi i njejti refuzon. Për këtë e njofton të akuzuarin Ismajl. Për të akuzuarit Ismajl dhe Hasan kanë qenë të papranueshme dhe inkompatibile në bazat "Marksiste" që anëtarë të komitetit **të jenë hoxhallarët**, kështuqë në këtë drejtim të akuzuarit Ismajl e sidomos i akuzuari Hasan Ukëhaxhaj është angazhuar që të gjej njerëz të përshtatshëm për komitet."* (Aktgjykimi kundër Ismail Haradinajt me shokë nga Gjykata e Qarkut në Pejë, Më datën 6 gusht 1981, P. nr. 106/81, www.pashtriku.org)

2. Në *Programin dhe Statutin e Frontit të Kuq Popullor*

Programi i Jusuf Gërvallës, është i shprehur mirë në përpilimin nga ai i Programit dhe Statutit të Frontit të Kuq Popullor.

Jusuf Gërvalla: *"Ekzistojnë shumë grupe e organizata, që të gjitha me një qëllim të vetëm, madje me një ide të vetme edhe për mënyrën e sendërtimit të këtij qëllimi (jo zogistë, ballistë... po vetëm komunist, marksist-leninistë që pranojnë vetëm pikëpamjet e një vendi të vërtetë socialist, siç është Shqipëria), por gjithë këto grupe e organizata e patën vështirë t´i shplohen shoqja-shoqes dhe t´i bashkojnë armët, sepse armiku pat infiltruar në radhët e tyre një armatë agjentësh."* (Bashkimi, janar-shkurt 1980, faqe 2, shtylla 4)

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.*

Mirëpo, ***kurrsesi*** *nuk gjente fuqi për të bërë* ***çfarëdo kompromisi me komunistët****, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i

konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Jusuf Gërvalla: *"Lufta kryesore dhe e vetme do të jetë lufta kundër robëruesit jugosllav, në krye me klikën titiste dhe shovinizmin sllavomadh (serb, malazez e maqedon) me qëllim të çlirimit social e nacional nga Jugosllavia dhe të bashkimit shoqëror e kombëtar me vendin amë, Shqipërinë Socialiste. Kjo është e drejtë legjitime e popullit shqiptar, i cili, megjithëse derdhi pa kursim gjakun e vet të shtrenjtë për tokat e veta të shenjta, u bë pre e apetiteve pushtuese jugosllave dhe e politikës diskriminuese të fuqive të mëdha.*

... Meqë interesat tona klasore e kombëtare përputhen me interesat klasore e kombëtare të popujve të Jugosllavisë, ne nuk dëshirojmë luftë me këta popuj, pos me klikën revizioniste të Beogradit. Prandaj në kohë "paqeje", FRONTI I KUQ POPULLOR ka për detyrë që me propagandë të shëndosh patriotike dhe marksiste-lenininste, t'i çjerrë maskën përgjithësisht klikës së egër të Beogradit dhe të thërras në luftë kundër saj edhe forcat përparimtare të popujve tjerë të Jugosllavisë. Mbi të gjitha, forca e propagandës i drejtohet popullit shqiptar, në mënyrë që ai të përgatitet në baza sa më të shëndosha e më të forta për revolucionin e ardhshëm.

... Strategjia e punës dhe e luftës së FRONTIT TE KUQ POPULLOR do të jetë strategjia e PPSH, e cila e ka demaskuar dhe demaskon me ngulm revizionizmin dhe politikën e egër jugosllave të gjenocidit mbi shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Lufta e shokut Enver Hoxha kundër revizionizmit, strategjia e hollë dhe trimëria e pashembullt e Tij në mbrojtjen e interesave jetike të popullit dhe të Shtetit Shqiptar, do të jenë mësimet bazë për të gjithë anëtarët e FRONTIT TE KUQ POPULLOR dhe do të studiohen me kujdes në mënyrë kreative, duke iu përshtatur kushteve konkrete.

... Vendimet bazë dalin nga komunistët, pasi të jenë analizuar në mënyrë kritike dhe pasi të jetë konstatuar se sjellin kontribut të padyshimtë për revolucionin. Me formimin e Partisë Komuniste Shqiptare (në viset e robëruara) FRONTI I KUQ POPULLOR do t'i organizojë masat rreth sajë, pasi PK do të jetë prezantuesja më e denjë e klasës punëtore.

Propaganda duhet të kryhet në çdo vend dhe në çdo rast e kohë; ajo duhet të jetë propagandë e shëndosh, që demanton dhe demaskon plotësisht realitetin revizionist jugosllav dhe sidomos politikën antishqiptare të Jugosllavisë.

... - TE RROJE SHOKU ENVER HOXHA, QE PO NA NDRIQON RRUGEN E VEPRIMIT!" (PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR, maj 1980)

3. Në gazetën *Bashkimi*

Programi i Jusufit në mënyrë të përsosur është i shprehur edhe në artikullin "Bashkimi bënë fuqinë" i botuar në numrin e fundit të gazetës Bashkimi.

Jusuf Gërvalla: *"Po deshëm që lufta jonë, nga një rezistencë spontane, të kalojë në luftë të organizuar për çlirimin kombëtar dhe klasor, atëherë para nesh shtrohet si domosdoshmëri studimi dhe përvetësimi i historisë kombëtare dhe i literaturës revolucionare marksiste-lenininste. Zotërimi i kësaj literature nga avangarda jonë dhe popullarizimi i saj në masa ka qenë dhe mbetet detyrë primare për zgjimin e vetëdijes kombëtare e klasore të masave popullore dhe të punonjësve.*

Nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, sot në Atdheun tonë socialist lulëzon një literaturë e begatshme revolucionare. Nga literatura e tillë, që duhet të përvetësohet

në mënyrë të domosdoshme dhe të ngutshme, sidomos nga pararoja jonë revolucionare, donë veçuar këto pikëmbështetje kryesore: veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit e ato të marksist-leninistit dhe prijësit të madh shqiptar, shokut Enver Hoxha; historia kombëtare shqiptare, ajo e PPSH-së dhe dokumentet e PPSH-së; shtypi shqiptar, sidomos publikimet shkencore nga lëmi i historisë dhe ai i ndërtimit teorik dhe praktik të socializmit në Atdheun tonë." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 1-2)

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si* ***ideologji ruse*** *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Jusuf Gërvalla: *"Për një Shqipëri socialiste të të gjithë shqiptarëve!*
Lëvizja jonë, lufta jonë nacionalçlirimtare, revolucioni ynë, na shpien pikërisht te qëllimi ynë kryesor: te një Shqipëri socialiste e të gjithë shqiptarëve. Kjo aspiratë është vënë edhe në ballë të organit tonë "Bashkimi" në trajtë parulle.

Nëse lufta jonë nacionalçlirimtare synon çlirimin kombëtar të të gjitha trojeve tona të pushtuara nga Jugosllavia, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri. Nëse pos çlirimit kombëtar synojmë edhe çlirimin klasor, atëherë jemi duke luftuar për një Shqipëri socialiste, e cila pas bashkimit të tokave që iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar, do të jetë Shqipëria socialiste e të gjithë shqiptarëve.

Ai që bënë zhurmë duke na e mohuar një të drejtë të tillë, në thelb është reaksionar, sepse pikëpamjet e tilla janë kryekëput pikëpamje imperialiste, kolonialiste e revizioniste. T'i mohosh popullit tonë të drejtën e luftës nacionalçlirimtare, do të thotë të pajtohesh me robërimin e popujve, dhe kjo është antimarksiste e antileniniste." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla: ***"Bashkëpunimi internacionalist i forcave tona çlirimtare***

Siç shihet edhe në Programin e Frontit të Kuq Popullor, ne kurrë nuk do të luftojmë kundër popullit serb, malazez e maqedonas. Përderisa ata të mos i përgjigjen ndërsimit të klikës titiste.

...Nga kjo del se ne, në baza të shëndosha marksiste-leniniste, nuk pranojmë të bëjmë gabime trashanike, siç është identifikimi i një populli me qeverinë e tij, kur kjo qeveri është antipopullore. As veprimet e individit të helmuar me politikën shoviniste që ndjek ndaj shqiptarëve udhëheqja revizioniste jugosllave, ne nuk do t'i përgjithësojmë dhe etiketojmë si akte të popullit serb, malazez e maqedonas. Lufta dhe revolucioni ynë do të jenë më të fuqishëm e më të plotë, sa më shumë që të shtrijnë ndikimin e tyre edhe në çlirimin kombëtar e klasor edhe të popujve të tjerë, mbi të cilët ushtrohet dhuna e pushtuesve të huaj apo e pushteteve të veta reaksionare e antipopullore." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla*: "Në gjithë të kaluarën tonë fqinjësore, siç tregon përvoja shekullore, "Bashkimi i armëve (shqiptare) me fqinjët e Ballkanit ka qenë (për ne) vetëvrasje." (Arben Puto).*

...Kështu, çështja e bashkëpunimit në baza të internacionalizmit proletar me serbët, malazezët dhe maqedonasit, për ne është një gjë shumë e vështirë, ndoshta edhe e pamundshme. Megjithatë, kur te këto popullsi të kemi hetuar disponim të mirë për bashkëpunim mbi bazat e përmendura ne nuk do të refuzojmë." (Bashkimi, janar 1981, faqe 1 shtylla 3)

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët

atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste." (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Jusuf Gërvalla: *"Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Populllor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inversion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë.* ***Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste.***

Për sa i përket strategjisë së ndjekur gjer më tash në luftë kundër socialshovinizmit jugosllav, ne kemi vlerësuar se pjesa më e madhe e grupeve dhe organizatave patriotiko-revolucionare shqiptare janë puqur në një pikë: në etapën e deritashme të luftës e të revolucionit tonë, ato i kanë dhënë armikut një grusht nga aspekti politik, duke bërë me veprimtarinë e tyre të ngritet vetëdija kombëtare e masave tona populllore. Vitet e fundit bashkë me vetëdijen kombëtare janë arritur rezultate të shënueshme edhe në ngritjen e vetëdijes klasore, që është një hap i madh cilësor drejt revolucionit. Këtë ua dimë për nder patriotëve e revolucionarëve tanë, që ditën ta përqafojnë e ta përhapin në masa literaturën revolucionare marksiste-leniniste, sidomos atë që po botohet në Tiranë dhe është bërë fener ndriçues edhe për forcat revolucionare në të gjithë botën.

Mirëpo, vlerësojmë ne gjithashtu, tani ka ardhur koha që të kalohet në një etapë tjetër të luftës: në aksione të sinkronizuara për dëmtimin e armikut edhe në pikëpamje ekonomike e luftarake. Kështu sikurse strategjia, edhe taktika e deritashme, në rast të tillë, duhet t'ia lëshoj vendin taktikës së re. Në këso kushtesh bëhet edhe më i nevojshëm bashkimi i shpejt i organizatave tona patriotiko-revolucionare, të cilat, deri më tash, megjithë strategjinë e njëjtë apo të ngjashme, kanë aplikuar taktika të ndryshme." (Bashkimi, janar 1981, faqe 2, shtylla 1)

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si* ***ideologji ruse*** *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Jusuf Gërvalla: *"Mirëpo na habit qëndrimi i pacipë i disa forcave, të cilat ndjekin rrugën revolucionare, siç janë ta zëmë disa parti marksiste-leniniste. Pa informata të sakta mbi historinë e popullit shqiptar dhe mbi gjendjen e mjeruar të shqiptarëve me banim në Jugosllavi, ato sikur duan të na e mohojnë gjithashtu të drejtën për luftë nacionalçlirimtare. Duke përdorur disa klishe prej arrivistësh të revolucionit, ata pëshpërisin: Ju duhet të veproni vetëm për ngadhënjimin e revolucionit proletar në Jugosllavi, jo ju duhet patjetër të zhvilloni një bashkëpunim internacionalist me serbët e malazezët, jo duhet të hiqni dorë nga vetëvendosja gjer në shkëputje dhe bashkimi me vendin amë, sepse vendi amë nuk e potencon kështu si ju çështjen tuaj, ju nuk keni të drejtë, e të tjera, e të tjera. Nga ana tjetër, kudo që u shfaqet rasti, ata nuk lënë pa propaganduar përkrahjen e tyre ndaj luftërave nacionalçlirimtare dhe revolucioneve."* (Bashkimi, janar 1981, faqe 2, shtylla 3)

Jusuf Gërvalla: *"Kështu do ta ruajmë edhe në të ardhmen njëri tjetrin: Shqipëria e PPSH dhe e shokut Enver Hoxha ne nga rreziku i çkombëtarizimit dhe i shfarosjes, dhe ne atë nga apetitet pansllave të Jugosllavisë; derisa të vijë edhe Nëntori i tretë - ai i bashkimit të plotë kombëtar dhe i jetës në liri e socializëm."* (Bashkimi, janar 1 981, faqe 3, shtylla 2)

4. Në revistën *Lajmëtari i lirisë*

Jusuf Gërvalla; *"Se anija jonë ka erë të mbarë, e cila do ta nxjerrë nga dallgët e stuhishme, dëshmon fakti se të gjitha organizatat patriotike shqiptare, që i janë vënë përballë deri më tash qeverisë fashiste të Beogradit, duke lëshuar përherë e më shumë rrënjë në popull, kanë pasur një drejtim dhe një platformë të vetme: çlirimin nga robëria jugosllave dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë, të tillë çfarë është ajo, me Partinë e Punës në krye. Kështu, lëvizja jonë mbi të gjitha, na del edhe largpamëse: ajo ka zgjedhur një platformë politike dhe një ideologji, e cila do të jetë ideologjia e së nesërmes së njerëzimit."* (Lajmëtari i lirisë, gusht 1980, faqe 2)

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste."* (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Jusuf Gërvalla: *"**Cila qenka platforma jonë?***

Përgjithësisht, ne përvetësojmë vijën ideopolitike të Partisë së Punës të Shqipërisë, me adaptime minimale, që implikohen aty-këtu nga gjendja jonë karakteristike. Përafërsisht këtë vijë ndoqën afro pesëdhjetë organizatat dhe grupet patriotike revolucionare të shqiptarëve të Kosovës, që armiku, fatkeqësisht, arriti t'i dëmtojë bukur shumë qe tridhjetë e pesë vjet.

Kemi njoftime se armiku ynë shekullor, qeveria e Beogradit, për të dëmtuar luftën tonë të drejtë, e cila mund të arrihet vetëm duke përfillur idenë e një revolucioni të përgjithshëm socialist, djem nga radha e shqiptarëve ushtron dhe organizon në një ushtri iluzioniste, në ushtrinë e treqind partive shqiptare, që hanë bukën e imperializmit dhe njëkohësisht ia zgjasin jetën qeverisë shoviniste të Beogradit. Lufta e emigracionit shqiptar, me rrënjë në imperializmin e kalbëzuar e me idenë e saj të përgjithshme shkatërrimin e Shqipërisë së sotme dhe të rezultateve të saj të shkëlqyera në avancimin e socializmit, jo vetëm që është luftë e huaj për ne, por ajo do të luftohet pa kompromis, sikundër që luftohet çdo fraksion armiqësor, që do të quhet dezertim nga e vetmja luftë e drejtë – revolucioni socialist." (Lajmëtari i lirisë, nr.1, gusht 1980, faqe 16)

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.*

*Mirëpo, **kurrsesi** nuk gjente fuqi për të bërë **çfarëdo kompromisi me komunistët**, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Jusuf Gërvalla: *"Si gjithmonë, edhe sot, pararoja jonë revolucionare dhe mbarë populli ynë, me sy e me zemër jemi të drejtuar nga nëna Shqipëri dhe presim çastin që fatin tonë do ta lidhë sërish me fatin e saj, si një pjesë e pandashme, për tërësinë e së cilës është derdhur gjaku i bijve martir të Shqipërisë ndër shekuj."* (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 3)

Jusuf Gërvalla: *"Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë njeriu kësulën në kokën e vetë të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike, dhe kjo ligjshmëri për të padituri shfaqet përplot pusi.*

Ideja e madhe komuniste mori krah në Gjermani, me Marksin në ballë. U avancua dhe materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini dhe të cilin e çoi përpara Stalini. Po pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, ideja e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e 'vogël'. Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, 'eurokomunizmin' fodull. Këtu u bë fener për proletarin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse siç thotë poeti, Shqipëria është një magje lirish, që formulën e lirisë nuk e mban sekret." (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 4)

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të **gjitha ideologjinë komuniste** e konsideronte si **ideologji ruse** dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Jusuf Gërvalla: *"Për fatkeqësinë e imperializmit, social-imperializmin e të social-shovinizmit, për fatkeqësinë e gjakësorit dhe të tradhtarit – bota anembanë po zien. Zien bota për fatbardhësinë e të shtypurit dhe të të shfrytëzuarit."* (Lajmëtari i lirisë, nr. 2, tetor-nëntor 1980, faqe 6)

5. Në letrën dërguar Enver Hoxhës

Jusuf Gërvalla: "*Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin se luftës sonë i duhet një*

emërues i përbashkët dhe i fuqishëm..., është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e robëruar të atdheut tonë të përbashkët.. Kështu do të përligjej dhe do të fuqizohej edhe lufta jonë e drejtë, po edhe përkrahja që do të merrnim nga PPSH. Ndihma, natyrisht nuk ka munguar as deri më tash. Literatura revolucionare dhe patriotike, që ka depërtuar në masë të madhe edhe te populli ynë këndej, ka rëndësi të madhe dhe ka ushtruar ndikim të madh. Një rol të rëndësishëm ka luajtur deri më tash sidomos Radio Tirana me emisionet e saj. Dhe një nga masat më të qëlluara për afrimin dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare, shoqërore, politike e ideologjike të popullit tonë në pjesën e robëruar të Shqipërisë, konsiderojmë ne, ka qenë ajo e 28 Nëntorit të kaluar, qëkur shqiptarët në Jugosllavi mund ta ndjekin edhe programin e Televizionit Shqiptar. Mirëpo për t'ia dalë në mënyrë sa më të denjë dhe sa më efektive qëllimit tonë të lartë, mendojmë se në mesin tonë duhet të punojë një dorë e rysur komuniste, që do të na i transmetonte drejtpërsëdrejti bazat e shëndosha të veprimtarisë së një partie komuniste marksiste-leniniste në kushtet e ilegalitetit të thellë. Nga ana jonë mund të themi se një gjë është fare e sigurt: njerëz përparimtarë nga të gjitha strukturat shoqërore te ne janë të gatshëm të punojnë pa kursyer asgjë për atdhe dhe për idetë e larta komuniste.

Pos kësaj, në mesin tonë dita ditës po nxjerr kokë një mendim i përgjithshëm: brezi ynë i sotëm e ndjen veten të thirrur ta bëjë një hap të madh përpara në luftën për liri dhe bashkim me vendin amë, në mos edhe ta realizojë përfundimisht revolucionin e pashmangshëm. Prandaj, të sigurt se kjo çështje është e denjë për kujdesin Tënd, të Partisë së Punës dhe të mbarë popullit shqiptar, ne presim që kërkesa e mbarështruar këtu për ndihmën e përmendur nga ana e PPSH-së, të hasë në mirëkuptim dhe të shqyrtohet në nivelin për të cilin do të konsideroni ju se është adekuat." (Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980; Marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 98-99)

6. Në artikuj teorik ende të pabotuar

Sabri Novosella: *"Metush Krasniqi kishte një shpirt përbashkues. Ai bënte çmos për të krijuar unitet, bile mundohej që t'i afronte edhe komunistët që kishin rënë në konflikt me politikën e Titos për shkak të Stalinit. Posaçërisht ishte shumë i kujdesshëm me të rinjtë që binin viktimë të propagandës komuniste, që vinte nga regjimi i Enver Hoxhës.*

*Mirëpo, **kurrsesi** nuk gjente fuqi për të bërë **çfarëdo kompromisi me komunistët**, të cilët ishin në shërbim të okupatorëve serbo-komunistë. Në këtë pikëpamje, Metushi ishte tejet parimor dhe i palëkundur.*

Nga komunistët stalinisto–enveristë, të keqen kryesore e shihte se ata do të ndikonin në çorientimin e djalërisë kosovare, duke e keqpërdorur autoritetin e shtetit amë. Ndaj komunistëve stalinisto–enveristë të brezit të ri ndjente dhembshuri të madhe. Këta i konsideronte thjesht viktima të regjimit komunist të Enver Hoxhës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.68-69)

Jusuf Gërvalla: "***Rruga e rezistencës më të vogël -*** *Historia e luftërave çlirimtare dhe revolucioneve ka treguar se lidhur me këtë çështje, në periudha të ndryshme kanë dalë divergjenca në lëvizjet revolucionare, **që kanë çuar edhe në përçarje të plotë dhe në tradhtinë e teorisë marksiste-leniniste, si teoria më e përsosur e revolucionit**, nga ana e revolucionarëve, që kanë qenë të prirur të ndjekin rrugën e*

rezistencës më të vogël, duke u përpjekur që pjesëzat e tërësisë t'i imponojnë si tërësi dhe qëllime të fundit. (...) Lëvizja revolucionare marksiste-leniniste synon dhe realizon krijimin e forcave të rregullta revolucionare, teorikisht të përgatitura dhe të lidhura në trajtë ingranazhi, që mund të sigurojnë vazhdimësinë e veprimtarisë revolucionare, ta përcaktojnë orientimin dhe koncentrojnë forcën goditëse të masave popullore e punonjëse, duke mos u zmbrapsur e hutuar as në kohën e vlimeve të masës e as në kohën e tërheqjes së saj para brutalitetit të armikut - t'ia bëjnë armikut varrin e vërtetë." (Luftë të dëshpëruarish apo lëvizje të ndërgjegjshme?)

7. Në letrat - raportet dërguar Sabri Novosellës

Sabri Novosella: "*E arsyeja ime, e cila në fakt ishte edhe qëndrimi i prerë i organizatës të cilës i takoja, e në veçanti i Metush Krasniqit, ishte se gjithsesi duhej krijuar një organizatë gjithëkombëtare në të cilën mund të militonin të gjithë shqiptarët atdhedashës e jo ndonjë parti Komuniste marksiste-leniniste."* (Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg, Suedi më 1997.)

Jusuf Gërvalla: *"Konkretisht në rrethinën e Shtutgartit janë nja 7 – 8 shokë të gatshëm e të përshtatshëm për punë patriotiko-revolucionare. Ata presin ndonjë orientim nga unë. Po unë duke qenë dhe vetë në mjegull për gjendjen time, nuk kam dashur t'i ngashënjej e pastaj t'i lë në gjysmë të rrugës. Prandaj u kam folur për gjëra të përgjithshme në çështje të organizimit, të propagandës dhe të agjitacionit si dhe kam bërë përpjekje për t'ua dhënë elementet e domosdoshme shkencore të historisë kombëtare dhe të lëvizjes komuniste shqiptare e ndërkombëtare. Janë punëtorë dhe ma ka marrë mendja se në radhë të parë u duhet një ngritje e tillë ideore, politike e shkencore. ...*

Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime. Demonstrata e parë, shumë e suksesshme, është bërë para ambasadës jugosllave në Bern të Zvicrës, më 11 prill, në të cilën kanë marrë pjesë edhe shqiptarë nga RFGJ. Demonstrata e dytë do të mbahet po në Zvicër, në qytetin Cyrih, më 18 prill, kurse të tretën e kemi parashikuar në Shtutgart, aty nga 26 prilli. ***Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste dhe përkrahin deri në fund kërkesat e rinisë heroike të Kosovës për republikë (që nënkupton edhe përfshirjen e tokave dhe të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi).*** *...*

Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i "Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 259-260)

8. Në revistën *Zëri i Kosovës*

Jusuf Gërvalla: "*Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi, ne – një pjesë e pararojës patriotike e*

komuniste *të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të* ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi*** *– dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 2)

Sabri Novosella: *"Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të* ***gjitha ideologjinë komuniste*** *e konsideronte si* ***ideologji ruse*** *dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars-4prill 1992)*

Jusuf Gërvalla*: "Një i burgosur politik kosovar paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexua asnjë vepër të Leninit.*

*Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti. Të burgosur politikë shqiptarë - vetëm pas ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe prillit - ka me mijëra, e të paktën janë 232 sish, të shpallur zyrtarisht, që kanë marrë dënime drakoniane. Dhe në mos të gjithë, në pjesën dërmuese po se po, në mos marksistë-leninistë të ngritur, këta të burgosur janë së paku ithtarë e dashamirës të marksizëm-leninizmit. Dhe kjo mjafton për fillimin e çdo lufte çlirimtare dhe të çdo revolucioni." (*Zëri i Kosovës, nr.2, janar 1982, faqe 10)

KOMUNISTËT RUANIN ROLIN HEGJEMON

Relacioni i LËVIZJES së JUSUF GËRVALLËS dhe ORGANIZATËS MARKSISTE LENINISTE TË KOSOVËS (OMLK) gjatë periudhës prill-tetor të vitit 1981

1. Komunistët **RUANIN** rolin hegjemon
2. Tash së fundi jam në kontakt
2. Ka një mirëkuptim midis nesh
3. Ndërprerja e daljes së Lajmëtarit të lirisë
4. Menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit
5. Bashkëpunim apo ndihmë e njëanshme për OMLK-në
6. I kam dhënë vetes të drejtë
7. Dy degë të të njëjtit trung
8. Ai ka një propozim konkret
9. Sugjerime nga instanca të rëndësishme
10. Titulli duhet ndërruar
11. Kur lindi Partia
12. Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa
13. Ndoshta pikërisht nga radhët e tyre
14. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë

15. Pse ke ardhur?
16. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?
17. As rastësisht nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur
18. Janë si buka prej një brumi
19. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste
20. Patentimi i formulës sekrete të lirisë dhe përralla e Crvenkapës

1. Komunistët RUANIN rolin hegjemon

Faridin Tafallari*: "Me organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK), që e kishte qendrën e vetë në Zvicër u vu në lidhje edhe Hysen Gegaj. Ky na tregoi se ishte takuar me përfaqësuesit e kësaj organizate. Hyseni foli shumë mire për ta. Por shtoi se për t'u bashkuar pranonin* ***vetëm me kushtin që të udhëhiqnin ata****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 28)

Vlerësimet e mëposhtme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit janë për librin "Terror-Dhimbje-Qëndresë të Faridin Tafallarit.

Hasan Mala*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

dhe

Xhafer Shatri*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...".* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Brat Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi* ***vetëquajtur*** *marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

...Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik.

...Përmes ngjyrimit ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun." . (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220*)*

Kështu pra OMLK e vetëquajtur marksiste-leniniste, me ngjyrimin e vetë ideologjik, me komunizmin e vetë të rrejshëm e ka luftuar komunizmin e vërtetë titist. Që në fillim duket qartë se cili është suksesi i OMLK-së që me komunizmin e vetë të rrejshëm e me ngjyrime, të cilit i ka dalë boja, ta RUAN rolin hegjemon në raport me Jusuf Gërvallën dhe Lëvizjen e tij.

2. Tash së fundi jam në kontakt

Jusuf Gërvalla*: "****Tash së fundi*** *jam në kontakt edhe me* ***një shok*** *të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht, për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket shumë i ngritur dhe i pjekur."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981;

Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259)

Për relacionin e Jusuf Gërvallës me Kadri Zekën kam shkruar pak në artikullin "*Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985"*. Këtu do të bazohem në çdo fjalë që e kam thënë më 1992, por situata e kërkon që ky shtjellim të zgjerohet ashtu siç e meriton. Këtë çështje tani është edhe më lehtë ta studiojmë pasi gati të gjitha letrat e Jusufit, si anëtarë i LNÇKVSHJ janë bërë publike.

Që ta kemi një tablo sa më të plotë do të kthehem pak në kohë në fillimet e njohjes së Jusufit me Kadriun, njohje e cila është bërë në kohën kur Jusufi me Ibrahim Kelmendin nuk ka kurrfarë kontakti. Letra e parë e Jusufit dërguar Sabri Novosellës më 14 prill 1981, është dokumenti i parë që Jusufi me shokë të Lëvizjes së vet flet për OMLK-në.

3. Ka një mirëkuptim midis nesh

Jusuf Gërvalla*: "**Ka një mirëkuptim midis nesh** dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërenditim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash, nëpër qendra të ndryshme evropiane, që kanë për qëllim të bëhen përpjekje e zëshme e ngjarjeve aktuale në Kosovën tonë trime."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259-260)

Këtu flet Jusufi për **mirëkuptim** me Kadri Zekën. Prej njoftimit e deri në fund të jetës, Jusufi kontaktet e veta me OMLK-së i ka vetëm përmes Kadri Zekës. Ky kontakt i Jusufit në bazë të karakterit të tij njerëzor dhe organizativ i mjafton. Se a ka pasur apo nuk ka pasur Kadriu asnjë anëtarë të organizuar jashtë, apo 300 anëtarë e 300 kandidatë kjo punë Jusufit nuk i ka interesua.



4. Ndërprerja e daljes së *Lajmëtarit të lirisë*

Kadri Rexha. *"Jusuf Gërvalla shihte në horizont bashkimin e domosdoshëm të forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, që vinte si nevojë e frontit të luftës së organizuar në kushte të reja, si nevojë e lëvizjes së masave të gjëra, si nevojë e rezistencës dhe e veprimit aktiv të popullit tonë. Prandaj duke e ndërprerë botimin e revistës (Lajmëtari i lirisë - shën. i Xh. D.) Jusuf Gërvalla në këtë drejtim po i jepte shenjat e para të bashkimit."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 199)

Se Jusufi, pas njohjes me Kadri Zekën dhe revistën "*Liria*" vendosë për ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë* është e vërtetë, dhe motivi i Jusufit është pikërisht ashtu siç e ka parashtrua Kadri Rexha.

Mehmet Hajrizi: *"Jusuf Gërvalla, pasi filloi bashkëpunimin me 'Lirinë' e pushoi botimin e 'Lajmëtarit të lirisë'. Po kështu veproi edhe Fronti i Kuq me 'Bashkimin'.*

Në revistën e tij 'Lajmëtari i lirisë', Jusuf Gërvalla shkruante: 'Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare 'Liria, organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndrimi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale, si dhe nga gjuha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndershme të autorëve të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta gjejnë e ta lexojnë me kujdes 'Lirinë'." (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, faqe 124)

Jusuf Gërvalla: *"Këto ditë na ra në dorë numri i parë i revistës ilegale kosovare 'Liria', organ i marksistë-leninistëve të Kosovës. Duke u nisur nga përmbajtja e saj, nga qëndrimi marksist-leninist në të shqyrtuar të temave të qëlluara vitale, si dhe nga gjuha e stili përkatës, shumë i pëlqyeshëm, si dhe nga entuziazmi për punën e ndershme të kësaj reviste, të gjithë lexuesve tanë u rekomandojmë ta gjejnë e ta lexojnë me kujdes 'Lirinë'.*

Po këtë porosi kemi edhe kur është fjala për revistën 'Bashkimi', organ i Frontit të Kuq, me të cilin besojmë, lexuesit tanë të ndershëm kanë pasur rastin të njihen edhe më herët." (Lajmëtari i lirisë, nr.2, tetor - nëntor 1980, faqe 14)

Shkaqet e ndërprerjes së "*Bashkimit*" të Frontit të Kuq dhe rolin e Sadik Blakajt i kam trajtuar në tërësi në shkrimin "Kështu e pata kuptuar" (www.pashtriku.org). Dalja e gazetës *Bashkimi* nuk ka qenë e mvrarur nga Fronti i Kuq por nga Jusuf Gërvalla. Jusufi e ndërprenë angazhimin në gazetën *Bashkimi* për hir të Hysen Gegës dhe jo për hir të revistës *Liria* apo të Kadri Zekës e Mehmet Hajrizit.

Sa i përket *Lajmëtarit të lirisë*, ashtu siç e kanë paraqitur shokët e Kadri Zekës e sidomos Mehmet Hajrizi nuk është. Sipas krekosjeve të disa komunistave të modës, del se përmbajtja e artikujve të "*Lirisë*" të shkruar nga komunistat e modës, me ngjyrën e ngjyrimet e modës, Jusufit ia kanë qitë vehten prej huji dhe sipas kësaj pikërisht pse Jusufit i paska dal vehtja prej huji, në atë farë gjendje depresioni vendosë me e ndërpre *Lajmëtarin e lirisë*. Numri i parë i *Lirisë* ka dal në tetor 1980, dy muaj pas numrit të *Lajmëtarit të lirisë*. Profecia e *Lajmëtarit* për daljen e *Lirisë*, pra është realizue brenda dy muajsh. Ajo çka është tepër e çuditshme në këtë mes është se si nuk doli deri më sot askush nga anëtarët apo kandidatët e flaktë të *Lirisë*, për ta akuzuar Jusufin se ua ka përvetësue emrin e ***Lirisë*** d.m.th. emrin "***Liria"*** e ka përdorë si pjesë në emërtimin e plotë "*Lajmëtari i* ***lirisë***" nga gazeta e tyre që ka dalë dy muaj më vonë. Kjo për mua është anomali dhe çështja më e pakuptueshme gjer më sot.

Siç e kam thënë në një rast tjetër, gjatë shkrimit të numrit të fundit të *Bashkimit* (dhjetor 1980), Jusufi as që e ka pasë ndërmend ndërprerjen e *Bashkimit*. Ky fakt tregon se përkundër të gjithave, përkundër krekosjeve të mëdha prej të cilave ekziston rreziku me i marrë mësysh vehtes, Jusufit nuk i ka dalë vehtja prej hujit edhe pasi i ka lexuar artikujt e modës të komunistave të modës në revistën *Liria*. Megjithatë fakti është fakt, revista *Liria* dhe serioziteti i dukur në atë kohë, që kanë ardhë prej anëtarëve të tubuar rreth *Lirisë*, ka ndikim të madh në ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë*. Këtu vlen të përsëritet se ndërprerja e *Bashkimit* është sqaruar tani tërësisht se është e një karakteri krejt tjetër. Përveç revistës *Liria*, ndikimi vendimtarë për ndërprerjen e *Lajmëtarit të lirisë* ka ardhur nga ngjarjet e Kosovës të filluara më 11 mars 1981. Ndërprerja e *Lajmëtarit* dhe koncentrimi i tërësishëm i Jusufit në botimin e *Lirisë*, si gjest i bashkimit të forcave për goditje sa më të koncentruara, është përshëndetja e përgjigja më domethënëse që Jusufi ia dërgon Kosovës.

4. Menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit

Një pasqyrë krejt tjetër false na e paraqet Sabri Novosella në shkrimin "Si e themeluam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSHJ", me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të LRSHJ – mars 1992.

Sabri Novosella*: "Në Evropë kishin marrë kontakt Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit të organizatave ekzistuese. Për këtë Jusufi vazhdimisht e njoftonte degën e LNÇKVSHJ-së në Turqi dhe Metush Krasniqin, Kryetarin e Lëvizjes në Kosovë."* (Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Jusufi i shkruan Sabri Novosellës më 14 prill 1981, se "***Tash së fundi*** *jam në kontakt edhe me një shok të grupit të Marksistë-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria".*

Kjo letra 14 prillit 1981është shumë informative ashtu siç është edhe çdo germë e Jusufit e hedhur në letër. Pika e parë kjo tregon se kontakt me shkrim Jusufi merr me Sabri Novosellën pikërisht 16 muaj pas ndarjes së tyre më 14 dhjetor 1979 në Prishtinë.

Sabri Maxhuni - Novosella*: "Ragip Hoxha ishte kryekonsull i Shqipërisë në Stamboll. Unë i prita shumë mirë. Ragipi kërkoi që të dalim dhe të bisedojnë më lirshëm. Dolëm. Ragipi më tregoi se ishte në dijeni për çdo gjë për mua, për rrugën time nëpër Shqipëri dhe porosinë që e kishte për të kontaktuar me mua. E falënderova për vizitën dhe kërkova nga Ragipi, nëse e kishte marrë adresën e Jusuf Gërvallës nga Gjermania, pasi që Ajet Haxhiu më kishte thënë "që mos të dërgoja njerëz te Jusufi, sepse Jusufi është vendosur në një vend të sigurt dhe se lidhjen me Jusufin do ta siguronte përmes lidhjeve tona."* (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, faqe 138)

Pika e dytë, kjo na tregon përafërsisht se kontakti me Kadri Zekën është vendosur ***tash së fundi*** (d.m.th. pas 11 marsit dhe si pasojë direkte e ngjarjeve në Prishtinë nga 11 marsi e më tutje dhe jo si pasojë e daljes së revistës *Lajmëtari i lirisë* apo *Liria*, siç kam menduar unë më 1992, nga shkaku se më 1992 nuk i kam pasur në dorë të gjitha faktet e Jusufit sikur më 2010).

Fjalia ime nga viti 1992

Xhafer Durmishi: *"Në tetor 1980, dy muaj pas numrit të parë të "Lajmëtarit të lirisë" filloi dalja e revistës "Liria", organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës, që pati si rrjedhim edhe njohjen e Kadri Zekës me Jusuf Gërvallën.*" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 327)

- në dritën e letrës së Jusufit del e gabuar. Unë kam menduar se Jusufi me Kadriun janë takuar shumë më heret se sa takimi e njohja e tyre në të vërtetë. Jo revistat por është 11 marsi ai që ka ndikua në njohjen e Jusufit me Kadri Zekën.

Jusufi me ndihmën e Bardhit del në skenë menjëherë qysh në janar 1980.

Letra e Jusufit e 14 prillit 1981 vërteton kohën e rivendosjes së kontaktit të Jusufit me Sabri Novosellën, pastaj kohën shumë të përafërt të vendosjes së kontaktit me Kadri Zekën. Kjo letër vërteton edhe kohën e sidomos mënyrën e vendosjes së kontaktit të Jusufit me Ibrahim Kelmendin. Ja se çka thuhet në te:

Jusuf Gërvalla*: "Në fillim të qëndrimit tim këtu,* ***më ofroi bashkëpunim*** *me gazetën "Bashkimi", organ i Frontit te Kuq Popullor, njëri nga bashkëpunëtorët e saj. Meqë gazeta edhe më parë shkonte në popull****, madje në një gjendje të keqe****, unë e pashë të udhës dhe të lejueshme dhe bashkëpunova me të në disa numra (të cilët po t'i dërgoj menjëherë – te artikujt e shkruar prej meje po e vë nga një shenjë)."*(Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 259)

Nga 8 faqet e botuara të Ditarit të Jusufit, ku përshkruhen ngjarjet e një muaji, pra nga 14 dhjetori 1979 deri më 14 janar 1980, askund nuk përmendet Ibrahim Kelmendi, çka

do të thotë se rreshtat e mëposhtëm janë falsifikime e shpikje të shokut të mirë të Sadik Blakajt:

I. Kelmendi*: (*Fjalë të atribuara Bardhoshit*):" – Mezi ia doli të arratisej vëllai, Jusufi. Isha ta ndihmoja për të hyrë ilegalisht në Austri. Ai dëshiron të të takojë sa më parë."* (Atentatet, faqe 9)

I. Kelmendi me fjalitë e mësipërme ka dashtë me thënë se është Jusufi ai që e ka kërkuar atë në radhë të parë dhe jo ai Jusufin. Kush e ka thirrur kend në telefon na del si çështje shumë më e rëndësishme siç do ta shohim në shtjellimet tjera të kësaj teme. Por ai (I. K.) thelbin e fjalisë së lartë e shkatërron dhe prapë se prapë e zbulon dhe e demanton veten duke thënë se është ai që iu ka afruar Jusufit së pari me shpresë se do të pranoj me ia redaktua gazetën.

I. Kelmendi: *" – Jusuf Gërvalla, i thonë. Tani do të më ndihmojë ta përsosë drejtshkrimin e shqipes dhe do të m'i korrigjojë shkrimet për gazetën Bashkimi.* ***Shpresoj se do të pranojë edhe ta redaktojë gazetën.*** *(*Atentatet, f.11)

Në fillim të shkurtit 1980 Jusufi i përvishet punës dhe e ndihmon revistën Bashkimi, organ i Frontit të Kuq, pa e ditur dhe pa dyshuar se Fronti i Kuq është emërtuar dhe bashkëthemeluar nga UDB-a. Pas mesit të dhjetorit 1980, për këtë çështje ai ka dyshime aq të forta dhe në mënyrë të njëanshme i ndërprenë të gjitha marrëdhëniet me I. Kelmendin.

Pa u largua nga tema, dua të them se Jusufin, përmes Bardhit ka qenë më lehtë me e gjetur sepse Jusufi me gazetën Bashkimi ka dalë në skenë menjëherë. Kadri Zeka ka qenë në Zvicër prej prillit 1978 dhe atij ka mundur t'i interesoi se çka është çështja e revistës Bashkimi dhe puna e Frontit të Kuq. Në sondazhet e tyre Hydajet Hyseni, heret e ka gjetur Ibrahim Kelmendin por jo edhe Jusufin. Arsyeja është tepër e thjesht. Ata nuk janë mërzit për Frontin e Kuq pasi kanë qenë të preokupuar me përgatitjen e Frontit të tyre të madh popullor.

Selatin Novosella: *"Duke folur për rrethanat e kohës dhe përpjekjet organizatave të ndryshme të bënin një bashkim veprues, Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "****Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën, i cili tashmë, bashkë me të vëllanë Bardhoshin, dhe të shoqen Suzanën, e kishin formuar Degën e Lëvizjes në Gjermani."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla*: "Dhe kështu, për kaq kohë sa njihemi- e nuk është pak po më* ***se dhjetë muaj****-ne të shumtën i kemi rënë kush thumbit e kush patkoit. Mendoj se kjo e ka arsyen e vet objektive. Ti ke njerëzit e tu, me të cilët, sipas mendjes sime, ke vështërsi në realizimin e kontakteve për shkak të largësisë. Kam përshtypjen se, pos kësaj, edhe me ta ke mospajtime dhe sygjerime e urdhrave të tyre s'të fle në hatër tu përmbahesh gjithmonë.* ***Unë nga ana tjetër i kam humbur të gjitha lidhjet me njerëzit e mi dhe për çdo hap që bëj kam stërngarkime, sepse nuk e di në mos bej gjësend, që nuk përputhet me luftën aktuale, që bëjnë ata në vendlindje****. Kjo është një tragjedi vetvetiu. Kurse tragjedia tjetër është se edhe unë edhe ti, në këto kushte, ndiejmë pasiguri në një pikë: kë përfaqësojmë..." (Letër I. Kelmendit, nëntor 1980;* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

Selatin Novosella:*" ...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton: "****Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën..."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Bardhosh Gërvalla: "*Herrn Nijazi Saracoglu, Mahmut Pasa Çadesi 82, TR-ISTAMBUL, Türkei*

I dashur Shoku Nijazi, dje, pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gëzuar, ***sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po presim ndonjë lajm nga shoku Bashkim Prishtina (Sabri Novosella-shën i Xh. D.)****, për të cilin ju mund ta dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllau im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t`ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prapë këndej.*
*... Me Shabanin (*Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 Munchen - shën i Xh. D.) *u njohëm para dy javësh në panairin e artizanatit, ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Ai edhe na dha adresën dhe telefonin tuaj. ... Kishte me qenë mirë sikur edhe* ***Bashkimi*** *të na shkruajë sa më parë. Në fund po iu përshëndes ju me gjithë familjen dhe dashamirët tuaj. Bardhosh Gërvalla, Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany,*
Tel. qyteti Ludwigsburg 7141/26091" (U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari si pjesë e shkrimit "Kur Jusuf Gërvalla shkruante" në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Selatin Novosella:*" ...Sabri Novosella, po në këtë numër të gazetës së cituar (Drita, Malmö, nr.10/1997-shën i Xh. D.), shton:* ***"Ne shumë shpejt vumë kontakte të rregullta me Jusuf Gërvallën..."*** (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 139)

Jusuf Gërvalla: "*Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se,* ***duke qenë krejt i vetmuar****, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Për mua do të ishte sa absurde aq edhe qesharake sikur t'i fajësoja përfaqësuesit e OMLK-së se pse nuk kanë marrë kontakt më heret me Jusufin, kur vetë si me thënë eprori i Jusufit në Organizatë, Sabri Novosella, nuk është në gjendje ta bëjë atë punë për 16 muaj të plotë. Ajo çka deshta të them është se "faji" për marrjen e kontaktit kaq të vonë me Jusufin, qoftë me Sabri Novosellën qoftë me Kadri Zekën nuk është i Jusufit.

Në dritën e këtyre fakteve, shtrembërimet në fjalinë e mëposhtme të Sabri Novosellës na dalin edhe më të qarta:

Sabri Novosella*: "Në Evropë kishin marrë kontakt Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka dhe menjëherë kishin shtruar çështjen e bashkimit të organizatave ekzistuese."*

Ta analizojmë pak këtë fjali të vetme. Në te është përdorë fjala *menjëherë.* Kjo fjala *menjëherë* në këtë rast vepron dhe krijon iluzione në dy drejtime edhe nëse qëllimi i autorit, në rastin më të mirë, ka qenë që ajo të ketë vetëm një kuptim. E vërteta është se:

-Në Evropë, Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka nuk janë takuar *menjëherë*,

-Pas takimit, Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka nuk e kanë shtruar çështjen e bashkimit të organizatave *menjëherë*.

Pas takimit me Jusufin, Kadri Zeka *menjëherë* i kërkon ndihmë Jusufit për përgatitjen e nxjerrjen e *Lirisë*, dhe Jusufi i jep *menjëherë* çdo ndihmë, ashtu siç i kishte ndihmuar Ibrahim Kelmendit gjatë vitit 1980. Dhe në këtë kohë Jusufi *menjëherë* e ndërprenë *Lajmëtarin e lirisë*. Si pasojë e ndihmës së pakursyer të Jusufit dhe bujarisë e zemërgjerësisë së tij, Kadri Zeka dhe shokët e tij nuk kanë as arsyen më të vogël me qenë të pakënaqur apo me u ngutë e me fillua ***menjëherë*** bisedime për bashkim.

5. Bashkëpunim apo ndihmë e njëanshme për OMLK-në

Hydajet Hyseni: *"Si rezultat, me propozim të Jusuf Gërvallës, u ndërpre botimi i gazetës Lajmëtari i lirisë dhe vazhdoi të dalë Liria si botim i përbashkët i OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së", i përgatitur bashkarisht dhe me një teknikë tjetër."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 290)

Puna e Jusufit në revistën *Liria* nuk mund të quhet bashkëpunim i Jusufit me Kadri Zekën e OMLK-në, pasi revista Liria nuk ka qenë projekt i përbashkët i Jusufit dhe Kadriut, por vetëm punë, projekt dhe pronë e OMLK-së dhe që Jusufi kurrë nuk ka pretendua e as ushqye vehten me ëndrra që ta ketë hisen e vetë në te. Në këtë kuptim puna e Jusufit duhet të quhet ashtu siç e ka emrin e vërtetë; **ndihmë e njëanshme për OMLK-në**.

Puna e përbashkët për organizimin e demonstratave e Jusufit dhe Kadri Zekës mund të quhet bashkëpunim i tyre, bashkëpunim i OMLK-së me LNÇKVSHJ-në, pasi demonstratat nuk janë bërë për hir të asnjërës organizatë, por hir të luftës së popullit në Kosovë.

Jusuf Gërvalla: "*Me një shok (Kadri Zekën - shën i Xh. D.) të "Lirisë" organizuam në Zvicër dhe në RFGJ katër demonstrata të punëtorëve kosovarë në botën e jashtme, dhe jemi në prag të organizimit të demonstratës së pestë. Duheshin shkrime, trakte dhe fjalime, pastaj, duhej një vrap i madh për tubimin e njerëzve. Demonstrata e parë u mbajt më 11 prill në Bern të Zvicrës, e dyta më 18 prill në Cyrih të Zvicrës, kurse e treta dhe e katërta në Shtutgart e Dyseldorf të RF Gjermane, me 25 prill, përkatësisht më 9 maj."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 261-262)

Se Jusufi nuk ka kurrfarë bashkëpunimi me I. Kelmendin në këtë kohë e në organizimin e demonstratave, është punë që është vërtetuar. Se si kanë bashkëpunuar në këtë periudhë Kadri Zeka me shokun e të mëvonshëm të organizatës Ibrahim Kelmendin është çështje që nuk më takon mua ta them.

Në letrën e 13 majit 1981, Jusufi i raporton Sabri Novosellës për Grupin e Riza Salihut e për Frontin e Kuq. Për Grupin e Marksistë-leninistëve të Kosovës ai ka konsiderata krejtësisht tjera:

Jusuf Gërvalla: *"I tillë nuk është as në shkrime as në pikëpamje të organizimit grupi i Marksistë-leninistëve të Kosovës, të bashkuar rreth organit të tyre "Liria". Përkundrazi ata, jo vetëm që luftojnë si ne për bashkimin e domosdoshëm me vendin amë, por, sa kam mundur të konkludoj nga kontaktet e mia me njeriun (Kadri Zekën - shën i Xh. D.) e tyre, janë edhe shumë të pjekur dhe organizatorë të zotët."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 265-266)

Kadri Rexha. *"Jusuf Gërvalla shihte në horizont bashkimin e domosdoshëm të forcave të organizuara patriotike dhe revolucionare, që vinte si nevojë e frontit të luftës së organizuar në kushte të reja, si nevojë e lëvizjes së masave të gjëra, si nevojë e rezistencës dhe e veprimit aktiv të popullit tonë. Prandaj duke e ndërprerë botimin e revistës (Lajmëtari i lirisë - shën i Xh. D.) Jusuf Gërvalla në këtë drejtim po i jepte shenjat e para të bashkimit. Kontributi i Jusuf Gërvallës në botimin e revistës "Liria" u shpreh në hartimin e materialeve origjinale, në përpunimin dhe redaktimin e materialeve të ndryshme, në lekturë, në daktilografimin e materialeve, në përgatitjen teknike, në përkujdesjen artistike, në botimin definitiv të revistës si dhe më në fund, në propagandimin dhe shpërndarjen e saj. Nga ky bashkëpunim i frytshëm kanë dalë në dritë nr.3 dhe nr.4-5 i revistës "Liria".* (Fati i Luleve, faqe 199)

Numri i tretë të "Lirisë", doli në maj 1981, nën mbikëqyrjen teknike të Jusufit, i cili e radhiti dhe bëri të gjithë punën grafike e teknike për nxjerrjen e numrit të tretë. Jusufi, si çdo mendimtar serioz dhe me cilësi të lartë vazhdimisht ka shkruar dhe gjithnjë ka pasur një varg artikujsh të gatshëm. Në këtë pikë ai nuk i ka thënë Kadri Zekës se këtë apo atë shkrim e kam për ty, por ia ka treguar Kadriut të gjitha shkrimet e gatshme për momentin, e në mesin e të cilave Kadriu vetë i ka zgjedhë ato që i janë dukur më të mirat. Për numrin 3 të Lirisë, Kadriu prej shkrimeve të Jusufit i ka zgjedhë:

1. Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve
2. Kosovë sa hije të ka xhamadani i trimërisë!

Jusufi gjithashtu organizoi dërgimin e këtij numri në Kosovë, duke e angazhuar për këtë punë shokun e vetë të ngushtë Haxhi Berishën nga Prapaqani, i cili ka futur me mijëra ekzemplarë të këtij numri në Kosovën e mbushur me forca të mëdha ushtarake e me atmosferën e orës policore. Për futjen e numrit të 3 të Lirisë në Kosovë ka kontribuar edhe Kadri Zeka. Për kryerjen me sukses të kësaj rruge ai e ka nisë shokun e vetë Qamil Isufin me pasaportë në xhep, kuptohet me pasaportë revizioniste dhe jo pasaportë proletare ashtu siç i këndon Vladimir Majakovski. Tmerrin dhe vuajtjet e udhëtimeve me pasaportë revizioniste vetëm një komunist i vërtet mundet me i përshkrua. Qamil Isufi shkon për ta organizuar pranimin e *Lirisë* në Kosovë.

6. I kam dhënë vetes të drejtë

Jusuf Gërvalla: *"Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai shoku (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) i " Lirisë", me të cilin kemi bashkëpunuar qe disa kohë.* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 270)

Kadri Zeka

Nga rreshtat e mësipërm duket përpikmëria e Jusufit. Ai i tregon Kadri Zekës për Novosellën, pasi ritmi i punëve dhe çështjet e bashkimit të vërtetë e kërkojnë këtë. Por ai nuk harron aspak dhe menjëherë e njofton Sabriun se e ka bërë këtë dhe për çfarë qëllimi e ka bërë. Në këtë çështje Jusufi asgjë nuk ia lenë harresës.

7. Dy degë të të njëjtit trung

Jusuf Gërvalla: *"Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasave, edhe LNÇKVSH edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung. Një patriot revolucionar, i cili prej kohësh qenka në burg (ai thotë se nuk është fjala për Ademin, por për dikë tjetër), qenka përgjegjës për ndërprerjen e kontakteve*

mes anëtarëve të vjetër të organizatës së hershme me anëtarët e krahut të ri të kësaj organizate. Kështu që, pjesa e vjetër e asaj organizate (të përbashkët) ka ndjekur një rrugë të caktuar dhe sot ka arritur deri te emri Marksistë-leninistët e Kosovës, kurse krahu i ri, duke mos marrë kontakt me kohë me anëtarët e vjetër, qenka zhvilluar në Lëvizjen e sotme Nacionalçlirimtare të Kosovës. Për këto konkludime ai merr për bazë pikërisht organin "Zëri i Kosovës", të cilin Marksistë-leninistët e paskan pasur gjithashtu organ të vetin për një kohë të gjatë(sidomos që nga viti 1974, thotë ai, paskan dalë disa numra të këtij organi). Në rast të tillë, sipas mendimit të tij, bashkimi i organizatave tona jo vetëm që nuk është i vështirë, por është puna më e natyrshme." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 270-271)

Hydajet Hyseni: "*Qysh në bisedën e parë që kishte zgjatur gjithë natën deri në mëngjes, ata jo vetëm kishin gjetur te njëri tjetri shokun e ardhshëm të kauzës e idealit, por edhe kishin konstatuar se në të vërtetë organizatat që përfaqësonin ata vepronin mbi bazë të së njëjtës platformë politike, dhe se ishin* ***degë të shkëputura të të njejtës rrënjë."*** (Për takimin e parë të Kadri Zekës me Vëllezërit Gërvalla.) ("Therror në themelet e Bashkimit", fejton në 8 vazhdime në Zëri, 21 shkurt-2 mars 2002, i ribotuar edhe në përmbledhjen e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 28)

Mehmet Hajrizi: *"... por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON "*** *(*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

8. Ai ka një propozim konkret

Jusuf Gërvalla: *"Lidhur me këtë, ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) ka një propozim konkret, të cilin ia kam aprovuar edhe unë, nëse pranon ti: të vijmë së bashku ai e unë te ti dhe ta ndriçojmë po qe e mundur këtë çështje. Fitimi, besoj, do të kish qenë i madh. Ai është një shok i mirë dhe mjaft i pjekur. Por, në qoftë se ti ngul këmbë që nuk duhet t'i hymë fare kësaj pune, atëherë ashtu edhe do të bëhet."* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

9. Sugjerime nga instanca të rëndësishme

Jusuf Gërvalla: *"Edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Po ky shoku (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) i "Lirisë", i cili lidhjet me shokët në Kosovë i mban rregullisht, tash së fundi na njofton sesi nga Kosova i paska ardhur porosia që tash e tutje të mos ngulim më këmbë në kërkesën për përfshirjen e tokave shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi brenda republikës së Kosovës, por të kufizohemi vetëm me statusin e republikës për territorin e sotëm të Krahinës Autonome të Kosovës, sepse gjoja, po të paraqitet kështu çështja, paska njëfarë mangësie për realizimin e kësaj kërkese. Ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) shton se gjoja sugjerime të tilla u paskan arritur nga instanca të rëndësishme të atdheut. Unë paraqita kundërshtimin tim kategorik. Në mos qentë tradhti e hapët, një lëshim i tillë, thashë unë, atëherë është një politikë e ligë konjukturale, të cilën vështirë se do të na e falte populli i pezmatuar, sidomos shqiptarët e viseve jashtë Krahinës, që janë në rrezik edhe nga asimilimi i madh."* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit*

1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 64)

Pse Abdullah Prapashtica është aq shumë i angazhuar në punët e brendshme të LNÇKVSHJ-së, dhe mundohet ta sqaroj **në detaje** (në të cilat therret aq keq) me pocërkën e vet, gjenezën e mbaresës 'Viseve shqiptare në Jugosllavi'.

Abdullahu është i interesuar në këtë pikë sepse po të ishte si thotë ai, rrjedhimi do të ishte: OMLK-ja është marrë vetëm me çështjen e shqiptarëve për atë territor që është quajtur Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij e kanë bërë të njëjtën gjë. Ushtruesi i profesionit të udbashit, Abdullah Prapashtica është i vetmi që me partinë e tij "komuniste" është brengos e ka luftuar për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

10. Titulli duhet ndërruar

Jusuf Gërvalla*: "Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:*

1) A e aprovon ardhjen time bashkë me atë shokun, lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon.

2) Pas "pështjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? ***Unë mendoj se titulli duhet ndërruar****.*

3) A duhet të pranojmë edhe ne, sikundër ata të "Lirisë", solucionin e republikës vetëm për territorin e sotëm të Krahinës së Kosovës?

4) A mendon se duhet edhe më tutje, pas këtyre njoftimeve, ta vazhdoj bashkëpunimin me shokun (Kadri Zekën - shën. i Xh. D.) në fjalë, apo të punoj vetëm, duke iu kushtuar kryekëput punëve të LNÇKVSH dhe të organit të saj të ardhshëm?
Të lutem t'i analizoni hollësisht këto çështje me shokë dhe të më përgjigjeni sa më parë që të jetë e mundshme." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 271)

Haxhi Berisha - gusht 1981

Jusufi përgatiti teknikisht numrin 4-5 të "Lirisë", që doli në fillim të gushtit 1981. Në këtë kohë jam vetë në Shtutgart dhe ngjarjet i di si pjesëmarrës i drejtpërdrejt. Për këtë numër prej shkrimeve të Jusufit Kadri Zeka zgjodhi artikullin

3. Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj, dhe poezinë
4. Shqipja bënë edhe pa gjëmë, i mjafton lavdia.

Edhe në këtë rast ai i dha detyrë Haxhi Berishës ta marrë përsipër futjen e këtij numri të dyfishtë në Kosovë. Kësaj radhe, prej anës së Kadri Zekës, ndihmës e shok i tij i rrugës u caktua Hasan Mala. Për ndryshim nga Qamil Isufi, Hasan Mala nuk i ndahet Haxhi Berishës gjatë tërë rrugës.

Çështja e bashkimit u aktualizua pas

pushimit të demonstratave në mërgim, aty kah fillimi i gushtit, kur numri 4-5 i “Lirisë” doli nga shtypi.

Në faqen e fundit të numrit 4-5 të "Lirisë" për herë të parë përmendet dhe botohet xhirollogaria e OMLK-së dhe vetëm e OMLK-së, me këto shënime:

Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene,
Konto 25-45475
Biel-Biene Schweiz"

Por në fund të korrikut e gjatë gushtit e shtatorit 1981, çështja e bashkimit të OMLK-së dhe LNÇKVSHJ dukej aq afër, sa Jusufi pa fijen e dilemave pajtohet me shtyp fletëpagesa të shumta të përshtatura për bankat gjermane për të dërguar të holla në këtë xhirollogari në Zvicër. Shumica e këtyre fletëpagesave shpërndahen nga Jusufi në Stuttgart dhe qytete tjera. Po në Stuttgart, redaktohet një trakt në emër të "*Lirisë*" për të ndihmuar luftën ekonomikisht dhe për këtë trakt Jusufi e mori një citat të Sami Frashërit, në të cilin në thelb, thuhej: *"Ai që nuk jep një grosh për Atdheun nuk meriton të varroset në te."*

Ndihma për Kosovën nga pjesa e rrethit të Shtutgartit - Sindelfingenit për vitin 1981 në xhirollogarinë: Hilfe für Kosova - Katharina Asal, 25-45475 Biel/Bienne, SCHWEIZ

Në formë anonime apo që Faridin Tafallari nuk ka mund t'i siguroj emrat ------		580 DM
Abdurrahman Sadiku	Dumnicë	100 DM
Avdullah Bobaj	Korishë	50 DM
Azem Berisha	Korbliq	100 DM
Halil Rexha	Korishë	100 DM
Halit Osmani	Dumnicë	50 DM
Islam Rafuna	Gjilan	50 DM
Mejdi Rexha	Korishë	200 DM
Muharrem Rexha	Korishë	100 DM
Nuhi Ibishi	Dërvar	120 DM
Nuhi Kabashi	Polac	500 DM
Nuhi Sylejmani	Llojan	120 DM
Qazim Ramadani	Smirë	100 DM
Rasim Toska	Gjilan	200 DM
Sali Hasani	Dumnicë	50 DM
Sejdullah Osmani	Qirez	100 DM
Shoqërija e Sindelfingenit		400 DM

(Shënim: Kjo listë m'u bë e njohur në janar 2012)

Për një nevojë të bashkimit flitej e bëhej shumë fjalë. Në pritje të një bashkimi u vendos që të mos dilet me “Zërin e Kosovës” si organ i LNÇKVSHJ-së.

Tek pas dështimit të plotë të bisedimeve në Stamboll, në tetor 1981, këto fletëpagesa, nga Jusufi trajtohen pak më ndryshe.

11. Kur lindi Partia

Ekziston një faktor që ka luajtur rëndësi shumë të madhe në ngritjen e temperaturës së bisedimeve apo të paktën zhurmës shurdhuese e çjerrjeve për bashkim e unitet e që nuk e kam lexua se dikush e ka përmend deri më sot. Në verë 1981 në vitin e 40 vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, doli libri me kujtime i Enver Hoxhës me

titull "Kur lindi Partia". Ky libër na erdhi në Shtutgart në gusht dhe Jusufi, unë e shokë të afërm e lexuam me vëmendje për të shikuar se çka mund të mësonim e nxirrnim prej tij lidhur me situatat organizative nëpër të cilat vet kalonim.

Krahasonim grupet, dëmin e liderëve të vjetër të infektuar me frymën e vjetër të grupeve, kush mund të jetë Koço Tashkoja, Enveri, Qemal Stafa, Vasili - Vasil Shantoja, Miladin Popoviqi e Dushan Mugosha ynë. Kush rrezikon të bëhet Anastas Lula e Sadik Premtja ynë.

Pamvarësisht diskutimit të detaleve e personazheve, ky libër e përqendroi vëmendjen tonë në diskutimin për formimin e Partisë Komuniste nga organizatat e asaj kohe, pra në mes LNÇKVSHJ dhe OMLK-së. Thelbi i këtyre ideve ishte shtruar nga Jusufi qysh në dhjetor 1980, në programin e tij të shprehur në artikullin "Bashkimi bënë fuqinë".

Në ndërkohë, përkundër ndërprerjes së *Lajmëtarit të lirisë,* e gjesteve të shumta konkrete të Jusufit në favor të bashkimit me OMLK-në, nga Kadri Zeka dhe OMLK-ja nuk kishte pasur asnjë lëvizje të vetme në këtë drejtim. Në këtë situatë Sabri Novosella i kërkon Jusufit që të filloj me përgatitjen e botimit të "Zërit të Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ. Jusufi ia fillon punës dhe pothuajse i ka të gjithë artikujt të gatshëm për numrin e parë, qysh në ditët e para të gushtit 1981. Ja se çka i shkruan ai Sabri Novosellës më 20 gusht 1981:

Jusuf Gërvalla: *"Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë,* ***Shpendi*** *(Xhafer Durmishi-shën im****) e Besniku*** *(Bardhosh Gërvalla -shën i Xh. D.) jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e* ***Shpendit****, e Besnikut dhe e* ***shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë****. Edhe* ***Shpendi*** *edhe* ***Besniku****, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne. Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës.* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451)

BARDHOSH GËRVALLA-BESNIKU

Pa u larguar nga tema, dua të shtoj se nga mesi i korrikut 1981 unë gjendem në Untergruppenbach e Ludwigsburg. Prania ime frymon e regjistrohet menjëherë në të gjitha letrat ku Jusufi diskuton çështje të Lëvizjes së tij Nacionalçlirimtare. Për praninë time në rrethin e Jusufit të shohim si nënshkruhet Nuhi Sylejmani, në vitin 2010, kur fletë për 21 janarin 1982,

rreth orës 14.00.

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Me Skënder Skënderin (Xhafer Durmishin-shën im) isha takuar **vetëm njëherë** në familjen Gërvalla**, në shtator të vitit 1981, në** prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit!" (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 88)

Kjo do të thotë se për numrin e parë të Zërit të Kosovës, të nëntorit 1981, përveç meje e Bardhit, edhe Kadri Zeka ia ka dhënë Jusufit një artikull të OMLK-së, sa për t'ia kthyer një pjesë të borxhit sidomos për artikullin e Jusufit "Tradhtarët e rinj dhe tradhtarët e vjetër" të botuar në numrin 4-5 të Lirisë. Artikulli që Kadri Zeka ia jep Jusufit në fund të korrikut është *"Planet e revizionistëve titistë për degjenerimin e rinisë sonë kanë dështuar me turp"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, f.7-8).

12. Do t'ia bëjmë edhe ne si Lech Walesa

Të vazhdojmë leximin e letrës së Jusufit të 20 gushtit 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Maqinë për të blerë nuk kemi gjetur ende, por shpresojmë se do të **na bjerë në dorë diçka e mirë.** Tani për tani duhet të marrim, për këtë numër, një maqinë të tillë me qira. Këtu praktikohet kjo gjë."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451-452)

Në mesin e shtatorit Jusufit i *bjenë në dorë diçka e mirë*. Ai e blen një maqinë për përgatitjen e "Zërit të Kosovës, të markës IBM, e quajtur me emrin e plotë "**IBM Electronic Selectric Composer".** Tani jemi në kohën kur Jusufit, përveç maqinës së IBM-it, i bjenë në dorë diçka edhe më e mirë se maqina, e kjo e mirë nuk është as më pak e as më shumë se sa dokumenti i OMLK-së me titull "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Këto *Teza të majit* janë përpiluar në maj 1981. Kur i kanë ardhur Kadri Zekës në Zvicër nuk e di. Por ajo çka është më kryesorja në këtë rast është se këto teza Jusufit i kanë ardhur në gjysmën e dytë të shtatorit 1981. Kadri Zeka ia ka dërguar me postë. Jusufi posa i ka marrë i ka rishkruar dhe radhitur mirë në maqinën e porsa blerë të IBM-it. Rishkrimi e radhitja e këtyre Tezave është e vetmja punë që është bërë për llogari të OMLK-së me maqinën e Jusufit me emrin komplet **IBM Electronic Selectric Composer.** Ky është vetëm aspekti teknik i kësaj çështje.

Në këtë kohë shumicën e ditëve të javës i kaloja në Ludwigsburg, ku banoja me Haxhi Berishën dhe Naim Haradinajn, ndërsa me Jusufin takoheshim çdo të shtune-diele. Të shtunën e parë pas ardhjes së Tezave, si kam shkue te Jusufi, në mes nesh biseda filloi në këtë mënyrë:

Jusufi: - Kam lajme shumë të mira.
Unë (Xh. D): - Pse çka ka ndodh?
Jusufi: - Do t'i bëjmë edhe ne si Lech Walesa!
Unë (Xh. D.) - E qysh si Lech Walesa?
Jusufi: - Shikoi e lexoj këto Teza që na kanë ardhur!

Jusufi m'i dha Tezat e rishkruara e radhitura nga ai, në të cilat shkruante me sa vijon:

"TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS

I

Kriza e rëndë që ka mbërthyer Jugosllavinë revizioniste, i ka sjellë masat punonjëse kudo në Jugosllavi në një gjendje shumë të vështirë. Por, veçanërisht e rëndë dhe e padurueshme është kjo gjendje në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, ku mbi masat punonjëse po ushtrohet një shtypje e shfrytëzim i egër e i shumëfishtë kolonial e kapitalist.

Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi ka luftuar në shekuj për lirinë, të cilën nuk e fitoi kurrë. Megjithë gjakun e shumtë që derdhi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ai nuk fitoi të drejtën e tij të ligjshme dhe të premtuar që të vendosë vetë për fatin e tij. Këtë të drejtë, që më parë e kishin proklamuar vetë shovinistët e rinj jugosllavë, pas përfundimit të luftës, e mbytën me gjak. Me anë të forcës e të tradhtisë, ata bënë që Kosova dhe tokat e tjera shqiptare, që fuqitë e mëdha i kishin shkëputur padrejtësisht nga shteti shqiptar, të pushtohen përsëri dhe të copëtohen në mes të Serbisë, Maqedonisë dhe Mali të ZI. Populli i robëruar shqiptar u bë objekt i një politike të egër shoviniste të shtypjes e shfrytëzimit të pamëshirshëm, objekt i dhunës dhe terrorit, shkombëtarizimit dhe gjenocidit të paparë. Çështja kombëtare e popullit tonë mbeti një problem i pazgjidhur, një plagë që kërkon shërim. Popullit shqiptar në Jugosllavi dhe sidomos atij në Maqedoni e Mal të Zi i janë mohuar e shkelur të drejtat më elementare kombëtare.

Përveç marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, gjendjen e masave punonjëse dhe të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi e rëndon edhe shfrytëzimi i egër kolonial që ushtrohet mbi të. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi janë shndërruar në koloni të vërteta të Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, në burim të tyre, thjesht të lëndëve të para dhe të krahut të lirë të punës. Mbi supet e klasës sonë punëtore dhe masave të tjera punonjëse po hidhen jo vetëm pasojat e krizës që ka mbërthyer ekonominë kosovare, por edhe ato të krizës së ekonomisë të të gjithë Jugosllavisë. Kjo ka bërë, që megjithë pasuritë e shumta që kanë Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi jo vetëm të jenë pjesa më e pazhvilluar në Jugosllavi, por që edhe prapambetja e tyre në krahasim me viset e tjera të Jugosllavisë të shtohet vazhdimisht. Kjo ka bërë që Kosova jonë e begatshme të mbetet " shtëpia e varfër e Evropës ", vendi i prapambetjes, papunësisë, kurbetit, analfabetizmit, errësirës, sëmundjeve, skamjes dhe mjerimit

I I

Populli ynë heroik ka luftuar në shekuj për lirinë dhe të drejtat e tij. Ashtu si dhe më parë, ai nuk u pajtua kurrë me zgjedhën e re të robërisë revizioniste. Luftën e pandërprerë të popullit tonë kundër zaptuesve të rinj shovinistë nuk kanë mundur ta shuajnë as gjenocidi, dhuna e terrori i egër fashist dhe as premtimet, demagogjia, feja, shthurja e degjenerimi. Krahas ngritjes së vazhdueshme të ndërgjegjes kombëtare e klasore të popullit tonë të robëruar, u rrit dhe u intensifikua edhe lufta e tij për të drejta e liri.

Lëvizja revolucionare e pranverës së këtij vitit është vazhdim i drejtpërdrejtë i luftës së pandërprerë të popullit tonë për liri, dëshmi e ngritjes së saj në një shkallë akoma më të lartë.

Grevat dhe demonstratat e mëdha të pranverës nuk kishin aspak karakter shovinist, irredentist, reaksionar e kundërrevolucionar, siç po për piqet t'i paraqesë ato propaganda jugosllave. Ato ishin pasojë e gjendjes së padurueshme, në të cilën ndodhet populli ynë, e shtypjes dhe shfrytëzimit të egër kolonial e kapitalist që ushtrohet mbi masat tona punonjëse. Me anë të këtyre demonstratave dhe grevave, populli ynë kërkoi kushte më të mira jetese, kërkoi lirinë dhe të drejtat e mohuara kombëtare e demokratike; dhe në mënyrë të veçantë kërkoi që Krahinës Autonome të Kosovës t'i jepet statusi i Republikës brenda Federatës Jugosllave. Këto kërkesa qenë paqësore; të përgjakshme ato i bënë shovinistët serbomëdhenj dhe tradhtarët shqiptarë, që urdhëruan shuarjen e tyre me armë dhe me gjak, me milici speciale, tanke dhe ushtri. Ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh në këto demonstrata popullore dhe për të gjitha dëmet që u shkaktuan.

Suksesi i demonstratave dhe grevave të këtij viti është i jashtëzakonshëm.

** U arrit një politizim, mobilizim dhe bashkim i paparë i popullit tonë.*

** U ngrit në një shkallë akoma më të lartë fryma e tij, luftarake, patriotike e klasore, u shtua edhe më shumë besimi i tij në forcat e veta të pashtershme.*

** Politika antipopullore e udhëheqjes shoviniste të Jugosllavisë u demaskua e u diskreditua edhe më shumë jo vetëm në sytë e popullit tonë, por edhe në sytë e popujve jugosllavë dhe të atyre të botës. Doli në shesh jo vetëm politika e shovinistëve serbomëdhenj për fashistizimin dhe rankoviçizimin e mëtejshëm të Jugosllavisë, por edhe plani i rrezikshëm që ata po kurdisin në bashkëpunim me socialimperialistët sovjetikë – kundër popujve të Jugosllavisë dhe të Ballkanit.*

** Çështja e Kosovës u popullarizua edhe më shumë në të gjithë botën. Lufta jonë e drejtë fitoi simpatinë dhe përkrahjen e të gjitha forcave përparimtare në të gjithë botën...*

I I I

Të tmerruar nga goditjet dërmuese që morën nga grushti i ngritur i popullit, shovinistët serbomëdhenj kanë shpërthyer tani një fushatë të tërbuar antishqiptare. Ata po përdorin të gjitha mjetet dhe metodat, me qëllim që ***të shkatërrojnë lëvizjen komuniste*** *e patriotike, që po rritet e forcohet vazhdimisht, ta nënshtrojnë popullin tonë të pamposhtur, ta mbysin luftën e tij çlirimtare, e madje edhe të na i rrëmbejnë ato pak liri e të drejta që i kemi fituar me gjak e sakrifica. Por, siç ka treguar historia jonë e lavdishme dhe siç po e tregon edhe lufta e gjithnjë në rritje që po bën populli ynë edhe në këto kushte, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtë popullin tonë të paepur, që të ndalë marshimin e tij të pandalshëm drejt lirisë e socializmit.*

** Në këto kushte,* ***para gjithë lëvizjes komuniste****, patriotike e revolucionare në Kosovë del detyrë e ngutshme bashkimi dhe organizimi më i mirë i gjithë popullit tonë dhe luftës së tij të drejtë.*

** **Organizata Marksiste – Leniniste** e Kosovës mendon se në kushtet e tanishme kjo mund të arrihet më së miri duke organizuar **FRONTIN POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**.*

I V

** Qëllimi i Frontit për Republikën e Kosovës është që Krahina e Kosovës të çlirohet nga sundimi i Serbisë dhe të fitojë statusin e republikës brenda federatës jugosllave*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës është e drejtë dhe përkrahet nga i gjithë populli shqiptar*

** Populli i Kosovës kurrë nuk ka vendosur për fatin e vet. Tokat e tij janë pushtuar me forcë, janë copëtuar dhe në kundërshtim me vullnetin e tij, i janë aneksuar Serbisë. Në mbledhjen e AVNOJ –it ku u vunë themelet e pushtetit të sotëm jugosllav, nuk u fol fare për çështjen e popullit shqiptar në Jugosllavi dhe më të nuk morri pjesë asnjë delegat shqiptar.*

** Populli shqiptar jeton në tokën e tij, ku ka jetuar brez pas brezi.*

** Populli shqiptar në Kosovë i ka të gjitha karakteristikat që përbëjnë një popull dhe një komb. Ai nuk është" pakicë kombëtare", nuk është" kombësi" dhe as "popullsi" (" narodnost"), siç e kanë cilësuar shovinistët jugosllavë. Ai përbën mbi 80 për qind të popullsisë së përgjithshme të Kosovës.*

** Për nga numri i banorëve, Krahina e Kosovës është rreth tri herë më e madhe se Mali i Zi, që ka republikën e vet.*

** Republika e Kosovës do ta bëjë të mundshëm zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik dhe kulturor të Kosovës si dhe afirmimin e mëtejshëm kombëtar të të gjithë popullit shqiptar në Jugosllavi.*

** Republika e Kosovës do të jetë fitore e madhe edhe për popullin shqiptar në Maqedoni, në "Serbinë e ngushtë" dhe në Mal të Zi, prandaj edhe përkrahet prej tij.*

** Republika e Kosovës nuk u sjell asnjë të keqe popujve jugosllavë dhe federatës së tyre; përkundrazi ajo është dhe në interes të tyre dhe e forcon Federatën jugosllave.*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës është një e drejtë që buron edhe nga Kushtetuta e Jugosllavisë, një e drejtë që e gëzojnë të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi. Dënimet që u jepen përkrahësve të kërkesës për Republikën janë të paligjshme.*

** Kërkesa për Republikën e Kosovës nuk është kërkesë për ndryshimin e kufijve në Jugosllavi e Ballkan. Ajo nuk është në kundërshtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara as me vendimin e Helsinkit dhe nuk sjell kurrfarë rreziku për paqen në Ballkan.*

V

** Për t'ia arritur këtij qëllimi, Fronti duhet të bashkojë në luftë për Republikën të gjitha masat popullore, punëtorët, fshatarët, zejtarët, rininë, gratë, inteligjencën revolucionare dhe elementë përparimtarë nga radhët e borgjezisë;* ***të gjithë komunistët****, patriotët dhe revolucionarët e vërtetë, pavarësisht nga bindjet politike e nga dallimet klasore, fetare e krahinore.*

** **Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë e sipër; jo qëllim në vete, por një levë e rëndësishme për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e masave popullore në luftë për të drejta e liri***

** **Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës marksiste leniniste të vërtetë, që do të dalë nga lëvizja komuniste në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë****.*

** Në Frontin për Republikën* ***do të bëjnë pjesë të gjitha organizatat dhe grupet ilegale komuniste****, patriotike e revolucionare, pavarësisht nëse janë ose jo për socializmin e vërtetë. Republika e Kosovës është në interes të të gjithë popullit të Kosovës, në interes të të sotmes dhe të së ardhmes së tij, prandaj në Front duhet të bëjnë pjesë të gjithë ata që janë për lirinë e Kosovës, për Republikën e saj.*

** Në Frontin për Republikën mund të bëjnë pjesë edhe shqiptarët që jetojnë jashtë Kosovës, në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, në viset e tjera të Jugosllavisë apo kudo në botë. Fronti do të luftojë për lirinë dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi.*

** Republika e Kosovës është në interes edhe të popujve joshqiptarë në Kosovë, prandaj edhe ata duhet ta përkrahin kërkesën për Republikë dhe të përfshihen në radhët e Frontit.*

** Fronti Popullor për Republikën e Kosovës nuk do të ketë asgjë të përbashkët, por do të jetë kundër LKJ-së dhe organizatave tradhtare të masave si LSPP, LRS, LS, KKASHG etj., që janë vegla të shovinizmit serbomadh. Fronti do të luftojë për demaskimin dhe izolimin e udhëheqjeve të tyre tradhtare dhe për tërheqjen në anën e tij të masave të mashtruara e të manipuluara prej tyre.*

** Në Frontin për Republikën nuk mund të bëjnë pjesë gjithashtu as grupet e organizatat fashiste e terroriste dhe agjenturat e ndryshme, që organizon reaksioni i jashtëm apo i brendshëm.*

V I

** Krahas luftës për Republikën, Fronti do të punojë edhe për organizimin e luftës në çdo ndërmarrje, fshat, shkollë e fakultet, për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, politike, ekonomike e shoqërore të klasës punëtore, fshatarësisë, rinisë, gruas, inteligjencës etj., për organizimin e rezistencës kundër plaçkitjes së pasurive të Kosovës, të luftës për mbrojtjen e kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë etj.*

** Për realizimin e qëllimeve të tij, Fronti do të përdorë të gjitha format e luftës dhe organizimit, do t'i kombinojë e zëvendësojë ato në përputhje me kërkesat e situatës dhe të strategjisë së tij.*

** Në veprimtarinë e tij, Fronti do t'i japë përparësi organizimit dhe luftës ilegale, por krahas kësaj ai do t'i shfrytëzojë gjerësisht edhe të gjitha format e mundshme legale.*

** Fronti është kundër reformizmit dhe legalizmit borgjez dhe, nga ana tjetër, lufton kundër pikëpamjeve dhe metodave anarkiste e terroriste të luftës, të cilat e dëmtojnë rëndë dhe e kompromet ojnë luftën tonë të drejtë.*

** Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për përçarjen e popullit tonë me anë të fesë, hakmarrjes, vëllavrasjes etj.*

** Fronti do të luftojë kundër përpjekjeve për armiqësimin e popullit shqiptar në Jugosllavi me Shqipërinë socialiste. Ai do t'i popullarizojë sukseset madhështore që po arrin në të gjitha fushat Shqipëria socialiste nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të shokut Enver Hoxha. Fronti do të përpiqet për zhvillimin e marrëdhënieve sa më të ngushta e të gjithanshme mes popullit shqiptar në Jugosllavi dhe atij në Shqipëri.*

** Fronti Popullor për Republikën e Kosovës do të luftojë gjithashtu edhe kundër përpjekjeve të shovinistëve serbomëdhenj për ta armiqësuar popullin shqiptar me popujt jugosllavë në Kosovë dhe në Jugosllavi. Fronti nuk i ngatërron popujt jugosllavë me krerët e tyre shovinistë. Luftën e tij ai jo vetëm që nuk e drejton kundër proletariatit dhe popujve jugosllavë, por përkundrazi, ai i konsideron ata si aleatë të tij në luftën për të drejta e liri.*

** Duke ndjekur një politikë konsekuente internacionaliste, Fronti do ta lidhë luftën e tij me luftën që bëjnë popujt dhe proletariati i të gjithë botës për liri e socializëm dhe do të luftojë kundër imperializmit me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër fashizmit dhe reaksionit të të gjitha ngjyrave.*

* * *

*Këto janë tezat kryesore që **Organizata Marksiste-Leniniste** e Kosovës i propozon si bazë për organizimin e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Gjatë diskutimit ato*

me siguri që do të plotësohen, të përsosen e kristalizohen më tej dhe mbi këtë bazë do të përcaktohet vija politike, ideologjike e organizative e Frontit.

***Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës** u bën thirrje të gjithë **komunistëve**, patriotëve e revolucionarëve të organizuar e të paorganizuar që t'i përgjigjen ashtu si duhet thirrjes së Atdheut për bashkimin e Frontit të përbashkët të luftës për të drejtat dhe lirinë tonë – për Republikën tonë.*

Forca jonë qëndron në unitetin tonë. Sa herë që populli ynë ka bashkuar armët dhe zemrat në një front të vetëm, ai ka arritur të mposhtë dhe të mbulojë me turp armiq shumë më të mëdhenj e më të armatosur. Këtë e dëshmojnë luftërat legjendare të Skënderbeut, e dëshmon lufta e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e dëshmon epopeja e lavdishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e dëshmojnë edhe grevat e demonstratat tona heroike.

*Në luftë për të drejtat tona, ne, gjatë kësaj pranvere, pavarësisht se cilës organizate i takonim, u lidhëm sup më sup dhe, si shokë e vëllezër të vërtetë, luftuam, u përleshëm e u gjakosëm me armiqtë dhe tradhtarët e urryer të popullit tonë. Tani para nesh shtrohen detyra që këtë bashkim të paparë që arritëm në luftën tonë, ta ruajmë e forcojmë më te, ta bëjmë të organizuar, të qëndrueshëm, të pathyeshëm, të përjetshëm. Bashkimi bën fuqinë. Bashkimi është imperativ i kohës. Të bashkuar e të lidhur si vëllau me vëllanë, ne jemi më të fuqishëm se të gjithë armiqtë tanë, të bashkuar ne jemi të pamposhtur. Vetëm të bashkuar si grusht i vetëm në **Frontin** Popullor për Republikën e Kosovës, ne do të arrijmë fitoren tonë, lirinë tonë.*

*Rroftë **Fronti** Popullor për Republikën e Kosovës*
***Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës" (**Teksti i *Tezave*, është marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 208-213)

Pas radhitjes, Jusufi i shumëzoj këto teza, i dërgoi një numër ekzemplarësh Kadri Zekës në Zvicër dhe vet i shpërndau në krejt rrethin e Shtutgartit. Bashkimi shikohej si një çështje dite, bisedat dukej se do të ishin vetëm formalitet me një procedurë shumë të shkurtë. Jusufi kurrë nuk do të përshkruante (radhiste) ato teza e t'i shpërndante sikur të mos pajtohej pikë për pikë me pikëpamjet e tyre.

Ibrahim Kelmendi nuk ishte i involvuar në këtë punë sa i përket pjesës së Jusufit, siç e dëshmon letra e 20 gushtit. Se në çfarë mase ka qenë i involvuar nga ana e Kadri Zekës do ta shohim më vonë.

13. Ndoshta pikërisht nga radhët e tyre

Jusufi qoftë me shtypjen e shpërndarjen e Tezave qoftë gojarisht ia shpreh Kadri Zekës përkrahjen e vet të pa rezervë për *Tezat e majit*. Tani në kohë jemi në gjysmën e dytë të shtatorit. Se sa arsye të madhe ka Jusufi të pajtohet e të jetë i kënaqur me këto Teza, duket më së miri nga artikulli i tij programatik "Bashkimi bënë fuqinë", nga dhjetori 1980, ku shkruan:

Jusuf Gërvalla: *"Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike**, pret** themelimin **e partisë sonë komuniste marksiste-leniniste** e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë **inversion** qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat **patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë**. Në këtë kontekst e shohim aktivitetin e **Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi** - një organizatë e hershme, që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për **njohje reciproke** dhe për bashkim. Në këtë kontekst jemi duke përcjellë*

gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta ***pikërisht nga radhët e tyre****, do të realizohet edhe* ***kërkesa e domosdoshme*** *për themelimin e vetë* ***partisë komuniste marksiste-leniniste****."* (Bashkimi - organ i Frontit të Kuq Populllor, nr.1, janar 1981, faqe 2, shtylla 1)

Bisedat e komunikimet e Jusufit dhe Kadri Zekës në këtë çështje mund të përmblidhen kështu:

K. Zeka: Si t'u dukën Tezat?
Jusufi: Shumë të mira, gjërat nuk mund të thuhen më qartë e më mirë.
K. Zeka: Atëherë mund të bashkohemi duke u bazuar në Tezat!
Jusufi: Patjetër, çështjen e bashkimit e shikoj më tepër teknike dhe formale.
K. Zeka: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti sa më parë!
Jusufi: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti dhe struktura organizative siç parashtrohet në Teza!
K. Zeka: Atëherë çka presim?!
Jusufi: Atëherë çka presim?!

Tezat, Jusufi i ka kuptuar në këtë formë:
- Formimi i partisë pararojë (Partisë Komuniste) e cila do ta udhëheqë Frontin,
- Në Partinë Komuniste do të hyjnë kuadrot më të formuara dhe më të dëshmuara.

Këtë lloj interpretimi e ka lënë të nënkuptohet Kadri Zeka gjatë kontakteve me Jusufin. Kadri Zeka nuk e ka bërë asnjë koment të vetëm shtesë para Jusufit, se si duhet kuptuar tezat në të vërtetë. Duke u sjellë në rreth, sa i përket kësaj çështje, Jusufi i thotë Kadriut, se unë me Tezat pajtohem por për t'u sqaruar konkretisht është shoku më kompetent i LNÇKVSHJ, Sabri Novosella, që gjendet në Turqi. Ti e ke përkrahjen time, me vete i merr Tezat që ua kam radhitur, dhe përveç kësaj si shok të rrugës që të mos mërzitesh e ta kesh krah po ta jep Bardhin.

14. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë

Kadri Rexha: *"Së pari kishte ndërprerë daljen e revistës "Lajmëtari i lirisë" dhe me të gjitha forcat e veta ishte përqendruar në botimin e revistës "Liria" dhe në organizimin e demonstratave të përbashkëta. Më në fund, po për këtë qëllim ai e kishte hedhur poshtë edhe idenë e formimit të komiteteve për Kosovën në botën e jashtme. Lidhur me disa punë që në atë kohë Jusuf Gërvalla autorizohej t'i kryente, ai vazhdimisht përmes përfaqësuesit të degës "Hasan Prishtina" i këshillonte shokët që para se të shtronin detyra përkatëse ta kishin parasysh edhe nevojën e bashkimit: "****Edhe kjo punë mund të vazhdojë po e patë ju të arsyeshme – u drejtohej shokëve të vetë Jusuf Gërvalla - por mendoj se kur merrni vendime për çështje të tilla, duhet ta mbani parasysh edhe rrethanën e nevojës së madhe të bashkimit, duke u prirë nga mendimi se me bashkim nënkuptohet bashkimi i mendimeve, i pikëpamjeve dhe i punëve të përafërta a identike të dy a më shumë organizatave. Atje ku duket se ka pasur pasivitet ose harresë nga unë, atje kryesisht ka qenë vendimtar ky parim dhe më pak harresa ose pasivizimi****."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 202)

Kadri Rexha: *"Në këtë takim, të mbajtur në tetor të vitit 1981, pala e MLK-së, e përfaqësuar nga Kadri Zeka, çështjen e bashkimit e sheh në dritën e formimit të një*

partie komuniste marksiste-leniniste, radhët e të cilës do të përbëheshin nga anëtarët e organizatës MLK dhe ***nga ndonjë komunist i verifikuar nga radhët e organizatës LNÇKVSHJ****. Sipas kësaj pale kjo parti duhej të konsiderohej si pararojë dhe udhëheqëse, ndërsa organizata LNÇKVSHJ konsiderohej si front i gjer i luftës. Qëndrimin e mësipërm pala e LNÇKVSHJ e përfaqësuar nga Sabri Novosella, nuk e pranoi, meqë bashkimin e kishte parë në dritën e barabarësisë së plotë të grumbullimit të forcave patriotike në frontin e luftës për liri kombëtare, në radhë të parë. Kështu edhe bisedimet e para lidhur me çështjen e bashkimit të këtyre organizatave përfunduan me mossukses."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 202-203)

Ibrahim Kelmendi*: "I dashur shoku Mërgim (Sabri Novosella - shën. im),*

"...Gjatë takimeve që kishim, disa herë u sjellën bisedimet te bisedat në mes teje e shokut Zeqë (Kadri Zekës - shën im). Lidhur me atë takim, mendoj, duhet të na informosh, pak më shumë se sa i ke shkruar "heroit"(Jusuf Gërvallës shën im). Them kështu pasi disa fjalë shpëtuan gjatë fjalosjes mes teje e shokut Ujkan, prandaj, pos arsyerave tjera, edhe që të mos lejohet mundësia për manipulim me fjalët që nuk janë inçizuar as mbajtur shënime. Sidomos do ndihmonte shumë informimi yt, pasi, me gjasë, ***vetëm ti je ndër të gjallët, që mund të informosh mbi bisedimet, ashtu siç janë zhvilluar****."*(Letër Sabri Novosellës, 17 janar 1984)

15. Pse ke ardhur?

Rreth 12 tetorit 1981 Kadriu dhe Bardhoshi udhëtojnë me aeroplan në Stamboll për çështje të "bashkimit" - bishtëzimit. Dëshmitari i gjallë i këtyre takimeve Sabri Novosella ka shtrembëruar çdo fjalë sa i përket këtij takimi.

Sabriu vazhdon: "*Unë dhe Bardhoshi dolëm me qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim: Të bashkohemi në një organizatë të vetme e cila mund të quhej Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi*". *(Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)*

Sabri Novosella: *"Me atë rast, unë dhe Bardhoshi i shtruam qëndrimet e organizatës të cilës i takonim, ndërsa Kadri Zeka qëndrimet e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës. Gjatë kësaj bisede procesverbalin e mbajti Bardhoshi, andaj të gjitha këto që po i them unë tashti janë të shënuara në shkrimin e tij. LNÇ e Kosovës doli me qëndrimin që të gjitha organizatat ekzistuese politike në Kosovë dhe jashtë të bashkoheshin në kuadër të një Lëvizje të vetme, me një Program, një Statut dhe një Platformë sipas të cilës mendonim se si fazë të parë, duhej luftuar për një Republikë Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë. Kurse OMLK-ja i kishte edhe tezat e shkruara (e rishkruara nga Jusufi - shën im) dhe angazhohej për një front, i cili do t'i bashkonte të gjitha grupet dhe organizatat, kurse në ballë të kësaj Lëvizjeje, apo fronti, të vihej pikërisht Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës e cila duhet ngritur në Partinë Marksiste-Leniniste të Kosovës. Ne nuk pranuam një gjë të tillë me arsyetimet tona dhe bindjen tonë se ishim të detyruar që të gëzonim përkrahjen edhe të shteteve tjera e në veçanti të shteteve tradicionalisht mike të kombit shqiptar si Gjermania, Austria, Hungaria, Turqia etj."* (Intervistë në Zëri e ribotuar në Drita, Trelleborg-Suedi, nr. 10/1997)

Sabri Maxhuni - Novosella: " *Me shpresë se do të arrihej bashkimi i organizatave në një Lëvizje Kombëtare, ku do të bashkohen veprimtarët, pavarësisht nga përcaktimet e tyre politike, isha përgatitur t'i prisja përfaqësuesit e OMLK-së. Në Aeroportin e Stambollit dola për t'i pritur së bashku me Sabri Kosovën, duke besuar se do të vinte edhe Jusuf Gërvalla, por Jusufi nuk pati mundësi të vinte për shkak të dokumenteve të udhëtimit ende të parregulluara. Ishte vendosur të vinte Bardhosh Gërvalla. Në aeroport arritën Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. U habita kur e pashë vetëm Kadri*

Zekën si përfaqësues të OMLK-së. Bardhoshi më tha se Kadriu kërkon që shoku që më shoqëronte të mos merrte pjesë në bisedime. Edhe përkundër dëshirës, e pranova propozimin.

U vendosëm në një hotel të Stambollit dhe pas një pushimi disaorësh i filluan bisedimet, unë dhe Bardhoshi, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së dhe Kadri Zeka, si përfaqësues i OMLK-së. Unë dhe Bardhoshi dolëm me propozim që të bashkohemi në një Lëvizje Kombëtare, pavarësisht përcaktimeve politike duke u mbështetur në qëllimin kryesor, çlirimin dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare dhe bashkimin me shtetin shqiptar, respektivisht krijimin e shtetit shqiptar brenda kufijve të vet kombëtarë. Kadri Zeka i kishte sjellë "Tezat për krijimin e frontit popullor të Kosovës". Unë dhe Bardhoshi i lexuam ato teza me vëmendje të posaçme. Tezat ishin të qarta: kërkohej bashkimi i të gjitha organizatave dhe grupeve politike në një front, i cili do të udhëhiqej nga Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës, e cila duhej të ngrihej në Parti Marksiste-Leniniste të Kosovës. Në të vërtetë, kjo ishte kopje identike e ndërtimit të piramidës shtetërore në Shqipërinë komuniste. Dhe, tragjedia qëndron pikërisht këtu: këtë ndërtim piramidal dëshironin ta bartnin në organizimin e emigracionit shqiptar në Perëndim!?

Gjatë tri ditëve u debatua me orë të tëra. Unë dhe Bardhoshi sillnim argumente se duhej një Lëvizje Kombëtare që do ta gëzonte përkrahjen e shteteve evropiane dhe të botës perëndimore në përgjithësi dhe të shteteve ku vepronin, siç ishin Turqia, Gjermania, Zvicra. Kadriu pohonte se si fitorja e proletariatit ndërkombëtar është e pa-evitueshme dhe se, sipas tij, e vetmja ideologji e drejtë është ideologjia marksiste-leniniste. Vetëm komunistët janë të denjë për ta udhëhequr luftën për çlirimin e Kosovës.

Kadriu propozoi që Metushi të jetë kryetar i Frontit Popullor të Kosovës, por gjithsesi komunistët duhet ta kenë Partinë Komuniste të Kosovës." (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, faqe 154-156)

Jusufi nuk ka përgatitur asgjë me shkrim për bisedimet e Stambollit të tetorit 1981, as Bardhoshit nuk i ka thënë asnjë fjalë për ndonjëfarë Lëvizje për Republikë apo Kombëtare. Jusufi është pajtuar me germën dhe me frymën e Tezave rreth Frontit për Republikë, ashtu si ai i ka lexuar ato dhe si ua ka përcjellë vetë të tjerëve. Në Stamboll, gjatë bisedimeve Kadriu jep sqarimin e vetë konkret e lakuriq se si duhet lexuar tezat:

- Jo parti pararojë (Jo Parti Komuniste Marksiste-Leniniste) e përbërë nga anëtarë të organizatave të tjera, por vetëm nga radhët e OMLK-së,
- vetëm anëtarët e OMLK-së janë marksistë, komunistë të formuar,
- në organizatat tjera të tillë nuk ka, prandaj të tjerët - në Front për Republikë, nën udhëheqjen e OMLK-së.

Bardhoshi u kthye nga Stambolli me sa më kujtohet të premten në mbrëmje më 16 tetor 1981. Në këtë datë bazohem në faktin se Panairi i librit i Frankfurtit, në vitin 1981 është mbajtur prej 14 (e mërkure) deri më 19 (e hënë) tetor 1981. Me Jusufin dhe shumë shokë të Shtutgartit ishim organizuar të shkonim në Panair. Por, Panairi në ditët e para (e mërkurë, e enjte dhe e premte) është i rezervuar vetëm për konferenca e tubime për ata që kanë ftesa e rezervime për ligjërata të ndryshme, ndërsa të shtunën dhe dielën është i hapur për të gjithë. Kështu, saktësisht në ditën e parë të hapjes së Panairit të librit në Frankfurt, për publikun e gjerë, dhe pikërisht, në kerr, në autostradë, gjatë rrugës për në Frankfurt, Bardhi na e shpjegoi mua e Jusufit rrjedhën e bisedimeve në Stamboll, ndeshjen e cakërrimet frontale rreth Frontit, në mes Kadri Zekës dhe Sabri Novosellës. Jusufi rrjedhën e këtyre bisedime e kishte dëgjuar qysh të premten në mbrëmje, por kishte dëshirë që Bardhi ta përsërit tregimin e tij edhe në praninë time e për mua.

Bardhoshi tregoi se bisedimet në mes Sabri Novosellës e Kadri Zekës sa i përket

bashkimit ishin të shkurta, dhe u ndërprenë shumë shpejt pasi Kadri Zeka tha se nuk ka ardhë të bisedoj për bashkim.
Thelbin e bisedimeve ai e tregoi me këto fjalë:

S. Novosella: Mund të fillojmë bisedimet për çka jemi mbledhur, bisedimet për bashkimin e organizatave në një të vetme?
Kadri Zeka: Ne jemi për krijimin e një Fronti në bazë të këtyre tezave, i cili do të udhëhiqet nga OMLK!
S. Novosella: Ne kemi menduar se do të vish për çështjen e bashkimit të organizatave. Është çështja e këtyre bisedimeve për shkak të të cilave ne e kemi pezulluar nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" qe disa muaj!
K. Zeka: Unë nuk kam autorizim me bisedua për bashkimin më shumë se ajo që thash, e që është në teza!
S. Novosella: Atëherë pse ke ardhur?
K. Zeka: Që të shihemi!
S. Novosella: Sa për t'u parë, mua më shumë më ka marrë malli për familjen time që nuk i kam pa qe dy vjet.
K. Zeka: Jusufi nuk pajtohet me ty, ai është krejtësisht në pozitat e Tezave tona. Këto teza që po i sheh në tavolinë janë të radhitura e rishkruara nga Jusufi.
S. Novosella: Jusufi pajtohet me mua dhe jo me ty.
K. Zeka: Ty ka me të dalë punë me Jusufin!
S. Novosella: Jo mua po ty ka me të dalë punë me Jusufin kurrë ta merr vesh thelbin e interpretimit të këtyre tezave që nuk ke guxua me ia bërë atje, por ke ardhë tek unë.
K. Zeka: Çka jeni kaq aq shumë pas atij njeriu?
S. Novosella: Është punë për ne për kend kapemi. A jam duke të pyetur unë ty se pse je kap aq shumë pas këtij apo atij njeriu?!

Bardhi tregon se gjatë kthimit, Kadriu ishte si një tjetër njëri. Atij dhe shokëve të tij më të ngushtë iu kishte ra sharra në gozhdë tepër keq. LNÇKVSHJ-a u kishte dalë kafshatë që nuk kapërdihet aq lehtë. Për dallim nga Kadri Zeka, Bardhi nuk e ka ndier vehten për asnjë moment keq nga kjo rrugë, edhe "*pse Sabri Novosella sillet shumë keq jo vetëm ndaj Kadri Zekës por edhe shokut të Organizatës së vetë Bardhoshit."*

Duhet të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut!

Në vend të përshëndetjes mirëseardhëse Sabri Novosella duhet të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut: "*Nuk pranoj të bisedoj me një komunist si ju të OMLK-së!"*

I. Kelmendi*: "Kur shkuan në Turqi Kadri Zeka e Bardh Gërvalla për t'u takuar me Sabitin, në tetorin e vitit të kaluar, në vend të përshëndetjes mirëseardhëse, Sabiti* ***duhet*** *të ketë thirrur me histerizëm në drejtim të Kadriut: "Nuk pranoj të bisedoj me një komunist si ju të OMLK–së!"* (Atentatet, f. 387)

Sipas skenarit të figurës frontale të Frontit të UDB-së, Sabri Novosella është **dashtë** t'i drejtohet me histerizëm Kadriut, por kështu nuk ka ndodhë. Kurrë nuk ma ka marrë mendja se debati apo falsifikimi i ngjarjeve të bëhet e të bjerë deri në këtë nivel sa primitiv aq edhe qesharak.

Sipas kësaj logjike (jo perverse) rrjedh se gjuhë të përbashkët, mirëkuptim e biseda të këndshme pune me komunistin Kadri Zeka, ka mundë të bëjë vetëm armiku i diktaturës komuniste dhe i sistemit komunist, I. Kelmendi.

Kur e paska marrë vesh Sabri Novosella se Kadri Zeka është anëtarë i OMLK-së, e komunist? Sipas kësaj del se ai këtë nuk e paska ditë derisa u takua me Kadriun në Stamboll, se Jusufi nuk e paska informuar Sabriun se Kadriu po vjen tek ti, si komunist e si anëtarë i OMLK-së.

Prapë se prapë unë e kuptoj se për çështje ideore e ideologjike nuk është punë e lehtë të merresh me Sabri Novosellën për shkak të stabilitetit të palëkundur në këtë drejtim dhe njohurive të tij të thella. Por është një aspekt tjetër shumë më konkret që e bënë Sabri Novosellën ndër personat më të përsosur dhe ai është aspekti ekonomik, tregtar. Po të kishte pas asi parimi Sabriu, që të mos flas me komunist, atëherë ai kurrë nuk kishte me e lejua atë (Kadriun) të tregohet aq i pakujdesshëm me të hollat e fituara nga puna e tij, kurrë nuk kishte me e lejua të harxhohej kot deri në Stamboll, ta bënte gjithë atë troshak kot së koti. Sabriu qysh atëherë ka qenë i kujdesshëm të mos e harxhoj askënd, as t'i lodhë të tjerët që fjalët e tij t'i mbledhin si trohët e bukës në sofër. Kujdesi për trohët e bukës në sofër, për mos me ba troha kot së koti, i Sabri Novosellës është i patejkalueshëm.

Thelbi i prishjes së Sabriut me Kadri Zekën në Stamboll qëndron në faktin se Kadri Zeka e ka fyer Sabriun duke i thënë se ai (Sabriu) nuk është komunist i modës sikurse që janë ai vetë (Kadri Zeka), Mehmet Hajrizi e Brat Berat Luzha. A ka fyerje më e rëndë e ulje e reputacionit se sa ta akuzosh një rrobaqepës të klasit të parë se nuk din çka është moda, se nuk është në gjendje ta përcjellë modën.

Saime Isufi*: "Më 18 tetor të vitit 1981, u nisa përsëri për në Zvicër. Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe* ***pastaj kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi****, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën. Në banesën e tij na priti Hasan Malaj, mua dhe Berat Luzhën. Me Hasanin, që atë natë udhëtuam diku në Gjermani për të marrë Kadriun. U takuam me Kadriun. Dukej shumë i lodhur, i rraskapitur, por edhe i dëshpëruar nga takimi që kishte pasur me Sabri Novosellën.*

Ai nuk i kishte përfillur, bile i kishte fyer e poshtëruar atë dhe Bardhosh Gërvallën." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f .98)

Kjo informatë është shumë domethënëse. Kadri Zeka, pas kthimit me Bardhin nga Stambolli, nuk shkon në Zvicër, po drejtë e në Gjermani tek Ibrahim Kelmendi.

Ismail Kadare*: "Në mbarim të vitit 1981 në panairin ndërkombëtar të librit në Frankfurt të Gjermanisë Perëndimore, pata rastin të takoj për herë të parë e të fundit shkrimtarin, gazetarin dhe personalitetin e shquar të Kosovës, Jusuf Gërvallën. Erdhi te stenda e librit shqiptar së bashku me të vëllanë një ditë shiu, pa rënë fare në sy, midis dhjetëra vizitorëve. Trupmesatar, gjysmëbiond ai kishte në tërë qenien e tij atë lloj thjeshtësie dhe paraqitjeje të zakonshme, pas të cilës ndihet menjëherë thellësia dhe e pazakonshmja.*

Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht." (Jusuf Gërvalla, Rrotull, Tiranë 1983, faqe 3)

16. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?

Mund të thuhet se shkaku i ndaljes së Kadri Zekës në Gjermani është Panairi i librit në

Frankfurt. Por kjo nuk është krejt e vërteta. Ai (Kadriu) ndalet dhe shkon në Gjermani, që Ibrahim Kelmendin dhe Frontin e tij të Kuq t'ia bashkoj OMLK-së e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Pra atë punë që nuk ka mund ta kryej e ta bëjë me Sabri Novosellën ta kryej me Ibrahim Kelmendin.

Saime Isufi: "*Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt* ***dhe pastaj kishte udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi****, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën."*

Hasan Mala: ***"Kur është kthye Kadriu prej mbledhjes (në Stamboll - shën i Xh. D.) që kanë pas****, unë kam qenë në panairin e librit në Frankfurt. Ishte edhe Ismail Kadareja, ishte edhe Isufi aty. Pak a shumë u njifshim me Isufin, por jo sa duhet. Kisha një respekt ndaj tij, ishte njeri i afërt. Vjen Kadriu aq i lodhur e aq i mërzitur sa nuk mundet me u marrë me mend, dhe më kapi për krahu e u ulëm rreth një tavoline.*

- Çka u bë puna si kaluat atje?

- Kurrqysh hiq nuk kemi kalue!

- Si?

- Nuk kemi mund të bëjmë asgjë, por frikohem se është prishë puna edhe më shumë.

- Po Bardhi si mendon?

- Bardhi nuk mendon keq, Bardhi, por megjithatë, kur ishte ndikimi i tij (Sabri Novosellës - shën im), para tij nuk e thoshte ndoshta edhe atë çka e mendonte, se Sabriu kishte më kompetencë. Por Isufi më la përshtypje të mirë, - se i ka folë Isufit aty.

Isufi i ka thënë se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Isufi e ka pritë me rezervë, domethënë pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë." (Marrë nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1992)

Dita e parë e Panairit të librit në Frankfurt, 14 tetor 1981

Në Panairin e librit në Frankfurt, të shtunën me 17 tetor, një ditë pas kthimit nga Stambolli, Jusufi ka rastin të takohet vetë me Kadri Zekën. Është shumë interesant thelbi i bisedës së tyre në Frankfurt, për të parë se "kujt i del punë me Jusufin e kujt jo?"

Kadriu e din se Jusufi është informuar shumë saktësisht nga Bardhi se si kanë shkuar bisedimet në Stamboll dhe për atë çështje ai nuk lodhet me i përsëritë gjërat, dhe se pikërisht misioni i Bardhit në këtë rrugë ka qenë mision i dëshmitarit, që ky Besnik në aq mënyrë besnike i përshkruan. As Jusufi nuk humbë kohë me Kadriun për ta pyetur shumë se a janë të vërteta fjalët e Bardhit. Jusufi, sa është i qartësuar dhe i kënaqur për qartësimin e shumë gjërave është edhe aq i revoltuar për shkakun se si është e mundur që Kadri Zeka, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Berat Luzha t'ia japin vetes të drejtën për të vendosur, për ta etiketuar e klasifikuar Jusufin si individ, dhe si anëtarë i një Organizate, pra të vendosin ata dhe askush tjetër, as më shumë e as më pak se: a është Jusufi komunist apo nuk është?! Dhe jo vetëm kaq, por është shumë i revoltuar se si këta komunistë të paepur gjer në fund i kanë kërkuar ndihmë Jusufit (edhe pse jokomunist) për t'ua përgatitur 3 numra të *Lirisë* dhe për t'ua dërguar në Kosovë në ditët më kritike, dhe në të njëjtën kohë luftojnë me çdo kusht ta mbajnë në distancë të sigurt duke e etiketuar si jokomunist.

Thelbi i bisedës së Jusufit me Kadriun më 17 tetor 1981 në Frankfurt, të cilën Jusufi ma transmeton menjëherë pas mbarimit të saj është:

Jusufi: Bardhi më tregoi se ti dhe shokët e tu e konsideroni LNÇKVSHJ-në si organizatë jokomuniste?

Kadriu: Është e vërtetë se LNÇKVSHJ nuk është Organizatë komuniste.

Jusufi: Se në LNÇKVSHJ ka mjaftë individë që nuk janë komunist, qoftë për shkak të bindjeve të formuara me kohë, qoftë për shkak se ende nuk kanë arritur të krijojnë botëkuptimet e tyre, këtë e pranoj.

Kadriu: Nuk është fjala për individ, cili është e cili nuk është komunist, cili mund të jetë e cili mund të mos jetë komunist. Në LNÇKVSHJ asnjë anëtarë i vetëm nuk është komunist.

Jusufi: Këto fjalë i thua ti duke më përfshi edhe mua. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?

Kadriu: Edhe për ty.

Jusufi: Ta zëmë se nuk qenkam komunist në ditën e sotme. A mendon ti dhe shokët e tu se unë si individ kam gjasa që të bëhem komunist dhe të meritoj të quhem komunist ndonjëherë në të ardhmen?

Kadriu: Pa u lodhur se si do të jetë e ardhmja dua të them atë që është kryesorja tani, se ti nuk je komunist!

Jusufi: A mendon ti sipas kritereve tuaja, se të gjithë anëtarët e OMLK-së me të vërtetë janë komunist të formuar.

Kadriu: Çdo anëtarë i OMLK-së është komunistë i formuar.

Jusufi: Tani i kuptoj plotësisht Tezat e juaja dhe seriozitetin që meritojnë ato. Edhe pse njihemi personalisht që nga marsi, njohja në këto 3-4 ditët e fundit është shumë cilësore.

Kadriu: Duke e parë relacionin tonë të deritanishëm në dritën e fakteve të reja konkrete që dolën nga rruga në Stamboll, a je i hidhëruar në mua dhe komunistët tanë që të jemi sjellë ndaj teje në atë mënyrë që ta do ta jepte të drejtën edhe ta quash shfrytëzim?

Jusufi: Unë kam qenë tepër i vetëdijshëm se çka kam bërë dhe për këtë nuk pendohem por jam krenar me punën time, andaj në këtë pikë nuk ka pse me iu vra ndërgjegjja. Në politikë e në luftë, kush i shërben kujt, kush është pjesë e një plani më të përgjithshëm, kush është pjesëza e kush është e tëra, kush e shfrytëzon kend, kush del më i paepur deri në fund, se a do jem unë një figurë episodike në Frontin tuaj të madh, apo do të

jeni ju figura episodike e të modës në Lëvizjen time, në planin e idealin tim të përjetshëm nuk dihet kurrë deri në finale, deri në fund.

Kadriu: Duke e parë relacionin tonë në dritën e fakteve të reja a ke aq durim sa të pranosh të kesh kontakte me mua edhe në vazhdim dhe a ma çelë derën nëse ta mësyj?

Jusufi: "*Rrudhat mbi ballin tim, për mikun e vendlindjes, për aq sa kam pasur indikacione 34 vjet të jetës sime, kanë shprehur qartë pamundësinë për të fshehur ndjenjën e fuqishme të brengës për fatin e atdheut të robëruar; ato kanë treguar se janë* ***dyer kurdoherë të hapura*** *kah shpirti, për të gjithë ata që kanë halle të ngjashme*."

Kadriu: Ne jemi bashkuar me Frontin e Kuq, pra me Ibrahim Kelmendin. Nuk kishte pas aq anëtarë, bile me të thënë të drejtën nuk ka pse të mbetet merak pse ti nuk je bashkuar me ta para nesh!

Jusufi: Ia pafsh hajrin! Ditën e mirë!

Kadriu: Ditën e mirë!

Jusuf Gërvalla*: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj* ***(e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z****. [Kadri Zekën në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë,* ***as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

Të shtunën më mbrëmje unë kthehem në Shtutgart, ndërsa Jusufi qëndron në Frankfurt natën e së shtunës dhe të dielën.

Ismail Kadare*: "Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht."* (Jusuf Gërvalla, Rrotull, Tiranë 1983, faqe 3)

Në momentin e parë që më ra të takohem me Jusufin pas kthimit nga Frankfurti, u ngjitëm në katin e tretë ku ishte studioja e punës. Në tavolinën e tij të madhe dhe në fiokat e saj gjendeshin më shumë se 100 kopje të *Tezave* që i kishte radhitur, e të cilat nuk kishte arritë me i shpërnda dhe një tubë fletëpagesash për xhirollogarinë *„Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene, Konto 25-45475, Biel-Biene Schweiz".* Ai i ndau 5-6 ekzemplarë të *Tezave* që t'i ruaj në arkivin e tij dhe kopjet tjera të Tezave së bashku me fletëpagesat, në praninë time i hodhi në shportën e mbeturinave. Me këtë veprim Jusufi ka dashtë të tregoj se Kështjella e Lëvizjes së tij është Kështjellë e lirë dhe e pamvarur në pikëpamje ideore, se në shtëpinë e tij askush pos tij nuk mund ta RUAJ rolin hegjemon, se Kështjella e tij është e lirë edhe në pikëpamje ekonomike pasi nuk ka kurrfarë obligimi t'i paguaj haraç ndokujt. Në të njëjtën kohë Jusufi kurrë nuk është përzier në punët e brendshme të të tjerëve e në shtëpitë e të tjerëve.

Kjo është e vërteta e trajtimit të Tezave të OMLK-së, nga ana e Jusufit, **para** takimit të Stambollit në mes Kadri Zekës e Sabri Novosellës, takim i cili u bë në pranin e dëshmitarit besnik Bardhosh Gërvalla. Kjo është e vërteta e trajtimit të këtyre Tezave, nga ana e Jusufit, **pas** takimit të Stambollit dhe jo vetëm kaq, por edhe **pas takimit** të Jusufit me Kadri Zekën, në Panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

17. As rastësisht nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON****."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Jusuf Gërvalla*: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.*

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z. [në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, ***as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të ÇORODITUR****, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka - shën im)*

Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por ***MEGALOMANINË*** *e arrivistëve të revolucionit,* ***ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët*** *dhe tendencën për* ***DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

18. Janë si buka prej një brumi

Faktin se Lëvizja e Jusufit është quajtur Lëvizje Nacionalçlirimtare, Sabri Novosella është munduar ta shfrytëzoj në maksimum për ta paraqitur këtë Lëvizje si organizatë që nuk ka të bëjë asgjë me idetë komuniste.

Sabri Novosella*: "Porsi shteti amë, prapëseprapë njëra nga këto organizata bënte njëfarë dallimi. Kjo ishte LNÇKVSHJ, e cila udhëhiqej nga Metush Krasniqi, i cili ishte demokrat i vërtetë dhe mbi të gjitha ideologjinë komuniste e konsideronte si ideologji ruse dhe si të tillë edhe antishqiptare, ashtu siç i konsideronte antishqiptarë sllavogrekobizantinët në përgjithësi." (Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)*

Kjo është taktika tepër e tejdukshme pas shembjes së 'komunizmit' dhe falimentimit të tij.

Faktin se Lëvizja e Jusufit është quajtur Lëvizje Nacionalçlirimtare e pamë se si është shfrytëzuar maksimalisht dhe në mënyrë tejet të vendosur apo edhe të paepur gjer në fund, për ta parkuar atë në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës dhe mbajtur në distancë të sigurt nga OMLK-ja, së bashku me elementët e dyshimtë, me krijesat e me Frontet e UDB-së, me arsyetimin se Lëvizja e Jusufit nuk është komuniste, se komunistët janë të ndërtuar prej një brumi të veçantë, se Jusuf Gërvalla nuk është prej brumit me të cilin është gatuar Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e brat Berat Luzha. Pas falimentimit të *komunizmit të Mehmet Hajrizit dhe të shokëve të tij,* rishkrimi e falsifikimi i historisë nga këta të fundit bëhet me po aq taktika qesharake e të tejdukshme, krejtësisht identike me ato të Sabri Novosellës, sa me të vërtetë të hyn dyshimi se jo vetëm që janë të një brumi por mos janë edhe bineq të një nane, të larë e të shpërlarë në të njëjtën koritë. Ja se si tingëllojnë ato në ditët e sotme:

Mehmet Hajrizi*: "Kjo Lëvizje (**L**ëvizje me **'L'** të madhe si në **Lëvizjen e Jusufit**, ndërsa OMLK-ja si rezultat i Luftës së Yjeve as që përmendet - shën ynë), ndonëse në dukje e fragmentuar në kohë dhe hapësirë, ka njësinë e saj e lidhjet organike (nga i njëjti brum-shën ynë), prandaj duhet trajtuar e pandarë, pavarësisht fazave të zhvillimit dhe formave të veprimit nëpër këto faza. Aq më pak, ato mund t'i kundërvihen njëra tjetrës, siç provohet ndonjëherë për interesa meskine."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 31)

Sabri Novosella*: "Dalja e shokut Xh. (Xhafer Shatri-shën im) e shkuarja tek shokët që para shumë vitesh i ka organizuar vet është bërë shumë mirë, bile më mirë se sa të kishte ardhë tek ju, pasi në atë organizatë motër Xh. gëzon besim shumë të madh, kurse nga ana tjetër me një shok që e kemi këtu ka afërsi shumë të madhe qysh nga koha e vuajtjes së dënimeve në kazamatet jugosllave para 13 viteve. Përveç kësaj ekziston edhe një histori tjetër që i lidhë këta dy shokë për lirinë e popullit tonë. Pasi edhe deri më tani është punuar në bashkimin e organizatave tona, nga ana **tjetër nuk ekzistojnë kurrfarë divergjencash parimore, mund të themi se çështja e bashkimit mund të merret si punë e kryer**." (*Letër 'Komitetit Vëllezërit Gërvalla' në Shtutgart, mars 1982)

Ta dëgjojmë se sa është në gjendje ta pranoj Mehmet Hajriz-Strofcin në *Strofullin* e Lëvizjes së Jusufit askush tjetër pos

Shefqet Jashari-Strofci: "*Ta zëmë rastin kur është futur në kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla. Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetarë i mirëfilltë, d.m.th. i painfektuar nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik."* (Drita, Trelleborg, Suedi, nr. 15, 1997, f. 15)

Unë mendoj se të paktën Shefqet Jashar-Strofcin duhet ta lëmë të qetë duke shpresuar që të paktën në atë dynja nuk do të përsërit akuzat kundër djajve të mallkuar bolshevik, apo ndoshta në rastin më fatlum qysh gjatë kësaj dynjaje të rrejshme do t'ua jep hallallin.

Sikur të ishte gjallë Jusufi me siguri kundër Shefqet Jashar-Strofcit dhe luftës së tij për ta ruajtur të pastër Strofullin e Lëvizjes së tij, do t'i përdorte vargjet:

"O bilbil ta bëra benë, në ta gjetsha dot folenë..."

Se sa organike e të pandara kanë qenë lidhjet e Lëvizjes së Jusufit me OMLK-në e komunistëve për meritën e komunistëve na duket shumë qartë. Për këtë do të kemi edhe disa letra të shkruara nga Jusufi që do t'i ndeshim në raste tjera. Sa lodhemi t'i shqyrtojmë "*Lidhjet e pandara organike të Lëvizjes së Jusufit me OMLK-në"* a nuk do të ishte shumë më mirë t'i shohim pak se sa të pandara e sa organike janë lidhjet e komunistëve të paepur të vitit 2008 me të kaluarën e tyre të vitit 1981.

Se çka kanë menduar në vitin 1981 Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Berat brati e Kadri Zeka e kemi pa në Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Ja si manifestohen lidhjet organike me këto Teza, mendimet e autorëve të tyre në vitin 2008.

19. Iu kemi kundërvu ideologjisë komuniste

"Apostol Duka*: Thatë se e ndërruat emrin e Grupit tuaj Revolucionar. Më lejoni t'ju pyes: E ndërruat sepse bindjet tuaja ideologjike ishin marksiste-leniniste, e ndërruat sepse duhej ndërruar, apo e bëtë këtë gjë për të qenë të ngjashëm me veprimtarinë politike e ideologjike të shtetit-amë?*

Mehmet Hajrizi: *E kuptoj këtë pyetje me ngut. Sot, pas kaq vitesh, duhen sqaruar këto emërtime të Organizatës,* ***që për brezin aktual duken demode dhe të largëta****, edhe pse nuk e cënojnë aspak karakterin nacionalçlirimtar dhe rëndësinë historike të saj...*

Lëvizja Kombëtare e Kosovës, ***ideologjinë marksiste që ishte në modë atëherë****, e ka përdorur si kulturë dhe mjet për çlirim." (*Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f.163-164)

Mehmet Hajrizi: *"Ndikimi nuk mund të mohohet, por ne fokusoheshim tek shkelja nga udhëheqja jugosllave e parimit të vetëvendosjes së popujve, e cila ishte pjesë përbërëse e doktrinës leniniste dhe premtim demagogjik i Titos e partisë së tij komuniste." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.165)*

"Së katërti regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm edhe për një arsye që e diktonin rrethanat historike." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f.166)

Mehmet Hajrizi: *"Sot, tridhjetë e pesë vjet pas, duhet sqaruar shkurtimisht këto emërtime të Organizatës, që për brezin aktual nuk janë* ***të afërta as të pranueshme****."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 96)

Mehmet Hajrizi: *"Sabile Keçmezi-Basha ka shkruar; "Organizata e cila pati më së tepërmi jehonë në qarqet e përgjithshme të popullatës shqiptare dhe e cila kontribuoi që rrjedhat e shoqërisë ish-socialiste në Kosovë të merrnin kah krejt tjetër, ishte pasardhësja e 'Grupit Revolucionar" që më vonë u shndërrua në Organizatën ilegale shqiptare "Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës."" (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 316)

Brat Berat Luzha: *"Faktikisht, ne jemi vetëquajtur marksistë-leninistë, por realisht kemi qenë atdhetarë të mirëfilltë, idealistë. Nuk kemi qenë të indoktrinuar nga ideologjia. Kemi qenë veprimtarë të çështjes kombëtare... Pak ose fare pak jemi marrë me çështje ideologjike.*

'Rilindjen' e kam drejtuar pa asnjë problem të tillë ideologjik." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220)

Brat Berat Luzha: *"Përmes ngjyrimit ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste. Edhe në këtë mënyrë e kemi goditur armikun."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 220)

Brat Berat Luzha*: - Lidhjet me Shqipërinë kujtoj ishin mjaft të brishta, kryesisht përmes ambasadave të saj. Unë nuk kam qenë protagonist i këtyre lidhjeve, prandaj nuk mund ta di saktë këtë gjë. Kadri Zeka ka vepruar në Zvicër dhe ai ka pasur disa kontakte me ambasadën shqiptare në Vjenë. Ndonjë takim mund të kenë bërë edhe kuadro të tjerë të organizatës, por asnjëherë për çështje ideologjike." (*Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 223*)*

"A. Duka: -A ishte organizata e Jusufit marksiste-leniniste?

Brat Berat Luzha*: - Ashtu nuk e quante veten, por kishte platformë të ngjashme me organizatën tonë dhe me organizatat e grupet tjera ilegale." (*Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 224-225)

20. Patentimi i formulës sekrete të lirisë dhe përralla e Crvenkapës

Më lartë e kemi pa luftën e Mehmet Hajrizit, Kadri Zekës dhe shokëve të tyre për ta mbajtur OMLK-në të pastër dhe në distancë të sigurt nga Jusufi dhe Lëvizja e tij, në vitin 1981 e 1982. Sabri Novosella dhe Jusufi nuk e pranojnë tutelën e Mehmet Hajrizit dhe Kadri Zekës të cilët e parashtrojnë situatën në mënyrë raciste duke thënë se vetëm ata kanë monopol në idetë komuniste, thuase ata e kanë zbuluar atë ide. Ja se çka shkruan Jusufi për shtegtimin e ideve komuniste dhe qëndrimin e Shqipërisë zyrtare në

atë kohë:

Mjerisht, Cërvenkapa dhe Gjyshja i kanë disa mosmarrëveshje jo vetëm konceptuale por edhe triviale

Jusuf Gërvalla*: "Mbi idetë dhe lëvizjet përparimtare asnjë popull nuk mund të vërë dorë përgjithmonë, ashtu si e vë* ***njeriu kësulën (Crvenkapën - shën i Xh. D.) në kokën*** *e vetë të patjetërsueshme. Ku zënë fill, nga shtegtojnë dhe ku ngrehin çerdhe lejlekët e anës së ndriçuar të vetëdijes së Planetit, është punë që nuk mund të hetohet jashtë ligjshmërisë dialektike, dhe kjo ligjshmëri për të paditurin shfaqet përplot pusi.*

Ideja e madhe komuniste mori krah në Gjermani, me Marksin në ballë. U avancua dhe materializua në Revolucionin e madh rus, të cilit i priu Lenini…Por pasi braktisi stepet e paskajshme, e pezmatuar në tradhtinë e akullt hrushoviane, ***ideja*** *e madhe komuniste u strehua dhe nguliti në Shqipërinë e 'vogël'. Këtu gjeti prehje dhe truall të përshtatshëm për lulëzim të plotë. Së këndejmi fshikullon sot pa mëshirë imperializmin dhe social-imperializmin, 'eurokomunizmin' fodull. Këtu u bë fener për proletarin, të nënshtruarin, të kolonizuarin. Kudo në botë. Sepse siç thotë poeti,* ***Shqipëria është një magje lirish, që formulën e lirisë nuk e mban sekret****." (*Lajmëtari i lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 4.)

Tek disa popuj thuhet se gëzimi i ndarë me dikend dyfishohet ndërsa dhimbja e ndarë me dikend përgjysmohet. Me sa duket kjo vlen më shumë në teori se sa në praktikë a aq më pak në politikë. Shumë më reale duken thëniet: Nëse del një punë mirë, atë e bëra unë dhe rezultati më takon vetëm mua. Nëse del keq atëherë atë e bëtë ju dhe pasojat duhet të bien vetëm mbi ju. Në rastin më të mirë e më ekstrem sa i përket pjesës së dytë, thuhet edhe forma: nëse del keq pasojat na takojnë të gjithëve në mënyrë solidare. Në zanatin e ndyrë të politikës këto djallëzi e kopili është vështirë me i pa tërë kohën. Në fushën e ekonomisë këto çështje janë aq të ndara e të pastra sa nuk ka ku shkon më tej dhe duken si drita e diellit dhe janë çështje që rregullohen me ligje të tëra.

Themelimi, starti i një ndërmarrje ekonomike nuk është gjithmonë vetëm premtues e i lidhur me prurjen e fitimeve por në vete përmban edhe rrezikun që kapitali i investuar të humbas. Në këtë pikë që në fillim partnerët, palët merren vesh për ndarjen e rrezikimeve për të cilat janë të vetëdijshëm që në fillim. Përveç rrezikut të humbjes si pasojë e natyrës së ekonomisë, ekzistojnë fatkeqësitë të shkaktuara qoftë nga faktori njeri qoftë nga natyra. Edhe për këso lloj rreziqesh me kohë paguhen e lidhen kontrata që kanë të bëjnë me fushën e sigurimeve. Këto gjëra në fushën e ekonomisë janë të qarta dhe shumë të definuara, të cilat në mënyrë të përafërt ndoshta mund të thuhet se i përmbledh fjalia e përgjithshme, nëse del keq, e keqja le të shpërndahet në sa më shumë veta, dhe mundësisht askush të mos merr përgjegjësi personale.

Rasti i kundërt është ai kur një ide komplete e mirë, një formulë kimike, apo një kombinim formulash kimike që e përbëjnë një ilaç të mirë, patentohet nga firma, në mënyrë që vetëm ajo të ketë të drejtë ta shes atë ilaç për 10 vjet, apo për një kohë të caktuar në mënyrë që t'i mbuloj shpenzimet e investimeve dhe shpenzimet tjera, plus të nxjerrë njëfarë fitimi. Në ekonominë e vendeve më të zhvilluara kështu veprohet dhe askush nuk çuditet pse është kështu. Nëse një profesor i një universiteti serioz merret me vjedhje e plagjiaturë ai përjashtohet nga puna dhe i duhet të zgjedhë ndonjë profesion ku hajnia sjellë fitime më të mëdha.

Në vitin 1981 e 1982, Mehmet Hajrizi, Kadri Zeka dhe shokët e tyre nuk e kanë njohur asnjë veprimtari të të tjerëve si aktivitet e lere më për të barabartë, dhe hisen e komunizmit të tyre nuk kanë dashtë me e nda me askënd. Kur ky komunizëm i tyre, QË E RUAN ROLIN HEGJEMON, ka falimentuar, këta dezertojnë nga postet e tyre (megjithëse janë të paepur gjer në fund) dhe mundohen me na e mbush mendjen se të gjitha organizatat e asaj kohe kanë qenë të ngjashme, identike me lidhje organike e të pandara, dhe se interesat meskine nuk mund t'i hedhin kundër njëra tjetrës.

Ja se si u bien mistri ish-ministri i propagandës Xhafer Shatri, dështimit të bisedimeve të Stambollit në mes OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së.

Xhafer Shatri: *"Një takim i mbajtur në Stamboll, në tetor të vitit 1981, e në të cilin kishin marrë pjesë në një anë, Kadri Zeka si përfaqësues i OMLK-së, dhe në anën tjetër Sabri Novosella e Bardhosh Gërvalla, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së kishte dështuar jo vetëm për shkak të dallimeve konceptuale." (*20 vjet nga vrasja e Vëllezërve Gërvalla dhe e Kadri Zekës, www.pashtriku.org)

Mehmet Hajrizi si ideolog i vërtetë që i kupton gjërat në tërë kompleksitetin e tyre na e heq tërë mjegullën para syve dhe e zbërthen edhe më tej mendimin e shokut të vet.

Mehmet Hajrizi: *"Në tetor të vitit 1981 Një takim i mbajtur në Stamboll, midis Kadri Zekës si përfaqësues i OMLK-së e i Tezave të Frontit, dhe të Sabri Novosellës e Bardhosh Gërvallës, si përfaqësues të LNÇKVSHJ-së kishte dështuar bashkimi i organizatave për shkak të dallimeve konceptuale, por edhe për arsye tjera triviale."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 292)

Saime Isufi: "*Më 18 tetor të vitit 1981, u nisa përsëri për në Zvicër. Kadriu nuk ndodhej në Zvicër. Ai kishte qenë në panairin e librit në Frankfurt dhe* ***pastaj*** *kishte*

udhëtuar me Bardhosh Gërvallën në Turqi, për bisedime rreth bashkimit të organizatave me udhëheqësin e LNÇKVSHJ, Sabri Novosellën. Në banesën e tij na priti Hasan Malaj, mua dhe Berat Luzhën. Me Hasanin, që atë natë udhëtuam diku në Gjermani për të marrë Kadriun. U takuam me Kadriun. Dukej shumë i lodhur, i rraskapitur, por edhe i dëshpëruar nga takimi që kishte pasur me Sabri Novosellën.

Ai nuk i kishte përfillur, bile i kishte fyer e poshtëruar atë dhe Bardhosh Gërvallën." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.98)

Sabri Novosella: *"Sa i përket asaj se unë paskam folur keq për Zeqën, kjo ka qenë kështu: Më pyeti Uka (Xhafer Shatri-shën. i Xh. D.) se pse janë prishë Jusufi me Zeqën kohëve të fundit? Ju përgjigja ashtu si ka qenë. Pas bisedimeve në Stamboll, Zeqa (Kadri Zeka-shën i Xh. D.) ia kishte dërguar një vendim të rrejshëm se gjoja ishte formuar "Fronti për Republikën e Kosovës", gjë që Sokoli (Jusuf Gërvalla-shën i Xh. D.) ishte hidhëruar së tepërmi dhe i kishte thanun në një letër: Çdo gjë që e ka fillimin në gënjeshtër është e gjykuar në dështim që në fillim. Në lidhje me bisedimet e Stambollit ia pata dërguar një letër të Sokolit Ukës e cila ia kishte luajtur mendjen dhe tash po mundohet me qpifë diçka kundër meje në atë drejtim, por atë letër po ua dërgoj edhe juve."* (Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984)

Në këtë rast nuk e shoh të rrugës as nuk e kam për detyrë t'u tregoj të tjerëve se ku ka qenë Kadri Zeka në këtë kohë, por për shkak se përmendet Bardhoshi e kam detyrë ta përsëris edhe njëherë, kur është hapur Panairi i librit të mërkurën më 14 tetor 1981, Bardhoshi e Kadriu kanë qenë në Turqi, dhe prej atje janë kthyer të premten më 16 tetor. Të shtunën më 17 tetor 1981, në lokalet e panairit Kadriu i ka tregua Jusufit se ai apo OMLK-ja është bashkuar me Frontin e Kuq e me Ibrahim Kelmendin. S. Isufi paska ardhë në Zvicër me Berat Luzhën të dielën më 18 tetor. Nëse Kadriu nuk është kthyer shpejtë në Zvicër, shkaku për këtë janë punët që i kanë dalë nga bashkimi me Ibrahim Kelmendin dhe jo kohë e kaluar me Jusufin apo me Bardhoshin në ndonjë rrugë në Turqi.

Bardhi (edhe pse i '*fyer e i poshtëruar*') kishte sjellë nga Turqia selamin e Sabriut që të fillohet me nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", si organ i LNÇKVSHJ-së, me arsyetimin se boll kemi ba sabër. Puna në nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" qe e shpejtë pasi artikujt për numrin e parë ishin pothuajse të gjithë të gatshëm qysh nga mesi i gushtit. Numri i parë doli në fillim të nëntorit 1981.

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të* ***RUANTE ROLIN HEGJEMON."*** *(*Historia e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)

Jusuf Gërvalla: *"Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj* ***(e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.*** *[në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të* ***pajtohesha plotësisht*** *me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë,* ***as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur****, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z (Kadri Zeka - shën im).*

Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por ***MEGALOMANINË*** *e arrivistëve të revolucionit,* ***ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët*** *dhe tendencën për* ***DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e

pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

KJO NUK DO TË NDODHË KURRË

Lëvizja e Jusuf Gërvallës në periudhën 1 nëntor 1981 - 12 janar 1982

1. Kërkesa e Jusufit rreth Kongresit VIII të PPSH
2. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
3. Asnjëherë nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur
4. QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM
5. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË
6. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E TYRE
7. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi dhe Besniku
8. Unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime
9. Në numrin e parë të Zërit të Kosovës Jusufi e fajëson Kadriun
10 Koncert në Sindelfingen për Nëntorin e Jugosllavisë
11. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Höpfigheim
12. Fjala e Jusuf Gërvallës në Stuttgart, në ditën e Flamurit, 28 Nëntor 1981
13. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA
14. Mos u habitni nëse ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave
15. Jusufi e Kadriu fillojnë të anëtarësojnë në organizatat e veta
16. Kadriu i propozon anëtarësim Ibrahim Kelmendit por ai nuk pranoi
17. Jusufi nuk i bëri Ibrahim Kelmendit asnjë propozim
18. Bojkotimi i Zërit të Jusufit nga Kadri Zeka
19. Dasma e Kadri Zekës dhe Saime Isufit
20 Dy ftesa të Kadri Zekës
21. Ibrahim Kelmendi në mes Jusufit e Kadri Zekës
22. Dilemat e Jusufit
23. Thirr cilët të duash dhe pyeti vetë!
24. Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!
25. Rrobaqepësi anadollak po e manipulonte Jusufin
26. Të kam pasur krah të djathtë çdo herë dhe vazhdoj të të kem
27. Iu drejtua Jusufit me dashamirësi e dhembshuri
28. Lëvizja jonë e bashkimi ynë morën përmasa të mëdha
29. Të dëshiroj forcë që të mos thyhesh shpirtërisht e moralisht
30. Më ndihmoi të këndellem
31. Të kërkoj falje për shkrimin në gazetë
32. Së shpejti të gjithë do të përfshiheshin në Front

1. Kërkesa e Jusufit rreth Kongresit VIII të PPSH

Është edhe një ngjarje me rëndësi që është zhvilluar në panairin e Librit në Frankfurt. Më 1 nëntor 1981 do t'i fillonte punimet Kongresi VIII i PPSH. Jusufi ishte shumë i interesuar të siguroj xhirime filmike sa më të plota nga zhvillimet e punimeve të Kongresit, me qëllim që të fitohej njohuri organizative për punën tonë që bënim në Gjermani. Për këtë arsye ai (Jusufi) kishte blerë një televizorë të cilësisë së lartë dhe dy videoaparate (VHS) të cilat ia dorëzon Engjëll Kolanecit. Në fillim të dhjetorit 1981, nga Shqipëria vjen përgjigje lidhur me kërkesën e Jusufit për videoxhirimet e punimeve të Kongresit VIII. Engjëll Kolaneci ia sjell Jusufit pesë videokaseta VHS, me këto filmime:- Epoka para Gjyqit, Dramë (Sylejman Pitarka e Kadri Roshi)

- Gërsheti i Luftërave, Dramë për Shote dhe Azem Galicën (Liri Lushi)
-Mësonjëtorja, Film (Roza Anagnosti etj.)
- Udha e shkronjave, Film
- Plumba Perandorit, Film

Siç shihet, përgjigjja që vjen në kërkesën e Jusufit është shumë interesante. Asnjë minutë i vetëm rreth Kongresit VIII. Porosia është e qartë si drita e diellit. Me fjalë tjera Jusufit i thuhet: Ti me Lëvizjen tënde Nacionalçlirimtare je në rrugë dhe në ide të drejta. Koncentrohu në çështjen kombëtare, dhe merr mësim nga Mësonjëtorja e Korçës, Abdyl Frashëri, Azem e Shote Galica dhe Vasil Laçi e mos u lodh për luftën ideologjike të Partisë së Punës, pasi për atë punë jemi ne vetë. Faza e metodat e luftës sonë janë të ndryshme me tuajat.

2. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit

Selatin Novosella: *"Duke qenë ndër udhëheqësit e nivelit më të lartë të LNÇKVSHJ-së, duke mbajtur lidhjet me Metush Krasniqin në Kosovë e Sabri Novosellën në Turqi, nga njëra anë: duke qenë mik i afërm me Hydajet Hysenin në Kosovë dhe Kadri Zekën në diasporë, si udhëheqësit më të lartë të OMLK-së, nga ana e dytë ... Jusuf Gërvalla, kështu do të shndërrohet në faktor koheziv dhe të pazëvendësueshëm."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 147-148)

Jusuf Gërvalla: ***"Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.***

Ka disa muaj që unë po fluturoja nga gëzimi, në pritje të bashkimit të forcave tona revolucionare, që isha bërë gati ta quaja bashkim historik. Më herët të kisha dërguar një letër dhe të kisha thënë se këtë bashkim unë vetë nuk e shoh çështje aq të thjeshtë. ***Ka probleme parimore për të cilat duhen marrëveshje serioze, siç është ai se a duhet të kemi fare parti k.m.- l., (komuniste marksiste-leniniste - shën i Xh. D.) apo ajo parti është e domosdoshme për t'i dalë në ballë popullit tonë në drejtim të luftës dhe të fitores. Ky ishte për mendimin tim problemi kyç.*** *Meqë me Organizatën e shokëve të "Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare dhe të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka. Për veten time, në shërbim të kësaj çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e shokut me shokun, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa besë dhe me grushtin të bashkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-274)

3. ASNJËHERË NUK KA RËNË FJALA PËR NJË "BASHKIM" TË TILLË TË ÇORODITUR

Hydajet Hyseni: *"Atëherë e quanim edhe një organizimi pararojë dhe një lloj armature e bashkimi gjithëpopullor. Synohej kështu një ndërlidhje e brendshme strukturale dhe funksionale dhe jo farë hierarkie organizimesh, siç ishte kuptuar e interpretuar aty-këtu dhe kjo o kishte krijuar vështirësi Jusufit me shokë. Jusufi dhe Bardhoshi e kishin përqafuar këtë skemë organizimi dhe sipas asaj që na kishte thënë Kadriu, ishte pikërisht Jusufi që kishte insistuar që Kadriu të shkonte dhe të punonte, së paku një kohë, me bërthamën prej pesë anëtarësh që kishte krijuar Jusufi sipas këtij koncepti të organizmit."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Jusuf Gërvalla*: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhemi se s'paska ardhur ende çasti i pritur i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.*

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z.), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka-shën im)" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

4. QENKA BËRË LOJË E PAHIJSHME ME PERSONIN TIM

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por megalomaninë e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët****. Kam dëshirë të madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.*

Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim*. Nuk di me se e kam merituar një gjë të tillë. Por tani, pas hidhërimit të parë, nuk ndiej kurrfarë nevoje të kërkoj ndonjë shpjegim e satisfaksion prej tyre. Sedra s'ka vend në këtë mes."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

5. NUK DO TË PENDOHEM PËR ANGAZHIMIN TIM TË KOTË

Jusuf Gërvalla: ***"****Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën.* ***Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

6. PO KUSH DYSHONTE NË MOSSINQERITETIN E TYRE!

Berat Luzha: *"Megjithatë ishte mendimi i Kadri Zekës se ky bashkim do të arrihej në të ardhmen, duke pasur parasysh se Jusuf Gërvalla ishte pajtuar me përmbajtjen e Tezave për Republikën e Kosovës, dhe bisedat në mes të Jusuf Gërvallës dhe Sabri Novosellës, do të rezultonin me bashkimin që ishte imperativ i kohës."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 190)

Jusuf Gërvalla*: "(**Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre**, kur nuk dhanë asnjë shenjë! Kjo më brengos edhe më shumë për rrugën e tyre.)*

*Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. **Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

7. KËTË MENDIM E KANË PLOTËSISHT EDHE SHPENDI DHE BESNIKU

Jusuf Gërvalla*: "Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi (Xhafer Durmishi - shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla - shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 275)

8. Unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime

Ibrahim Kelmendi si shkrues të historisë së Lëvizjes së Jusufit.

Pas shkrimit të shkëlqyeshëm të historisë së "Frontit të Kuq" apo "Frontit të Kuq Popullor", I. Kelmendi ka mirësinë dhe jep kontribut të shquar në shkrimin e historisë së Lëvizjes së Jusufit.

Në mesin e tetorit 1981, në Stamboll, bisedimet, përpjekjet e Kadri Zekës, për ta bashkuar, futë në një thes, e shkri Lëvizjen e Jusufit në "Frontin për Republikën e Kosovës" së bashku me "Frontin e Kuq" (pjesërisht të bashkëformuar dhe 100% të emërtuar nga UDB-a, e me aktivitet të ngrirë), pra për ta futë nën tutelën udhëheqëse të OMLK-ja, pësojnë disfatë brenda 5 minutave.

I. Kelmendi*: "Jusufi urdhërohet menjëherë nga Sabiti të fillojë botimin e organit të Lëvizjes. Edhe emrin e organit Zëri i Kosovës e zgjodhi Jusufi. Ai kishte dëgjuar se në fillim të viteve të 80–ta, Grupi Revolucionar në Kosovë kishte botuar organin e tij me po këtë emër, prandaj e parapëlqeu këtë emërtim."* (Atentatet, f.306)

A ka dorë Jusufi në zgjedhjen e emrit "Zëri i Kosovës", si emër gazete i Lëvizjes së vetë? Abdullah Prapashtica e ka quajtur të rrugës që edhe ai të merret me historinë e Lëvizjes së Jusufit. Këtu duhet treguar mirëkuptim për faktin se ata njerëz që nuk kanë histori të veten, duhet të merren me të tjerëve. Këtu nuk ka asnjë risi dhe asgjë të keqe. Jo çdo kush mund të bëjë histori. Jo çdo kush mund të shkruaj histori. Turpi e katastrofa e tyre qëndron në luftën e mjerë për ta shtrembëruar atë që nuk mund të shtrembërohet.

A ekziston ndonjë dokument i shkruar me dorën e Jusufit ku kjo çështje sqarohet në tërësi. Ja se çfarë sqarimesh jep Jusufi në këtë pikë.

Jusuf Gërvalla*: "Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se, duke qenë krejt i vetmuar nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. ...Unë që në* ***fillim e kam ditur se organ i Lëvizjes është "Zëri i Kosovës", se kjo shihet nga vet statuti****. Dhe me kënaqësinë më të madhe, në vend që të dilte "Lajmëtari i lirisë" kam menduar të bëja që të dilte "Zëri i Kosovës". Nuk e bëra për dy arsye. Së pari nuk isha i autorizuar nga Lëvizja, së dyti këtu kishte vepruar qysh më heret një i ashtuquajtur Grup Komunist "Zëri i Kosovës" ...Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm, provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur "të dërguar special të UDB-së" pikërisht për arsyen se pata thënë që "Zëri i Kosovës" është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet. Po për këtë arsye, para se t'i hyjmë botimit të këtij organi, duhet të marrë nga Ti dhe Lëvizja edhe fjalën e fundit, sepse ka mundësi që titulli "Zëri i Kosovës" si organ i LNÇ, të përzihet në mendjen e naivëve me Grupin Komunist "Zëri i Kosovës".* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 263-264)

Të njëjtën çështje Jusufi e shtjellon edhe në letrën vijuese dërguar Sabri Novosellës më 16 qershor 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:*

... 2) Pas "pështjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? ***Unë mendoj se titulli duhet ndërruar."(***Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 271)

Jusuf Gërvalla: *"TË DASHUR LEXUES, Kemi nderin, detyrën dhe përgjegjësinë e madhe të dalim para jush me revistën periodike "Zëri i Kosovës"* pikërisht në një çast historik, kur në ndërgjegjen e popullit dhe të rinisë sonë heroike po trokasin fuqishëm pulset e lirisë që po agon....*

**Deri më tash "Zëri i Kosovës" ka dalë në trajtë buletini dhe ka botuar materiale të përdorimit të brendshëm për anëtarët e LNÇKVSHJ"* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, f. 3)

Se Ibrahim Kelmendi nuk ka qenë i involvuar në asnjë mënyrë në çështjen e bisedimeve e përpjekjeve për bashkim, sidomos prej anës së Jusufit, e dëshmon letra rekomandë e Jusufit dërguar I. Kelmendit të premten, më 15 janar 1982.

Shefqet Cakiqi-Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.* (Fjalë të drejtuara Ibrahim Kelmendit, Afishuar me: 23.03.2007 21:22, www.kosova.de)

Ibrahim Kelmendi: *"Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë."* (Fjalë të drejtuara Shefqet Cakiqit-Llapashticës, Afishuar me: 23.03.2007 22:57, www.kosova.de)

Gjatë vitit heroik 1981 nuk ekziston asnjë letër që Jusufi ia dërgon direkt I. Kelmendit. Për aq sa e komenton Jusufi punën e I. K. ai e bënë pikërisht ashtu siç duhet, vetëm e vetëm në letrat që ia dërgon shokut të vetë të Lëvizjes, Sabri Novosellës. Rrezja e veprimit të kësaj letre të 15 janarit 1982 mund të thuhet se për kohën e kaluar shtrihet deri në datën 20 gusht 1981, ndërsa për kohën pas kësaj date kjo rreze e veprimit është e përjetshme. Ja se çka i shkruan Jusufi, I. Kelmendit:

Jusuf Gërvalla*: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për* ***bashkimin e dy (d.m.th. vetëm dy: LNÇKVSHJ e OMLK pa Frontin e Kuq-shën i Xh. D.) organizatave****. Por, unë kam edhe më pak leje të të*

*informoj për to**, tani që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi **kundër punëve të tyre të pahijshme**."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411)

Fjalët ***tani që e di se ku bënë ti pjesë*** dhe ***Shokët e tu të rinj*** na i ka lënë Jusufi si dëshmi prej anës së tij se Kadri Zeka dhe I. Kelmendi janë bashkuar. Struktura dhe detalet e këtij bashkimi nuk e përbëjnë objektin e interesit tim. Ajo çka është në thelb pika më interesante është ajo që na e vërteton Jusufi dhe jo vetëm Jusufi. Më vonë do të ndeshemi edhe me dëshmi tjera në këtë çështje.

9. Në numrin e parë të *Zërit të Kosovës* Jusufi e fajëson Kadriun

Jusufi në numrin e parë të "Zërit të Kosovës" i komenton publikisht bisedimet e dështuara në Stamboll në mes Kadri Zekës dhe Sabri Novosellës. Pa ia përmend emrin, e pa qenë në gjendje të gjykojë, Jusufi e fajëson Kadriun për dështimin.

I. Kelmendi*: "Numrin e parë Jusufi e botoi në nëntor, të dytin në dhjetor. Në numrin e parë Jusufi shkroi se bashkimi nuk u arrit për faj të Kadriut, pa ia përmendur emrin. Aty shprehet dëshpërim kundër Kadriut, pa qenë në gjendje të gjykojë se fajtori i vërtetë ishte komanduesi i tij, Sabiti."* (Atentatet, f. 306*)*

Siç e kemi pa disa herë më parë I. Kelmendi është njeri që nuk të përfolë e edhe nëse i ndodhë që të mos kuptoj ai kurrë nuk të keqkupton por ta bënë shah-mat.

Shtrohet pyetja: A ekziston ndokund, ndonjë ekzemplarë i numrit të parë të "Zërit të Kosovës" të nëntorit 1981. Në cilën faqe, dhe në cilin artikull dhe në cilin rresht, shprehet dëshpërimi kundër Kadriut? Natyrisht se "Zëri i Jusufit" i nëntorit 1981 gjendet në duart e shokëve të Jusufit. Në te nuk ka asnjë koment dhe asnjë aludim për bisedimet e dështuara të tetorit në Stamboll. Është pikërisht e kundërta. Në këtë numër gjendet artikulli Hydajet Hysenit, që Jusufit i epet nga Kadri Zeka, me titull "*Planet e revizionistëve titistë për degjenerimin e rinisë sonë kanë dështuar me turp" (faqe 7-8).*

Përmbajtja e Zërit të Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, nr.1, nëntor 1981

Autori	Titulli
Jusuf Gërvalla	Kosova gjëmëmadhe, trimëresha Kosovë
KQ i LNÇKVSHJ	Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi KQ = Komiteti Qendror i LNÇKVSHJ (në Shtutgart)
Jusuf Gërvalla	Të dashur lexues
Fatime Sokoli	Në PRANVERË 81 / Këngë
Arif Vladi	Prite Azem Galicën / Këngë
Jusuf Gërvalla	Dënimet e rënda nuk e mposhtin popullin as rininë tonë
Jusuf Gërvalla	S'e ka të gjatë robëria
Jusuf Gërvalla	Luftëtar deri në vdekje (kushtuar Hasan Prishtinës)
Hydajet Hyseni	Planet e revizionistëve titistë për degjenerimin e rinisë sonë kanë dështuar me turp (artikull të cilin Jusufit ia jep Kadri Zeka në gusht 1981)
Jusuf Gërvalla	Turpi i mizorit dhe lavdia e heronjve (kushtuar Tahir e Nebih Mehës në bazë të tregimit të Xhafer Durmishit)
Jusuf Gërvalla	Më shumë se fashistë
Sabri	Kur shovinizmi akuzon për shovinizëm

Novosella	
Jusuf Gërvalla	Letër e hapur popujve të Jugosllavisë
Jusuf Gërvalla	Masa për paralizimin e arsimit në Kosovë
Sabri Novosella	Nga dega në degë
Xhafer Durmishi	Do të na bashkoj lufta shoku S.
Jusuf Gërvalla	S'na frikësojnë inskenimet
Sabri Novosella	Në Kosovë dy njerëz u ringjallën
Bardhosh Gërvalla	Një aksion i qëlluar
Bardhosh Gërvalla	Disbalancim në shkëmbimet tregtare mes Jugosllavisë dhe Shqipërisë
	Ne, bijtë e Kosovës (poezi)
	Më shumë se kundërajrorë (poezi)
Jusuf Gërvalla	Gjuha shqipe dhe flamuri shqiptar në shënjestër
Sabit Rrustemi	Nën maskën e mysafirëve
Hydajet Hyseni	Ushtarëve të huaj në tokën tonë (Nga përmbledhja "Këngët e lirisë")
Bardhosh Gërvalla	Besimtarët dhe kleri janë me ne
Xhafer Durmishi	Imbecili dhe mendimi politik

Se Jusufi ka marrë ndihmë me artikuj nga unë, Bardhoshi dhe Kadri Zeka e dëshmon letra e Jusufit dërguar Sabri Novosellës më 20 gusht 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë, Shpendi e Besniku jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e* ***Shpendit (Xhafer Durmishit - shën im), e Besnikut (Bardhosh Gërvallës - shën im) dhe e shokut të "Lirisë" (Kadri Zekës - shën im), që këta më dhanë me disa artikuj të mirë****. Edhe Shpendi edhe Besniku, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

Bisedimet e dështuara Jusufi i komenton në mënyrë indirekte tek në numrin e 2 të Zërit të Kosovës, shumë ekzemplarë të të cilit ndodheshin në gepekun e kerrit të Bardhit me regjistrimin HN-CY353, në të cilin u drejtuan plumbat e vrasësve profesionistë të UDB-së.

10. Koncert në Sindelfingen për Nëntorin e Jugosllavisë

"Në mesin e mërgimtarëve u hap lajmi se nga Kosova do të vinte një Shoqëri Kulturore e Artistike për të dhënë koncert. Koncerti ishte paraparë të mbahej më ***14***

***nëntor 1981**, në qytetin Sindelfingen, nën përkujdesjen e konsullatës jugosllave. Organizimin e kishte marrë përsipër klubi „Hasan Prishtina“ me qendër në Shtutgart. Në rrethana të tjera, një koncert i tillë do të na gëzonte pa masë dhe do ta kishim pritur me lule, flamuj e brohoritje. Por, duke e pasur parasysh tërbimin dhe egërsinë që kishin treguar autoritetet jugosllave kundër studentëve dhe mbarë popullit shqiptar në Jugosllavi, këtë organizim e cilësuam si provokim, përpjekje për fshehje krimesh dhe hedhje hi syve mbarë mërgatës, se gjoja shqiptarët janë populli më i lumtur në Jugosllavi, se në Kosovë nuk kishte ndodhur asgjë e keqe, asnjë trazirë. Se populli po i kënaqej gjendjes së jashtëzakonshme, burgosjeve, diferencimeve ideopolitike, ndjekjes së intelektualëve, skamjes e mjerimit, dhe për këtë lumturi vetë autoritetet jugosllave e kishin marrë mundimin që përmes artistëve më të spikatur, të merrnin një rrugë kaq të gjatë e të mundimshme, për t'i kënaqur e dëfryer mërgimtarët të cilët ndodheshin në dhe të huaj, jo për të mbijetuar, por për pushime verore e turizëm..*

... „U përgatitëm“ për koncert. Me vete morëm magnetofon dhe kaseta me këngë patriotike, e veçmas këngën e Fatime Sokolit „Oj Kosovë kështjellë burrnie“, që i përkrahte demonstratat dhe luftën e drejtë të popullit shqiptar që jetonte brenda kufijve të Jugosllavisë. Përgatitëm doza ngjyrash të kuqe për t'ua „stolisur“ veturat konsujve jugosllavë, stafit të tyre dhe posaçërisht autobusin e Kosovatransit, që i kishte sjellë artistët për të na kënaqur, dëfryer dhe mallëngjyer...

U tubuam në „Kongres halle“. Salla filloi të mbushej. Në skenë i kishin vendosur instrumentet muzikore. Disa mikrofona i kishin vendosur mbi trekëmbësha, në mes të tribunës. Muret anësore të skenës i kishin stolisur me flamuj jugosllavë. Në murin përballë e kishin vendosur një fotografi të madhe të Titos, dhe poshtë saj mbishkrimi: „Druzhe Tito mi te se kunemo!“ Rreth e qark sallës kishin defiluar kujdestarët nga klubi „Hasan Prishtina“, të cilët po kujdeseshin për rehatinë e publikut. Për mirëseardhje shpërndanin bonbone nga Banka e Lubjanës!

Bardhoshi po endej sa lart-poshtë sallës, në kërkim të studentit nga Mynheni, i cili ishte caktuar për leximin e referatit të përgatitur nga Jusufi. Disa nga shokët i hodhën bonbonet me neveri. Jehoi kënga e Fatime Sokolit nga magnetofonat tanë. Me sa zë që pata thirra "Kosova Republikë". Ndërkohë, e pashë ndërhyrjen e policisë që e nxorën jashtë Bardhoshin... sigurisht, me kërkesën e konsujve jugosllavë, sepse Bardhoshi për ta ishte person i rrezikshëm dhe ia kishin frikën se do t'ua punonte si në demonstratën e Shtutgartit muaj më parë!

Salla sikur mori flakë." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 61-62).

11. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Höpfigheim

Si ka qenë atmosfera në këtë mbrëmje pjesërisht, e vërteton edhe Faridin Tafallari.

Faridin Tafallari*: "Edhe kur ishte Jusufi ka pasur ndonjë mosmarrëveshje, por këto i shkaktonin disa që bënin shpifje. Kur Jusufi e kuptoi qëllimin e keq të tyre, diti t'i shuaj grindjet dhe t'i kaloj në mirëkuptim, duke mënjanuar ata që villnin vrer kundër shokëve. Për disa raste të tilla kam qenë edhe vet dëshmitar; kur në kremtimin e 28 nëntorit 1981 disa mundoheshin të nxitnin njerëzit kundër Kadri Zekës. Jusufi i kuptoi shpejt marifetet e disave dhe ua preu shkurt."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, faqe 115)

Për festën e 28 Nëntorit në Shtutgart, Jusufi e Kadriu i ndajnë punët në këtë formë. Kadriu do t'u flet bashkatdhetarëve për revizionizmin jugosllav dhe karakterin antipopullor të revizionizmit, pasi si komunist është kompetent në këtë pikë. Jusufi vendoset që të flet për 28 Nëntorin dhe të koncentrohet në argumentimin e kërkesës

Kosova-Republikë. Gjatë mbrëmjes së 28 Nëntorit 1981, Jusufi i shkëmben këto fjalë me Kadriun:

Jusufi: Si t'u duk ty dhe shokëve tjerë në Zvicër, "Zëri i Kosovës"?

Kadriu: Mund të përgjigjem për vete por edhe për shokët e Zvicrës megjithëse ata nuk e kanë pa, pasi ne nuk e kemi ndërmend me e shpërnda Zërin tënd në radhët tona.

Jusufi: Ani mirë, por megjithatë jam kureshtar si t'u ka dukur ty e me këtë edhe atyre, pasi ti flet në emër të tyre?

Kadriu: Zëri yt është plagjiat.

Jusufi: Plagjiat i kujt?

Kadriu: Plagjiat i Lirisë.

Salla në Höpfigheim (Melchior - Jägerstuben, Burgunderstraße 4) ku u festua 28 Nëntori i viti 1981 (Fotografoi Faridin Tafallari)

Në këtë kohë, pas katastrofës në Stamboll, Kadri Zeka i ndihmuar pa kursim nga Ibrahim Kelmendi, fillojnë fushatë kundër Jusufit.

Në kryeartikullin e Jusufit me titull "T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS", i cili u lexua nga Jusufi në mbrëmjen e 28 Nëntorit, pos tjerash, thuhet:

Jusuf Gërvalla*: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e ARRIVIZMIT revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh MEGALOMANË (***fjalët

i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij - shën im)*, dhe* ***ato që janë organizuar prej ELEMENTESH TË DYSHIMTA****, (këto fjalë i drejtohen ish-inspektorit të UDB-së Abdullah Prapashtica - shën im) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."* (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË E ARRIVISTËVE të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët****."*(Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Selatin Novosella: *"Duke qenë ndër udhëheqësit e nivelit më të lartë të LNÇKVSHJ-së, duke mbajtur lidhjet me Metush Krasniqin në Kosovë e Sabri Novosellën në Turqi, nga njëra anë: ... duke qenë në bashkëpunim me ... kryetarin e Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi, Abdullah Prapashticën, nga ana e tretë, Jusuf Gërvalla, kështu do të shndërrohet në faktor koheziv dhe të pazëvendësueshëm."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 147-148)

Kah i erdhi Jusufit mendimi me e përdorë fjalinë *"dhe ato që janë organizuar prej* ***ELEMENTESH TË DYSHIMTA"***?

Pas mesit të nëntorit 1981, Sabri Novosella e njofton Jusufin se në Turqi, në shtëpinë e tij, është takuar me "komunistin", ish-inspektorin e UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica, me sekretarin dhe nipin e tij. Në bazë të fjalëve të Abdullahut, Sabriu e njofton Jusufin se:

- Motivi i ish-inspektorit të UDB-së për largim nga Jugosllavia është bashkimi i të gjitha grupeve e organizatave, pasi çështja e bashkimit nuk i paska ra askujt ndërmend para tij,

-Partia "Komuniste" e ish-inspektorit të UDB-së është organizatore e demonstratave të vitit 1981,

-Adem Demaçi i takon Partisë "komuniste" të ish-inspektorit të UDB-së!

"Adem Demaçi: *Unë nuk kam qenë as enverist ose komunist.*

A. Duka:- I keni njohur në atë kohë Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën?

A. Demaçi: Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur, ndërsa Kadri Zekën jo." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 150-156)

Këta trika të ndryshëm të Abdullahut, Sabriu ia përcjellë Jusufit në mënyrën e vet. Në bazë të informatave të Sabriut, Jusufi i përdorë fjalët: *"dhe ato që janë organizuar prej* ***ELEMENTESH TË DYSHIMTA"***. Këto fjalë janë të vetmet fjalë përshëndetëse që Jusufi i përdorë në jetën e tij lidhur me partinë "komuniste" të ish-inspektorit "komunist" të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica.

12. Fjala e Jusuf Gërvallës në Stuttgart, në ditën e Flamurit, 28 Nëntor 1981

Shkruan: Faridin TAFALLARI

Në këtë material, të cilin unë e nxora nga kasetofoni, fjalë për fjalë, pa ndryshuar asnjë germë, pa ndryshuar asnjë pikë apo presje, jam i bindur, që lexuesi do të gjejë forcën e madhe të fjalës së tij, tepër aktuale për ditët e sotme, largpamësinë e kthjellët, mprehtësinë e mendimit, arsyetimin e shëndoshë për problemin madhor të statusit të Republikës së Kosovës.

Janë munduar dhe vazhdojnë të mundohen, për të shtrembëruar qëllimet e vërteta të veprimtarisë së tij politike. Por ai është i gjallë në mes të gjallëve dhe me fuqinë e fjalës së tij godet në shenjë, aty ku duhet…!!!

Jusufi dhe Bardhoshi në mbrëmjen festive të 28 Nëntorit 1981 (Foto: Faridin Tafallari)

Jusuf Gërvalla: "*Kemi dëgjuar të flitet, se si në një numër të "Zërit të Rinisë", i cili botohet në Kosovë, vite më parë diku nga viti 67, figuron një fotografi e Fadil Hoxhës, ku gjoja ai ka ngritur gishtin dhe nën fotografinë e tij qëndrojnë fjalët Republika e Kosovës. Qarkullojnë fjalë të themi të drejtën, se informata të sakta për*

ekzistimin e një fotografie të tillë, me fjalë të tilla nuk ekzistojnë. Mirëpo nga ana tjetër është përmendur fakti, se edhe udhëheqja kosovare, edhe populli kosovar, sidomos në vitin 68 dhe në vitin 1974, kanë paraqitur një kërkesë të tillë, për arsye, se një kërkesë e tillë ishte e logjikshme dhe e drejtë edhe para vitit 1981.

Mirëpo po të nisemi nga angazhimi i Fadil Hoxhës, me kompani, me realizimin e të drejtave të ligjshme kushtetuese, për shqiptarët, që jetojnë në Jugosllavi, atëherë mund të themi, se edhe po të jetë bërë një kërkesë e tillë, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës nga Fadil Hoxha me kompani, ajo është shtruar në atë mënyrë, në mënyrën në të cilën shërbëtori shtron para zotriut një lutje dhe jo një kërkesë. Me këtë rast duhet të bëjmë një sqarim të qartë. Qeveria kuislinge e Kosovës, e cila ka tradhtuar me themel interesat e popullit shqiptar në Jugosllavi edhe po ta bëj kërkesën për një republikë apo çfarëdo të drejte tjetër kushtetuese e njerëzore, për shqiptarët në Jugosllavi, këtë kërkesë do ta bëj formalisht edhe do ta bëjë në formë lutje edhe posa të paraqitet problemi i parë, siç është paraqitur më 68, në se është e vërtetë ç'kërkesa, siç është paraqitur po ashtu në vitin 1974. Fadil Hoxha me shokët janë treguar të gatshëm, për t'u tërhequr sa më shpejt nga kërkesat e tilla.

Po ndryshon krejtësisht mënyra, ndryshon krejtësisht intensiteti, me të cilën rinia revolucionare dhe populli shqiptar në Jugosllavi e paraqiti kërkesën, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, në pranverën e përgjakshme të këtij viti (mars 1981). Nuk është fare e vështirë, të thuhet se asnjë popull dhe kështu as populli ynë kurrë nuk ka mundësi të shtrojë kërkesa në rrugë të padrejtë. Prandaj mund të mendojmë dhe të jemi të kënaqur, të jemi shumë të gëzuar, që populli ynë diti ta bëjë kërkesën pikërisht në një kohë të tillë, kur edhe ekzistojnë kushtet më objektive për realizimin e saj, pa marrë parasysh viktimat, që u tregua e gatshme qeveria e Beogradit, të shkaktojë në radhët e popullsisë shqiptare, pa marrë parasysh reprezaljet, që ajo po merr kundër rinisë dhe popullit shqiptar, pa marrë parasysh këmbënguljen e saj, që me rrena, me demagogji, me shpifje e trillimet më të poshtra ta hedhë poshtë kërkesën, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës.

Dhe pyetje e tretë ishte, se deri kur do të presë populli, që të realizohet Kosova Republikë. Në pamundësi, që të zgjatemi, për arsye që nuk është e hijshme, që kjo tribunë këtu të shndërrohet në tribunë të dy-tre shokëve, po ne e kemi menduar si një tribunë të popullit, ku do të marrë pjesë ai që është i interesuar të bëjë një pyetje ose të parashtrojë një problem. Po të përpiqem t'i bie shkurt. Kjo pyetje, se deri kur do të presë populli, që të realizohet kërkesa Kosova Republikë, është çështje e objektivitetit. Populli në radhë të parë nuk është duke pritur fare, për arsye se , këtu disa herë u tha sonte edhe mendojmë se, nuk do të mund ta mohojmë, që populli, me aksione të ndryshme, me parulla, me sabotimin e diferencimeve politike, me injorimin e tyre në çdo mënyrë, është duke marrë të gjitha masat që mos pajtohet me situatën të cilën ia imponon qeveria e Beogradit. Prandaj populli nuk është duke pritur, populli ka bërë një hap të drejtë, një hap të ligjshëm, ka bërë një hap, i cili tash i lejon atij që të kthehet edhe të presë përgjigjen përfundimtare të qeverisë shoviniste të Beogradit. Populli pa dyshim është ai, që e di më së miri deri kur duhet të presë që të realizohet kërkesa Kosova Republikë. Populli është i pagabueshëm!!! Unë, ti ai tjetri mund të gabojmë të gjithë me radhë, për arsye se jemi njerëz, jemi individ, kurse populli, i cili po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës, që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, pa kurrfarë dyshimi, do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit, për fitimin e statusit të Republikës. Kosova Republikë!!!

Dhe ne, si bij të këtij populli, që jemi, kurrsesi nuk duhet ta vëmë mendjen në gjumë! Nuk duhet të kotemi, duhet të jemi sy qelë, ta masim pulsin e popullit dhe të

presim prej tij, ato detyra, që na shtron ai! Të presim prej tij ato rrugë, që na përcakton ai dhe të jemi gjithmonë të gatshëm, që t'i përgjigjemi! S'ka kurrfarë dyshimi, se kur do të tregohet jo objektive pritja e mëtejshme, për kërkesën Kosova Republikë, populli do të dijë ta hedhë poshtë një kërkesë të tillë edhe të dal me kërkesë tjetër, me fjalë të tjera, me qëllimin e tij të fundit që është ka qenë dhe do të jetë bashkimi i gjithë shqiptarëve, bashkimi i ligjshëm i gjithë shqiptarëve në shtetin e tyre kombëtar!

(...) Se ç'ka do t'i sjell, çfarë të mira do t'i sjellë Kosovës statusi i Republikës, ne ose duhet të realizojmë (analizojmë) ta shtrydhim mendjen , të mendojmë ditë e natë. Kemi edhe disa pika të tjera si të mbështetemi edhe të logjikojmë pse një njeri i mençur thotë, se mendimi është e vetmja parajsë, prej së cilës nuk mund të na ndjekin. Ta zëmë se një pikë mbështetje prej të cilës mund të nisemi ne kur të analizojmë, se çfarë të mirash do të na sjellë statusi i Republikës për Kosovën, mund të drejtohemi konkretisht te armiku. Po të ishte kërkesa Kosova Republikë, një kërkesë boshe, një kërkesë në ajër, një kërkesë mendje lehtë, një kërkesë, të cilën e kanë bërë aventurierët, një kërkesë të cilën e kanë bërë, ata që ëndërrojnë pa baza, pa farë dyshimi se Beogradi, qysh më 11 mars të këtij viti, do të dilte me dokumentin për statusin e Republikës së Kosovës dhe do të na thoshte urdhëroni shqiptarë ja ku e keni Republikën! Por a është kështu, po e shohim që prej afër nëntë muajsh. Të gjitha forcat, gjithë plehun, gjithë vrerin shovinist të 74 vjetëve, qindra vjetëve më të përparshëm, Beogradi, tashmë e ka akumuluar, e ka grumbulluar, për ta shtypur kërkesën e Kosovës Republikë. Prandaj ne po duam ta vlerësojmë punën. Mund të nisemi edhe nga ky moment, po të ishte kjo kërkesë, një kërkesë me rëndësi të vogël, ose pa rëndësi, padyshim se Beogradi, do të shfrytëzonte rastin edhe do të na e bënte qejfin. Por është një kërkesë shumë vitale për popullin shqiptar dhe prandaj Beogradi, qeveria e Beogradit, si një qeveri shoviniste e tërbuar në kulm, na e mohon me aq këmbëngulje për arsye se , a do të mund të na mohojë apo jo do ta tregojë e nesërmja e shenjtë, se si do të mbarojë puna!

Po kështu kam edhe një përgjigje tjetër edhe një plotësim tjetër. Kur është fjala për saktësimin, se sa do të mund të na ndihmojnë forcat përparimtare, forcat internacionaliste në botë! Por sa do të mund të na ndihmojë vendi ynë amë Shqipëria Socialiste! Po ndalem te pika e parë, për forcat internacionaliste, nuk duhet të kemi iluzionin, se populli shqiptar, është populli më fisnik në botë, se populli shqiptar ka dallime të mëdha me popujt e tjerë në botë. Duhet të jemi realist dhe të themi se populli shqiptar është një prej popujve të botës, për të cilin vështirësitë, tragjeditë kombëtare, gjatë historisë e kanë prurë deri në këtë shkallë, sa ai sot të tregojë një afinitet për të qenë një popull luftarak, për të qenë një popull fisnik, për të qenë një popull i cili respekton të drejtat e të tjerëve, i cili s'ka kurrfarë aspiratash për të shkelë të drejtat e të tjerëve, i cili shumë i donë dhe madje nuk mund të jetojë pa të drejtat e liritë e veta. Nëqoftëse populli shqiptar ishte në gjendje që në vitin 1936/37 të dërgonte njësitë të tëra me në krye heronjtë e popullit tonë, që ne sot i njohim, si Asim Vokshi, Xhemal Kada, Mehmet Shehu, Justina Shkupi e të tjerë në Front, në luftë për republikën e Spanjës, atëherë si mund të dyshojmë dhe nëqoftëse ne dyshojmë në forcat progresive të botës do të gabojmë për arsye se është një mori njerëzish progresivë njerëzish liridashës në botë, që lirinë e të tjerëve e respektojnë si lirinë e vet. Kurrsesi nuk duhet të dyshojmë në ndihmën që do të kemi nga forcat internacionaliste të gjithë botën, aq më tepër kur sot ekziston një pishtar, i cili është burim për energjitë e këtyre forcave përparimtare. E ky burim nuk është as më shumë e as më pak po pikërisht vendi amë i shqiptarëve pra i kosovarëve, ai që sot të gjitha forcave në botë, po jua tregon rrugën e

drejtë të lirisë, të drejtësisë, njerëzisë, humanitetit, të demokracisë e socializmit.

Kur është fjala për pyetjen e tretë, që shtroi shoku natyrisht kjo është një çështje sa delikate aq edhe vitale, e rëndësishme për popullin tonë, jo vetëm për Kosovën, jo vetëm Maqedoni e Mal të Zi, por edhe për atë në Shqipëri, se siç tha më parë shoku emri Shqipëri, sot nuk është një emër të cilin nuk guxon ta prekë shqiptari, të cilin nuk guxon ta përmend shqiptari i Kosovës dhe përgjithësisht ai i Jugosllavisë.

Në një referat, në një punim, i cili u lexua sonte, u tha se një prej arsyeve të cilat Jugosllavinë e shtyjnë ta zhagisë kërkesën e kosovarëve për Republikë, është pikërisht përpjekja e Jugosllavisë, që edhe në momentin e ardhshëm, kur të shtrëngohet, të ja pranojë Kosovës statusin e Republikës, në atë moment të përpiqet, që Republikën e Kosovës, ta japë me kufij sa më të ngushtë! Mirëpo populli ynë, i cili derdhi gjakun në pranverë, që sot s'po pushon me aksione, që sot s'po pushon me parulla, i cili çdo ditë e më shumë po organizohet për ditë e më shumë, po del me veprime, që janë veprime karakteristike për një fazë të pjekur, ndoshta të kryengritjes popullore, jo të demonstratave të thjeshta, do të dijë të dalë përballë Beogradit, edhe kur është fjala për ngushtimin e kufijve të ardhshëm të Republikës.

Pa dyshim, thashë në fillim, se pyetja është delikate. Deri para pak kohësh kishte njerëz, që një atribut të tillë, do të thotë atributin e tradhtisë kundrejt kufijve të Kosovës, ja mveshin edhe Shqipërisë socialiste, duke thënë se ajo siguroi kufijtë e vetë dhe për vëllezërit e Kosovës, nuk deshi të dijë më tutje. Se sa ishte e vërtetë kjo parullë e përhapur aq më shumë e aq më pak përveçse nga Udbeja, u muar vesh sot. Sot e njëjta Jugosllavi, e cila deri më sot përhapte parulla se Shqipëria dhe PPSH-ja i kanë kthyer shpinën Kosovës, e njëjta Udbe sot përhap parulla , se si kërkesa për Kosova Republikë është kërkesë krye këput e Enver Hoxhës, i cili gjoja qenka përzier në disa punë të brendshme të Jugosllavisë.

Natyrisht se do të varet shumë edhe nga vëllezërit tanë në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Serbi, se sa do të ju afrohemi realizimit të kërkesave tona objektive plotësisht të ligjshme. Po të jetë puna te kosovarët, për ata që i kanë pjekur hesapet, ata që e kanë shtrydhur mendjen për luftën e kaluar në mars e në prill e për këtë që po vazhdon e sidomos për atë që do të vijë, këtu është shumë fjalë e rëndë, që flitet për ndonjë tradhti të tillë, që të flitet për ndonjë harresë kur është fjala për vëllezërit në Maqedoni edhe në Mal të Zi. Por natyrisht në drejtimin e asaj, që të realizohen të drejtat e ligjshme të të gjithë popullit Shqiptar në Jugosllavi, për përfshirjen e të gjithëve brenda kufijve të ardhshëm të Kosovës, kjo varet shumë siç thashë edhe më parë, nga vetë aktiviteti që do të zhvillojnë vëllezërit tanë në regjionet përkatëse. Por duhet ta kemi guximin e të flasim objektivisht e të themi, se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, siç e tha kohë më parë Zëri i Popullit, pikërisht Arbër Korabi, që kjo kërkesë para se të jetë një aspiratë, një qëllim të fundit të popullit shqiptar në Jugosllavi, paraqet më parë një protestë që do të thotë se vetë kërkesa që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës është një kërkesë, e cila flet qartë se në këtë moment popullit shqiptar në Jugosllavi ka përqafuar idetë e luftës, për një autonomi të vërtetë të shqiptarëve në Jugosllavi.

A është e drejtë kjo, mund të kthehemi mbrapa në histori. Në kohën e Lidhjes së Prizrenit, apo në kohën e kryengritjeve të mëdha të Kosovës, më 1908/10/11 ku 12 kushtet objektive nuk lejonin, që populli në atë kohë të dilte menjëherë me kërkesën për pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Por populli u detyrua të dalë për një autonomi në radhë të parë, që do të jetë themeli i shëndoshë edhe për luftën e mëtutjeshme edhe për fitoren e pavarësisë së plotë të popullit shqiptar.

Një rrugë e tillë, sa do që historia nuk përsëritet na imponohet sot edhe ne popullit shqiptar në Jugosllavi dhe gjithë kombit tonë kur është fjala për realizimin e të drejtave tona qoftë në kuadër të kufijve jugosllavë, qoftë me bashkimin e plotë që do të bëhet nesër patjetër në mes gjithë shqiptarëve që jetojnë kudo në tokat e tyre." (ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981; www.albaniapress.com, 22 nëntor 2008)

13. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Më 7 dhjetor 1981, me postë, paradite, ka ardhur tek Jusufi një zarf postal me dy dokumente në te. Njëri ka qenë ftesa personale (me sa më kujtohet), individuale apo familjare për Jusufin, për dasmë dhe tjetri ka qenë një dokument me titull "Thirrje - Të gjithë në Front të gjithë për Frontin", që në bazë kishte të pavërtetën, pra ishte një lloj testimi se mos këtë të pavërtetë e këtë manovrim po e përbinë edhe Jusufi. Jusufi po atë ditë, në praninë time i shkruan këtë përgjigje Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla: "*Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

14. MOS U HABITNI NËSE NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E TË PAVËRTETAVE

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Jusuf Gërvalla: *"Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se* ***keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha, me manovrime nga ana juaj.***

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave. (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

Për këtë arsye, si rezultat i dokumentit "Thirrje - Të gjithë në Front të Gjithë për Frontin", po atë ditë në mbrëmje, më 7 dhjetor 1981 (këtë datë e përmendi në bazë të librit Terror, Dhimbje, Qëndresë, të Faridin Tafallarit, f.46), në studion e punës së Jusufit betohen edhe njëherë individualisht para Jusufit, si anëtarë të ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi***, Sefedin Tafallari dhe vëllau i tij Faridini, Remzi Ademaj, Nuhi Sylejmani nga rrethi i Kumanovës, Mejdi Rexha nga Korisha dhe dy të tjerë. Në këtë rast jo vetëm që shprehen qëndrimet e palëkundura të Jusufit, por me këtë hap e konsideron edhe si punë plotësuese të letrës që ia dërgon "Frontit". Në mbrëmjen e 7 dhjetorit 1981, tek Jusufi kam qenë edhe unë.

15. Jusufi e Kadriu fillojnë të anëtarësojnë në organizatat e veta

Jusufi fillon të anëtarësojë anëtarë në Lëvizjen e tij, e Kadriu në Frontin për Republikën e Kosovës.

Sefedin Tafallari

I. Kelmendi: *"Jusufi dhe Kadriu fillojnë anëtarësimin. Jusufi anëtarësonte në Lëvizje, ndërsa Kadriu në Frontin për Republikën e Kosovës." (Atentatet, f. 306)*

Shtrohet pyetja se prej kujt dhe kur e ka marrë vesh I. Kelmendi se Jusufi po anëtarëson anëtarë në Lëvizjen e tij, e cila e ka ruajt rreptësishtë fshehtësinë e anëtarëve të saj? Prej kujt e ka marrë vesh I. Kelmendi se Kadri Zeka po anëtarëson anëtarë në Frontin e vetë?

Faktin se 7-8 shokë të Shtutgartit, janë betuar si anëtarë të LNÇKVSHJ-së para Jusufit, më 7 dhjetor 1981, në mesin e të cilëve kanë qenë Remzi Ademaj, Sefedin Tafallari, Mejdi Rexha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani e disa të tjerë e ka përmend për herë të parë Farin Tafallari në librin Terror Dhimbje Qëndresë (faqe 46) të botuar më 1997.

Faridin Tafallari: *"Më 7 dhjetor të vitit 1981 Jusufi ftoi disa nga shokët e këtij rrethi për të bërë betimin. Më ftoi edhe mua... U nisëm dhe unë mora me vete vëllaun tim,* ***Sefedinin****, pasi isha marrë vesh edhe me Jusufin. Vëllai kishte shfaqur dëshirë për këtë gjë."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 46)

Këtë fakt të bërë publik më 1997 I. Kelmendi mundohet me na e shitë si zbulim të një sekreti të madh duke u përpjekur të na e mbush mendjen se Jusufi paska biseduar me te se si të organizohet me shokët e vetë të Shtutgartit. Por nuk është vetëm ky rast që I. Kelmendi mundohet të vjedhë nga libri i Tafallarit "sekrete të ngjashme" pra fakte publike që nga viti 1997 e të na i servoj si zbulime 10 vite më vonë, në shkurt 2007.

Faridin Tafallari: *"Para se të botoje librin tënd "Atentatet", m'i kërkove librat e mi "Terror, Dhimbje, Qëndresë" dhe "Dhimbje Krenare" dhe shumë materiale të tjera të kësaj natyre, dhe unë edhe pse e dija, se ti nuk ke besë t'i dërgova...por ti nuk m'i ktheve kurrë!"* (IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE

BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!??? , www.albaniapress.com, 5 qershor 2009)

16. KADRIU I PROPOZON ANËTARËSIM IBRAHIM KELMENDIT POR AI NUK PRANOI

Shefqet Cakiqi-Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.* (Fjalë të drejtuara Ibrahim Kelmendit, Afishuar me: 23.03.2007 21:22, www.kosova.de)

Ibrahim Kelmendi: *"Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë."* (Fjalë të drejtuara Shefqet Cakiqit-Llapashticës, Afishuar me: 23.03.2007 22:57, www.kosova.de)

Jusuf Gërvalla*: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to**, tani që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Dëshmitari i komunistëve të OMLK-së, Ibrahim Kelmendi nuk pranon të bëhet shok organizate me Kadri Zekën.

Ibrahim Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi** me arsyetimin se dëshironte të priste edhe ca, pasi bisedimet duhet të rindodhnin shpejt dhe ato do të sillnin bashkimin."*(Atentatet, f. 306)

Kush e di këtë punë më së miri pos I. Kelmendit? Se si nuk pranon Ibrahim Kelmendi të bëhet shok në një organizatë me Kadri Zekën, përveç Jusufit, në mënyrë të mrekullueshme

-e dëshmon Faridin Tafallari:

Faridin Tafallari*: "Për herë të parë u prezantova me të në Shtutgart; ai ishte me Ibrahim Kelmendin që kishte telefonuar të vija në takim. M'u afrua dhe më tha: "Ti Faridin me të vërtetë je luftëtar i lirisë. Të kam veçuar nga të tjerët. Duhet të bisedojmë bashkë shtruar e gjerësisht.*

Po i thash - jam i lumtur dhe me dëshirë pres atë çast. Që aty u nisëm për në banesën time. Kadriu me Ibrahimin e kishin vendosur që më parë të më takonin dhe prandaj më kishin telefonuar... Kadriu më foli për Organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK). Më pyeti se a isha i organizuar diku dhe unë iu përgjigja se për këtë kam biseduar me Jusufin. ...

Çështjen e organizatave si e shikoni shoku Zekë, fjalën e kam për bashkimin e tyre se Jusufi më ka folur për bashkimin e të gjitha organizatave që veprojnë.

*-**Po Faridin tha Kadriu**, - nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.*

***Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar** dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)." (Terror, Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 37-38)*

- e dëshmon Hasan Mala, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë:

Hasan Mala: *"Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f. 382)

- e dëshmon Xhafer Shatri, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë.

Xhafer Shatri: *"Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës..."*. (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, f. 382)

Për sqarim në këtë rast dua të them se vlerësimet e mrekullueshme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit për librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë (1997) gjenden të botuara në librin vijues të F. Tafallarit, Dhimbje Krenare (Tiranë, 1998).

Dëshmia e Faridin Tafallarit, Hasan Malës dhe Xhafer Shatrit për bashkimin e Kadri Zekës me Frontin e Kuq Popullor përputhet tërësisht me faktin që na e ka lënë Jusufi me shkrim.

Jusuf Gërvalla: *"Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to**, tani që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Jusufi e di dhe na e jep faktin më të fuqishëm e të padiskutueshëm se **ku bënë pjesë** dhe cilët janë **shokët e rinj** të Ibrahim Kelmendit, të cilët ky far Ibrahim Kelmendi, i cili është person "*që i respekton vendimet*", e demonstron besnikërinë për shokun e vetë të vrarë në këtë formë:

"*Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi"***,
e mohon me sa fuqi që ka. Por nuk është vetëm Ibrahim Kelmendi që e mohon Kadri Zekën e gurin e varrit të tij. Ky farë Ibrahim Kelmendi, ky farë shoku i Kadri Zekës është dëshmitari i besueshëm i vëllezërve të Kadriut, Saime Isufit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës e Mehmet Hajrizit.

17. Jusufi nuk i bëri Ibrahim Kelmendit asnjë propozim

Jusufi nuk ia bëri I. Kelmendit asnjë propozim për anëtarësim në Lëvizjen e tij për dy arsye kryesore:

Ibrahim Kelmendi*: "Kurse Jusufi nuk ia bëri Miranit asnjë propozim, meqë*

***Jusuf Gërvalla: 1**. "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të*

cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër S. Novosellës, 13 maj 1981)

***J. Gërvalla: 2**."Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani **që e di se ku bënë ti pjesë**. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë."(Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)*

*ishte **dezinformuar** nga Nuriu se gjoja Miranin e kishte futur nën tutelë të tij Kadriu dhe po e manipulonte, duke e **dezinformuar** edhe për takimin në Turqi."(Atentatet, f.306-307)*

I. Kelmendi e pranon që Jusufi nuk i ka bërë atij asnjë propozim për ta anëtarësuar në Lëvizjen e tij. Po I. K. nuk mjaftohet vetëm me kaq. Ai asnjë shpjegim, si në tërë librin, nuk e lenë përgjysmë por e zbërthen bindshëm gjer në fund. Pra ai (I. K.) na e tregon edhe shkakun se pse Jusufi nuk i ka bërë atij asnjë propozim.

Pra Jusufi manipulohet jo vetëm nga Sabri Novosella, por edhe nga Nuhi Sylejmani, pasi Jusufi nuk është i aftë të gjykojë drejtë e të nxjerrë përfundime të pavarura nga kontaktet e tij me Kadri Zekën e I. Kelmendin. Përkundër faktit se Jusufi i ka nxjerrë 3 numra të Bashkimit, si organ i "Frontit të Kuq" (dy numra) apo "Frontit të Kuq Popullor" (një numër) na del se ai nuk është në gjendje të vlerësoj se kush është I. Kelmendi por për të arritur në konkluzionet e tij i duhet ndihma e Nuhi Sylejmanit.

Jusuf Gërvalla*: "Ti mund dhe besoj **se je i painformuar** lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

18. BOJKOTIMI I *ZËRIT TË KOSOVËS* NGA KADRI ZEKA

A ka shkruar dikush deri më sot për atë se Kadri Zeka nuk ka lejuar që tek shokët e tij të shpërndahet "Zëri i Kosovës"?

I. Kelmendi: *"Të gjithë u angazhuan për shpërndarje të* Lirisë *dhe të* Zërit të Kosovës*, edhe pse gojëkëqijtë dhe përçarësit, përgojonin e dezinformonin se gjoja Kadriu e Mirani po sabotonin shpërndarjen e Zërit të Kosovës."* (Atentatet, f. 307)

A ekziston ndokush tjetër, që e ka trajtuar çështjen e mospranimit të "Zërit të Kosovës" në ato pika ku ka pas ndikim OMLK-ja?

Faridin Tafallari*: "Jusufi më ka thënë se aty këtu kishte lindur edhe ndonjë mospajtim i vogël; për to kishin dijeni vetëm njerëzit e organizuar bile shumë të pakët, ata që ishin më të besuar.*

Unë di një rast të tillë: 'Jusufi me Bardhoshin sollën organin e Lëvizjes (LNÇKVSHJ) 'Zërin e Kosovës" në Nagold. Në makinën e tyre kishin edhe organin Liria. Kur ma dha 'Zërin e Kosovës', Jusufi më dha edhe disa numra të 'Lirisë", duke më thënë: 'Faridin, shpërndaji edhe këto; edhe pse ata të OMLK-së nuk po pranojnë të marrin 'Zërin e Kosovës" për ta shpërnda, ne do ta shpërndajmë si 'Zërin e Kosovës' ashtu edhe 'Lirinë'." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 39)

Faridin Tafallari*: "Në mëngjes u kthyem; nuk donim t'ia ndalnim këngës në minibusin që po na binte sërish në qytet. Jusufi ishte më i lodhur se ne sepse ai punonte edhe për nxjerrjen e gazetës "Zëri i Kosovës"; atë e mundonte edhe mosmarrëveshja*

me organizatën tjetër ku kishte edhe anëtarë që nuk pranonin ta merrnin dhe ta shpërndanin "Zërin e Kosovës"."(Terror-Dhimbje-Qëndresë f. 48)

Të shohim se çka thotë Shkolla e UDB-së, e përfaqësuar nga Abdullah Prapashtica.

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Ndër mërgimtarë qarkullonte një lajm i pakonfirmuar, se gjoja Kadri Zeka e kishte ndaluar shpërndarjen e „Zërit të Kosovës" në Zvicër, kurse në anën tjetër i kishte ftuar në dasmën e tij, që do të mbahej më 2 janar 1982, në qytetin Bile Biene të Zvicrës, jo vetëm Jusufin e Bardhoshin, por më kishte ftuar edhe mua dhe shumë mërgimtarë të tjerë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.66)

Përkundër pakonfirmimeve të fjalëve të vendosura nën emrin e Nuhi Sylejmanit, fjalët e Faridin Tafallarit konfirmohen në mënyrë të mrekullueshme nga:

Hasan Mala*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

dhe

Xhafer Shatri*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...".* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f. 382)

19. Dasma e Kadri Zekës dhe Saime Isufit

Saime Isufi*: "Pasi mora këtë vendim, Kadriu në konsultim me shokët, filloi të organizonte një dasmë. U bë një dasmë e thjeshtë, me 'dasmorët' e republikës së Kosovës."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008, f. 99)

Hydajet Hyseni*: "E tillë ishte miqësia e tyre gjer në fund. Në dasmën e Kadriut, Jusufi dhe Bardhoshi ishin mysafirët më të nderuar."* (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 118)

Hydajet Hyseni*: "Shprehje e frymës gjithnjë e më të fortë të bashkimit dhe në funksion të këtij bashkimi ishte edhe dasma e Kadri Zekës me shoqen e punës dhe luftës ilegale, Saime Isufin, 'Bulen'. Quhej Bule në shembullin e antifashistes Bule Naipit."* (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 141)

Se Jusufi e Bardhoshi ishin *mysafirët më të nderuar* në dasmën e Kadriut e Saimes e vërteton një njëfarë mënyre, shoku i nderuar i Kadriut, Ibrahim Kelmendi.

I. Kelmendi*: "Viti i Ri 1982 do t'i gjejë të gëzuar Jusufin, Kadriun, Bardhin, Miranin dhe shumë të tjerë. Kadriun sepse ishte bashkuar me Bulen. Të tjerët sepse po u martohej bashkëveprimtari dhe ishin ftuar në dasmën e tyre që do ta bënin, më 2 janar në Zvicër.* ***Por, gëzimi i Jusufit kufizohej pothuajse vetëm në faktin se një shqiptar, i njohur i tij, po martohej, ndërsa ishte në dilemë nëse do të merrte pjesë në dasmë****. Më në fund gjykoi se duhej të merrte pjesë, më shumë për hatër të dasmorëve që ishin kryesisht aktivistë të të njëjtave radhë. Ata dëshironin t'i shihnin udhëheqësit e tyre të bashkuar. Sa për Kadriun, Jusufi nuk do të merrte pjesë. Me të ishte hidhëruar që nga tetori." (Atentatet, f.308)*

Ta zbërthejmë citatin e lartpërmendur në pjesët përbërëse.

a) Viti i Ri 1982 do t'i gjejë të gëzuar Jusufin..

b) Të tjerët sepse po u martohej bashkëveprimtari dhe ishin ftuar në dasmën e tyre që do ta bënin, më 2 janar në Zvicër.

Shtrohet pyetja se a i ka ftuar Kadri Zeka personalisht Jusufin, Bardhin dhe familjet e tyre në dasmë apo jo?

c) Por, gëzimi i Jusufit kufizohej pothuajse vetëm në faktin se një shqiptar, i njohur i tij, po martohej.

Sipas shembësit të mitit të Jusufit, del se Jusufi fillimisht gëzohet tërësisht dhe gëzimi i tij në intensitet, nuk dallohet prej gëzimit të të tjerëve, por kur i bien më vonë ndërmend se për çka është fjala, gëzohet vetëm pjesërisht.

d) Jusufi ishte në dilemë nëse do të merrte pjesë në dasmë.

Kujt ia shfaqi ato dilema rreth pjesëmarrjes së tij në dasmë?

e) Më në fund gjykoi se duhej të merrte pjesë, më shumë për hatër të dasmorëve që ishin kryesisht aktivistë të të njëjtave radhë. Ata dëshironin t'i shihnin udhëheqësit e tyre të bashkuar.

Qe sa e sa herë e kemi pa Jusufin të pavendosur, që është për keqardhje, që manipulohet nga jointelektualët, se bënë gjykime të gabuara, por në këtë rast gjykon (I. Kelmendi na len pak si në mjegull dhe nuk na sqaron se a është gjykim i drejtë kësaj radhe apo jo) të merr pjesë për hatër të dasmorëve.

Prapë duhet të pyesim: A e ka ftuar personalisht Kadriu, Jusufin në dasmë apo jo?

Nëse e ka ftuar Kadriu Jusufin në dasmë atëherë del se shkaku i vetëm dhe krejtësisht i vetëm për të shkuar në dasmë është ftesa që i ka ardhë prej Kadri Zekës.

A ka mundësi që Kadri Zeka të mos e ketë ftuar Jusufin në dasmë dhe ai (Jusufi) i ka shkuar i paftuar e vetëm për hatër të dasmorëve?

Nëse del se marrëdhëniet e Kadri Zekës dhe Jusufit paskan qenë në nivel kaq të ulët në fund të dhjetorit 1981, dhe përkundër këtyre marrëdhënieve të ftohta Kadri Zeka i fton Jusufin e Bardhin me familje në dasmë, prapë shtrohet pyetja: Pse Kadri Zeka i dërgon ftesë Jusufit për dasmë? Pse e respekton shumë Jusufin apo më shumë për hatër të dasmorëve?

f) Sa për Kadriun, Jusufi nuk do të merrte pjesë.

A ka mundësi që Jusufi, përkundër ftesës së Kadri Zekës nuk do të merrte pjesë dhe nuk do t'ia kthente një përgjigje me shkrim.

Shtrohet pyetja mos i ka dërguar Jusufi ndonjë lutje Kadri Zekës që të ftohet prej tij në dasmë?

f) Me të ishte hidhëruar që nga tetori.

A është e vërtetë apo jo se Jusufi është hidhëruar me Kadri Zekën si person privat, që nga tetori 1981 dhe a i ka shkëputë lidhjet me te prej kësaj kohe?

20. DY FTESA TË KADRI ZEKËS

Kush ishin të ftuar në dasmë?

Ibrahim Kelmendi*: "Dasmorët vinin nga metropole të ndryshme evropiane. Kadriu ishte kujdesur të thërriste* ***dy a tre veta nga secili metropol*** *ku kishte shqiptarë të angazhuar për veprimtari çlirimtare.* ***Vetëm nga Dusseldorfi ai kishte ftuar më së shumti, gjashtë veta, me Miranin shtatë."*** (Atentatet, f. 308)

Shumë fjalë interesante. Të gjithë të ftuarit janë anonim, nga dy-tre veta prej çdo qyteti. Jusufi nuk përmendet me emër se ka qenë i ftuar. I vetmi që përmendet me emër si i ftuar është I. Kelmendi.

Prapë dalin disa pyetje: Pse ftoi Kadri Zeka më së shumti dasmorë nga Dusseldorfi? A rrjedhë nga kjo se Dusseldorfi ka qenë pika më e fuqishme mbështetëse e Kadri Zekës? Në çfarë rrethanash u bë Dusseldorfi pika më e fuqishme mbështetëse e tij? A është e vërtetë se më shumti dasmor pati nga Dusseldorfi? Sa ishin nga Shtutgarti? A ekziston ndokund ndonjë ftesë e shkruar me dorë të Kadri Zekës, dhe çka thuhet në ato ftesa?

Është interesant t'i lexojmë dy letra (ftesa) të shkruara nga dora e Kadri Zekës lidhur me dasmën e tij, dërguar Faridin Tafallarit:

"Ftesë

Shokut Faridin Tafallari për pjesëmarrje në gazmendin tonë familjar, i cili do të organizohet në qytetin Biel të Zvicrës. Në mbrëmje do të marrin pjesë shumë miq e shokë tani si dhe mysafirë të huaj. Për këtë qëllim është siguruar një lokal i përshtatshëm që do të jetë 24 orë në disponimin tonë të plotë. Vendtakimi do të bëhet n'ora 17,15 min. (të shtunën më 2 janar) në Stacionin e Trenit të Bielit, ku pastaj së bashku do të vemi në lokalin e caktuar, që ndodhet në periferi të qytetit. Pjesëmarrja e ***juaj dhe bashkëshortes suaj*** *do të na gëzoj e nderoj.*
Përshëndetje vëllazërore, Zeça" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 404)

Kjo është ftesa për Faridinin dhe shoqen e tij Zade Tafallari. D.m.th. vetëm me këtë ftesë nga Shtutgarti u bënë katër (Faridini e shoqja dhe dy fëmijë) persona të ftuar. Në këtë kohë Faridini e ka pas fqinjë të parë Qemal Haxhillarin. Të dytë kanë banuar në adresën, Haiterbacherstr. 75, 7270 Nagold. Edhe Qemali ka shkuar në dasmë si i ftuar vetë i treti (me shoqen dhe një fëmijë). Pra nga familjet e Faridinit dhe Qemalit u bënë shtatë, d.m.th. sa krejt dasmorët e Dusseldorfit. Por shumë më interesante është ftesa tjetër në formë të përgjithshme ku **emrat e të ftuarve** dhe **numrin e të ftuarve** Kadriu, përveç katër vetave të përmendur me emër, ia lenë Faridinit që të vendosë në atë mënyrë si ai ta gjej të arsyeshme. Letra që ka të bëjë me ftesën e gjerë është kjo:

"Shoku Faridin, bashkë me ftesën tënde po t'i dërgoj edhe disa ftesa tjera për t'ua shpërndarë njerëzve që e gjen ti të arsyeshme, pasi unë nuk po u di adresat (është fjala për njerëzit e mirë në rrethin tuaj). Ti vetëm u shënon emrat e atyre që duhet ftuar. Pos të tjerëve dëshiroj të ftohen ***baca Jahir (Jahiri - shën im)****,* ***Nuhiu*** *(****Sylejmani*** *- shën im) dhe* ***Shaban e Ismet Klaiqi****. Sa për të tjerët din ti vet.*
Prano shumë të fala vëllazërore e revolucionare, Zeça" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 404)

Çka do të thotë kjo?

- Se numri më i madh i dasmorëve prej Gjermanisë kanë qenë nga rrethi i Shtutgartit.
- Se çështjen se kush mund të shkoj në dasmë e kush jo, Kadri Zeka këtë punë nuk ia beson Jusufit por Faridin Tafallarit. Faridin Tafallari i boton këto ftesa për të treguar se sa afërsi e sa besim ka pasur tek ai Kadri Zeka. Por po të lexohet me kujdes ftesa e përgjithshme pikërisht ashtu siç shkruan në te:

Shoku Faridin, bashkë me ftesën tënde po t'i dërgoj edhe disa ftesa tjera për t'ua shpërndarë njerëzve që e gjen ti të arsyeshme, ***pasi unë nuk po u di adresat*** *(është fjala për njerëzit e mirë në rrethin tuaj)*

- rrjedh se Kadri Zeka sa e nderon Faridinin aq edhe shpreh keqardhje se si nuk ka mundur t'ua mësoj ende adresat e njerëzve më të mirë të rrethit të Shtutgartit. Çka kish me ndodh sikur Kadriu t'ua kishte ditur adresat personale aktivistëve më të mirë të Shtutgartit? Asgjë tjetër pos asaj se për këtë punë Kadriu jo që nuk e angazhon apo ia lenë Jusufit që të vendosë, por edhe më pak kishte me ia lënë këtë punë Faridinit. Kjo përputhet plotësisht me tezën e Tezave se komunistët e paepur të cilët e RUAJNË ROLIN HEGJEMON, duan bashkim me popullin, me masat dhe jo me krerët. Se nuk ka kala që komunistët nuk e marrin dhe nuk ka asnjë krerë që komunistët e paepur nuk ia rrëmihin dheun nën këmbë.

OMLK: ***"Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore.."*** (Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës, maj 1981)

Jusufi natyrisht me logjikën dhe sidomos me edukatën e tij e ka të pamundur të mendoj se Kadri Zeka është në gjendje t'i shkruaj Faridin Tafallarit letra të tilla, duke u nisur nga vetja se ai kurrë nuk do të shkruante në këtë formë të tillë. Edhe Faridin

Tafallari siç vërtetohet nuk mundohet, nuk pranon me e luajtur atë rol të cilin mundohet me ia dhënë Kadri Zeka, sepse vetë Faridini deklaron:

Faridin Tafallari: "*Aty nga mbarimi i mbrëmjes së Vitit të Ri, Jusufi na afroi dhe na tha: "Ju e dini se Kadri Zeka na ka ftuar në dasmën e vetë dhe ne duhet t'i shkojmë. Por ne në dasmë nuk kemi pse të përziejmë mosmarrëveshjet tona organizative. Ne do të shkojmë si miq."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 47)

Faridin Tafallari: *"Shkuarjen në dasmën e Kadriut në Zvicër, nga Shtutgarti e organizoi Jusufi."* (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 62)

Ibrahim Kelmendi, si për t'i plotësuar ftesat e dasmës së Kadri Zekës i dërgon Faridin Tafallarit letër në prag të vitit të Ri ku në mes tjerash thuhet:

I. Kelmendi: "Si shokë që jemi dëshiroi që gjatë vitit të Ri 1982 shoqëria të thellohet edhe më shumë, në baza të shëndosha revolucionare marksiste-leniniste!" (F. Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, f.411)

21. Ibrahim Kelmendi në mes Jusufit e Kadri Zekës

I. Kelmendi i nxitë dasmorët për të qeshur me shakat e tij, herë me e herë pa kripë.

Ibrahim Kelmendi*: "Mirani, që nuk ishte merakosur fare të vishej siç vishen dasmorët, kishte ardhur me xhinse të vjetruara, flokë të gjata e kaçurrela. Ai po i nxiste dasmorët për të qeshur me shakatë e tij, herë me e herë pa kripë." (*Atentatet, f. 309)

Jusufi është serioz dhe i vetëpërmbajtur e që nuk donë të bie në sy dhe I. Kelmendi i jep mësim Jusufit se si i ka hije e si nuk i ka hije të sillet në dasmë.

I. Kelmendi*: "Vetëm Jusufi rrinte serioz, i vetëpërmbajtur ulur në qoshen e poshtme të sallës për të mos rënë në sy. Bardhi, ndërkaq, po mundohej të integrohej në këtë atmosferë gëzimi. Duke parë Jusufin në këtë gjendje Mirani iu afrua.*

– Shoku Jusuf, nuk të ka hije të rrish kaq i ngrysur, kur të gjithë dasmorët janë të angazhuar në argëtim*. Nëse e ke inatin e sajuar nga shpifjet e dezinformatat. se Kadriu dhe unë kemi sabotuar shpërndarjen e Zërit të Kosovës, siç kam dëgjuar, atëherë këtu janë shumë aktivistë dhe mund t'i pyesësh vetë se cila është e vërteta.*

Jusufi e shikoi ngultas Miranin sikur desh t'i thoshte: "Or ti, hiqmu qafe se kam ardhur vetëm sa për të bërë radhën!". (Atentatet, f. 309)

I. Kelmendi që nuk të keqkupton kurrë, ia venë Jusufit melhemin mbi plagë.

I. Kelmendi*: "Por Mirani ia kishte vënë melhemin mbi plagë, meqë vërtet* ***shpifjet*** *dhe* ***dezinformatat e kishin hidhëruar më shumë*** *se dështimi i bisedës për bashkim, siç e vlerësonte ai."* (Atentatet, f. 309)

I. Kelmendi: *"Numrin e parë Jusufi e* ***botoi në nëntor****, të dytin në dhjetor. Në numrin e parë Jusufi* ***shkroi se bashkimi nuk u arrit për faj*** *të Kadriut, pa ia përmendur emrin. Aty shprehet dëshpërim kundër Kadriut, pa qenë në gjendje të gjykojë se fajtori i vërtetë ishte komanduesi i tij, Sabiti."* (Atentatet, f. 306)

22. DILEMAT E JUSUFIT

Jusufi, si harresës i madh na del shumë i lëkundur dhe ka nevojë për kthjellime nga I. Kelmendi.

I. Kelmendi (fjalë të atribuara Jusufit)*: "Pasi u mendua pakëz, ia ktheu:*

– Vërtet janë në gjendje këta aktivistë të dëshmojnë se ju nuk e keni sabotuar shpërndarjen e Zërit?" (Atentatet, f. 309)

Shtrohet pyetja se prej kujt e ka marrë vesh Jusufi se Kadri Zeka dhe OMLK-ja nuk duan, jo ta shpërndajnë por as ta marrin Zërin? Pyetje tjetër: A ka qenë Jusufi me të

vërtetë i shqetësuar apo fare i interesuar se Fronti i bashkëthemeluar dhe i emërtuar nga UDB-a nuk dëshiron ta shpërndaj Zërin e tij ashtu siç donë me na e mbush mendjen figura frontale e Frontit të UDB-së?! Se sa i shqetësuar ka qenë Jusufi se si pritet Zëri i tij nga Fronti i Kuq e tregojnë rreshtat e mëposhtëm:

Jusuf Gërvalla: 1. ”*Sa për organizatën e bashkuar rreth organit ”Bashkimi”, më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e “Bashkimit” në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të “Bashkimit”, (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.”*(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Jusuf Gërvalla 2. "*Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t’i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre,* ***pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

-dhe ja se si flet Jusufi për OMLK-në e Kadri Zekën:

Jusuf Gërvalla*: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me një shok të grupit të marksist-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre ”Liria”. Personalisht për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim në mes nesh dhe kemi rënë në ujdi që t’i bashkërendisim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash nëpër qendra të ndryshme evropiane…"* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 259-260)

Se OMLK-ja nuk është e interesuar ta shpërndaj Zërin e Jusufit në radhët dhe tek simpatizantët e vetë, kjo nuk ka qenë një çështje sekrete pasi qysh në fillim të nëntorit këtë qëndrim ia ka shprehë Kadriu direkt Jusufit. Pas botimit të numrit të parë të Zërit të Kosovës, Kadriu e ka quajtur atë plagjiat të Lirisë, d.m.th. vetë Jusufin si plagjiator të Mehmet Hajrizit, Hydajet Hysenit dhe Brat Berat Luzhës, të cilët natyra i ka zgjedhur për t'i kuptuar problemet ekonomike shoqërore e lëvizjet e shoqërisë njerëzore në tërë kompleksitetin e vetë, d.m.th. të jenë origjinal e pa ngjyrime të rrejshme.

Se kjo punë ka qenë kështu dëshmohet nga Faridin Tafallari, Hasan Mala dhe Xhafer Shatri.

Faridin Tafallari*: "Jusufi më ka thënë se aty këtu kishte lindur edhe ndonjë* ***mospajtim i vogël****; për to kishin dijeni vetëm njerëzit e organizuar bile shumë të pakët, ata që ishin më të besuar.*

Unë di një rast të tillë: 'Jusufi me Bardhoshin sollën organin e Lëvizjes (LNÇKVSHJ) 'Zërin e Kosovës" në Nagold. Në makinën e tyre kishin edhe organin Liria. Kur ma dha 'Zërin e Kosovës', Jusufi më dha edhe disa numra të 'Lirisë", duke më thënë: 'Faridin, shpërndaji edhe këto; edhe pse ata të OMLK-së nuk po pranojnë të marrin 'Zërin e Kosovës" për ta shpërnda, ne do ta shpërndajmë si 'Zërin e Kosovës' ashtu edhe 'Lirinë'." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 39)

Faridin Tafallari (duke u kthyer nga dasma): *"Në mëngjes u kthyem; nuk donim t'ia ndalnim këngës në minibusin që po na binte sërish në qytet. Jusufi ishte më i lodhur se ne sepse ai punonte edhe për nxjerrjen e gazetës "Zëri i Kosovës"; atë e mundonte edhe mosmarrëveshja me organizatën tjetër ku kishte edhe anëtarë që nuk pranonin ta merrnin dhe ta shpërndanin "Zërin e Kosovës"."* (Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 48)

- e dëshmon Hasan Mala, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë:

Hasan Mala*: Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)

- e dëshmon Xhafer Shatri, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë

Xhafer Shatri: *"Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës..."*. (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, f.382)

Pyetje vazhduese: A është përpjekur Jusufi qoftë edhe me një fjalë të vetme apo gjest të vetëm ta barazoj, ta vendosë në një plan e ta fus në një thes Kadri Zekën me Ibrahim Kelmendin ashtu siç është munduar vetë Kadri Zeka ta barazoj e fus në një thes Jusufin me Ibrahim Kelmendin dhe Frontin e tij? Natyrisht se Jusufi nuk është përpjekur ta bëjë kurrë këtë punë në jetën e tij. Ajo çka mbetet fakt është se me mjeshtëritë e komunistëve të cilët e RUAJNË ROLI HEGJEMON, Fronti i Kuq i është bashkuar OMLK-së dhe Ibrahim Kelmendi pa asnjë rezervë i ka shërbyer Kadri Zekës në përpjekje për ta minuar dhe izoluar punën e Jusufit jo vetëm në rrethet e veta por edhe në Shtutgart.

23. Thirr cilët të duash dhe pyeti vetë!

Për ndryshim nga qëndrimi harresës dhe i lëkundur i Jusufit, I. Kelmendi rrezaton siguri të plotë.

I. Kelmendi:*"– Sigurisht, thirr cilët të duash dhe pyeti vetë! – tha Mirani me një zë që përmbante siguri të plotë. Ai ishte i sigurt se, jo vetëm që nuk e kishte sabotuar shpërndarjen e* Zërit*, por as që e kishte komentuar me ndonjërin shkakun e dështimit të takimit për bashkim."* (Atentatet, f.309)

Kur jemi tek dasma e tek "ndërmjetësimi" i I. Kelmendit si "njeri i paanshëm" dhe vetë atmosfera e dasmës duket më së miri nga letra e Jusufit dërguar shokut organizativ të Kadri Zekës, Ibrahim Kelmendit:

Jusuf Gërvalla: *"Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar* ***që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij.*** *Arsye për të qenë* ***aq gjaknxehtë*** *mbase nuk kam pasur.* ***Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq****. Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime* ***të një shoku (Kadri Zekës - shën. i Xh. D.))*** *, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin* ***një lojë e pamirë****, së pari*

***me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë**, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411)

Jusufi është gjaknxehtë në dasmë për shkak të fushatës së OMLK-së, të Kadri Zekës por edhe të I. Kelmendit kundër Jusufit personalisht dhe Lëvizjes së tij me "argumentet" se Lëvizja e Jusufit është nuk është komuniste, se në kryesi ka persona që nuk janë komunistë dhe çka është ma e keqja, edhe pse këta fatëzij nuk kanë fatin për t'u bërë komunistë të paktën nuk e bëjnë atë që është puna më e mirë për ta: të pranojnë të udhëhiqen nga komunistë që janë të paepur, pra nga komunistë që komunizmin e konsiderojnë si modë të kësulave.

24. Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!

Ftesa e dërguar për dasmë Jusufit i dërgohet së bashku me thirrjen e famshme: Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin! Jusufi i lëkundur e i pavendosur vazhdon të manipulohet nga shpifësit dhe dezinformatorët.

I. Kelmendi: *"Mirani nuk mund ta fshihte hidhërimin ndaj Jusufit se përse po u besonte shpifësve e dezinformuesve për të e për Kadriun."* (Atentatet, f.309-310)

Është shumë interesant se si Jusufi i lëkundur e i manipuluar në këtë kohë, nuk bënë dhe as nuk di të bëjë kurrfarë dallimi në mes Kadri Zekës dhe I. Kelmendit por i futë të dytë në një thes. Apo thënë edhe më qartë: A mundohet Jusufi ta futë Kadri Zekën e I. Kelmendin në një thes apo është plani i Kadri Zekës me e futë I. Kelmendin dhe Jusufin në një thes, respektivisht në një Front (e duke e lënë OMLK-në e tij të paprekur, d.m.th. të papërlyeme)?!

Kur jemi tek dezinformatat dhe përpjekjet e vënies së të tjerëve para aktit të kryer, të shohim se çka shkruan Jusufi në një letër të fillimit të dhjetorit 1981 dërguar Kadri Zekës. Por së pari t'i lexojmë fjalët e Hydajet Hysenit:

Hydajet Hyseni*: "Shprehje e frymës gjithnjë e më të fortë të bashkimit dhe në funksion të këtij bashkimi ishte edhe dasma e Kadri Zekës me shoqen e punës dhe luftës ilegale, Saime Isufin, 'Bulen'. Quhej Bule në shembullin e antifashistes Bule Naipit."* (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 141)

Sabri Novosella*: "Sa i përket asaj se unë paskam folur keq për Zeqën, kjo ka qenë kështu: Më pyeti Uka (Xhafer Shatri - shën. i Xh. D.) se pse janë prishë Jusufi me Zeqën kohëve të fundit? Ju përgjigja ashtu si ka qenë. Pas bisedimeve në Stamboll, Zeqa (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) ia kishte dërguar një vendim të rrejshëm se gjoja ishte formuar "Fronti për Republikën e Kosovës", gjë që Sokoli (Jusuf Gërvalla - shën i Xh. D.) ishte hidhëruar së tepërmi dhe i kishte thanun në një letër: Çdo gjë që e ka fillimin në gënjeshtër është e gjykuar në dështim që në fillim. Në lidhje me bisedimet e Stambollit ia pata dërguar një letër të Sokolit Ukës e cila ia kishte luajtur mendjen dhe tash po mundohet me qpifë diçka kundër meje në atë drejtim, por atë letër po ua dërgoj edhe juve."* (Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984)

Hydajet Hyseni ka aq të drejtë sa asnjë lexues i jashtëm nuk mund ta merr me mend. Së bashku me ftesën për dasmë, ku Jusufi ftohet si individ, Kadri Z. ia dërgon një ftesë shumë më interesante, me titullin "Thirrje! Të gjithë në Front të gjithë për Frontin!" Pra në këtë rast ndodh ajo që quhet; *Një udhë e dy punë*. Jusufi me të njëjtën dërgesë postale, me të njëjtin zarf, ftohet në dasmë si individ dhe bëhet manovrimi që Lëvizja e tij të vihet para aktit të kryer e të futet në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës. Këtë farë "Thirrje për hyrje në Frontin e madh", Kadriu ka dëshirë që vetë Jusufi ta shtyp, radhisë e shpërndaj në rrethin e vetë si postier i tij, të veprojë me te në të njëjtën

formë siç kishte vepruar në shtator me Tezat, pra ta bëjë një reprizim të ngjarjeve, sikur takimi i Stambollit të mos kishte ekzistue. Por ky manovrim e testim dështon tepër keq, pasi kësaj farë "Thirrje" Jusufi i përgjigjet me këto fjalë:

Jusuf Gërvalla*: "Mirëdita, shoku Z (Kadri Zeka-shën im)!*

Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ***ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë,*** *së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.*

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta.

Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha, me manovrime nga ana juaj.

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave. Me përshëndetje revolucionare, Drini (Jusuf Gërvalla-shën im)" (Marrë nga botimi i parë tek shkrimi i Faridin Tafallarit, IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!???, www.albaniapress.com, 5 qershor 2009)

25. RROBAQEPËSI ANADOLLAK PO E MANIPULONTE JUSUFIN

I. Kelmendi, edhe pse vetë figurë frontale e Frontit të pagëzuar nga UDB-a, e pa asnjë lidhje me Lëvizjen e Jusufit, bëhet bujar dhe e merr rolin e avokatit të Jusufit për ta mbrojtur atë nga manipulimet e Sabri Novosellës.

I. Kelmendi*: "Kisha parandjenjë se Rrobaqepësi anadollak po e manipulonte Jusufin. Ai edhe në Kosovë e kishte shpërdorur ilegalitetin dhe konspiracionin që t'i imponohej këtij."* (Atentatet, f.310)

Të shohim se sa është i gatshëm Jusufi ta pranoj I. Kelmendin si avokat ndaj manipulimeve të Sabri Novosellës:

Jusuf Gërvalla*: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre, pra* ***mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe*

sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

Ironia e fatit. Sabri Novosella nga Turqia mundohet me çdo kusht ta bëjë Jusufin më të zhdërvjelltë në mënyrë që ta afroj I. Kelmendin sa më shumë me Lëvizjen e Jusufit para se të tjerët t'ia rrëmbejnë nga dora. Por Jusufi nuk do të ishte kurrë Jusuf sikur t'i kishte ndjekur këshillat e të tjerëve pa i verifikuar e përputhë secilin hap me ndërgjegjen e vetë.

I. Kelmendi, i cili nuk të keqkupton kurrë, fletë për shkrimin apo kritikën e rreptë të Jusufit kundër Kadriut në numrin e parë të "Zërit të Kosovës".

I. Kelmendi: "Pastaj, mos vallë Jusufin po e shtynte të dyshonte se ne po e sabotojmë veprimtarinë e tij, meqë ai në numrin e parë të Zërit të Kosovës

> ***Jusuf Gërvalla**: "Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë, Shpendi e Besniku jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e **Shpendit, e Besnikut dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë."** (Letër S.N., 20 gusht 1981)*

*ka **shkruar rrebtë kundër Kadriut**!? Jo more, atë shkrim mund ta kishte bërë vetë Rrobaqepësi gjysmanalfabet dhe t'ia kishte redaktuar Jusufi...!" (Atentatet, f.310)*

A mund ndokush ta gjej komplet këtë numrin e parë të "Zërit të Kosovës" dhe të na tregoj se në cilën faqe, në cilën shtyllë e në cilin rresht Jusufi fletë apo aludon edhe vetëm me një fjalë të vetme kundër Kadri Zekës?

Përmbajtja e Zërit të Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, Nr.2, Janar 1982

Autori	Titulli
Jusuf Gërvalla	T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS (Fjalim që u lexua nga Jusufi në mbrëmjen e festimit të 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart)
KQ i LNÇKVSHJ	Abusus non tollit usum (Komiteti Qendror i LNÇKVSHJ në Shtutgart)
Jusuf Gërvalla	Të dashur lexues
	RINISË KOSVARE (Nga krijimtaria e re popullore - poezi)
Xhafer Durmishi	Kur s'është dëgjuar fjala është ndier pushka e shqiptarit
Xhafer Durmishi	Me dyqind e ca komunista lule nisi Shqipëria historinë e kuqe
Enver Hoxha	Është shkelur vullneti i lirë i shqiptarëve
Lenin	Vive la son du canon! (Me shënim hyrës të Jusuf Gërvallës)
Bardhosh Gërvalla	Ngathtësia anadollake dhe ligësia fashiste
Xhafer Durmishi	Një ditë që na i burrëroi edhe fëmijët
Jusuf Gërvalla	Në dijeni të vëllezërve në shërbimin ushtarak
Sabri	Adem Demaçi - simbol i rezistencës shqiptare

Novosella	
Jusuf Gërvalla	Mbase takohemi një ditë
Bardhosh Gërvalla	Milicia Serbe
Bardhosh Gërvalla	Familja Brecaj e tëra në burg
Ismail Kadare	Merr nga gjaku im
Jusuf Gërvalla	Njëri nga ata (Burimi për këtë shkrim është Sabri Novosella)
Jusuf Gërvalla	Haraçi për milicinë serbe
Hydajet Hyseni	Në ty Kosovë (poezi nga "Këngët e lirisë")
Jusuf Gërvalla	Si përçohen në Ballkan interesat e superfuqive

Zëri i Kosovës, i nëntorit 1981 nuk e ka asnjë koment direkt apo indirekt për bisedimet e dështuara të bashkimit. Komenti i tyre gjendet në numrin e dytë, me të cilin ka qenë i mbushur gepeku i kerrit kundër të cilit janë drejtuar plumbat e vrasësve profesionist të UDB-së.

Jusuf Gërvalla: *"Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta, e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar****. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ..., - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."*(Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 2, shtylla 2)

Mund të thuhet se nuk është edhe aq gabim të bëhet një harresë e përzierje e vogël kohore që kap dy-tre muaj, në një libër të botuar 25 vjet më vonë. Në dukje mund të jetë kështu. Por këtu kemi të bëjmë me artikuj të shkruar dhe jo fjalë goje. Artikujt mund të verifikohen pasi gazetat janë ruajtur. Jusufi, në emër Lëvizjes së tij, LNÇKVSHJ, përmes shtypit, në jetën e tij, ka folur vetëm dy herë: në nëntor 1981 dhe janar 1982. Në nëntor 1981 është fjala e tij e parë, në janar 1982 është fjala e tij e fundit (edhe artikujt e Jusufit të botuar në Zërin e marsit janë të shkruar në janar 1982). Për këtë arsye këtu nuk mund të bëjmë fjalë për distancë dy-tre mujore në perspektivën 25 vjeçare, por çështja është tejet e rëndësishme pasi puna qëndron në faktin: Se cila është fjala e parë e Jusufit në gazetë, si anëtarë i LNÇKVSHJ (nëntor 1981) dhe cila është fjala e fundit (janar 1982). Dhe fjala e fundit e Jusufit për Kadri Zekën, OMLK-në dhe ish-inspektorin e UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica ("organizatorin e demonstratave të Pranverës 1981") është:

"Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta, e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë

anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar."

A është interesuar dhe shqetësuar me të vërtetë Jusufi se si është pritë Zëri i Tij në pikat ku ka pas ndikim I. Kelmendi?

Në faqet 311-313 të librit Atentatet, I. Kelmendi fletë se si Jusufi ka qenë i jashtëzakonisht i shqetësuar se si po pritet Zëri në pikat ku ka pas ndikim ai!

Jusuf Gërvalla*: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

A mund të jetë kjo e vërtetë? A është Jusufi aq i dezorientuar sa t'i fus në një thes Frontin e emërtuar nga UDB-a me OMLK-në e Kadri Zekës, Hydajet Hysenit e Mehmet Hajrizit? A është përpjekur Jusufi qoftë edhe me një germë të vetme t'i fus në një plan, në një thes Kadri Zekën me I. Kelmendin, figurën frontale të Frontit të TANJUG-ut?

Jusuf Gërvalla*: "Tash së fundi jam në kontakt edhe me një shok të grupit të marksist-leninistëve të Kosovës, të tubuar rreth organit të tyre "Liria". Personalisht për organin e tyre kam mendim shumë të mirë, po edhe shoku me të cilin kam kontaktuar duket i ngritur dhe i pjekur. Ka një mirëkuptim në mes nesh dhe kemi rënë në ujdi që t'i bashkërendisim veprimet. Lidhur me këtë, për fillim, kemi zënë të organizojmë një varg demonstratash nëpër qendra të ndryshme evropiane..."* (Letër S. Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 259-260)

26. Të kam pasur krah të djathtë çdo herë dhe vazhdoj të të kem

Jusufi i është mirënjohës I. Kelmendit për sqarimin se "Zëri i Kosovës" nuk është sabotuar në Dusseldorf apo Gjenevë.

I. Kelmendi: *"-Miran, sa shumë isha hidhëruar ndaj teje këto ditë! Tani të jam shumë mirënjohës për këtë sqarim.* ***Të kam pasur krah të djathtë çdo herë dhe vazhdoj të të kem."*** (Atentatet, f. 313*)*

Se çfarë ndihme pret Jusufi prej I. Kelmendit pas dhjetorit 1980 tregojnë fjalët:

Jusuf Gërvalla*: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për*

mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Jusuf Gërvalla*: " (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre, pra* ***mercenar i mercenarit***)."(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

A është e mundur që Jusufi t'i ketë thënë këto fjalë. Pasi e kemi pa më heret se i thotë I. Kelmendit naiv e i sinqertë, sigurisht që i ka thënë edhe fjalët e mësipërme. Këto shprehje artistike duhet të vërtetohen edhe me fjalët dokumentare në letrat e Jusufit.

Jusuf Gërvalla: *"I dashur shok Ibrahim, Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë mbase nuk kam pasur.* ***Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq.*** *Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një shoku, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin* ***një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë****, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411)

Pse Jusufi ia dërgon këtë letër (në mënyrë të rekomanduar) Ibrahim Kelmendit? Jusufi ia dërgon pasi në këtë kohë Ibrahim Kelmendi është shok organizativ i Kadri Zekës dhe është i involvuar në fushatën për luftimin, izolimin, dominimin dhe RUAJTJEN E ROLIT HEGJEMON kundër Jusufit, fushatë që e intensifikon Kadri Zeka prej tetorit 1981. Fjalët "*I dashur shok Ibrahim*" përveç formës së përgjithshme të mirësjelljes, duhet kuptuar më shumë si rikujtim i kohës në të cilën Jusufi ka bërë botimin e revistës Bashkimi, të kohës kur Jusufi e ka konsideruar I. K. "*një shok me të cilin* ***nuk kemi pasur*** *kufij*." Jusufi e pranon se në dasmë është treguar i padrejtë ndaj I. Kelmendit, pasi të gjitha gjërat që në gjaknxehtësi Jusufi ia numëron I. Kelmendit, në të vërtetë i ka merituar Kadri Zeka dhe jo ai (I.K.). Por për shkak të dasmës, Jusufi nuk mund t'ia thotë vetë Kadriut ato çka i ka merituar. Kjo letër si dhe të tjerat është e një rëndësie të jashtëzakonshme dhe do ta citojmë në vazhdim në pjesë të ndryshme.

27. Iu drejtua Jusufit me dashamirësi e dhembshuri

I. Kelmendi, i cili kurrë nuk të keqkupton, i drejtohet Jusufit me dashamirësi e dhembshuri.

I. Kelmendi*: "Mirani heshti për një moment për të menduar se çfarë duhej t'i thoshte.*

-Or Bacalok, – iu ***drejtua me dashamirësi e dhembshuri Jusufit****, ndaj të cilit rrallëherë e përdorte këtë epitet. – Si këta që po të dezinformojnë e nxisin këtu, ka për të dalë edhe Rrobaqepësi. Kjo më është bërë më e qartë se kurdoherë nga sytë e Bardhit kur bisedova me të pasi u kthye nga takimi në Turqi."* (Atentatet, f.313)

Del se Jusufin paska qenë e mundur ta nxitë dikush. Se Bardhi pas ardhjes së bisedimeve të dështuara në Turqi, në tetor 1981, paska biseduar për këto bisedime të dështuara me I. Kelmendin.

A mund të jetë kjo e vërtetë? A mund të ekzistoj ndonjë fakt që e dëshmon të kundërtën?

Jusuf Gërvalla*: "Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë mbase nuk kam pasur. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime të një shoku, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më* ***dalin një lojë e pamirë, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë****, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411)

Të analizojmë më tej se çka na informon i informuari mirë I. Kelmendi:

I. Kelmendi: *"Kjo më është bërë më e qartë se kurdoherë nga sytë e Bardhit kur bisedova me të pasi u kthye nga takimi në Turqi."* (Atentatet, f. 313)

Shefqet Cakiqi-Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.* (Fjalë të drejtuara Ibrahim Kelmendit, Afishuar me: 23.03.2007 21:22, www.kosova.de)

Ibrahim Kelmendi: *"Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë."* (Fjalë të drejtuara Shefqet Cakiqit-Llapashticës, Afishuar me: 23.03.2007 22:57, www.kosova.de)

Gërvalla*: "****Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur*** *në përçapjet* ***për bashkimin e dy organizatave****. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme.*

Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne*. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Se Ibrahim Kelmendi nuk e ka takuar asnjë çast të vetëm Bardhin, pas kthimit nga Stambolli, në tetor 1981, e vërtetojnë këto fjalë të I. Kelmendit të drejtuara Sabri Novosellës:

Ibrahim Kelmendi: *"I dashur shoku Mërgim (Sabri Novosella-shën im),*

...Gjatë takimeve që kishim, disa herë u sjellën bisedimet te bisedat në mes teje e shokut Zeqë. Lidhur me atë takim, mendoj, duhet të na informosh, pak më shumë se sa i ke shkruar "heroit". Them kështu pasi disa fjalë shpëtuan gjatë fjalosjes mes teje e shokut Ujkan (Xhafer Shatri-shën im), prandaj, pos arsyerave tjera, edhe që të mos lejohet mundësia për manipulim me fjalët që nuk janë inçizuar as mbajtur shënime. Sidomos do ndihmonte shumë informimi yt, pasi, me gjasë, ***vetëm ti je ndër të gjallët, që mund të informosh mbi bisedimet, ashtu siç janë zhvilluar***."(Letër Sabri Novosellës, 17 janar 1984)

Sabri Novosella: *"Sa i përket asaj se unë paskam folur keq për Zeqën, kjo ka qenë kështu: Më pyeti Uka (Xhafer Shatri-shën im) se pse janë prishë Jusufi me Zeqën kohëve të fundit? Ju përgjigja ashtu si ka qenë. Pas bisedimeve në Stamboll, Zeqa ia kishte dërguar një vendim të rrejshëm se gjoja ishte formuar "Fronti për Republikën e Kosovës", gjë që Sokoli (Jusuf Gërvalla-shën im) ishte hidhëruar së tepërmi dhe i kishte thanun në një letër: Çdo gjë që e ka fillimin në gënjeshtër është e gjykuar në dështim që në fillim. Në lidhje me bisedimet e Stambollit ia pata dërguar një letër të Sokolit Ukës e cila ia kishte luajtur mendjen dhe tash po mundohet me qpifë diçka kundër meje në atë drejtim, por atë letër po ua dërgoj edhe juve. IK e ka edhe ai një hall tjetër: i kishte thënë dikujt se gjoja unë e paskna "prishë" me Sokolin dhe ia dërgova një letër të Sokolit që ma ka dërguar me kohë dhe ajo ia kishte luajtur mendjen, pasi Heroi Sokol e ka treguar me fakte se kush është IK dhe unë jam ai që kam bërë çmos që Sokoli mos ta largoj krejtësisht IK-në."* (Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984)

I. Kelmendi ndien keqardhje për Jusufin për shkak se është manipuluar nga Sabri Novosella.

I. Kelmendi*: "Më* ***vjen shumë keq që do të zhgënjehesh rëndë në momentin që ke për ta takuar personalisht****, sepse ai nuk do të jetë më në gjendje të të manipuloj e të spekuloj në emër të ilegalitetit e konspiracionit, siç të ka manipuluar edhe në Kosovë, siç të ka injoruar për gati një vit e gjysmë pas arratisë sate dhe të tij."* (Atentatet, f. 313)

Pas shkrimit të shkëlqyeshëm rreth formimit Frontit të emërtuar nga UDB-a, I. Kelmendi vazhdon ta luaj rolin e avokatit të Jusufit në raport me anëtarët e udhëheqësit e Lëvizjes së vet. Por kjo është vetëm gjysma e të mirës. E mira e plotë është se edhe Jusufi e pranon I. Kelmendin si avokat për punët e brendshme të Lëvizjes së tij dhe i është mirënjohës, kësaj dore të djathtë, këtij armiku të sistemit komunist dhe diktaturës komuniste.

Është interesant dhe kënaqësi ta kesh dhe ta pranosh për avokat të shkëlqyeshëm shembësin e mitit tënd. A ka mundësi që Jusufi ka ndie nevojë për avokaturën e për këshillat e I. Kelmendit? A ekziston ndonjë germë e shkruar nga dora e tij në këtë drejtim?

Jusuf Gërvalla: *"Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si* ***një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne****. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit.* ***Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer***

në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z." (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 412)

Kjo letër e 15 janarit 1982, është e vetmja letër përmes të cilës Jusufi me fjalët ***një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne*** aludon në Sabri Novosellën por pa ia përmendur emrin. Se Sabri Novosella jeton në Turqi dhe është ***një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne*** Ibrahim Kelmendi e ka mësuar nga shoku i vet organizativ Kadri Zeka.

28. Lëvizja jonë e bashkimi ynë morën përmasa të mëdha

I. Kelmendi: *"Ai të ka kontaktuar vetëm kur **lëvizja jonë** mori përmasa të mëdha. Ka sabotuar tërbueshëm **bashkimin tonë** në takimin e tetorit."* (Atentatet, f.313)

A ekziston edhe një germë e vetme që dëshmon se Jusufi e ka përzije apo implikuar Lëvizjen e vetë me Frontin e I. Kelmendit, apo me çkado tjetër që do t'i jepte të drejtë I. Kelmendit të përdorë shprehjen "bashkimin tonë" dhe "lëvizja jonë".

Të shohim se sa është i gatshëm Jusufi ta përziej Lëvizjen e tij me I. Kelmendin për t'ia dhënë atij të drejtën të shprehet me fjalët ***lëvizja jonë*** e ***bashkimin tonë.***

Jusuf Gërvalla: "*Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e **mercenare** të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë **mercenar** i tyre, pra **mercenar** i **mercenarit**). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 198; Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

Të shohim se si u përgjigjet Jusufi përpjekjeve të tërbuara për të ndërtuar fole, strofull në Lëvizjen e Jusufit.

I. Kelmendi (për Sabri Novosellën): "*Ka sabotuar **tërbueshëm bashkimin tonë** në takimin e tetorit."* (Atentatet, f. 313)

Shefqet Cakiqi-Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981.* (Fjalë të drejtuara Ibrahim Kelmendit, Afishuar me: 23.03.2007 21:22, www.kosova.de)

Ibrahim Kelmendi: *"Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë."* (Fjalë të drejtuara Shefqet Cakiqit-Llapashticës, Afishuar me: 23.03.2007 22:57, www.kosova.de)

Jusuf Gërvalla: *"Ti mund dhe besoj **se je i painformuar** lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e **dy** organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë.** Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër*

*punëve të tyre të pahijshme**. Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar**. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

29. Të dëshiroj forcë që të mos thyhesh shpirtërisht e moralisht

Jusufi thyhet shpirtërisht e moralisht e distancohet nga Sabri Novosella në dasmën e Kadri Zekës e Saime Isufit. I. Kelmendi, që nuk të keqkupton dhe që është melhem për plagët e Jusufit, i dëshiron Jusufit forcë që të mos thyhet shpirtërisht e moralisht kur të takohet me Sabri Novosellën (sikur Jusufi nuk e paska takuar atë kurrë më parë), por si duket dashamirësia e fjalët melhem të I. Kelmendit janë të vonuara pasi Jusufi në dasmë, për ndryshim nga komunistët e pathyeshëm, është i thyer moralisht e shpirtërisht dhe këtë thyerje e shfaq pikërisht para figurës frontale të Frontit të bashkëthemeluar dhe emërtuar nga UDB-a.

I. Kelmendi*: "**Të dëshiroj forcë që të mos thyhesh shpirtërisht e moralisht** kur ta takosh dhe do të më vinte keq nëse vazhdon veprimtarinë nën komandim të tij!*

– Uroj të mos kesh të drejtë! – u përgjigj Jusufi, por tashmë nuk e kundërshtoi dhe nuk iu hidhërua si herave të mëparme.

Kësaj radhe Mirani konstatoi në paraqitjen e Jusufit një si pakënaqësi ndaj Sabriut, ndryshe nga herat e tjera." (Atentatet, f. 313-314)

Jusuf Gërvalla*: "Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër**. Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast."* (Letër S. Novosellës, 5 nëntor 1981; Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Sipas projektit për shembjen e mitit të Jusufit, të I. Kelmendit, Jusufi thyhet shpirtërisht e moralisht gjatë dasmës dhe këtë thyerje e demonstron para figurës frontale të Frontit të Kuq. Kur predhat e UDB-së e godasin në gjoks, këtë mit të pathyeshëm, më 17 janar 1982, ato veç e godasin një person e një mit që është thyer nga kryesuesi i Frontit të formuar, pagëzuar dhe popullarizuar prej saj, pra prej UDB-së.

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populloor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Se Jusufit iu ka nevojit forcë morale prej I. Kelmendit e dëshmojnë fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla*: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj*

vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre, pra* ***mercenar*** *i* ***mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton.(Letër S. Novosellës,* 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

Se si mendon Jusufi për *sabotimet e* bashkimit në Stamboll e dëshmojnë këto fjalë:

Jusuf Gërvalla*: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit (në panairin e Frankfurtit më 17 tetor 1981-shën i Xh. D.) në bisedë me shokun Z. (Kadri Zeka - shën i Xh. D)), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por* ***megalomaninë*** *e arrivistëve të revolucionit,* ***ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët*** *dhe tendencën për* ***dominim (RUAJTJES SË ROLIT HEGJEMON-shën i Xh. D.) me çdo kusht mbi të tjerët****. Kam dëshirë të madhe të më dalin gabim përshtypjet e këqija që formova për ta pas atij takimi dhe pasi mësova për qëndrimin e tyre.*

Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Të shohim shpjegimin e I. Kelmendit: *"– Uroj të mos kesh të drejtë! – u përgjigj Jusufi, por tashmë nuk e kundërshtoi dhe nuk iu hidhërua si herave të mëparme.*

Kësaj radhe Mirani konstatoi në paraqitjen e Jusufit një si pakënaqësi ndaj Sabriut, ndryshe nga herat e tjera." (Atentatet, f. 313-314)

Të shohim se sa i gatshëm është Jusufi të lëkundet, të thyhet e të largohet prej shokëve të vetë nën ndikimin e fjalëve të I. Kelmendit.

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

I. Kelmendi (Jusufit*): **Të dëshiroj forcë që të mos thyhesh shpirtërisht e moralisht** kur ta takosh dhe do të më vinte keq nëse vazhdon veprimtarinë nën komandim (të Sabri Novosellës-shën i Xh. D.) të tij!"* (Atentatet f. 313-314)

Se prej kujt merr e pret Jusufi forcë morale që kurrë të mos thyhet shpirtërisht e moralisht e tregojnë fjalët:

Jusuf Gërvalla*: "Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. ***Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

30. Më ndihmoi të këndellem

Jusufi, në dasmën e Kadri Zekës e Saime Isufit, ka sjellje jo burrërore dhe joshoqërore, por duke ju falënderuar mençurisë e burrnisë së figurës frontale të Frontit të emërtuar nga UDB-a, mundohet të bëhet burrë dhe shok.

I. Kelmendi: *"– Bacalok, do të ishte burrërore e shoqërore që ta thërrasim edhe Kadriun dhe t'i bëjmë tre-katër minuta bisedë, – shtoi Mirani.*

– Por jo këtu, që të biem në sy, – miratoi Jusufi." (Atentatet, f.314)

Se çfarë këshillash burrërore e shoqërore ka marrë Jusufi në dasmë prej I. Kelmendit e tregojnë fjalët e Jusufit të shkruara 13 ditë pas dasmës:

Jusuf Gërvalla: *"Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që* ***gjaknxehtësinë*** *time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq* ***gjaknxehtë*** *mbase nuk kam pasur.* ***Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. "*** (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411)

I. Kelmendi që në shkrimin "Në Kalanë e Jusuf Gërvallës" e kemi pa si tallet me sekretet naive të organizatave të Jusufit e Kadriut e i hedhë njërin kundër tjetrit, i pajton Jusufin e Kadriun, të cilët ishin të hidhëruar që nga tetori 1981.

I. Kelmendi: *"Mirani ftoi Kadriun dhe Jusufin që të ngjiteshin në çati të asaj pushimoreje ku gjendeshin dhomat e vogla të fjetjes." (*Atentatet, f.314)

Jusuf Gërvalla*: "Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që* ***gjaknxehtësinë*** *time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq* ***gjaknxehtë*** *mbase nuk kam pasur.* ***Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq. "*** *(Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)*

Jusufi, i thyer shpirtërisht e moralisht, ndihmohet që këndellet nga figura e Frontit të pagëzuar nga UDB-a, I. Kelmendi.

I. Kelmendi: *"– Edhe një herë urime të përzemërta dhe u trashëgofshi! – e mori ngrykë Jusufi Kadriun duke e shtrënguar për qafe. –* ***Mirani më ndihmoi të këndellem****, sepse më kishin bombarduar nga shumë kënde dezinformuesit e shpifësit përçarës." (*Atentatet, f.314)

Jusuf Gërvalla (13 ditë pas dasmës): "*Me bisedën që patëm në dasmë, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që gjaknxehtësinë time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë mbase nuk kam pasur.* ***Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq."*** **(**Letër I.K**.,** 15 janar 1982)

Çka mendon Jusufi për Frontin e Kuq e kemi pa mjaft herë. Ja se çka mendon Jusufi për *dezinformuesit e shpifësit përçarës*:

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër****. Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast.*

Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku."

(Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274-275)

Jusufi, tani me besim përfundimisht të humbur në Sabri Novosellën, edhe pse i thyer moralisht e shpirtërisht, e ndien veten mjaftë të këndellun e të përkrahur nga Fronti i Kuq, i emërtuar nga UDB-a, sa e merr përgjegjësinë vendimtare që ai vetë dhe askush tjetër të flasë në emër të Lëvizjes së tij (LNÇKVSHJ).

I. Kelmendi (Fjalë të atribuara Jusufit): *"Besoj shumë shpejt, pasi ta kesh kryer muajin e mjaltit, do të takohemi për të biseduar për bashkim të radhëve tona."* (Atentatet, f.314)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë."*** *(*Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Jusuf Gërvalla (13 ditë pas dasmës): ***"Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq...*** *Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, ***do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."*** (Letër rekomandë dërguar I. Kelmendit më 15 janar 1982)

Ta qesësh Jusufin para aktit të kryer ka qenë e pamundur dhe këtë më mirë se kushdo tjetër e ka ditur UDB-a, e cila nuk ka mund t'ia zenë askund pritën pos në pragun e derës së shtëpisë pranë gruas dhe fëmijëve.

31. Të kërkoj falje për shkrimin në gazetë

Jusufi, i thyer moralisht dhe shpirtërisht, i kërkon falje Kadri Zekës për shkrimin në gazetë, në numrin e parë të "Zërin të Kosovës", të nëntorit 1981.

I. Kelmendi (Fjalë të atribuara Jusufit*): "Kështu nuk shkon më.* ***Të kërkoj falje për shkrimin në gazetë****."* (Atentatet, f.314)

Shihet qartë lufta shpifëse për t'ia mveshur Jusufit një faj të cilin ai kurrë nuk e ka bërë dhe as që ka pasur nevojë t'i kërkoj falje.

Prapë shtrohet pyetja: Në cilën faqe, në cilën shtyllë e në cilin rresht gjenden fjalët e shkruara të Jusufit, në numrin e parë të Zërit të Kosovës, kundër Kadri Zekës? Me siguri se ato gjenden brenda 20 faqeve të formatit A4, të numrit në fjalë. Ato mund të gjenden pasi I. Kelmendi është një njeri që nuk keqkupton, se fjalët e tij janë melhem për plagët e Jusufit dhe se ai me durim e aftësi të jashtëzakonshme i pajton Jusufin e Kadriun.

E kemi potencuar më parë, se Zëri i Kosovës, i nëntorit 1981, jo vetëm që nuk ka asgjë kundër Kadri Zekës e OMLK-së, por është pikërisht e kundërta. Në këtë numër, në faqen 7-8 gjendet artikulli që Jusufi e ka pranuar nga Kadriu qysh në fillim të gushtit 1981, me titull *"Planet e revizionistëve titistë për degjenerimin e rinisë sonë kanë dështuar me turp."* Tek në numrin e janarit 1982, faqe 2, shtylla 2, Jusufi shkruan në mënyrë indirekte për Kadri Zekën dhe Abdullah Prapashticën me fjalët që i kemi cituar edhe më herët.

Jusuf Gërvalla*: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në*

tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.
Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta, e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar****. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ..., - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."*(Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 2)

Këto fjalë kanë dalë nga shtypi, dhe janë shpërnda rreth 10 ditë pas dasmës dhe sidomos në ditët e para pas atentatit. Kuptohet se këto fjalë janë tepër të pakëndshme, por Jusufi nuk është penduar kurrë për to. Këto fjalë kanë pasur rast t'i lexojnë sidomos ata që kanë ardhur për ngushëllime. Fjalët ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë, dhe ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta, e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar*** kanë qenë melhem për varrë sidomos për ata që kanë ardhur në shtëpinë e Jusufit, jo për ngushëllime por të parë se kujt i ka mbetur zotshpillaku apo "kush e ka uzurpuar zotshpillakun në shtëpinë e vetë e në Organizatën e vetë."

Kush i ka kërkua falje kujt, e kush i ka borxh kujt është shtjelluar mjaftë mirë nga letrat e Jusufit dhe nga biseda e Jusufit me Kadri Zekën më 17 tetor 1981 në Frankfurt.

Kadriu u tregon Jusufit e I. Kelmendit se ai nuk ka nevojë për muaj mjalti. Jusufi kërkon që të takohen. I. Kelmendi me të qeshurat e tij flet e miraton në emër të dhëndrit. Pajtimi arrin kulmin kur Jusufi e Kadriu ia hedhin dorën mbi supe njëri-tjetrit

I. Kelmendi: *"– Për muaj të mjaltit nuk kemi kohë. Do të më mjaftonte po të kisha vetëm një javë, – u përgjigj me të qeshur e i gëzuar Kadriu.*
– Atëherë, pas disa ditësh planifikoje kohën që të takohemi, – tha Jusufi.
– Po e miratoj unë, meqë dhëndrit të ri nuk i takon të flas kaq shumë, – u përgjigj me në të qeshur Mirani.
Të tre zbritën shkallëve. Jusuf e Kadriu zbrisnin krahas duke ia mbajtur dorën mbi supe njëri-tjetrit." (Atentatet, f.314)

E vetmja gjë që i mungon kësaj skene mahnitëse në libër është një pikturë e mirë që do ta bënte edhe më konkrete këtë skenë. Besoj se kjo nuk duhet të jetë aq e pamundur me rastin e ribotimit të këtij libri.

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër****. Kjo nuk do të ndodhë kurrë****.* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Jusuf Gërvalla: "*Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq...*

*Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (*Letra dërguar I. Kelmendit më 15 janar 1982)

"Ahengu i dasmorëve zgjati deri në mëngjes. Ishte koha të shpërndaheshim. Para se të përshëndeteshim me çiftin e ri, me pëlqimin e shokëve ia dhashë Kadriut një zarf me një

shumë modeste parash, duke i uruar përzemërsisht të trashëgoheshin e të kishin jetë të gjatë e të lumtur bashkëshortore." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.67)

Faridin Tafallari: *"Në mëngjes u kthyem; nuk donim t'ia ndalnim këngës në minibusin që po na binte sërish në qytet. Jusufi ishte më i lodhur se ne sepse ai punonte edhe për nxjerrjen e gazetës "Zëri i Kosovës"; atë e mundonte edhe mosmarrëveshja me organizatën tjetër ku kishte edhe anëtarë që nuk pranonin ta merrnin dhe ta shpërndanin "Zërin e Kosovës"*."(Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 48)

32. Së shpejti të gjithë do të përfshiheshin në Front

Kadri Zeka harron se ka bërë marrëveshje për takim me Jusufin, e se si ia kanë hedhur dorën njëri tjetrin në supe, për gëzimin e të gjithë dasmorëve e të I. Kelmendit dhe shkon në Dusseldorf tek I. Kelmendi në mënyrë që simpatizantët e Frontit të I. Kelmendit t'i anëtarësojë e konvertoj në Frontin e OMLK-së.

I. Kelmendi: *"**Ditën e enjte të 14 janarit**, Kadriu udhëtoi në Krahinë të Ruhrit në Gjermani. **Tani ai po merrej me propagandimin e Tezave të Frontit** për Republikën e Kosovës, meqë mendonte se të gjithë aktivistët patriotë se shpejti duhej të përfshiheshin në këtë Front."* (Atentatet, f.315)

I. Kelmendi, për nevojat e veta i duhet që kohën me Kadriun ta shkurtoj sa më shumë, bile mund të themi deri në atë shkallë sa Kadriut e Ibrahimit nuk u ka ra as nga një kafe me e pi rehat, apo me e pushua vehten me një sy gjumë për shkak se Jusufi i ka thirrur në Shtutgart për çështjen e bashkimit. Saime Isufi mendon pakëz më ndryshe, sidomos lidhur me kohën që anëtarët e Organizatës së përbashkët Kadri Zeka e I. Kelmendi e kalojnë së bashku.

Saime Isufi: "***Më 12 janar 1982, Kadriu u nis në** Gjermani për të kontaktuar me veprimtarë. Ndër ta edhe me Vëllezërit Gërvalla. Me vete mori edhe materialet e numrit 6-të të 'Lirisë' për t'i botuar si dhe 'Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës'. Tezat do t'i konsultonte edhe me vëllezërit Gërvalla. Numri i 6-të i 'Lirisë' doli pas rënies së Kadriut. Kadriu duhej të kthehej më 17 janar, pikërisht atë natë që e vrau dora gjakatare, sepse të nesërmen do të fillonte punë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.101-102)

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

.Djetor 1981 Nr. 6

DENIMET E RENDA

Revista Liria, Nr.6, Dhjetor 1981

Të martën më 12 janar Kadri Zeka niset nga St. Galleni për në Düsseldorf, tek Ibrahim Kelmendi për punët e Frontit Popullor për Republikën e Kosovës. Në

Düsseldorf bartës i aktiviteteve kryesore ka qenë Klubi "Emin Duraku" lokalet e të cilit kanë qenë në Graf-Adolf strasse 63-65. Për ta kaluar këtë distancë prej 660 km, në mënyrën më të shkurt, lidhjet e trenave kalojnë përmes qendrës së Shtutgartit dhe Heilbronn-it. Kadri Zeka qëndron me Ibrahim Kelmendin në Düsseldorf nga e marta (12 janar) deri të shtunën më 16 janar. Të shtunën në mbrëmje, Kadriu e Ibrahim Kelmendi pasi kanë qëndruar së bashku 5 ditë, e bëjnë rrugën prej 420 km dhe mbërrijnë në Bernhausen, në banesën e Murat Kryeziut në Nord-West-Ring 30, ku mbi 20 aktivist të rrethit të Shtutgartit janë tubuar për të shikuar disa videofilma shqiptar, në mesin e të cilën janë edhe Jusufi e Bardhoshi. Shikimi i filmave vazhdon deri më 17 janar në ora 02.00. Prej Bernhuaseni në Untergruppenbach (70 km), Vëllezërit Gërvalla, Kadri Zeka e Ibrahim Kelmendi mbërrijnë më 17 Janar 1982, në ora 03.00.

Jusuf Gërvalla: *"Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***NE TANI MUND TË THEMI SE KEMI SHTYPIN TONË."*** (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Çka do të thotë kjo? Se pas tetorit 1981 e sidomos në janar 1982 Jusufi është i angazhuar vetëm e vetëm me SHTYPIN TONË, pasi nuk donë të merret më me angazhime të kota. **Se ai nxjerrë mësimin: sinqeriteti - për shokët e sinqertë**. Besoj se çështjen e konsultimit të Tezave duhet ta konsiderojmë si punë të kryer qysh më 17 tetor 1981 në Frankfurt.

Jusuf Gërvalla: ***"****Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën.* ***Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

Përpjekjeve për manipulime me emrin dhe punën e tij, nga organizata të tjera, Jusufi u përgjigjet me këto fjalë të përjetshme:

Jusuf Gërvalla***: "Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. KJO NUK DO TË NDODHË KURRË."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi

Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi

I shtyrë nga shtypja e egër ekonomike, politike, shoqërore e kombëtare nën thundrën e pushtetit gjakatar titist, populli shqiptar në Jugosllavi është ngritur i tëri në luftën e tij të drejt për bukë, liri dhe të drejta demokratike. Ai e pa të arsyeshme të kërkojë me këmbëngulje Republikën e federuar të shqiptarëve në Jugosllavi. Në themelet e kësaj kërkese të shtruar në rrugë paqësore, me fajin e qeverisë shoviniste të Beogradit, u vu gjaku i derdhur, plagët e shumta dhe torturat çnjerëzore që po i bëhen burgjeve e gjyqeve një rinie të tërë shqiptare. Sot për këtë kërkesë është hedhur në

gjyqin e tërbuar fashist i tërë populli ynë liridashës, të cilin, në prezencën dhe nën kërcënimin e milicisë dhe të ushtrisë serbe, po e detyrojnë të "diferencohet" nga kërkesat e veta më vitale, të shtruara në pranverë nga ana e djalërisë patriotike, komuniste e revolucionare të Kosovës.

Aktet barbare, me të cilat udhëheqja serbomadhe po përpiqet ta shtypë me çdo kusht e me çdo mjet vullnetin dhe të drejtat e patjetërsueshme të popullit tonë heroik, rrezikojnë në mënyrën më flagrante çdo arsyeshmëri dhe çdo cak të bashkëjetesës normale të popullit tonë me popujt e Jugosllavisë në kushtet ekzistuese, i hedhin helm plagës së madhe të popullit tonë martir dhe nxisin – me përmasa të papara deri më tash – urrejtjen ndërnacionale mes shqiptarëve dhe popujve të Jugosllavisë.

Prandaj, në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë të ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi, ne - një pjesë e pararojës patriotike e komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi – dalim para popullit tonë, para opinionit jugosllav dhe atij botëror me këto kërkesa minimale të parevokueshme:

1) Pa iu njohur Kosovës statusi i Republikës në kuadër të federatës jugosllave;

2) Po iu njohur shqiptarëve në Jugosllavi statusi i kombit dhe, rrjedhimisht, e drejta demokratike e leniniste për vetëvendosje deri në shkëputje;

3) Pa u marrë masat konkrete të të gjithë bashkësisë jugosllave që ritmi i zhvillimit të Kosovës të shpejtohet së paku në shkallën e parashikuar dhe të premtuar nga federata – do të thotë 60 për qind mbi mesataren jugosllave;

4) Pa u marrë masa të menjëhershme kundër papunësisë katastrofike në viset shqiptare, që në afatin sa më të shpejt të inkuadrohet krahu i lirë (ekzistues) i punës dhe të tërhiqen punonjësit tanë të shkapërderdhur në Perëndim dhe nëpër Republikat e zhvilluara të Jugosllavisë;

5) Pa shpalljen e amnistisë së përgjithshme, me të cilën do të liroheshin menjëherë dhe pa kusht të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, që vuajnë dënime të rënda nëpër kazamatet jugosllave;

6) Pa marrë nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës politiko-shoqërorë, publicistë e njerëz të tjerë, qofshin nga Kosova ose republikat e Jugosllavisë, që janë implikuar në një mënyrë a në një tjetër në tragjedinë më të re të Kosovës, në fushatën e tërbuar antishqiptare të serbomëdhenjve, duke i shkaktuar popullit tonë plagë të reja dhe duke ndërsyer kundër tij popujt jugosllavë, të nxitur nga propaganda;

7) Pa formimin e një komisioni të posaçëm, që do të studiojë me themel dhe në hollësi aksionet shtetërore jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve, para e pas lufte, gjë që presupozon edhe publikimin e dokumenteve të fshehta shtetërore (të vjetra e të reja), që kanë të bëjnë me aksionin në fjalë; pa marrë dënimin e merituar të gjithë aktorët e gjallë (Çubrilloviçi me shokë) dhe të vdekur (Andriç, Vukotiçi etj.) të këtij akti barbar të gjenocidit; pa iu marrë e drejta qytetare publike të gjitha atyre veprave letrare (Duçiçi, Laliçi, Çosiçi, Bulatoviçi), kuazishkencore (Gjorgjeviçi, Cvijiçi etj.) e publicistike, në të cilat pasqyrohet përçmimi kombëtar e synimet antishqiptare, dhe mbi to të vihet embargo e përhershme jo vetëm në Kosovë po në mbarë Jugosllavinë;

8) Pa u rivendosur e pa u zhvilluar më tej marrëdhëniet e filluara kohë më parë mes popullit shqiptar (dhe popujve tjerë) në Jugosllavi me shtetin dhe me popullin shqiptar në RPS të Shqipërisë, të ndërprera në mënyrë të njëanshme arbitrare e me qëllime thellësisht antishqiptare –

– Pa këto masa të menjëhershme, rigorozisht të plota, populli shqiptar i martirizuar nuk do ta ketë as satisfaksionin më të vogël për krimet e vazhdueshme 70-

vjeçare të gjenocidit nën regjimet e egra jugosllave, sidomos nën regjimin e vetëquajtur socialist dhe vetadministrues të klikës titiste-rankoviçiste, rrjedhimisht, nuk do të qetësohet deri në ngadhënjimin e plotë të të drejtave dhe të lirisë së tij.

Në qoftë se përkundrazi, udhëheqja jugosllave nuk merr qëndrim të matur, gjakftohtë e të drejtë përballë kërkesave tona krejt të ligjshme, por edhe më tutje vazhdon të godasë padrejtësisht popullin tonë, duke nxitur por të tjerash kundër tij edhe popujt e pafajshëm të Jugosllavisë, përgjegjësinë për këtë do ta marrin mbi vete ekskluzivisht udhëheqja e Serbisë dhe ajo e federatës.

Asnjë kërcënim e shantazh për gjoja implikacionet e brendshme dhe ndërkombëtare, që – siç duan të thonë për demagogji serbomëdhenjtë – mund të dalin nga këmbëngulja e shqiptarëve për kërkesat aktuale, nuk mund të jenë kurrë pasojë e luftës së popullit tonë për bukë e liri. Çdo implikacion eventual, konkludojmë ne me ndërgjegje të plotë e të pastër, do të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë i politikës që na i mohon këto të drejta të ligjshme, rrjedhim i politikës së egër aktuale antishqiptare, që ndjek udhëheqja jugosllave, e cila, me dashje ose me pahir, është kapur në vallen fashiste të serbomëdhenjve.

Prandaj, asnjë pengesë, e vogël a e madhe qoftë, nuk do të na ndalë në luftën tonë të drejtë, e cila patjetër do të kurorëzohet me fitore, pa marrë parasysh disponimin, propagandën dhe masat e egra antishqiptare, që ia grisën krejtësisht maskën regjimit titist.

VDEKJE FSHIZMIT – LIRI POPULLIT!

(Ky dokument i KQ të LNÇKVSHJ (në Shtutgart) u botua për herë të parë në revistën Zëri i Kosovës, Nr.1, nëntor 1981, faqe 2-3)

Abusus not tollit usum

Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare

Nga pikëpamja jonë e luftëtarëve të lirisë përjashtohet si gjë absurde çdo polemikë me atë demagogji titiste e serbomadhe të qeverisë së Beogradit, e cila i ka të gjitha tiparet e rrenës së kulluar edhe për mendjen më të mjegulluar njerëzore. Ne s'kemi pse ta pranojmë, nga ky aspekt, sfidën për t'iu përgjigjur një për një të ashtuquajtur Platformë politike e LKJ për çështjen e Kosovës, e cila u aprovua në Mbledhjen e 22-të të LKJ. Ne hedhim poshtë si të paligjshme të gjitha tezat e kësaj platforme dhe, nga ana jonë, dalim me këtë:

KUNDËRPLATFORMË TË LUFTËTARËVE TË LIRISË

Platforma jonë ngërthen dy momente kyçe: programin minimum të luftëtarëve të lirisë – luftën për Republikën Socialiste të Kosovës, që s'është gjë tjetër pos lufta për autonominë e popullit shqiptar në Jugosllavi; dhe programin tonë maksimum – luftën për realizimin e të drejtës demokratike e leniniste për vetëvendosjen e popullit tonë deri në shkëputje, që është lufta për pavarësinë e plotë kombëtare e shoqërore të shqiptarëve në Jugosllavi.

I

E drejta e popujve për vetëvendosje deri në shkëputje është parim i të drejtës ndërkombëtare dhe i politikës ndërkombëtare, sipas të cilit çdo popull ka të drejtë të vetëvendosë lirisht në cilin shtet donë të jetojë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për formimin e shtetit të vet dhe të përcaktoj vetë formën dhe rregullimin e tij (Mala Enciklopedija "Prosveta", Beograd, botimi i dytë).

Për rrjedhim, çdo shkelje e kësaj të drejte – qoftë fjala për popuj të vegjël apo të mëdhenj – nga ana e shteteve dhe popujve të tjerë, është në kundërshtim flagrant me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe (në parim) tërheq me vete pasoja të rënda për shkelësin.

Jashtë këtij kuadri, siç është fare e logjikshme, nuk ka si të shikohet as çështja e shqiptarëve në Jugosllavi, të cilët përbëjnë një popull e një komb, me gjuhë, histori, kulturë e tradita të lashta. Shqiptarët në Jugosllavi, historikisht, kurrë nuk e kanë pasur mundësinë që ta shfaqin lirisht vullnetin e tyre për të jetuar në shtetin e tyre kombëtar. Paqja e Shën Stefanit dhe po atë vit Kongresi i Berlinit, kanë prerë si me shpatë krahina të tëra nga trungu shqiptar dhe ia kanë aneksuar Serbisë dhe Malit të Zi. Po kështu kanë vepruar fuqitë e mëdha të kohës edhe në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, në Paqen e Versajës më 1919 dhe në Konferencën e Paqes të Parisit më 1946. Për rezultat, më shumë se gjysma e trojeve shqiptare dhe gati gjysma e popullsisë shqiptare, për vullnetin e lirë të së cilës s'ka pyetur njeri, kanë mbetur jashtë kufijve shtetërorë e kombëtarë shqiptarë.

Vetëm një herë shqiptarët në Jugosllavi janë ndodhur afër rrethanave për ta shfaqur vullnetin e lirë për bashkim me shtetin amë, Shqipërinë. Kjo pat ndodhur në Mbledhjen e Bujanit, dhjetor 1943-janar 1944. Rezoluta e kësaj mbledhjeje i çoi peshë shqiptarët në Jugosllavi që të ngriheshin si petrita dhe të skuqnin tokën stërgjyshore me gjakun e tyre në luftë kundër okupatorëve nazi-fashistë italo-gjermanë. Kjo gjë, sipas Rezolutës së Bujanit, shqiptarëve në Jugosllavi ua bënte të mundshëm bashkimin me Shqipërinë. Por, siç u vendos në AVNOJ dhe siç doli në realitet gjatë këtyre dyzet vjet robërie nën Jugosllavinë titiste, duke u shkelur vendimet e Mbledhjes së Bujanit, u provokuan ligësisht aspiratat e ligjshme shekullore të shqiptarëve në Jugosllavi. AVNOJ-i vendosi që tokat shqiptare të "trashëguara" nga kralët e vjetër të Serbisë e të Malit të Zi jo vetëm të mbaheshin sërish nën thundrën jugosllave, po edhe të copëtoheshin më tej mes tri republikave sllave.

Duke u mbështetur në rrethanat historike krejtësisht brutale e të disfavorshme për popullin tonë, serbët, gjatë sundimit të tyre afro 70 vjeçar mbi tokat shqiptare, janë përpjekur me kohë ta ngrisin në tezë shkencore pretendimin mbi të drejtat historike dhe etnike (!) të tyre mbi këto toka.

Si përgjigje për këtë pretendim, ne shtrojmë pyetjen që shtronte në fillim të këtij shekulli Lenini: A i zotëron në mënyrë të ligjshme paratë një batakçi, që i ka shtënë në dorë me kambial fals? Dhe, të gatshëm për ta çuar në vend të drejtën, e cila, siç thotë populli ynë, vonon por nuk harron, ja ku përgjigjemi vetë se për ne sot ka dalë "Ma mirë flakë e kuqe se futë e zezë."

II

Një premtim tjetër i "komunistëve" jugosllavë pasqyrohet në disa deklarata të shtypit komunist dhe të vetë satrapit Tito para e gjatë Luftës II Botërore: se shqiptarëve, në qoftë se nuk deklarohen për bashkim me vendin e tyre amë, duhet t'u takoj gjithsesi republika kombëtare brenda federatës jugosllave. Ky premtim, i përmendur disa herë në dialogun mes "Zërit të popullit" dhe Tanjugut, asnjëherë nuk u demantua nga jugosllavët dhe nuk ekziston as më i vogli dyshim për vërtetësinë e tij. Dhe duke qenë kërkesa e shqiptarëve për republikën e tyre kombëtare brenda federatës një kërkesë sa e

ligjshme aq edhe e logjikshme, ajo u shtrua nga studentët në Demonstratat e vitit 1968 dhe u shua me gjak; së dyti u shtrua më 1974 nga intelektualët e Kosovës dhe u refuzua me demagogji, e demagogjia titiste u pranua pa zhurmë nga renegatët shqiptarë. Dhe sërish kjo kërkesë po shtrohet sot me këmbënguljen më të madhe, të ujitur edhe me gjak, nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi, dhe sërish po shtypet nga serbomëdhenjtë, po tani me tanke e bajoneta, me pushtetin ushtarak që është vendosur në Kosovë.

III

Serbomëdhenjtë duan të thonë se shqiptarët e paskan konsumuar të drejtën e tyre për vetëvendosje deri në shkëputje, se ata paskan zgjedhur vetë të jetojnë në kuadrin e Jugosllavisë titiste. Kur, ku e si? Këtë s'kanë si ta thonë, se kjo është një gënjeshtër e ligë. Ata duan të thonë se shqiptarët e kanë konsumuar edhe kërkesën për republikën e tyre kombëtare brenda Jugosllavisë dhe kanë zgjedhur që të ngelin nën Republikën e Serbisë, të Malit të Zi e të Maqedonisë! Po kur dhe si?...

Ne u themi atyre:

1) Se kjo nuk është e vërtetë. Po të kenë argumente, le t'i nxjerrin, ç'po presin më!

2) Se, edhe sikur kjo të kishte qenë e vërtetë, vullneti i lirë i një populli nuk është artikull i konsumit të gjerë që mund të konsumohet njëherë e përgjithmonë. Në botë nuk ka ligje absolute, ecuria njerëzore shkon duke shkelur, në bazë të dialektikës, gjithë ato ligje që deri më dje janë dukur të mira, kurse sot bëhen pengesë për progresin e shoqërisë përgjithësisht dhe të popujve në veçanti. Prandaj shqiptarët e kanë kurdoherë të drejtën të shprehin vullnetin e tyre të lirë, qoftë për të kërkuar status republike për Kosovës, qoftë për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Kërkesa e shqiptarëve për Republikën e Kosovës, siç tha Arbër Korabi, edhe në mos qoftë në germën, është në frymën e Kushtetutës jugosllave. Përnga numri, shqiptarët përbëjnë popullin e tretë me radhë në Jugosllavi. Konstitucioni i republikës në federatën jugosllave nënkupton një territor kompakt etnik. Shqiptarët janë kompakt në të gjitha tokat shqiptare nën Jugosllavi. Pastaj, në Jugosllavi kanë republika edhe popuj më të vegjël, siç janë maqedonasit dhe malaziasit, që së bashku edhe me hungarezët nuk bëjnë vetëm sa ka shqiptarë në Jugosllavi.

Qeveria jugosllave e ka të qartë se shqiptarët kanë vendosur ta kundërshtojnë me luftë këtë padrejtësi. Ata edhe po të duan të jetojnë ende në bashkësinë federative, kurrsesi nuk duan më të jetojnë nën sqetullën e Serbisë.

Kjo e tmerron qeverinë e Beogradit, të cilën e mbajnë në këmbë shovinistët serbomëdhenj. Egërsia dhe paturpësia e tyre u ngjit në kulm në Mbledhjen e 22-të të LKJ, kur qeveria doli me parullën se, sa i përket LKJ-së, "Kosova – Republikë" brenda Federatës dhe Kosova – Republikë jashtë Federatës jugosllave janë njësoj"! Dhe ne këtë e kemi pritur, sepse jemi të vetëdijshëm se kështu e ka logjika e shovinistëve serbë.

Por, në emër të kujt flasin kështu serbomëdhenjtë?

Në mbledhjen e përmendur nuk na ra të dëgjojmë duke sulmuar kërkesën e kosovarëve për Republikë thuaja asnjë përfaqësues nga republikat e Sllovenisë, Kroacisë dhe B e H. Për më tepër, ka indikacione të qarta dhe mendime në shtypin e vendit e atë të huajin, që thonë se ky nuk është fare mendimi as i udhëheqjes e as i popujve në Slloveni, Kroaci dhe B e H. Çka do të thotë LKJ për protestat e studentëve kroatë e sllovenë kundër represalieve të egra të serbomëdhenjve mbi popullin dhe rininë shqiptare? E marrim me mend sa janë tmerruar serbomëdhenjtë kur qeverisë iu paraqit protesta e nënshkruar nga 119 studentë të Universitetit të Beogradit kundër dënimeve drakoniane të rinisë kosovare, që vlerësohet si protesta më e madhe në Jugosllavinë e pasluftës!

Kjo s'do të thotë gjë tjetër veçse dalje në shesh të abuzimeve të rënda ndaj Kushtetutës jugosllave nga ana e LKJ. Por, abusus not tollit usum (Keqpërdorimi nuk e suprimon përdorimin e drejtë). Herët a vonë, njerëzit që kanë mbetur ende esëll në Jugosllavinë e dehur, e cila në krizën e saj më të madhe ka ndarë mendjen të sillet si karasevdaliu i fundit i kësaj bote, këta njerëz do t'u japin fund abuzimeve të shumta, sidomos abuzimit të vetë Kushtetutës jugosllave nga ana e serbomëdhenjve, po deshën të shpëtojnë atë që mund të shpëtohet akoma në Jugosllavi.

Sa për popullin shqiptar, "qeveria do të arrijë, ndoshta, ta shtyjë orën e dhënies së llogarisë, por kjo shtyrje e afatit vetëm se do ta bëjë më madhështor hapin e mëtejshëm të sulmit revolucionar dhe asgjë tjetër" (Lenini, Vepra, vëll. 8 botimi shqip, Tiranë 1954, faqe 99).

Populli shqiptar, përveç intuitës për veprimet e drejta e të ligjshme, sot ka nxënë edhe pak dije sa të mund të lexojë e ta interpretojë edhe atë të shkretë Kushtetutë jugosllave. Mbi të gjitha, njeriu ynë po bëhet përditë e më i vetëdijshëm se nuk është populli a që ekziston për kushtetutën, por është kushtetuta që ekziston për popullin dhe që formalisht edhe ka dalë prej popullit. Veç kësaj, shovinizmi i tërbuar serbomadh na ka prurë në atë situatë që, edhe po të avullohen brenda nate të gjitha nenet e të gjitha paragrafet e Kushtetutës jugosllave që kanë mundur të përmbajnë eventualisht ndonjë të mirë edhe për popullin shqiptar në Jugosllavi, ne nuk kemi humbur asgjë nga kjo. Populli shqiptar në Jugosllavi e ka ngritur sot parullën e fuqishme se:

ASNJË LIGJ, ASNJË KUSHTETUTË NUK PARAQESIN ASGJË PËRPARA VULLNETIT TË LIRË TË NJË POPULLI!

Komiteti Qendror i LNÇKVSH (në Shtutgart)

Zëri i Kosovës, Janar 1982, faqe 3-4

Simultanka dhe shah-mati i Jusuf Gërvallës

Do ta sjellë shqiptarin në POTEZ për të zgjedhur

I. Kasparovi dhe Simultanka e Jusuf Gërvallës në vitin 1980

-1. Rregulla themelore të lojës së shahut

-2. Kasparovi për rëndësinë e figurave të bardha dhe të zeza

-3. Tabela e parë - Letër e hapur satrapit Josip Broz Tito

-4. Tabela e dytë - Letër renegatit Fadil Hoxha

-5. Tabela e tretë - Letër Enver Hoxhës

II. Shah - mati kundër UDB-së dhe TANJUG-ut në vitin 1981

-1. Drejtleximi dhe drejtshkrimi i bibliotekistit

-2. Internacionalizmi proletar i Frontit të Kuq

-3. Ma bëre shah-mat, - tha Jusufi duke qeshur

-4. GJITHSESI NUK TË KAM KEQKUPTUAR

-5. Jusuf Gërvalla si përkthyes i kulturës

-6. Rezignacioni i UDB-së dhe TANJUG-ut

Do ta sjellë shqiptarin në POTEZ për të zgjedhur

Jusuf Gërvalla: *"Vetë armiku, që kohë më parë e dinim edhe për politikan të regjur, me këtë intervenim ushtarak e policor mbi shqiptarët bëri pa dyshim gabimin më të madh në historinë e vet shtetërore-politike; ky gabim do t'i kushtojë shtrenjtë, sepse gjithë situata, edhe në mos vazhdoftë menjëherë lufta definitive për bashkim me Shqipërinë tonë, pra gjithë situata do të ndjekë në të ardhmen e afërme atë drejtim, i cili* ***do ta sjellë shqiptarin në potez për të zgjedhur*** *se ç'dëshiron brenda kuadrit të Jugosllavisë, madje duke na lejuar të bëhemi edhe mjaft nazeqarë..."!* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 260-261)

I. Kasparovi dhe Simultanka e Jusuf Gërvallës në vitin 1980
-1. Rregulla themelore të lojës së shahut

Të gjithë adhuruesit e shahut e kanë të njohur faktin se Garry Kasparov, më 2007, botoi librin e tij të famshëm "How Life Imitates Chess" (Si e imiton jeta shahun).
Para se ta analizojmë më nga afër librin e Kasparovit, po japim disa nga rregullat themelore të FIDE (Federatës Ndërkombëtare të Shahut).

"RREGULLA THEMELORE

§ 1: Karakteri dhe qëllimi i lojës së shahut

1.1 Shahu luhet në mes dy kundërshtarëve të cilët sipas radhës, lëvizin pjesët në një tabelë kuadratike, 'tabela e shahut'. Lojtari me figura të bardha e fillon partinë. Për një lojtar thuhet se 'e ka radhën' kur lëvizja e kundërshtarit të tij është krye. (Shiko §6.8)

§ 4: Kryerja e lëvizjes

4.1. Çdo lëvizje duhet të bëhet vetëm me një dorë.

4.2. Lojtari i cili e ka radhën mundet t'i vendosë më mirë një figurë apo më shumë në katrorët e vet, nëse ai qysh më parë e tregon qëllimin e vet (p. sh. duke thënë "j'adoube" apo "I adjust").



4.3. Nëse lojtari që e ka radhën - me përjashtim të asaj që rregullohet sipas 4.2 - qëllimisht në tabelën e shahut prek

a) një apo disa prej figurave të veta, është i detyruar ta lëvizë figurën e parë të prekur e cila mund të bëjë lëvizje, ose

b) një apo disa prej figurave të kundërshtarit, është i detyruar ta godas figurën e parë të prekur e cila mund të goditet.

c) një prej figurave të veta dhe një prej figurave të kundërshtarit, është i detyruar ta godas figurën e kundërshtarit me figurën e vet, apo nëse kjo është kundër rregullave, të lëvizë apo godas figurën e parë që mund të lëvizë apo figurën e parë që mund të goditet. Nëse është e paqartë se cila figurë është prekur së pari, figura e lojtarit në radhë konsiderohet si figura e prekur së pari."

Të gjitha rregullat në pikën e lartpërmendur tregojnë se nuk është e

mundur me i ra pishman për Lëvizjen e bërë, nuk është e mundur që potezi i kryer të kthehet prapë, e bëra të bëhet e pabërë dhe të fshihen gjurmët e asaj që është bërë, kur për këtë ka fakte si drita e diellit.

Disa kanë arsye të jenë përjetësisht krenarë për Lëvizjen e vetë apo Lëvizjet e veta, ndërsa të tjerë luftojnë me çdo mënyrë për fshehur gjurmët e shtigjet e errëta që kanë ndjekur.

§ 6 Rregullat e turnireve

6.8

a) Gjatë partisë çdo lojtar është i detyruar që pas kryerjes së lëvizjes së tij në tabelën e shahut, ***ta ndalë orën e vet dhe ta startoj orën e kundërshtarit****. Një lojtar duhet të lejohet ta ndaloj orën e tij. Lëvizja e tij nuk konsiderohet e kryer përderisa ai të mos e bëjë atë, përveç në ato raste kur lëvizja e bërë e përfundon partinë...*

b) Lojtari është i detyruar ta ndalë orën e tij me të njëjtën dorë me të cilën e ka kryer lëvizjen...." (Marrë nga Rregullat e shahut të FIDE-s, 2005).

Kjo pikë më lartë (6.8 a) tregon se për dikend koha është e përjetshme dhe nuk i harxhohet kurrë, ndërsa të tjerë e kanë afatin e kufizuar se sa u shkon kungulli mbi ujë.

-2. Kasparovi për rëndësinë e figurave të bardha dhe të zeza

Kasparovi mendon se shumë veta, me mendjelehtësi të tepruar, në bisedat e përditshme e përdorin shprehjen "ta bëra shah-mat" apo "ma bëre shah-mat". Një vëmendje të veçantë ai i kushton sidomos rolit apo ndikimit të figurave të bardha dhe atyre të zeza. Siç dihet, në bazë të rendit të partive, vazhdimisht lojtarët kanë herë figura të bardha e herë figura të zeza. Sa më i përsosur është lojtari, aq më tepër hetohet rëndësia e figurave të bardha. Në nivelin e kryemjeshtërve, të dhënat statistikore tregojnë se ata që kanë figura të bardha shënojnë fitore në 29% të rasteve, në 18% të rasteve fitojnë ata me figura të zeza dhe 53% të partive përfundojnë remi.

Në të shumtën e rasteve, persona të ndryshëm për ta minimizuar veprën e Jusufit kanë thënë se ai e ka pasur lehtë pasi e ka pasur Bardhoshin apo Bardhin, figurën e tij më të fuqishme në mesin e figurave të bardha. Ky fakt Jusufin nuk e ka penguar kurrë, përkundrazi ai ka qenë shumë krenar për këtë. Kur Jusufi ka fituar çdo betejë edhe kur e kanë pasur rendin figurat e zeza, atëherë të gjithë janë detyruar ta pranojnë faktin, se ai ka fituar jo vetëm për faktin se e ka pasur Bardhin, por edhe për atë pse ka qenë Jusuf.

Përveç kësaj që u tha, ka raste kur radha e lojës herë me figura të bardha e herë me të zeza nuk ndiqet. Kjo ndodhë në simultanka, kur një lojtar, një kryemjeshtër tepër superior zhvillon duele me shumë kundërshtar përnjëherë. Në këto raste është kryemjeshtri ai që si rregull i ka figurat e bardha. **Për vitin 1980**, simultanka e Jusuf Gërvallës mund të përmblidhet me tri tabelat e saj kryesore: Fillon në janar, me letrën dërguar Satrapit Josip Broz Tito, në fillim të gushtit me letrën - ëndrrën publike dërguar Fadil Hoxhës dhe e arrin kulmin në letrën dërguar Enver Hoxhës.

-3. Tabela e parë - Letër e hapur satrapit Josip Broz Tito (Bashkimi, www.pashtriku.org)

-4. Tabela e dytë - Letër renegatit Fadil Hoxha
KTHIMI I BIRIT PLANGPRISHËS
(Ëndërr në tri pamje)

Në pamjen I dhe II Jusufi, shkruan se si ka mund me qenë Fadil Hoxha. Në pamjen e tretë flitet vetëm për atë se si ka qenë ai në realitet.

Pjesë nga pamja III

"*Shqypnia, shokë… Shqypnia po përzihet në pun't tona t'mrenshme. Ju, shokë, duhet m'e dit vet dhe m'u kallxu' edhe thmive t'tu, net m'sojnë qysh duhet ën shkoll, qysh duhet m'e punu' tokën; me i hek lopt e vogla, me bo lop të mdhaja, qi për me pjell viça të mdhaj.. Ju, shokë, duhet m'e dit kush na i ka dhon kto lop e kta viça, përveçse Tita, Jugosllavia e Tit's. Djemt le ta trusin bythën e ne t'rrinë rahat, i ka qit sefaja mëç… Eqrem Qabej, Eqrem Qabej! E kush koka Eqrem Qabej? E kemi na Idriz Ajetin, ma i mir s'na duhet! S'e hekin goje njifar Kada… Kadarin… Kadarenë. Thonë, koka shkrimtar i mirë. Pse, Azem Shkreli jon koka shkrimtar i keq a? A pak shkrimtar kemi na pa ata të Shqypnisë? Qe, për shemull, Ivo Andriqi, Dobrica Qosiqi… Vasa Qubrloviqi… (Jo, ky s'koka shkrimtar po shkenctar!) Punë e madhe!*

E fika (radion-shën im) me rrëmbim. Deri kur do të na kuisë kaq kobshëm mbi portat e shtëpive kjo sorrë ndjellakeqe, kjo qyqe nate, kjo kukuvajkë, kjo shpendkeqe?!

Këtë "fjalim famoz" të analfabetit-renegat Fadil Hoxha e kisha dëgjuar me qindra herë, në të njëjtin edicion, të qëruar ndjenjash dhe mendimesh. E dija përmendsh çdo të thoshte më tej. A s'ishte ai vetë ai disku i dëmtuar i gramafonit, në të cilin Beogradi ka incizuar mbeturinat e demagogjisë dhe të propagandës më të poshtër e më të tejdukshme, që Fadili t'i shesë me pozat e tij karakteristike prej kreteni që i mban të përveshura buzët dhe me gjuhën e tij të ntrashur prej të çkombëtarizuarit atje ku i shiten më së paku, në Istog, Irzniq, në "zem-zadrugën" e Bishtazhinit. Thua se ka të bëjë me koka lakrash, e jo me pasardhësit e popullit më të lashtë të Gadishullit Ilirik, që ta marrin kokrrën në sy dhe s'u bëhet vonë për rrenat e pakripura, sepse kanë punë më të urta në shtëpi. Thua se ka të bëjë me "lopt dhe viçat" e këtyre "zem-zadrugave", të cilat s'i heq goje. Këtë detyrë i kanë dhënë "urtakët" e Beogradit ish nënkryetarit të Kryesisë së RSFJ, Fadil Hoxhës: që ky të bëjë agjitacion për zëvendësimin e lopëve të vogla "tradicionale" me lopë të mëdha të Banatit, të Kragujevcit, të Danimarkës, që bëjnë viça të mëdhenj.

Pthu! – pështyva, duke menduar në ëndrrën absurde të natës së kaluar. Dhe, në çast, vendosa: bashkë me viçat e mëdhenj të lopëve si ajo që polli Fadilin, do ta shpall të pavlefshme në gazetë edhe ëndrrën time të marrë. Nuk do të blej më viça të mëdhenj, për t'i hyrë në qejf Fadilit, dhe nuk do të shoh kurrë më ëndrra kaq pa lidhje.

Për ata që besojnë me këmbëngulje se ëndrra ka patjetër një dimension të realitetit të përjetuar, kam një ide. Të lidhemi me kusht: a mund të bëjë Fadili zgjandërr qoftë edhe hijen e asaj që bëri në ëndrrën time absurde?

Unë them se jo. Kurrë!

Po ju, vëllezër, si thoni ju?" (Marrë nga Lajmëtari i lirisë, nr.1, gusht 1980, f. 9-10)

-5. Tabela e tretë - Letër Enver Hoxhës

Në tabelën e tretë po japim citate - pjesë nga, potezi, Lëvizja e Jusuf Gërvallës të bërë para 30 vitesh. Ora e Jusufit, flamuri i ngritur i Jusufit, flamuri i parëzuar i Lëvizjes së tij Nacionalçlirimtare, në këtë tabelë është ndalur në datën e përjetshme 19 gusht 1980. E shohim të udhës ta nënvizojmë se letrën për Enver Hoxhën, Jusufi e shkruan **si anëtarë** i "**Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi"**. Këtë fakt vetë Jusufi ia potencon Enver Hoxhës. Nga kjo letër po japim disa pjesë të zgjedhura:

Jusuf Gërvalla: ***"I dashur shoku Enver!***

... Larg ndenjës revanshiste e shoviniste, te ne është ndezur shkëndija e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken në horizont.

Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të socialshovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i ndryshuar i popullit tonë: bashkimi me vendin amë, Shqipërinë, është një e drejtë historike, që iu mohua por nuk iu çrrënjos kurrë popullit tonë të vënë me shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike po të papërkulur kurrë."

Ne prekemi thellë nga ata që sjellin dekurajim e pakënaqësi

"Por, gjithashtu ***ne prekemi thellë*** *në sedër sa herë që, nga mosbesimi në ne apo nga konspiracioni i thellë, ndonjë shtetas i RPS të Shqipërisë ngul këmbë sesi në Jugosllavi nuk jemi aq keq dhe se Shqipëria nuk ka fare të bëjë me të vërtetën sa i përket qëndrimit të Shqipërisë socialiste ndaj tokave të veta të pushtuara,* ***sjellin dekurajim dhe pakënaqësi në mesin e popullit tonë të shumëvuajtur****."*

Ne jemi skeptik rreth pritjes për bashkim në baza marksiste-leniniste

"Prandaj, ne jemi skeptikë se për realizimin e aspiratave tona shekullore, të drejta për bashkimin e tokave dhe të popullit tonë, mund të priten rrethana të rivendikimit në baza marksiste-leniniste."

Lufta jonë politike është fituar

"Pakënaqësia në rritje e popullit tonë, njëherazi, është edhe pasqyrë e luftës politike ndërmjet titizmit dhe popullit shqiptar. Dhe kjo pakënaqësi sot ka arritur në atë shkallë, ***sa mund të thuhet që lufta jonë politike kundër këtij pushtuesi të egër revizionist është fituar gati në mënyrë përfundimtare****."*

Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë

"Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më 1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. ***Përjashtim bën Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë.*** *Kjo lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gji të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare."*

Luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm

"Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin ***se luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm...,*** *është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e*

robëruar të atdheut tonë të përbashkët." (Përmbajtja e plotë e kësaj letre, për herë të parë është botuar në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99 dhe në dy libra tjerë gjatë vitit 2010).

Të drejtën, të veprojë dhe çka është kryesorja, të flasë në emër të Organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi" apo t'i thotë Enver Hoxhës se "*Përjashtim bën Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë"* Jusufi e ka marrë pos të tjerëve edhe nga ata anëtarë që në proceset gjyqësore janë dënuar me 218 vjet burg të përmbledhur.

II. Shah - mati kundër UDB-së dhe TANJUG-ut në vitin 1981

-1. Drejtleximi dhe drejtshkrimi i bibliotekistit

Të gjitha citatet e mëposhtme të këtij nëntitulli janë nga libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit.

"Ai i ishte përgjigjur se në shkollë fillore dhe të mesme i kishte rastisur të kishte mësues të dobët të gjuhës shqipe." (Atentatet, f.13)

"Fatkeqësisht, nuk më ka rastisur të kem mësues të përkushtuar të gjuhës në shkollë të mesme."(f.63)

"Do të thotë, është pothuajse njësoj të jesh mësues ose pjesëtar i strukturave policore dhe shërbimeve sekrete." (f.126)

*"Me përkushtim më ke mësuar se si duhet të shkruaj,– u shpreh ai, duke mos qenë në gjendje ta fshihte vetëkënaqësinë për lavdërimin e sinqertë të Jusufit, – por e kam pasur të vështirë ta kompensoj deficitin e njohjes se gjuhës e stilit, meqë mësuesit në Kosovë i kam pasur të pakualifikuar." (f.*186)

"Një mësues imi i dikurshëm, Saud Gorani, që tani është oficer i policisë kriminalistike në Pejë, informoi për pritat e policisë djalin e axhës, Imerin. Menjëherë u alarmuam. Më ndihmuan të arratisem dhe ia dola." (Atentatet, f. 209)

Si rregull dashuria për gjuhën dhe rregullat e drejtshkrimit lindin si pasojë e etjes për të lexuar. Pra dashuria për letërsinë të sjellë tek rruga e gjuhësisë, drejtleximi të ndihmon për tek drejtshkrimi. I. Kelmendi i akuzon mësuesit e tij të dobët, por megjithatë kjo nuk e ka penguar që të bëhet bibliotekist i të tjerëve.

-2. Internacionalizmi proletar i Frontit të Kuq

Të gjitha citatet e mëposhtme të këtij nëntitulli janë nga libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit. Nga mendimet e mëposhtme shkëlqen internacionalizmi proletar i Frontit të Kuq të emërtuar nga UDB-a.

*"– Pyetja e fundit: Përse pothuajse shumica e pjesëtarëve të organizatës suaj i kanë **gratë ose dashnoret serbe**, duke filluar nga Emil Kastrioti, Vehbi Ibrahimi, e të tjerë si këta?*

– Mendoj se ua kanë dhënë eprorët, për t'i mbajtur më mirë nën kontroll edhe jashtë. Po nga i di ti të gjitha këto, nëse më lejohet të të pyes?

– Të gjithë ata që i njohin, flasin për këtë dukuri, meqë jo të gjithë anëtarët i keni të rekrutuar nga kjo farë UDB–ja serbe. Disa i keni anëtarësuar, meqë i keni mashtruar sa për t'i përdorur për informatorë dhe për t'ua zhvatur ndonjë para në emër të anëtarësisë dhe të kontributit për veprimtari, në dukje patriotike. Ata të

*shkretë nuk ju njohin, por nuk durohen pa folur, meqë nuk u pëlqen pse i kanë **gratë e dashnoret serbe**.*
– Edhe unë nuk ua kam begenisur atyre këtë përçudni. Ti e pe, unë e kam gruan shqiptare, atë që ma ka fejuar baba, sipas traditës." (Atentatet, f.81)

*"I dëgjova kur dolën së bashku Rezili me atë gruan. Ata flisnin midis tyre **serbisht, mbase kroatisht apo boshnjakisht**, gjuhë që unë nuk i dalloj." f.133*
*"– Mos më hidhëro, sepse nuk e kam pasur të lehtë ta survejoj dhe sidomos të përmbahem pa e vrarë në shkallë kur e shihja të bisedonte e të tallej me atë **shkinulë**.*
*– Atëherë qenka puna thellë. Nuk doka kallauz për të konstatuar se ai është kuadër i UDB–së. Edhe individë të tjerë, për të cilët unë kam formuar bindje se janë udbashë, i kanë gratë serbe. Ata, si nacionalistë e patriotë që reklamohen, për **gratë dhe dashnoret e tyre serbe, gënjejnë se i kanë boshnjake ose kroate**. Meqë qenka kështu, të shkojmë te Jusufi e Bardhi.*
– Po shkojmë,– miratoi Vasili." f.133
*"– Të shohim nëse vërtet Rezili jeton me atë **gruan**, për të cilën ti po dyshon që është **serbe."** f.134*

*"Dhoma e gjumit duhej të ishte përballë, por nuk e dinte nëse në atë kohë ishte aty gruaja dhe djali. Ai po mendonte se **serbja** dhe fëmija duhej të ishin në dhomë të gjumit, meqë takimi ishte planifikuar në lokal." f.136*
"– Përjashta! – ulëriti Rezili tashmë i tërbuar fare. Nuk të duhet gjë ty, është jetë private kjo!
– Mos ulërit se nuk ta kam frikën. Mos më bëj të të hedh nga dritarja! – ia ktheu Mirani.
*– Ti do të duhet të shpjegosh se përse **bashkëjeton me një serbe** në një banesë? Përse e ke mbajtur deri tani këtë të fshehtë ndaj këtyre, nënkryetarit e sekretarit të Grupit? Duhet t'u tregosh këtyre se në çfarë vendi të sigurt, nën përkujdesjen e një **serbeje,** ruake gjithë dokumentacionin e Grupit!*
*Mirani fliste drejtuar nga Rezili, por po vështronte herë pas here Maksin, se mos ai bënte ndonjë lëvizje. Tjetri nuk lëvizte vendit, por dukej se ishte shokuar nga shpërthimet e Rezilit, të **bashkëjetesës së tij me serbe**, siç e mori vesh më në fund." f.143*
"Rezili iu kishte afruar dritares dhe mbante kokën me të dy duart, duke mërmëritur nëpër dhëmbë, por që nuk kuptohej se ç'thoshte. Ndërkohë Maksi foli me zë të theksuar:
*– Vasil, ku po do? Ndal të bisedojmë pse ky qen bashkëjetoka **me një shkinulë** këtu, kurse gruaja ime dhe shokët tanë janë në burg në Kosovë për tradhtinë që na e paska bërë ky pis." f.143-144*
*"– Çfarë po flisni kështu, ai duhet vrarë,– foli Maksi i përndezur.– I kam dorëzuar në origjinal formularët e anëtarësimit të plotësuar e të nënshkruar në Kosovë, pa ditur se ai jeton në të njëjtën banesë me një **shkinë**, me të cilën paska edhe djalë." (Atentatet, f.145)*

-3. Ma bëre shah-mat, - tha Jusufi duke qeshur

Ibrahim Kelmendi: "*Ndoshta vetëm disa nga udhëheqësit e OMLK-së kishin bindje të thekur komuniste dhe Enver Hoxhën e çmonin si klasik të komunizmit. Por, jo të tjerët, kurrsesi jo. Për ilustrim po marrë shembullin e Jusuf Gërvallës. Nuk besoj të kem njohur bashkevëprimtar më "enverist" fanatik sesa Jusuf Gërvallën. Ai vërtet e çmonte Enver Hoxhën për idhull, ama, vetë ai, në parim, ishte antikomunist, sepse doktrinën komuniste e identifikonte dhe e diskualifikonte si doktrinë sllavomadhe."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.185)

Internacionalisti i Frontit të Kuq të emërtuar nga UDB-a befasohet nga shabllonizimet raciste të Jusuf Gërvallës. Ibrahim Kelmendit, personi të cilin Jusufi më 20 gusht 1981 e cilëson si mercenar të mercenarit, të cilit mësuesit e dobët të gjuhës nuk ia kanë mësuar rregullat e drejtshkrimit dhe drejtleximit, i epet rasti të bëhet bibliotekist i Jusuf Gërvallës dhe i mban atij ligjërata për letërsinë botërore.

Ibrahim Kelmendi: *"Mirani nuk e merrte me mend, sesi një rrobaqepës mund të bëhej udhëheqës i Jusufit, këtij intelektuali poliedrik...*
– Kësaj radhe nuk më ke sjellë libra, apo nuk ke më?
– Nga fusha e letërsisë nuk kam të tjera pos atyre që t'i kam sjellë.
Kam kompletin e veprave të Leninit, të Stalinit, të Enverit. Po të interesuan të sjell nga ato. Këtu e kam edhe një listë të librave që kam, meqë më kërkojnë bashkatdhetarët dhe mbaj evidencë.
– Të atyre dy komunistëve sllavë nuk i dua, të Shokut Enver po.
– Nuk të shkon të bësh shabllonizim të këtillë, – ia ktheu Mirani i befasuar, meqë nuk e priste këtë nga Jusufi.– Po të Tolstojit, të Dostojevskit, të Gorkit dhe të shkrimtarëve të tjerë të mëdhenj sllavë, të pëlqejnë?
– ***Ma bërë shah–mat,– tha ai duke qeshur.***
– Më ka ndodhur të dëgjoj vlerësime të tilla të disa shqiptarëve, se urrejnë Leninin e Stalinin vetëm për shkak se na qenkan sllavë, Marksin për shkak se ka qenë çifut, e kështu me radhë." (Atentatet 148-149)

Ibrahim Kelmendi: "*Sa i përket pyetjes vijuese, nuk do të thosha se Jusuf Gërvalla ishte ideolog dhe as lider i përmasave te madhërueshme. Ai ishte një krijues e kritik letrar goxha brilant dhe, po të vazhdonte të jetonte, do të na kishte dhënë vepra të mira letrare, po vetëkuptohet, nëse nuk do te merrej me veprimtari politike, do të thosha. Ishte këngëtar me zë tejet melodik, instrumentist, kompozitor, gazetar e publicist brilant, madje i talentuar edhe në artet grafike, por ideolog e udhëheqës nuk ishte, sepse literaturën përkatëse e ka urryer dhe as ndonjë përvojë të atij lëmi nuk kishte. Ne vitin 1980 pati nisur të lexonte veprat e Leninit dhe me vrull i përdorte citatet nga ato. Them se për lider nuk mund të vlerësohet, derisa pranonte ta udhëhiqte, më saktësisht ta manipulonte një rrobaqepës gjysmanalfabet, siç ishte Sabri Novosella, për të mos thënë dhe ndonjë sharlatan edhe me i ulët se rrobaqepësi. Tjetër është madhërimi dhe mitizimi që i kemi bërë, ndër të cilët jemi dhe ne të dy, ne për interes të hovëzimit te lëvizjes çlirimtare, disa të tjerë për ta shpërdorur për interesa egoiste e të ulëta vetjake.*

Thënë shkoqur, asnjë bashkëveprimtar nuk e kam pasur më për zemër se Jusufin, ama mitizimet dhe madhështitë deri në banalizime, që po u bëhen Jusufit dhe shumë të tjerëve, vërtet po ma zbehin admirimin për veprimtarë kombëtar heronj." (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.39-40)

-4. GJITHSESI NUK TË KAM KEQKUPTUAR

Ibrahim Kelmendi: *"– Nuk më paske kuptuar, – reagoi Jusufi pa pritur nëse Mirani do të vazhdonte të fliste,– kur të thashë se më zure shah–mat.*
– Edhe mundet, por ***gjithsesi nuk të kam keqkuptuar****.*
– (Jusufi - shën i Xh. D.) Atëherë po të sqaroj, ***unë nuk i dua komunistët, për të mos thënë jam kundërkomunist...****"* (Atentatet, faqe 150)

Jusuf Gërvalla: *"Ju porosis të shikoni* ***ndonjë shok me bibliotekë*** *të pasur dhe të merrni prej tij e ta lexoni librin e V. I. Leninit: "Ç'të bëjmë?". E gjeni në vëllimin 5 të kompletit të veprave të Leninit, nga faqja 401 deri në fund. Unë besoj se do ta gjeni, po të përpiqeni. Kurse leximi i kësaj vepre është i domosdoshëm."* (Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 28)

Jusuf Gërvalla: *"Aq më parë është e rëndësishme ta sheshojmë mënyrën e punës së "Frontit...", sepse është në kundërshtim të rreptë me veprimtarinë revolucionare marksiste – leniniste, pa marrë parasysh që vetë ka si pikënisje idenë marksiste – leniniste. Por, vetëm formalisht..."* ((Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30)

Jusuf Gërvalla: "***Përshëndetje shqiptare e komuniste, „Lajmëtari“"*** (Letër Nuhi Sylejmanit, pas 11 marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 36)

I. Kelmendi i fletë Kadri Zekës për parashikimet profetike të kryeartikullit të shkëlqyeshëm, e pa asgjë origjinale të Bashkimit. Na e përkujton se Jusufi këtij kryeartikulli ia patë shtuar një citat të Leninit (atij Lenini që dikur Jusufi e urren në baza raciste vetëm e vetëm pse është sllav).

I. Kelmendi: "– Në ilegalitet të thellë dhe për shkak të konspiracionit, ndonjëherë edhe naiv, vështirë gjenden lidhjet. Pastaj, sikur hetoj një dukuri që ka të bëjë me pozimet tuaja, sikur keni kushedi çfarë organizime të shtrira dhe të fuqishme. Tani jemi të vonuar dhe po dëshmohen parashikimet që patëm bërë në kryeartikull të Bashkimit. ***Bile Jusufi pat shtuar një citat të Leninit, që dikur e urrente për shkak të përkatësisë së tij sllave****, se kur ndodhin shpërthimet, është e pamundur të organizohet forca udhëheqëse." (Atentatet, f.295)*
I. Kelmendi: "– ***Si nuk e paske harruar qëndrimin tim për Leninin****? – pyeti Jusufi, duke shprehur pakënaqësinë pse Mirani po e thoshte këtë në prani të Kadriut. –* ***Vërtet unë isha vetëm enverist dhe nuk doja Lenin e Stalin, meqë ishin sllavë****.* Por, për *Stalinin më tregoi Mirani, se nuk ishte sllav..." (Atentatet, f.296)*

I. Kelmendi është njeri që mund të të mos kuptoj por ai kurrë nuk të keqkupton.

Si mund të jetë mit i qëndrueshëm e universal një person që urren të tjerët në baza raciste. A nuk mjafton vetëm kjo 'dëshmi' e I. Kelmendit për shembjen e mitit të Jusufit.

E vërteta e këtyre etiketimeve të shokut të Sadik Blakajt për Jusufin, për njërin ndër përkthyesit më cilësor të kulturës sllave, si të Ciril Zlobecit e Danilo Kishit në gjuhën shqipe e ka bazën në urrejtjen për zbulimin që bënë Jusufi në letrën e ditës së Tahir Mehës dërguar Nebih Mehës:

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I .Kelmendi - vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin

e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta ***në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj,*** *që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar,* ***të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.*****"**(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)
e cila e ka vazhdimin më 20 gusht 1981

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët ***në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij****, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari,*** *atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të.* ***Të shpresojmë se ai e meriton."(***Letër S. Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

-5. Jusuf Gërvalla si përkthyes i kulturës

Të shohim me pak fjalë respektin e Jusufit për kulturën e vërtetë, në këtë rast atë sllave të dokumentuar më së miri nga shoku i Jusufit, Kadri Rexha. Për Jusufin si përkthyes i veprave të kulturës sllave në gjuhën shqipe apo të kulturës shqipe në gjuhët sllave, kështu shkruan

Kadri Rexha: *"Ndër përkthimet më të rëndësishme të Jusuf Gërvallës nga letërsia jugosllave dhe ajo botërore vlen të ceken këto: një pjesë nga romani "Kështjella" të Mesha Selimoviqit, botuar në revistën 'Jehona' të Shkupit; pjesë nga romani 'Uliksi' të shkrimtarit Xhems Xhojs botuar në 'Bota e re' të Prishtinës; një cikël tregimesh poetike të shkrimtarit Franc Kafka, botuar në 'Bota e re' të Prishtinës. Për nevoja të Teatrit Popullor Krahinor në vitin 1975 Jusuf Gërvalla përktheu dramën 'Gloria' të Ranko Marinkoviqit, të cilën e botoi edhe Redaksia e botimeve 'Rilindja' e Prishtinës. Me përkushtim të madh Jusuf Gërvalla e përktheu edhe romanin 'Klepsidra' të shkrimtarit Danilo Kish, të cilin e botoi Redaksia e botimeve 'Rilindja'. Po ashtu nga opusi poetik i poetit të shquar slloven Ciril Zllobec Jusuf Gërvalla bëri zgjedhjen dhe përktheu vëllimin poetik me titull "Amshimi im i shkurtër", të cilin e botoi Redaksia e botimeve 'Rilindja'. Gjithë talentin dhe vokacionin e tij prej përkthyesi Jusuf Gërvalla e shkriu në përkthimin e veprës madhore poetike "Legjendat e Guatemalës" të shkrimtarit latinoamerikan Asturias, po ashtu e botuar nga 'Rilindja'. Nga eseistika këtu vlen të ceket përkthimi i esesë së shkrimtarit Edgar A. Po lidhur me poezinë 'Korbi', të botuar në revistën 'Jehona'.*

Ndër përkthimet më të rëndësishme të Jusufit nga gjuha shqipe në gjuhën serbokroate po i përmendim këto: një pjesë nga romani 'Padrona' të shkrimtarit Teki Dërvishi, botuar në një revistë letrare të Nishit; poema 'Frymëmarrjet e detit' e T. Dërvishit; romanin 'Halveti' të T. Dërvishit, me të cilin autori mori pjesë në një konkurs letrar me karakter jugosllav, përkthim që ka mbetur i pabotuar; dramën televizive 'Vdekja e

Gjergjezit' të B. Musliut, me të cilin autori mori pjesë në një konkurs letrar, por përkthimi nuk është botuar; esenë 'Moda e mallkuar' të Rexhep Qosjes. Ndërkaq për shkaqe të njohura e la të papërfunduar, në dorëshkrim, romanin 'Zanoret e humbura' të Zejnullah Rrahmanit.

Një veprimtari të dendur në fushën e përkthimit Jusuf Gërvalla e zhvilloi edhe për nevojat e Televizionit të Prishtinës. Këtu vetëm po e përmendim përkthimin e filmit të Kinostudios 'Shqipëria e re' 'Beni ecën vetë' të regjisores Xh. Keko. Ky film u përkthye nga gjuha shqipe në gjuhën serbokroate. Në gjuhën shqipe Jusuf Gërvalla i përktheu edhe disa filma dhe emisione dokumentare nga produksioni i shtëpive filmike dhe televizive të Jugosllavisë. Në bashkëpunim me Shaqir Shaqirin përktheu dhe shqipëroi edhe një numër të konsiderueshëm filmash artistikë nga kinematografia botërore." (Fati i luleve, Prishtinë 1993, f.133-134)

-6. Rezignacioni i UDB-së dhe TANJUG-ut

Jusufi, përndryshe një harresës i pandreqshëm, befasohet se si I. Kelmendi nuk e ka harruar rastin e 'shah-matit' që e ka marrë nga I. K. lidhur me mendimet e veta (pra të J. G.) raciste ndaj Leninit dhe e përsëritë se ai ka qenë vetëm enverist. Shokut të mirë të Sadik Blakajt, nipit të Dajës Ramë dhe të dëshmitarit të besueshëm të OMLK-së është rasti t'u tregojmë se shokët e Jusufit nuk i harrojnë kurrë fjalët që i ka shkrua Jusufi më 1981, të botuara në Zërin e tij, në janar 1982.
Të shohim çka shkruan Jusufi në "Zërin e tij" në janar 1982:

"Vive le son du canon!

Nga artikulli i V. I. Leninit: Parathënie për broshurën 'Promemorja e drejtorit të departamentit të policisë, Lopuhin'

Një i burgosur politik kosovar paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexua asnjë vepër të Leninit.

Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti. Të burgosur politikë shqiptarë - vetëm pas ngjarjeve të përgjakshme të marsit dhe prillit - ka me mijëra, e të paktën janë 232 sish, të shpallur zyrtarisht, që kanë marrë dënime drakoniane. Dhe në mos të gjithë, në pjesën dërmuese po se po, në mos marksistë-leninistë të ngritur, këta të burgosur janë së paku ithtarë e dashamirës të marksizëm-leninizmit. Dhe kjo mjafton për fillimin e çdo lufte çlirimtare dhe të çdo revolucioni.

Nga ana tjetër, ky është një grusht i rëndë për sistemin e arbitrarizmit policor jugosllav, sado që qeveria e Beogradit, me maskën e "marksizëm-leninizmit" mbi surrat, ushtron një pushtet thellësisht antimarksist, antipopullor e antikombëtar. Prandaj i pëlqen aq shumë Tanjugut ta ngrejë në dukuri çështjen e atij luftëtarit tonë të lirisë, i cili s'e paska lexuar Leninin. Por kjo nuk na brengosë fare, ne jemi të vetëdijshëm që Tanjugu, sikur të kish pasur në dorë shënime qoftë vetëm edhe për një tjetër të burgosur politik shqiptar, "që të mos e ketë lexuar Leninin", nuk do të lente kurrë pa e propaganduar gjerë e gjatë në shtyp me një vetëkënaqësi edhe më të madhe kreteneske. Por, tukse s'e përdori, do të thotë se nuk e gjeti.

VIVE LE SON DU CANON!

Nga artikulli i V. I. Leninit: Parathënie për broshurën «Promemorja e drejtorit të departamentit të policisë, Lopuhin»

Një i burgosur politik koso var paska deklaruar para do kohësh se është marksist-leninist i bindur; kur e pyesin më gjatë në hetuesi, ai gjoja qenka përgjigjur se nuk e ka lexuar asnjë vepër të Leninit.

Kështu thotë Tanjugu dhe kjo mund të jetë edhe e vërtetë, dhe, edhe po të jetë e vërtetë, s'ka krisur kiameti.

Zëri i Kosovës, Nr.2 janar 1982, faqe 10

Konkluzioni është i qartë. Policia e fshehtë jugosllave, ose në mënyrë më të popullarizuar

> Ibrahim Kelmendi*: "Kam kompletin e veprave të Leninit, të Stalinit, të Enverit. Po të interesuan të sjell nga ato. Këtu e kam edhe një listë të librave që kam, meqë më kërkojnë bashkatdhetarët dhe mbaj evidencë.*
> *– Të atyre dy komunistëve sllavë nuk i dua, të Shokut Enver po.*
> *– Nuk të shkon të bësh shabllonizim të këtillë, – ia ktheu Mirani i befasuar, meqë nuk e priste këtë nga Jusufi." (*Atentatet, faqe 148-149)

UDB-ja, përpiqet ta kompromentojë me cinizëm figurën e luftëtarëve tanë të lirisë. Prandaj, me gojën e Tanjugut, ajo bien në 'rezignacion' pse këta nuk e paskan lexuar Leninin! E ç'të mirë mund të pres arbitrarizmi policor jugosllav nëse kundërshtari i tij i lexon veprat e viganit të revolucionit socialist. Ato, a ishin në anën e arbitrarizmit

policor, apo pikërisht në anën e kundërshtarëve të tij? Mos, duke lexuar Leninin, luftëtarit tonë do t'i bjerë hovi revolucionarë? Apo do të ngjasë e kundërta.

Megjithatë, pasi i 'pëlqeka' UDB-së, ne që s'e kemi lexuar dhe që e kemi lexuar pak Leninin, tash e tutje do ta lexojmë edhe më me zell.

Ja ç'thotë Lenini për një situatë në Rusinë cariste të vitit 1905. Sa është ajo e ngjashme me situatën e sotme në Kosovë e në viset tjera shqiptare në Jugosllavi, le të konkludoj vetë lexuesi ynë i ndershëm. Tanjugu le të qesë fall me letra, le të shikoj në filxhan të kafesë ose në shpatull të pulës se si do të zhvillohen fatet e mëtejme të shovinizmit serbomadh..."

Ia lëmë fjalën Leninit:

Pak e sak! - duket sikur thotë zoti Lopuhin në promemorjen e tij. Një gjë e mirë për policinë është Ligji "i përkohshëm" mbi rojën e përforcuar, që qysh prej vitit 1881 është bërë një nga ligjet themelore më të qëndrueshme të Perandorisë ruse. Policia merr të gjitha të drejtat dhe fuqitë e plota "për t'i mbajtur ndër duar qytetarët", sipas shprehjes së qëlluar të promemories, shprehje që të bie aq më shumë në sy, sa më shpesh ngec duke e lexuar atë ngaqë është shkruar në mënyrat më të rënda, të mbrapshta, burokratike të të folurit (për krahasim, lexoni Platformën politike të LKJ për çështjen e Kosovës — red. e "Zërit të Kosovës"). Po policia ra rehat me këtë "Ligj", por vetijat e tij "të mira" e llastuan policinë. Kjo nga njëra anë. Kurse nga ana tjetër, masat e jashtëzakonshme të shtypjes, të cilat mund të dukeshin të jashtëzakonshme këtu e njëzet e pesë vjet përpara, janë bërë aq të zakonshme, sa që, nëse mund të shprehemi kështu, edhe popullsia u mësua me to. Vlera represive e këtyre masave të jashtëzakonshme është dobësuar, siç dobësohet një sustë e re nga përdorimi i saj i gjatë dhe jashtë masës. Nuk ia vlen barra qeranë, - thotë drejtori i Departamentit të policisë z. Lopuhin, me tërë promemorjen e tij, që bashkohet nga një ton melankolie dhe dëshpërimi.

Një përshtypje jashtëzakonisht të kënaqshme i bën socialdemokratit ky ton dëshpërimi, kjo kritikë konkrete, e thatë dhe megjithatë e pamëshirshme, e një njeriu të policisë, kritik që drejtohet kundër ligjit themeltar të Rusisë. Perënduan ditët e mira të mbarëvajtjes së policisë! Perënduan vjetët 1860-1870, kur as që mendonte njeri se kishte një parti revolucionare. Perëndoi dhjetëvjetëshi i tetë, kur forcat e një partie të tillë, që padyshim ekzistonte dhe kallte tmerr, ishin "të mjaftueshme vetëm për atentate të veçanta, por jo edhe për një revolucion politik". Në ato kohëra, kur "agjitacioni ilegal gjente mbështetje në persona e rrethe të veçuara", kjo sustë e shpikur rishtas mund të bënte njëfarë efekti. Po sa shumë është shthurur kjo sustë tani, "në gjendjen e sotme të shoqërisë, kur në Rusi po zhvillohet në shkallë të gjerë edhe pakënaqësia kundrejt gjendjes ekzistuese të punëve edhe një lëvizje e fortë opozitare". Sa absurde dhe sa pa kuptim dhe pa kuptim dolën masat e jashtëzakonshme të rojës së përforcuar, kur u bë e nevojshme pikërisht: *u bë e nevojshme* që ato të përdoren me mijëra "kundër punëtorëve për grevat që kishin karakter paqësor dhe synonin në objektiva vetëm e vetëm ekonomike", kur edhe gurët filluan të konsiderohen si armë të rrezikshme nga pikëpamja politike!

I gjori Lopuhin nga dëshpërimi vë dy pikëçuditëse, duke i ftuar zotërinjtë ministra të qeshin bashkë me të me pasojat absurde, në të cilat çoi ligji mbi rojën e përforcuar. U pa se asgjë s'vlen në këtë ligj që kur lëvizja revolucionare depërtoi si duhet në popull dhe u lidh pazgjidhshmërisht me lëvizjen klasore të masave punëtore, - asgjë, duke filluar që nga regjistrimi i pasaportave dhe duke mbaruar me gjyqet ushtarake. Edhe "instituti i portierëve", instituti i mrekullueshëm shpëtimtar i portierëve i nënshtrohet një kritike asgjësuese nga ministri i policisë, që e akuzon këtë institut pse ka ushtruar një influencë dobësuese mbi aktivitetin preventiv të policisë.

Me të vërtetë, një falimentim i plotë i rendit policor!

Lenini si mysafir i Maksim Gorkit, në prill 1908 në Capri të Italisë, duke luajtur shah me A. A. Bogdanovin

"Vladimiri, ashtu si në lojën e shahut, ai kurrë nuk e tërhoqi një lëvizje prapa, por ai nuk u lejonte as të tjerëve ta bëjnë këtë."

Dhe ky falimentim vërtetohet, përveç deklaratave të një personi aq kompetent, si shumë i nderuari z. Lopuhin, nga gjithë procesi i zhvillimit të politikës cariste. Atëherë, kur akoma nuk kishte një lëvizje revolucionare me të vërtetë popullore, kur lufta politike akoma nuk përbënte një të tërë të pandarë me luftën e klasës, atëherë ishin të vlefshme vetëm masat policore kundër personave dhe rretheve të veçanta. Kur u drejtuan kundër klasave, këto masa u bënë tepër të pafuqishme dhe qesharake dhe duke qenë kaq të tepërta, ato filluan të bëhen një pengesë për punën e policisë. U pa se paragrafet dikur të tmerrshme të Ligjit mbi rojën e përforcuar s'ishin veçse disa kleçka mezerabël, meskine, të cilat më tepër ndezin pakënaqësinë e "qytetarëve" që nuk bëjnë pjesë në radhët e revolucionarëve, se sa prekin seriozisht revolucionarët. Kundër revolucionit popullor, kundër luftës së klasës, nuk mund të mbështetesh te policia; prapë duhet të mbështetesh te populli, prapë duhet të mbështetesh te klasat. I tillë është morali që del nga promemoria e z. Lopuhin. Dhe i tillë është edhe morali, në të cilën arrin në praktikë qeveria autokratike. U dobësuan sustat e mekanizmave policore. Nuk mjaftojnë më vetëm forcat ushtarake, duhet ndërsyer armiqësia nacionale, raciale, duhet organizuar "qindëshe të zeza" nga shtresat më pak të zhvilluara të borgjezisë së vogël

qytetare *(dhe më vonë, natyrisht edhe të borgjezisë fshatare),* duhen bërë përpjekje që të bashkohen për mbrojtjen e frontit të gjithë elementët reaksionarë të popullsisë, duhet shndërruar lufta e policisë kundër rretheve në një luftë të një pjese të popullit kundër pjesës tjetër të tij.

Pikërisht kështu vepron tani qeveria, duke ndërsyer latarët kundër armenëve në Baku, duke u përpjekur të provokoj pogrome të reja kundër çifutëve, duke organizuar qindëshet e zeza kundër zemistëve, studentëve dhe gjimnazistëve rebelë, duke u bërë apel fisnikëve besnik dhe elementëve konservatorë të fshatarësisë. Ç't'i bësh? Ne, socialdemokratët, nuk çuditemi nga kjo taktikë e absolutizmit dhe nuk trembemi prej saj. Ne e dimë se qeveria nuk do të arrijë të shfrytëzoj ndezjen e armiqësisë raciale tani, kur punëtorët kanë filluar të organizojnë rezistencën e armatosur kundër pogromistëve; ndërsa duke u mbështetur në shtresat shfrytëzuese të borgjezisë së vogël, qeveria do të bëjë që kundër saj të ngrihen masa edhe më të gjëra me të vërtetë proletare. Ne nuk kemi pritur kurrë dhe nuk presim që revolucionet politike dhe sociale të vijnë nga "bindja" e atyre që kanë fuqinë në dorë ose nga kalimi i njerëzve të kulturuar në anën e "virtytit". Ne kemi thënë dhe themi gjithmonë se lufta e klasave, lufta e pjesës së shfrytëzuar të popullit kundër pjesës shfrytëzuese të tij përbën bazën e transformimeve politike dhe *në fund të fundit* vendos fatin e të gjitha transformimeve të këtij lloji. Duke pranuar dështimin e plotë të metodave policore meskine dhe duke kaluar në organizimin e drejtpërdrejtë të luftës civile, qeveria provon me këtë se dita *e llogarisë së fundit* po afrohet. Aq më mirë. Qeveria po fillon luftën civile. Aq më mirë. Edhe ne jemi për luftën civile. Në qoftë se ne e ndiejmë gjëkundi veten veçanërisht të sigurt, është pikërisht në këtë fushë, në luftën e masës kolosale të popullit të shtypur dhe pa të drejta, të popullit shumëmilionësh, që punon dhe mban të gjithë shoqërinë kundër një grupi parazitësh të privilegjuar. Sigurisht, duke ndezur armiqësinë raciale dhe urrejtjen midis kombësive, qeveria mund ta ndalojë përkohësisht zhvillimin e luftës së klasave, por kjo vetëm për një kohë të shkurtër dhe me çmimin e një zgjerimi akoma më të madh të fushës së luftës së re, me çmimin e zemërimit akoma më të madh të popullit kundër absolutizmit. Prova: pasojat e pogromit të Bakusë, i cili bëri që shpirti revolucionar i të gjitha shtresave të popullsisë kundër carizmit të dhjetëfishohet. Qeveria mendonte ta frikësonte popullin me derdhjen e gjakut dhe me viktimat e panumërta të përleshjeve nëpër rrugë - po në të vërtetë ajo *po ia nxjerrë popullit frikën* nga gjakderdhja, nga përpjekjet e armatosura të drejtpërdrejta. Në të vërtetë ajo po vepron në favorin tonë me një agjitacion aq të gjerë dhe aq bindës, sa që ne as që e kemi ëndërruar. Vive le son du canon! themi ne, duke përdorur fjalët e këngës së revolucionarëve francezë - "Rroftë gjëmimi i topave!", Rroftë revolucioni, Rroftë lufta e hapur e popullit kundër qeverisë cariste dhe përkrahësve të saj.
Artikulli është marrë nga vëllimi i 8 i veprave të Leninit, botimi shqip, Tiranë, 1954"
(Zëri i KOSOVËS, nr.2, janar 1982 faqe 10-11)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980 ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës.*" (Letër Sabri Novosellës, korrik 1981)

Ibrahim Kelmendi: "*Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..."* (I. Kelmendi për Sadik Blakajn më 21 janar 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Konkluzioni është i qartë. Policia e fshehtë jugosllave, ose në mënyrë më të popullarizuar UDB-ja, përpiqet ta kompromentojë me cinizëm figurën e luftëtarëve tanë të lirisë. Prandaj, me gojën e Tanjugut, ajo bien në 'rezignacion' pse këta nuk e paskan lexuar Leninin!"*

NE TANI KEMI SHTYPIN TONË

Çështje të brendshme dhe të jashtme të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës të trajtuara nga Jusuf Gërvalla në tri letrat e tij të fundit, të shkruara më 14 e 15 janar 1982.

I. ÇËSHTJE TË BRENDSHME
1. Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë
2. Kështu e pata kuptuar më në fund
3. Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë
4. Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna
5. Marku dhe Kola
6. Ndoshta mund të gjeni ndonjë shofer shqiptar nga Turqia
7. Me presionin dhe insistimin e Shpendit
8. Themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë
9. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"

II. ÇËSHTJE TË JASHTME
1. Pesë filma e drama shqiptare të shkëlqyeshme
2. Të përgëzoj për martesën
3. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë
4. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq
5. Lojë e pamirë me personin tim dhe Organizatën time
6. Ti mund dhe besoj se je i painformuar
7. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë
8. Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar
9. Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste
10. Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e **famshme** "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"
11. Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta
12. Po të nxori rruga këndej ndonjë ditë

I. ÇËSHTJE TË BRENDSHME

Çështjet të cilat shqyrtohen në këtë pjesë (pikat 1-8) i referohen letrës së Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës, më 14 janar 1982. Kjo letër për herë të parë është botuar në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 452-454.

1. Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë

Jusuf Gërvalla: *"Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë. Unë e shkrova në disa variante, por me asnjërin prej tyre nuk mbeta i kënaqur. Nuk jam mësuar të komunikoj me një nivel të tillë. Më së fundi e lash variantin që e mora prej teje.*

Hapi si hap më pëlqeu shumë dhe më duket shumë i dobishëm. Por, nuk di a duhet të jemi të kënaqur si e kemi realizuar.

Në letrat e fundit na kanë ardhur disa këshilla nga ana juaj. Ta them të drejtën se mua personalisht më kanë lënë me një ndjenjë të ftohtë. Thelbi i tyre konsiston, sipas përshtypjes sime, në një tërheqje në vete, që u dashka të aplikohet prej nesh. Ose nuk kam qenë në gjendje ta kuptoj qartë. Se cilësia duhet të ketë përparësi ndaj sasisë, kjo dihet dhe për këtë kam shkruar edhe vetë, nëse të kujtohet, në atë Qarkoren drejtuar shokëve në D., që ti e ke pas pëlqyer." (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Për çfarë letre të planifikuar për Komitetin Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë është fjala? Këtu është fjala për një letër të planifikuar si pasojë e rastit të Mehmet Shehut më 17 dhjetor 1981. Pjesa e dytë e citatit ka të bëjë me taktikën për mos tërheqje prapa përkundër terrorit serbomadh.

2. Kështu e pata kuptuar më në fund

Jusuf Gërvalla*: "Por që atëherë kushtet kanë ndryshuar shumë. Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit,* ***gatishmëria e madhe për flijime të larta,*** *ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë. Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët.* ***Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit - shën im) dhe timen në KQ.*** *Rinia jonë revolucionare po kërkon radhët e revolucionarëve të organizuar. Ajo do të kapet në ato hallka që do t'i gjej më lehtë. Po e mbyllëm ne, ajo do të kapet për radhët e të tjerëve. Më duket se Lëvizja duhet të mblidhet, t'i trajtojmë me seriozitetin më të madh disa çështje vitale që dalin nga momenti aktual e që i kanë rrënjët në kushtet e ndryshuara shumë pas demonstratave të pranverës së shkuar.* ***Mendoj se Lëvizja duhet të përfshihet prej impulsesh të reja. Se cilat do të jenë këto impulse, unë nuk jam në gjendje ta them. Por, po të përpiqen shokët, do ta gjejnë doemos."*** (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

3. Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë.*** *Por pa u siguruar mënyra e sigurt e transportit dhe e shpërndarjes së tij, shtypi mbetet gjysmë i vdekur. Kurse ne nuk mund të krenohemi se kemi krijuar kushte as për transport, e mbase as për përhapjen e tij të suksesshme. Kjo gjë po ushtron ndikim negativ edhe në punën e vetë redaksisë së "Z.K." Është një ndjenjë e ligë kur mendon se je duke shkruar diçka që e ka shumë vështirë të bjerë në dorën e lexuesit."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Në këtë pikë, më 14 janar 1982, Jusuf Gërvalla flet për se "kemi shtypin tonë" duke menduar në "Zërin e Kosovës" si organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe asgjë tjetër. Fati i gazetave të organizatave tjera ka qenë çështje e organizatave përkatëse dhe jo e Jusufit dhe Lëvizjes së tij.

4. Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna

Jusuf Gërvalla*: "Siç e di, ne kemi pas bërë këndej njëfarë transporti të shtypit. E kemi futur atë në Atdhe, por atje s'i kemi pasur njerëzit që do ta shpërndanin si duhet. Tani,*

në drejtimin e transportit, kemi pësuar më në fund edhe një disfatë. Me numrin 1 të "Z.K." dërguam për në Atdhe ***dy punëtorë****. Rruga e futjes së materialit ishte po ajo që kishim ndjekur në tri raste të suksesshme të transportit. Por kësaj radhe puna dështoi dhe ata dy punëtorët ndodhen në duart e UDB-së. Pas kësaj e kemi shumë vështirë të ndjekim të njëjtën rrugë. Tani a ta qajmë materialin që nuk ra në duart e lexuesit, apo të qajmë njerëzit që na u dëmtuan. Aktualisht s'po i bëjmë ballë dot t'u japim rrugë. Është disfata e parë kësodore qe dy vjet e këtej dhe na ka demoralizuar shumë. Sa patëm zënë të kënaqemi e të marrim krah nga materialet që po na arrinin për revistën, tash u desh të na dilte ky problem."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Me fjalët *dy punëtorë* mendohet në Shaban Klaiqin dhe Islam Rafunën. Për këta është shkruar një punim i veçantë në www.pashtriku.org, me titull "Si u dënuan Shaban Klaiqi dhe Islam Rafuna për Zërin e Kosovës?"

Nami Ramadani (majtas) dhe Kolë Mërturi

5. Marku dhe Kola

Jusuf Gërvalla*: "Nga ana tjetër, mënyra se si është vepruar nga ana juaj atje me futjen e materialit brenda, jo vetëm që nuk i plotëson nevojat për shtypin revolucionar në Atdhe, por është e pasigurt dhe e rrezikshme po aq sa mënyra jonë. Si me një kopje të "Z.K." si me një mijë, njeriu rrezikohet njësoj.*

S'i t'ia bëjmë këtij halli të madh? ***Marku*** *s'na erdhi. Edhe po të kish ardhur, më duket, (sipas fjalëve të* ***Kolës****) se edhe ai tashmë nuk është i pakompromet*uar *në sytë e UDB-së."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Me Markun mendohet në Mark Mërturin, i cili ka bërë punë të rëndësishme për Lëvizjen e Jusufit. Marku e ka ndihmua dhe organizua arratisjen e Sabri Novosellës në

Shqipëri në dhjetor 1979. Me Kolën mendohet në Kolë Mërturin, i afërm i Markut, punëtor në rrethin e Shtutgartit që njihet me Bardhoshin qysh në ditët më të hershme. Kolë Mërturi është person i rëndësishëm i cili i ndihmon Jusufit në mbajtjen e lidhjeve me Kosovën.

6. Shofer shqiptar nga Turqia që kalon nëpër Jugosllavi

Jusuf Gërvalla*: "Ne kemi vrarë mendjen se rruga më e sigurt për futjen e shtypit në Atdhe është shfrytëzimi i ndonjë transportuesi në relacionet evropiane. Juve ndoshta mund t'u vij përdoresh të gjeni ndonjë shofer shqiptar nga Turqia që bartë mall me kamion të madh prej shteteve evropiane, e që kalon nëpër Jugosllavi. Ne do t'ia jepnim që këtej materialin, kurse shokët brenda duhet të gjejnë mënyrën se si ta marrin prej tij në dorëzim atë material. Në rast të tillë neve do të na zvogëlohej problemi edhe sa i përket shtimit të tirazhit të revistës edhe shpeshtimit të daljes së saj, gjë që ka rëndësi të madhe.*

Është keq që këtë punë s'e kemi bërë para disfatës sonë të parë, por tash kjo duhet të na bëhet preokupim shumë serioz. Ndryshe, spontaniteti do të na kushtojë shtrenjtë dhe do të bëjë që të zhagitemi si zvarranikë e jo të vrapojmë fuqishëm si revolucionarë." (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Edhe në këtë pikë shihet preokupimi i Jusufit vetëm me Zërin e Kosovës, dhe sugjerimet e idetë që ia jep Sabri Novosellës për metodat e futjes së revistës në Kosovë. Idetë për mendimet e tij në këtë pjesë të letrës Jusufi i merr nga Nami Ramadani, i cili ka punuar si shofer kamioni në Gjermani dhe është marrë me shpërndarjen e një pjese të gazetave të Jusuf Gërvallës me kamionin e tij gjatë udhëtimeve nëpër Gjermani e Evropë Perëndimore.

7. Me presionin dhe insistimin e Shpendit

Jusuf Gërvalla*: "Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e Shpendit (Xhafer Durmishit - shën. im), për të mos thënë me presionin e tij, Shpendi shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri. Së andejmi u paraqit disa herë në telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm, a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Me insistimin tim dhe me ndihmën e Jusufit unë nisem për Kosovë, rreth 10 dhjetorit 1981, me qëllim që ta pranoj "Zërin e Kosovës" në Slloveni dhe të organizoj shpërndarjen e tij në Kosovë. Poashtu qëllimi im ishte të kontaktoj me një jurist, (S. K.) i cili do të na ndihmonte në trajtimin juridik të dënimeve që bëheshin nga pushteti jugosllav, të mbledhi informata për ngjarjet prej qershori deri në dhjetor në Kosovë. Për këtë qëllim Jusufi dhe djali i Ismail Haradinajt - Naimi, nga Gllogjani, më kanë përcjell deri në Munchen. Në Munchen kemi bujtë ne të tre një natë tek Misin Mavraj. Në këtë rrugë kisha edhe një aparat fotografik të vogël, të kualitetit të lart për atë kohë të cilin do t'i jepja Asllan Muharremit për të bërë fotografime për llogari të revistës Zëri i Kosovës. Në ato ditë Jusufit i patën ardhë ndihmë nga Turqia 10 mijë dollarë amerikan. Prej kësaj ndihme, nga Jusuf Gërvalla, janë paguar të gjitha shpenzimet e mia për këtë rrugë. Pas shkuarjes në Kosovë, tek Sheremet e Ismet Saraçi në Bivolak dhe Asllan Muharremi në Mihaliq, kam kontaktuar Bahtir Haradinajn nga fshati Stanoc i Epërm.

Asllan Muharremi

Me Bahtirin, si anëtar i Lëvizjes - i anëtarësuar prej meje qysh më heret, kemi shkuar në Lesce Bled, në mënyrë që prej aty të marrim udhëzimet nga Suzana, përmes telefonit të fqinjës së saj Ursula Lindmeier se ku duhet të shkojmë e si ta pranojmë revistën. Në bisedën e parë nga Sllovenia, Suzana më ka thënë që të kthehem në Kosovë, pasi shokët e caktuar, nuk janë lajmëruar sipas marrëveshjes çka domethënë se janë arrestuar. Ngjarje të kësaj periudhe e rruge i kam përshkruar më gjerësisht në kapitullin "Si më njoftoi UDB-a për vrasjen e Jusuf Gërvallës?"

8. Themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë

Jusuf Gërvalla*: "Tani po kthehem edhe njëherë në fillim të letrës.* ***Mendimi im është se disa çështje parimore, siç është themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë, pastaj mënyra e organizimit të Lëvizjes në kushtet e reja të luftës, duhet të diskutohen e të pleqërohen më dendur me shokët, sidomos me Plakun (Bujar Hoxhën - shën i Xh. D.)****. Jo vetëm gabimet e mëdha parimore, por edhe të voglat ka mundësi të evitohen shumë më mirë në këtë mënyrë.* ***Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun.*** *Në këtë pikëpamje ne jua kemi lakmi, se këndej punët me relacione të tilla nuk janë aq të thelluara, jo për fajin tonë.*

Në fund, duke ju dërguar të fala vëllazërore e revolucionare, kërkoj falje për helmin e derdhur në këtë letër, por na helmuan ca problemet e përmendura dhe është e udhës t'i ndajmë bashkë." (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Me fjalët ***Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun*** Jusufi mendon në Bujar Hoxhën. Pse Jusufi i thotë këto fjalë? Sepse Sabriu krenohet shumë se ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me te (pra me Bujar Hoxhën).

9. S'KEMI PSE UA DËRGOJMË AS "HELMIN"

Pal Sokoli: "*Emocione zgjoj edhe akti kur unë (Pal Sokoli) në marrëveshje me kryetarin z. Martin Çuni dhe kryesinë e LSHAKSH-së në Gjermani shpalla vendimin për anëtarësimin, (post mortum) në Lidhjen e shkrimtarëve, artistëve dhe krijuesve shqiptarë në Gjermani, e dy figurave të ndritshme të kombit tonë; patriotin, poetin dhe artistin;* ***Jusuf Gërvalla****, si edhe albanologun, linguistin, shkrimtarin modern, dhe pedagogun e urtë prof.* ***Martin Camaj.*** *Salla e duartrokiti në duke qëndruar në këmbë disa minuta, këtë vendim të qëlluar. Në skenë e ftova z. Martin Çuni, që në emër të LSHAKSH-së në Gjermani, fletë anëtarësimin më emër të Jusuf Gërvallës të ja dorëzoi bijës së tij, Donikë Gërvalla- Schwarz.* ***Donika e pranoi e emocionuar dhe tha:" Ju falënderoj përzemërsisht për këtë akt, dhe e besoj se po të ishte gjallë Jusufi, askund nuk do ta ndjente veten më mirë së në gjirin e kësaj Lidhje..".*** (LSHAKSH dhe SH.I.H.K nderuan trinomin Gërvalla dhe Zeka; www.zemrashqiptare.net, 6 maj 2012)

Jusuf Gërvalla: "*Vehbi Ibrahimi, i vrarë në Belgjikë, ishte sekretari personal i (E. Kastriotit). Ky far Emili i së ashtuquajturës "Besëlidhja shqiptare", është një nga reaksionarët më të mykyr të shqiptarëve në Perëndim. Enver Hadri, për sa jam i informuar, i takon gjoja një partie komuniste, por me orientim prorus.* ***Edhe Martin Camaj, për sa dimë, është kundër Shqipërisë.*** *Për emrat e tjerë, adresat e të cilëve na janë dërguar me nganjë pikëpyetje pranë, nuk dimë gjë. Ne s'po u dërgojmë tash për tash asgjë, derisa të mos vërtetohet puna e tyre.* ***Në qofshin si këta që përmendëm më lartë, s'kemi pse ua dërgojmë as "helmin", lëre më shtypin tonë****. (Fjala është për Hasan Beun në Amerikë, Hysen Çamin në Suedi, Vincenzo Gollettin në Frankfurt)."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 454)

II. ÇËSHTJE TË JASHTME

Përveç planeve dhe punëve të brendshme të Lëvizjes së vet të cilat i diskuton vetëm me atë që duhet me i diskutue, pra me eprorin e vet të Lëvizjes së tij Sabri Novosellën, Jusufi të premten më 15 janar i shkruan dy letra për personat që nuk janë në Organizatën e tij, Lëvizjen e tij.

1. Pesë filma e drama shqiptare të shkëlqyeshme

Çështjet të cilat shqyrtohen në këtë pjesë (pikat 1-2) i referohen letrës së Jusuf Gërvallës dërguar Kadri Zekës, më 15 janar 1982. Kjo letër është botuar për herë të parë në www.albaniapress.com, më 5 qershor 2009 nga Faridin Tafallari, si shtojcë e shkrimit "IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!???")

Jusuf Gërvalla*: "Para disa ditësh e mora* ***videokasetën e pritur. Në të janë pesë filma e drama*** *shqiptare të shkëlqyeshme. Shfaqjet e tyre të para ndër punëtorët tanë, treguan se janë shumë frymëzues. Ne ende nuk arritëm t'i shumëzojmë e t'jua dërgojmë edhe juve, sepse po na mungon edhe një videofon i dytë.*

Sa më shpejt që të mundemi ta bëjmë inçzimin e tyre, ne do t'jua dërgojmë videokasetën. ***Ndoshta Ibrahimi ka mundësi më të mira, prandaj i thashë të vijë me videofonin e klubit****, e po të vijë e bëjmë një kopje edhe për ju në Zvicër. Po kështu kam marrë edhe disa shirita me radiodrama (për kasetofon).*

E mbase t'i shohim për të mbuluar shpenzimet e tyre. Në to janë përfshirë radiodramat: " Epoka para gjyqit"; "Besa e madhe"; " Toka jonë"; " Prijësja e komitëve"; "Toka e ndezur". (Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982)

Në *videokasetën e pritur*, Jusufi ka pritur se do të vijnë materiale nga zhvillimet e punimeve të Kongresit VIII të PPSH. Në vend të punimeve të Kongresit, në videokasetën e pritur vijnë filmat/dramat: Mësonjëtorja, Gërsheti i luftërave, Udha e shkronjave, Epoka para gjyqit dhe Plumba Perandorit.

2. Të përgëzoj për martesën

Jusuf Gërvalla*: "Njëherazi shfrytëzoj rastin t'ju përgëzoj edhe njëherë për martesën dhe t'ju uroj trashëgim të frutshëm shqiptar."* (Letër Kadri Zekës, 15 janar 1982)

Këtë letër Jusufi ia shkruan Kadriut në Zvicër të premten, më 15 janar 1982, pa e ditur aspak se ai qysh nga 12 janari (e marta) gjendet në Düsseldorf. Me këtë nuk dua të them se Kadri Zeka ka pasur nevojë t'i jep llogari Jusufit se kah shkon e kur del prej shtëpie.

Aspak. Me këtë dua të them vetëm e vetëm këtë se në këtë kohë Kadriu i ka koordinuar punët me shokun e vetë të Organizatës, Ibrahim Kelmendin. Ai ka shkua në Gjermani vetëm për llogari të OMLK-së dhe Frontit të OMLK-së. Se sa respekt të madh ka për Jusufin e tregojnë ftesat e Faridin Tafallarit të dërguara për dasmë, dhe përshëndetja e I. Kelmendit dërguar Faridinit për Vitin e Ri 1982. Se si i kanë marrë me mend sjelljet e Jusufit në këtë kohë Kadriu e Ibrahimi mundet me na e dhënë një ide të vogël letra e I. Kelmendit dërguar Faridin Tafallarit, në një situatë e vitit 1980 që ka mjaftë ngjashmëri me janarin 1982.

I. Kelmendi*: "Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye, ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete. Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin."* (Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980; FT, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)

Letra tjetër i dërgohet shokut të organizatës së Kadri Zekës, Ibrahim Kelmendit, e cila përfundimisht i hedh poshtë të pavërtetat se Jusufi i ka ftuar Ibrahimin e Kadriun në Shtutgart.

3. Arsye për të qenë aq gjaknxehtë

Çështjet të cilat shqyrtohen në këtë pjesë (pikat 3-12) i referohen letrës së Jusuf Gërvallës dërguar Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982. Kjo letër është botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Jusuf Gërvalla: "*Me bisedën që patëm **në dasmë**, unë në njëfarë mënyre u tregova i padrejtë ndaj teje. Por, duhet ta kesh kuptuar që **gjaknxehtësinë** time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij. Arsye për të qenë aq **gjaknxehtë** mbase nuk kam pasur."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufi i thotë I. Kelmendit se në dasmën e Kadri Zekës më 2 janar 1982, është treguar i padrejtë ndaj tij. Pse i padrejtë? Sepse shumë gjëra që Jusufi ia thotë Ibrahim Kelmendit, në të vërtetë i ka merituar dhe kanë qenë të adresuara për Kadriun, por pasi ka qenë dasmë Jusufi nuk mund t'ia thotë atij direkt por ia thotë shokut të tij të organizatës, Ibrahim Kelmendit.

*Por, duhet ta kesh kuptuar që **gjaknxehtësinë** time mund ta zbrazja vetëm mbi një shok me të cilin nuk kemi pasur kufij.* Me këtë fjali Jusufi ka parasysh dy periudha nga viti 1980; Shkurt - prill 1980 dhe kohën nga 28 Nëntori 1980 deri më 18 dhjetor 1980, kur Jusufi pa kurrfarë kufizimesh e ndihmon dhe mundëson botimin e gazetës "Bashkimi".

Pse Jusufi është gjaknxehtë? Sepse në këtë kohë Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi zhvillojnë fushatë, nëpër Zvicër e Gjermani kundër Lëvizjes dhe vet Jusufit. Si mund të përmblidhet përmbajtja e kësaj fushate?

- Në përputhje me TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS, është formuar FRONTI POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.
- Të gjitha organizatat në Kosovë i janë bashkuar FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS.
- OMLK-ja për këtë qëllim e ka përpiluar dokumentin "THIRRJE - TË GJITHË NË FRONT! TË GJITHË PËR FRONTIN!
- Vetëm Lëvizja e Jusuf Gërvallës nuk po donë me iu bashkua Frontit!
- Vetëm Jusuf Gërvalla ka dalë kundër bashkimit! Pra të gjithë janë për bashkim, vetëm ai është kundër!

- Kjo do të thotë se në Lëvizjen e Jusuf Gërvallës ka njerëz antikomunist që nuk pranojnë të udhëhiqen nga komunistët!
- Në një organizatë që nuk pranon të udhëhiqet nga komunistët punët qëndrojnë shumë keq!

4. Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq

Si përgjigje në fushatën e Kadri Zekës, në të cilën është i involvuar edhe Ibrahim Kelmendi Jusufi përgjigjet me fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla: *"Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon **aspak keq**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

5. Lojë e pamirë me personin tim dhe organizatën time

Jusuf Gërvalla*: "Por, nga takti më kanë nxjerrë disa gjeste e veprime **të një shoku**, që të kundruara nga distanca e të sotmes, më dalin **një lojë e pamirë**, së pari me personin tim, e pastaj edhe me një organizatë, çka, më shumë organizatë revolucionare, madje në një çast madhështor të historisë sonë, që implikon dashurinë, afrimin dhe sinqeritetin më të madh mes luftëtarëve të lirisë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me ***gjeste e veprime të një shoku*** Jusufi ka parasysh Kadri Zekën. Gjestet e tilla Jusufi i konsideron ***lojë e pamirë*** edhe me atë si person e gjithashtu edhe me Lëvizjen e Jusufit (LNÇKVSHJ).

6. Ti mund dhe besoj se je i painformuar

Shefqet Cakiqi - Llapashtica: "*E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981."* (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 21:22)

Ibrahim Kelmendi: "*Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë **kam qenë i inkuadruar në të gjitha takimet për bisedime**. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë." (www.kosova.de,* Afishuar me: 23.03.2007 22:57)

Jusuf Gërvalla*:" Ti mund dhe besoj se **je i painformuar** lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë **kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Letra e Jusufit e 15 janarit 1982 është letra e parë që Jusufi ia dërgon Ibrahim Kelmendit, pas një letre në nëntor 1980.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i ***përfshirë, inkuadruar*** *apo* ***informuar*** prej anës së Jusufit gjendet i sqaruar në tërësi në dy letra të Jusufit të dërguara Sabri Novosellës; më 13 maj dhe 20 gusht 1981. Këto dy letra unë i kam shtjelluar në kapitujt "Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore" dhe "Në Kalanë e Jusuf Gërvallës" andaj nuk është nevoja të zgjerohem këtu më shumë.

Shkaku pse Ibrahim Kelmendi nuk është i ***përfshirë, inkuadruar*** *apo* ***informuar*** në bisedimet rreth bashkimit prej anës së Kadri Zekës nuk është çështje me të cilën ka pasur nevojë të merret Jusufi dhe rrjedhimisht nuk është çështje me të cilën kam nevojë të merrem unë. Jusufi i përgjigjet shumë mirë Ibrahim Kelmendit:

*Por, unë **kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë.***

Çka dinë Jusufi? Ku bënë tani (më 15 dhjetor 1982) Ibrahim Kelmendi?

Jusufi e din se Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi janë në të njëjtën organizatë.
Kush i tregoi Jusufit këtë fakt? - Kadri Zeka!
Ku? - Në panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

7. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë

Jusuf Gërvalla*: "Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusufin nuk e lejon edukata e tij të përzihet në punët e brendshme të Kadri Zekës e Ibrahim Kelmendit. Jusufi i thotë I. Kelmendit se shokët e tu të rinj (Kadri Zeka etj.) e kanë me borxh me të përfshi, me të inkuadrua e me të informua.

8. Nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar

Jusuf Gërvalla*: "Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, **do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme.** Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Të gjitha thëniet e këtij citati janë aq të qarta sa është vështirë, ndoshta edhe mëkat me u mundua e me i thënë më mirë.

9. Antikomunist e kundërshtar i partisë iluzioniste

Jusuf Gërvalla*: "Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. **S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne**. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "**antikomunist**" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Me **njeriun antikomunist të Lëvizjes** mendohet Sabri Novosella. Pra, Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi mendojnë se Sabri Novosella mundet me u ndie i ofenduar nëse ata e shpallin si antikomunist. Këtu shtrohet prapë një çështje delikate. Pasi Kadri Zeka dhe OMLK-ja e konsiderojnë vetëm veten komunist të formuar dhe askënd tjetër, kjo domethënë se e meta dhe gjynahu i Sabriut nuk qëndron në atë se pse ai nuk është komunist, por pse është **antikomunist** e kundërshtar i partisë iluzioniste.

10. Bashkimi i shpallur si akt i kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"

Jusuf Gërvalla: *"Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në **thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!"**, të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z (Kadri Zeka - shën i Xh. D.).*

*Tani po e kupton se unë hyra shumë thellë në punë që s'janë të miat, **në punë tuaja të brendshme.** Prandaj, nuk shkoj dot më tej. Dëshiroj që ana jonë këndej të jetë e gabuar dhe juve t'ju shkojë puna për së mbari deri në arritjen e fitores. Ne s'ndiejmë frikë as*

kemi dëm nga cilado forcë me të vërtetë patriotike e revolucionare e popullit tonë. Përkundrazi, atë kërkojmë si qorri sytë dhe ajo na bënë të mburremi. Por kemi një çikë ndruajtje se punës i është zënë jo fort mirë peta." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

11. Bashkimin do ta bëjnë njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta

Hydajet Hyseni: *"Ata dy, Jusufi e Kadriu, madje, kishin biseduar dhe ishin pajtuar edhe për ndonjë kompromis e për ndonjë tërheqje taktike, për të evituar këto keqkuptime me shpresë se në këtë mënyrë do ta lehtësonin realizimin e synimit madhor të bashkimit të ri të lëvizjes."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Hasan Mala*: "Isufi i ka thënë (Kadri Zekës - shën i Xh. D.) se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Jusufi e ka pritë me rezervë, domethënë ai e ka pritë me rezervë që pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë."* (Nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1992)

Jusuf Gërvalla*: "Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e **bashkimit**. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, **do ta bëjnë** kur të vijë koha, **njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta**."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

12. Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë

Jusuf Gërvalla*: Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu.*

Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë *dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë.* ***Me këtë rrugë, për të njëjtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z****., megjithëqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Jusuf Gërvalla: *"Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z (Kadri Zekën - shën i Xh. D.). Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por* ***megalomaninë*** *e arrivistëve të revolucionit,* ***ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981).

Ibrahim Kelmendi: *"Kritere ideopolitike Jusufi nuk kishte paraqitur ndonjëherë, meqë edhe nuk i njihte në atë nivel sa për të këmbëngulur në të tijën. Të vetmin kriter tepër fanatik kishte idhujtarinë për Enver Hoxhën, por më shumë si udhëheqës i kombit, sesa si ideolog komunist."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.48)

Po në këto ditë del edhe numri i dytë i Zërit të Kosovës, Zëri i Jusufit i cili haptazi i diskuton disa aspekte të çështjeve të bashkimit. Ja se çka shkruan Zëri i Kosovës, i janarit 1982, në faqe 2.

Jusuf Gërvalla*: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në*

tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.
*Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. **Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë (**fjalët i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij - shën i Xh. D.)*, dhe **ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta**, (këto fjalë i drejtohen ish - inspektorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica - shën i Xh. D.) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."* (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2)

Kadri Zeka me I. Kelmendin, në mbrëmjen e 16 janarit, nga Düsseldorfi vijnë në Shtutgart, bëjnë telefonata tek shokët e Jusufit, me shpresë se Jusufi, ashtu siç ka prognozuar më parë I. Kelmendi, ka hy në lëkurën e vetë. Prej ndonjërit prej tyre marrin vesh se aktivistët e dalluar janë të tubuar në Bernhausen. Kadri Zeka, siç e kemi parë më parë i ankohet Faridinit se pse nuk ua din adresat njerëzve më të mirë në rrethin e Shtutgartit dhe për ta kompensuar këtë mangësi e ka I. Kelmendin me vete, i cili pa vonesë e qon në Bernhausen. Kaq e ngutshme dhe e shenjtë është puna e bisedimeve të bashkimit, "e ftesa e Jusufit" sa ata qëndrojnë duke parë video-filma deri në 02.00 të natës të 17 janarit 1982. Në Untergruppenbach mbërrijnë në ora 03.00 të 17 janarit 1982, pesë ditë pasi Kadriu ka udhëtuar nga Zvicra.

NË QOFSH GJALLË

Ngjarje nga koha e rrethimit të Jusuf Gërvallës, nga DARKA E FUNDIT, e mbrëmjes së 16 janarit deri në 05.00 të agimit të 17 janarit 1982

1. DARKA E FUNDIT
2. Po vijmë bash qysh kemi pas qejf
3. As njeri nuk besonte se do të kthehej ai
4. Të gjithë kanë qenë të një mendimi
5. MË NË FUND U MORËN VESH
6. VETË JUSUFI KISHTE KËRKUAR
7. TË MBAHEJ SI ARTIKULLUES I FUQISHËM ATDHETARIE
8. SIPAS TË GJITHA GJASAVE NË NATËN E VRASJES
9. TRI NGJARJE HISTORIKE PËR KOSOVËN
10. SIPAS DËSHMISË SË BASHKËVEPRIMTARIT TË TYRE
11. Ju kam thirrur që të rifillojmë bisedimet për bashkim
12. Jemi informuar se kush hyn e del te ti
13. NËSE BASHKOHEMI DO TË RREZIKOHEMI
14. Vendet tona t'i zënë njerëzit e saj
15. Vetëdija e Jusufit për peshën e punës së vet
16. Rrjedha e bisedimeve më 17 janar 1982 nga ora 03.00-05.00

17. TASHMË JEMI SQARUAR SE KUSH NA E BLLOKOI VENDIMIN TONË
18. Tani m'u duk momenti i duhur
19. E kishte njohur mjaftë mirë - Unë nuk e kam njohur
20. Të shkuara e të harruara, siç thotë populli
21. Gëzim i madh që propozimin po e bënte vetë Jusufi
22. E HARTOJMË VENDIMIN TË CILIN PROPOZOJ TA NËNSHKRUAJMË
23. TANI E TUTJE NUK JANË MË TEZA POR PROGRAM
24. Sy të mbushur me lot - Je i pastër si loti
25. Nuk e kishte plotësuar stazhin e kandidatit
26. ATENTATET BASHKË ME SHOKËT MA VRANË EDHE KËTË PROPOZIM
27. SI DUHET TË BASHKËPUNOJMË ASHTU SIÇ ISHTE BASHKËPUNUAR PËRPARA
28. MË DUKET NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE

Shkurtesa QE: Qendra Ekzekutive (QE), ka ekzistua prej 15 janarit 1983, kur është themelua në Ludwigsburg e deri më 3 mars 1984 kur është shpërbërë, në një mbledhje të mbajtur në Gjenevë pas demonstratës së organizuar po atë ditë në atë qytet. Anëtar të saj kanë qenë Xhafer Shatri, Faridin Tafallari, Xhafer Durmishi, Hasan Mala dhe Ibrahim Kelmendi. Pse jam i detyruar ta jap këtë sqarim për një organ të Lëvizjes që ka vepruar nga 15 janari 1983 - 3 mars 1984 në këtë punim ku afati kohor në shqyrtim është nga 16 - 17 janari 1982? Sepse letrat që janë shkruar për anëtarët e kësaj Qendre Ekzekutive, të cilat i kam përdorë, janë (përveç letrave të Jusufit dhe fjalëve të gruas së tij, Suzanës rreth amanetit të tij) ndër faktet më vendimtare, më të fuqishme për t'i kuptuar fabrikimet dhe falsifikimet që kanë bëjnë me atë që ka ndodhë dhe atë që nuk ka ndodhë nga mbrëmja e 16 janarit deri në mesditën dhe mbrëmjen e 17 janarit 1982.

1. DARKA E FUNDIT

Majtas: Murat Kryeziu, Kolë Mërturi, Nami Ramadani etj. Djathtas: Faridin Tafallari me shoqe dhe gratë e Muratit, Kolës e Namiut, në përkujtim të Darkës së Fundit, më 17 Janar 2009 në Heilbronn

Jusufi, ky harresës i madh, harron se të premten më 15 janar 1982 ia nisë një letër rekomandë, I. Kelmendit në adresën e tij, dhe një tjetër të shkurtë Kadri Zekës në Zvicër, dhe i thërret në Shtutgart, të shtunën më 16 janar 1982, por jo në shtëpinë e vet por tek Murat Kryeziu në Bernhausen (afër aeroportit të Shtutgartit) I. Kelmendin dhe Kadriun.

I. Kelmendi*: "Ndërkohë Muja, vëllai i Miranit, bëri telefonatë dhe njoftoi se Jusufi i kishte thirrur Kadriun e Miranin të shkonin sonte tek ai, por pikëtakimi ishte te Murtez Kryebardhi në Bernhausen, afër aeroportit të Shtutgartit"* (Atentatet, f. 316)

"*Shfaqja zgjati deri rreth orës dy pas mesnate. Pas përfundimit të shfaqjes, grupe-grupe dolëm jashtë. Pasi u përshëndet me ne, Ibrahim Kelmendi bashkë me Sylë Nuhën u nisën për Dyseldorf."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 69)

Faridin Tafallari: *"Ndejtëm aty deri vonë; nga mesnata u ndamë. Kur dolëm jashtë dhe po ndaheshim, unë i thash Kadriut që të vinte tek unë për të fjetur. Kadriu pranoi dhe i tha Jusufit: "**Unë po shkoj te Faridini**". Por Jusufi iu përgjigj: "Jo, sonte do të vish tek unë." Kadriu përsëri i tha: **"Ti mund të kesh mysafirë në shtëpi dhe bëhemi shumë vetë; prandaj po shkoj te Faridini."** Por Jusufi e mori me vete dhe për atë natë u ndamë pasi u përqafuam. Sikur ta dinim që ai do të ishte përqafimi i fundit.!!*

Nuk më kujtohet ai i thanë apo jo edhe Ibrahim Kelmendit që edhe ai të shkonte me ta, por di se Ibrahimi i tha: "Mua më duhet të udhëtoj për Dyseldorf, pasi edhe atje dua t'i tuboj bashkatdhetarët për të shfaqur këta filma." Dhe ashtu u bë. Kadriu shkoi me Jusufin e Bardhoshin kurse Ibrahim Kelmendi me Sylë Nuhën shkuan për në Dyseldorf." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 49)

Hasan Mala (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, f. 382)

Xhafer Shatri (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës..."*. (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, f. 382)

Jusuf Gërvalla*: "Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. **Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta.***

*Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu. **Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë**. Me këtë rrugë, për të njëjtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z., megjithëqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon.* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

2. Po vijmë bash qysh kemi pas qejf

"*Atëherë njëri prej të Dymbëdhjetëve, ai që quhet Judë Iskarioti, shkoi te kryepriftërinjtë dhe u tha: "Çka po më jepni e unë po jua dorëzoj?" Ata i caktuan **TRIDHJETË** sikla të argjendta. Që atëherë Juda kërkonte rastin e volitshëm për ta tradhtuar."* Bibla, Mateu 26 (14-16)

Numri i rrugës në murin e banesës së Murat Kryeziut në Bernhausen
(Foto: Faridin Tafallari)

Murat Kryeziu tregon se *Në mbrëmjen e shfaqjes së filmave "Gërsheti i luftërave", "Epoka para Gjyqit", "Udha e shkronjave" e "Mësonjëtorja" kanë qenë:*

Jusuf Gërvalla,	*Bardhosh Gërvalla,*	*Remzi Ademaj*
Selim Dulla	*Faridin Tafallari*	*Ismet Klaiqi,*
Shaban Bobaj,	*Mejdi Rexha,*	*Halil Rexha,*
Qemal Haxhillari,	*Nuhi Sylejmani,*	*Shemsi Bunjaku me një shoqe gjermane,*
Ismajl Qirezi,	*Abdurrahman Sadiku,*	*Nami Ramadani me tre shokë*
Jahir Jahiri.		

Pas disa orësh të shikimit të filmave kanë ardhur Kadri Zeka, Ibrahim Kelmendi dhe Sylë Nuha.

Shoqja e Shemsi Bunjakut, një gjermane, nuk ka qëndrua tërë mbrëmjen pasi e ka mundua tymi i duhanit.

Në fillim Bardhi ka pasur vështirësi me programimin e videos dhe televizorit tim dhe për ndihmë e kam thirrur një fqinjë slloven me emrin Alojz i cili më kishte ndihmuar edhe më parë dhe ai me Bardhin e kanë bërë rregullimin e funksionimit të televizorit me videon.

Rreth orës dy të natës 02.00 të ditës së diell (17 janar 1982) Sylë Nuha më ka thënë se a ka kabinë telefonike afër. I kam tregua se ka (kabina ka qenë 20 metra prej hyrjes së banesës) dhe e kam përcjellë gjer tek kabina dhe e kam pritë deri se e ka krye bisedën dhe në këtë mënyrë edhe kam pasë mundësi me e dëgjua bisedën telefonike të Sylë Nuhës. Sylë Nuha i ka thënë këto fjalë në telefon:

"- Po vijmë bash qysh kemi pas qejf."

Dhe personit me të cilin ka folur në kabinë telefonike Sylë Nuha ia kërkua dy numra të telefonave të cilët i ka shënua në letrën e një pakete cigaresh Marlboro. Këtë deklaratë ia kam dhënë policisë gjermane në rastin e parë në shtëpi të Jusufit në Untergruppenbach dhe çka është më së interesanti këtë deklaratë e kam dhënë në prani

të Ibrahim Kelmendit e Sylë Nuhës, pasi këta dy të fundit gjithashtu kanë mbërri në shtëpi të Jusufit. Policia më ka pyet:

- Cili është ky Sylë Nuha, i cili ka folur në telefon?

Ia kam treguar me gisht. Ibrahim Kelmendi e ka dëgjua këtë bisedë nga afër dhe shumë i idhnuem më ka thënë se pse ia tregove atë fakt policisë. Unë iu kam përgjigj Ibrahim Kelmendit me këto fjalë:

- Këtu janë vra tre veta dhe policisë duhet me ia dhënë çdo imtësi. Murat Kryeziu tregon se këto fjalë me këtë thelb të përmbajtjes ia ka thënë policisë gjermane dhe i ka ritreguar shumë herë për familjen e Vëllezërve Gërvalla. Përmbajtjen e mësipërme Murat Kryeziu ma ka përsëritur edhe mua, Xhafer Durmishit, gjatë disa bisedave telefonike të bëra në prill 2010.

Më heret e kemi ëndrrën e I. Kelmendit, sipas të cilës Bardhi, qysh në ditën që mbërrin Jusufi në Gjermani, më 21 dhjetor 1979, pa i heq këpucët i bënë telefon I. Kelmendit dhe gjoja i thotë se Jusufi është i interesuar ta takoj atë sa më parë. E të njëjtit stil është edhe fantazia e "bisedës telefonike" të 16 janarit 1982. Jusufi i dërgon dy letrat e fundit në jetë, të premten më 15 janar 1982 dhe atë një Kadri Zekës dhe një Ibrahim Kelmendit. Pikërisht fakti se Jusufi i dërgon letër Kadriut në Zvicër vërteton se ai (Jusufi) as që e ka idenë më të vogël se Kadriu gjendet në Düsseldorf për rregullimin e punëve të Frontit për Republikë qysh nga e marta, 12 janari 1982. Dy letrat e Jusufit dëshmojnë se ai nuk ka bërë kurrfarë thirrje Kadri Zekës dhe I. Kelmendit.

Se sa është në gjendje Jusufi të bëjë punë të pabesa e kokë më vete e t'i shes shokët e Lëvizjes së vet, e të filloj edhe bisedën më të vogël për ndonjëfarë bashkimi pa u konsultuar, sidomos kur atë mundësi e ka të shkëlqyeshme e që i ka munguar aq shumë për 16 muaj rresht, e tregojnë më së miri fjalët e Jusufit:

Jusuf Gërvalla*: "Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. ***Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku."*** (Letër S. Novosellës, 5 nëntor 1981)

3. As njeri nuk besonte se do të kthehej ai

Jusuf Gërvalla*: "****E kishin vrarë xhandarët në Pejë****, te Zalli, endej fjala rreth tangarit mbi prushin që shkrihej me përtesë. Dalëngadalë, Keta u harrua, si bora e parvjetme. E morën të ligat e përroit dhe bëmat e haxhuzeve. As njeri, as dru në mal nuk besonte më se do të kthehej ai në Vijuj ndonjë vjeshte të vonë, apo me syrin e* ***NDONJË PRANVERE TË JASHTËZAKONSHME.***

Kishte kohë që rripi i ngushtë i livadhit dhe oborri i madh i kullës së Ketës po shndërroheshin në një rudinë të shkretë, tek luanin guxhas barinjtë. Bari i shkelur pa mëshirë në vjetët e gjatë të arratisë kurbetqare ishte përvjelë dalëngadalë duke u lëmekur nën të mbathurat e barinjve, sa dikur kishte dalë lëkura e fortë e tokës së murrme, shkelur e ngjeshur si dhiarja skaj varrezave të katundit. Kopshti i vogël përmbi shpatin kundruall kullës së tij, rrethuar me një gardh të bërë gati rrafsh me tokën, ishte mbushur me bar të keq, me shkurre e manaferra dhe kishte vjet e vjet që pemët nuk

lidhnin më fruta të ëmbla. Pullazin po e shkelte këmba-këmbës një blerim i praptë që kapej mbi rrasat e zëna pisk nga myshqet dhe lagështia e tyre veshtullore.

Po pate nevojë për ndonjë rrasë, ja tek e ke pullazin e kullës së Ketës. Nëse të duhet ndonjë hu i shëndosh gardhi, ja gardhi i zhgardhuar i Ketës: sa kalben në ato hurdha, merri - njeri i gjallë s'të del përpara. Në kullë kishin mbetur edhe ca dërrasa të forta, që të mund ta duronin peshën e një bualli, kush - edhe në pend buaj mund t'i mbanin ato! Po deshe, mund t'i zhgojoje dhëmbëzish e gozhdësh dhe të bëje me to ndonjë varr: sa merr malin e prenë bungun, ja tek i ke ata trarë të drejtë.

Se si erdhi e u zverdh një shkretëtirë e vogël rreth kullës së Ketë Avdisë. Rrëzë mureve të saj pluhur, plehra njerëzish, farë bari të keq. Një mbretëri e tërë bëzhdilesh, ku loznin fëmijët, që natën u hynte tmerri dhe s'merrnin dot zemër të rrinin aty. Se aty flinin shpirtrat e këqij të gjysharroshkëve flokëverdhë.

Pranvera të lagështa, oborri bëhej bërrak, strofull bretkosash e gjarpërinjsh.

Hija e Ketës u zbeh fare në kujtesën e fshatarëve dhe vetëm ndonjë plake të shthurur nervash i kujtohej ende e i dhimbsej fytyra thatime e djalit-dragua, të cilin e shporrën vatre fjalët e liga të botës mahiçare, ajo fytyrë e mpirë që djemve të zgjuar po u bëhej shenjë vetmie dhe arratie të dashurisë, kuptim i vëllait të pavëlla, i vëllait të dashur të motrës, që u dha pas shtatë bjeshkësh, në botën e largët e të verdhë." (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 82-84)

4. Të gjithë kanë qenë të një mendimi

Mendime e deklarime lidhur me rrugën e Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit në Shtutgart (në Bernhausen) në mbrëmjen e 16 janarit dhe shkuarjen në shtëpi të Jusufit në Untergruppenbach, në ora 03.00 të 17 janarit 1982.

Taip Zeka: *"...Jo Jusuf, siç na kanë thanë neve këtu, po Isuf e ka pasë emnin. E ka qitë edhe ai gazetën 'Lajmëtari i lirisë' dhe kanë hy edhe në Kosovë ç'ato tri gazeta. Por u bënë shumë gazeta, duheshin shumë para. Atëherë janë marrë vesh mes veti për me ba një gazetë të vetme.*

Për këtë punë Kadriu kalon prej Zvicre dhe del në Gjermani dhe janë takua në banesë të Isufit. Aty janë kanë Isufi, Kadriu, Ibrahim Kelmendi, po edhe shokë të tjerë ka pasë. ***Të gjithë kanë qenë të një mendimi****: me ba një gazetë të vetme dhe atë me e quajtë 'Liria'. Pra e kanë ba bashkimin, mirëpo nuk është mbërri gazeta me dalë, se ata janë vra atë natë, më 17 janar 1982." (*Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 23-24)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Ibrahim Kelmendi: " *Mirani... e* ***vuante përgjegjësinë për botim të Bashkimit****, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 288)

Muharrem Blakaj: *"Virtytet e një burri të* ***papërkulshëm****, siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë në* ***bashkëpunim të barabartë*** *me të ... Sesa kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla që bëri një përzgjedhje të tillë, flet vetë Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, të përjetuara nga një* ***inferioritet vandal****..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 7-8)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i*

kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Taipi vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, një ish-UDBash, nuk është cicijash sikur Taipi, Mirani dhe Mirjana. Pse ky ish-UDBash nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."(***Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982*)*

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot."(***Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Jusuf Gërvalla: *"Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot* ***shpresën e bashkimit****. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e* ***aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

5. MË NË FUND U MORËN VESH

"Apostol Duka: -U arritë ky bashkim, ose shkrirja e ***dy organizatave*** *në një të vetme, nëse mund të shprehemi kështu?*

Hasan Mala: *- Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të* ***dyja organizatat*** *të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej 'Liria'. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e Frontit, gjë që ndodhi realisht."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 256-257)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hasani vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, një ish-UDBash, nuk është cicijash sikur Hasani, Mirani dhe Mirjana. Pse ky ish-UDBash nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Saime Isufi*: "Pikërisht në natën e kobshme* ***ku ai ishte bashkuar*** *me vëllezërit Gërvalla, kishte dalë për të më telefonuar se atë natë nuk mund të kthehej."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f. 102)

Faridin Tafallari: *"Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot."*** *(*Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Bedri Islami: *"...Jusufi, Kadriu dhe Bardhi, duke pasur mirëkuptimin dhe gatishmërinë edhe të drejtuesve dhe grupacioneve tjera politike ilegale,* ***vendosën të bënin bashkimin dhe shkrirjen e të gjitha lëvizjeve politike*** *atdhetare, në një organizatë të vetme politike. Realizimi i saj më 17 janar 1982 ishin fryti më i madh i bashkëpunimit dhe i qartësisë së mendimit politik. Ata kishin realizuar një ëndërr të madhe."* (Nga shkrimi 'Merrni nga unë atë që nuk është ndarje')

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e ***aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër shokut të Organizatës së Kadri Zekës, Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Resul Bedo*: "Dy ditët e fundit të jetës së tij, Kadri Zeka i kalon në Düsseldorf mes atdhetarëve dhe më 16 janar 1982, pasdite udhëton për në rrethin e Shtutgartit,* ***ku është i ftuar*** *nga Jusuf e Bardhosh Gërvalla."* (Pishtarët e lirisë, Prishtinë, 2002, faqe 19)

Jusuf Gërvalla*: "Tani po të njoftoj se këto ditë na arriti në videokasetë me pesë filma shqiptarë. Filmat janë të shkëlqyeshëm dhe shumë inspirues. Ne ende s'ia kemi dalë ta shumëzojmë videokasetën, se për këtë punë po na duhet edhe një videofon i dytë, që s'e kemi, dhe një shtojcë speciale për riinçizim, që s'e kemi poashtu.* ***Po të nxorri rruga këndej ndonjë ditë dhe po pate mundësi, merr videofonin tuaj e eja t'i riinçizojmë.*** *Me këtë rrugë, për të njëjtën çështje po e njoftoj edhe shokun Z., megjithëqë më duket se ata nuk kanë ende as videofon."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

6. VETË JUSUFI KISHTE KËRKUAR

Hydajet Hyseni*: "Ngjarjet e vitit 1981, krijuan jo vetëm nevojën, por edhe kushtet për një bashkim të gjerë të të gjitha forcave patriotike në një front të përbashkët të luftës për Republikën. ... Po për këtë formë organizimi ishte edhe Jusuf Gërvalla dhe ishte pikërisht ai që kishte këmbëngulur që Kadriu, për shkak të përvojës dhe përgatitjes që kishte të shkonte e punonte së bashku me Jusufin në bërthamën pesëanëtarëshe që kishin krijuar në Gjermani. Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që*

'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët. Madje edhe pasi qe imponuar nxjerrja e dy botimeve "Liria dhe Zëri i Kosovës", për të evituar përçarjet dhe keqkuptimet, Kadriu dhe Jusufi vazhdojnë të punojnë së bashku, gjë që dëshmohet më së miri me materialet e përziera, të botuara në të dy botimet." (Kadri Zeka - Në 50 vjetorin e lindjes; Marrë nga përmbledhja e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, faqe 140-141)

Jusuf Gërvalla*: "Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSH MBI TË TJERËT****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla***: "Në këtë mes, më duhet të pranoj se, nga ana e atyre shokëve, qenka bërë një lojë e pahijshme me personin tim****."*

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla: ***"****Nuk do të pendohem për angazhimin tim (të kotë) në këtë drejtim, as për sinqeritetin që ua kam falur atyre pa rezervë. Mjafton ndërgjegjja e pastër dhe qëllimet e mira, që më kanë udhëhequr gjithë kohën."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla***: "Veçse, një mësim duhet nxjerrë: sinqeriteti - për shokët e sinqertë."***

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "****Po kush dyshonte në mossinqeritetin e tyre****, kur nuk dhanë asnjë shenjë!"*

Hydajet Hyseni*: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin.* ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."*

Hydajet Hyseni: "Ata qenë marrë vesh që në funksion të bashkimit që po ndërtohej të bashkonin edhe shtypin. ***Vetë Jusufi kishte kërkuar*** *që 'Liria' të botohej dhe përgatitej si organ i përbashkët."*

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË e arrivistëve të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe TENDENCËN PËR DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT."***

Jusuf Gërvalla*: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Hydajeti vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, një ish-UDBash, nuk është cicijash sikur Hydajeti, Mirani dhe Mirjana. Pse ky ish-UDBash nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet*. - S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)*

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e ***aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

7. TË MBAHEJ SI ARTIKULLUES I FUQISHËM ATDHETARIE

Brat Berat Luzha*: "Në vitin 1980 në Zvicër filloi të dilte edhe një gazetë tjetër, organi "Liria" nga Kadri Zeka me shokë, të cilën Jusufi e Bardhoshi e përfaqësojnë* (nëse është gabim shtypi mund të themi se e përqafojnë pasi Jusufi as nuk ka pas kurrë leje e as nuk i ka dhënë vetes të drejtë të përfaqësojë gazeta e organizata në të cilat nuk ka qenë anëtarë-shën ynë*) si të veten. Kjo u bë edhe rast për t'u njohur, për të vënë kontakte edhe për të vendosur bashkëpunim të ngushtë. Jusufi ndërpret botimin e 'Lajmëtarit të lirisë', ndikon edhe për ndërprerjen e 'Bashkimit', me qëllim që 'Liria' të mbahej një artikullues i fuqishëm atdhetarie, sepse sipas tij 'Kosova nuk kishte nevojë për disa zëra të mekur, por për një zë të vetëm dhe të fuqishëm'. (*Si u krijua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, 'Zëri', 18 janar 1992, Prishtinë)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË"****.*

Berati vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, një ish-UDBash, nuk është cicijash sikur Berati, Mirani dhe Mirjana. Pse ky ish-UDBash nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla: *"Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet. - *S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

Jusuf Gërvalla: *"Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare.* ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)*

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Brat Berat Luzha: *"Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi u vranë natën e 17 janarit 1982 në një fshat afër Shtutgartit, ku ata ishin në krye të detyrës së madhe për t'i bashkuar dhe organizuar mërgimtarët tanë dhe emigracionin politik që atëherë rritej me të madhe. Armiku kishte llogaritur se me vrasjen e tre veprimtarëve se jo vetëm do ta dëmtonte kreun e emigracionit politik, por do ta pengonte edhe bashkimin e grupeve dhe të organizatave politike në Kosovë dhe jashtë,* ***por për fat ata punën e kishin kryer****, bashkimi i grupeve u shpall vetëm pak ditë pas vrasjes së tyre."* (Si u krijua *Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës*, 'Zëri', 18 janar 1992, Prishtinë).

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të ***nevojshëm e aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

8. SIPAS TË GJITHA GJASAVE NË NATËN E VRASJES

Xhafer Shatri: *"Një parantezë. Në prag të vrasjes tragjike të shokëve tanë Jusufit e Bardhoshit (kanë qenë siç dihet anëtarë të ish Lëvizjes nacionalçlirimtare...) dhe Zeqës (anëtar i ish-Organizatës Marksiste-Leniniste...) janë zhvilluar bisedime për bashkim. Bisedimet kanë qenë të suksesshme dhe* ***sipas të gjitha gjasave natën e vrasjes (pra jo mëngjesin nga ora 03.00-05.00*** *siç thotë dëshmitari i Mehmet Hajrizit-shën i Xh. D.) ka ardhur gjer te bashkimi."* (Letër në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, 1983)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne, do ta***

bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Mehmet Hajrizi: *"Siç e thashë, bashkimi i të gjitha organizatave ilegale të asaj kohe ka qenë fusha kryesore e veprimtarisë së Kadriut. Ai i ka hyrë kësaj pune me të gjitha forcat dhe pasionin e tij. E ka bërë dendur këtë punë, sidomos me Jusuf Gërvallën, me të cilin më në fund, kanë arritur marrëveshjen e bashkimit të organizatave dhe të dy organeve të shtypit. Po për fat të keq, ata u vranë fill pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, prandaj bashkimi u vonua, por u arrit më vonë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, f. 183)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë KURRË****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Ibrahim Kelmendi: " *Mirani... e* ***vuante përgjegjësinë për botim të Bashkimit****, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 288)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Mehmeti vuan vetëm për Lirinë.

Mirani vuan vetëm për Bashkimin.

Mirjana vuan vetëm për Sllobodën.

Abdullah Prapashtica, një ish-UDBash, nuk është cicijash sikur Mehmeti, Mirani dhe Mirjana. Pse ky ish-UDBash nuk është cicijash? Sepse Inferioriteti i tij vandal e fatal është kolosal.

Jusuf Gërvalla: "Shtypi revolucionar zë një vend me rëndësi në veprimtarinë e çdo organizate revolucionare. ***Ne tani mund të themi se kemi shtypin tonë."*** *(*Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

9. TRI NGJARJE HISTORIKE PËR KOSOVËN

Mehmet Hajrizi: *"****Në natën*** *e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e* ***tri organizatave*** *çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

Jusuf Gërvalla: *"Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Bedri Islami*: "Nëse nuk do të ishin fillesat e vitit 1980 dhe puna e Kadriut, Jusufit dhe Bardhit, si dhe* ***organizatës së krijuar prej tyre më 17 janar 1982****, Lëvizja Populllore për Republikën e Kosovës, nuk do të kishim pasur një diasporë si ajo që u shfaq madhërishëm në luftën e Kosovës".* (Marrë nga Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008 f. 293)

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të ***nevojshëm e aq të shenjtë për ne,*** *do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta.* (Letër Ibrahim Kelmendit, më 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

10. SIPAS DËSHMISË SË BASHKËVEPRIMTARIT TË TYRE

Mehmet Hajrizi: *"Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (****sipas dëshmisë së bashkëveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit****) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008 f. 307)

Jusuf Gërvalla*: "Tash për tash mund të të them se kjo gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij....*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm ***e aq të shenjtë për ne****, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta."* (Letër dërguar **shokut të Organizatës së Kadri Zekës**, **bashkëveprimtarit të Kadri Zekës**, Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982)

Faridin Tafallari*: "Jusufi:* ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot."*** (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Cilat janë ato materiale që Jusufi pak i ka shpërnda tek shokët, e me të cilat bodrumi është plot. Fjala është për "Zëri i Kosovës", Nr.2 janar 1982.

Në galerinë e rrenave e falsifikimeve të shembura e shkatërruara nga Jusufi, kemi disa mospërputhje kardinale ashtu siç është rendi çdo herë kur kemi të bëjmë me gënjeshtra e rikonstruktime.

Taip Zeka flet vetëm për bashkim gazetash dhe për 'Lirinë'.

Saime Isufi nuk flet as për gazeta e as për organizata, por mjaftohet vetëm me thënien se "ai (Kadriu) është bashkuar me Vëllezërit Gërvalla".

Bedri Islami thotë krejt diçka tjetër. Ai nuk përmend as gazeta (për shkak se i din vuajtjet e I. Kelmendit për gazetën Bashkimi) dhe as organizata. Sipas tij, më 17 janar 1982, në shtëpinë historike të Jusufit është bërë **bashkimi e shkrirja e të gjitha** organizatave politike (por nuk lodhet me e përmend asnjë me emër, sigurisht për arsye se ato janë aq shumë sa është vështirë me i numërua të gjitha me emër).

Hydajet Hyseni nuk përmend fare organizata, por vetëm bashkimin e gazetave dhe "kërkesën e Jusufit që të mbetet Liria".

Brat Berat Luzha, apo lulja e kurora e gazetarisë së Kosovës, flet vetëm për Lirinë dhe bashkimin e grupeve pa e bërë as përcaktimin më të vogël, se për cilat është fjala.

Xhafer Shatri mendon se "sipas të gjitha gjasave" bashkimi është bërë vetëm në mes LNÇKVSHJ dhe OMLK-së, d.m.th. pa Frontin e krijuar nga UDB-a. Konkretizimi i tij shtrihet edhe më tej. Ai mendon se ky bashkim është bërë në mbrëmje, pa Ibrahim Kelmendin.

Siç do të ndalemi më gjatë I. Kelmendi, harron se çka ka shkrua me dorën e vetë në vitet 1983-1984, dhe thotë se bashkimi është bërë në mes tri organizatave-organizimeve (dhe jo dy) dhe jo në mbrëmje por në mëngjesin e orët e para të 17 janarit. Për mbrëmje ka mbetur të bëhet vetëm formulimi i vendimit me shkrim, të cilin I. Kelmendi nuk ka mundur ta pres sepse i kanë dalë punë më të rëndësishme.

Mehmet Hajrizi, në librin për Kadri Zekën të Apostol Dukës, flet për bashkimin e dy gazetave, e të organizatave, ndërsa në librin e vetë të cituar më lart, flet për bashkim të tri organizatave, pa i përmendur me asnjë fjalë se cilat ishin ato dhe si u quajt organizata që doli nga bashkimi. Pse vepron historiani Mehmet, i cili për garant të vërtetës së historisë se vetë e ka zgjedhur as më pak e as më shumë se vet Ciceronin. Këtë ai e bënë vetëm e vetëm sepse është një ideolog i thellë, zhiva enciklopedi, që i kupton gjërat në tërë kompleksitetin e vetë, dhe në fund të fundit është shumë i vetëdijshëm se kur nuk ke asgjë konkrete nuk mund të përdorësh emra konkret. Kur t'ia shtojsh gjithë kësaj se ai përveç Ciceronit si dëshmitarë kryesor për fundin apo finalen e të vërtetës së Organizatës së vetë e ka zgjedhë edhe Ibrahim Kelmendin, atëherë na sqarohet e gjithë tablloja dhe ne e kuptojmë se këtu me të vërtetë kemi të bëjmë me një person e me një bimë tepër të rrallë që ka bi në bokrrinat e Strofcit, i cili të gjitha problemet i kupton me themel në tërë kompleksitetin e vetë dhe na i servon shumë të qarta e të thjeshta në formën e dokrrave.

Për mbylljen e këtij kapitulli nuk kam gjetë fjalë më të mira se ato të Jusufit nga romani Rrotull.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet. - *S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës. Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

11. Ju kam thirrur që të rifillojmë bisedimet për bashkim

Jusufi, i thyer moralisht e shpirtërisht, e i shkëputur përfundimisht nga Sabri Novosella, por falë këndelljes që e ka marrë nga figura frontale e Frontit të Kuq, të bashkëformuar dhe pagëzuar nga UDB-a, e nisë bisedën dhe shfaq gatishmërinë që Lëvizjen e tij ta futë në një thes me Frontin e formuar nga UDB-a, pra në Frontin e Kadri Zekës, i cili do të udhëhiqet nga OMLK-ja e papërlyeme.

Ibrahim Kelmendi*: "– Shokë, – tha Jusufi, – ju kam thirrur që të rifillojmë bisedimet për bashkim, por më erdhi keq për provokimin që bëri Nuriu në banesë të Shokut Murtez.* ***Në fakt, atje kisha mendimin të bisedonim dhe të vendosnim për bashkim, në prani të aktivistëve që kisha thirrur, por më pengoi provokimi i tij****."* (Atentatet, f.320)

Pra Jusufi jo vetëm që i fton Kadriun dhe figurën e Frontit për bisedime por ka ndërmend që ta shpallë bashkimin në prani të aktivistëve që i ka thirrur në banesën e Murat Kryeziut. Por, për ta shpallur bashkimin para 23 vetave (në Bernhausen, ngjitur me aeroportin e Shtutgartit) e pengon Nuhi Sylejmani.

"*Shfaqja zgjati deri rreth orës dy pas mesnate. Pas përfundimit të shfaqjes, grupe-grupe dolëm jashtë. Pasi u përshëndet me ne, Ibrahim Kelmendi bashkë me Sylë Nuhën u nisën për Dyseldorf."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 69)

Faridin Tafallari: *"Ndejtëm aty deri vonë; nga mesnata u ndamë. Kur dolëm jashtë dhe po ndaheshim, unë i thash Kadriut që të vinte tek unë për të fjetur. Kadriu pranoi dhe i tha Jusufit:* ***"Unë po shkoj te Faridini"****. Por Jusufi iu përgjigj: "Jo, sonte do të vish tek unë." Kadriu përsëri i tha:* ***"Ti mund të kesh mysafirë në shtëpi dhe bëhemi shumë vetë; prandaj po shkoj te Faridini."*** *Por Jusufi e mori me vete dhe për atë natë u ndamë pasi u përqafuam. Sikur ta dinim që ai do të ishte përqafimi i fundit.!!*

Nuk më kujtohet ai i thanë apo jo edhe Ibrahim Kelmendit që edhe ai të shkonte me ta, por di se Ibrahimi i tha: "Mua më duhet të udhëtoj për Dyseldorf, pasi edhe atje dua t'i tuboj bashkatdhetarët për të shfaqur këta filma." Dhe ashtu u bë. Kadriu shkoi me Jusufin e Bardhoshin kurse Ibrahim Kelmendi me Sylë Nuhën shkuan për në Dyseldorf." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 49)

Hasan Mala (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."* (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, f. 382)

Xhafer Shatri (për librin Terror-Dhimbje-Qëndresë)*: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës...".* (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, f. 382)

Xhafer Durmishi: "*Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksistë-Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach****. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30****. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrur në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës."* (Letër Pajazit Ibrahimit në Australi, 7 mars 1982)

Se sa është në gjendje Jusufi të bëjë punë të pabesa e kokë më vete e t'i shes shokët e Lëvizjes së vet, e të filloj edhe bisedën më të vogël për ndonjëfarë bashkimi pa u

konsultuar, sidomos kur atë mundësi e ka të shkëlqyeshme e që i ka munguar aq shumë për 16 muaj rresht, e tregojnë më së miri fjalët e Jusufit.

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër.* ***Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. ***Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku."*** (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Se sa bashkëbisedues serioz i konsideron Jusufi, Kadri Zekën e I. Kelmendin e dëshmon ky fakt, këto fjalë:

Jusuf Gërvalla*: "Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha****, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta****."* (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Se sa ka qenë në gjendje Jusufi të bëjë punë të pabesa e kokë më vete e t'i shes shokët e Lëvizjes së vet, e të filloj edhe bisedën më të vogël për ndonjëfarë bashkimi pa u konsultuar, sidomos kur atë mundësi e ka të shkëlqyeshme e që i ka munguar aq shumë për 16 muaj rresht, e të "rifilloj bisedime për bashkim" e tregojnë më së miri fjalët e Ibrahim Kelmendit të 30 qershorit 1983, 10 e 11 janarit 1984.

I. Kelmendi: *"Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të* ***bashkëpunojmë*** *për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte* ***bashkëpunuar*** *përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani-shën im) dhe Nexh. (Nexhati - 'Osman Osmani -shën im'-, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë."* (Letër QE, 30 qershor 1983)

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*
QARKORE
"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën..
-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
(Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e Bashkimit që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:
"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***në një të vetme****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...
Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (Zëri i Kosovës, qershor 1982, f. 2)

Kjo Komunikatë e lartpërmendur u shtyp dhe për herë të parë në Evropë u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku me Kushtrim - Thirrjen e demonstratës së Bernit të 26 qershorit 1982.

I. Kelmendi: *"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*
Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 11 janar 1984

"...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë, ***sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore****. Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit.* ***Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë****."* (Letër dërguar QE - Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 11 janar 1984, faqe 7)

Këta rreshta të shkruar nga dora e I. Kelmendit vërtetojnë se Jusufi

- nuk i ka ftuar Kadri Zekën e Ibrahim Kelmendin,
- në shtëpi të Jusufit as në orët e para në mëngjes (03.00-05.00) e as në orët e vona në mbrëmje Jusufi nuk ka bërë kurrfarë marrëveshje me Ibrahim Kelmendin e Kadri Zekën së bashku, e as me Kadri Zekën veçmas,
-se ideja e fabrikimi i planit për ta luajtur rolin e dëshmitarit të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës, I. Kelmendit i ka lindur dekada më vonë.

Ai i cili dëshiron ta luaj rolin fenomenal të dëshmitarit, të të vetëquajturve marksist-leninist, të cilët e kanë luftuar sistemin socialist me socializmin e vetë, është dashur me kohë që t'i fshij të gjitha gjurmët dhe të mos lej pas vetes asnjë fakt. Vetëm në mungesë faktesh djallëzia e dëshmisë (edhe kur është e rrejshme) mund të ketë njëfarë domethënie. Kur ekzistojnë faktet e padiskutueshme thirrja në dëshmitarë të rrejshëm tregon mjerimin dhe katastrofën e atyre që kanë mbetur pa histori.

12. Jemi informuar se kush hyn e del te ti

Jo vetëm Jusufi na del harresës, por edhe Kadriu që tani e kritikon Jusufin se pranon shumë njerëz që nuk i njeh, harron se ai (Kadriu) ka thënë se njoftohet për çdo kend që hyn e del në stacionin e trenit, pra në shtëpinë e Jusufit.

I. Kelmendi: *"– Shoku Jusuf, – mori fjalën Kadriu, – edhe përpara kemi biseduar se në shtëpi po të vijnë shumë njerëz, edhe nga ata që nuk i njeh se kush janë dhe nuk e di se përse vërtet vijnë."* (Atentatet, f. 320)

Këtu del se edhe Kadriu (sipas I. Kelmendit) është harresës i pandreqshëm, pasi ai më parë ka deklarua se është i njoftuar për çdo kend që hyn e del në shtëpinë e Jusufit.

I. Kelmendi*: "– Domethënë njeriu juaj nuk paska informata të bollshme. Por, nga të tjera burime* ***jemi informuar ne*** *se kush hyn e del te ti, –* ***ndërhyri Kadriu****, pa pritur nëse Jusufi kishte përfunduar përgjigjen e tij."* (Atentatet, f. 291)

Këto pra janë dredhjet e përdredhjet e shokut të mirë të Sadik Blakajt, por jo vetëm të tij por edhe i Kadri Zekës. Këto janë fjalët e dëshmitarit të Mehmet Hajrizit.

Pra fjalët se Kadriu din për secilin që hyn në shtëpinë e Jusufit, janë të I. Kelmendit, por ai i vendosë ato në gojën e Kadriut vetëm e vetëm pse është naiv dhe nuk të

keqkupton, se fjalët e tij janë melhem për plagët e Jusufit. Me këto fjalë ai, si me thënë me sinqeritetin e vetë kontribuon në pajtimin e Kadriut me Jusufit.

13. NËSE BASHKOHEMI DO TË RREZIKOHEMI

I. Kelmendi: *"Nëse do ta bashkojmë veprimtarinë në një **organizim të vetëm** dhe nëse do ta forcojmë, siç duhet të ndodhë pas bashkimit, atëherë ne do të rrezikohemi."* (Atentatet, f.321)

Jusufi tregon se nëse do ta bashkojmë veprimtarinë në një **organizim** (shumë fjalë precize dhe e qartë kjo fjala **organizim**, e personit naiv, të sinqertë, konkret e transparent, I. Kelmendi), pra në një organizatë të vetme, atëherë ne do të rrezikohemi. Pra Jusufi deklaron se vetëm nëse Lëvizja e tij hynë në një thes me Frontin e emërtuar nga UDB-a, atëherë ai do të rrezikohet pikërisht nga UDB-a. Përgjigjen edhe në këtë fjali e kemi të plotë nën nëntitullin e pikës 15.

14. Vendet tona t'i zënë njerëzit e saj

Jo vetëm Jusufi, po as Kadri Zeka nuk e ndien veten të rrezikuar tani për tani, por ai e ka një shpjegim krejtësisht tjetër nga ai i Jusufit.

I. Kelmendi: *"Kjo do të ndodhë, them unë, pasi ajo të ketë infiltruar njerëz të saj në radhët tona që, pos eliminimit tonë fizik, të godasë rëndë edhe radhët tona pastaj duke futur përçarje e dyshim, duke synuar që vendet tona t'i zënë njerëzit e saj."* (Atentatet, f. 321)

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim: **ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.** Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..."* (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)

Saime Isufi: ***"Të përgëzoj nga zemra!...*** *Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë. Kjo më bën të besoj se edhe ata të cilët nuk pata mundësi t'i njihja, i ke paraqitur tamam ashtu siç ishin në realitet, të lidhur me UDB-në jugosllave, për të shkatërruar lëvizjen..."* (Letër Ibrahim Kelmendit më 5 mars 2007)

15. Vetëdija e Jusufit për peshën e punës së vetë

Jusufi u thotë Kadri Zekës dhe I. Kelmendit, në orët e hershme të 17 janarit 1982, se "***ne tani për tani, nuk meritojmë atentate nga UDB-ja***" pasi Lëvizja e Jusufit ende nuk ka pranua të bashkohet e të futet në një thes me Frontin e emërtuar nga UDB-a, dhe Frontin tjetër, Frontin e OMLK-së.

I. Kelmendi*: "Them se ne, **tani për tani, nuk meritojmë atentate nga UDB-ja**, pasi veprimtaria jonë kohëve të fundit nuk duhet të vlerësohet nga ana e saj si aq e rrezikshme."* (Atentatet, f. 321)

Domethënë Jusufi nuk paska bërë asnjë punë që do të tërhiqte vëmendjen e UDB-së me punën e vetë personale. Sipas shokut të Sadik Blakajt e dëshmitarit të OMLK-së, Jusufi është i rrezikshëm për UDB-në vetëm e vetëm nëse e lejon Kadri Zekën që Lëvizjen e Jusufit ta vendosë në një rrafsh, ta futë në një thes me Frontin e Kuq të emërtuar nga UDB-a. Nëse plani i Kadri Zekës e OMLK-së ka sukses - Jusufi rrezikohet, nëse Jusufi nuk pranon në asnjë mënyrë e përjetë që ta përziej Lëvizjen e tij me Frontin e emërtuar nga UDB-a, atëherë Jusufit nuk i kanoset atentati. Pasi dëshmitari i OMLK-së i thotë fjalët e mësipërme, atëherë ato me të vërtetë duhet të vlejnë për Kadri Zekën. Sa i përket Jusufit puna qëndron krejt ndryshe, pasi Jusufi është vet dëshmitarë e shkrues i historisë së tij dhe nuk ka lejuar të jetë i mvarun prej atyre dëshmitarëve me të cilët e ka lidhur historinë e vetë (dhe fundin e saj) OMLK-ja, e komplet udhëheqja e saj.

Faridin Tafallari: *"Isah Demi kur u kthye nga Kosova, na tha se atje ishte takuar me Metush Krasniqin. Metushi e kishte porositur që t'i bënte shumë të fala Jusufit dhe t'i thoshte që të kishte kujdes, se armiku e ka në shënjestër prandaj të ruhej. Bashkë me Isain shkuam dhe e takuam Jusufin dhe Isahi i tregoi për Metush Krasniqin. Jusufi pyeti: 'Po si e njeh ti Metushin?' Dhe dëgjoi me interesim të madh shpjegimet e Isahit. Në fund Jusufi tha: 'Isah, kur të shkosh përsëri në shtëpi, të më lajmërosh dhe unë kam për të dhënë porosi për Metushin.'* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 47)

Të shohim disa mendime të Jusufit në këtë çështje.

Jusuf Gërvalla*: **"E kishin vrarë xhandarët në Pejë,** te Zalli, endej fjala rreth tangarit mbi prushin që shkrihej me përtesë. Dalëngadalë, Keta u harrua, si bora e parvjetme. E morën të ligat e përroit dhe bëmat e haxhuzeve. As njeri, as dru në mal nuk besonte më se do të kthehej ai në Vijuj ndonjë vjeshte të vonë, apo me syrin e NDONJË PRANVERE TË JASHTËZAKONSHME."* (Dorëshkrim i vitit 1979, Romani Rrotull, Tiranë 1983, f. 82)

Jusuf Gërvalla*: "Troshi e ndoqi me një inercion lëvizjen e padukshme të kokës së gruas dhe pa xhandarin që po i qasej tinëzisht plakut. Pamja e fundit, para se të largohej, i pazoti për të bërë çkado, sikur të kishte qenë çilimi, i shëmbëlleu me një gjah në mbarim e sipër, ku gjuetari i qaset ngadalë e si me dashamirësi kafshës së namatisur që është zënë në kurth, duke u frikësuar vazhdimisht se mos është i dobët kurthi dhe kështu do të mbetet pa prenë e lakmuar." (*Dorëshkrim i vitit 1979, Romani Rrotull, Tiranë 1983, f. 97)

Kadri Rexha*: "Jusuf Gërvalla ishte më se i bindur se do të vritej nga dora e armikut tonë shekullor. Lidhur me këtë ai kishte edhe **shenja të sigurta**. "**Do të më vrasin më tha më një rast...** Vdekja do të më gjej në krye të detyrës. Njëherë e përgjithmonë jetën ia kam falur atdheut dhe popullit tim martir!"* (Fati i Luleve, Prishtinë 1993, f.174)

Jusuf Gërvalla: "*Natyrisht, shqiptarët e robëruar duan t'ia dinë edhe më pak: ata kanë përpara vetëm një qëllim – çlirimin, dhe nuk do të pyesin për çmimin e lirisë. Për Jugosllavinë, ka gjithmonë një mundësi rezervë: tërheqja kufijve të vet të vërtetë, kur zjarri të bëhet i padurueshëm;* ***ndërkaq për revolucionarët dhe për popullin shqiptar ka vetëm një alternativë: të presin të asimilohen, t'i shtrohen gjenocidit dhe ta bjerrin qenjen e vet kombëtare në mënyrën më mizore nga dora e sllavëve të jugut, ose luftën e vet ta shpien deri në fund, deri në fitore, e cila arrihet vetëm pas formimit të shtetit unik të të gjithë shqiptarëve. Për sakrifica, të thuash, nuk ka fare vend të mendohet."*** (Bashkimi, prill 1980, faqe 5)

Jusuf Gërvalla*: "Për babanë e studentit N. të burgosur, për etërit e të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë, që s'e kanë kursyer veten për çështjen e shtrenjtë të atdheut, ne nuk kemi fjalë ngushëllimi, po vetëm urime.* ***Këtë të drejtë na e jep gatishmëria që as ne të mos largohemi kurrë nga rruga patriotike e revolucionare, jo***

vetëm kur na kërcënohet burgu i rëndë sikurse ai ku lëngojnë shokët e vëllezërit tanë, por edhe atëherë kur do të na kërcënohet edhe vdekja. Sepse nuk kemi iluzione për liri të fituar pa sakrifica dhe pa gjak.” (Lajmëtari i lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 2)

Jusuf Gërvalla*: "Përpjekjet e armiqve të shumtë kanë dashur ta errësojnë dhe ta mohojnë fare lavdinë e atyre moteve që sollën shpalljen e Pavarësisë shqiptare. Por mbetet fakt i pakundërshtueshëm se këtë akt madhështor e kushtëzoi, në radhë të parë dhe mbi të gjitha, lufta e pamposhtur e popullit shqiptar, i cili ishte ngritur në këmbë i tëri**, i vetëdijshëm një për një se lirinë s'ta sjellë njeri dhe se çmimin e lirisë nuk e paguajnë as luftërat e ashpra dhe as gjaku i derdhur pa kursim**."* (Lajmëtari i lirisë, janar-shkurt 1981, faqe 2)

Jusuf Gërvalla*: "Dhe punës nuk do t´ia ndajmë deri në fitoren e plotë. Prandaj edhe ju mblidhni forcat, mos u bëni "amin" burgosjeve, ndjekjeve, frikësimeve e shantazheve. Kjo le të jetë përgjigja e popullit për terrorin e armikut. **Ne, po na e dhatë të drejtën dhe mundësinë, jemi të gatshëm të vdesim në ballë të radhëve tuaja."** (*Bashkimi, janar 1981, faqe 1)

Jusuf Gërvalla*: “Sot për sot, në trupin e këtij populli dhe të kësaj rinie po vizatohen qartë projeksionet e plagëve të reja që do të merren, por njëherazi po hidhen edhe themelet e çelikta të ardhmërisë së sigurt e të ndritshme.”* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, f. 3)

Jusuf Gërvalla*: “Në ballë të këtij populli dhe te këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.”* (Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 3)

Jusuf Gërvalla: *„Është një fjalë e popullit shqiptar sipas të **cilës shqiptari kurrë nuk i është lutur armikut që të mos e vras**, përkundrazi ai gjithmonë është përpjekur që të merr masa që t'i del përballë këtij armiku“.* (Fjalim më 28 nëntor 1981 në Shtutgart)

Jusuf Gërvalla*: “Sulmi, në vend që të arrinte objektivat e planifikuara – qetësimin e menjëhershëm të situatës në Kosovë – i përzjeu të gjitha përmasat. Ai ndihmoi që, te shtresat e popullsisë sonë, atje ku qe dukur apatia dhe tërheqja në vete, të nxirrte kokë trimëria dhe iniciativa, ku qe kursyer edhe fjala e gojës, tani të dilte në **dritë gatishmëria për të dhënë jetën pa pyetur për kusur**.”* (Zëri i Kosovës, janar 1982, faqe 1)

Jusuf Gërvalla: *"Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit, **gatishmëria e madhe për flijime të larta,** ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)

16. Rrjedha e bisedimeve më 17 janar 1982 nga ora 03.00-05.00

Jusufi, në emrin Lëvizjes së tij, i thyer e i shkëputur përfundimisht nga Sabri Novosella, qysh më 2 janar, i fton në shtëpinë e tij I. Kelmendin e Kadri Zekën, të cilëve, të dyve së bashku u rastisë të gjenden në Düsseldorf në vlugun e konvertimeve të simpatizantëve të Frontit të Kuq në Frontin Popullor të OMLK-së.

I. Kelmendi: *"– Them, – u ngut Jusufi, – që të kalojmë në temën që na preokupon më shumë, atë **për bashkim të radhëve tona**, për **çka ju kam ftuar**..."* (Atentatet, f.323)

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*
QARKORE
*"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata **mbi Bashkimin** (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën."*
(Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e **Bashkimi**t që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:

"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***në një të vetme****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...

Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (Zëri i Kosovës, qershor 1982, faqe 2)

Dhe ja si duket '**ftesa'** e Jusuf Gërvallës.

Jusuf Gërvalla: ***" Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Jusuf Gërvalla*: "Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq... Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave...*

Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

17. TASHMË JEMI SQARUAR SE KUSH NA E BLLOKOI VENDIMIN TONË

Jusufi është i distancuar tërësisht nga Sabri Novosella, pasi ai e ka bllokua bashkimin, e vendimit për bashkim në mes Jusufit, Kadriut dhe Frontit të I. Kelmendit, të bërë të shtunën e tretë të gushtit, pra më 15 gusht 1981, në shtëpinë e Jusufit në Untergruppenbach.

I. Kelmendi: *"– Urdhëro, po të dëgjojmë, – miratoi Kadriu.*

– Në parim ne qemë marrë vesh qysh ***në muajin gush****t*

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të ***datës 14 gusht****, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët*

*dhe zogistët, madje duke u bërë vetë **mercenar** i tyre, pra **mercenar** i **mercenarit**). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton." (Letër Sabri Novosellës, **20 gusht** 1981)*

*që platformë e bashkimit të jenë Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës. Sipas meje, për bashkimin që ne u dakorduam atëherë duhej të jepte vetëm miratimin formal Sabiti, të cilin menduam ta nderojmë si veteran i lëvizjes patriotike. **Por tashmë jemi sqaruar se ai jo vetëm që nuk dha miratimin formal, por na bllokoi fare duke mos marrë parasysh mendimin dhe vendimin tonë paraprak**. Tani nuk kemi pse të marrim si shkak refuzimin bllokues të Sabitit që ne të mos merremi vesh se si dhe çka duhet të vendosim."* (Atentatet, f. 323)

Se sa **tashmë i sqaruar** dhe i distancuar nga Sabri Novosella duket Jusufi pas dështimit e bllokimit të bashkimit në takimin e Stambollit e vërtetojnë këto fjalë të Jusufit:

Jusuf Gërvalla*: **" Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Se sa i afërt e çfarë mirëkuptimi ka në këtë kohë në mes Jusufit dhe Kadri Zekës e shokut të tij të Organizatës Ibrahim Kelmendi e vërtetojnë fjalët e si më poshtë:

Jusuf Gërvalla*: "Puna e Organizatës në të cilën bëjë pjesë nuk shkon aspak keq... Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin **e dy organizatave...***

Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z (Kadri Zekës-shën im)." (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

18. Tani m'u duk momenti i duhur

Jo vetëm Jusufi është i zhgënjyer e i thyer nga Sabri Novosella, por në një shkallë edhe më të madhe është thyerja e Bardhit. Aq i thyer e i dëshpëruar na del Bardhi prej Sabri Novosellës, sa ai nuk ka mund t'ia thotë të gjitha Jusufit, vëllaut të vetë dhe shokut të organizatës së vetë, por këtë e bënë pikërisht në praninë e I. Kelmendit dhe Kadriut, pasi në praninë e tyre Bardhit i duket se është momenti i duhur.

I. Kelmendi (dëshmitari i OMLK-së): *"– Thënë të drejtën, – mori fjalën Bardhi, – pasi pa se asnjëri nuk po fliste për momentin, – mua më ka ardhur shumë keq që e kam njohur Sabitin. Edhe më keq më erdhi për rastin dhe mënyrën se si e njoha atë, pasi Jusufi dhe unë e kemi idealizuar deri në idhull. S'e peshoj me mall, siç praktikohet të thuhet, po të mund ta zhbëja shkuarjen tek ai në Turqi. Sidomos më ka ardhur keq për Kadriun se si u soll Sabiti ndaj tij. Po kështu edhe për diplomatin shqiptar, Shokun Bujar Hoxha, më erdhi keq sepse u zhgënjye nga harbutëria e destruktiviteti i Sabitit. Unë kam nguruar deri sonte t'ia them këto Jusufit, sepse më vinte keq ta zhgënjeja, por tani m'u duk momenti i duhur."* (Atentatet, f.323)

Këtu e shohim se si shembet idhulli Sabri. Por jo vetëm kaq, këtu na del i shembur dhe i thyer edhe intimiteti, shoqëria e besimi në mes Jusufit e Bardhit, të cilët e fitojnë besimin në njëri tjetrin vetëm e vetëm duke iu falënderua ndihmës këndellëse të I. Kelmendit, figurës frontale të Frontit të emërtuar nga UDB-a. Të shohim se sa është shembur autoriteti i Sabri Novosellës pas kthimit të Bardhit nga Stambolli:

Jusuf Gërvalla*: **"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku (Bardhi-shën ynë) ." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

19. E kishte njohur mjaftë mirë - Unë nuk e kam njohur

Jo vetëm Jusufi por edhe Bardhi na del harresës dhe i dezorientuar sa deklaron se I. Kelmendi e kishte pas njohur shumë mirë Sabri Novosellën, ndërsa I. Kelmendi tallet edhe me te e harresën e tij duke e korrigjuar e thënë se "unë nuk e kam njohur personalisht".

I. Kelmendi (dëshmitari i OMLK-së): *"Prandaj, koha prej atëherë e deri tani duhet të vlerësohet si kohë e humbur, krejtësisht për fajin e Sabitit, të cilin Mirani e kishte njohur mjaft mirë, po ne, jo vetëm që nuk e dëgjonim, por edhe i hidhëroheshim kur ai na informonte dhe e vlerësonte si njeri negativ.*

– Unë nuk e kam njohur personalisht, – shtoi Mirani." (Atentatet, f. 323-324)

Se sa harresës janë Bardhi e Jusufi dhe sa e ka njohur I. Kelmendi (përmes Jusufit) Sabri Novosellën e vërtetojnë fjalët e mëposhtme:

Jusuf Gërvalla (Pronari i historisë së tij): *"Një punë, megjithatë të ngarkon edhe ty. S'ka pasur hije pa marrë edhe mendimin tim, ta shpallje ndër njerëz se si një nga njerëzit e rëndësishëm të Lëvizjes na qenkësh, në mos antikomunist, atëherë së paku kundërshtar i partisë (iluzioniste) që do të formoheshka ndër ne. E vërteta është krejt*

ndryshe. Shoku Z. i ka procesverbalet e takimit me të. Po deshtët të ngulni këmbë edhe më tej në qëndrimin "antikomunist" të atij shokut të Lëvizjes, urdhëroni e bëjeni këtë punë në baza më të shëndosha e më të ndershme, merrini përbazë procesverbalet e takimit. Atje shihet se ku qëndron e vërteta për bashkimin e paarritur, e megjithatë të shpallur si akt të kryer në thirrjen e famshme "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!", të cilën ndoshta nuk e ke pasur në dorë, ngase botimi i saj u spostua pas letrës sime dërguar shokut Z (Kadri Zeka-shën. ynë). " (Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Se sa poshtë ka rënë autoriteti i Sabriut pas kthimit të Bardhit nga Stambolli, dhe sa e fajësojnë Bardhi e Jusufi - Sabri Novosellën e vërtetojnë fjalët:

Jusuf Gërvalla *(Pronari i historisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare):* ***"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë****. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

20. Të shkuara e të harruara, siç thotë populli

I. Kelmendi i mban ligjëratë Jusufit për Sabri Novosellën në agimin e 17 janarit 1982, (në mes orës 03.00-05.00) dhe Jusufi i thyer moralisht e shpirtërisht por edhe i këndellun nga figura frontale e Frontit të Kuq, e dëgjon me vëmendje, dhe kënaqet me konstatimin e I. Kelmendit se raporti e tij me udhëheqësin e Lëvizjes së tij është "punë e shkuar dhe e harruar siç thotë populli".

I. Kelmendi (dëshmitari i OMLK-së): *"– Përpara kisha dëgjuar për emrin e tij dhe kisha respekt. Pa u zgjatur për folur për të kësaj radhe, meqë mund ta kem tepruar herave të tjera, po shpreh një dilemë konkrete: Shoku Jusuf, ai t'u lajmërua vetëm* ***kur ne e rritëm veprimtarinë****, do thotë pas një viti e gjysmë që kur je arratisur. Edhe atëherë kur t'u lajmërua, dyshoj ta ketë bërë vetëm sa për ndërhyrje destruktive.* ***Por, të shkuara e të harruara,***

> *Jusuf Gërvalla: "Tash për tash mund të të them se kjo* ***gjë nuk do të mbetet shumë kohë pa u sqaruar****. Do të dalë në shesh se kush është duke bërë zhurmë për bashkimin, duke u çjerrë për të e duke luftuar kundër tij."* (Letër I. K. 15 janar 1982)

siç thotë populli*. Tani rëndësi ka se e kuptuam të gjithë që bashkimi jo vetëm që është i domosdoshëm, por është edhe i vonuar dhe për këtë bashkim, të paktën këndej, mund të vendosim vetë ne. Prandaj, propozoj të bisedojmë vetëm për bashkimin sesi të bëhet ai konkretisht."* (Atentatet, f. 324)

Nga këto fjalë gjeniale rrjedh se çdo punë e bërë e Jusufit në kuadër të Lëvizjes së tij, me shokët e organizatës së tij populli duhet ta konsideroj të shkuar e të harruar. I. Kelmendi që shumë herë tallet me harresën e Jusufit e Bardhit, megjithatë në parim nuk është krejtësisht kundër harresave, pasi ai ka ide shumë të qarta se çka duhet mbajtur

mend e çka duhet harruar. Ajo që duhet të mbahet mend, që të mos jetë kurrë e harruar dhe e shkuar është vendimi i Jusufit për ta futë Lëvizjen e vetë e vehten në një thes me Frontin e emërtuar nga UDB-a, në Frontin e përlyer të OMLK-së, nën udhëheqjen e OMLK-së së papërlyer. Ajo që duhet të harrohet është heroizmi mbinjerëzor i Jusufit ta ruaj Lëvizjen e tij kombëtare dhe busullën e saj të drejtë për interesat e vegjëlisë, të pastër si loti nga çdo përzierje me Fronte të dyshimtë e të rrejshëm, punë të cilën e ka bërë me sukses duke vdekur si Yll i Pashuar e si anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, si anëtar i Lëvizjes së Pashuar. Se Jusufi i pavdekshëm ka vdekur si anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, më mirë se kushdo tjetër e ka vërtetuar I. Kelmendi (edhe pse me sa duket ka harruar apo paraqitet se ka harruar se çka ka shkrua me dorën e vetë).

I. Kelmendi (dëshmitari i komunistëve të paepur): *"Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të **bashkëpunojmë** për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte **bashkëpunuar** përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani-shën im) dhe Nexh. (Nexhati - 'Osman Osmani - shën im'-, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë."* (Letër QE, 30 qershor 1983)

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*
QARKORE
"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën..
-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
(Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e Bashkimit që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:
"KOMUNIKATE

*Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave **në një të vetme**. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...
Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (Zëri i Kosovës, qershor 1982, f. 2)

Kjo Komunikatë e lartpërmendur u shtyp dhe për herë të parë në Evropë u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku me Kushtrim - Thirrjen e demonstratës së Bernit të 26 qershorit 1982.

I. Kelmendi*:"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*
Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 11 janar 1984

"...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen

*zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë**, sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore**. Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. **Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë**."* (Letër dërguar QE - Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit,, faqe 7)

21. Gëzim i madh që propozimin po e bënte vetë Jusufi

Jusufi u propozon Kadri Zekës dhe I. Kelmendit të bashkohen në bazë të miratimit të shtunës së tretë të gushtit 1981, duke pasur për bazë Tezat për Front, të OMLK-së.

I. Kelmendi (dëshmitari i Mehmet Hajrizit*): "– E mbështes propozimin e Miranit, – miratoi Bardhi.*

*– Atëherë nuk kemi pse harxhojmë kohë, – u pozicionua Jusufi, duke bërë ndërrim të pozicionit të të ulurit në fotele për të marrë pozicion me serioz. – Besoj se të gjithë jemi që për platformë të organizatës që po krijojmë përmes bashkimit të organizimeve tona të deritanishme të jenë Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës, ashtu siç i patëm miratuar në fund të **gushtit**. Po i patëm harruar **vendimet** e atëhershme mund t'i gjej shënimet që kam mbajtur. Them që ti Kadri dhe ti Miran, të deklaroheni nëse jeni edhe ju për të njëjtat **vendime** që patëm marrë atëherë.*

Kadriu dhe Mirani shprehën miratimin e tyre duke shfaqur gëzimin, sidomos për faktin që këtë propozim tani po e bënte vetë Jusufi." (Atentatet, f. 324)

Po e patëm harruar vendimin e 15 gushtit 1981 atëherë e kemi vërtetimin përherë të freskët të shkruar pesë ditë më vonë, më 20 gusht 1981.

Jusuf Gërvalla*: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës **14 gusht**, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e **mercenare** të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë **mercenar** i tyre, pra **mercenar** i **mercenarit**). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton."* (Letër Sabri Novosellës, 20 **gusht** 1981)

I. Kelmendi është i gëzuar se Jusufi vetë, ai Jusuf i thyer moralisht e shpirtërisht në dasmën e Kadri Zekës, me iniciativën e vetë propozon që Lëvizjen e vetë ta fus në një thes me Frontet e rrejshme.

Tani shtrohet pyetja më delikate që mund të jetë shtruar ndonjëherë: Si është e mundur që OMLK-ja të jetë udhëheqëse iniciatore e kësaj pune dhe njëkohësisht të mbetet e paprekur dhe e papërlyer. Mençuria e këtij rasti duket në këtë formë: Nëse projekti i formimit të Frontit për Republikë, del një punë e suksesshme që nuk do të harrohet kurrë, atëherë kjo është vepër e komunistëve të OMLK-së. Nëse ky projekt komunist përkundër të gjitha ligjeve të materializmit dialektik e historik, dështon, falimenton, atëherë faji për këtë është tërësisht i Jusufit i cili ka propozua që Fronti i emërtuar nga UDB-së, Fronti i OMLK-së dhe Lëvizja e tij të futen në një thes. OMLK-ja komuniste mbetet e paprekur dhe e papërlyer.

Se sa janë në gjendje Jusufi e Bardhi të bëjnë të vepra pabesie e mohim të shokëve të vet e tregojnë më së miri fjalët:

Jusuf Gërvalla (Shkruesi i historisë*: **" Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981)

Por jo vetëm fjalët parimore të Jusufit, para 17 janarit 1982, janë interesante. Shumë e më shumë interesante janë fjalët e Ibrahim Kelmendit, pas 17 janarit 1982:

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*
QARKORE
"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën..
-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
(Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e Bashkimit që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:
"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***në një të vetme****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...
*Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (*Zëri i Kosovës, qershor 1982*)*

Kjo Komunikatë e lartpërmendur u shtyp dhe për herë të parë në Evropë u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku me Kushtrim - Thirrjen e demonstratës së Bernit të 26 qershorit 1982.

"Kadriu dhe Mirani shprehën miratimin e tyre duke shfaqur gëzimin, sidomos për faktin që këtë propozim tani po e bënte vetë Jusufi" (Atentatet, f. 324)

Është shpresa ime që edhe shokët e Jusufit, dhe të gjithë ata që shkrimin e historisë luftojnë ta bazojnë sa më shumë në fakte, të mos ngurrojnë ta shprehin gëzimin që këta rreshta i ka shkrua vetë Ibrahim Kelmendi.

22. E HARTOJMË VENDIMIN TË CILIN PROPOZOJ TA NËNSHKRUAJMË

Kadri Zeka kërkon pushim, pasi bisedimet për bashkim janë kryer me sukses, para se ta hartojnë dhe nënshkruajnë vendimin.

I. Kelmendi: *"– Tani ta ndërpresim bisedën pasi jemi të lodhur, – tha Kadriu. Pasi të flemë tre-katër orë, e hartojmë vendimin, të cilin propozoj ta nënshkruajmë dhe të bisedojmë për mënyrën e organizimit konkretisht."* (Atentatet, f. 324)

I. Kelmendi: *"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*

Të dashur shokë të QE, ...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë, ***sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore.*** *Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit.* ***Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë****."*(Letër Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 11 janar 1984 faqe 7)

Besojë se kemi arsye të gëzohemi që Ibrahim Kelmendi i ka dërguar letra jo vetëm Xhafer Durmishit-Skënderit, por edhe udhëheqësve të OMLK-së të cilët janë në dijeni shumë të mirë për ekzistencën e kësaj letre të 11 janarit 1984.

I. Kelmendi*: "Ta zëmë se organizatën e masave duhet ta udhëheqë pararoja marksiste-leniniste. Në rrethana të reja nuk ka nevojë të jetë kështu, nga se përvoja na ka treguar* ***se ne kemi funksionuar shumë mirë së bashku****, edhe kur u takonim organizimeve të ndryshme. Që kur janë hartuar janë quajtur Teza, që të diskutohen dhe të modifikohen, duke u zgjedhur varianti më i përshtatshëm sipas gjykimit tonë."* (Atentatet, f. 325)

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së pak për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit",(19 dhjetorit 1980 - shën i Xh. D.) të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë."*(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Ja se si janë vu në jetë gjatë bashkimit të Kadri Zekës me Ibrahim Kelmendin ***Tezat rreth Frontit për Republikën e Kosovës:*** *"Fronti Popullor për Republikën duhet të jetë jo një koalicion i paqëndrueshëm i krerëve të forcave të ndryshme politike, por një bashkim luftarak i pathyeshëm i të gjitha masave tona popullore; jo marrëveshje me fjalë në letër, por një bashkim në luftë*
e sipër; jo qëllim në vete, por një levë e rëndësishme për edukimin, mobilizimin dhe organizimin e masave popullore në luftë për të drejta e liri.

*Bazë e Frontit duhet të jetë aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe **të pararojës marksiste**-leniniste të vërtetë, që do të dal nga lëvizja **KOMUNISTE** në Kosovë, e cila po rritet, bashkohet e forcohet çdo ditë. Bashkimi bënë fuqinë. Bashkimi është imperativ i kohës."*

Ibrahim Kelmendit " *i interesonte po aq çlirimi i Kosovës sa edhe luftimi i **diktaturës komuniste** jugosllave."* (Atentatet, f. 11)

Faridin Tafallari*: "-Po Faridin **tha Kadriu**,- nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.*

***Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar** dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)."*

I. Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, por Mirani nuk pranoi"*

23. TANI E TUTJE NUK JANË MË TEZA POR PROGRAM

Jusufi, në rolin e servilit më të pa kurriz që të jetë e mundur të mendohet, ia jep vetes të drejtën që Tezat, në të cilat nuk e ka vendos asnjë germë, t'i shndërroi në Program të Frontit për Republikën e Kosovës, Front të cilit nuk i ka takuar kurrë as për së gjalli e as për së vdekuri.

I. Kelmendi: *"– Tani e tutje nuk janë më Teza, por Program i Frontit për Republikën e Kosovës, derisa ta mbajmë Kuvendin e Parë, – konkludoj Jusufi."* (Atentatet, f. 325)

A do të mjaftonte qoftë edhe vetëm ky argument për shembjen e mitit të Jusufit.

Gjithashtu rrjedh sipas I. Kelmendit, se në agimin dhe paraditën e 17 janarit 1982, në shtëpinë e Jusufit është bërë bashkimi. Shtrohen pyetjet: Kush është bashkuar me kend? Cili është emri i organizatës së bashkuar? A është formuar Fronti për Republikën e Kosovës më 17 janar 1982 apo shumë e shumë më heret? Kur e ka përfunduar aktivitetin faktik dhe formal "Fronti i Kuq Popullor"? A e ka bërë Jusufi Lëvizjen e tij, shtojcë apo bisht të Frontit të OMLK-së? A e ka shuar Jusufi, ky yll i pashuar Lëvizjen e tij, a ia ka dhënë Jusufi lejen vetes të veprojë kokë më vete? Të gjitha këto pyetje mund të thuhet se i kanë marrë përgjigjet në shtjellimin që kam bërë më parë në këtë shkrim por edhe në shkrime tjera. Duke e ditur fatin e Tezave rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës, se çka ka bërë me to Jusufi kur është kthyer nga Frankfurti, pas bisedës me Kadri Zekën, më 17 tetor 1981, përpjekjet e I. Kelmendit për t'i gjallëruar e aktualizuar megjithatë janë për çdo lavdatë.

Të shohim edhe një fakt tjetër të dëshmitarit të OMLK-së.

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*

QARKORE

"Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën."

PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!" (Letër Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

24. Sy të mbushur me lot - Je i pastër si loti

I. Kelmendi: *"Gjatë muajve në vazhdim Jusufi e Kadriu ndërprenë bashkëpunimin, madje Jusufi i qe hidhëruar aq shumë Kadriut, saqë për këtë shkroi edhe në Zëri të Kosovës.. Në dasmë të Kadriut e Sarandës u sqaruam. **Me nismën e Jusufit u takuam***

më 16 janar, një ditë para atentateve të kobshme. Në agun e 17 Janarit rivendosëm themelimin e Lëvizjes për Republikën e Kosovës." (Atentatet, f. 381)

Skena mahnitëse në shtëpinë e Jusufit. Jusufi dhe I. Kelmendi përqafojnë njëri tjetrin me gëzim e u mbushen sytë me lot nga gëzimi se u arritë bashkimi në mes orës 03.00-05.00 të mëngjesit të 17 janarit 1982

I. Kelmendi: *"– Urime për Bashkimin! – u ngrit në këmbë Bardhi duke ia zgjatur dorën Kadriut, meqë e dinte se këtë lloj prononcimi përurues po e priste secili, por ja që secili nga të tre po ngurronte ta thoshte i pari. Pas tij u ngritën edhe Mirani, Kadriu e Jusufi, duke uruar e përqafuar njëri-tjetrin me gëzim. Jusufit e Miranit iu mbushën sytë me* ***LOT.***

> I. Kelmendi*: "Sadik (Blakaj-shën. ynë).. ndoshta je i pastër si* ***LOTI*** *dhe mbetemi shokë të mirë."*

– Dalshim faqebardhë dhe fitues! – uroi Jusufi gjithnjë në këmbë.– Të lumtë goja! – thanë njëzëri Kadriu e Mirani.

– Të flemë pak dhe kur të zgjohemi e konkretizojmë këtë bashkim historik edhe me ***formulim me shkrim dhe me nënshkrimet tona****! – tha Kadriu pasi përfunduan me përurime entuziaste të njëri-tjetrit. Ranë të flinin rreth orës* ***pesë të mëngjesit****."* (Atentatet, f.325)

Faridin Tafallari*."-Po Faridin* ***tha Kadriu****,- nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.*

Ne me Frontin e Kuq Populllor jemi bashkuar *dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)."*

Jusuf Gërvalla: "...*tani që e di se ku bënë ti pjesë... Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme."*

I. Kelmendi: "*Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, por Mirani nuk pranoi... Kurse Jusufi nuk ia bëri Miranit asnjë propozim.. "*

E vetmja gjë që mungon në libër është tabloja e ndonjë piktori të famshëm. Kam shpresë se nuk do të vonoi tepër derisa ta kemi pikturën apo videofilmin e kësaj skene.

Shtrohet pyetja ku janë këto formulime me shkrim e nënshkrime që nuk u duket gjurma më e vogël e tyre qe 30 vjet.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet*. - S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës.* ***Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..****"* (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

25. Nuk e kishte plotësuar stazhin e kandidatit

I. Kelmendi i ankohet Xhafer Shatrit se Sabri Novosella e Skënderi i Shtutgartit e kanë mbështetë për muri. Këtë mahitje e vazhdon me tallje duke i treguar përfaqësuesit të autorizuar të OMLK-së, Xhafer Shatrit se Hasan Mala nuk është anëtarë i OMLK-së, pasi Kadriu i ka tregue se nuk e ka plotësuar stazhin e kandidatit

I. Kelmendi: *" Më shumë kisha nevojë ta informoja dhe ta përfitoja Bacalokun, sepse krahu i Sabitit e Xhafarit më kishin mbështetur për muri****. I tregova se edhe Hakani nuk ishte anëtarësuar akoma në OMLK, pasi Kadriu thoshte për të se nuk e ka plotësuar stazhin e kandidatit.*** *Këtë ia thashë për ta sqaruar se edhe Hakani nuk është i informuar për vendimet që kishim marrë Jusufi, Kadriu, Bardhoshi dhe unë. Por*

Xhabirin e luta që ta respektojë e dëgjojë Hakanin me takt, pasi është punëtor i moshuar megjithëse tani ka begenisur veten udhëheqës në vend të Kadriut." (Atentatet, f. 391)

Saime Isufi: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." *(Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)*

Intelektualët e kalibrit të Xhafer Shatrit e I. Kelmendit del se për një çast e harrojnë Sabri Novosellën e Skenderin e Shtutgartit, pasi kanë frikë se do t'u del punë me traktoristin e gurthyesin Hasan Mala, duke e plotësuar edhe qëndrimin e Kadri Zekës se pse ai nuk e ka anëtarësuar Hasanin në OMLK-së por e ka mbajtur në statusin e kandidatit.

Thelbi i këtyre fjalive është se, atë çka e ka bisedua Kadri Zeka me I. Kelmendin, figurën frontale të Frontit të pagëzuar nga UDB-a, nuk e ka biseduar kurrë me Hasan Malën. Pasi Ibrahim Kelmendi është edhe dëshmitarë i Mehmet Hajrizit, atëherë kjo punë sigurisht mund të jetë ashtu. Pasi ato janë çështje të tyre të brendshme, nuk kam nevojë e as leje të thellohem më shumë.

I. Kelmendi: *"– Plak, me këtë "një punëtori", e ke gjetur një si marifet për t'u imponuar. Ishe ti, punëtori, kur na e imponove Xhabirin si të dërguar nga Kosova për të përfaqësuar OMLK–në. Ky uzurpoi rolin e trashëgimtarit të Kadriut. Sigurisht, nuk ta ka pre mendja, si punëtor që ish-OMLK–ja në Kosovë, të cilës policia ia pamundësoi funksionimin përmes arrestimeve të shumta, nuk e ka gjetur pikërisht Xhabirin në burg për ta përfaqësuar. Po ta kishte ngarkuar ajo që ta përfaqësonte, atëherë Xhabiri do të ngarkohej të bazohej në Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës, siç qe ngarkuar Kadriun.* ***Bile, sikur të kishte OMLK–ja funksionalitet në Kosovë, atëherë ti, Plak, do të duhej ta informoje atë për bashkimin e***

> ***17 tetorit 1981*** *në panairin e librit në Frankfurt të Frontit të Kuq Popullor me Frontin Popullor të OMLK-së së Kuqe:*
> "-Po Faridin tha Kadriu,- nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.
> **Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar** dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ**).**
> ***Hasan Mala****: "Nga zemra të uroj shumë sinqerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë .... se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta."*

17 Janarit të '82–shit. Ajo do ta kishte parë të udhës të dërgonte zëvendësin e Kadriut, por jo të na imponohej ky Xhabir si përfaqësues i OMLK–së. Dhe erdhi pa ditur gjë OMLK–ja të të shpërdorojë ty, punëtor i nderuar, dhe ia bashkëngjiti OMLK–në atij farë bashkimit të 17 shkurtit..." (Atentatet, f.435)

Figura frontale e Frontit të pagëzuar nga UDB-a, nuk ndihet e befasuar se Xhafer Durmishi apo Skënderi i Shtutgartit, nuk u interesua fare të informohet nga I. Kelmendi, të paktën për orët e fundit të jetës dhe veprimtarisë së Jusufit

I. Kelmendi: *"Sa për qëndrimin e Xhafarit, i cili nuk* ***u interesua fare të informohet*** *nga unë për orët e fundit të jetës dhe veprimtarisë, të paktën të Jusufit, nuk jam befasuar dhe nuk po befasohem as tani."* (Atentatet, f. 388)

Nuk jam unë ai që kam qenë i painformuar nga Jusufi, pasi ne, në të njëjtën ditë e me të njëjtin vendim jemi bërë anëtarë të KQ të Lëvizjes së Jusufit. Është Kadri Zeka, shoku i I. Kelmendit që e ka lënë atë të painformuar apo e ka informuar ashtu siç ia ka

dashtë qejfi e interesi. Por unë si shok i Jusufit, i përsëris fjalët e Jusufit dhe nuk më takon të përzihem në punët e brendshme të Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit.

26. ATENTATET BASHKË ME SHOKËT MA VRANË EDHE KËTË PROPOZIM

Qysh nga 15 gushti 1981 e gjer në 17 janar 1982, I. Kelmendi ka dëshiruar që organizata e bashkuar nga organizatat e asaj kohe të quhet vetëm 'Lëvizja për Republikën e Kosovës'

Ibrahim Kelmendi*: "Dikur dëshiroja të quhej vetëm* ***Lëvizja për Republikën e Kosovës****, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."* (Atentatet, f.434)

A ka gjë më *elementare* se sa fakti që emri më preciz e më kuptimplotë i organizatës së bashkuar të vijë nga askush tjetër, jo nga Jusufi apo Kadriu, por pikërisht nga figura frontale e Frontit 100% të pagëzuar nga UDB-a. Prej nga del se sikur ta kishim dëgjuar figurën frontale të Frontit, të paktën tri vjet e gjysmë sorollatjesh ideologjike do të ishin kursyer e do të kishim fituar në kohë. Pra nuk është kot nëse thuhet se të tjerët u sollën sa u sollën e nuk patën çare pa u kthye tek fjala gjeniale e figurës frontale të Frontit të emërtuar nga UDB-a. Këtë far lloj DÉJÀ-VU-je, këtë lloj triku qesharak, të stilit: ja shikoni se si doli fjala ime, a është i vetmi që e përdorë I. Kelmendi apo kjo ide sa gjeniale aq edhe origjinale u ka ra ndërmend ta përdorin edhe disa të tjerë, e në shoqërinë e të cilëve figura frontale e Frontit nuk ndihet aspak mirë.

Të shohim me fabrikimet artistike dhe faktet dokumentare të I. Kelmendit për emrin e Lëvizjes. Citati i përsëritur, i fabrikuar artistikisht dhe të gjitha citatet dokumentare prej nënpikës 1-12 janë të Ibrahim Kelmendit.

-1. Fabrikimi artistik*: "Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar(Trakt): *Kërcënimet çetnike nuk na frikësojnë,* pa datë, viti 1983

"-Rroftë Republika Shqiptare në Jugosllavi"

Kërcnimet çetnike
nuk na frikësojnë!

lori shqiptar do të rrojnë ne shekuj!
– Rroftë Republika Shqiptare në Jugosllavi!

Punëtorët patriotë
(Simpatizantë të LRSHJ-së)

-2. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar*: "-PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!" "-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"*

E nënshkruar "Shoku", 4 maj 1983"



Në mërgim..., me 4.05.1983

I dashur shoku S.,
Letrën tënde e mora. Të falenderoj që më shkrove – është letra e parë, njëherit edhe fillimi i leter-shkembimit mes nesh.

- PER NJE REPUBLIKË SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI !
- RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI !

Shoku

PS. Kopjet e letrës do ua dërgoj edhe shokëve, pasi pos mendimeve që janë vetëm në nivel të përgje-gjjes, janë edhe disa mendime propozime për të cilat duhet t'i shprehin mendimet dhe qendrimet e tyre edhe shokët. Veprohet kështu (pasi e shoh të arsyeshme) në pamundësi për t'u takuar, për ku-shte që dihen.

-3. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*



Ibrahim Kelmendi për Xhafer Duramidhin

Në mërgim..., më 3.06.1983

I dashur shoku S.,

ca me vonesë po të shkruaj për t'ju përgjegjur letrës së 17 majit, të cilën unë e

Fakti dokumentar*: "I dashur shoku S., Në mërgim..., më 3 qershor 1983*

Përfundim i letrës *-PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*
-RROFTE LRSSHJ-a !"



diskutimi dhe vlerësimi. Për mendimin tim do të duhej të kopletohet i tëri për t'u diskutuar e aprovuar, duke e shoqëruar me një material shoqërues-udhëzues, për më-nyrat e diskutimit, të grumbullimit të vrejtjeve dhe propozimeve, që përfundimisht të studjohen dhe të nxjerret Programi dhe Statuti i LRSSHJ-së.

- PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!
- RROFTE L R S S H J - a!

Të përshëndet Shoku

-4. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: *"Shumë të dashur shokë, Suedi më 30 qershor 1983*



Suedi, më 30 qeshor 1983

Shumë të dashur shokë, Ibrahim Kelmendi për Xhafer Duramidhin

pasi më ra në dorë Qarkorja (pa datë, por mua më erdhi me 29 qesh.), edhe pse më posht

Përfundim i letrës
"-PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!



- PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI !
- RROFTE LRSHJ-a !

Përshëndetje revolucionare

PS. Sa i përketë strehimit, ende nuk jam rregulluar. Sa po më mundon, pasi disi jam lidhur dhe kjo po pengon edhe në punë, pos që isha mësuar 'nomad'.

Mirëupafshim.

RROFTE LRSSHJ-a ! Përshëndetje revolucionare

- PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI !
- RROFTE LRSHJ-a !

Përshëndetje revolucionare

PS. Sa i përketë strehimit, ende nuk jam rregulluar. Sa po më mundon, pasi disi jam lidhur dhe kjo po pengon edhe në punë, pos që isha mësuar 'nomad'.

Mirëupafshim.

5. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*
Fakti dokumentar:: *Shumë të dashur shokë, 30 qershor 1983*
"Para se të merret fushatë demaskimi, do të lypsej edhe njëherë të kthehemi 'dokumenteve' (që përmendin ata – të 17 shkurtit), të cilat, mendoj dokumentat, duhet t'i ketë LRSHJ-a në dispozicion, që të ecim ma hapa të sigurt, pasi armiqtë kanë më së shumti sukses atëherë kur shfrytëzojnë lëshime e gabime, që ndonjëherë shpëtojnë."
"Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të ***BASHKËPUNOJMË*** *për ta*

Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të bashkpunojmë për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte bashkpunuar përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por

vazhduar luftën, ashtu siç ***ishte BASHKËPUNUAR përpara****, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani) dhe Nexh. (Nexhati - Osman Osmani, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë."*
"-PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!
-RROFTE LRSHJ-a !" (Letër QE, 30 qershor 1983)

-6. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*
- Fakti dokumentar: Titull letre
"-PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

PER NJE REPUBLIKE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI! 1(2)

Ibrahim Kelmendi per Xhafer Durmishin

Suedi, me 25 gusht 1983

Te dashur shoke te QE,

Suedi, më 25 gusht 1983
....Parollën që përdora në fillim, të cilën e kam përdorur edhe në letra tjera, a është e drejtë? Mos kishte me qenë edhe më e drejtë PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI! Ose, që të dyja nuk duhet të praktikohen fare dhe përse? Përshëndetje revolucionare, Ilazi" (Letër QE, 25 gusht 1983)

Parollen qe perdora ne fillim, te cilen e kam perdorur edhe ne letra te tjera, a eshte e drejte? Mos kishte me qene edhe me e drejte PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI! Ose, qe te dya nuk duhet te praktikohen fare dhe perse.

Pershendetje revolucionare Ilazi

-7. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: Titull "*PER NJE REPUBLIKE TE SHQIPTAREVE NE JUGOSLLAVI*

Të dashur shokë të QE *RFGJ,. 10 tetor 1983*

Pranoni përshëndetjet revolucionare e vëllazërore nga Ilazi" (Letër QE, 10 tetor 1983)

PER NJE REPUBLIKE TE SHQIPTQREVE NE JUGOSLLAVI!

Ibrahim Kelmendi per Xhafer Dyrmishin

RFGJ., me 10.tet.1983

Te dashur shoke te QE,

Pranoni pershendetjet revolucionare e vellazerore nga Ilazi

PS. Bashk me letren po ua dergoj materialin per nje artikull per t'i fshikulluar ata qe meritojne.

-8. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: "*(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*

QARKORE

"Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën."

zjes. Themelet e Programit duhet te jene Komunikata mbi Bashkimin (le shuar ne "Zeri te Kosoves", nr.1, 1982), si dhe kerkesa e mirefillta te mbare popullit, te vulosura me gjak e sakrifica dhe te njohura ta-

Mbyllje e letrës

-*"PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"*

"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!" (Letër QE, 10 janar 1984)

dhet e LRSHJ-se, per t'i dalur zot me sukses misionit!

Rezultatet e diskutimeve duhet te jene dhene me se voni gjer ne fund te shkurtit, 1984. Kurse fushata per grumbullimin e adresave duhet te vazhdoj cdo here.

- PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!
- LAVDI TE RENEVE PER LIRI E TE DREJTA TE POPULLIT E ATDHEUT!
- RROFSHIN POPUJT LIRIDASHES TE MBARE BOTES!
- RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

Me x.Janar.1984 Komiteti Qendror i LRSHJ-se.

-9. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: Titull "*"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*

Të dashur shokë të QE, *Në mërgim..., më 11 janar 1984*



PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

1(20)

Ne mergim..., me 11.jan.'84

Te dashur shoke te QE,

Ibrahim Kelmendi por Xhafer Durmishi

...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë, ***sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore.*** *Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë."* (Letër QE, 11 janar 1984, faqe 7)

Ne perfundim te letres shoku Salih na shkruan per datat, 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prap te "allashvareshet" e rendometa qe po zhvillohen zakonisht ne biseda telefonike. Mendimi i shokut Salih lidhur me keto dy data, se nuk na qenkan per natyre te tij te dores se pare, sikur me duket neglizhim i rendesise aq parimore. Kurse me data qe ende je ne to, do te thoja per rastin konkret, nuk ka si te merret historia. Ne kete rast kontestuase eshte se si te shkruhet ne Program Politik, perkatesisht cila date - dhe kjo ka rendesi te madhe, pasi ndryshimi i datave percjellet me shkelje te Komunikates se leshuar me rastin e Bashkimit. Une jam per ata, nese duhet te vendoset ndonje date ne Program Politik, atehere te mbetet ashtu si eshte ne Komunikate.

-10. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: TITULL *"PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"*

I dashur shoku Mërgim, Në mërgim..., (Letër Sabri Novosellës dhe QE, 17 janar 1984)



PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

1(4)

Ne mergim..., me 17.jan.1984

I dashur shoku Mergim,

Nga nje kopje te kesaj letre po ua dergoj shokeve te KE (QE).

Mireupafshim.

Kopjuar nga origjinali - Ilijazi

-11. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: *Titull "-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*

*Në mërgim..., më 19 janar 1984, Ilazi"(*Letër QE, 19 janar 1984)



PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

Ne mergim..., me 19.01.1984

Te dashur shoke te QE,

asaj qe kam marre me mend dhe qe kam mundur t'i ik...

Po ua dergoj edhe kopjen e letres, derguar shokut Mergim.

-12. Fabrikimi artistik: *"Dikur dëshiroja të quhej vetëm Lëvizja për Republikën e Kosovës, por atentatet, bashkë me shokët, ma vranë edhe këtë propozim."*

Fakti dokumentar: Titull i letrës *"PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"*



PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!

Ne mergim..., me 19.03.84

Te dashur shoke,

Në mërgim, më 19 mars 1984, e nënshkruar *"Shoku"* (Letër Xhafer Durmishit, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit dhe Hasan Malës, 19 mars 1984)



Klubi ED ka vendosur bashk me 6-Vjetorin (si preteks maskues) te shenon 3-Vjetorin e Demonestratave ne Kosove, me karakter te gjere. Cfare mendoni edhe ju?

Pranoni pershendetje revolucionare

Ibrahim Kelmendi është i vetmi që nuk ka lëshuar asnjë rast e nuk e ka shkrua asnjë letër pa e përmend emrin e Organizatës si më lartë. Asnjë nga themeluesit e Lëvizjes nuk e ka bërë këtë.

Siç do ta shohim nuk është vetëm Ibrahim Kelmendi që ka qenë "largpamës", që ka pa me vite të tëra para të tjerëve sepse pikërisht këtë veti e ka edhe nemesisi i tij Sabri Novosella.

Sabri Novosella*: "Në Stamboll e morëm një dhomë në një hotel dhe pas një pushimi të shkurt filluam bisedimet për çka ishim takuar. Unë dhe Bardhoshi dolëm me qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim: të bashkohen organizatat ekzistuese në një Organizatë të vetme, e cila mund të pagëzohet* ***"Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi..."*** (Si e themeluam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSHJ, Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

27. SI DUHET TË BASHKËPUNOJMË ASHTU SIÇ ISHTE BASHKËPUNUAR PËRPARA

I. Kelmendi: *"– Dalshim faqebardhë dhe fitues! – uroi Jusufi"* (Atentatet, f. 325)

Se Jusufi ka dal gjithmonë faqebardhë dhe fitues duke e ruajtur Lëvizjen e vetë Nacionalçlirimtare të pastër prej Frontit të krijuar e emërtuar nga UDB-a, dhe prej Frontit të planifikuar në themelin e të cilit kanë qenë të pavërtetat e dëshmon më së miri



Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqën B. të shokët në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të bashkpunojmë për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte bashkpunuar përpara, ishin të pranishëm, – jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...,– Nuh. me Nexh. (siç e quanin një tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda të kuptoj se Nexh. ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... dhe siç më dukej, nga disa shokë të rij dhe fare të paekspriencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...), ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë. Potencova këtë rast, nga fri-

I. Kelmendi*: "Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të* ***bashkëpunojmë*** *për ta*

*vazhduar luftën, ashtu siç ishte **bashkëpunuar** përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani - shën im) dhe Nexh. (Nexhati - 'Osman Osmani -shën im'-, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë."* (Letër QE, 30 qershor 1983)

I. Kelmendi*: "(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*
QARKORE
"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën..
-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"
"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!" (Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e Bashkimit që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:

"KOMUNIKATE

*Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave **në një të vetme**. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...
Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ" (Zëri i Kosovës, qershor 1982)

Kjo Komunikatë e lartpërmendur u shtyp dhe për herë të parë në Evropë u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku me Kushtrim - Thirrjen e demonstratës së Bernit të 26 qershorit 1982.

28. MË DUKET NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE

I. Kelmendi*:"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*
Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 11 janar 1984

Ne perfundim te letres shoku Salih na shkruan per datat, 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prap te "allashvareshet" e rendometa qe po zhvillohen zakonisht ne biseda telefonike. Mendimi i shokut Salih lidhur me keto dy data, se nuk na qenkan per natyre te tij te dores se pare, sikur me duket neglizhim i rendesise aq parimore. Kurse me data qe ende je ne to, do te thoja per rastin konkret, nuk ka si te merret historia. Ne kete rast kontestuase eshte se si te shkruhet ne Program Politik, perkatesisht cila date - dhe kjo ka rendesi te madhe, pasi ndryshimi i datave percjellet me shkelje te Komunikates se leshuar me rastin e Bashkimit. Une jam per ata, nese duhet te vendoset ndonje date ne Program Politik, atehere te mbetet ashtu si eshte ne Komunikate.

"...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi - shën im) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po

*zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë**, sikur më duket NEGLIZHIM i rëndësisë aq parimore**. Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. **Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë**."* (Letër dërguar QE - Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit,, faqe 7)

Nga letrat e datave 30 qershor 1983, 10 e 11 janar 1984 del se sa shumë e ka keqkuptua Ibrahim Kelmendi punën time kur shprehet ***...sikur më duket neglizhim i rëndësisë aq parimore.*** Gjërat parimore nuk i kam neglizhuar kurrë. Garat e Sabri Novosellës, Xhafer Shatrit e Abdullah Prapashticës i kam neglizhuar atëherë e këtë e bëjë edhe sot. Datat që kanë të bëjnë me Lëvizjen e Jusufit dhe historinë e Jusufit nuk i kam neglizhuar kurrë. Sa keq janë mashtruar e mashtrohen ata që mendojnë se unë nuk e di historinë fitimtare të Jusufit por kam nevojë ta mësoj prej të tjerëve, se në këtë drejtim jam në mëshirën e të tjerëve.

Jusuf Gërvalla*: "Të paça vëlla* - vazhdoi Troshi pa vullnet. - *S'po priten më lum Keta... janë bërë kafshë të prapta. I pret në arë, i gjen te gardhi, te trarët e kullës.* ***Eja t'u paftë hairi, NË QOFSH GJALLË, e dilu zot shtëpisë sate e mallit tënd..."*** (Rrotull, Tiranë 1983, faqe 95).

TELEFONI NDODHEJ NË RRUGËN MATANË SHTËPISË

1. Telefoni nuk punon - Lëshoja telefonin
2. I kujt është faji?
3. Telefoni në rrugën matanë shtëpisë
4. Kujt i takon merita?

1. Telefoni nuk punon - Lëshoja telefonin

Sabri Hamiti: "KEQA, *ngrihet, shikon orën*.
Isë, ku e ke telefonin?

ISA, *habitshëm.*
Telefoni nuk punon." (Misioni, Prishtinë 2007, faqe 44)

Sabri Hamiti: "LULI
Baca Isë, s'më zë gjumi pa e ndëgjuar zërin e Lulës. Nuk e kam parë tri ditë. Qesh si në turp.

ISA
Po thirre! *Zënës. Lëshoja telefonin.*

LULI, *në telefon.*
Alo! Lulë, si je e dashur... Po të dua sa jetën... Si? Po si të të harroj kur mendjen e kam te ti... Po jam te Isa, te baca Isë. Te Isa de, sonte jam këtu... Nuk ka punuar telefoni deri tash. *Ia shkelë syrin Isës duke buzëqeshur*. Të vij tash... Është vonë. Sa është ora? Shikon orën në mur 24.00... Me çka? ... Jo me tren. Të puth. Cëk. *E lëshon telefonin*.

ISA, *kurioz.*
Ka gjë të re?

LULI, ngutet.
U nisa. Çohet. Më fal!

ISA, *i çuditur.*
Ka ndodhur gjë?

LULI
Jo, por duhet të nisem. Me tren jam atje rrafsh për dy orë, me tren të shpejtë, ngutu. Po dal se për 15 minuta e kam trenin.

ISA, *Zanës.*
Çikë, thirre Bardhylin, ta përcjellim djalin në stacion. *Del Zana*.
Te dera mbathen me nguti. Zana përshëndetet me Lulin. Bardhyli fshin me duar gjumin nga sytë.

ZANA, *duke i dhënë shallin Isës.*
Ka ngricë. Bardhyl, ke kujdes se udha është nën ngricë.

ISA, *duke dalë.*
Çikë, mbylle derën e bjer në gjumë!

ZANA, *duke u ngjitur shkallëve.*
Kjo ngricë, ky acar! Sa ditë e mërzitshme!

Ndëgjohen breshëri krismash nga jashtë. Mandej qetësi. Prapë breshëri krismash. Fishkëllimi i rrotave në asfalt. Heshtje. Mandej britma." (Misioni, Prishtinë 2007, faqe 51-54)

2. I kujt është faji?

Për shkak të provokimeve të shumta që prej fillimit të daljes së Jusufit në Gjermani, Vëllezërit Gërvalla, në shtëpinë e tyre në Untergruppenbach nuk abonojnë lidhje telefonike. Të gjitha kontaktet e bisedat e shpejta kryhen përmes zyrës së Bardhoshit në Ludwigsburg, përmes telefonit: 07141-26091.

Në mungesë të kësaj lidhjeje telefonike, në natën e 17 janarit 1982, pas orës 22.00 Jusufi, Kadriu e Bardhi dalin për ta bërë një bisedë nga kabina telefonike e fshatit Happenbach, dy kilometra e gjysmë prej Untergruppenbachut. Lidhja e zinxhirit të shkakut dhe pasojës pa kurrfarë kriteri të çon në absurditete, shtrembërime e akuzat më të turpshme, sa naive aq edhe djallëzore. Biseda telefonike dhe mungesa e telefonit nuk janë shkaku i vrasjes. Shkaku i vrasjes është vepra e Jusuf Gërvallës. Biseda telefonike nuk ka këtu ndonjë rëndësi thelbësore.

Pas lirimit të Hysenit nga burgu, Hysen dhe Abdyl Gërvalla, dalin në Zvicër. Këta kanë kërkuar sqarime pos tjerash në këto dy pika:

Hysen e Abdyl Gërvalla: *"c) -Sqarimin rreth veturës "Citroën", me targa të Zvicrës, pronë e shokut më të ngushtë të Kadri Zekës, veturë kjo e cila është gjetur me rastin e vrasjes në fshatin Untergruppenbach.*
d) Insistimin e ish-shoqes [gruas] së Kadri Zekës, (Saime Isufit) për t'iu paraqitur Kadriu asaj në telefon me çdo kusht, pikërisht natën e 17 janarit 1982, pra natën e vrasjes." (Gazeta Shqiptare, Gjenevë, maj 1997)

I të njëjtit mendim është edhe Avdi Ibrahimi.

Avdi Ibrahimi: *"Por tashmë duhet të punohet intensivisht e më mençuri për të nxjerrë nga mendja e shpirti i njeriut esencën e besueshmërisë dhe, të qëndresës stabile, të arsyeshmërisë. Pra të bëhet një lloj ndeshjeje e të arsyeshmes me të paarsyeshmen…E vërteta të ndeshët ballë për ballë pa u frikësuar me të pavërtetën e shëmtuar…E moralshmja ta fundosë në Had të pamoralshmën Paniotike. Kështu mania e tërbimi e çmendurisë, të bëhen vetëtimë e mekur e kafshërisë e cila po jep shpirt në shekullin e ri që po vjen së shpejti. Njerëzit naiv të mos jenë viktima të kësaj marrëzie jonjerëzore. Këta fatkeq duhen shpëtuar nga këta shantazhist që në fshehtësinë e tyre ruajnë krimin e mistershëm. Kështu i trokeste në kokë ideja: Kush e vrau Bajram Currin, nuk më duket se ai ka vrarë vetën?! Atë e ka vrarë tradhtia. Kush e vrau Luigj Gurakuqin e ditur?! Avni Rrustemin shpresën djaloshare të shqiptarisë?! Kush e vrau diellorin Hasan Prishtinas?! Kush e vrau Papa Kristo Negovanin e shkolluar?! Kush e vrau Qemal Stafën…Kush e vrau Halim Spahiun, Emin Durakun, Meto Bajraktarin, Xhevdet Dodën…?! Kush e vrau Enver Hadrin…?! Kush i vrau Rexhep Malën e Nuhi Berishën…?! Kush i vrau Afrim Zhitinë e Fahri Fazliun…?!* ***Po si ndodhi që në ditën e vrasjes së Lajmëtarit të gjendej aty pranë ajo vetura "Citroen" me targë të Zvicrës*** *dhe ajo vetura të ishte e shokut më të ngushtë të Kandilit, tani të fikur…?!* ***Po pse, pikërisht në natën e krimit Kandili duhej t'i telefononte me çdo kusht Bules…?!*** *Po ku mbeti ajo revolja që kishte qenë e destinuar për likuidimin e Lajmëtarit…?! Kuushsh i vrau…Kuuushshsh… Kuuuushshshsh…i vrau?! Hamlet të lutem ma zgjidh këtë enigmë…Shqiptoi këto fjalë Hektori dhe, kështu kishte filluar për ta vënë në gjumë fyelli i Nolit që ju kishte dukur se ai tingull muzikor po i vinte nga varrezat e Bostonit."* (KUSH E VRAU LAJMËTARIN, Novelë, VATRA - Prishtinë 2000, Redaktor Rifat Kukaj)

Këtu vlen të theksohet se novelën 'Kush e vrau Lajmëtarin' e ka redaktuar Rifat Kukaj. Edhe ai (Kukaj), autori i Bareshës së Nexhmije Pagarushës i kushton rëndësi bisedës telefonike të Kadriut me Bulen.

Mendime të ngjashme ka edhe Shefqet Jashari-Strofci.

Shefqet Jashari: *"Saime Isufi ka për detyrë të përgjigjet edhe në një pyetje po qe se dëshiron të zbardhet kjo vrasje nga organet e drejtësisë së Kosovës: Nga shumë burime flitet se kur është nisur Kadri Zeka për Gjermani, bashkëshortja e tij e ka porositur, që kur të shkojë në Gjermani të lajmërohet nëpërmjet telefonit se si ka kaluar rrugës. Plotësisht ka qenë e drejtë dhe e arsyeshme brenga e Saimes për bashkëshortin e saj. Por Saimja duhet të tregoi se kur ia ka thënë atë porosi Kadriut, a ishte aty pari Ibrahim Kelmendi apo ndokush tjetër ? A ka pasur njohuri Ibrahim Kelmendi se Kadri Zeka ishte i detyruar t'i lajmërohet bashkëshortes së tij me telefon nga Gjermania për t'i treguar se si ka kaluar rrugën."* (PSE U VRANË DHE KUSH MUND TË JENË TË

PËRZIER NË VRASJEN U JUSUF GËRVALLËS, BARDHOSH GËRVALLËS DHE TË KARDI ZEKËS, Bota sot, 26 shkurt -9 mars 2002)

Saime Isufi: *"Sa qëndroi në Gjermani, më merrte çdo ditë në telefon. Më njoftonte për punët që bënte dhe për të rejat në takimet me punëtorët. Pikërisht në natën e kobshme ku ai ishte bashkuar me vëllezërit Gërvalla, kishte dalë për të më telefonuar se atë natë nuk mund të kthehej. Pati të tillë që i thanë Kadriut se nuk ka nevojë t'i telefonosh, se ia ke frikën gruas etj., por ai iu kishte thënë se atë e kam shoqe dhe të gjitha i ka lënë për mua, ndaj nuk dua të bëhet merak. Kjo ishte e natyrshme, por natyrisht jo për të gjithë."* (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, f.102)

3. Telefoni në rrugën matanë shtëpisë

Apostol Duka: *"Kadri Zeka u vra sepse në orët e vona të natës tragjike të 17 janarit shfaqi dëshirën po aq njerëzore të shkëmbente, përmes **telefonit që ndodhej rrugën matanë shtëpisë** së Jusuf e Bardhosh Gërvallës, dy fjalë zemre. Dhe luftëtarët profesionistë, njëlloj si aviatorët, marinarët dhe minatorët, gabojnë vetëm një herë në jetë."* (Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 392)

Xhafer Durmishi*: "Jusufi, anëtar i LNÇKVSHJ pra e ka ndihmuar dhe popullarizuar në masën më të madhe "Frontin e Kuq". Prej janarit 1981 Jusufi nuk i ndihmon më Ibrahim Kelmendit në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi" për disa shkaqe.*

*Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksist - Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrur në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e **kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare** gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës."* (Letër Pajazit Ibrahimit në Australi, 7 mars 1982)

Xhafer Durmishi: "*Shoku Remzi, Posa ta marrësh këtë letër, ju lutem të përpiqesh të na e kryesh këtë punë:*

1. E fotografon shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla, përballë dhe anash në tri-katër poza, në mënyrë që njërën prej tyre ta botojmë në numrin e janarit.

2. E fotografon atë kabinën telefonike, tek e cila kanë qenë tue dalë, e cila është në hyrje të fshatit Habenpach (apo Habanpach, nuk di si shqiptohet drejt) dhe

3. E fotografon së bashku me Hafizin nga kerri, apo parkohesh pak në autoban dhe e fotografon tabelën e autobanit që tregon për daljen (ausfahrt) Untergruppenbach, sepse atë fotografi do ta botojmë duke ua tërhequr mendjen mërgimtarëve, që sa herë t'i bien asaj rruge tu bie ndërmend ai rast." (Letër Remzi Ademajt, dhjetor 1984)

Xhafer Durmishi*: "Shoku Faridin,*

Kjo letër ka të bëjë me kabinën telefonike që Jusufi, Bardhi e Kadriu natën e 17 janarit kanë dalë për të telefonuar. Duhet ta kesh të qartë pra se në vitin 1981-1982 Untergruppenbachu nuk ka pas kabinë telefonike.

Në atë kabinë mua më ka ra shumë herë me shkua me Bardhin e Jusufin. Kabina gjendet në fshatin Happenbach. Rruga L1111 e lidhë Untergruppenbachun me

Happenbachun, ndërsa E41 i bien në mes tyre. Kur thash gjendet, ndoshta më drejt është me thënë se ka ekzistue pasi sot në kohën e telefonave të dorës nuk është e sigurt se gjendet më. Pasi ajo kabinë ka shumë rëndësi për historinë e popullit tonë është mirë me i mbledhë të gjitha faktet për te.

Prandaj lidhur me këtë punë po ia jap vetes të drejtën me t'i shtrue këto çështje apo detyra, pasi besoj se në mesin e të gjallëve, me përjashtim të dy-tre vetave, më të interesuar se unë e Ti me i sqarua këto punë sa më hollësisht nuk ka.

1. Nëse kabina telefonike gjendet, shënoje adresën e saktë se ku gjendet dhe i bënë disa fotografi të mira dhe e merr numrin e kabinës.

2. Nëse kabina nuk gjendet merr vesh nga komuna të cilës i takon Happenbachu se në cilën adresë ka qenë kabina telefonike në vitin 1981 e 1982. Këtë organet komunale mund dhe duhet ta dinë. Të njëjtin fakt e din edhe Deutsche Post und Telecom. Ose prej komune ose prej firmës së telefonave merri të gjitha faktet për fotografinë, numrin e kabinës dhe adresën e saktë se ku ka qenë kabina.

3. Me ndihmën e kilometrazhës së kerrit mate ekzakt distancën në kilometra apo metra prej shtëpisë së Jusufit deri tek vendi i kabinës.

Kabina telefonike në Happenbach e fotografuar nga Remzi Ademi në dhjetor 1984. Nën fotografi, dorëshkrimi i R.A.

4. Merre një vërtetim nga komuna të cilës i takon Untergruppenbachu apo nga firma e post-telekomit se në vitin 1981-1982 në fshatin Untergruppenbach nuk ka pasur kabinë telefonike. Kjo puna e vërtetimit si e tillë ndoshta është delikate. Më së lehti merret nëse Post-Telecomit (apo si quhet firma shtetërore e Telefonike në Gjermani) të Heilbronit i drejtohesh me shkrim duke u bërë këtë pyetje:

E shënon emrin e mbiemrin Tënd dhe adresën e plotë, pastaj vazhdon diçka në stilin; Zotërinj të nderuar, kam një pyetje e cila është e rëndësishme për mua.

-A ka pasur fshati Untergruppenbach në vitin 1981 dhe 1982 kabinë telefonike?

Organet Gjermane me shtetësi mijëvjeçare përgjigjen në pyetjen Tënde, e kanë për detyrë me t'u përgjigj. Përgjigjja e tyre pastaj mund të përdoret si vërtetim në këtë punë.

Në bazë të fakteve të mbledhura prej teje, e në bazë të disa shkrimeve që ekzistojnë e kishim bërë një shkrim të mirë me të cilin do të informoheshin të gjithë për këtë punë dhe disa thash e theme, shtrembërime e rrena të pakryp kishin marrë fund. Shkrimin isha përpjekë me e përmbyllë pa u vonuar shumë, por botimin nuk kishte pas nevojë të bëhet para janarit 2011. (Letër Faridin Tafallarit, 20 janar 2010)

Xhafer Durmishi*: "Mirë dita shoku Faridin,*

...Edhe fotografitë janë shumë të mira. Por, siç thonë fjala po e nxjerrë fjalën. E këto fotografi, sidomos të telefonit më dhanë ide të reja, dhe shoh se koha në Happenbach nuk ka qëndrua në vend siç ka qëndruar në kokën time. Vendi, sigurisht është pikërisht ku ka qenë kabina më 1982. Por kuptohet ky telefon (aparati si aparat, nuk është. Ndryshime sigurisht janë bërë pas futjes së Euros e heqjes së DM si valutë shtetërore. Me sa duket ky telefoni ne fotografi ndoshta nuk është fare me të holla, por vetëm me karta. Kabina telefonike e 1982-shit ka qenë e mbulueme dhe me derë. Prapë se prapë mirë është që janë mbledhë faktet.

Jam duke i përgatitë disa shkrime, e të shohim se si do të dalin." (Letër Faridin Tafallarit, 27 mars 2010)

Nga biseda me Faridinin është sqaruar se fshati Untergruppenbach ka pasur kabinë telefonike, por ajo ka qenë vetëm për biseda brenda Gjermanisë. Ndërsa kabina telefonike e Happenbachut ka qenë edhe për biseda jashtë. Fotografinë e kabinës të bërë nga Remzi Ademi në dhjetor 1984 e gjeta në mesin e albumeve fotografike pas bisedave që bëra me Faridinin në janar e mars 2010. Pohimi i Apostol Dukës është një shtrembërim jashtë çdo mase. Ai është munduar ta thjeshtësoj dhe ta paraqes sa më të drejtë kërkesën e Kadriut për ta bërë bisedën telefonike dhe pikërisht e ka bërë të kundërtën.

"Kadri Zeka u vra sepse në orët e vona të natës tragjike të 17 janarit shfaqi dëshirën po aq njerëzore të shkëmbente, përmes ***telefonit që ndodhej rrugën matanë shtëpisë*** *së Jusuf e Bardhosh Gërvallës, dy fjalë zemre."*

E para: Sipas Dukës, edhe pse telefoni paska qenë rrugën matanë shtëpisë, Kadri Zeka na del aq zotëri i madh që nuk ka mund me e kalua rrugën matanë shtëpisë në këmbë, por qenka dashtë të shkoj me kerr.

E dyta: Nëse kabina telefonike nuk ka qenë në rrugën matanë shtëpisë, por 2 kilometra e gjysmë, atëherë sipas Dukës, biografit të Kadri Zekës, dëshira e tij aq njerëzore na del shumë e paarsyeshme dhe e panatyrshme.

Për të gjithë shokët e Jusufit në Shtutgart, kërkesa e Kadri Zekës ka qenë e arsyeshme, e njerëzishme dhe e natyrshme pamvarësisht distancës deri tek kabina e telefonit.

Më 5 shkurt 2007 në Hotel Viktoria në Prishtinë, u promovua libri *Atentatet* i Ibrahim Kelmendit. Pas këtij botimi, me sa kam mund me vërejt autoriteti i Ibrahim Kelmendit është rritur sidomos tek shokët e Kadri Zekës. Për te, fjalë superlative kanë folur vëllezërit e Kadriut, Mehmet Hajrizi e pranon si dëshmitarë në shkrimin e historisë së OMLK-së, Saime Isufi e përgëzon nga zemra. Xhafer Shatri, Saime Isufi e Ismet Rashiti bëjnë çdo gjë që është e mundur për të mos e bërë as dallimin më të vogël në mes Jusufit, Bardhoshit, Kadri Zekës dhe Ibrahim Kelmendit. Për hir të vërtetës duhet pranuar se në lavdatat superlative për librin e I. Kelmendit nuk ka pasur dëshirë të mbetet pas të tjerëve as Hysen Gërvalla.

Sipas dëshmitarit të OMLK-së, Kadri Zeka në agimin e 17 janarit 1982, paska qenë i mendimit se nuk meriton atentat nga UDB-a, se ajo do të përpiqet ta vret vetëm kur ajo të ketë mundësi që vendin e tij ta zëvendësoj me agjentët e saj.

Ibrahim Kelmendi: *"Kjo do të ndodhë, them unë, pasi ajo të ketë infiltruar njerëz të saj në radhët tona që, pos eliminimit tonë fizik, të godasë rëndë edhe radhët tona pastaj duke futur përçarje e dyshim, duke synuar që vendet tona t'i zënë njerëzit e saj."* (Atentatet, f. 321)

Në librin *Atentatet*, Ibrahim Kelmendi, i mësuar me pluhurin rreth bisedës telefonike, i bënë disa etiketime të veçanta, me fjalë të shkruara prej tij, për gruan e Kadri Zekës dhe shton se kam folur keq dhe kam fajësuar të tjerët për rrethimin e Vëllezërve Gërvalla, që automatikisht do të pasonte rrjedhimi se me këtë kam nënçmuar dhe harruar në këtë mënyrë të gjithë punën e Jusufit dhe Bardhoshit prej momentit të shkeljes së Jusufit në tokën gjermane e deri në momentin e vrasjes.

4. Kujt i takon merita?

Pra përveç luftës së "detektivëve" për zbulimin e vrasësve dhe fajtorin për vrasjen, po aq, në mos edhe më e egër e më dinake është lufta se kujt do t'i takoj "merita" për vrasjen e Jusufit në pragun e derës së shtëpisë së vetë pranë gruas dhe fëmijëve të vetë. Këtë lojë e këtë kartë e luan edhe ish-inspektori i UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica, i cili thotë se *merita* për vrasjen e Jusufit i takon atij dhe jo shefave të tij, sepse UDB-a e ka pa që Jusufi mund të bëhet shumë më i rrezikshëm vetëm e vetëm nëse ai (Jusufi) futet nën tutelën "komuniste" të ish-inspektorit të UDB-së Serbe se sa nën tutelën e komunistëve tjerë hegjemon.

Abdullah Prapashtica (ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Kështu Lëvizja për Pavarësinë e Kosovës në fazën e vet përfundimtare, u krijua me iniciativën e Partisë Komuniste MLSHJ e cila ju bëri thirrje për bisedime për bashkim LNÇKVSHJ dhe OMLK. Këto thirrje për bisedime me shkrim ju drejtuan Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës që gjendeshin në Evropë, përmes të Sabri Novosellës që në atë kohë gjendej në Adapazar të Turqisë. (...) Sipas të gjitha gjasave fillimi i këtyre bisedimeve për bashkim nuhatet nga regjimi titoist dhe për te e penguar realizimin e bashkimit ton, Beogradi zyrtar jep urdhër UDB për vrasjen e Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës ne Gjermani."* (DËSHMI E NJË NGJARJE HISTORIKE, 17 shkurt 2008, http://kosova.albemigrant.com)

Këtë taktikë e luftën për ta marrë mbi vete 'meritën' për vrasjen e Jusufit e luan edhe vetë I. Kelmendi, nipi i UDBashit me zile, por jo në cilësinë e informatorit të UDB-së (për të cilat dyshime të bazuara është përjashtuar nga shtëpia e Jusufit rreth 15 marsit 1982) por si person që e ka *bashkuar organizimin e vetë me organizimin e Jusufit në një organizim.* Vetëm pas kësaj UDB-a e ka hetuar se Jusufi është i pathyeshëm.

Ne shokët e Jusufit nuk kemi akuzuar asnjë individ apo organizatë shqiptare dhe çka është kryesorja "*meritën"* për vrasjen e Jusufit, vrasje e cila është rezultat i duelit të Jusufit me UDB-në e Beogradit, nuk ia falim dhe as nuk ia shesim në treg askujt, sado djallëzore që të jenë planet e tyre, sado e tmerrshme aq edhe e mjerë të jetë etja e tyre për të bërë histori në kurriz të të tjerëve, sado e tmerrshme të jetë djallëzia, renegatizmi e metamorfoza e atyre që kanë mbetur pa histori.

SI MË NJOFTOI UDB-a PËR VRASJEN E JUSUF GËRVALLËS?!

Ibrahim Kelmendi: *"Papritmas erdhi një polic që e njihja dhe më dha lajmin për atentatet."* (Atentatet, f.342)

Në fillim të vitit 1978, shokët e Organizatës, Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, e cila ka vepruar në fshehtësi, në komunën e Vushtrrisë, më kanë propozuar që të anëtarësohem në Lëvizjen konkrete, me emrin konkret 'Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Këta shokë të Jusufit (edhe pse nuk e kanë ditur në atë kohë se janë në të njëjtën organizatë me Jusufin, edhe pse nuk e kanë ditur se kanë fatin të jenë në një Organizatë me Jusufin) kanë menduar se unë mund të kontribuoj për të mirë në këtë Lëvizje konkrete. Edhe unë kam besuar sikur ata dhe e kam pranuar propozimin e tyre. Duke pasur parasysh kushtet e veprimtarisë në ilegalitet të thellë mund të thuhet se nuk ka ekzistuar mundësia që unë ta kërkoj rrugën deri tek Organizata e Jusufit, por ka ndodhë e kundërta, ajo më ka gjetur mua.

Në vjeshtën e vitit 1979 kam marrë pasaportën në Mitrovicë. Kah fundi i vitit 1979 në Kosovë bëhen arrestime të disa anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit, por jo edhe të atyre me të cilët unë kam pas lidhje direkte, andaj nuk kam pas nevojë për ndonjë shqetësim direkt për personin tim. Jusufi arratiset nga Kosova dhe më 21 dhjetor 1979 mbërrin në Shtutgart.

Përafërsisht në të njëjtën kohë, në të njëjtën javë, për arsye krejtësisht private, në bazë të lidhjeve familjare, e me iniciativën e kësaj lidhjeje, kam bërë udhëtimin e parë jashtë shtetit, dhe kam qëndruar pjesën kryesore të pushimit shkollor-dimëror 1979-1980 në Berlinin Perëndimor, pa përjashtuar as shëtitjet në Berlinin Lindor. Për këtë rrugë të gjitha shpenzimet i ka paguar personi i farefisit tim i cili ka punuar në Berlin. Poashtu në bazë të lidhjeve familjare, në pushimet verore të vitit 1980 kam punuar në Zvicër.

Në janar të vitit 1981, me kërkesën e dy shokëve të Lëvizjes së Jusufit, me të cilët kam pas kontakt, (Sheremet dhe Ismet Saraçi) kam udhëtuar për në Stamboll për ta takuar Sabri Novosellën. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi m'i kanë paguar dy shokët që më kanë dërguar, të cilët kanë punuar si arsimtarë në një shkollë fillore. Sabri Novosellën e kam takuar në banesën e Tefik Strajës. Pa u zgjeruar shumë me këtë rast, dua të them se Sabriu e ka marrë vesh nga unë ekzistencën dhe botimin e revistave „Lajmëtari i lirisë“ dhe „Liria“. Edhe pse ia kam përmend se në Kosovë flitet shumë për Jusuf Gërvallën, Sabriu nuk më ka thënë se Jusufi është i organizatës tonë, apo se fare e njeh. Pas qëndrimit disa ditësh në Stamboll, para se me u nda, Sabriu ma ka dhënë numrin e telefonit të banesës së vetë në Adapazar.

Pas kthimit tim nga Stambolli, pas rreth dy muajve filluan ngjarjet historike të Pranverës 1981. Dhuna policore, ndjekja e aktivistëve të organizatave politike dhe ngjarjet që u zhvilluan lanë gjurmë të ashpra tek unë. Duke pasur parasysh veprimtarinë time modeste në Kosovë dhe shqetësimin e madh psikik, i cili nuk ishte në proporcion me punën time, në marrëveshje edhe me shokët që kisha kontakt, në qershor 1981 shkova tek të afërmit e mi në Zvicër, për të punuar, ashtu siç kisha bërë një vit më parë. Me vete e kisha numrin e telefonit të Sabriut. Pas disa ditësh e kam thirrur në telefon dhe i kam treguar se jam në Zvicër. Në bisedën e parë, Sabriu ma ka dhënë numrin 0049714126091, i cili ka qenë numri i telefonit të zyrës së Bardhosh Gërvallës në Ludwigsburg, në Solitudestrasse 44, dhe më ka thënë që të merrem vesh me Bardhin dhe të shkoj në Shtutgart.

Rreth, apo pikërisht më 17 korrik 1981 kam marrë trenin nga Zurichu për në Shtutgart. Jusuf Gërvallën, Bardhin, familjet e tyre dhe Naim Haradinajn për herë të parë në jetë i kam takuar më 17 korrik 1981. Përkundër argumenteve të pakta, unë pata menduar se në Shtutgart pas ndonjë jave do të kërkoj azil. Këtë ide timen Jusufi e ka hedhur poshtë menjëherë. Jusufi, jo vetëm mua, por nuk e ka lejua asnjë shokë të vetëm të vetin të kërkoj azil, duke përfshi edhe ata që kanë pas argumente shumë më të fuqishme e solide se unë. Me ndihmën e Bardhit dhe Haxhi Berishës, pas disa ditësh kam filluar punën në një fabrikë.

Për punën time me Jusufin në kuadër të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi nuk po zgjerohem. Para shokëve të tij, Jusufi më ka prezantuar me emrin Skender. Pos Jusufit, Bardhit e gruas së Jusufit - Suzanës, vetëm Haxhi Berisha nga Prapaqani e ka ditur emrin tim të vërtetë. Duke pas parasysh mbrojtjen e identitetit tim para të tjerëve nga ana e Jusufit dhe e imja, të dhënat se policia nuk më ka kërkuar gjatë muajve sa nuk kam qenë në fshatin tim të lindjes si dhe nevojat e Lëvizjes së Jusufit pas fillimit të botimit të revistës, me presionin dhe me insistimin tim, jam nisë për në Kosovë, rreth 10 dhjetorit 1981. Kjo rrugë është rruga e vetme (e para dhe e fundit) që e kam bërë për në Kosovë pas njohjes me Jusufin e për të gjallë të Jusufit. Këtë rrugë e kam bërë për t'i shërbyer Jusufit. Këtë rrugë dhe të gjitha shpenzimet rreth saj m'i ka paguar Jusufi. Për në këtë rrugë Jusufi më ka përcjellë deri në Munchen, së bashku me djalin e madh të Smajl Haradinajt nga Gllogjani, Naimin. Udhëtimin tim në Kosovë, Jusufi e komenton në letrën e tij të fundit që ia dërgon Sabri Novosellës, më 14 janar 1982.

Jusuf Gërvalla: "*Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e Shpendit, për të mos thënë me presionin e tij, Shpendi shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri. Së andejmi u paraqit disa herë në telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm, a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982)



Shaban Klaiqi, shok i orëve të para i Jusuf Gërvallës

Një nga detyrat e mia me udhëtimin ka qenë ta pranoj numrin e parë të "Zërit të Kosovës", në Slloveni, sipas kohës dhe instruksioneve që do t'i merrja nga Suzana, gruaja e Jusufit, pas thirrjeve të mia që do t'i bëja në telefonin e fqinjës së tyre të parë gjermane. Për këtë kam udhëtuar, (pasi kam mbërri së pari në Kosovë), vetë i dyti në Slloveni. E kam thirrur Suzanën në telefon dhe ajo më ka thënë të largohem menjëherë nga Sllovenia pasi ata që kanë pas me e sjellë gazetën janë zënë nga policia jugosllave (bëhet fjalë për arrestimin e veprimtarëve

Shaban Klaiqi e Islam Rafuna: Lexoni "Si u dënuan Shaban Klaiqi e Islam Rafuna për Zërin e Kosovës" në www.pashtriku.org). Pasi jemi kthyer në Kosovë së bashku me Bahtir Haradinajn, pas një nate apo dy, Televizioni Shqiptar e komunikoi lajmin e „vetëvrasjes" së Mehmet Shehut. Lajmi i „vetëvrasjes" së tij ka qenë lajm shumë i rëndë për ne që i kishim sytë e zemrën të kthyer nga Shqipëria.

Gjatë ditëve në vijim jam angazhuar me të gjitha aftësitë e mia të merrem me detyrat tjera që kisha marrë nga Jusufi.

Pas mesit të janarit 1982, një mëngjes, kemi dalë së bashku apo e kemi lënë të takohemi në Prishtinë (kjo nuk më kujtohet me saktësi), me Asllan Muharremin, i biri i Behram Muharremit nga fshati Mihaliq, komuna e Vushtrrisë, i cili tani jeton me familjen e tij në periferi të qytetit Malmö, në jug të Suedisë. Kemi shkuar në Qendrën e Rinisë dhe kemi zënë vend në një kafe. Derisa unë isha ulur për të porositur kafet, Asllani shkoi në një kioskë të afërm për me e ble „Rilindjen". Pas disa minutave erdhi Asllani dhe më thotë se ka lexuar një lajm shumë të keq në „Rilindje", duke ma dhënë gazetën të hapur në faqen ku ishte lajmi, në të cilin lexova me sa vijon:

konstatua parimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve tradicionale miqësore ndërmjet Holandës dhe Jugosllavisë. Në këtë kontekst u bë fjalë për bashkëpunimin e parlamenteve të të dy vendeve dhë për mënyrat q[illegible] ai të përparojë më tej.

arabëve për t'u ballafaquar me Izraelin në rast se Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara» «nuk ndërmerr kurrfarë aksioni kundër Izraelit». Ai theksoi se vendimi për aneksimin e Rrafshnaltës së Golanit është ilegjitim.

RILINDJA

DEL ÇDO DITË

VITI XXXVII—NUMËR 8193
Drejtor ASLLAN FAZLIU
Kryeredaktor përgjegjës MAKSUT SHEHU
E REDAKTON KËSHILLI REDAKTUES
TELEFONAT
Centrali: 22-666 dhe 28-611
Drejtori 24-571, Kryeredaktori 24-859
Zv. kryeredaktori 27-002
Rubrika e brendshme 28-605, Rubrika e kulturës 28-036,
Rubrika e sportit 29-606
Shërbimi i korrespondencës dhe i stenografisë 23-184, 28-606
Shërbimi komercial 26-156
SHËRBIMI I TIRAZHEVE 28-[illegible]5
TELEXI 18-163 YU RILIND
LLOGARIA RRJEDHËSE E REDAKSISË
68400-603-4127 pranë Kontabilitetit shoqëror Prishtinë
PARAPAGIMI: Për 1 muaj 135 dinarë, për 3 muaj 405 din. për 6 muaj 810 din. për 1 vit 1620 dinarë.
Për botën e [illegible]shtme: ÇMIMET DYFISHOHEN
Të hollat e parapagimit dhe të hollat për shpalje dërgohen në: LLOGARINË RRJEDHËSE: 68400-[illegible]3 SHKSH — Prishtinë.
Kërkesat për parapagim dërgohen në këtë adresë:
Shërbimi Komercial OPGBG «RILINDJA» Pallati i Shtypit — Prishtinë
Dorëshkrimet nuk kthehen

NË RF TË GJERMANISË

U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia, i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se «fjala është për krim me prapavijë politike», sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë «rryma» dhe «grupacione».

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rreptë vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se «qeveria shpreh kequrdhje për shkak të përleshjeve të tilla.»

Në RF të Gjermanisë

U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë

politike", sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rrept vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla.

Kjo është mënyra se si dhe kur jam njohur me Jusuf Gërvallën. Ky lajm i botuar në Rilindje, nga UDB-a, apo thënë më konkretisht nga sponsori medial i veprave të UDB-së, TANJUG-u, ishte mënyra se si u njoftova për vrasjen e Jusufit. Jo vetëm mua, por në këtë mënyrë UDB-a u përpoq ta informoj gjithë opinionin shqiptar e botëror, sikur të mos ishte këmbëngulja e pathyeshmëria e pafund e Jusufit dhe mospranimi i Tij për të hyrë në sallën e operacionit para se ta jep një deklaratë para policisë, në spitalin e Heilbronit.

Pasi leximit të këtij lajmi si kam mbërri me u përgatitë mirë në rrethanën e parë jam nisë nga Fushë-Kosova për në Shtutgart dhe në Untergruppenbach kam mbërri më 21 janar 1982, në orën e fundit (rreth orës 14.00) kur firma e varrimeve i kishte sjellë kufomat në shtëpi të Jusufit, në mënyrë që familja dhe shokët të bënin përshëndetjet e fundit. Para arkivoleve me trupat e të vrarëve kam qenë i vetmi që e kam mbajtur një fjalim.

Të shtunën më 23 janar 1982 është bërë një demonstratë në Shtutgart për të cilin e kam shkrua fjalimin "Emrat tuaj, flamuj një beteja" (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 8.).

Në javët, muajt dhe pikërisht në tri vitet në vazhdim, pra nga Janari 1982 deri në Janar 1985 kam bërë udhëtime tjera në shërbim të vazhdimit e përjetësimit të veprës së Jusufit, shtytjes së luftës përpara. Udhëtimet në vazhdim, shumicën absolute të tyre, i kam bërë së bashku me shokët e Shtutgartit, e nganjëherë edhe vetëm, por edhe në këto raste gjithmonë kam udhëtuar vetëm atëherë kur kam pasur përkrahjen, ndihmën dhe kërkesën e këtyre shokëve.

AMANETI I JUSUF GËRVALLËS

1. A e pe vrasësin? - E pashë por nuk e njofta.
2. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Jusufit në orët e para pas atentatit
3. Interesimi i Peter Platzmanit
4. Siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë
5. Ishte njeriu të cilin me padurim po e prisnin
6. Udhëheqjen e organizatës e mori në mënyrë misterioze
7. Suzana ma prezantoi si "zëvendës" të Jusufit
8. Sirtari im

9. Skedari im
10. Që më se paku i shkonte një trashëgimtari të Jusufit
11. Që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit
12. Ishte përcaktuar t'i përmbahej hierarkisë organizative
13. Ne kemi marrë vendime me rëndësi
14. Të rrahurat e makinës së shkrimit dëgjoheshin përgjatë gjithë korridorit
15. Letra e Jusufit nuk ka përmbajtje aktuale
16. Midis jush nuk kam si hyj
17. Edhe më shumë neveriteshin
18. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha
19. Ajkuna e thërriste Miranin pranë saj
20. Ajo i merrte duart e Miranit në duart e saja
21. Varrimi i Yjeve të pashuara të qiellit shqiptar
22. Shkolla e UDB-së dhe amaneti i Jusufit
23. Varrim madhështor
24. Trajtimi i OMLK-së në shtëpinë e Jusufit

1. A e pe vrasësin? - E pashë por nuk e njofta.

Nuhi Sylejmani*: "„Nuhi, a je ti?"– Ishte Suzana, e shoqja e Jusuf Gërvallës.*
„Po. Unë jam Nuhiu!" – iu përgjigja.
„A dëgjove se ç'më gjeti?"
„Po... A ka shpëtuar ndonjëri?" – e pyeta.
„Jo!"
„Mbahuni të fortë... ja tani po marr leje dhe menjëherë po vij!"
„Jo, tash për tash mos eja... shtëpia është e mbushur plot me policë... edhe ne ndodhemi jashtë! Dikur më vonë..." – tha me zë të përvajshëm dhe e mbylli telefonin." (Vrasja e trefishtë, f.70)

Sabri Hamiti*: "DONA, e përmalluar -E mandej përqafimi i fortë. Është shurdhuar flauta ime në Prishtinë. Ka vdekur gitara e babait atje. Muzika ka vdekur në Prishtinë përgjithmonë." (Misioni, faqe 108)*
Faridin Tafallari: *"Po i afroheshim Untergruppenbachut; doli para nesh tabela dhe mua m'u rrënqeth shtati...*
...Jashtë pash Premtonin që kishte dalë të na priste në një rrugë të fshatit Untergruppenbach...
Dëgjova muzikë*; e shikova Suzanën: "Po Faridin, po, kështu na e la Jusufi me gojë: Armiku do të kënaqet po të na qani."*

Suzana filloi të më tregoi se si kishte ndodhur ngjarja.
Suzana: Pas krisjes së armëve në garazh ne arritëm vonë. Kur vajtëm në garazh Bardhi dhe Kadriu kishin vdekur. Jusufi ishte mbrapa në ulëset e makinës; ishte gjallë dhe e mbante dorën te vendi ku e kishte marrë plumbi. Unë ju afrova. Sapo ju afrova më tha:
Jusufi: Oj Suzanë, po Bardhi dhe Kadriu a janë gjallë?
Suzana: Po, po, i thashë.
Jusufi: Ah, jo jo, - ata kanë vdekur!
Dhe e vërteta ishte ashtu.
Suzana: Jo ata janë gjallë!

Faridin Tafallari, vëllezërit e Kadri Zekës dhe Nami Ramadani, më 21 janar 1982 duke përshëndetur të vrarët. (Foto nga arkivi i Faridin Tafallarit)

I thash prapë edhe pse Bardhi kishte vdekur te timoni i makinës dhe nuk lëvizte. Poashtu edhe Kadriu, por unë për të mos e shqetësuar Jusufin i thash se ishin gjallë.

Jusufi: *Po pse nuk po flasin? Pse nuk po lëvizin?*
Suzana: ***A pe ndonjë njeri?***
Jusufi: ***Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****. (Terror Dhimbje Qëndresë, f. 52)*

Suzana Gërvalla: "*Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e* ***TË CILËN E PUNOVA UNË ME KËTO DUAR*** *pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

Materialet që Jusufi ia lenë amanet Suzanës është pikërisht numri i dytë i "Zërit të Kosovës" i cili porsa kishte dalur nga shtypi. Në kryeartikullin e tij, në faqe 2 shkruan:

Jusuf Gërvalla: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e arrivizmit revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh megalomanë*** *(*fjalët i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij-shën ynë*), dhe* ***ato që janë organizuar prej elementesh të dyshimta****, (këto fjalë i drejtohen ish inspektorit të UDB-së Abdullah Prapashtica si gënjeshtar skandaloz lidhur me organizimin e demonstratave, i cili kishte dalë me i bashkua organizatat se nuk i paska ra ndërmend kujt kjo punë përpara këtij ish inspektori - shën ynë) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë." (Zëri i Kosovës" nr. 2 janar 1982)*

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Nr. 2 Janar 1982

Ky është materiali i shpërndarë tek shokët e me të cilin bodrumi është plot

2. Lëvizja Nacionalçlirimtare e Jusufit në orët e para pas atentatit

Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, LNÇKVSHJ, përkundër faktit se plumbat e vrasësve profesionist të UDB-së ishin të drejtuara kundër anëtarëve të saj, kundër udhëheqjes së saj, kundër Kështjellës së saj të paharruar në Habichthöhe, kundër familjes së Vëllezërve Gërvalla e pragut të derës së shtëpisë së tyre, falë organizimit të qartë që e kishte lënë Jusufi me shokët e tij, të cilët ishin betuar e ribetuar para tij më 7 dhjetor 1981, tani në orët e para të 18 janarit organizohen shpejt dhe veprojnë si orë e mirë.

Xhafer Shatri: *"Pas rënies së tyre në popull u krijua një indinjim i pakufishëm* ***e mjerisht edhe një huti e palejueshme****."* (verë 1983)

Është interesant se si megalomanët e papërmirësueshëm edhe pse të hutuar e pa krye nuk munden me u përmbajtur nga lakmia për t'u përzier në punët e organizatave tjera dhe hutinë e vet me djallëzi t'ua shesin të tjerëve, se si këta megaloman nuk heqin dorë nga shqetësimi se kujt i ka mbetur zotshpillaku në shtëpitë tjera dhe në organizatat tjera.

Në orët e para, në momentet e para e thërrasin shokun e Jusufit, eprorin e Jusufit, i mbështeten pikërisht atij që është dashtë dhe me të cilin është konsultuar

Jusufi përpara, Sabri Novosellës në Adapazar. Sabriu, pasi i merr informatat e nevojshme për shokët më të afërt të Jusufit e të Lëvizjes në Shtutgart jep udhëzime pikërisht ashtu siç duhet. E cakton njeriun më të moshuar dhe ndër aktivistët më të dalluar të rrethit të Jusufit, Nuhi Sylejmanin nga rrethi i Kumanovës që të jetë ai i cili do t'i pres e do t'i përcjell bashkëluftëtarët, bashkatdhetarët, shokët, mysafirët gjatë ditëve të ngushëllimit që do të pasonin. Nuhi Sylejmanit i bien detyra e pritjes së mirë të miqve, shokëve, bashkëluftëtarëve, për të cilët shtëpia e Jusufit e atmosfera e saj kanë qenë po aq e ngrohtë për ta sa edhe banesat e konviktet e tyre. Bashkëluftëtarët e shokët e Vëllezërve Gërvalla, të Jusufit, të gjithë ata të cilët kanë qenë aq të vetëdijshëm se çfarë vendi kanë pasur në zemrën e Jusufit, nuk e kanë pasur të vështirë të vendosin se në cilën pjesë të sallonit të ulen apo të presin dikush t'ua tregoj vendin se ku duhet të ulen. Në emër të familjes së Jusufit, në emrin e fëmijëve e bijve të mitur të Jusufit dalin nipi i Jusufit Haxhi Berisha nga Prapaqani, dhe Naim Haradinaj nga Gllogjani, të cilin baba i tij Ismail Haradinaj e kishte lënë nën kujdesin dhe për t'i ndihmuar Jusufit. Nga mesi i punëtorëve për të gjitha punët praktike aq të shumta, barra më e rëndë bien mbi Faridin Tafallarin, e pastaj Nami Ramadanin, Remzi Ademajn e Mejdi Rexhën etj. Në këtë gjendje, kur prej të gjitha anëve, bashkëluftëtarët ia mësyjnë Untergruppenbachut, në Habichthöhe, i gjejnë shokët e Jusufit dhe të Lëvizjes së tij në detyrat e tyre. Në këtë gjendje, pas kryerjes së atentatit prej vrasësve profesionist, kur UDB-a u jep detyrë informatorëve të vetë që të mbledhin informata se kush e ka uzurpua zotshpillakun në shtëpinë e Jusufit e Lëvizjen e Jusufit, këta shokë përpiqen dhe ia dalin me sukses të plotë që t'u ndihmojnë dhe t'ua lehtësojnë këtyre informatorëve misionin e tyre.

Në këtë gjendje, në mesin e qindra vetave që ishin në rrugë drejt Habichthöhe isha edhe unë, në një tren që ishte nisur prej Kosovës duke kaluar në mes fushash, malesh, urash e tunelesh.

3. Interesimi i Peter Platzmanit

Në këtë ditë të rikthimit në Untergruppenbach, të enjten më 21 janar 1982 rreth orës 14.00, për herë të parë në jetë e kam takuar Ibrahim Kelmendin. Por para se ta takoj e të ndërroj ndonjë fjalë me te, të gjithë shokët e Jusufit, pa asnjë përjashtim më kanë treguar se si Ibrahimi ka qenë me ta në natën e të shtunës dhe paraditën e të dielës dhe se dyshojnë në te se është i implikuar në ndonjë mënyrë në këtë atentat. Të gjithë këta shokë të betuar para Jusufit, më kanë pritur me gëzim. Këtë e dëshmojnë më së miri ata që kanë ardhur jo për ngushëllime, por për të raportuar se kujt i ka mbetur zotshpillaku në Habichthöhe, në këto ditë të dhembjes së madhe. Pos tjerash fjalët e Haxhi Berishës dhe Naim Haradinajt kanë qenë: Ibrahim Kelmendi, çdo punë e iniciativë që e fillojmë mundohet me na e mbytë e sabotoj që në fazën e propozimit me çdo lloj preteksti, ndërsa në anën tjetër ai vetë nuk del me asnjë iniciative për të bërë ndonjë punë. Andaj gëzimi i tyre ka pasur të bëjë sidomos për faktin se unë këtij sabotimi që në hapin e parë do t'i jepja fund.

> Faridin Tafallari: *"Xhafer Durmishi erdhi tek Jusufi dhe Jusufi e donte, se ai ishte besnik. Ne e mirëpritëm dhe e nderuam, se e la Jusufi, por ama nuk e la për trashëgimtar, se ai nuk besonte, se një ditë do ta ndalte hovin drejt veprës së tij të madhe."* (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, f. 303)

Në atë ditë e në ato çaste, posa firma e varrimit i mori kufomat nga shtëpia, Nuhi Sylejmani e nisë këtë bisedë:

Nuhi Sylejmani:	Peter Platzmani dëshiron me folë me ty. Unë e dija se ai ishte kryetar i Shoqatës së miqësisë Gjermani-Shqipëri, por nuk e njihja dhe ai nuk më njihte.
Xh. Durmishi:	Unë nuk e njoh personalisht dhe nuk di se çka i nevojitem.
Nuhi Sylejmani:	Peteri më pyeti se kush është ai shok i Jusufit, i cili do ta vazhdoj Zërin e pavdekshëm e të përjetshëm të Jusufit e do mbaj të ndezur stafetën e Jusufit në këto çaste, e unë duke e ditur betimin e bërë më 7 dhjetor 1981, i thash prit se tani ta sjell. Kështu qëndron puna.

Atëherë, edhe pse isha i befasuar me këtë rrethanë unë e Nuhiu shkuam pranë Peter Platzmanit, ku Nuhiu më prezantoi.

P. Platzman:	Kisha dashur të dijë nga ti këtë gjë. Nuk dua të pyes se kush do t'ia zen vendin Jusufit, pasi kjo pyetje është tepër e komplikuar dhe e pavend bile edhe absurde në këtë rast. Ajo që dua të di është kjo; Ju shokët e Jusufit, e në mesin e tyre edhe ti, luftën që do ta bëni në vazhdim në bazë të aftësive tuaja, a do të jetë ajo në atë rrugë e në atë frymë që e ka shtruar e ndjekur Jusufi?
Xh. Durmishi:	Ne do ta ndjekim atë rrugë sipas aftësive tona.
P. Platzman:	Dhe nuk ke fije dyshimi në këtë pikë?!
Xh. Durmishi:	Asnjë fije dyshimi. Për këtë të jesh i sigurt.

Peter Platzmanit m'u duk se i erdhi mirë nga fjalët e mia, më shtrëngoi dorën dhe u largua. Vlen të përmendet se Peter P. e dinte shumë mirë shqipen dhe kjo bisedë u bë në gjuhën shqipe.

Duke pasur parasysh gjendjen shumë të rënd të krijuar pas atentatit dhe mospërvojës tonë në çdo pikëpamje, unë dhe Haxhi Berisha pas disa ditësh kemi udhëtuar në Dortmund për ta takuar Peter Platzmanin. Peterin e kemi pyetur kryesisht si të sillemi ndaj policisë e cila vazhdimisht vinte ato ditë në shtëpinë e Jusufit si dhe ia kemi shprehur dyshimet tona për Ibrahim Kelmendin. Ai na i ka dhënë disa këshilla të përgjithshme dhe na ka thënë se ato dyshime që i keni në Ibrahim Kelmendin nuk kanë baza të mjaftueshme në fakte. Por na ka thënë duhet ta keni shumë parasysh se policia gjermane din shumë më tepër gjëra se sa ju. Rrugën për në Dortmund na e ka paguar Suzana.

Është interesant të lexohet mendimi i Shkollës së UDB-së Serbe, i shkruar më 2010 lidhur me kthimin tim nga Kosova në Habichthöhe 40, lidhur me këto momente të 21 janarit 1982 rreth orës 14.00.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Me Skënder Skënderin (Xhafer Durmishin-shën im) isha takuar **vetëm njëherë** në familjen Gërvalla**, në shtator të vitit 1981, në** prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës" të Jusufit! "Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva Suzanës, se Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk **ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin**. Suzana më sqaroi se Skënderi ishte i dërguar i Mërgimit, i cili ishte udhëheqësi i ynë, dhe se pa urdhrin*

dhe lejen e tij ne nuk guxonim të merrnim asnjë vendim. Pas këmbënguljes sime për të marrë vesh se kush fshihej pas pseudonimit Mërgimi, ajo më tregoi se ishte Sabri Novosella." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 88)

Të shtunën më 23 janar 1982 është bërë një demonstratë në Shtutgart për të cilin e kam shkrua fjalimin "Emrat tuaj, flamuj një beteja" (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 8.).

4. Siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë

Suzana (Drita), gruaja e Jusufit i jep shpjegime I. Kelmendit se çka kanë bërë në orët e fundit Jusufi e Kadriu. Gjithashtu Suzana tregon se Jusufi, i thyer moralisht e shpirtërisht, ka besim e intimitet më të madh me këndellësin, me figurën frontale të Frontit të pagëzuar nga UDB-a dhe me Kadri Zekën, se sa me te (pra me Suzanën).

I. Kelmendi*: "– Pasi shkuat ju, – filloi Drita, – Jusufi e shoku Kadri u ngujuan në dhomë të punës. Nuk kanë dalë derisa i kam thirrur të hanë darkë. Jusufi më porositi që ta vonojë darkën. Disa herë kam hyrë sa për t'u çuar çaja,* ***por, siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë.*** *Në tavolinë kishin fletë shënimesh, por ato tani i ka marrë policia."* (Atentatet, f.338)

Suzana Gërvalla: "*Ne me të vërtetë këtu kemi shoqëri të re dhe përkrahje të madhe por mendët i kemi atje te ju te varrezat e Shtutgardit, se atje i lam ata ma të afërmit. E tash nuk dimë as si duken varrezat e tyre, spati kush me na que asnjë fotografi prej atjehit. Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e* ***TË CILËN E PUNOVA UNË ME KËTO DUAR*** *pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi."* (Raport Lëvizjes në Turqi, korrik 1981)

Pra faktin se Jusufi ka pas biseda më të ngushta e më të besueshme me Kadri Zekën e I. Kelmendin (nipin e dajës Ramë, mercenarin e letrës së 20 gushtit 1981) se sa me gruan e vet, sipas I. Kelmendit e pranon Suzana me gojën e vetë. Pasi në praninë e Suzanës Kadriu e Jusufi **'nuk flisnin gjë'** shtrohet pyetja se në çfarë gjuhe memecësh janë marrë vesh me te kur kanë pas nevojë për çaja e kafe.

Shtrohet pyetja me kend ka folë Jusufi kur ka ardhë Kadri Zeka për përgatitjen e numrit 3 të Lirisë në maj 1981. Kush e ka bërë përgatitjen grafike të numrit 3, e 4-5 të Lirisë. Kush i nisi Hasan Malën e Haxhi Berishën për Kosovë me mijëra ekzemplarë të Lirisë në distancë të sigurt nga figura frontale e Frontit të UDB-së? Ishte pikërisht gruaja e Jusufit Suzana.

Këto përralla e këto 'dëshmi' I. Kelmendi mundet me i shitë aty ku i shiten, pra aty ku e ka pasë organizatën, vendin, në OMLK - në Frontin e saj, për të gjallë të Kadri Zekës, e tek shokët e tij pas vdekjes deri në ditët e sotme.

Shqyrtimin e plotë të këtij far "argumenti" se "***por, siç e di edhe ti, në praninë time nuk flisnin gjë"*** do ta shohim më vonë.

Faridin Tafallari: *"Suzana: **A pe ndonjë njeri?***

*Jusufi: **Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot**." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)*

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu **deri në çastin e vdekjes**."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

5. Ishte njeriu të cilin me padurim po e prisnin

Përshtypja e takimit të parë të I. Kelmendit me Xhafer Durmishin (Skenderin e Shtutgartit), më 21 janar 1982, në shtëpinë e Jusufit, kur firma e varrimit kishte sjellë kufomat e Jusufit e Bardhit, në mënyrë që të afërmit e familjes dhe shokët të përshëndeteshin për herën e fundit.

I. Kelmendi*: "Të mërkurën nga Kosova erdhi Xhalat D., i cili njihet vetëm me emrin Xhafari. **Ishte njeriu të cilin me padurim po e prisnin Drita dhe disa të tjerë**.*

> Jusuf Gërvalla: *"Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët. **Kështu e pata kuptua më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit - shën im) dhe timen në KQ (Komitet Qendror-**shën im.)"(*Letër S.N., 14 janar 1982)

Atë po e prisnin që të zinte vendin e Jusufit në organizatë.** Ardhja dhe paraqitja e parë e tij qe tepër zhgënjyese, sepse ai stononte gjithanshëm sa të bënte të ndiheshe i neveritur nga paraqitjet e tij, sidomos nga zëri i tij shterrak. Xhafari, **duke qenë i kompleksuar

> I. Kelmendi*: "Përpara e **VUANTE** përgjegjësinë për botim të* Bashkimit*, meqë vlerësonte vetën se nuk ishte kompetent për t'i dalë zot asaj përgjegjësie."* (Atentatet, f.288)

***për të metat e tij natyrore**, ndjeu eufori për rolin që po merrte. Parapëlqeu të rrëfente se sa rëndë e kishin goditur atentatet e shokëve."* (Atentatet, f.341-342)

*"Kërkesa e shumëpritur për sjelljen e kufomave në familjen Gërvalla për lamtumirën e fundit, u realizua më **21 janar 1982, rreth orës 14:00"***. (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.83)

Faridin Tafallari*: "Nuk mund ta përshkruaj çastin, kur trupat e TRIMAVE i futëm në dhomë, një dhembje dhe tronditje e madhe! Nuk ishte e lehtë aspak, të shihje tre shokë, tre udhëheqës të vrarë, të goditur pabesisht nga armiku dhe tradhtarët, natën, në pragun e derës së shtëpisë..... I përshëndesnim me grushtet lart dhe betoheshim para trupave të tyre, se rrugën e nisur, do ta vazhdonim, ashtu, siç na kishin mësuar ATA...Erdhi Xhafer Durmishi....i përshëndeti tepër i mallëngjyer me grushtin lart dhe*

*me një fjalim burrëror. Që nga ai moment Xhaferi nuk do të ndahesh prej nesh." (*Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 65-66)

6. Udhëheqjen e organizatës e mori në mënyrë misterioze

Për këto çaste vlen të merren parasysh edhe mendimet e Abdullah Prapashticës dhe Osman Osmanit, të vendosura në mendjen e Nuhi Sylejmanit.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi. Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim, kur dihet se Sabri Novosella (Mërgimi), emigrant në Turqi, asnjëherë nuk e kishte marrë mundimin për riorganizimin e LNÇKVSHJ-së, por e kishte krijuar (apo ishte kyçur) në një organizatë krejt tjetër, të quajtur „Komiteti Hasan Prishtina". Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë drejt dobësimit apo shuarjes totale."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.124)

Si është e mundur që kjo Suzanë, grua e Jusufit, e cila pak më lartë e pranon se afërsia e punës së Jusufit me I. Kelmendin është aq e madhe sa gjëra që i ka biseduar ai me I. Kelmendin e Kadri Zekën nuk i ka biseduar kurrë me te, të harroj çka thotë pak më heret dhe ta pret me padurim, së bashku me disa të tjerë, Xhafer Durmishin apo Skenderin e Shtutgartit, që ta zenë vendin e Jusufit në organizatë.

Prapë shtrohet pyetja: Shokët e Jusufit, në shtëpinë e Jusufit, ata që e kanë njohur më së miri dhe që kanë bërë për te më së shumti, Remzi Ademaj, Haxhi Berisha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani, Naim Haradinaj etj. a kanë pas aso qëndrimesh dhe asi karakteri sa me të vërtetë kanë menduar se Jusufi e ka lënë një vend që mund të zihet, një boshllëk që mund të mbulohet në përgjithësi apo nga Skënderi i Shtutgartit në veçanti?

Pyetje tjetër: *"...që ta zenë vendin e Jusufit në organizatë*." Në cilën organizatë më konkretisht apo në cilin organizim? Vetëm e vetëm në Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, pra në Lëvizjen e pashuar të Jusufit, të yllit të pashuar apo në ndonjë organizatë tjetër, të shuar, të pushuar apo të ngrirë si p.sh. në Frontin i Kuq Popullor, në Frontin e OMLK-së, në Partinë "Komuniste" të Shkollës së UDB-së, etj.

Nëse fjala është vetëm për Lëvizjen e pashuar dhe të përjetshme të Jusufit, të këtij ylli të pashuar, lind prapë pyetja: Kujt i takon të merret me çështjen se si me u vazhdua puna e Jusufit në Lëvizjen e pashuar të Jusufit? Shokëve të organizatës së tij apo personave të një organizate tjetër apo të paorganizuar fare, pra personave jashtë asaj organizate e të cilët nuk ka të bëjnë me te në asnjë mënyrë.

Nëqoftëse Remzi Ademaj, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani, Sabri Novosella, Naim Haradinaj, vetë Suzana, shokë që në kohë të ndryshme janë betuar me Jusufin e para Jusufit si anëtarë të Lëvizjes së Jusufit, e dinë se Organizata, **Lëvizja e pashuar e Jusufit ka mbetur e pashuar dhe e pa futur në një thes me Frontin e pagëzuar e popullarizuar nga UDB-a**, atëherë për pabesinë dhe turpin më të zi e më të përjetshëm, na paska qenë detyrë e Skënderit të Shtutgartit t'i hedhë poshtë të gjitha mendimet e shokëve të vetë, e të gruas së Jusufit dhe t'u besoj fjalëve të I. Kelmendit, të një personi që kurrë nuk e ka takuar më parë. Sikur Skënderi i Shtutgartit do t'u besonte fjalëve të I. Kelmendit më tepër se sa të gjithë shokëve të vetë prapë lind pyetja se si do të ndikonte kjo punë në moralin, punën e nderin e Jusufit, kur puna e tij, betimet me shokët e tij do të merreshin kaq lehtë nëpërkëmb ende pa u varrosur kufoma e tij.

Përveç raportit tim të dëshmuar nga letra e Jusufit, e shkruar dy ditë para vrasjes, të shohim se sa dramatike është gjendja, brenda në Kështjellën e Jusufit, pas pranimit në këtë kështjellë, të emisarit e vëzhguesit të Abdullah Prapashticës, Osman Osmanit, ku derdhet helmi e shfaqet tërbimi për unitetin e pathyeshëm në mes shokëve të Jusufit dhe familjes së tij.

Faridin Tafallari: *"Suzana: **A pe ndonjë njeri?***

*Jusufi: **Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot."*** (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

7. Suzana ma prezantoi si "zëvendës" të Jusufit

Të gjitha citatet e këtij nëntitulli (me një përjashtim) janë të Shkollës së UDB-së Serbe të Abdullah Prapashticës, nga libri i quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010).

Këtu shohim mllefin e Shkollës së UDB-së kundër unitetit të familjeve të Vëllezërve Gërvalla me shokët e organizatës së tyre.

*Shkolla e UDB-së Serbe: "Me **Skënder Skënderin** isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, **Suzana** ma prezantoi si „**zëvendës" të Jusufit**! Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva **Suzanës**, se Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk **ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin**. **Suzana** më sqaroi se **Skënderi** ishte i dërguar i Mërgimit, i cili ishte udhëheqësi i ynë, dhe se pa urdhrin dhe lejen e tij ne nuk guxonim të merrnim asnjë vendim. Pas këmbënguljes sime për të marrë vesh se kush fshihej pas pseudonimit Mërgimi, ajo më tregoi se ishte Sabri Novosella." (N.S. Vrasja e trefishtë, f.88)*

*Shkolla e UDB-së Serbe: "Kisha fituar përshtypjen se këto veprime nuk ishin fare të tijat. Ai zbatonte urdhra dhe thurte komplote, por nën diktatin e tjetërkujt... Assesi nuk ishte vetëm! E kishte ndihmën dhe këshillat politike të Hafiz Gagicës, i cili nuk dallonte aspak nga **Skënderi.** Prandaj, nuk besoja se pranonte dhe zbatonte direktiva nga Sabri Novosella (Mërgimi), të cilin **Suzana** na e prezantonte si udhëheqës të Lëvizjes, edhe pse asnjëri nga ne anëtarët e Lëvizjes nuk kishim dijeni për ekzistimin e një udhëheqësi të tillë!" (N.S., Vrasja e trefishtë, f.89)*

*Shkolla e UDB-së Serbe: "Flitej dhe punohej për mundësinë e ardhjes së prindërve të viktimave nga Kosova, kurse udhëheqësi ynë i vetëshpallur, **Skënder Skënderi**, vazhdonte me punët e tij të „mëdha" politike. **Konsultohej vetëm me Suzanën.** Bënte biseda të gjata telefonike me Sabri Novosellën. Merrte urdhra dhe jepte informata. Përgjonte e përvidhte. Zhbironte dhe ndërhynte. I hetonte dhe i godiste si rrufe „tradhtarët" dhe ata që kishin gisht në vrasjen e trefishtë... pastaj, „detyrimisht" bënte udhëtime „zyrtare", sa në Vjenë, sa në Stamboll... kurse për mbulimin e shpenzimeve tejet të larta për xhepin e mërgatës, isha i ngarkuar unë... dhe herë pas here **Suzana** më thoshte se këto para duhet të paguhen." (Vrasja e trefishtë, f.90-91*

*"Me direktivat e **Skënder Skënderit** ndalohej rreptësishtë mbajtja e shënimeve për shumat e parave që hynin e dilnin nga arka, detyrë që më ishte ngarkuar qysh herët nga Kadri Zeka e Jusuf Gërvalla, dhe që vazhdoja ta ushtroja edhe tani! Pavarësisht këtyre sugjerimeve, pavarësisht kërkesës **së Suzanës** dhe arsyetimeve se mbajtja e shënimeve do t'i rrezikonte njerëzit, unë vazhdova mbajtjen e evidencës për të hyrat dhe të dalat. Këto shënime isha i shtrënguar t'i mbaja për arsyen e ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë*

që kisha. Shumat që kërkoheshin nga ***Suzana*** *ia dorëzoja pa asnjë paragjykim apo pyetje se ku do të shkonin paratë. Të gjitha këto shpërfillje, keqpërdorime, shpërdorime nderesh, nxirosje fytyrash, akuza për tradhti e vrasje idealesh, isha i shtrënguar t'i gëlltisja për shkak të situatës... por jo edhe t'i harroja!" (f.91)*

"Skënder Skënderi *vazhdonte me ngulm parapërgatitjen e dekonspirimit, përmes gazetës „Zëri i Kosovës", të sekreteve të Komitetit Qendror dhe të dhënave biografike të tre martirëve të atentatit të 17 janarit. Unë dhe Agron Sela ishim kundër, kurse Skënderi dhe Suzana ishin për botimin e biografive. Bulen as që e pyeste kush. Ajo trajtohej si Hirushe e shtëpisë...*

Suzana ishte në përkrahje të Skënder Skënderit*, duke e cilësuar atë si student të diplomuar e që i dinte më mirë se unë këto punë. Isha i nevrikosur, ndoshta më tepër se ç'duhej, andaj ia ktheva Suzanës se për të luftuar kundër sllavëve nevojitet guxim, strategji, mençuri e jo diplomë... as Shota e Azem Galica kur luftuan kundër çetnikëve serbë nuk patën diploma, por jehona e trimërisë së tyre dekada me radhë ua futi tmerrin në bark ushtarëve serbë... Megjithatë, u bë ashtu siç e kishin paraparë ata. Në faqen e parë u botuan fotografitë e martirëve dhe një artikull me titull: „Tre ranë me mijëra u ngritën", duke vazhduar në faqen e dytë me titull: „Nekrologji", ku jepeshin të dhëna të sakta për jetën dhe veprat e Jusufit, Bardhoshit dhe Kadriut. (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë,* f.118-119)

Faridin Tafallari: *"Suzana:* ***A pe ndonjë njeri?***

Jusufi: ***Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)*

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Tekst konciz në një faqe A4 me titull: Biografi e Jusuf Gërvallës)

8. Sirtari im

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ndërkohë, një letër ngushëlluese nga Turqia i kishte arritur Suzanës. Pasi e lexoi, më tha se ia kishte dërguar Mërgimi, dhe me indinjatë e hodhi në shportën e bërllokut. Ndoshta veprova keq, por letrën që ishte dërguar për familjen Gërvalla, e nxora nga shporta dhe e* ***futa në sirtarin tim****. Mendova se kjo letër, ndoshta dikur, kur të jenë më të qetë, do t'i duhet familjes Gërvalla! Arsyen se pse e kishte hedhur Suzana letrën në shportë e gjeta pasi e lexova letrën. Gjatë gjithë letrës, shoku Mërgim, as një herë të vetme nuk e kishte parë të arsyeshme ta përmend, të paktën formalisht, emrin e Kadri Zekës, shokut të luftës dhe të idealit të Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, i cili bashkë me ta, natën e 17 janarit të vitit 1982, ra dëshmor në altarin e lirisë."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 127)

Këtu kemi taktikën e shkollës së UDB-së me e hedh Suzanën e familjen Gërvalla kundër Sabri Novosellës. Njeriu i painformuar me intrigat e kuzhinës së UDB-së, nëse e merr parasysh se Suzana Gërvalla dhe asnjë pjesëtar i familjes së Jusufit nuk janë dukur publikisht me Sabri Novosellën mund të mendoj se ndoshta këtu mundet me pasur diçka të vërtetë. Por fakti se që nga janari 1982, Suzana dhe bijtë e bija e saj nuk janë paraqitur publikisht deri më sot për asnjë rast të vetëm, jo vetëm me asnjë shokë të Jusufit, por as me ndonjë të afërm të Kadri Zekës dëshmon, se kjo çorbë e kuzhinës së shkollës së UDB-së është çorbë e shkollës së UDB-së dhe asgjë tjetër.

9. Skedari im

I. Kelmendi: *"Ndaj këtij farë Xhafarit edhe më herët kishte shprehur dyshime, por të përmbajtura meqë akoma nuk e kishte kategorizuar në skedarin e tij as si shërbëtor të UDB-së, as si patriot të vërtetë, siç i kategorizonte ai njerëzit me të cilët kishin të bënin." (Atentatet, f.342)*

Shoku i mirë i Sadik Blakajt, nipi i Dajës Ramë e dëshmitari i Mehmet Hajrizit, e paska pasur për adet të bëjë kategorizime në skedarin e tij se kush është patriot e kush shërbëtor i UDB-së, nip i UDB-së apo shok i mirë i Sadik Blakajt. Ky kategorizim për mua, prej mercenarëve do të kishte njëfarë rëndësie sikur të mos e kishte bërë kategorizimin e vetë me kohë Jusuf Gërvalla që kishin rëndësinë e vetë në vendosjen e raporteve të mia me shokët e Jusufit e të LNÇKVSHJ.

I. Kelmendi përveç hollësive të Lëvizjes së Jusufit di detale të rëndësishme edhe për Skenderin e Shtutgartit.

I. Kelmendi: *"Xhafari gjatë vitit 1981 ishte shpesh te Jusufi dhe ishte angazhuar për ta ndihmuar atë në përgatitje të Zërit të Kosovës. Pastaj shkonte në Kosovë dhe atje nuk i ndodhte asgjë, sado që nuk kishte praktikuar ndonjë konspiracion për të qenë. Dhe tani rrëfente se për atentatin ishte informuar nga një polic duke qenë në një ëmbëltore në Prishtinë. Prej atje vinte pa ndonjë pengesë për të trashëguar vendin e Jusufit, sepse kështu duhej të kishte vendosur udhëheqësi Sabit."* (Atentatet, f.342)

> Faridin Tafallari: *"Xhafer Durmishi erdhi tek Jusufi dhe Jusufi e donte, se ai ishte besnik. Ne e mirëpritëm dhe e nderuam, se e la Jusufi, por ama nuk e la për trashëgimtar, se ai nuk besonte, se një ditë do ta ndalte hovin drejt veprës së tij të madhe."* (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, f. 303)

Në vitin 2007 I. Kelmendi zbulon sekrete mahnitëse para publikut se si unë, Skënderi i Shtutgartit, gjatë vitit 1981 paskna qen shpesh tek Jusufi dhe i paskam ndihmua në përgatitjen e "Zërit të Jusufit". Nga leximi i cili na serviret në vitin 2007, fitohet përshtypja se këtë fakt, këtë rrethanë I. Kelmendi e ka ditë qysh në vitin 1981. Kur e marrë vesh I. Kelmendi se unë e kam ndihmua Jusufin në përgatitjen e "Zërit të Jusufit"?

Kur e ka marrë vesh I. Kelmendi se unë pasi kam qenë tek Jusufi, kam shkua në Kosovë? Prej se jam takuar me Jusufin sa herë kam qenë në Kosovë? Kur dhe prej nga i ka marrë vesh këto fakte I. Kelmendi, që na i thotë më 2007, e që përpiqet të lej përshtypjen se i ka ditur më 1981. Prej kujt e kam marrë vesh lajmin për atentatin në Jusufin dhe kush ka qenë i pranishëm kur e kam marrë vesh këtë lajm?

Si edhe në mjaft raste tjera, I. Kelmendi vjedh mendime e ngjarje të bëra publike nga libri Terror-Dhimbje-Qëndresë i Faridin Tafallarit nga viti 1997 dhe përpiqet të na i shet si sekrete e gjëra të panjohura dhjetë vjet më vonë, më 2007.

Të gjitha këtyre çështjeve të shtruara të cilat dëshmojnë se Ibrahim Kelmendi nuk ka ditur asgjë para 21 janarit 1982, u jam përgjigjur në shkrimin "Si më njoftoi UDB-a për vrasjen e Jusuf Gërvallës?" të publikuar në www.pashtriku.org, në janar 2010. Përgjigje e merituar këtyre çështjeve u është dhënë edhe në këtë libër deri këtu.

10. Që më se paku i shkonte një trashëgimtari të Jusufit

Skënderi i Shtutgartit, para mysafirëve, para personave që nuk i takuar kurrë më parë, që në takimin e parë, porsa firma e varrimit i ka marrë kufomat e Jusufit e Bardhit për t'i

dërguar në morgun e Heilbronit, e para I. Kelmendit, fletë para atyre që e kanë pritë me padurim, e nuk i pritet të tregoj se çfarë vendi ka ai në Lëvizjen e pashuar të Jusufit.

I. Kelmendi*: "**M**iranin e provokoi mënyra se si e filloi Xhafari fjalën e tij, që më se paku i shkonte një trashëgimtari të Jusufit në atë moment, prandaj nuk mundi të përmbahej pa ndërhyrë. Disave, sidomos Nuriut, nuk u pëlqeu ndërhyrja e Miranit, kurse Xhafari ia hedhi një vështrim të egërsuar, por me vetëpërmbajtje për të mos reaguar hapur aty për aty. Xhafari vazhdoi rrëfimin e tij me zërin që mezi i dilte nga gryka dhe mezi dëgjohej:*

– Unë jam i kooptuar nga Udhëheqësi për të drejtuar organizatën në Evropën Perëndimore duke e zënë kështu vendin e shokut Jusuf. Tani e tutje do t'i nënshtroheni udhëheqjes sime...

– Si urdhëroni! – ndërhyri përshpejtueshëm Nuriu." (Atentatet, f.342)

A është e mundur që unë Skënderi i Shtutgartit, e i betuari para Jusufit, kam pas nevojë t'u tregoj Haxhi Berishës, Faridin Tafallarit, Nuhi Sylejmanit, Naim Haradinajt, Remzi Ademajt e Hafiz Gagicës, të cilët më paskan pritë me padurim, se kush jam unë dhe atë ende pa u larguar mirë kufomat e Jusufit dhe Bardhit nga shtëpia? A ka mundësi që unë paskam pas nevojë t'u mbushi mendjen këtyre aktivistëve "të painformuar, të papërvojë organizative, e pa ndonjë përgatitje politike", të cilët më kanë pritë me padurim, se kush jam dhe krejt këtë punë ta bëjë para syve e në prani të personit të informuar, me përvojë dhe me përgatitje politike, I. Kelmendit, nipit të Dajës Ramë, figurës frontale të Frontit të bashkëthemeluar dhe 100% të pagëzuar nga UDB-a?

Shtrohet pyetja se mos këto fjalë i kam thënë pikërisht para I. Kelmendit për ta marrë edhe miratimin e Miranit, miratimin tij në mënyrë që unë ta forcoj e konsolidoj autoritetin tim para shokëve të Lëvizjes së Jusufit, të cilët më kanë pritë me padurim? A është e mundur që unë ndonjëherë në jetën time politike kam pas nevojë për përkrahjen e I. Kelmendit, që ta fitoj, ruaj e mbaj një vend?

11. Që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit

Xhafer Durmishi apo Skënderi i Shtutgartit, shokëve të Lëvizjes së Jusufit, që janë të painformuar dhe të papërvojë organizative e pa ndonjë përgatitje politike u imponohet si udhëheqës në vend të Jusufit.

I. Kelmendi: *"Të tjerë si Hafifi, Fahriu, Nazimi, Naili e Goni, që ishin të painformuar dhe të papërvojë organizative e pa ndonjë përgatitje politike, vetëm po vështronin si të hutuar pa ditur se çfarë qëndrimi duhej të mbanin. Ata po i zgurdullonin sytë të ulur rreth Xhafarit **që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit**, pa qenë në gjendje të vlerësonin se çfarë po nxirrte nga goja ai."* (Atentatet, f.343)

Shtrohet pyetja se Hafiz Gagicën, Faridin Tafallarin, Sefedin Tafallarin, Nami Ramadanin, Naim Haradinajn, Haxhi Berishën, Remzi Ademajn, nëse ishin të painformuar kush i la pa u informua? Nëse ishin të papërvojë kush i la pa përvojë? Nëse ishin pa ndonjë përgatitje politike kush i la pa përgatitje politike? Më 17 janar 1982 unë kam qen në Kosovë. Në Untergruppenbach kam ardhur pas 3 ditë e 16 orëve, d.m.th. më 21 janar. rreth orës 14.00. I. Kelmendi i ka pasur tri ditë të plota t'i informoj shokët e Jusufit (të cilët Jusufi në natyrën dhe karakterin e tij nuk qenka përpjekur t'i informoj, organizoj e përgatisë politikisht, por ndoshta i paska mbajtur edhe ai në statusin e kandidatit) se është bërë bashkimi. Pse këta shokë të Jusufit, të painformuar e të papërvojë jo vetëm që nuk iu mbështetën asnjë i vetëm I. Kelmendit, por përkundrazi kishin vetëm dyshime në te se ka njohuri të veçanta për atentatin.

"Ata po i zgurdullonin sytë të ulur rreth Xhafarit që po u imponohej si udhëheqës në vend të Jusufit, pa qenë në gjendje të vlerësonin se çfarë po nxirrte nga goja ai."

Pse ata kanë nevojë t'i zgurdullonin sytë dhe në të njëjtën kohë ishin ulur rreth Xhafarit, Skënderit të Shtutgartit. Kur kishin gjithë ato dilema sa zgurdullonin sytë, pse nuk ulën rreth tjetër kujt por pikërisht rreth Skënderit? A ka pasë nevojë apo nuk ka pasë nevojë Skënderi t'u imponohet shokëve që e kanë pritë me padurim dhe ulen rreth tij?

Ta zëmë se unë paskam ndie nevojë t'u imponohem shokëve të mi me të cilët jam betuar para e bashkë me ta e me Jusufin në Lëvizjen e Jusufit, atëherë lind pyetja se kujt i takon të merret me punët e brendshme të Lëvizjes së Jusufit? A i takon kjo punë shokëve, anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit apo ndonjë njeriu të jashtëm, me aq përvojë organizative, me aq përgatitje politike dhe aq të informuar siç ka qenë I. Kelmendi, figura frontale e Frontit të bashkëthemeluar dhe 100% të pagëzuar nga UDB-a. A do të ishte njëqind herë më vdekje për Jusufin sikur punët e Lëvizjes së pashuar e të përjetshme të Jusufit të kishin mbetur të duart e kryesuesit të Frontit të pagëzuar nga UDB-a, i cili qysh tani na e ka tërhequr vërejtjen se kur një ditë do të hapen dosjet duhet t'i marrim me shumë rezervë pasi ato mund të jenë të manipuluara, duke shtuar se vendimtarë në këtë çështje duhet të jetë mendimi i aktivistëve e *arkivi i popullit*. Këto na i thotë pra njeriu naiv, konkret i sinqertë dhe transparent, I. Kelmendi.

12. Ishte përcaktuar t'i përmbahej hierarkisë organizative

Nuhi Sylejmani, nga anëtarë konkret i Lëvizjes së Jusufit, si ujk i regjur e din se cilin rol do ta luaj në kuadër të lëvizjes çlirimtare (lëvizjes me germën 'l' të vogël), pra lëvizjes më të përgjithshme, të papërcaktuar dhe si të tillë abstrakte. Është projekti i shembjes së mitit të Jusufit, që Lëvizjen e tij konkrete ta bëjë lëvizje abstrakte, që shokët e tij konkret t'i bëjë individ abstrakt. Skënderi u hedhë vështrim të egërsuar pikërisht atyre që e kanë pritë me padurim. Por kulmi i situatës arrihet kur Suzana, me burrin e kunatin të vrarë para tri ditësh, ende të pa varrosur, e me përgjegjësi për tre fëmijë të mitur, përcaktohet t'i përmbahet hierarkisë organizative të një organizate të përjetshme që Jusufi ia paska marrë jetën në agimin e 17 janarit 1982, dhe mendon ta nxjerrë vehten në pah, pra të bëjë karrierë politike, kjo grua e Jusufit e cila I. Kelmendit dy ditë më parë i ka tregua se Jusufi e Kadriu nuk kanë nxjerrë asnjë fjalë nga goja kur ajo ua ka dërgua çajat.

I. Kelmendi*: "Kurse, ujqër të regjur si tullaci Nuriu, Xhehili dhe ndonjë tjetër e dinin se cilin rol duhej të luanin në kuadër të lëvizjes çlirimtare, pas goditjes së rëndë nga atentatet. Disa punëtorë që nuk po e kuptonin rrjedhën e ngjarjeve, i ishin nënshtruar inercisë.*

Drita në ato çaste po bisedonte me ca gra, të cilave u tregonte për ngjarjen e kobshme. Ajo nuk po e dëgjonte Xhafarin, po edhe sikur ta dëgjonte, ishte përcaktuar t'i përmbahej hierarkisë organizative që po kurdiste Sabiti nga Stambolli. Ajo po mendonte të nxirrte veten në pah." (Atentatet, f.343)

Pra del se Suzana, gruaja e Jusufit është e gatshme që për hir të vetes e karrierës së vetë ta sakrifikoj të vërtetën, pra të vërtetën e padiskutueshme se në organizimin e në organizatën e tij politike, në Lëvizjen e tij, në Lëvizjen e Jusufit, shoku më i ngushtë ka qenë nipi i Dajës Ramë, I. Kelmendi, dhe t'i përmbahet hierarkisë së caktuar nga Sabri Novosella, 2500 km larg nga Shtutgarti. Del se Suzana për hir të vetes e sakrifikon të vërtetën e burrit të vetë. A ka fakt më të mjaftueshëm për shembjen e mitit të Jusufit se sa ky?

Në dasmën e K. Zekës e S. Isufit e pamë se si Jusufi thyhet moralisht e shpirtërisht gjer në fund nga Sabri Novosella. Këtë thyerje morale Jusufi (një prej vetive themelore të Jusufit ka qenë thyerja morale e shpirtërore ndaj shokëve të Lëvizjes së vetë dhe në këto momente thyerjeje është mbështetë tërësisht në Fronte të huaja të formuara nga UDB-a apo nga komunistët e paepur gjer në fund) që pëson ai (J.G.) më 2 janar 1982, ka pasur rast t'ia transmetoj gruas e shoqes së vetë të jetës për 15 ditë rresht, pra gjer më 17 janar 1982. Si është e mundur që Sabri Novosella, prej të cilit Jusufi është thyer përfundimisht, shpirtërisht e moralisht më 2 janar 1982, ta marrë kontrollin e plotë, pra 100% në shtëpinë e Jusufit përmes bisedave telefonike 2500 km larg nga Shtutgarti, dhe që nga Adapazari ta ketë fuqinë e autoritetin në Shtutgart, sa qysh më 18 janar ta reduktoj I. Kelmendin në një vizitor të rëndomtë. Prej nga lindi ky autoritet i përdhosur e i vdekur i Sabriut në familjen e Jusufit e Bardhit, në Suzanën, Tushën, në Nuhi Sylejmanin, Haxhi Berishën e Naim Haradinajn. A ka mundësi që autoriteti i Sabriut tek Jusufi ka mbetur i pathyeshëm, i pa përdhosur e i përjetshëm ashtu siç ka qenë Lëvizja e Jusufit e cila në mënyrën më të palëkundur e ka përballuar goditjen e përqendruar të UDB-së pikërisht kundër Jusufit e kundër saj?

Faridin Tafallari: *"Suzana: **A pe ndonjë njeri?***

Jusufi*: **Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot**."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

13. Ne kemi marrë vendime me rëndësi

I. Kelmendi, vetëm pasi kanë kaluar katër ditë nga atentati, kur në shtëpinë e Jusufit, tërë kohën nuk është biseduar asgjë tjetër pos asaj se si i kanë kaluar punët e bisedat më 16 e 17 janar, tek më 21 janar nisë të tregoj 'se në orët e fundit para atentatit ndaj dëshmorëve tanë, ne kemi marrë vendime me rëndësi dhe na duhet t'i konkretizojmë pasi të kemi kryer ceremoninë e varrimit', por as pas katër ditësh këtë fjali e komunikim të vendimit për bashkim nuk është në gjendje ta çoj gjer në fund sepse ndërpritet nga Skënderi i Shtutgartit, që është një hileqar.

I. Kelmendi: *"– Mos u ngutni! – mori fjalën Mirani pasi nëpër kokë po i kalonin një mori mendimesh, – sepse në orët e fundit para atentatit ndaj dëshmorëve tanë, **ne kemi marrë vendime me rëndësi** dhe na duhet t'i konkretizojmë pasi të kemi kryer ceremoninë e varrimit...*

– Mirë thotë Mirani, - ndërhyri Xhafari hileçar, i frikësuar se po ta lejonte atë, do ndodhte ta komunikonte

> **Këtë vendim:** *" -Po Faridin tha Kadriu,- nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.*
>
> ***Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar** dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (e Jusufit - shën im)."(*Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, f.37-38)

***vendimin**, të cilin veç atij nuk e dinte njeri, ndërsa më vete thoshte: "Ç'kërkon këtu ky njeri, tashmë i mundur, të cilit së shpejti do t'ia tregojmë vendin ku e ka."'"* (Atentatet, f.343)

Si është e mundur që unë Skënderi i Shtutgartit me e penguar I. Kelmendin ta thotë këtë mendim, ta qoj fjalën deri në fund, të na tregoj për këtë bashkim, në shtëpinë e Jusufit më 21 janar 1982 kur ai ka qenë shtëpi të Jusufit prej 18 janarit 1982 dhe ka

mund që shokëve të Jusufit t'ua komunikoj 100 herë në pastë dashtë, e të cilin ky nuk ka mundur ta thotë deri më 5 shkurt 2007. Si është e mundur që unë të kem pas frikë për vendin tim në Lëvizjen e Jusufit nga një person që kurrë nuk ka qenë anëtarë i saj. Vetëm ideja më e vogël që unë, Skënderi i Shtutgartit, shoku i betuar para Jusufit, në Lëvizjen e pashuar të Jusufit ta kisha pranuar personin e jashtëm të Lëvizjes, I. Kelmendin si të barabartë me shokët tjerë të Jusufit e të betuar para Jusufit do të ishte turpi e vdekja më e madhe për Jusufin dhe shuarja më vdekjeprurëse e Lëvizjes së tij. Në këtë batak e në këto punë të ulëta unë nuk kam ra kurrë dhe natyrisht ato ditë nuk ka ra asnjë shokë i Jusufit.

Jusuf Gërvalla*: "Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit e vërtetë të punëve të vërteta." (*Letër I. Kelmendit, 15 janar 1982)

Se çfarë bashkimi ("*të cilin veç atij nuk e dinte njeri")* ka bërë Jusufi me organizatën e përbashkët të Ibrahim Kelmendit e Kadri Zekës, mund ta kuptoj çdo njeri që di shkrim lexim nga letra e askujt tjetër pos vetë dëshmitarit të paepur të komunistëve të paepur:

Dëshmi e I. Kelmendit para 17 janarit 1982:

I. Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, por Mirani nuk pranoi... Kurse Jusufi nuk ia bëri Miranit asnjë propozim.. "*

Dëshmitari i paepur i komunistëve të paepur gjer në fund për natën e 17 janarit dhe për kohën e përjetshme pas kësaj date:

I. Kelmendi*: "Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të* ***BASHKËPUNOJMË*** *për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte* ***BASHKËPUNUAR*** *përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani-shën ynë) dhe Nexh. (Nexhati - 'Osman Osmani -shën ynë'-, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë."* (Letër QE, 30 qershor 1983)

I. Kelmendi: "*(Shokëve të QE – për diskutim, përmirësim e aprovim)*

QARKORE

"...Themelet e Programit duhet të jenë Komunikata mbi Bashkimin (lëshuar në 'Zëri të Kosovës', nr.1, 1982), si dhe kërkesat e mbarë popullit, të vulosura me gjak e sakrifica dhe të njohura tani për mbarë botën..

-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"

"-RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!"

(Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)

Ja se si fillon Komunikata e Bashkimit që I. Kelmendi kërkon të shërbejë si themel i Programit të Lëvizjes për Republikë:

"KOMUNIKATE

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave ***NË NJË TË VETME****. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982...

Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ"

Kjo Komunikatë e lartpërmendur u shtyp dhe për herë të parë në Evropë u shpërnda nga Xhafer Shatri së bashku me Kushtrim-Thirrjen e demonstratës së Bernit të 26 qershorit 1982.

I. Kelmendi*:"-PER REPUBLIKEN SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!*
Të dashur shokë të QE, Në mërgim..., më 11 janar 1984

*"...Në përfundim të letrës shoku Salih (Xhafer Durmishi) na shkruan për datat 17 shkurt apo 15 maj, duke u ndalur prapë te 'allashvereshet' e rëndomta që po zhvillohen zakonisht me këto dy data, se nuk na qenkan për natyrë të tij, të dorës së parë**, SIKUR MË DUKET NEGLIZHIM I RËNDËSISË AQ PARIMORE**. Kurse me data që ende je në to, do të thoja për rastin konkret, nuk ka si të merret historia. Në këtë rast kontestuese është se si të shkruhet në Program Politik, përkatësisht cila datë – dhe kjo ka rëndësi të madhe, pasi ndryshimi i datave përcjellet me shkelje të Komunikatës së lëshuar me rastin e Bashkimit. **Unë jam për atë, nëse duhet të vendoset ndonjë datë në Program Politik, atëherë të mbetet ashtu si është në Komunikatë**."* (Letër dërguar QE - Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit,, faqe 7)"

Këto letra, këto dokumente historike të cilat tregojnë pastërtinë e Lëvizjes së Jusufit dhe mospërlyerjen e saj me Frontin e formuar nga UDB-a dhe aleatët e këtij Fronti, siç shihet i kanë Hasan Mala, Xhafer Shatri, çka do të thotë se i kanë edhe Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Saime Isufi e Brat Berat Luzha. Pse ata paraqiten budallenj e sikur nuk i din këto fakte do ta shohim më vonë.

Faridin Tafallari: *"Suzana: **A pe ndonjë njeri?***

*Jusufi: **Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot**."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu **deri në çastin e vdekjes**."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

Agron Bajrami*: "Në njëfarë mënyre të çuditshme ndoshta edhe atentati i kontrubuoi qëllimit që e patë Jusufi, sepse më duket se Lëvizja deri në një masë u unifikua pas vrasjes në Untergruppenbach."*

Donika Gërvalla: "*Ashtu është. Gjatë kohës që, para atentatit pati përpjekje për bashkimin e mekanizmave të ndryshëm. Ato nuk patën sukses gjatë kohës sa jetoi babi."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 8.50-9.22)

14. Të rrahurat e makinës së shkrimit dëgjoheshin përgjatë gjithë korridorit

Skënderi vendosë censurë të rreptë se kush duhet të formulojë ndonjë tekst në shtëpinë e Jusufit. I. Kelmendit i vjen ta kundërshtojë brutalisht por përmbahet se është në ceremoni mortore.

I. Kelmendi*: "Si me zor Mirani kishte shtypur e shumëzuar një informatë nekrologjike për Heronjtë e rënë. Kundër kësaj ishin Nuriu dhe disa të tjerë. Por, meqë ata vetë nuk dinin të shkruanin, u detyruan ta pranonin sepse edhe ata mendonin se duhej të kishin diçka të shkruar për t'ua shpërndarë bashkatdhetarëve. Për këtë punë u informua udhëheqësi i ri Xhafar, alias Skënderi, të cilit nuk i erdhi mirë pse e kishte bërë Mirani dhe urdhëroi që herave të tjera gjithçka duhet të bëhej vetëm me leje të tij. Miranit sesi*

po i vinte ta kundërshtonte brutalisht, por përmbahej se ishte në ceremoni mortore." (Atentatet, f. 345)

Në shtëpinë e Jusufit, ka qenë dy makina të thjeshta shkrimi (përveç asaj me të cilën është shtypur, radhitur Zëri i Jusufit e cila në këtë kohë ka qenë e marrun nga policia për hetime) të cilat kanë mund të përdoren prej çdo kujt. Pra ka mund të përdoret prej I. Kelmendit por edhe prej Saime Isufit e cila gjatë tërë kësaj kohe ka qenë në Untergruppenbach. Pse nuk na e tregon I. Kelmendi ndonjë kopje të kësaj farë informate nekrologjike apo tekstin e saj. Cila ishte Nekrologjia e vetme që u shtyp dhe u shpërnda në atë kohë? Kush e shkroi atë? Kur e shkroi atë? Në emër të kujt u shtyp e u shpërnda ajo? Përgjigjja në këto pyetje do të ishte interesante për I. Kelmendin, por megjithatë shumë më interesante është për Saime Isufin dhe komunistët tjerë të paepur gjer në fund të OMLK-së. Në këtë çështje do të ndalemi prapë kur rrjedha e ngjarjeve të na sjellë menjëherë pas 5 shkurtit 1982.

Lidhur me dijeninë e shkrimit të Ibrahim Kelmendit, ja se çka thotë Nuhi Sylejmani, i cili përndryshe ka respekt për intelektualin dhe udhëheqësin e denjë të "Frontit të Kuq".

"Arritëm rreth orës dy pas mesnatës së 19 janarit të vitit 1982. Derën na e hapi Suzana. Dukej e molisur. Na dërgoi në dhomën e ndejës. Aty e takuam Ibrahim Kelmendin. Kishte zënë vend pranë tavolinës, me një makinë shkrimi përpara. Dukej i thelluar në mendime. E përshëndetëm. Nuk luajti fare nga vendi, bile as kokën nuk e ktheu nga ne. Si nëpër dhëmbë na e ktheu përshëndetjen. Zumë vend. E ngushëlluam dhe na ngushëlloi Suzana. Ibrahimi shkruante. Të rrahurat e makinës së shkrimit ishin të rënda në qetësinë mortore të mëngjesit dimëror. ...Të rrahurat e makinës së shkrimit dëgjoheshin përgjatë gjithë korridorit... jo vetëm makina, por as Ibrahimi që po ju binte pamëshirshëm shkronjave të saj, sikur nuk po e kuptonin hallin e dhembjen tonë! Kur hyra në dhomë, pashë drejt Ibrahimit, i çuditur me sjelljet e tij, kurse Suzana, duke më shikuar, pa folur, përmes mimikës e drejtoi gishtin drejt Ibrahimit, duke e tundur lart-poshtë në shenjë qortimi... ndërsa unë, po ashtu, pa folur e kryqëzova gishtin tregues me buzët e mia për t'i dhënë shenjë të heshtte!

Kot prita që Ibrahimi ta linte për një çast shkrimin, të më ngushëllonte e t'i pranonte ngushëllimet e mia për shokët tanë të vrarë! Ai vazhdonte të shkruante... të shkruante, të shkruante pa e kthyer kokën për të parë se ç'po ndodhte rreth tij! Vetëm shkruante! Vallë çfarë shkruante? Kurrë nuk e mora vesh! (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 70-71)

Nuhi Sylejmani, si shok i mëvonshëm e i ngushtë i ish-inspektorit të UDB-së Serbe vajton të gjitha "afrimet e tij" të pasuksesshme drejt prijësit, intelektualit dhe udhëheqësit të denjë, Ibrahim Kelmendi, pra nipit të Dajës Ramë.

Shkolla e UDB-së Serbe (për nipin e Dajës Ramë): "*Sjelljet e tilla më dukeshin jo shoqërore, jo miqësore,* ***sjellje që nuk i përkisnin një prijësi, një intelektuali, e aq më pak një udhëheqësi të denjë të „Frontit të Kuq Popullor!****" Çdo afrim timin drejt tij, çdo tentim bisede nga ana ime e priste me një injorancë përbuzëse dhe fodulle, por unë e ndjeja se nuk ndodhesha në atë shtëpi për sherr, në atë shtëpi ku vrasja tragjike e kryefamiljarëve ishte e freskët, e rëndë dhe e tmerrshme! Unë ndodhesha aty për ta përmbushur amanetin e fundit të Zotit të Shtëpisë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.72)

Sipas Shkollës së UDB-së Serbe amaneti i Jusufit ka qenë që çelësat e shtëpisë së tij të pamposhtur t'i dorëzohen Ibrahim Kelmendit, intelektualit dhe udhëheqësit të denjë të "Frontit të Kuq Popullor".

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi* ***në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.*** *...* ***në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzën nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në* ***dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Faridin Tafallari: *"Suzana:* ***A pe ndonjë njeri?***

Jusufi: ***Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (*Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)

15. Letra e Jusufit nuk ka përmbajtje aktuale

Dy letrat e fundit të Jusufit, të shkruara të premten më 15 janar 1982. Një i dërgohet Kadri Zekës në Zvicër, kur ai veç më 12 janar ka marrë trenin për tek shoku i tij I. Kelmendi në Düsseldorf, ndërsa tjetra i dërgohet rekomandë I. Kelmendit, por i cili gjendet në aktivitete e biseda pune me Kadri Zekën, kështu që letra kthehet në shtëpinë e Jusufit e të cilën I. Kelmendi e pranon nga dora e Suzanës.

I. Kelmendi duke e pranuar nga dora e Suzanës letrën e Jusufit drejtuar atij më 15 janar 1982:

I. Kelmendi*: "Po kërkoj të mos ia japësh askujt, sepse këtu ka pjesë të përmbajtjes, e cila është e kapërcyer, sidomos sa i përket hidhërimit të Jusufit ndaj Kadriut. Kjo do të mund të keqpërdorej po t'u binte në dorë dashakëqinjve."* (Atentatet, f. 346)

Këtë letër të Jusufit, këtë pronë të Jusufit, këtë pronë të popullit, këtë pronë të të gjithë brezave aktualiteti i së cilës është i përjetshëm ashtu siç është e përjetshme vlera historike e çdo dokumenti që pasqyron të vërtetën e një kohe e ka botuar për herë të parë Faridin Tafallari qysh më 1997.

16. Midis jush nuk kam si hyj

Suzana, para së cilës Jusufi kurrë nuk paska fjalë asnjë fjalë për politikë, e falënderon I. Kelmendin që ia jep një kopje të letrës së 15 janarit 1982, të shkruar nga Jusufi, por që qenka bërë pronë e I. Kelmendit. Gjithashtu Suzana harron se është shndërruar në një karrieriste në shërbim të Sabri Novosellës dhe i thotë I. Kelmendit se Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtarë më të afërt se ty.

I. Kelmendi*: "–* ***Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja****. Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më kështillosh që të mos ia jap askujt.* ***Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty.*** (Atentatet, f.347)

Jusuf Gërvalla: *"E marr me mend (e kjo spikat edhe në letrën tënde) ç'mundime ke pasur të më shkruash në "nivelin" tim, sikur. thua se vetëm në "nivelin" tim të shkrimit paska për mua afrim, respekt e dashuri për njerëzit! E çka do të kish qenë "niveli" im, sikur t'u jepej flirteve absurde narcisoide me vetveten dhe të injoronte faktin, se ka pa numër virtyte të tjera, që mund ta marrin vizën e njerëzisë para se një aftësi mesatare e*

të shkruarit?! ***Ky është ofendimi më i madh, që më ke bërë ndonjëherë: të më zhveshësh nga gjithçka njerëzore dhe të më identifikosh me një aftësi gati-gati mediokër të shkrimit!*** *(Ti këtë se thua konkretisht, po del nga qëndrimi yt.) (Letër Ibrahim Kelmendit, nëntor 1980;* Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 281-283)

I. Kelmendi: *"– **Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja**. Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt.* ***Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty.*** *(Atentatet, f.347)*

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku përsa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfillte dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) i kam ndërprerë."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981:Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

I. Kelmendi: *"– **Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja**. Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt.* ***Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty."*** (Atentatet, f.347)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të populllit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ...* ***ËSHTË NIP I NJË AGJENTI ME ZILE TË UDB-SË, I QUAJTUR RAMË NIKÇI OSE IBËRDEMAJ, PUNON NË POSTËN E PEJËS****. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

*Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (*Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

I. Kelmendi*: "– **Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja**. Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt.* ***Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush***

midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty." (Atentatet, f.347)

Jusuf Gërvalla*: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e* ***mercenare*** *të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë* ***mercenar*** *i tyre, pra* ***mercenar*** *i* ***mercenarit****). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451-452)*

I. Kelmendi: *"–* ***Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja****. Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt.* ***Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty.*** *(Atentatet, f.347)*

Jusuf Gërvalla*: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë.* ***Shokët e tu të rinj e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. ...***
Përkundër të gjithave, ne s'e kemi humbur as e humbim dot shpresën e bashkimit. Veçse kemi konstatuar se një mision i tillë aq të nevojshëm e aq të shenjtë për ne, do ta bëjnë kur të vijë koha, njerëzit ***e vërtetë të punëve të vërteta****." (*Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 411-412)

Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush.

Një fjalë popullore thotë se në mes burrit e gruas nuk mund të hyj askush. Por si çdo rregull që ka përjashtime, edhe këtu kemi të bëjmë me një përjashtim, pasi vetë kjo Suzana, e cila harron se më parë më shumë i ka interesua karriera se sa brenga për rritjen e fëmijëve, detyrohet ta pranoj para I. Kelmendit faktin se: midis jush nuk kam si hyj unë, e jo vetëm unë por nuk do të mund të hynte askush tjetër.

A ka fakt më të madh se ky për shembjen e mitit të Jusufit? Se Jusufi shokun më intim e më të afërm edhe se gruan e vetë e paska pasur I. Kelmendin, figurën frontale të Frontit të bashkëthemeluar dhe 100% të pagëzuar nga UDB-a dhe pikërisht sipas Jusufit, të udhëhequr nga UDB-a.

17. Edhe më shumë neveriteshin

I. Kelmendi dhe Saime Isufi ndihen të neveritur në shtëpinë e Jusufit e cila çdo ditë ishte e mbushur nga ata që vinin për ngushëllime.

I. Kelmendi: "*Atentatet e bërë ndaj tre personaliteteve tashmë po jepnin pasojat konkrete në mënyrën më të vrazhdët. Sjelljet dhe inskenimet e Nuriut, Xhafarit dhe ndonjë tjetri afër tyre, të komanduar nga Sabiti, po rivrisnin shpirtin e atyre që kishin*

dhimbje të madhe, që qanin e krenoheshin në heshtje. Përditë po ndodhnin atentate ndaj shpirtit të tyre të plagosur.
"Trashëgimtarët" vazhdonin të rrinin kokë me kokë, në mënyrë demonstrative e provokative, duke përshpëritur se si do të duhej të vinin në skenë prapësitë e tyre të radhës. Nënëmadhja e nemitur neveritej nga sjelljet e tyre. Edhe më shumë neveriteshin Saranda, nusja e Kadriut, Hakani, bashkëvendësi dhe miku i afërt i Kadriut, ***Mirani, shoku e bashkëveprimtari më i ngushtë***

> I. Kelmendi*: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, por* ***Mirani nuk pranoi****... Kurse Jusufi nuk ia bëri Miranit* ***asnjë propozim****.. "*

i tre personaliteteve*, tashmë dëshmorë, që vazhdonin të qëndronin në morgun e spitalit në Hajlbron, në pritje të lejes nga vrasësit jugosllavë për t'u bartur e varrosur në Kosovë."* (Atentatet, f. 349-350)

E kemi parë më heret neverinë e I. Kelmendit që ia shfaq Jusufit për Sabri Novosellën. Tani me atmosferën e shtëpisë së Jusufit i ka ardhë radha të neveritet përpos shokut më të ngushtë të Kadri Zekës, I. Kelmendit edhe Saime Isufit.

Gjatë kohës kur Saime Isufi e I. Kelmendi neveriten në shtëpinë e Jusufit, Suzana prapë harron se I. K. ka qenë shoku më i afërt i Jusufit, harron brengën për përgjegjësinë ndaj tre fëmijëve të mitur dhe e ndien veten të detyruar t'i përmbahet hierarkisë dhe disiplinës organizative, të një organizate që Jusufi disa orë para vdekjes fizike, kokë më vete ia paska marrë jetën Lëvizjes së vetë, dhe synon të bëhet kuadër në një organizatë që më nuk ekziston, pasi Jusufi, ky yll i pashuar e paska shuar në mëngjesin e 17 janarit 1982, dhe ia paska marrë jetën Lëvizjes së vetë të përjetshme.

I. Kelmendi*: "Drita dukej e mpirë dhe e hutuar nga mizanskenat që po i ndodhnin para syve të saj, të kurdisura nga "trashëgimtarët" politikë. Ajo ndiente keqardhjet për vjehrrën, për nusen e Kadriut dhe për gjithë të tjerët që vërtet këto vrasje i kishin goditur,* ***por ishte e detyruar t'i përmbahej hierarkisë dhe disiplinës organizative****, meqë po synonte të bëhej kuadër në organizatë."* (Atentatet, f.350)

18. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha

Baba i Kadriut mban ballin e dhomës, bënë durim stoik dhe mundohet t'i inkurajojë të goditurit. Skenderin e Shtutgartit ashtu siç e ka penguar afirmimi i Kadri Zekës në demonstratën e Shtutgartit më 25 prill 1981, tani në mënyrë krejt identike e pengon afirmimi i babës së tij, Pajazitit.

A ka gjë më normale e më elementare se sa të të pengoj afirmimi i babës (Pajazit Zekës) kur veç është dokumentuar në mënyre përfundimtare se të ka penguar afirmimi i të birit (Kadri Zekës)?

I. Kelmendi*: "Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*
– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu ***do të afirmohesha****,* ***do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB-së...***
Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga inati. Xhafari nuk u përmbajt pa thënë:

– Qenka manjak e i matufosur! Po zëri i tij i gërvishtur nuk i shkoi në vesh Hakanit. Ndërsa Mirani sa nuk u ngrit ta nxirrte atë zvarrë përjashta." (Atentatet, f. 350)

Shtrohet pyetja se a ka nevojë për koment ky citat i lartshënuar?

"Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit."

A janë me të vërtetë fjalë inkurajuese apo jo? Kush mund të inkurajohet më së shumti nga këto fjalë nëse janë thënë nga baba i Kadri Zekës? Kush ka arsye të gëzohet më së shumti për këto fjalë inkurajuese? Kuptohet se këto fjalë janë inkurajuese për renë e vetë Saime Isufin dhe shokun më të ngushtë të djalit të vetë I. Kelmendin. Kuptohet ai me këto fjalë ka dashtë t'i inkurajojë të goditurit dhe do të vazhdojnë për jetë të jetëve t'i inkurajojnë të goditurit.

"Ndonjëherë, si për inat të 'trashëgimtarëve', bënte shaka në dukje marrashe."

A është preokupuar me të vërtetë babai i djalit të vrarë në ato momente dhimbje me çështje trashëgimie, se kush është trashëgimtarë e kush nuk është? A i ka interesua fare atij kjo çështje apo jo? A mos e paska harrua ai dhimbjen e vetë, nga goditja e plumbave që kanë ra mbi kokën e djalit të vetë, dhe qenka marrë me inkurajimin e të goditurve duke e ditur se kush janë të goditurit e cilët janë ata që godasin, se kush është ajo dorë vrastare që ka goditë dhe kush është njohësi i asaj dore vrastare e goditëse? A janë këto fjalë shaka, që në dukje janë marrashe? Nëse vetëm në dukje janë marrashe atëherë çka janë po të analizohen më thellë? Del po të analizohen më thellë nuk janë as shaka e as marrashe.

"– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë."

Si është e mundur të ketë kullë, muze, një person të cilin nuk e kanë njohur as në katundin fqinjë? Sa bëhet e besueshme, shkencore, historike, që komunisti, djali më besnik i vegjëlisë paska lindë në një kullë, kur as në katundin fqinjë nuk paska dëgjuar kush as për atë kullë e as për pronarin e saj? Lumja kulla kend ka brenda!

"Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta ***kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB-së..."***

Më parë e pamë se si Suzana harron vrasjen e burrit, kunatit, brengën për rritjen e tre fëmijëve të mitur, dhe preokupimi i saj themelor është që të afirmohet në hierarkinë e organizatës së Sabri Novosellës, organizatë e cila nuk ekziston më. Pas Suzanës dhe etjes së saj për afirmim, radhën e ka baba i Kadriut, Pajazit Zeka ta shprehë kënaqësinë se është bërë i afirmuar, bile duke na treguar se po ta dinte se do të afirmohej kaq shumë, vetë do ta kishte kryer veprën, do ta kishte vrarë djalin e vetë duke mos e lënë UDB-në të lodhet me këtë punë, por turpin e fajin e kësaj vepre të ndyrë e të padëgjuar ndonjëherë në asnjë kohë, në asnjë vend e në asnjë kulturë, të kryer nga ai (Pajazit Zeka) do t'ia kishte lënë UDB-së.

Shtrohet pyetja se a i ka thënë këto fjalë baba i Kadri Zekës apo jo? Historikisht kush do të njihet dhe citohet për jetë, si autor i vërtetë i këtyre fjalëve? Kush do të njihet si autori i vërtetë i këtyre frazave të fantazuara e të vendosura në gojën e babës së Kadri Zekës?

Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga inati. Xhafari nuk u përmbajt pa thënë:

– Qenka manjak e i matufosur! Po zëri i tij i gërvishtur nuk i shkoi në vesh Hakanit. Ndërsa Mirani sa nuk u ngrit ta nxirrte atë zvarrë përjashta."

A është e vërtetë se këto fjalë i kanë dëgjuar ndonjëherë 'trashëgimtarët e Jusufit' para leximit të tyre për herë të parë në mars 2007. Si është e mundur që unë, Skënderi i Shtutgartit, 'armiku' i madh e zemërkatran i Kadri Zekës, i OMLK-së, i komunistëve të

paepur gjer në fund e i revistës Liria, të pëlcas nga inati pas dëgjimit të këtyre fjalëve nga goja e babës së Kadri Zekës, Pajazit Zeka? Sikur unë me të vërtetë të kisha qenë i tillë siç më ka përshkruar I. Kelmendi dhe Saime Isufi, mos me mua është dashtë të ndodhë e kundërta, pra të pëlcas jo nga inati por të pëlcas e eksplodoj nga gëzimi. Pra unë është dashtë t'i them të lumtë se bash këto fjalë m'u kanë nevojit, se këto fjalë më kanë munguar, e jo ta kritikojë por t'i them vetëm vazhdo dhe a mos ke edhe ndonjë xhevahir e diamant tjetër të këtij lloji.

I. Kelmendit e Saime Isufit i paskan pëlqye aq shumë këto fjalë, sa vetë Mirani, përpak që nuk u ngritë e ta nxjerrë Skenderin e Shtutgartit, 'trashëgimtarin e Jusufit', zvarrë nga shtëpia e Jusufit.

Heret apo vonë këto fjalë të I. Kelmendit të vendosura në gojën e Pajazit Zekës, babait të Kadriut do të bien në dorën e trashëgimtarëve të TANJUG-ut, të UDB-së, të shkrimtarëve të UDB-së, të piktorëve të saj, të kameramanëve të saj. Do të jetë shumë interesant sikur ta dinim, se cilën anë do ta mbajnë ata? A do të inkurajohen dhe solidarizohen me të godituri apo do të pëlcasin nga inati shumë më tepër se sa 'trashëgimtarët e Jusufit'?

Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga inati.

Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga gëzimi.

*Xhafari (*Skënderi i Shtutgartit*) nuk u përmbajt* pa u distancua nga kjo shpifje e insinuatë e turpshme dhe e ndyrë, në vitin 2010, nga këto fjalë të dala nga thellësitë e errëta të shpirtit të I. Kelmendit dhe këshilltarëve të tij, e të vendosura në gojën e babait të Kadriut, të shpallura publikisht në ditën e varrimit të Kadriut, 25 vjet më vonë, më 5 shkurt 2007, të cilat nuk mund të gjenden në asnjë kohë, tek asnjë popull, tek asnjë kulturë e tek asnjë prind në botë.

Por ky distancim nuk u bë nga gruaja e Kadri Zekës, nga reja e Pajazit Zekës, Saime Isufi e cila pa asnjë rezervë të vetme, përmes një letre të shkurtë por shumë domethënëse e të publikuar nëpër disa faqe të internetit, i doli krah I. Kelmendit dhe u mundua t'ia vërtetojë çdo fjalë në përmbajtjen e këtij libri që e kemi në shqyrtim. Ky distancim nuk u bë nga asnjë shokë i Kadri Zekës, nga asnjë shokë i OMLK-së. Turpi do të rëndoj përjetë mbi ta, për këtë tradhti e pabesi që ia bëjnë shokut të vetë dhe babait të tij.

Të shohim se si e shprehë kënaqësinë Saime Isufi për portretizimin e Pajazit Zekës:

Saime Isufi*: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Mail-letër, 05.03.2007)

Mllefi kundër personazheve që janë të "*lidhur me UDB-në"* është i kuptueshëm, por çka me iu bërë atyre personazheve që janë të gatshëm me e vra fëmiun e vetë me qëllim të afirmimit dhe pastaj me e akuzuar për këtë UDB-në e cila sipas kësaj logjike nuk ta ka fijen e fajit. Por meqë këtu kemi të bëjmë me dëshmitarin e besueshëm të vëllezërve të Kadriut dhe Mehmet Hajrizit e Hydajet Hysenit, nuk po shkoj më tutje.

19. Ajkuna e thërriste Miranin pranë saj

Pas nderimit të gruas së Jusufit që është e preokupuar me çështje karriere, pas nderimit të babës së Kadri Zekës, që do ta kishte vrarë djalin e vetë më të zgjuar e më të vyeshëm po ta dinte se do të afirmohej aq shumë, radha i vjen edhe Nënës së Jusufit, që edhe ajo ta merr hisen e vetë, e të portretizohet në mënyrë të ngjashme nga I. Kelmendi.

I. Kelmendi: *"Të godituri mundoheshin të gjenin ndonjë rast për të ndenjur larg pranisë se "trashëgimtarëve", por këta shpirtkatranë vigjilonin gjithandej. Nënëmadhja fliste tepër rrallë, më shumë si rrjedhojë e neverisë që po i shkaktonin*

“trashëgimtarët”, se sa nga goditja. Ajo po mbahej si të ishte Ajkuna e legjendave. Kur gjente ndonjë rast të përshtatshëm, sido mos kur aty nuk ishin “trashëgimtarët”, ajo thërriste Miranin pranë saj për të qarë halle, siç bën rëndom nëna me të birin në këso raste të rënda." (Atentatet, f. 350-351)

Nga kjo rrjedh se edhe nëna e Jusufit qenka preokupuar më shumë se kush janë të goditurit (I. Kelmendi etj.), njohësit e duarve vrastare të goditësve vrastarë e kush 'trashëgimtarët'. Ajo, Ajshja fletë rrallë, më shumë si rrjedhojë e neverisë që ia shkaktonin 'trashëgimtarët', se sa nga goditja. Pra ajo e harron goditjen e vetë që ia kanë vra dy djem dhe neveritet pse nuk po u jipet haku i vërtetë të goditurve të vërtetë, pra trashëgimtarëve të vërtetë. Ajo e thërriste Miranin, (I. Kelmendin) njohësin e dorës vrastare të djemve të vetë, nipin e Dajës Ramë për të qarë halle, siç bënë rëndom nëna me të birin (nëna me njohësin e dorës vrastare të djemve të vetë) në këto raste të rënda.

Projekti për shembjen e mitit të Jusufit, për të qenë i plotë ai nuk mund të kufizohet vetëm me Jusufin, por ai duhet të përfshijë gruan, fëmijët dhe nënën e tij.

A do të kishte vdekje më e madhe për Jusufin, sikur vërtetë Nëna e Jusufit të ketë qarë halle me I. Kelmendin, me njohësin e dorës vrastare të djemve të saj, me atë I. Kelmendi në të cilin të gjithë shokët e familja e Jusufit kanë dyshuar se ka njohuri të thella për vrasjen e Jusufit e Bardhit, që nga momenti i vrasjes e deri më sot, dyshime të cilat janë tregue shumë të drejta dhe shumë të justifikuara sidomos pas botimit të librit Atentatet (që më vete përbën një dokument shumë të çmuar) dhe intervistave të karakterit dokumentar të I. Kelmendit gjatë vitit 2007.

Nëna e Jusufit krijon besim ndaj I. Kelmendit. Pra asaj nuk i nevojitet mendimi i rejave të veta Suzanës e Tushës dhe as i nipit të vetë Haxhi Berishës e shokut të tij të pandashëm Naim Haradinajt, për t'u treguar se kush është I. Kelmendi, e kush janë të pranishmit e përhershëm ato ditë në shtëpinë e djemve të saj, por bazohet në sensin e saj të rryer jetësor dhe i drejtohet pikërisht I. Kelmendit, njohësit të dorës vrastare të djemve të saj dhe e pyet se kush janë ata të pacipë që ia kanë uzurpuar shtëpinë e zotshpillakun e bijve të saj, kur ai zotshpillak që sipas rendit e traditës (apo thënë më drejtë sipas planit të vrasësve) do të duhej t'i takonte pikërisht njohësit të dorës vrastare të bijve të saj.

I. Kelmendi*: "Nënëmadhja kishte krijuar besim e konfidencë ndaj Miranit duke u mbështetur në intuitën dhe sensin e saj të rryer jetësor. Ndaj nuk hezitonte që ta pyeste se kush ishin këta të pacipë që ia kishin uzurpuar shtëpinë e bijve të saj."* (Atentatet, f.351)

A ka më vdekje e më shembje më të madhe të mitit të Jusufit, sikur nëna e tij me sensin e vetë të rryer të jetës, në vend që të qaj halle e të bisedoj me dy rejat e veta e me nipin e vetë Haxhi Berishën, t'i drejtohet për këshilla, qarje hallesh e informime pikërisht njohësit të vrasësve të bijve të saj.

20. Ajo i merrte duart e Miranit në duart e saja

A ka pamje më makabre sikur Nëna e Jusufit dhe Bardhit të vrarë, të kishte zhvilluar biseda të stilit 'nënë e birë' dhe t'i merr në duart e saja të regjura e të rrudhura, duart e I. Kelmendit, njohësit të duarve vrastare të djemve të saj, njohës i cili ka pritë 25 vjet që ta 'zbardhë', nxijë këtë rast.

I. Kelmendi: *"Gjatë këtyre bisedave, si mes nënës e të birit, ajo ia merrte duart **Miranit** në duart e saja të regjura e të rrudhura. Kështu bëjnë nënat kur ndjejnë dhimbje të madhe për të birin e cfilitur."* (Atentatet, f. 351)

Nëna e Jusufit dhe e Bardhit i harron djemtë e vetë të vrarë dhe e koncentron dhimbjen 'për të birin e cfilitur' I. Kelmendin, njohësin e duarve vrastare të djemve të saj.

Sikurse edhe tek rasti i babës së Kadri Zekës, këto skena makabre janë zhvilluar vetëm në thellësitë e errëta të shpirtit të I. Kelmendit. Nëna e Jusufit, pikërisht sikurse Suzana e Tusha me të gjithë shokët e Jusufit në Shtutgart kanë dyshuar se I. Kelmendi ka njohuri të thella dhe të veçanta për atentatin në Jusufin e Bardhin.

Nëna e Jusufit e sheh se njohësi i dorës vrastare të djemve të saj, Mirani (I. Kelmendi) është i cfilitur deri në dërmim, Saime Isufi e Pajazit Zeka rrinë të strukur, fëmijët e Jusufit dhe gratë e Jusufit e Bardhit kanë frikë nga nipi i vetë Haxhi Berisha, nga Nuhi Sylejmani, Naim Haradinaj, Xhafer Durmishi e Hafiz Gagica, kontakte me të cilët këta anëtarë familje (me përjashtim të Xhafer Durmishit) i kanë pasë të përditshme gati gjatë gjithë vitit 1980 e 1981.

I. Kelmendi*: "Nënëmadhja po i lexonte vetë pothuajse të gjitha prapësitë që inskenonin "trashëgimtarët". I lexonte ajo në sytë, tkurrjet dhe dronë e fëmijëve të Jusufit, në cfilitjen dërrmuese të Miranit, në strukjet e Sarandës, babait të Kadriut, në tërheqjen e nemitur të të resë, Tinës, bashkëshortes engjëll të Bardhit,... I vështronte dhe ofshante, por edhe ofshamat i kishte të fshehta. Nuk dëshironte t'i kënaqte "trashëgimtarët" kopukë."* (Atentatet, f.351)

A ka shembje më të madhe të mitit të Jusufit sikur Nëna e tij të harronte dhimbjen e vetë dhe të koncentrohet kryesisht në të goditurit e vërtetë e tek njohësi i dorës vrastare I. Kelmendi. Në projektin për shembjen e mitit të Jusufit, I. Kelmendi dhe këshilltarët e tij janë të pasigurt dhe janë të vetëdijshëm se gjenden para një detyre të pamundur, prandaj çdo ndihmë për ta është e mirëseardhur. Në shërbim u hyjnë të gjithë ata që mund të kontribuojnë; baba i Kadriut, gruaja e Jusufit e Bardhit, fëmijët e Jusufit, gruaja e Kadriut etj.

I. Kelmendi harron se më parë na tha se baba i Kadriut, gjendej në ballin e vendit prej nga i inkurajon të goditurit, ndërsa disa rreshta më poshtë, pasi e ka shndërruar në vrasës së djalit të vetë me të vetmin motiv që të afirmohet, baba i Kadriut nuk i nevojitet në ballë të vendit por i duhet që të jetë i strukur së bashku me renë e vetë Saimen.

21. Varrimi i Yjeve të pashuara të qiellit shqiptar

Më 5 shkurt 1982 varrosen Vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka, në varrezat kryesore të Shtutgartit. Pikërisht në këtë ditë, 25 vjet më vonë, më 5 shkurt 2007 në Hotel Viktoria, në Prishtinë lansohet projekti për varrosjen e vërtetë dhe shembjen e mitit të pashembur të Jusufit, i cili falë shokëve të Jusufit, pëson disfatë katastrofale.

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi. Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim, kur dihet se Sabri Novosella (Mërgimi), emigrant në Turqi, asnjëherë nuk e kishte marrë mundimin për riorganizimin e LNÇKVSHJ-së, por e kishte krijuar (apo ishte kyçur) në një organizatë krejt tjetër, të quajtur „Komiteti Hasan Prishtina“. Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë drejt dobësimit apo* ***shuarjes*** *totale."* (Fjalë të vendosura në librin- Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.124)

Ramadan Pllana: "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."* **(**DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ, mars 2009, www.pashtriku.org)

I. Kelmendi*: "Më 5 shkurt, në varrezat e qytetit të Stuttgartit po vinin shqiptarë nga të gjitha anët." (Atentatet, f.376)*

Më 5 shkurt 2007, disa të ftuar po vinin dhe u tubuan në Hotel Viktoria në Prishtinë.

Monologje të I. Kelmendit, të prezantuara si dialogje në mes Nënës së dy djemve të vrarë dhe njohësit të dorës vrastare. Nënën Ajshe, Nënën e dy djemve të vrarë e mban në këmbë njohësi i dorës vrastare, dhe ecin së bashku, nëna e të vrarëve me njohësin e vrasësve, duke i tërhequr hapat zvarrë-zvarrë.

I. Kelmendi*: "Nënë Ajshen po e mbante Mirani për krahu dhe po ktheheshin me hapa që i tërhiqnin zvarrë-zvarrë drejt daljes nga varrezat.* (Atentatet, f.377)

I. Kelmendi i tregon Nënës së Jusufit se pas kryerjes së ceremonisë së varrimit do të largohet nga shtëpia e Jusufit për fajin e 'trashëgimtarëve'.

I. Kelmendi: *"– Ku do shkosh tani, djali i nanës? Mezi e shqiptoi pyetjen Nëna Ajshe.*
– Përse po ma bën këtë pyetje, Nënëmadhe? – ia bëri ai.
– Hëëëëëm, mor djali i nanës, mos kujto se pleqnia më ka matufosun. Të gjitha i kam pa n'sytë e tu. E di nana. Ti nuk ki ma vend në shtëpinë e bijve të mi, që tani i ***rehatova nën tokën gjermane****. Aty po komandojnë kopukët e hileçarët. Por, ti e di gjithashtu se tani as nana nuk ka ma vend aty. Ishalla vijnë kohë ma të mira për ne!...*

Të dy iu hodhën në përqafim njëri-tjetrit dhe mbetën ashtu për disa çaste, si të ishin shndërruar në statujë.
Mirani shkoi në ish-shtëpinë e Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla, paketoi plaçkat që kishte në ***ish-dhomën e tij****, u përshëndet me fëmijët dhe gratë e shokëve me keqardhje të madhe dhe iku që andej duke mbajtur kokën prapa për të parë shtëpinë derisa i humbi nga shikimi.*

Ditëve në vazhdim Mirani nuk u kthye më në atë shtëpi dhe as mori vesh se kur dhe si e lëshuan Gjermaninë dhe ku shkuan gratë dhe fëmijët e Jusufit dhe Bardhoshit. "Trashëgimtarët politikë" të Jusufit, Xhafari me sejmenë, kishin vendosur t'i izolonin ata nga Mirani. Atë e digjte malli sidomos për fëmijët e Jusufit, me të cilët kishte pasur një afërsi të madhe." (Atentatet, f. 377-378)

Donika Gërvalla: *"Kelmendi ka një talent të madh që të vërtetat e vogla t'i ndërlidh me gënjeshtra të mëdha. Ai ka shumë kohë që mua përpiqet të më kontaktoj, më dërgon letra herë mbas here, por unë nuk kam asnjë lloj interesi të bisedoj me te krejt pavarësisht nga roli i tij apo nga asnjë lloj roli që mund të ketë pasur në organizimin e kësaj vrasjeje."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.56-5.20)

22. Shkolla e UDB-së dhe amaneti i Jusufit

Shkolla e UDB-së Serbe: "*Sjelljet e tilla më dukeshin jo shoqërore, jo miqësore,* ***sjellje që nuk i përkisnin një prijësi, një intelektuali, e aq më pak një udhëheqësi të denjë të „Frontit të Kuq Populllor!****" Çdo afrim timin drejt tij, çdo tentim bisede nga ana ime e priste me një injorancë përbuzëse dhe fodulle, por unë e ndjeja se nuk ndodhesha në atë shtëpi për sherr, në atë shtëpi ku vrasja tragjike e kryefamiljarëve ishte e freskët, e rëndë dhe e tmerrshme! Unë ndodhesha aty për ta përmbushur amanetin e fundit të Zotit të Shtëpisë!" (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.72)

Sipas Shkollës së UDB-së Serbe amaneti i Jusufit i ka dy pjesë: E para ka të bëjë me atë se çfarë duhet të bëhet me Lëvizjen e tij Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Në këtë pikë plani së Shkollës së UDB-së Serbe është;

Shkolla e UDB-së Serbe: ***"****Edhe pas propozimit tim që të* ***formohej një organizatë e ngjashme politike*** *e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë, e cila e kishte pranuar zëvendësimin e autoritetit të burrit të saj me njëfarë Skënder Skënderin, dhe e heshtur i ishte nënshtruar diktatit fantazmë të Sabri Novosellës." (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 88)

Pjesa e dytë e amanetit të Jusufit ka të bëjë me familjen në shtëpinë e tij. Në këtë pikë sipas Shkollës së UDB-së Serbe amaneti i Jusufit është që çelësat e shtëpisë së tij të pamposhtur, t'i epen Ibrahim Kelmendit, nipit të UDB-së Serbe.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Suzana na ftoi* ***në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.*** *...* ***në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Populllor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të populllit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose*

Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ... Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (*Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)*"*

Shkolla e UDB-së Serbe*: "... e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në* ***dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Faridin Tafallari: *"Suzana:* ***A pe ndonjë njeri?***

Jusufi: ***Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52)*

Suzana Gërvalla*: "Ai ishte gjithashtu anëtar i KQ të LNÇKVSHJ. Pas demonstratave të vitit 1981, ai zhvillon aktivitet të dendur. Kështu ai ishte edhe Kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë të cilën e kreu* ***deri në çastin e vdekjes****."* (Biografi e Jusuf Gërvallës)

23. Varrim madhështor

Kur jemi tek çështja e varrimit më 5 shkurt 1982 në Shtutgart është shumë me interes t'i shohim përshtypjet e anëtarëve të familjes Kadriut.

Apostol Duka: "Taip Zeka: *Atëherë kam marrë babën, edhe Ahmet Isufi erdhi prapë me ne, nana e Isufit kishte pas mbërri edhe ajo gjatë kësaj kohe dhe varrimi u ba me bashkatdhetarë. Një varrim aty, qysh i ka hije me u ba. Me përgatitje shumë të mëdha, me krejt...."* (Vrasje në Shtutgart, faqe 26)

Xh.Durmishi, Premton dhe Mirjeta Gërvalla tek varrezat e Shtutgartit, mars 1982 (Foto: Faridin Tafallari)

...Kur janë rivarrosë Kadriu, Isufi e Bardhi, u ba ndarja e tyne, kur ata nuk i kishte nda as vdekja ***dhe as ai varrim madhështor në Gjermani****.."* (Vrasje në Shtutgart, faqe 40)

Sabri Novosella: "*Varret ishin të rregulluara shumë mirë, me lapidar për secilin veç e veç. Në lapidar shkruante: Atdhetari Jusuf Gërvalla, Atdhetari Bardhosh Gërvalla, komunisti Kadri Zeka. Ishte zhvilluar një debat i gjatë kur ishte vendosur se si të shkruhet në lapidar, "atdhetar" apo "komunist". Hafiz Gagica e Xhafer Durmishi ishin konsultuar me mua dhe unë nuk kisha lejuar që në lapidar kurrsesi të mos shkruhet epiteti komunisti, por atdhetari. Këtë e kishte përkrahur edhe gruaja e Jusuf*

Gërvallës, Suzana. Gruaja e Kadri Zekës, Saime Jusufi, Hasan Mala, ndërkaq, kishin qenë kategorik që të shkruhet epiteti "komunisti" mbi lapidar. Ashtu edhe ishte vepruar. Jusufit e Bardhoshi t'u shkruhej "atdhetari", ndërsa Kadriut "komunisti". (Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.177-178)

Varrimi i 5 shkurtit 1982 në Shtutgart ka qenë varrim sa i thjeshtë aq edhe madhështor. Në çështjen e formës, germave dhe simboleve në gur nuk ka pasur ndikim as Suzana e as Sabri Novosella. Gurët e varreve janë vendosur nga firma e caktuar në vjeshtë 1982. Kjo është bërë për shkak se duhet të kaloj një kohë e mirë derisa të qetësohet dheu mbi varre. Në këtë kohë Suzana ka qenë në Shqipëri dhe lidhjet me te nuk kanë qenë të lehta. Megjithatë, nga fjalët e mësipërme del se Suzana apo Sabri Novosella, epitafin e Jusufit, tekstin mbi gurin e Jusufit e Bardhit, ashtu si dhe fjalët për veprën e idetë e tyre do t'i kishin skalitur më mirë. Me shokët e Kadri Zekës nuk është bërë kurrfarë debati në këtë pikë. Ata nuk i kemi pyetur për epitafin e Jusufit dhe Bardhoshit dhe ata nuk na kanë pyetur apo marrë leje se çka të shkruajnë në gurin e varrit të Kadri Zekës. E vetmja pyetje për firmën e gurëve ka qenë: a është e mundur që një sfond i shqiponjës në gurë të jetë me ngjyrë të kuqe si në flamur. Përgjigja gjermane ka qenë: Jo! Ngjyra e kuqe nuk përdoret në gurët e varrezave. Edhe kjo temë është mbyllë me një pyetje të vetme dhe këtu nuk ka pasur kurrfarë debati as me gjerman e as me shokët e Kadri Zekës.

24. Trajtimi i OMLK-së në shtëpinë e Jusufit

A është e vërtetë se I. Kelmendi është larguar nga shtëpia e Jusufit në ditën e ceremonisë së varrimit më 5 shkurt 1982, pra pas kryerjes së kësaj ceremonie apo jo? A ekziston ndonjë dëshmitarë i gjallë që mund ta vërtetoj këtë fakt? A ekziston ndokund ndonjë letër e shkruar me dorën e I. Kelmendit që e vërteton këtë fakt? Të shohim se çka shkruan Faridin Tafallari në këtë pikë.

Faridin Tafallari: "Ato ditë, me rastin e vrasjes tragjike, nga dora gjakatare e UDB – së, e tre YJEVE, Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, LNÇKVSHJ përgatiti dhe shpërndau traktin: *" Jemi më të fortë...!*

Më 17 janar 1982, në orën 22,30, në Untergruppenbach (afër Shtutgartit) ranë për të mos vdekur kurrë, nga bandat kriminale të UDB –së titiste tre shokët tanë të pandarë në luftën tonë për të drejta dhe liri. Ishin këta shokë : 1) Jusuf Gërvalla – 36 vjeçar, 2) Kadri Zeka (Zeqa)- 28 vjeçar, 3) Bardhosh Gërvalla – 31 vjeçar.

UDB –ja titiste e Beogradit me terrorin e tyre për të mos lënë shqiptar mbi faqen e dheut tonë, edhe kësaj here vrau me dinakëri, siç e ka zakon, në mes të natës, këta tre shokë, të cilët deri në momentin e fundit të jetës së tyre nuk kursyen asgjë për çlirimin e popullit tonë nga zgjedha titiste e Beogradit. (...)

Kosovë, qëndro krenare, se bijtë e tu ranë dëshmorë, për të mos vdekur kurrë! Ne menduam se do të bashkohemi në Kosovën e lirë, pranë nënave, t'jau shërojmë plagët, por ja, në vend që t'i kthehemi Kosovës me grushtin lart, po kthehemi theror, me porosinë e fundit : Lufta duhet vazhduar....! "

POPULLI DO JU MARRË HAKUN!
VDEKJE ARMIQVE – LIRI POPULLIT!
LUFTA JONË ËSHTË E DREJTË DHE DO TË FITOJË !
KOSOVA – REPUBLIKË!"

Ky trakt i LNÇKVSHJ, i shkruar në shtëpinë e Jusufit, nuk u nënshkrua në emër të Lëvizjes së Jusufit, për të mos prekë e as lënduar në mënyrën më të vogël askënd, duke pasur parasysh ngjarjet e bisedimet, që ishin zhvilluar më parë në mes të organizatave.

Më 5 shkurt është bërë varrimi i të vrarëve.

Më 13 shkurt Xhafer Durmishi shkon në Munchen në mënyrë, që nga aty të udhëtoj për në Turqi, për t'i raportuar Sabri Novosellës mbi gjendjen e krijuar në Untergruppenbach dhe Lëvizjen e Jusufit. Dhe më 22 shkurt 1982 Xhaferi kthehet nga Turqia në shtëpinë e Jusufit në Untergruppenbach, ku gjen të gjithë shokët e Jusufit nga rrethi i Shtutgartit, dhe gjithashtu Saime Isufin, Hasan Malën, Ibrahim Kelmendin, etj., ashtu siç i kishte lënë para se të nisej për rrugë.

Hasan Mala, Saime Isufi dhe Halil Mala (Foto: Faridin Tafallari, 21 janar 1982)

Më datën, 24 apo 25 shkurt Xhafer Durmishi shkruan këtë NEKROLOGJI, për TRIMAT , e vrarë në tragjedinë e 17 janarit të kobshëm.

"Nekrologji

Jusuf Gërvalla (...) Ishte anëtarë i KQ të LNÇKVSHJ. Aktivitet të bujshëm zhvillon sidomos pas demonstratave të Pranverës 1981. ***Si anëtarë i KQ, ai ishte edhe kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë në të cilën ishte deri në çastin e vdekjes.***

Jusuf Gërvalla u vra në mbrëmjen e 17 Janarit të vitit 1982, afër banesës së tij në Untergruppenbach, por emri i tij do të jetoj përherë në zemrën e popullit dhe do të shërbejë si frymëzim për të gjithë luftëtarët e lirisë.

Bardhosh Gërvalla,(...) Anëtar i LNÇKVSHJ ishte nga viti 1977. Për meritat e mëdha dhe besnikërinë ndaj atdheut u zgjodh sekretar i degës së LNÇKVSHJ për Gjermaninë Perëndimore. Bardhosh Gërvalla si shumë bashkatdhetarë shkoi me mall të Kosovës, sepse pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi larg saj. Vdiq, duke e mundur vdekjen, më 17 Janar 1982 si luftëtar i pakompromis për të drejtat e popullit shqiptar në Jugosllavi. Bardhoshi (Besniku) do të jetoj përgjithmonë në zemrën e popullit.

Kadri Zeka (...) Ishte anëtar i një organizate motër. Atë mbrëmje ndodhej tek vëllezërit Gërvalla për bisedime, të cilat bëhen në mes luftëtarëve, shokëve të idealit. (...) 17 shkurt 1982 Redaksia e revistës 'Liria'"

Kjo Nekrologji e shkruar nga Xhafer Durmishi, fillimisht dhe nga i tërë teksti duket se është përpiluar nga pozitat e LNÇKVSHJ, dhe ka qenë mendimi i tij ta nënshkruaj LNÇKVSHJ. Për këtë e tregon më së miri fjalia ku për Kadri Zekën thuhet se : "Ishte anëtar i një organizate motër". Redaksia e 'Lirisë' do ta kishte të pamundur ta quante personin e vetë kryesor (Kadriun) anëtar të një organizate motër. Por duke qenë në

Shkolla e UDB-së e Serbe: *"Bulen (Saime Isufin-shën im) as që e pyeste kush. Ajo trajtohej si Hirushe (Cinderella -shën im) e shtëpisë."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f.118)

Ismet Rashiti: *"Nga të katër anët filluan protestat e shqiptarëve. Kudo shprehej hidhërimi i papërmbajtur, revolta e papërshkruar. Kërkohej zbulimi i atentatorëve. Kështu ndodhi edhe në demonstratën e 26 janarit të udhëhequr nga Saime Isufi, në të cilën pjesëmarrësit njëherësh, u betuan se do ta vazhdojnë luftën e drejtë në bazë të mësimeve të tyre.*" (Përjetësia e dëshmorëve, www.pashtriku.org, 15 janar 2010)

Sabri Hamiti: "*ZANA (Suzana Gërvalla - shën i Xh. D.), me mëdyshje. (për Saime Isufin - shën i Xh. D.) S'e kam takuar kurrë. As në shtëpi nuk më ka qenë. Jemi ndarë jo mirë, në kohën kur po mirreshim me varrimin. Ishte fort luftarake, s'donte të ndiente për dhimbjen, apo luante ashtu. Shtronte kërkesa bashkë me Keqën, por nuk bënte gjë prej gjëje. Tash kam mirëkuptim për të. Ka qenë tepër e re dhe e padijshme."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 94)

Nga fjalët e mësipërme shihet se numri i palës së këpucëve (të Hirushes-Cinderella) të Shkollës së UDB-së Serbe të promovuara në Ambasadën e Bernit, Ismet Rashitit dhe Suzana Gërvallës nuk përputhen në asnjë pikë.

shtëpinë e Jusufit, Xhaferi e ka të pamundur, (për hir të Jusufit), me e shfrytëzua epërsinë e vendit dhe me e nënshkrua LNÇKVSHJ. Për këtë arsye ia jep Saime Isufit, që ta lexoj dhe i kërkon leje, që ta nënshkruaj në emër të Redaksisë së revistës "Liria", me bindje të plotë se po të ishte gjallë Jusufi, ashtu kishte me veprua. Saime Isufi, pasi e lexon, e jep pajtimin që Nekrologjia të nënshkruhet në emër të Redaksisë së revistës "Liria". Me këtë pajtohet edhe Ibrahim Kelmendi. Kështu nënshkruhet dhe kështu shpërndahet. Xhaferi e zgjedhë për datë të përpilimit pikërisht 17 shkurtin 1982, kur ai me pseudonimin Skënderi, në këtë datë, në kryeqytetet osmane ka takuar osmanët. Me këtë Skënderi ka dashtë të tregojë se përderisa ai ka takuar osmanët në Perandorinë osmane, "zotë shtëpie" në shtëpinë e Jusufit ka qenë Redaksia e "Lirisë" dhe jo në gjysmë por në maje të shtizës ka valua flamuri i "Lirisë".

Prej momentit të vrasjes e deri në përfundim të të pamunit, kjo Nekrologji është i vetmi dokument që është lëshuar në emër të një organizate, dhe atë në emër të OMLK e revistës "Liria".

Kjo Nekrologji dëshmon se, pothuajse 20 ditë pas varrimit ka ekzistue (përkundër dyshimeve e hidhërimeve me vend e pa vend) një atmosferë e mirë në Untergruppenbach dhe në shtëpinë e Jusufit i është dhënë moral e forcë njëri tjetrit. Saimja e Hasan Mala janë larguar nga e pamja, kah 5 marsi 1982 d.m.th. fiks një muaj ditë, pas ditës së varrimit. Në kulmin e atij dëshpërimi të madh dhe të asaj dhembje që nuk po njihte kufi, për humbjen e Jusufit të Madh, Bardhoshit e Kadriut, "zotëria e tij",

Ibrahim Kelmendi, na këndonte pa pra këngën e Shote Galicës!!? ...Dhe ka vazhduar të qëndroj aty, deri kah 15 marsi...dhe nuk ka pas ndërmend të shkoj në shtëpi të vet, derisa Suzana, nuk ka mund ta duroj më dhe i ka thënë nipit të Jusufit, Haxhi Berishës nga Prapaqani, ta përjashtojë nga shtëpia!!!" (Me Tre Yjet e Pavdekësisë, Tiranë 2010, f. 70-74)

Jusuf Gërvalla: *"Shokët e Vjenës (të Ambasadës së Shqipërisë - shën im) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K. (Ibrahim Kelmendin-shën im), i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

INSPEKTORI DHE NIPI

Gara në mes ish-inspektorit të UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica dhe nipit të UDB-së Serbe, Ibrahim Kelmendi.

1. Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë
2. Sabri Novosella e përzgjodhi Nuhi Sylejmanin
3. Inferioriteti vandal i burrit të papërkulshëm
4. Ishte i angazhuar në përgatitjen e Zërit të Kosovës
5. Ai nuk përfillte askënd
6. Po ta dija se do të afirmohesha
7. Internacionalizmi proletar i udbashit "komunist" dhe hienat sllave
8. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla
9. E kemi dëshminë se si u bë trashëgimtarë
10. Uzurpuesit e zotshpillakut u imponuan si trashëgimtarë

Cili është motori apo forca lëvizëse në garën në mes ish-inspektorit të UDB-së Serbe dhe nipit të UDB-së Serbe? Si inspektori (në mënyrë indirekte) ashtu edhe Nipi në mënyrë direkte, mundohen me të gjitha metodat e tyre për të na treguar se i kanë qëndruar Jusuf Gërvallës më së afërmi, dhe në çastet e fundit të jetës, Jusufi, me plumbat e UDB-së Serbe në trup, nuk e ka pasur vëmendjen askund tjetër, as tek jeta e familjes së vet, as tek Lëvizja dhe revista e vet me fjalët e shkruara prej tij, por vetëm e vetëm tek Shkolla e UDB-së Serbe dhe Nipi i Dajës Ramë.


Eshtë nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj,punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës mjedhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë*

fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...

...Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"
Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

1. Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë

Shkolla e UDB-së: "*Me Skënder Skënderin isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 88)

Ramadan Pllana: *"... Xhafer Durmishi... Tani, në shkrimet e tyre, këta „dëshmohen“ si „shpëtimtarë“ të LNÇKVSHJ-së dhe si „trashëgimtarë“ të Jusuf Gërvallës"* (www.pashtriku.org, 15 shkurt 2011)

> Faridin Tafallari: *"Xhafer Durmishi erdhi tek Jusufi dhe Jusufi e donte, se ai ishte besnik. Ne e mirëpritëm dhe e nderuam, se e la Jusufi, por ama nuk e la për trashëgimtar, se ai nuk besonte, se një ditë do ta ndalte hovin drejt veprës së tij të madhe."* (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, f. 303)

Ramadan Pllana: "*Në faqet 375-358 (të librit Terror-Dhimbje-Qëndresë të F. Tafallarit-shën im)* ***kemi dëshminë se si u bë Xhafer Durmishi “trashëgimtar” i Jusuf Gërvallës,*** *me direktiva të Sabri Novosellës, në letrën dërguar Komitetit të degës së LRSHJ “Hasan Prishtina” në Stamboll, pra nuk thirret më dega e LNÇKVSHJ-së, shkruar më 26 shkurt 1982: (...) Pra komiteti i degës së LRSHJ „Vëllezërit Gërvalla“ për Evropën perëndimore ka këtë përbërje: ... 1. Shpendi Kryetar - (Xh. Durmishi)"* (www.pashtriku.org, 15 shkurt 2011)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së* ***tij më përzgjodhi mua*** *për t’u përkujdesur për gjënë më të shenjtë që e ka njeriu në jetë, familjen, apo pati të drejtë Xhafer Durmishi të shpallej apo të vetëshpallej si zëvendës i tij pas vdekjes! Një gjë është e qartë: para se të vdiste Jusuf Gërvalla, nuk i ishte kujtuar askujt të kishte lënë ndonjë amanet që njëfarë Xhafer Durmishi duhej ta zëvendësonte atë pas vdekjes!?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

2. Sabri Novosella e përzgjodhi Nuhi Sylejmanin

Ibrahim Kelmendi: *"Miranit nuk po i dilej, meqë ende nuk i kishte kaluar*

hidhërimi nga reagimi arrogant i Nuriut. Në këtë gjendje, megjithatë, vendosi ta pyeste Dritën:

– Si mundi të të urdhërojë kaq shpejt ai udhëheqësi nga Turqia, kur ju nuk keni telefon!?

-Ai (Sabri Novosella -shën i Xh. D.) nuk më telefonoi mua, por kur erdhi Nuriu më tha se e kishte urdhëruar udhëheqësi ynë që ai ta drejtonte ceremoninë mortore derisa të vijë një shok nga Kosova. Pastaj ai do ta zëvendësojë Jusufin. Drita shpjegonte duke i tërhequr fjalët zvarrë ngase po i mungonte vullneti përkatës." (Atentatet, f.340)

Shkolla e UDB-së: "*Nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë, e cila e kishte pranuar zëvendësimin e autoritetit të burrit të saj me njëfarë Skënder Skënderin, dhe e heshtur i ishte nënshtruar diktatit fantazmë të Sabri Novosellës*." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.88)

3. Inferioriteti vandal i burrit të papërkulshëm

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit", ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...** Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 7- 8)

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit", ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Shkolla e UDB-së: "***Edhe pas propozimit tim që të formohej një organizatë e ngjashme** politike e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë...*" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.88)

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...** Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 7- 8)

Shkolla e UDB-së: "*Që isha bërë **pengesë** për „kryesorin" (Xhafer Durmishin), zëvendësin e Jusuf Gërvallës, e kisha vërejtur qysh ditën e parë kur ai u vendos në familjen Gërvalla. Gjatë gjithë kohës ai e kishte sabotuar çdo nismë, aktivitet apo propozim timin."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.148)

4. Ishte i angazhuar në përgatitjen e Zërit të Kosovës

Shkolla e UDB-së: "*Me Skënder Skënderin **isha takuar vetëm njëherë** në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 88)

Ibrahim Kelmendi: *"Xhafari gjatë vitit 1981 **ishte shpesh te Jusufi dhe ishte angazhuar për ta ndihmuar atë në përgatitje të Zërit të Kosovës.** Pastaj shkonte në Kosovë dhe atje nuk i ndodhte asgjë, sado që nuk kishte praktikuar ndonjë konspiracion për të qenë. Dhe tani rrëfente se për atentatin ishte informuar nga një polic duke qenë në një ëmbëltore në Prishtinë. Prej atje vinte pa ndonjë pengesë për të trashëguar*

vendin e Jusufit, sepse kështu duhej të kishte vendosur udhëheqësi Sabit." (Atentatet, f. 342)

Shkolla e UDB-së: "*Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva Suzanës, se Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.88)

Ibrahim Kelmendi. "*Miranin e provokoi mënyra se si e filloi Xhafari fjalën e tij, që më se paku i shkonte një trashëgimtari të Jusufit në atë moment, prandaj nuk mundi të përmbahej pa ndërhyrë.*" (Atentatet, f.342)

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...**. Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 7- 8)

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

5. Ai nuk përfillte askënd

Ibrahim Kelmendi: *"Atmosfera në shtëpi të Familjes Gërvalla është e shumëllojshme. Për të goditurit rëndë nga atentatet kjo atmosferë është shumëfish e rënduar. Për "trashëgimtarët" politikë të Jusufit e Bardhit, ishte tepër ngazëllyese si të jetonin në ekstazë."* (Atentatet, f.349)

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Shkolla e UDB-së: "*Ndodhesha para një sprove të re. Deri në një masë, njerëzit ishin njoftuar për „zëvendësin“ e Jusufit. Ai nuk përfillte askënd."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.88)

I. Kelmendi: *"Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të **bashkëpunojmë** për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte **bashkëpunuar** përpara, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues...., - Nuh. (Nuhi Sylejmani-shën im) dhe Nexh. (Nexhati - 'Osman Osmani -shën im'-, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...). Unë nuk munda ta kuptoj se Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të paeksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexhati, **sa për Nuhiun të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë**."* (Letër QE, 30 qershor 1983)

Shkolla e UDB-së: "*Gjatë periudhës 116 ditore, sa qëndrova pranë këtyre familjeve, duke e ndarë dhembjen dhe dëshpërimin me to, u ballafaqova herë hapur e herë tinëz me akuza të rënda, fyerje të paskrupullta, intriga e kurthe nga më të ndryshmet. Të gjitha këto më erdhën si peshqesh nga disa „shokë“ të vetëshpallur si zëvendës, si prijës e trashëgimtarë të rrugës e luftës së Jusufit, Kadriut e Bardhoshit, deri në çlirimin e atdheut."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.158)

Ibrahim Kelmendi: *"Trashëgimtarët" vazhdonin të rrinin kokë me kokë, në mënyrë demonstrative e provokative, duke pëshpëritur se si do të duhej të vinin në skenë prapësitë e tyre të radhës."* (Atentatet, f.349-350)

6. Po ta dija se do të afirmohesha

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së* ***tij më përzgjodhi mua...*** *!?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: "*Drita dukej e mpirë dhe e hutuar nga mizanskenat që po i ndodhnin para syve të saj, të kurdisura nga "trashëgimtarët" politikë."* (Atentatet f. 350)

Shkolla e UDB-së: *"Tensionet në mes të „zëvendësit" brenda familjes Gërvalla vazhdonin në stilin „ngreh e mos këput!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.93)

Ibrahim Kelmendi: *"Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*
– Isha fare i panjohur,– tha ai kur i kërkuan të fliste.– Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. ***Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha****, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB-së...*
Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlcitën nga inati." (Atentatet, f.350)

Shkolla e UDB-së: *"Krenar dhe i pathyeshëm dukej Skënder Skënderi... Vetë „të qenit" zëvendës i Jusufit ia krijonte një ndjenjë të tillë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.93)

Ibrahim Kelmendi: *"Të goditurit mundoheshin të gjenin ndonjë rast për të ndenjur larg pranisë se "trashëgimtarëve", por këta shpirtkatranë vigjilonin gjithandej. Nënëmadhja fliste tepër rrallë, më shumë si rrjedhojë e neverisë që po i shkaktonin "trashëgimtarët", se sa nga goditja."* (Atentatet, f.350)

7. Internacionalizmi proletar i Shkollës së UDB-së dhe hienat sllave

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ky ishte nderi i trimit të paepur të kauzës kombëtare, nderi i zëvendësit të vetëshpallur të Jusuf Gërvallës... pra, ishte nderi i shokut Xhafer Durmishi me kompaninë e tij, që e kishin nisë luftën për ta çliruar atdheun e pushtuar e të nëpërkëmbur nga* ***hienat sllave****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: "*Ajo po mbahej si të ishte Ajkuna e legjendave. Kur gjente ndonjë rast të përshtatshëm, sidomos kur aty nuk ishin "trashëgimtarët", ajo thërriste Miranin pranë saj për të qarë halle, siç bën rëndom nëna me të birin në këso raste të rënda."* (Atentatet, f.350-351)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së* ***tij më përzgjodhi mua...*** *!?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: "*Nënëmadhja po i lexonte vetë pothuajse të gjitha prapësitë që inskenonin "trashëgimtarët". I lexonte ajo në sytë, tkurrjet dhe dronë e fëmijëve të Jusufit, në cfilitjen dërrmuese të Miranit, në strukjet e Sarandës, babait të Kadriut, në tërheqjen e nemitur të të resë, Tinës, bashkëshortes engjëll të Bardhit, i cili kishte lindur pasi ia kishin vrarë babain. Prandaj Nënëmadhja e kishte pagëzuar me të njëjtin emër. I vështronte dhe ofshante, por edhe ofshamat i kishte të fshehta. Nuk dëshironte t'i kënaqte "trashëgimtarët" kopukë."* (Atentatet, f.351)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së* ***tij më përzgjodhi mua...*** *!?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: "*Nënëmadhja kishte krijuar besim e konfidencë ndaj Miranit*

duke u mbështetur në intuitën dhe sensin e saj të rryer jetësor. Ndaj nuk hezitonte që ta pyeste se kush ishin këta të pacipë që ia kishin uzurpuar shtëpinë e bijve të saj." (Atentatet, f. 351)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së **tij më përzgjodhi mua...** !?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: *"Nënëmadhja po i lexonte vetë pothuajse të gjitha prapësitë që inskenonin "trashëgimtarët ... I vështronte dhe ofshante, por edhe ofshamat i kishte të fshehta. Nuk dëshironte t'i kënaqte "trashëgimtarët" kopukë."* (Atentatet, f.351)

8. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla

Shkolla e UDB-së: "*Atëherë, paksa i çuditur më pyeti se a njihesha për së afërmi me „zëvendësin" e Jusufit, pra me **shefin** e tanishëm të familjes Gërvalla, Skënder Skënderin."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.121)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuriu po vështronte vëngër e me hatërmbetje se përse nuk po ia dorëzonte Hajzeri atij ndihmat financiare, meqë ai tashmë kishte uzurpuar plotësisht **rolin e bosit**."* (Atentatet, f.352)

Ibrahim Kelmendi: *"– Dëgjo, kriminel i shpifur, po flas për hir të pjesëmarrësve të tjerë, të cilët i ke mashtruar duke uzurpuar rolin prej trashëgimtari të Jusufit..."* (Atentatet, f.364)

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit", ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Ibrahim Kelmendi: *"Pasi e mbaroi shfryu me vete: "Falemnderit Sulejman, po më duket sikur këtë roman e paske shkruar enkas për mua, që në këto çaste të bëhem i fortë dhe i zgjuar për të përballuar goditjet që po m'i bën Beogradi përmes shqipfolësve që po imponohen si patriotë e si trashëgimtarë politikë të Jusufit."* (Atentatet, f.372)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së **tij më përzgjodhi mua...** !?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: *"Pastaj, në ceremoninë mortore na janë imponuar individë që vetën e quajnë trashëgimtarë politikë të Jusufit."* (Atentatet, f.375)

Shkolla e UDB-së: "*Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit", ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

Ibrahim Kelmendi: *"Ditëve në vazhdim Mirani nuk u kthye më në atë shtëpi dhe as mori vesh se kur dhe si e lëshuan Gjermaninë dhe ku shkuan gratë dhe fëmijët e Jusufit dhe Bardhoshit. "Trashëgimtarët politikë" të Jusufit, Xhafari me sejmenë, kishin vendosur t'i izolonin ata nga Mirani. Atë e digjte malli sidomos për fëmijët e Jusufit, me të cilët kishte pasur një afërsi të madhe."* (Atentatet, f.378)

9. E kemi dëshminë se si u bë trashëgimtarë

Ramadan Pllana: "*Në faqet 375-358 (të librit të Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë - shën im) **kemi dëshminë se si u bë Xhafer Durmishi "trashëgimtar" i Jusuf Gërvallës,...** "* (www.pashtriku.org, 15 shkurt 2011)

Faridin Tafallari: *"Xhafer Durmishi erdhi tek Jusufi dhe Jusufi e donte, se ai ishte besnik. Ne e mirëpritëm dhe e nderuam, se e la Jusufi, por ama nuk e la për trashëgimtar, se ai nuk besonte, se një ditë do ta ndalte hovin drejt veprës së tij të madhe."* (Me tre yjet e pavdekësisë në

ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, f. 303)

Shkolla e UDB-së: *"Sesa pati sukses dhe jetëgjatësi shpallja apo vetëshpallja, emërimi apo vetemërimi i Xhafer Durmishit si zëvendës i Jusuf Gërvallës, e tregoi koha! **Jusuf Gërvalla ishte një kolos** i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Muharrem Blakaj: "*Virtytet e një burri të **papërkulshëm** siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë të jenë **në bashkëpunim të barabartë me të, ...** Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër, **të përjetuara nga një inferioritet vandal**,..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 7- 8)

10. Uzurpuesit e zotshpillakut u imponuan si trashëgimtarë

Ibrahim Kelmendi: *"Pas atentatit Hakani po përpiqej të luante rolin e trashëgimtarit politik të Kadriut, përafërsisht siç po bënte Xhafari që uzurpoi vrazhdësisht rolin e trashëgimtarit politik të Jusufit."* (Atentatet, f.379)

Shkolla e UDB-së: "*Kurrë nuk e mora vesh në kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla, që në grahmat e fundit të jetës së **tij më përzgjodhi mua...** !?"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.150)

Ibrahim Kelmendi: "Më 3 prill organizuam demonstratë në Bonn. Formalisht isha bashkorganizues. Trashëgimtarëve të Jusufit, ndërkohë edhe trashëgimtarëve të Kadriut, po u duhesha vetëm si argat, meqë ata nuk dinin si organizohej demonstrata." (Atentatet, f.389)

Shkolla e UDB-së: "*Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve, por edhe në mesin e mërgimtarëve."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.158)

Ibrahim Kelmendi: "*Dhe të hidhërohesha sidomos kur në shtëpinë tënde, gjatë ceremonisë mortore, uzurpuesit e zotshpillëkut të shtëpisë sate, u imponuan si trashëgimtarët e tu politikë."* (Atentatet, f.467)

Ibrahim Kelmendi: *"Më konkretisht, të zbatonin komandimet e "udhëheqësit" Sabri Novosella, meqë edhe shtëpia e Vëllezërve Gërvalla kishte mbetur pa Zot."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.87)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*


Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, për njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me të, i thashë se është n[illegible]jeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpia [illegible], ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin."
Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht, flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në

Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!" (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

BUJARI DHE BUJARIA E LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS

1. Udhëtim në Vjenë për t'u konsultuar me Ambasadën Shqiptare
2. Cicërimë më të ëmbël nuk kish
3. Bujar Hoxha dhe bujaria e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës
4. "Komunistët" nuk i dalin në takim njëri-tjetrit
5. Bazat teorike të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës për për-puthjen ideologjike me Partinë "Komuniste"
6. PËRDORIMI ME ZGJUARËSI I KËRBAÇIT
7. Sakrifica e Lëvizjes dhe Zërit të Jusuf Gërvallës për hir të Partisë "Komuniste"
8. Formimi i "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"
9. MBLEDHJA E KOMITETIT "VËLLEZËRIT GËRVALLA" MË 11 KORRIK 1982
10. OXHAKU I TIJ I LARTË, QË I MBETI NË KËMBË

1. Udhëtim në Vjenë për t'u konsultuar me ambasadën Shqiptare

Për të njëjtat shkaqe për të cilat unë e Haxhi Berisha kemi shkua në Dortmund, 10 ditë pas atentatit, më 27 janar 1982 kam udhëtuar unë vetëm në Vjenë, për të takuar ndonjë person të Ambasadës Shqiptare, për të qarë hallet me ta, për t'i informuar për situatën në Untergruppenbach dhe për të marrë ndonjë këshillë. Unë kisha thirrur në telefon më përpara për t'i informuar se do të shkoja tek ata. Në Vjenë kam mbërri kah mesdita. Jam shkuar menjëherë në ambasadë. Persona të ambasadës më kanë thënë se ata që kanë me bisedua me ty janë të zanun, prandaj eja në ora 18.00 në mbrëmje. Në ora 18.00 kam shkuar në ambasadë. Më kanë pritur Skender Dushi dhe Lirim Shyti. Me ta kam biseduar gjer në 24.00. Këtë orë, pra mesin e natës nuk e harroj kurrë. Mbasi ua kam shtruar të gjitha gjërat që kam pasur ndërmend dhe mbasi iu kam përgjigjur të gjitha pyetjeve, pra në mesin e natës më kanë përcjellë tek dera e ambasadës dhe më kanë thënë natën e mirë. Asnjëherë në jetë më parë nuk kam qenë më i befasuar e i mërzitur psikikisht se në ato momente, me përjashtim të lajmit për vrasjen e Jusufit. Por kur e kam marrë lajmin e vrasjes nuk kam qenë vetëm, kur jam ballafaquar me trupat e vrarë kurrë nuk kam qenë vetëm, nuk e kam ndier veten të vetmuar. Të hollat për këtë rrugë m'i ka dhënë Suzana. Unë kisha të holla edhe për hotel por Skender Dushi e Lirim Shyti as që u lodhën me më pyet për atë punë edhe pse e dinin se në atë kohë nuk kisha ndonjë tren për Shtutgart. Gjuhën gjermanishte mund të them se nuk e dija, me përjashtim të ndonjë fraze të përgjithshme dhe atyre fjalëve që më nevojiteshin për leximin e tabelave e orareve në stacionet e trenave. Me vete e kisha një adresë të një të

afërmi në Vjenë, dhe më shkoi gati më shumë se një orë gjersa e gjeta banesën e tij. Atë nuk e gjeta aty dhe personi që m'u përgjigj, pasi nuk më njohu u frikua me më pranua në banesë. U ktheva, dhe duke u sjellë nëpër qytet më ka gjetur mëngjesi i 28 janarit. Atë natë dhe të nesërmen e kam ndier veten shumë keq. Në orët e mëngjesit më është dukur se dikush është duke më përcjellë dhe këto hije të dyshimta kur të piqen në kokë nuk mundesh me i zhdukë vetëm. Të paktën kjo ka vlejtur për mua. Duke u kthye me tren vetëm, e duke u përpjekur t'ju iku 'personave që po më përcillnin' kam zbritur prej treni, më duket në Regensburg, dhe rrugën prej këtij qyteti deri në Nürnberg e kam bërë me taksi. Tek kur kam mbërri në rrethinën e Shtutgart m'u ka heq frika pasi si me thënë ishte vend që e njihja mirë, ishte 'terreni im'. Kur kam mbërri në Untergruppenbach në mesin e shokëve kjo ndjenjë e frikës më është zhdukur tërësisht dhe këtë aspekt, këtë anë të përjetimit të kësaj rruge nuk ia kam komentuar askujt.

Lart nga e majta: Agron Sela e Hafiz Gagica
Poshtë nga e majta: Xhafer Durmishi e Hasan Rrahmani, në Untergruppenbach, janar 1982 (Foto: Faridin Tafallari)

Por përcjelljen time tek dera në mesin e natës dhe indiferencën e këtyre diplomatëve ia kam treguar në telefon Sabri Novosellës i cili ia ka përcjellë Bujar Hoxhës. Sabriu më ka thënë pastaj se si Skender Dushi e Lirim Shyti qenkan qortuar për këtë punë. Sidoqoftë, pasi kemi bërë luftë për një çështje që ka të bëjë me popullin, nuk ka mund me pasur vend tek unë inatet personale. Por ky rast ka qenë tepër i mjaftueshëm për të ma mbytur kureshtjen për jetë se mos kam pasur unë të mësoj ndonjë gjë me vlerë prej diplomatëve të Partisë së Punës të Shqipërisë. Më vonë prej diplomatëve në Vjenë jam takuar vetëm me Engjëll Kolanecin, i cili më ka thënë që për çështjet tona të Kosovës të mos bisedoj me askënd tjetër në ambasadë përveç tij. Engjëllin e kam takuar dhe biseduar me te disa herë gjatë vitit 1982, shumicën e herave së bashku me dhe në praninë e Faridin Tafallarit.

2. Cicërimë më të ëmbël nuk kish

Jusuf Gërvalla: "**Cicërimë më të ëmbël e më prekëse në dhe të huaj thuase nuk kish."**

Faridin Tafallari: *"Suzana do të shkonte në Shqipëri; asaj iu bë e mundur që të shkonte dhe të jetonte aty me gjithë fëmijët e saj (Premtonin, Donikën dhe Ergonin). Pra do të shkonte në shtetin amë që aq fort e kishte dashur Jusufi. Ekziston një letër të cilën **Jusufi ia ka dërguar Enver Hoxhës** dhe ku ndër të tjera thuhet:*

I dashuri shoku Enver,
Djali im dyvjeçar e gjysmë po llafosej me të motrën tetëvjeçare ndaj të gdhirë.
- Dua, - i thoshte asaj - të vijë me ty në shkollë.
- Kur të rritesh edhe pak - ia ktheu ajo dhe shtoi me një dëlirësi të dhembshur fëmijërore; - Kur t'i bëhesh ti motrës për shkollë, ne do të jemi në Shqipërinë tonë të dashur.
***Cicërimë më të ëmbël, por edhe më prekëse, për të më nxjerrë gjumin e një mëngjesi të gdhirë me përtesë në dhe të huaj, thuase nuk kish**. Isha i lumtur që fëmija im s'e hiqte mendjen nga mundësia për të jetuar në Shqipërinë tonë të dashur. Por fjalët e saj më prekën shumë se sendërtimin e dëshirës së fëmijëve të mi nuk e kisha unë në dorë...'"*
(Terror dhimbje qëndresë, Tiranë 1997, faqe 59-60)

3. Bujar Hoxha dhe bujaria e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës

Më 13 shkurt nga Untergruppenbachu kam udhëtuar për në Munchen, në mënyrë që nga aty ta marrë aeroplanin për në Stamboll. Biletën e kam ble më 13 shkurt, dhe atë natë kam bujtur tek Muharrem Gjocaj në Munchen. Të nesërmen më 14 shkurt 1982 kam marrë aeroplanin Munich - Stamboll. Në Stamboll më ka pritur Tefik Straja, në banesën e të cilin kisha qëndruar disa ditë në janar 1981 kur isha takuar për herë të parë me Sabri Novosellën. Tefiku menjëherë më ka përcjellë dhe më ka qitur në trenin e Adapazarit ku në stacion më ka pritur Sabriu. Qëllimi im i vetëm për të shkuar në Turqi ka qenë për t'i raportuar Sabriut për gjendjen e krijuar pas atentatit. Është e vërtetë se Sabriu i ka treguar Jusufit për ardhjen e ish-inspektorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashticës me sekretarin dhe nipin e vet në Turqi, qysh pas gjysmës së nëntorit 1981dhe për "shkaqet apo misionin e tyre për daljen jashtë". Por rasti i Atentatit tek unë ka bërë që unë as që e kam pasur idenë më të vogël për ta dhe e kam harruar ekzistencën e tyre.

Bujar Hoxha, i biri i Hoxhë Kadrisë

Pasi i kam treguar gjithçka që dija për gjendjen në Untergruppenbach e Shtutgart, Sabriu më ka thënë se duhet të shkojmë në Ankara që të takohemi me Bujar Hoxhën, pasi Bujari i paska thënë që kur të vijë shoku nga Gjermania, merre pa u vonuar e eja tek unë. Sabriu thotë se Bujari është shumë i interesuar që shumë gjëra t'i dëgjoj vetë prej teje. Duke pasur parasysh përvojën e para disa ditësh me diplomatët në Vjenë, unë isha shumë i befasuar (për të mirë) që një diplomat tjetër i të njëjtës parti të kërkonte patjetër ta takoja duke bërë qindra kilometra rrugë. Sabriu më tregon se në Ankara gjendet Abdullahu ("komunisti" ish-inspektori i UDB-së Serbe) me osmanët e vetë.

Në orët e vona të natës së 16 shkurtit e kemi marrë autobusin për në Ankara, dhe në një natë që dukej shumë e ftohët, kemi udhëtuar deri në Ankara ku kemi mbërri në mëngjesin e 17 shkurtit. Kemi shkuar drejtë

në Ambasadën Shqiptare. Pas një bisede të gjatë, Bujar Hoxha, djali i Kadri Prishtinës, në ditën e njëmujorit të 17 janarit 1982, ma ka komunikuar vendimin e PPSH (apo thënë me drejtë të Enver Hoxhës) për pranimin e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Shqipëri, kërkesë të cilën ia kisha bërë Engjëll Kolanecit, me dëshirë e porosi të Suzanës, dëshirë e ide të cilën Jusufi ia ka mbjellë qysh kur ai ka qenë gjallë. Bujari ishte tregua shumë bujar me udhëheqjen e Partisë "Komuniste" dhe ai kërkoi që edhe ne, në frymën e Jusuf Gërvallës të tregoheshim edhe më bujar se ai. Ish-inspektori i UDB-së Abdullahu, nga diplomatët shqiptar ishte dërguar në Tiranë me ymyd se do të shtrydhin apo mjelin prej fukarallakut të tij në kokë ndonjë trik të UDB-së Serbe. Duke e pasur parasysh thatësirën nga shkëputja e marrëdhënieve me KGB-në ruse prej dekadash më parë, ma merr mendja se në pusin e Sigurimit Shqiptar të vitit 1981, ish-inspektori i UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica është konsiderua peshkaqeni më i madh që është zënë ndonjëherë me sitë në lumin e Sitnicës. Për këtë arsye Bujari, në cilësinë e të birit të Kadri Prishtinës, kërkoi nga ne, përfaqësuesit e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, që edhe ne, në frymën e Jusufit, të tregohemi edhe më bujar ndaj këtij ish-udbashi dhe t'ia dhamë një *second chance*. Për hir të frymës e shpirtit të Jusuf Gërvallës, Kadri Prishtinës dhe amanetit të gjeneratës së tij, ne shokët e Jusufit pranuam të bisedojmë me këtë ish-udbash të UDB-së Serbe, me këtë përdorues të zgjuar të kërbaçit i cili i kishte duart e përgjakura me gjakun e shokëve tonë. Pa influencën e Bujar Hoxhës bisedime për bashkim nuk do të kishte.

4. "Komunistët" nuk i dalin në takim njëri-tjetrit

Sabriu thotë se Shtabi i partisë me Abdullahun në krye, me gjithë gjërat qesharake e budallallëqet e tyre çmohet shumë nga diplomacia shqiptare e Bujar Hoxha. Ne do të bisedojmë me ta për bashkim. Mos ta nënçmojmë gjendjen, përkundër budallallëqeve që ke me i dëgjuar nga goja e tyre, mund të ndodhë që të vij deri te bashkimi.

Udhëheqja e Partisë përbëhej nga:

- Abdullah Prapashtica, Kryetar i Partisë Komuniste Marksiste Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ),
- gruaja e tij (e cila do të zgjidhej) kryetare e organizatës së gruas,
- Osman Osmani, sekretar,
- Faton Topalli, kryetar i organizatës së rinisë dhe nip i Abdullahut.

I vetmi prej tyre që din diçka, thotë Sabriu, është Fatoni, por si nip i Abdullahut nuk guxon të ketë mendime të pavarura.

Dhe me të vërtetë kur u takuam më vonë dukej se Fatoni ishte në aso pozite të keqe ku e kishte vu Abdullahu sa nuk di se a mund të gjendet ndonjë rast i ngjashëm tjetërkund. Vuajtja dhe mundimi i Fatonit qëndronte në atë se ai shpesh ngatërrohej dhe e kishte vështirë se si ta thirrte Abdullahun; shoku Kryetar apo dajë.

Thelbi i aktivitetit të partisë në gjithë “modestinë” e vetë ishte ky:

- Partia është autore e kërkesës Kosova Republikë dhe organizuese e demonstratave të vitit 1981,

> "Më 14 prill 1981, KQ të LKJ dhe Qeverisë Jugosllave, i dërguan "Notë", me ç'rast muarën përgjegjësinë për organizimin e demonstratave" (Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 661)

- Abdullahu, në cilësinë e inspektorit të sigurimit shtetëror, ka pas mundësinë ta studioi aktin e Adem Demaçit. Për këtë arsye Adem Demaçi i takon PKMLSHJ-së, ai është ideologu i saj.
- Kriteri kryesor për zgjerimin e radhëve të partisë janë lidhjet familjare,
- Partia ka nxjerrë organin e vetë "Revolucioni", në të cilin Kryetari i partisë dhe sekretari i saj shpallen heronj të popullit, si dhe organin e rinisë "Atdheu",
- Partia "Komuniste" i ka shkruar KQ të LKJ-së dhe e ka thirrur në bisedime nga pozita të barabarta, por takimi nuk është realizue, pa e dhënë ndonjë përgjigje të kënaqshme se kush e mban përgjegjësinë për mosdalje në takim: inspektori i UDB-së apo LKJ-a?

"Më 14 gusht 1981, KQ të LKJ dhe Qeverisë Jugosllave, i dërguan letër dhe e ftuan LKJ për bisedime si partner dhe parti të barabarta." (Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 661)

Prandaj, vazhdohet me stilin e "modestisë",
- çdo gjë e mirë nga demonstratat e vitit 1981 janë vepër e popullit, ndërsa për pasojat merr përgjegjësinë Partia,
- të gjithë ata që kanë luftuar për bashkim kombëtar janë njerëz të kompromet uar nga pikëpamja e Kosovës Republikë, dhe si të tillë duhet të tërhiqen mënjan ose t'i vihen në dispozicion politikës, e shtabit të partisë, i cili ka dalë jashtë t'i bashkoi të gjitha organizatat në Partinë "Komuniste".

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. **Një tentim për kontakt kishte edhe me (Partinë Komuniste - shën im) PKMLSHJ**, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal në takim."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)

Pse nuk i ka dal në takim Abdullah Prapashtica, Berat Luzhës?

Sepse *"Martin Quni (...) Prej Hamzë Morinës e ka marrë 'Liria nr.1' të cilën ia ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon materiale të tilla, ngase siç deklaron ky i akuzuar, **nuk u për-puthet ideologjia**."* (Aktgjykimi i PKMLSHJ, P-K nr. 167/72; Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 678)

Ndaj budallallëqeve të këtyre kalorësve të situatave, unë reagova ashtu siç ishte e natyrshme për të reaguar. Përkundër të gjithave ne do të bisedonim me ta.

5. Bazat teorike të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës për për-puthjen ideologjike me Partinë "Komuniste"

E tërë përmbajtja e këtij nëntitulli, dhe një pjesë nën pikën vijuese (6) është marrë, pjesë-pjesë, nga libri "REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH" i Sabri Novosellës.

Mulla Hamiti

"LRBSH-ja po ecte e sigurt në hullitë e Lidhjes së Prizrenit, të udhëhequr nga i madhi Ymer efendi Prizreni (1878), të Lidhjes së Pejës (1899), të udhëhequr nga i famshmi Mulla Haxhi Zeka, të Kuvendit të Taksimit (1912), kësaj ngjarjeje me rëndësi në historinë e kombit shqiptar, organizuar dhe udhëhequr nga legjenda e kombit, Hasan Prishtina, ku u morën vendime të rëndësishme dhe u dha kushtrimi për çlirimin e të katër vilajeteve shqiptare. ....

Pas lirimit të Mulla Hamitit, patriotit të pathyeshëm, që po kthehej në Kosovë pas gjashtë vjet vuajtjesh nëpër burgjet jugosllave për aktivitetin e tij në kuadër Lëvizjes Nacionale Demokratike Shqiptare, e njohur në popull si NDSH, arrita t'i vija kontaktet me këtë burrë, përmes disa lidhjeve familjare. Njohuritë e mia për të kaluarën, për vuajtjet dhe heroizmin e popullit shqiptar për liri dita-ditës po shtoheshin.

Në dyqanin tim vinin sidomos shokët e Metush Krasniqit. Vizitor i përhershëm ishte mulla Ramë Govori, një atdhetar i devotshëm, i cili ishte burgosur si aktivist i NDSH-së. Ai fillimisht ishte dënuar me pushkatim, por ia kishin zbritur dënimin me burg të rëndë. Mulla Rama i kishte vuajtur plot pesëmbëdhjetë vjet burg të rëndë.



Mulla Izet Tasholli

Mulla Ramë Govori vazhdimisht përsëriste: "Fusha e luftës për lirinë e Kosovës i ka dy anë. Në njërën janë atdhetarët shqiptarë, në tjetrën komunistët shqiptarë. Në mes tyre është lumi i gjakut – dhjetëra mija kufoma të luftëtarëve të lirisë". Ai, mes tjerash, na tregoi edhe për një bashkëluftëtar të tij, i cili me rastin e therjes së një kurbani për bajram i ishte lutur Zotit: "O Zot, siç po prehet ky kurban, ashtu u prefsha dhe u bëfsha kurban, edhe unë për Atdhe"... Ndodhi pikërisht ashtu si iu lut ai Zotit. Në një ditë prej ditësh, gjatë luftës për çlirimin e Kosovës nga gjakpirësit sllavo – komunistë dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë ishte therur mu në fyt! ...

Mulla Izet Tasholli ishte nga Gadimja e Ferizajt. Mulla Izeti ishte një hoxhë shumë i dijshëm, e mbi të gjitha ishte vizionar i madh. Të kaluarën e njihte shumë mirë. Të gjitha të këqijat për popullin shqiptar, e kishte bindjen se, i kishin ardhur nga sllavo-greko-bizantinët. Komunizmin te shqiptarët e shihte si kurorë me gjemba të linjës sllavo-greke, por e kishte bindjen se me rënien e komunizmit në Rusi, ai do të binte edhe në tërë botën dhe kësisoj do të merrte fund ndikimi sllavo-grek edhe te shqiptarët.

Mulla Izeti fliste shumë për të ardhmen e popullit shqiptar. E dëgjoja me kujdes të veçantë, edhe pse gati më dukeshin të pabesueshme ato që thoshte ai. Tregonte se si njëherë, me rastin e shitblerjes së një kafshe, një serb i kishte treguar se çka i kishte ndodhur kur kishte qenë ushtar në Manastir të Maqedonisë, kur ushtria serbe e kishte pushtuar këtë qytet në vitin 1912. Duke u ndodhur në shërbim të kryegjeneralit të

ushtrisë pushtuese serbe, gjenerali qenka vendosur në shtëpinë të një hoxhe. Ishte një shtëpi dykatëshe. Në katin e dytë ishte vendosur gjenerali, ndërsa në katin e parë banonte hoxha, pronari i shtëpisë. Gjenerali kishte dëgjuar që hoxha po u fliste njerëzve se si do t'u vinte e ardhmja. Një mbrëmje gjenerali e urdhëron ushtarin që ta sillte hoxhën tek ai. Dhe hoxha vjen te gjenerali. Gjenerali e pyet hoxhën, ndër të tjera, edhe se si do të dukej e ardhmja e Serbisë. Hoxha druante t'ia thoshte gjeneralit atë që e mendonte, sepse mund ta pësonte, por gjenerali i betohet në fëmijë e në familje se nuk do t'i ndodhte asgjë, pavarësisht nga ajo që do t'ia thoshte hoxha. Hoxha i Manastirit kishte filluar t'i tregonte të ardhmen dhe çdo fjalë që i thoshte, gjenerali e përpinte me sy e vesh duke i thënë "e pastaj hoxhë"? Hoxha prapë vazhdonte t'i rrëfente për ardhmërinë e Serbisë dhe kësisoj derisa për të fundit herë, kur insiston gjenerali edhe më tej ta vazhdojë rrëfimin e tij, hoxha i thotë prerazi: "Serbia do t'i humbë këto vilajete dhe krejt këtë vend. Deri te Molla e Kuqe (në afërsi të Nishit) kanë me e sundua njerëzit me plisa të bardhë"!

*Gjenerali më nuk kishte mundur ta dëgjonte hoxhën dhe e kishte urdhëruar që ta ndërpriste rrëfimin profetik. Mirëpo, gjenerali e kishte mbajtur fjalën. Hoxhës nuk i kishte ndodhur asnjë e keqe." (*Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f. 35-61)

Aktgjykim: *"**Sipas mendimit të Jusuf Gërvallës në komitet** duhet të marrin pjesë të akuzuarit **Ismajl Haradinaj**, Nimon Mustafaj, Nazmi Selmani dhe dy **hoxhallarë, imami i fshatit Drenofc dhe një hoxhë nga Gjakova**. ... Sipas porosisë së **Jusufit** bëjnë bisedë edhe me të akuzuarin Nimon Mustafaj, e njoftojnë me "Statut" dhe "Programin" e "Lëvizjes nacionalçlirimtare të Kosovës", i **përcjellin porositë e Jusuf Gërvallës dhe i shtrojnë për detyrë që të kontakton dhe angazhoj Hafizin - hoxhë**, të cilën detyrë e pranon, kështuqë pas 3-4 ditësh shkon në Gjakovë, gjen momentin e përshtatshëm për bisedë me Hafizin, i parashtron qëllimin e ardhjes së tij, mirëpo nuk arrin me e angazhuar pasi i njëjti refuzon. Për këtë e njofton të akuzuarin Ismajl. Për të akuzuarit Ismajl dhe Hasan kanë qenë të papranueshme dhe inkompatibile në bazat "Marksiste" që anëtarë të komitetit **të jenë hoxhallarët**, kështuqë në këtë drejtim të akuzuarit Ismajl e sidomos i akuzuari Hasan Ukëhaxhaj është angazhuar që të gjej njerëz të përshtatshëm për komitet."* (Aktgjykimi kundër Ismail Haradinajt me shokë nga Gjykata e Qarkut në Pejë, Më datën 6 gusht 1981, P. nr. 106/81, www.pashtriku.org)

6. PËRDORIMI ME ZGJUARËSI I KËRBAÇIT

Sabri Novosella*: "Mulla Izeti thoshte me bindje të plotë se, ashtu siç u realizua profecia e hoxhës së Manastirit, e thënë që në vitin 1912, për ato që ndodhën deri në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, do të realizohen edhe ato që do të ndodhin në të ardhmen.*

*Tregimet profetike të mulla Izetit, si parashikime të një futuristi që ia rikujtoja dhe ia ritregoja, Shefqetit, atij i bënin shumë përshtypje dhe i dëgjonte me vëmendje. Madje, në shumë raste, kur kishim kohë pak më shumë, vazhdimisht kërkonte që t'ia tregoja bisedat e mulla Izetit, duke më thënë: "Hajt Sabri, hajt, edhe diçka prej mulla Izetit"!"" (*Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010, f.61*)*



Shefqet Jashari-STROFCI

Shefqet Jashari: *"Hetimet zgjatën 7-8 muaj. Është vështirë të përmenden gjithë hetuesit që merrnin pjesë në maltretime. Veçmas kanë qenë të pashpirt Asllan Sllamniku, Sllavkoviqi dhe njëfarë Muharremi. Kam pasur rastin ta njoh edhe Abdullah Prapashticën, e cili e shikonte duke më rënë me kërbaç këmbëve i pashpirti Asllan Sllamniku. Ai me zgjuarsi ia mori kërbaçin A. Sllamnikut, duke më ngritur në këmbë dhe duke më goditur shumë pak hundëve, prej nga më doli gjaku. Si duket A. Sllamnikun gjakun i dalur nga hundët e mia e zbuti. Ai pastaj dha urdhër që të më kthejnë në burg. Me gjestin që e bëri Abdullah Prapashtica, kam qenë i bindur se nuk është i shitur për serbosllavët, por ka hyrë të punojë në SPB-në e Kosovës për qëllime patriotike."* (Drita, Trelleborg-Suedi, nr. 15/1997, faqe 18)

7. Sakrifica e Lëvizjes dhe Zërit të Jusuf Gërvallës për hir të Partisë "Komuniste"

Abdullah Prapashtica ("komunist" dhe ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Por, pas vrasjes së tyre (Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës-shën im), neve na paraqitet Sabri Novosella si përfaqësues i LNÇKVSHJ. Ne i besuam atij, duke ditur se ai ishte dënuar së bashku me ADEM Demaçin! Mirëpo me që vetëm ai do të ishte i pa pranueshëm për vazhdimin e bisedimeve, Sabri Novosella e sjell me vete një Durmishin."* (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)

"Organizatën e LNÇKVSHJ e përfaqësojnë anëtarët e KQ Mërgimi (Sabri Novosella) dhe Shpendi (Xhafer Durmishi)."

Abdullah Prapashtica ("komunist" dhe ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ishte hera e parë dhe fundit që jam takuar me këtë njeri në Ankara, me 17 Shkurt 1982. Përshtypja ime ishte se Sabri Novosella e kishte marrë me vete formalisht, sepse Durmishi me as një fjalë domethënëse nuk morri pjesë në ato bisedime. Ishte i pranishëm, por me asgjë nuk mbaj mend praninë e tij, sepse dukej si i humbur andaj ishte dhe mbeti një njeri anonim për mua!"* (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)

Para takimit të 17 shkurtit 1982, Sabriu kishte në kujtesë të freskët takimin e dështuar me Kadri Zekën, në tetor 1981, prandaj ishte i interesuar që të mos ketë një dështim të ngjashëm me "komunistin" e ish-inspektorin e UDB-së, Abdullah Prapashtica.

Edhe ish-udbashi "komunist" i kishte dy tentativa e përjetime shumë të hidhura më heret. Njëri takim i kishte dështuar me KQ të LKJ, ndërsa tjetri me "komunistin" Berat Luzha. Të dy takimet e lartpërmendura nuk ishin mbajtur për shkak të mospër-puthjes së ideologjisë. Për këtë arsye takimi me Sabriun për te ishte i treti, pra "E treta e vërteta"! Ja kësaj radhe, ja kurrë! Si rrjedhim i gjithë kësaj, edhe Sabriu edhe ish-udbashi "komunist" ishin të gatshëm që për të arritur një bashkim, të bënin sakrifica të mëdha.

Përdorimi me zgjuarsi i kërbaçit nga Abdullahu, në përgjakjen e hundës dhe buzëve të Shefqet Jasharit ishte një bazë e mirë për përgatitjen e për-puthjes së ideve të Lëvizjes me Partinë "Komuniste" të ish-udbashit.

Gjatë qëndrimit tim në Adapazar tek Sabriu, kur ai më flet për Partinë "Komuniste", thotë se kur të shkojmë në Ankara tek Bujar Hoxha, patjetër që do të takohemi edhe për përfaqësuesit e Partisë. Mundet që të mos merremi vesh, por ka edhe mundësi të vij tek bashkimi. Ai ishte i interesuar edhe për përgatitjet e mia teorike në fushën e materializmit dialektik dhe historik dhe sidomos për atë se a posedoj ndonjë aftësi sado elementare për t'i kapur problemet në gjithë kompleksitetin e tyre teorik. Për këtë arsye ai m'i shtroi dy pyetje jashtëzakonisht komplekse në pikëpamje teorike, të cilat ishin:

Sabri Novosella: Cili është sharti i parë i turqnisë?
Xhafer Durmishi: Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!
Sabri Novosella: Cili është sharti i parë i shkinisë?
Xhafer Durmishi: Proletarë të të gjitha vendeve, socializmin luftojeni me socializëm!

Sabriu dyshoi në baza solide dhe më pyeti se a kam knue në Sarajevë, pasi ai si rrobaqepës i njohur dhe *menaxher kitaristash* kishte lidhje aq të ngushta sa më tha se gjatë një periudhe, *Bijelo Dugmen* e ka sjellë në maje të gishtit. Pra më duket se ai fitoi një përshtypje se jam i knueshëm (për moshën), përderisa i analizonte përgjigjet e mia në tërë kompleksitetin e vet. Për këtë ai shkroi më vonë: *"Xhafer Durmishi u bë më marksist se vetë Marksi, më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini."*

Nga biseda me mua ai nxorri konkluzionet se çfarë sakrificash do të ishte i detyruar të bënte në takimin me treshen "komuniste" të Partisë dhe kërkoi nga unë që të mos flas fare nëse nuk është e nevojshme, nëse bisedimet nuk sillen rreth çështjeve tepër komplekse e teorike që kanë të bëjnë me materializmin dialektik e historik.

"*Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave* ***MOTRA****, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave* ***NË NJË TË VETME."***

Të pranishëm ishim Fatoni, unë, Osman Osmani, Abdullahu dhe Sabriu. Askush tjetër nuk ka qenë i pranishëm.

Pasi Sabriu u tregoi se fusha ime e interesit ishte teoria, Abdullahu me shokë nuk u interesuan fare të rrahin asnjë mendim në këtë fushë dhe thanë se në atë drejtim ideologjia e Partisë "Komuniste" përputhet pikë për pikë me ideologjinë e Lëvizjes dhe se diskutimi të bëhet vetëm rreth emrit të Organizatës dhe emrit të gazetës. Abdullahu tha se është shumë me rëndësi me ia fillua prej zeros, le të kuptohet që kemi të bëjmë me një fillim të ri dhe se kjo duhet të shprehet në emrin e Organizatës dhe të gazetës. Duke ia nisë prej zeros, ne me shembull konkret po tregojmë se çfarë sakrifice të madhe jemi duke bërë para shokëve tanë dhe gjithë të tjerëve. Ky shpirt i sakrificës e i bujarisë dëshiroj të vjen në shprehje edhe te Baci Sabri.

Osmani propozoi që **ORGANIZATA E VETME** që do të dalë nga bashkimi të quhet **LËVIZJE**, për hir, apo si vazhdim i drejtpërdrejt i **LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS**. Sabriu, shumë i kënaqur me propozimin e Osmanit dhe për ta bërë idenë e tij më komplete tha: "*Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin "Zëri i Kosovës".*

Abdullahu me sekretarin dhe nipin iu drejtuan Sabriut: Baci Sabri, pajtohemi me propozimin tënd, megjithëse duhet ta them atë që na e ndjen shpirti ("komunist" - se komunistët i thonë gjërat hapur), se shpirti i sakrificës e bujaria për të cilën fola më parë dhe të cilin kisha dëshirë ta shihja kah vjen në shprehje, sikur po mungon prej anës tënde. Nëse pajtohemi krejtësisht me ty, kjo do të linte hapësirë për kritika ndaj nesh

prej komunistëve tanë kur të takohemi me ta ndonjëherë në të ardhmen. A ke ndonjë ide se si duhet ta parashtrojmë para tyre e qëndrimin e Partisë "Komuniste"?

Sabri Novosella: Nuk pajtohem me mendimin tënd Abdullah se shpirti im i sakrificës nuk ka ardhur në shprehje, as me akuzën tënde krejt të pabazë se jam tahmaçar. Përkundër përdorimit me zgjuarsi të kërbaçit, unë, si shok i Adem Demaçit, Shefqet Jasharit, Jusuf Gërvallës po pranoj me bisedua me ty nga pozita të barabarta. A sakrificë e vogël po të duket kjo! A e meritoj vërtetë me thënë tahmaçar?! Nuk e di se a je i vetëdijshëm se çka do të thotë kjo për reputacionin tim? Ku kam fytyrë me u dalë përpara Mulla Hamitit, Mulla Ramës apo futuristit-Mulla Izetit, po ta dinin ata, se unë po bisedoj me komunistë për çështje të Kosovës?!

Sa i përket çështjes se çka t'u thoni "komunistëve" kur t'i takoni në të ardhmen, nëse u bien rasti me takua ndonjë, unë kisha me ua propozua këtë formulim: *"Në natën e 17 shkurtit 1982, në Ankara të Turqisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën;1. Në bazë të Lëvizjes dhe Zërit të Jusuf Gërvallës u arritë marrëveshja për bashkimin e Dy Organizatave çlirimtare shqiptare; 2. U nderuan me një përkujtim të veçantë në ditën e njëmujorit të rënies edhe në këtë mënyrë të vrarët në Kështjellën e Jusuf Gërvallës dhe 3. Pushoi së vepruari Partia "Komuniste".*

> Mehmet Hajrizi: *"**Në natën** e 17 janarit 1982, në Untergruppenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e **tri organizatave** çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari OMLK...." (*Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f.11)

Abdullahu, Osmani dhe Fatoni: Baci Sabri, si shok, si veteran e si prishtinali, kurrë këtë të mirë, këtë sakrificë, këtë mençuri nuk kemi me ta harrua, se me të vërtetë po duket se nuk ke qenë rastësisht njëri ndër personat më të afërm të Mulla Hamitit, Mulla Ramës dhe Mulla Izetit, se me bujarinë tënde haxhillakun sonte e ke fitue. Do të jemi mirënjohës përjetë, që na e dhe mundësinë që kapitullin e Partisë "Komuniste" ta mbyllim në gjirin e përqafimin e Jusuf Gërvallës dhe shokëve të rënë se sa të përfundonim në ndonjë vend të keq.

Sabri Novosella: Në paçi mend, fjalët e mia i shtini në xhep, nëse jo, paçi vehten në qafë.

"D O K U M E N T

*Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të **KQ** të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ*

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

*Organizatën e **LNÇKVSHJ** e përfaqësojnë anëtarët e **KQ** (Komitetit Qendror-shën. im) Mërgimi (Sabri Novosella) dhe **Shpendi (Xhafer Durmishi)**.*

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësojnë Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) dhe Halimi (Osman Osmani), anëtar të KQ. Në këtë mbledhje merr pjesë edhe anëtari i KQ të PKMLSHJ Qemali (Faton Topalli) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Pas afër tre muajsh bisedime dolëm me propozime konkrete.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin "LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSHJ).

LRSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një KQ, një organ (revistë, gazetë) qendrore.

LRSHJ do të formojë organizatat e veta të brendshme; të gjitha organizatat që i ka një Republikë Federative Jugosllave.

*Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ **Shpendi** (Xhafer Durmishi) deklaroi:*

-Pajtohem që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj si e tillë deri në momentin kur të realizohet kërkesa për formimin e Republikës.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) deklaroi:

-Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parashef ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

*-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga **Shpendi** (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.*

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin "Zëri i Kosovës".

V E N D I M

I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. Organizatat e brendshme do të organizohen simbas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

3. Më vonë të formohet komisioni nga anëtarët e KQ për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSHJ.

4. Në KQ të hyjnë anëtarët e dy KQ të mëparshme në përbërje të plotë.

5. Udhëheqja e KQ të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme të KQ.

6. Organi i LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës" pasi ky emër shpreh zërin e Kosovës, kurse organi i Rinisë të quhet "Republika".

Qemali (Faton Topalli),
Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)

Mërgimi (Sabri Novosella)

17 shkurt 1982" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)

Pas marrjes së vendimit kemi shkuar prapë në ambasadë. Më 18 shkurt jemi kthyer me Sabriun në Adapazar. Pastaj kemi shkuar në Stamboll në banesën e Tefik Strajës ku kemi qëndruar disa ditë dhe jemi takuar prapë me Bujarin. Bujari na e ka paguar rrugën e aeroplanit mua dhe Osmanit. Unë kisha marrë të holla prej Suzanës të cilat më mjaftonin edhe për biletën kthyese por Bujari nuk më ka lejuar ta paguaj vetë biletën.

Unë dhe Osman Osmani kemi marrë aeroplanin Stamboll-Munchen më 22 shkurt 1982. Para se me u nisë apo thënë me konkretisht në aeroport Abdullahu e Osmani disa herë e kanë pyet Sabriun se a ka shokë tjerë në Shtutgart që janë si Skënderi? Se si e në çfarë kalibri më kanë përkufizuar nuk mund ta dijë. Sabriu më tregon se posa e kanë bërë atë pyetje e kam ditur mirë se me çfarë qëllimi ka ardhë Osman Osmani në Gjermani, ku si pikë fillestare e mbështetëse në këtë punë vetë ia kemi mundësuar ta ketë pikërisht shtëpinë e Jusufit në Habichthöhe str. 40 në Untergruppenbach.



Dy biletat e Xhafer Durmishit, Munchen-Stamboll e Stamboll-Munchen, të shkurtit 1982

8. Formimi i "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"

I. Kelmendi, më 5 shkurt 2007 na tregon se e ka pa protokollin e mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla, të formuar më 26 shkurt 1982 në Ludvigsburg.

I. Kelmendi: *"Edhe pse më 17 shkurt Sabiti, Xhafari e Avdyli themeluan LRSSHJ–në, në mars, një muaj më vonë, në banesë të Halim Berbatit formohet "Komiteti i Vëllezërve Gërvalla". Pjesëmarrës: Xhafar Durdeli, alias Skënderi, Drita Gërvalla, Halim Berbati, Nail Harabadaj, Fahri Tafaleku, Osalan Osforti, Hafif Gagaj, Nuri Syleviqi – Qerosi. Kopjen e protokollit themelues, të firmosur nga emrat e sipërshënuar e kam parë dhe habitem si kam mundur t'i mbaj mend gjithë këta emra. Ndoshta duhet të kem harruar edhe emrin e një ose dy pjesëmarrësve: Fazit Melaj dhe Xhahil Rambeja, alias Xhaviti." (Atentatet, f.388)*

Shtrohet pyetja se Komiteti Vëllezërit Gërvalla, a është formuar si pjesë e LRSHJ apo si organizatë më vete? A ka mundësi që pos Skënderit të Shtutgartit, anëtarë i këtij komiteti të ketë qenë edhe Osman Osmani, sekretari organizativ i ish PKMLSHJ-së, organizatori i demonstratave të vitit 1981 dhe i kërkesës Kosova-Republikë.

dhe habitem si kam mundur t'i mbaj mend gjithë këta emra. Ndoshta duhet të kem harruar edhe emrin e një ose dy pjesëmarrësve: Fazit Melaj dhe Xhahil Rambeja, alias Xhaviti.

Është me të vërtetë për t'u habitur me këta trika sa djallëzor aq edhe qesharak e primitiv. Është për t'u habit se si i ke mbajtur mend këta emra kur e ke pas në dorë një libër interesant të botuar në vitin 1997, ku për herë të parë ai dokument apo përshkrim i atij dokumenti në formë letre është botuar. Si quhet libri prej të cilit i ka mësua këto fakte për herë të parë? Kush e ka shkrua atë libër? Në cilën faqe të këtij libri i ka marrë këta emra në vitin 1997 që në mënyrë qesharake mundohet me na i servua se i ka ditë qysh më 1982?

Më heret e kemi pa se si Xhahil Rambejës, (Xhavitit), i ka rastisë që në emër UDB-së t'ia ngjet rastësisht emrin Fronti i Kuq, organizatës së I. Kelmendit, emër të cilin edhe I. Kelmendit nuk i ka rastisë ta ndryshoj edhe pas largimit të Xhavitit, informatorit të UDB-së. Tani I. Kelmendi mendon se ndoshta duhet të ketë harruar edhe emrat e Fazli Memajt e Xhavit Ramabajës si anëtarë të Komitetit Vëllezërit Gërvalla, me fjalë tjera duhet të ketë harruar se ndoshta prapë informatorit të rastësishëm të UDB-së nga mbledhja themeluese e Frontit të Kuq t'i ketë rastisë të marrë pjesë edhe në mbledhjen themeluese të Komitetit Vëllezërit Gërvalla.

Dokumenti për formimin e 'Komitetit Vëllezërit Gërvalla' është publikuar në librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, në vitin 1997, plotë 10 vjet derisa këtë fakt publik I. Kelmendi mundohet me na e shitur si zbulim të një sekreti të madh.

Faridin Tafallari: *"Para se të botoje librin tënd "Atentatet", m'i kërkove librat e mi "Terror, Dhimbje, Qëndresë" dhe "Dhimbje Krenare" dhe shumë materiale të tjera të kësaj natyre, dhe unë edhe pse e dija, se ti nuk ke besë t'i dërgova...por ti nuk m'i ktheve kurrë !"* (IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS, www.albaniapress.com, 5 qershor 2009)

Ky është dokumenti që gjendet në librin e Faridin Tafallarit nga viti 1997.

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla:" "Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"

Të dashur shokë!

Udhëtimin e Shpendit e quajtëm si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm. Ditën kur u

kthye Shpendi pra të hënën, ditën e parë të javës, kur shokët ia filluan javës së re të punës.

Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishin farë automjeti, mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirr gjer më 26 shkurt 1982. Atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën: Shpendi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Drita (Suzana Gërvalla), Agimi (Nuhi Sylejmani), Agroni dhe Guximi (Haxhi Berisha).

Mbledhjen e hapi Shpendi i cili në fillim i ***njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën*** *e re dhe me detyrën e qëllimin e ardhjes së Halimit.*

Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Formimi i degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore.

a) Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet "Komiteti Vëllezërit Gërvalla".

b) Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë

Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua njëzërit nga të pranishmit.

1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit, pra pesë veta. Meqë Agimi ishte edhe më parë si arkatar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe Shpendin nuk u diskutua shumë rreth tyre se a duhet të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që Komiteti t'i ketë edhe dy kandidatë. Ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimi që në fillim tha se pyetjen për arkatar nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkatarin e vyeshëm e kemi që nga fillimi. Propozimi i Arsimit që edhe më tutje të jetë arkatar Agimi i aprovua.

Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoj në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. *Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e mori Drita e cila u falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se* ***Shpendi ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ të ish-LNÇKVSHJ****. Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore. Edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan. Për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.*

Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet Halimi. *Ndërsa anëtarë i ri i komitetit do të jetë Arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të zgjidhet Luli.*

a) Propozimi që komiteti të quhet "Vëllezërit Gërvalla" u aprovua njëzërit.

b) Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari i ri Halimi edhe ca anëtarë të tjerë të ish-LNÇKVSHJ nuk dinin shumë në lidhje me përbërjen në numër të një komiteti, mbretëroi pak heshtja. Me këtë rast Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon qe disa vjet dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperiencë lidhur me funksionimin e një komiteti të tillë sidomos në kushtet jashtë atdheut dhe pasi ne ishim të pranishëm tetë ndërsa komiteti do të kishte vetëm pesë anëtarë. Halimi tha se faktikisht për anëtarët e këtij komiteti po dinë 8 veta. Ai tha se edhe ata aktivist të dalluar të jen si kandidat për komitet. Ky propozim dhe arsyetimi i cekur më lartë u pranua. Pra komiteti i degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla" për Evropën Perëndimore ka me shkuarjen e Dritës ai do të duket kësisoji:

1. Shpendi Kryetar Xhafer Durmishi

2. Drita/Halimi	*Sekretar*	*Suzana Gërvalla/Osman Osmani*
3. Agimi	*arkatar*	*Nuhi Sylejmani*
4. Agroni	*anëtarë*	*Faridin Tafallari*
5. Halimi	*anëtar*	*Osman Osmani*
6. Halili	*kandidat*	*Hafiz Gagica*
7. Guximi	*kandidat*	*Haxhi Berisha*
8. Arsimi	*Përgjegjës i rinisë*	*Naim Haradinaj*

2) Në pikën të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, çështjet materiale, puna rreth vendosjes në një bazë të re dhe nxjerrjes sa më të shpejtë të numrit të ri të organit.

Për këto dhe të tjerat herën e ardhshme.

Ju përshëndesin shokët e "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"

Kosova – Republikë" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358)

Në këtë kohë unë, më 22 shkurt, veç ia kisha komunikua Suzanës, vendimin e Shqipërisë për ta pranuar familjen e Jusufit.

Ne e patëm qitë fjalën edhe atë vetëm për shokët më të ngushtë se Suzana do të shkoj në A. (d.m.th. Australi, nën përkujdesjen e Rilind Bytyçit dhe Shoqërisë "Bajram Curri"), pasi kishim kontakte të vendosura me ta dhe botimet e tyre ishin të dukshme në Kalanë e Jusufit.

9. MBLEDHJA E KOMITETIT "VËLLEZËRIT GËRVALLA MË 11 KORRIK 1982

Një dokument i kohës në të cilin përshkruhet puna prej 18 janarit 1982 deri në korrik 1982, e sidomos përjashtimi i Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e Jusufit është ky:

"Procesverbal i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla i mbajtur më 11/7-1982

Rendi i ditës:

Një analizë e punës së gjertanishme
Diskutimi rreth Projektstatutit të Lëvizjes
Puna rreth revistës
Caktimi i datës për takimin e ardhshëm
Të ndryshme

Shtatë të pranishmit: Skënderi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Naim Haradinaj, Faridin Tafallari, Haxhi Berisha, Hafiz Gagica dhe Nuhi Sylejmani, njëzëri e aprovojnë propozimin mbi rendin e ditës. Skënderi hapë diskutimin rreth pikës së parë.

Fjalën e merr shoku Faridin.

Shpjegim: Në diskutim u vendosë që analiza të bëhet nga 17 janari e gjer më sot.

***Faridin Tafallari**: Pritja e njerëzve sipas Faridinit ka qenë e mirë dhe ndihmat për këtë kanë ndikua. Kjo nuk është bërë me një organizim të mirëfilltë por është veprua në atë mënyrë që secili ka veprua si ia ka marrë mendja më së miri. Dalja e numrit të tretë të ZK ka qenë ngjarje e madhe.*

Sjelljet e Ibrahim Kelmendit (I.K.) nuk kanë qenë të mira.

***Veprim i ngutshëm nga ana jonë, pra nga Skënderi dhe Haxhiu, si dhe vonimi i Nuhiut që të thotë fjalën e tij me një shumë të hollash prej** njëmbëdhjetëmijë DM. Mosmarrëveshja në mes veti për këtë veprim. Demonstratat kanë kaluar mirë.*

Udhëtimi i Suzanës për në Shqipëri ka qenë në rregull. Formimi i KVG (Komitetit 'Vëllezërit Gërvalla-shën i Xh. D) konsiderohet ngjarje e madhe. Riorganizimet në rregull. I dyti jo aq i mirë sepse mungoi Haxhiu. Fushata e shfaqjes së filmave çmohet lartë. Demonstrata e Bonit çmohet lartë e gjithashtu e Vjenës përkundër vështirësive. Haxhiu nuk e sqaroi situatën gjer në fund. Demonstrata e Bernit në rregull. Numri i fundit i revistës dhe komunikata të mira. Me kaq shoku Faridin e mbylli fjalën e tij.
Pas kësaj Skënderi i drejtohet Nuhiut që ta merr fjalën por ai përgjigjet se donë të dëgjoj të tjerët e vetë do të flasë në fund. Të tjerët pajtohen me këtë.

Fjalën e merr Naimi:

***Naim Haradinaj: Pritjen e quan të mirë megjithëse ram në konflikt me I.K. (Ibrahim Kelmendin). Hapat tonë i quan të drejtë sidomos përjashtimin e tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga shtëpia e Jusufit. Edhe Nuhiu** ka qëndrua mirë një kohë të gjatë në pritjen e njerëzve. Marshet protestuese në rregull. Varrimi kishte me qenë më i mirë sikur për inçizimin me videokamerë të angazhohej një punëtor profesional. Numri i tretë i revistës i realizuar mirë. Demonstrata e Vjenës më e mirë se e Bonit. Formimi i KVG me vend. E sheh si rënie dhe në kundërshtim me komunikatën. Heqja e citatit të Jusuf Gërvallës e gabueshme. Me kaq Naimi e mbaron fjalën e vetë.*

Haxhi Berisha: Pritja në rregull. Për shkak të mosorganizimit më të mirë kanë lindur mospajtime. ***Ka pasur sabotim dhe zhagitje të punëve nga ana e I. K. I është tërheq vërejtja disa herë. Sipas mendimit tim ai nuk ka jetuar fare me atmosferën ato ditë.*** *Angazhimin e një punëtori profesional për inçizimin e varrimit e quan të panevojshëm. Përmes formimit të KVG u vazhdua puna e mëparshme. Vështirësitë me demonstratën e Vjenës kanë të bëjnë me qëndrimin anësor të policisë të cilët na thonin herë po e herë jo. (Haxhiu ka qenë i angazhuar për leje dhe ka bërë një udhëtim gjer në Vjenë ditën e enjte më 22 prill 1982). Megjithatë këtë e çmoj më shumë se të tjerat.*

Halimi (Osman Osmani): Formimi i KVG i domosdoshëm (ky ia fillon nga kjo ngjarje pasi më parë nuk ka qenë këtu). Puna ka vazhdua por ka pasur dobësi. Për shkak të mospërvojës mund të kemi bërë gabime, por largimi i tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga familja i mirë për të mos thënë i domosdoshëm. Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha. Puna e komitetit dhe vetë ekzistenca e tij kanë qenë formale.

Nuhi Sylejmani*: Pritja ka mund me qenë më e mirë, por ngjarje të tilla të befasishme s'kemi mund ndryshe. Nuk është i kënaqur. Pritja ka qenë formale. Nuk kemi diskutue në mes veti. Ditën e varrimit nuk dilnin njerëzit prej dhome. Ka shkua si në diktaturë. Videofilmimin e varrimit është dashur ta bëjë një profesionist ashtu siç thotë Naim Haradinaj. Formimi i KVG i mirë por është dashur më parë të formohen celulat e pastaj komiteti dhe jo anasjelltas. S'kemi pasur asnjë shokë afër veti. Organizimi i brendshëm jo i mirë. Dekonspirimin e dënon dhe e quan krim të madh.*
Veprime me gjaknxehtësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë I. K. fakte për sulm megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.

Udhëtimi i Suzanës në Shqipëri mirë, megjithëse nuk jemi marrë vesh në mes veti. ***Demonstrata e Bonit e mirë por me Skenderin ka pasur mosmarrëveshje sepse kam brohoritur Kosova-Republikë dhe lavdi Marksizëm-leninizmit e ai më ka thënë mos bëjë ashtu. (Shkaktohet një qeshje kur Nuhiu thotë se më ka thënë mos thuaj Kosova-Republikë, Marksizëm-Leninizëm dhe Nuhiu e përmirëson veten dhe thotë se më ka thënë vetëm mos me brohoritë Marksizëm-Leninizëm.***

***Skënderi (Xhafer Durmishi)**: "...**Shfaqja publike e dyshimeve ndaj I. K. e gabueshme.** Demonstrata e Vjenës përkundër vështirësive është historike sepse është demonstrata e parë shqiptare që bëhet për Kosovën në Austri. Përgjigjja e masave në thirrjet tona është fakti më demantues kundër gënjeshtrave se njerëzit janë dëshpëruar."*

Nga ky dokument, më së interesanti është konstatimi i Osman Osmanit, i cili në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla ka ardhë më 22 shkurt 1982, d.m.th. 17 ditë pas ditës së varrimit më 5 shkurt 1982. Edhe pse ka ardhë pas kaq ditësh ai e gjen I. Kelmendin në Habichthöhe dhe mendon se përjashtimi i tij nga shtëpia e Jusufit ka qenë i domosdoshëm. Fjalët e tij **'Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha'** mund të duken të drejta për atë kohë. Në perspektivën historike dhe në bazë të fakteve të mëvonshme, një nga punët më të ndershme e më heroike të asaj kohe që kanë bërë shokët e Jusufit është pikërisht fakti se I. Kelmendit ia kanë thënë të gjitha dhe atë në formë publike dhe në bazë të dyshimeve të bazuara, familja e Jusufit e ka përjashtuar nga Habichthöhe.

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korrigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...*

Shokët e Vjenës (Ambasadës Shqiptare në Vjenë - shën im) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!" (Raport Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Faridin Tafallari: *"Suzana: **A pe ndonjë njeri?***
*Jusufi: **Po e pash një njeri me trup të gjatë po nuk munda ta njoh. Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. AMANET po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot**." (*Terror-Dhimbje-Qëndresë, f. 52*)*

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi. Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim ... Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë **drejt dobësimit apo shuarjes totale**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 124)

Ramadan Pllana: "*LNÇKVSHJ-ja, **u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."*

10. OXHAKU I TIJ I LARTË, QË i MBETI NË KËMBË

Jusuf Gërvalla: *"Në ballë i kërceu një damar i trashë.*

Iu bë se ishte rritur për këmishën e dragoit, që dikur ishin përpjekur t'ia shplonin më kot të tjerët. U ngjit lart në tavan, mes frymëve që kaluronin natën, dhe e veshi atë këmishë.

Ç'po ngjante kështu?

I fërkoi sytë. Një zhurmë e brendshme ia kaploi trupin.

Po zgjohej zhurmshëm nga kotja e rëndë shekullore, që e ngurron nganjëherë edhe draguan.

***Oxhaku i tij i lartë, që i mbeti në këmbë** si shenjë e shpotitjeve të Dakë Skelës dhe të Bekë Troshit, atë ditë e sot, shekuj me radhë, **nxjerrë tymin** duaj-duaj dhe pos fluskave të bardha të borës e **ZËRIT** të thekshëm të kalamajve, s'ka frymë as erë tjetër që ia tollovit fqollat që marrin erë thikë përpjetë." (*Rrotull, Tiranë 1983, faqe 124-125)

Halil Matoshi: "*Lidhur me rolin e LNÇKVSHJ dhe të Jusuf Gërvallës në demonstratat e vitit 1981, fjalën e vetë do ta thotë historia, por një gjë dihet botërisht: nuk është zhvilluar asnjë proces politik në gjykatat serbe të Kosovës gjatë viteve të tetëdhjeta ku të mos jetë përmendur emri i Jusuf Gërvallës dhe gazetat e tij "Lajmëtari i lirisë" dhe "Zëri i Kosovës*". (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 104)

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

Emrush Xhemaili: ***"Në qershor të vitit 1982** në Gjermani me teknikën që kishte lënë dëshmori **Jusuf Gërvalla VAZHDON** botimi i gazetës (së pashuar-shën. im) **"Zëri i Kosovës".** Redaktor i gazetës ishte Skender Durmishi (Xhafer Durmishi-Skënderi-shën im*). (20 vjet veprimtari, 1982-2002)

RËNDËSIA E GODITJES SË PARË

Qëndrime për Abdullah Prapashticën dhe Nuhi Sylejmanin të shprehura më 2009 dhe në fillim të vitit 2010, që mund të merren si përgjigje në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010.

Lidhur me diskutime që kanë të bëjnë me ngjarjen e 17 janarit 1982 në Shtëpinë e Jusuf Gërvallës, me Faridin Tafallarin, gjatë vitit 2009, kam këmbyer pos tjerash këto mendime:

Xhafer Durmishi: *"Që në fillim dua të them se jo vetëm ky shkrim por sipas mendimit tim asnjë shkrim tjetër i yti nuk e mbërrin nivelin e asaj që e ke thënë në librin e parë "Terror, dhimbje, qëndresë". Megjithatë unë ende nuk e kam dhënë një mendim të përmbledhur për librin tënd të parë.*
Forcë të librit tënd të parë pos tjerash e konsideroj faktin se ti aty Riza Salihut e Hysen Gegës në cilësinë e shokut të Rizahut ua kushton 5-6 rreshta e jo më shumë.
Në reagimin tënd të mëparshëm "Zhgënjim" dhe në këtë që ma ke dërgua shumë qëndrime që i ke pas p.sh. për Hysen Gegën, Riza Salihun e Nuhi Sylejmanin në librin e parë tani i ke ndryshua.
Mendimi im është se me pasojat juridike të librit dhe deklaratave të Ibrahim Kelmendit do të duhej të merreshin gjykatat dhe jo të tjerët. Është për keqardhje që në këtë drejtim gjykatat dhe juristët e Kosovës nuk janë marrë gjer më sot.
Aspektet e ndryshme të luftës për pushtet me mënyra që i përdorin shumica e partive sot mendoj se duhet veçuar nga rasti i 17 janarit 1982.
Unë nuk jam duke u marrë me shkrime, por po të shkruaja në këtë temë do të shkruaja më ndryshe...
.... Për Nuhi Sylejmanin nuk kisha me shkrua më keq se sa e meriton. Ndaj njerëzve që nuk merren me shkrime dhe ndoshta nuk kanë aftësi për t'u mbrojtur duhet treguar kujdes më të madh." (Letër dërguar Faridin Tafallarit, 3 qershor 2009)

Faridin Tafallari, në janar 2010 botoi në librin e tij "ME TRE YJET E PAVDEKËSISË në ato vite të stuhishme". Këtë libër e kam lexuar në dorëshkrim dhe i kam dhënë vërejtjet e mia. Falënderimi i Faridin Tafallarit për punën time në këtë libër e ka këtë përmbajtje: *"Me rastin e botimit të librit tim: ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, NË ATO VITE TË STUHISHME", dëshiroj të falënderoj Xhafer Durmishin, i cili e ka lexuar përmbajtjen e librit në dorëshkrim, dhe përkundër qëndrimeve të tij, megjithëse ende të pashprehura publikisht në tërësi, pa rezervë më ka bërë vërejtje, të cilat i kam marrë parasysh.* ***Pjesën e tretë****, të fundit, Xhafer Durmishi* ***nuk e ka komentua****".*

Pjesa e tretë e librit të lartpërmendur përmban shkrime rreth asaj se kush mund të jetë i implikuar (Riza Salihu etj.) në vrasjen e 17 janarit 1982, në shtëpinë e Jusuf Gërvallës.

Jo për hir të Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit, e aq më pak për inatin e tyre, por vetëm e vetëm për hir të Jusuf Gërvallës, unë kurrë në jetë nuk kam shprehur asnjë dyshim ndaj Nuhi Sylejmanit apo ndaj ndokujt tjetër, përveç asaj çka e ka shkrua dora ime prej janarit 1982 e deri më sot, si në letra private ashtu edhe në trakte e dokumente publike.

Ramadan Pllana: *"Nëse e ke përcjellë një reagim ndaj meje të Avdullah Prapashticës ku flet për bashkimin e dy organizatave ne Stamboll, ku ai thotë se erdhi në Stutgart, ku ishe ti, e "shpëtoi" Organizatën sepse ishte në krizë nga mungesa e Jusufit....Vetëm Faredin Tafallari reagoi dhe ia mbylli gojën."* (Letër Xhafer Durmishit, 10 nëntor 2009)

Një letër dërguar Ramadan Pllanës shprehen qëndrimet e mia të vërteta ndaj Abdullah Prapashticës.

Xhafer Durmishi : *"Shkrimin e Abdullah Prapashticës e kam lexuar dhe ka shumë pak tekste që më bëjnë me qesh e që më kënaqin shpirtin më shumë se shkrimet e budallallëqet e Abdullah Prapashticës, dhe shpresoj që ai të vazhdoj me kontributin e tij teorik edhe më tutje. Zoti jetën ia shtoftë e i dhashtë shëndet. Është mirë që të ka ra ndërmend se ekziston Faridin Tafallari, si shok i Jusufit e njohës i mirë i rrethanave të asaj kohe. Për ekzistencën e Faridin Tafallarit e librit të tij "Terror Dhimbje Qëndresë" të kam tregua më 2006, ndërsa ti ishe i fokusuar më shumë dhe i kishe pas ra në trag Nuhi Sylejmanit e për Faridin Tafallarin nuk kishe ndie kurrë deri sa të tregova unë. Me fjalë tjera në këtë rast i ke shitë dardhagjisë dardha."* (Letër dërguar Ramadan Pllanës, më 11 nëntor 2009)

Një qëndrim tjetër për Nuhi Sylejmanin.

Xhafer Durmishi: *"Pas demonstratës së Bernit (26 qershor 1982) në muajin korrik Osman Osmani u largua nga rrethi ynë. Për këtë qëllim kishte jo vetëm përkrahjen nga shokët e vetë në Turqi por edhe nga diplomatët shqiptarë në Vjenë. Prej shokëve të afërm të Jusufit, Nuhi Sylejmani ishte i vetmi që iu bashkua. Pra atentati i 17 janarit në rrethin organizativ të Jusufit nuk krijoi ndonjë turbulencë. Ato fërkime që ndodhën ishin pasojë e pranimit të Osman Osmanit, pjesëtar i një organizate të huaj në shtëpinë e Jusufit, i cili kishte ardhë me mision ta lartësoj punën e ...Abdullah Prapashticës dhe ta denigroj atë punë që ishte bërë në Shtutgart dhe në Zvicër më parë. Nuhi Sylejmani, një aktivist i dalluar në rrethin e Jusufit, pas vdekjes së Jusufit u lëkund në qëndrimet e tij, por për këtë nuk ndiej kurrfarë mllefi ndaj tij, pasi në histori pas vdekjes së një personaliteti të madh janë lëkundur shumë e shumë burra më të mëdhenj se sa Nuhi Sylejmani. Forca tërheqëse e Jusufit kishte ndikuar që Nuhiu të tregonte anët e veta më të mira për një kohë. Pas vdekjes se Jusufit, forca tërheqëse e jonë nuk ishte e mjaftueshme për te dhe ai për një kohë tregoi veti që nuk ishin në mesin e më të mirave."* (Letër dërguar N.N., 13 shkurt 2010)

Janë raste shumë fatlume për ata të cilët i përgatisin sulmet në mënyrë aq të mirë sa goditja e parë e tyre të jetë edhe e fundit. Teorikisht shumë veta ëndërrojnë se e kanë këtë veti. Fatkeqësisht, në praktikë, në jetë, këto janë raste tepër, tepër të rralla.

Me këto fjalë deshta të them se duket sikur është krijuar një situatë për keqardhje, në të cilën disa persona janë bërë aq mendjelehtë ndaj fakteve të një kohe jo fort të largët, sa janë duke u sjellur sikur unë vërtetë prej kohësh të mos ekzistoja fare, sikur unë realisht të mos isha në mesin e të gjallëve, duke krijuar kështu një atmosferë në të cilën fitohet përshtypja se qentë endacak janë duke bredhur triumfalisht nëpër fusha e nëpër ara me eshtrat a mia në gojë.

"U kthye edhe njëherë. Jo për hir të zymtësisë shekullore të tjegullave që i rrinin barrë katundit, po iu hodh jetimit ta shikonte edhe njëherë oxhakun e kullës së gjyshit, të vetmin oxhak që atë mëngjes nuk po nxirrte tym dhe të vetmin që kishte mbetur pa ngrohtësinë e djalit pranë, pa ngrohtësinë e djepit të kërthirit, të cilin s'ka as dorë që ta përkund."

SHKOLLA E UDB-SË
KUNDËR
JUSUF GËRVALLËS

E shfaqur në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010

1. Çështja e Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ
2. GJENEZA E EMRIT "ZËRI I KOSOVËS", SIPAS GJENAZEVE
3. GJENEZA E EMRIT "LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE **VISEVE TJERA SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI**" SIPAS GJENAZEVE
4. Jusufi nuk ishte mbret!
5. Propozimi për t'ia nisur nga zeroja
6. Nuk ishte pajtuar - Ishte pajtuar
7. Mohimi i Zërit të përgjakur nga gjaku i Jusufit dhe të të vrarëve
8. Shkrirja - Ngrirja dhe Shuarja totale e Partisë "Komuniste"
9. Vazhdimi i punës nga aty ku e kishte lënë Jusufi dhe vazhdimi i punës nga aty ku e kishte lënë UDB-a Serbe
10. Faqosja e Zërit të Jusufit sipas falsifikatorëve të pa faqe d.m.th. të pafytyrë
11. Shkolla e UDB-së si hotelieriste e pronare çelësash në Kështjellën e pamposhtur të Jusuf Gërvallës
12. Shkolla e UDB-së e shpëton familjen e Jusuf Gërvallës prej hamendjeve

Sqarim: Shkrimi *Shkolla e UDB-së kundër Jusuf Gërvallës* u botua për herë të parë në www.pashtriku.org më 1 dhjetor 2010. Lajmi i datës 26 shkurt 2011, lidhur me promovimin e librit në fjalë, në lokalet e Ambasadës së Kosovës në Bern iu shtua më 16 qershor 2011.

Lufta e dështuar e Dordolecit superior Abdullah Prapashtica dhe vëzhguesit të tij, kundër Jusuf Gërvallës.

Kjo luftë bëhet në katër drejtime:

-1. Kundër Lëvizjes së Jusuf Gërvallës,
-2. Kundër Jusuf Gërvallës si person,
-3. Kundër mureve e hapësirës së shenjtë të shtëpisë së tij dhe
-4. Kundër familjes së tij.

Për të evituar çdo keqkuptim dua të them se përkujdesja ime për familjen e ngushtë të Jusufit, si shok në mesin e shokëve të Jusufit është e një afati të kufizuar dhe preciz kohor dhe shtrihet vetëm e vetëm nga 21 janari gjer më 28 mars 1982, d.m.th. 67 ditë. Sa i përket qëndrimit ndaj Bardhoshit e ndaj Jusufit si luftëtar e ideolog i lirisë, si anëtarë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në/nën Jugosllavi punët qëndrojnë pakëz më ndryshe dhe ma merr mendja se do të vlejnë periudha tjera kohore.

E quaj të arsyeshme të përmendi se Abdullah Prapashtica ka qenë ushtrues legal, zyrtar d.m.th. jo i fshehët por i shkolluar në mënyrë profesionale, i detyrës së inspektorit të UDB-së Serbe, profesion prej të cilit i ka siguruar mjetet për jetesë, dhe prej të cilit ka dezertua. Këtë e bëjë për të evituar dyshimet për etiketime të pa baza me të cilat ushqehen shumë e shumë veta dhe për ta argumentuar titullin e këtij shkrimi. Përkundër kësaj, sikur ai ta kishte pasur guximin me i nënshkrua fjalët e veta me emrin e vet, titulli i këtij shkrimi do të ishte tjetër. Pozita ime delikate është se para citateve e kam pasur vështirë ta vendosi emrin e Nuhi Sylejmanit apo të Abdullah Prapashticës dhe Vëzhguesit të tij. Një lehtësim megjithatë ekziston, pasi Dordoleci superior Abdullahu dhe Vëzhguesi i tij Osman Osmani, pas asnjë rezervë, janë deklaruar me shkrim për librin ”e tyre” ”Vrasja e trefishtë”.

Abdullah Prapashtica

Abdullah Prapashtica: *"Ajo që sjell Nuhi Sylejmani në librin e vet është* ***dëshmia e ti personale*** *si njëri nga bashkëpunëtorët e rrethit të ngushtë të Jusuf Gërvallës në Gjermani, mbi atë bashkëpunim që kanë pas ata së bashku në kuadër të ish LNÇKVSHJ dhe* ***dëshmi autentike*** *e zhvillimeve të pastajshme... (...)Nuhi Sylejmani shkruan me kompetencë..."* (MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT“ TË NUHI SYLEJMANIT, www.albaniapress.com, 14 tetor 2010)

Osman Osmani: ***"Kujtimet dhe dokumentet përcjellëse brenda librit sjellin fakte historike të pakundërshtueshme dhe të panjohura gjer më tani****. **Në mënyrën më të përpiktë**, paraqitet gjendja dhe zhvillimi i tri organizatave shqiptare të asaj kohe, që vepronin kryesisht në botën e jashtme si Fronti i Kuq*

Populllor, GMLK/OMLK dhe LNÇK/LNÇKVSHJ, si dhe për proceset organizative dhe ideologjike nëpër të cilat kalojnë këto organizata para dhe pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.

Autori ndër të tjera, ***në mënyrën më besnike****, përshkruan peripecitë dhe ballafaqimet me sfida të shumta të familjeve Gërvalla dhe Zeka pas atentatit të 17 janarit të vitit1982."* (Kopertina e mbrapme e librit Vrasja e trefishtë)

"*Libri "Vrasja e trefishtë" është promovuar të shtunën që shkoi (26 shkurt 2011-shën ynë), në* ***ambientet e Ambasadës së Kosovës në Bern****. Folësi i parë,* ***Faton Topalli****, hapi promovimin duke përshëndetur në emër të organizatorit, Bashkësisë Shqiptare të Shafhauzenit dhe qendrës Pro Integra. Ai, në fjalën e tij, librin e vendosi në kontekstin e kohës që po jetojmë, kohë antagonizmash të shumtë, sipas tij. "Ky libër, edhe për shkak të kësaj kohe, fiton një rëndësi të veçantë. (...)*

KY ORGANIZIM ËSHTË NDER PËR AMBASADËN E KOSOVËS

Në cilësinë e nikoqires, organizatorët i ka përshëndetur ***Artana Bardhi****, ministre-këshilltare në Ambasadën e Kosovës në Bern. Ajo, duke përcjellë përshëndetjet e ambasadorit Naim Malaj, ka vlerësuar lartë rolin dhe sakrificën e mërgatës në të gjitha proceset e shtetformimit të Kosovës. Një pjesë e kësaj sakrifice, ka thënë ajo, dokumentohet edhe në librin që po promovojmë. Prandaj ky organizim është nder edhe për ambasadën e Kosovës, ka thënë znj. Bardhi."* (Marrë nga http://www.albinfo.ch, 28 shkurt 2011)

Një letër dërguar Ramadan Pllanës më 11 nëntor 2009 shprehen qëndrimet e mia të vërteta ndaj Abdullah Prapashticës, pra rreth 10 muaj **para** leximit (në gusht 2010) të librit "Vrasja e trefishtë", fjalë të cilat jam shumë i kënaqur që i kam thënë.

Xhafer Durmishi: *"Shkrimin e Abdullah Prapashticës e kam lexuar dhe ka shumë pak tekste që më bëjnë me qesh e që më kënaqin shpirtin më shumë se shkrimet e budallallëqet e Abdullah Prapashticës, dhe shpresoj që ai të vazhdoj me kontributin e tij teorik edhe më tutje. Zoti jetën ia shtoftë e i dhashtë shëndet. Është mirë që të ka ra ndërmend se ekziston Faridin Tafallari, si shok i Jusufit e njohës i mirë i rrethanave të asaj kohe. Për ekzistencën e Faridin Tafallarit e librit të tij "Terror Dhimbje Qëndresë" të kam tregua më 2006, ndërsa ti ishe i fokusuar më shumë dhe i kishe pas ra në trag Nuhi Sylejmanit e për Faridin Tafallarin nuk kishe ndie kurrë deri sa të tregova unë. Me fjalë tjera në këtë rast i ke shitë dardhagjisë dardha." (Letër dërguar Ramadan Pllanës, më 11 nëntor 2009,* www.pashtriku.org*, 23 shtator 2010)*

Pse Abdullah Prapashtica dhe vëzhguesi i tij Osman Osmani veprojnë kështu, me këtë intensitet, ndaj Jusufit dhe Lëvizjes së tij, të cilët mund të thuhet se nuk u kanë bërë asgjë të keqe përveç të mirave, kjo me të vërtetë më ka befasuar, befasi e cila shihet në mënyrën më të qartë nga rreshtat e letrës së mësipërme.

1. Çështja e Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ

Jusuf Gërvalla: *"Mbrëmë ishim me Besnikun (Bardhosh Gërvalla-shën im) te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë.* ***Unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku****, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të* ***Komitetit të degës së këtushme****."*

(Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981, Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Çka tregon letra e mësipërme? Kjo letër është **vërtetimi i parë** se më 20 gusht 1981 (brenda një muaji pas arritjes sime) në Shtutgart ka ekzistue ***"Komiteti i degës së këtushme"*** , do me thënë jo Komitet Qendror. Anëtarë të këtij *"Komiteti të degës së këtushme"* janë **Jusuf Gërvalla, Xhafer Durmishi (Shpendi) dhe Bardhosh Gërvalla (Besniku)** të cilët i analizojnë anët dhe virtytet e mira të një bashkatdhetari në Visloh (Isa Bulan-shën i Xh. D.) afër Heidelbergut dhe vendosin se do të kish qenë mirë ta bënim atë menjëherë anëtarin e katërt të "***Komitetit të degës së këtushme.***"

Shkolla e UDB-së: "*Jusuf Gërvalla kishte qenë anëtar i Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), që datonte qysh nga viti 1975. Arrestimet e 14 dhjetorit të vitit 1979, e detyruan Jusufin të emigrojë në Gjermani, ku ishte i punësuar vëllai i tij, Bardhoshi. Duke i parë lëvizjet ilegale të diasporës, ai e pa të arsyeshme që* ***ta riorganizojë edhe njëherë Lëvizjen****, duke e themeluar Komitetin Qendror me këtë përbërje:*

Jusuf Gërvalla, me pseudonim – Sokoli
Bardhosh Gërvalla, me pseudonim – Besniku
Nuhi Sylejmani, me pseudonim – Luani

Pas themelimit të Komitetit Qendror, që do të merrej me çështjet organizative, u vendos që Jusufi të merrej me përpilimin e statutit dhe mundësinë e botimit të një gazete. Bardhoshi do të merrej me procedurat e regjistrimit si parti politike, e cila do të vepronte legalisht në shtetin gjerman, kurse unë do të merresha me përzgjedhjen e anëtarëve të rinj dhe përmes tyre grumbullimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të shtypit dhe për ndihma humanitare për familjet e të rënëve, të burgosurve politikë dhe të varfërve në Kosovë dhe në viset e tjera ku jetonin shqiptarët në Jugosllavi!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 60)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ), që ishte shkapërderdhur pas goditjes së 14 dhjetorit të vitit 1979, për herë të parë ishte riorganizuar në Untergruppenbach të Gjermanisë, nën përkujdesjen e Jusuf Gërvallës (Sokolit) dhe në praninë e dy anëtarëve të emëruar nga Jusuf Gërvalla. Anëtari i parë ishte emëruar Bardhosh Gërvalla (Besniku), kurse anëtari i dytë ishte emëruar Nuhi Sylejmani (Luani)."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 124)

Jusuf Gërvalla: "*I dashur vëlla Mërgim, 14 janar 1982*
Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë. Unë e shkrova në disa variante, por me asnjërin prej tyre nuk mbeta i kënaqur. Nuk jam mësuar të komunikoj me një nivel të tillë. Më së fundi e lash variantin që e mora prej teje.
Hapi si hap më pëlqeu shumë dhe më duket shumë i dobishëm. Por, nuk di a duhet të jemi të kënaqur si e kemi realizuar.
Në letrat e fundit na kanë ardhur disa këshilla nga ana juaj. Ta them të drejtën se mua personalisht më kanë lënë me një ndjenjë të ftohtë. Thelbi i tyre konsiston, sipas përshtypjes sime, në një tërheqje në vete, që u dashka të aplikohet prej nesh. Ose nuk kam qenë në gjendje ta kuptoj qartë. Se cilësia duhet të ketë përparësi ndaj sasisë, kjo dihet dhe për këtë kam shkruar edhe vetë, nëse të kujtohet, në atë Qarkoren drejtuar

shokëve në D., që ti e ke pas pëlqyer. Por që atëherë kushtet kanë ndryshuar shumë. Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit, gatishmëria e madhe për flijime të larta, ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë. Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët. ***Kështu e pata kuptua më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ (Komitetin Qendror-shën im)."*** (Letër Sabri Novosellës më 14 janar 1982. E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

Jusufi nuk ka qenë i autorizuar me themelua e as me riorganizua Komitet Qendror. Këtë punë nuk ia ka lejua vetes. Këtë çështje ai, si anëtar me disiplinë shembullore ia ka besuar Sabri Novosellës. Riorganizim e thirrje në Komitet Qendror është bërë vetëm përmes Sabri Novosellës. Bardhosh Gërvalla nuk ka qenë anëtar i Komitetit Qendror.

Nuhi Sylejmani: *"Në faqen e parë (Zëri i Kosovës, mars 1982-shën. i Xh. D.) u botuan fotografitë e martirëve dhe një artikull me titull: „Tre ranë me mijëra u ngritën", duke vazhduar në faqen e dytë me titull: „Nekrologji",* ***ku jepeshin të dhëna të sakta*** *për jetën dhe veprat e Jusufit, Bardhoshit dhe Kadriut."* (Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 119)

Të dhënat e sakta për Bardhoshin janë si vijon:

Xhafer Durmishi: "*U bë mbështetja më e fortë e Jusufit në vazhdimin e punës patriotike jashtë atdheut. Anëtar i LNÇKVSHJ ishte nga viti 1977. Për meritat e mëdha dhe besnikërinë ndaj atdheut u zgjodh* ***sekretar i degës së LNÇKVSHJ*** *për Gjermaninë Perëndimore.* ***Bardhosh Gërvalla*** *si shumë bashkatdhetarë shkoi me mall të Kosovës, sepse pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi larg saj. Vdiq, duke e mundur vdekjen, më 17 Janar 1982 si luftëtar i pakompromis për të drejtat e popullit shqiptarë në Jugosllavi. Bardhoshi (Besniku) do të jetoj përgjithmonë në zemrën e popullit."* (Nekrologji, Zëri i Kosovës, nr.3 mars 1982, faqe 2)

Të dhënat e sakta për Jusufin janë si vijon:

Xhafer Durmishi: "*Ishte drejtues i Komitetit të LNÇKVSHJ për Evropën Perëndimore. Me plotë suksese redaktoi dhe udhëheqi revistën patriotike "Lajmëtari i Lirisë", e cila bëri aq jehonë tek shqiptarët e Kosovës. Ishte anëtarë i KQ të LNÇKVSHJ. Aktivitet të bujshëm zhvillon sidomos pas demonstratave të Pranverës 1981. Si anëtarë i KQ, ai ishte edhe kryeredaktor i organit qendror të LNÇKVSHJ "Zëri i Kosovës", detyrë në të cilën ishte deri në çastin e vdekjes."* (Nekrologji, Zëri i Kosovës, nr.3, mars 1982, faqe 2)

Po ta marrim rigorozisht renditjen e anëtarëve të Komitetit Qendror, atëherë citati i letrës së Jusufit duket kështu:

Kështu e pata kuptua më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ (Komitetin Qendror-shën im)."

Jusufi i ka dërguar Nuhi Sylejmanit katër letra. Në tri prej letrave pseudonimi i Nuhiut është Nuhi ndërsa në të katërtën Vullnet. Çka rrjedh nga kjo? Se pseudonimi *Luan*,

Nuhi Sylejmanit i është dhënë nga Dordoleci superior, për shkak të vetive të tij superiore që i karakterizojnë vetëm Luanët e vërtetë. Këtë pseudonimin Luan, Nuhi Sylejmani e ka përdorë kur i ka nënshkruar letrat në emër të Partisë 'Komuniste' (PKMLSHJ), në vitin 1985.

Kjo punë është e sqaruar si drita e diellit. Përpjekja e Dordolecit për ta shkruar e manipuluar historinë e udhëheqjes së LNÇKVSHJ është e kotë. Këtë punë e ka kryer vetë Jusufi. Dezertori i UDB-së duhet ta ndiej vehten të kënaqur se është i kursyer prej lodhjes në këtë drejtim.

2. GJENEZA E EMRIT "ZËRI I KOSOVËS", SIPAS GJENAZEVE

Shkolla e UDB-së: *"Në takimin e radhës që pata me vëllezërit Gërvalla, u bisedua për mundësinë e nxjerrjes së një organi të ri në kuadër të LNÇKVSHJ-së. Mosarritja e bashkimit në mes të OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së, i la duar të lira Jusufit që të kujdesej për nxjerrjen e një organi që do t'i shërbente interesave të organizatës sonë. Për këtë qëllim, paraprakisht ishte pajtuar edhe Mërgimi.* ***Gjatë leximit të veprës numër një të Enver Hoxhës, faqe 60-61, botimi i vitit 1968, kisha hasur në një njoftim se në Kosovë, gjatë vitit 1942 ishte botuar një organ i quajtur „Zani i Kosovës", që në atë kohë ishte pritur shumë mirë nga populli shqiptar. Prandaj, ripërtëritja e këtij organi më dukej e qëlluar! Pas një analize të hollë, Jusufi erdhi në*** *përfundim se kjo çështje kërkonte një analizë më të gjerë, për arsye se tani për tani në mesin e mërgatës qarkullonte një fletushkë me emër të njëjtë, gjë që do të kundërshtohej nga autori i saj, Riza Salihu.* ***Kishte edhe arsye të tjera që e ngadalësuan marrjen e vendimit për këtë çështje, si punimet e Kongresit të Tetë të PPSH-së, për përcjelljen e të cilit nevojitej një përkushtim maksimal****. Megjithatë, vendimi definitiv për nxjerrjen e „Zërit të Kosovës" ishte marrë menjëherë pas dështimit për bashkim të bisedimeve të Stambollit.* ***Jusufi i filloi menjëherë përgatitjet për numrin e parë, të cilin synonte ta nxirrte në vigjilje të festave të nëntorit."*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 60-61)

Jusuf Gërvalla: "*Unë, që në fillim të Lëvizjes e kam pasë ditur se organ i Lëvizjes është "Zëri i Kosovës", se kjo shihet nga vetë Statuti. Dhe, me kënaqësinë më të madhe, në vend që të dilte "Lajmëtari i lirisë", kam mundur të bëja që të dilte "Zëri i Kosovës". Nuk e bëra për dy arsye. Së pari nuk isha i autorizuar nga Lëvizja. Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajturi Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë* ***RAPORT*** *të gjerë. Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur " të dërguar specialë të UDB-së ", pikërisht për arsyen se i pata thënë që " Zëri i Kosovës" është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet. Po për këtë arsye, para se t'i hymë botimit të këtij organi, duhet të marr nga Ti dhe Lëvizja edhe fjalën e fundit, sepse ka mundësi që titulli "Zëri i Kosovës" si organ i LNÇ, të përzihet në mendjen e naivëve me Grupin Komunist " Zëri i Kosovës". (...) Por kur është fjala për botimin e "Zërit të Kosovës", mendoj se del edhe një problem. Sipas të gjitha gjasëve, tashmë është identifikuar se kush qëndron prapa "Lajmëtarit" dhe kështu edhe mënyra se si radhitet ai. Pra, kjo makinë shkrimi, sipas mendjes sime, nuk do të duhej të përdorej edhe në radhitjen e "Zërit të Kosovës" (...)*

Sido që të jetë, para se t'ia nis punës për nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", duhet të dija se deri në çfarë shkalle mund të më ndihmoni së andejmi materialisht.

Kur është fjala për materialet që mora, përveç atyre me titull " Në Kosovë dy njerëz u ngjallën" dhe "Adem Demaçi, simbol i rezistencës shqiptare", mendoj se të tjerët nuk kanë elemente të mjaftuara për një revistë çfarë e mendoj unë "Zërin e Kosovës". Në ta gjenden të meta ideopolitike dhe janë shkruar jo në nivel.." (Letër Sabri Novosellës më 13 maj 1981. E botuar e plotë për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 261-266)

Jusuf Gërvalla: "*Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai shoku (Kadri Zeka-shën i Xh. D.) i " Lirisë", me të cilin kemi bashkëpunuar qe disa kohë. Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasave, edhe* ***LNÇKVSHJ*** *edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë* ***dy degë të të njëjtit trung****.*

Hydajet Hyseni: "*Qysh në bisedën e parë që kishte zgjatur gjithë natën deri në mëngjes, ata jo vetëm kishin gjetur te njëri tjetri shokun e ardhshëm të kauzës e idealit, por edhe kishin konstatuar se në të vërtetë organizatat që përfaqësonin ata vepronin mbi bazë të së njëjtës platformë politike, dhe se ishin* ***degë të shkëputura të të njëjtës rrënjë."*** (Për takimin e parë të Kadri Zekës me Vëllezërit Gërvalla.) ("Therror në themelet e Bashkimit", fejton në 8 vazhdime në Zëri, 21 shkurt-2 mars 2002, i ribotuar edhe në përmbledhjen e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, faqe 28)

Një patriot revolucionar, i cili prej kohësh qenka në burg (ai thotë se nuk është fjala për Ademin, por për dikë tjetër), qenka përgjegjës për ndërprerjen e kontakteve mes anëtarëve të vjetër të organizatës së hershme me anëtarët e krahut të ri të kësaj organizate. Kështu që, pjesa e vjetër e asaj organizate (të përbashkët) ka ndjekur një rrugë të caktuar dhe sot ka arritur deri te emri Marksistë-leninistët e Kosovës, kurse krahu i ri, duke mos marrë kontakt me kohë me anëtarët e vjetër, qenka zhvilluar në Lëvizjen e sotme Nacionalçlirimtare të Kosovës. ***Për këto konkludime ai merr për bazë pikërisht organin "Zëri i Kosovës"****, të cilin Marksistë-leninistët e paskan pasur gjithashtu organ të vetin për një kohë të gjatë (sidomos që nga viti 1974, thotë ai, paskan dalë disa numra të këtij organi). Në rast të tillë, sipas mendimit të tij, bashkimi i organizatave tona jo vetëm që nuk është i vështirë, por është puna më e natyrshme. (...)*

Tani prej teje pres përgjigje të prerë për sa vijon:

1) A e aprovon ardhjen time bashkë me atë shokun, lidhur me sqarimin e çështjes së përmendur, apo se lejon.*

2) Pas "pështjellimeve" rreth titullit të organit "Zëri i Kosovës", a të duket e udhës që organit tonë të ardhshëm t'i vëmë një titull tjetër? Unë mendoj se titulli duhet ndërruar." (Letër Sabri Novosellës më 16 qershor 1981. E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271*).*

Jusuf Gërvalla: *"Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." (Zërit të Kosovës-shën. im) janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, e* ***unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku*** *(Bardhosh Gërvalla-shën im) jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua*

dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana ***e Shpendit, e Besnikut*** *dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe* ***Shpendi edhe Besniku****, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne."* (Letër Sabri Novosellës më 20 gusht 1981. Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Sa i përket Abdullah Prapashticës dua t'i them se Zëri i Kosovës, si emër gazete ka ekzistua në kokën e Jusufit, sa ka qenë në Kosovë, me vite para se me ardhë në Gjermani. Pse ish inspektori i UDB-së është shumë i interesuar ta lokalizoj gjenezën e "Zërit të Kosovës" te veprat e Enver Hoxhës dhe Nuhi Sylejmani? Ai është shumë i interesuar për këtë sepse si Hydajet Hyseni ashtu edhe Jusuf Gërvalla kanë shkruar se ka mundësi që Lëvizja e Jusufit dhe OMLK-ja kanë qenë degë të një trungu. Trungu i prishë punë trurit të thatë të Dordolecit pasi ëndrra e tij e mjerë është që rolin e trungut, rolin e qendrës ta luaj truri i tij dhe "pozifat" e tij.

Se sa gënjeshtër skandaloze është ideja e Abdullah Prapashticës tregon më miri vetë Jusuf Gërvalla.

Jusuf Gërvalla: *"TË DASHUR LEXUES,*
Kemi nderin, detyrën dhe përgjegjësinë e madhe të dalim para jush me revistën periodike "Zëri i Kosovës" pikërisht në një çast historik, kur në ndërgjegjen e popullit dhe të rinisë sonë heroike po trokasin fuqishëm pulset e lirisë që po agon....*
****Deri më tash "Zëri i Kosovës" ka dalë në trajtë buletini dhe ka botuar materiale të përdorimit të brendshëm për anëtarët e LNÇKVSHJ"*** *(Zëri i Kosovës, nëntor 1981, faqe 3)*

E shumë më mirë edhe vetë Sabri Novosella.

Sabri Novosella: *"Jam i mendimit që numri i vitit të ardhshëm të filloi prapë me 1 (Nji) ashtu si praktikohet në "Përparimin", "Jetën e re" e të tjera. Unë numrin e parë të ZK (Zëri i Kosovës- shën im) e konsideroi të dalur në vitin 1973 ose 74. Këtë duhet ta dijë më mirë U.(Uka=Xhafer Shatri-shën im) Dallimin e bën viti, për shembull: (Nr. 1. 1983)* (Letër Xhafer Durmishit më 4 nëntor 1982)

Në këtë rast për Nuhi Sylejmanin mund të thuhet: Përderisa ai është një gjendje të gënjej në mënyrë kaq të ulët për revistën e organizatës së vetë, me të cilën e ka ilustruar kopertinën e parë të librit të tij "Vrasja e trefishtë", ai është një gjendje të gënjej në mënyrë edhe më të ulët për rrethanat e Lëvizjes dhe njerëzit e saj me të cilët ka vepruar.

Përpjekja e Abdullah Prapashticës për ta sqaruar këtë çështje është katastrofale. Këtë çështje si edhe shumë të tjera ai i merr me tepër mendjelehtësi sa edhe me mendjemadhësi. Është interesante anatomia e shkollës së UDB-së se çka është në gjendje të bëjë me viktimat e veta, e t'u ngarkoj aso detyrash për sqarimin themelor të disa gjërave të koklavitura me të cilat as vet Jusufi nuk është marrë.

3. GJENEZA E EMRIT "LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE VISEVE TJERA SHQIPTARE NËN JUGOSLLAVI" SIPAS GJENAZEVE

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas pak ditësh Jusufi më njoftoi se „Zëri i Kosovës" kishte dalë nga shtypi, por nevojiteshin* ***1.600 marka për ta tërhequr nga shtypshkronja.*** *Më gëzoi fakti se gazeta kishte dalë jashtëzakonisht mirë, duke i përmbushur të gjitha standardet. Pas titullit me germa të mëdha - „Zëri i Kosovës", shkruante:* ***Organ i Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ). Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie.*** *" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 64)*

Aktgjykim: *"Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës, të sigurisë së RSFJ, e veçanërisht të cenimit kundër revolucionar të rregullimit shtetëror, të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e njerëzve punues, shkatërrimin e bashkim-vllaznimit e të barazisë së kombeve e kombësive si dhe të ndërrimit antikushtetutar të rregullimit shtetëror federativ, gjatë vitit 1977 në Prishtinë, si një ndër organizatorët, në kontaktet e takimet e shpeshta me Sabri Novosellën dhe të akuzuarin Avdyl Lahu, me qëllim të masovizimit të grupit ilegal armiqësor të Kosovës dhe viset tjera të RSFJ ku jetojnë shqiptarët, merren vesh për formimin e organizatës "****Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës****" të cilën edhe e formojnë në vitin 1978 dhe vendosin që të njëjtën ta udhëheqë "Komiteti Qendror" e që njëri prej anëtarëve të tij të bëhet i akuzuari Shefqet Jashari"* (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Në këtë aktgjykim emri i organizatës thuhet se është: *"****Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës****"*

Aktgjykimet e përgatitura nga UDB-a mund të përmbajnë shumë të vërteta por në to ka edhe të pavërteta. Në këtë rast emri i Organizatës nuk është i plotë dhe askujt nuk i mbetet hatri pse UDB-a nuk e jep emrin e plot.

Emrin e plot e kemi të dhënë, apo sqaruar me shkrim, tetë herë prej Jusufit, para datës 12 shtator 1981.

1. Jusuf Gërvalla: "*Prandaj, pasi ne nuk kemi pse të frikësohemi për "teorizime", do të thoshim se na duhet një program i denjë për një lëvizje të denjë. Me këtë rast duhet të vëmë në dukje se ne ende nuk kemi qenë në gjendje ta formojmë partinë tonë komuniste marksiste-leniniste, pa të cilën gati do të jetë e pamundshme hyrja konkrete në luftën e ardhshme nacionalçlirimtare dhe në revolucionin tonë. Kjo na nxjerr te një çështje tjetër që kërkon sqarim. Ishte Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës e Shqipërisë) ajo që e pat themeluar Frontin Nacional Çlirimtar (sot Fronti Demokratik). Dhe kjo ishte rruga e drejtë. Te ne ka ngjarë e kundërta. Fronti i Kuq Popullor, i themeluar prej forcash patriotike, pret themelimin e partisë sonë*

komuniste marksiste-leniniste e cila do të vihet në ballë të luftës dhe të revolucionit. Sipas vlerësimeve të Frontit, arsyeja për këtë inverzion qëndron në kushtet konkrete, të cilat kanë ndikuar që forcat patriotike të masave të gjëra të ecin një hap përpara organizimit të komunistëve tanë. Në kësi konteksti e shohim aktivitetin e ***Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe të Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi - një organizatë e hershme,*** *që ka mbledhur dhe mban rreth vetes njerëz me eksperiencë patriotike e revolucionare dhe me të cilën jemi duke bërë përpjekje për njohje reciproke dhe për bashkim. Në kësi konteksti jemi duke përcjellë gjithashtu edhe aktivitetin e Marksist-leninistëve të Kosovës, që po shfaqen këto kohët e fundit me organin e tyre "Liria". Duke u nisur nga kryeartikulli në numrin e parë të këtij organi, si dhe nga përmbajtja e tij përgjithësisht e nga trajtimi marksist-leninist i problemeve nga ana e krijuesve të "Lirisë", ne e vlerësojmë shumë të drejtë punën e Marksist-leninistëve kosovarë. Kjo na jep shpresë që së shpejti, ndoshta pikërisht nga radhët e tyre, do të realizohet edhe kërkesa e domosdoshme për themelimin e vetë partisë komuniste marksiste-leniniste."* (Bashkimi bënë fuqinë, Bashkimi-Organ i Frontit të Kuq Populllor, **janar 1981**, faqe 2, shtylla 1)

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: Janari 1981 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

Në Lajmëtarin e lirisë, janar 1981 gjendet shkrimi "Një komb shqiptar, një shtet shqiptar", prezantimin e të cilin Jusufi e bënë në këtë mënyrë:

2. Jusuf Gërvalla: "*Ky artikull paraqet një trakt të Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës* ***dhe viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi****, i cili qarkullon qe një* ***kohë të gjatë*** *në radhët e patriotëve dhe të revolucionarëve tanë."* (Lajmëtari i lirisë, janar-shkurt 1981, faqe 12)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: Janari 1981 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

3. Jusuf Gërvalla: *"Në vazhdën e rezistencës patriotike e revolucionare, u formua edhe organizata “ Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës” e cila më vonë, me kërkesën e komiteteve të qarqeve dhe të komiteteve të vendeve në trojet shqiptare të robëruara jashtë Kosovës, u quajt “Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve*

të Tjera Shqiptare", lëvizje që ka për qëllim çlirimin e të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia." (Lajmëtari i lirisë, Janar 1981, faqe 15)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: Janari 1981 apo 12 shtatori 1981?

4**. Jusuf Gërvalla**: "*Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se, duke qenë krejt i vetmuar, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë. Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 263)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 13 maji 1981 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

5**. Jusuf Gërvalla**: *"Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur " të dërguar specialë të UDB-së ", pikërisht për arsyen se i pata thënë që " Zëri i Kosovës" është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 263)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 13 maji 1981 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

6. Jusuf Gërvalla: *"Sipas të gjitha gjasave, edhe* ***LNÇKVSHJ*** *edhe Marksistë-leninistët e Kosovës janë dy degë të të njëjtit trung."* (Letër Sabri Novosellës më 16 qershor 1981. E Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 269-271*).*

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 16 qershori 1981 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit***

1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

7a. Jusuf Gërvalla: *"Thuajse rregullisht, veprimtaria e tyre është zbuluar dhe është ndëshkuar që në gjysmë të rrugës. Atyre u ka munguar konspiracioni i thellë, i domosdoshëm në veprimtarinë ilegale. Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më 1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. Përjashtim bën* ***Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë.*** *Kjo lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gji të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare. Pos kësaj, edhe anëtarët e saj kanë qenë nga të gjitha strukturat shoqërore, gjë që organizatës i ka dhënë një karakter të përgjithshëm shoqëror. Megjithë të metat që janë përcjellë në aktivitetin e grupeve dhe të organizatave patriotike revolucionare të shqiptarëve në Jugosllavi, ne, para se t'i sulmojmë me kritikën tonë lidhur me ndonjë aspekt të posaçëm të tyre më në fund, siç është fare e natyrshme, ka qenë në përputhshmëri me mundësitë që afrojnë kushtet e përgjithshme shoqërore ndër ne."* (Letër Enver Hoxhës më 19 gusht 1980. Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 19 gushti 1980 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

7b. Jusuf Gërvalla: *"Përjashtim bën* ***Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam edhe unë."*** (Letër Enver Hoxhës më 19 gusht 1980. Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 23)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: 19 gushti 1980 apo 12 shtatori 1981?

Shkolla e UDB-së: ***"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi". Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit", i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."***

8. Jusuf Gërvalla: *"Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina"*

RAPORT

mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor

Me përfaqësuesin kryesor të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin

*e LNÇK "Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në ekzistencën e këtij organi dhe të **LNÇKVSH**, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njëjtin emër dhe, meqë, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrsesi nuk ia kapte rradakja të bënte dallimin në mes një organizate me emrin "Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull "Zëri i Kosovës" që i takonte koinçidentalisht një organizate krejt tjetër."* (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Pyetje e drejtpërdrejtë për Shkollën e UDB-së, për të na sqaruar në detaje:
Cila datë është më e hershme: korriku 1981 apo 12 shtatori 1981?

Ashtu siç qëndron puna me gënjeshtrën rreth emrit të plotë të Organizatës, në të njëjtën mënyrë vlen edhe gënjeshtra e mëposhtme në fjalinë e cila fillon citatin e faqes 64, të cilin e kemi shqyrtuar:

*"Pas pak ditësh Jusufi më njoftoi se „Zëri i Kosovës“ kishte dalë nga shtypi, por nevojiteshin **1.600 marka për ta tërhequr nga shtypshkronja."***
Këtë shprehjen *për ta tërhequr nga shtypshkronja* do ta analizojmë në një pikë tjetër më poshtë.
Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi*: "K O M U N I K A T Ë E KOMITETIT QENDROR TË LËVIZJES NACINALÇLIRIMTARE TË KOSOVËS*

Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si ”romantizëm nacional” dhe ”nacionalizëm e shovinizëm shqiptar” si dhe për të gjetur ”organizatorin” e demonstratave, duke fajësuar herë një ”grup huliganësh”, herë ”ekstremistët” shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Leninistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t’ia ngarkoj fajin kryesor Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
Ndër ”organizatorët” e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë ”vepra” që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.
E kemi parë të udhës që, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan ”informatat” e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t’ju drejtohemi me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.
1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkohen askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

Donika Gërvalla: *"Jusuf Gërvalla luftoi me penë për*

Republikën e Kosovës." (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 1.05.13-1.05.19)

2. Kërkesa për t'iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i lirisë", si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të inteligjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më herët, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë.

3. Nga Statuti, Programi dhe të gjitha dokumentet e LNÇK del qartë se ne nuk e aprovojmë dhe nuk e aplikojmë asnjë formë terrori dhe anarkie. As sot LNÇK nuk merr përsipër as përgjegjësinë më të vogël për aktet e "terrorit" e të "anarkisë", që i trumbeton me të madhe policia sekrete jugosllave, siç është djegia e ndonjë fabrike a ndërmarrjeje, përdhunimi i monumenteve kulturo-historike, i varrezave serbo-malazeze etj. (...)Komiteti Qendror
i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës

Kjo komunikatë u përpilua nga Jusuf Gërvalla e Xhafer Durmishi në gusht 1981, në Untergruppenbach dhe u nënshkrua si: "Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës"." (www.pashtriku.org)

Shtrohet pyetja: pse në gusht 1981, Jusufi dhe unë e përdorim emrin *Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës?*

Këtu duhet të kihet parasysh se kjo *Komunikatë* është përgjigje direkte kryepolicit Franjo Herleviç (në këtë kohë eprori kryesor i Abdullah Prapashticës). Herleviçi akuzon organizatat e ndryshme për organizimin e demonstratave, e në mesin e tyre edhe Lëvizjen e Jusufit. Në këtë rast eprori i Abdullah Prapashticës e përdor atë emër që e ka përdorur UDB-a në përgatitjen e aktgjykimit të 4 qershorit 1980, d.m.th. *Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës.* Këtë emër (*Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës) e transmetojnë agjencitë e gazetat e ndryshme botërore.*

Komunikata e mësipërme ishte pikërisht një dokument që iu drejtohej agjencive të lajmeve dhe gazetave të ndryshme. Për të mos shkaktuar huti se për cilën organizatë është fjala Jusufi dhe unë e përdorim vetëm emrin *Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës.*

Kjo është e vërteta në këtë pikë. Këtu është shumë interesant të shohim se si Abdullah Prapashticës (përndryshe 'organizator' i demonstratave të vitit 1981) i ka bërë përshtypje më vendimtare lufta dhe nomenklatura e përdorur ndaj Herleviçit se sa letra dërguar Enver Hoxhës. Por është e kuptueshme që Shkolla e UDB-së të tregon më tepër respekt për emrin e përdorur me eprorin e saj Herleviçin se sa me Enver Hoxhën.

Dhe në fund të kësaj pike është me rëndësi të përgjigjemi në pyetjen: Pse Abdullah Prapashtica është aq shumë i angazhuar në punët e brendshme të LNÇKVSHJ-së, dhe mundohet ta sqaroj **në detaje** (në të cilat therret aq keq) me pocërkën e vet, gjenezën e mbaresës 'Viseve shqiptare në Jugosllavi'.

"Jusufi na sqaroi më në detaje termin e „Viseve shqiptare në Jugosllavi“. Na tha se ky term gjenezën e kishte te „Zëri i popullit“, i 12 shtatorit 1981, dhe te Kongresi i 8-të i PPSH-së, dhe se tani ne po i përmbaheshim kësaj terminologjie."

Abdullahu është i interesuar në këtë pikë sepse po të ishte si thotë ai, rrjedhimi do të ishte: OMLK-ja është marrë vetëm me çështjen e shqiptarëve për atë territor që është quajtur Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Jusuf Gërvalla dhe Lëvizja e tij e kanë bërë të njëjtën gjë. Ushtruesi i profesionit të udbashit, Abdullah Prapashtica është i vetmi që me partinë e tij "komuniste" është brengos e ka luftuar për të gjithë shqiptarët në Jugosllavi.

4. Jusufi nuk ishte mbret!

Shkolla e UDB-së: *"Me **Skënder Skënderin** (Xhafer Durmishin-shën.) im isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time, **Suzana ma prezantoi si „zëvendës“ të Jusufit!** Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva Suzanës, se Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk **ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin**. Suzana më sqaroi se Skënderi (Xhafer Durmishi-shën. i Xh. D.) ishte i dërguar i Mërgimit, i cili ishte udhëheqësi i ynë, dhe se pa urdhrin dhe lejen e tij ne nuk guxonim të merrnim asnjë vendim. Pas këmbënguljes sime për të marrë vesh se kush fshihej pas pseudonimit Mërgimi, ajo më tregoi se ishte Sabri Novosella."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 88)

"D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

(...)

*Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin ”**LËVIZJA** PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI” (LRSHJ). (...)*

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga Shpendi (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

***Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur (Stilograf-shën i Xh. D.) të Jusuf Gërvallës**, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin ”Zëri i Kosovës”.*

VENDIM

(...)

*6. Organi i LRSHJ të jetë "**Zëri i Kosovës**" pasi ky emër shpreh zërin e Kosovës,..."* (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)

Analizimin e kësaj pjese kurrë nuk e kisha shtjellua në këtë formë sikur të mos isha i detyruar. Jusufi nuk ka qenë mbret. Kjo insinuatë është shpikje e shkollës së UDB-së Serbe. Mbretit ia zënë vendin vetëm biri apo bija e farefisi i gjakut. Unë nuk kam pasur kurrfarë lidhje familjare me Jusufin. Mua me te më ka lidhur vetëm fryma dhe idetë e tij. Në këtë pikë është pikërisht e kundërta. Abdullah Prapashtica ka pasur ëndrra Kim il Sungiste, në bazë të të cilave, si Kryetar i Partisë 'Komuniste' (P'K'MLSHJ) gruan e vet e ka bërë kryetare të grave 'komuniste', e në Stafin e tij gjithashtu e ka pasur nipin e vet Faton Topallin me pseudonimin Qemali i cili ka qenë kryetar të organizatës së rinisë 'komuniste'. Se çfarë analogjie është bërë apo kush është përpjekur të imitohet nuk mundem me e marrë me mend. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se vetëm ata që i kanë takuar hises së përçës së Prapashticës, kanë pasur shans në Partinë e tij 'Komuniste' sado e madhe dhe e papërmbajtur të ketë qenë dëshira, qejfi e **Vullneti** i të tjerëve për ta përçafuar programin e saj. Bazimi në lidhjet e përçës për Dinastinë e Partisë 'Komuniste' të Prapashticës është konsideruar si masa kryesore për t'i mbajtur në distancë të sigurt njerëzit me potencial të madh për komplote e përçarje.

Të kthehemi edhe njëherë tek Stilografi i Jusuf Gërvallës.

Shkolla*: "Menjëherë pas kësaj demonstrate (sipas N.S. të 4 korrikut 1981 në Frankfurt-shën i Xhafer Durmishit), ne nëntë anëtarët e celulës „**Vullneti**" u mblodhëm për të diskutuar rreth mundësisë së grumbullimit të parave për blerjen e makinës së shkrimit, për të cilën ditë më parë kishim diskutuar me Jusufin. (...)*
*Në ditët pasuese Bardhoshi e kishte blerë një makinë shkrimi të tipit **„Olivetti**", në vlerë **prej 13.000 markash**."*(Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 56)

Shkolla e UDB-së Serbe: "***Pas blerjes së makinës** së shkrimit (pas 20 gushtit 1981-shën im), Jusufi bëri një **punë të jashtëzakonshme**. I nxori nga shtypi revistat „Lajmëtari i lirisë" dhe „Bashkimi". Në anën tjetër, Kadri Zeka e kishte përgatitur revistën „Liria" dhe në bashkëpunim me Jusufin e nxorën nga shtypi edhe këtë në fund të muajit gusht."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f.58)

Megjithatë përmendja e mbretit ndoshta për Dinastinë Dordolece e ka njëfarë kuptimi. Siç shihet nga Dokumenti i Bashkimit të 17 shkurtit 1982, dhe dy citatet e mësipërme, ndoshta askush nuk është ngulë më mirë në Stilografin e Jusuf Gërvallës se sa Dinastia e Shkollës. Po që se gjërat shqyrtohen në këtë kuptim, duket se është plotësisht e arsyeshme për Shkollën dhe Dinastinë e tyre dordolece dhe ata janë të vetmit që me të vërtetë kanë të drejt ta shtrojnë çështjen se a ka qenë Jusufi mbret apo jo.

5. Propozimi për t'ia nisur nga zeroja
PROPOZIM PËR T'U FORMUAR NJE ORGANIZATË E NGJASHME

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Edhe pas propozimit tim që të **formohej një organizatë e ngjashme politike** e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë, e cila e kishte pranuar zëvendësimin e autoritetit të burrit të saj me njëfarë Skënder Skënderin, dhe e heshtur i ishte nënshtruar diktatit fantazmë të Sabri Novosellës." (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 88)

Vullneti i Shkollës së UDB-së për t'ia nisur prej zeros, për t'ia nisur nga aty ku e kishin lënë vrasësit e saj, nuk ka nevojë për koment.

6. Nuk ishte pajtuar-Ishte pajtuar

Nuk ishte pajtuar Mërgimi

"*Pas shumë konsultimeve që u bënë për bashkimin e organizatave që vepronin në mërgatë, u vendos që Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla të udhëtonin për* ***Turqi****. Qëllimi ishte që të takoheshin me* ***Mërgimin*** *dhe t'i afronin qëndrimet për bashkimin e OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së13, pasi që më parë ky bashkim ishte arritur me Frontin e Kuq Popullor. Këto biseda, sipas Bardhosh Gërvallës, ishin tejet të shkurtra, pasi Kadriu që në fillim kishte deklaruar se nuk kishte çfarë t'iu shtonte atyre që ishin të shkruara në „Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës", me çka* ***nuk ishte pajtuar Mërgimi****."* (Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 60)

Ishte pajtuar edhe Mërgimi

"Në takimin e radhës që pata me vëllezërit Gërvalla, u bisedua për mundësinë e nxjerrjes së një organi të ri në kuadër të LNÇKVSHJ-së. Mosarritja e bashkimit në mes të OMLK-së dhe LNÇKVSHJ-së, i la duar të lira Jusufit që të kujdesej për nxjerrjen e një organi që do t'i shërbente interesave të organizatës sonë. Për këtë qëllim, paraprakisht ***ishte pajtuar edhe Mërgimi****."* (Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 60)

Shkolla e UDB-së: "*Me Skënder Skënderin (Xhafer Durmishin-shën im) isha takuar vetëm njëherë në familjen Gërvalla, në shtator të vitit 1981, në prezencën e Islam Rafunës. Pastaj, as nuk e kam parë, por as nuk kam dëgjuar më për të. Nuk e mora vesh se nga erdhi, nga Kosova apo nga ndonjë vend tjetër, ndodhej ilegal në Gjermani, apo kishte ndonjë leje qëndrimi. Në fillim mendova se qëllimi i vizitës së tij ishte ngushëllimi, por pak kohë më vonë, për befasinë time,* ***Suzana ma prezantoi si „zëvendës" të Jusufit!*** *Tani e kuptova qëllimin e vërtetë të ardhjes së tij. I çuditur, ia ktheva Suzanës, se* ***Jusufi nuk ka qenë në dijeni se do të vritej dhe të parapërcaktonte një zëvendës... as nuk ishte mbret që të linte në fron trashëgimtarin.*** *Suzana më sqaroi se Skënderi ishte i dërguar i Mërgimit, i cili ishte udhëheqësi i ynë, dhe se pa urdhrin dhe lejen e tij ne nuk guxonim të merrnim asnjë vendim. Pas këmbënguljes sime për të marrë vesh se kush fshihej pas pseudonimit Mërgimi, ajo më tregoi se ishte Sabri Novosella."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 88)

Nuk kishim dijeni se kush ishte pajtuar dhe kush nuk ishte pajtuar

Shkolla*: "Kisha fituar përshtypjen se këto veprime nuk ishin fare të tijat. Ai zbatonte urdhra dhe thurte komplote, por nën diktatin e tjetërkujt... Assesi nuk ishte vetëm!*
*E kishte ndihmën dhe këshillat politike të Hafiz Gagicës, i cili nuk dallonte aspak nga Skënderi. Prandaj, nuk besoja se pranonte dhe zbatonte direktiva nga Sabri Novosella (***Mërgimi****), të cilin Suzana na e prezantonte si udhëheqës të Lëvizjes, edhe pse asnjëri nga ne anëtarët e Lëvizjes* ***nuk kishim dijeni për ekzistimin e një udhëheqësi të tillë****!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 89)

Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka kanë ditur për Sabri Novosellën por "Luani i Komitetit Qendror të Partisë së Shkollës" paska mbetur i painformuar në këtë pikë. Pyetja e pashmangshme që shtrohet këtu është: Kush e mban përgjegjësinë për mosinformimin e Luanit superior?

Është interesant të shohim memorien fenomenale të Shkollës, kur gjëra që i pohojnë në librin e tyre në faqe 89 harrojnë tërësisht se çka kanë thënë në faqe 60. Si është e mundur me i pajtua kundërthëniet e rrenat e tilla skandaloze të këtyre farë pajtonxhinjve?

7. Mohimi i Zërit të përgjakur nga gjaku i Jusufit dhe të të vrarëve

"TERHEQJA" E ZËRIT ME 8 SHKURT

Xhafer Durmishi: ***"Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së, i drejtuar nga Jusuf Gërvalla***

Dalja me "Zërin e Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ-së ishte planifikuar në verën e vitit 1981, por bisedimet me OMLK-në e që nxirrte revistën "Liria" e pezulluan këtë punë gjer në nëntor 1981, kur doli numri i parë i saj. Në janar 1982 doli numri i dytë. Vetura e Bardhosh Gërvallës në të cilën u vranë vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka ishte e mbushur me këtë numër i cili posa kishte dalë nga shtypshkronja. Mu për këtë, për aktivistët e rrethit të Shtutgartit kjo gazetë mori një përmbajtje shumë më të thellë se sa që kishte pasur përpara." (Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985, 1992, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 334 dhe www.pashtriku.org)

Shkolla e UDB-së: *"Të nesërmen, më 8 shkurt (1982-shën i Xh. D.), shkova në shtypshkronjën „Luzifer-Verlag" në Ludvigsburg,* ***për ta tërhequr numrin*** *e dytë të „Zërit të Kosovës", me ç'rast bëra pagesën në shumë prej* ***1.300 markash****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 118)

Xhafer Durmishi: "*Me të vërtetë tani jemi në njëfarë krize materiale. Puna ime tani nuk është aq me rëndësi: me rëndësi është ajo se ne tani kemi edhe* ***1300 marka borxh*** *për këtë numrin e "Z" (Zërit të Kosovës-shën i Xh. D.) e janë mbi emrin e Hafizit (Gagicës). E ai në këto momente nuk e ka punën mirë. Shokut larg ia dërgova një letër të gjatë lidhur me këto e gjithashtu me përmbajtjen e bisedimeve që i patëm te Uka (Xhafer Shatri) në H."* (Letër Faridin Tafallarit më 30 dhjetor 1982, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 442)

Faridin Tafallari: "Jusufi: ***Po ti Suzanë, kujdes fëmijët, t'i rritësh dhe t'i bësh trima. Amanet po të lë edhe materialet që i kam shpërndarë tek shokët; bodrumi është plot****." (Terror Dhimbje Qëndresë, f. 52)*

Përkundër faktit të ditur prej të gjithëve që kanë qenë në Shtutgart se bodrumi, e jo vetëm bodrumi por edhe gepeku i kerrit, të rrethuar nga atentatorët, me targë HN-CY353, ka pasur pako me numrin 2 të Zërit të Kosovës, i cili ka qenë gati krejtësisht i përfunduar para 10 dhjetorit 1981, Shkolla e servon këtë gënjeshtër:

"Të nesërmen, më 8 shkurt, shkova në shtypshkronjën „Luzifer-Verlag" në Ludvigsburg, për ta ***tërhequr*** *numrin e dytë të „Zërit të Kosovës", me ç'rast bëra pagesën në shumë prej 1.300 markash." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.118*)

Më 8 shkurt 1982 është bërë pagesa e borxhit për gazetën e cila **është tërhequr** në janar. Bardhi ka bërë kontratë me atë firmë dhe në kontrata të tilla kur në pyetje janë me mija marka, nuk janë paguar çdo herë të hollat në dorë sikur e paguan dikush një litër qumësht në dalje të vetëshërbimit. Kjo gënjeshtër në këtë formë është gatuar nga Abdullah Prapashtica, për ta zbutur luftën e tij kundër veprës së atyre që u vranë më 17 janar 1982. Nuhi Sylejmani nuk ka shkuar për ta tërhequr numrin dy të Zërit të Kosovës, se atë e ka tërheq Bardhoshi rreth 8 janarit 1982, por ka shkuar për ta paguar borxhin.

Letra ime dërguar Faridin Tafallarit e dëshmon më së miri këtë punë, se në të shumtën e rasteve pagesa është bërë në një kohë pas marrjes së gazetës. Ajo çka bien shumë në sy është edhe përputhja e shumës **1300** marka gjermane, megjithëse fjala është për dy ngjarje, njëra në shkurt e tjera në dhjetor 1982.

Shtrohet pyetja se pse e nxitë Abdullah Prapashtica ta bëjë këtë dëshmi të rrejshme Nuhi Sylejmanin? Ai e bënë këtë pasi po të ishte kështu, ia thotë atij logjika e vetë, lufta e tij që gjithçka të filloj nga zeroja, nga aty ku e kanë lënë vrasësit e UDB-së Serbe do të dukej pakëz më e justifikueshme se sa në rastin e ekzemplarëve të Zërit të Kosovës, që ishin përgjakur me gjakun e Jusufit nga ulëset e prapme të veturës, apo me gjakun e tre të vrarëve.

8. Shkrirja-Ngrirja dhe Shuarja totale e Partisë "Komuniste"

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi.* ***Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim, kur dihet se Sabri Novosella (Mërgimi), emigrant në Turqi, asnjëherë nuk e kishte marrë mundimin për riorganizimin e LNÇKVSHJ****-së, por e kishte krijuar (apo ishte kyçur) në një organizatë krejt tjetër, të quajtur „Komiteti Hasan Prishtina". Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë* ***drejt dobësimit apo shuarjes totale****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 124)

Jusuf Gërvalla: "*Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina" /* ***RAPORT*** *mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor"* (korrik 1981)

"***D O K U M E N T***

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

(...)

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet ***shkrirja*** *e dy organizatave në një të vetme me emrin "****LËVIZJA*** *PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSHJ). (...)*

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga Shpendi (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë ***teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës****, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin* ***"Zëri i Kosovës".***

VENDIM

(...)

6. Organi i LRSHJ të jetë ***"Zëri i Kosovës"*** *pasi ky emër shpreh zërin e Kosovës,..."*
(Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)

Osman Osmani: *"Të bëhet* ***shkrirja*** *e dy organizatave* ***në një të vetme*** *me emrin* ***'LËVIZJA'****....."*

Besnik Prishtina*: "Megjithatë, pasi PKMLSHJ e realizon bashkimin LNÇKVSHJ e OMLK në LRSSHJ, me 17 Shkurt/15 Maj 1982, vet e PKMLSHJ* ***e ngriu*** *aktivitetin e vet partiak...."* ***(HISTORINË E SHKRUAJNE VEPRAT PRAKTIKE E JO DEKLARATAT TEORIKE,*** www.zemrashqiptare.net***, 13 maj 2010)***

Pamvarësisht se a bëhet fjalë për **Shkrirjen e *të Pabesit*** apo për **Ngrirjen e *'Besnikut'*** në këtë rast kemi të bëjmë me të njëjtin efekt termodinamik, **Shuarjen** e Partisë 'Komuniste' me vite të tëra para se i njëjti fat t'i gjej partitë 'komuniste' të të njëjtit brum, (të ngushëlluara me telegrame nga Abdullahu e Osmani) duke përfunduar aty ku përfundoi Muri i Berlinit.

Lëvizja e Jusuf Gërvallës u **shkri në Lëvizje** dhe Vërshoi, Zëri i Jusuf Gërvallës i dha rezonancë me amplitudë maksimale Zërit të Kosovës dhe Jehoi, siç do të Jehoi përjetësisht. Ky Vendim, ky Dokument është fakti i përjetësimit të **Zërit** e **Lëvizjes** së Jusuf Gërvallës - LNÇKVSHJ.

9. Vazhdimi i punës nga aty ku e kishte lënë Jusufi dhe vazhdimi i punës aty ku e kishte lënë UDB-a Serbe

Shkolla e UDB-së*: "Menjëherë pas këtij bashkimi, nga Turqia për në Gjermani udhëtuan Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani. U vendosën në familjen Gërvalla në Untergrupenbach të rrethit të Heilbronn-it.* ***Vazhduam punën aty ku e kishte ndërprerë Jusufi, duke i përfunduar artikujt e përgatitur prej tij."*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 126)

Vëzhguesi i Dordolecit, Osman Osmani nuk është marrë në asnjë pikë e me asnjë germë të vetme me Zërin e Kosovës, të LNÇKVSHJ, të marsit 1982. As unë e lere më ky far vëzhguesi, nuk kemi përfunduar asnjë artikull të Jusufit, pasi ai nuk ka lënë asnjë artikull të nisur e të papërfunduar. Ka qenë plani që Zëri i Kosovës, i marsit 1982 të del si organ i Lëvizjes për Republikë. Vëzhguesi ka ndërhy duke thënë se është më mirë të del në emër të LNÇKVSHJ. Plani i Shkollës ka qenë që përkundër nënshkrimeve të tyre, çështjen e emrit të gazetës dhe të gjitha çështjet t'i shtrojnë prej fillimit, pra t'ia nisin prapë prej zeros në takimin kur do të merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e OMLK-së.

Në këtë kuptim mund të thuhet se Dordoleci dhe Vëzhguesi i tij ishin të dehur prej suksesit. Ata, brenda dy orëve të vona të 17 shkurtit 1982, kishin arritur t'i ndërpresin-përfundonin dy gazeta të tyre famoze, andaj mendonin se të njëjtin sukses do ta përsëritnin edhe me Zërin e Jusufit.

Plani dhe misioni im ka qenë që me forcat e mia ta vazhdoj punën nga aty ku e ka lënë Jusufi. Plani i Osman Osmanit është përputhur me planin e UDB-së. Plani i UDB-së me

vrasjen ka qenë që ne të detyrohemi me ia nis prej zeros. Argumenti "t'ia nisim prej zeros" ishte baza e veprimeve të Abdullah Prapashticës dhe Osman Osmanit.

10. Faqosja e Zërit të Jusufit sipas falsifikatorëve të pa faqe d.m.th. të pafytyrë

Shkolla e UDB-së: *"Nxjerrja e këtyre dy numrave, të shkruar dhe daktilografuar nga kjo redaksi, u ndihmua teknikisht (faqosja dhe përgatitja për shtyp) nga "marksist-leninistët gjerman" të rrethit të Stuttgard- it."* (Nuhi Sylejmani, Vrasje e trefishtë, 2010, faqe 126)

Me fjalët *Nxjerrja e këtyre dy numrave* mendohet në "Zërin e Kosovës" (organ i LNÇKVSHJ) nr.3, mars 1982 dhe "Zëri i Kosovës" (organ i LRSSHJ) nr.1, qershor 1982.

Historia e përgatitjes së këtyre dy numrave është krejtësisht e ndryshme prej njëri tjetrit. Numri i marsit nuk është daktilografuar nga vëzhguesi "komunist" dhe as nga ndonjë komunist gjerman, por pikërisht nga një firmë *kapitaliste* gjermane për çmimin prej 1400 DM, prej të cilëve është daktilografuar, radhitur në formën e shtyllave, gjerësinë e të cilave ua kam caktuar unë. Neve, shokëve të Jusufit, na është dhënë filmi i shtyllave (në pllaka plastike) të cilat pastaj janë pre dhe përgatitja grafike e faqeve (faqosja, nëse e përdorim shprehjen e rrencave të pafaqe) në 24 faqe A4 është bërë në shtëpinë e Jusufit nga Suzana dhe unë.

Suzana Gërvalla: "*Ne me të vërtetë këtu kemi shoqëri të re dhe përkrahje të madhe por mendët i kemi atje te ju te varrezat e Shtutgardit, se atje i lam ata ma të afërmit. E tash nuk dimë as si duken varrezat e tyre, spati kush me na que asnjë fotografi prej atjehit. Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin dhe Nuhi Sylejmanin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Pastaj është bërë dorëzimi për shtyp në të njëjtën firmë. Letra e mëposhtme e vërteton atmosferën e asaj kohe më së miri.

Xhafer Durmishi (Shpendi): *"Organin e dorëzuam për radhitjen e shtyllave na kushtoi* ***1400 DM****. Janë 17 artikuj (pa poezi). S'bashku me fotografitë dhe titujt besoi se do të dal mjaftë material. Pjesa dërmuese e shkrimeve është e Sokolit, megjithëse nga kapuçonët nuk është kthyer as gjysma e materialeve të përgatitura për numër. Organin do ta nxjerrim si numrin 3 të LNÇKVSHJ, por për hir të informimit më të shpejtë, që të mos presim deri tek numri i ardhshëm do të dalim me një fletë të shkapur si te Lajm. Nr. 3, duke e quajtur shtojca e zërit. Artikujt e saj "Një udhëtim në izr..." dhe "Plisi i bardh mbi faqe të zezë" nuk u dorëzuan në radhitje pasi H. e kishte humbur ndërsa të dytin arkatari ma solli me vonesë. Unë i kisha dorëzuar në radhitje për hir të shpejtësisë edhe pse kështu krejtësisht s'na doli, dhe më tepër për shkak të familjes vendosëm që këtë numër ta punojmë në shtypin e qytetit, sepse këta kapuçonët interesohen fortë se ç'po bëhet, e pa rregullimin e shoqes së Sokolit nuk kishim mund t'i largojmë mjetet e punës siç është një makinë e tillë. Dhe besojë se kjo është e arsyeshme. Kam frikë se organi do të na del me ca gabime gjuhësore jo për fajin tonë, por për shkak të atyre që e*

përgatisin." (Letër dërguar Sabri Novosellës, mars 1982. Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 285-286)

Pas daljes së numrit 3 (mars 1982) të Zërit të Kosovës, po kaloj shkurtimisht tek mbledhja e 14 e 15 majit në mes meje, Xhafer Shatrit dhe Vëzhguesit e përfaqësuesit 'komunist' të PKMLSHJ, Osman Osmani i cili kërkoi që të ndërprehet, përfundoi "Zëri i Kosovës" i përgjakur nga vrasja e 17 janarit 1982. Se çfarë përshtypje i bëri kjo punë Xhafer Shatrit e tregon kjo letër e shkruar të nesërmen më 16 maj 1982, për Xhafer Durmishin dhe Osman Osmanin ku pos tjerash thuhet:

Xhafer Shatri: " *Po që se ju jepet rasti, ju lutem që t'ia përcillni Kamberit (Sabri Novosellës-shën i Xh. D.) argumentimet* ***tona*** *lidhur me nevojën e* ***ndryshimit të emrit të organit*** *(ndryshmit të emrit* ***'Zëri i Kosovës' me një tjetër****, pra me ia fillua prej zeros-shën i Xh. D.) dhe përpiquni të jeni sa më origjinal dhe sa më të arsyeshëm dhe këtë mos e bëni sa për ta bërë, por vetëm pse është shumë e nevojshme."* (Letër Xhafer Durmishit dhe Osman Osmanit, 16 maj 1982. Marrë nga Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 163)

Xhafer Durmishi. *"Dje e mora një letër nga Xhafer Shatri. Po ta dërgoj të fotokopjuar. Edhe letrat tuaja të dërguara tek shoku gjerman i mora. Do të veprohet asisoji dhe besoj se do të ndikojë pozitivisht. Momentalisht nuk kemi gjetur banesë por sot do të shikojmë një vend për një dydhomëshe që kushton 400 DM në muaj. Nëqoftëse nuk është e zënë do të bëhet shumë mirë. Këtu po ta dërgoj edhe nga një letër që kam marrë nga Suedia dhe SHBA.* ***Jemi duke punuar në dalje të revistës, por prapë se prapë emri i saj po kontestohet e diskutohet****. Prej Ankarasë nuk ka ardhë ndonjë material." (Letër Sabri Novosellës, 22 maj 1982)*

Në ditët në vazhdim e kam përgatitë numrin e parë të Zërit të Kosovës, dhe në këtë numër ideologu Abdullah Prapashtica me shokët e vetë nuk kontribuoi me asnjë germë të vetme. Të vetmin kontribut që Osman Osmani e ka bërë për këtë numër ka qenë daktilografimi i dy shkrimeve të mija dhe kërkesa e tij që të hiqet citati i Jusufit:

"Në ballë të këtij populli dhe tek këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme."

Kërkesën e tij, me arsyetimin se mos Jusufi po përjetësohet më shumë se sa duhet dhe atë në kurriz të Abdullahut dhe jo të për shkak të meritave të veta, e kam pranuar dhe e kam hequr këtë citat. Efekti i këtij "kontributi të anëtarit të redaksisë" ishte i asaj natyre sa ky Vëzhgues u bë i padurueshëm në rrethin e Jusufit dhe u detyrua më vonë të gjej ndonjë mes tjetër për ta bërë objekt të vëzhgimeve të tija. Befasia e rrethit në Shtutgart nga kërkesa e Osman Osmanit e Abdullah Prapashticës dukej edhe më interesante në dritën e insistimit të tyre të marsit, kur me çdo kusht kishin kërkuar të del Zëri i Kosovës, si Zëri i Jusufit, në emër të LNÇKVSHJ (përkundër bashkimit e nënshkrimeve të 17 shkurtit) me arsyetimin që UDB-ja të mos mendoj se ia ka arritur qëllimit.

Përveç heqjes së citatit, Osman Osmani ma përcolli edhe një porosi rigoroze nga Abdullah Prapashtica, që ta kam në mendje gjatë publikimit të artikujve të shkruajtur nga unë. (Skender Skënderi=Xhafer Durmishi)

Osman Osmani:	Në asnjë pikë nuk guxon të devijohet nga kërkesa "Kosova-Republikë!", apo të bëhen aludime tjera.
Skender Skënderi:	Pse po u kërkuaka ky rigorozitet pikërisht në këtë numër?

Osman Osmani: Sepse ky do të jetë numri i fundit i Zërit të Kosovës, dhe i Lëvizjes për Republikë!

Skënder Skënderi: Si është e mundur kjo?

Osman Osmani: Është e mundur sepse Partia jonë Komuniste ia ka dërgua një Notë Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, që ta shqyrtojë në Kongresin XII, që do të filloj më 26 qershor 1982.

Skender Skënderi: Cilat do të jenë rrjedhimet nga kjo?

Osman Osmani: Partia jonë Komuniste i ka dërguar ultimatum Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë.

Skender Skënderi: Çka thuhet në ultimatumin e Partisë tuaj Komuniste?

Osman Osmani: Thuhet kjo: PKLMSHJ, autore, ideatore dhe organizatore e kërkesës Kosova-Republikë, pret nga Kongresi XII i LKJ ta aprovoj kërkesën e PKMLSHJ-së Kosova-Republikë. Nëse kjo nuk ndodh, PKMLSHJ do të heq dorë nga kjo kërkesë dhe do të kalojë në kërkesën për bashkim kombëtar, dhe do ta formojë Armatën e Kuqe Shqiptare. Të gjitha pasojat e pakëndshme të kësaj pune do të bien mbi LKJ-në.

Abdullah Prapashtica: *"**Në ULTIMATUMIN e fundit** që ia kam dërgua udhëheqjes jugosllave në Beograd në vitin 1981, ju kam thanë se: ose do të pranohet kërkesa për Republikën e Kosovës, brenda te cilës do të bashkohen gjitha viset shqiptare nën sundimin e Jugosllavisë, ose Jugosllavia do të zhduket nga harta gjeografike!"* (Letër-urimi Isa Mustafës, www.zemrashqiptare.net, 9 nëntor 2010)

Skender Skënderi: Përveç taksiratit që po i ndodhka LKJ-së, çdo do të thotë kjo konkretisht këtu për ne në muajt më të afërm?

Osman Osmani: Kjo do të thotë se do të bëhet e qartë për ty dhe për të gjithë të tjerët se jetoni në epokën e Abdullah Prapashticës, dhe jo të Jusuf Gërvallës apo tjetër kujt. Jusuf Gërvalla dhe të tjerët nuk janë vizionarë të kalibrit të Abdullahut. Partia jonë Komuniste e ka gjykuar mirë se kur duhet luftuar për Republikë në kuadër të RSFJ dhe kur nuk duhet.

Në këtë kohë unë, Haxhi Berisha dhe Naim Haradinaj, momentalisht banonim në Bitigheim-Bisingen, në katin e epërm të një restorant. Kushtet për punë të cilën e bënim nuk ishin të mira. Për këtë arsye Haxhi Berisha e pyet Hasan Veselin, i cili ishte afruar me ne, se a mund ta vendosim makinën në shtëpinë e tij. Duhet cekur mirë se në këtë kohë disa shokë kanë qen shumë të gatshëm me na ndihmua në mënyrë shoqërore në atë që quhet sferë shoqërore, por kanë dashur (gjë që është shumë normale) që sferën private ta kenë vetëm për vete. Hasani i gjendur ngushtë, tha se në banesën time nuk ka mundësi, por e kam një të afërm në Ulm, ku ndoshta ka mundësi më të mira. Për shkak se ne gjendeshim në një pozitë më të vështirë se sa mund të mendohet (pasi Jusufi nuk kishte lejuar asnjë shok nga rrethi i vetë të kërkoj azil) ne i thamë se bënë me shkua e me e pa. Në Ulm udhëtuam unë, Osman Osmani e Hasan Veseli. Kur e mori vesh i afërmi i tij se me çka merremi, ai u frikua, pasi nuk banonte aspak vetëm, por puna jonë mund të vërehej edhe prej disa të tjerëve. Jemi kthyer menjëherë, vetëm sa kemi pi nga një kafe. Menduam të punonim në lokalin e librarisë e Partisë Komuniste Gjermane në Shtutgart, në adresën: Hausmannstr. 107, 7000 Stuttgart, por edhe në këtë lokal nuk qëndruam më shumë se një pasdite.

Puna kryesore u bë dhe përfundua në konviktin e Studentëve në:

Studentenwohnheim
Eduard-Spranger-Straße 7
71634 Ludwigsburg

në të cilin u vendosëm pas disa ditësh.

Të kthehemi edhe njëherë te citati i shkollës së UDB-së, tek faqosjet e të pafytyrëve.

Shkolla: *"Nxjerrja e këtyre dy numrave, të shkruar dhe daktilografuar nga kjo redaksi, u ndihmua teknikisht (faqosja dhe përgatitja për shtyp) nga "marksist-leninistët gjerman" të rrethit të Stuttgard- it."* (Nuhi Sylejmani, Vrasje e trefishtë, 2010, faqe 126)

Shtrohet pyetja: pse Shkolla e bënë këtë gënjeshtër e fyerje të Jusufit dhe shtëpisë së tij? Sipas shkollës së UDB-së, në atë shtëpi ku ka dalë revista Lajmëtari i lirisë, numri i fundit i gazetës Bashkimi, tre numra të revistës Liria dhe dy numra të Zërit të Kosovës për të gjallë të Jusufit, me atentatin e vdekjen e Jusufit vdesin edhe të gjitha njohuritë se si luftohet kundër UDB-së Serbe, vdesin të gjitha njohuritë se si përgatitet teknikisht një gazetë.

Siç do ta shohim në ndonjë rast tjetër nuk është vetëm Shkolla ajo të cilës i pëlqen ideja apo shprehja se me vdekjen e Jusufit shuhet çdo gjë, dhe se pas tij kemi qenë të detyruar me ia fillua prej zeros. Kulmi i gjithë kësaj djallëzie na del, se sa më shumë që të themi se me Jusufin vdes e shuhet çdo gjë aq më shumë nderohet e lartësohet puna e tij madhore, e cila na del aq *madhore* sa menjëherë pas vdekjes *shuhet* e bëhet e mundshme të merret nëpër këmbë prej kujtdo qoftë duke përfshi edhe shkollën e UDB-së Serbe.

E vërteta është se kështu nuk ka ndodhë më 1982, as më 2009, as 2010 dhe as nuk do të ndodhë kurrë.

11. Shkolla e UDB-së si hotelieriste e pronare çelësash në Kështjellën e pamposhtur të Jusuf Gërvallës

Pikërisht pas dorëzimit të Hysen Gegës në dorën agjentit të UDB-së, Sadik Blakajt, I. Kelmendi, figura frontale e Frontit të emërtuar nga UDB-a, tregon se dhoma e vetme e mysafirëve në shtëpinë e Jusufit është quajtur *dhoma e Miranit*, në të cilën Jusufi nuk ka lejuar të hyj tjetërkush.

Ibrahim Kelmendi: *"Kur u ndanë (Ibrahim Kelmendi prej shokut të mirë e të pastër si loti, agjentit të UDB-së Sadik Blakaj dhe Hysen Gegës me rastin e nisjes së tyre për në Kosovë, më 19 dhjetor 1980-shën. i Xh. D.), Mirani shkoi te Jusufi e Bardhi. Ata ndërkohë ishin vendosur me banim në Untergruppenbach, një fshat i madh në afërsi të Hajlbronit dhe Shtutgartit. Aty kishin zënë me qira një shtëpi të re, dy katshe e gjysmë, përkatësisht dy kate dhe çati. Shtëpia e sapondërtuar po pranonte banuesit e parë. Në katin e dytë, të cilit gjermanët i thonë kat i parë, përballë përfundimit të shkallëve, ishte një dhomë e vogël rreth dhjetë metra katrore. Këtë dhomë Jusufi e kishte caktuar vetëm për Miranin. Fëmijët kishin filluar të parët t'i thoshin dhoma e Axhit Miran. Pastaj kështu kishin filluar t'i thoshin të gjithë anëtarët e Familjes Gërvalla. Kur Mirani nuk ishte aty nuk hynte njeri, meqë kështu kishte urdhëruar Jusufi." (*Atentatet, Prishtinë 2007, f.184*)*

Një fjalë popullore thotë: 'Kur të kesh vend në zemrën e dikujt, bythës i gjendet vendi lehtë.' I. Kelmendi është tepër i sigurt se e ka pas vendin e veçantë në zemrën e Jusufit, por kjo atij si duket nuk i ka mjaftua. Ai në mënyrë mahnitëse na e ka dëshmua se tek Jusufi, pasi e ka dorëzua Hysen Gegën në dorën e Sadik Blakajt, në dorën e shokut të

vetë të mirë, të sinqertë e të pastër si loti, në dorën e UDB-së, e ka pasë një çerdhe, një fole për ta pushua bythën e vetë. A mund të jetë e vërtetë kjo dhe prej nga, e prej cilit hotel e ka kopjuar këtë idenë për dhomën e Miranit që rimon aq mirë me një hero tjetër të hoteleve, kur para hotel Interkontinentalit, në Grand të Prishtinës sigurisht nga personeli qenka informuar për dhomën e Arkanit.

Kur është vendosë Jusufi në Untergruppenbach, në adresën e famshme Habichthöhe str. 40? Këtë duhet ta dijë familja e Jusufit. Kjo është një punë që vërtetohet lehtë.

Cila dëshmi publike gjer më sot tregon kohën se kur Jusufi është vendosë në Untergruppenbach, Habichthöhe str. 40? Dokument publik tani për tani kemi letrën e Jusufit dërguar Enver Hoxhës më 19 gusht 1980 pikërisht e dërguar nga Untergruppenbachu.

Më 4 qershor 1980 I. Kelmendi i shkruan këto fjalë Faridin Tafallarit:

Ibrahim Kelmendi: *"Veprimtaria e tillë diversioniste ka lënë pasoja. Shoku Isuf ndoshta me arsye,* ***ka vendosur të mbyllet në lëkurë të vet, ose të themelojë apo edhe ka organizatë në vete.*** *Kryesorja ai ka distancuar veten nga shokët tanë, të cilët mbanin kontakt me të dhe konsultoheshin." (Letër Faridin Tafallarit,* ***4 qershor 1980****; Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, Tiranë, 1998, f. 159)*

Kjo do të thotë se të paktën prej gjysmës së dytë të majit 1980 Jusufi nuk ka asnjë kontakt të vetëm me I. Kelmendin deri në prag të 28 Nëntorit 1980, d.m.th. fiks 6 muaj.

Ibrahim Kelmendi: *"****Kjo gjendje vazhdoi*** *derisa Jusufi e Mirani u takuan në festën e* ***28 Nëntorit****, në Nürnberg. Në manifestim Jusufi bëri një diskutim, jo fjalim, por shumë përmbajtësor. Që të dy kishin presion nga Vasili e Maksi për të rivendosur bashkëpunimin. Ata me të dy mbanin lidhje dhe iu bënin përherë lutje që të pajtoheshin e të bashkëvepronin."* (Atentatet, Prishtinë 2007, f.174-175)

Kjo do të thotë se I. Kelmendi as nuk e ka pa shtëpinë e Jusufit në Untergruppenbach, në këta gjashtë muaj (të paktën jo nga brenda), përpos nëse i porositur është sjellë jashtë saj me qëllim të përgjimit.

Faridin Tafallari: *"Jusufi ka dyshuar tek Ibrahim Kelmendi, duke e ditur se si mendonin* ***ky dhe "shokë" të tjerë për likuidimin e tij.*** *Jusufi nuk e ka pasur shok I. Kelmendin, këtë e di edhe vetë ai. Në një bisedë lidhur me I. K. Jusufi më tha se i kishte thënë Ibrahimit që mos t'i afrohet më afër se 50 metra te shtëpia e tij."* (Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 114)

Se Ibrahim Kelmendi fletë për interesa të veta për *dhomën e Miranit*, disa herë në librin e tij Atentatet, e sipas kronologjisë në këtë libër, për herë të parë e përmend më 19 dhjetor 1980, mundet edhe me u kuptua më lehtë. Por ajo çka është më delikate është se për interesa të kujt flet Dezertori i UDB-së Serbe dhe Vëzhguesi i tij, përmes Nuhi Sylejmanit, i cili e paska pasur për detyrë të kujdeset për familjet e Vëllezërve Gërvalla.

Ibrahim Kelmendi: "*Sa u përket individëve që luajnë këtë "lojë" dhe PKMLSHJ, nuk kam nevojë të ndalem, pasi edhe nuk më është kërkuar të dij. Besoj se shokët Salih (Xhafer Durmishi-shën im) e Fahri (Faridin Tafallari-shën im) dinë dhe kjo do ndihmonte. Them këtë, pasi "trajnerët" e ekipës janë sjell shumë në atë teren, bile e kanë patur si* ***"çerdhe"... banesën e shokëve Jusuf e Bardhosh****, ndër ta kryesisht Nuhiu, i cili shfrytëzoi në maksimum oportunizmin dhe naivitetin e disave..."* (Letër Qendrës Ekzekutive, 30 qershor 1983)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Pas largimit të Saimes, Suzana na ftoi* ***në dhomën e ndarë enkas për shokun Ibrahim Kelmendi.*** *Shkuam të gjithë sa kishim ngelur në familjen Gërvalla, unë, Ibrahimi dhe Xhaferi. Kam për t'ju treguar diçka tha, dhe e shpaloi palën e jorganit, duke pyet se kush nga ne i kishte fshehur ato para aty. Xhafer Durmishi shikonte pa folur, Ibrahim Kelmendi tha: „dikush i paska lënë cullak aty", kurse unë i thashë Suzanës të m'i jepte mua paratë. Pa hezitim ajo m'i dha. I numërova dhe i vendosa në arkë në prezencën e tyre. Ishin gjithsej 4.880 marka.* ***Paratë e fshehura u legalizuan, por pyetja se kush mund t'i ketë fshehur në dhomën ku kishte qasje vetëm Ibrahim Kelmendi, nuk u sqarua kurrë!"*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 123-124)

Donika Gërvalla: *"Ibrahim Kelmendi është i vetmi person që unë kam përjetuar gjatë jetës time dhjetëvjeçare me babain tim si i vetmi person që ai e ka përzën nga shtëpia. I ka thënë dil nga shtëpia dhe të të mos shoh më."* (Intervistë në KOHA-TV, 18 maj 2012, koha në videofilm 4.25-4.37)

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Enigmë mbeti shuma prej 4.880 markash, e gjetur nga Suzana Gërvalla fshehur në* ***dhomën e ndarë enkas për Ibrahim Kelmendin****."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 156)

Në dhjetor 1980 nën ndikimin e shokëve të Shtutgartit dhe sidomos të Hysen Gegës, Jusufi për llogari të I. Kelmendit e përgatitë dhe boton numrin e Bashkimit, në të cilin shkruan nr. 1 Janar 1981, Viti i tretë i botimit. Punën me këtë numër Jusufi e përfundon disa ditë para vitit të ri, pra para se I. Kelmendi ta dorëzoj Hysen Gegën në dorën e agjentit të UDB-së Sadik Blakaj (më 19 dhjetor 1980), shokut të mirë, të sinqertë e të pastër si loti të Ibrahim Kelmendit. Se I. Kelmendi e ka pas Sadik Blakajn shok të mirë, të sinqertë, e të pastër si loti është bërë e ditur më 1997 nga Faridin Tafallari. Jusufi nuk ka ditë për përmbajtjen dhe ekzistencën e kësaj letre por vjen në konkludimin e vet përfundimtar dhe ndërprenë të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin.

Në shtëpinë e Jusufit ka pasur vetëm një dhomë për mysafirët. Në te kanë fjetur më së shumti Haxhi Berisha e Naim Haradinaj, e gjithashtu edhe të gjithë mysafirët tjerë të Vëllezërve Gërvalla. Në atë dhomë të mysafirëve ka qëndruar për disa kohë edhe Osman Osmani, Vëzhguesi i Abdullah Prapashticës, të cilin në atë kohë e konsideronim si shok të barabartë dhe i kuptuar si i tillë ka hy në atë shtëpi. Në vitin 2010 është vërtetuar me shkrim misioni i tij i pabesë, ku ai ishte aty vetëm me qëllim të vëzhgimit dhe asgjë tjetër.

Nuhi Sylejmani, *Luani superior*, edhe pse ka deklaruar se e ka mençurinë e trimërinë e Azem Galicës, triməri e mençuri të cilat i ka *me të leme dhe jo me të bleme* (pra të lindura e të atij lloji që nuk mund të blihen në bankat e shkollave), megjithatë nuk është i vetëdijshëm se çfarë pabesie e çfarë shitje u ka bërë Vëllezërve Gërvalla kur ka pranuar ta vendos nënshkrimin e vetë pas fjalëve të shkruara nga Abdullah Prapashtica. Atë çka nuk e din Nuhiu e dinë shumë mirë ish-udbashi dhe Vëzhguesi i tij. Një ditë kur të dalin dokumentet nga arkivat e UDB-së, vërtetimet nga Serbia, Kroacia apo Sllovenia e Dollancit, se si kanë shkuar disa punë rreth Shtutgartit në vitet 1980-1982, apo në fund të fundit sikur të mungonin fjalët e shkruara nga Jusufi, atëherë vetëm mundet me u marrë me mend se çka do të thoshte për Jusufin, sikur shtëpia i tij në Habichthöhe 40, në Untergruppenbach, të kishte qenë çerdhe ekskluzive e shokut të mirë të Sadik Blakajt, Ibrahim Kelmendit.

Në këtë pikë historinë e vet e ka shkruar Jusufi dhe përpjekja e Shkollës së UDB-së do të kthehet si bumerang kundër saj.

12. Shkolla e UDB-së e shpëton familjen e Jusuf Gërvallës prej hamendjeve

Shkolla e UDB-së: *"Pas gjithë asaj tragjedie, dukej se jeta në Untergruppenbach për familjen Gërvalla ishte bërë e padurueshme. Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri, kurse Tusha për disa muaj të qëndronte në Gjermani, për shkak të shtatzënisë, e pastaj të vendoste. Për këtë vendim duhej njoftuar ambasada e Shqipërisë në Vjenë. Vendosëm që me këtë punë të merrej Xhafer Durmishi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Kadri Rexha: *"Kështu për Jusufin erdhën kohë të vështira. Ai që deri në atë kohë kishte qarë më tepër hallin e të tjerëve, tash po i takonte që edhe vetë të ndeshet drejtpërsëdrejti me vrazhdësinë, presionin dhe peshën e rëndë plumb të pushtetit. Në këto rrethana edhe Teatri e kishte larguar nga puna. Dhe në këtë mënyrë Jusuf Gërvallës sikur po i priteshin përnjëherë të gjitha ëndrrat dhe iluzionet rinore. Betimi i heshtur që t'i përkushtohet çështjes së shenjtë të atdheut dhe të popullit të tij sikur po tretej në qiellin e murrmë të pafund. Të kthehej në fshat dhe të merrej me profesionin e përjetshëm dhe të vetëm të të parëve të tij ishte e pamundur, meqë nuk kishte tokë e as shtëpi të vetën. **Ndaj, në bashkujdi me të shoqen, vendos të arratiset nga Kosova dhe të kalojë në RP të Shqipërisë.** Para se të jetësojë këtë akt jetësor, e sheh të udhës që t'i njoftojë shokët e ngushtë dhe të këshillohet edhe me ta. Pothuajse nga secili shok merr përgjigje të prerë që të mos e merrte një hap të tillë, por sido që të mundej të qëndronte në Kosovë, ngase shihej qartë nga të gjithë se kësaj radhe koha po punonte për popullin tonë të shumëvuajtur dhe atmosfera e përgjithshme jepte shenjat se po afrohej dita kur njëherë e përgjithmonë populli ynë do t'i këpuste zinxhirët e mallkuar të robërisë. Të gjithë e këshilluan që të qëndronte ngase koha në të cilën jetonin kishte nevojë të madhe sidomos për njerëzit si Jusufi, i cili veç e kishte dhënë provimin e madh të luftëtarit të lirisë. Dhe më në fund Jusufi e pa të arsyeshme dhe vendosi të mos largohej nga Kosova."* (Fati i luleve, Prishtinë 1993, faqe 110-111)

Jusuf Gërvalla: "*I dashur shoku Enver!*

Djali im I vogël, dy vjeç e gjysmë, po llafosej me të motrën, tetë vjeçe ndaj të gdhirë, "Dua", i thoshte asaj, të vij me ty në shkollë! "Kur të rritesh edhe pak" , ia ktheu ajo dhe shtoi me një dlirësi të dhembshur fëmijënore: "Kur t`i bëhesh ti motrës për shkollë, ne do të jemi në Shqipërinë tonë të dashur!" (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 60)

Shkolla e UDB-së Serbe: "*Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: "*Cicërimë më të ëmbël, po edhe më prekëse, për të më nxjerrë gjumin e një mëngjesi të gdhirë me përtesë në dhe të huaj-thuaja se nuk kish.*

Isha I lumtur që fëmija im s`e hiqte mendjeje mundësinë për të jetuar në Shqipërinë tonë të dashur. Por fjalët e saj më prekën shumë se sendërtimin e dëshirës së

fëmijëve të mi dhe gjakimin tim, nuk e kisha unë në dorë." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 60)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: "*Unë, me të arritur në Ludvigsburg i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej shokëve të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaportë e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej shokëve të Ambasadës së përmendur.*

Nga ajo kohë u bënë afro katër muaj dhe lidhur me kërkesën time nuk mora ndonjë përgjigje." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: *"Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver." (*Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: *"Nuk ishte punë e lehtë për mua të vendos që të Ju drejtohem Ju, shoku Enver, për një çështje që ndoshta nuk është e denjë te merreni me të. Në krahasim me të ligat që kanë rënë mbi kokë familjes sime para dhe pas lufte, me të ligat që kam*

përjetuar vetë dhe me situatën e përgjithshme shumë të vështirë në Kosovë, gjendja ime është, siç i themi ne nga Kosova, lule e dritës." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: "*Kur i marr parasysh çështjet në gjithë gjerësinë e tyre, kërkesa për të m`u dhënë e drejta e strehimit në atdheun tim, më duket si një luks, dhe atëherë më rrëmben një ndjenjë turpi. Por i vetëdijshëm se në Kosovë, përderisa gjendja të mos ndërrojë rrënjësisht, këmba ime s`ka si shkel më sa të jem gjallë, e në anën tjetër, me këtë botë të huaj s`më lidh asnjë cikërrimë dhe këtu nuk shoh kurrfarë perspektive, e vetmja rrugë e drejtë dhe e njerëzishme më duket jeta në Shqipëri."* (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Ishim të pranishëm unë, Xhafer Durmishi dhe Osman Osmani, kur Suzana e hapi këtë bisedë. U dhanë disa propozime. Dikush ishte i mendimit të largohej vetëm nga ky rreth, duke u zhvendosur në një krahinë apo qytet tjetër brenda territorit gjerman. Pati propozim që kjo familje të vendosej në një shtet tjetër evropian. ...**Pas shumë hamendjesh**, Suzana vendosi që ajo me fëmijët e saj të strehoheshin në Shqipëri."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 128)

Jusuf Gërvalla: *"Jam i vetëdijshëm edhe për disa probleme të pahijshme, që kanë shkaktuar disa kosovarë, duke dalë me qëllime të ulëta në territorin e RPS të Shqipërisë. Për fat, makinacionet e UDB-së, që në Kosovë e viset e tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë kanë bërë kërdinë në dëm të popullit tonë, në shtetin shqiptar s`kanë gjetur shesh për të bërë përshesh. Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurt se unë s`do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës." (*Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

Xhafer Durmishi*: "Në orët e vona të natës së 16 shkurtit 1982 (me Sabri Novosellën) e kemi marrë autobusin, dhe në një natë që dukej shumë e ftohët, kemi udhëtuar deri në Ankara ku kemi mbërri në mëngjesin e 17 shkurtit. Kemi shkuar drejtë në ambasadën shqiptare. Pas një bisede të gjatë, Bujar Hoxha, djali i Kadri Prishtinës, në prani të Sabri Novosellës, ma ka komunikuar vendimin e PPSH (apo thënë me drejtë të Enver Hoxhës) për pranimin e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Shqipëri, kërkesë të cilën ia kisha bërë Engjëll Kolanecit, me dëshirë e porosi të Suzanës, dëshirë e ide të cilën Jusufi ia ka mbjellë qysh kur ai ka qenë gjallë."*

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla*": "Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoj në A. (Australishën i Xh. D.). Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. (...)* ***Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet***

Halimi. "(Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi më 26 shkurt 1982, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358

Përmes kontaktit me Pajazit Ibrahimit kisha marrë lidhje me Shoqërinë Bashkimi Kombëtar Bajram Curri në Australi. Për ta ruajtur fshehtësinë e plot derisa të kryhej puna, patëm thënë se familja e Jusufit, nën përkujdesjen e Rilind Bytyçit me shokë do të vendoset në Australi.

Xhafer Durmishi: *"Përcjellja e Suzanës, Premtonit, Donikës dhe Ergonit për Shqipëri*
Pas kërkesës që ia kisha bërë Engjëll Kolanecit për vendosjen e Suzanës me fëmijët në Shqipëri, e cila ishte edhe kërkesë e Suzanës dhe dëshirë e shprehur më parë nga vetë Jusufi, dhe ardhjes së përgjigjes pozitive që m'u komunikua nga Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982, në fund të marsit u bë organizimi i dërgimit të familjes së ngushtë të Jusufit në Shqipëri. Pas bisedave që kisha bërë me Engjëllin, nga Untergruppenbachu, më 28 mars 1982, u nisëm Haxhi Berisha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani dhe unë. Faridini për këtë rrugë e ka huazuar një kombi prej Nami Ramadanit, nga fshati Tenovë i Tetovës, që jetonte në Esslingen. Faridini me Nuhiun e kanë ngarkuar kombin me tesha e sende. Unë e Haxhi Berisha me Suzanën dhe fëmijët e kemi marrë trenin nga Shtutgarti për në Vjenë. Adresën e takimin na e ka caktuar Engjëll Kolaneci. Atë ditë ne të gjithë jemi takuar në Muzeun, në të cilin gjendej shpata e Skënderbeut. Unë, Faridini dhe Nuhiu jemi përshëndetur me Suzanën, Premtonin, Donikën e Ergonin në Muze dhe jemi kthyer së bashku me kombin e Namiut. Haxhi Berisha ka qëndruar më gjatë se ne me familjen atë ditë dhe është kthye më vonë, vetëm, me tren."

Në përfundim për ta ilustruar trimërinë, mençurinë e lindur, **luftën e 'komunistëve' kundër sllavëve** në bazë të parimeve të internacionalizmit proletar, dhe respektin për shkollat e ndryshme të shprehura në librin e Shkollës **'komuniste'** në shqyrtim, t'i shohim këto fjalë Pol Pot-iste të Dinastisë Dordolece Kim il Sungiste:

"***Suzana ishte në përkrahje të Skënder Skënderit*** *(Xhafer Durmishit-shën im), duke e cilësuar atë si student të diplomuar e që i dinte më mirë se unë këto punë. Isha i nevrikosur, ndoshta më tepër se ç'duhej, andaj ia ktheva Suzanës se për të luftuar* ***kundër sllavëve*** *nevojitet guxim, strategji, mençuri e jo diplomë... as Shota e Azem Galica kur luftuan kundër çetnikëve serbë nuk patën diploma, por jehona e trimërisë së tyre dekada me radhë ua futi tmerrin në bark ushtarëve serbë..."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 118-119)

Për të evituar çdo keqkuptim dua të them se përkujdesja ime për familjen e ngushtë të Jusufit, si shok në mesin e shokëve të Jusufit është e një afati të kufizuar dhe preciz kohor dhe shtrihet vetëm e vetëm nga 21 janari gjer më 28 mars 1982, d.m.th. 67 ditë. Sa i përket qëndrimit ndaj Bardhoshit e Jusufit si luftëtar e ideolog i lirisë, si anëtar të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në/nën Jugosllavi punët qëndrojnë pakëz më ndryshe dhe ma merr mendja se do të vlejnë periudha tjera kohore.

PORTRETE FEMRASH

Në librin *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit dhe diskutimet rreth tij

I KURVA, KURVARË DHE KURVËRIME
1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre
2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar
3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri
4. U tërbova duke i thënë kurvar
5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër
6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat
7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve
8. Shkrimtari harton fabula
9. Qenke njeri i poshtër
10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike
11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim
12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën
13. Që të mos flinin me gratë e tyre
14. Cipërcullakosje
15. Epitete
16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp

II SERBET E MASKUARA SI KROATE E BOSHNJAKE

III PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

I
KURVA, KURVARË DHE KURVËRIME

Të gjitha citatet (me përjashtim të atij rreth dramës Misioni të Sabri Hamitit) nuk kanë asnjë koment përveç titujve që kanë për qëllim lehtësimin e dukjes së citateve.

> ***KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën****, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të* ***cilave nuk solli asnjë qindarkë****, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)*
>
> ***I. Kelmendi****: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (****e as bir kurve****), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë* ***se nuk kam shpërdoruar*** *e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me****:*** *23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

Daut Demaku: "***Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq***

domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse brumi është aq i vërtetë, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..." (Prishtinë, 26 gusht 2007, www.pashtriku.org)

1. Shqiptarët kurvarë garonin midis tyre

Gjatë marrjes në pyetje, në Vjenë, të kolegut të Dajës Ramadan nga posta e Pejës, i cili i zënë ngushtë betohet në kokën e vajzës

*I. Kelmendi: "Betimi në kokë të vajzës e neveriti Miranin, meqë kishte dëgjuar se ajo po ushtronte prostitucion në Vjenë. I kishin thënë se ishte e pashme e tërheqëse dhe se shqiptarët **kurvarë** në Vjenë garonin midis tyre që t'i jepnin asaj shilinga dhe të krekoseshin para njëri–tjetrit." (Atentatet, f.80)*

2. Faturat përmbajnë tatimin e vlerës së shtuar

Aparat për regjistrimin e hyrje-daljeve, i aprovuar nga organet tatimore

I. Kelmendi për vetveten dhe për kurvarët profesionist që mbajnë kontabilitet e i paguajnë tatimet dhe sigurimet sociale me rregull

*I. Kelmendi: "Se si po më vjen keq që qenka katandisur në atë gjendje. Më drejtohet duke më poshtëruar, se dashka të bëka seks **më mua**, meqë nuk paska të holla për të paguar mashkull **kurvar**, nga ata që e kanë si marrëdhënie pune dhe paguhen nga femrat për të dëfryer ato kur kanë deficit seksual. Edhe ato fatura të pagesës përmbajnë **tatimin e vlerës se shtuar**, që duhet t'ia paguajnë shtetit, njësoj si edhe prostitutat e legalizuara që paguajnë të gjitha sigurimet sociale dhe tatimin vjetor mbi fitimin." (Atentatet, f.95)*

3. A të fascinoi edhe për bixhoz dhe kurvëri

Për Sadik Blakajn

Ibrahim Kelmendi: "– Pse nuk po flet? – ia ndërpreu Vasili mendimet.
– Po atëherë çfarë ndodhi?
– Vërtet, Sadiu erdhi pas dy ditëve. Ndenjëm ca ditë bashkë te Demushi në Nagold. Atje u fascinova nga shkathtësitë dhe patriotizmi i tij. Kishte shkathtësi të falsifikonte dokumente të të gjitha llojeve. Madje edhe bileta të trenit. Kishte shkathtësi për të qenë gueril i përkryer...
*– A të fascinoi edhe për bixhoz dhe **kurvëri**, sepse kohën më të madhe e kalon me to? f.180*
"– Po bëhem kurban,– ndërhyri Vasili.– Më mirë unë se ti dhe Baca Jusuf.
*– Çfarë rëndësie ka kjo sprovë naive e shoqëruar me rrezik të qind për qindtë!? Në fakt, përse po na duhet ky farë Sadiu!? Ti vetë duhej të ishe bindur të paktën se ai është **kurvarë**, bixhozxhinj, rrugaç! – i foli rrebtë Mirani." (Atentatet, f.182)*

4. U tërbova duke i thënë kurvar

Rreth fatit të një femre në duart e UDB-së e cila nga Kosova është nis enkas me plan të martohet me figurën frontale të Frontit të Kuq

*Ibrahim Kelmendi: "Menjëherë u tërbova duke i thënë pusht, **kurvar** e të ngjashme. Bëra të iki, por ai e kishte mbyllur derën dhe çelësin e kishte futur në xhep." (Atentatet, f. 204)*

5. Sa për kurvërim të kam ty këtu më afër
(Në bisedë me heroinën e vetë Renatën)

*Ibrahim Kelmendi: "– Edhe ty nuk të shkoi mendja aq afër dhe aq qëllueshëm. Unë të fola për lisa, kurse ti më flet për fshesa, siç shprehet populli ynë. A nuk e kisha Martën këtu, e cila më përgjërohej**, pa pagesë**. Atëherë, përse u dashka të shkoj deri në Berlin për **kurvërim**? E di ti sa janë shpenzimet e udhëtimit deri atje dhe si keqtrajtohesh kur kalon transit nëpër Gjermaninë Lindore? Pastaj, po të **kisha kurvërimin si qëllim, a nuk të kam ty këtu më afër?***
*– Stop! Stop! Mua kurrsesi për **kurvërim**. More vesh!?*
– Stop! Stop! Ti e nise e para dhe më ofendove." (Atentatet, f.214-215)

***KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të **cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)*

***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje."* (Afishuar me**:** 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)

6. Kapni kurvarët që jua bënë shoshë gratë e vajzat

Në doganën e Gjermanisë Lindore (DDR)

*I. Kelmendi: "Atëherë, i thashë, kapni **kurvarët** që jua bënë shoshë gratë e vajzat, duke i paguar devizat që ndërrojnë në treg të zi." f.216*
*"Iu përgjigja se nuk kisha menduar ashtu, por se doja t'ju thosha t'i pengoni **kurvarët***

që po vijnë, po bëjnë kontrabandë dhe po jua provokojnë gratë e vajzat me para." (Atentatet, f.216)

7. Nuk ka bir nëne e as bir kurve

***KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të **cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (*Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me**:** 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

8. Shkrimtari harton fabula

Mustafë Xhemaili: *"Skema e famshme e Aristotelit lidhur me historinë dhe letërsinë është e qartë. Ajo nuk ka ndryshuar as sot dhe është kështu: **Historia tregon atë që ka ndodhur, ndërsa letërsia (poezia) tregon atë që mund të ndodhë;** historia tregon çka ngjet, letërsia tregon si mund të ngjajë; historia tregon gjëra të veçanta, letërsia tregon gjëra të përgjithshme, prandaj letërsia është më filozofike se historia. Më tutje: historiani shënjon referencat (të dhënat), **shkrimtari shënjon tekstin fiktiv**, të mundshmen; **historiani nuk harton fabula**, **kurse shkrimtari harton fabula**. Edhe më tej: historia mund të jetë e shkruar në vargje e të mos bëhet letërsi. Sepse e para mbështet te e vërtetdukshmja (që do të thotë e mundshme) kurse e dyta në ngjashmëri (që do të thotë e besueshme). (**shih te S. Hamiti: Tematologjia, f.70**)."* (Atentatet e zbuluara - Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf (Gjermani), për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET, www.pashtriku.org)

9. Qenke njeri i poshtër

Atyre që ju intereson teoria e letërsisë mund shohin çka thotë Sabri Hamiti tek "Tematologjia f.70". Atyre që u intereson Drama e 17 janarit 1982, mund të shohin tek drama Misioni, pjesa e parë, skena IV, ku flitet për Ibrahim Kelmendin **(Keqën),** Kadri Zekën **(Lulin),** Jusufin **(Isën)** gruan e Jusufit **(Zanën)** dhe gruan e Kadri Zekës **(Lulën).** Pa komentuar aspekte tjera, interesant është 'respekti" për gratë, të cilin Sabri Hamiti duhet ta ketë mësuar nga burimi i tregimit të tij. Për hir të qartësisë brenda citateve në kllapa janë vënë emrat e personazheve të vërteta.

Pjesët e cituara paraqesin biseda në shtëpinë e Jusufit në mesditën e 17 janarit 1982.

Keqa nuk mund të jetë i keq

Sabri Hamiti: "ZANA (Suzana), *hap derën, fut kokën.*
Mirëdita të gjithëve!

KEQA (Ibrahim Kelmendi), *Zanës.*

Hyn fisnike vetëm një minutë. *Ia shtrin dorën, përshëndetet, mandej ulet*. Këtij Lulit tonë po i ngutet. Si e pleqnon ti fisnike këtë punë? *Zana rrudhë krahët*. **Ky e ka mendjen te Lula e vet e re që ia ka lënë shtratin thatë.** *Qetësi.* Unë jam kalli vetëm dhe s'kam çka të ngutem. E kam nanën vejushë të cilës s'mund t'ia gjej një plak. E kam edhe një motër, e sa për motër moj fisnike ia kam gjetur burrin. Ha-ha-ha. Do ta bëjmë dhëndër Isën për së dyti. *Isa hesht. Shikon Zanën, e cila pa asnjë fjalë del.*

LULI (Kadri Zeka), ***i mërdhezur.***

E mira e të mirave po të lut, Lulën mos e përmend.

ISA (Jusuf Gërvalla), *mban veten.*

Të lutem Keqë, **respekt për shtëpinë, konakun, për femrën**. Të gjithë jemi me nerva, **por kjo është shtëpi."** (*Misioni, Prishtinë 1997, faqe 41*)

Sabri Hamiti: **"KEQA (Ibrahim Kelmendi)**, *dredhas.*

Ky prapë nuk e ka mendjen këtu. Ha-ha-ha. E ka mendjen te shtrati i thatë i Lulës.

LULI (Kadri Zeka), *e gjuan fytyrës me bllok.*

Qenke njeri i poshtër!" (*Misioni, Prishtinë 1997, faqe 46*)

S.H.: "Keqa nuk mund të jetë i keq" (*Misioni, faqe 49*)

Dordoleci superior i UDB-së Serbe dhe Vëzhguesi i tij superior: *"Në këtë pozitë* ***inferiore*** *nga ana e „zëvendësit", ndjehej* ***edhe*** *udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 89)

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)*

10. Pa pretendim për të qenë të vërteta historike

Ibrahim Kelmendi*: "Ato (ngjarjet-shën. i Xh. D.) janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend,* ***pa pretendim për të qenë të vërteta historike****."(kopertina e mbrapme e romanit Atentatet)..."romanin e kam shkruar sipas qejfit"."*

Ibrahim Kelmendi: *"Mirani mori frymë thellë për të pritur reagimin. Kishte frikë mos po e humbiste durimin, pasi ishte bindur se shtabi i UDB-së që kishte urdhëruar atentatet, tani kishte dhënë urdhër që të provokohej Mirani për të bërë ndonjë hata ndaj provokuesve.*

– Jo vetëm ti, por as ajo ***kurva****, që ju po i thoni Bule, nuk jeni të dëshiruar të qëndroni më këtu, – foli Xhafari.*

Të gjithë të pranishmit hapen sytë në drejtim të Xhafarit, pos Nuriut që vazhdonte të mbante ***kokën ulur, pothuajse midis këmbëve****.* ***Sikur pjesëmarrësit nuk po u zënin besë veshëve çfarë dëgjuan.***

– Përse është kurvë bashkëshortja e nderuar e Kadriut? *– ia drejtoi Mirani Xhafarit, duke ruajtur qetësinë e jashtme, të cilën përbrenda pothuajse e kishte humbur. Sa s'po eksplodonte.*

– ***Ajo kurvë e dërguar nga UDB-ja*** *i ka qitur shokët në pritë, – u përgjigj Xhafari, që po ngjante me shumë në një kërmë se sa në njeri.*

– Pa na e zbërthe edhe këtë komplot, se si i keni sajuar detajet!?
– Nuk jam këtu para UDB-së që të përgjigjem në pyetjet e tua, – tha Xhafari.
– Mor kriminel i dërguar, do të sqarosh apo do të ta dredh qafën si të gjelit!? – e kërcënoi Mirani, i cili po shtrëngohej për t'ia mbërthyer fytin. Tashmë Mirani kishte fituar siguri se pos ndërhyrjes për t'i ndarë nuk do t'i hidheshin të tjerët.
– Dihet, – nisi të përgjigjet Xhafari, që kishte humbur davanë, ***– Kadriu ka lënë orarin kur do t'i telefonojë kurvës së tij****. Ajo ka informuar vrasësit për orar dhe pastaj vrasësit kanë zënë pritë." (Atentatet, f. 363-364)*

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)*

Dezertori apo Dordoleci superior i UDB-së Serbe dhe Vëzhguesi i tij superior: *"Në këtë pozitë* ***inferiore*** *nga ana e „zëvendësit", ndjehej* ***edhe*** *udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 89)

11. Mos më keqkuptoni, por kam shkruar sipas qejfit tim

Ibrahim Kelmendi*: "Ato (ngjarjet-shën. i Xh. D.) janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend,* ***pa pretendim për të qenë të vërteta historike****."(kopertina e mbrapme e romanit Atentatet)..."romanin e kam shkruar sipas qejfit"."*
Saime Isufi: "*...Këtë e bëj, pas leximit të* ***veprës tënde historike*** *"Atentatet", për të cilën të përgëzoj nga zemra! Edhe njëherë urime!*
...Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)
I. Kelmendi*: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "****Mos më keqkuptoni****, por* ***romanin*** *e kam shkruar sipas* ***qejfit*** *dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija* ***qejfin****, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." (www.kosova.de)*

12. Keqpërdori ndihmat për Kosovën

Përjashtimi i Ibrahim Kelmendit prej KQ të LRSSHJ (Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi), pos tjerash për keqpërdorimin e ndihmave për Kosovën

*"***Njoftim**

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ

"Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën ynë) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer (Shatri-shën ynë) në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e

thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. ***Keqpërdori ndihmat për Kosovën****, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin* ***e Suedisë*** *në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë*

> *I. Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë* ***pesëdhjetë mijë korona*** *suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)*

luftës sonë prej 50.000 korona, ***prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë****, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë."*

"Kështuqë KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.
10 shkurt 1985 Zvicër
KQ i LRSSHJ" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

Dëshmitare kur Ibrahim Kelmendit i janë dhënë 50 mijë korona suedeze nga Nexhmi e Shefkate Sherolli është Saime Isufi. Anëtare e Komitetit Qendror të LRSSHJ në Zvicër, i cili më 10 shkurt 1985 e përjashton Ibrahim Kelmendin për hajni është Saime Isufi.

Ibrahim Kelmendi*: Afishuar me: 23.03.2007 21:18 "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e* ***as bir kurve****), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje."* (www.kosova.de)

13. Që të mos flinin me gratë e tyre

Letër publike Zotëriut Peter Feith

(Kjo pikë nuk ka të bëjë me librin *Atentatet*, por e mora se i përshtatet temës që është në shqyrtim)

I. Kelmendi*: "Ju lus, sepse jam i bindur, se po që se do u sugjeronit Ju qeveritarëve tanë që të* ***mos flinin me gratë e tyre****, binduni, ata vërtetë nuk do të flinin, sepse edhe këtë sugjerim Tuajin ata do ta kuptonin si urdhër. Dhe meqë do ta kuptonin si urdhër, ata do frikësoheshin se ju do i hiqni nga postet qeveritare, po nuk ju dëgjuan. E ata i duan postet qeveritare më shumë se gratë e tyre, gjithsesi edhe më shumë se qytetarët e tyre." (Letër publike shefit të ICO-s, Zotëri Peter Feith, 5 shkurt 2009, Botuar në www.pashtriku.org)*

14. Cipërcullakosje

Biseda në forumin www.kosova.de rreth librit Atentatet

Moskeqkuptime, qejfe, cipërcullakosje, zhveshje, mveshje, pa pretendime për të qenë të vërteta, fantazi të vitit 2007 dhe jo ngjarje të vitit 1982

"Asgjë më të bukur e më të ëmbël s'ka sesa e vërteta."

***I. Kelmendi**: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar sipas **qejfit** dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija **qejfin**, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre."(www.kosova.de)*

***Sali Kabashi**: "...duke qenë se në librin e tij e shohim **cipërcullak të zhveshur**... ...edhe mjeranët shqiptarë" (Prill 2007, Republika)*

***I. Kelmendi**: "Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..." (Republika, prill 2007)*

***I. Kelmendi**: "Ato janë paraqitur ashtu siç i kam përjetuar dhe siç i kam mbajtur mend, **pa pretendim për të qenë të vërteta historike**."(kopertina e mbrapme e romanit Atentatet)..."romanin e kam shkruar sipas qejfit"."*

*I. Kelmendi: : Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar **sipas qejfit** dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija qejfin, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." . (www.kosova.de)*

*I. Kelmendi: "Mendimet dhe vlerësimet **janë të kohës, kur kanë ndodhur ngjarjet**." (Kopertina e mbrapme e librit Atentatet)*

***I. Kelmendi**: I nderuar Z. "panta_rhei" ! (Afishuar me: 25.03.2007 21:11) "Ju keni të drejtë kur mendoni, se romanin ATENTATET nuk e ka shkruar **Ibrahim Kelmendi i viteve 1978-1985, por Ibrahim Kelmendi i vitit 2007.** Kapitullin e fundit ia kam dorëzuar redaktuesit (Z. Adem Gashi) në fillim të janarit të këtij viti." (www.kosova.de)*

I. Kelmendi: "Këshillë - Të mos lexohet nga adoleshentët (nën moshën 16-vjeçare)"

*Sali Kabashi: "...duke qenë se në librin e tij e shohim **cipërcullak të zhveshur**... ...edhe mjeranët shqiptarë"*

*I. Kelmendi: "Pastaj, po të kisha **kurvërimin si qëllim, a nuk të kam ty këtu më afër?"***

*I. Kelmendi: "**Mos më keqkuptoni**, por romanin e kam shkruar sipas qejfit dhe bindjeve të mia. Edhe po t'i dija qejfin, bindjet dhe përcaktimin Tuaj, ua them më keqardhje, nuk do ta kisha shkruar sipas tyre." (www.kosova.de)*

*I. Kelmendi: Afishuar me: 26.03.2007 15:45 "Ju keni të drejtë kur mendoni, se romanin ATENTATET nuk e ka shkruar **Ibrahim Kelmendi i viteve 1978-1985, por Ibrahim Kelmendi i vitit 2007.** Kapitullin e fundit ia kam dorëzuar redaktuesit (Z. Adem Gashi) në fillim të janarit të këtij viti." (www.kosova.de)*

15. Epitete

***KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të **cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi." (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)*

***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

16. Nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp

Faridin Tafallari: *"**Ibrahimi** (Kelmendi-shën ynë) ka ecur më shumë. Ai ishte i pa disiplinuar, me ca sjellje jo të mira dhe aq më **shumë të pa pranueshme tek ne shqiptarët**. **Futej në kuzhinë, te gratë**...Shtrihej në dhomë gjerë e gjatë dhe nuk e kishte për gjë, se ishe ti me familje. Ai shtihej sikur të ishte në shtëpinë e vet... **Nuk tregoi asnjëherë mirënjohje për gjitha ato pritje që i bëheshin nga gratë e shokëve** duke e nderuar si një patriot! Prandaj **ai nuk e dinte të mirën, nuk kishte turp**."(*ÇKA PRET IBRAHIM KELMENDI, PSE NUK BËN KALLZIM PENAL NDAJ VRASËSIT TË JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËS DHE KADRI ZEKËS (!?!), www.pashtriku.org, 26 qershor 2007)

II
Serbet e maskuara si kroate e boshnjake

Të gjitha citatet e mëposhtme janë nga libri Atentatet i Ibrahim Kelmendit.

*"– Pyetja e fundit: Përse pothuajse shumica e pjesëtarëve të organizatës suaj i kanë **gratë ose dashnorët serbe**, duke filluar nga Emil Kastrioti, Vehbi Ibrahimi, e të tjerë si këta?*

– Mendoj se ua kanë dhënë eprorët, për t'i mbajtur më mirë nën kontroll edhe jashtë. Po nga i di ti të gjitha këto, nëse më lejohet të të pyes?

*– Të gjithë ata që i njohin, flasin për këtë dukuri, meqë jo të gjithë anëtarët i keni të rekrutuar nga kjo farë UDB–ja serbe. Disa i keni anëtarësuar, meqë i keni mashtruar sa për t'i përdorur për informatorë dhe për t'ua zhvatur ndonjë para në emër të anëtarësisë dhe të kontributit për veprimtari, në dukje patriotike. Ata të shkretë nuk ju njohin, por nuk durohen pa folur, meqë nuk u pëlqen pse i kanë **gratë e dashnorët serbe**.*

-Cila është Serbe?, - Cila është boshnjake?, - Cila është kroate? A mundeni me më tregue? -Sepse unë nuk mundem me i dallue!

– Edhe unë nuk ua kam begenisur atyre këtë përçudni. Ti e pe, unë e kam gruan shqiptare, atë që ma ka fejuar baba, sipas traditës." (Atentatet, f.81)
"I dëgjova kur dolën së bashku Rezili me atë gruan. Ata flisnin midis tyre ***serbisht, mbase kroatisht apo boshnjakisht****, gjuhë që unë nuk i dalloj." f.133*
"– Mos më hidhëro, sepse nuk e kam pasur të lehtë ta survejoj dhe sidomos të përmbahem pa e vrarë në shkallë kur e shihja të bisedonte e të tallej me atë ***shkinulë****.*
– Atëherë qenka puna thellë. Nuk doka kallauz për të konstatuar se ai është kuadër i UDB–së. Edhe individë të tjerë, për të cilët unë kam formuar bindje se janë udbashë, i kanë gratë serbe. Ata, si nacionalistë e patriotë që reklamohen, për ***gratë dhe dashnoret e tyre serbe, gënjejnë se i kanë boshnjake ose kroate****. Meqë qenka kështu, të shkojmë te Jusufi e Bardhi.*
– Po shkojmë,– miratoi Vasili." f.133
"– Të shohim nëse vërtet Rezili jeton me atë ***gruan****, për të cilën ti po dyshon që është* ***serbe."*** *f.134*
"Dhoma e gjumit duhej të ishte përballë, por nuk e dinte nëse në atë kohë ishte aty gruaja dhe djali. Ai po mendonte se ***serbja*** *dhe fëmija duhej të ishin në dhomë të gjumit, meqë takimi ishte planifikuar në lokal." f.136*
"– Përjashta! – ulëriti Rezili tashmë i tërbuar fare. Nuk të duhet gjë ty, është jetë private kjo!
– Mos ulërit se nuk ta kam frikën. Mos më bëj të të hedh nga dritarja! – ia ktheu Mirani.
– Ti do të duhet të shpjegosh se përse ***bashkëjeton me një serbe*** *në një banesë? Përse e ke mbajtur deri tani këtë të fshehtë ndaj këtyre, nënkryetarit e sekretarit të Grupit? Duhet t'u tregosh këtyre se në çfarë vendi të sigurt, nën përkujdesjen e një* ***serbeje,*** *ruake gjithë dokumentacionin e Grupit!*
Mirani fliste drejtuar nga Rezili, por po vështronte herë pas here Maksin, se mos ai bënte ndonjë lëvizje. Tjetri nuk lëvizte vendit, por dukej se ishte shokuar nga shpërthimet e Rezilit, të ***bashkëjetesës së tij me serbe****, siç e mori vesh më në fund." f.143*

"Rezili iu kishte afruar dritares dhe mbante kokën me të dy duart, duke mërmëritur nëpër dhëmbë, por që nuk kuptohej se ç'thoshte. Ndërkohë Maksi foli me zë të theksuar:
– Vasil, ku po do? Ndal të bisedojmë pse ky qen bashkëjetoka ***me një shkinulë*** *këtu, kurse gruaja ime dhe shokët tanë janë në burg në Kosovë për tradhtinë që na e paska bërë ky pis." f.143-144*
"– Çfarë po flisni kështu, ai duhet vrarë,– foli Maksi i përndezur.– I kam dorëzuar në origjinal formularët e anëtarësimit të plotësuar e të nënshkruar në Kosovë, pa ditur se ai jeton në të njëjtën banesë me një ***shkinë****, me të cilën paska edhe djalë." (Atentatet, f.145)*

III
PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË

HEROINAT E STOLISURA DHE FATI I BIZHUTERIVE TE TYRE, APO:
PREJ NJË SHPATI T'I LËSHOVA SYTË
KUR T'I PASH RRUAZAT NË FYT

Të gjitha citatet e këtij nëntitulli janë marrë nga libri Atentatet i Ibrahim Kelmendit

"Në shtëpi të malësorit nga Tetova, e njeh edhe ti Saimir Përcën, po palosnim Bashkimin, për të kursyer që të mos e paguanim shtypshkronjën për këtë. Ishte babai dhe bashkëshortja e Saimirit. Ajo sapo kishte ardhur nga vendlindja. Ishin edhe gjashtë

bashkëveprimtarë të tjerë. Në një çast të papritur, bashkëshortja e Saimirit vuri mbi tavolinë ***bizhuteritë*** *e saj duke thënë: "Urdhëroni, shfrytëzoni këto për të financuar daljen sa më të shpeshtë të gazetës. Duhet t'ju vijë keq që nuk po e ndihmoni financiarisht. Mirani po detyrohet të jap të hollat e veta që po i fiton duke shpërndarë natën pamflete e reklama...".*

Babai i Sajmirit, vjehrri i saj, i bërtiti: "Nuse, të ka lënë mendja, si po na turpëron kështu!"

Ajo ia ktheu: "Jo baba, por këto m'i keni blerë mua, janë të miat dhe unë po vendos t'i jap për botim të gazetës. Po më vret ndërgjegjja t'i mbaj për vete, sidomos kur po shoh se ju nuk po e kuptoni që duhet të ndihmoni më shumë se sa ndihmat simbolike. Ju dëgjova kur u paraqit raporti i ndihmave që kishit grumbulluar. Më erdhi keq..." "Pusho më!" – e pat ndërprerë vjehrri." (Atentatet, f.157)

"Erdha këtu dhe pashë se si shqiptarët po bënin vetëm llafe, po punonin si skllevër për të paluar sa më shumë dollarë dhe i kishte mbërthyer vesi i babëzisë për të hëngër tri herë në ditë steka. Unë nuk po mundem ta duroj këtë gjendje. Ja ku i ke ***bizhuteritë*** *e mia,– foli Mirëvetja në drejtim të Miranit,– sepse nuk po mund t'i mbaj në qafë mbi 100 tonelata miell, kur në Prishtinë vëllezërit e motrat tona që po përzihen nga puna për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata nuk kanë bukë të hanë, nuk kanë as armë të vetëmbrohen nga kriminelët serbë.*

Vaji me dënesë ia ndërpreu fjalën emocionuese.

Bizhuteritë e shumta

I hoqi ***bizhuteritë e shumta*** *nga qafa dhe i vendosi mbi tavolinë. Iku për të vazhduar vajin gjëmë në dhomën tjetër. Kunatat i shkuan prapa dhe po e lagnin me ujë*

duke menduar se e kishte humbur vetëdijen kur u përplas në shtrat në dhomën ku rrinte familja me mysafirët. Binaku dhe Mirani mbeten të heshtur pa ditur çfarë të flisnin. Nuk po lëviznin vendit dhe dukeshin në gjendje prej të nemiturve.

*Mirani po mendonte me vete: "Hera e pestë që gratë po shfaqin gatishmëri për të ndihmuar veprimtarinë çlirimtare në mënyrë konkrete. Hera parë me ka ndodhur në vitin 1978, në Düsseldorf. Malësorja nga Tetova, emri i së cilës tani nuk po më kujtohej, por di që është bashkëshortja e bashkëveprimtarit Saimir Përca, kishte ofruar gjithashtu **bizhuteritë** e saja për të financuar botimin më të shpeshtë të gazetës Bashkimi. Ajo tani nuk është në Gjermani, pasi UDB–ja pat arrestuar Saimirin kur shkoi për pushime në Tetovë. Herën e dytë, Fatushi, vajza e veteranit Hysen Kalishta që kishte lindur në kampe të refugjatëve të luftës në Greqi, ishte organizuar në Bruksel bashkë me tri shoqe të saja që t'u trokisnin derë më derë shqiptarëve duke u kërkuar atyre ndihma financiare për Kosovën. Gojëkëqijtë ishin përpjekur ta sabotonin këtë aksion duke i përgojuar ato se gjoja po mblidhnin të holla për vete. Herën e tretë, Malësorja e Gostivarit, Hana, me shami të havalesë në kokë, gjatë vitit 1981, mblodhi ndihma simbolike në tubimet e gjermanëve, pasi u kishte folur atyre për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për domosdoshmërinë e çlirimit të Kosovës nga pushtimi serb dhe nga diktatura komuniste. Herën e katërt, Fllanza, bashkëshortja e patriotit veteran Nexhip Pogradeci dhe motra e Enis Mitrovicës, e cila bashkë me të Shoqin dha ndihmë pesëdhjetë mijë korona suedeze kur ishim gjatë vizitës në Suedi në fund të shkurtit të vitit 1982. Tani edhe Mirëvetja po i ofronte **bizhuteritë** e veta në këtë mënyrë kaq demonstrative dhe dramatike. Se mos është kjo dhunti e mendësi,– po rezymonte Mirani,– që ka për bazë ndjeshmërinë më të theksuar të gruas, për dallim nga burrat, meqë nuk kam përjetuar ndonjëherë që burrat, madje as bashkëveprimtarët, të shprehin gatishmërie kaq konkrete dhe kaq me vlerë për të ndihmuar veprimtarinë çlirimtare!?". (Atentatet, f.409-410)*

***KOMITETI QENDROR I LRSSHJ " Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të **cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi."* (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

***I. Kelmendi**: "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se **nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me**:** 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

Shkolla e UDB-së Serbe si hetuese e Atentatit të 17 Janarit 1982

Kontributi në hetimet e vrasjes së 17 janarit 1982 nga polici dhe ish-inspektori i UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica, i shfaqur në librin e quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010

1. Qërim tipik hesapesh
2. Kush ka shfaqur dyshime?
3. Kush është I.K. (Ikaja)? - Derisa po çuditesha u çuditë ai me mua!
4. *KUSH E VRAU JUSUF GËRVALLËN?*
5. Dyshimi në Bulen më tronditi
6. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla
7. Zoti Gynter nuk më la të çuditesha!
8. Suzana i tha se më së miri do ta mbronte një avokat
9. Ujku e shikon Luanin e inferioriteteve vandale si prenë e tij
10. Na befasoi dhe krijoi të çara në mesin e familjeve të dëshmorëve
11. Dyshimet çorientuan mbarëvajtjen e hetimeve
12. Nga "dëshmitë" e Xhafer Durmishit u arrestua Riza Salihu

1. Qërim tipik hesapesh

Para se ta analizojmë kontributin e Shkollës së UDB-së Serbe, të shohim lajmin e TANJUG-ut, të 18 janarit 1982.

"Në RF të Gjermanisë

U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë politike", sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rreptë vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla." (Rilindja)

2. Kush ka shfaqur dyshime?

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Skënder Skënderi (Xhafer Durmishi - shën im), duke e parë se unë nuk e kisha „vërejtur“ situatën, nuk i kisha „zbuluar“ tradhtarët në mesin tonë, nuk po i kuptoja „rrotullat“ që luheshin përreth dhe nuk kisha vënë dyshimin mbi askënd, hapur më tha: „**Kemi informata se në këtë vrasje të trefishtë kanë gisht vetëm dy veta, e këta janë: Bulja dhe Ikaja!“** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 89)

Jusuf Gërvalla: *"Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e Shpendit (Xhafer Durmishit - shën im), për të mos thënë me presionin e tij, Shpendi shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri (rreth 10 dhjetorit - shën i Xh. D). Së andejmi u paraqit disa herë në telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm, a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. **Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar."** (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 454)

Atentati ka ndodhur pak pas orës 22.00 në mbrëmjen e 17 janarit. Prej rreth 10 dhjetorit 1981 deri më 20 janar kam qenë në Kosovë për punë të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Në Untergruppenbach kam mbërri rreth orës 14.00 më 21 janar 1982. Në momentin e marrjes së lajmit përmes leximit të "Rilindjes" mërzia ime mundet me u marrë me mend vetëm nga shokët e Jusufit. Pos kësaj pas disa çastesh më është lajmëruar edhe frika se çka mund të mendojnë shokët në Shtutgart. E kam pyetur veten se mos ata, apo ndonjë i vetëm prej tyre mund të mendojë se unë pa vetëdije, pa asnjë kontakt dhe 1600 km nga vendi i ngjarjes mund të kem kontribuar në atë që kishte ndodhë. Këtë pyetje e këtë shqetësim ua kam shfaqur Haxhi Berishës, Naim Haradinajt dhe shokëve të tjerë brenda disa orëve pasi kam mbërri. Të njëjtat shqetësime i kanë pasur edhe ata, të njëjtat pyetje ia kanë bërë vetes edhe ata pa përjashtim. Kështu është pastruar atmosfera jonë, për t'u marrë pastaj me punët tjera. Në Untergruppenbach kam mbërri në çastet e para të shikimit të kufomave, kur i ka sjellur firma e varrimit kufomat për lamtumirën e fundit, që del se kjo punë është bërë të enjten më 21 janar pas orës 14.00. Kjo do të thotë se në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla kam mbërri 3 ditë e 16 orë pas Atentatit. Gjatë tërë kësaj kohe unë nuk kam pasur asnjë ide si janë sjellur rrethanat e çka ka ndodhur para dhe pas atentatit. Gjatë këtyre tri ditëve e 16 orëve, tërë kohën është biseduar e analizuar se kush mund ta ketë ndihmuar UDB-në. Të gjitha dyshimet që kanë qenë kundër Ibrahim Kelmendit, nuk i kam gjetur në ajër, në gjendje të gaztë, as në gjendje të lëngët. Të gjitha këto dyshime, duke u bazuar edhe në sjelljet e Ibrahim Kelmendit, që kanë qarkulluar gjatë tri ditëve e 16 orëve, i kam gjetur të kristalizuara. Në mesin e atyre që ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin, në radhë të parë ka qenë Nuhi Sylejmani. Por jo vetëm ai. Çka është më së interesanti, nuk ka ekzistua asnjë shokë i Jusufit që nuk ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin. Këtyre dyshimeve, në dashtë le të quhet dobësi, në dashtë le të quhet naivitet e papjekuri, në dashtë le të quhet mençuri, iu kam bashkua edhe unë. Këto dyshime kurrë nuk i janë shprehur policisë, pasi ajo e ka ditur punën e vetë. Këto dyshime në sy i janë thënë Ibrahim Kelmendit, nga ne, para të gjithë neve duke e përfshi edhe Osman Osmanin, para se Suzana, përmes nipit të vet Haxhi Berisha ta përjashtoi nga shtëpia, 40 ditë pas ditës së varrimit, rreth 15 marsit 1982.

Me kalimin e viteve kam menduar ndonjëherë se mos i kemi hy në hak Ibrahim Kelmendit. Por të gjitha dilemat në këtë pikë janë zhdukur në janar e shkurt 2007. Ibrahim Kelmendi, jo në formë artistike por në atë dokumentare në gazeta të ilustruara me fotografinë e tij, me tituj të mëdhenj ka deklaruar: "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës". Pa hyrë në analizën e kuzhinierisë së librit Atentatet, dhe deklaratave dokumentare në gazeta e revista, me veprën e vet, Ibrahim Kelmendi, të gjithë atyre që kanë dyshuar në te se ka njohuri për Atentatin e 17 janarit 1982 u ka thënë: Keni pasur të drejtë pasi - "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës."

3. Kush është I.K. (Ikaja)? - Derisa po çuditesha u çuditë ai me mua!

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Skënder Skënderi, duke e parë se unë nuk e kisha „vërejtur" situatën, nuk i kisha „zbuluar" tradhtarët në mesin tonë, nuk po i kuptoja „rrotullat" që luheshin përreth dhe nuk kisha vënë dyshimin mbi askënd, hapur më tha: „**Kemi informata se në këtë vrasje të trefishtë kanë gisht vetëm dy veta, e këta janë: Bulja dhe Ikaja!"***

***Derisa po çuditesha** nga ato që po i dëgjoja, e pyeta se kush ishte Ikaja! **I çuditur me mua** që nuk e dija se kush ishte Ikaja, më tha me zë paksa të ulët: Ibrahim Kelmendi. Pasi e kundërshtova në mendimet e tij të krisura, i thashë se këto janë mendime të tij personale, dhe se do të bënte mirë t'i shikonte punët e veta!* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.89-90)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Ibrahim Kelmendi: "*Vasili kishte një makinë tepër të vjetër. ... U nisën për qytezën e Sindelfingen–it, vendlindjen e "Mercedesit", pasi i futën ekzemplarët e Bashkimit në makinë. Gjatë rrugës Vasili i shpjegonte Miranit se në fabrikën e Mercedesit në Siendelfingen punonin qindra bashkatdhetarë, banoin në hajme, që ngjanin me konviktet e studentëve në Prishtinë, të ndërtuara në oborr të fabrikës enkas për punëtorë të huaj, të cilët nuk i kanë familjet me vete.*

Kur po i afroheshin Siendelfingen–it, qytezë në periferi të Shtutgartit, Vasili i propozoi Miranit që të shkonte në konvikte për të shpërndarë Bashkimin, meqë atë e njihnin disa bashkatdhetarë. Ai i tregoi disa numra të dhomave dhe disa emra, duke sqaruar se ndonjëri nga ata do t'ia tregojë edhe dhomat e të tjerëve. Për sa kohë që Mirani do të shpërndante gazetën, Vasili do të priste në parking.

*Gjatë shpërndarjes, **ndoshta në dhomën 205**, Mirani hasi në një qeros biond, sykaltër. Sy me maje iu dukën atij. Edhe pse ishin shumë veta, siç praktikonin shpesh të shkonin të njëri-tjetri, **Nuriu**, të cilit Mirani ia vuri nofkën "qeros", e mirëpriti gazetën...*

*Nuriu e mori Miranin në përqafim, e shtrëngoi aq shumë sa gati ia zuri frymën, si të qenë shumë të dashur që s'ishin parë prej kohësh. I ofroi një karrige për t'u ulur. Nuriu nuk po pushonte së foluri. U prezantua me emrin **Nuri Syleviqi**, nga rrethi i Kumanovës. Pothuajse në formë urdhërese, kërkoi që herave të tjera t'ia jepnin atij gazetën për ta shpërndarë. Po në mënyrë pompoze u interesua për t'u anëtarësuar në Organizatën ilegale – Fronit i Kuq Popullor, meqë gazetën Bashkimi e botonte kjo organizatë. Aty për aty ia zgjati Miranit një letërzë, të cilën sapo e grisi nga blloku që nxori prej xhepit, shënoi të gjitha të dhënat e tij personale, dhe tha:*

– Ju lutem, më bëni librezën e anëtarësisë.

– Nuk e di kush e bën këtë punë,– u përgjigj Mirani duke refuzuar copëletrën dhe duke sqaruar se gazeta atij i kishte shkuar me postë, pa adresë të dërguesit." (Atentatet, f. 31-32)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Ibrahim Kelmendi*: "Kësaj radhe po ju dërgoj 50 "BASHKIMA". I shpërndani. Gjithsesi duhet të shkoni në Mercedes, ke shokët atje, për t'u dhënë "BASHKIMAT" dhe për të biseduar për Shanton, por jo që të frigohen se u ndodh atyre si Shantos, por që t'u shtohet revolta edhe më. Nëse u duhen shokëve të* ***Mercedesit*** *më shumë, atëherë ma dërgoni adresën e njërit prej tyre. U thoni se* ***konviktet*** *e tyre duhet t'i furnizojnë ata vetë, dhe jo vetëm t'i dërgohet çdonjërit për vete, pse shpenzimet janë të mëdha. Këtë e bëjnë, kur dinë se në cilat dhoma banojnë bashkatdhetarët tanë dhe atëherë kur ata kanë ndërrimin e punës nën derë t'u shpërndahet "BASHKIMI"."* (Letër Faridin Tafallarit, 31 janar 1981;Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 409-410)

Një prej shokëve kryesor Mercedesit ka qenë Nuhi Sylejmani. Letra e Ibrahim Kelmendit tregon se ai (I.K.) i njeh mirë konviktet e Mercedesit, çka do të thotë se Nuhi Sylejmani e dinë shumë mirë se kush është I.K. (Ibrahim Kelmendi).

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Ibrahim Kelmendi: *"Edhe për të Mirani i rrëfeu kryehetuesit Mayer gjerësisht.*

– Përse nuk e thoni emrin e të dyshuarit nga takimi në Bernhausen, pavarësisht arsyetimit që bëtë. Atij nuk i bëni ndonjë padrejtësi të madhe, sepse ne do të hulumtojmë dhe, nëse del i pafajshëm, nuk do t'i ndodhë asgjë. Kështu ju kontribuoni në zbulim të dorasëve dhe njerëzve të prapavijës, që i kanë ndihmuar ata për të bërë këtë krim.

– Atëherë, ai është ***Nuri Syleviqi (Nuhi Sylejmani****-shën i Xh. D.). Ia patëm vënë nofkën Qerosi, meqë është pa flokë. Banon në Sindelfingen.*

– Mbi ç'bazë dyshoni në Nuriun?

– Që kur e kam njohur, besoj në tetor të viti 1978*, më është dukur i dyshimtë, fillimisht në bazë të intuitës, pastaj të sjelljeve."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 333)

Ibrahim Kelmendi – sipas Shkollës së UDB-së Serbe, "një prijës, një intelektual, një udhëheqës i denjë i "Frontit të Kuq Popullor"" – dhe inicialet e tij **I. K.** kanë qenë të njohura për Nuhi Sylejmanin, sipas Ibrahim Kelmendit – prijësit, intelektualit e udhëheqësit të denjë, prej tetorit 1978, mbi tri vjet para se ai të njoftohet me mua. Unë për herë të parë, Ibrahim Kelmendin e kam takua më 21 janar 1982. Është gënjeshtër e shpifje skandaloze e kuzhinës së Shkollës së UDB-së se unë ua paskam mësua rrethit të Shtutgartit dhe Nuhi Sylejmanit, inicialet I. K. të Ibrahim Kelmendit.

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I.K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla*: "Me **I**. dhe H. kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin", t'i përpunoj materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit."(*Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30)

Domethënien e kësaj fjalie e kam shpjeguar në tërësi, në kapitullin "Shkolla e UDB-së kundër Jusuf Gërvallës". Në këtë rast qëllimi im është vetëm e vetëm të tregoj se Shkolla e UDB-së Serbe i ka shumë të qarta inicialet (I. K.) të emrit Ibrahim Kelmendi. Pra Shkolla e ka shumë të qartë në këtë rast se kush mendohet me shkronjën I., që Jusufi e përdorë në letrën e tij dërguar Nuhi Sylejmanit në janar 1981. Dhe Nuhiu nuk i shpreh kurrfarë **çudie** Jusufit se kush mendohet me germën I. Këtë adetin e **çuditjes** Nuhiu e ka përpunuar shumë më vonë në këshillime me Shkollën e UDB-së.

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla: *"Nëpër të ashtuquajtura klube kosovare në mërgim, që ishin dhe shumica vazhdojnë të jenë çerdhe agjenturore të përfaqësive diplomatike jugosllave në Perëndim****, I. K****. është ekspozuar në masën më të madhe të mundshme edhe para përfaqësuesve diplomatikë jugosllavë."* (Raport, korrik 1981)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla: "*Pasoja pozitive ka qenë inkurajimi i punëtorëve kosovarë, pasoja negative - dëmtimi i disa punëtorëve që kanë marrë pjesë në klubet ku është paraqitur **I. K**. Këta punëtorë ndodhen në burgje jugosllave."* (Raport, korrik 1981)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla: "*Por, doli ndryshe. Doli se **I. K**. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një program dhe statut të një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare“ menjëherë pas „korrigjimeve“ që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s'ishte punë korrigjimi."* (Raport, korrik 1981)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla: *"Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me **I. K.,** i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"."* (Raport, korrik 1981)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (I. K.) Ikaja?

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të **I. K**., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella."* (Raport, korrik 1981)

Shkolla e UDB-së Serbe: Kush është (**I. K.) Ikaja?**

Jusuf Gërvalla: *"Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me **I. K.** Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme.*" (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

Edhe në këtë rast shihet përdorimi i inicialeve **I. K**. duke menduar në Ibrahim Kelmendin, dhe as Shkolla e UDB-së e as Nuhi Sylejmani nuk kanë shprehur ndonjë **çudi** ndaj Jusufit rreth asaj se kush mund të jetë I. K. (Ikaja)?

Pra siç dokumentohet, teatralizmin e çuditjes kur ndeshet para inicialeve **I. K.,** Nuhi Sylejmani e ka ushtruar në bazë të regjisë së Shkollës së UDB-së Serbe të Abdullah Prapashticës. Faktet e parashtruara vërtetojnë gënjeshtrën që përmban çdo fjalë e Shkollës së UDB-së Serbe të cituar më lartë.

Të shohim se çka kanë thënë më 11 korrik 1982, në mbledhjen e Komitetit "Vëllezërit Gërvalla" (KVG), Nuhi Sylejmani dhe Osman Osmani.

Nuhi Sylejmani: *"Pritja ka mund me qenë më e mirë, por ngjarje të tilla të befasishme s'kemi mund ndryshe. Nuk është i kënaqur. Pritja ka qenë formale. Nuk kemi diskutue në mes veti. Ditën e varrimit nuk dilnin njerëzit prej dhome. Ka shkua si në diktaturë. Videofilmimin e varrimit është dashur ta bëjë një profesionist ashtu siç thotë Naim Haradinaj. Formimi i KVG i mirë por është dashur më parë të formohen celulat e pastaj komiteti dhe jo anasjelltas. S'kemi pasur asnjë shokë afër veti. Organizimi i brendshëm jo i mirë. Dekonspirimin e dënon dhe e quan krim të madh.*
*Veprime me gjaknxehtësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë I. K. (Ibrahim Kelmendit - shën i Xh. D.) fakte për sulm **megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.***
Udhëtimi i Suzanës në Shqipëri mirë, megjithëse nuk jemi marrë vesh në mes veti."

Fjala e Osman Osmanit ka të bëjë vetëm me kohën pas 22 shkurtit 1982.

Osman Osmani-Halimi*: "Formimi i KVG i domosdoshëm (ky ia fillon nga kjo ngjarje pasi më parë nuk ka qenë këtu). Puna ka vazhdua por ka pasur dobësi. Për shkak të mospërvojës mund të kemi bërë gabime, por largimi i tij (Ibrahim Kelmendit -*

shën i Xh. D.) nga familja i mirë për të mos thënë i domosdoshëm. ***Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha."*** (Nga procesverbali i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla, 11 korrik 1982)

Një nga punët më të ndershme dhe të drejta e strategjike është pikërisht ajo pse Ibrahim Kelmendit ia kemi thënë të gjitha. Pse?

Sepse, pa hyrë në analizën e kuzhinierisë së librit Atentatet, dhe deklaratave dokumentare në gazeta e revista, me veprën e vet, Ibrahim Kelmendi, të gjithë atyre që kanë dyshuar në te se ka njohuri për Atentatin e 17 janarit 1982 u ka thënë: Keni pasur të drejtë pasi - "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës."

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë rrjedh se citati:

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Skënder Skënderi, duke e parë se unë nuk e kisha „vërejtur" situatën, nuk i kisha „zbuluar" tradhtarët në mesin tonë, nuk po i kuptoja „rrotullat" që luheshin përreth dhe nuk kisha vënë dyshimin mbi askënd, hapur më tha: „**Kemi informata se në këtë vrasje të trefishtë kanë gisht vetëm dy veta, e këta janë: Bulja dhe Ikaja!"*

Derisa po çuditesha *nga ato që po i dëgjoja, e pyeta se kush ishte Ikaja!* ***I çuditur me mua*** *që nuk e dija se kush ishte Ikaja, më tha me zë paksa të ulët: Ibrahim Kelmendi. Pasi e kundërshtova në mendimet e tij të krisura, i thashë se këto janë mendime të tij personale, dhe se do të bënte mirë t'i shikonte punët e veta!* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.89-90)

është produkt i fantazisë së Shkollës së UDB-së Serbe dhe asgjë tjetër.

4. *KUSH E VRAU JUSUF GËRVALLËN?*

Këtu, më poshtë, dua t'ua përkujtoj të gjithëve se kam qenë i vetmi që qysh në shkurt 1982, me shkrim jam deklaruar për vrasjen e Jusuf Gërvallës. Këtë deklarim kaq të qartë nuk e ka bërë asnjë tjetër. Këto fjalë që i kam thënë atëherë i kam thënë seriozisht, dhe me po atë seriozitet i përsëris tani. Edhe sikur të kishte ekzistua mundësia me bërë ndonjë ndreqje, këtyre fjalëve më poshtë nuk do t'i shtoja e as nuk do t'i heqja në përmbajtjen thelbësore, asgjë.

Xhafer Durmishi*: "Konzullata jugosllave në Shtutgart na e ka borxh gjakun e të treve*

"....UDB-a Jugosllave na vrau...!" Ishin këto fjalët e fundit që i tha Jusuf Gërvalla para se të pushonte jeta e tij.

Vrasjet e trishtueshme të UBD - së Jugosllave të 17 janarit 1982, kur vrasësit e paguar e profesional i vranë Vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën në një fshat gjerman, pranë Shtutgartit do të mbesin përherë të freskëta e të pa harruara te ne punëtorët e Kosovës që punojmë në RF të Gjermanisë. Para syve tanë kemi gjakun e vëllezërve tanë, kemi lotët e grave dhe vajin dhe thirrjet e fëmijëve të tyre,..."zgjohu babë!" Parasysh kemi Nanën e vëllezërve Gërvalla duke i puthë dëshmorët në ballë, përpara e kemi babën e Kadriut, atë burrë krenar. Gjithnjë i kemi parasysh të gjithë ata prindër e familje të gjithë atyre dëshmorëve të popullit të Kosovës që u vranë nga fillimi i demonstratave 1981 e gjer më sot.

Larg Kosovës gjendemi por mirë i ndiejmë zinxhirët e tankeve dhe zhurmën e aeroplanëve e helikopterëve që fishkëllojnë mbi djepat e Kosovës, i shohim prangat në duart e disa dhjetëra mijëra të burgosurve. Por neve punëtorëve kosovarë na djeg për së afërmi kjo vrasje këtu në mes të Evropës, në mes të Gjermanisë, pranë nesh. Dhe mendojmë si t'ia bëjmë?! E dimë ne fare mirë se çfarë duhet bërë dhe me atë me siguri nuk do të vonojmë shumë, por shqiptari e ndjek rendin sipas rregullit e traditës. E kemi shprehi të flasim me vepra e fjalë por kemi borxh ndaj mikpritësit pasi këtë krim e

përjetuam në vendin e tyre, prandaj po i presim si po na përgjigjen. Administrata dhe organet shtetërore të RF të Gjermanisë i din fare mirë të gjitha veprimet terroriste të Jugosllavisë në Kosovë, por e din edhe atë se terrori i UDB-së jugosllave i ka kaluar shumë herë kufijtë e RSFJ, se ajo i ka vra më tepër se 80 qytetarë të RSFJ vetëm në Gjermani, e në mesin e tyre edhe këta TRE.

Që nga koha e vrasjes e deri më sot organet hetuese gjermane nuk na komunikuan asnjë lajm për masat e ndërmarra as ndaj vrasësve direkt as ndaj Konzullatës Jugosllave në Shtutgart e as ndaj qeverisë së Beogradit e cila është organizatore dhe zbatuese e këtyre krimeve në territorin e RF të Gjermanisë. Përkundrazi u dëgjuan edhe disa dilema të përgatitura nga Beogradi, mbi "mundësinë e qërimit të hesapeve të brendshme" etj. JO!

Jusuf Gërvalla nuk la dilema. Ai i pa dhe e diti se ishin njerëzit e UDB-së ata të cilët kryen atentat mbi te. Andaj për dilema nuk ka aspak vend.

E qartë është se para së gjithash Konzullata Jugosllave e Shtutgartit është zbatuese e këtij krimi. Është e pamundur që ne si punëtor të bëjmë zbulime të thella. Ne e dimë se kush na i ka drejtua plumbat. Ne nuk do të caktojmë njerëz me detyra për veprim, por cili arrin i pari dhe cili e ka hallall gjakun e qumështin e Nënës shqiptare i din detyrat e veta. Megjithatë edhe një kohë do të presim fjalën e organeve të shtetit Gjerman dhe sigurisht do të dëgjojmë mendimin e popullit dhe të Lëvizjes së tij për Republikë. 25 shkurt 1982

Ky tekst i shkruar nga Xhafer Durmishi në atë kohë, 20 ditë pas varrimit u nënshkrua: "Punëtorët kosovarë në regjionin e Shtutgartit" dhe u shpërnda në formë trakti nëpër qytete të ndryshme të Evropës." (www.pashtriku.org, Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, f. 362-363)

5. Dyshimi në Bulen më tronditi

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Dyshimi në Bulen më tronditi. Ajo ishte një grua intelektuale. Rridhte nga një familje me tradita. Brez pas brezi ishin vrarë me serbë. Ishin të ndjekur dhe të persekutuar nga pushteti jugosllav, por të pathyeshëm. Që nga dita kur kishte ardhur në familjen Gërvalla, kishte rënë në nivelin e anëtarit të familjes. ...Për çdo gjë konsultohej paraprakisht me Suzanën, me Ibrahimin, apo me Skënderin, pa e ditur se për çfarë po e akuzonte ky i fundit! Ishte e sinqertë, e urtë, e dashur dhe punëtore... Vallë, mbi ç'prova e mbështeste Skënder Skënderi dyshimin e tij kundër saj?!!!" (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.90)

Askush prej shokëve të Jusufit nuk ka shfaqur dyshime ndaj gruas së Kadri Zekës. Këto shpifje, para Shkollës së UDB-së Serbe i ka sajuar Ibrahim Kelmendi për ta larguar vëmendjen nga vetja. Këto fjalë për interesa tjera riprodhohen nga ish inspektori i UDB-së serbe Abdullah Prapashtica përmes Nuhi Sylejmanit.

Saime Isufi nuk është konsultuar për asgjë sepse nuk ka pasur nevojë me u konsultuar. Sikur të kishte dashur me u konsultuar ia kisha dhënë numrin e Sabri Novosellës, e i kisha thënë ato fjalë çka ia ka thënë Jusufi burrit të saj: Urdhno e merru vesh me te.

Ja si i përshkruan Nuhi Sylejmani ngjarjet më 11 korrik 1982, në mbledhjen e Komitetit Vëllezërit Gërvalla (KVG).

Nuhi Sylejmani: "*Pritja ka mund me qenë më e mirë, por ngjarje të tilla të befasishme s'kemi mund ndryshe. Nuk është i kënaqur. Pritja ka qenë formale. Nuk kemi diskutue në mes veti. Ditën e varrimit nuk dilnin njerëzit prej dhome. Ka shkua si në diktaturë. Videofilmimin e varrimit është dashur ta bëjë një profesionist ashtu siç thotë Naim Haradinaj. Formimi i KVG i mirë por është dashur më parë të formohen*

celulat e pastaj komiteti dhe jo anasjelltas. S'kemi pasur asnjë shokë afër veti. Organizimi i brendshëm jo i mirë. Dekonspirimin e dënon dhe e quan krim të madh.
Veprime me gjaknxehtësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë I. K. (Ibrahim Kelmendit - shën i Xh. D.) fakte për sulm megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.
Udhëtimi i Suzanës në Shqipëri mirë, megjithëse nuk jemi marrë vesh në mes veti." (Nga procesverbali i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla, 11 korrik 1982)

6. Shefi i tanishëm i familjes Gërvalla

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Përnjëherësh e ndërroi temën e bisedës, duke më pyetur se a njihesha me Mërgimin (duke e cilësuar si shefin tonë) dhe me Xhafer Durmishin. I thashë se nuk njihesha me Mërgimin, kurse për Xhafer Durmishin as që kisha dëgjuar ndonjëherë për ndonjë emër të tillë. Atëherë, paksa i çuditur më pyeti se a njihesha për së afërmi me „zëvendësin" e Jusufit, pra me* ***shefin e tanishëm të familjes Gërvalla****, Skënder Skënderin. E pranova se njihesha me Skënderin, duke e vrarë mendjen se ç'lidhje kishte ai me atë farë Xhafer Durmishin? Atëherë, me zë paksa të qetë, zoti Gynter më tha se Skënder Skënderi është Xhafer Durmishi... „****Shkurt, ne kemi dyshime në këtë njeri, prandaj mendimi i juaj do të ndihmojë shumë në procesin e hetimeve!" Tepër u çudita kur e mësova emrin e vërtetë të Skënder Skënderit****. Për herë të parë po e dëgjoja! Por, tepër i zhgënjyer edhe me hetuesinë gjermane për dyshimet që iu ngarkoheshin vetëm shokëve tanë, troç ia thashë Gynter Meierit se nuk isha në një mendje me të.* ***„Unë nuk dyshoj në shokët e mi!"*** *– i thashë shkurt!* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.121)

Shprehjen *shefin e tanishëm të familjes Gërvalla,* Shkolla e UDB-së, si në disa vjedhje tjera, e ka marrë ashtu siç i ka hije, nga shoku i mirë i Sadik Blakajt, Ibrahim Kelmendi.

Ibrahim Kelmendi: "*Nuriu (Nuhi Sylejmani - shën i Xh. D.) po vështronte vëngër e me hatërmbetje se përse nuk po ia dorëzonte Hajzeri atij ndihmat financiare, meqë ai tashmë* ***kishte uzurpuar plotësisht rrolin e bosit***." (Atentatet, faqe 352)

Më 18 janar policia gjermane i ka marrë letrat e Jusufit dhe gjithashtu makinën e shtypit "IBM Electronic Selectric Composer". Derën e dhomës së punës së Jusufit e kam gjetë të blombuar kur jam kthyer nga Kosova, më 21 janar. Pas disa ditësh ka ardhur policia me një përkthyes gjerman për të marrë dokumente tjera për nevojat e hetimeve. Para se me e çelë derën, ata i kanë tregua Suzanës pse kanë ardhur, dhe kanë kërkuar nga ajo, që ajo vetë apo ndonjë i besueshëm i saj t'i shoqëroj në dhomën e punës dhe të jetë dëshmitarë se çfarë dokumentesh po merren. Suzana më ka thënë që të shkoj me ta në dhomë dhe të shoh se çka po merret. Asnjë nuk kemi pasur leje qëndrimi, si pasojë e principeve të Jusufit. Mua ma kanë kërkuar pasaportën. Vulat e DDR-it në pasaportën time, nuk iu ka ardhë mirë kur i kanë pa dhe ma kanë mbajtur pasaportën nja gjysmë ore e pastaj ma kanë kthye. Nëse gjatë hetimeve kanë pyetur të tjerë për emrin tim të vërtetë nuk ka asgjë për t'u çuditur megjithëse shkolla e UDB-së mundohet me e paraqit këtë si një sensacion të jashtëzakonshëm. Unë nuk kam pasur nevojë me i tregue Nuhi Sylejmanit emrin e vërtetë pasi ai nuk ka pasur nevojë për te. Ia di për nder që më paska pastruar prej dyshimeve, por e vërteta është se as ai dhe askush tjetër, para syve të policisë gjermane nuk ka mund me më pastruar prej dyshimeve, çka do të thotë automatikisht se nuk kanë pasur as kapacitet me më njollosë edhe sikur ta kishin marrë këtë porosi nga të shkolluarit e UDB-së serbe.

Për mua unë kam qenë krejtësisht i panjohur. Se policia gjermane mund t'i ketë tregua Nuhiut emrin tim mund të jetë shumë gënjeshtër, megjithëse parimisht ata nuk kanë qenë të paguar e të zotuar me i mbajtur të fshehta pseudonimet tona.

7. Zoti Gynter nuk më la të çuditesha!

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Zoti Gynter nuk më la shumë të çuditesha.* *Hapur më tha se 'vrasjen e shokëve tuaj e kanë ndihmuar Ibrahim Kelmendi dhe Saime Jusufi, prandaj do të ishte mirë ta nënshkruash protokollin, se edhe ti je në një mendje me ne dhe ke dyshime të bazuara mbi këta persona'. Për një çast u trondita. Në mendje m'u shfaqën fjalët e shokut Skënder Skënderi, kur më kishte thënë hapur se fajtorët kryesorë për vrasjen e tre dëshmorëve janë Ikaja dhe Bulja! Do të thotë se zoti Gynter vetëm po i përsëritë dyshimet e „kryesorit" tonë të vetëshpallur! Në shenjë revolte, në vend se t'i përgjigjem i thashë ta shkruante pa hezitim edhe emrin tim pranë të dyshuarëve të tyre, sepse „nëse ata janë ndihmës në vrasje, padyshim se unë duhet të jem vrasësi?!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.122)

Për herë të parë Nuhi Sylejmani deklaron se policia i ka thënë se ata dyshojnë në Ibrahim Kelmendin e Saime Isufin. Nëse policia i ka thënë këtu, kjo është çështje e policisë. Mua nuk më kanë thënë kurrë se dyshojnë në këtë apo atë, dhe nuk më kanë lyp mendim, dhe nuk kam bërë asnjë bisedë me ta lidhur me hetimet.

Deklarimi se policia gjermane ka tentuar me e marrë nënshkrimin e Nuhi Sylejmanit si argument për dyshimet e tyre është i denjë vetëm për UDB-në "komuniste" dhe nxënësit e saj "komunist" që i kanë kryer shkollat në bankat e saj. Nxënësit e UDB-së duhet ta dinë se i gjithë procesi hetimor është i shkruar nga policia, ruhet sot, dhe një kopje e këtyre hetimeve të plota gjendet në pronësinë e familjes së Jusufit.

8. Suzana i tha se më së miri do ta mbronte një avokat

Shkolla e UDB-së Serbe: "*Ishte pasdite. Posa u ktheva nga qyteti, më thanë se policia e kishte shoqëruar Saimen në komisariat. U shqetësova pa masë për të. Ishin akuzat e sajuara kundër saj nga Xhafer Durmishi dhe hetuesi Gynter, që më bënë të shqetësohesha. Nuk më zinte vendi vend derisa prisja të kthehej. Biseda nuk shkonte. Ibrahim Kelmendi dukej indiferent, kurse Xhaferi sikur po i kënaqej vonesës së saj. Ndërkohë, ra zilja. Para nesh u shfaq Saimja. Ishte tepër e shqetësuar. Me zë të përvajshëm na tha se po e akuzonin rëndë! E hodha vështrimin nga Xhafer Durmishi. I ndritnin sytë.* ***Suzana përpiqej ta qetësonte, duke i thënë se më së miri do ta mbronte një avokat****. Ndërhyri Xhaferi me një zë kërcënues, duke i thënë se vetëm avokati është ai që të ndihmon ty... askush tjetër! Pas këtyre fjalëve, shqetësimet e saj sikur rriteshin. Dukej edhe më e trembur. Ndërhyra unë, duke i thënë se ti nuk ke nevojë të shqetësohesh. Ti je e pastër. Ti nuk ke bërë asgjë, asnjë faj, asnjë krim... kot të akuzojnë! Prandaj, e drejta është në anën tënde dhe ajo të mbron ty më së miri. E sa për avokat, nuk ke fare nevojë për të. Është e kundërta e asaj që po të preferon shoku ynë i çmuar, se gjoja vetëm avokati të ndihmon. Jo! Angazhimi i avokatit do të thotë pranim faji! „Mua më mbron e drejta" – tha në fund Saimja." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.123)*

Nuk i kam thënë se vetëm avokati është ai që të ndihmon ty, as nuk iu kam bërë vetë avokat dhe as nuk i kam propozua ndonjë avokat, duke përfshi këtu edhe avokatët e kalibrit të Ibrahim Kelmendit e Nuhi Sylejmanit, Abdullah Prapashticës e Osman Osmanit dhe as nuk dua me u deklarua se sa e lavdishme është rrethana kur ke avokat të këtyre karaktereve.

9. Ujku e shikon Luanin e inferioriteteve vandale si prenë e tij

Shkolla e UDB-së Serbe: *"U krijua një atmosferë e tendosur. Herë pas herë Xhaferi më shikonte egër si ujku prenë dhe gati me ngërdhucje dhëmbësh! Kjo situatë e padurueshme sikur* ***po m'i rriste prore shqetësimet...***

*Së bashku me Suzanën vendosëm që Saimes t'ia japim një sasi të hollash. Në praninë e Suzanës ia dhashë 1.000 marka dhe 530 franga zvicërane. Me propozimin e Suzanës i përgatitëm edhe 30 copë fotografi në kornizë, të tre dëshmorëve. Nuk i mori të gjitha. E përcollëm deri te vetura, duke i uruar rrugë të mbarë." (*Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.123)

Nuk ekziston asnjë fakti deri më sot se një ujk mund ta ketë shikuar me ngërdhucje dhëmbësh një luan. Shkolla e UDB-së ia ka dhënë Nuhi Sylejmanit pseudonimin *Luan,* vetëm e vetëm që ai të mos bien pre e ujqve. Duke u marrë me ujq, *Luani* Nuhi Sylejmani, me inferioritetin e tij vandal, ka ra pre e Shkollës së UDB-së Serbe.

10. Na befasoi dhe krijoi të çara në mesin e familjeve të dëshmorëve

Për raportin tim me familjet e Vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla nga 21 janari deri më 28 mars 1982 kam folur në disa punime tjera në faqen www.pashtriku.org.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës" i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave,* ***krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve****, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Përkundër faktit se Nuhi Sylejmani, sipas Shkollës së UDB-së, para 21 janar 1982 më paska takuar vetëm njëherë, thotë se influenca ime në shtëpinë e Jusufit paska qenë aq dominuese sa Suzana e paska harruar apo nuk paska qenë fare në dijeni për asnjë detaj të veprimtarisë së Jusufit e Bardhit, i cili mund të ketë qenë vendimtar për qëndrimet e saja nga 18 janari e deri më 28 mars 1982. Në këtë pikë taktika për ta paraqitur Suzanën krejtësisht të painformuar është e njëjtë me të Ibrahim Kelmendit. Por këtu edhe përfundojnë ngjashmëritë në mes shokut të Sadik Blakajt dhe inspektorit "komunist" të UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica, sepse nga shqyrtimi na del se përderisa Jusufi e lenë Suzanën krejtësisht të painformuar, inspektori 'komunist' i UDB-së Serbe, gruan e tij e ka bërë Kryetare të Organizatës së grave "Komuniste" në Partinë e tij.

Lidhur me atë se çfarë ndikimi e çfarë influence mund të kem pasur në familjen e gjerë Gërvalla, apo vetëm tek familja e ngushtë e Jusufit, prej 21 janarit deri më 28 marsi 1982 dhe prej 28 marsi 1982 deri më sot, flasin faktet e mëposhtme.

Hysen Gërvalla: "*Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive.*

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka theksuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut.

Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as

individë." (Letër e hapur - Tri grupeve, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së, 12 korrik 1985)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës" i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave,* ***krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve****, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Xhafer Durmishi: "*Nga ti, Hysen Gërvalla e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur.*

Ne e dimë se jeni vëllau i madh i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të merremi vesh në të gjitha pikat." (Përgjigje Hysen Gërvallës, 22 korrik 1985)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës" i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave,* ***krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve****, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Emrush Xhemaili: "*1985: Hysen Gërvalla kooptohet në Komitetin Qendror të LPRK-së."* (20 vjet veprimtari 1982-2002)

Faridin Tafallari: "*Fjalën e mori Plaku (Hasan Mala - shën i Xh. D.), që shprehu gëzimin se puna jonë po vlerësohej edhe nga vëllezërit tanë të Shqipërisë. "Ne Bacë - tha ai - duke ju drejtuar Hysenit (Gërvallës - shën i Xh. D.) - jemi me ty dhe ti na ke mbrapa me gjithë këta shokë dhe na prij ashtu siç është më mirë, se rrugë tjetër nuk kemi; vetëm me unitet të çeliktë mund të ecim përpara."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 97)

Fjalët e mësipërme të Faridinit kanë të bëjnë me vjeshtën 1985.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës" i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave,* ***krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve****, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Faridin Tafallari: "*Sot më 16 janar (1986-shën i Xh. D.) Baci (Hysen Gërvalla-shën i Xh. D.) më telefoni dhe më tha se po ndahej politikisht me ne. Ky ishte shkaku pse nuk pranoi të dilte në protestën dhe në marshimin përkujtimor të katërvjetorit të rënies së shokëve. "****Unë nuk shkoj pas Hasan Malës e të tjerëve. Me shokët e mi do të dalë nesër më 17 janar.****""* (faqe 105)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës" i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave,* ***krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve****, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Faridin Tafallari: "*Më 21 shtator (1987 -shën i Xh. D) në mbrëmje vonë u ktheva nga Zvicra. Isha në vizitë te Hysen Gërvalla; vizitën e bëra më shumë për Suzanën që kishte ardhur nga Shqipëria. ... Baci (Hysen Gërvalla - shën im) vazhdonte me akuza të ulëta kundër Hasan Malës dhe të tjerëve. ... I thash edhe Suzanës që të shkonte te Hasan Mala. Por edhe ajo nuk kishte fjalë të mira për ata që merreshin nëpër gojë. ... Mbeta vetëm me Hysen Gërvallën, i cili m'u drejtua kështu: "Unë e* ***demaskova Xhafer Durmishin, Ibrahim Kelmendin*** *se ashtu e bënë punën..."* (faqe 114-116)

Sabri Hamiti: "*ZANA (Suzana Gërvalla shën i Xh. D.),* pa përfillje*. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun*

*e Gjergjin. **Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij.**"* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 83-84)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, **krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve**, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Sabri Hamiti: "*ZANA (Suzana Gërvalla - shën i Xh. D.), me mëdyshje. (për Saime Isufin - shën i Xh. D.) S'e kam takuar kurrë. As në shtëpi nuk më ka qenë. Jemi ndarë jo mirë, në kohën kur po mirreshim me varrimin. Ishte fort luftarake, s'donte të ndiente për dhimbjen, apo luante ashtu. Shtronte kërkesa bashkë me Keqën, por nuk bënte gjë prej gjëje. Tash kam mirëkuptim për të. Ka qenë tepër e re dhe e padijshme."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 94)

Hysen Gërvalla: *"Pasi dolën në Perëndim bënë përpjekjet e para për dialog kombëtar e njerëzor me "krerët" e OMLK-së dhe të grupimeve tjera që u përngjanin tufave të deleve, duke u përpjekur t'i ofrojnë mërgimtarët, t'i largojnë nga kursi ideologjik, në mënyrë që të viheshin të gjithë në binarë kombëtarë. Fatkeqësisht, gjithë këto përpjekje dështuan, sepse tufat e deleve që i kishte organizuar Enver Hoxha nëpër kruzhoqet partiake, ishin me tru të shpërlarë. Megjithatë, Jusufi e Bardhoshi nuk u ndalen. Dhe, deri në ditën kur u vranë nuk pushuan së insistuari për një pajtim të arsyeshëm e të qytetëruar....*

...Gjatë takimeve të LNÇKVSHJ-së (Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi, e udhëhequr nga Jusuf Gërvalla) me përfaqësues zyrtarë të Tiranës, doli hapur se diktatori Enver Hoxha nuk ishte i interesuar për forcimin e Lëvizjes Kombëtare, por për formimin dhe zgjerimin e organizatave komuniste në diasporë. Për këtë shkak dështojnë edhe bisedimet për bashkim në mes të Lëvizjes Kombëtare të Jusufit dhe OMLK-së se Hydajet Hysenit, që u mbajtën në Stamboll në tetor të vitit 1981." (Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, **krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve**, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Hysen GËRVALLA: "*Qëllimet majtiste tani janë të kthjellëta si loti: ose do të ketë shtet siç mendon tradhtia, ose mos të formohet fare shteti i Kosovës."* (Bota Sot, 12 mars 2003)

Sabri Hamiti: "*ZANA (Suzana Gërvalla shën i Xh. D.), pa përfillje. Nuk kam çka sugjeroj në mënyrë të veçantë. **Sa për miqtë e Isës, ai i ka pasur dy miqë të mirë, Nakun e Gjergjin**. **Ata mund t'ju flasin çka e vlen, për veprën e tij.**"* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 83-84)

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Paraqitja e beftë e Xhafer Durmishit si „zëvendës“ i Jusuf Gërvallës dhe rënia e tij pre e dezinformatave të fabrikuara jugosllave, **krijoi të çara jo vetëm në mesin e familjeve të dëshmorëve**, por edhe në mesin e mërgimtarëve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 158)*

Sabri Hamiti: "*ZANA (Suzana Gërvalla - shën i Xh. D.), me mëdyshje. (për Saime Isufin - shën i Xh. D.) S'e kam takuar kurrë. As në shtëpi nuk më ka qenë. Jemi ndarë jo mirë, në kohën kur po mirreshim me varrimin. Ishte fort luftarake, s'donte të ndiente për dhimbjen, apo luante ashtu. Shtronte kërkesa bashkë me Keqën, por nuk bënte gjë prej gjëje. Tash kam mirëkuptim për të. Ka qenë tepër e re dhe e padijshme."* (Misioni, Prishtinë 1997, faqe 94)

11. Dyshimet çorientuan mbarëvajtjen e hetimeve

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Dyshimet e tij të „bazuara“ se tradhtarët që e kishin ndihmuar vrasjen e tre heronjve ishin Saime Isufi, Ibrahim Kelmendi, Nuhi Sylejmani etj., kurse atentatorët ishin shqiptarë nga Peja, Deçani, Prishtina, Suhareka, Kamenica, Mitrovica…, krijuan huti në opinion dhe çorientuan mbarëvajtjen e hetimeve." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.158)*

Ish-UDBashi Abdullah Prapashtica, koka e dinastisë së falimentuar, bënë gabim katastrofal kur e krahason punën e policisë gjermane me punën e vet si UDBash i falimentuar i Serbisë. Sipas ish inspektorit të falimentuar të UDB-së unë paskna ra pre e dezinformatave të shokëve të tij UDBash, në mënyrë direkte, dhe për të qenë historia edhe më interesante përmes meje, pre e këtyre dezinformatave paska ra policia gjermane e shteti gjerman. Me këto përralla ish UDB-ashi Abdullah Prapashtica mundet me i vu në gjumë organizatën e pionierëve të vet, t'i ushqej ata me fajtor, se kush është fajtori e përçarësi i përrçës së dinastisë. Ish UDB-ashi Abdullah Prapashtica ka harruar se policia gjermane për këtë rast ka mbajtur hetime me shkrim, shkrime të cilat ekzistojnë, të cilat janë me mija faqe. Policia e UDB-a e Abdullah Prapashticës nuk ka qenë në gjendje ta zëvendësojë një njeri, dhe prej aty ka filluar dezintegrimi i UDB-së e i shtetit. Policia gjermane, policia e një prej popujve më vital në botë, është palca kurrizore e strukturës organizative të një kontinenti të tërë. Kjo polici dyshimet e veta i ka pasur në bazë të punës së vet dhe jo thashethemeve të fabrikuara nga UDBashët e vërtetë apo UDBashët e falimentuar. Unë nuk kam pasur kapacitet as me ngjall dyshime në askënd tek policia dhe as me e pastruar askënd prej dyshimeve, ashtu siç paska pasur mundësi Luani i dinastisë Prapashtica, Nuhi Sylejmani. Ia di për nder që më ka pastruar prej dyshimeve, por si edhe në të gjitha punët e kësaj vegle servile të ish udbashit Abdullah Prapashtica, katastrofa e tij ka qenë totale, pasi policia gjermane e ka ditur punën e vet.

Masha e Abdullah Prapashticës kurrë nuk ka pasur fuqi me më pastruar as mua dhe askënd tjetër para policisë gjermane dhe çka është kulmi i mrekullisë kjo mashë nuk ka pasur as aftësinë të mbjellë dyshime në mua dhe në askënd tjetër tek policia gjermane, tek pothuajse palca kurrizore e godinës së Unionit Evropian. Kjo polici për ndryshim nga udbashi i falimentuar ka marrë hapa vetëm e vetëm kur ka pasur fakte shumë të forta dhe faktet e veta në fazën e hetimeve nuk ia komunikua askujt e aq më pak atyre që në bazë të gënjeshtrave dhe etjes fatale për të qenë dikushi, i plotësojnë të gjitha parakushtet për të qenë informatorë potencial të UDB-së, për t'ua zënë vendin atyre "me të cilët kanë pasur bashkëpunim të barabartë." Pasi sipas logjikës së udbashit të falimentuar vendi i të vrarëve është dashur të zëvendësohet vetëm nga ai që ka pasur "bashkëpunim të barabartë me tre të vrarët" e ky bashkëpunëtor i barabartë nuk është askush tjetër pos Nuhi Sylejmani.

Nuk ekziston asnjë fakt se dikush prej shokëve të Jusufit ka shprehur dyshime në Saime Isufin. Nuk ekziston asnjë fakt se dikush ka shpreh dyshime në Nuhi Sylejmanin. Dyshimet kanë ekzistua vetëm e vetëm ndaj Ibrahim Kelmendit. Në mënyrë tejet perfide Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet, mundohet me i zhduk dyshimet që kanë ekzistuar kundër tij dhe i shkarkon mbi Saime Isufin, dhe ajo për arsye të veta i gëlltitë komplet ato që ia servon Ibrahim Kelmendi.

Atentati ka ndodhur pak pas orës 22.00 në mbrëmjen e 17 janarit. Në këtë kohë unë kam qenë në Kosovë. Në Untergruppenbach kam mbërri në çastet e para të shikimit të kufomave, kur i ka sjellur firma e varrimit kufomat për lamtumirën e fundit, që del se kjo punë është bërë të enjten më 21 janar pas orës 14.00. Kjo do të thotë se në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla kam mbërri 3 ditë e 16 orë pas Atentatit. Gjatë tërë kësaj kohe unë nuk kam pasur asnjë ide si janë sjellur rrethanat e çka ka ndodhur para dhe pas atentatit. Gjatë këtyre tri ditëve e 16 orëve, tërë kohën është biseduar e analizuar se kush mund ta ketë ndihmuar UDB-në. Të gjitha dyshimet që kanë qenë kundër Ibrahim Kelmendit, nuk i kam gjetur në ajër, në gjendje të gaztë, as në gjendje të lëngët. Të gjitha këto dyshime, duke u bazuar edhe në sjelljet e Ibrahim Kelmendit, që kanë qarkulluar gjatë tri ditëve e 16 orëve, i kam gjetur të kristalizuara. Në mesin e atyre që ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin, në radhë të parë ka qenë Nuhi Sylejmani. Por jo vetëm ai. Çka është më së interesanti, nuk ka ekzistua asnjë shokë i Jusufit që nuk ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin. Këtyre dyshimeve, në dashtë le të quhet dobësi, në dashtë le të quhet naivitet e papjekuri, në dashtë le të quhet mençuri, iu kam bashkua edhe unë. Këto dyshime kurrë nuk i janë shprehur policisë, pasi ajo e ka ditur punën e vetë. Këto dyshime në sy i janë thënë Ibrahim Kelmendit, nga ne, para të gjithë neve duke e përfshi edhe Osman Osmanin, para se Suzana, përmes nipit të vet Haxhi Berisha ta përjashtoi nga shtëpia, 40 ditë pas ditës së varrimit, rreth 15 marsit 1982.

Me kalimin e viteve kam menduar ndonjëherë se mos i kemi hy në hak Ibrahim Kelmendit. Por të gjitha dilemat në këtë pikë janë zhdukur në janar e shkurt 2007. Ibrahim Kelmendi, jo në formë artistike por në atë dokumentare në gazeta të ilustruara me fotografinë e tij, me tituj të mëdhenj ka deklaruar: "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës". Pa hyrë në analizën e kuzhinierisë së librit Atentatet, dhe deklaratave dokumentare në gazeta e revista, me veprën e vet Ibrahim Kelmendi, të gjithë atyre që kanë dyshuar në te se ka njohuri për Atentatin e 17 janarit 1982 u ka thënë: Keni pasur të drejtë pasi - "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës."

12. Nga dëshmitë e Xhafer Durmishit u arrestua Riza Salihu

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Policia gjermane filloi kërkimin e „vrasësve profesionistë“ në mesin e mërgimtarëve shqiptarë. I morën në pyetje të gjithë ata që në një mënyrë a në një tjetër kishin pasur kontakte me të vrarët, dhe në fund, nga „dëshmitë e verifikuara“ të Xhafer Durmishit dhe të Ibrahim Kelmendit, u arrestua Riza Salihu."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.158)

Ish-inspektori i UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica, duhet ta kuptoj se unë kurrë në jetë nuk e kam akuzuar Riza Salihun për vrasjen e Jusufit, pasi ky do të ishte nënçmimi më i madh për Jusufin. Pra këtë nuk e kam bërë për shkak të respektit ndaj Riza Salihut, shokut e bashkëpunëtorit të Abdullah Prapashticës, por vetëm e vetëm për hir të së vërtetës dhe respektit ndaj Jusufit. Por ish-inspektori i UDB-së Abdullah Prapashtica duhet ta dijë se Riza Salihu ka organizuar atentat në Jusufin e Bardhoshin gjatë vitit 1980. Nga ky atentat ka heq dorë Hysen Gega (ai i cili është nxitur ta kryej këtë punë) vetëm e vetëm pasi është takuar me Jusufin, dhe pa ndikimin e askujt tjetër. Hysen Gega ka hequr dorë nga kjo punë vetëm nën ndikimin e ndërgjegjes së vetë dhe nga takimet me Jusufin, të cilit ia ka treguar gjithë përgatitjen. Fakti se Riza Salihu nuk ka dorë në atentatin e 17 janarit 1982, dua t'ua përkujtoj shokut të tij Abdullah Prapashticës nuk do të thotë se populli duhet ta harroj ëndrrën vrastare të Riza Salihut, të cilën është përpjekur, por nuk ka mundur ta realizoi në muajt e parë të vitit 1980.

Hysen Gega: *"Kjo është e vërtetë, Riza Salihu thoshte dhe propagandonte se Jusufi është agjent i UDB-së. Pohimet e tij më shtynë që unë të bëja pyetje në ambasadën shqiptare në Vjenë se mos kishin ndonjë fakt për Jusufin. Aty atëherë ishte njëri që më duket se quhej Simon Qirici, sekretar i parë, ndërsa vetë ambasadori ishte farefis me Avni Rrustemin. Prej tyre mora garancinë se Jusufi është i pastër dhe se mund të bashkëpunonim lirisht e pa asnjë rezervë me të. Ata madje edhe na rekomandonin bashkëpunimin. .....*

.... Me t'u kthyer nga Vjena takova Riza Salihun dhe i thashë që të mos merrej me thashetheme, me akuza të rreme e me shpifje ndaj bacës Jusuf. I propozova që të shkonim së bashku në ambasadën shqiptare e të dëgjonte vetë se ç'thuhej aty për Jusuf Gërvallën. ... Në këtë rast ai nuk pranoi që të shkonim bashkë në Vjenë, me arsyetimin se po i dhembte syri, me gjithë ngulmimin tim se unë do të vozisja dhe ai vetëm do të rrinte i qetë. Megjithatë, edhe pas këtij episodi ai vazhdonte shpifjet e tij kundër Jusuf Gërvallës, duke shkuar aq larg sa në një rast më tha: "I vjen keq se s'ka kush e bën sepse ai madje e meriton edhe plumbin", duke nxjerrë me këtë rast edhe revolen e duke më thënë: "Ja merre këtë dhe vrite, sepse ai e meriton plumbin", propozim të cilin ia refuzova me fjalët: "Më mirë mbaje për vete, sepse mund të të duhet ndonjë ditë për të vrarë veten". (Kam refuzuar ta vras Jusuf Gërvallën, kosova-sot.info, 28 Mars 2012)

Cakiqi: "*E di se në vitin 1980, ky Riza Salihu ka pas pakënaqësi pse gazeta e Organizatës së Jusufit e ka po të njëjtin emër si "gazeta" e tij "Zëri i Kosovës"!! Jusufi është takua me këta Grupi Komunist "Zëri i Kosovës", që ishin Riza Salihu, Hysen Gega...*" (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 21:22)

Kelmendi: "*Në vitin 1980 Jusufi nuk kishte filluar me botim të "Zërit të Kosovës", por tek në Nëntor të vitit 1981, kur "Grupi komunist Zëri i Kosovës" nuk ekzistonte më. Rezili pat filluar fushatën kundër Jusufit, sapo Jusufi arriti në Gjermani. Gjithë kohën shpifte: "UDB-ja ka dërguar Jusuf Gërvallën" ... Pas dy-tre muajve Rezili, si Kryetar i "Grupit komunist Zëri i Kosovës", e ka urdhëruar Vasilin (që e kishte kooptuar Rezili për nënkryetar të këtij Grupi), për të bërë atentat ndaj Jusufit. 5-6 muajt e parë Jusufi dhe Rezili nuk janë takuar asnjëherë.* ***Takimi i parë i tyre ka qenë ballafaqimi për të gjykuar urdhrin për atentat.***" (www.kosova.de, Afishuar me: 23.03.2007 22:57)

Jusuf Gërvalla: *"Unë, që në fillim të Lëvizjes e kam pasë ditur se organ i Lëvizjes është "Zëri i Kosovës", se kjo shihet nga vetë Statuti. Dhe, me kënaqësinë më të madhe, në vend që të dilte "Lajmëtari i lirisë", kam mundur të bëja që të dilte "Zëri i Kosovës". Nuk e bëra për dy arsye. Së pari nuk isha i autorizuar nga Lëvizja. Së dyti, këtu kishte vepruar qysh më herët një i ashtuquajturi Grupi Komunist "Zëri i Kosovës",*

për punën e errët të të cilit me ndonjë rast tjetër mund të bëj para Lëvizjes ndonjë ***RAPORT*** *të gjerë. Tash për tash po theksoj se udhëheqësi i këtij grupi (Rizah Salihu, nga Mushtishti, një provokator ose njeri shumë naiv dhe i rrezikshëm), provoi të organizonte me shokë likuidimin tim dhe të vëllaut tim, duke na quajtur " të dërguar specialë të UDB-së ", pikërisht për arsyen* ***se i pata thënë*** *që "Zëri i Kosovës" është organ i LNÇKVSH, kurse ai e kishte marrë për emër të grupit të vet. Po për këtë arsye, para se t'i hymë botimit të këtij organi, duhet të marr nga Ti dhe Lëvizja edhe fjalën e fundit, sepse ka mundësi që titulli "Zëri i Kosovës" si organ i LNÇ, të përzihet në mendjen e naivëve me Grupin Komunist " Zëri i Kosovës".* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 114-115)

Südwestdeutsche Zeitung*: "Policia e kërkon jugosllavin Riza Salihu, i* ***cili në vitin 1980*** *kishte sjellë në pronësinë e tij postën e bashkatdhetarëve të tij dhe kundër së cilit ekziston edhe fletarresti edhe për delikte tjera."* (30 janar 1982; Marrë nga Xhafer Leci e Kadri Mani, U vranë tre emigrantë jugosllavë, www.zemrashqiptare.net, 17 janar 2009)

Jusuf Gërvalla: "*Me përfaqësuesin kryesor të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" jam njohur, pra, në fund të dhjetorit 1979. Quhet Riza Salihu, nga fshati Mushtisht. Ra fjala për organin e LNÇK "Zëri i Kosovës" dhe ai, me një ton të ashpër, shprehu dyshimin jo vetëm në ekzistencën e këtij organi dhe të LNÇKVSH, por edhe në besnikërinë time. Arsyeja ishte se ai qëndronte vetë në krye të Grupit me të njëjtin emër dhe, meqë, siç del logjikisht, nuk dinte për ekzistimin e LNÇKVSH dhe kishte edhe vetë një logjikë të kufizuar, kurrsesi nuk ia kapte rradakja të bënte dallimin në mes një organizate me emrin "Zëri i Kosovës" dhe një organi me titull "Zëri i Kosovës" që i takonte koinçidentalisht një organizate krejt tjetër. Po atë natë, ai më njohu mua dhe vëllaun tim me dy shokët e tij, Hysen Gega (tani i burgosur në burgun e Prishtinës) dhe Maksut Saramati, me punë të përkohshme në RFGJ. Që në fillim ra në sy kapadaillëku në rigorozitetin prej një shefi bande i Riza Salihut dhe natyrshmëria e zgjuarsia e dy shokëve të tij (anëtarë të KQ të "Z.K.").*

Me Hysenin e Maksutin u pamë dhe ndenjëm disa herë me radhë dhe e pritëm bashkë Vitin e Ri 1980. Hyseni lente të kuptohej se kishte diku në Gjermani një shok më të mirë se Rizanë, një student. Ai fliste dendur për të dhe vëllaut tim, Bardhit, që kishte njohur kohë më parë një person të tillë, i shkoi mendja mos ishte fjala për njëfarë Ibrahim Kelmendin. Por Hyseni e fshehte, prandaj nuk ngulëm këmbë për t'u njohur. Pak ditë më vonë vijnë te Hyseni e Maksuti dhe na tregojnë se si Rizai kishte ardhur, që në takimin e parë me mua, në përfundim se unë jam "i dërguar special i UDB-së" dhe se u kishte propozuar haptazi Hysenit e Maksutit të më likuidonin bashkë me vëllaun, Bardhin. ...

Nga gjysma e gushtit të vjemë te unë erdhi në banesë policia kriminalistike gjermane (po atë orë Bardhi ndodhej në qendrën e kësaj policie në Shtutgart, ku e kishin marrë nga puna). Ata na morën në pyetje veç e veç. Çështja kishte të bënte me Riza Salihun. Ai kishte hapur në postën e Shtutgartit 14 fah-postale në emër të 14 njerëzve të ndryshëm, ku ndalte letrat e këtyre dhe i lexonte për nevojat e veta. Mes të 14, kishim qenë unë e vëllau, Hysen Gega, Ibrahim Kelmendi etj. Policia e kishte zënë, e kish hedhur në burg dhe dyshonte se është agjent i UDB-së. Ndërkohë që Rizai kishte shpallur ndër punëtorë sesi ka kërkuar azil politik në Gjermani, ai kishte qenë pesë herë, në prag të burgimit, në konsullatën jugosllave në Shtutgart. Këto i kishte të shënuara në bllokun e shënimeve. Për mua, vëllaun dhe Ibrahim Kelmendin kishte dhënë te policia deklarata shumë të liga me shkrim, me plot gënjeshtra edhe për dy takimet që kishim pasur e ku kishim shumë dëshmitarë. Policia në fjalë kërkonte prej nesh: të thoshim edhe ne se Rizai është spiun jugosllav. Natyrisht, ne s'bënim dot një gjë

të tillë pa qenë të sigurt, dhe insistimet e policisë, të bazuara nga ana e saj në disa fakte që ne s'na e mbushnin mendjen, i kthenim mbrapshtë me arsyetimin se UDB-ja ka mundësi të mëdha të kurdisë gracka, e kështu ka mundur të veproj edhe me R. S." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

Shefqet Cakiqi - Llapashtica: "*Me të vra Rezili (Riza Salihu) është si me të hangër qenët."* (www.kosova.de, 23.03.2007 21:22)

Xhafer Durmishi: "*Në policitë e Gjermanisë dhe të Zvicrës vazhdojnë të qëndrojnë dokumentet e marra pas atentatit, të cilat flasin për punën e tyre dhe bashkëpunimin e tyre (në mes Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës - shën im) njëvjeçar."* (Zëri i Kosovës, Stockholm, janar 1985)

Për qëndrimin e tij në Shqipëri në verën e vitit 1985 dhe kthimin prej andej, kështu shkruan

Faridin Tafallari: "*Më 31 gusht (1985-shën i Xh. D.) paradite erdhën Sulejmani dhe Petriti; do të rrimë ca çaste me ta se pasdite do të nisem për në Gjermani. Do të vijë edhe Suzana, e shoqja e Jusufit. Për në aeroportin na përcjell Fiqiriu, Papi, Premtoni, Donika dhe Ergoni e ca të tjerë. U përshëndeta me Fiqiriun, Ergonin e të tjerët dhe hipëm në aeroplan. Zbritëm në aeroportin e Vjenës; bënte ftohtë. ... Me makinën e ambasadës shkuam në ambasadë; porsa i lam teshat, shokët Petrit dhe Ylli na çuan në një hotel larg qytetit për të ngrënë darkë dhe pas një pushimi u kthyem përsëri, morëm biletat për Gjermani. Me ne ishte edhe Shabani që udhëtonte për në Mynih; ky merrej me tregti. Në kufirin Austri-Gjermani na u afrua doganieri për punën e vet dhe po na shikonte pasaportat. Ishte për t'u habitur: ne ishim që të tre nga Kosova, por kishim pasaporta të ndryshme: unë pasaportë të Jugosllavisë, Shabani të Turqisë, kurse Suzana kishte pasaportë shqiptare. Doganierit i treguam se si ishte puna dhe ai u çudit.* ***Suzana vinte në Gjermani për të marrë teshat e Jusufit dhe të kunatit (Bardhoshit), si dhe për disa punë tjera që kishin të bëjnë me policinë gjermane."*** (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 94-95)

Më 18 janar 1982, policia gjermane i ka marrë të gjitha letrat e Jusufit, dhe ato gojarisht nga një përkthyes kompetent kanë mund të përkthehen brenda dy orëve. Planet e Riza Salihut, policia gjermane i ka marrë vesh prej letrës së Jusufit dhe askujt tjetër. Në letrën e 13 majit 1981 dërguar Sabri Novosellës dhe Raportin e korrikut 1981 për Komitetin e Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina", Jusufi i përshkruan në hollësi planet dhe motivet e Riza Salihut. Riza Salihu përmendet në këtë letër me emrin e tij të vërtetë dhe jo me ndonjë pseudonim. Letrat e Jusufit kanë qëndruar në policinë gjermane deri në vitin 1985, kur nga Shqipëria ka ardhur Suzana për t'i marrë.

Atë çka e ka thënë në mënyrën më të qartë Llapashtica e din shumë mirë edhe ish-inspektori i UDB-së Serbe Prapashtica, kryetari i Partisë 'Komuniste' të falimentuar, andaj edhe lufton me aq zell që të tallet me viktimën e vet të mjerë, Luanin e inferioriteteve vandale Nuhi Sylejmanin, duke bërë çdo gjë që është në dorën e tij, për ta njollosur Lëvizjen e lavdishme të Jusuf Gërvallës.

Nga faktet e shkruara me dorën e Jusuf Gërvallës është arrestuar Riza Salihu. Nga fjalët e Jusuf Gërvallës para operacionit në spital është treguar UDB-a vrastare dhe jo Riza Salihu. Nga faktet e Jusuf Gërvallës është shkruar dhe përjetësisht do të shkruhet Historia e lavdishme dhe e ndritshme e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi.

MVESHJET E MIRANIT
DHE
CIPËRCULLAKOSJET E MJERANËVE

1. E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës-nuk kam bërë denoncim
2. Shokë të veprave dhe jo fjalëve
3. Forumistët në www.kosova.de
4. Riza Salihu sajon
5. Blatuar hyjneshës së tij
6. I tillë është djali
7. I tillë është Babai
8. Qelepirxhinj e komunistë
9. Defektet e ndërgjegjes
10. Mik i autorit dhe njohës i shpirtit të tij
11. Vonesa e mbarë 25 vjeçare e njeriut të hazërxhevapeve
12. BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN TË TREMBË PËRHERË
13. Arkivi më i saktë është vetë populli
14. Unë do ta zbardhi rastin Gërvalla
15. Dimensioni i mendimit pozitiv
16. Koloseku i Frontit të Kuq
17. Sahati i Sinanit
18. Më ke gëzuar
19. Poema e Bedës - Shumë u gëzova që u gabova
20. Përgojuesit, lakmitarët dhe intrigantët

1. E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës-nuk kam bërë denoncim

Alfonsi: "*z. Kelmendi, Besoj se keni menduar shume deri sa keni shpallur publikisht kete emër. Tani me kjo u ba. Qfar pritni tani dhe si deshironi te rrjedh e gjithe kjo e tera?"* (www.kosova.de, Afishuar me: 25.03.2007 01:56)
Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi.*

JU: Qfar pritni tani dhe si deshironi te rrjedh e gjithe kjo e tera?
Unë: Që romani të mirëpritet nga lexuesit... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim." (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi *:"Janë me qindra që e dinë emrin e vërtetë të **Rezilit**, pasi e dinë se ai ka qenë kryetar i grupit komunist "Zëri i Kosovës*". (Gazeta "Express", Prishtinë, 12 mars 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh **Riza Salihu** sajon Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Edhe për **Rezilin** ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)

2. Shokë të veprave dhe jo fjalëve

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që **i mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Në radhë të parë do të përmendja ata që nuk e kanë thënë asnjë fjalë për këtë libër të mirë, por mirësinë e tyre e kanë tregue në mënyrë të mrekullueshme duke e ndihmuar materialisht autorin. Dhe autori Ibrahim Kelmendi i ka përjetësuar emrat i tyre duke i botuar këta në faqen e fundit:
"Deri më 12.01.2007 ndihma kanë dhënë:

Rinor Cara Tetovë Një Laptop
Sahit Krasniqi CH-Biel/Bienne 150 Euro
Muamet Ameti Tetovë 200 Euro
Fanol Bardhaj D - Bochum 100 Euro
Ramiz Lladrovci Prishtinë 20 Euro
Muharrem Berisha dhe miqtë në Bruxelles 600 Euro
Isuf Idrizi / Uglari CH-Cyrih 500 SFr
Blerim Muriqi CH-Cyrih 300 SFr"

Në këtë grup pra ma merr mendja se kemi të bëjmë me shokë të veprave dhe jo të fjalëve. Në mesin e tyre ka njerëz që e njohin Ibrahim Kelmendin një kohë të gjatë, me dekada, të cilët kanë besim të palëkundur në te, besim të cilin ky nuk e ka keqpërdorë kurrë.

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

3. Forumistët në www.kosova.de

Tema: Z. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u përgjigjet lexuesve!

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që **i mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Një kategori tjetër vlerësuesish janë persona të cilët në një chat-bisedë me shkrim, përmes forumit të internetit në adresën www.kosova.de, të zhvilluar nga 22.03.2007, ora 14:16 e deri më 27.03.2007, ora 07:23 , me përjashtim të Shefqet Cakiqit Llapashtica, janë anonim, e në mesin e të cilëve ka që e njohin I. Kelmendin por shumica e tyre nuk e njohin nga afër. Forumistët që kanë zhvilluar bisedën janë: *marinsi, grepi, qeku11, Mok, *DIELLI* , Hyena, caka, tarasi, "D"(Shefqet Cakiqi – Llapashtica), piloti, kreksi, gjarperi, Ministri, Qosi, cercizi, Nositi, prishtinasi-pp, Grasha_1, global_info, Kruja, Shqipëruesi, bumerang, TAFILIBRIGI, Labinoti, Dongil, drenasi_28, sportisti007, mili2, gentelmeni, Kitka-ch, xhevati, Kembana, hotiani, okii, Delegati, diogjeni, trixi, sharraxhiu, Andi, Alfonsi, "panta_rhei", Çakalli, Feni-X, Livadhi, AmazInG, urberari, Burimi35, Shpetimi, lorik, lu-gu dhe Apokalypse.*

Për këta persona nuk vlen titulli i këtij shkrimi pamvarësisht se disa edhe pse paraqiten me pseudonime, me të vërtetë e kanë demaskua veten keq me fjalët e tyre. Pjesa më e madhe e forumistëve ka vlerësime pozitive për librin Atentatet. Përjashtim bëjnë Shefqet Cakiqi-Llapashtica i cili thotë gjëra shumë të sakta, Shqipëruesi, trixi, "panta_rhei", dhe disa të tjerë.

Nga biseda në këtë forum përveç besimit të Alfonsit dhe vrojtimeve të Shefqet Cakiqit-Llapashticës, më kanë bërë përshtypje mendimet e mëposhtme që mendoj se janë reprezentative për opinionet e ndryshme të forumistëve:

kreksi: "*Keni dhene nje pershkrim te bukur qe ne hyrje me nje stil te pakopjushem ne literaturen shqiptare*."(22.03.2007 21:44)

gentelmeni: "*I nderuari Kelmendi, Ku po e gjene gjithe kete fuqi shpirterore qe edhe djallin e bene engjull.*" **(**24.03.2007 01:48)

hotiani: "*Nuk pata fatin as rastin te ju njoh personalisht, por emeri dhe vepra e juaj dhe bashkeluftetareve dhje bashkeveprimtareve juaj ka qene nje udherrefyes per secilin nga ne qe me zemer dhe pa hile i sherbyem aq sa ditem e mundem atdheut . Me beri pershtypje modestia dhe sinqeriteti pothuajse femijeror i parashtrimit si ne roman si ne pershkrimet dhe pergjegjejet tuaja forumisteve, pra parashtrimi i rolit tuaj ne ato rrjedha historike*." (24.03.2007 16:48)

trixi: "*Ne bindjen e njeriut nuk mund te ndikon kurrfar romani, kur eshte fjala per te verteta, andaj keto "arsyetimet" dhe berja me gisht tash pas 25-vitesh sikur tingllon shfajsim, larje e ndergjegjjes se papaster apo edhe ri-atentat !!"* (24.03.2007 18:48)

"panta_rhei": "*Te jeni i sigurte z. Kelmendi se ju falenderoj nga zemra qe keni shkruar nje roman te tille pikerisht ju. Absolutisht e keni vertetuar se te gjitha dyshimet kane qene shume te bazuara. Poashtu e keni vertetuar permes ketij romani se ju jeni me te vertete Ibrahim Kelmendi, tamam ashtu siq kemi degjuar dhe siq ju njohim.*" **(**25.03.2007 21:11)

kreksi: "*Per mua ky eshte "bestselleri" i pare qe po lexoje ne gjuhen shqipe*." **(**24.03.2007 19:07)

4. Riza Salihu sajon

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë njerëz që kanë bërë emër në fushën e kulturës, shkrimtarë e poet, gazetarë e shkollues gazetarësh, të politikës e luftës për çlirim, aktiviteti i disa prej tyre me të drejtë është cilësuar si mbarëkombëtar. Në këtë grup bëjnë pjesë veprimtarë të cilët janë marrë me shkrime, d.m.th. se janë të vetëdijshëm se çka po thonë, se kanë përvojë të gjatë në analizimin e teksteve. Këtu bëjnë pjesë shokë që kanë vepruar në organizatë me I. Kelmendin dhe asi që nuk kanë vepruar në organizatë me te. Kjo ia rritë peshën librit "Atentatet" si në kuptimin e përgjithshëm ashtu edhe në të veçantat e veta.

Në këtë grup bëjnë pjesë: Adem Gashi, Avni Dehari, Bedri Islami, Daut Demaku, Mustafë Xhemaili, Prend Buzhala, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Sadri Ramabaja, Sali Kabashi, Shaban Sinani e Fatos Aliu.

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që **i mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)

Adem Gashi, kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës në një kohë, është redaktor i librit Atentatet. Për këtë libër Adem Gashi me sa di unë është shprehur në tri raste. Më datat 7 e 8 janar i ka marrë një intervistë I. Kelmendit për gazetën "Epoka e re". Në faqet e para dhe në kopertinën e mbrapme të librit janë disa fjalë të qëndisura nga thesari i tij i shprehjes. Gjithashtu me rastin e promovimit, më 5 shkurt 2007 ka bërë shkrimin "Dyndalla e mendimeve". Citatet që më janë dukur më kryesore nga këto raste jepen më poshtë. Fjalët e qëndisura në kopertinë jepen pa shkurtime.

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh **Riza Salihu sajon** Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

Adem Gashi: "*Këtyre ditëve në faqet e shtypit është dukur një kërkesë për mbështetje rreth botimit të një romani tuaj. Me pak rreshta përvijohet tematika që jo rrallë ka trazuar shpirtrat e shqiptarëve. Është fjala për atentatin ndaj vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës...*

Përse këtë herë zgjodhët pikërisht gjininë e romanit? Mendoni se zbardhja do të jetë më e thellë dhe më totale?

Ibrahim Kelmendi: *"...Zgjodha zhanrin e romanit historik e politik për të kompletuar sa më shumë tabloidin e veprimtarisë, jetës dhe të atentateve, sidomos ato që nuk dukeshin. Njëherit, zgjodha romanin, për të paraqitur edhe figurën e kryedorasit të mundshëm, për të cilin unë vazhdoj të jem i bindur se e ka bërë këtë krim të rëndë..."* (Epoka e re, 7-8 janar 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim*." (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Ibrahim Kelmendi: "*Rezili është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit.*" (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

5. Blatuar hyjneshës së tij

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që **i mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)

Adem Gashi: *"Gjatë formimit shoqëror e kombëtar, kulturor e religjioz, shkencor e politik, autori ka njohur shumë mite, kulte, idole e hyjni. Përfundimisht kredoja e tij e ka përmbysur hierarkinë e idiolatrisë duke ia shpalosur surrogatët e tyre. Ju mund ta akuzoni autorin për mungesë modestie, gjatë gjithë kohës që ai njeh, respekton, i falet me përkulje dhe devotshmëri **vetëm të vërtetës.***

Adem Gashi - armiku i mistrecave komunist

Është krejt i ndërgjegjshëm se një ditë të gjithë do t'ia kthejnë shpinën e do ta lënë. Një ditë, është plotësisht i ndërgjegjshëm, gjithçkaje të kësobotshme do t'ia kthejë shpinën e do ta lërë. Edhe kur e lënë, edhe kur i lë, në thelb nuk ndërron gjë. E vërteta do të qëndrojë e përjetshme në fronin e saj... Kjo vravashkë s'ka të bëjë as me Dialogët e Platonit, as me Mbrojtjen e Sokratit.

Ky shkrim s'është tjetër veçse një akt dëshmimi i autorit, blatuar hyjneshës së tij, të vetmës dhe të tërëkohshmës." (Në hyrje dhe në kopertinën e mbrapme të librit Atentatet)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

6. I tillë është djali

Adem Gashi: *"Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë **mistreci komunist**, pranë urtisë populllore sloganet e zvjerdhura të moralit të shpëlarë, pranë dijes së orakullit fodullëku i të parit të mëhallës.*

Ibrahim Kelmendin e kam takuar së pari në verën e vitit 1990, në Zvicër.

E kam ditur dhuntinë e tij për shkrime të tjera, po kurrë për letërsi.

Ajo sjell atmosferën, gjendjen psikologjike e shpirtërore, vrasjen, vetëvrasjen, grackën, lëkundjen, tundimin e ndërgjegjes së njerëzve.

Kelmendi shumë më saktë e jep tablonë përmes bashkëbisedimit sesa përmes përshkrimit. Vetjet e romanit, po të flisja sipas teorisë së dramës, i përkasin personave autentikë të emigracionit, duke u shfaqur me siglat e emrave e të mbiemrave." (Më 5 shkurt 2007, Hotel Viktoria)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(www.pashtriku.org, Republika, prill 2007)

7. I tillë është Babai

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Avni Dehari: "*Si bashkëveprimtar i tyre Ibrahim Kelmendi ka sjellë brumë të mjaftueshëm për t'u njohur me përpjekjet dhe veprimtarinë organizative për çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi...*

Të katër bashkëveprimtarët janë më se të vetëdijshëm se bashkimi i organizatave OMLK, LNÇKVSHJ dhe Fronti i Kuq Populllor që përfaqësoheshin me organet "Liria", "Lajmëtari i lirisë" dhe "Bashkimi" ishte më se i domosdoshëm. Ata do t'i hyjnë punës së palodhshme për bashkimin e këtyre organizatave në organizatën Lëvizja/ Fronti për Republikën e Kosovës...

Shumica e personazheve në këtë roman ose janë bashkëpunëtorë të autorit dhe dëshmorëve ose kundërshtarë të tyre. Një pjesë e emrave të tyre janë të vërtetë, ndërsa të tjerët edhe pse të sajuar shumë lehtë mund të identifikohen me bartësit e tyre....

...I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës,** i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB-së, ndër të tjera thoshte: **'Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë (mveshë-shën im) fajin UDB-së.'

Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen..." (www.pashtriku.org, Gazeta Focus, 2 mars 2007)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

8. Qelepirxhinj e komunistë

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007



Prend Buzhala - nuk i do qelepir-xhinjt dhe komunistët

Prend Buzhala: *"Kur merr fund leximi i romanit "Atentatet" të Ibrahim Kelmendit, tek iu bëhet homazh përjetësisë së tri personaliteteve historike, vëllezërve Jusuf e Bardhosh Gërvalla e Kadri Zeka, në trevjetorin e rënies, lexuesi e ndien se nuk është në gjendje të dalë nga gjeratoret e misterit të krimit politik...*

*I del parasysh panorama e gjerë epike e romanit, në të cilin parakalojnë personazhe të mërgatës shqiptare të të gjitha ngjyrave, me huqet e karaktereve që kanë, parakalojnë revolucionarë, politikanë kafenesh,.. mashtrues e **qelepirxhinj** të ndryshëm, ...ambasadorë, diplomatë, **komunistë e pseudo-ideologji** të të gjitha tarafeve...*

...Bioproza e Ibrahim Kelmendit përbën një thurje shumështresore dhe të ndjeshme, përbën një modalitet të veçantë të së vërtetës..." (www.pashtriku.org, *Prishtinë 5 shkurt 2007)*

Ibrahim Kelmendi: *"Si shokë që jemi dëshiroi që gjatë vitit të Ri 1982 shoqëria të thellohet edhe më shumë, në baza të shëndosha revolucionare marksiste-leniniste!" (Letër për Faridin Tafallarin: Marrë nga libri i F.T., Terror-Dhimbje-Qëndresë, f.411)*

KOMITETI QENDROR I LRSSHJ *" **Keqpërdori ndihmat për Kosovën**, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë luftës sonë prej 50.000 korona, prej të **cilave nuk solli asnjë qindarkë**, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi."* (Vendim i Komitetit Qendror të Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi për përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga KQ, më 10 shkurt 1985. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f .253-254)

Ibrahim Kelmendi: *"Në xhepat e mij të grisur nuk ka bir nëne (**e as bir kurve**), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë **se nuk kam shpërdoruar** e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (Afishuar me: 23.03.2007 21:18, www.kosova.de)*

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

9. Defektet e ndërgjegjes

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër*

tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim." (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Rasim Selmanaj: *"Raportet e mia me këtë libër dhe me këtë autor, nuk janë raporte të rëndomta të botuesit me autorin, dhe as të interesit.*
Është jehona e ngjarjes së madhe të para-çerekshekullit që vjen në jehonën e kohës duke më ndjekur gjithandej, vijave që formojnë biografinë time: në shkollë, në punë, në luftë, në burg, në liri e në paqe. Në këtë përthyerje vijash, jeta ime ndahet përgjysmë: para atentatit dhe pas atentatit. Çuditërisht, në këtë të dytën, zë fill misteri si një lum nëntokësor që herë shfaqet, e herë humbet, duke lënë sheshit vetëm ca shenja e kode si pika orientimi brenda një hapësire të pacaktuar." (www.pashtriku.org, Prishtinë, 05 mars 2007)

Rasim Selmanaj

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

10. Mik i autorit dhe njohës i shpirtit të tij

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, **Prill 2007)**

Sadri Ramabaja: *"...autori i romanit ATENTATET, i ka vënë vetës për detyrë parasëgjithash mbrojtjen **e së vërtetës dhe vetëm të vërtetës**. Krahas kësaj përmes përmbysjes së hierarkisë së ideolatrisë utopiste, ai prajshëm, por pa atë modestinë që e karakterizon në jetë, ndjek hullinë e ..., duke u shndërruar plotësisht në një shkrimtar të angazhuar në kuptimin e mirëfilltë dhe më pozitiv të mundshëm të kësaj fjale...*

*... heroit- Miranin – që si busull orjentuese në jetën e tij, si personalitet i kompletuar, ka intencën kombëtare, **njerëzoren dhe të vërtetën...** ... kur fillon botimin e Bashkimit, shtron platformën politike të Frontit të Kuq, kur bashk me Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën diskutojnë rreth Tezave e Frontit, që më vonë do të shndërrohen në Platformë politike të Lëvizjes për Republikën e Kosovës etj. Ai për asnjë çast, si intelektual i kompletuar nuk lejon që të shndërrohet në farë idealisti utopist. Shi për këtë me kohë mendon*

diferencueshëm, nuk e identifikon socializmin teorik me pseudosocializmin e shteteve pseudosocialiste, gjegjësisht me sistemin diktatorial monist...

... Romanin ATENTATET kam prirje ta shikoj si një vepër letrare që ka një mision tjetër jashtëletrar – të dëshmojë për të vërtetën rreth atentatit fizik dhe atentateve tjerë politik etj. që iu bë Jusufit, Kadriut e Bardhit më 17 janar 1982 dhe Lëvizjes si tërësi deri në qershor të vitit 1999." (Sadri Ramabaja, www.pashtriku.org)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

11. Vonesa e mbarë 25 vjeçare e njeriut të hazërxhevapeve

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007



Salih Kabashi-i veshur deri në kapuç

Sali Kabashi: ”*Ibrahim Kelmendi nuk është kushdokushi... ...Nuk ka shumë muaj qyshse në një komunikim përmes postës elektronike i kisha shkruar se ai duhej, më në fund, të shkruante versionin e tij lidhur me atentatin e UDB-së mbi Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën e Bardhosh Gërvallën... ...një orator shembullor**, një njeri i hazërxhevapeve...***

*...Miku im, më një nuhatje fantastike, më pat thënë e më vonë edhe e pat shkruar në shtypin slloven, se lider i ardhshëm i Kosovës se re **paskomuniste** do të ishte Ibrahim Kelmendi. Peter Bozhiç quhej shkrimtari slloven dhe si fëmijë kishte kaluar nëpër kampet naziste në Gjermani...”* (Revista REPUBLIKA, nr. 3, 2007)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

12. BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN TË TREMBË PËRHERË

Intervistoi: Salih KABASHI, Botues i revistës Republika
Salih Kabashi: ”*Ibrahim Kelmendi ...muaj më parë ka bërë një bum të vërtetë mediatik me librin më të ri të tij me titull “Atentatet”, ku me një stil të rrallë dhe modern prej rrëfimtari të saktë... ...Duke qenë se libri “Atentatet” është një arenë e gjerë ku zbulohen e demaskohen prapaskena të ngjarjeve të ndryshme brenda gjirit të mërgatës sonë,* ***duke qenë se në atë arenë defilojnë rezilë e katilë përballë një mase shqiptarësh të vuajtur dhe të djegur për Atdhe, duke qenë se***

në librin e tij e shohim cipërcullak të zhveshur.*.. ...edhe* ***mjeranët*** *shqiptarë, të cilët pa ia ditur mirë hallin vetit, ishin futur atje ku e kanë vendin vetëm të mençurit, të ndershmit dhe trimat, duke parë, në fund, se me librin “Atentatet”, pothuajse është hequr misteri i atentatit më të bujshëm të UDB-së mbi tre shqiptarë të mëdhenj, duke e nxjerrë në kokër ledine vetë vrasësin, ne, autorit të librit, z. Ibrahim Kelmendi, i jemi drejtuar për një intervistë...*
Republika: *...duke biseduar rreth librit tënd kam vënë re se disa edhe janë trembur!*
KELMENDI: *E logjikshme se do të tremben. Nuk është i lehtë ballafaqimi me të kaluarën,... Është dashur Mirani dhe bashkëveprimtarët e tij t’ia vështirësojnë e t’ia ngatërrojnë aq shumë vetes jetën e tyre, gjegjësisht veprimtarinë e tyre?... ...Përse është dashur t’i bëjnë aq shumë hile njëri-tjetrit? Përse të angazhuarit e UDB-së dhe të strukturave të ngjashme nuk kanë respektuar ligjet përkatëse të kohës, për të mos sharruar deri në krime të rënda e antiligjore, rrjedhimisht përse janë angazhuar deri në kriminalitet ekstrem – atentat ndaj personaliteteve kaq njerëzore, siç ishin Jusufi, Kadriu e Bardhi?... ...Përse panevojshëm i kanë ngatërruar konceptet ideo-politike, kur, parë nga pozicionimi i tanishëm, duket se duhet ta kenë pasur më të lehtë t’ia qëllojnë,... ...Duke iu përgjigjur pyetjeve të tilla, secili personazh i romanit do të duhej të ndjehej i ndruajtur, për të mos thënë i trembur, siç jeni shprehur ju. Po vjen koha e llogaridhënies... ...ai që ka bërë krime të japë llogari për krime,...*
Republika: Kjo kohë e PASLIBRIT, le ta quaj kështu, çfarë përmbushje (kënaqësie) të ka sjellë?

KELMENDI: *Thënë të drejtën, ndjehem sikur kam bërë një si katarsis (çlirim të shpirtit), pasi kam qenë i mbingarkuar me barrë të rëndë, kurse tani sikur po ndjehem i shkarkuar.*

Asgjë më të bukur e më të ëmbël s'ka sesa e vërteta.

Republika: *Në librin tënd ka lloj-lloj personazhesh, disa prej të cilëve, pavarësisht kamuflazhit të hollë që u ke bërë, disa nga ne nuk e kemi aq vështirë t'i identifikojmë... ...Cilat janë reagimet e tyre, pasi që, supozoj, nuk do ta kenë lehtë gjatë asaj cope jetë që atyre u ka mbetur?*

KELMENDI: *Edhe Miranit mund t'i vijë keq për shumë (mos)angazhime të tij, edhe atij i duhet të merret me të kaluarën në pjesën e jetës që i ka mbetur, që do të thotë, edhe Mirani do të më japë llogari mua... ...Uroj që t'u ketë mbetur njerëzi e mjaftueshme, që ta përpunojnë njerëzishëm të kaluarën e tyre.* ***Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri***

pa këto gjynahe që i mvishen në roman*... ...Sa u përket reagimeve të personazheve, deri tani kam pasur vetëm reagime pozitive. Në përurim të librit ishte i pranishëm edhe Vasili, me të cilin u përqafuam shumë përmallshëm, pasi nuk ishim parë prej kohësh. Letër më ka dërguar edhe bashkëshortja e Kadriut....*

...Po i mirëpres edhe reagimet kundërshtuese, sulmuese e fyese,... ...kur na kanë ndodhur gjithë ato përplasje, hile e tragjedi, por edhe suksese, meqë, megjithatë, ia dolëm të formojmë organizatën për të cilën ishim angazhuar dhe kishim vendosur bashkë: Jusufi , Kadriu, Bardhoshi dhe unë.

Republika: *...A mendon se në të ardhshmen mund të kemi edhe nga të tjerë libra të ngjashme mbi veprimtaritë në emigracion?*

KELMENDI: *...Kur z. Shaban Sinani i bëri recensionin librit për emigracionin e Belgjikës, më pati këshilluar që ta shtyj për më vonë botimin e atij libri. Pra, bëhet fjalë për librin, të cilit i është bërë edhe korrektura gjuhësore dhe është bërë faqosja dhe ai po pret i faqosur (në boca) kohën kur duhet të botohet...*

...Kurse gjykimin real do ta bëjë brezi tjetër, pasi ai do jetë i liruar nga subjektivizmi ynë. Atij brezi do t'ia lehtësojmë punën vlerësuese, nëse i përgatisim sa më shumë informacion dhe analiza, qofshin këto edhe subjektive.

13. Arkivi më i saktë është vetë populli

Republika: *Një ditë do të hapen dosjet, ku secili do të ketë mundësi, si në Sllloveni, bie fjala, që të ketë qasje në dosjen që ka mundur ta ketë mbajtur për të Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, apo ndryshe policia politike komuniste e njohur si UDB. Kur kihet parasysh se dosje të tilla janë bartur në Beograd, a mund të imagjinosh rrëmujën që do të shkaktonte kthimi i tyre në Kosovë dhe hapja e tyre për publikun?*
KELMENDI: *Nëse Beogradi nuk do të demokratizohet, atëherë duhet pritur se dosjet do të manipulohen e do të sajohen, varësisht nga nevojat politike ditore, për t'i shërbyer politikës se tyre nacionaliste. E vetmja mundësi për t'ju kundërvënë spekulimeve hileqare është trajtimi i tyre nga ekspertët. Zhvillimi i shkencës ka shkuar deri atje, sa të konstatojë saktësisht se kur është përpiluar një shkresë, gjegjësisht një dosje. Prandaj dhe duhet të shfaqim rezerva, kur ata do t'i servirin.* ***Kurse arkivi më i saktë është vetë populli, pasi secilit individ ai ia di veprimtarinë konkrete, që do thotë se rrethi ku jam angazhuar unë e di se cili kam qenë dhe çfarë kam bërë....*** " (Republika, Prill 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër për Sadik Blakajn më 21 janar 1981. Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 407)*

14. Unë do ta zbardhi rastin Gërvalla

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh **Riza Salihu sajon** Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

Pjesë nga intervista e I. Kelmendit e publikuar në Express (sipas www.pashtriku.org) më 11 e 12 mars 2007

(Nebih Maxhuni) gazeta Express Prishtinë 10 mars 2007

Gazeta Express: "*Express: Kush është Vasili, ngase lexuesit tanë nuk e dinë?*

Ibrahim Kelmendi: *Vasili është njëri nga personazhet e romanit. Ai ka pasur një urdhër për të bërë atentat ndaj Jusuf Gërvallës, por trimërisht ka refuzuar ta zbatojë. Për këtë ai duhej të ndëshkohej nga UDB-ja." (Gazeta Express, 10 mars 2007)*

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Gazeta Express: "*Ibrahim Kelmendi në romanin e tij "Atentatet" dëshmon se vrasësi është Rezili. Për këtë ai thotë se ka fakte të mjaftueshme. Nuk frikësohet për vete sepse beson se ka ndërgjegjen e pastër.*

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh* ***Riza Salihu sajon*** *Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

Lexoni vazhdimin e dytë në Express të intervistës me Ibrahim Kelmendin...

Riza Salihu

"Unë do ta zbardhi rastin Gërvalla."

Express: *Pse personazhi juaj do të jetë vrasës dhe pse shqiptari duhet të jetë vrasës i Jusuf Gërvallës e jo për shembull njerëz të specializuar të UDB-së?*

Ibrahim Kelmendi*: Sepse edhe unë po të kisha qenë oficer i UDB-së njësoj do të kisha vepruar, do kisha zgjedh një shqiptar si doras..."*

Ibrahim Kelmendi: "*Rezili është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Express: *Ju e dini se kush është vrasësi. Ai është Rezili...*

Ibrahim Kelmendi: *Obligimi im moral është që të* ***testoj*** *opinionin,...*

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de)

Express: *Kemi të bëjmë me vrasje, porosia është çështje morale.*

Ibrahim Kelmendi: *Unë kam dilema, prandaj po marrë mendime nga njerëzit, se çfarë përshtypjeje u ka bërë romani. Edhe të tjerët kanë mundësi të bëjnë denoncimin.* ***Janë me qindra që e dinë emrin e vërtetë të Rezilit, pasi e dinë se ai ka qenë kryetar i grupit komunist "Zëri i Kosovës".*** (Gazeta "Express", Prishtinë, 12 mars 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh* ***Riza Salihu sajon*** *Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

15. Dimensioni i mendimit pozitiv

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i* ***mvishen*** *në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Daut Demaku: "*Për mua, për këndin tim të vështrimit, ky veprimtar (Ibrahim Kelmendi-shën. i Xh. D.) ka qenë njëlloj nxitjeje,... ...Mezi kam pritë të ketë diçka të shkruar! Pse? Sepse njerëzit që ecin rrugëve të shtruara, trotuareve të gjera, ata nuk janë krijues, janë njerëz të rëndomtë... ...dëmtojnë bukën.*



...Dimensioni politik i romanit "Atentatet" është aq i thellë dhe aq domethënës sa iu mbetet studiuesve të rinj që ta zbërthejnë në qetësi, sepse ***brumi është aq i vërtetë****, aq konkret dhe aq i bollshëm sa mjafton për gatime të të gjitha veprave politike, juridike, kriminalistike, psikologjike..."* (Prishtinë, 26 gusht 2007, pashtriku.org)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim* ***cipërcullak*** *të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

16. Koloseku i Frontit të Kuq

Ibrahim Kelmendi*: "Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar* ***Xhavitin****, meqë për te krijova përshtypje se* ***ishte informator i UDB-së****, i urdhëruar për t'u anëtarësuar në PKGj/M-L, që të informonte për veprimtarinë e kësaj partie komuniste sigurimet e fshehta jugosllave dhe gjermane. Kurse për Proletarin formova përshtypjen se ishte një dogmat primitiv."(Atentatet, f.40)*

Fatos Aliu: *"Me librin paraprak, Atentatet, autori ka përshkruar katrahurën e planifikuar, për* ***zhvendosjen e binarëve*** *të lëvizjes kombëtare, me vrasjen e veprimtarëve të shquar për vetëvendosje dhe bashkim kombëtar, të vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zeka."(*www.pashtriku.org, Prishtinë, 18 tetor 2008)

Xhahili (Xhaviti), informatori i UDB-së propozon emërtimin "Fronti i Kuq"

*I. Kelmendi:" **Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion",** etj. Proletari propozonte ta quanim "Partia Komuniste e Kosovës /Marksiste-Leniniste", duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. ...Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë **avullnetshëm** u dakordova me propozimin e tyre. **Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues." (**Atentatet, Prishtinë 2007, f.41-42)*

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi"(Frontit të Kuq-shën i Xh. D.), më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. ...Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në **qendër të saj**, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën i Xh. D.), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981;* Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

Me qëllim të rregullimit të binarëve Jusufi e ndërprenë punën e vet në Frontin e Kuq, në dhjetor 1980.

17. Sahati i Sinanit

Prof. Dr. Shaban Sinani: *"Përveç librit "Shqipëria - jashtë "Veriut" dhe Jugut"", kushtuar ngjarjeve të mistershme të vitit 1997,... ... dhe librit letrar-jetëshkrimor "Atentatet" kushtuar fillimeve të vështira e të rrezikshme të lëvizjes së organizuar politike në mërgim për zgjidhjen e "gjysmës tjetër" të çështjes kombëtare, kam pasur rast të lexoj dhe një libër tjetër të tij, ende të pabotuar, me përjetime të protagonistëve të mërgatës së vjetër e të re shqiptare, nga shteti i vjetër dhe nga Kosova, për të cilin pata menduar se ishte **ende shpejt të dilte në publik**."*

Shaban Sinani

(www.pashtriku.org, Tiranë, 6 tetor 2008)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

18. Më ke gëzuar

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45) Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Ramiz Kelmendi: *"(...) Librin e kam marre bashke me "Fokusin", sapo ka dale. Edhe e kam lexuar. (...) Si pune e pare, mund te te them se me ke habitur - jo pak! - me stilin, ta quaj romanesk, te librit. D.m.th.,* ***me ke gezuar****, ta kam pelqyer. E dyta, libri lexohet me nje fryme, edhe pse, perkunder natyres sate,* ***si te njoh une****, d.m.th. qe nuk nguron fare t'i thuash te bardhes e bardhe dhe te zezes e zeze, kesaj here me ka munguar kjo kurajo jotja duke u fshehur pas emrave te trilluar (me ndonje perjashtim). (...) Libri ka nevoje per nje lekture me te mire. (...)"*
(www.pashtriku.org, 14 mars 2007)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim* ***cipërcullak*** *të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

I gëzuemi - Ramiz Kelmendi

19. Poema e Bedës - Shumë u gëzova që u gabova

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i* ***mvishen*** *në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

Bedri Islami - Beda i Migjen/ Kelmendit

Bedri Islami: *"Kur disa kohë më parë, miku im Ibrahim Kelmendi do të më niste fillimet e kapitujve të parë të romanit "Atentatet", nuk e kisha besuar se më në fund do të kishim një vepër të tillë, e cila, për nga përmasat që mbart, është shumë dimensionale...*

...nuk e kisha besuar, sepse, sado që njihem prej më shumë se 14 vitesh me të, nuk e kam ditur gjithë furinë që ai kishte kaluar dhe që do na e jepte një ditë. ***Pra, u gabova me autorin e librit dhe jam ndjerë shumë i kënaqur që u gabova....*** *...nuk mund të ndodhë që të jesh indiferent ndaj tij, ndaj jetës së tij, punës që ka bërë, asaj që ka kaluar, në fund të fundit, do apo nuk do, do të marësh një qëndrim.*

...Në fakt ky nuk ishte dhe nuk është mllef kundër tij, më shumë se gjithçka ishte një hidhërim kundër vetes, që nuk kishin mundur të qëndronin ashtu si duhej, që u kishin ikur ideve që kishin pasur,... ... frika e dëshmisë që mund të vinte nga Kelmendi, një ndjenjë frike e përhershme

... Pra ai nuk është shkruar aty për aty, menjëherë pas ngjarjes, kur llava ishte ende

përvëluese, dhe kur, si ndodh rëndom, sugjestioni i kohës, mund të kishte çuar në dreq gjithçka. Kelmendi ka pritur deri sa llava e romanit të tij të ftohet, të zërë vend,
të krijojë shtratin e përshtatshëm për tu shkruar dhe, kur ka ardhur çasti i duhur, ai e ka thënë, ashtu si ka ditur. Dhe ka ditur ta
thotë fare mirë.
...Jo rrallë, po ashtu natyrshëm, shumë njerëz, pasi kanë lexuar librin, kanë pyetur se cili qëndron pas njërit personazh apo tjetrit. Mendoj se kjo gjë e natyrshme ka lidhje me vërtetësinë që ka sjellë libri, sepse duke qenë i vertetë, ai ka zgjuar tek njerëzit dëshirën për të ditur edhe emrat real të atyre, që për mirë apo për keq, lëvizin nëpër faqet e romanit "Atentatet". Në këtë grackë kam rënë edhe unë. ***Kisha harruar se kush fshihej pas "Rezilit" dhe thirra autorin të më tregonte.***

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh* ***Riza Salihu sajon*** *Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart." (Epoka e re, 7 janar 2007)*
Ibrahim Kelmendi*:* ***"Janë me qindra që e dinë emrin e vërtetë të Rezilit****, pasi e dinë se ai ka qenë kryetar i grupit komunist "Zëri i Kosovës".* (Gazeta "Express", Prishtinë, 12 mars 2007)

...Romani "Atentatet" është një libër që do të mbesë. Ai nuk do të bjerë në harresë. Me gjithë të metat që mbart, sidomos në disa perceptime, ai do të jetë gjithnjë një libër i ditës...
....Në fund të fundit ka qenë një vonesë e mbarë.
Nëse libri do të ribotohej (meqë botimi i parë ka mbaruar), ***mendoj se ai duhet "krehur"****. Kjo duhet bërë domosdo. Rishikimi i tij, siç ndodh rëndom me ribotimet, do e bënte atë edhe më të vlershëm."* (Bedri Islami, 27 mars 2007, www.pashtriku.org)
Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim* ***cipërcullak*** *të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

20. Përgojuesit, lakmitarët dhe intrigantët

Ibrahim Kelmendi: *"****Rezili*** *është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45
Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i* ***mvishen*** *në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)
Mustafë Xhemaili: *"Ndërsa nga dëshmia e tij, duket kthjellët se ai vetëm Jusuf Gërvallën e ka pasur shok të vërtetë! Dhe kjo ishte e natyrshme. Në rininë e tij IK, si gjithë të tjerët, duhej ta kishte një shok të vërtetë. Dhe, ai, e gjeti pikërisht atë që i duhej për bisedë, edukim, qortim, grindje, debatim, orientim, organizim, bashkëveprim - atë më të mirin, shokun ideal! Për gjithë jetën!*
Pra, të shkruash apo të mos shkruash – kjo është çështja! Të heshtësh apo të flasësh – kjo është çështja! E IK., ka vendosur që thënien e Hamletit të perifrazuar kështu në këtë rast nga unë, ta merr si njëdrejtimëshe:
Të flasësh, mos të heshtësh!
Të jetosh me historinë!
Të flasësh të vërtetën!
Ta dëshmosh aktivisht atë!

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Historia - Dëshmia - Tronditja

Me ATENTATET, Ibrahim Kelmendi dëshmon fuqishëm për një kohë. Për rrethana të caktuara. Ai dëshmon për një rrjedhë të historisë *së caktuar që vërtetë ka ndodhur, dhe ai e tregon përmes prozës së gjatë. Mënyra e të treguarit (pra të diskursit) dhe personazhet realë ose të retushuar në mënyrë fare transparente, bënë me dije, se* ***qëllimi i autorit nuk është letërsia, por dëshmia – pra historia****..."*

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i* ***mvishen*** *në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007

...Historia e letrarizuar bëhet shkak më i fortë për t'u lexuar dhe komentuar. Se brenda ka një a më shumë të vërteta, një a më shumë personazhe realë. Madje në këtë rast pjesa më e madhe e tyre janë gjallë dhe vegjetojnë diku nëpër Kosovë dhe Evropë.

Cilët janë personazhet

Mustafë Xhemaili

Personazhet e veprës së IK., mund t'i ndajmë në katër grupime. Me që janë të gjithë personazhe historikë, pra që i përkasin një kohe dhe epoke të caktuar, disa prej tyre janë edhe të kamufluar me një shtresë të hollë konspiracioni të përkohshëm...

...Grupi i tretë ***i përgojuesëve, lakmitarëve, intrigantëve, pseudopatriotëve, shantazuesëve, arrivistëve dhe problematikëve****: Sabit Katunriu, ...Nuri Syleviqi-Qerosi..., ...Fahri Faleku, Xhahil Rambeja (Xhaviti), Proletari, Enver Hadri, Hafif Gagaj, Fazit Melaj, Halim Berbati, ...Xhafar Dunkeli (****Skënderi****),... ...në ATENTATET, janë ata të cilët bënë ashtu siç u detyruan të bëjnë, siç patën dëshirë të bëjnë, siç nuk ditën të bëjnë, apo siç i urdhëruan të tjerët të bëjnë kundër lirisë së popullit të vet...."* (Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf (Gjermani), për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET, botoi "Fokus", Prishtinë, 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në Rezilin (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Salih Kabashi: *"Në librin e tij e shohim **cipërcullak** të zhveshur... ...edhe mjeranët shqiptarë."*(Republika, prill 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"**Rezili** është një personazh i romanit, i cili dyshohet si doras në vrasjen e Jusufit, Kadriut e Bardhoshit."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 15:45)

Ibrahim Kelmendi: "*Edhe për **Rezilin** ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i mvishen në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk po ju kuptoj për ke e keni fjalën. Nëse po mendoni në **Rezilin** (personazhin e romanit ATENTATET), atëherë unë nuk kam publikuar ndonjë emër tjetër të këtij personazhi... Kam shkruar roman dhe nuk kam bërë denoncim."* (www.kosova.de, Afishuar me: 26.03.2007 04:56)

Ibrahim Kelmendi *:"Janë me qindra që e dinë emrin e vërtetë të **Rezilit**, pasi e dinë se ai ka qenë kryetar i grupit komunist "Zëri i Kosovës*". (Gazeta "Express", Prishtinë, 12 mars 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Për të na u kundërvënë, pas nesh **Riza Salihu** sajon Grupin Komunist "Zëri i Kosovës", në Stuttgart."* (Epoka e re, 7 janar 2007)

Ibrahim Kelmendi: *"Edhe për **Rezilin** ndjej keqardhje,... ...edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Salih Kabashi, Republika, Prill 2007)

FLAKA E PASHUAR E LËVIZJES
në Untergruppenbach

"Oxhaku i tij i lartë, që i mbeti në këmbë atë ditë e sot, shekuj me radhë, nxjerrë tymin duaj-duaj"

Shoku i Sadik Blakajt:	**Në Kështjellën e Jusufit kishte urdhër të regjistrohej e evidentohej çdo gjë!**
Shkolla e UDB-së:	**Në Kështjellën e Jusufit kishte urdhër të rreptë që të mos regjistrohej e evidentohej asgjë!**

Ramadan Pllana: "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."***(**DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ, mars 2009, www.pashtriku.org)

Shkolla e UDB-së": *"Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi. Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim ... Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë **drejt dobësimit apo shuarjes totale**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 124)

***Ibrahim Kelmendi**: "Në fundjavë vërshuan qindra bashkatdhetarë për të shprehur ngushëllimet dhe admirimin për heronjtë. Nuk erdhën sa parashikoheshin, pasi kishte dalë fjala se në Familje të Gërvallajve ku mbahej ceremonia mortore ishin ca njerëz që*

mbanin evidencë për vizitorët. Edhe kur nuk i njihnin i pyesnin për ***emër e mbiemër, për vendlindjen dhe i regjistronin*** *ose i detyronin të shënoheshin në libër të zisë me të dhëna të plota personale. Bashkatdhetarët kishin filluar të frikësoheshin se do ta pësonin kur të shkonin për pushime në Kosovë, prandaj një numër i madh i tyre hezitonin të vinin për vizitë ngushëlluese." (Atentatet, f.351-352)*

Ibrahim Kelmendi: *"Sadik, ...Gjithsesi, çdo gjë do nxjerrë koha në dritë, por ti duhet të provosh menjëherë ta përshkruash ngjarjen pastaj të shohim:* ***ndoshta je i pastër si loti dhe mbetemi shokë të mirë.*** *Për të ardhur gjer tek kjo, do të ishte dashur një sinqeritet i thellë, duke pranuar edhe ndonjë gabim të vogël nga mosdija..." (Letër Sadik Blakajt, 21 janar 1981)*

Kështjella e pamposhtur e Vëllezërve Gërvalla, e pa njollosur përveç fluskave të bardha të borës, e fotografuar nga Remzi Ademi në dhjetor 1984 me kërkesën e Xhafer Durmishit



Dorëshkrimi i Remzi Ademit

Jusufi e ka ndalua të mbahet zi në shtëpinë e tij, sepse me këtë do të kënaqej vetëm UDB-a dhe informatorët e saj. Aktivist të Shtutgartit janë ruajtur nga Ibrahim Kelmendi pasi të gjithë e kanë pasur të njohur rastin e Hysen Gegës dhe kush ia ka kurdisë kurthën.

Ajo çka është e vërtetë është se ka shumë raste, kur bashkatdhetarë të rrethit të Shtutgartit kanë ardhur deri në derë për ngushëllime, kur kanë marrë vesh se brenda në shtëpi, në mesin e ngushëlluesve është I. Kelmendi, ata ia kanë shprehë ngushëllimet Suzanës apo Haxhi Berishës tek dera dhe janë kthye. Por edhe sikur të kenë qarkullua këto fjalë, frika e bashkatdhetarëve në këtë pikë ka qenë e pavend pasi askush nuk ka guxua ta përdorë të pamën në Kështjellën e Jusufit për të marrë në pyetje askënd për asnjë shënim apo të dhënë personale. Këtë nuk e ka bërë askush. Shokët e Jusufit, të regjur në punë ilegale kanë kërkuar që askush të mos i jep ndonjë të dhënë askujt, sidomos nga ata që kanë udhëtuar rregullisht në Kosovë, dhe si përfundim, të mbledhë shënime se kush po vjen për ngushëllime nuk ka mund ta bëjë as vetë i godituri, i cfilituri deri në dërmim, naivi, konkreti, i sinqerti e njohësi i dorës vrastare, I. Kelmendi.

Se marrja e shënimeve personale, emrave, është ndaluar rreptësisht është vërtetuar më së miri prej Nuhi Sylejmanit (ish shok i Jusufit), shokut më të ngushtë të Dezertorit të UDB-së Abdullah Prapashtica dhe Vëzhguesit të tij, për mëse 28 vite.

E quaj të arsyeshme të përmendi se Abdullah Prapashtica ka qenë ushtrues legal, zyrtar d.m.th. jo i fshehët por i shkolluar në mënyrë profesionale, i detyrës së inspektorit të UDB-së, profesion prej të cilit i ka siguruar mjetet për jetesë, dhe prej të cilit ka dezertua.

Një letër dërguar Ramadan Pllanës më 11 nëntor 2009 shprehen qëndrimet e mia të vërteta ndaj Abdullah Prapashticës, pra rreth 10 muaj **para** leximit (në gusht 2010) të librit "Vrasja e trefishtë", fjalë të cilat janë shumë i kënaqur që i kam thënë.

Xhafer Durmishi: *"Shkrimin e Abdullah Prapashticës e kam lexuar dhe ka shumë pak tekste që më bëjnë me qesh e që më kënaqin shpirtin më shumë se shkrimet e budallallëqet e Abdullah Prapashticës, dhe shpresoj që ai të vazhdoj me kontributin e tij teorik edhe më tutje. Zoti jetën ia shtoftë e i dhashtë shëndet. Është mirë që të ka ra ndërmend se ekziston Faridin Tafallari, si shok i Jusufit e njohës i mirë i rrethanave të asaj kohe. Për ekzistencën e Faridin Tafallarit e librit të tij "Terror Dhimbje Qëndresë" të kam tregua më 2006, ndërsa ti ishe i fokusuar më shumë dhe i kishe pas ra në trag Nuhi Sylejmanit e për Faridin Tafallarin nuk kishe ndie kurrë deri sa të tregova unë. Me fjalë tjera në këtë rast i ke shitë dardhagjisë dardha." (Letër dërguar Ramadan Pllanës, më 11 nëntor 2009,* www.pashtriku.org*, 23 shtator 2010)*

Është interesant se zelli i Dezertorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica për t'i njollosur shokët e Jusufit, dhomat dhe muret e Kështjellës së Jusufit, është ndoshta edhe më i madh se sa i Ibrahim Kelmendit, por efekti i fakteve të Nuhi Sylejmanit është katastrofal si për Ibrahim Kelmendin (për të cilin Abdullah Prapashtica ka një respekt të madh si intelektual e udhëheqës i denjë i Frontit të Kuq), si për vet Abdullah Prapashticën, si për UDB-në ashtu edhe për misionin e saj, si për UDB-në ashtu edhe

për ata që kanë dezertuar nga UDB-a. Ja faktet që sjell Nuhi Sylejmani.

> **Ramadan Pllana:** "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."*

*Nuhi Sylejmani: "Shuma e mbledhur gjatë periudhës **19 janar 1982, deri më 25 prill 1982**, arrinte shifrën rreth 70.000 marka." (Vrasja e trefishtë, f.156)*

Lista e atyre që ndihmuan luftën dhe e mbajtën FLAKËN TË PASHUAR në Kështjellën e Vëllezërve Gërvalla dhe me këtë e nuk ia lejuan UDB-së Serbe dhe vrasësve të saj ta shuaj si subjekt edhe Lëvizjen e tyre Nacionalçlirimtare:

Shokët e Remzi Ademajt	1990 DEM	
Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni	6240 DEM	
Shokët e Remzi Ademajt nga Heilbroni	2520 DEM	
Shoku i Remzi Ademajt	260 DEM	
Shoku i Remzi Ademajt – kroat	50 DEM	
Shokët e Remzi Ademajt	200 DEM	
Shokët e Remzi Ademajt	386 DEM	
Shokët e Remzi Ademajt nga Mynheni	920 DEM	(bashkërisht 12566 DM)

Remzi Ademaj, me kurorë në dorë gjatë ceremonisë së varrimit të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, më 5 shkurt 1982 në varrezat e Bad Canstatit në Shtutgart.

„Shoqëria Vullneti“	11970 DEM	
Klubi „Emin Duraku“ i Dyseldorfit	9480 DEM	
	26500 BEF	
	700 FRF	
	150 DEM	
Vëllezërit nga Berni	1410 SFR	
	2000 SEK	(bashkërisht 21960 DEM (pa valuta tjera)
Miku i Hasan Malës nga Manhajmi	200 DEM	
Shokët e Shaqir Shabanit nga Manhajmi	210 DEM	
Shokët e Mynhenit, Abdyl Pacolli	330 DEM	
Hetem Fejza me shokë	300 DEM	
Tezaku i Hysenit	50 DEM	
Shokët e Murat Kryeziut	500 DEM	
Shoku i bacit Jahë	20 DEM	

Shokët nga Sindelfingeni	120 DEM
Shokët nga Zvicra	500 DEM
Shokët nga Cyrihu	200 DEM
Shokët nga Berna	200 DEM
Shokët e Shtutgartit	500 DEM
Shoqëria Bernhauzen	300 DEM
Shoqëria Ahmet Sadikut nga Frankfurti	490 DEM
Shokët nga Mynheni	600 DEM
Shokët nga Ludvigsburgu	330 DEM
Ramadani dhe shoku i tij	200 DEM
Shoku i Nami Ramadanit	100 DEM
Shokët nga Manhajmi	250 DEM
Shokët nga Bitighajmi	1100 DEM
Shoku i Zhujit	100 DEM
Shoqëria Mörs – 3 Replenstrase 14	2200 DEM
Solidariteti Bremen	1300 DEM
Solidariteti "Fronti Popullor"	240 DEM
Ramadan Kurtishi me shokë.	
Këta shokë dhanë gjithsej	930 DEM
Shokët nga Zvicra	980 DEM
	+250 SFR+2130 dinarë
Shokët nga Manhajmi	330 DEM +100 BFR
Miku i Zhujit	300 DEM
Shokët e Zhujit	170 DEM
Shokët e Ahmet Sadikut	
nga Dajmler Benz kontributi i librave	140 DEM
Shokët nga Manhajmi	250 DEM
Frankfurti	970 DEM
Shoku i Mynhenit	100 DEM
Shoku i Nami Ramadanit	20 DEM
Shokët e Zvicrës	1100 SFR
Shoku i Ulqinit	140 DEM
Shokët e Zhujës	600 DEM
Shokët e Murat Kryeziut	200 DEM

Fqinjët gjermanë nga Untergruppenbach 790 DEM (bashkërisht 16260 DEM)
Në mënyrë anonime, përmes shokëve të vet janë dhënë 50786 DM (Marka Gjermane) 2760 SFR (Franga Zvicerane= 3353 DEM, 26600 BEF (Franga të Belgjikës) =1412 DEM, 700 FFR (Franga Franceze)=259 DEM
2000 KR (Korona Suedeze)=774 DEM, 2310 dinarë
Shuma totale së bashku me valutat tjera 56584 DEM

Osman Shemsiu e Shaip Bukoshi	400 DEM
Skënderi me një shoqe nga Ludvigsburgu	200 DEM
Hysen Gërvalla	200 DEM
Rifat Kadriu	620 DEM
Sylejmani nga Boni	100 DEM
Zymber Kryeziu	1200 DEM
Ademi	100 DEM
Ahmeti	100 DEM
Ramushi	100 DEM

Shaqir Shabani	140 DEM	
Ademi me një shok, ka shitur fotografi dhe atë shumë e ka dhënë për ndihmë	10 DEM	+50 SFR
Elfi Agushi, Gjenevë (nga Ferizaj)	500 DEM	
Jahir Jahiri	500 DEM	
Qemal Haxhillari	200 DEM	
Vezir Kelmendi	100 DEM	
Drejtori i shkollës Gjermane	100 DEM	
Fahredin Tafallari	500 DEM	
Nami Ramadani	1000 DEM	
Fetahu	200 DEM	
B. Ramadani	100 DEM	
Latifi	500 DEM	
Fazliu	200 DEM	

Flaka e pashuar e oxhakut në Untergruppenbach

Ramadan Pllana: "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."*

Mahmut Agushi përmes postës	1000 DEM
Muhameti	100 DEM
Zhuji	200 DEM
Niman Osmani	200 DEM
Besim Rexha	100 DEM
Shokët: Smajl Jashari, Arif Jasiqi, Magllan Jahaj, Zenel Gjocaj, Muhamet Dukaj, Mustafë Mazrekaj,	
Nysret Hajdari nga Beningeni/ nga Prishtina	530 DEM

Nuhi Sylejmani nga Sindelfingeni/ nga Llojani	500 DEM
Shabani	100 DEM
Mustafë Bajraktari	100 DEM
Dinë Salihu	100 DEM
Haxhi Berisha	100 DEM
Isa	50 DEM
Sami Ramadani nga Smira	100 DEM
Halim Hasanaj	100 DEM
Ragbi nga Zyrihu	900 DEM
Halili nga Mynheni	200 DEM
Rizah Hoxha	100 DEM
Eshref Morina	100 DEM
Kamber Bajram Alija	20 DEM
Sonja me një shoqe	1300 DEM
Besim Rexhaj	700 DEM
Përmes postës Selim Bega nga Franca	386.84 DEM
Zymer Basha	200 DEM
Ramë Hysaj nga Erlageni	100 DEM
Rifat Kadriu nga Mynheni	100 DEM
Hajrullah Rugova	100 DEM
Kadri Ipek	200 DEM

Shuma totale	14756,86 DEM
	+ 50 Frangat Zvicerane
	14817,61 DEM

Shuma totale (nga ata që ndihmuan pa i dhënë emrat e mbiemrat)	56584 DEM	79%
Shuma totale (nga ata që ndihmuan dhe emrat tyre u shënuan me pëlqimin e tyre)	14817 DEM	21%
	71401 DEM	

Lista e atyre që e kanë mbajtur të pamposhtur nga UDB-a dhe Shkolla e saj, Kështjellën e qëndresës në Habichthöhe 40, FLAKËN TË PASHUAR, është marrë nga: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 157.

Ramadan Pllana: "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës*"

Kursi i valutave për vitin 1982 në raport me 1 dollar amerikan

Gjermani	Francë	Zvicër	Suedi	Belgjikë
DEM	FRF	SFR	SEK	BEF
2.43	6.5721	2.0303	6.2826	45.691

Faridin Tafallari gjithashtu ka thënë se ka shënime se si është ndihmuar lufta në atë kohë.

Përveç të dhënave nga Nuhi Sylejmani, fushata për ndihma lidhur me rastin e 17 janarit 1982 janë bërë edhe në Australi dhe SHBA. Vlen të theksohet se me Kështjellën e Jusuf Gërvallës kanë qenë të lidhur përveç të tjerëve edhe **Bytyçët nga skajet e**

ndryshme të Botës, siç kanë qenë Rilind Bytyçi nga Australia, Sejdi Bytyçi nga New Yorku, Sadije dhe Ibush Bytyçi nga Parisi, Leme dhe Sylejman Bytyçi nga fshati Kravasari, me adresë në Kirch winkel str.5, 5031 Peine, West Germany dhe Mejdi Bytyçi nga Heilbroni e shok i Remzi Ademit.

Rilind Bytyçi dhe Shoqëria Bashkimi Kombëtar "Bajram Curri" në Australi, me të cilët e kisha siguruar unë kontaktin përmes Pajazit Ibrahimit kanë mbledhur ndihma, si për familjet Gërvalla ashtu edhe për shoqen e Kadri Zekës. Çeku bankar që ka ardhë në Shtutgart nuk ka mundur të përdoret pasi ka qenë në emër të një pseudonimi. Sa i përket ndihmës për shoqen e Kadri Zekës i kam drejtuar në adresën që më është dhënë në Zvicër. Kjo është krejt çka di në këtë pikë.

Sejdi Bytyçi nga New Yorku, i cili adresën e Kështjellës së Jusuf Gërvallës e ka siguruar nga policia e New Yorkut, në një letër më 5 qershor 1982 më shkruan këto fjalë:

Sejdi Bytyçi: *"...gjithashtu tani u hap fushata edhe për ndihmën e dy të vejave të vëllezërve Gërvalla."* (Letër Xhafer Durmishit, 5 qershor 1982)

Përveç Sejdi Bytyçit, në një letër të atyre ditëve (pa datë), nga Amerika thuhet kështu:

"Komiteti Shqiptar i Detroitit me rrethe, ditën përkujtimore të dëshmorëve të ri të Kosovës, hapi një fushatë të vogël, më tepër shpirtërore se financiare, të posaçme për familjet e vëllezërve Gërvalla.

Në të njëjtën kohë të gjithë shqiptarët e Michiganit ju ngushëllojnë me zemër për humbjen tragjike tuajën dhe tonën si vëllezër shqiptar. Zoti i past buzë vedit

Me nderime dhe respekt, ***Julian Efa, Xhevdet Hoxhaj"***

Për këto ndihma, dhe atë se në cilën adresë janë dërguar, nuk di. Vlen të theksohet se sa i përket xhirollogarisë së botuar në revistën "Liria", në gusht të vitit 1981;

Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene, Konto 25-45475, Biel-Biene Schweiz

më janë bërë të njohura nga Faridin Tafallari vetëm kontributet e rrethit të Sindelfingenit-Shtutgartit gjatë vitit 1981 dhe këto të dhëna janë publikuar më heret. Pas 17 janarit 1982, e as pas 15 majit 1982 dhe as në ndonjë rast tjetër nuk jam njoftuar për asnjë shifër të vetme.

Në dritën e fakteve të shohim edhe njëherë fjalët e Ibrahim Kelmendit në luftën e tij për njollosjen e Kalasë së pamposhtur të Vëllezërve Gërvalla.

Ibrahim Kelmendi*: "Në fundjavë vërshuan qindra bashkatdhetarë për të shprehur ngushëllimet dhe admirimin për heronjtë. Nuk erdhën sa parashikoheshin, pasi kishte dalë fjala se në Familje të Gërvallajve ku mbahej ceremonia mortore ishin ca njerëz që mbanin evidencë për vizitorët. Edhe kur nuk i njihnin* ***i pyesnin për emër e mbiemër, për vendlindjen dhe i regjistronin*** *ose i detyronin të shënoheshin në libër të zisë me të dhëna të plota personale. Bashkatdhetarët kishin filluar të frikësoheshin se do ta pësonin kur të shkonin për pushime në Kosovë, prandaj një numër i madh i tyre hezitonin të vinin për vizitë ngushëlluese." (Atentatet, f.351-352)*

Një sulm të ashpër në Kalanë e Jusufit me qëllim për ta marrë atë nga brenda, e për ta osmanizuar atë, e bënë edhe Shkolla e UDB-së Serbe - Abdullah Prapashtica me sekretarin e vet, Vëzhguesin Osman Osmani. Në pamundësi për ta vendosur emrin e Abdullahut para fjalëve të tij e kam vendosur emrin e shkollës së tij.

Shkolla e UDB-së*: "**Me direktivat e Skënder Skënderit ndalohej rreptësisht mbajtja e shënimeve për shumat e parave që hynin e dilnin nga arka**,.. **P**avarësisht këtyre sugjerimeve, pavarësisht* ***kërkesës së Suzanës dhe arsyetimeve se mbajtja e shënimeve***

***do t'i rrezikonte njerëzit**, unë vazhdova mbajtjen e evidencës për të hyrat dhe të dalat. Këto shënime isha i shtrënguar t'i mbaja për arsyen e ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë që kisha. " (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 91)*

***Shkolla e UDB-së: "„Mos mbaj shënime", që për mua nënkuptohej: „Ti mos le gjurmë, që të mos jap përgjegjësi unë!"**"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.148)

Faridin Tafallari: "*Po, po edhe këtu gënjen se unë e di fare mirë, kur Xhafer Durmishi të tha mos i pyet njerëzit dhe mos mbaj shënime për emrat por evidento shifrat, se ata po frigojnë... **E unë të them me përgjegjësi se, asnjëherë, asnjëherë nuk janë keqpërdorur të hollat dhe për të gjitha shpenzimet ekzistojnë dhe sot e kësaj dite vërtetimet e rregullta."*** (ASKUSH S'MUND TA ZËVENDËSONTE DHE AS MUND TA ZËVENDËSOJË JUSUF GËRVALLËN!, www.albaniapress.com, 30 shtator 2010)

Në këtë drejtim është shumë interesant se si Shkolla e UDB-së Serbe nuk më akuzon vetëm mua por shumë më tepër e akuzon, pikërisht ashtu siç i ka hije asaj, shokun e mirë të Sadik Blakajt, Ibrahim Kelmendin.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Në këtë pozitë **inferiore** nga ana e „zëvendësit", ndjehej **edhe** udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f. 89)

Sipas Abdullah Prapashticës, sikur Ibrahim Kelmendi ta kishte poseduar superioritetin e tij dhe të Vëzhguesit të tij Osman Osmanit, atëherë Kalaja ka pasur mundësi me u marrë nga brenda.

> **Shkolla e UDB-së Serbe:** *"Pas vrasjes së Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, udhëheqjen e organizatës, në mënyrë misterioze, e mori Xhafer Durmishi. Ky emërim apo vetemërim kishte ndodhur pa dijen dhe pëlqimin tim ... Prandaj, emërimet e tilla, pa ndonjë marrëveshje paraprake me anëtarët e mbijetuar të kësaj Lëvizjeje, do ta degradonin LNÇKVSHJ-në, duke e shtyrë **drejt dobësimit apo shuarjes totale**."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 124)
>
> **Ramadan Pllana:** "*LNÇKVSHJ-ja**, u shua** si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."*

Duket qartë se sulmi sa është djallëzor, shumë më tepër del edhe i pakoordinuar i cili bëhet nga shkolla e UDB-së kundër Kalasë së Jusufit, që mund të përmblidhet me psherëtimën serbomadhe *Kasno Janko na Kosovo stize!* Njëri sulmon duke thënë se ka qenë urdhër i rreptë që çdo kujt t'i merret emri e mbiemri, vendbanimi etj., ndërsa pala tjetër sulmon duke thënë se ka pasur direktiva të rrepta që të mos shënohet asnjë shifër. Si është e mundur që kemi shifra shumë ekzakte dhe kemi emra konkret vetëm për 21% të rasteve. Kjo do të thotë se shkolla e UDB-së, sado që të sulmojë prej dy fronteve, me shpifjet e tyre në mënyrë katastrofale e godasin dhe asgjësojnë njëra tjetrën, ndërsa Kalaja e Jusufit, Oxhaku i Jusufit, për të mirën e nderit të Jusufit dhe shokëve të tij, mbetet e pamposhtur, mbetet në këmbë. Edhe ata 21% të personave që e kanë dhënë emrin e mbiemrin, në mënyrë direkte e indirekte, shumica absolute e tyre përbëjnë bërthamën e atyre që kanë dalur haptazi në luftë kundër pushtimit serb gjatë pranverës e verës së vitit 1981 duke demonstruar nëpër sheshet e kryeqendrave evropiane, dhe me këtë nuk kanë mundur të shkojnë në Kosovë për 20 vite.

Thelbi i kësaj çështje del se direktivat e mia dhe të shokëve të Jusufit kanë qenë që rreptësisht të shënohet çdo shifër dhe po aq rreptësisht nuk guxon askush të pyetet kundër dëshirës së tij se si e pate emrin e mbiemrin. Fakti se 79% për qind e ndihmave janë dhënë nga persona që kanë dashur të jenë anonim flet më së miri për katastrofën e

shkollës së UDB-së në luftë për ta osmanizuar Kalanë e Jusuf Gërvallës, se njerëzit heroik që luftojnë në mënyrë heroike pa menduar në çdo çast tek emri e dukja e tyre, janë Kala e pamposhtur, janë material tepër i papërshtatshëm për t'i manipuluar shkolla e UDB-së në stilin se nuk janë respektuar e nuk u është ditur kimeti sa duhet.

Shkolla e UDB-së Serbe: "Skënder Skënderi (Xhaferi Durmishi-shën im), vazhdonte me punët e tij të „mëdha" politike. Konsultohej vetëm me Suzanën. ... pastaj, ***„detyrimisht" bënte udhëtime „zyrtare", sa në Vjenë, sa në Stamboll****... kurse për mbulimin e shpenzimeve tejet të larta për xhepin e mërgatës, isha i ngarkuar unë... dhe herë pas here Suzana më thoshte se këto para duhet të paguhen." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.90-91)*

Pse Abdullah Prapashtica e udhëzon Nuhi Sylejmanin ta vendos nënshkrimin nën rreshtat e mësipërm, pastaj harron krejtësisht se çka ka bërë dhe të njëjtit i thotë t'i nënshkruaj edhe rreshtat e mëposhtëm.

Nuhi Sylejmani: "Shuma e mbledhur gjatë periudhës ***19 janar 1982, deri më 25 prill 1982****, arrinte shifrën rreth 70.000 marka. Këto mjete në masë të madhe u shfrytëzuan për shërbime juridike, shpenzimet e varrimit, për avokatin e familjes Gërvalla, për shtypin e numrit dy dhe tre të „Zërit të Kosovës", për leje demonstratash,* ***për udhëtime zyrtare në Vjenë e Stamboll,*** *për kthimin e Saime Jusufit në Zvicër, udhëtimin përfundimtar të familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri, kthimin e familjes së Bardhosh Gërvallës në Kosovë etj." (Vrasja e trefishtë, f.156)*

Si mund të kuptohen kontradiktat e citatit nga faqe 90-91 me atë të faqes 156?

Përgjigja është kjo: Nëse unë kam bërë udhëtime nëpër Gjermani, në Vjenë, në Stamboll e në Ankara për ta takuar Engjëll Kolanecin, Sabri Novosellën e Bujar Hoxhën për çështje të familjes së Jusufit, e për çështje të Lëvizjes e të luftës në përgjithësi, atëherë këto udhëtime na dalin të detyrueshme, shpenzime të papërgjegjshme e tejet të larta për xhepin e mërgatës. Por nëse këto udhëtime **nuk** janë bërë për familjet e Vëllezërve Gërvalla, për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës dhe për luftën në përgjithësi **por vetëm e vetëm** për t'iu përgjigjur "pozifave" të imagjinatës së gënjeshtarëve të paskrupullt - të Abdullah Prapashticës dhe Vëzhguesit të tij, atëherë këto udhëtime na dalin zyrtare dhe të justifikueshme.

Në bazë të fakteve të mësipërme, në këtë aradhë luftëtarësh dallohet shumë qartë roli i **Remzi Ademit** dhe shokëve të tij, si kontribuuesit më të fuqishëm të Flakës së Janarit dhe oksigjenit të saj, në ato ditë.

Ramadan Pllana: "LNÇKVSHJ-ja, u shua si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës."

Në mesin e këtyre luftëtarëve që në momentin e caktuar historik u gjendën aty ku e deshti nderi, rrethanat e ndryshme kanë ndikuar që të gjendem edhe unë. Në këtë drejtim jam përpjekur deri në atomin e fundit të energjive të mia, të jem në shërbim të këtyre shtyllave të pamposhtura, të këtyre luftëtarëve të njohur e të panjohur, që të kontribuoj që Lëvizja e Jusuf Gërvallës dhe Zëri i Jusuf Gërvallës të qëndrojnë, të mos mposhten nga UDB-a serbe, as nga vrasja përmes krismës së plumbave, as nga planet vrastare të saj, për t'i vrarë me njollosje e heshtje.

OXHAKU I TIJ I LARTË QËNDROI NË KËMBË I PARRËZUAR DHE I PASHUAR

Jusuf Gërvalla: *"Në ballë i kërceu një damar i trashë.*

Iu bë se ishte rritur për këmishën e dragoit, që dikur ishin përpjekur t'ia shplonin më kot të tjerët. U ngjit lart në tavan, mes frymëve që kaluronin natën, dhe e veshi atë këmishë.

Ç'po ngjante kështu?

I fërkoi sytë. Një zhurmë e brendshme ia kaploi trupin.

Po zgjohej zhurmshëm nga kotja e rëndë shekullore, që e ngurron nganjëherë edhe draguan.

***Oxhaku i tij i lartë, që i mbeti në këmbë** si shenjë e shpotitjeve të Dakë Skelës dhe të Bekë Troshit, atë ditë e sot, shekuj me radhë, **nxjerrë tymin** duaj-duaj dhe pos fluskave të bardha të borës e*

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

***ZËRIT** të thekshëm të kalamajve, s'ka frymë as erë tjetër që ia tollovit fqollat që marrin erë thikë përpjetë." (*Rrotull, Tiranë 1983, faqe 124-125)

Emrush Xhemaili: *"**Në qershor të vitit 1982** në Gjermani me teknikën që kishte lënë dëshmori **Jusuf Gërvalla VAZHDON** botimi i gazetës (së **PASHUAR**-shën. im) **"Zëri i Kosovës".** Redaktor i gazetës ishte Skender Durmishi (Xhafer Durmishi-Skënderi-shën im*). (20 vjet veprimtari, 1982-2002)

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptua më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)." (14 janar 1982)*

FAKTE rreth Lëvizjes së Jusuf Gërvallës

FAKTE për disa "DËSHMI" të shprehura në shkrimin "DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ" të Ramadan Pllanës, në formë të një interviste dhënë Fadil Shytit dhe Kristina Rasit, 17 mars 2009, publikuar në www.albaniapress.com dhe www.pashtriku.org

Citatet e mëposhtme të Ramadan Pllanës, aty ku nuk është shënuar data, janë marrë nga shkrimi i lartpërmendur.

LNÇKVSHJ - Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, Lëvizje në të cilën figura qendrore ka qenë dhe ka mbetur Jusuf Gërvalla, e njohur shkurtimisht e pa shkurtesa si Lëvizja e Jusuf Gërvallës.

1. Fakte rreth Jusuf Gërvallës

Ramadan Pllana: "*Pra, unë, kam pas kontakt me Bujar Hoxhën* ***në tetor të vitit 1979****, me të cilin nuk jam pajtuar kurrsesi që LNÇKVSHJ-ja të ndërroj platformën e vet për bashkim me Shqipërinë. Ai, këmbëngulte që ne t'i kërkonim të drejtat tona në kuadër të RSFJ-së, se, Titoja , sipas tij, ishte i mirë. Nuk do të shpjegoj më shumë, sepse i ke në pjesët e mësipërme për bisedat që i kam pasur me të."* **(**Pse të trazojnë kujtimet e mia, Abdullah Prapashtica?!, www.albaniapress.com, 20 mars 2009)

Ramadan Pllana: *"Në vitin 1978 në «Komitetin Qendror» pranohen edhe dy anëtarë, që kishin marrë besimin nga udhëheqësit e LNÇKVSHJ-së, dhe këta:*

1. "Sokoli", alias, Jusuf Gërvalla, në mesin tonë organizativ ***i njohur si Gazetari****, i propozuar nga Sabri Novosella dhe*

2. "Qemajli", alias, Ramadan Pllana, në mesin organizativ i njohur si Studenti i Frëngjishtes, i propozuar nga Shefqet Jashari." (17 mars 2009, www.pashtriku.org)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptuar më në fund edhe* ***zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ*** *(Komitetin Qendror-shën im)."*

Shefqet Jashari*: "Ta zëmë rastin kur është futur në kryesinë e ngushtë Jusuf Gërvalla.* ***Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka****, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur. Sabriu ka thënë se e njoh një kohë të gjatë, është atdhetarë i mirëfilltë,* ***d.m.th. i painfektuar*** *nga ideologjia e djallit të mallkuar bolshevik." (D*rita, Trelleborg, Suedi, nr. 15, 1997, faqe 15)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptuar më në fund edhe* ***zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ*** *(Komitetin Qendror-shën im)."*

Ramadan Pllana: *"Deri më tani,* ***historikisht, është vërtetuar*** *se në këtë Komitet (Komitetin Qendror të LNÇKVSHJ-shën. im) kanë qenë të angazhuar Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Shefqet Jashari, Jusuf Gërvalla dhe, unë, Ramadan Pllana."* (Avdi Kelmendi-një veprimtar i çështjes kombëtare, www.albaniapress.com, 19 dhjetor 2010)

Ramadan Pllana*: "Sokoli", alias, Jusuf Gërvalla, në mesin tonë organizativ* ***i njohur si Gazetari"***

Shefqet Jashari (për Jusuf Gërvallën): ***"Unë nuk kam ditur si quhet, çfarë profesioni ka****, ku punon dhe jeton dhe ku ka lindur."*

Shefqet Jashari*: "Dihet se ti me Sabri Novosellën nuk keni pasur kontakte të drejtpërdrejta dhe ai nuk ka ditur për ty më shumë se sa që unë i kam treguar.* ***Për ty Sabriu, Metushi e nëpërmjet tyre ndoshta edhe Jusufi kanë ditur aq sa unë i kam informuar për ty****."* (Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009)

Jusuf Gërvalla: "*Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit, gatishmëria e madhe për flijime të larta, ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë. Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët. Kështu e pata kuptuar më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982, Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, 1997, faqe 452-454)

"D O K U M E N T

*Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të **KQ** (Komiteti Qendror-shën im) të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ*

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

*Organizatën e **LNÇKVSHJ** e përfaqësojnë anëtarët e **KQ** (Komitetit Qendror-shën i Xh. D.) Mërgimi (Sabri Novosella) dhe **Shpendi (Xhafer Durmishi)**."* (Ankara, **17 shkurt 1982;** Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptua më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."*

Ramadan Pllana: *"Deri më tani, historikisht, është vërtetuar se në këtë Komitet (Komitetin Qendror të LNÇKVSHJ-shën. im) kanë qenë të angazhuar Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Shefqet Jashari, Jusuf Gërvalla dhe, unë, Ramadan Pllana."* (Avdi Kelmendi-një veprimtar i çështjes kombëtare, www.albaniapress.com, 19 dhjetor 2010)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptuar më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."*

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla"*: "Fjalën pastaj e mori Drita (Suzana Gërvalla-shën. i Xh. D.) e cila u falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se **Shpendi (Xhafer Durmishi-shën. im) ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin (Jusuf Gërvallën-shën i Xh. D.) dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ (Komitetit Qendror-shën. im) të ish-LNÇKVSHJ**."* (Letër dërguar Komitetit Hasan Prishtina, **26 shkurt 1982**; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358)

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982, Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, 1997, faqe 452-454)

Nga faktet e *painfektuara* të Shefqet Jasharit rrjedh se Ramadan Pllana nuk e ka njohur Jusuf Gërvallën **në asnjë mënyrë** e **as përmes profesionit**, pasi këtë punë nuk e ka ditur as vetë Shefqet Jashari **(lidhja e vetme e** Ramadan Pllanës me udhëheqjen e Lëvizjes që duket edhe më mirë nën pikën 2 më poshtë). Nga letra e *infektuar* e Jusufit rrjedh se Jusufi është pranuar në Komitetin Qendror të LNÇKVSHJ pas 17 korrikut 1981, në të njëjtin moment apo me të njëjtin vendim së bashku me Shpendin, përmes Sabri Novosellës.

*"Kështu e pata kuptuar më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ".*** Kjo do të thotë se me gradë, në Kosovë, Ramadan Pllana ka qenë më i lartë se Jusuf Gërvalla.

Çështja se a ka qenë Ramadan Pllana anëtar i Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ është çështje që nuk diskutohet e as kontestohet. Me këtë rast dua të shtoj se unë jam i pari që ia kam përgatitur për publikim faqes www.pashtriku.org, Aktgjykimin e anëtarëve të LNÇKVSHJ të datës 4 qershor 1980, i cili në faqen pashtriku.org u botua më 2 qershor 2010, me disa komente, me titullin "Lufta jonë është e drejtë". Në Aktgjykimin e lartpërmendur, të përgatitur për botim prej meje, vërtetohet se Ramadan Pllana ka qenë anëtar i KQ të LNÇKVSHJ.

Se Ramadan Pllana, "Dëshmitari i dëshmive të kohës", ka qenë anëtarë i Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ e vërteton Shefqet Jashari.

Shefqet Jashari-Strofci*: "Me siguri, Ramadan Pllana, nuk ka harruar se, deri sa ishim në vuajtje të dënimit në Zajeçar, Sigurim Federativ i Jugosllavisë, pati bërë përpjekje për t'i përseritur hetimet ndaj meje, sepse, sipas tyre, gjatë hetimeve të bëra kundër meje në Prishtinë, ''nuk kam zbuluar asgjë'' për Organizatën dhe anëtarët e* ***Komitetit Qendror*** *të LNÇKVSHJ."* (PSE RAMADAN PLLANA GËNJEN DHE SHPIF PËR LNÇKVSHJ DHE UDHËHEQJEN E SAJ, www.shefqet-jashari-strofci.ch, 24 mars 2012)

Por është modestia e tepër e madhe e Ramadan Pllanës që e shtyn mos me i dalë Jusufit përpara, andaj edhe deklaron se është pranuar në KQ në të kohë të përafërt me Jusufin. Shtrohet pyetja: Pse Ramadan Pllana i shtrembëron faktet në mënyrë kaq të tejdukshme për personin kryesor të Organizatës së vetë, përkundër fakteve me shkrim të shkruara nga dora e Jusuf Gërvallës tri ditë para vrasjes?

2. Fakte rreth Bujar Hoxhës, djalit të Kadri Prishtinës (Hoxhë Kadrisë)

Ramadan Pllana nga fshati Shtitaricë, të cilin e mbron Zeqir Arni av. nga Prishtina, sipas detyrës zyrtare, për vepër penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ, ...

... ***GJYKON***

Të akuzuarin Ramadan Pllanën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh." (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Ramadan Pllana: "*Nga analizat dhe shoshitjet e mia që ia kam bërë këtij udhëtimi në Stamboll, qysh nga qëndrimi në Turqi, pastaj në burg, në mërgatë dhe në biseda me shokë kam konstatuar se shkuarja ime në Stamboll, ishte një komplot i kurdisur i disa personave zyrtarë, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, që ishin kundër ribashkimit të Kosovës me Shqipërinë, në krye të të cilit, me gjasë, qëndronte* ***diplomati i shtetit*** *shqiptar* ***Bujar Hoxha****."*

BUJAR HOXHA

KADRI PRISHTINA - babai i BUJAR HOXHËS

Shefqet Jashari: "*Të thuhet se është bërë komplot kundër teje në ato rrethana kur Organizata jonë ishte në formim e sipër, është e papranueshme dhe e pakapshme, kur dihet se ti me Sabri Novosellën nuk keni pasur kontakte të drejtpërdrejta dhe ai nuk ka ditur për ty më shumë se sa që unë i kam treguar.* ***Për ty Sabriu, Metushi e nëpërmjet tyre ndoshta edhe Jusufi kanë ditur aq sa unë i kam informuar për ty****."* (Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009)

Ramadan Pllana: "*Aty, pas një kohe, afërsisht rreth orës15, erdhën dy persona të cilët Tefiku m'i prezentoi si* ***diplomatë*** *të shtetit shqiptar, me gjasë* ***Bujar Hoxha*** *dhe një tjetër me të cilët* ***pata një polemikë të ashpër*** *lidhur me ndryshimin e pikës së parë të Statutit tonë, d.m.th. të hiqnim dorë nga ribashkimi me Shqipërinë."*

Faridin Tafallari: "*Ja po ta shënoj edhe* ***kohën e Bujar Hoxhës****, ish punonjës në Ambasadën e Shqipërisë në Ankara të Turqisë. Ai ka qenë që nga* ***QERSHORI I VITIT 1981 deri ne TETOR 1982*** *(emërtimi) MINISTER FUQIPLOTE I SHQIPERISE ne ANKARA (të dhëna nga e bija)."* (Letër Xhafer Durmishit, 28 tetor 2009)

Shefqet Jashari: "*Për Shqipërinë Organizata jonë dhe as udhëheqësia e saj nuk kishin në atë kohë, atë forcë dhe rëndësi që Partia e Punës do të duhej të bënte komplote në atë mënyrë siç mendoni ju ndaj njerëzve të saj."* (Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009)

Thelbi i kësaj çështje del ky: Kur Ramadan Pllana ka qenë në Stamboll nga 5-8 tetor 1979, Bujar Hoxha nuk ka shërbyer si diplomat në Turqi. Në kohën kur Bujar Hoxha ka qenë diplomat në Turqi, nga qershori 1981 deri në tetor 1982, Ramadan Pllana ka qenë në burg.

3. Fakte rreth Lëvizjes së pashuar të Jusuf Gërvallës

Ramadan Pllana: *"- LPRK-ja, më vonë LPK-ja, si vazhdimësi e Lëvizjes gjithpopullore, në udhëheqësinë e vet, kishte anëtarët më konsekuentë të OMLK-së, LNÇKVSHJ-së, e të shumë grupeve të tjera, që kishin vepruar pa u ndalë kundër okupatorit serbo-sllav. Mirëpo, De facto:* ***LNÇKVSHJ-ja, u shua si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës****. Praktikisht, me vrasjen e Jusufit dhe Kadriut, të cilët ishin pionierët e bashkimit të mirëfilltë të të gjitha organizatave patriotike në Kosovë dhe në viset tjera të ish RSFJ-së, do të zbehet edhe aktiviteti organizativ, që do të zgjatë deri në lirimin e të dënuarve të ndërgjegjes kombëtare, sidomos të atyre, që u gjykuan për organizimin e demonstratave të vitit 1981. Kurse, De jure: Aktiviteti i LNÇKVSHJ-së* ***u shua*** *një muaj pas atentatit makabër që u bë në Shtutgart më 17 janar të vitit 1982. Pra, një muaj, pas rënies heroike të dëshmorëve të*

lartpërmendur, më 17 shkurt të vitit 1982. Në Turqi, Sabri Novosella, në emër të LNÇKVSHJ-së, dhe Abdullah Prapashtica, në emër të PKMLSHJ-së, pa e përfillur OMLK-në, me të cilën, Jusufi e Kadriu, i kishin bashkuar aktivitetet nga viti '81, ***në prezencën paternaliste të diplomatit*** *të shtetit shqiptar në Turqi,* ***Bujar Hoxhës****, - shpallin të formuar Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ).*"

Kadri Rexha: *"Edhe qëllimi i tretë do të dështojë. Dhe, këtu nuk kam asnjë fije dyshimi. Sikur Skënderbeu, edhe Jusuf Gërvalla, për jetë të jetëve do t'i çajë shekujt e historisë, si trim i mirë me shokë shumë."* (Mendjelehtësi apo diçka tjetër, lidhur me artikullin „Katër rrëfime për Jusuf Gërvallën", të nënshkruara nga Fokusipress, botuar në gazetën „Fokusi", nr. 10, datë 17 janar 2004, faqe 3-7)

Përkundër fjalëve Ramadan Pllanës LNÇKVSHJ nuk është shuar me vrasjen e Jusufit e Bardhoshit. Vrasja e Kadriut nuk mund të shtrohet në relacion me LNÇKVSHJ pasi ai ka qenë i një organizate tjetër dhe në punët e të cilave nuk më takon të përzihem qoftë edhe në rolin e avokatit. Shokët e Jusufit dhe Bardhit pas vrasjes së tyre, kanë:
- organizuar demonstratë në Shtutgart më 23 janar 1982,
- organizuar varrimin madhështor më 5 shkurt 1982, i cili gjithashtu ka qenë një veprim shumë më i madh se një demonstratë e zakonshme,
-bashkorganizuar demonstratë më 3 prill 1982 në Bon
- vazhduar e përjetësuar Zërin e Kosovës, si Zë i Jusufit, në mars, i cili ka jehuar deri sa është larguar edhe ushtari i fundit i Serbisë nga Kosova,
-kanë organizuar demonstratë në Vjenë, më 24 prill 1982.

Ibrahim Kelmendi: "*Në muajin mars Xhafari (Xhafer Durmishi-Skënderi-shën im) nxori* Zërin e Kosovës." (Atentatet, faqe 389)

Suzana Gërvalla: "*Ne me të vërtetë këtu kemi shoqëri të re dhe përkrahje të madhe por mendët i kemi atje te ju te varrezat e Shtutgardit, se atje i lam ata ma të afërmit. E tash nuk dimë as si duken varrezat e tyre, spati kush me na que asnjë fotografi prej atjehit. Tash unë më nuk e shof as* ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e të cilën e punova unë me këto duar pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptuar më në fund edhe* ***zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ*** *(Komitetin Qendror-shën im)."*

Përkundër të gjitha këtyre megjithatë nga deklarimet e Ramadan Pllanës mund të nxirret një konkluzion. Me fjalët e tij ai ka kërkuar që me gjithë këtë punë e gjithë këtë vitalitet që e kanë treguar shokët e Jusufit, pikërisht për meritën e Jusufit, ai nuk është i interesuar të identifikohet me te, megjithëse e ka pasur një lloj të drejte morale ta bëjë këtë. Por ky është problem për te. Ai është i lirë dhe me fjalët e veta ka deklaruar se nuk është i interesuar të identifikohet me asnjë punë që shokët e Jusufit e kanë bërë pas vrasjes së tij, si në Shtutgart apo nga ata prej të cilëve janë angazhuar e kanë marrë kontakt me Kështjellën e tij në Untergruppenbach, prej skajeve të Globit, me vendosmërinë më të madhe për ta vazhduar qëndresën.

Teksti i tij i lartpërmendur përmban njëzetmijë (20000) fjalë, ndërsa unë në 5 citatet nga ai i kam përdorë vetëm 444 fjalë, d.m.th. i kam analizuar vetëm për pak më shumë se 2% nga teksti i tij i përgjithshëm.

Këto fakte të parashtruara prej meje po i plotësoj me fjalët e Halil Matoshit dhe shokut të Ramadan Pllanës, Emrush Xhemailit.

Halil Matoshi: "*Lidhur me rolin e LNÇKVSHJ dhe të Jusuf Gërvallës në demonstratat e vitit 1981, fjalën e vetë do ta thotë historia, por një gjë dihet botërisht: nuk është zhvilluar asnjë proces politik në gjykatat serbe të Kosovës gjatë viteve të tetëdhjeta ku të mos jetë përmendur emri i Jusuf Gërvallës dhe gazetat e tij "Lajmëtari i lirisë" dhe "Zëri i Kosovës*". (Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, f. 104)

Emrush Xhemaili: *"**Në qershor të vitit 1982** në Gjermani me teknikën që kishte lënë dëshmori Jusuf Gërvalla **vazhdon** botimi i gazetës (së pashuar-shën. im) "Zëri i Kosovës". Redaktor i gazetës ishte Skender Durmishi (Xhafer Durmishi-Skënderi-shën im*). (20 vjet veprimtari, 1982-2002)

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptuar më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."*

Shefqet Jashari-Strofci: "*I dashur Xhafer, E lexova me vëmendje dhe interesim të veçantë shkrimin tënd: **"Flaka e pashuar e Lëvizjes në Untergruppenbach"**. Ishte një punim shumë i rëndësishëm për t'i rrëzuar për toke gënjeshtrat dhe shpifjet e vjedhësve (hajnave) të historisë. Të përgëzoj për këtë punë të vlefshme dhe të çmuar për Historinë tonë më të re. I Madhi Zot të ruajt nga djalli i mallkuar dhe nga djajtë-njeri dhe të dhashtë vullnet, forcë dhe energji për t'i luftuar manipuluesit e shumtë, që po bëjnë përpjekje për shtrembnimin e ngjarjeve të rëndësishme të Historisë tonë kombëtare, si dhe mohimin e personaliteteve që ndikuan fuqishëm në ato ngjarje. Me nderime vëllazërore, Shefqeti (20 janar 2011)*

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptua më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."*

Ramadan Pllana: *"Në Turqi, zyrtarisht, ishte formuar Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ), një muaj pas vrasjes makabër të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, nga përfaqësues të dy grupimeve patriotike të fshehta, Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica (të arratisur politik nga Kosova), kur me ndërmjetësimin e ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxha shpallin bashkimin e organizatave ilegale. LRSSHJ ishte vazhdimësi e organizatave, LNÇKVSHJ, OMLK, FKP dhe i PKMLSHJ. **Ky bashkim kishte dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për të drejtat e barabarta të shqiptarëve me popujt tjerë në ish-Jugosllavi, për krijimin e Republikës së Kosovës bashkë me të drejtën për shkëputje në rast të shpërbërjes së RSFJ-së."*** (Xhavit Haziri - një hero i merituar, www.albaniapress.com, 1 shtator 2011)

Shefqet Jashari-Strofci: "*I dashur Xhafer, E lexova me vëmendje dhe interesim të veçantë shkrimin tënd: **"Flaka e pashuar e Lëvizjes në Untergruppenbach"**. Ishte një punim shumë i rëndësishëm për t'i **rrëzuar për toke gënjeshtrat dhe shpifjet e vjedhësve (hajnave) të historisë."***

Jusuf Gërvalla*: "Kështu e pata kuptua më në fund edhe **zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ** (Komitetin Qendror-shën im)."*

Raporti Jusuf Gërvalla - Xhafer Durmishi

Shënim hyrës: *Ky punim u botua për herë të parë në faqen www.pashtriku.org më 18 janar 2011. Në atë kohë unë i kam përmend të gjitha letrat që kanë qenë bërë publike deri atëherë. Në ndërkohë është publikuar edhe njëra prej letrave më të rëndësishme të Jusufit, Raport dërguar degës së LNÇKVSH në Turqi me emrin "Hasan Prishtina", që mban një datë të shënuar me dorë, 31 korrik 1981. Kështu numri i letrave dërguar Sabri Novosellës nuk është 6 ashtu si kam menduar në janar 2011, por është 7.*

Në vitin 2010, mund të thuhet se letrat që ia ka shkrua dora e Jusuf Gërvallës, si anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe për llogari e për luftën e pavdekshme të kësaj Lëvizjeje, janë bërë publike. Jusufi ka shkruar pak letra, por rëndësia dhe vlera e tyre besoj se është klasike.

Nga letrat e publikuara,

-1 i drejtohet Enver Hoxhës (19 gusht 1980)

-3 Ibrahim Kelmendit, (e para në pranverë 1980, e dyta në nëntor 1980 dhe e treta më 15 janar 1982)

-2 letra Kadri Zekës, (e para më 7 dhjetor 1981 e dyta më 15 janar 1982)

-4 letra Nuhi Sylejmanit (anëtarit të LNÇKVSHJ)

-3 letra Faridin Tafallarit (anëtarit të LNÇKVSHJ)

-7 letra Sabri Novosellës (kuadrit udhëheqës të LNÇKVSHJ, para të cilit Jusufi, përveç punëve të furishme me iniciativë të tij, ka raportuar dhe ka marrë udhëzime të cilat ai vetë dhe me përkrahjen e shokëve i ka vu në jetë).

Këto shtatë letra të dërguara Sabri Novosellës-Maxhunit, janë dokumente të rëndësishme sa i përket punës së Jusufit si luftëtar e ideolog por edhe fakte që hedhin dritë mbi çështjet e brendshme të LNÇKVSHJ dhe raportet e saj të jashtme me organizatat tjera. Letrat janë të shkruara nga 14 prilli 1981 deri më 14 janar 1982.

Datat konkrete të këtyre letrave apo raporteve të LNÇKVSHJ janë këto:

1. Letra e parë, 14 prill 1981
2. Letra e dytë, 13 maj 1981
3. Letra e tretë, 16 qershor 1981
4. Letra e katërt korrik 1981
4. Letra e pestë, 20 gusht 1981
5. Letra e gjashtë, 5 nëntor 1981
6. Letra e shtatë, 14 janar 1982.

Nëpërmes udhëzimeve të Sabri Novosellës, kam shkuar në Shtutgart e Untergruppenbach, më 17 korrik 1981.

Pseudonimi i cili është përdorur për herë të parë nga Sabri Novosella për mua para Jusufit, përmes bisedës telefonike me Bardhoshin, apo ndonjë letre ka qenë "Shpendi". Pseudonimi Shpendi përdoret nga Jusufi në raportet-letrat dërguar Sabri Novosellës. Prania ime vërehet menjëherë në të gjitha letrat e Jusufit dërguar Sabri Novosellës, pas 17 korrikut 1981.

Sqarim pseudonimesh:

Shpendi=Xhafer Durmishi
Besniku=Bardhosh Gërvalla

Jusuf Gërvalla: *"Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, e **unë, Shpendi Besniku** jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana **e Shpendit, e Besnikut** dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe **Shpendi edhe Besniku**, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne. (...)*

*Mbrëmë ishim me Besnikun te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë. **Unë, Shpendi e Besniku**, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; E botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Nga letra e mësipërme shprehen që në fillim fakte se çfarë ndihme mund të pret Jusufi prej meje qysh në fazat përgatitore të gazetës.

Jusuf Gërvalla: *"Paska qenë e logjikshme nga ana juaj që të ndruheni se mos unë ia kam kthyer shpinën ose kam ndër mend t'ia kthejë Lëvizjes, duke kaluar në taborin e ndonjë organizate tjetër. **Kjo nuk do të ndodhë kurrë**. Përkatësisht, deri në çastin që të bindem plotësisht se Lëvizja e ka lënë rrugën e drejtë dhe, në vend që të luftojë si duhet për popullin, i sjell dëme pikërisht kësaj lufte. Shenjat për këtë, fatbardhësisht, nuk janë dukur gjëkundi deri më këtë çast. Bashkëluftëtarët tanë, në paçin sado pak veçoritë dhe virtytet e tua luftarake e patriotike, Mërgim, mund të mburren se janë duke u shkrirë si qiriu, që populli të shohë dritë.*

*Është e tepërt të thuhet se do t'i çojmë në vend këshillat, sugjerimet dhe urdhrat që do të na vijnë nga ana juaj. Këtë mendim e kanë plotësisht edhe **Shpendi e Besniku.***

Më lejo të kalojmë te disa çështje mbi përgatitjen sa më të mirë të "Zërit të Kosovës" në të ardhmen. (...)

Nga temat e ngjashme, që propozova më lart, unë kam ndarë për vete të shkruaj në numrin 2 një artikull mbi mbrojtjen e kishave dhe të manastireve serbe nëpër Kosovë nga shqiptarët në të gjitha furtunat e tashme. Do të shërbehem me disa të dhëna që jep Dr. Mark Krasniqi në librin e tij "Gjurmë e gjurmime". Qëllimi është të sheshohet respekti i kosovarëve ndaj monumenteve të huaja të kulturës dhe mosprirja e tyre për vandalizëm, në një anë; në anën tjetër," shpërblimi" i pushteteve serbe për këtë mbrojtje dhe shovinizmi i tyre në gjithçka që ka të bëjë me shqiptarët si "racë më e ulët" në krahasim me ta.

*Pres propozime e sugjerime edhe për tema të tjera, me realizimin e të cilave do të rrekeshim **unë, Shpendi e Besniku**.*

(...) *Adresën e B. Krasniqit (**Besnik Krasniqit-djalit të Metush Krasniqit**-shën i Xh. D) do ta sigurojmë dhe të ta dërgojmë sa më shpejt që të jetë e mundshme. Me **K. (Kolë Mërturin - shën im)** do të bisedojmë për ato që u morëm vesh, Djelmoshave të tjerë në Romë, **Besniku** (Bardhosh Gërvalla-shën i Xh. D.) u kishte lënë 200 dollarë, këtu e kemi një shok të njërit prej tyre dhe prandaj shpresojmë se do ta fitojmë besimin e tyre dhe t'i bëjmë shokë edhe ata."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981. Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-276)

Kjo letër më lart është shkruar pas dështimit të bisedimeve për bashkim në mes LNÇKVSHJ dhe OMLK në Stamboll në tetor 1981.

Jusuf Gërvalla: "*Por që atëherë kushtet kanë ndryshuar shumë. Tash ka dalë sheshit pezmi i madh i popullit, gatishmëria e madhe për flijime të larta, ideja e luftës për liri është materializuar më shumë se kurrë. Sipas njohurive të mia të pakta teorike, më duket se tash, në vend të reduktimeve e të përkufizimeve, duhet të aplikojmë zgjerimin e furishëm të radhëve, ashtu siç thotë Lenini me një rast, madje në atë mënyrë që rekrutët e rinj të zënë vendin e luftëtarëve të rëndomtë, kurse ushtari i vjetër të zërë vendin e oficerit të ulët.* ***Kështu e pata kuptua më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Xhafer Durmishit-shën im) dhe timen në KQ (Komitetin Qendror-shën im).*** *Rinia jonë revolucionare po kërkon radhët e revolucionarëve të organizuar. (...)*

Edhe një lajm jo fort të mirë kam për ju. Me insistimin e ***Shpendit****, për të mos thënë me presionin e tij,* ***Shpendi*** *shkoi në Kosovë për një qëndrim të shkurtër, disa kohë para vitit të ri. Së andejmi u paraqit disa herë në telefon, e së fundi disa ditë para vitit të ri, kur tha se do të kthehej menjëherë pas vitit të ri. Mirëpo, sot jemi më 14 janar, e ai as na thirri më, as erdhi. Por, jemi të brengosur shumë se mos i ka ndodhur gjë. Ndonjë lajm, a shenjë për të keq nuk kemi, veçse vonesa e tij na brengos. Nëse ka fat dhe kthehet, ai do të na sjellë materiale me vlerë, sepse për atë qëllim edhe pat shkuar."* (Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982. E botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

Kjo letër më lart është përgjigje definitive për të gjithë ata që kanë fabrikuar rrena skandaloze rreth asaj se kanë qenë në Komitet Qendror me Jusufin apo janë pranuar në këtë Komitet në kohë të përafërt apo me të njëjtin vendim së bashku me Jusufin.

Në këtë drejtim jam i detyruar me i përmend këto fakte dhe më vjen keq, pasi çdo njeri i arsyeshëm e kupton se kujtimet e gjalla e përjetimet gjatë përpjekjeve për liri dhe në kohë të lira (në rastin tim) për gati 5 muaj rresht janë në mënyrë të pakrahasueshme më interesante dhe ua kalojnë këtyre 833 fjalëve në këto letra. Në këto letra nuk jam thirrur kurrë dhe nuk kam ndier nevojë të thirrem kur janë në pyetje shokët e vërtetë të Lëvizjes së Jusufit të cilët i kanë ruajtur dhe publikuar këto dokumente. Por, për shkakun se këto letra e këto fjalë do ta mbijetojnë jetën e shumë e shumë TRUPAVE është shpresa ime që të jenë edhe varr i mjaftueshëm i shumë TURPEVE, gënjeshtrave, shpifjeve e përpjekjeve të mjera për denigrime që e kanë burimin në urrejtjen që disa e kanë ndaj "Zotit" apo Natyrës, për shkak se "Ai" apo Ajo nuk ua ka dhënë atyre atë që ma ka dhënë mua.

Pseudonimi **Shpendi** (si anëtarë i Komitetit Qendror të LNÇKVSHJ) për mua Xhafer Durmishin është përdorë në Dokumentin e bashkimit të 17 shkurtit 1982 në Ankara, në mes LNÇKVSHJ dhe Partisë "Komuniste" (P'K'MLSHJ).

"D O K U M E N T

Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të ***KQ*** *të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ*

Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre dy organizatave në një të vetme.

Organizatën e ***LNÇKVSHJ*** *e përfaqësojnë anëtarët e* ***KQ*** *(Komitetit Qendror-shën. im) Mërgimi (Sabri Novosella) dhe* ***Shpendi (Xhafer Durmishi****).*

Organizatën e PKMLSHJ e përfaqësojnë Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) dhe Halimi (Osman Osmani), anëtar të KQ. Në këtë mbledhje merr pjesë edhe anëtari i KQ të PKMLSHJ Qemali (Faton Topalli) si përfaqësues i këtyre bisedimeve.

Pas afër tre muajsh bisedime dolëm me propozime konkrete.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Halimi (Osman Osmani) doli me këtë propozim; të bëhet shkrirja e dy organizatave në një të vetme me emrin "LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI" (LRSHJ).

LRSHJ të ketë një platformë, program e statut të vetëm, një KQ, një organ (revistë, gazetë) qendrore.

LRSHJ do të formoj organizatat e veta të brendshme; të gjitha organizatat që i ka një Republikë Federative Jugosllave.

*Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ **Shpendi** (Xhafer Durmishi) deklaroi:*

-Pajtohem që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj si e tillë deri në momentin kur të realizohet kërkesa për formimin e Republikës.

Përfaqësuesi i PKMLSHJ Kushtrimi (Abdullah Prapashtica) deklaroi:

-Pajtohem me propozimin e dhënë për bashkimin e organizatave tona dhe për mënyrën e organizimit të cilën e parashef ky propozim. Gjithashtu jam i mendimit që organizata në fjalë (LRSHJ) të ekzistoj deri te arritja e kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi, për konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi.

Përfaqësuesi i LNÇKVSHJ Mërgimi (Sabri Novosella) deklaroi:,

*-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga **Shpendi** (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.*

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës, propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin "Zëri i Kosovës".

V E N D I M

I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ

1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. Organizatat e brendshme do të organizohen simbas shembullit të republikave tjera të Federatës Jugosllave.

3. Më vonë të formohet komisioni nga anëtarët e KQ për përpilimin e tezave të programit dhe statutit të LRSHJ.

4. Në KQ të hyjnë anëtarët e dy KQ të mëparshme në përbërje të plotë.

5. Udhëheqja e KQ të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme të KQ.

6. Organi i LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës" pasi ky emër shpreh zërin e Kosovës, kurse organi i Rinisë të quhet "Republika".

Qemajli (Faton Topalli)

Shpendi (Xhafer Durmishi)
Halimi (Osman Osmani)
Kushtrimi (Abdullah Prapashtica)
Mërgimi (Sabri Novosella)

17 shkurt 1982" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)

Pseudonimi **Shpendi,** për mua është përdorë edhe në mbledhjen e formimit të Komitetit Vëllezërit Gërvalla, në Ludwigsburg në Studentenwohnheim,
Eduard-Spranger-Straße 7, 71634 Ludwigsburg
"*Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"*
Të dashur shokë!

*Udhëtimin e **Shpendit** e quajtëm si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm. Ditën kur u kthye **Shpendi** pra të hënën, ditën e parë të javës, kur shokët ia filluan javës së re të punës.*

*Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishin farë automjeti, mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirrur gjer më 26 shkurt 1982. Atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën: **Shpendi** (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Drita (Suzana Gërvalla), Agimi (Nuhi Sylejmani), Agroni dhe Guximi (Haxhi Berisha).*

*Mbledhjen e hapi **Shpendi** i cili në fillim i **njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën** e re dhe me detyrën e qëllimin e ardhjes së Halimit.*
Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:
Formimi i degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore.
a) Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet "Komiteti Vëllezërit Gërvalla".
b) Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë
Të ndryshme
Ky rend dite u aprovua njëzërit nga të pranishmit.

*1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit, pra pesë veta. Meqë Agimi ishte edhe më parë si arkatar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe **Shpendin** nuk u diskutua shumë rreth tyre se a duhet të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që Komiteti t'i ketë edhe dy kandidatë. Ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimi që në fillim tha se pyetjen për arkatar nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkatarin e vyeshëm e kemi që nga fillimi. Propozimi i Arsimit që edhe më tutje të jetë arkatar Agimi i aprovua.*

*Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkoj në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë në mesin tonë. Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e mori Drita e cila u falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se **Shpendi (Xhafer Durmishi-shën. im) ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ (Komitetit Qendror-shën. im) të ish-LNÇKVSHJ**. Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore. Edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan. Për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.*

Në këtë Konvikt, në katin 10, dhoma nr.10, më 26 shkurt 1982 u formua "Komiteti Vëllezërit Gërvalla"

Me shkuarjen e Dritës (Suzana Gërvallës në Shqipëri-shën i Xh. D.) ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet Halimi. *Ndërsa anëtarë i ri i komitetit do të jetë Arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të zgjidhet Luli.*

a) Propozimi që komiteti të quhet "Vëllezërit Gërvalla" u aprovua njëzërit.

b) Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari i ri Halimi edhe ca anëtarë të tjerë të ish-LNÇKVSHJ nuk dinin shumë në lidhje me përbërjen në numër të një komiteti, mbretëroi pak heshtja. Me këtë rast Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon qe disa vjet dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperiencë lidhur me funksionimin e një komiteti të tillë sidomos në kushtet jashtë atdheut dhe pasi ne ishim të pranishëm tetë ndërsa komiteti do të kishte vetëm pesë anëtarë. Halimi tha se faktikisht për anëtarët e këtij komiteti po dinë 8 veta. Ai tha se edhe ata aktivist të dalluar të jen si kandidat për

komitet. Ky propozim dhe arsyetimi i cekur më lartë u pranua. Pra komiteti i degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla" për Evropën Perëndimore ka me shkuarjen e Dritës ai do të duket kësisoji:

1. Shpendi	*Kryetar*	*Xhafer Durmishi*
2. Drita/Halimi	*Sekretar*	*Suzana Gervalla/Osman Osmani*
3. Agimi	*arkatar*	*Nuhi Sylejmani*
4. Agroni	*anëtarë*	*Faridin Tafallari*
5. Halimi	*anëtar*	*Osman Osmani*
6. Halili	*kandidat*	*Hafiz Gagica*
7. Guximi	*kandidat*	*Haxhi Berisha*
8. Arsimi	*Përgjegjës i rinisë*	*Naim Haradinaj*

2) Në pikën të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, çështjet materiale, puna rreth vendosjes në një bazë të re dhe nxjerrjes sa më të shpejtë të numrit të ri të organit.

Për këto dhe të tjerat herën e ardhshme.

Ju përshëndesin shokët e "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"

Kosova – Republikë" (Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 357-358)

Pas 15 majit 1982 pseudonimi ***"Shpendi"*** nuk është përdorur më. Nikoqiri i takimit të 14-15 majit 1982, për mua Xhafer Durmishin-Skenderin, sa i përket shkëmbimit të letrave, ka zgjedhur një pseudonim tjetër e modest për mua. Ka qenë bindja e ime e thellë, qysh në atë kohë, se misioni i tij në jetë, misioni i fluturimit të ***Shpendit*** është kryer më mirë se sa ai e ka pritur nga krahët e tij.

ZËRI I LËVIZJES DHE INFERIORITETI I PARTISË "KOMUNISTE"

1. Inferioriteti i "Luanit" të Partisë "Komuniste"
2. Partia "Komuniste" gjithmonë na e garanton nisjen prej zeros
3. Inferioriteti i Partisë "Komuniste"
4. Misioni i sekretarit të Partisë "Komuniste"
5. Definimi i rebelimit sipas "komunistëve" të Shkollës së UDB-së Serbe
6. Gjatë një kohe, kam qenë anëtar i vetëm një Organizate
7. Pse LNÇKVSHJ një muaj pas 17 shkurtit 1982?
8. Partia "Komuniste" kundër hienave sllave para proletariatit gjerman

1. Inferioriteti i "Luanit" të Partisë "Komuniste"

Shkolla e UDB-së Serbe (përmes Nuhi Sylejmanit)*: "Edhe pas propozimit tim që të formohej **një organizatë e ngjashme politike** e mos të bëheshin përpjekje për ta zëvendësuar atë që ishte e pamundur, nuk më ngeli gjë tjetër veçse t'i përfillja urdhrat e zonjës së shtëpisë, e cila e kishte pranuar zëvendësimin e autoritetit të burrit të saj me njëfarë Skënder Skënderin, dhe e heshtur i ishte nënshtruar diktatit fantazmë të Sabri Novosellës."* (Vrasja e trefishtë, f.88)

Shkolla e UDB-së Serbe:: *"Deri në një masë, njerëzit ishin njoftuar për „zëvendësin“ e Jusufit. Ai nuk përfillte askënd... Ndaj nesh, „vartësve të tij“, siç na konsideronte,* ***ishte shumë i vrazhdë. I përbuzte mendimet apo përpjekjet e të tjerëve****.."* (Vrasja e trefishtë, f.88)

Muharrem Blakaj*(redaktori i librit Vrasja e trefishtë): "Sesa kishte pasur të drejtë Jusuf Gërvalla që bëri një përzgjedhje të tillë, flet vetë Nuhi Sylejmani, autori i këtij libri, duke shpalosë kujtimet e tij të veneruara nga një këndvështrim tjetër,* ***të përjetuara nga një inferioritet vandal****, por gjithsesi të mbështetura me fakte e dokumente autentike të kohës."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 7-8)

Shkolla e UDB-së Serbe tërbohet pse edhe nipi i dajës Ramë, Ibrahim Kelmendi shfaq inferioritet të ngjashëm me inferioritetin vandal të "Luanit" Nuhi Sylejmanit.

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Në këtë pozitë* ***inferiore*** *nga ana e „zëvendësit“, ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi."* (Vrasja e trefishtë, f.89)

Pak ditë pas përjashtimit të Ibrahimit, rreth 20 marsit 1982 ka dal "Zëri i Kosovës" si organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Vazhdimi i Zërit të Jusufit, Zë i cili jehoi deri sa u largua edhe ushtari i fundit me uniformën pushtuese prej Kosove është një punë që më bënë krenar. Bile pas botimit të këtij numri e kam pasur shpesh një ndjenjë të thellë se misioni im për të cilin kam lindur në këtë jetë, qysh në moshën time 23 vjeçare është kryer.

Më lartë e pamë inferioritetin vandal të "Luanit"- të Nuhi Sylejmanit, të konstruktuar në vitin 2010. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit nuk paraqet rëndësi pasi ai ka nuk ka qenë anëtarë i LNÇKVSHJ, sepse Lëvizja e Jusufit nuk ka pasur ndonjë marrëveshje me te.

2. Partia "Komuniste" gjithmonë na e garanton nisjen prej zeros

A nuk do të ishte shumë më interesant ta analizojmë inferioritetin vandal të Abdullah Prapashticës dhe sekretarit të tij Osman Osmani, të marsit 1982, të cilët përdridhen si bolla. Sa herë t'ua kërkoj interesi, sa herë që shqisat e tyre i informojnë se janë në rrugën e dominimit të të tjerëve - deklarohen se janë anëtarë të Lëvizjes së bashkuar, e cila emrin Lëvizje (me 'L' të madhe), e kishte marrë nga Lëvizja e Jusufit. Sa herë që shqisat e tyre gjarpërore i informojnë se hapi i tyre për dominim dështoi, atëherë ata me shpejtësinë e vetimës shndërrohen në anëtar të Partisë "Komuniste", dhe bëhen vëzhgues. Pse manifestohet kjo dyfytyrësi e këto lakime si të bollës? Sepse në çdo rast kur pësojnë disfata në kuadër të Lëvizjes, është anëtarësia në Partinë "Komuniste" ajo që u ndihmon të përgatisin sulme të reja, plane të reja, pajtime të reja, gjarpërime të reja, betime të reja se më nuk do të jenë prodhues të helmeve të reja. Thirrja në Partinë "Komuniste", edhe pas 17 shkurtit 1982, u jep mundësi (sipas logjikës së tyre djallëzore) që çdo herë, në çdo kohë të shkruajnë letra historike e ftesa për të biseduar me të tjerët e me këdo qoftë, nga pozita të barabarta. Përfundimi i kësaj logjike gjarpërore e dyfytyrëshe është: Nëse kemi gjasa me fitua gjithçka, jemi anëtarë të Lëvizjes. Nëse, krejt krejt rastësisht, për shkak të komplotistëve - ndikimi i të cilëve është vështirë të parashikohet, nuk fitojmë gjithçka, atëherë ne e kemi planin rezervë, planin B, që e fusim në mënyrë krejtësisht automatike në veprim dhe bëhemi anëtar të Partisë "Komuniste", dhe si rrjedhim i gjithë kësaj është se Partia "Komuniste" na garanton se edhe atëherë kur nuk fitojmë, të paktën nuk kemi humbur asgjë.

Në teori kështu duket mekanizmi i kësaj loje, që nganjëherë ka njëfarë suksesi të vogël në praktikë, por si rregull këto farë krijesash me dy mendje kurrë nuk kanë krijuar diçka me vlerë historike. Vetëm ata që kanë vepruar me një mendje kanë krijuar histori dhe këtë do ta bëjnë edhe në të ardhmen.

3. Inferioriteti i Partisë "Komuniste"

Ta analizojmë inferioritetin vandal të Abdullah Prapashticës dhe Osman Osmanit.

Në nëntor 1981, gjenden në Turqi kryetari i Partisë "Komuniste" Abdullah Prapashtica-Kushtrimi (dajoku), sekretari Osman Osmani-Halimi, dhe kryetari i organizatës së rinisë Faton Topalli-Qemali (nipi). Për heroizmat e tyre gjatë vitit 1981 në Kosovë nuk dua të flas, pasi ata kanë shkruar vet. As për mendjemadhësinë e paskrupullt pas daljes në Turqi, nuk ia vlen barra qiranë me humbë kohë. Por çka është e vërteta, është se me ndihmën e kësaj mendjemadhësie skandaloze dhe me ndihmën e Bujar Hoxhës, ia bien Sabri Novosellës diellin mbi krye, sa që ai nuk mundet një çaj me e pi rahat, apo me e bërë një bisedë të qetë me turqishten e tij me theks Vjenezo-Prishtinas, as me hanmin e as me abllën, e lere më me tjetër kend.

Abdullahu, Osmani dhe Fatoni i kanë vendosë nënshkrimet e veta në një Dokumentin e bashkimit të 17 shkurtit 1982, vullnetarisht pa i detyruar askush, në një bisedë shumë të qetë. Nuk mundem me e përshkrua momentin dhe procesin psikik në kokat e tyre se kur janë penduar për nënshkrimet e tyre, por kjo nuk ka zgjatë shumë. Sipas të gjitha gjasave, pija apo hipnoza zhbiruese u ka dalë qysh ditën e nesërme.

4. Misioni i sekretarit të Partisë "Komuniste"

Më 22 shkurt 1982 unë jam kthyer nga Turqia tek ai mes e ai rreth të cilit i kam takua që nga 17 korriku 1981. Me mua ka ardhë Osman Osmani, me misionin e tij, me mllefin e tij për inferioritetin vandal që kishte shfaqur ai me Stafin e tij, më 17 shkurt 1982. Misioni i tij ka qenë ta vazhdoj punën të cilën e kishte filluar UDB-ja një muaj më parë, ta përfundoj, ta ngulfati Zërin e Jusufit, nën pretekstin se me gjynahe të vjetra nuk bëhet lufta e re, ata që kanë vdekur për bashkim kombëtar janë të dëmshëm dhe të pavlefshëm në luftën për Republikë, çdo gjë duhet të filloj nga zeroja. Qëllimi i UDB-së vrastare kishte qenë që ne që kishim mbetur të detyrohemi me ia filluar prej zeros. Ky ishte edhe qëllimi i atyre që ishin të interesuar ta çonin në fund procesin të cilën UDB-ja nuk kishte pasur kurrë fuqi ta bënte.

Misioni im në jetë ka qenë i kundërt. Unë nuk e kam pasur detyrë sikur Osman Osmani që ta vazhdoj punën aty ku e ka lënë UDB-ja. Unë e kam pasur detyrë dhe misioni e betimi im ka qenë ta vazhdoj punën aty ku e ka lënë Jusufi, dhe t'i tregoj UDB-së dhe të gjithë të tjerëve se nuk ka pasur forcë në botë, që pas 17 janarit 1982, të na detyroj të nisemi prej zeros.

Pas atentatit maqina radhitëse e Jusufit, IBM Electronic Selectric Composer ishte marrë në policinë gjermane së bashku me shumë materiale e adresa

> Xhafer Durmishi: *"Nga Australia, respektivisht nga shoqëria "Bajram Curri" na ka ardhë një ngushëllim për familjen dhe një falënderim për dërgimin e revistave të cilat i kanë pëlqyer shumë. U çova prapë edhe ekzemplarë tjerë duke përfshirë edhe numrat e Lajmëtarit. Adresën e Besnikut (djalit të Metush Krasniqit-shën i Xh. D.)nuk e kemi. Besojmë se* ***shumë adresa të konfiskuara*** *së shpejti do t'i kemi në dorë. Megjithatë na i dërgo të gjitha ato adresa që na ke pas dërguar më parë. Gjithashtu na dërgo adresat që do t'i sigurosh nëpërmjet Plakut (Bujar Hoxhës-shën i Xh. D.).* (Letër Sabri Novosellës, mars 1982 Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 287)

të marra nga dhoma e studioja e punës së Jusufit. Po e përsëris kohën, jemi në mesin e marsit 1982. Turma e bashkatdhetarëve që kishin qenë e vinin për të pame ishte rralluar. Aktivistët e Zvicrës që kishin qenë me vizë A, por të eksponuar gjatë demonstratave të 1981-shit, rruga e të cilëve për Kosovë ishte ndërpre, ishin vendosë tek të afërmit e vetë në Gjermani. Ende pa u kthyer maqina, me artikujt të Xhafer Durmishit, Jusuf Gërvallës, shkrimin "Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë", artikullit të Sabri Novosellës për Adem Demaçin dhe askujt tjetër filloi përgatitja e numrit të "Zërit të Kosovës", si vazhdim i luftës.

5. Definimi i rebelimit sipas "komunistëve" të Shkollës së UDB-së Serbe

Më 17 shkurt 1982, në Ankara më ishte komunikuar nga Bujar Hoxha vendimi për pranimin e Suzanës me fëmijët në Shqipëri. Prandaj, në kuadrin e këtyre masave dhe largimit nga Kështjella e Jusufit, duhej të pastronim shtëpinë prej gjërave të panevojshme. Në këtë kohë Lëvizja e Jusufit, nuk ka asnjë kontakt me OMLK-në.

Gjatë këtyre ditëve unë dhe Faridin Tafallari e takuam disa herë Engjëll Kolanecin. Në njërën prej këtyre takimeve atij i dhamë shumë gjëra që ishin të arkivuara në shtëpinë e Jusufit. Pos tjerash atij ia dhamë edhe punën origjinale që Jusufi kishte bërë në përgatitjen e numrave 3 dhe 4-5 të revistës "Liria". Engjëlli i mori me shumë dëshirë duke thënë se ato ruhen më mirë në Shqipëri se sa tjetërkund. Në shtëpinë e Jusufit kishte shumë gjëra të duheshin larguar nga shtëpia. Për disa dokumente e materiale duhej të tregonim kujdes të madh për disa të tjera më të vogël.

Atmosfera e atyre ditëve është e dokumentuar më së miri në letrat e mia dërguar Shoqërisë Bashkimi Kombëtar "Bajram Curri" në Australi.

Xhafer Durmishi: *"Jusufi, anëtar i LNÇKVSHJ pra e ka ndihmuar dhe popullarizuar në masën më të madhe "Frontin e Kuq". Prej janarit 1981 Jusufi nuk i ndihmon më Ibrahim Kelmendit në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi" për disa shkaqe.*
Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksistë-Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrur në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës. ***Sa i përket OMLK-së nuk dimë se si do të organizohen e vazhdojnë punën e tyre****. Sa i përket LNÇKVSHJ mund të them se do të përpiqemi ta vazhdojmë luftën me hov edhe më të madh. Këtu kemi organizua një komitet me emrin Vëllezërit Gërvalla. Për shkak të disa arsyeve që nuk po i përmendi, me Ibrahim Kelmendin do të bashkëpunojmë e koordinojmë aktivitetin por nuk do të kemi marrëdhënie të ngushta me te."* (Letër Pajazit Ibrahimit në Australi, 7 mars 1982)

Shkolla e UDB-së Serbe:: *"Derisa po përgatitej numri tre i „Zërit të Kosovës", ndodhi* ***rebelimi*** *i pritur i Skënder Skënderit. Fyerjet kundër personalitetit të Kadri Zekës shpërthyen me përbuzje dhe cinizëm. Bëri grisjen e fletëpagesave* ***të gazetës „Liria".*** *Shkatërroi mbi 4.000 fletëpagesa, të cilat ishin shtypur në Gjermani, nën përkujdesjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës, dhe në emër të kontos së hapur në Zvicër*

nga Kadri Zeka, të quajtura „Hilfe für Kosova“ – 25-45475 Biel-Bienne, Schweiz" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.118)

Është taktikë djallëzore e Abdullah Prapashticës dhe Osman Osmanit për të më mveshur shprehje e fjalë që nuk i kam thënë. Unë nuk kam fyer askënd pasi nuk kam pasur nevojë. Fjala rebelim kur je zot i vërtetë në Kështjellën e Organizatës tënde është absurde. Nuk kam bërë grisje fletëpagesash, por rreth 200 deri në 300 copa i kam hedhur në shportën e mbeturinave. Ato fletëpagesa kanë qenë prej ditës së parë kur kontoja është publikuar në numrin 4-5 të Lirisë, vetëm e vetëm të OMLK-së dhe askujt tjetër. Përkundër disa gjërave të paqarta në fillim, ky fakt i është qartësuar Jusufit definitivisht më 17 tetor 1981 në panairin e librit në Frankfurt. Me këtë del e qartë si drita e diellit se ato fletëpagesa kanë qenë të një Organizate tjetër me të cilën Lëvizja e Jusufit nuk ka pasur ndonjë marrëveshje. Prandaj ato fletëpagesa, sidomos pas 17 tetorit 1982, nuk e kanë pasur vendin në Kështjellën e Jusufit. Pjesën kryesore i ka hedhur vetë Jusufi në shportë të mbeturinave. Unë kam menduar se Jusufi i ka hedhur të gjitha.

Fyerjet janë cilësi e njerëzve që pësojnë humbje, katastrofa, falimentime, kur nuk iu realizohet asnjë ëndërr, asnjë plan, kur dështojnë me çdo gjë. Duke qenë i vetëdijshëm se Zëri i Jusufit po mbahet gjallë dhe po i mbijeton atentatit në Kështjellën e Jusufit, në praninë e vëzhguesve të cilët thurnin plane për varrosjen e tij, unë nuk kam pasur nevojë të rebelohem as të fyej askënd. Të fyer, të poshtëruar, të ndyrë, të falimentuar kanë nevojë me qenë vetëm ata të cilët për shokët e vetë në burgje apo kudoqoftë, nuk e kanë lënë me shkrim as edhe një germë të vetme të atyre ditëve shumë dramatike. Nuk ka gjë më të ndyrë e më të fëlliqët se urrejtja e impotentëve.

6. Gjatë një kohe, kam qenë anëtar i vetëm një Organizate

Sikur të kishte ndodhur ngjarja tjetër kund dhe të kisha qenë anëtarë i një organizate tjetër, i kisha hedh në shportë çekat e një organizate me të cilët organizata ime nuk ka pasur asnjë marrëveshje. Kështu vepron çdo njeri dinjitoz që nuk është agjent i organizatave të huaja, e më këtë edhe i shteteve të huaja.

Kurrë në jetën time nuk kam qenë për asnjë moment të vetëm anëtarë i dy apo më shumë organizatave në të njëjtën kohë. Gjithmonë kam pasur lojalitet të plotë vetëm për atë organizatë të cilës në periudha të ndryshme i kam takuar. Kurrë në jetën time unë nuk u kam shërbyer dy zotërinjve në të njëjtën kohë. Kjo është një nga vetit e mia themelore që ma ka afruar me Jusuf Gërvallën. Personat të cilët janë lojal vetëm ndaj një organizate janë personat më të nderuar ndër shokë e miq, janë personat më të nderuar ndër kundërshtarë e armiq, kuptohet në ato raste kur ata e kanë një lloj karakteri e një fije burrnie, e nuk janë në shërbim të UDB-së apo dezertor të mjeruar të saj.

7. Pse LNÇKVSHJ një muaj pas 17 shkurtit 1982?

Numri i tretë i Zërit të Jusuf Gërvallës, teknikisht u përgatit në të njëjtën mënyrë siç ishte përgatit Lajmëtari i lirisë nr. 1, i gushtit 1980. Njohuri lidhur me këto çështje teknike kishte në shtëpinë e Jusuf Gërvallës. Në atë shtëpi, në atë Kështjellë historike ku ishte përgatitur numri i fundit i "Bashkimit", Lajmëtari i lirisë, tre numra të Lirisë dhe dy numra të Zërit të Kosovës kishte aq njohuri solide e traditë se si teknikisht përgatitet një gazetë, më shumë se kudo tjetër.

Suzana Gërvalla: "*Ne me të vërtetë këtu kemi shoqëri të re dhe përkrahje të madhe por mendët i kemi atje te ju te varrezat e Shtutgardit, se atje i lam ata ma të afërmit. E tash nuk dimë as si duken varrezat e tyre, spati kush me na que asnjë*

fotografi prej atjehit. Tash unë më nuk e shof as ***ORGANIN TONË, GAZETËN*** *për të cilën e ka dhënë jetën burri dhe kunati im e të* ***CILËN E PUNOVA UNË ME KËTO DUAR*** *pse ska kush me ma que prej atjehit."* (Letër nga Tirana për Faridin Tafallarin dhe Nuhi Sylejmanin, 22 shkurt 1983; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 77)

Planet e UDB-së dhe atyre që luftonin që gjithçka të filloj nga zeroja, të filloj nga aty ku e kishin përfunduar punën vrasësit profesionist të UDB-së dështuan me turp. Jusufi nuk i kishte marrë të gjitha njohurit e tij në varr. Jusufi nuk e kishte marrë historinë e shokëve të tij, raportet me ta, historinë e Lëvizjes së tij në varr si shpresonin ata që luftonin me ia nisë prej zeros, prej aty ku kishte qenë qëllimi i UDB-së. Ky numër u përgatit brenda mureve të Kështjellës së Jusuf Gërvallës dhe askund tjetër. Radhitjen e faqosjen e mundësoi Suzana Gërvalla e ndihmuar nga Xhafer Durmishi përkundër sabotimeve të personave që në shtëpinë e Jusufit qëndronin si vëzhgues të inferioriteteve vandale.

Jusufi nuk kishte lënë asnjë artikull të papërfunduar ashtu siç kishin shpresuar ata që luftonin për t'u nisur nga zeroja. Ndërsa e gjithë ngjarja e 17 janarit 1982, në këtë numër të marsit u përjetësua nga shkrimet e nisura dhe të përfunduara vetëm nga Xhafer Durmishi dhe askush tjetër, nga as edhe një germë e vetme e tjetër kujt. Artikujt e shkruar nga Jusufi dhe unë, iu dërguan një firme gjermane (kapitaliste) ta radhisë tërë tekstin në shtylla të gjëra nga 4 cm. Firma gjermane na pyeti se a e duami masën e tekstit të radhitur në letër apo drejtpërdrejt në pllaka plastike (që në fakt) do të përbënin filmin prej nga do të shtypej më vonë gazeta. Në firmë ishim bashkë me Suzanën dhe ajo tha se nuk ka problem, teksti mundet me na u dhënë në pllaka filmike-plastike. Kështu u bë. Në ditën e caktuar u muar materiali nga një firmë gjermane, të cilën për këtë punë e paguam me 1400 DM. Ky material u pre dhe u rendit në faqe gazete, (Zëri i Kosovës, mars 1982) në të njëjtën mënyrë siç ishte bërë me Bashkimin, Lajmëtarin e lirisë, Lirinë dhe numrat paraprak të Zërit të Kosovës, në katin e tretë, në studion e Jusufit, në Habichthöhe 40. Këto njohuri të përsosura teknike iu përcollën shokëve më të afërt të Jusufit që do ta vazhdonin luftën. Nga këto njohuri do të mësonte, në qershor 1982 Osman Osmani, por për fatin e keq të tyre nuk patën kurrë mundësi në jetë që të kenë ndonjë dobi prej tyre, pasi siç dihet çdo punë që duhet ta bëjë dora më parë ajo duhet të kryhet në tru.

Puna përgatitëse për këtë numër filloi kur maqina radhitëse e Jusufit e markës IBM ishte së bashku me shumë materiale tjera e adresa shqiptarësh nëpër Evropë e botë, gjendeshin në polici. Ne nuk ishim të sigurt se kur do të na kthehet maqina, prandaj e porositëm radhitjen në një firmë, për të qenë krejtësisht ekzakt, në një firmë kapitaliste. Përveç vonesës së maqinës, ishte edhe mendimi, pasi në rend të ditës ishin edhe shumë punë praktike që kërkonin zgjidhje për familjen e Jusufit dhe Bardhoshit, u quajt e arsyeshme mospritja e kthimit të maqinës nga policia.

Përmbajtja e Zërit të Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, Nr.3, Mars 1982

Autori	Titulli
Xhafer Durmishi	TRE RANË ME MIJËRA U NGRITËN
Xhafer Durmishi	NEKROLOGJI
Jusuf Gërvalla	Fletë Testamenti
Xhafer Durmishi	Të dashur lexues
Remzi Ademi	TRE DËSHMORËVE TË KOSOVËS
Jusuf Gërvalla	Armikun ta grishim në logun që duam vet
Jusuf Gërvalla	Shënim në dorëshkrim, 13 tetor 1968
Jusuf Gërvalla	Në vend të urimit

Xhafer Durmishi	Ju u bëtë pronë e brezave (Fjalim me rastin e varrimit më 5 shkurt 1982 të Jusufit, Kadriut e Bardhoshit)
Xhafer Durmishi	Emrat tuaj flamuj në beteja
Xhafer Durmishi	Dy demonstrime, prova të gatishmërisë sonë
Xhafer Durmishi	Njoftim
Jusuf Gërvalla	Sa derra ka në botë
Jusuf Gërvalla	Bota prognozon të vërtetën se sheh (thotë)!
Jusuf Gërvalla	Lëvizja e organizuar dhe spontaniteti
Faqe 12	Portret i Jusuf Gërvallës (tërë faqja)
Këngë	Çou moj Shotë
Faqe 14	Portret i Bardhosh Gërvallës (tërë faqja)
Faqe 15	Portret i Kadri Zekës (tërë faqja)
Jusuf Gërvalla	Mbrojtja e kishave dhe shenjtoreve serbe nga shqiptarët në shekuj
Jusuf Gërvalla	Kur ishim nxënës
Sabri Novosella	Adem Demaçi - simbol i rezistencës shqiptare
Radio Tirana	Azem Galica udhëheqës legjendar i lëvizjes kaçake të Kosovës
Jusuf Gërvalla	Dialog në mes shkencëtarit dhe "shkencëtarëve"
	Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vetë (Material që ka qarkullua në radhët e LNÇKVSHJ në mbarim të viteve 1970-të)

Plani fillestar ishte që ky numër i marsit i "Zërit të Kosovës" të dilte si organ i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, në përputhje me vendimin e 17 shkurtit 1982 në Ankara.

Osman Osmani në koordinim të vazhdueshëm me dajën Abdullah dhe me nipin Qemal i cili ishte në Stafin e dajës kërkoi ta zhagitë e sabotoi daljen e këtij numri me qëllim që të mos bëhet asgjë me rëndësi në emër të Lëvizjes për Republikë, pa u takuar edhe me OMLK-në. Kur kjo punë u duk e pamundshme, Osmani me porosinë më

> *Në orën 21.10 të datës 17 shkurt 1982 (në Ankara – vërejtja ime) filluan bisedimet për bashkimin e organizatave motra, LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, gjegjësisht për shkrirjen e këtyre* ***DY ORGANIZATAVE NË NJË TË VETME.*** *...*
>
> ***V E N D I M***
>
> *I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ*
>
> *1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet* ***LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI (LRSHJ)***. (17 shkurt 1982)

inferiore dhe më vandale kërkoi që "Zëri i Kosovës" të del si numër 3 i LNÇKVSHJ. Shtrohet pyetja: Pse Osmani, daja dhe nipi kërkojnë që të del Zëri i Kosovës si Zëri i Lëvizjes së Jusufit dhe jo si Zëri i Lëvizjes për Republikë, të formuar një muaj më parë.

Përgjigja në këtë punë, si në çdo punë të lavdishme të inferiorëve vandal i ka dy anë.

Kur Naim Haradinaj e Haxhi Berisha në dhomën e mysafirëve e pyetën Osmanin se pse po insiston që patjetër Zëri i Kosovës, të del si Zëri i Jusufit dhe jo si Zëri i Lëvizjes

për Republikë? ana e parë, ana formale e arsyetimit të Osmanit dhe dajës me nip (me të cilët ishte në kontakt të vazhdueshëm telefonik, gjë që nuk ka gjë të keqe të jesh në kontakt me shokë) ishte:

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

Zëri i Kosovës, si Organ i LNÇKVSHJ (emri LNÇKVSHJ u vendos me insistimin e Partisë "Komuniste"), që u përgatit dhe doli nga shtypi një muaj pas Vendimit të bashkimit të 17 shkurtit 1982

– Ana e parë apo formale e arsyetimit inferioro-vandal të Osman Osmanit: UDB-ja e ka pasur në shënjestër Jusufin, Lëvizjen dhe shtëpinë e tij. Ju si shokë të

Jusufit është shumë me rëndësi që të vazhdoni me e nxjerrë gazetën si Zëri i Lëvizjes së Jusufit, pasi kjo do të ishte përgjigja më e mirë për UDB-në. Efekti i arsyetimit të tij ishte i mahnitshëm sidomos për **Naim Haradinajn (në fotografinë anash)**. Aq fenomenal ishte arsyetimi i tij, sa unë kisha frikë se Naimi, Haxhi Berisha e shokë të tjerë do të prishen me mua si me një njeri që kam dashtë me e botua Zërin e Kosovës si Zëri të Lëvizjes për Republikë dhe jo si Zëri të Lëvizjes së Jusufit. Edhe pse e dija se nënshkrimi im më 17 shkurt 1982, pas këtij veprimi do të peshonte më lehtë, pranova me ia plotësua dëshirën Osmanit, dajës dhe nipit, dhe është një nga punët më të mira që kam bërë në jetë, dhe kam frikë se për këtë të mirë që ia kanë bërë Lëvizjes së Jusufit e emrit të Jusuf Gërvallës, kurrë nuk mundem me u dalë hakut, dhe për gjithë këtë vendim e mora vetëm e vetëm në bashkëpunim me shokët e Jusufit në Shtutgart, ndërsa me Sabri Novosellën

> Shkolla e UDB-së Serbe*: "Skënder Skënderi, vazhdonte me punët e tij të „mëdha" politike.* ***Konsultohej vetëm me Suzanën. Bënte biseda të gjata telefonike me Sabri Novosellën.*** *Merrte urdhra dhe jepte informata. Përgjonte e përvidhte.* ***Zhbironte dhe ndërhynte."*** (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.90)

në këtë çështje kaq thelbësore nuk bëra asnjë bisedë telefonike por ia dërgova një letër, ku në mes tjerash thuhet:

Xhafer Durmishi (Shpendi): "*Organin e dorëzuam për radhitjen e shtyllave na kushtoi 1400 DM. Janë 17 artikuj (pa poezi). S'bashku me fotografitë dhe titujt besoi se do të dal mjaftë material. Pjesa dërmuese e shkrimeve është e Sokolit, megjithëse nga kapuçonët nuk është kthyer as gjysma e materialeve të përgatitura për numër. Organin do ta nxjerrim si numrin 3 të LNÇKVSHJ, por për hir të informimit më të shpejtë, që të mos presim deri tek numri i ardhshëm do të dalim me një fletë të shkapur si te Lajmëtari i lirisë, Nr. 3, duke e quajtur Shtojca e Zërit....*

Unë i kisha dorëzuar në radhitje për hir të shpejtësisë edhe pse kështu krejtësisht s'na doli, dhe më tepër për shkak të familjes vendosëm që këtë numër ta punojmë në shtypin e qytetit, sepse këta kapuçonët interesohen fortë se ç'po bëhet, e pa rregullimin e shoqes së Sokolit nuk kishim mund t'i largojmë mjetet e punës siç është një makinë e tillë. Dhe besojë se kjo është e arsyeshme. Kam frikë se organi do të na del me ca gabime gjuhësore jo për fajin tonë, por për shkak të atyre që e përgatisin." (Letër Sabri Novosellës, mars 1982; Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 285-286)

Duke mos e kuptuar deri në fund motivin e vërtetë të Osman Osmanit, dajës Kushtrim dhe nipit Qemal, ne shokët që kishim qenë në Shtutgart afër Jusufit, kush më heret e kush më vonë, megjithatë e shtypëm Komunikatën e bashkimit, të 17 shkurtit 1982, në dy mijë kopje, për ta shpërnda së bashku me Zërin e Kosovës të marsit 1982.

Organin do ta nxjerrim si numrin 3 të LNÇKVSHJ, por për hir të informimit më të shpejtë, që të mos presim deri tek numri i ardhshëm do ***të dalim me një fletë të shkapur*** *si te Lajmëtari i lirisë, Nr. 3, duke e quajtur Shtojca e Zërit....* (pjesë nga citati më lartë)

Por këtë punë prapë nuk e lejoi Osman Osmani në konsultim të vazhdueshëm me Abdullah Prapashticën. Pse ai vepronte kështu?

– Ana e dytë, ana reale, nuk është aq inferiore vandale sa pjesa që e pamë më lart. Qëllimin e vërtetë të shfaqjes së inferioritetit vandal Osman Osmani e shfaqi para Skender Skënderit (Xhafer Durmishit), disa ditë më vonë, në këtë formë:

Osman Osmani: Në bisedimet e 17 shkurtit janë bërë lëshime e gjëra të ngutshme ku në mënyrë të tepërt është favorizuar Lëvizja e Jusufit. Kjo gjë duhet të korrigjohet menjëherë në takimin që do ta kemi me OMLK-në. Në bisedimet me ta, të gjitha lëshimet do të korrigjohen, gjithçka do të jetë objekt i diskutimit, emri i organizatës, emri i gazetës, e të gjitha. Ata së bashku me ne kurrë nuk do ta pranojmë emrin Zëri i Kosovës, pasi është emër i njëanshëm, i një organizate. Na si komunistë nuk lejojmë që asnjë komunist tjetër ta qesim para një akti të kryer. Fakti se Zëri ka dalë si Zëri i Jusufit, do të thotë se unë në takim me OMLK-së kam me e përfaqësua Stafin e Partisë "Komuniste", dhe kam me folë vetëm në emër të Partisë "Komuniste". Besoj se shokët komunistë në Zvicër do të jenë shumë më të arsyeshëm e më të gatshëm me e përqafua qëndrimin tonë se gjithçka duhet të filloj nga zeroja.

Natyrisht se këto ishin argumente tejet interesante dhe unë si shok i Jusufit i merrja parasysh.

8. Partia "Komuniste" kundër hienave sllave para proletariatit gjerman

Pas botimit të numrit të tretë të "Zërit të Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ Ibrahimi është sjellë kah Shtutgarti dhe ka shkuar tek Faridin Tafallari ta komentoj se çka është mirë në te apo më pak mirë e të ngjashme. Fakti se Ibrahim Kelmendi është

përjashtuar nga shtëpia e Jusufit nuk do të thotë se ne e kemi mohuar rolin e tij në Gjermaninë veriore dhe ndikimin në rrethin e Dusseldorfit. Ato ditë kemi biseduar për organizimin e një demonstrate në Bon. Për këtë, përmes Faridin Tafallarit është organizuar një takim me I. Kelmendin lidhur me organizimin e demonstratës në Bon më 3 prill 1982. Takimi është thirrur rreth 20 marsit në një restorant në qendër të Manheim-it. Në atë takim ka dalë Ibrahimi me Fazli Memajn nga Korisha, që në atë kohë qëndronte tek të afërmit e vetë në Dussledorf. Prej anës tonë kemi dalë unë dhe Haxhi Berisha. Ne të katërtit jemi marrë vesh për çështjet praktike rreth organizimit të kësaj demonstrata në Bon.

Lidhur me demonstratën e Bonit të 3 prillit 1982, Nuhi Sylejmani shkruan si më poshtë:

"E pyeta nëse do të ishin si ato të mëparshmet, apo ndryshe. „Sikur ato të mëparshmet“, – më tha disi i hutuar. Në demonstratat e mëparshme ishte praktikuar që gjatë pushimeve të shkurtra, mes dhe gjatë leximeve të referateve, të brohoriteshin parullat, si: „Kosova Republikë!“, „Republikë Kushtetutë!“ etj., prandaj edhe në këtë demonstratë, kur ma mori mendja se duhej thirrur, përmes megafonit thirra tri herë: „Kosova Republikë!“, dhe dy herë „Lavdi Marksizëm-Leninizmit“, por për të tretën herë nuk thirra dot, sepse ***Xhafer Durmishi, me pseudonimet Skënder e Shpend****, u afrua pranë dhe më qortoi me zë të lartë, duke më thënë: „Çka po bërtet ashtu, a? Le, boll e mos bërtit mâ!...“ U ndjeva shumë i fyer! Gjaku më vloi ethshëm nga zemërimi, por e mbajta vetën! Nuk fola asnjë fjalë, por e ula kokën sikur të kisha bërë ndonjë faj të pafalshëm!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.133)

Vet Nuhiu, ka harrua kur ka thënë se për herë të parë më ka takuar në shtator të vitit 1981 në shtëpi të Jusufit. Kjo do të thotë se unë nuk kam marrë pjesë në demonstratat e vitit 1981. Të vetmet manifestime që kam marrë pjesë ka qenë demonstrata e 23 janarit 1982, dhe dita e varrimit më 5 shkurt 1982. Në asnjërën prej këtyre manifestimeve nuk është brohorit "Marksizëm-Leninizëm". Se gjatë vitit 1981 në demonstratat e organizuara nga Jusufi e Kadri Zeka apo anasjelltas, krahas parullave të ndryshme është brohoritë "Marksizëm-Leninizëm" për herë të parë në thelb e kam kuptuar në nëntor 2009, kur më është dhënë mundësia t'i lexojë të plota letrat e Jusufit, të pranverës 1981.

Pa u thellua në teorizime të gjata, vlen të theksohet se udhëheqësit si Jusufi e Kadriu duke e krijuar në një masë të mirë pas vetes është dashur t'i përshtaten një opinioni që e ka dominua politikën e shtetit shqiptar. Kjo mund të jetë përparësia e tyre. Përveç kësaj ideali i Jusufit ka qenë i vërtetë i formuar gjatë gjithë jetës dhe nuk ka qenë maskë apo ngjyrim për të manipuluar të tjerët. Në qartësimin ideologjik, demonstratat e vitit 1982 dhe më vonë kanë qenë më të avancuara se ato të vitit 1981, që historikisht janë më të vlefshmet.

Nuk thuhet kotë se lufta duhet çuar përpara dhe jo me numrue në vend. Është në përputhje të plotë me mësimet e Marksit dhe të Leninit, se një popull që është i rrezikuar si komb nga një komb më i madh pushtues duhet ta zgjidhë në radhë të parë çështjen kombëtare, sepse pa e zgjidhur atë nuk mund të merret me çështje tjera. I bazuar në këto principe i kam thënë Nuhi Sylejmanit mos brohorit "Marksizëm-Leninizëm" qysh në thirrjen e parë, dhe kurrë qëllimi im nuk ka qenë me nënvlerësua apo ta bëjë të ndihet fajtor, por i kam thënë si bashkëluftëtar.

Po e përfundojë këtë pjesë me tri gjëmime e vajtime të inferioriteteve huno-vandale-serbomadhe.

1. Muharrem Blakaj: *"Virtytet e një burri të papërkulshëm, siç ishte Nuhi Sylejmani, u hetuan me kohë nga Jusufi, Kadriu dhe Bardhoshi, prandaj nuk ishte e rastit që vendimet më kapitale që u morën në atë kohë* ***të jenë në bashkëpunim të barabartë me të****, duke ia besuar edhe atij pjesën e përpjekjeve për luftë të përbashkët."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 7)

Vlerësimin e Muharrem Blakajt, se Nuhi Sylejmani ka pasur bashkëpunim të barabartë me Jusuf Gërvallën, do me thënë i barabartë me Jusufin e Bardhoshin, Shkolla e UDB-së Serbe e konsideron si gabim fatal:

2. Shkolla e UDB-së Serbe: *"Jusuf Gërvalla ishte një kolos i pazëvendësueshëm i çështjes kombëtare. Prandaj, përpjekja për zëvendësimin e tij ishte një gabim fatal, që i kushtoi shumë shtrenjtë gjithë çështjes kombëtare shqiptare, e veçmas organizatave politike që vepronin në atë kohë!"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë f.150)

3. Vajtimi vandal serbomadh: "*Kasno Janko na Kosovo stize*!"

MËSUESI DHE I BURGOSURI I PARË

Xhafer Durmishi: "*Shkollën fillore e kam mbaruar në fshatin Prilluzhë. Në dy vitet e para mësim më ka dhënë* ***Qerkin Peci****. Në këto dy vite, përveç Qerkinit praktikën si mësues e ka bërë Sheremet Saraçi, i cili e ka zëvendësua Qerkinin për dy muaj. Në klasën e tretë dhe të katërt mësuese e kemi pas Hanëmshahe Pasomën. Pas mbarimit të shkollës fillore në fshatin Prilluzhë, me sukses shembullor, d.m.th. pa asnjë katërshe gjatë tetë viteve, regjistrohem pa provim pranues në Qendrën Shkollore Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Kjo shkollë nuk ka qenë shkollë komunale por pronë e Kombinatit të Obiliqit, dhe ka pas për detyrë të shkolloj punëtorët e kuadrot e profileve të ndryshme për Kombinatin.*



Xhafer Durmishi pas mbarimit të shkollës së mesme

Në shkollën e mesme në Obiliq, shok të ngushtë e kam pas Hakif Krasniqin nga fshati Zhilivodë. Me Hakifin nuk më ka lidhë shumë interesi i lëndëve shkencore në shkollë si kimia, fizika e matematika (për diskutimin e këtyre lëndëve kam pas një rreth krejt tjetër) por interesi ynë i përbashkët ka qenë për gjuhën e letërsinë shqipe dhe leximi i veprave të letërsisë shqipe deri tek ato të realizmit socialist, të botuara në Shqipëri e të cilat na kanë ra në dorë, apo i kemi huazuar në biblioteka.

Hakifi me vëllaun e vetë më të vogël Hasanin dhe nanën kanë jetuar në Zhilivodë. Sa motra më të rritura i ka pas nuk më kujtohet. Por e di se një motër e tij

më e madhe, Bedrija ka qenë e martuar me Ismet Saraçin, nga fshati Bivolak. Ismeti ka qenë shok i ngushtë me Sheremetin dhe këta të dy së bashku shokë me Shefqet Jasharin nga Strofci. Përmes shokut tim të shkollës së mesme Hakifit jam njohur me Ismetin dhe rinjohur me Sheremetin (pasi Sheremeti më kishte dhënë dy muaj mësim në dy vitet e para të shkollës fillore). Në fillim të vitit 1978, Ismet Saraçi, pasi më kishte takuar shumë e shumë herë më ka folë për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi, më ka propozuar të anëtarësohem dhe unë jam pajtuar. Ismeti më ka anëtarësuar në Lëvizje në shtëpinë e tij në Bivolak. Viti 1978 është viti i 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit dhe në këtë vit puna ime si anëtar i Lëvizjes është një pikë ujë në deti në krahasim me punën pothuajse krejtësisht zyrtare për të kujtuar 100 vjetorin e Lidhjes." Përmes Hakifit jam njohur edhe me Behxhet Krasniqin, i cili përmes meje është anëtarësua në LNÇKVSHJ."



P-nr.9/83

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICËN E TITOS, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarëve: Jusuf Mejzini - kryetar, Branko Jarediq - antar, gjyqtarëve porot: Zenel Hamza, Millutin Markoviq dhe Radojica Gjokoviq - antarë, me proçesmbajtsen Mevlyde Hamza, në çështjen penale të të akuzuarit REGJEP MEHMETIT për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevulucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, të të akuzuarëve SHEFQET DIBRANI, QERKIN PECI dhe MUSTAFË MULOLLI, secili veç e veç për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevulucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, sipas aktakuzës së

Nga Aktgjykimi i mëposhtëm shihet se **Qerkin Peci** me shokët e tij janë të burgosurit e parë të LËVIZJES PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI.

*

* *

P-nr. 9/83
NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICËN E TITOS, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarëve: Jusuf Mejzini-kryetar, Branko Jarediq-anëtar, gjyqtarëve porotë: Zenel Hamza, Millutin Markoviq dhe Radojica Gjokoviq-anëtarë, me procesmbajtësen Mevlude Hamza, në çështjen penale të të akuzuarit **REXHEP MEHMETIT** për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 të LPJ lidhur me veprën penale Cënimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ, të të akuzuarve **SHEFQET DIBRANI, QERKIN PECI** dhe **MUSTAFË MULOLLI,** secili veç e veç për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 të LPJ lidhur me veprën penale Cënimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, sipas aktakuzës së Prokurorisë publike të qarkut në Mitrovicën e Titos PP-nr. 84/82 të datës 02.02.1983, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, verbal e publik me datën 26 maj 1983 në prezencë të përfaqësuesit të aktakuzës zëvendës PPQ në Mitrovicën e Titos Faruk Korenicës, të akuzuarve, mbrojtësve të tyre avoketëve: Mehmet Dushkut nga Prishtina, Abedin Naxhiut dhe Zaim Istrefit, të dytë nga Mitrovica e Titos, më datën 27 maj 1983 muarr dhe në prezencë të palëve publikisht shpall këtë

AKTGJYKIM

TË AKUZUARIT:

1. **Rexhep Mehmeti,** i biri i Hajdarit dhe Azemines e gjinisë Haziri, i lindur më 10.04.1954 në fshatin Dumnicë e Ultë komuna e Vuçitërnës, ku e ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer SHNE - dega për agjystator, momentalisht i papunë, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Zagreb më 1981, gjindet në EU pranë KK Vuçitërnë, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 15.08.1982,

2. **SHEFQET DIBRANI**, i biri i Aliut dhe i Kadës e gjinisë Ferizi, i lindur më 14.09.1944, në fshatin Dumnicë e Ultë komuna e Vuçitërnës, ku ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, i pa martuar, ka të kryer SHNE - dega për vegëltar, punëtor në fabrikën "Poliester" në Podujevë, shërbimin ushtarak nuk e ka rregulluar, i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, (...) kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05.08.1982,

3. **QERKIN PECI,** i biri i Hajdarit dhe i Halimes, e gjinisë Haziri, i lindur më 20.04.1944 në fshatin Zhazhë komuna e Mitrovicës së Titos, vendbanimin e ka në Mitrovicën e Titos në lagjen "Tamnik" rruga 8 nr. 30, shqiptar, shtetas i RSFJ, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, ka të kryer Fakultetin filozofik - grupi i albanologjisë, i martuar, babë i 3 fëmijëve të mitur, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Nish më 1971, gjindet në EU pranë KK Mitrovicë e Titos, i pa dekoruar, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05.08.1982,



3. QERKIN PECI, i biri i Hajdarit dhe i Halime
e gjinisë Haziri, i lindur më 2o .o4. 1944 në fshatin
Zhazhë komuna e Mitrovicës së Titos, vendbanimin e ka në
Mitrovicën e Titos në lagjën "Tamnik" rruga 8 nr.3o,
shqiptar, shtetas i RSFJ, profesor i gjuhës dhe i letër-
sis shqipe, ka të kryer Fakultetin filozofik - grupi i
albanologjis, i martuar, babë i 3 fëmijve të mitur, shër
bimin ushtarak e ka rregulluar në Nish më 1971, gjindet
në EU pranë KK Mitrovicë e Titos, i pa dekoruar, me gje-
ndje të mesme ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër ti
nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale,
gjindet në paraburgim prej o5 .o8. 1982.

4. **MUSTAFË MULOLLI,** i biri i Rrustemit dhe i Mihanes e gjinisë Fejzullahu, i lindur me 03.10.1955 në fshatin Shajkovc komuna e Podujevës ku e ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, ka të kryer dy klasë të shkollës së mesme ekonomike, punëtor administrativ - shaptilografist, i martuar, babë i 1 fëmiu të mitur, (...), i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, më parë jo i dënuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej datës 05.08.1982,

Janë fajtorë

SEPSE:

I. REXHEP MEHMETI

Nga mesi i muajit shkurt të vitit 1982, me qëllim që të rrëzoj pushtetin e klasës punëtore dhe të punonjësve, të minojë rregullimin shoqëror-ekonomik të përcaktuar në kushtetutë, sistemin shoqëror-politik e sistemin e vetëqeverisjes, bazën ekonomike të vendit, thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, në Mitrovicën e Titos ka formuar grupin armiqësor të ashtuquajtur "treshi" të përbërë prej të akuzuarve Shefqet Dibranit, Qerkin Pecit dhe Mustafë Mulollit, i cili grup është pjesë përbërëse e organizatave: "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ) dhe "Partisë komuniste Marksiste-Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi" (PKMLSHJ) dhe prej datës 19.02.1982 "Lëvizja për republikën shqiptare në kuadër të Jugosllavisë", i cili pastaj, si udhëheqës i grupit, më datën 09.05.1982 dhe më vonë ka organizua dhe

Xhafer Shatri: *"Pas rënies së tyre (Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës -shën i Xhafer Durmishit) në popull u krijua një indinjim i pakufishëm* ***e mjerisht edhe një huti e palejueshme****... Në Kosovë u bënë burgosje të mëdha. Nga të gjitha organizatat u burgosën shumë*

njerëz, shumë të tjerëve iu deshtë t'ia mësyjnë mërgimit, ndër ta edhe udhëheqësi i PKMLSHJ. ***Në mërgim janë zhvilluar bisedime në mes tij dhe shokëve të ish LNÇ... ka ardhur te bashkimi, gjegjësisht formimi i LRSHJ, jo LRSSHJ. Përkundër kësaj nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti, kjo ka mbetur anonime, çështje e tre-katër njerëzve.*** *"* (Qershor 1983, shkruar nga Xhafer Shatri, e nënshkruar 'Redaksia e Zërit të Kosovës')

ka shpërnda 90 ekzemplarë të afishes "Komunikatë" dhe më tepër se 100 ekzemplarë të afishes "Thirrje" e kjo e fundit në këtë përmbajtje: "në të cilën ftohen punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerëz të çdo moshe që me datën 26.06.1982 kur fillon Kongresi XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkojnë të drejtat e veta për krijimin e Republikës së Kosovës në Jugosllavi", e të cilat krejt kanë pasur përmbajtje armiqësore, në atë mënyrë që një sasi të të njëjtave ka shpërnda duke futur në pliko dhe adresuar personave të ndryshëm ndërsa sasinë tjetër i ka shpërnda duke vendosur nëpër vende të ndryshme, e krejt në territorin e KSA të Kosovës,

- me këtë ka kryer veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ.

II. SHEFQET DIBRANI, QERKIN PECI DHE MUSTAFË MULOLLI:

Nga mesi i muajit shkurt 1982 në Mitrovicën e Titos, me qëllim që ta rrëzojnë pushtetin e klasës punëtore dhe të punonjësve, të minojnë rregullimin shoqëror - ekonomik të përcaktuar me kushtetutë, sistemin shoqëror - politik e sistemin e vetëqeverisjes, bazën ekonomike të vendit, thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit të vendit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, janë bërë anëtarë të grupit armiqësor "treshit", i cili është pjesë përbërëse e organizatave armiqësore: "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ), dhe Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi" (PKMLSHJ) dhe prej datës 19.02.1982 "Lëvizja për Republikën Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë", dhe me datën 9 maj të vitit 1982 të ngritur në këmbë para flamurit kombëtar shqiptar kanë dhënë betimin me fjalë: "do të luftojmë psiqikisht, moralisht, politikisht dhe fizikisht për Republikën Shqiptare në Jugosllavi dhe në fund nëqoftëse është nevoja do ta flijojmë edhe jetën", pas çkafit janë angazhuar në shpërndarjen e afisheve armiqësore ndaj vendit tonë: "Komunikatës" dhe "Thirrjes" e kjo e fundit me përmbajtje: "në të cilën ftohen punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerëz të çdo moshe që me datën

Shkolla e UDB-së Serbe: *"**VONË U NJOFTOVA** ... Më 24 qershor, gjatë një vizite të **rastësishme** në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor (1982-shën i Xh. D.)"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f 142 e 145)

26.06.1982 kur fillon Kongresi XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkojnë të drejtat e veta për krijimin e Republikës së Kosovës në Jugosllavi", e të cilat krejt kanë pasur përmbajtje armiqësore,

- me këtë secili veç e veç, kanë kryer veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al. 2. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ.

Andaj, kjo gjykatë në bazë të dispozitave të përmendura ligjore dhe me aplikimin e neneve 33., 41. të LPJ dhe të nenit 351 të LPP, i

GJYKON

Të akuzuarin Rexhep Mehmetin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 8 (tetë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të akuzuarin Shefqet Dibranin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 5 (pesë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të akuzuarin Qerkin Pecin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 3 (tri) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të akuzuarin Mustafë Mulollin ME DËNIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 4 (katër) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05.08.1982 e tutje deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Të gjithë të akuzuarit obligohen që të paguajnë dhe atë solidarisht në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën sipas fletës definitive të shpenzimeve si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili nga 800.00 din., krejt këto brenda 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në bazë të nenit 353. al.6 lidhur me al.1. dhe al. 2 të LPP, kundër të akuzuarve vazhdohet paraburgimi.

Në bazë të nenit 69. të LPJ shqiptohet masa e sigurimit njashtu që mirren: makina e shkrimit e markës "Unis" TBM deluxe nr. 15-5231546, makina e shkrimit e markës "Unis" TBM deluxe nr. 15-4974532, dy palë dorëza të gomës, tri cop kese të najlonit, dy thasë të najllonit për pleh artificial, si mjete me të cilat janë kryer veprat penale, 1 pushkë ushtarake "kragujevka" të kal. 7,9 mm., nr. 123980, 1 revole "Zastava" M-57" nr. I-116541 të kal. 7,61 mm., 1 revole "Zbrojevka Vzor 50" nr. D-677321 të kal. 7,55 mm., 1 thikë dy tehëshe me dorëz të ilustruar me fotografitë e dy artistëve, municioni: 24 fishek të pushkës të kal. 7,9 mm., 17 fishek të revoles së kal. 7,61 mm., 4 fishek të kalibrit 7,65 mm., 1 brushë për pastrimin e gypit të revoles, 1 kuti me patenta "Meega", për shkak të sigurimit të përgjithshëm, librat dhe fletushkat "Rruga e partisë", organ i KQ të PPSH nr.2/78 dhe 11/78, librat: "Vetadministrimi jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste", "Demokracia proletare është demokraci e vërtetë", "Teoria dhe praktika e revolucionit", "Hrushqovi në gjunjë para Titos", "Si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi imperialisto revizionist i vendit tonë dhe efekti i presionit të tij mbi ne", "Letër

e KQ të PPSH dhe qeverisë së RPSSH drejtuar KKT PK të Kinës dhe qeverisë kineze", "Mbi bazat e leninizmit", "Lufta e PPSH për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit", një ekzemplar i statutit të LNÇKVSH, shumë ekzemplarë të marrun të afisheve "Komunikatë" dhe "Thirrje", si mjete të destinuara për kryerjen e veprave penale.

Arsyetimi

Prokuroria publike e qarkut në Mitrovicë të Titos ka ngritur aktakuzën PP-nr. 84/82 të datës 02.02.1983 kundër Rexhep Mehmetit për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ, Shefqet Dibranit, Qerkin Pecit dhe Mustafë Mulollit, secilit veç e veç për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.2 të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ. Pranë kësaj aktakuze gjatë tërë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi edhe përfaqësuesi i saj, zëvendës PPQ në Mitrovicën e Titos Faruk Korenica, i cili në fjalën e vet përfundimtare i propozon gjykatës që të akuzuarit për veprat penale me të cilat akuzohen të deklarohen fajtor dhe të ndëshkohen sipas ligjës.

Avokati Mehmet Dushku nga Prishtina, mbrojtësi i të akuzuarit Rexhep Mehmetit, në fjalën e vet përfundimtare deklaron se nuk u vërtetue që i akuzuari Rexhep ka qenë udhëheqës dhe organizator i grupit armiqësor të "treshit" pasiqë me pamëdyshje u vërtetua se organizatori i këtij grupi ka qenë Ymer Berisha ndërsa ky ka qenë vetëm anëtar i këtij grupi. Prandaj në rast më të pavolitshëm, në veprimet e Rexhepit mund të ekzistojnë vetëm elemente të veprës penale nga neni 136. al. 2. të LPJ. Pastaj, qëllimi i këtij grupi ka qenë vetëm që të shpërndahet materiali propagandistik, kështuqë, nëse gjykata nuk akcepton tezën e parë të mbrojtjes, mund të flitet vetëm për veprën penale nga neni 133. al.1. të LPJ. Me rastin e matjes së dënimit në fund e lutë gjykatën që në anën e të akuzuarit Rexhep të marrë parasysh një mori rrethanash lehtësonjëse.

Avokati Abedin Nagjiu nga Mitrovica e Titos, i caktuar sipas detyrës zyrtare për mbrojtës të të akuzuarve Shefqet Dibrani dhe Mustafë Mulolli, në fjalën e vet përfundimtare deklaroi: se në provat e nxjerruna nuk u vërtetua që të mbrojturit e tij kanë qenë anëtar dhe pjesëmarrës të grupit armiqësor "treshit" dhe nuk kanë shpërnda material armiqësor. Prandaj propozon gjykatës që të mbrojturit e tij të lirohen nga aktakuza, e në rast më të pavolitshëm, nëse gjykata gjen se në veprimet e këtyre ekzistojnë elemente inkriminuese, propozon që ndaj tyre të shqiptohet një dënim sa më adekuat.

Avokati Zaim Istrefi nga Mitrovica e Titos, mbrojtësi i të akuzuarit Qerkin Pecit, në fjalën e vet përfundimtare deklaron: se edhe pse i mbrojturi i tij ka ra në konflikt me ligjin, është bërë anëtar i grupit "treshit", ka dhënë betimin, ai nuk ka ditë se cilës organizatë i takon, çfarë qëllimesh ka kjo dhe kush të njëjtën e ka formuar. I akuzuari Qerkin është anëtarësua në këtë grup duke qenë i informuar nga i akuzuari Rexhep Mehmeti dhe Ymer Berisha se qëllimi i këtij grupi është vetëm shpërndarja e materialit propagandistik e për këtë, në rastin konkret mund të flitet vetëm për veprën penale propagandë armiqësore, me rastin e matjes së dënimit propozon gjykatës që të merr parasysh një mori rrethanash lehtësonjëse duke shqiptuar një dënim sa më adekuat.

I akuzuari Rexhep Mehmeti, në mbrojtjen e vet, si në procedurën paraprake ashtu edhe në shqyrtimin kryesor, thekson se është anëtarësue në grupin e ashtuquajtur "treshi" që është pjesë përbërëse e organizatës: "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi" e jo pjesë përbërëse e "LNÇKVSHJ" dhe "PKMLSHJ", se bashkë me Ymer Berishën dhe të akuzuarin Qerkin Pecin e kanë dhënë betimin si anëtar të këtij "treshi" se bashkë me Ymer Berishën kanë marrë material armiqësor kundër RSFJ nga Turqia, se këtë material që të tretë e kanë shpërnda, se çdo anëtar i këtij "treshi" ka pas për detyrë të formojë njëherit "tresha" të rinj, dhe se qëllimi kryesor i organizatës, anëtar i së cilës është, ka qenë të formohet "Republika Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë".

I akuzuari Shefqet Dibrani në mbrojtjen e vet gjatë hetuesisë nuk mohon faktet se nga i akuzuari Rexhep Mehmeti ka marrë material propagandistik: fletushkat "Zëri i Kosovës" nr. 2-3 në brendinë e njërës prej tyre ishte futur afishi "Thirrja" për organizimin e demonstratave e

> **Shkolla e UDB-së Serbe**: *"**VONË U NJOFTOVA** ... Më 24 qershor, gjatë një vizite të **rastësishme** në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor (1982-shën i Xh. D.)"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f. 142 e 145)

datës 26.06.1982, se që nga viti 1979 ka marrë libra dhe revista me përmbajtje armiqësore dhe të botuara jashtë vendit tonë nga Sabri Novosella, se ka dhënë një betim me përmbajtje armiqësore ndaj vendit tonë, por këtë betim, mbrohet ai, e paska dhënë në dyqanin e Sabri Novosellës duke qitur duert para flamurit kombëtar shqiptar dhe duke lexuar betimin qysh i ka thënë Sabriu. Ndërkaq në shqyrtimin kryesor i akuzuari Shefqet tani në tërësi i mohon edhe ato thënie para gjyqtarit hetues, duke theksuar se aktakuza ndaj tij është tërësisht e montuar nga organet e sigurimit, se gjatë jetës së tij kurrë nuk është marrë me veprimtari armiqësore, nuk ka marrë prej askujt e as që ka pas në shtëpi material armiqësor, nuk ka dhënë kurrfarë betimi dhe nuk ka qenë e as nuk din për grupin armiqësor të tërë "treshit".

I akuzuari Qerkin Peci, në mbrojtjen e vet si në hetuesi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor nuk i mohon faktet se është bërë anëtar i grupit armiqësor "treshi", ka dhënë betimin e qëllimi i këtij grupi ka qenë me karakter demokratik propagandistik vetëm që të njihet statusi i "Kosovës Republikë", e jo për ndonjë qëllim tjetër e për këtë ka marrë vesh prej të akuzuarit Rexhep Mehmetit dhe Ymer Berishës të cilët edhe i kanë propozue që të anëtarësohet në këtë grup. Pastaj, nuk i mohon faktet se ai, si anëtar i këtij grupi ka bërë shpërndarjen e materialit armiqësor. Mirëpo, në arsyetimin e shkakut se pse është anëtarësue në këtë grup i njëjti mbrohet duke theksuar se ka qenë i demoralizuar pasi është përjashtuar nga puna, një kohë të gjatë ka ndejtë pa punë, i cili demoralizim ke ai paska kalue në revoltë, e në pyetjen e bërë ai përgjigjet se ka qenë i revoltuar ndaj atyre personave legjitim të cilët përfaqësojnë organet e pushtetit.

I akuzuari Mustafë Mulolli, në mbrojtjen e tij, në procedurën paraprake, nuk i mohon faktet se që nga viti 1975 ka marrë libra me përmbajtje armiqësore, se duke lexuar këto libra e duke përcjell programin e TV Tiranës është frymëzuar për veprimtari armiqësore dhe është marrë me shkrimin e disa poezive që kanë karakter armiqësor ndaj vendit tonë, se në shoqëri me Naim Shalën, Enver Tupellën dhe të akuzuarin Rexhep Mehmetin, ka zhvilluar bisedë rreth formimit të një grupi për veprimtari armiqësore, se

më 26.03.1981 ka marrë pjesë në demonstratat armiqësore në Prishtinë, se ka organizue më 31.03.1981 bojkotimin e mësimit të nxënësve në Universitetin e punëtorëve në Prishtinë, se në muajin mars 1981 ka shpërndarë disa parulla armiqësore, se ka pas në posedim afishin "Komunikatë" por mbrohet se këtë afishe e ka marrë prej Osman Pacollit me qëllim shumëzimi dhe shpërndarjeje, se në Prishtinë është takue me të akuzuarin Rexhep dhe nga "Komunikata" bashkë kanë nxjerr afishi

> **Shkolla e UDB-së Serbe**: *"**VONË U NJOFTOVA** ... Më 24 qershor, gjatë një vizite të **rastësishme** në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor (1982-shën i Xh. D.)"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.145)

"Thirrje" për demonstratat e 26.06.1982 të cilat i ka shumëzue e pastaj shpërnda në Podujevë. Mirëpo, i njëjti, në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit kryesor i mohon në tërësi edhe këto thënie të dhëna në hetuesi duke u mbrojtur se nuk pajtohet se thëniet nga aktakuza, se nuk është anëtar i kurrfarë organizate ilegale dhe nuk ka dhënë kurrfarë betimi për ndonjë organizatë armiqësore.

Pas çmuarjes së provave të nxjerruna, Gjykata e qarkut vërtetojë gjendjen faktike vijuese:

Para demonstratave kontrarevolucionare në Kosovë të muajve mars, prill të vitit 1981, të akuzuarit: Rexhep Mehmeti, Shefqet Dibrani, Qerkin Peci dhe Mustafë Mulolli, janë marrë me aktivitete të organizuara kontrarevolucionare dhe armiqësore ndaj RSFJ. Kështu, Rexhep Mehmeti, Mustafë Mulolli dhe Naim Shala, punëtorë të fabrikës së amortizerëve në Prishtinë kanë zhvilluar biseda me përmbajtje armiqësore ndaj vendit tonë e njëherit këta kanë organizuar edhe ndërprerjen e punës në këtë fabrikë. Më 26.03.1981 Të akuzuarit Rexhep dhe Mustafë, kanë marrë pjesë në demonstratat armiqësore në Prishtinë, për çka janë dënuar me burgim nga gjyqtari për kundërvajtje e pastaj që të dytë janë përjashtuar nga marrëdhënia e punës. I akuzuari Qerkin Peci ka marrë pjesë në demonstratat kontrarevolucionare në Mitrovicën e Titos me datën 03.04.1981 për çka është dënuar me burgim nga gjyqtari për kundërvajtje dhe iu është ndërprerë marrëdhënia e punës si mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe e gjatë vuajtjes së këtij dënimi në burgun e Smrekonicës është njoftuar me të akuzuarin Rexhep Mehmetin. I akuzuari Shefqet Dibrani qysh nga fundi i vitit 1979 është furnizuar me libra, revista dhe broshura, të gjitha të botuara në Tiranë, të cilat kanë pas karakter armiqësor ndaj RSFJ e të cilat me rastin e paraburgimit gjatë bastisjes në shtëpinë e tij janë gjetë dhe janë marrë.

Nga mesi i muajit shkurt të vitit 1982, i akuzuari Rexhep Mehmeti, në Mitrovicën e Titos ka formuar grupin armiqësor të ashtuquajtur "treshi" të përbërë prej të akuzuarve Shefqet Dibrani, Qerkin Peci dhe Mustafë Mulolli i cili grup është pjesë përbërëse e organizatave armiqësore: "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi" (LNÇKVSHJ) dhe "Partia komuniste Marksiste Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi" (PKMLSHJ) dhe prej datës 19.02.1982 këto dy organizata janë shkrirë në një të vetme të ashtuquajtur "Lëvizja për Republikën Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë". Deri te arritja e formimit të këtij "treshi", i ndihmuar dhe sipas udhëzimeve të ekstremit armiqësor Ymer Berishës, i akuzuari Rexhep Mehmeti ka ndërmarr disa veprime paraprake. Kështu në shkurt të vitit 1982, bashkë me Ymer Berishën, ka udhëtuar në Turqi me qëllim të caktuar, që të lidhen me emigracionin ekstrem shqiptar për të marrë instrukcione e udhëzime rreth

formimit të grupit në vend i cili kishte me zhvilluar aktivitete armiqësore ndaj sistemit të RSFJ. Në Adapazar të Turqisë takohet me emigrantët ekstrem nga Kosova Sabri Maxhuni dhe Sabri N. me të cilët janë marrë vesh që në Kosovë të formojnë grupin armiqësor që të punojë për organizatën "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi". Me t'u kthyer nga Turqia për në Jugosllavi prej këtyre emigrantëve, i akuzuari Rexhep e Ymer Berisha marrin afishin "Komunikatë" në të cilin bëhet fjalë për shkrirjen e organizatave të përmendura armiqësore, në një të vetme të quajtur "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi". Në këtë afishe njëherit bëhet fjalë për instrukcionet e punës së mëtejme armiqësore. Përveç kësaj Rexhepi dhe Ymeri nga emigrantët ekstrem i kanë marrë edhe dy numra nga tre ekzemplarë (gjashtë copa) të fletushkës "Zëri i Kosovës" nr. 1 e 2., organ i kësaj organizate ekstreme emigrante shqiptare në perëndim, që të sillin në Jugosllavi me qëllim të shpërndarjes e propagimit. I akuzuari Rexhep kur kthehet nga Turqia në vend, fillon të punojë për "Lëvizjen", duke formuar "treshin" armiqësor, ashtuqë si u tha më lartë, angazhon dhe ia arrin qëllimit që të anëtarësojë në këtë tresh: bashkëfshatarin e tij të akuzuarin Shefqet Dibranin, të akuzuarin Qerkin Pecin me të cilin më parë është njohtë gjatë vuajtjes së dënimit të burgut në Smrekonicë duke
bashkëpunuar me ekstremin armiqësor Ymer Berishën, dhe të akuzuarin Mustafë Mulollin, kolegun e dikurshëm të punës me të cilin qysh më parë ka pas bisedë rreth formimit të një grupi armiqësor. I akuzuari Rexhep, në shtëpinë e vet, bashkë me Ymer Berishën, me makinë të shtypit, kanë

> Xhafer Shatri*: "Pas rënies së tyre (Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës -shën i Xhafer Durmishit) në popull u krijua një indinjim i pakufishëm* ***e mjerisht edhe një huti e palejueshme****... Në Kosovë u bënë burgosje të mëdha. Nga të gjitha organizatat u burgosën shumë njerëz, shumë të tjerëve iu deshtë t'ia mësyjnë mërgimit, ndër ta edhe udhëheqësi i PKMLSHJ.* ***Në mërgim janë zhvilluar bisedime në mes tij dhe shokëve të ish LNÇ... ka ardhur te bashkimi, gjegjësisht formimi i LRSHJ, jo LRSSHJ. Përkundër kësaj nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti, kjo ka mbetur anonime, çështje e tre-katër njerëzve.*** *"* (Qershor 1983, shkruar nga Xhafer Shatri, e nënshkruar 'Redaksia e Zërit të Kosovës')

shtypur "Komunikatën" në 90 ekzemplar, i kanë vu në koverta të adresuara personave të ndryshëm në territorin e KSAK duke i shpërnda nëpër posta të ndryshme e njëherit duke lënë në vende të ndryshme të KSAK. Një prej marrësve të kësaj "Komunikate" ka qenë edhe i akuzuari Qerkin Peci, me të cilin pastaj i akuzuari Rexhep bashkë me Ymerin kthehet në kontakt dhe ia arrin qëllimit që ta anëtarësoj në këtë tresh. Në prezencë të akuzuarit Rexhep me datën 9 maj 1982, të akuzuarit Shefqet, Qerkin dhe Dibran, të ngritur në këmbë kanë dhënë betimin me fjalët: "Do të luftojmë psiqikisht, moralisht, politikisht dhe fizikisht për Republikën Shqiptare në Jugosllavi dhe në fund nëqoftëse është nevoja do ta flijojmë edhe jetën."
Qëllimi i këtij grupi ka qenë tejet armiqësor dhe kontrarevolucionar ndaj sistemit të RSFJ, e detyrat konkrete të anëtarëve të grupit kanë qenë që në ilegalitet të punojnë në organizatën e "Lëvizjes", e njëherit secili anëtar ka pas për detyrë të formojë "tresha" të rinj. Ymer Berisha nga Turqia prej emigrantëve ekstremë sjell materiale të reja armiqësore duke ia dhënë të akuzuarit Rexhep që ato të lexohen, shumëzohen dhe shpërndahen. Në mesin e këtyre materialeve ishin 6 ekzemplarë të fletushkës "Zëri i Kosovës" nr.3 dhe origjinali i afishes "Thirrje". Teksti i afishes "Thirrje" kishte këtë

përmbajtje: "në të cilën ftohen, punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerëz të çdo moshe që me

> **Shkolla e UDB-së Serbe**: *"**VONË U NJOFTOVA** ... Më 24 qershor, gjatë një vizite të **rastësishme** në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor (1982-shën i Xh. D.)"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.145)

datën 26.06.1982 kur fillon Kongresi i XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkojnë të drejtat e veta për krijimin e Republikës së Kosovës në Jugosllavi". I akuzuari Rexhep pastaj kontakton me secilin të akuzuar veç e veç, dhe që të gjithë angazhohen në shumëzimin dhe shpërndarjen e kësaj afisheje. Mënyra e shumëzimit dhe e shpërndarjes së kësaj afishe ishte e njëjtë si me atë të "Komunikatës". Njëherit të akuzuarit i kishin ndarë territoret ku kanë vepruar në shpërndarjen e afisheve. Kështu, i akuzuari Qerkin ka shpërndarë afishet në territorin e Mitrovicës së Titos, i akuzuari Mustafë në territorin e Podujevës, i akuzuari Rexhep në territorin e Vuçitërnës dhe të Sërbicës, Ymer Berisha në territorin e Prishtinës e në një rast të akuzuarit Rexhep dhe Shefqet bashkarisht kanë shpërndarë afishet duke filluar prej fshatrave të Vuçitërnës e duke shkuar deri në Gradicë të Gllogovcit. I akuzuari Rexhep diku në mars të vitit 1982 pas mesnate në një shitore afër stacionit të autobusave në Velika Rekë KK Vuçitërnë i ka shkruar parullat armiqësore "Kosova Republikë" dhe "jashtë apo poshtë tradhtarët".

Ky grup ka pas për detyrë të formojë komitetin i cili do të kishte kryesinë prej 9 anëtarëve, kryetarin, sekretarin dhe arkatarin dhe është kanë dashtë të punojë dhe koordinoj në mënyrë ilegale dhe të formohet pas Kongresit të XII të LKJ.

Gjendjen e këtillë faktike kjo gjykatë e vërtetojë pas çmuarjes së gjithanshme dhe të plotë të provave të nxjerruna: me ndëgjimin e dëshmitarit Xhevat Isufit, me leximin në dëshminë e dëshmitarit Fahri Vishit të dhënë në hetuesi, me vështrimin në materialin propagandistik hollësisht të theksuar në dispozitivin e aktgjykimit në pjesën ku flitet për masën e sigurimit, të cilat përputhen: gadi në tërësi në deklaratat e të akuzuarve Rexhep dhe Qerkin si në hetuesi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor, pjesërisht në deklaratat e të akuzuarve Shefqet e Mustafë të dhëna në hetuesi.

Nuk janë kontestuese faktet: se është formuar grupi armiqësor "treshi", se anëtarët e të njëjtit kanë dhënë betimin para flamurit kombëtar shqiptar të cekur më lartë, se janë marrë me shpërndarjen e afisheve "Komunikata" dhe "Thirrja", se i kanë lexuar fletushkat "Zëri i Kosovës" se tërë materiali armiqësor si edhe origjinalet e afisheve të përmendura i kanë marrë nga emigracioni i jashtëm në Turqi me qëllim të leximit, shumëzimit dhe shpërndarjes, se ky grup ka punuar në ilegalitet, se çdo anëtar i të njëjtit ka pas detyrë me punue "tresha" të rinj me qëllim të masovizimit sa më të madh të ithtarëve, përkitazi me tekstin e përmbajtjes së afisheve të përmendura.
Me vështrimin në afishen "Komunikatë" origjinalin e të cilit ky grup i "treshit" e ka marrë nga emigracioni i jashtëm të cilin fakt e pohon edhe i akuzuari Rexhep, kjo gjykatë vërtetoj faktet përkitazi me tekstin e kësaj afisheje ku bëhej fjalë për shkrirjen e dy organizatave armiqësore në një të vetme të përmendura më lartë. Prandaj me pamëdyshje konkludohet se ky grup i "treshit" së pari ka qenë pjesë përbërëse e dy organizatave të para të përmendura e pastaj është bërë pjesë përbërëse e organizatës së

fundit të përmendur armiqësore. I akuzuari Rexhep pohon se është anëtar i organizatës "Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi" ndërsa mohon se është anëtar i atyre dy organizatave të para të përmendura edhe pse kjo nuk është me rëndësi, kjo gjykatë këtë mohim të të njëjtit e hudhi poshtë me vështrimin në afishen e përmendur.

Prej deklaratës së Rexhepit, vërtetohet se ai ka qenë pjesëmarrës i demonstratave në Prishtinë më 26.03.1981 për që arsye është largue nga marrëdhënia e punës, se vazhdon të mirret me veprimtari armiqësore duke kontaktuar me Ymer Berishën, pastaj me emigrantët Sabri Maxhunin dhe Sabri N. prej të cilëve ka marrë udhëzime për veprimtari armiqësore e qëllimi kryesor ka qenë formimi i grupit të "treshit" ashtuqë pastaj secili anëtar i "treshit" të formojë grupin e vet, se prej Turqisë është furnizuar me material armiqësor. Mirëpo ky, pasiqë privohet nga liria, me qëllim të shmangies qoftë edhe të pjesërishme të përgjegjësisë penale është i vetëdijshëm se si organizator dhe udhëheqës i grupit mban peshën më të madhe të përgjegjësisë se sa si anëtar para organeve të ndjekjes, pa bazë përpiqet të justifikohet duke theksuar përpos atyre që u thanë më lartë, se ai kinse paska qenë vetëm anëtar ndërsa organizator i këtij grupi paska qenë Ymer Berisha, e në këtë grup e pranon vetëm anëtarësimin e të akuzuarit Qerkin kurse të akuzuarit Shefqet e Mustafë i eliminon.

Në këtë drejtim nëse analizohet hollësisht deklarata e tij e dhënë në hetuesi dhe në shqyrtimin kryesor në të cilin shihet se ai ka qenë në kontakt me secilin të akuzuar dhe me lidhjen e pjesërishme të deklaratave të të akuzuarve tjerë, do të shihet qartazi se kjo mbrojtje e Rexhepit është e pabazë. Kështu, duke u nisur nga faktet jo kontestuese se ky "tresh" ka punuar në ilegalitet, se shumëzimi dhe shpërndarja e afisheve të përmendura u kanë qenë të njohura vetëm anëtarëve të "treshit", pastaj duke u nisur nga deklarata e Qerkinit në të cilën ai pranon se është anëtar i grupit, nga deklaratat e të akuzuarve Rexhep dhe Mustafë të dhëna në hetuesi në të cilat këta deklarojnë se në Prishtinë kanë pas takime, se Mustafa është njohtë me afishet e përmendura e pastaj ka shumëzue dhe shpërnda afishin "Thirrje" në Podujevë, nga deklaratat e Rexhepit dhe Shefqetit të dhëna në hetuesi, në të cilat pranojnë se i kanë shpërnda afishet "Thirrjet" prej fshatrave të Vushtrrisë e deri në Gradicë të Gllogovcit, vetvetiu rrjedh konkludimi i kësaj gjykate se organizator dhe udhëheqës i këtij grupi ka qenë i akuzuari Rexhep, ndërsa anëtarët kanë qenë të akuzuarit tjerë. Me këtë drejtim çdo verzion tjetër që rrjedh nga mbrojtja e të akuzuarve është i gabuar sepse këta në verzionet e tyre shihet interesi i të njëjtëve për shmangien e tërësishme apo qoftë edhe të pjesërishme të përgjegjësisë penale.

Kështu si u tha më lartë, i akuzuari Rexhep përpiqet që të japi verzionin se ai kinse paska qenë anëtar ndërsa Ymeri organizator i këtij grupi e për me u kompletue edhe me një anëtar ai tregon vetëm të akuzuarin Qerkin.

I akuzuari Shefqet në hetuesi deklaron se ka dhënë betimin si anëtar i grupit por pa bazë përpiqet të justifikohet se këtë e ka dhënë para Sabri Novosellës e gjatë betimit ka përsërit fjalët e Sabriut, se kinse nuk ka ditë se cilës organizatë i takon ky grup, se pranon faktin që me Rexhepin kanë shpërnda afishen "Thirrja" por mbrohet se ai këtë vetëm e ka shoqërue, se prej Rexhepit ka marrë "Zërin e Kosovës" nr.1 e 2., se më parë prej Sabriut qysh prej vitit 1979 është furnizuar me libra, fletushka armiqësore, kështu që sipas konkludimit të gjykatës, i akuzuari Shefqet në hetuesi përpiqet edhe pjesërisht t'i shmanget përgjegjësisë penale duke hudhë fajin në Sabri Novosellën për të cilin fare mirë e din se ai gjendet në emigracion në Turqi, duke u përpjekur me e mëshehë faktin se është anëtarësue në "tresh" se betimin e ka dhënë edhe i akuzuari Rexhep. Mirëpo, Shefqeti, edhe këto thënje pjesërisht pohuese por të cilat pak a shumë kanë lidhshmëri me provat materiale dhe deklaratën e të akuzuarit Rexhep në shqyrtimin kryesor të njëjtat në tërësi i demanton duke shkuar aq saqë tani deklaron se kurrë nuk është marrë

me veprimtari armiqësore, nuk është furnizuar dhe nuk ka pas në shtëpi asnjë libër, fletushkë apo broshurë armiqësore, e harron faktin se me rastin e bastisjes në shtëpinë e tij janë gjetë materialet armiqësore të cilat janë cekë në dispozitivin e aktgjykimit e të cilat janë marrë me vërtetim.

Verzionin e të akuzuarit Mustafë Mulollit, në të cilin ai vehten nuk e futë në grupin e "treshit" kjo gjykatë e hudhë poshtë si të pa bazë sepse duke u nisur nga deklarata e të njëjtit në hetuesi në të cilën thotë se ka pas në posedim afishen "Komunikatë" se prej të njëjtës bashkë me Rexhepin e kanë nxjerrë afishen "Thirrje" të cilën pastaj e ka shumëzue dhe shpërnda në Podujevë, vetvetiu tregon lidhmërinë e këtij me Rexhepin përkitazi me veprimtarinë e tyre armiqësore që rrjedh nga aktiviteti i këtij grupi edhe pse nuk mund të pranohen e këtij se prej "Komunikatës" bashkë e kanë nxjerrë "Thirrjen", sepse me pamëdyshje vërtetojnë se origjinalet e këtyre afisheve janë sjellë nga emigracioni i jashtëm e nuk kanë pas këta çka të nxjerrin prej njërës për të përpilue afishen tjetër, por këta i kanë pas detyrat konkrete të cilat rrjedhin nga veprimtaria e grupit e të cilat kanë qenë shumëzimi dhe shpërndarja e afisheve, si edhe kanë bërë.

Kjo gjykatë refuzojë të dhënat e të akuzuarve Shefqet dhe Mustafë në shqyrtimin kryesor, në të cilat këta pa bazë e me qëllim të shmangies së përgjegjësisë penale theksojnë se deklaratat që i kanë dhënë në hetuesi janë të montuara dhe nën presionin e organeve të sigurimit sepse këta në këtë drejtim nuk ofrojnë asgjë bindëse e aq më tepër kur dihet që këta deklaratat i kanë dhënë para gjyqtarit hetues ku nuk ka pas pjestarë të sigurimit dhe ndonjë presion të çfarëdo lloji, a për ndryshe edhe sikur të ishte ashtu qysh këta theksojnë, në deklaratat e tyre kishin me pranue në tërësi e jo pjesërisht si kanë veprue egzistimin e veprave penale në drejtim të së cilave u zbatua hetuesija ndaj tyre.

Nga gjendja faktike më lartë e vërtetuar, gjykata e qarkut gjen se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet qenjësore të veprave penale hollësisht të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit, për të cilat këta deklarohen fajtor dhe penalisht përgjegjës. Nga arsyet më lartë të cekura, u refuzuan si të pa baza tezat e mbrojtjes së mbrojtësve dhe të vet të akuzuarve.

Në kuptim të nenit 41. të LPJ, kjo gjykatë muarr parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e matjes së dënimit. Kështu, si rrethana lehtësonjëse te të gjithë të akuzuarit gjeti se këta janë persona relativisht të rinjë, se, përpos të akuzuarit Shefqet, të tjerët janë të martuar, kanë fëmijë, më parë nuk kanë qenë të dënuar. Ndërsa si rrethana rëndonjëse muarr: të të gjithë të akuzuarit faktin se këta një kohë të gjatë janë marrë me aktivitete armiqësore të cilat i kanë shprehë edhe me pjesëmarrjen e tyre në demonstratat kontrarevolucionare në Kosovë, vendosshmërinë e tyre të shkallës së lartë që të jenë sa më aktiv në kryerjen e veprimeve armiqësore që shihet në shumëzimin dhe shpërndarjen e numrit të madh të afisheve dhe në dhënien e betimit, në tekstin verbal të të cilit qartaz shihet se këta kanë qenë shumë të eksponuar armiqësisht ndaj RSFJ, te i akuzuari Rexhep: përpjekja e tij permanente dhe e vendosur në formimin e "treshit" duke i bindë dhe maksimalisht angazhue anëtarët e grupit në shumëzimin dhe shpërndarjen e afisheve, angazhimin e tij që sa më shumë material armiqësor të merr nga emigracioni i jashtëm dhe pastaj të njëjtat t'i shpërndaj.

Prandaj duke marrë parasysh këto rrethana dhe me aplikimin e dispozitave ndëshkuese nga neni 136. al. 1. lidhur me nenin 114. të LPJ për të akuzuarin Rexhep dhe nga neni 136. al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ për të akuzuarit tjerë, gjykata të

akuzuarit i gjykojë me dënimi burgimi të cekura në dispozitivin e aktgjykimit, duke qenë plotësisht e bindur se me këto dënime, me pamëdyshje do të arrihet qëllimi i dënimeve nga neni 33. të LPJ.

Kjo gjykatë vendosi ndaj të akuzuarve të vazhdohet paraburgimi në bazë të nenit 353. al. 6. lidhur me al. 1. dhe al. 2 të LPP.

Vendimin mbi shqiptimin e masës së sigurimit, kjo gjykatë e muarr me aplikimin e nenit 69. al. 1. dhe al. 2. të LPJ.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitivin e aktgjykimit.

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS
P-nr. 9/83, - më 27.05.1983

PROCESMBAJTËSJA
Mevlyde Hamza, d.v.

KRYETARI I TRUPIT-GJYQTARI,
Jusuf Mejzini, d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa brenda 15 dite nga dita e marrjes përmes të kësaj gjykate, Gjykatës supreme të Kosovës në Prishtinë.

TË NISEMI PREJ ZEROS

Agron Sela

1. Si mori kontakt me mua Xhafer Shatri?
2. Përjashtimi im nga Zvicra për periudhën 20 prill 1982 - 20 prill 1984
3. Prapa shpinës së Prapashticës
4. Nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti
5. Ndryshimi i emrit "Zëri i Kosovës" është shumë i nevojshëm
6. Tri kushtrime dhe ndikimi i kulloshtrës

1. Si mori kontakt me mua Xhafer Shatri?

Mehmet Hajrizi*: "Xhafer Shatri, ... nga burgu i Prishtinës ia arrin të iki më **4 shkurt** 1982."* (Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, faqe 350-351)

"*Nuk vonoi shumë dhe Agron Sela (nga **Dibra** - shën i Xh. D.) tha se kishte vendosur të largohej nga Gjermania, pasi nuk shihte*

ndonjë perspektivë. Kishte vendosur të shkonte në Itali dhe nëse do të kishte fat, tutje në Amerikë. Më ***10 shkurt*** *i kishte përgatitur valixhet. Meqenëse ai nuk kishte pasur të ardhura dhe as përkujdesje nga shteti gjerman, u morëm vesh me Suzanën që ta ndihmonim Agronin me një shumë prej njëmijë markash."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 123)

Xhafer Durmishi (Shpendi*): "Një shok nga* ***Dibra*** *për të cilin të kam folur, ka shkuar në kamp. Ai prej kampi na lajmëron se si ka arritur një spiun të UDB- së. Fjalët e tij i muarëm me rezervë të madhe, sidomos kur të kihet parasysh historia e XH. SH., e njëherazi edhe ky shoku është njeri që dyshon shumë sa që tani po më thonë se ai paska shprehur dyshime edhe në mua, kur unë kam thënë një herë kam banuar gjatë studimeve e njëherë jo. Unë vërtetë ashtu kam thënë se gjatë 4,5 viteve studimi edhe kam banuar edhe kam udhëtuar. Nejse.*

Pas bisedës me ju që atë natë, për në Itali i nisëm katër shokë me një automobil. Ndër ta edhe Halimi (Osman Osmani - shën i Xh. D.)." (Letër Sabri Novosellës, mars 1982; Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 285)

Më 3 prill 1982, pas mbarimit të demonstratës më është afruar Hasan Mala dhe ma ka dhënë një numër telefoni të një kabine telefonike në Zvicër. Shtrohet pyetja se me çfarë metode munda t'i bie në fije se numri i telefonit është i Zvicrës. Këtë e bëra në bazë të dy fakteve: E para: numri i telefonit fillonte me 0041- dhe e dyta: unë kisha pak njohuri për përjetimet e Sherllok Holmsit në Zvicër. Me metodën e deduksionit nga këto dy premisa erdha në përfundimin fenomenal se numri i telefonit sipas të gjitha gjasave duhet të jetë në Zvicër. Në atë kohë kabinat telefonike në Zvicër kanë pasur numra në të cilët ke mundur të thërrasësh. Pra nga kabinat telefonike të Zvicrës jo vetëm që ke mund me thirrur të tjerët por ke mund edhe me pranua biseda prej të tjerëve. Hasani më ka thënë se ky është numri i "atij shokut - apo bacalokut", nuk më kujtohet me saktësi, dhe ma ka dhënë ditën dhe orën e caktuar që ta thërras në telefon. Se është fjala për Xhafer Shatrin nuk kishte nevojë për mua për ndonjë fije dyshimi, pasi Agron Sela nga Dibra, i cili ka qenë në Untergruppenbach ka pas shkuar në Itali, në kampin Latina, dhe ai na pat shkruar se aty e ka takuar Xhafer Shatrin.

Në ditën e orën e caktuar e kam thirrur Xhafer Shatrin. Më ka thënë se është vendosur në Francë, se e ka ndërmend të vendoset në Paris. Mua më la përshtypje rrena flagrante se kur është i vendosur në Francë çfarë nevoje e shtynë të hyj në Zvicër e ta rrezikoj veten për t'i bërë bisedat telefonike. Por nuk u hidhërova edhe aq nga një rrenë e tillë duke menduar se është luftëtarë i 'vjetër dhe me përvojë', dhe mund t'i ketë arsyet e veta pse thotë kështu, e të cilat unë nuk mund t'i dijë dhe as nuk më hynin në punë që t'i dijë. Ishte një shfaqje e hapur e mosbesimit, por as kjo nuk më ka vra aspak pasi gjithmonë kam menduar se besimi është çështje që fitohet vullnetarisht prej dikujt dhe me këtë, se nuk mund ta detyrosh askend me forcë për të besuar. Pastaj do të ishte tepër naive që unë me mësimin e respektimin e rregullave të konspiracionit të thellë të prisja nga një person i panjohur për mua se do të më besonte pa rezervë që në bisedën e parë telefonike. Pra unë nuk kërkoja e as nuk prisja se Xhafer Shatri do të më tregoj gjëra sekrete apo të ndonjë rëndësie që në bisedën e parë. Por asesi nuk prisja që të ma servon qysh në bisedën e parë edhe një rrenë aq rrënuese, të tejdukshme e të pa fijen e krypës. Kjo rrenë, edhe pse nuk më hidhëroi ajo më befasoj, pasi, si me thënë ishte një fyerje tejet e rëndë për ligjet më elementare të deduksionit.

Pasi e kam thirrur disa herë në këtë kabinë, në rrethin e Gjenevës, jemi marrë vesh që unë ta marrë trenin nga Shtutgarti dhe të shkoj në Gjenevë për ta takuar.

2. Përjashtimi im nga Zvicra për periudhën 20 prill 1982 - 20 prill 1984

Më 20 prill 1982 jam nisur nga Shtutgarti për në Gjenevë për ta takuar Xhafer Shatrin. Në Basel më ka zbrit policia zvicerane prej trenit, më kanë kontrolluar hollësisht, dhe pa përkthyes pa bisedua me mua fare, kanë marrë vendim dhe ma kanë ndaluar hyrjen në Zvicër për dy vjet, pra prej 20 prillit 1982 - 20 prill 1984. Pas mbajtjes prej dy-tri orëve në stacionin e policisë kufitare, më kanë qitë në tren të Gjermanisë, pa e kontaktuar fare policinë gjermane. Këto dy tri orë në stacionin policor kufitar zviceran në Basel janë një nga kujtimet e mia më të këqija të asaj kohe.

Pasi jam kthye në Shtutgart e kam thirrur Xh. Shatrin në orën e caktuar në kabinën e caktuar në mbrëmje, të njëjtën ditë, pra më 20 prill. Menjëherë e ka marrë fjalën e ka filluar në mënyrë të ulët me më akuzua me fjalë të ashpra e kritike se pse unë mos me e mbajtur fjalën e mos me i dalë në takim në orën në të cilën ishim marrë vesh, se gjoja ai Xhafer Shatri nëse nuk del në takimin e caktuar në minutën e caktuar atëherë duhet me e ditë të gjithë se ai ka vdekur. Ia fillova me fjalë të buta duke u mundua me ia shpjegua se çka më kishte ndodhë në kufi. Por ai as që donte me ndëgjue por mundohej që me fjalët e veta me ia kalua vrazhdësisë së policisë zvicerane. Sjellja e tij më befasoj tepër, pasi vetë kisha dëgjuar fjalë të mira për te prej shokëve në Kosovë, dhe Sabriu ma kishte çua në qiell. Andaj kur e pash se nuk merr vesh me fjalë të urta, ia ktheva edhe unë në të njëjtin stil siç e meritonte. I thash se ti e ke shumë lehtë me u lavdue se del në takim në orën e minutën e caktuar nëse i lenë takimet në derë të shtëpisë e të tjerëve u duhet me udhëtua me qindra kilometra e me kalua kufirin më rigoroz, me të njëjtin ngjyrë të zërit me ndoshta edhe më ashpër se ai. Kur i thash kështu, u zbutë aq shumë, kaloi në një ekstrem tjetër, e ia nisi me dredhue me shpejtësi. Ia nisi me thënë se e kupton, por edhe ai ka hjekë gjatë rrugës njësoj, se nuk jeton në Gjenevë, por ka udhëtuar prej Parisi me dalë në këtë takim të caktuar si me thënë në gjysmë të rrugës, si për njenin si për tjetrin, duke pritur se mos po nisi unë me ia vajtue e me iu këndue elegji hjekave e peripetive të tij gjatë rrugës së asaj dite prej Parisi në Gjenevë.

Pas kësaj ngjarjeje mua m'u zvogëlua disi shija për biseda të shpeshta në telefon me te në kabinën e caktuar, e sigurisht e njëjta gjë mund t'i ketë ndodhë edhe atij.

Më 24 prill 1982 u organizua demonstrata e parë shqiptare në Vjenë. Në këtë demonstratë e pata më lehtë të udhëtoj pasi shkova në grup me autobus, e autobusi nuk kontrollohej aq shumë. Megjithatë në këtë rrugë e kisha pasaportën time të lëshuar në Mitrovicë, por vula e ndalimit të hyrjes në Zvicër ishte një lloj vërejtje për të gjithë kufijtë tjerë evropian. Në ndërkohë pas ngjarjes e këmbimit të fjalëve të mia me Xhafer Shatrin më 20 prill, me te kryesisht është marrë Sabri Novosella. Edhe unë kam qenë vazhdimisht në kontakt me Sabriun. Një njërën prej atyre ditëve, përmes telefonit kam biseduar me Sabriun, i cili më ka thënë se "puna e bashkimit të Lëvizjes me OMLK-në është kryer, se unë (S.N.) dhe Xh. Shatri jemi marrë vesh në të gjitha pikat. Ti (Xh. Durmishi) dhe Osman Osmani duhet me u takua me Xhafer Shatrin dhe me i krye formalitetet, pra me ia ba aminin asaj për çka jemi marrë vesh ne."

3. Prapa shpinës së Prapashticës

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Këtij takimi i paraprinë dy përpjekje për ta takuar Xhafer Shatrin, i cili pas ikjes nga burgu ishte vendosur si refugjat në Itali.* ***Përpjekjen e parë e kishte bërë Xhafer Durmishi*** *dhe atë, pa dijeninë dhe prapa shpinës së Osman Osmanit, gjë që dështoi pa arritur kalimin e kufirit.* ***Ndërsa përpjekjen e dytë e bëri Osman Osmani*** *së bashku me dibranin, Hysen Spahija.* ***Nuk arritën ta takonin në***

kampin e refugjatëve në Itali, sepse ndërkohë, ai kishte kaluar në Zvicër." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.127)

Xhafer Durmishi (Shpendi*): "Një shok nga* ***Dibra*** *për të cilin të kam folur, ka shkuar në kamp. Ai prej kampi na lajmëron se si ka arritur një spiun të UDB- së. Fjalët e tij i muarëm me rezervë të madhe, sidomos kur të kihet parasysh historia e XH. SH., e njëherazi edhe ky shoku është njeri që dyshon shumë sa që tani po më thonë se ai paska shprehur dyshime edhe në mua, kur unë kam thënë një herë kam banuar gjatë studimeve e njëherë jo. Unë vërtetë ashtu kam thënë se gjatë 4,5 viteve studimi edhe kam banuar edhe kam udhëtuar. Nejse.*

Pas bisedës me ju që atë natë, për në Itali i nisëm katër shokë me një automobil. Ndër ta edhe Halimi (Osman Osmani - shën i Xh. D.)." (Letër Sabri Novosellës, mars 1982; Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 285)

Sipas Shkollës së UDB-së Serbe, përpjekjen e parë e paskna bërë unë për ta takuar Xhafer Shatrin në Zvicër, ndërsa përpjekjen e dytë e ka bërë Osman Osmani për ta takuar duke ***u nisur që atë natë,*** posa e kemi marrë vesh se është në Itali. Nga kjo rrjedh sipas logjikës së Shkollës së UDB-së se Xhafer Shatri paska dalë së pari në Zvicër tek shokët e Organizatës së vet dhe prej atij mjedisi paska kaluar pastaj në kampin e refugjatëve *Latina* në Itali.

Nuk janë bërë dy përpjekje për ta takuar Xhafer Shatrin, si takime paraprirëse për bashkim. Xhafer Shatri, sipas Mehmet Hajrizit është arratisë nga burgu më 4 shkurt 1982. Kur ka mbërri në Itali Xhafer Shatri nuk e di. Agron Sela, nga Untergruppenbachu në kampin Latina, ka shkua më 10 shkurt 1982, në mënyrë që nga aty të shkoj në Amerikë, ku ka pasur farefis të vetin. Është Jusufi ai që nuk e ka lejua Agronin, Naim Haradinajn, Haxhi Berishën, mua dhe asnjë tjetër me kërkua azil në atë kohë, as në Gjermani e as në ndonjë vend tjetër. Diku pas 22 shkurtit Agroni e ka shkruar një letër nga Italia dhe informon se është takuar me Xhafer Shatrin. Nga Untergruppenbachu i kemi telefonuar Sabri Novosellës. Me kërkesën e Sabriut, kanë shkuar 4 veta me kerr. Osman Osmani ka qenë i pari që ka tregua gatishmëri me u përfshi në këtë rrugë. Tani del se ai e ka bërë këtë jo për shkaqe shoqërore, njerëzore e humanitare por paska shkuar për të diskutuar çështje rreth bashkimit.

Sido që të jetë puna në këtë pikë, del ***se përpjekjen e parë*** për t'u takuar me Xhafer Shatrin e ka bërë Osman Osmani dhe jo Xhafer Durmishi. Përpjekja ta takoj unë Xhafer Shatrin para se ai të del në Itali duket absurde. Unë ndoshta kisha bërë ndonjë përpjekje me e takua para se me dalë ai në Itali, por për këtë punë më janë dashtë kontakte shumë të forta me ish shefat e Abdullah Prapashticës, të cilat nuk i kam pasur.

Përpjekjen e parë *e kishte bërë Xhafer Durmishi dhe atë, pa dijeninë dhe* ***prapa shpinës*** *së Osman Osmanit, gjë që dështoi pa arritur kalimin e kufirit.*

Kjo gënjeshtër flet në mënyrë të qartë si drita e diellit çfarë sistemi koreanoverior kishte me instalua familja e ish-inspektorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica me firmën e tij private familjare me Partinë e tij "komuniste".

Kur Osman Osmani, më 22 shkurt 1982, 7 muaj e 5 ditë pas meje ka ardhë me misionin e firmës familjare të Abdullah Prapashticës, në familjen Gërvalla e ka gjetur Saime Isufin dhe Ibrahim Kelmendin. Prej 22 shkurtit e deri më 5 mars 1982, Osman Osmani ka mundur të bisedoj për çfarë të dojë me Saime Isufin, prej mëngjesit e deri në orët e gjumit pa i marrë leje askujt. Të njëjtën gjë ka mundur ta bëjë edhe me Ibrahim Kelmendin, por me këtë edhe më shumë, deri rreth 15 marsit. Me të dytë e ka pasur lirinë e plotë që t'i përpunoj, kuptohet, nëse mundet, ashtu siç e ka përpunuar Nuhi Sylejmanin dhe me porosi të dinastisë e ka graduar 'Luan'. Pse nuk e ka bërë këtë, kur

interesi i firmës familjare, interesi i krijimit të dinastisë Kim il Dul Prapashtica e ka kërkuar këtë, unë nuk mundem me e marrë me mend.

Kontaktin e parë me mua e ka marrë Xhafer Shatri me iniciativën e tij, përmes Hasan Malës, në demonstratën e Bonit më 3 prill 1982. Ai ka dashtë me bisedua me mua, pasi ka dashur ta dijë se kush është ai që e vazhdoi Zërin e Jusufit, dhe unë kam pranua, dhe pasi nuk kam pasur kunorë me Osman Osmanin kam zhvilluar biseda telefonike dhe jam nisur ta takoj më 20 prill 1982, por policia Zvicerane në Basel nuk më ka lejua me hy në Zvicër. Kurrë nuk jam mërzit as nuk më ka interesua se a është Xhafer Shatri duke biseduar me Osman Osmanin.

Sabri Novosella: "*Komitetit të degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla"*

...Dalja e shokut Xh. e shkuarja tek shokët që para shumë vitesh i ka organizuar vet është bërë shumë mirë, bile më mirë se sa të kishte ardhë tek ju, pasi në atë organizatë motër Xh. gëzon besim shumë të madh, kurse nga ana tjetër me një shok që e kemi këtu ka afërsi shumë të madhe qysh nga koha e vuajtjes së dënimeve në kazamatet jugosllave para 13 viteve. Përveç kësaj ekziston edhe një histori tjetër që i lidhë këta dy shokë në për lirinë e popullit tonë. Pasi edhe deri më tani është punuar në bashkimin e organizatave tona, nga ana tjetër ***NUK EKZISTOJNË KURRFARË DIVERGJENCASH PARIMORE, MUND TË THEMI SE ÇËSHTJA E BASHKIMIT MUND TË MIRRET SI PUNË E KRYER.***

Të fala vëllazërore e revolucionare

Komiteti i Degës së LRSHJ "Hasan Prishtina" (mars 1982)

4. Nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti

Të shohim se si është shkruar nga të tjerët për takimin e 14-15 majit në Biel-Bienne.

Xhafer Shatri *:"Një parantezë. Në prag të vrasjes tragjike të shokëve tanë Jusufit e Bardhoshit (kanë qenë siç dihet anëtarë të ish Lëvizjes nacionalçlirimtare...) dhe Zeqës (anëtar i ish-Organizatës Marksiste-Leniniste...) janë zhvilluar bisedime për bashkim. Bisedimet kanë qenë të suksesshme dhe sipas të gjitha gjasave natën e vrasjes ka ardhur gjer te bashkimi. Këto organizata kanë vepruar në mërgim sidomos dhe gjithmonë i kanë koordinuar aksionet, janë ndihmuar në mes veti me të madhe, ky është një fakt i padiskutueshëm. Pas rënies së tyre në popull u krijua një indinjim i pakufishëm* ***e mjerisht edhe një huti e palejueshme****... Në Kosovë u bënë burgosje të mëdha. Nga të gjitha organizatat u burgosën shumë njerëz, shumë të tjerëve iu deshtë t'ia mësyjnë mërgimit, ndër ta edhe udhëheqësi i PKMLSHJ.* ***Në mërgim janë zhvilluar bisedime në mes tij dhe shokëve të ish LNÇ... ka ardhur te bashkimi, gjegjësisht formimi i LRSHJ, jo LRSSHJ. Përkundër kësaj NUK ËSHTË ZHVILLUAR KURRFARË AKTIVITETI, kjo ka mbetur anonime, çështje e tre-katër njerëzve.*** *Në maj, më 14 e 15 maj janë zhvilluar bisedime edhe me përfaqësues të ish OMLK. Ka ardhur gjer tek bashkimi gjegjësisht formimi i LRSHJ. Për këtë ekzistojnë dokumente. Në bisedime kanë qenë dy përfaqësues të organizatave të mëparshme, si përfaqësues të organizatave të tyre."(*Qershor 1983, shkruar nga Xhafer Shatri, e nënshkruar 'Redaksia e Zërit të Kosovës'*)*

Pas punimeve të mija të mëparshme më duket e tepërt t'i analizoj shprehjet ***mjerisht edhe një huti e palejueshme*** dhe ***nuk është zhvilluar kurrfarë aktiviteti.*** Në këtë rast ajo çka më duket më e rëndësishme dhe të sqarohet në mënyrë të domosdoshme është fakti se me çfarë stilografi, Xhafer Shatri i ka shkruar, sidomos fjalët e mësipërme?

Ibrahim Kelmendi: ***"– Kriminel e shkuar kriminelit, – ndërhyri Mirani i përmbajtur. – Hape setrën se ke stilografin në xhep të mbushur me qumësht!"*** **(**Atentatet, f.440*)*

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër Ibrahim Kelmendit, 5 mars 2007)

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk mund të quhet bashkim, por bashkëngjitje*" (Atentatet, f.380) *"Ia thashë troç se ata nuk ishin bashkuar, por Xhabiri ia kishte bashkëngjitur OMLK-në"* (Atentatet, f.392)

Xhafer Durmishi: *"Kur jemi duke folur për këtë, nga sjelljet, tani kuptohet se ai (Xhafer Shatri -shën i Xh. D.) me çdo kusht ka dashtë që të thotë se: ''Tre shokët u vranë, dhe sikur të mos kisha qenë unë, aktivitet në botën e jashtme nuk kishte me pas një kohë të gjatë, për të mos thënë nuk kishte me pas fare. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët e ulëta të tij që kanë të bëjnë me bisedimet e bashkimit me më 14 e 15 maj 1982, ku disa shokëve që kanë ardhë tek ai nga Kosova u ka thënë se sikur të mos kisha qenë unë nuk ishte bërë bashkimi, por më 14 maj këtu unë atyre që kanë ardhë për bisedime ua kam thyer dhëmbët. ... Unë dua të theksoj se sa mund të arrij ta konsolidoj veten politikisht njeriu me këto gënjeshtra."* (Letër shokëve të Shtutgartit, 14 maj 1984, faqe 7)

Mehmet Hajrizi: *"Xhafer Shatri, njëri nga udhëheqësit e GRK-së, në dimrin e vitit 1982 arratiset nga burgu dhe u bashkangjitet radhëve të Organizatës në Zvicër. I autorizuar nga OMLK, ai vazhdon bisedimet për bashkim me organizata të tjera të Lëvizjes, si LNÇKVSHJ, PKLMSH, etj., që rezulton* ***me formimin*** *në maj të vitit 1982 të* ***frontit të përbashkët****, të quajtur Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi." (*Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981 f. 311)

Mehmet Hajrizi: *"Pas rënies së Kadri Zekës, Hasan Malaj dhe veprimtarët e tjerë e autorizojnë Xhafer Shatrin, i cili pas arratisë nga burgu kishte arritur në mërgatë, për ta përfaqësuar OMLK-në në marrëveshjen e bashkimit të organizatave. Më 15 maj 1982 është mbajtur mbledhja për bashkim në fshatin Lanovil, afër Bielit, në banesën e Hasan Malajt. Nga ana e OMLK-së ka marrë pjesë Xhafer Shatri, nga ana e LNÇKVSHJ-së, Skënder Durmishi, kurse nga ajo e PKMLSHJ-së, Osman Osmani. Në atë mbledhje është arritur bashkimi dhe* ***prej asaj date organizata*** *është quajtur "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi" (LRSSHJ), kurse organi i saj "Zëri i Kosovës." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, f. 389)*

Ibrahim Kelmendi: "*Nuk mund të quhet bashkim, por bashkëngjitje*" (Atentatet, f.380) *"Ia thashë troç se ata nuk ishin bashkuar, por Xhabiri ia kishte bashkëngjitur OMLK-në" (Atentatet, f.392)*

5. Ndryshimi i emrit "Zëri i Kosovës" është shumë i nevojshëm

Xhafer Shatri*: "Po që se ju jepet rasti, ju lutem që t'ia përcillni Kamberit (Sabri Novosellës - shën i Xh. D.) argumentimet tona lidhur me nevojën* ***E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË ORGANIT (REVISTËS "ZËRI I KOSOVËS" -shën i Xh. D.)*** *dhe përpiquni të jeni sa më origjinal dhe sa më të arsyeshëm dhe këtë mos e bëni sa për ta bërë, por vetëm pse* ***ËSHTË SHUMË E NEVOJSHME."*** *(*Letër Xhafer Durmishit e Osman Osmanit, 16 maj 1982; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 163)

Unë dhe Osman Osmani jemi nisë për në Biel-Bienne, më 14 maj 1982. Pasi 24 ditë më parë më ishte ndaluar hyrja në Zvicër për dy vjet, për këtë udhëtim ma ka dhënë pasaportën e vetë NN. Faridin Tafallari është marrë vesh me Shefket Musliun rreth çështjeve teknike të kësaj rruge. Faridini na ka çue me kerr deri në një vend afër kufirit Zviceran. Shefketi ka dalë me kerr dhe na ka marrë. Nuk e di për cilën pikë kufitare të një fshati i ka ra, por në Zvicër kemi hy pa problem, pa na pyetur askush. Shefketi na ka çue deri në qendër të Bernit. Aty jemi takuar me Hasan Malën e Xhafer Shatrin me të

cilët shkuam në banesë të Hasanit. Shefketi u kthye në banesë të vetë në rreth të Zurichut, duke na thënë se ashtu siç ju pruna edhe ju kthej në Gjermani.

Në mbrëmje kemi biseduar për gjëra të përgjithshme por edhe konkrete. Por thelbi i diskutimit që nuk e harroj ka qenë rreth një pike. Osman Osmani e ka hap diskutimin e parë në këtë pikë duke thënë se gazeta e Jusufit "Zëri i Kosovës" nuk duhet të mbetet gazetë e Lëvizjes për Republikë (pasi ne nga organizata e Jusufit veç e kemi marrë emrin 'Lëvizje' dhe kjo duhet të jetë mjaft). Po që se e pranojmë edhe emrin e gazetës së Jusufit "Zëri i Kosovës" atëherë shtrohet pyetja se çka po mbetet nga historia jonë, kur dihet se na, Partia i kemi nxjerrë dy gazeta për ekzistencën e të cilave, edhe nëqoftëse nuk është i njoftuar populli, përmes letrash është njoftuar UDB-a dhe Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, e sidomos pjesa pozitive e LKJ. Xhafer Shatri, i cili nuk e kishte bërë asnjë bisedë më parë me Abdullah Prapashticën e as Osman Osmanin për të bërë ndonjë sondazh të situatës, u shokua e u befasua aq shumë se si mund të ketë kaq njerëz të pabesë, deri në këtë farë shkalle, ndaj nënshkrimeve të veta të hedhura në letër më 17 shkurt 1982 në Ankara. Pasi e mori veten pak nga ky shokim prej pabesisë së shokut të ish-inspektorit të UDB-së, edhe Xhaferi ra krejtësisht në pozitat e tij, edhe pse për arsye krejt tjera, dhe tha se është e një rëndësie tejet të madhe që "Zëri i Kosovës" pasi në nëntor 1981, e janar 1982 është botuar nga Jusufi, të mos mbetet gazetë e Lëvizjes për Republikë. Edhe ne e kemi nxjerrë 'Lirinë' dhe ashtu siç thotë Osmani, është mirë që t'ia nisim prej zeros, pasi ky është një fillim i ri. Pasi u sollën e mbështollën shumë herë rreth kësaj pike për të ma mbushur mendjen se duhet me ia nisë prej zeros, unë ju thash se edhe pse kam mirëkuptim të skajshëm se ju mund të keni arsye me ia nisë zeros, për mua kjo çështje, duke parasysh historinë e Organizatës sime, është krejtësisht e pamundur. Me shokun e ish inspektorit të UDB-së Osmanin, unë në ato çaste nuk kisha çka me folë pasi me te isha marrë vesh qysh më 17 shkurt 1982 në Ankara dhe kisha pasur rastin të këmbej mendime të mjaftueshme deri në atë ditë. Nga ana tjetër Xhafer Shatri, veterani i vitit 1974 e kishte trashëguar një situatë shumë delikate në Zvicër nga Kadri Zeka, i cili vetë dhe të gjithë shokëve të vetë u kishte thënë të mos e lexojnë, pranojnë apo të kenë çfarëdo lidhje me Zërin e Jusufit.

Kur Xhafer Shatri filloj t'i përkrah qëndrimet e Osmanit dhe osmanëve tjerë, unë i thash se këtu unë për veti nuk kam ardhë me bërë kurrfarë diskutimi pos kryerjes së një formaliteti. Për të gjitha çështjet tjera ke pasur kohë me u marrë vesh me Sabriun, e atë kohë e ke në dispozicion edhe më tutje. Të nesërmen, më 15 maj, paradite është formuluar një tekst nga Xhafer Shatri, të cilin ai ma ka diktuar gojarisht dhe unë me dorën time e kam shkrua, dhe është nënshkruar nga Xhafer Shatri, unë dhe Osman Osmani.

Me aq sa më kujtohet dhe besoj se kjo është e vërtetë 99%, kur ma ka diktuar tekstin Xhafer Shatri, mua dhe Osman Osmanin nuk na trajton (apo dikton fjalët) si anëtarë të Lëvizjes për Republikë veç të formuar më 17 shkurt 1982 por si anëtarë të LNÇKVSHJ dhe të PKMLSHJ.

> Faridin Tafallari: "*Në fillim ky besim i Xhafer Durmishit ishte shumë i sinqertë." ... "Xhafer Durmishi në fillim ishte shumë i sinqertë dhe punonte me zell të madh."* (Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 64 e 69)

Unë nuk kam qenë i fokusuar në kopilitë e këtyre detaleve në këtë aspekt pasi fokusimi kryesor ka qenë ruajtja e fjalëve "Lëvizje" për hir të Jusufit dhe ruajtja e emrit "Zëri i Kosovës" poashtu vetëm e vetëm për hir të Jusufit. Kur Sabri Novosella ka ardhë në Gjenevë tek Xhafer Shatri, në nëntor 1983, e kur janë prishur e grindur në mënyrën më skandaloze, një nga shkaqet e skandalit ka qenë çështja e interpretimit të bashkimit të 15 majit 1982. Sabriu i ka thënë se Lëvizja për Republikë është formuar në Ankara

më 17 shkurt ndërsa OMLK-ja ju ka bashkangjitur kësaj Lëvizjeje më 15 maj, pa shtruar asnjë kusht, ndërsa Xhafer Shatri i ka thënë se Lëvizja për Republikë është formuar nga unë (Xh. Sh.), se Osman Osmani e Xhafer Durmishi kanë ardhë si anëtarë të dy organizatave të ndryshme dhe për këtë e kam tekstin të cilin e ka shkruar dora, apo stilografi i Xhafer Durmishit. **Më 15 maj u vendosë poashtu që për ditën e fillimit të Kongresit XII të LKJ, më 26 qershor 1982 të organizohet një demonstratë në Bern.** Pas kryerjes së takimit ka ardhë Shefket Musliu dhe me kerrin e tij na ka çue deri në një vend në Gjermani, prej nga unë e Osman Osmani kemi vazhduar me tren për në Shtutgart. Të nesërmen, më 16 maj 1982, Xhafer Shatri u shkruan një letër Xhafer Durmishit dhe Osman Osmanit, ku po tjerash thuhet:

Xhafer Shatri: " *Po që se ju jepet rasti, ju lutem që t'ia përcillni Kamberit argumentimet tona lidhur me nevojën e* ***ndryshimit të emrit të organit*** *(ndryshmit të emrit* ***'Zëri i Kosovës' me një tjetër****, pra me ia filluar prej zeros-shën i Xh. D.) dhe përpiquni të jeni sa më origjinal dhe sa më të arsyeshëm dhe këtë mos e bëni sa për ta bërë, por vetëm pse është shumë e nevojshme."* (Letër Xhafer Durmishit dhe Osman Osmanit, 16 maj 1982)

Xhafer Durmishi. *"Dje e mora një letër nga Xhafer Shatri. Po ta dërgoj të fotokopjuar. Edhe letrat tuaja të dërguara tek shoku gjerman i mora. Do të veprohet asisoji dhe besoj se do të ndikojë pozitivisht. Momentalisht nuk kemi gjetur banesë por sot do të shikojmë një vend për një dydhomëshe që kushton 400 DM në muaj. Nëqoftëse nuk është e zënë do të bëhet shumë mirë. Këtu po ta dërgoj edhe nga një letër që kam marrë nga Suedia dhe SHBA.* ***Jemi duke punuar në dalje të revistës, por prapë se prapë emri i saj po kontestohet e diskutohet****. Prej Ankarasë nuk ka ardhë ndonjë material." (*Letër Sabri Novosellës, 22 maj 1982)

Në ditët në vazhdim e kam përgatitë numrin e parë të Zërit të Kosovës, dhe në këtë numër ideologu Abdullah Prapashtica me shokët e vetë nuk kontribuoi me asnjë germë të vetme. Të vetmin kontribut që Osman Osmani e ka bërë për këtë numër ka qenë daktilografimi i dy shkrimeve të mija dhe kërkesa e tij që të hiqet citati i Jusufit:

"Në ballë të këtij populli dhe tek këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme."

6. Tri kushtrime dhe ndikimi i kulloshtrës

Më 17 shkurt 1982 bëhet bashkimi i Organizatave në bazë të dokumentit si vijon:
"DOKUMENT , Nga mbledhja e përbashkët në nivel të përfaqësuesve të KQ të LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, (...) ,VENDIM
I mbledhjes së përbashkët të përfaqësuesve të dy organizatave motra patriotike revolucionare LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ
1. Organizata e formuar nga dy organizatat e mëparshme LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ të quhet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ)....
6. Organi i LRSHJ të jetë "Zëri i Kosovës" pasi ky emër shpreh zërin e Kosovës... ".
Qemajli (Faton Topalli), Shpendi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani)
KUSHTRIMI *(Abdullah Prapashtica), Mërgimi (Sabri Novosella)"*

Shkolla e UDB-së*: "Më 24 qershor, gjatë një vizite të* ***rastësishme*** *në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor (1982-shën i Xh. D.)"* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.145)

Për Nuhi Sylejmanin, Abdullah Prapashticën dhe Osman Osmanin, demonstrata dhe njoftimi për demonstratën e 26 qershor 1982, paska qenë i rastësishëm. Por për të gjithë

të tjerët kjo ditë nuk ka qenë e rastësishme. 26 qershori 1982 ka qenë dita e fillimit të punimeve të Kongresit XII të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe në këtë ditë është organizuar demonstratë në Bern dhe Sydney, në koordinim përmes Rilind Bytyçit dhe Xhafer Durmishit.

> Ramadan Pllana: *"... me ndërmjetësimin e ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxha shpallin bashkimin e organizatave ilegale..."*
> Abdullah Prapashtica ("komunist" dhe ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Bujar Hoxha nuk e ka **shpallur** bashkimin e organizatave ilegale, por këtë e ka bërë Komiteti Drejtues i LRSSHJ me një **Komunikatë**."* (Çka është dëshmi e çka jo?, www.albaniapres.com, 14 shtator 2011)

Thirrjen për këtë demonstratë (të Bernit) e ka shkrua Xhafer Shatri. Së bashku me këtë thirrje është publikuar në Evropën Perëndimore **për herë të parë** edhe Komunikata e bashkimit të organizatave më 17 shkurt e 15 maj 1982. Komunikata e bashkimit të 17 shkurtit 1982 është shpërndarë (pa i marrë leje Abdullah Prapashticës) menjëherë në Kosovë nga Sabri Novosella përmes Imer Berishës e Rexhep Mehmetit. Pezullimi i shpalljes së bashkimit në Evropë, pra ndalimi i shpërndarjes së Komunikatës, prej 17 shkurtit deri në prag të 26 qershorit 1982 është bërë me kërkesën e insistimin e Partisë "Komuniste" të Shkollës së UDB-së Serbe, kërkesë të cilën unë, për ndryshim nga Sabriu, e kam respektuar. Edhe atëherë kur Komunikata e bashkimit botohet, Shkolla e UDB-së me teatralizmin e vetë paraqitet se nuk është njoftuar për këtë, por se thirrjen e demonstratës së 26 qershorit e me këtë edhe Komunikatën nuk i paskan pa, por rastësisht e gojarisht, më 24 qershor kanë marrë vesh se më 26 qershor do të organizohet demonstratë në Bern.

Teksti i Komunikatës:

"KOMUNIKATE

*Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave **NË NJË TË VETME**. Pas arritjes së bashkimit u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.*

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit, përfaqësuesit e tri organizatave në mes tjerash morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet ''Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).

2. LRSHJ-a si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës e terrorit serbomadh janë detyruar t'i lëshojnë trojet e veta të stërlashta.

3. LRSHJ-a do të luftoj për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilën duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare, dhe për realizimin e këtij qëllimi do të shërbehet me të gjitha mjetet që lejon etika revolucionare, duke u nisur nga bindja politike e gjer tek revolucioni i armatosur, po që se e kërkon nevoja.

4. LRSHJ-a është thellësisht e bindur se duke luftuar për Republikën Shqiptare në kuadrin e Federatës Jugosllave do t'i kontribuoj ruajtjes dhe forcimit të bashkimit dhe vëllazërimit të mirëfilltë në mes popujve të Jugosllavisë. Si përfaqësuese e vetme e popullit shqiptar në shtetin jugosllav, LRSHJ-a konsideron se lufta e saj e drejtë i

shërben edhe forcimit të unitetit të Federatës Jugosllave, ruajtjes së paqes në Ballkan dhe stabilitetit të përgjithshëm në Evropë e më gjerë.
5. LRSHJ-a llogaritë në ndihmën dhe përkrahjen e të gjitha forcave progresive të Jugosllavisë, të cilave u propozon luftë të përbashkët kundër forcave hegjemoniste, kolonialiste, shoviniste dhe forcave tjera reaksionare në Jugosllavi, të cilat sot kanë pozita dominuese në të gjitha strukturat e shtetit dhe si të tilla paraqesin rrezik permanent për të ardhmen e Jugosllavisë, për perspektivën e popujve që jetojnë në te dhe për paqen në këtë regjion.

KOMUNIKATË

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe të Viseve tjera shqiptare në Jugosllavi(LNÇKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mblodhën më 17 shkurt 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave në një të vetme. Pas arritjes së bashkimit u vendosë që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Në ndërkohe bisedime u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës(OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 maj 1982.

Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit përfaqësuesit e të tri organizatave me këtë rast pos tjerash, morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të pagëzohet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi;
2. LRSH-ja si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar në Jugosllavi, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës dhe terrorit serbomadh janë detyruar t'i lënë trojet e veta të stërlashta.
3. LRSHJ-a do të luftojë për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, në të cilin duhet të përfshihen të gjitha territoret etnike shqiptare dhe për realizimin e këtij qëllimi do te sherbehet me te gjitha mjetet qe lejon etika revolucionare:

Kjo Komunikatë u daktilografua, u shtyp dhe u shpërnda nga Xhafer Shatri, në të njëjtën fletë (së bashku) me thirrjen - KUSHTRIMIN- e demonstratës së Bernit, të 26 qershorit 1982

6. LRSHJ-a me të gjitha forcat do të luftoj kundër çdo shovinizmi e separatizmi, sepse edhe këto izma reaksionare, që mund të paraqiten edhe tek ndonjë shqiptar, e dëmtojnë unitetin e Jugosllavisë dhe vetvetiu edhe luftën e drejtë që bënë populli ynë.

7. LRSHJ-a përshëndet qëndrimin e drejtë të të gjithë opinionit progresiv ndërkombëtar, që u solidarizua dhe po solidarizohet me kërkesën e drejtë të popullit tonë për Republikën e vet në kuadrin e Federatës Jugosllave.
8. Përshëndetet qëndrimi i PPSH dhe i qeverisë shqiptare ndaj kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi për konstituimin e Republikës së vet në kuadrin e Federatës Jugosllave, me çka dëshmon interesimin e vet për këtë pjesë të kombit dhe prinicipialitetit të politikës së jashtme ndaj RSFJ, ku respektohen me përpikmëri parimet e moscënimit të sovranitetit dhe integritetit territorial, mospërzierjes në punët e brendshme, respektimit reciprok dhe barazisë së plotë në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ruajtjes së fqinjësisë së mirë, duke qenë gjithmonë në gatishmëri të plotë të mbrojë interesat e pjesë së kombit brenda normave dhe ligjeve ndërkombëtare.
9. LRSHJ-a u bënë thirrje të gjitha grupeve ekzistuese dhe individëve që luftojnë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi që t'i bashkohen Lëvizjes për Republikë.
10. LRSHJ-a që tash distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë terrorizmi dhe s'do t'ua shtrijë dorën e pajtimit individëve që i kanë duart e zhytura me gjakun e popullit. Gjithashtu Lëvizja s'do të bashkëpunojë asnjëherë me rrymat e organizatat politike që mbajnë vulën e tradhtisë, apo kanë qëllim ta rrezikojnë pavarësinë e Jugosllavisë.
11. Organ qendror i LRSHJ-së do të jetë "Zëri i Kosovës".
12. LRSHJ-a ua bënë me dije si OKB-së ashtu edhe qeverive të të gjitha shteteve që janë për paqe, liri dhe demokraci në botë, se pa iu njohur popullit shqiptar në Jugosllavi statusi i kombit dhe e drejta e patjetërsueshme e tij për Republikën e vetë në kuadrin e Federatës Jugosllave; pa u liruar pa asfarë kushti të gjithë të burgosurit politik dhe pa mundësimin e kthimit në vendlindje të të gjithë atyre që luftuan për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, LRSHJ-a nuk do të qetësohet kurrë.
RROFTE REPUBLIKA SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI!
RROFSHIN TE GJITHE POPUJT E RSFJ!
RROFTE LEVIZJA PER REPUBLIKE!
Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ"

Fillimi i thirrjes për demonstratë, i shkruar nga Xhafer Shatri ishte
"Motra shqiptare, e ju vëllezër të shtrenjtë, ju të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë, para jush LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI lëshon:

KUSHTRIMIN

Të gjithë ju, i madh e i vogël, në shtatë e shtatëdhjetë, kudo që të ndodheni, kur t'u bjerë në dorë kjo thirrje, lërini të gjitha dhe përgjigjuni zërit të atdheut, sepse ai ka nevojë më shumë se kurrë për ju."

Kur na vjen kjo thirrje në Shtutgart Osman Osmani bëhet tym e idhnohet e bunitet sa nuk ka ku shkon më tej. Kur e pyes se pse je idhnue e çka ka të keqe në këtë thirrje, Osmani thotë se, askush tjetër pos Abdullahut nuk guxon me lëshue farë kushtrimi a farë uzbune, se nuk është rastësi që Duli, apo dajoku e ka pseudonimin **Kushtrim Kosova.**

Pra siç shihet shumë qartë për atë që ka se sy me pa dhe mend me marrë vesh, pseudonimi i themeluesit të Lëvizjes dhe organizatorit të demonstratave të vitit 1981 Abdullah Prapashticës në atë kohë ka qenë **KUSHTRIM** Kosova çka do të thotë kjo se vetëm Abdullahu në atë kohë e ka pasur të drejtën me e dhanë urdhrin për uzbunë.



Motra shqiptare, e ju vëllezër të shtrenjtë, ju të ndjekur, të shtypur e të shpërndarë, para jush, LËVIZJA PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI lëshon:

KUSHTRIMIN

Të gjithë ju, i madh e i vogël, në shtatë e shtatëdhjetë, kudo që të ndodheneni, kur t'u bjerë në dorë kjo thirrje, lërini të gjitha dhe përgjigjiuni zërit të atdheut, sepse ai ka nevojë më shumë se kurrë për ju. Pra edhe kësaj radhe organizohuni masovikisht dhe ashtu tok ejani të shtunën me 26 qershor në ora 11 në stacionin e trenit në Bern të Zvicrës, sepse aty do të ju presin qindëra vëllezër e motra, që kanë ardhur nga anë e anës për t'i dalë atdheut zot, për ta marrë popullin tonë të shumëvuajtur në mbrojtje dhe për ta ngritur lart e më lart gjer në diell zërin e trojeve tona të stërlashta që sot rënkojnë nën helmetën qizmën dhe bajonetën jugosllave. Prandaj lërini të gjitha punët dhe meritë e rastit, hudhini mospajtimet e ndryshme dhe të bëheni grusht si gjithnjë kur e do interesi i atdheut, unikë e të fortë si graniti dhe ashtu të shkojmë bulevardeve të kësaj metropole evropiane dhe t'ua përcjellim të gjithë përfaqësuesve të shteteve të botës, rënkimet e nënave që kanë mbetur me duar në gji, sepse jugosllavët ua vranë fëmijët e ua shkelën burrat me tanke; t'ua përcjellim ofshamjet e mijera vellezerve e motrave tona që po torturohen e masakrohen nëpër burgjet e llahtarshme jugosllave; t'ua përcjellim gjëmimin e rrugëve tona të përgjakura që s'po mund ta durojnë më qizmën,helmetën dhe bajonetën jugosllave... dhe në këtë mënyrë t'ia bëjmë me dije tërë botës se vullneti i një populli dymilionësh s'mund të shtypet me forcën e armëve.

Thirrja për demonstratën e Bernit, për 26 qershor 1982 (për të cilën u vendos më 15 maj, në prani të Osman Osmanit) u shtyp bashkërisht me Komunikatën e bashkimit të 17 shkurtit dhe vendimit të 15 majit 1982. Pezullimi i shpalljes së bashkimit të 17 shkurtit, në Evropë, deri në prag të 26 qershorit 1982 u bë me kërkesën e Partisë "Komuniste" që shpresonte se 15 maji do t'u jepte më shumë se 17 shkurti.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"***VONË U NJOFTOVA ...** ***Më 24 qershor****, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe145)

Unë me tërë forcën time e kam mbrojtur Xhafer Shatrin, dhe argumenti im kryesor ishte se poternica kundër tij ka qenë shumë më e ashpër se sa për ish-inspektorin e UDB-së.

Më lartë e pamë se si Shkolla e UDB-së Serbe gënjen se rastësisht kanë marrë vesh për demonstratën e Bernit, kur në këtë kohë Abdullah Prapashtica e Osman Osmani thoshin se i kanë dërgua Notë, Ultimatum LKJ-së në Kongresin XII. Përjashtimi im nga Zvicra të cilin e kam sqaruar më herët, nga 20 prilli 1982-20 prill 1984, ka ndikuar që unë të hyj në Zvicër me pasaportë të një shoku. Kjo do të thotë se në pasaportën e huazuar, e as në timen, nuk kam futur kurrfarë adrese sekrete, as nuk kam pasur me vete kurrfarë adrese sekrete për këtë udhëtim. Më 20 prill 1982 në Basel, kur policia zvicerane ma ka ndaluar hyrjen në Zvicër për dy vjet, ma kontrolluar bllokun e adresave. Në atë bllok ka qenë adresa e Rilind Bytyçit në Australi, Sejdi Bytyçit në Nju Jork, adresa e Vëllezërve Gërvalla në Untergruppenbach e disa numra telefonash.

Këto adresa nuk më janë konfiskuar, por e marrë me mend se policia mund të ketë mbajtur shënime.

Shkolla e UDB-së Serbe*: "Gjatë kontrollit, u hetua se Hafiz Gagica udhëtonte me pasaportën e Xhafer Durmishit, brenda së cilës ndodheshin edhe disa* ***copa letrash me adresa sekrete, që i kishin takuar Jusuf Gërvallës.*** *Policia kufitare zvicerane* ***i konfiskoi adresat****, duke treguar se e njëjta pasaportë ishte e regjistruar në organet kufitare si e parregullt. Përveç Hafizit, nga autobusi e nxorën edhe Osman Osmanin. Krejt në fund, kufitarët zviceranë bënë një gjest jashtëzakonisht të mirë. Edhe pse jo në rregull, ju dhanë leje ta vazhdonin rrugën."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.146)

Nga kjo rrjedh se edhe fjala "konfiskim adresash" është gënjeshtër e kulluar. Kjo shprehja "konfiskim adresash" të përgatitura e mbledhura nga Jusufi, ku ai dërgonte gazetat e "Zërin e Kosovës" përmendet në një letër timen dërguar Sabri Novosellës, në mars 1982.

Xhafer Durmishi: *"Adresën e Besnikut (djalit të Metush Krasniqit - shën i Xh. D.) nuk e kemi. Besojmë se shumë* ***adresa të konfiskuara*** *së shpejti do t'i kemi në dorë. Megjithatë na i dërgo të gjitha ato adresa që na ke pas dërguar më parë. Gjithashtu na dërgo adresat që do t'i sigurosh nëpërmjet Plakut." (*Letër Sabri Novosellës, mars 1982; Marrë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme..., Tiranë 2010, faqe 287)

Për adresa të konfiskuara bëhet fjalë vetëm për adresat e konfiskuara, apo të marra për hetime së bashku me shumë materiale nga studioja e Jusufit, prej anës së policisë gjermane të Heilbronit, të marra më 18 janar dhe të cilat nuk i ishin kthye familjes gjer në mesin e marsit 1982. Ilustrimet e përdoruara nga Shkolla e UDB-së Serbe në librin *Vrasja e trefishtë* faqe 147, kanë të bëjnë me adresa të Jusufit të marra nga policia gjermane prej shtëpisë së Jusufit më 18 janar 1982 dhe të kthyera diku në mars dhe jo adresa të gjetura në pasaportën time në kufirin zviceran më 26 qershor 1982, të cilat "policia kufitare zvicerane i paska konfiskuar prej pasaportës time dhe ia paska dorëzua Shkollës së UDB-së Serbe".

Pasi është kryer kjo demonstratë e Bernit, të gjithë demonstruesit janë mbledhë në një sallë që ishte rezervuar me kohë, ku do të shfaqeshin recitues të ndryshëm e do të këndoheshin këngë. Ka qenë praktikë, apo ka qenë e shndërruar në traditë, sidomos në vitet 1982-1984, që pas çdo demonstrate të bëhej një tubim në ndonjë sallë të mirë, e cila rezervohej posa të merrej leja e demonstratës. Qëllimi me këto tubime ka qenë që bashkatdhetarët të kenë rast me pushue e me u freskue pas udhëtimeve të gjata prej qyteteve të largëta të Evropës. Një bërthamë e fortë e këtyre demonstruesve prej afër 300 vetash që kishte dalë në çdo demonstratë gjatë vitit 1981, ishte eksponuar shumë para agjentëve e informatorëve të UDB-së dhe nuk kishin shkuar në Kosovë, në pushimet e vitit 1981 e 1982, e shumë prej tyre nuk do të mund të shkonin gjer më 1999. Këta demonstrues në vend të çmalljes me Kosovën, çmalleshin duke e takuar njëri tjetrin edhe në tubimet që bëheshin pas këtyre demonstratave.

Në sallë ishim afër me njëri tjetrin unë, Osman Osmani, Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi. Gjatë kohës kur Osman Osmani ishte duke ia shpreh Xh. Shatrit protestën apo komunikua NOTËN e ish-udbashit për përdorimin e paautorizuar të uzbunës, pas dy tri recitimeve, doli në skenë një këngëtarë nga Dusseldorfi, Mustafë Kelmendi dhe ia krisi këngës:

*Në Perëndim kush e dha **KUSHTRIMIN**,*
Oooooo Isuf Gërvalla me Ibrahimin!

Xh. Shatri m'u afrue pa humbur kohë dhe më tha, a e ndëgjove atë jaranin kah e këndon vëllaun e vetë. U afrua pastaj Ibrahim Kelmendi, bajagi si i skuqur nga turpi për këtë lavdatë duke thënë se këtë farë kënge vëllau i tij e ka përgatitë me javë pa lejen e tij, bile shtoi se me e tjerrë hollë e hollë këtë punë, këtë farë rapsodi nuk e kam krejtësisht vëlla por vetëm gjysmë vëllau, pra vëlla prej babe, se ai nuk është nip i dajës Ramë.

Shumë vite pas qëndrimit tim në Suedi, më ka interesua se cili është shkaku themelor pse disa janë të prirur për kushtrime, dhe një psikolog shumë i njohur më ka thënë se për kushtrime janë të prirur sidomos ata që kanë pi shumë kulloshtër.

STILOGRAFAT E JUSUF GËRVALLËS

Naim Frashëri: "Lum ti moj Shqipëri thash
armët e Tij kur pash
në Belvedere në Vjenë
sikur pash Skenderbenë"

Jusuf Gërvalla: *"Më ke pyetur si qëndrojmë me çështjen financiare, lidhur me*



nxjerrjen e gazetës. Numri i parë (i Lajmëtarit të lirisë, gusht 1980-shën. i Xh. D.), i cili është radhitur e shtypur krejtësisht në një shtypshkronjë, e që është e natyrshme që ka dalë teknikisht më së miri, ka kushtuar 2540 mark. Ky ishte një çmim shumë i lartë sa të mund ta përballoja, madje edhe me pjesëmarrjen modeste të disa njerëzve që u treguan të gatshëm të ndihmojnë (pa e ditur për çka është fjala). Prandaj, bashkë me vëllaun vendosëm ***ta marrim me kredi një makinë shkrimi të përshtatshme*** *(është kjo, me të cilën po ta shkruaj letrën dhe me të cilën* ***janë radhitur dy numrat e fundit të "Lajmëtarit të lirisë****"). **Makina kushtonte relativisht pak (5080 mark)** dhe, me disa funksione elektronike që kryente, jepte mundësi të nxirrej disi revista, sado që mua më ngarkonte shumë, sepse, pos që i shkruaja të gjithë artikujt, më duhej edhe t'i radhitja e t'i përgatisja teknikisht të gjitha faqet. Por, shpenzimet që mbeteshin për t'iu paguar shtypshkronjës në proçesin e mëtejshëm të shtypjes e të shumëzimit të revistës, ishin shumë të vogla, vetëm 600 mark." (Letër Sabri Novosellës, më 13 maj 1981;*Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 264*).*

Makina për të cilën këtu bëhet fjalë, e cila ka kushtuar 5080 DEM (marka gjermane) ka qenë një makinë e firmës Olivetti. Pra siç shihet, me këtë makinë janë (radhitur) përgatitur për shtyp numrat 2 (tetor-nëntorit 1980) dhe 3 (janarit 1981) të Lajmëtarit të lirisë. Poashtu me këtë makinë është përgatitur për shtyp edhe numri i fundit i Bashkimit, para 19 dhjetorit 1980, para nisjes së Hysen Gegës në Kosovë. Me këtë makinë të markës Olivetti janë përgatitur për shtyp edhe numrat 3 (maj) dhe 4-5 (gusht) 1981 të revistës "Liria" Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës.

Ajo çka vlen të përmendet është se Jusufi gjatë përgatitjes së "Lirisë" përdor të njëjtin lloj të germave sikurse i ka përdorur tek numri 2 e 3 i "Lajmëtarit të lirisë".

Jusuf Gërvalla: *"Por kur është fjala për botimin e "Zërit të Kosovës", mendoj se del edhe një problem. Sipas të gjitha gjasave, tashmë është identifikuar se kush qëndron prapa "Lajmëtarit" dhe kështu edhe mënyra se si radhitet ai. Pra, kjo makinë shkrimi, sipas mendjes sime, nuk do të duhej të përdorej edhe në radhitjen e "Zërit të Kosovës". Kurse radhitja në shtypshkronjë kushton shtrenjtë, siç u pa. Mbesin dy mundësi: ose të shitet kjo makinë (po tash me çmim më të ulët, se kështu ngjan këtu) dhe të blehet një lloj tjetër makine, duke shtuar edhe para të tjera, ose të merret kohë pas kohe me qira ndonjë makinë tjetër për radhitjen e gazetës. Se sa do të shpenzoheshin me variantin e parë dhe sa me të dytin, të informoj këto ditë në telefon, por e di se, për një punë më të rregullt në nxjerrjen e gazetës, do të duhej një ndihmë bukur e madhe financiare. Dhe unë nuk e di se sa keni mundësi, Ti me shokët, të ndihmoni së andejmi. Për shembull, një makinë për radhitje, me të gjitha llojet e germave ë përdoren në gazeta e libra e që prandaj s'ka si të identifikohet, e re kushton mbi 20 mijë mark, po e përdorur ka mundësi të gjendet edhe 10 mijë. E këto janë para të mëdha. Ndryshe, po të zgjidhet çështja e makinës, shpenzimet e shumëzimit të revistës do t'i përballoja vetë, me disa shokë këtu, pa kurrfarë problemi. Këtu kam një propozim. Ai shoku në Mynhen, përmes të cilit e mora lidhjen me Ty, Shabani, është një milioner. Nëse shokët që ke Ti atje kanë ndikim në të, atëherë ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do t'i ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju. Sido që të jetë, para se t'ia nis punës për nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", duhet të dija se deri në çfarë shkalle mund të më ndihmoni së andejmi materialisht."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 264-265)

Dokumenti i gatshmërisë

Gjithë ai shqiptar që – duke harruar demostratat historike të vitit 1968 – ka harruar ç'është forca e masës së revoltuar, këto ditë pati rast të përkujtohet edhe një herë, me demostratat e futbolldashësve të Prishtinës, më 21 shtator.

Vendi dhe preteksti i tyre mund të jetë i pakuptim në dukje të parë: reagim për një padrejtësi sportive në fush ën e futbollit. Por, duhet të jesh fare jashtë realitetit shoqëror kosovar, nëse çështjen e kufizon në këtë mënyrë. Edhe fizikisht, demostratat kaluan jashtë fushës së sportit, u përhapën në rrugët e Prishtinës dhe zgjatën deri na- tën vonë. Vallë, një padrejtësi e thjeshtë sportive mund t' i shtynte qytetarët tanë që "tërbimin" e tyre ta derdh- nin mbi çdo autobuj, të madh a të vogël, që nuk kishte targë të Krahinës sonë?! A s'i përkujtojnë autobusët dhe ve turat e përmbysura, demostratat e 1968-ës?!

Lajmëtari i lirisë, tetor-nëntor 1980, faqe 6. Pjesë nga artikulli "Dokumenti i gatshmërisë"

Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj

Cdo pushtues, për të bërë zap popullsinë e pushtuar, rekruton në organet e pushte tit të vet një numër vendësish,të cilët bëhen përçes të politikës, të ideologjisë dhe të urdhrave të atij pushteti.

Nga viti 1912, kur tokat shqiptare në Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe ato në Serbinë e sotme të ngushtë iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar dhe hynë nën zgjedhën e egër serbomalazeze, në shërbim të pushtetit të huaj hynë edhe njerëz nga radhët e popullsisë vendëse shqiptare, që nga "poverenikët" më të thjeshtë e deri te deputetet në parlament.

Përfaqësues tipikë të indigjenëve të rekrutuar në aparatin shtetëror të pushtues- ve jugosllavë ishin dikur Dragajt e Mitrovicës, Begollët e Pejës, Kruezitë e Gjakovës etj., dhe më pastaj, në aparatin revizionist titist – Fadilj Hodžët, Džavid Nimanët, Mahmud Bakalët etj.

Liria, gusht 1981, faqe 12. Pjesë nga artikulli i Jusuf Gërvallës, "Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj"

Kurthet dhe hendeqet

Kosova dhe dispozita kushtetutare jugosllave mbi statusin e territorit kombëtarisht të papërzier

Herët a vonë,pushtuesit dhe klikat antipopullore do të gremisen atje ku ua kanë bërë vendin historia dhe popujt e shtypur. Këtij mallkimi nuk do të mund t'i bëjë bisht as Jugosllavia titiste.Ajo vërtet ka kurdisur shu- më leqe dhe ka hapur shumë llagëme për punonjësit dhe popujt e shtypur,që të mbajtur me forcën e dhunës brenda kufijve administrativo-politikë të këtij shteti socialshovinist,do të shtrëngohen t'i japin shumë e shumë zor për ta hequr qafën nga laku.Megjithatë,përditë po bëhet më e qartë se kë- ta popuj do të mbesin edhe më tej ata që janë – të përjetshëm,kurse në ku rthat e në hendeqet e kurdisura për ta do të bjerë vetë kreatura e regji- mit antipopullor jugosllav,në krye me hegjemonizmin serb,e me shovinizmin malazez e maqedonas shokë të ngushtë.

Lajmëtari i lirisë, janar 1981, faqe 7. Pjesë nga artikulli "Kurthet dhe hendeqet". Ajo që duket qartë dhe që vërtetohet është se të gjitha këto gazeta, janë bërë me të njëjtën makinë dhe për këta artikuj është përdorë i njëjti lloj i germave të shtypit (në anglisht-Fonts)

Ajo që duket qartë dhe që vërtetohet është se të gjitha këto gazeta, janë bërë me të njëjtën makinë dhe për këta artikuj është përdorë i njëjti lloj i germave të shtypit (në anglisht-Fonts)

Faridin Tafallari: *"Një ditë Bardhoshi më thirri në telefon në firmën ku punoja dhe më tha: 'Faridin, sonte ty dhe Nuhi Sylejmanin ju ka thirrur Jusufi që të vini se ka diçka me bisedue'. Unë mora Nuhiun dhe shkuam te Bardhoshi në Ludwigsburg. Pritëm deri sa la punën dhe së bashku vajtëm te Jusufi. U gëzua edhe ai kur na pa. Pas shumë bisedimesh na lajmëroi se do të nxirrte një gazetë, "Zërin e Kosovës", të cilin e kishte në përgatitje e sipër. Pas një heshtje të shkurtër na tha: "Pra sonte do t'ju kërkoj ca të holla se kam gjetur një makinë radhitëse shtypi. Kur është e re ajo kushton 20 mijë*

Lloj koke e makinës Olivetti

marka, por unë e kam gjetur një makinë pak të përdorur, po që është e mirë dhe që kushton 9 mijë marka." Unë dhe Nuhiu i thamë që ta blente makinën se ne do ta ndihmonim atë. Dhe ashtu u bë; të hollat ia çuam disa ditë më vonë dhe unë i dhashë 3000 DM. Pas një kohe mua m'i ktheu të hollat, sepse ashtu më kishte thënë. Korrektësia e tij shfaqej në çdo gjë." (Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f.35)

Për këtë makinë shkrimi Nuhi Sylejmani në vend që ta tregoj të vërtetën, servon gënjeshtra të paturpshme e skandaloze, i nxitur nga gënjeshtarët, dhe me këtë ia humbë veti edhe atë punë të ndershme që e ka bërë.

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Menjëherë pas kësaj demonstrate (sipas N.S. të 4 korrikut 1981 në Frankfurt-shën i Xhafer Durmishit), ne nëntë anëtarët e celulës „Vullneti" u mblodhëm për të diskutuar rreth mundësisë së grumbullimit të parave për blerjen e makinës së shkrimit, për të cilën ditë më parë kishim diskutuar me Jusufin. Pasi i pleqëruam hollësisht mundësitë tona, arritëm në përfundim se vetëm ne, nëntë anëtarët e celulës sonë, që ishim: Nuhi Sylejmani, Ismet Klaiqi, Shaban Klaiqi, Mejdi Rexha, Islam Rafuna, Ismajl Qirezi, Hesat Dushica, Abdurrahman Sadiku dhe Rasim Lipovica, pa u zgjeruar me shokë të tjerë, kishim mundësi që ta grumbullonim shumën e nevojshme. Vendosëm t'i ndajmë nga 2.000 marka për çdo anëtar. Brenda një kohe të shkurtër u grumbulluan 18.000 marka. Me pëlqimin e shokëve, i mora paratë dhe shkova në shtëpinë e vëllezërve Gërvalla. Të dy vëllezërit i gjeta në shtëpi. Më pritën jashtëzakonisht ngrohtë. Pas bisedave të rëndomta, i tregova Jusufit arsyen e vizitës, duke ia lëshuar në dorë shumën prej 18.000 markash. Fytyra i ndriti nga kënaqësia e beftë. Shumën në fjalë ia dorëzoi Bardhoshit, duke më falënderuar përzemërsisht.*

(Këto të dhëna që dëshmohen nga nëntë anëtarët e celulës „Vullneti", janë në kundërshtim të plotë me ato që shkruan Fahredin Tafallari, në faqen 35, të librit të tij me titull „Terror, dhembje, qëndresë", se gjoja ai ia paskësh huazuar Jusuf Gërvallës 3.000 marka për blerjen e makinës së shkrimit.) Në ditët pasuese Bardhoshi e kishte blerë një makinë shkrimi të tipit ***„Olivetti****", në vlerë* ***prej 13.000 markash****. Edhe pse makina nuk ishte e re, i plotësonte të gjitha standardet e nevojshme. Ndërsa, me mbetjen prej 5.000 markash kishte blerë dy videorekorderë të rinj, me qëllim inçizimi dhe shumëzimi të materialeve propagandistike dhe filmave nga kinostudioja „Shqipëria e Re".* (Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 56)

Ajo çka thotë Faridin Tafallari në këtë rast është gjithçka e vërtetë dhe ajo çka e thotë Shkolla e UDB-së Serbe e Abdullah Prapashticës, përmes Nuhi Sylejmanit, prej fillimit e deri në mbarim është rrenë dhe asnjë shokë i tij i asaj kohe, duke e njohur labilitetin e Nuhiut, nuk guxon me u lidhë për fjalët e tij si shok i dezertorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica.

Makina e blerë e Jusufit, në vjeshtën 1981, pika e parë nuk ka qenë e markës Olivetti. Edhe pse Nuhiu lufton me thënë se ka qenë shokë që i di rrethanat rreth Jusufit këtë

emrin e markës Olivetti, Dezertori i UDB-së, për llogari të Nuhiut, e ka vjedhur nga gënjeshtra e Ibrahim Kelmendit prej librit Atentatet.

Ibrahim Kelmendi: *"Xhabiri zuri të tregojë se teknika e Zërit të Kosovës do të kalojë në Zvicër, pa precizuar se do të vendosej në banesën e tij, duke paralajmëruar vetëlavdërueshëm se këtej e tutje Zëri do të dalë më cilësor. Bëhej fjalë për një makinë të markës* ***"Olivetti",*** *me të cilën mund të radhiteshin e faqoseshin tekstet e Zërit. Atë e kishte blerë Jusufi me dhjetë mijë dollarë që ia kishte dërguar si ndihmë Enver Hoxha. Kaq i kishte kërkuar Jusufi në letrën që i kishte dërguar Enverit." (Atentatet, Prishtinë 2007, f.432)*

Fatkeqësia e rrenës së Nuhiut dhe Dezertorit të UDB-së bashkë me Vëzhguesin, është se ai këtë rrenë të Ibrahimit e ka marrë për të vërtetë dhe u mundua të na jep detale për të krijuar përshtypjen se thotë gjëra të vërteta, por ka ndodh e kundërta. Rrena e vjedhur nga Ibrahim Kelmendit na del rrenë e shitur prej Nuhi Sylejmanit. Siç e pamë më lartë, makina e markës Olivetti (edhe pse këtë markë nuk e përmend Jusufi) ka kushtuar 5080 marka gjermane dhe është ble me kredi nga Jusufi e Bardhi.

Jusuf Gërvalla: *"Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe,* ***unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla-shën im)*** *jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e* ***Shpendit, e Besnikut*** *dhe e shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe* ***Shpendi edhe Besniku****, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne.*

Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës. ***Maqinë për të blerë nuk kemi gjetur ende, por shpresojmë se do të na bjerë në dorë diçka e mirë****. Tani për tani duhet të marrim, për këtë numër, një maqinë të tillë me qira. Këtu praktikohet kjo gjë."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981. Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Nga letra e mësipërme del se Jusufi, më 20 gusht 1981 i tregon Sabri Novosellës se *Maqinë për të blerë nuk kemi gjetur ende, por shpresojmë se do të na bjerë në dorë diçka e mirë.* Në dritën e fakteve të lartpërmendura është shumë interesant me i analizua gënjeshtrat e Dezertorit të UDB-së Serbe dhe Vëzhguesit të dezertorit të UDB-së Serbe me të cilat e kanë ushqye "Luanin e tyre superior".

"***Pas blerjes së makinës*** *së shkrimit, Jusufi bëri një* ***punë të jashtëzakonshme****. I nxori nga shtypi revistat „Lajmëtari i lirisë" dhe „Bashkimi". Në anën tjetër, Kadri Zeka e kishte përgatitur revistën „Liria" dhe në bashkëpunim me Jusufin e nxorën nga shtypi edhe këtë në fund të muajit gusht."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, f.58)

Nga citati i mëhershëm i Nuhi Sylejmanit (Vrasja e trefishtë, faqe 56) del se Nuhiu me shokët e Sindelfingenit e kanë diskutuar mbledhjen e të hollave për makinën e Jusufit, pas demonstratës së Frankfurtit (sipas Nuhi Sylejmanit, të 4 korrikut 1981).

Tash është vendi me e pyet Dezertorin e UDB-së Serbe Abdullah Prapashticën dhe Vëzhguesin e tij Osman Osmanin: Si është e mundur që me një maqinë të cilën Jusufi nuk e ka posedua e as lokalizua me 20 gusht 1981 të përdoret për të bërë ***"punë të jashtëzakonshme"*** për nxjerrjen e Lajmëtarit të lirisë dhe Bashkimit, kur dihet nga të gjithë të interesuarit, fakti se numrat e fundit të Lajmëtarit dhe Bashkimit janë kryer së radhituri dhe dorëzuar në shtyp në dhjetor 1980 e janar 1981. Vetëm e vetëm këto gënjeshtra të Nuhi Sylejmanit dhe Dezertorit të UDB-së Serbe Abdullah Prapashtica,

mjaftojnë për ta studiuar karakterin e shpifjeve që gjenden në librin "Vrasja e trefishtë", taktikën e shkollës së UDB-së Serbe për ta vjedhur mundin e djersën e të tjerëve. Pas këtyre gënjeshtrave të gatuara nga kuzhina e shkollës së UDB-së Serbe, cili është ai shok i Vëllezërve Gërvalla që guxon me u lidhë për rrenat e Nuhi Sylejmanit. Jo vetëm kaq por ata do të duhej me i kërkua llogari se prej kah i piku e drejta që Nuhi Sylejmani, historinë e tyre të lavdishme si shokë të Vëllezërve Gërvalla, ta lidhë me historinë e turpshme dhe të rrejshme të Dezertorit të UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica dhe Vëzhguesit të Dezertorit të UDB-së Serbe, Osman Osmanit.

Makina e markës "IBM Electronic Selectric Composer." dhe një prej llojeve të kokave të shkrimit (madhësia e kokës krahasuar me monedhën prej 2 euro)

Kjo fotografi paraqet modelin ekzakt të makinës së Jusuf Gërvallës, por jo origjinalin. ***Origjinali i makinës së Jusufit gjendet në Muzeun Belvedere të Vjenës??***

Kundërthënie e njëjtë skandaloze vlen edhe për përgatitjen e revistës Liria. Edhe revista Liria që është radhitur e përgatitur për shtyp (numri 3, maj 1981) dhe numri 4-5 (në fund të korrikut 1981) janë përgatitura nga e njëjta makinë Olivetti (që ka kushtuar 5080 marka) dhe jo ndonjë makinë tjetër. Përkundër të gjitha sqarimeve në një pikë nuk kam mundur të jap përgjigje të kënaqshme dhe ajo qëndron në faktin se "komunistët" kopuk të Shkollës së UDB-së Serbe a janë më të xhymert në komplimente apo në kopek.

Në mesin e shtatorit Jusufit i bjenë në dorë diçka e mirë. Ai e blen një maqinë për përgatitjen e "Zërit të Kosovës, të markës IBM, e quajtur me emrin e plotë "IBM Electronic Selectric Composer". Në vitin 1975 IMB-i lajmëron, reklamon maqinën "IBM Electronic Selectric Composer." Ky Composer ka mundësi të mbaj mend (në kapacitetin e memories) rreth 5000 goditje (shtypje të tangentave të maqinës), rreth 2 faqe A4. Kjo maqinë ka qenë një përmirësim dramatik i maqinës origjinale të quajtur "IBM Composer".

Faridin Tafallari dhe Nuhi Sylejmani ia huazojnë Jusufit së bashku rreth 6000 (gjashtëmijë) apo diçka më shumë, marka gjermane (DM) dhe me këto të holla paguhet maqina (duke ia shtua një pjesë më të vogël edhe Bardhi e Jusufi). Çmimi, me të cilën kjo makinë është ble ka qenë rreth 8000 DM. Dy muaj më vonë (nëntor 1981), Jusufit i vijnë 10 mijë dollarë amerikan nga Turqia. Sipas kursit të dollarit me markën gjermane në vitin 1981, 10 mijë dollarë kanë bërë 22 mijë e 600 marka. Prej këtyre të hollave Jusufi ua kthen huan Faridin Tafallarit e Nuhi Sylejmanit.

Tani (shtator 1981) jemi në kohën kur Jusufit, përveç maqinës së IBM-it, i bjenë në dorë diçka edhe më e mirë se maqina, e kjo e mirë nuk është as më pak e as më shumë se sa dokumenti i OMLK-së me titull "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Këto Teza janë përpiluar në maj 1981. Kur i kanë ardhur Kadri Zekës në Zvicër nuk e di. Por ajo çka është më kryesorja në këtë rast është se këto teza Jusufit i kanë ardhur në gjysmën e dytë të shtatorit 1981. Jusufi posa i ka marrë i ka rishkruar dhe radhitur mirë në maqinën e porsa blerë të IBM-it. Rishkrimi e radhitja e këtyre Tezave është e vetmja punë që është bërë për llogari të OMLK-së me maqinën e Jusufit me emrin komplet *IBM Electronic Selectric Composer.*

Me makinën "IBM Electronic Selectric Composer" është radhitur numri i parë dhe i dytë i Zërit të Kosovës, si Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi, e gjithashtu me këtë makinë është kryer së radhituri nga Jusufi, artikulli *"Armikun ta grishim në logun që duam vet"* që është botuar në numrin 3 (mars 1982) të Zërit të Kosovës si organ i LNÇKVSHJ.

Për makinën e Jusufit flitet gjatë bisedimeve të formimit të Lëvizjes për Republikë në Ankara në këtë formë:

Sabri Novosella: *"-Duke pasur parasysh që propozimi i bërë nga Halimi (Osman Osmani) dhe i përkrahur nga Shpendi (Xhafer Durmishi) e Kushtrimi (Abdullah Prapashtica), kam bindjen se i plotëson kërkesat e forcave patriotike revolucionare dhe të popullit shqiptar që jeton në Jugosllavi; pajtohem plotësisht me këtë propozim dhe shtoj; që të dy komitetet e organizatave të mëparshme të përbëjnë komitetin e LRSHJ kurse udhëheqësia e Komitetit Qendror të zgjidhet në një mbledhje të ardhshme.*

Të formohet një komision nga anëtarët e këtij komiteti për përpilimin e programit dhe statutit të LRSHJ.

Pasi që deri në momentet e fundit të jetës së tij që ra nga plumbat e shovinistëve serbomëdhenj e redaktoi dhe udhëhoqi me plot sukses e edhe pas tashit do të punohet me ***atë teknikë të përsosur të Jusuf Gërvallës,*** *propozoi që organi i LRSHJ të mbaj emrin Zëri i Kosovës".* (Dokumenti i formimit të Lëvizjes për Republikën Shqiptare në

Jugosllavi - LRSHJ, 17 shkurt 1982, Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë, 1997, faqe 217-218 dhe www.pashtriku.org, 2008)
Në kohën kur vendoset vazhdimi i "Zërit të Kosovës" të botuar nga Jusufi, makina e tij ndodhej ende në organet hetimore të policisë kriminalistike gjermane dhe ajo na u kthye disa ditë pas mesit të marsit 1982.

Për makinën e shtypit të Jusuf Gërvallës shkruan Emrush Xhemaili.

Emrush Xhemaili: *"-17 shkurt 1982 në Turqi, përfaqësues të dy grupimeve patriotike të fshehta, Sabri Novosella dhe Abdullah Prapashtica (të arratisur politik nga Kosova), në prezencë edhe të ambasadorit të Shqipërisë në Turqi, z. Bujar Hoxha shpallin të formuar Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ).*
- Më 15 maj të vitit 1982 në Zvicër përfaqësuesi i grupit të tretë patriotik Xhafer Shatri deklaron hyrjen në LRSSHJ.
- Qëllimi i LRSSHJ ishte që të arrihet formimi i Republikës së Kosovës në kuadër të federatës jugosllave ku do të përfshiheshin viset e banuara me shumicë shqiptarë...
***-Në qershor të vitit 1982 në Gjermani me teknikën që kishte lënë dëshmori Jusuf Gërvalla vazhdon botimi i gazetës "Zëri i Kosovës". Redaktor i gazetës ishte Skender Durmishi (Xhafer Durmishi-Skenderi-shën im*).** (20 vjet veprimtari 1982-2002)

Më 28 mars 1982 përcillen gruaja dhe fëmijët e Jusufit për në Shqipëri.

Unë, Haxhi Berisha dhe Naim Haradinaj pjesën më të madhe të verës e kaluam në konviktin e studentëve në **Eduard-Sprangerstrase 7, në Ludwigsburg**. Pas një udhëtimi të kotë, e një qëndrimi të kotë dy orësh në Ulm, dhe një pasdite në librarinë e komunistëve gjerman në adresën Buchhandlung, Hausmannstr 107, 7000 Stuttgart, në Konviktin e Ludwigsburgut në **Eduard-Sprangerstrase 7,** nga shkrimet e mia dhe të Jusuf Gërvallës, falë njohurive teknike e grafike që i kisha mësuar nga Jusuf Gërvalla, u punua numri i Zërit të Kosovës, i qershorit 1982.

Numri vijues i Zërit të Kosovës është përgatitur në banesën e Heroit të Popullit, Remzi Ademajt nga Zhuri, i cili në këtë kohë ka banuar në Marktstr. 29, 7129 Brackenheim, West Germany.

Makina e Jusufit prej banesës së Remzi Ademajt është vendosur në shtëpinë e Ismail Hoxhës nga fshati Marali i komunës së Malishevës, në adresën Heiligen str. 25, 6630 Saarlouis-Roden, West Germany.

Xhafer Durmishi: *" P.S. Dërgoma menjëherë një numër të Zërit, të vitit që kaloi. Pra dërgoma atë Nr. 2 që u botua në janar të vitit të kaluar se do të botojmë artikullin: "T'i japim shtytje të re luftës."*

*I thuaj Hafizit (Gagicës) le të interesohet nëpërmjet gjermanëve se koka **PR-9-B** e kompozerit (composer-it) m'u ka prishur."* (Letër dërguar Faridin Tafallarit, më 2 janar 1983, e botuar në librin e F.Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 442-443)

Emrush Xhemaili: *"- Gjatë vitit 1983: teknika dhe redaktimi i gazetës "Zëri i Kosovës" kalon në Zvicër. Redaktor i gazetës deri në vitin 1985 do të jetë Xhafer Shatri."* (20 vjet veprimtari 1982-2002)

Kah gjysma e muajit shkurt 1983 Ismail Hoxha, në bazë të marrëveshjes time me Xhafer Shatrin të 15 janarit 1983, e mori këtë makinë dhe ia dorëzoi Faridin Tafallarit. Këtë makinë në mesin e shkurtit Faridini e ka marrë në kerrin e tij dhe ia ka dërguar Xhafer Shatrit në Gjenevë.

Faridin Tafallari: "*Më 11 mars (datë e gabuar, duhet të jetë 11 shkurt, shih më poshtë citatin e Xhafer Shatrit - shën im) shpërngula makinën e shtypit për në Zvicër, sipas marrëveshjes së Xhafer Durmishit me Xhafer Shatrin. Me këtë makinë Jusuf Gërvalla kishte nxjerrë dy numra të "Zërit të Kosovës".... Makinën pas Jusufit e kishte përdorur*

Xhafer Durmishi... Por tani sipas marrëveshjes, përgjegjësinë për shtypin e mori Xhafer Shatri, prandaj ai duhej ta kishte makinën në Zvicër. Pasi kalova kufirin nuk mërzitesha fare as për rrugën e gjatë as për lodhjen, se nuk ndjeja aspak lodhje gjersa puna dilte me sukses. Te stacioni i madh i Gjenevës më priste Xhafer Shatri, te një vend i caktuar. U përqafuam si dy shokë ideali dhe me dashuri vëllazërore...

Me makinën e shtypit ishte vështirë të punohej; duhej patjetër që Shatrin ta ndihmonte Xhafer Durmishi që kishte praktikë. Unë me Xhafer Durmishin shkuam dhe e morëm dokumentin e H. për të kaluar kufirin. Kufirin e kaluam në mëngjes pa dalur drita dhe nuk na doli ndonjë problem. Te stacioni i trenit në Basel e lash Xhafer Durmishin dhe u ktheva në Nagold." (Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 71-72)

Për makinën e Jusuf Gërvallës e pranimin e saj në mënyrë të shkëlqyeshme shkruan Xhafer Shatri.

Xhafer Shatri: *"I dashur shok, e mora materialin. Në tërësi është i mirë sepse shtron ide të cilat kërkojnë realizim të menjëhershëm. Për çështjen e mbledhjes është bukur problem sepse mua ato ditë kur të vish këtu duhet të më ndihmosh në përgatitjen e organit, sepse* ***unë s'po merrkam aspak vesh në makinë, ama aspak,*** *bile bile edhe shiritin ia kam ngatërruar sa që s'po di si t'ia rregulloj.... Ndërmerr të gjitha masat që më* ***1 mars*** *të jesh këtu."* (Letër Xhafer Durmishit, shkurt 1983)

Lum ti moj Shqipëri thash
armët e Tij kur pash...

Makine e organit Liria

Fotografia e mësipërme e kësaj makine është marrë nga libri i Mehmet Hajrizit, HISTORI E NJË ORGANIZATE POLITIKE dhe DEMONSTRATAT E VITIT 1981, Tiranë 2008. Libri në fjalë i Mehmet Hajrizit i ka 506 faqe të numëruara. Në fund të

librit, pas faqes 506 vjen kapitulli "Foto e faksimile" në të cilin nuk ka faqe të numëruara. Në faqen e 12 të këtij të kapitullit "Foto e faksimile" gjendet kjo fotografi me nëntekstin, "Makine e organit Liria".

Kjo fotografi e kësaj makine si "Makine e organit Liria" është publikuar nga Saime Isufi në shkrimin: VLERAT HISTORIKE, STUDIMORE E SHKENCORE TË LIBRIT "HISTORI E NJË ORANIZATE POLITIKE DHE DEMONSTRATAT E VITIT 1981"; Rreth librit të autorit Mehmet Hajrizi: „Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981" - Botimet Toena, Tiranë 2008. (www.pashtriku.org, 2 qershor 2009).

Çka paraqet kjo makinë? Kjo është makina e Jusuf Gërvallës.

Kjo është makina e markës *IBM Electronic Selectric Composer* të cilën e blen Jusuf Gërvalla në mesin e shtatorit 1981. Kjo është makina me të cilën Jusufi dhe unë punuam në Zërin e Kosovës. Kjo është makina me të cilën pas vrasjes së Jusufit punova deri në mars 1983. Kjo është makina të cilën, përmes Faridin Tafallarit, ia dërgova Xhafer Shatrit dhe të cilin e mësova se si të punoj me te, gjatë gjysmës së parë të marsit 1983 në banesën e tij në Gjenevë. Kur e pash këtë makinë, pas aq shumë vitesh mu kujtuan vargjet:

"Lum ti moj Shqipëri thash
armët e Tij kur pash
në Belvedere në Vjenë
sikur pash Skenderbenë"

BYTYÇËT E BOTËS

1. Letër nga Pajazit Ibrahimi (Australi), 24 shkurt 1982
2. Letër për Pajazit Ibrahimin, 7 mars 1982
3. Letër nga Sejdi Bytyçi (New York), 23 prill 1982
4. Letër nga Rilind Bytyçi për "Komitetin Vëllezërit Gërvalla" 17 maj 1982
5. Letër nga Rilind Bytyçi, 1 qershor 1982
6. Letër nga Rilind Bytyçi, 2 qershor 1982
7. Letër nga Sejdi Bytyçi, 7 qershor 1982
8. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 qershor 1982
9. Letër nga Sejdi Bytyçi, 24 qershor 1982
10. Fjalimi i Rilind Bytyçit në Demonstratën e Sydneut më 26 qershor 1982
11. Letër nga Pajazit Ibrahimi, 5 shtator 1982
12. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 nëntor 1982
13. Letër nga Sejdi Bytyçi, 22 nëntor 1982

Të gjitha letrat e mëposhtme janë dërguar për mua Xhafer Durmishin, apo të dërguara meje.

1. Letër nga Pajazit Ibrahimi (Australi), 24 shkurt 1982

Pajazit Ibrahimi (Australi)*: "I nderuar bashk-Atdhetar - Skënder!*

Letrën e juaj, bashkë me katër revista i mora. Pra ju lumtë Vëlla i dashur, që tue ju falëmenderua shumë, më ju thënë të drejtën, meqë isha tepër i demoralizuar, mbi çështjet mizore që po ndodhin në Atdheun tonë, dhe lajmet na vinë me vonesë, ngase

gjendemi shumë larg Vendlindjes, pra letrat dhe revistat tuaja na gëzuan pa masë, dhe mi qetësuan nervat. Dhe kjo se çka po ndodhë me Vëllezërit dhe Motrat tona në Atdhe, por më gëzon Lufta që bëjnë, dhe njëkohësisht edhe veprat e punëtorëve tanë në Perëndim. Ju lumtë Vëllezër, se Revolucioni dhe Patriotizmi atë rrugë e ka, dhe le të jetë e lavdishme çdo vepër, e çdo një kosovari trim që sakrifikon gjakun dhe jetën e vet për Atdheun tonë Kosovën trime, që me shekuj e sunduan ...

Vrasja e tre Patriotëve që ndodhi në Gjermani, të dy Vëllezërve Gërvalla dhe një Kosovari tjetër, është humbje e madhe për Atdheun dhe për Popullin tonë, e posaçërisht për familjen Gërvalla. Oh mizori! Qe armiku po na sundon në Vatrën tonë, dhe ajo më e keqja nuk po na lenë në qetësi edhe jashtë kufirit. Por ... pushtuesve dhe tradhtarëve nuk po u shohin sytë se është çuar në këmbë për çlirimin e vendit dhe do të luftojnë deri në pikën e fundit. ...

Këtu në Australi, megjithëse gjendet një numër kogja i madh shqiptarësh, por megjithate disa janë të shitur e disa janë frigacak. Edhe këtu ekziston një grup atdhetarësh, që nuk kursejnë asgjë dhe punojnë për mbrojtjen e Atdheut. Për të ju informuar më mirë, qe urdhëroni një prej revistave, që botohen nga kjo Shoqëri Revolucionare. ...

Megjithëse e kam kuptuar pak se kush jeni, por në të ardhmen ju lutem më shkruani me jeni të vërtetë. ...

Në përfundim, i dërgoj ngushëllimet e mia Familjes Gërvalla dhe shumë të fala juve dhe mbarë Atdhetarëve në Gjermani.

RROFTË KOSOVA E LIRË!" (Letër Xhafer Durmishit, 24 shkurt 1982)

2. Letër për Pajazit Ibrahimin, 7 mars 1982

Pajazit Ibrahimit në Australi 7 mars 1982

Shoku Pajazit,

Përgjigjen në letrën time e mora nga shoku prej të cilit ta kam dërguar. Unë jam në banesën e Familjes Gërvalla. Mirëpo shkrimi i letrave me adresë të kësaj familje nuk është i mirë sepse nganjëherë letrat po vijnë të çelura.

Revistat me sa e kuptova u paskan pëlqyer dhe për këtë jemi të gëzuar. Edhe ne na erdhi mjaft mirë që kishit dërguar ata ekzemplarë të numrit 16 të gazetës së Shoqërisë "Bajram Curri." Herave tjera na dërgoni më tepër, sepse ndikojnë mirë tek punëtorët në Perëndim, të cilët janë të shumtë dhe që shkojnë shpesh në Atdhe.

Në fillim po të prezantohem me të vërtetë se kush jam.

Unë jam Xhafer Durmishi, nga Stanovci i Poshtëm, një fshat afër Vushtrrisë. Vëllau im i madh quhet Xhevat, është student i mjekësisë dhe është shok i ngushtë i vëllaut tënd Nexhatit. Në qershor të vitit 1981 u largova pasi e ndieja veten të rrezikuar nga fushata e burgosjeve. Unë në Kosovë kam qenë anëtarë i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Kur dola jashtë, përmes lidhjeve me shokë jashtë atdheut mora kontakt me Jusuf Gërvallën, një nga udhëheqësit me rëndësi të Lëvizjes.

Për punën dhe aktivitetin e Lëvizjes do të informohemi edhe në letrat tjera. Verën e vitit të kaluar isha pak ditë tek Nexhati në Chur. Aty ai ma tregoi një letër tuajën në të cilën ju flitshi për disa shqiptarë të Zvicrës, anëtar të "Frontit të kuq". Atë organizatë e kemi kuptuar, e udhëheqë një Ibrahim Kelmendi nga fshati Vuthaj, tani i shpërngulur në një fshat afër Pejës. Me ardhjen e Jusuf Gërvallës në Gjermani ai

njoftohet edhe me Ibrahim Kelmendin, të cilit i ndihmon dhe ia nxjerrë tre numra të gazetës së "Frontit të Kuq" me emrin "Bashkimi".

Jusufi, anëtar i LNÇKVSHJ pra e ka ndihmuar dhe popullarizuar në masën më të madhe "Frontin e Kuq". Prej janarit 1981 Jusufi nuk i ndihmon më Ibrahim Kelmendit në nxjerrjen e gazetës "Bashkimi" për disa shkaqe.

Në organizimin e demonstratave të punëtorëve në Perëndim, krahas Lëvizjes e cila ka bërë shtypjen e thirrjeve me teknikën e saj kanë ndihmuar dhe marrë pjesë Organizata e Marksist - Leninistëve të Kosovës të cilën jashtë Atdheut e ka udhëheqë Kadri Zeka, i cili u vra në mbrëmjen e 17 janarit në Untergruppenbach. Atë ditë aty ka qenë edhe Ibrahim Kelmendi i cili nga këta është larguar kah ora 13.30. Këta të tre janë vra kah ora 22.15 kur me insistimin e Kadriut dalin për të thirrur në telefon në Zvicër prej një automati. Për shkak të provokimeve, familja Gërvalla nuk kishte telefon, e kabina telefonike për thirrje ndërkombëtare gjendej në një fshat tjetër. Kadriu donte t'i telefononte gruas së tij në St Gallen të Zvicrës. Sa i përket OMLK-së nuk dimë se si do të organizohen e vazhdojnë punën e tyre. Sa i përket LNÇKVSHJ mund të them se do të përpiqemi ta vazhdojmë luftën me hov edhe më të madh. Këtu kemi organizua një komitet me emrin Vëllezërit Gërvalla. Për shkak të disa arsyeve që nuk po i përmendi, me Ibrahim Kelmendin do të bashkëpunojmë e koordinojmë aktivitetin por nuk do të kemi marrëdhënie të ngushta me te.

Këtu, si edhe tek ju ka shumë shqiptarë, ka shumë të mirë dhe ka disa agjentë të konsullatave jugosllave të cilat ekzistojnë në shumë qytete të Gjermanisë.

Duke pasur përbazë këtë, shumë shokë të Lëvizjes e poashtu edhe të OMLK nuk njihen nga masat me emrat e tyre të vërtetë por vetëm përmes pseudonimeve. Këtu me shokë jemi marrë vesh të quhem Skënder. Si Xhafer pos dy tre vetave askush nuk më njeh. Tani po më njeh edhe ti. Pra është mirë që këtë punë ta din vetëm ti e para shokëve tuaj më përmend me emrin Skënder. Tani letrën ma ktheni dhe më folni se si po ju duket kjo puna jonë. Ne do t'ju informojmë më gjerësisht në letrat tjera. Presim edhe mendimet tuaja.

Unë mendoj se unë dhe ti përbëjmë një rast të mirë që të ndikojmë në afrimin e Lëvizjes dhe Shoqërisë "Bajram Curri" në Australi. Kështu përveç këmbimeve të letrave tona private të bëhet komunikimi në mes Komitetit Vëllezërit Gërvalla, Komitetit të Lëvizjes në Zvicër dhe Sh.B.K Bajram Curri. Këtë po e përfundoj me kaq duke ju nisur njëherit edhe disa ekzemplarë të Zërit të Kosovës, të janarit 82, me bindjen se po u plotësoj dëshirën ju dhe bashkatdhetarëve tjerë. Shkruani për aktivitetin, për jetën dhe peripetitë e bashkatdhetarëve në Australi.

Përshëndetje vëllazërore dhe revolucionare nga ne të gjithë.

Kosova-Republikë!

Personalisht ti dhe Shoqëria Bajram Curri, Familjes Gërvalla mund t'i drejtoheni në adresën:
Familja Gërvalla
Habichthöhe str. 40
7101 Untergruppenbach
West Germany (Letër e Xhafer Durmishit për Pajazit Ibrahimin)

3. Letër nga Sejdi Bytyçi (New York), 23 prill 1982

Sejdi Bytyçi: *"I dashur Lul, Letrën tande e lexova me kënaqësi, poashtu edhe të përkohshmet, të cilat do të shumëzohen për njerëzit e përshtatshëm. Të jam mirënjohës që ke shpenzue kohën me m'u përgjigj gjansisht. Fatkeqësisht nuk mund të marrim pjesë në demonstratën tuaj më 24, sepse thirrja erdhi me vonesë, por sidoqoftë u dëshirojmë*

sukses dhe zemrat tona janë atje me shqiptarët e ndershëm. Përmbajtjen e kësaj thirrje do t'ua paraqes të tri radioprogrameve shqipe këtu në New York, që t'i dëftojmë komunitetit tonë se shqiptarët ne Evropën Perëndimore nuk rrijnë duarkryq. Edhe këtu kemi ba shumë demonstrata por ajo ma me sukses ka qenë në Detroit, ku qyteti u detyrua ta ndaloj festivalin e ashtuquajtun jugosllav, i cili mbahej çdo vit. Me atë rast u bë edhe përleshje fizike, ku fituem na dhe një polic pati guximin me na ofendua flamurin tonë, por edhe kundër këtij u morën masa ligjore dhe u pushua nga detyra. Të gjitha këto ngjarje i ka përfshi gazeta e Detroitit Free Press në faqen e parë." (Letër Xhafer Durmishit, 23 prill 1982)

4. Letër nga Rilind Bytyçi për "Komitetin Vëllezërit Gërvalla" 17 maj 1982

Shkolla e UDB-së Serbe: "*Vonë u njoftova* *se Xhafer Durmishi, më 7 mars 1982, pa dijeninë time, por në emrin tim, i kishte shkruar dy letra të njëpasnjëshme dhe i kishte adresuar në shoqatën Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri“ në Australi, duke dhënë njoftime rreth „Komitetit Vëllezërit Gërvalla“. Letrat i kishte dërguar në këtë adresë:*
P. O. Box 36,
Hastings, VIC., 3915 – Australia
Përgjigjja e Rilind Bytyçit nga Australia, drejtuar Xhafer Durmishit (Skënder Skënderit) ishte..." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, f.142)

(Letër e dërguar në Sindelfingen dhe e fshehur nga Nuhi Sylejmani e Osman Osmani prej meje të cilën për herë të parë pata rastin ta lexoj në vitin 2010)
Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri“ në Australi
„Komitetit Vëllezërit Gërvalla“.
P. O. Box 36,
Hastings, VIC., 3915 – Australia

I dashuri shoku Skënder, 17 maj 1982
Përmes shokut P. Ibrahimi muarem një letër që i dërgonit juve. Dhe për sa shkruanit mbetëm të kënaqur.

Në letrën në fjalë, përveç tjerash mësuam se pakot (2) me revistat e shoqërisë tonë „B. Curri“ nuk i kishit marrur, për arsye vërtetimi, siç e shpjegonit juve. Gjithashtu, mësuam edhe për aktivitetin e „Lëvizjes për Republikë“ në Kosovë dhe tuajin në Evropë. Gjë që na vjen shumë mirë edhe na jep shpresë e kurajo për të ardhmen e dëshiruar.

Juve kishit cekur dhe ndie nevojën edhe për bashkimin e BKSH. „Bajram Curri“ me
„Lëvizjen për Republikë“, që ishit shprehur edhe nga shokët brenda në Kosovë. Edhe për këtë ndihemi më se të kënaqur edhe u falënderojmë juve të gjithë sa jeni për besimin që keni në Shoqërinë tonë. Dhe, për këtë çështje kaq të rëndësishme ne nuk kemi kurrgjë kundërshtim përveç se kjo duhet bërë pak më zyrtarisht, me baza më bindëse zyrtare. Me keqardhje e themi, por e vërtetë është se në dy letrat – jo zyrtare – që kemi prej juve nuk mund të bazohemi shumë dhe as të bindemi për saktësinë e personit tuaj. Sepse, juve njëherë jeni Xhafer Durmishi (S. S.) dhe pastaj Nuhi Sylejmani (S. S.): Ne e kuptojmë nevojën për kujdes e pseudonim, por në raste të këtilla dikuj duhet treguar e vërteta, nëse mendohet për sukses më të gjerë.

Pra nëse keni simpati dhe e ndieni nevojën për bashkim me BKSH „B. Curri“ duhet të keni besim edhe në paraqitjen e vërtetë të personit tuaj. Ne, mund t'u themi se

asnjë e keqe nga BKSH „Bajram Curri“ nuk ka me u ardhur juve dhe askujt tjetër me parime patriotike dhe dashurinë për popullin dhe Mëmëdhenë tonë të dashur.

Juve bënit fjalë se na keni dërguar nja 20 revista tuajat në adresën e Shoqërisë, ndërsa ne për herë të parë të premten e kaluar muarëm një pako me revistën „Zëri i Kosovës“ nr. 1-2 dhe lajmëtari, dhe këto nga shoku Driton Zogaj dhe jo tre emrat e juaj. E nëse keni edhe emrin e katërt, D. Zogaj, atëherë e dini se revistat i muarëm. Sidoqoftë, shoku Driton Zogaj i faleminderit dhe mbetemi me shpresë se do të marrim edhe tjera revista e letra.

I dashur Skënder,

Siç ceka edhe më sipër, ne nuk kemi kurrnjë kundërshtim për bashkimin e plotë me „Lëvizjen për Republikë“, përkundrazi, kishim me qenë krenar për një gjë të tillë. Vetëm kjo duhet bërë më qartë dhe në mënyrë zyrtare. Pra mbetemi në pritje për një përgjigje të këtillë.

Për bashkim, nuk duhet përjashtuar edhe shokët e „Frontit të Kuq“, nëse këtu nuk ka prova për ndonjë konspiracion e tradhti në vrasjen e tre bashkëvëllezërve Isuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka ((ashtu siç shprehnit dyshim juve në letrën e 7 marsit 1982). Përsa shkruani për përgatitjen e një Demonstrate më 24 Prill 1982 në Vjenë, dëshirojmë që të keni patur sukses dhe herën tjetër na shkruani për të. Ndërsa edhe ne këtu patëm organizuar tri Demonstrata: 24 Prill 1981, 22 Gusht 1981 dhe 2 maj 1982. Me këtë rast po u dërgojmë ca foto me përmbajtje nga këto Demonstrata.

E siguroni një adresë legale – zyrtare, dhe na shkruani për gjithçka u lejojnë kushtet.

KOSOVA – REPUBLIKË!

Rilind Bytyçi

5. Letër nga Rilind Bytyçi, 1 qershor 1982

BASHKIMI KOMBETAR SHOQENIJA 1 qershor 1982
”BAJRAM CURRI”
P.O. Box 36
Hastings
VIC. 3915
Australia

I nderuari shoku Driton,

Duke ju dëshiruar shëndet të mirë dhe suksese gjithnjë e më të shkëlqyeshme në punën për jetë dhe atë patriotike, u njoftojmë se para ca ditëve muarëm një pako me revistat ”Zëri i Kosovës” dhe ”Lajmëtari i lirisë” dhe njëherit i shpërndamë nëpër shokë. Pra u falemnderit për kujdesin që keni treguar. Dhe shpresojmë se do të marrim edhe numra të tjerë në të ardhmen.

Revistat në fjalë pëlqehen shumë nga shqiptarët e rinj të këtushëm për materialin dhe të dhënat që sjellin mbi ngjarjet në Kosovë. E njejta simpati është edhe për revistën ”Liria” dhe gazetën ”Bashkimi”. Sepse të gjitha këto jan me parim të ngjashëm.

Kosova-Republikë!

Deri në radhën tjetër, shëndet dhe të fala shumë
Rilind Bytyçi (Rilind Bytyçi për Xhafer Durmishin)

6. Letër nga Rilind Bytyçi, 2 qershor 1982

I dashur Skënder, 2 qershor 1982

Letrën tuaj të datës 25 maj 1982 e muarëm dhe përsa shkruanit e kuptuam plotësisht, dhe mbetëm të kënaqur që letra jonë kishte arritur tek motrat Gërvalla.

Në letrën para kësaj, edhe pse isha i porositur nga shoku P. Ibrahimi që t'u njoftoj se ai e ndërron adresën e tij, prapë kisha harruar dhe letrën që i kishit dërguar kohët e fundit mund ta marrë me vonesë, ose edhe mund të humbisi fare. Pra, radhë të tjera, nëse ka diçka të rëndësishme për Shoqërinë tonë, lutemi që të drejtoheni në adresën e qendrës së BKSH "B. Curri". Kështu nuk humbet koha, që nganjëherë mund të jetë me shumë rëndësi.

KOSOVA REPUBLIKË!

Përshëndetje vëllazërore
Rilind Bytyçi (Për Xhafer Durmishin)

7. Letër nga Sejdi Bytyçi, 7 qershor 1982

Sejdi Bytyçi: *"Sot e mora paketën me "Zërin e Kosovës", për të cilën gjë të falenderoj. Këtu po të sjell një çek ($ 50) për t'i mbuluar shpenzimet e vogla që ke (për pulla postale etj.) ...*

Siç thash, këtu do të bëhet një demonstratë me rastin e ardhjes së Stamboliqit, prandaj po pate mundësi të na i shkruash ca sllogane për parullat që do t'i shkruajmë për demonstratë, ne i përkthejmë anglisht, sepse këto i kopjojnë gazetarët dhe bëjnë efekt. Të fala vëllazërore Sejdiu" (Letër Xhafer Durmishit, 5 qershor 1982)

Pajazit Ibrahimi (Australi): "Për sa më shkruajshit për çështjen e një demonstrate në një vend të Evropës, unë këtu e bëra me dije qendrën e Shoqërisë, që edhe neve këtu të organizohemi, me të njëjtat qëllime dhe në të njëjtën kohë. Por si do të jetë rezultati ende nuk kam marrë lajmin. Ju bëjë me dije se edhe më 1 Maj - të majit të kaluar ne e bëmë një demonstratë para konzullit serb, ku morën pjesë një numër i mirë shqiptarësh dhe na u bashkangjitën shumë prej australianëve dhe kroatëve." (Letër Xhafer Durmishit, 7 qershor 1982)

8. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 qershor 1982

BASHKIMI KOMBETAR SHOQENIJA 17 qershor 1982
"BAJRAM CURRI", P.O. Box 36, Hastings, VIC. 3915, Australia
I dashur Skënder,

Sipas fjalëve tuaja në letrën që më dërguat mua më 24 maj 1982 dhe të asaj të shokut Pajazit Ibrahimi, unë dhe shoku Mahmut Rexha, arkatar i Shoqërisë tonë, më

> **Shkolla e UDB-së Serbe: "*Vonë u njoftova** *se Xhafer Durmishi, më 7 mars 1982, pa dijeninë time, por në emrin tim, i kishte shkruar dy letra të njëpasnjëshme dhe i kishte adresuar në shoqatën Bashkimi Kombëtar, Shoqëria „Bajram Curri" në Australi, duke dhënë njoftime rreth „Komitetit Vëllezërit Gërvalla"."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142)

12 qershor vajtëm në Sydney, kryeqytet i shtetit Wales i Ri Jugor (880 km Melbourne-Sydney) dhe pas dy ditë qëndrimi në atë qytet u dakorduam me shokët e atjeshëm që më 26 qershor të organizohet dhe të bëhet një demonstratë.

Arsyeja që demonstratën nuk e organizuam në Melbourne por në Sydney është se, në Sydney deri më tani nuk është bërë ndonjë demonstratë shqiptare dhe më keq, që atje, Konsulli jugosllav, përmes një tradhtari të quajtur I. Hasa, i cili është si nëpunës i

konsullit në fjalë, patë formuar një shoqëri – njëherit pas shpërthimit të demonstratave të Kosovës – me emër "Agimi" dhe në emër të Shoqërisë "Agimi" dhe të gjithë shqiptarëve të Sidneut i patën dërguar telegram Beogradit, me të cilin dënonin kërkesat e drejta e të ligjëshme të popullit shqiptar të Kosovës. Prandaj, ne menduam se Demonstrata e 26 Qershorit do të jetë si përgjigje e mirë për dredhitë e poshtëra të serbomëdhenjve e njëkohësisht shpresojmë që pas Demonstratës të shkapërderdhet edhe Shoqëria "Agimi" dhe në vend të saj të formohet një shoqëri me parime patriotike e ndoshta edhe si degë e jona.

Me atë rast, me vete patëm marrë dramën "Besa e Madhe" në videokasetë dhe ua shfaqëm shqiptarëve të atyshëm, të cilët mbetën më se të kënaqur. Gjithashtu atyre u premtuam që kur të shkojmë për Demonstratën e 26 Qershorit, bashkë me parullat dhe traktet për Demonstratë do t'ua dërgojmë edhe dramat "Epoka para Gjyqit" dhe "Gërsheti i luftës" dhe "Manifestimi i punëtorëve të Kryeqytetit – Tiranës – për 1 majin 1982", që t'i shohin pasi të mbaroi Demonstrata....

Deri në letrën tjetër shëndet dhe të fala shumë ty dhe të gjithë bashkëvëllezërve të tjerë me të cilët punoni ju. Kosova – Republikë! Me nderime dhe sinqeritet vëllazëror

Juaj – Rilind Bytyçi (Për Xhafer Durmishin)



BASHKIMI KOMBETAR SHQENIJA

''BAJRAM CURRI''

P.O. Box 36, Hastings, VIC., 3915 - Australia.

Shokut S. Skënderi
Gjermani.

17/Qërshor/1982

R. Bytyçi për Xhafer Durmishin

I dashur Skënder,

Sipas fjalëve tuaja në letrën që më dërguat mua më 24/5/1982 dhe të asaj të shokut P. Ibrahimi, unë dhe shoku Mahmut Rexha, arkatar i Shoqërisë tonë, më 12 Qërshor vajtëm në Sydney, kryeqytet i shtetit Wales i Ri Jugor (880 km. Melbourne-Sydney) dhe pas dy ditë qëndrimi në atë qytet u akorduam me shokët e atjeshëm që më 26 Qërshor të organizohet dhe të bëhet një Demonstratë.

Arësyeja që Demonstratën në fjalë nuk e organizuam në Melbourne por në Sydney është se, në Sydney deri më tani nuk është bërë ndonjë Demonstratë shqiptare dhe më keq, që atje, Konsulli sllav, përmes një tradhëtari të quajtur Met Hasa, i cili është si nëpunës i konsullit në fjalë, pat formuar një shoqëri - njiherit pas shpërthimit të Demonstratave të Kosovës - me emër "Agimi" dhe në emër të Shoqërisë "Agimi" dhe të të gjithë shqiptarëve të Sidneut patën dërguar telegram Beogradit, me të cilin denonin kërkesat e drejta e të ligjëshme të popullit shqiptarë të Kosovës. Prandaj, ne menduam se Demonstrata e 26 Qershorit do të jetë si përgjigje e mirë për dredhitë e poshtërta të serbomëdhenve e njëkohësisht, shpresojm që pas Demonstratës të shkapërderdhet edhe Shoqëria "Agimi" dhe në vend të saj të formohet një shoqëri me parime patriotike

Shkolla e UDB-së Serbe: *"***VONË U NJOFTOVA ...** ***Më 24 qershor****, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe145)

9. Letër nga Sejdi Bytyçi, 24 qershor 1982

Sejdi Bytyçi: *"I dashur Lul, para tri ditësh mora letrën tënde të bukur. Të hënën më 14 u bë demonstrata antijugosllave në Chicago dhe të hënën më 21 u bë këtu në New York ku morën pjesë afër 3000 veta. Organizimi ishte fantastik, por shtypi e televizioni qenë të shurdhët. Shihet se janë marrë masa nga J. Parulla "Kosova-Republikë" ka marrë një hov të madh kudo, ku shihej nga afishet që mbanin dhe nga pullat që çdo demonstrues i kishte në gjoks, të cilat po t'i sjell ca që t'i kesh. Të njëjtën kohë po të sjell edhe ca fotografi që po deshe mund t'i botoni në "Zërin e Kosovës". Të gjitha janë nga demonstrata e datës 21 qershor. Ndërtesa me tulla të kuqe është ajo e konsullatës famëkeqe, ku shihen ca fytyra duke vërejtur demonstruesit mu prapa derës."* (Letër Xhafer Durmishit, 24 qershor 1982)

10. Fjalimi i Rilind Bytyçit në Demonstratën e Sydneut më 26 qershor 1982

BASHKIMI KOMBËTAR SHOQENIJA "BAJRAM CURRI"
DEMOSTRATË SHQIPTARE NË SYDNEY - 26 qershor 1982

Të dashur vëllezër dhe motra, zotërinj dhe zonja,

Sot, të gjithë ne, kemi dalë këtu në këtë demostratë në përkrahje dhe solidaritet të plotë me zërin dhe kërkesat e drejta e legjitime të bashkëvëllezërve e motrave tona, të prindërve dhe gjithë popullit tonë shqiptar në Jugosllavi. Në përkrahje të atyre që për të drejta e liri, për mëse një vit e gjysmë, pa ndërprerje po derdhin gjakun lumë në përleshje me ushtrinë e milicinë e okupatorëve serbomëdhenj, të Jugosllavisë revizioniste.


BASHKIMI KOMBETAR SHOQENIJA
''BAJRAM CURRI''

DEMONSTRATE SHQIPTARE NE SYDNEY - 26/6/1982.

Fjalimi i demostrates së Sydnejit derjuar Xhafer Durmishit

TË DASHUR VËLLEZËR DHE MOTRA, TË NDERUAR ZOTËRINJ DHE ZONJA!

SOT, TË GJITHË NE, KEMI DALUR KËTU NË KËTË DEMONSTRATË NË PËRKRAHJE DHE SOLIDARITET TË PLOTË ME ZËRIN DHE KËRKESAT E DREJTA E LEGJITIME TË BASHKËVËLLEZËRVE E MOTRAVE TONA, TË PRINDËRVE DHE GJITHË POPULLIT TONË SHQIPTAR NË JUGOSLLAVI. NË PËRKRAHJE TË ATYRËVE QË PËR TË DREJTA E LIRI, PËR MËSË NJË VIT E GJYSMË, PA NDËRPRERJE PO DERDHIN GJAKUN LUMË NË PËRLESHJE ME USHTRINË E MILICINË E OKUPATORËVE SËRBOMËDHENJË, TË JUGOSLLAVISË REVIZIONISTE.

SHPËRTHIMI I DEMONSTRATAVE KRYENGRITËSE TË POPULLIT SHQIPTARË NË JUGOSLLAVI QË NGA MARSI I VITIT TË KALUAR ËSHTË REZULTAT I VUAJTJEVE TË TMERRSHME QË PËRJETONTE NËN THUNDRËN E ROBËRUESVE TË BEOGRADIT; ËSHTË MOHIMI I TË GJITHA TË DREJTAVE DEMOKRATIKE DHE LIRISË KOMBËTARE. PËR TË GJITHA KËTO DHE PËR SHTYPJEN

Shpërthimi i demonstratave kryengritëse të popullit shqiptar në Jugosllavi, që nga marsi i vitit të kaluar është rezultat i vuajtjeve të tmerrshme që përjetonte nën thundrën e robëruesve të Beogradit, është mohimi i të gjitha të drejtave demokratike

dhe lirisë kombëtare. Për të gjitha këto dhe për shtypjen e dhunën e egër që ushtrohej nga klika revizioniste e Beogradit, populli shqiptar humbi durimin dhe me zemërim e urrejtje të mbledhur në dekada robërie shpërtheu si vullkan i fuqishëm në demonstrata të mëdha popullore.

I gjithë populli, të rinj e pleqë, me këngë patriotike në gojë e me parulla në duar dual rrugëve të të gjitha qyteteve të trevave shqiptare, duke kërkuar punë, të drejtat demokratike dhe lirinë e mohuar. Parullat dhe thirrjet e popullit shqiptar për të drejta e liri të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe ngritjen e Kosovës në Republikë, e tmerruar qeverinë e pushtuesve të Beogradit, e në veçanti shovenizmin serbomadh. Prandaj udhëheqësit revizionistë të Beogradit në koordinim edhe me disa vegla tradhtare vendëse i dhanë urdhër policisë e ushtrisë që të suleshin si bisha të egra mbi popullin që kërkonte liri e drejtësi në trojet e veta mijra vjeçare dhe duarthatë, ndërsa armiku i armatosur deri në dhëmbë u sul me tankse, mitralozë e me aeroplanë duke bërë kërdinë mbi të rinj e të reja, gra, pleqë e fëmijë, mbi gjithë popullin shqiptarë që askujt nuk i ka ra në qafë, mbi popullin e pafaj.

Vërtetë që popullit tonë iu vranë e iu plagosën në masë, por ai nuk u frikësua dhe as u gjunjëzua përpara armikut e tradhtarëve, por edhe më me vendosmëri ngul këmbë në kërkesat e tij të ligjëshme. Me zërin e tij të fuqishëm që gumëzhin anekënd trevave shqiptare nën robërinë e sllavëve të jugut: "KOSOVA-REPUBLIKË!" e Vetëvendosje, armikut ia ka ngri gjakun në trup, dhe me sy të çakërdisur, si prej njeriu të prishur mendsh sillen e mbështillen të hakëruar. Ata çirren, bërtasin, shajnë e nuk

> **Shkolla e UDB-së Serbe***: "* **VONË U NJOFTOVA ...** ***Më 24 qershor****, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe 45)

lënë gur pa luajtur që ta mëshefin të vërtetën historike dhe atë të sotme, por pa sukses, sepse, siç thotë populli:" Shigjeta nuk mund të mëshihet në thes, dhe as dielli me shoshë nuk mbulohet." Kështu pra nuk mund të mëshifet e të mbulohet me asgjë dhe nga askush edhe e vërteta historike dhe e sotme e popullit tonë, atë e shofin dhe e dëgjon gjithë bota, qartë e mirë si edhe dritën e diellit, sepse është e pastërt dhe e drejtë, prandaj edhe do të fitojmë.

Edhe ne këtu, duke qenë bij dhe pjesë e atij populli atje, s'kemi rrugë tjetër pos të mbështesim plotësisht përkrahjen dhe solidaritetin tonë me popullin dhe për popullin tonë, për kërkesat e tij të ligjëshme. Përndryshe s'kemi si të konsiderohemi, përveç të ligj e tradhtarë!

Vitin e kaluar, pas shpërthimit të demonstratave popullore të trevave shqiptare në Jugosllavi, me urdhër të klikës revizioniste të Beogradit, konsulli ose çerdhja e agjenturës së Beogradit këtu në Sydney me shpejtësi ngritën Shoqërinë "Agimi" dhe në emër të saj dhe të të gjithë shqiptarëve të Sydneyt, tradhtisht, ashtu si e kanë për traditë të tyre, i dërguan telegram Beogradit, dhe atyre kriminelëve që lanë në gjak popullin tonë të pafaj e duarthatë, duke deklaruar gjoja se shqiptarët e Sydneut dënojnë rreptësisht demonstratat e popullit shqiptar dhe kërkesat e tyre, dhe se solidarizohen plotësisht me masat e egra shtypëse të ushtrisë e policisë fashiste të Beogradit kundër popullit shqiptar të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe viseve tjera shqiptare.

Por ja, ja ku janë bijtë e atij populli, në emër të të cilëve keni dërguar atë

> **Shkolla e UDB-së Serbe***: "* **VONË U NJOFTOVA** *... **Më 24***

***qershor**, gjatë një vizite të rastësishme në Sindelfingen, u takova me Xhafer Durmishin dhe Fahredin Tafallarin, të cilët më njoftuan se e kishin organizuar një demonstratë që do të mbahej në Bern të Zvicrës, më 26 qershor."* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, faqe 142 dhe145)

telegram të poshtër, o kriminelë, o tradhtarë të marksizëm-leninizmit, dilni pra, dilni nëse ua mbanë dhe tani pyeti bijtë e atij populli që e shtypni brutalisht, pyeti se me kend janë dhe se kend përkrahin: Klikën tuaj gjakatare apo popullin shqiptar dhe kërkesat e tij të drejta e legjitime? Por jo, jo, e dimë se juve nuk keni guxim të dilni këtu, sepse e dini mirë se çfarë kishte m'u ngjarë, e dini që këta bij të shqipes do t'u bënin copë e grimë nga zemërimi dhe urrejtja që ndjejnë për ju kriminelë.

Por edhe pse këtu nuk dilni, mos mendoni se do t'i shpëtoni dorës së popullit për krimet që keni bërë e po bëni në të. Populli nuk i harron dhe dora e tij e është e madhe dhe e fuqishme. Pra një ditë do t'i paguani pikë për pikë, për të gjitha ato që po bëni mbi popullin tonë shqiptar.

RROFTË POPULLI SHQIPTAR!
LAVDI DËMSHMORËVE TË RËNË!
POSHTË OKUPATORI SERBOMADH!
KOSOVA - REPUBLIKË!
Rilind Bytyçi: "Fjalim që mbajta në demonstratën e Sydneut, më 26 qershor 1982 përpara konsullatës jugosllave të atyshme".

11. Letër nga Pajazit Ibrahimi, 5 shtator 1982

Pajazit Ibrahimi (Australi)*: "Për demonstratën e 26 qershorit të mbajtur në Bern, që tash na lajmëroni e kuptuam ... Këtu në Australi demonstrata u organizua poashtu më 26 qershor, në Sydney, para konzullit sllav. Dhe megjithë përpjekjet e disa tradhtarëve e armiqve tanë, demonstrata filloj dhe mbaroj me sukses."* (Letër Xhafer Durmishit, më 5 shtator 1982)

12. Letër nga Rilind Bytyçi, 17 nëntor 1982

Rilind Bytyçi: *"Javën e kaluar muarëm edhe revistat "Zëri i Kosovës" që na kishit dërguar (Nr. 2, 40 kopje). Dhe, ne këtu, më 13 dhe 14 Nëntor patëm shfaqur një foto Ekspozitë "38 Vjet Shqipëri Socialiste", si edhe gjëra të artizanatit shqiptar, kostume kombëtare, pulla poste dhe libra të ndryshme nga Shqipëria Mëmë, e me atë rast, shfaqëm edhe 4 filma: "Udha e Shkronjave", "Isa Boletini", "Ylberet mbi Alpe" dhe Koncert me këngë të zgjedhura nga ansambli "Skënderbeu" - Korçë. Prandaj, duke përfituar nga rasti, menduem se revistat "Zëri i Kosovës" të shpërndahen me një çmim prej dy dollarësh, dhe kështu u bë. Këtë e bëmë, sepse, askush tjetër mos past dijeni se sa shpenzime e punë ka një veprimtari si kjo e LRSHJ, neve e dijmë se kemi një përvojë shumë vjeçare. Pra, tani jam duke vajtur në Bankë dhe do t'ua dërgoj ato pak të holla. Por, nëse juve, ose, njerëzit me përgjegjësi në udhëheqjen e Lidhjes nuk akordohen e nuk mbeten të kënaqur me këtë që bëmë ne, pa udhëzimet e juaja, ne kërkojmë falje dhe u sigurojmë se nuk do të përsëritet në të ardhmen. Vetëm, në një letër mjaft kohë më parë, juve shkruanit se në një Demonstratë atje në Evropë, i kishit pas shitur revistat me një çmim prej disa markave. E në bazë të kësaj, edhe ne vepruam ashtu.*

I dashur Skënder,

Me këtë rast, Juve dhe përmes juve, dëshirojmë që edhe familjeve të tre bashkëvëllezërve Dëshmorë, Isuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka t'u dhurojmë nga një shenjë kujtimi vëllazëror.

Tani përshëndetje mëse vëllazërore dhe suksese në punën e shenjtë patriotike për kauzën e popullit dhe Kosovës tonë të dashur. Njëkohësisht: Gëzuar festat e Nëntorit të Kuq, 70 vjetorit të pavarësisë kombëtare dhe 38 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë tonë të dashur nga ushtritë Nazi-Fashiste.

Me nderime vëllazërore

Rilind Bytyçi" (Letër për Xhafer Durmishin, 17 nëntor 1982*)*

13. Letër nga Sejdi Bytyçi, 22 nëntor 1982

Sejdi Bytyçi (New York): *I nderuar Lul, Jemi mirë të cilën gjë dëshirojmë dhe për ju. Të falemnderit për numrat e "Zërit të Kosovës". Numri i fundit ka qenë me të vërtetë i pasur dhe i nivelit të duhur. Pashë që këtu ishte përhap dhe popullarizuar mjaftë kjo revistë e re. Pra ju lumtë dhe mbajeni këtë organ të vlefshëm kombëtar në mërgim. Pranoni urimet tona për festën e 28 Nëntorit. Të fala Sejdiu"* (Letër Xhafer Durmishit, 22 nëntor 1982)

STILOGRAFA TË MBUSHUR ME QUMËSHT

1. Në banesë të Hakanit e Sarandës më 29 maj 1982
2. Organizime e vështirësi të verës 1982
3. Mbledhja po mbahej në banesë të Hakanit dhe Sarandës
4. Mos e shprush se i vjen era
5. Stilografa të mbushur me qumësht
6. Formimi i Qendrës Ekzekutive në Ludwigsburg

1. Në banesë të Hakanit e Sarandës më 29 maj 1982

Mbledhje (sipas I. Kelmendit) e LRSSHJ, më 29 maj 1982, në Biel/Bienne në banesën e Hasan Malës dhe Saime Isufit për formimin e Komitetit Qendror të përbërë nga 15 veta.

I. Kelmendi: "*Pas shpalljes se formimit të LRSSHJ–së Xhabiri u tregua shumë operativ. **Ai thirri mbledhjen më 29 maj**, për të formuar organin drejtues. Mbledhja u mbajt në Biel/Bienne, **në banesë të Hakanit dhe Sarandës**. Në mbledhje morën pjesë Xhabir Shatori, alias Bacaloku ose Halili, Xhafar Durdeli, alias Skenderi, Hakan Mali, alias Plaku, Fahri Tafaleku, alias Taksisti, Sarandë Istrefaj, alias Bulja dhe Miran Bruçaj i papseudonim publik ndonjëherë. Xhabiri uzurpoi imponueshëm drejtimin e mbledhjes.*

– Fillimisht po ju informoj se në mbledhje nuk është i pranishëm asnjë përfaqësues i krahut të Avdyl Prapashpinës. Këtë mungesë të tyre po e arsyetojnë se kinse ata janë penduar pse janë bashkuar me ne. Tani propozoj që organi drejtues i organizatës të quhet Komiteti qendror, i cili do të përbëhet nga 15 anëtarë, 6 në Kosovë dhe 7 jashtë Kosove, në Perëndim.

– Kush është për dhe kush kundër? – pyeti Xhabiri duke ***vështruar zhbirueshëm*** *me radhë pjesëmarrësit. Propozimet e tij u miratuan njëzëri pa asnjë diskutim e kundërshtim.*
Prapë Xhabiri: – Konstatim: Propozimi u votua njëzëri dhe duhet ta protokolloj.
Tashmë Xhabiri jo vetëm që po e drejtonte Komitetin Qendror, por po e komandonte atë dhe njëherit po luante rolin edhe të procesmbajtësit.
Prapë Xhabiri: – Propozoj që tre anëtarë në Kosovë t'i caktojnë Shoku Sabit ose Shoku Xhafar, kurse tre të tjerë do t'i caktoj unë. Jashtë Kosove, këtu në mërgatë, këto dy organizata që u bashkuan do t'i caktojnë nga tre veta, i shtati do të jetë Mirani. Emrat e anëtarëve në Kosovë do të mbahen të fshehtë. Vendimet e tyre në Komitetin Qendror në Zvicër do t'i komunikojmë unë dhe Sabiti ose Xhafari. Emrat e anëtarëve në mërgatë do të jenë: Nga OMLK–ja: Unë, Hakani dhe Saranda. Nga LNÇKVSHJ–a: Sabiti, Xhafari dhe Fahriu. Sabiti do të vijë së shpejti nga Turqia dhe do të vendoset në Zvicër. I shtati, siç thashë më parë, do të jetë Mirani." (Atentatet, f.395-396)

Nga citati i lartshënuar rrjedhin këto pyetje:

- A është mbajtur ndonjë mbledhje në emër të LRSSHJ, pas 14 e 15 majit 1982?

Pas takimit të 14-15 majit në Biel të Zvicrës në mes Xhafer Shatrit, Osman Osmanit dhe Xhafer Durmishit, gjatë vitit 1982 nuk është mbajtur asnjë mbledhje e vetme në emër të ndonjë forumi. Ideja se ka ekzistua KQ i Lëvizjes në vitin 1982 është rrenë e kulluar, nga kushdoqoftë që e thotë atë, përkundër faktit se Komunikata e bashkimit është e nënshkruar nga KQ (Komiteti Qendror - me mendimin se ai do të formohej shpejt). Se çfarë teknike të punës e relacionesh ka pasur Xhafer Shatri me rrethin e vetë është punë në cilin nuk jam përzier kurrë. Pas mbledhjes së parë më 15 maj, Osman Osmani me porosi të Abdullah Prapashticës dhe përkrahjen e Engjëll Kolanecit është larguar nga rrethi i Shtutgartit sidomos nga ajo bërthamë shokësh që i ka qëndruar më së afërti Jusufit (pasi ka dështuar ta përvetësoi si të plotë). Çfarë letrash taktizuese e çfarë 'politike të madhe' kanë bërë në këtë kohë (pra gjatë vitit 1982) në mes veti Xhafer Shatri e Abdullah Prapashtica nuk e di, por e di se Xhafer Shatri i është kënaq punës përçarëse të Abdullah Prapashticës në Shtutgart përmes mashës së vetë Osman Osmanit, dhe poshtërsive të tyre është munduar t'u jep peshë sa më të madhe. Xhafer Shatri në Sindelfingen e ka sjellë Milaim Zekën me mision për t'ua ftofë Skenderit dhe të tjerëve. Këtë ma ka thënë Milaimi në Suedi. Por edhe në këtë pikë katastrofa e tij ka qenë aq fatale, pasi nuk thonë kotë se atë gropë që mundohesh me e çelë për dikend mundësia është shumë e madhe që vetë ke me ra në te. Për të mos u largua nga tema e pyetja e shtruar, dua të them aktiviteti kryesor i Lëvizjes në vitin 1982 është bërë përmes letrave të këmbyera në mes Xhafer Shatrit e Xhafer Durmishit të ndërmjetësuara nga Faridin Tafallari e Remzi Ademaj. Është kjo kohë kur unë jam marrë me përgatitjen teknike dhe punë tjera në revistën e Lëvizjes.

- A ka marrë pjesë I. Kelmendi në ndonjë mbledhje të Lëvizjes ku ka qenë i pranishëm Skenderi i Shtutgartit gjatë vitit 1982?

- Asnjëherë. Kush pretendon të thotë budallallëqe të tilla gënjen në mënyrë të paskrupullt. Se si e kanë trajtuar I. Kelmendin (shokun e organizatës së Kadri Zekës) si e kanë afruar e si e kanë mbajtur në distancë në Zvicër është punë që nuk më ka interesua kurrë pasi ka qenë punë e tyre e brendshme të cilën e kanë trashëguar nga Kadri Zeka. Edukata ime ma ka ndalua të interesohem për punët e tyre të brendshme. Kurrë nuk më kanë interesuar as muajt e tyre të mjaltit e as egërsimet e tyre, pasi unë kurrë nuk kam pas autoritet e as aspirata as t'i pajtoj e as t'i egërsoj në mes veti.

- A kanë marrë pjesë I. Kelmendi dhe Hasan Mala, në ndonjë mbledhje të Lëvizjes ku ka qenë i pranishëm Skenderi i Shtutgartit gjatë vitit 1982?

- A ka marrë pjesë ndonjëherë në jetën e vetë Saime Isufi në ndonjë mbledhje të Lëvizjes ku ka qenë i pranishëm Skenderi i Shtutgartit?

- Kurrë. Asnjëherë, në asnjë formë e mënyrë.

A kanë qenë anëtarë të një forumi ndonjëherë në jetën e vetë Saime Isufi dhe Skenderi i Shtutgartit?

- Kurrë, asnjëherë.

A ekziston ofendim më i madh se sa ky për Saime Isufin, kur bëhet aludimi se Skenderi i Shtutgartit përkundër sjelljeve të tij botërisht të njohura ndaj të goditurve, paska merituar apo arritë të bëjë të pamundurën, pra të bëhet anëtarë i një forumi së bashku me te?

Këtij qëllimi Skenderi i Shtutgartit, përkundër të gjitha aftësive të tij, kurrë nuk ia ka arritë. Pra Saime Isufi kurrë nuk ka pas nevojë të ofendohet deri në atë shkallë sa të jetë anëtare e një forumi me Skenderin e Shtutgartit.

Në cilën datë, në cilin vend, dhe nga kush është afruar për herë të parë I. Kelmendi në Lëvizje e në një mbledhje të përbashkët me Skenderin apo në një forum të përbashkët me Skenderin dhe Faridin Tafallarin?

Pas demonstratës për 17 janarin e vitit 1983, në banesën e Hafiz Gagicës në Ludvigsburg është formua Qendra Ekzekutive, në të cilën janë zgjedhur Xhafer Shatri, Faridin Tafallari, Hasan Mala, Ibrahim Kelmendi dhe unë. Në këtë Qendër Ekzekutive është Xhafer Shatri ai që e ka afruar I. Kelmendin. Në këtë pikë as nuk e kam përkrahur e as nuk e kam kundërshtuar. Kam menduar se është më me përvojë dhe vendimin e tij e kam respektuar përkundër ngjarjeve të mëparshme dhe përjashtimit të tij (I. K.) nga ana e familjes së Jusufit nga shtëpia, nga prona e atmosfera private, më 15 mars 1982.

2. Organizime e vështirësi të verës 1982

Pas demonstratës së Bernit në muajin korrik Osman Osmani u largua nga rrethi ynë. Për këtë qëllim kishte jo vetëm përkrahjen nga shokët e vetë në Turqi por edhe nga diplomatët shqiptarë në Vjenë. Prej shokëve të afërm të Jusufit, Nuhi Sylejmani ishte i vetmi që iu bashkua. Efektet e mungesës së Jusufit në planin e Lëvizjes së tij, si dhe në atë të përgjithshëm është vështirë me i analizua. Por mund të thuhet se atentati i 17 janarit **në rrethin** organizativ të Jusufit nuk krijoi ndonjë huti. Ato fërkime që ndodhën ishin pasojë e pranimit të Osman Osmanit, pjesëtar i një organizate të huaj në shtëpinë e Jusufit, i cili kishte ardhë me mision ta lartësoj punën e ish-inspektorit të UDB-së Abdullah Prapashtica dhe ta denigroj atë punë që ishte bërë në Shtutgart dhe në Zvicër më parë. Nuhi Sylejmani, një aktivist i dalluar në rrethin e Jusufit, pas vdekjes së Jusufit u lëkund në qëndrimet e tij, por për këtë nuk ndiej kurrfarë mllefi ndaj tij, pasi në histori pas vdekjes së një personaliteti të madh janë lëkundur shumë e shumë burra më të mëdhenj se sa Nuhi Sylejmani. Forca tërheqëse e Jusufit kishte ndikuar që Nuhiu të tregonte anët e veta më të mira për një kohë. Pas vdekjes se Jusufit, forca tërheqëse e jonë nuk ishte e mjaftueshme për te dhe ai për një kohë tregoi veti që nuk ishin në mesin e më të mirave.

Në verë të vitit 1982, unë, Haxhi Berisha dhe Naim Haradinaj ishim si me thënë ilegalisht në Gjermani. Hafiz Gagica e kishte vendin tek baba i vetë, dhe ai përmes avokatit të Bardhit jo vetëm që u ndie i detyruar të kërkoj azil i pari, por ishte edhe i vetmi që kërkoi azil në Shtutgart dhe qëndroi në atë qytet deri më sot. Unë, Haxhiu e Naimi pjesën më të madhe të verës e kaluam në konviktin e studentëve në Eduard-Sprangerstrase në Ludwigsburg. Në këtë konvikt u punua numri i Zërit të Kosovës, i qershorit 1982. Numri vijues i Zërit të Kosovës është bërë në banesën e Remzi Ademajt

nga Zhuri, i cili në këtë kohë ka banuar në Marktstr. 29, 7129 Brackenheim, West Germany.

Më duket në gusht 1982, me porosi të Sabriut, unë e Faridin Tafallari kemi udhëtuar me tren për në Bruksel, por nuk mundem me shkua pasi policia belge mua nuk më lejoi me hy në Belgjikë, dhe në një kupe të mbyllur nga policia kufitare më kanë kthyer në Gjermani. Faridini tërë kohën ishte me mua. (Herën e dytë ia kemi mësy dhe shkuam në Bruksel me kerrin e fqinjit të Faridinit, Qemal Haxhillarit.) Prej kufirit belg jemi kthye e kemi shkua në Düsseldorf në klubin Emin Duraku. Aty tërë mbrëmjen jam bombarduar me pyetje e akuza nga magjistri më premtues i drejtësisë në Kosovë, Mr. Muhamet Kelmendi, i cili e kishte të pamundur me e fshehë inatin se pse Haxhi Berisha, 40 ditë pas ditës së varrimit, si nip i Jusufit, me kërkesën e Suzanës e kishte përjashtuar kusherinin e tij, nipin e dajës Ramë nga shtëpia e Jusufit. Ky (Muhameti) e konsideronte klubin *Emin Duraku* e lokalin e tij si një territor më privat e intim për te, se sa Haxhiu e Suzana shtëpinë e vetë. Një akuzë tjetër e magjistrit të drejtësisë ishte se çfarë faktesh kemi pasur ne në Shtutgart që kemi shprehur mendimin, dyshimin, të cilin ia kemi thënë së pari vetë Ibrahim Kelmendit, se ai (Ibrahim Kelmendi) mund të ketë njohuri për atentatin e 17 janarit 1982. Në asnjë pyetje Mr. Muhamet Kelmendit, e në prani të Ibrahim Kelmendit nuk i kam mbetur borxh. Marrjet e tij në pyetje kanë vazhduar deri në orët e vona të mbrëmjes. Kemi dalë nga klubi vonë unë, Faridini dhe Zymer Kryeziu. Na ka përcjellë edhe Ibrahimi, i cili u afrua tek një kiosk që ishte ende hapur dhe i bleu dy jogurta pemësh prej nga 3-4 decilitrash dhe na i dha mua e Faridinit. Unë e Faridini u befasuem pak nga gjesti i tij, duke pasur parasysh marrjet në pyetje të kusherinit të tij. Zymer Kryeziu u ndal një copë herë duke na shikuar se çka do të bënim ne me gotat plastike të jogurtit. Ne ia nisëm me i pi. Kur u largua Ibrahimi, ia nisëm me qesh, e Zymeri tha se këtij të pabesi nuk i besohet as me e marrë një gotë uji prej tij.

Ali Ademi - Shkëmbi dhe shtylla e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës në Hamburg

Përafërsisht në këtë kohë, ne bërthama e rrethit të shokëve të Jusufit, të cilët të gjithë ishim pa dokumente në mesin e të rinjve u shpërndamë. Hafiz Gagica kishte kërkuar strehim në Shtutgart. Haxhi Berisha shkoi e kërkoi azil dhe u vendos në Zvicër, ku i ndihmoi një dhëndër i Hafizit, i cili banonte në Roschah. Naim Haradinaj gjatë dimrit 1982 dhe pranverës 1983 qëndroi në Hamburg, si tek **Ali Ademi** nga fshati Pestovë i komunës së Vushtrrisë ashtu edhe tek disa tetovarë.

Faridin Tafallari e kishte një kushëri (Ramitin) afër Trierit. Ky i kishte tregua Faridinit se në Saarlouis refugjatët banonin në banesa private dhe jo në kampe dhe se në këtë qytet ishte një aktivist i dalluar, Ismail Hoxha nga fshati Marali i komunës së Malishevës, dhe se krahina e Saarlandit kishte mirëkuptim më të madh për

refugjatët se sa shtetet tjera federale gjermane.

Në bashkëpunim me Faridinin vendosa të shkoj e të kërkoj azil në Saarlouis. Faridini më ka que me kerr tek kushëriri i vetë Ramiti. Me Ramitin atë të nesërme kemi shkuar në Saarlouis tek Ismail Hoxha. Këtë e kam bërë me sa më kujtohet në tetor të vitit 1982. Prej tetorit 1982 gjer në 14 janar 1983 nuk kam udhëtuar për në Shtutgart, megjithëse Hafizi dhe shokët tjerë më kanë thirrur disa herë. Shpërndarjen tonë nga Shtutgarti është munduar ta shfrytëzoj Osman Osmani me instruksionet e Abdullah Prapashticës por ka dështuar. Largimin tonë është munduar ta shfrytëzojë edhe Xhafer Shatri, i cili së bashku me Hasan Malën e kanë sjellë në këtë kohë (janar 1983) Milaim Zekën në Shtutgart, në Sindelfingen tek Selim Koca nga Polaci, në mënyrë që Milaimi të bëjë propagandë dhe t'i minoj pozitat e Haxhi Berishës, Naim Haradinajt e Xhafer Durmishit në Shtutgart. Se Xhafer Shatri e Hasan Mala mund ta sjellin me mision minues në Shtutgart, Milaimin, e kisha vështirë me e marrë me mend një pabesi të tillë në atë kohë, kur ne ishin në një organizatë.

3. Mbledhja po mbahej në banesë të Hakanit dhe Sarandës

Mbledhje e planifikuar e Komitetit Qendror të Lëvizjes në janar 1983 në Zvicër në banesë të Hasan Malës e Saime Isufit.

I. Kelmendi*: "Ditën e parafundit të vitit 1982 Mirani udhëtoi drejt Zvicrës. Pasaporta jugosllave i kishte skaduar para gjashtë ditëve. Bisedoi në telefon me një aktivist në Lindau për mundësinë e kalimit ilegal të kufirit.... ....Donte të ishte në Zvicër që të merrte pjesë në mbledhjen e Komitetit Qendror në janar dhe, ndoshta atje mund të kërkonte strehim, që të prezantonte rregullisht në mbledhjet e këtij Komiteti, i cili tubimet i mbante kryesisht në Zvicër, meqë në Gjenevë jetonte Xhabiri." (Atentatet, f.426)*

I. Kelmendi*: "Përkundër rrezikut, Mirani studioi mundësinë e kalimit ilegal për në Zvicër, meqë ishte i vendosur të merrte pjesë në mbledhje të janarit të organit drejtues të Lëvizjes." (Atentatet, f.429)*

I. Kelmendi*: "**Mbledhja po mbahej në banesë të Hakanit dhe Sarandës**. Në mbledhje ishin të pranishëm vetëm Xhabiri, Hakani, Saranda, Fahriu dhe Mirani. Tre të parët ende po vazhdonin të ndiheshin si krah i Xhabirit, kurse Fahriu ishte shabllonizuar si krah i Sabitit. Kjo doli nga sqarimet që bëri Xhabiri kur hapi mbledhjen dhe shpjegoi se Xhafari kishte arsyetuar pamundësinë e pjesëmarrjes me mungesë të dokumentit të udhëtimit. Sapo Xhabiri bëri këtë sqarim, Mirani si në humor tha:*

– E po, e ka prapanicën e madhe dhe nuk ia mban të kalojë ilegalisht kufirin. Edhe unë nuk kam dokument udhëtimi, por erdha. Megjithatë, e quaj të arsyeshme frikën dhe mosardhjen e tij." (Atentatet, f.430)

A ka pas Komitet Qendror, Lëvizja për Republikë në vitin 1982 e 1983?

Lëvizja për Republikë, prej formimit të saj e gjer në demonstratën e Gjenevës, më 3 mars 1984 nuk ka pasë Komitet Qendror. Prej 15 janarit 1983 gjer më 3 mars 1984 ka funksionuar Qendra Ekzekutive. Më 3 mars 1984, në Gjenevë pas demonstratës është bërë një mbledhje në të cilën kanë marrë pjesë Faridin Tafallari, Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Haxhi Berisha dhe Xhafer Durmishi. Aty për herë të parë është vendosë për formimin e Komitetit Qendror prej 15 vetash, por më 7 prill ndodhi ngjarja e Düsseldorfit, çka bëri që ky Komitet nuk veproi asnjëherë ashtu siç qe menduar në mbledhjen themeluese. Si kanë shkuar punët më tutje në Zvicër dhe çfarë riorganizimesh e vampirizimesh janë bërë, këtë në mënyrën më të mrekullueshme dhe shkencore e ka bërë Faridin Tafallari.

4. Mos e shprush se i vjen era

I. Kelmendi e pyet sa për humor, Faridin Tafallarin, në mbledhjen e Komitetit Qendror, në janar 1983, në banesën e Hasan Malës dhe Saime Isufit, se si dhe kur është bërë ai (Faridini) pjesëtar i krahut të Sabri Novosellës dhe Xhafer Durmishit?

I. Kelmendi: *"Ndërsa ty Fahri, sa për humor, po të pyes: kur dhe si u bërë pjesëtar i krahut të Sabitit e Xhafarit?*
– Mos shprush se i vjen era! – filloi të përgjigjet Fahriu i zënë ngushtë,– unë nuk jam pjesëtar i asnjërit krah, por vetëm i Lëvizjes." (Atentatet, f.430)

Në këtë pyetje humoristike Faridin Tafallari, i zënë ngushtë e jep përgjigjen më gjeniale që mund të mendohet: "*Mos e shprush se i vjen era*."

Është shumë interesant ta shohim se kush dhe me ndihmën e bekimin e kujt e ka bërë shprushjen më të shkëlqyeshme e më të art të tij.

Të shohim krenarinë e Faridin Tafallarit, se si i ka ardhë puna të jetë shok i Jusuf Gërvallës dhe rrethit të Jusufit:

Faridin Tafallari*: "Më 7 dhjetor të vitit 1981 Jusufi ftoi disa nga shokët e këtij rrethi për të bërë betimin. Më ftoi edhe mua... U nisëm dhe unë mora me vete vëllaun tim, Sefedinin, pasi isha marrë vesh edhe me Jusufin. Vëllai kishte shfaqur dëshirë për këtë gjë."* (Terror, Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 46)

Ja se si e vjen era shprushjeve rreth përpjekjeve të Ibrahim Kelmendit dhe Kadri Zekës për ta përdorur Faridin Tafallarin si mjet për minimin e izolimin e Jusufit:

Kadri Zeka*: "Shoku Faridin, bashkë me ftesën tënde po t'i dërgoj edhe disa ftesa tjera për t'ua shpërndarë njerëzve që e gjen ti të arsyeshme, pasi unë nuk po u di adresat (është fjala për njerëzit e mirë në rrethin tuaj). Ti vetëm u shënon emrat e atyre që duhet ftuar. Pos të tjerëve dëshiroj të ftohen baca Jahir, Nuhiu dhe Shaban e Ismet Klaiqi. Sa për të tjerët din ti vet.*
Prano shumë të fala vëllazërore e revolucionare
Zeça"

Ibrahim Kelmendi*: "Si shokë që jemi dëshiroi që gjatë vitit të Ri 1982 shoqëria të thellohet edhe më shumë, në baza të shëndosha revolucionare marksiste-leniniste!"*(Faridin Tafallari, Terror dhimbje qëndresë f. 411)

I. K. *"– Mos shprush se i vjen era! – filloi të përgjigjet Fahriu i zënë ngushtë"*

5. Stilografa të mbushur me qumësht

Xhafer Shatri e I. Kelmendi kanë zënka në mes veti. Skenderi u gëzohet këtyre zënkave. Stilografi i të autorizuarit nga OMLK-ja mbushet me qumësht për të sajuar dokumente të falsifikuara. Kjo ngjarje dëshmohet edhe nga Saime Isufi, me letrën superlative dërguar I. Kelmendit më 5 mars 2007

I. Kelmendi*: "Xhafari vetëm heshtte. Ai i gëzohej kësaj zënke duke menduar se cilido që të humbte, ai do të dilte fitues."*

"Xhabiri doli në korridor dhe prej andej u fut në kuzhinë. Sarandës i tha që të mos e pengonte njeri, meqë dëshironte të përpilonte një propozim për mbledhje. Sapo

hyri dhe
mbylli derën, ai nxori qumështin nga frigoriferi. Pastaj nxori stilografin nga xhepi dhe ia derdhi ngjyrën në lavaman. E shpëlau me ujë dhe e mbushi me qumësht. Hapi furnelën që të ngrohej. Nxori një letër të bardhë dhe filloi të shkruante me stilograf të mbushur me qumësht." (Atentatet, f.437)

"Fiku furnelën dhe vendosi qumështin në frigorifer. Hapi derën dhe e pyeti Sarandën nëse kishte një gotë qumësht për të pirë." (Atentatet, f.438)

"– Kriminel e shkuar kriminelit, – ndërhyri Mirani i përmbajtur. – Hape setrën se ke stilografin në xhep të mbushur me qumësht!" (Atentatet, f.440)

> Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."*

"Mirani po mendonte të mos e dramatizonte falsifikimin më shumë, meqë mund të prisheshin dhe të përçaheshin me pasoja të rënda për Lëvizjen.
Sapo mbaruan kafet ai e mori fjalën:
– Shokë dhe ti shoqja Sarandë, jam i mendimit ta vlerësojmë të pandodhur këtë falsifikim të shokut Xhabir, gjegjësisht të Bacalokut, siç e emërtoi për kamuflim Hakani. Njerëz jemi dhe prandaj ndonjëherë gabojmë. Unë po ia shtri dorën shokut Xhabir t'ia fal këtë gabim të rëndë, i bindur se tani e tutje do të na e shpërblejë me veprimtari konstruktive. Kurse juve do t'ju lutesha ta miratoni propozimin tim dhe ta heshtim këtë incident të rastit. Ndërsa letrën, mendoj ta zhdukim se asnjërin nuk na nderon, nëse e ruajmë."
– Të lumtë! – foli Hakani.– Kështu i ka hije revolucionarit që di të falë burrërisht.
*Të tjerët miratuan **zvarrë–zvarrë**, ndërsa Xhafarit po i lexohej në fytyrë dëshpërimi.*
Mirani ia zgjati dorën Xhabirit duke i thënë:
– Mos u ngushto, shok i dashur, se ta fala meqë jam i bindur se tani e tutje do të jemi më të vëmendshëm, më të sinqertë

> Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."*

ndaj njëri–tjetrit dhe më konstruktivë e më të bashkuar.
– Të falënderoj,– u përgjigj Xhabiri me një zë që mezi u dëgjua dhe me kokën varur turpshëm.
– Atëherë shokë,– mori fjalën Mirani,– gjykoj se sot nuk mund ta vazhdojmë këtë mbledhje. Shihemi nesër meqë kemi nevojë të qetësohemi se njerëz jemi. Atmosfera është e ngarkuar dhe e papërshtatshme për të qenë të ekuilibruar dhe konstruktivë.
Të gjithë miratuan propozimin e Miranit, sekush duke ndërruar vend, sekush duke pastruar tavolinën, i dhanë fund mbledhjes tejet skandaloze. Xhabiri menjëherë iku për në Gjenevë, Xhafari e Fahriu po e komentonin sjelljen e Miranit sesi nuk e shfrytëzoi shansin e tij deri në fund për t'iu hakmarrë Xhabirit, kurse Hakani e Saranda po merreshin me rregullim të banesës." (Atentatet, f.440-441*)*

Këto citate me këto gënjeshtra absurde nuk do t'i kisha përdorë kurrë sikur të mos e kishte shkruar Saime Isufi letrën e saj. Në këto mbledhje të turpshme e në këso farë inskenimesh unë nuk ka marrë pjesë kurrë. Asnjëherë, në asnjë mbledhje të Lëvizjes, apo çfarëdo qoftë, pra kurrë në jetën time politike nuk kam marrë pjesë së bashku me Saime Isufin. Por unë nuk çuditem që këto kurtha e pabesi, sulme e kundërsulme,

egërsime e pajtime të sinqerta, brenda dy minutash, ia kanë bërë njëri tjetrit ashtu siç fabulohet në roman. Saime Isufi nuk ka qenë kurrë anëtare e Qendrës Ekzekutive.

Këto citate e gënjeshtra të turpshme me përpjekjen që të shiten si të vërteta i komentova edhe për faktin se një shok në telefon më thërret dhe më thotë: A e pe çka i kish bërë Xhafer Shatrit-Bacalokut, ia kish nxanë stilografin e mbushur me qumësht.

6. Formimi i Qendrës Ekzekutive në Ludwigsburg

A është mbajtur mbledhje e Komitetit Qendror në **banesën e Hasan Malës dhe Saime Isufit,** në janar 1983. Kjo është një rrenë sa qesharake aq edhe absurde. Janari i vitit 1983 ka qenë përvjetori i parë pas atentatit të 17 janarit 1982. Të gjithë aktivistët me dokumente e pa dokumente kanë bërë çdo gjë që të jetë e mundur të vijnë në Shtutgart për demonstratën e planifikuar me kohë për këtë ditë. Prandaj është jashtë çdo logjike të thuhet se pikërisht në janar 1983 qenka bërë përpjekje për mbledhje të njëfarë KQ në banesën e Hasan Malës e Saime Isufit.

Si është quajtur organi më i lartë i Lëvizjes nga 15 janari 1983 e gjer më 3 mars 1984?

Është quajt Qendër Ekzekutive dhe ka pasë 5 anëtarë.

Kur është themeluar ky organ, në cilin vend dhe në banesën e kujt?

Është themeluar më 15 janar 1983 në banesën e Hafiz Gagicës, Karlstr. 11, 7140 Ludwigsburg.

Kur ka ardhur koha e përvjetorit të parë të 17 janarit, është organizuar demonstratë në Shtutgart më 15 janar 1983. Me Ismail Hoxhën dhe familjen e tij kemi ardhur nga Saar-Louis në Shtutgart. Unë jam ndalë në Shtutgart për një kohë, ndërsa Ismaili është kthye vonë të nesërmen.

Pas demonstratës, jemi tubuar në banesën e Hafiz Gagicës në Ludwigsburg unë, Xhafer Shatri, Hasan Mala dhe Ibrahim Kelmendi. Ka qenë e paraparë me marrë pjesë edhe Faridini, por ai ishte ato ditë në spital. Me propozim të Xhafer Shatrit u vendos që të formohet forumi i quajtur Qendra Ekzekutive, e përbërë prej 5 vetave, pra ne të katërve në mbledhje dhe Faridin Tafallari. Po ashtu me propozim të Xhafer Shatrit janë ndarë këto detyra: Xhafer Shatri me gazetën Zëri i Kosovës, Hasan Mala lidhjet me Kosovën, Faridin Tafallari me çështjet financiare, Ibrahim Kelmendi lidhjet me organizatat e huaja dhe unë me çështjet organizative jashtë e sidomos ndërtimi i relacioneve me klubet shqiptare. Kah fundi i këtij tubimi, i cili nuk ka qenë i gjatë, në të cilën është bërë marrëveshja për themelim, andaj edhe nuk ka pasur se për çka të diskutohet aq, me kërkesën e Xhafer Shatrit kemi hyrë vetëm unë dhe Xhafer Shatri në një veturë të një bashkatdhetari për të biseduar pak. Xhaferi më tha se pas ndarjes së këtyre detyrave do të ishte mirë që makina, Stilografi i Jusufit, me të cilën përgatitej Zëri të bartet tek ai në Zvicër, pasi sipas tij (Xh. Sh.) kanë ardhur disa vërejtje të forta e perfide në adresën e Zërit në Biel-Bienne, prapa të cilave mund të qëndroj diplomacia shqiptare. Për këtë arsye duhet ta masim çdo fjalë në peshë të arit, e kjo punë është vështirë të bëhet nëse makina e Jusufit mbetet në Gjermani, por kjo do të ishte shumë më e lehtë të bëhet nëse makina kalon në Zvicër.

Unë, pa u konsultuar me askend tjetër jam pajtua me këtë propozim të atij dhe më është dukur i arsyeshëm. Qysh prej tetorit 1982 pjesa kryesore e shkrimeve të botuara në Zëri kanë qenë edhe ashtu të Xh. Shatrit, e puna ime në thelb më shumë ka qenë teknike se sa ideologjike.

Ka qenë praktikë e asaj kohe që kur formohej një forum, anëtarët e atij forumi të merrnin pseudonime të cilat i dinin vetëm ata anëtarë. Në vazhdën e kësaj praktike pseudonimet që janë nda gjatë kësaj mbledhje kanë qenë:

Xhafer Shatri - Xhema

Ibrahim Kelmendi	- Ilazi
Hasan Mala	-Plaku
Faridin Tafallari	-Fehmiu
Xhafer Durmishi	-Salihu.

Ndokush mundet me thënë se çka na nevojiten me i mbajtur në mend pseudonimet në këtë kohë. Mjaftojnë vetëm emrat (mos qofshin edhe ata të tepërt). Kjo është e drejtë por këto pseudonime janë sqaruese për ata që duan t'i lexojnë letrat që janë këmbyer në mes veti në kuadër të këtij forumi. Pra të gjitha letrat që janë këmbyer në kuadër të këtij forumi janë nënshkruar me pseudonimet e lartpërmendura.

Kjo Qendër Ekzekutive (QE) ka ekzistua prej 15 janarit 1983 (kur është themelua në Ludwigsburg) e deri më 3 mars 1984 (kur është shpërbërë, në një mbledhje të mbajtur në Gjenevë pas demonstratës së organizuar po atë ditë në atë qytet).

Pas demonstratës së 15 janarit 1983, për këtë përvjetor është mbajtur një tubim i madh në Hamburg, ku unë e kam bërë udhëtimin e parë në këtë qytet së bashku me 5-6 shokë të Shtutgartit, kur kemi shkuar me tren me një biletë të lirë të përbashkët. Në mesin e tyre ishte Remzi Ademaj e Faridin Tafallari. Remzi Ademaj m'i dha 150 DM për biletë kthyese vetëm, në mënyrë që unë të ndalesha në Hamburg e në qytete tjera të Gjermanisë veriore gjatë kthimit. Kjo më interesonte, pasi ishte në përputhje me detyrën që më ishte dhënë më 15 janar 1983.

VËLLEZËR E SHOKË BURGJESH

1. Bartja e makinës së Jusufit në Gjenevë
2. "Pengesat teknike" të një telefoni
3. Mbledhja e parë e Qendrës Ekzekutive
4. Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve
5. Frymëmarrja artificiale e sindikatave të pa zemër
6. Kërkesa ime për dorëheqje nga Qendra Ekzekutive
7. Formimi i Bashkësisë së Klubeve
8. Vëllezër e shokë burgjesh
9. Mbledhja e parealizuar e natës së Vitit të Ri 1984
10. Formimi i Klubit "Isa Buletini" në Sindelfingen
11. Shkuarja ime nga Gjermania në Francë
12. Mbledhja në Gjenevë më 3 mars 1984

1. Bartja e makinës së Jusufit në Gjenevë

Xhafer Shatri: *"...sa i përket Skenderit (Xhafer Durmishit- shën im) unë për çdo ditë po bindem se ai është njeri i punës e besa edhe mjaft i sinqertë.."* (Letër Sabri Novosellës, 12 tetor 1982)

Kah gjysma e muajit shkurt 1983, Ismail Hoxha, në shtëpinë e të cilit gjendej makina e shkrimit e Jusufit, në bazë të marrëveshjes së 15 janarit e mori këtë makinë dhe ia

dorëzoi Faridin Tafallarit. Këtë makinë në mesin e shkurtit Faridini e ka marrë në kerrin e tij dhe ia ka dërguar Xhafer Shatrit në banesën e tij në Gjenevë.

Xhafer Shatri: *"I dashur shok, e mora materialin. Në tërësi është i mirë sepse shtron ide të cilat kërkojnë realizim të menjëhershëm. Për çështjen e mbledhjes është bukur problem sepse mua ato ditë kur të vish këtu duhet të më ndihmosh në përgatitjen e organit, sepse unë s'po merrkam aspak vesh në makinë, ama aspak, bile bile edhe shiritin ia kam ngatërruar sa që s'po di si t'ia rregulloj.... Ndërmerr të gjitha masat që më 1 mars (1983- shën im) të jesh këtu."* (Letër Xhafer Durmishit, shkurt 1983)

Pasi Xhafer Shatri nuk dinte me e përdorë këtë makinë, dhe nuk kishin gjetë ndonjë person me njohuri teknike në Zvicër (se po ta kishin gjetur nuk më kishin thirrur kurrë), ky (Xh. Shatri) e thërret Faridinin dhe i thotë se unë duhet të shkoj në Zvicër, në Gjenevë për ta mësuar atë se si përdoret makina dhe se si bëhet përgatitja grafike e gazetës. Unë i thash se për mua është çështje jo e lehtë me shkua në Zvicër për shkak të mungesës së dokumentit dhe vendimit kundër meje për ndalimin e hyrjes në Zvicër për dy vjet. Xh. Shatri për punën e dokumentit kishte biseduar me një aktivist N.N. në Düsseldorf, i cili pasaportën e vetë ia kishte dërguar Faridinit që ta ketë (për mua) për këtë punë. Prej Saarlouisit, në fillim të marsit kam shkuar në Shtutgart. Më 6 mars Faridini më ka marrë dhe me kerr të tij e kemi kaluar kufirin. Më ka përcjell derisa e kam marrë trenin në Basel (në pjesën Zvicerane) për Gjenevë, e vetë është kthyer në shtëpi. Në stacion të trenit në Gjenevë më ka pritë Xhafer Shatri.

Në banesën e Xhafer Shatrit, prej 7-11 mars kemi punuar në përgatitjen e numrit të Zërit të Kosovës të muajit mars 1983. Në këto ditë ia kam mësuar operacionet e nevojshme të makinës që janë përdorë për krijimin e shtyllave të gazetës, dhe ia kam mësuar punën e përgatitjes grafike të cilën e kisha mësuar nga Jusufi. Gjatë qëndrimit tim prej më tepër se 7 ditë në banesë të Xh. Shatrit patëm rastin të këmbejmë mendime për shumë çështje.

Tek ai, (në adresën e Zërit: Buchhandlung, Badhausstr. 35, 2503 Biel-Bienne, Suisse) kishin ardhur disa letra për mua që nuk m'i kishte dërguar. Letrat ishin nga persona të cilët në mungesë të një adrese të përhershme m'i kishin dërguar në redaksinë e Zërit të Kosovës. Konkretisht ishte fjala për shumë letra të Shoqatës "Bajram Curri" nga Australia. Duke e parë se që në fillim ra në sy një atmosferë joshoqërore më tha: "Mua jeta më ka mësuar që të mos i besoj askujt." Atmosferë më jo shoqërore dhe shprehje më flagrante të pabesisë nuk kisha përjetuar. Në çdo rast tjetër do të kisha dalë menjëherë prej shtëpie. Por mua m'u dashtë për hir të punës që më duhej me e bërë me qëndrua deri në fund të asaj jave.

2. "Pengesat teknike" të një telefoni

Një episod e paharruar gjatë qëndrimit tim tek Xhafer Shatri në këto ditë ishte një bisedë telefonike me Shaqir Shabanin nga rrethi i Vitisë i cili jetonte në rrethin e Gjenevës.

Si njoha u njoha me Shaqirin?

Me këtë më ka njoftuar Nuhi Sylejmani. Vazhdimi i Zërit të Jusufit i kishte bërë përshtypje sidomos për faktin se ai i kishte parë nga afër thashethemet e intrigat për bojkotimin e luftimin e kësaj gazete sa kishte qenë gjallë Jusufi. Gjallëria e kësaj gazete kishte bërë përshtypje tek shumë e shumë bashkatdhetarë në Zvicër e jo vetëm tek Shaqiri. Në dasmën e Kadri Zekës, Shaqiri ia kishte dhuruar Saime Isufit një revole, në prani të të gjithë dasmorëve.

Saime Isufi*: "Mendoja pse nuk e mori me vete revolen kur i thashë, ta kishte me vete për çdo rast, (revolen të cilën na kishin dhuruar veprimtarët e Gjenevës në dasmën tonë, të mbajtur para dy javësh, më 2 janar 1982), por edhe ai më kishte thënë se nuk mund ta merrte, sepse mund të kontrollohej në kufi dhe t'i shkonte rruga huç..." (*Duke kujtuar atë natë të trishtuar janari, www.pashtriku.org, 17 janar 2010*)*
Xhafer Shatri*: "Është edhe një çështje tjetër, çështja e Shaqës. Në një letër aspak shoqërore Salihu (Xhafer Durmishi-shën im) më thotë e urrej në masën më të madhe unitetin formal, dhe vazhdon pse nuk po ndalen thashethemet kundër Shaqës. Dreqi e marrtë po Shaqa i ka nxitur vet thashethemet me sjelljet e tij të poshtra udbeske. Ai shkon dhe i thotë njeriut shko dhe organizoje filan fistekun në Lëvizje sikur L. të ishte kafene. Pastaj i mashtron dhe frikëson se do ta qes në Zërin e Kosovës, se ka kompetenca të mëdha e çka po di unë. Për këtë njeri unë nuk dua të harxhojë fjalë e kohë, por po them se ky është një element destruktiv puna e të cilit nuk ka asgjë të përbashkët me Lëvizjen. Ai ose është ambiciozë i sëmurë,* ***ose njeri i udbës, dhe unë më shumë droj se ky është i dyti."*** (Letër Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

Duke jetuar në rrethin e Gjenevës, Shaqiri ishte treguar skajshmërisht i papjekur dhe kishte shfaqur simpati të hapur për *Zërin e Kosovës* që u botua në Shtutgart duke konsideruar këtë si punë me të cilën do të luftohej UDB-ja vrastare, në kohën kur ata që i kishin qëndruar afër Kadri Zekës, nuk e konsideronin vitalitetin e përjetësinë e Zërit të Jusufit si vepër kundër UDB-së, por si punë kundër revistës *Liria*. Në këtë mënyrë kundër Shaqirit dhe të gjithë rrethit e shokëve të tij zhvillohej fushatë e egër dhe konsiderohej si i dyshimtë e *udbash që kishte lidhje me udbashët e Shtutgartit.* Pas bashkimit të 15 majit me OMLK-në unë në atë naivitetin tim i thosha Shaqirit dhe rrethit të tij se organizatat tona janë bashkuar, tani jemi të gjithë një, dhe ju që jeni në Zvicër duhet të veproni në kuadrin e organizatës në Zvicër e jo të keni lidhje me ne në Shtutgart. Këtë qëndrim ia kisha shprehë Shaqirit dhe po këtë edhe Xhafer Shatrit. Me aq sa mund ta dijë dhe që e kam parë Shaqiri ishte i interesuar të veproi por për shkak të stigmatizimit të tij, si person që njëherë ka pasur punë me Shtutgartin çdo punë në Zvicër e kishte të vështirë. Për këtë çështje fola me Xhafer Shatrin dhe për t'ia përsëritur qëndrimet u mora vesh që t'i telefonoi prej telefonit të tij e ta takoj.

Gjatë një shëtitje nëpër qytet së bashku me Xhafer Shatrin, e thirra Shaqirin prej qyteti, prej një kabine, dhe ashtu siç isha marrë vesh me Xh. Shatrin ia dhashë numrin e telefonit të shtëpisë së tij (Xh. Shatrit) dhe u mora vesh që në një orë e minutë të caktuar të mbrëmjes të më thërret në telefon. Në kohën e caktuar Shaqiri thirri, por para se ta pranoj këtë bisedë Xhafer Shatri m'i dha disa udhëzime që njeriu po që se është i lindur me fat mundet t'i mësoj vetëm një herë në jetë.

Pikërisht këtu fillon një detal teknik tepër origjinal. Instruksionet e Xh. Shatrit kishin të bënin me atë se si mund përdoret telefoni duke e bërë së pari demonstrimin e eksperimentit vetë. E mori telefonin dhe e vendosi pjesën e receptorit, (pranuesit të zërit) në vesh, pra aty ku duhet dhe në këtë pikë falë IQ (kuotës së inteligjencës) time nuk e pata vështirë ta kuptoj. Vështirësia apo komplikimet u paraqitën tek pjesa e mikrofonit (tek goja), tek pjesa në të cilën flitet. Ai e mori këtë pjesë e mbylli me dorë dhe e çoi nën mjekër dhe më tha:

- Kur të thërret Shaqiri dhe t'ia nisë me folë i thua një copë herë se nuk po dëgjohesh fare e ai vazhdon me folë, bile e ngritë zërin. Fakt është se ai ty nuk të dëgjon mirë se e ke mbyllë mikrofonin me dorë, dhe me këtë tek ai krijohet iluzioni se ashtu siç nuk të ndëgjon ai ty, (gjë që është e vërtetë) poashtu as ti nuk je duke e dëgjuar atë (gjë që nuk është e vërtetë, por është tallje). Kur Shaqiri thirri, unë pranova me e çue këtë eksperiment deri në fund, dhe ishalla zoti nuk më bënë azap për këtë gjynah në atë dynja.

Finalja dhe pjesa më interesante e këtij eksperimenti ishte se Xhafer Shatri këtë farë triku e kishte vu në sistem me siguri me shumë e shumë të tjerë, pasi këtë farë loje e kishte bërë shumë herë edhe me mua, (por kishte harrua krejtësisht dhe situata i kishte dalë prej kontrolli sepse nuk e dinte se me kend e ka bërë këtë lojë e këtë tallje e cilët i kanë mbetur ende pa iu nënshtrua asaj). Rezultati i kësaj loje ishte se unë Xhafer Shatrin nuk e thirra më kurrë në telefon.

3. Mbledhja e parë e Qendrës Ekzekutive

Tek ai (Xh. Shatri) qëndrova gjer më 12 mars 1983, pra kur më 12 mars u bë edhe mbledhja e parë e Qendrës Ekzekutive në përbërje të plotë. Por para se të takohemi të gjithë së bashku, në një banesë të një aktivisti tjetër, u takuam në banesën e Xh. Shatrit; Unë, Faridini, Hasan Mala dhe Xh. Shatri, ku biseduam për shumë çështje në mes të cilave më e rëndësishme qe puna e arkatarit. Faridini i dorëzoi Xh. Shatrit një regjistër mbi shënimet e plota lidhur me të gjitha shpenzimet duke u nisur prej asaj dite që e ka marrë punën e çështjeve materiale nga Nuhi Sylejmani e gjer në atë ditë. Hasan Mala dhe Xh. Shatri as përafërsisht nuk qenë në gjendje të bëjnë ndonjë shpjegim të saktë lidhur me shpenzimet e ndryshme, e të mos flasim për të hollat të cilat janë mbledhur në konton ”Ndihma për Kosovën”.

Biseduam edhe në lidhje me Ibrahimin, me të cilin unë gjithmonë i kam pas kartat e hapura dhe çka i kam thënë ia kam thënë gjithmonë parasysh, kurse Xh. Shatri e ka quajtur shok para syve, ia ka dhënë megafonin në demonstrata dhe gojë më gojë me te (nga i njëjti megafon) kanë brohoritur parulla të ndryshme, kurse prapa shpine ka veprua ndryshe. Këtë e dëshmojnë disa letra. Këtë e dëshmon edhe sjellja e tij në atë mbrëmje, kur ende pa u takuar me Ibrahimin, thoshte se këtë punë (afrimin e tij në QE pra) e kam bërë me dy mendje, dhe se për gabimin e tij të parë do ta bëjmë ”fuz”. Këtë fjalën ”fuz” e përsëriti disa herë para se të takoheshim.

> Xhafer Shatri: *”Në Bruksel s’është puna mirë. Ata njerëz ishin si kalamaj. Për çdo javë po na dërgojnë nga një procesverbal qesharak me fjalë të mëdha, ndërsa tash ishin përçarë e bërë pikë e pesë. Nëse kësaj radhe hetohet se pas kësaj qëndron* ***Ibrahimi****, atëherë* ***me të do të duhet qëruar hesapet njëherë e mirë****. Kjo do të ishte thikë prapa shpine edhe pse Agimi është bukur naiv dhe me gjestet e veta i nxitë njerëzit.”* (Letër Xhafer Durmishit, shkurt 1983)

Gjatë takimit unë e kritikova për disa çështje Ibrahimin, sidomos për disa pika që kishin të bënin me klubet. Si duket ai toni im i kritikës dhe mënyra ime e argumentimit e frikësoi Xh. Shatrin se mos ndonjë ditë do të ndodhet vetëm para meje, kështuqë për të ruajtur vehten e për të mbajtur ekuilibrin, në fund të mbledhjes tha se me Ibrahimin duhet të sillemi më mirë, të jemi më korrekt se ka punuar shumë.

Në atë tubim unë lexova të vetmin material që ishte përgatitur për atë mbledhje, në mënyrë më të qartë e që kishte të bënte me punën e aktivitetin që do ta zhvillojmë në mërgim. Sa u përket klubeve unë shpreha disa ide si këto:
- se ne që kemi rënë më shumë në sy me aktivitete të mos dukemi fare nëpër klube,
- t'u sugjerojmë bashkatdhetarëve të shkojnë në të gjitha klubet pa marrë parasysh se kush është në udhëheqjen e tyre,
- që në aktivitetin tonë të orientohemi për të hapur sa më shumë klube, por pasi në to mund të hyj kush të dojë të respektohen rigorozisht simbolet e RSFJ dhe të ndiqet një politikë e tillë që të mos rrezikojmë punëtorë.

Të gjitha këto pikëpamje të miat u aprovuan, me përjashtim të pikës që ne të rënët në sy, të mos dukemi nëpër klube.

Pas këtij tubimi jemi kthye në Gjermani me kerr të Faridinit, unë, I. Kelmendi dhe Faridini. Ibrahimin e lamë në Karlsruhe për ta vazhduar rrugën e tij, ndërsa ne vazhduam për Shtutgart.

Prej Shtutgarti e kam thirrur bashkatdhetarin NN në Düsseldorf, pasaportën e të cilit e kisha përdorë për këtë rrugë. E thirra ta falënderoj dhe t'i tregoj se u ktheva mirë dhe ta njoftoj se do t'ia postojmë pasaportën. Ai ma tërhoqi vërejtjen dhe më tha: -Mos gabo me ma dërgua pasaportën në letër rekomandë, se të vetmin dokument që e kam për t'ia treguar postës kur të më vijnë letra rekomandë është vetë pasaporta. Qeshëm pak në telefon dhe ia dërguam pasaportën me postë të rëndomtë.

4. Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve

Gjatë muajit prill 1983, një tregtar nga Muncheni (Shaban Yldrim, Bayerstr.5, 8000 Munchen) dhe Engjëll Kolaneci e organizojnë ardhjen e Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve për një turne nëpër Gjermani, duke filluar prej jugu e deri në veri. Ky turne ishte shumë i suksesshëm. Në te kishte mjaftë publik gjerman, por pjesa dominuese ishin punëtorët nga Kosova.



Afish rreth turneut të Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve

Në këtë kohë Naim Haradinaj ndodhej në Hamburg. Në Hamburg i kishte lind ideja që të shkoj në Suedi për të kërkuar azil dhe më pyet për me i ndihmua. Në Suedi e kisha adresën e një çifti i cili kishte ardhur për ngushëllime në familjen e Jusufit në Untergruppenbach. Ky çift ishte Shefkate Sherolli nga Mitrovica dhe Nexhmi Sherolli nga Shqipëria. Ne nuk i dinim relievet e relacioneve të ndryshme në atë kohë, por ky çift e konsideronte Ibrahim Kelmendin figurë shumë pozitive. Ne i patëm treguar se Suzana i ka thënë Haxhi Berishës ta përjashtoi nga shtëpia dhe ai e ka bërë këtë, 40 ditë pas ditës së varrimit. I pata shkrua Shefkates në një letër, se e kemi një shokë të

ngushtë në Hamburg që donë me ardhë në Suedi. Ajo m'u përgjigj, se rrethanat janë shumë të mira për këtë punë. Për ta përcjellë koncertin e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve, do të vinte në Hamburg një autobus me bashkatdhetarë nga Suedia. Naimi le të afrohet tek autobusi dhe duhet ta kërkoj Xhemail Durakun. Xhemaili ka me i ndihmua me hyrjen në Suedi, e merr në autobus dhe i ndihmon në ditët në vazhdim.

Në këtë mënyrë u vendosë shoku i parë i Jusufit nga rrethi i Shtutgartit në Suedi. Këtë rrugë, do ta ndiqnim të gjithë ne që kishim qenë afër Jusufit (me përjashtim të Hafiz Gagicës); unë, Haxhi Berisha, Sabri Novosella, e më pas edhe vetë Suzana me Premtonin dhe Ergonin.

Tash po kthehem tek vendimet e mbledhjes së QE të 12 marsit 1983.

I mbështetur në këto orientime e vendime për të cilat Ibrahimi e Xh. Shatri patën fytyrë të betohen edhe para fotografive të tre shokëve të përgatitura në forme fasciklle të Sh.B.K. ”Bajram Curri” në Australi, se vendimeve të marruna në të gjithë veprimtarinë do t’iu përmbahen, unë qëndrova disa ditë ndër bashkatdhetarë në München, ku të gjithëve u fola për këto orientime që kemi marrë, prej aty shkova në Bielefeld (gjatë muajit maj e në fillim të qershorit 1983) ku edhe aktivistëve kryesor të klubit ”Kosova” u fola për orientimet e marra, të cilat të gjithëve u pëlqyen.

Unë atyre u fola edhe për mundësinë apo ta kenë në perspektivë vënien e fotografisë së Titos në klub. Ky ishte si me thanë vetëm një mendim lidhur me klubet që e kanë hequr apo se kanë vu kurrë. Të gjithë e quanin të drejtë me përjashtim të ndonjërit që kishin frikë se mos po i përçanë konsullata jugosllave. Këtë mendim ua thash edhe pesë vetave të klubit ”Emin Duraku” (Hyzri Rekës, Zymer Kryeziut, Avdi Begishollit, Mustafë Kelmendit dhe Musa Dakës). Me mua në këtë takim ishte edhe Xhavit Ramabaja. Përveç punës së fotografisë ne diskutuam edhe shumë çështje tjera. Ata më thanë se është vështirë për t’u realizuar kjo ide tek ne, përndryshe është bërë një gabim i madh kur është heq.

Yrysh të madh kanë pas marrë ”patriotët e mëdhenj me vulë e adresë” kundër meje duke thënë se si ka guxua ai me e diskutuar atë punë, se për ç’arsye kam shkuar atje, se a kam shkua aty për ndonjë punë private apo çfarë. Me një fjalë, një fushatë e egër e vume në praktikë prej njerëzve të padjallëzuar në Düsseldorf dhe e aprovuar me kënaqësi prej Gjeneve.

5. Frymëmarrja artificiale e sindikatave të pa zemër

Siç e kam thënë me herët, Osman Osmani (sekretari i Partisë "Komuniste") si rezultat i bashkimit të 17 shkurtit 1982 erdhi në Untergruppenbach më 22 shkurt. Sipas porosive të Abdullah Prapashticës dhe kuptohet edhe vullnetit të vetë u mundua deri në fund që këtij bashkimi t'i jap krejtësisht ngjyrën e Partisë "Komuniste". Kjo sjellje është në parim normale, pra që një luftë e tillë të bëhet para se të merret vendimi i bashkimit. Është interesant se këta u munduan ta bëjnë këtë punë tek pas hedhjes së nënshkrimeve të bashkimit, pikërisht atë punë që nuk kishin qenë në gjendje ta bënin më parë. Për shkak të këtij dështimi ata ishin të pakënaqur dhe u larguan vetë. Në ndarje më vete u ndihmoi me aq sa mundi ambasada shqiptare në Vjenë. Përkundër ndihmës që patën, dobësia e tyre ishte e pandreqshme dhe frymëmarrjet artificiale të ambasadës shqiptare të Vjenës, të pasuksesshme.

Me sa më kujtohet në pranverë 1983, Abdullahu me shokë e nxorën një numër të një fletushke apo gazete me emrin "Punëtorët" si gazetë e sindikatave. Prej njohjes së parë, Xhafer Shatri ka mbajtur korrespondencë me anëtarët e Partisë "Komuniste", që vazhdimisht përkundër bashkimit vazhdonin ta quanin vehten Parti "Komuniste" dhe Xh. Shatrin me kompani i kanë trajtuar vazhdimisht si anëtarë të Organizatës Marksiste-

Leniniste. Nga këto pozita Xhafer Shatri ka mbajtur korrespondencë me ta, përkundër thyerjeve që kishim ne me këta në Shtutgart. Në mënyrë dinake Xh. Shatri është munduar ta luaj një farë roli se gjoja ai është aq shpirtgjerë sa qëndron mbi divergjencat e ndryshme që kanë karakter gjoja lokal, dhe në fakt është munduar t'u fryj këtyre divergjencave sa më shumë. Këto lojëra të tij në atë kohë unë nuk i dija, por rreth kësaj pike Xh. Shatri ka biseduar shumë gjerësisht me Sabriun në nëntor 1983, kur Xh. Shatri është krenuar para Sabriut se ai si komunist i Organizatës Marksiste-Leniniste kurrë nuk ka ndërruar fjalë të keqe me asnjë komunist të Partisë "Komuniste", ndërsa ju (Sabriu e Abdullahu) jeni munduar me ia hedhë njëri-tjetrit.

Pas 12 marsit 1983 e udhëtimeve të mia që i bëra me ndihmën e shokëve të Shtutgartit në München, Düsseldorf, Bielefeld e Hamburg në muajt prill - qershor 1983, unë vendosa me dhënë dorëheqje nga Qendra Ekzekutive. Shkaqet për këtë ishin këto: Unë nuk mund të kryeja atë detyrë që më ishte dhënë (marrjen me çështjet organizative jashtë) pasi me këtë punë merreshin tërë kohën vetë Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi. Ibrahim Kelmendi e trajtonte klubin "Emin Duraku" në Düsseldorf pronë shumë më private se sa hisen e tokës që mund t'ia ketë lënë baba i vetë apo ndonjë bakshish të dajës Ramë. Xhafer Shatri zhvillonte një korrespondencë të dendur edhe për çështje organizative me rrethe të ndryshme e me shokë që kisha kontakte personale në Shtutgart dhe kurrë nuk më njoftonte për ndonjë instruksion të tijin. Më lartë tregova se si ai i kishte fshehë letrat e mia personale për mos me m'i tregua me arsyetimin se "jeta e ka mësue mos me i besua askujt." Kur letrat e mia nuk m'i ka përcjellë, kërkesa për të më treguar ndonjë komunikim me të tjerët më duket se del sa absurde aq edhe qesharake. Xh. Shatri më thoshte se duhet t'ju afrohesh punëve ngadalë e t'ua rrëmihësh dheun të tjerëve nën këmbë. Kjo farë kopilie e rrëmihjes së dheut nën këmbë e kjo farë taktike nuk më interesonte dhe nuk më hynte në punë për ndërtimin e sa më shumë klubeve dhe bashkimit të bashkatdhetarëve në këto klube. Milaim Zeka në këtë kohë ka qëndruar në Düsseldorf. Mua, shokë në Düsseldorf në verë të vitit 1983 më treguan se na ka thënë Bacaloku (Xh. Shatri), kur të vjen Skenderi i Shtutgartit (Xhafer Durmishi), ndiqeni me rrametë. Këto fjalët 'ndiqeni rrametë' m'i ka vërtetua edhe Milaim Zeka në verë të vitit 1984 në Stockholm.

6. Kërkesa ime për dorëheqje nga Qendra Ekzekutive

Për këto shkaqe unë pata vendosë me kërkua dorëheqje në mënyrë të qetë që të shkëputem prej Xhafer Shatrit, Ibrahim Kelmendit dhe kleçkave të tyre. Xh. Shatri e kishte trashëguar një situatë delikate prej Kadri Zekës dhe rrethit të tij. Ata për të gjallë të Jusufit nuk kishin pranuar me e marrë e të mos flasim për shpërndarjen e Zërit të Kosovës. Tortura e tyre shpirtërore pas mbetjes së Zërit të Kosovës, Zërit të Jusufit si e vetmja gazetë, mundet vetëm me u marrë me mend. Në njëfarë mënyre unë i kuptoja kleçkat e kurthat e Xh. Shatrit si një lloj kompensimi me të cilin ai kishte nevojë me i ushqye shokët e vetë. Figura ime ishte tepër e lidhur me Zërin e Kosovës, andaj urrejtjen që e kishin pasur kundër kësaj gazete e kishin fokusuar në personin tim. Unë përpiqesha të kem mirëkuptim për vuajtjet e traumat e tyre dhe pata vendosur të jap dorëheqje. Me sakrifikimin e vetvetes mendoja se do ta forcoj pozitën e shokëve të Shtutgartit, pasi mendoja se urrejtja e tyre e madhe kundër meje nuk do të shkarkohej mbi ta. Pastaj mund të thuhet se në ato ditë edhe Xhafer Shatri edhe unë kishim të drejtë me qenë shumë të kënaqur: ai për arsye se brenda një viti, me mjeshtërinë dhe përvojën

kolosale, kishte arritur të ngritet në krye të Lëvizjes, duke pasur maqinën e Jusufit, një adresë gazete në të cilin i vinin letra dhe një xhirollogari në të cilët bashkatdhetarët dërgonin ndihma. Unë në anën time, edhe pse niveli i ambicieve kishte qenë jashtëzakonisht më i vogël, përkundër aftësive të kufizuara dhe mospërvojës kisha dhënë kontribut vendimtarë për të ruajtur emrat "Lëvizje" nga Lëvizja e Jusufit, dhe "Zëri i Kosovës" nga Zëri i Jusufit. Unë nuk kisha ndonjë shpresë tjetër se jeta ka në fshehtësi detyra më të rëndësishme për mua.

Të kthehemi tek fletushka "Punëtorët", tek ky far organi i sindikatave të Abdullah Prapashticës. Xhafer Shatri dhe unë, në bazë të sugjerimeve të mia, merremi vesh ta organizojmë një tubim dyditor të aktivistëve më të dalluar të të gjitha klubeve dhe rretheve, në Zvicër, afër Bielit. Qëllimi i këtij tubimi ishte formimi i një bashkësie të klubeve, që do t'i organizonte punëtorët në klube kombëtare, pasi ekzistonte mundësia e çoroditjes së këtij organizimi në sindikata nga A. Prapashtica dhe ndihma që kishte nga ambasada shqiptare e Vjenës në këtë punë. Xh. Shatri, i cili tërë kohën kishte taktizua e këmbye letra me Partinë "Komuniste", si anëtarë i Organizatës Marksiste Leniniste të Kosovës, punë me të cilën krenohej, më thotë ta përgatisë referatin kryesor për këtë tubim dhe tehu i tij duhet të jetë kundër veprimtarisë përçarëse të A. Prapashticës me kompani. Unë e mora seriozisht këtë detyrë dhe e shkova një material prej afër 14 faqe A4, por në përdorim në tubimin e organizuar i përdora si koncept vetëm 11 faqe.

Më 9 e 10 korrik 1983 u mbajt takimi i shumicës së rretheve e klubeve, në Zvicër, ku u vendos themelimi i Bashkësisë së Klubeve, si dhe u demaskua fuqishëm veprimtaria përçarëse e Abdullah Prapashticës me kompani. Në atë tubim fjalën kryesore më ra ta mbaj mua. Aktivistëve që kishin udhëtuar nga qytete të largëta u fola gati dy orë. Xh. Shatri, I. Kelmendi dhe Saime Isufi marrë së bashku nuk iu afruan as kohës as kualitetit të fjalës time. Referat tjetër me shkrim nuk u lexua, përkundër asaj që ishte përgatitur ndonjë, por pasi e lexova unë, u vendos vetëm të flitet (d.m.th. spontanisht) e jo të lexohet, sepse me sa duket e kuptuan se nuk kanë çka me lexua. Pasi dolëm, (pas mbarimit të fjalimit tim) Faridini më thotë: Të lumtë se na e zbardhe fytyrën dhe aq mirë e ke thënë sa po më duket se Xh. Shatrit nuk i ka ardhë mirë (nga frika kuptohet). Kjo ishte shumë e vërtetë. Pas atij takimi të gjerë, unë dhe Faridini u ndalëm. Do të takoheshim ne të pestët e QE. Në këtë tubim Xh. Shatri kishte mjaftë çka për të na kritikuar mua dhe Ibrahimin. Mua pse nuk kam punuar mjaft për demaskimin e fraksionit (por nuk tregonte se tërë kohën ka këmbyer letra 'miqësore' me ta). Kjo ishte një mënyrë e poshtër sjelljeje sipas devizës ”mbrojtja më e mirë është sulmi”. Ai kishte arsye të mbrohej për kleçkat e tija në drejtim timin si në Hamburg e Düsseldorf, si dhe për atë që kurrë për asnjë çast të vetëm nuk më kishte pyetur se a kam të holla me udhëtuar për të përmbushur detyrën që kisha marrë përsipër, respektivisht që më ishte ngarkuar.

Sa i përket Ibrahimit atë do ta akuzonte si agjent të ”shërbimit informativ shqiptar”, se e ka dekonspiruar Qendrën Ekzekutive para Shefkate Sherollit, e cila këto të dhëna dhe disa të tjera ia paska dorëzuar Ambasadës Shqiptare në Suedi, në Stockholm. Në bazë të poshtërsive që ishin bërë në drejtim timin unë kërkova dorëheqje nga një Qendër e tillë. Megjithatë unë isha i interesuar që puna t'i shkoj mbarë kësaj Qendre Ekzekutive edhe pa mua, sa edhe u propozova që vendin tim mund ta zenë Xhavit Ramabaja, aktivist në Bielefeld, Gjermani. Kërkesa ime për dorëheqje nuk u aprovua prej asnjërit. **Unë e tërhoqa këtë kërkesë sidomos për hir të Faridin Tafallarit dhe Hasan Malës, duke gabuar kështu**, pasi sikur të kisha qenë

këmbëngulës në këtë pikë do ta kurseja veten prej shumë konflikteve artificiale e disa punëve të ulëta. Në atë takim u vendos që të organizohet një demonstratë në Strasbourg, në qytetin e selisë së Parlamentit Evropian, më 28 tetor 1983.

7. Formimi i Bashkësisë së Klubeve

Në këtë kohë unë nuk kisha iluzione se Xh. Shatri e I. Kelmendi do të ndryshonin qëndrimin e tyre ndaj meje përkundër faktit se kishin qenë kundër dorëheqjes time. Dëshira e tyre ishte që unë organizimin jashtë ta bëja duke anëtarësuar bashkatdhetarë në lëvizje me emër e mbiemër, të përpiloj lista anëtarësh dhe t'ua jap këto lista Xh. Shatrit e I. Kelmendit në mënyrë që ata t'i përdorin këto si e shohin më të arsyeshme. Natyrisht se unë me këta farë njerëzish që "jeta i ka mësuar mos me i besua askujt", përkundër moshës nuk kam pranuar kurrë me ra në gabime e kurtha të tilla. Në muajt në vazhdim nuk kam bërë ndonjë udhëtim, për të mos thënë asnjë udhëtim vetëm. Ato pak udhëtime i kam bërë vetëm me Faridinin me të cilin më 16 tetor 1983 kemi shkuar në mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve shqiptare në Evropë, e cila u mbajt në Gjenevë, mbledhje për të cilën unë e kisha përgatitë një program dhe përpunuar një statut të cilat u aprovuan. Në këtë mbledhje kryetar i Bashkësisë së klubeve u zgjodh Faridini, ndërsa në punën ideore të kësaj bashkësie ndihmoja unë përmes Faridinit. Në tubimin e 16 tetorit, në statutin e aprovuar, pika 4 kishte këtë përmbajtje:

4. Bashkësia do të koordinoj të gjitha aktivitetet e lira në nivel të bashkësive të klubeve. Kjo do të realizohet përmes organit më të lartë të bashkësisë, i cili quhet Këshilli Drejtues i Punës (KDP) i cili përbëhet prej tre gjer në pesë veta.

> *a) Këshilli Drejtues i Punës (KDP) në përbërjen e vet ka Kryetarin, nën Kryetarin, Sekretarin dhe Arkatarin.*
> *b) KDP ka edhe ndihmësat e vet që u vendos të quhet "Këshilltarë" të cilët janë nga një nëpër vende të ndryshme në mërgim.*
> *c) Përfaqësimi i vendeve të tjera që ende nuk janë të përfaqësuara me Këshilltarë pranë KDP-së do të bëhet në të ardhmen në raport me aktivitetin që do të organizohet nëpër ato vende.*
> *d) Tubimet e rregullta KDP së bashku me Këshilltarët do t'i mbaj* ***në çdo tre muaj****, ndërsa tubimet me të gjithë Këshilltarët e delegatët e të gjitha klubeve një herë në vit.*

Më 28 tetor 1983 u organizua demonstratë në Strasbourg në të cilën mora pjesë.

8. Vëllezër e shokë burgjesh

Xhafer Shatri: *"Ai (Xhafer Durmishi-shën i) në fillim ishte shok i sinqertë, por me kohën duke u mashtruar nga dallaveret e Sabriut nisi të bëhet burizan i shpifjeve të tij nëpër Evropë. E them këtë pasi të gjitha fjalët e Milaimit e Fazliut i ka akorduar Skënderi, gjë që nuk i bënë aspak nder."* (Letër Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, f. 426)

Skandalet e Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit në Gjenevë.

Sabri Novosella: "*Sot më ra në dorë proqesi i komisionit të mbajtur për rastin e U. (Xhafer Shatrit) i cili ishte i shkruar me dorë të I. (Ibrahim Kelmendit). Së pari po kërkoj falje për këto që do t'i them, pasi që ndoshta fjalët e shënuara në te nuk janë të juajat por të shkruara me kokë të vetë nga Ibrahimit. Nëqoftëse janë të thanuna nga S. (Xhaferi) e F. Faridini pak po habitem. S. (Xhafer Durmishi) thotë se nuk jam për ate që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët dhe vazhdon se Mërgimi ka qenë i ndikuar nga diplomacia lidhur me sjelljet e tij.*

Unë jo vetëm se kam qenë i ndikuar nga ata, por fjalët e tyre kanë qenë fakti i parë në të cilin jam bazuar, kurse fakti i dytë ka qenë ajo kur e pash me sy të mij, kur ju tha të tjerëve: A i pe shpijunat e Shqipërisë dhe duhet të ruhemi nga shpijunat e tyre.

Për çdo kend që i ka dy kokrra mend në kokë, njeriu që i thotë tjetrit shpijun i Shqipërisë, duhet ta dij se vetë është shpijun i UDB-së. Vjen pyetja; nëqoftëse dikush e akuzon tjetrin se është shpijun i Shqipërisë, vetë shpijun i kujt është. Pasi këto fjalë i tha U. Para syve të mij dhe i kisha faktet që m'i kishte thënë Profesori dhe m'i kishi përcjellë edhe ju fjalët e E. Engjëll Kolanecit, gjë që plotësisht u përputheshin, për mua nuk patë më kurrfarë dyshimi se U. është i tillë. Këtë fakt e pa çdo kush në tryezë dhe në dorë. U. është njeri i mërgatës së qyqeve dhe të gjithë ata që janë të mërgatës së qyqeve, janë shpijuna të UDB-së, gjegjësisht të gjithë ata që janë kundër Tiranës, janë në shërbim të Beogradit në një mënyrë ose në një tjetër. Përndryshe unë aty e pash një frymë antiShqipëri e cila më tmerrojë.

Zoti U. më tha me gojë të vetë se, nëqoftëse do të del në botën e jashtme Rexhep Mala, së pari do ta urdhëron vëllaun e tij me bisedua me te dhe me ia largua frymën që e ka, pasi që të gjithë ata që po vijnë mbrendshmit, po vijnë me frymë të atjehit; me dashuri për Shqipërinë dhe për udhëheqësit e saj. Pasi t'ia mbushë mendjen Rexhepit vëllau i vetë, atëherë edhe ne i ndihmojmë e e kthejmë kundër tyre. Se ka vepruar kështu edhe me të tjerët e pash edhe vet ashtu si e keni parë edhe ju; kishte përgatitur njerëzit dhe i kishte bërë ashtu si ishte vet dhe faktikisht aty e kishte formuar bandën antiShqipëri. Do të shifni se ku do ta qoj zotin U. ajo veprimtari e poshtër e tij. Për gjakun e dëshmorëve, sa m'u ka dhimbtë Rexhep Mala, aq edhe ia pata lakmi që e dha jetën si patriotë e me atë frymë që e ka pasur deri në çastet e fundit të jetës, dhe nuk doli rrugëve të botës me manipuluar gjithfarë njerëzish të poshtër me te dhe me ia turbulluar mendjen dhe ndjenjat e pastërta." (Letër Xhafer Durmishit dhe Faridin Tafallarit, 16 janar 1984)

Në fillim të nëntorit 1983 falë ndihmës së Xhafer Shatrit, Sabri Novosellës i mundësohet sigurimi i pasaportës turke dhe viza për një vizitë në Suedi.

Ardhja e Sabriut nga Turqia në Evropën Perëndimore nuk ishte ndonjë çështje e shpëtimit të vijës së Lëvizjes. Sabriu ishte mërzitur vetëm në Turqi dhe donte të vinte në Perëndim. Si refugjat politik në Turqi ai e kishte shumë vështirë të merr pasaportë. Xhafer Shatri ia dërgoi disa vërtetime e dokumente përmes lidhjeve që kishte me Ramadan Osmanin në Malmö të Suedisë. Ramadan Osmani nga rrethi Preshevës ishte ndër refugjatët e parë shqiptarë në Suedi, i cili kishte ardhur në vitet 1960 apo fillim të viteve 1970. Ai përmes adresës së Zërit të Kosovës merr kontakt me Xhafer Shatrin. Xhafer Shatri kur e përgatitnim Zërin në banesën e tij (mars 1983), përkundër atmosferës jo shoqërore në mjaft momente, ndaj Sabriut dukej se kishte qëndrim krejt tjetër. Xh. Shatri m'i tregoi disa dokumente e ftesa për vizitë në Suedi, që i kishte bërë gati për Sabriun. Këto ftesa për vizitë që i bëheshin Sabriut për në Suedi ishin të lëshuara nga Bashkësia Islame e Suedisë, në të cilin Ramadan Osmani kishte kontaktet e veta. Bile më kujtohet se mjaftë tekste e flet kishin ornamente (pra ishin të luluara) me fjalë të arabishtes, që duhet të kenë qenë citate me *fjalë të zotit*. Këto dokumente të

përgatitura nga Ramadan Osmani, ishin vendimtare që Sabriut t'i jipet pasaporta e leja për të udhëtuar. Xhaferi krenohej se është i gjindshëm në këtë punë dhe disa herë u shprehë në formën: "Ta shpëtojmë Sabriun nga shkretinat e Anadollit".
Në fillim të nëntorit 1983 Sabriu erdhi në Gjenevë te Xhafer Shatri dhe dukej sikur "moti ishte i kthjellët" e çdo gjë do të jetë mirë. Sidomos qëndrimi i tyre ndaj diplomacisë shqiptare ishte pika më unike.

Pas disa ditësh Sabriu sheh se, për gjithë ato kontakte që ishin krijuar përmes adresës së "Zërit" në Biel Bienne, ai ishte i painformuar dhe e ndjen veten të mënjanuar. Divergjenca të tjera lindin edhe për atë se, në historinë e Lëvizjes për Republikë, cila datë është më e rëndësishme: 17 shkurti apo 15 maji 1982. Pikë tjetër fërkimi ishin edhe bisedimet e tetorit 1981 të Stambollit me Kadri Zekën, ku Sabriu e paska paraqitur Xhafer Shatrin si anëtar të organizatës së vetë dhe krejt lindjen e OMLK, vetëm si rezultat të shkëputjes së lidhjeve me LNÇKVSHJ-në.

Sabriu e akuzon Xhafer Shatrin në Gjenevë për agjent të UDB-së dhe akuzat i shpërndanë përmes telefonit të tij. Akuzat e Sabriut pra nuk ishin ndonjë kritikë, por akuza të vrazhda që kishin për qëllim shkarkimin e Xhafer Shatrit si drejtues të "Zërit të Kosovës", qërimin e hesapeve me te në stilin "ose-ose". Brutalitet, ashpërsi e urrejtje më të madhe të një njeriu për një tjetër, pra këtë oscilim brenda tri-katër ditësh nga vëlla e shoku më i ngushtë, në armikun më të madh, vetë nuk kisha përjetuar. Për kalime nga shok në armiqësi të tilla kisha lexuar e dëgjuar nga spastrimet politike në Rusi e Shqipëri. Por tjetër send është me ndëgjue, e me paramenduar, e krejt tjetër është me i pa këto metamorfoza para syve tu. Në akuzat e tilla Sabriu mbeti i vetmuar, sepse ato nuk i pranoi askush. Argumentin e sulmit të vetë, (edhe pse ishte prishur për punë krejt tjera që kishin të bënin me prestigje personale), Sabriu mundohej të na e mbushte mendjen se e ka nga diplomatët e Shqipërisë.
Për mbrëmjen e 11 nëntorit 1983 ka qenë i thirrur një takim, për t'i shqyrtuar akuzat e Sabriut dhe gjendjen e krijuar por për shkak të prishjes së një koncerti të organizuar nga ambasada jugosllave në Shtutgart, ku atë mbrëmje unë e Faridini i kaluam në qeli arresti në një burg apo stacion policie, ky takim u mbajt më 13 nëntor.
Më 13 nëntor shkuam unë e Faridini në Zvicër. Unë e kalova kufirin në Konstanc. Në Amriswil, në banesën e Haxhi Berishës qëndruam pak me Sabriun, e muarën atë dhe shkuam tek Hasan Mala, afër Bielit. Në banesën e Hasan Malës u bë një mbledhje e Qendrës Ekzekutive plus Sabri Novosellës.

Nga procesverbali i mbajtur prej Ibrahim Kelmendit, del se unë, Xhafer Durmishi, lidhur me fjalët që lëshonte diplomacia shqiptare kundër Xhafer Shatrit në vende të ndryshme tek shumë njerëz e jo vetëm tek Sabriu, i cili u bë zëdhënës i tyre, them: **"Nuk jam për atë që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët**". Ky qëndrim i imi ndaj intrigave të diplomacisë shqiptare figuron edhe në letrën e Sabri Novosellës të 16 janarit 1984, dërguar mua e Faridin Tafallarit. Unë dhe Faridin Tafallari *nuk e pranuan propozimin e Ibrahim Kelmendit për përjashtimin e Sabriut nga Lëvizja, dhe kështu erdhi tek një thyerje e re*, thotë Sabriu në një shkrim të tij nga viti 1992.

Në atë takim ku ishim ne të pestët nga QE ishte edhe Sabri Novosella. Në atë takim ne shumica vlerësuam se nuk mund të themi se Xhafer Shatri është një njeri në shërbim të udbës, ashtu siç e kishte akuzuar Sabriu dhe disa individ të tjerë, por vlerësuam se gabimet e tij në Zëri janë më se evidente dhe për atë u vendos formimi i

një komisioni i cili do të diskutoj për devijimet e vërejtura, dhe ai komision i studioi e shprehu ato devijime në një mbledhje më 18 dhjetor 1983.

Pikëpamjet e ndryshme e diametralisht të kundërta të Xhafer Durmishit me Ibrahim Kelmendin kanë qenë rregull dhe votimi i ndryshëm në këtë pikë nuk ishte diçka e re. As Xhafer Shatri nuk ishte për thellimin e acarimeve për faktin e thjeshtë se sulmi i Sabriut mbeti i pa efekt. Kjo nuk do të thoshte se do të vazhdonte loja sikundër nuk ka ndodhur asgjë.

Keqpërdorimi i fatkeqësisë së bashkëshorteve.

I. Kelmendi*: Një ditë pas zënkës së madhe, më 13 nëntor, mbahet mbledhje e QE.*

"Juve, të katërve, ju bashkoi dikush dhe ju urdhëroi të sajoni bashkimin në LRSSHJ. Ishit gjoja përfaqësues, ju kishin ngarkuar gjoja organizatat që ju u shtirët se i përfaqësonit. Ju depërtuat duke shpërdoruar fatkeqësinë e rëndë të bashkëshorteve të Jusufit e Kadriut. Ju depërtuat duke shpërdoruar goditjen e rëndë dhe naivitetin e hilen e Nuriut, Hakanit, Fahriut." (Atentatet, f.452)

Saime Isufi: "*Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë."* (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

9. Mbledhja e parealizuar e natës së Vitit të Ri 1984

Në atë tubim të 18 dhjetorit 1983 u vendos që të riformohet KQ i LRSHJ prej 15 vetash. Në të vërtetë Komitet Qendror të Lëvizjes për Republikë nuk ka pasur më parë, megjithëse Komunikata e bashkimeve të 17 shkurtit e 15 majit është nënshkruar 'Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ'. Në përbërjen e tij do të hynin, në bazë të organizatave të mëparshme 7 nga krahu i ish-LNÇKVSHJ dhe 7 nga ish-OMLK dhe Ibrahim Kelmendi. Lidhur me këtë u la një takim **për natën e vitit të ri.** Vendtakimi nuk u caktua. Për arsye se në të **gjitha** takimet e vitit 1983, përveç atij të janarit që u bë pas demonstratës në Shtutgart, unë në të gjitha rastet kisha dalë në Zvicër, kësaj radhe nuk kisha mund me sigurua dokument (huazuar pasaportë), kisha të drejtë të thosha se edhe ata (të Zvicrës) bënë me dalë në Gjermani. Megjithatë u tentua të organizohet ai takim por nuk pati sukses. Faridini thoshte të dalim në Zvicër sikurse herave tjera. Unë i thash se deri në kufi, në Konstanz vij dhe aty pres, nëse do Xh. Shatri me dalë këndej le të del, se kësaj radhe nuk dua me rrezikue. Faridini thoshte eja shkojmë deri në Konstanz se pastaj ia bëjmë më lehtë kësaj pune duke menduar se më thehet mendja. U nisëm për në kufi, Konstanz, unë, Faridini dhe Ibrahim Kelmendi. Faridini kishte pasaportën nga Kosova, me leje pune e qëndrimi dhe për te nuk kishte problem. Për çështjet private të Ibrahim Kelmendit nuk dija. Faridini u mundua me ma mbush mendjen me e kalua kufirin në këmbë por nuk pranova. Së pari e kisha një parandjenjë të keqe rreth kufirit dhe isha i bindur se edhe sikur të dalim, Xhafer Shatri nuk e prish taraqillakun e natës së vitit të ri për ne, sidomos kur dihej fakti se sulmi i Sabriut as përafërsisht nuk e kishte pasur efektin e vetë. Kufirin e kaloi Faridini vetë në mënyrë legale. Ibrahimi provoi në atë ilegale dhe u zu në kufi, në natën e Vitit të Ri 1984, pra në mbrëmjen e 31 dhjetorit 1983. Në librin Atentatet Ibrahimi tregon se ky rast e ka detyrua me kërkua azil, por në mënyrë djallëzore e rrene të tejdukshme këtë ngjarje e shtyn plot një vit më heret, pra më 31 dhjetor 1982.

Ibrahim Kelmendi: ***"Ditën e parafundit të vitit 1982*** *Mirani udhëtoi drejt Zvicrës. Pasaporta jugosllave i kishte skaduar para gjashtë ditëve. Bisedoi në telefon*

me një aktivist në Lindau për mundësinë e kalimit ilegal të kufirit. Ai e dinte se pa pasaportë nuk do të mund të lëvizte si përpara, ndërsa po të kërkonte strehim politik në Gjermani, do t'i vonohej dokumenti i udhëtimit, siç ia kishin vonuar Jusufit. Donte të ishte në Zvicër që të merrte pjesë në mbledhjen e Komitetit Qëndror në janar dhe, ndoshta atje mund të kërkonte strehim,që të prezantonte rregullisht në mbledhjet e këtij Komiteti, i cili tubimet i mbante kryesisht në Zvicër, meqë në Gjenevë jetonte Xhabiri.
Kur arriti me tren në Lindau, bashkatdhetari Dren T. i premtoi se do ta nxirrte në Zvicër pa problem. U nisen sapo u errësua. Në kufirin gjerman Miranin e kapi policia dhe e burgosi. Gjatë marrjes në pyetje nuk pranoi të përgjigjej fare pa kontaktuar me avokatin. Policia ia mundësoi. I telefonoi avokatit Karl E., mikut nga koha e studimeve. Ai u alarmua:
– Është kohë e festave. Ka rrezik të të ekstradojnë në Beograd. Po nisem menjëherë me motorin tim sportiv.
Rreth 550 km., i bëri për katër orë. Arriti pak para mesnatës. Më vete solli kërkesën për azil politik, të cilën e kishte shkruar në byro në të nisur. Para se ta dorëzonte kërkoi nga personeli i burgut që ta takonte Miranin, meqë i duhej autorizimi i tij për t'ia bashkëngjitur kërkesës.
– Të jam shumë mirënjohës, mik i dashur! – i foli Mirani duke e përqafuar.
– Qetësohu tani, sepse mënjanuam rrezikun e ekstradimit tënd në Beograd.
Sa për mirënjohje që po më shpreh, po ta kthej me proverbin shqiptar që ma ke thënë sa herë: "Miku i mirë në ditë të vështirë".
– Nuk po frikësohem,– u përgjigj Mirani duke e keqkuptuar sikur avokati Karl e bëri frikaman.
– Ta njoh kokën tënde, nuk të thashë mos u frikëso, por qetësohu!
Shqetësimi dhe frika nuk janë njësoj.
– Shko tani fli në hotel, ndoshta ndonjëherë ta paguaj këtë mund! – tha Mirani.
– Po ta dija se do të më përmendje pagesën nuk do të vija. Nuk bëhet gjithë kjo rrugë në këtë kohë të acartë për para. Sikur nuk po e kupton çfarë do të thotë të kesh një mik të vërtetë gjerman.
– Më fal, nuk qeshë i vëmendshëm sa duhet!
Të martën, më katër janar 1983,Mirani u lirua nga burgu. Kërkesa për strehim do të shqyrtohej në Lindau dhe aty duhej të mbetej derisa të vendosej nëse do t'i njihej statusi i azilantit." (Atentatet, f.426-427)

Ja si duket e vërteta:

Ibrahim Kelmendi: *"PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!*

Konstanz, më 3 janar 1984

Shumë i dashuri shoku Fahredin,

jam mirë. Ti dhe familja qofshin mirë. Ndoshta të erdhi ca keq kur m'i vuan prangat, por s'kemi ç't'bëjmë; Derisa jemi të detyruar të bredhim rrugëve të botës, kështu e ka. Kryesorja është se unë jam fare i pafajshëm dhe si i tillë, besoj, së shpejti do të dal, nëse ende sundojnë ligjet e vendit dhe jo dëshirat e ministrit të Punëve të Brendshme, Z. Zimmermanit.

Gjer më tani jam i gjykuar të më dërgojnë në Jugosllavi. Unë jam ankuar, kurse edhe advokati ka bërë të veten. Shumë më mirë do të ishte sikur të gjeje që në fillim advokat të mirë në qytet, këtu. Por të shohim si do të ndodhë. Gjasat nuk janë fortë të mira, pasi po shihet ku po shkon Gjermania...

Sido të ndodh, të mërzitemi nuk kemi pse, pasi kështu do gëzohen ata të regjimit.

Më mirë do të ishte ta festonim Vitin e Ri 1984 së bashku....

Të përqafon Shoku

PS. Nuk ka nevojë të mësojnë mbi arrestimin tim edhe të tjerë bashkatdhetarë, pasi kjo është gjë e vogël dhe kalimtare.

Të mira dhe sukses në këtë Vit!

Mirëupafshim

*Harrova të the: Sikur t'i kishe telefonua shokut këtu (**Hasim Mjakut**-shën i Xh. D.) që të m'i blen ca ndërresa, një peshkir dhe vegla për rroj."* (Letër për Faridin Tafallarin, 3 janar 1984

Hasim Mjaku (mjatas) dhe Faridin Tafallari

Atë natë (natën e Vitit të Ri 1984) Faridini u nervozua, pasi kur kishte dalë në Zvicër, Xhafer Shatri iu kishte përgjigj në telefon e i kishte thënë se nuk mund të vjen gjer në St. Gallen, por e lëmë për një herë tjetër. Faridini u nervozua shumë. Por ai, Bacaloku, kur e ka marrë vesh se jemi kthye në Gjermani iu kishte lajmëruar Faridinit në shtëpi dhe i kishte thënë se si mos me më prit kur unë ty të kisha pritë as më shumë e as më pak se pesë vjet. Si thonë shaka, 5 vjet.

10. Formimi i Klubit "Isa Buletini" në Sindelfingen

Gjatë muajve nëntor e dhjetor 1983 dhe deri më 14 janar 1984 kam qëndruar më shumë në banesën e Ismet Klaiqit, i cili banonte vetëm në qendrën e Sindelfingenit. Në Sindelfingen ishte fabrika e Mercedesit, kishte shumë punëtorë nga viset shqiptare dhe ishte baza e aktiviteteve për rrethin e Shtutgartit. Përveç punës me Bashkësinë e klubeve, në ato ditë jam marrë me themelimin e klubit "Isa Buletini" në Sindelfingen e cili e filloi veprimtarinë në janar 1984. Më 14 janar në Shtutgart u mbajt mbledhje e Këshillit drejtues të Punës, të Bashkësisë së klubeve që drejtohej prej meje përmes

Faridin Tafallarit. Në banesë të Ismetit i studiova për herë të parë veprat e zgjedhura të Marksit e Engelsit në dy vëllime dhe ato të Leninit në tri vëllime.

Në vjeshtë të vitit 1983, një shok i afërm, përmes kontakteve të Ismail Hoxhës të cilin e kishte njohur përmes meje, shkoi në Francë për të kërkuar azil dhe lënda e tij iu shqyrtua pozitivisht brenda pak muajsh. Tani ishte janari 1984, ndërsa unë kisha kërkuar azil në vjeshtën e vitit 1982. Policia gjermane e dinte se unë kam qenë në Untergruppenbach menjëherë pas atentatit. Ata (policia) në atë kohë (në shtëpinë e Jusufit) ma patën kërkuar pasaportën e lëshuar në Mitrovicë, dhe kur i kanë pa vulat e Gjermanisë Lindore i kanë marrë faktet rreth pasaportës. Kur më kanë marrë në pyetje në zyrën qendrore të refugjatëve për Gjermaninë në Zindorf, në gjuhën serbokroate, referenti për refugjatë (i cili vetë fliste serbokroatisht) disa herë më ka pyet se ku e kam pasaportën. Unë nga frika nuk pata guxua me e tregua dhe ai nuk më besoi. Instanca e parë ma kishte refuzuar kërkesën për azil në Gjermaninë Federale, ndërsa përgjigja e dytë ende nuk më kishte ardhur. Në këtë situatë vendosa të shkoj në Francë që të kërkoj azil.

11. Shkuarja ime nga Gjermania në Francë

Rreth 23 janarit 1984, unë u largova nga Gjermania dhe u nisa për në Francë. Ismail Hoxha, unë dhe Imer Berisha u nisëm nga Saarlouisi dhe shkuam në qytetin Méru, 60 km në veri të Parisit. Në Méru, në *Rue du 8 Mai 1945*, banonte tezja e Ismail Hoxhës, Zarifja me burrin e saj Vehbiun dhe fëmijët e tyre, disa të rritur. Vehbi Kuçi ishte nga Suhareka. Pas pak ditësh kam shkuar në Paris ku më parë e njihja Ibush Bytyçin, i cili jetonte në periferinë jugore të Parisit. Ibushi më ka njoftuar me Valdet Kuçin (apo Hamitin, të dy këta mbiemra janë përdorur për te). Valdeti ishte piktor, e njihte mirë kolonia shqiptare e Parisit dhe e Brukselit. Valdetin e njihnin edhe disa rrethe kulturore franceze. Një prej shokëve të Valdetit ishte dizajneri (kreatori i modës) Izet Curri, i cili e kishte një banesë të zbrazët në qendër të Parisit, të cilën ia kishte lënë në disponim Valdetit. Në këtë banesë e takova Valdetin për herë të parë. Valdeti ishte njohës i shkëlqyeshëm i frengjishtes dhe u përkthente shqiptarëve. Valdetit ia kam treguar në pika të shkurta të gjithë ngjarjen time dhe i thash se kam ardhur të kërkoj strehim. Ky e njihte një referente, vendim-marrëse në qendrën ku merren në pyetje refugjatët. Më ka thënë se nuk ka me pas kurrfarë problemi, kjo punë ka me u rregullua, se Unë (Valdeti) e thërras nëpunësen kompetente për këtë punë dhe me ndihmën e Ibushit takohemi në vendin e caktuar. Në datën e caktuar kemi shkua me Valdetin i cili do të më përkthente. Nëpunësja e qendrës për refugjatë më ka pyetur pak, në një bisedë aq të lirë e të qetë që nuk harrohet kurrë. Valdeti më tha se kjo nuk do të pyet aq si ke mund me e paramenduar pasi kësaj ia kam treguar rastin tënd. Kështu që më duket ajo, sa foli me mua për veprimtarinë politike, foli aq me Valdetin për çështje të artit e të kulturës. Në fund të bisedës, Valdeti më tregoi se kjo sot gjatë bisedës e ka marrë vendimin me ta dhënë statusin e refugjatit në Francë, por ajo që vonon është koha kur të gjen kjo me e formulua me shkrim. Më 20 shkurt 1984 më është lëshuar Çertifikata e refugjatit në Francë, kjo do të thotë edhe leja e qëndrimit e të drejta tjera që e përcjellin këtë.

12. Mbledhja në Gjenevë më 3 mars 1984



Në takimin e mbajtur më 3 (tre) mars 1984 në Gjenevë, pjesëmarrësit e këtij takimi deklarojnë:

jemi të autorizuar që në emër të organizatave të mëparshme, që u shkrinë në LRSHJ, përkatësisht në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror brenda, – që në pamundësi nuk po mund të takohen, – dhe në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror jashtë, të cilët për arsyena shëndetsore e teknike nuk mund të marrin pjesë, të marrim të gjitha vendimet e mundshme e të nevojshme në emër të tyre.

Vendimet që marrim në pjesëmarrësit e këtij takimi, me shumicë apsolute votash, janë të plotëfuqishme për tërë LRSHJ, përderisa ato përputhen me vendimet që dalin nga Komunikata për Bashkim (ZK, nr. 1, 1982).

Ata që nuk u përmbahen vendimeve që do marrim do të marrin mbi vete përgjegjësinë e pasojat.

Dokumentin e nënshkruajmë me emër e mbiemër.

1. Faridin Fallari Fadi
2. Xhafer Shatri XShatri
3. Xhafer Durmishi, XDurmishi
4. Ibrahim Kelmendi Kelmendi

Dokumenti u nënshkru nga katër veta, të pranishem në këtë takim.

Dokumenti i formuluar nga Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi, në mbledhjen e 3 marsit 1984 në Gjenevë. Dorëshkrimi është i Ibrahim Kelmendit.

Në takimin e mbajtur më 3 (tre) mars 1984 në Gjenevë, pjesëmarrësit e këtij takimi deklarojnë:

jemi autorizuar që në emër të organizatave të mëparshme, që u shkrinë në LRSHJ, përkatësisht në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror brenda, – që në pamundësi nuk po mund të takohen, – dhe në emër të anëtarëve të Komitetit Qendror jashtë, të cilët për arsyera shëndetësore e teknike nuk mund të marrin pjesë, të marrim të gjitha vendimet e mundshme e të nevojshme në emër të tyre.

Vendimet që marrim ne pjesëmarrësit e këtij takimi, me shumicë absolute votash, janë të plotëfuqishme për tërë LRSHJ, përderisa ato përputhen me vendimet që dalin nga Komunikata për Bashkim (ZK, nr.1, 1982). Ata që nuk u përmbahen vendimeve që do marrim do të marrin mbi vete përgjegjësinë dhe pasojat.

Dokumentin e nënshkruajnë me emër e mbiemër:

1. Faridin Tafallari, nënshkrimi
2. Xhafer Shatri, nënshkrimi
3. Xhafer Durmishi, nënshkrimi
4. Ibrahim Kelmendi, nënshkrimi

Dokumenti u nënshkrua nga katër veta, të pranishëm në këtë takim.

Për datën 3 mars 1984 Xhafer Shatri mori iniciativën për thirrjen e një demonstrate në Gjenevë. Iniciativa ishte krejtësisht e tij, pasi si duket ai kishte nevojë ta mobilizonte vehten pas atyre sulmeve brutale e të vrazhda që ia kishte bërë Sabri Novosella në shtëpinë e tij në Gjenevë..

Për ne këtë demonstratë kam udhëtuar me Ibush Bytyçin dhe shoqen e tij, nga Parisi. Në xhep e kisha letërnjoftimin francez, por jo edhe pasaportën. Por edhe sikur ta kisha pasaportën, në Zvicër ishte vendimi për ndalimin e hyrjes time, i cili ishte në fuqi deri më 20 prill 1984. Ibushi ma pruni fare lehtë kalimin e kufirit dhe hyrjen në Zvicër prej territorit francez. Dhe ashtu më doli.

Në pasditën e kësaj dite, pas demonstratës, në një banesë në Gjenevë u tubuam Unë, Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Haxhi Berisha dhe Faridin Tafallari. Do të formohej KQ i LRSHJ në formën siç e kam përmend edhe më lartë (7 nga ish LNÇKVSHJ + 7 nga ish OMLK + 1 I. Kelmendi) në këtë punim. Si përfaqësues të ish-LNÇKVSHJ mbetëm vetëm unë, Faridini dhe Haxhiu, që do të vendosnim për tre shokë tanët jashtë dhe për katër brenda të cilët do të hynin në përbërjen e KQ. Ibrahim Kelmendi e Xhafer Shatri dolën jashtë, për të na lënë ne treve të qetë për t'i bërë disa konsulta paraprake. Këtë nevojë nuk e kishin I.K. e Xh. Sh. pasi ata nuk kishin asnjë shok tjetër në mbledhje pos vetes. Megjithatë pjesa kryesore e kësaj mbledhje në bazë të marrëveshjes, u bë në mes Xhafer Shatrit, Ibrahim Kelmendit, Faridin Tafallarit dhe meje, me ç'rast u përpilua edhe një dokument, formulimin e të cilit e bënë kryesisht Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi.

Për çështjet materiale edhe kësaj radhe nuk u diskutua, sepse mungonte Plaku (Hasan Mala), e Xh. Shatri nuk paska pas mundësi me ardhë gjer tek ato shënime, kështuqë kjo temë nuk u shqyrtua fare. Në mungesë kohe, pika për planifikimin e punës në të ardhmen mbeti pa u diskutuar. Kjo mbledhje u karakterizua edhe nga "komplimentet" e Xhafer Shatrit në momentet kur frikohej se do të kritikohej nga unë duke më thënë: "Se unë nuk di çka mëshihet nën flokët e tua, dhe se ti një ditë mund të kontribuosh më shumë, pasi ne kemi letra të Jusufit ku ai është shprehur se së shpejti me Shpendin (unë e kisha me te pseudonimin Shpendi) do t'i ndajmë punët.

Me Ibushin u ktheva në Paris dhe rruga me dalë në Zvicra në Francë, në vendin që e zgjodhi Ibushi qe shumë më e lehtë se hyrja.

Ibrahim Kelmendi: *"Data e krijimit te qendrës ekzekutive ndoshta është pikërisht 15 janari 1983, por e shuarjes së saj nuk besoj të ketë qenë 3 marsi 1984. Informatën për shuarjen ju mund ta keni marrë nga "libri" i "trashëgimtarit" të atdhetarit të madh Jusuf Gërvalla, pra të Zotëri Xhafer Durmishit, sepse, meqë me 3 mars 1984 ai paskësh dhënë "dorëheqjen" nga qendra ekzekutive, atëherë menduaka se edhe ajo është shuar!"* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.135)

Dokumenti i lartpërmendur u përgatitë me iniciativën e Xhafer Shatrit dhe Ibrahim Kelmendit dhe u shkrua në dorëshkrim nga Ibrahim Kelmendi dhe u nënshkrua nga katër të pranishmit. Me këtë pushoi së ekzistuari Qendra Ekzekutive, e formuar më 15 janar 1983 në Ludwigsburg. Forumi i ri ishte planifikuar të quhej KOMITET QENDROR, ndërsa identifikimi e referimi tek ky Komitet Qendror në korrespondencën tonë do të bëhej me emrin "**DUKAGJINI**".

Ibrahim Kelmendi: "*Pasi nuk patëm kohë për të biseduar, propozoj gjithashtu që artikujt që kanë shpërndarë Mërgimi e Musa Hoti, duke keqpërdorur simpatizantë të Lëvizjes, që mu më kanë rënë në dorë gjithsejt tetë, të mos pranohen se i ka nxjerr **Dukagjini**, "në emër të të cilit" janë shpërndarë."* (Letër Faridin Tafallarit, Xhafer Shatrit e Xhafer Durmishit, 19 mars 1984)

Letra e 19 marsit 1984, është letra parë dhe e fundit që kam marrë në cilësinë e anëtarit të "Dukagjinit".

NË DUSSELDORF MË 7 PRILL 1984

DOKUMENTE RRETH MBRËMJES SË 7 PRILLIT 1984

I. TEKNIKA E SHKËPUTJES SË MIKROFONAVE

1. Xhafer Durmishi: Programi dhe Statuti i Bashkësisë së klubeve
2. Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve
3. Ibrahim Kelmendi: Pjesë nga Letra kryesisë së Lëvizjes për Republikë
4. Xhafer Durmishi: Letër delegatëve të Bashkësisë së Klubeve
5. Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve
6. Raport i komisionit të mbrëmjes së 7 prillit 1984
7. Letër e Bacalokut dërguar shokëve të Shtutgartit
8. Letër e Xhafer Shatrit dërguar Ibrahim Kelmendit
9. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet
10. Xhafer Shatri: Letër Qendrës Ekzekutive
11. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet
12. Pjesë nga letra e mbyllur e Xhafer Durmishit dërguar shokëve të Shtutgartit
13. Xhafer Durmishi: Tubimi i 7 prillit 1984 në Düsseldorf

II. TEKNIKA E NGJITJES SË MIKROFONAVE

14. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" i vitit 1992

15. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" më 1992 dhe disa relacione me mbrëmjen e 7 prillit 1984

I. TEKNIKA E SHKËPUTJES SË MIKROFONAVE
1. Xhafer Durmishi: Programi dhe Statuti i Bashkësisë së klubeve

Nga "*Programi Aksional i Bashkësisë së klubeve të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia në Evropën Perëndimore*"

Për qëllimet dhe interesat e tyre, në fillim, iniciativën për hapjen e klubeve shqiptare e përkrahën edhe policët e sigurimit jugosllav të veshur me petkun e diplomatit. Ata ushqenin shpresat se me ndihmën e klubeve do të kryenin më lehtë misionin e tyre të spiunazhit.

Shikuar realisht, po të kishte nisje nga qëllime të mira, krejt puna në këtë drejtim do të duhej të kryhej nga ana e përfaqësuesve të RSFJ, të cilët këtë punë edhe e bëjnë kur janë në pyetje klubet e kombeve dhe kombësive tjera nga Jugosllavia, të cilave pos ndihmës së ndryshme administrative u ofrohen edhe ndihma materiale.

Kur planet djallëzore me shqiptarët u dështuan, atëherë edhe çjerrja e maskës dhe zbulimi i vërtetë i planeve të tyre nuk ka vonuar të duket. Disponimi i përgjithshëm antishqiptar i shovinistëve të Beogradit dhe sidomos i politikës së tyre të jashtme antishqiptare erdhi në shprehje edhe në qëndrimin e tyre ndaj shqiptarëve të mërguar nga Jugosllavia, si thonë në mënyrë ironike "me punë të përkohshme". Duke u nisur nga ky qëndrim, ku më heret e ku më vonë filluan presionet ndaj aktivistëve të ndryshëm që kishin kontribuar më së shumti në tubimin e shqiptarëve të shkapërderdhur, duke i etiketuar si element armiqësorë dhe ndaj pjesës dërmuese të tyre u morën masa të ndryshme; prej marrjes së pasaportave e deri tek burgosjet e rënda.

Këto fërkime në mes punëtorëve e aktivistëve të ndryshëm dhe ambasadave e konsullatave jugosllave arritën kulmin në momentet pas shpërthimit të demonstratave në Kosovë, të cilat pos të tjerash çuan edhe tek tubimet e shumta nëpër klubet shqiptare, të organizuara nga përfaqësitë jugosllave, të cilat nga punëtorët shqiptarë në mërgim kërkonin të dënonin vëllezërit dhe motrat e tyre në Kosovë. Konsullatat, vet, në emrin e disa klubeve dërguan telegrame në Radio Prishtinë, sipas të cilave bashkatdhetarët në botën e jashtme i dënonin demonstratat në Kosovë. Gënjeshtrat e tilla u denoncuan në mënyrën më kuptimplote me anën e tetë demonstratave që u organizuan vetëm në Pranverën dhe Verën e vitit 1981 e që do të vazhdonin edhe në vitin 1982.

Nga ngjarjet më të ndryshme të të gjitha llojeve në këtë kohë nuk u kursyen as klubet e shqiptarëve. Sot është fakt me rëndësi se këto klube dita ditës po grumbullojnë rreth vetes gjithnjë e më shumë anëtarë të rinj dhe në përgjithësi po konsolidohen. Kjo i dedikohet më së shumti faktit se mërgimtarët po e kuptojnë se një prej detyrave të para për ta është ajo, që në këto momente të jenë sa më të bashkuar.

Që kjo punë të intensifikohet edhe më shumë, deri në atë shkallë që e kërkojnë interesat e kohës, më 9 korrik 1983, nga përfaqësuesit e shumicës së klubeve dhe rretheve të dalluara të shqiptarëve në Evropën Perëndimore u vendos që të themelohet BASHKËSIA E KLUBEVE DHE RRETHEVE SHQIPTARE NE EVROPEN PERENDIMORE.

Ideja themelore e Bashkësisë është solidariteti.

Bashkësia me punën e vetë ka për qëllim:

-Të koordinoj punën e të gjitha klubeve në Perëndim, duke aplikuar përvojën e përparuar të ndonjë klubi në një tjetër; të bëjë njohjen e tyre reciproke, të organizojë

mbrëmje të përbashkëta në mes klubeve fqinje dhe të atyre më larg, të cilat do të shkojnë në interesin e mërgimtarëve.

-Të ndihmojë me të gjitha forcat, me njerëz, me mjete materiale dhe me ndihmë morale në hapjen e sa më shumë klubeve, duke organizuar sa më shumë mërgimtarë që të tubohen rreth tyre.

-Edhe pse përfaqësitë diplomatike dhe të gjithë mekanizmat tjerë të RSFJ-së, që kanë kontakte më të shpeshta me ne, duke u nisur prej një diplomati e deri tek një polic i thjeshtë në autostradë apo tren po sillen ndaj nesh tejet armiqësisht, ne do të vazhdojmë të respektojmë simbolet e RSFJ, ashtu siç veprojnë edhe klubet e kombeve e kombësive tjera megjithëse trajtimi i tyre në krahasim me ne është diametralisht i kundërt.

-Bashkësia do të përkrahë kërkesën e popullit shqiptarë "Kosova-Republikë" dhe në këtë drejtim ajo e shikon me simpati punën e Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi. Konsiderata e lartë e Bashkësisë ndaj Lëvizjes i vjen sidomos kur të kihet parasysh fakti se Lëvizja u ngritë lart duke pasur në themelet e saj edhe gjakun e freskët të tre heronjve që ranë afër Shtutgartit.

Bashkësia me këtë punë, me koordinim të aktivitetit, ka për qëllim që në kushtet e ashpërsimit të krizës t'i ndihmojë mërgimtarët tanë në mundësitë e veta që problemet e tyre që po u shtohen dita ditës, t'i përballojnë më lehtë.

Bashkësia është e vetëdijshme për situatën e rëndë të popullit të Kosovës dhe këtë situatë ajo e vlerëson si të jashtëzakonshme, situatë që u afrohet kushteve të luftës, andaj ajo me ndihmën e mërgimtarëve do të ndërmarrë hapa të atillë që i kalojnë kufijtë e aktivitetit të Bashkësisë në kushte normale. Kjo do të thotë pos të tjerash se Bashkësia, pjesën më të goditur të popullit të Kosovës për aq sa i lejojnë mundësitë, do ta ndihmojë edhe materialisht.

Xhafer Durmishi, Gusht 1983, Saarlouis

(Marrë nga libri: Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 226-228

STATUT I BASHKËSISË SË KLUBEVE

Statut i Bashkësisë së klubeve të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia përkohësisht në Mërgim

1. Përfaqësuesit e klubeve dhe shoqërive propozuan që koordinimi i punës së tyre të bëhet përmes organizimit të tillë që u vendos të quhet "Bashkësia e klubeve të punëtorëve shqiptarë përkohësisht në mërgim".

2. Bashkësia e formua me qëllim që t'i jap shtytje aktivitetit dhe mbarëvajtjes së klubeve, ta koordinoj punën e tyre dhe të organizoj ndihmën e tyre reciproke e cila është e domosdoshme. Ajo punën e vet do ta orientojë edhe në atë drejtim që rrethet e ndryshme të aktivizuara t'i organizoj në nivel të klubeve.

3. Klubet dhe rrethet e ndryshme në Bashkësi dërgojnë nga një delegat. Me rastin e thirrjes së tubimit të Bashkësisë, nëse delegati i ndonjë klubi apo shoqërie nuk ka mundësi të shkoj në atë tubim, çështja zgjidhet në atë mënyrë që klubi në fjalë dërgon për atë tubim një tjetër të deleguar vetëm për atë rast, i cili zgjidhet me pëlqimin e udhëheqësisë së klubit dhe të delegatëve të tij.

4. Bashkësia do të koordinoj të gjitha aktivitetet e lira në nivel të bashkësive të klubeve. Kjo do të realizohet përmes organit më të lartë të bashkësisë, i cili quhet Këshilli Drejtues i Punës (KDP) i cili përbëhet prej tre gjer në pesë veta.

a) Këshilli Drejtues i Punës (KDP) në përbërjen e vet ka Kryetarin, nën Kryetarin, Sekretarin dhe Arkatarin.

b) KDP ka edhe ndihmësat e vet që u vendos të quhet "Këshilltarë" të cilët janë nga një nëpër vende të ndryshme në mërgim.

c) Përfaqësimi i vendeve të tjera që ende nuk janë të përfaqësuara me Këshilltarë pranë KDP-së do të bëhet në të ardhmen në raport me aktivitetin që do të organizohet nëpër ato vende.

d) Tubimet e rregullta KDP së bashku me Këshilltarët do t'i mbaj në ***çdo tre muaj,*** *ndërsa tubimet me të gjithë Këshilltarët e delegatët e të gjitha klubeve një herë në vit.*

e) KDP në raste të nevojshme mund të thërras tubim të jashtëzakonshëm të Bashkësisë.

5. Të punoj për grumbullimin e shënimeve për inventarin e të gjitha klubeve.

6. Të punoj për grumbullimin e shënimeve dhe të shpeshtoj kontaktet:

a) me të gjithë punëtorët social dhe përkthyesit e ndryshëm,

b) me përfaqësues aktivistë të sindikatave të vendit dhe me aktivist tjerë vendas që merren me problemet e të huajve, të cilët do të mund t'u vinin në ndihmë punëtorëve tanë.

7. Lidhur me çështjet materiale, Bashkësia do të përpunoj një politikë të atillë që përveç nivelizimeve dhe ndihmave për iniciativa do të ketë orientime të qarta lidhur me detyrimet e veta ndaj popullit të Kosovës. Bashkësia materialisht do të ndihmohet nga të gjitha klubet duke u mbështetur e secilit klub dhe rreth.

Ky Statut u parashtrua nga **Xhafer Durmish**i dhe u aprovua në mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve më 16 tetor 1983 në Gjenevë.
(Marrë nga libri: Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 280-281)

2. Faridin Tafallari: "*Thirrje për mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve*

"Këshilli Drejtues i Punës i Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim
Thërret

Mbledhjen e vetë të parë të zakonshme, më 14 janar 1984, me ketë rend të ditës:

1. Përpilimi i planit të punës njëvjeçare të Bashkësisë së klubeve shqiptare në mërgim;

2. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në Shtutgart, më 14 janar 1984 dhe do të filloj në ora 15.00.
Vendtakimi është në stacionin e autobusëve të Shtutgartit në ora 14.30."

3. Ibrahim Kelmendi: Pjesë nga Letra kryesisë së Lëvizjes për Republikë

"*PËR REPUBLIKËN SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI!*

Në mërgim..., më 19 mars 1984

...Tani jemi në prag të 3-Vjetorit të demonstratave të përgjakshme të Kosovës. Besoj se pos një kryeartikulli që duhet të botohet në ZK, do të duhej të organizohen aktivitete.

Sa për demonstratë, pasi nuk ka ndonjë aktivitet ndërkombëtar, përkatësisht ndonjë tubim ndërkombëtar, nuk do më dukej e domosdoshme të thirret ndonjë dasmë. Sikur të kishim biseduar dhe përgatitur teren, marr parasysh "disponimin" momental të opinionit austriak, shumë do të kishte qenë mirë të thërrisnim një dasmë atje. Por, po e patë të arsyeshme, nuk do të duhej ta qesim në harresë ndonjë dasmë, ose t'i koncentrojmë forcat, që në mënyrë më të përgatitur se herat tjera, të dalim në demonstratë, masovikisht, për 1 Majin, bashkë me proletariatin e vendit.

Klubi ED (Emin Duraku-shën i Xh. D.) ka vendosur bashkë me 6-Vjetorin (si pretekst maskues) ta shënon 3-Vjetorin e Demonstratave në Kosovë, me karakter të gjerë.

Çfarë mendoni edhe ju?

Pranoni përshëndetje revolucionare, Shoku"

4. Letër e Xhafer Durmishit delegatëve të Bashkësisë së Klubeve

Të dashur shokë, delegatë pranë Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim, *mars 1984*

Në bazë të vendimit të aktivistëve më të dalluar të klubeve të ndryshme shqiptare në Evropën Perëndimore, që u bë në një tubim më 9 korrik 1983, mbi formimin e Bashkësisë së klubeve, kjo Bashkësi thirri mbledhjen e vetë të parë më 16 tetor 1983 në Gjenevë, në të cilën pos të tjerash u aprovua Statuti i Bashkësisë dhe një Rezolutë me anë të së cilës klubet marrin përgjegjësi që për organin udhëheqës të Bashkësisë (Këshillin Drejtues të Punës KDP) të përgatisin raporte mbi aktivitetin e tyre.

Puna në këtë drejtim filloi. Disa klube në këtë drejtim u dalluan më shumë se të tjerat. Disa shokë janë përpjekur në çdo rast që iu është dhënë mundësia të japin sugjerimet e tyre lidhur me atë se në çfarë binarësh të orientojmë aktivitetin nëpër klubet megjithëse Bashkësia filloi nga puna duke pasur në gjirin e vetë një heterogjenitet sipërfaqësor, por jo edhe të parëndësishëm në çështje praktike. Bashkësia me disa aktivitete të saj është përpjekur sidomos t'ia ndalë hovin veprimeve spontane nëpër klube.

Siç jeni në korrent në bazë të letrave, mbledhja e dytë e Bashkësisë së Klubeve ka qenë e planifikuar për datën 14 prill 1984, por me që ra kjo mbrëmje (e 7 prillit) u pa e arsyeshme që ta shfrytëzojmë këtë rast për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve në këtë vit.

Ne besojmë se ju aktivistë të klubeve keni pasur kohë të mendoni dhe vendosni për ato çështje që doni të shtroni në këtë mbledhje. Në këtë mbledhje do të diskutojmë e marrim qëndrime për;

- organizimin e festës së 1 Majit,

- planifikimin e pikave, në të cilat mendojmë të hapim klube të reja gjatë këtij viti,

- angazhimin e disa shokëve për marrjen e kontakteve dhe informatave nga organizata të ndryshme për çështje të emigrantëve, kontakte këto që do të na nevojiten për shokët të cilëve nuk do t'ju vazhdohet viza nga konsullatat jugosllave dhe për çështje tjera që tani janë të njohura në praktikën e punën tonë.

Në këtë takim do të ishte me rëndësi që të sillni me vete edhe Statutet e Klubeve. Kjo shtrohet e rëndësishme pasi Bashkësisë i kanë ardhur vërejtje se një klub në Statutin e tij e paska një nen të atillë në të cilin po u thoka se për t'u bërë anëtarë duhet të shkruar një lutje me shkrim.

Aktualisht udhëheqësitë e klubeve duhet ta ruajnë unitetin e tyre.

Një aktivist i Bashkësisë (Xhafer Durmishi-Skenderi)

5. Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve

Këshilli Drejtues i Punës i Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim (KDPBKSHM)

Thërret

*Mbledhjen e vetë të dytë të zakonshme më **8 PRILL 1984**, me ketë rend të ditës:*

1. Analizë e punës së gjertanishme të Bashkësisë së klubeve shqiptare në mërgim;

2. Detyra në të ardhmen e BKSHM

3. Të ndryshme

Mbledhja do të mbahet në Düsseldorf më 8 prill 1984 dhe do të filloj në ora 10.00.

P.S. Të dashur shok, delegat të Bashkësisë së klubeve shqiptare në mërgim, KDPBKSHM, bëri këtë ndryshim të datës nga 14 prilli 1984 në 8 prill 1984 për arsye të një tubimi të përgjithshëm në Düsseldorf që do të mbahet më 7 prill 1984. Prandaj për të shfrytëzuar këtë rast bëri këtë ndryshim të datës me një javë më par.

Vendtakimi do të jetë në klubin "E. Duraku" në Düsseldorf.

Përshëndetje Revolucionare

BKSHM Nënshkrim i Faridin Tafallarit

6. Raport i komisionit të mbrëmjes së 7 prillit 1984

Pas përfundimit të mbrëmjes, më 8 prill 1984, u tubuan anëtarët e komisionit të caktuar për udhëheqjen e kësaj mbrëmjeje e në mungesë të Xhavit Ramabajës nxorën këto

Vlerësime

Para fillimit të mbrëmjes, u caktua komisioni prej pesë vetave, nga ana e shokëve me sa vijon:

1. Zymber Kryeziu *2. Qamil Rexhepi*
3. Faridin Tafallari *4. Hyzri Rekaj*
5. "Skenderi" (Xh.D.) *6. Malush Ademaj*
7. Ganiu (Milaim Zeka) *8. Hafiz Gagica*
9. Fazli Mema *10.Ibrahim Kelmendi*
11.Mejdi Rexhaj *12.Shaban Bobaj*
13.Muhamet Kelmendi *14.Xhavit Ramabaja*

Nga këta shokë u zgjodh ky komision në mënyrë unanime:

1. Faridin Tafallari *2. Muhamet Kelmendi*
3. Xhavit Ramabaja *4. Zymber Kryeziu*
5. Hyzri Rekaj

Para se të zgjidhet komisioni, lindën disa grindje nga Ganiu (Milaim Zeka) dhe Ibrahimi, me përmbajtje të Ganiut nga Xhaviti dhe Fazliu, i cili tha se Ibrahimi ta ngjet për koqe (na falni në shprehje). Njëherit Ganiu tha se, kur kam qenë unë në Lëvizje, ti (Ibrahim) ke qenë duke u shëtitur nëpër bare, kafe të degjeneruara në Perëndim. E gjithë kjo u arrit, kur Ibrahimi i tha se duhet ti nënshtroheni disiplinës së LRSHJ-së, por me këtë rast Ganiu iu përgjigj se unë i përmbahem Zërit të popullit të Kosovës.

Përkundër të gjitha mosmarrëveshjeve, të gjithë shokët vendosën unanimisht për komisionin e lartpërmendur të mbrëmjes dhe për të cilët Skenderi ka dhënë propozim i pari, me të cilët u pajtuam të gjithë. Shokët e komisionit e morën vendin e caktuar për udhëheqjen e mbrëmjes festive dhe për të cilën u pajtuan që asnjëri mos të ndërhyj në

punët e tij. Komisioni filloi punën, me ç'rast filluan të vijnë referatet nga rrethet e ndryshme për t'i shqyrtuar dhe analizuar, se a janë për këtë mbrëmje të organizuar nga LRSHJ-a.

Duke u nisur nga fakti se këtë mbrëmje e organizon LRSHJ-a, nga komisioni u pa e arsyeshme të lexohet vetëm referati i Lëvizjes, për arsye që të mos lexohen shumë referate tjera. Në ndërkohë erdhi Skenderi me një referat në dorë dhe ia paraqiti komisionit të lexohet referati i Ganiut, ndërsa referatin e vetë për të cilin tha se kam punuar dy net po e heqi. Në mënyrë vëllazërore duke e sqaruar se ky komision vendosi të lexohet vetëm një referat, me ç'rast ai na u drejtua me fjalët; cili referat? Aty ishte Ibrahimi, na e kishte dorëzuar referatin prej 22 faqesh, në të cilin ishin të përfshira të gjitha ngjarjet brenda këtyre tri viteve në pika të shkurta. Dhe komisioni pat vendos që ky referat të lexohet, pasi t'i hiqen disa pjesë për të lehtësuar mbrëmjen, sepse kishim pika të shumta të përgatitura nga të gjitha rrethet.

Në këtë rast Skënderi me këmbëngulje dhe në mënyrë brutale ndërhyri në punën e komisionit, duke ia imponuar referatin e Ganiut si të domosdoshëm për t'u lexuar, pa marrë parasysh natyrën e referatit, i cili sipas tij ka disa (shumë) pika kontraverze. Njëherit ai na u kërcënua se pa marrë parasysh se a do të lejoni apo jo, ai ka për t'u lexuar. Komisioni duke u bazuar në kërcënimet e Skenderit nga ana e të cilit u acarua gjendja e muar në shqyrtim referatin dhe pas analizës vendosi njëzëri që të mos lexohet. Referati ishte i ngarkuar me sharje, ofendime, kërcënime dhe demaskime të disa shokëve, e në të cilin përdhosej LRSHJ-a. Referati kishte tri faqe, me ç'rast komisioni pjesën e dytë të faqes së tretë e nënvizoi me laps të thjesht si të dëmshme me dalë para masës. Pavarësisht nga kokëçarjet që kishte komisioni u sulmua nga Skenderi dhe Ganiu, e kohë pas kohe edhe nga Fazliu.

Mbrëmja filloi dhe për masën çdo gjë ishte në rregull. Meqenëse këta persona bënin shantazhe e kërcënime, komisioni vendosi që referati të lexohet nga shoqja prej Suedie, e cila edhe e udhëhoqi programin. Masa e entuziazmuar përcillte me kënaqësi dhe respekt programin dhe me duartrokitje frenetike e përshëndeti referatin kryesor. Por gjatë kësaj kohe nga masa nuk u diktuan kërcënimet e shantazhet e këtyre personave sepse ne tentonim me çdo kusht që të mos vjen gjer tek konflikti. Pas një kohe me kërcënime filloi programi me këngë e recitime dhe me pika tjera të përgatitura.

Meqenëse Xhaviti propozoi që në fillim të dal Ganiu dhe Fazliu me pikat e paraqitura, komisioni pas dy tri pikave vendosi të dalin me pikat e tyre. Por me këtë rast Xhaviti i shkeli qëndrimet e komisionit dhe tha që ta lejojmë ta merr fjalën Ganiu, sepse ai ka vendosë me dalë pa lejen e komisionit. Pasi e cekëm edhe më lartë se kishim shumë pika të përgatitura dhe duke i parë tendencat e tyre për të prishur mbrëmjen, komisioni qëndroi në vazhdimin e programit, sipas rendit të parashikuar.

Në këtë rast, ne biseduam me Ganiun në mënyrë vëllazërore, si gjatë tërë kohës ai erdhi në pajtim për nder të masës dhe bacit Faridin (të cilit ai i deklaroi) të mos dali në binë (skenë). Mirëpo në atë moment erdhi Skenderi në binë dhe i tha Ganiut ti ke me dalë dhe me i folur të gjitha ato çka i ke shkruar në referat pasi ti ato i din përmendësh. Kurse ne komisioni duke parë se mbrëmja po përfundon mirë e lutëm Skenderin që kjo mbrëmje të përfundoj ashtu siç ka vazhduar më parë. Mirëpo Skenderi në mënyrë brutale i hyri në frymë komisionit, duke i mëshuar me grushta tavolinës dhe me za të lartë tha kush jeni ju. Ju jeni një klikë e poshtër dhe unë nuk ju njoh për komision, të cilin unë (Skenderi) e hudhi në pleh. Përsëri vazhdoi duke thënë se Ganiun Enver Hoxha e ka propaganduar dy muaj në ekranin e RT Shqiptarë.

Në ndërkohë Haxhi Krasniqi ia muar shoqes që e udhëheqte programin dhe e kapi për krahu Ganiun dhe e qiti në binë, ku ai ia filloi pallavrave të tija. Në atë moment hypën në binë të tjerët dhe aty u bë një tollovi, kurse komisioni duke e mbrojtur mbrëmjen me tërë fuqinë që kishte, bile edhe më shumë lutje që bina (skena) të jetë e mbyllur me perde, për të mos parë masa se çka po ndodhë në skenë. Në atë kohë, njerëzit e përgatitur së shpejti hypën në binë me armë dhe ia filluan sulmeve të tyre me thika dhe revole. Përkundër asaj që ne u munduam të qetësojmë, në pamundësi kaluam në mbrojtje për të mos u derdhur gjaku ndërsa në atë rast Musa Daka i therri dy shokë, Haxhi Begën dhe Sylë Nuhën, të cilët gjenden të shtrirë në spital. Dhe gjithë kjo krijoi në masë një gjendje të ndjerë dhe aspak të kënaqur.

Komisioni nënshkruan me emër e mbiemër duke ia dhënë nga në kopje çdo anëtari dhe redaksisë ia dërgoi një kopje për masat e mëtutjeshme.
Anëtarët e komisionit:

1. Faridin Tafallari *2. Hyzri Rekaj*
3. Muhamet Kelmendi *4. Zymber Kryeziu*

Më në fund komisioni propozon:

Për të mos ardhur deri tek dezinformimi i masës, mendojmë që nëpër rrethe: Skenderi, Xhaviti, Ganiu, Fazliu, Musa, Haxhiu të paraqiten si shkaktarët kryesor të eksesit të mbrëmjes. Kurse për qëndrime definitive, iu la LRSHJ-së, duke i propozuar të formohet komision i posaçëm ose të merret ky material për bazë, i cili u përpilua nga komisioni i mbrëmjes së trevjetorit.

Ju lutemi që urgjentisht t'i analizoni këto dhe të merrni masa urgjente.
Komisioni i mbrëmjes.

Unë (Faridin Tafallari) mendoj dhe jam për atë që ky procesverbal të botohet pasi që është një dëshmi e një ngjarje të rëndësishme të (trishtuar) dhe nuk ka asgjë që mund ta ndryshoi. Nuk përjashtohet se aty kanë luajt role edhe të tjerë por rolet që i kanë zbatuar ndoshta edhe të të tjerëve që kanë qen anash... Pra janë këta dhe ky rast duhet të ndriçohet medoemos. (Marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 359-361)

7. Letër e Bacalokut (Xh. Shatrit) dërguar shokëve të Shtutgartit

Të dashur shokë,
mbrëmë bisedova me Faridinin dhe më tregoi për dëshpërimin tuaj në Dyseldorf. Më besoni se edhe unë kam qenë në lëkurën tuaj, por mërgimi qenka shumë i rëndë. Këtu nuk paska fjala peshë. Të shtunën unë kam biseduar me një shok në Dyseldorf. Kishte fjalë të mira. Pastaj bisedova edhe me Plakun dhe ai foli me të plagosurit. Edhe ata e sidomos Syla patën fjalë të mira. Duke u nisur nga kjo e pash të arsyeshme që t'u shtrihet shokëve sa më parë dora e pajtimit. Ju nga ana juaj e keni bërë tuajën, pse dikujt nuk i ka konvenuar kjo është tjetër çështje. Dhe nesër po që se ndodhë diçka dihet se kujt do t'i mbetet përgjegjësia. Kujt iu kujtuar që në këtë çështje ta përziej Lëvizjen si dhe të gjithë atyre që duan të bëjnë shesh për përshesh në këtë situatë kaq të rëndë do t'ua bëjmë me dije, me punën dhe përpjekjet tona të përditshme se i kanë bërë hesapet pa hanxhiun. Prandaj mos u dëshproni, me Musain mbani kontakt parreshtur dhe pos jush mos të kërkoj ai as mësues e as shokë tjerë, sepse do ta qesin në pozitë edhe më të keqe. Thuani le ta ruaj gjakftohtësinë dhe të mos flas me askend tjetër pos me juve për këtë çështje. Herëdokur të vie pajtimi, në mes fjalësh nuk mund të jetë dikush tjetër pos jush. Mu për këtë, prandaj mbajeni Musain afër, këshillojeni, sepse ata që e kanë

penguar pajtimin, të jini të sigurtë nuk do t'u dalë e tyrja, sepse jo vetëm juve, por edhe neve na kanë pre në besë.

Armiku memzi po pret të fus pyka në këtë mjegull që e kanë krijuar ata që janë ushqyer me bukën e punëtorëve tanë zemërbardhë e duarplasaritur, prandaj si këta të parët që e kanë nxitur këtë kasaphanë, si këta të dytët që nuk lejojnë të shtrihet dora e pajtimit mes vëllezërish, do të pësojnë disfatë të turpshme para vullnetit të shokëve që kanë lënë shtëpi e familje, dhe janë në gjendje ta lënë edhe kokën për lirinë e popullit.

Prandaj mos u mërzitni, me ata shokë që i keni përreth rrini më shpesh, konsultohuni në mes veti, kijeni parasysh se e tërë kjo mjegull nuk është bërë për tjetër veçse ndonjë hesap i Serbisë t'i ngul dhëmbët në gjak shqiptari. Qoftë edhe një hap apo ndërmarrje të vetme mos e bëni pa u konsultuar me shokët e atyshëm, sidomos me Hafizin, me Musën (të riun) etj. Ta keni parasysh se ne, kështu siç jemi, që të gjithë jemi me ju, sepse keni shkuar në Dyseldorf me qëllimet më të pastra e më fisnike.

Në këtë situatë më shumë s'po mund të bëjë, veçse përmes kësaj letre t'ju përshëndes përzemërsisht.

Të fala shokëve, Bacës Selim, Lutanit, Ismetit dhe të gjithë shokëve tjerë.

Zvicër 1 Maj 1984 B.cl (B. cl është shkurtesë për Bacalokun, emër apo titull i përdorur nga Xhafer Shatri)

8. Letër e Xhafer Shatrit dërguar Ibrahim Kelmendit

"Me asnjë kusht nuk do t'i shkruaja këta rreshta, sepse më me dëshirë do të takohesha me ty dhe do të bisedonim gjerësisht, sepse e tërë ajo që dua të them, as përciptazi nuk mund të përfshihet në një letër. Por mbrëmë bisedova me Faridinin, me shokun tonë të mirë, dhe dëshpërimi i këtyre njerëzve të ndershëm që kanë udhëtuar më shumë se 1000 km për ta bërë mirë dhe sjellja jote arrogante ndaj përpjekjeve të tyre po më detyrojnë të them troç: Ti je i papërmirësueshëm. Ti përgjithmonë ke mbetur mbreti i rrugëve, i mospërgjegjësisë dhe i thashethemeve.

Së pari nuk denjove të shkruash për ngjarjen si ka ndodhur në tërësi, por një letër plot panik "me shyqyr që mbeta gjallë." Për atë që është në dijeni të gjërave më mirë ka qenë që ti të mbetesh aty, bile do të qanim... E unë e di mirë se nëse Skënderi është fajtori kryesor që i nxiti punëtorët tanë t'ia fusin thikat njëri-tjetrit, atëherë ti je ai që me tërë forcën tënde ke kontribuar të krijohen kushtet për një atmosferë të tillë. Ti vetë më ke gënjyer në pyetjen time se a ke biseduar me Faridinin lidhur me mbrëmjen e 7 prillit dhe më ke thënë po, e kjo nuk kishte qenë e vërtetë. Madje jo vetëm kaq, por ke shkuar aq larg, sa agjutanti yt, Muhameti, të cilin me çdo kusht po përpiqesh ta mbash nën hijen tënde të mjerë, ka thënë Lëvizja është ku janë masat. E ajo s'ka qenë e vërtetë, sepse Lëvizjen aty e keni përfaqësue ti dhe Faridini e jo masa. Ashtu siç më ke thënë ti, duke të besuar, se njeriu dreqi e marrtë duhet t'u besoj njerëzve, unë e shkrova traktin. Dhe në atë e kam përmendur, sipas asaj që më the edhe 5 vjetorin e themelimit të Klubit. Sepse sipas teje "s'është dashur të rrezikohet Muhameti në Bohum." Merre me mend ti interesat e një njeriu i vë mbi interesat e 200 e sa të tjerëve. Po kush është Muhameti të rrezikohet? Po atëherë pse ka dalë këndej? Si është e mundur të përmendësh gjëra të tilla? I lëmë këto. Pastaj si ke guxuar ti t'i telefonosh Mujës që ta dërgoj telegramin për ta përflliqur traktin që ishte shpërnda anë e kënd Evropës? Me çfarë të drejte manipulimet e tua të ulëta prej një mediokri prepotent përpiqesh në sy të 600 njerëzve, të m'i hedhësh mua (sepse njerëzit e dinë se prej ku është dërguar trakti)? Pse nuk telefonoje te Plaku apo te unë dhe të na thuash neve, që kemi qenë parreshtur

në banesa, por e ke gjetur Mujin, po ashtu shokun tonë të mirë dhe ke manipuluar me të.

Jo vetëm kaq, por siç del edhe nga procesverbali i BK, ti i ke thënë Musa Dakës "myzevir" që pa nisur kjo punë, sepse për fjalë ti zakonisht je i zoti, prandaj, mos u mbaro si Pilati para askujt, bile jo para atyre që e dinë punën fare mirë. Unë Musain nuk e shoh si vëllavrasës, ai është një viktimë, së paku nga kjo perspektivë, e sharlatanizmit tënd, pafytyrsisë së Skenderit dhe karrierizmit të Milaimit. Dhe kur ne në pamundësi të kontaktojmë me ty, i çuam disa shokë shumë qëllim mirë, që t'i vënë kapak kësaj pune, që të mos lejojnë më gjakderdhje, që të mos lejojnë të fusë armiku pyka, sepse ti nuk je aq budalla të mos e dish kush dhe pse po shpërndanë trakte, në të cilat të përziejnë edhe ty. Dhe vijnë njerëzit atje e ti je aq i pacip, sa që një Sylë e Haxhi që të mbrojtën me trupin e tyre, dëshiron t'i bësh lodra të kapitalit tënd të mjerë politik. Po të m'i kishe dërguar gabelët e Pejës për një pajtesë unë nuk do t'i ktheja prapa. Ti me çdo kusht ke dashur të përziesh Lëvizjen dhe përmes petkut të saj të akuzosh kundërshtarë të ndryshëm. Njeriu nuk guxon të hipën mbi popullin e vet për t'u dukur më i madh as më i pastër. Dhe i kthen njerëzit, shokët tanë të mirë, pa kryer asgjë, bile edhe i keqpërdor. Për tërë këtë përgjegjësia bien mbi ty.

Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna, e të mos e dish se në këtë çështje nuk guxon të përzihet çështja - lufta. Në këso situatash i duhet vënë kapak punës, sepse do ta shpëtoje edhe Musain nga kthetrat e merimangave të tipit të Skenderit, sepse në emër të tij nuk kanë ardhur rrugaçë, por njerëz, të cilëve Musa Daka nuk do të guxojë t'i luaj kurrë. Sepse që të gjithë ata janë njerëz të familjeve të ndershme që nuk luajnë me dikë, por as që lejojnë dikend të luaj me ta. Ata kanë ardhur nga qëllimet e pastra, ata janë konsultuar me ne. Plaku ka biseduar me shokët e plagosur, që të dy kanë treguar gatishmëri për ta bërë mirë. Por ti, që këso rastesh i pret si shkretira shiun apo si bora, ke shkuar aty dhe si njeriu i Lëvizjes ke dashur të bësh gjyq e ligj. Ti ke pasur rastin të tregohesh burrë, t'i shtish njerëzit të pajtohen dhe ta vrasësh një zagar të fëlliqur siç është Skenderi, me pjekurinë tënde, por edhe këtë rast e ke shfrytëzuar të tregosh se je kampion absolut i mospërgjegjësisë dhe meskinitetit.

Nuk po dua të çaj dërrasa më me ty, por po dua të përfundoj: Nëse atyre njerëzve sot apo nesër u ndodh diçka, nëse ata njerëz ndërrojnë në mes veti qoftë edhe një fjalë të keqe, apo po që se këtë atmosferë të rëndë e shfrytëzon armiku në çfarëdo aspekti qoftë, dije mirë se faji të a mbetur ty dhe poashtu dije mirë se unë do të kujdesem që t'i njoftoj njerëzit për atë se kush është shkaktari kryesor.

Nëse vjen gjer te pajtimi, në mes fjalësh nuk guxon të ketë njeri tjetër, pos atyre që kanë qenë gjer aty, sepse fjalëve të tyre Musa Daka nuk mund t'u luaj kurrën e kurrës.

Letra mos më shkruaj dhe ki kujdes e të mos ndodhë më kurrë që të përdorësh letrat me stemën e Lëvizjes për t'u treguar njerëzve "kompetencat" e tua. Janë disa raste që i di mirë, që ti i ke keqpërdorë këto letra.

Edhe sa për të më shkruar mos u lodh, sepse pas kësaj unë kurrë s'do t'u besoj fjalëve të tua Xh. (Xhafer Shatri)

(Marrë nga Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 417-419)

9. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet

I. Kelmendi: "*Më 7 prill organizohet tubim i madh në Düsseldorf. **Sejmenët** e Sabitit dhe të **Xhafarit**, ndër të cilët Xhahili**, M.Z.**, M.D., Baca Zymri, e Faziti provokojnë*

gjakderdhje, të bindur se do t'i japin goditjen e fundit Miranit dhe bashkëveprimtarëve të tij. M.D., godet me thikë prapa shpine Suliot Nelajn, kur ai ishte angazhuar të qetësonte zënkat që po ndodhnin në skenë, prapa perde ***për të dalë në mikrofon ose jo M. Z.*** *Sapo Sulioti merr goditjen e rëndë, shkon qetësisht deri te Mirani që gjendej në fund të sallës."* (Atentatet, f. 459)

10. Xhafer Shatri: Letër Qendrës Ekzekutive

Xhafer Shatri: "*...një rast tjetër edhe më flagrant me rastin e shfaqjes së koncertit në Dyseldorf. Shkon Engjëlli (Kolaneci, diplomat shqiptar në Vjenë-shën i Xh. D.) dhe i merr Xhavitin, Hyzriun dhe Fazliun e u thotë: ku është Lëvizja, keni kujdes se aty është udba, mos u mashtroni, hapni sytë dhe kështu në këtë kuptim...diçka e pabesueshme dhe ata burrat e botës asnjëri se kanë njoftuar shokun me të cilin kanë kontakt (Xhafer Durmishin-shën ynë).''* (Letër Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

11. Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet

I. Kelmendi: *"Fundjavës vijuese Lëvizja organizoi demonstratë në Bernë. Pas demonstrate u bë edhe mbledhja e QE-së. Në demonstratë dhe në mbledhje nuk morën pjesë Sadriu, Xhafari dhe sejmenët e tyre. Në vend që të merrte pjesë në demonstratë dhe mbledhje, Xhafari shkroi një letër* ***publike*** *prej* ***12 faqesh*** *dhe ua drejtoi shokëve të Stuttgaritit me rrethinë."* (Atentatet, f. 461)

12. Pjesë nga letra e mbyllur e Xhafer Durmishit dërguar shokëve të Shtutgartit

"Shokëve të Shtutgartit e me rrethinë, 14 maj 1984

... Kah gjysma e muajit shkurt 1983, makina (e shkrimit) u dërgua në Zvicër. Meqë ata që e kishin marrë përsipër nuk kishin haber nga puna me te, dhe me radhitjen (punën grafike) në përgjithësi në fillim të muajit mars shkova në Zvicër, ku e kalova kufirin me Faridinin (me pasaportë të H.R.) i cili më la në Basel. Në Gjenevë më priti Uka në Stacion. Tek ai qëndrova gjer më 13 mars 1983 kur u bë edhe mbledhja e parë e QE në përbërje të plotë. Por para se të takohemi të gjithë së bashku, u takuam në banesën e Ukës; Unë, Faridini, Plaku (Hasan Mala) dhe Uka ku biseduam për shumë çështje në mes të cilave më e rëndësishme qe puna e arkatarit. Faridini i dorëzoi Ukës një regjistër mbi shënimet e plota lidhur me të gjitha shpenzimet duke u nisur prej asaj dite që e ka marrë punën e çështjeve materiale nga Nuhiu e gjer në atë ditë. Plaku dhe Uka as përafërsisht nuk qenë në gjendje të bëjnë ndonjë shpjegim të saktë lidhur me shpenzimet e ndryshme, e të mos flasim për të hollat të cilat janë mbledhur në konton ''Ndihma për Kosovën''. Sa kanë qenë gjallë shokët ka pasur një marrëveshje (gojore) të precizuar në këtë çështje se ato do të jenë të përbashkëta, respektivisht do të ndahen në mënyrë të barabartë, pasi të dy palët kanë pasur njerëz të burgosur në Kosovë.

Biseduam edhe në lidhje me Ibrahimin, me të cilin unë gjithmonë i kam pas kartat e hapura dhe çka i kam thënë ia kam thënë gjithmonë parasysh, kurse Uka e ka quajtur

shok para syve, ia ka dhënë megafonin në demonstrata dhe gojë më gojë me te (nga i njëjti megafon) kanë brohoritur parulla të ndryshme, si herën e fundit në Gjenevë, kurse prapa shpine nuk ka lënë gjë të zezë pa thënë kundër tij. Këtë e dëshmojnë disa letra. Këtë e dëshmon edhe sjellja e tij në atë mbrëmje, kur ende pa u takuar me Ibrahimin, thoshte se këtë punë (afrimin e tij në QE pra) e kam bërë me dy mendje, dhe se për gabimin e tij të parë do ta bëjmë "fuz". Këtë fjalën "fuz" e përsëriti disa herë para se të takoheshim.

Gjatë takimit unë e kritikova për disa çështje Ibrahimin, sidomos për disa pika që kishin të bënin me klubet. Si duket ai toni im i kritikës dhe mënyra ime e argumentimit e frikësoi Ukën se mos ndonjë ditë do të ndodhet vetëm para meje, kështuqë për të ruajtur vehten e për të mbajtur ekuilibrin, në fund të mbledhjes tha se me Ibrahimin duhet të sillemi më mirë, të jemi më korrekt se ka punuar shumë. Gjatë qëndrimit tim prej më tepër se 10 ditë në banesë të Ukës patëm rastin të këmbejmë mendime për shumë çështje. Tek ai (në adresën e gazetës) kishin ardhur disa letra për mua që nuk m'i kishte dërguar. Duke e parë se që në fillim ra në sy një atmosferë joshoqërore më tha: " Mua jeta më ka mësuar që të mos i besoj askujt." Në ato ditë punuam për "ZiK" nr.2 të vitit 1983. Në atë tubim unë lexova të vetmin material që ishte përgatitur në atë mbledhje, në mënyrë më të qartë e që kishte të bënte me punën e aktivitetin që do ta zhvillojmë në mërgim. Sa u përket klubeve unë shpreha disa ide si këto:

- se ne që kemi rënë më shumë në sy me aktivitete të mos dukemi fare nëpër klube,

- t'u sugjerojmë bashkatdhetarëve të shkojnë në të gjitha klubet pa marrë parasysh se kush është në udhëheqjen e tyre,

- që në aktivitetin tonë të orientohemi për të hapur sa më shumë klube, por pasi në to mund të hyj kush të dojë të respektohen rigorozisht simbolet e RSFJ dhe të ndiqet një politikë e tillë që të mos rrezikojmë punëtorë.

Të gjitha këto pikëpamje të miat u aprovuan, me përjashtim të pikës që ne të rënët në sy, të mos dukemi nëpër klube. Këtë pikë e kundërshtuan Uka (Xhafer Shatri) e Ibrahimi." (Letër e mbyllur 5-6 shokëve më të afërt në Shtutgart në 12 faqe A4, faqe 3-4)

13. Xhafer Durmishi: Tubimi i 7 prillit 1984 në Düsseldorf

Kurrë në jetën e tyre e as në prill të vitit 1984, Xhavit Ramabaja, Milaim Zeka e Musa Dakaj nga Korisha, Zymer Kryeziu, Fazli Memaj nga Korisha nuk kanë qenë sejmen të Skenderit të Shtutgartit.

Për datën 7 prill 1984, Ibrahim Kelmendi mori iniciativën për organizimin e një mbrëmje në Düsseldorf, si shënim i përvjetorit të demonstratave në Kosovë, por që formalisht do të paraqitej para publikut si tubim për shënimin e një përvjetori të klubit Emin Duraku. Këtu kemi pra taktikën e tij të kundërt me timen, luftën për implikimin e përzierjen sa më të madhe të klubit me Lëvizjen dhe organizimet politike. Unë, nga Parisi, kontaktova me Faridinin dhe e shkruam thirrjen për Këshillin Drejtues të Punës, të Bashkësisë së klubeve, për ditën e nesërme pra për datën 8 prill.

Këtu për lexuesit e këtij punimi po i jap disa shënime plotësuese që m'i ka treguar me kujdes Milaimi disa herë në Suedi. M. Zeka, nga fshati Obri, ishte arratisur së pari në Austri. Pastaj në vjeshtën e vitit 1982 ishte gjetur në mesin e rrethit të ngushtë të Hasan Malës dhe Xhafer Shatrit në Zvicër. Në demonstratën e 10 dhjetorit 1982, në Gjenevë, e cila ka qenë demonstrata më e suksesshme gjer atëherë Milaimi ka qenë ai që më së shumti u ka folë demonstruesve përmes megafonit që ia ka dhënë Xhafer Shatri. Arsyeja e kësaj lidhjeje të ngushtë të Xhafer Shatrit e Hasan Malës me Milaimin ishte se ai e konsideronte veten anëtarë të OMLK-së, dhe se burri i motrës së tij Fatmir Krasniqi

nga fshati Komoran i Komunës së Gllogovcit, në aktakuzën e datës 25 maj 1982 kundër Hydajet Hysenit, Jakup Krasniqit, Mehmet Hajrizit, Berat Luzhës, Azem Sylës, (gjithsejtë 19 veta) ishte i akuzuari me numrin rendor 14 dhe është dënuar me ta. Më heret kam shkrua se si pas demonstratës së Shtutgartit të janarit (1983), Hasan Mala dhe Xhafer Shatri e sjellin Milaimin në Shtutgart (Sindelfingen) për punë minuese dhe për shkatërrimin e ndikimit tim, të Haxhi Berishës e të tjerëve në rrethin e Shtutgartit. Pas një qëndrimi të tij në Sindelfingen, Milaimi gjendet në Düsseldorf, në pranverë 1983. Në prill 1983, Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve e bënë turneun e vetë nëpër Gjermani, turne e cila ishte organizuar nga Engjëll Kolaneci, diplomat në Ambasadën Shqiptare në Vjenë. Pas një koncerti në Gjermaninë veriore, Milaimi e blen një tubë të mirë me lule për Enver Hoxhën dhe ia jep përfaqësuesve të Ansamblit në skenë dhe ky gjest me mjeshtëri propagandistike videofilmohet për t'u shfaqur më vonë në televizionin shqiptar, (dhe nëpër një videokasetë që u shpërnda për shitje, nëpër Evropë), se si i shkojnë karanfilat Enver Hoxhës prej të rinjve kosovarë. Kjo ngjarje e karanfilave nuk është primare në këtë shtjellim, por më interesant janë disa ngjarje që pasojnë. Talentin për propagandë të Milaimit, përveç Xhafer Shatrit e heton edhe Engjëll Kolaneci i cili e organizon shkuarjen e tij në Shqipëri në vjeshtën e vitit 1983. Në Shqipëri, Milaimi qëndron dy-tre muaj ditë, dhe kohën më me rëndësi e kalon me Ajet Haxhiun. Ajeti me qëndrimin dhe përvojën e tij, e përgatitë mirë dhe i jep argumente të bollshme ideore për ta kthyer në luftë kundër Xhafer Shatrit.

> Xhafer Durmishi: *"Në takimin e fundit u diskutua edhe përpilimi i Programit Politik të LRSHJ me rastin e njëvjetorit të formimit. Deri më sot, kur jam duke e shkruar këtë letër, për diçka më shumë në këtë drejtim nuk jam i informuar. Poashtu mendoj që përmes letrash të vendoset se kush do ta bëjë një projektprogram i cili në rrethet e ngushta duhet të lëshohet në diskutim së bashku me projektstatutin. Përndryshe çdo hap tjetër në këtë drejtim është joserioz dhe mund të ketë pasoja të këqija."* (Letër Qendrës Ekzekutive, 4 maj 1983)

Këtë, Ajeti e bënë duke ia analizuar e zbërthyer fjalë për fjalë të gjitha frazat që Xhafer Shatri i kishte shkruar në Zërin e Kosovës, gjatë vitit 1983, e sidomos të njëfarë programi të tij. Ajeti shkon deri në atë masë sa i thotë Milaimit: "Nëqoftëse patjetër do me veprua për Kosovën, dhe ta zëmë se nuk të kanë mbetur shumë mundësi me zgjedhë, atëherë Kosova ka me të llogaritë ma patriotë e ma bir të ndershëm nëse bashkohesh në fund të fundit edhe me UDB-në e LKJ-së revizioniste se sa me Xhafer Shatrin."

Gjatë gjithë kësaj kohe, unë nuk di asgjë për këtë punë, pasi nuk kam pasur mundësi si t'i marrë vesh këto rrjedha. Sidoqoftë, me përkrahjen e diplomatëve shqiptarë e të Ajet Haxhiut, Milaimi gjatë muajve të parë të vitit 1984 është shokë i pandarë me Fazli Memajn nga fshati Korishë afër Prizrenit, dhe këta dy qëndrojnë shumë tek bashkëfshatarët e Fazliut në rrethin e Bilefeldit dhe në Düsseldorf. Në Düsseldorf, apo thënë më saktësisht afër Düsseldorfit, qëndrojnë më së shumti tek Musa Daka, nga Korisha, i cili ka banua në Duisburg. Musa Daka ka qenë aktivist i dalluar në klubin Emin Duraku të Düsseldorfit.

Gjatë vjeshtës 1983 si organizator dhe ideator i Bashkësisë së klubeve shqiptare në Evropë e kam takuar Musa Dakën në shtëpinë e tij në Duisburg. Arsyeja se e kam takuar Musën ka qenë në radhë të parë pasi ai ka qenë aktivist i dalluar. Shkak tjetër ka qenë edhe fakti se përkundër asaj se isha caktuar nga Lëvizja të merresha me klubet, kjo punë në praktik minohej e më bëhej e pamundur nga I. Kelmendi e Xhafer Shatri për

shkak të urrejtjes që kishin ndaj meje qysh nga 15 marsi apo 15 maji i vitit 1982. Por jo vetëm Musën e kam takuar në banesën e tij, pasi në banesat e tyre kam shkuar edhe te shumë aktivist tjerë si në Düsseldorf ashtu edhe në qytete tjera, pasi ideja ime themelore në këtë punë ka qenë që në klube të dukem fizikisht sa më pak apo aspak.

Milaimi ka shkuar vazhdimisht në klub me Musën, dhe në klub me aftësitë dhe memorien e tij, i ka përsëritur vazhdimisht të gjitha argumentet që ia kishte mësuar Ajet Haxhiu në Tiranë, kuptohet se Milaimi nuk i ka thënë të gjitha fjalët deri në fund se çka i ka thënë Ajeti. Gjithashtu Milaimin, sa ka qëndruar tek Musa Daka e kanë vizituar dhe përkrahur diplomatët shqiptarë të Vjenës.

Në këtë situatë e në këto rrethana, pos tjerash, është organizuar mbrëmja e 7 prillit 1984 në Düsseldorf.

Për të marrë pjesë në këtë mbrëmje jam nisur nga Parisi për në Düsseldorf, kur do të takohesha me Faridinin për të diskutuar përgatitjen e mbledhjes për udhëheqjen e Bashkësisë së klubeve. Edhe pse kisha marrë leje qëndrimi në Francë, pasaporta nuk më ishte lëshuar andaj një shok NN në Paris ma ka dhënë një pasaportë të Kosovës, të një kushëriri të tij, i cili kishte emigruar në Kanada e e kishte lënë pasaportën tek ai.

Në mbrëmjen e 7 prillit erdhi një numër i madh bashkatdhetarësh nga Shtutgarti. Unë nuk i njihja mirë rrethanat e krijuara dhe krejtësisht seriozitetin e tehut të propagandës së Milaimit. Rrethanat e asaj mbrëmje në një mënyrë i ka përshkruar Faridin Tafallari në librin "Terror, dhimbje, qëndresë" (1997). Në një formë krejtësisht tjetër i ka përshkruar Ibrahim Kelmendi në librin Atentatet, ku Milaim Zekën dhe Musa Dakën mundohet me i paraqitë si 'sejmen' të mi (Xhafer Durmishit). Në atë mbrëmje qe formuar një komision që do të merrej me atë se kush mundet me dalë në skenë e me folë e kush nuk mundet. Thelbi i këtij hapi ishte që të mos i jipet fjala Milaimit. Unë nuk isha kurrë për atë që me çdo çmim t'i jipet fjala Milaimit. Por kur shumica në komision ishin që kurrsesi të mos i jipet fjala, unë me atë rast e kam përdorë shprehjen *banditizëm*. E pranoj se është shprehje e gabueshme dhe unë nuk është dashtë me e përdorë këtë fjalë. Por kjo fjalë ka qenë si me thënë një shprehje në tërheqje e sipër, pra një shfryrje për faktin se Milaimit nuk do t'i jepej fjala.

Pas largimit tim prej tavolinës së komisionit të asaj mbrëmjeje, e ka marrë Musa Daka, Milaimin dhe e ka përcjellë në skenë deri tek mikrofoni. Sa ia ka nisë me folë Milaimi, Sylë Nuha, një shokë e shofer i afërm i Ibrahim Kelmendit i shkëputë telin (përçuesin) e mikrofonit prej altoparlantëve (megafonave, apo zmadhuesve të zërit). Këto skena nuk i kam pa nga afër por po tregoj ashtu si m'i kanë përshkruar më pas. Musa Daka mundohet me e pengua Sylë Nuhën në hapin e tij, por nuk ka sukses. Atëherë Musa e paska therë thikë në një mënyrë apo tjetër Sylën dhe një tjetër. Syla, në gjendjen e vetë menjëherë është largua dhe ka shkua tek Ibrahimi me i tregua se çka ka ndodhë. Kjo mbrëmje përbën një nga ngjarjet më të zymta që kam pasur rastin ta përjetoi.

Kundër Milaimit, këtij anëtari të hershëm të OMLK-së në fillim të vitit 1984 kanë luftuar Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi duke u munduar me çdo çmim t'ia mbytin zërin e të mos e lejojnë të flas në tubime publike, duke ia shkëputur kabllat e mikrofonave prej altoparlantëve në sytë e të gjithë bashkatdhetarëve. Është fatkeqësi ajo që ka ndodhë në mbrëmjen e 7 prillit 1984 në Dyseldorf.

Është fatkeqësi e imja pse unë me u gjetë në atë mbrëmje, dhe lejua veten të implikohem në luftën e Xhafer Shatrit e Ibrahim Kelmendit kundër njëri tjetrit e kundër të tjerëve, sidomos kur dihet se kam kërkuar dorëheqje nga Lëvizja, nga Qendra Ekzekutive, në korrik 1983 dhe *në këtë kuptim* mund të them se është faji i Hasan Malës dhe Faridin Tafallarit që nuk jam lejuar të largohem.

Unë atë natë u ktheva me një shokë në një qytet afër kufirit me Francën, pastaj vazhdova për në Paris. Nga libri i Faridinit (më 1997) kam marrë vesh se është bërë një tubim të nesërmen në klubin Emin Duraku dhe fajin kryesor për atë mbrëmje, një grup së bashku me Muhamet Kelmendin, Hyzri Rekën e Faridin Tafallarin, na e kanë lënë mua, Xhavit Ramabajës, Milaim Zekës dhe tre vetave tjerë.

Në ditët në vazhdim nuk kam bërë asnjë hap të vetëm apo ndonjë veprim të veçantë, përveç disa bisedave telefonike që i bëja me Faridinin dhe Haxhi Berishën. Faridini më thirrte në telefonin e Ibush Bytyçit në Paris. Në këtë kohë Faridini kishte kontakte të mira me Xhafer Shatrin, dhe në përçarjen e shkaktuar nga Sabriu në nëntor 1983, Faridini në fillim mendonte se Xhafer Shatri është më i drejtë, se e ka më drejtë.

Shtrohet pyetja se si kanë rrjedhë gjërat disa vjet më vonë. A ka ndonjë provë historike, ndonjë projekt historik që pikërisht Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi të kenë nevojë për mikrofonat, kabllot, altoparlantët e teknikën elektrike e elektronike pikërisht të Milaim Zekës?

Xhafer Durmishi nuk merr pjesë në demonstratë dhe në mbledhjen e Qendrës Ekzekutive më 14 prill 1984 në Bern, megjithëse rendi e ka dashtë të merr pjesë në demonstratë dhe në mbledhje

I. Kelmendi*: "Fundjavës vijuese Lëvizja organizoi demonstratë në Bernë. Pas demonstrate u bë edhe mbledhja e QE-së. Në demonstratë dhe në mbledhje nuk morën pjesë Sadriu, Xhafari dhe sejmenët e tyre. Në vend që të merrte pjesë në demonstratë dhe mbledhje, Xhafari shkroi një letër publike prej 12 faqesh dhe ua drejtoi shokëve të Stuttgaritit me rrethinë."* (Atentatet, f.461)

Unë nuk kam qenë i informuar dhe as i thirrur në ndonjë mbledhje të Qendrës Ekzekutive, nga asnjë anëtar i saj, as gojarisht e as me shkrim, e as që e kam ditë se do të bëhet demonstratë në Bern. QE, pas demonstratës së 3 marsit 1984 në Gjenevë nuk ka ekzistua. Letra ime prej 12 faqesh nuk ka qenë publike por i është dërguar vetëm 5-6 shokëve më të dalluar në Shtutgart e rrethinë të cilët kanë qenë në njohuri të rrjedhave themelore të ngjarjeve nga viti 1980 e më tej. Xhafer Shatri pa I. Kelmendin, është angazhuar ta bëjë një takim në të cilin unë, sipas bujarisë së Xhafer Shatrit, do të kisha shansin për t'u mbrojtë prej akuzave. Këto ftesa m'i ka bërë gojarisht përmes Faridin Tafallarit, në telefonin e Ibush e Sadije Bytyçit në Paris. Kur i kam thënë se çdo ftesë e çdo gjë në këtë pikë dua ta kem me shkrim dhe kërkoj që në takim të jetë edhe I. Kelmendi, Xhafer Shatri nuk donte të përgjigjej.

II. TEKNIKA E NGJITJES SË MIKROFONAVE

14. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" i vitit 1992

Express: Pa rrotullat e Milaimit
E Diel, 01-02-2009, 04:45pm (GMT+1) www.zemrashqiptare.net
Milaim Zeka në Gazeta Express. Express: Milaim, emisioni (Pa Rrotlla më 17 janar 2009-shën i Xh. D.) filloi dhe po duket se është mjaft i nxehtë sa i përket temave, komenti i juaj për këtë?

Milaim Zeka: "*Paj nëse doni ta kuptoni se sa shoqëri e mjerë jemi ne ballkanasit në përgjithësi, ju lutem gërmoni qoftë edhe sipërfaqësisht ndonjë temë e cila është lakuriq përpara nesh, por që ne i mbyllim sytë. Mos mendoni që vetëm këta primitivcat me petkun e veshur të Usama bin Ladenit me kanë kërcënuar. Reagime ka pasur edhe rreth emisionit të pare ku bëhej fjalë për Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën. Pse e more Sabri Novosellën me thoshte Hysen Gërvalla. Një tjetër me thoshte, po çka deshi aty Adem Demaçi. Një doktor me thoshte po ku e ka njoftë,*

Jusufin, Kastriot Haxhirexha. Të gjithë i shikoja si krokodilë të lloçit. Të gjithëve ju thosha edhe po ju them edhe atyre që u munduan të ma diktojnë emisionin tim; "Askush prej jush nuk me keni pyet se çfarë rrobash të trupit me vesh, apo çfarë mobilesh me ble në shtëpi. Sa të jetoj, deri në vdekje, kurrë nuk kam me leju imponime në emisionin tim. Këshilla e sugjerime po, ama imponime jo. Ato kurrë nuk i kam pranuar. Prandaj kam jetuar 18 vite në perëndim pa e pa familjen dhe Kosovën, vetëm pse e kam dashtë mendimin e lirë dhe fjalën e lirë. Sa ju përket reagimeve të disa bastardeve të fesë islame, po edhe të atyre të krishtera, ju them se ata janë shkelës të librave të shenjtë. Mirëpo unë nuk frikësohem, sepse gjyshi im me ka thënë kur kam qenë i vogël, "Zoti ta jep dhe vetëm Zoti ta merr Shpirtin". (Marrë nga zemrashqiptare.com, më 1 shkurt 2009)

15. Filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" për Jusufin, Kadriun e Bardhoshin më 1992 dhe disa relacione me mbrëmjen e 7 prillit 1984 në Düsseldorf

Milaim Zeka: *"Për mua, figurat qendrore të emigracionit, për çka mund të lexoni edhe në fejton të Rilindjes në vitin 1987 kanë qenë Xhafer Shatri dhe Xhafer Durmishi. Këtu e kemi fjalën pas vrasjes së Jusufit dhe Kadri Zekës. Xhafer Durmishi ka qenë një njeri i mrekullueshëm, por një pjesë e njerëzve që e rrethonin në atë kohë, e nxitnin për disa veprime të pakontrolluara dhe të nxituara."* (Drita, Trelleborg-Suedi, nr.11, 1997, faqe 9)

Në vitin 1992 ishte 10 vjetori i 17 janarit 1982. Ishte edhe 10 vjetori i formimit të Lëvizjes për Republikë, më 17 shkurt 1982. Lëvizja (LPRK) në Zvicër (Emrush Xhemaili) më kontaktojnë në Suedi, përmes Hajdin Abazit dhe më ftojnë në Zvicër për shënimin e 10 vjetorit të formimit të Lëvizjes. Nuk shkova. Emrushi më tha: A mundesh me na e dërgua një telegram përshëndetës. I thash po, dhe përmes telefaksit, Emrush Xhemailit ia dërgova këtë përshëndetje: *"Me rastin e 10 vjetorit të formimit të Lëvizjes për Republikë uroj që puna juaj të jetë në interes të popullit shqiptar."*

Në janar të vitit 1992, me rastin e dhjetëvjetorit të 17 janarit 1982, përmes televizionit shqiptarë u shfaq filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?" i cili duhet të jetë përgatitur gjatë vitit 1991. Kush ishte sponsor e porositës i këtij filmi? Kush bashkëpunoi gjatë punës me këtë film?

Është interesant si e angazhoji Xhafer Shatri Milaim Zekën dhe mikrofonat e ngjitur e të montuar për mrekulli për altoparlant e kamera televizive, për filmin dokumentar ku një vend të veçantë e kishte Ibrahim Kelmendi, pastaj Hyzri Reka - një ndër aktivistët kryesor të Klubit "Emin Duraku" të Dusseldorfit. A bashkëpunoi në këtë projekt apo a u ftua të marrë pjesë fare në këtë projekt Xhafer Durmishi, nga "*sejmeni i tij Milaim Zeka*"?

Dhe kulmi i gjithë kësaj del se këta persona, që i kërkuan Milaim Zekës ta merr teknikën më të mirë nga televizioni suedez së bashku me kameramanin Nikolla Majstoroviç, një ndër ustashët më të papërmirësueshëm, a u ra ndërmend gjatë këtij afrimi e bashkëpunimi, pajtimi i Haxhi Begës, i Sylë Nuhës, shkëputësit të kabllove e mikrofonave, me plagën e thikës në trup, me Musa Dakën, të cilit i ka ndodhë kjo fatkeqësi duke u munduar që mikrofoni i Milaim Zekës të mos shkëputet?

Plaga e Sylë Nuhës e Haxhi Begës nga thika e Musa Dakës, fizikisht mund të jetë shëruar. Plaga psikike nga pabesia e udhëheqësve të tyre është më e rëndë. Kjo nuk

është asgjë tjetër pos një lloj justifikimi i Musa Dakës që me çdo çmim të kujdeset për kabllot e mikrofonat e Milaim Zekës për të cilët kanë aq shumë nevojë, para të gjithëve vetë Ibrahim Kelmendi e Xhafer Shatri.

Xhafer Shatri ishte ministër i informatave. Për përgatitjet e filmit dokumentar që u shfaq së pari atë vit, nuk kam ditur asgjë dhe as sot nuk i di sendet në hollësi. Por edhe ajo çka di më duket se është interesant. Xhafer Shatri, nuk di sa ka punuar në bashkëpunim me Ibrahim Kelmendin e angazhojnë Milaim Zekën që të merret me anët teknike të mikrofonave, kabllove e altoparlantëve, pikërisht atë Milaim që me çdo çmim kishin luftuar të mos ia japin fjalën e mikrofonat në Düsseldorf më 7 prill 1984, për çka punëtorët ishin therë me thika, në përpjekje për t'ia marrë mikrofonin prej dore. Kështu Milaimi angazhohet në këtë projekt nga ata që i kishin qëndruar afër në fund të 1982 e fillim të 1983.

Këtu nuk po dua të bëjë ndonjë recension të filmit të 1992-shit. As ta komentoj seleksionimin e shokëve të Jusufit. Sikur natyra të mos ma kishte dhënë aftësinë time me u shpreh vetë, me siguri që do ta mërzitesha sikur historia ime të mvarej prej bujarisë së Xhafer Shatrit. Ajo çka dua të them është vetëm kjo, se vetëm e vetëm ata që kanë dashtë me ia shkëputë mikrofonat Milaim Zekës më 1984 e kanë angazhuar më 1992. Ky fakt, besoj se është e arsyeshme ta përdori, ma jep të drejtën të them, e vërteton rrethanën, se pesha ime e vërtetë në mbrëmjen e 7 prillit 1984, kur mikrofonat e Milaimit janë shkëputë, në realitet ka qenë e barabartë me peshën time në vitin 1992, kur mikrofonat e Milaimit janë ngjitë. Kjo tregon se unë nuk kam nxitë armiqësi në mes Musa Dakës, Sylë Nuhës e Haxhi Begës. Kjo tregon gjithashtu se unë nuk i kam shitur kurrë këta tre persona e bërë aleanca e pajtesa prapa shpinës së tyre as për llogari të mia dhe as për llogari të kujtdoqoftë.

Pikërisht më 17 janar 1992, Milaimi e ka udhëheq programin e Radios Suedeze të gjuhës shqipe, dhe në transmetim direkt, pa kurrfarë paralajmërimi paraprak më ka thirrur në shtëpi (në Oskarshamn) në telefon. Unë këtë ditë nuk kam qenë në banesën time (në Oskarshamn, 350 km prej Stockholmi) por kam qenë pikërisht në Stockholm për të përkthyer tek avokati im i dikurshëm Kjell Jönsson. Me këtë deshta të shtoj se me rastin e 10 vjetorit të 17 janarit 1982, me Milaimin nuk kam pasur diçka të organizuar. Edhe kur është bërë një përpjekje e vetme për kontakt, rrethanat janë sjellë në atë mënyrë sa edhe kontakti i rastit nuk është arritur të vendoset. Në këtë rast dua të them se në premierën e programit 'Pa Rrotlla' më 17 janar 2009, Milaimi ka deklaruar në televizion se të ftuar në studio kemi qenë edhe unë Xhafer Durmishi, Hafiz Gagica dhe Donika Gërvalla. Për Hafizin e Donikën nuk mund të përgjigjem, sa për mua, puna qëndron kështu: Hafiz Gagica, rreth një muaj ditë pas emitimit të programit më ka tregua se si Milaimi e paska ftuar Hafizin në këtë emision dhe i ka thënë atij për të na e përcjellë përshëndetjen mua dhe Donikës. Fakti mbetet fakt, unë nuk jam njoftuar për kurrfarë ftese në këtë program, para emitimit të tij, as në mënyrë direkte e as indirekte.

DEUS EX MACHINA

1. Thirrjen për takim e dua me shkrim

2. Dekonspirime pozitive dhe negative
3. *Zëri i Kosovës* në Suedi
4. Vendosja ime në Suedi
5. Distancimi i Sabri Novosellës nga "Zëri i Suedisë'
6. Deus ex machina

1. Thirrjen për takim e dua me shkrim

Kah fundi i prillit, me porosi të Xhafer Shatrit, por edhe të Hasan Malës shkojnë në Düsseldorf, Faridini me disa shokë të Shtutgartit për të arritur njëfarë pajtimi. Në mesin e shokëve të Shtutgartit kishte edhe nga Korisha, pra nga fshati i Musa Dakës. Ata e vizitojnë Sylë Nuhën dhe Syla u thotë se unë pajtohem me çdo vendim të Lëvizjes. Por për shkuarjen e tyre merr vesh Ibrahimi dhe shkon tek Syla dhe ia ndalon të bëjë çfarëdo pajtimi, dhe vetë Ibrahimi i flet Sylës në emër të Lëvizjes. (Këtë fakt e kam marrë vesh tek më 1997 nga libri' Terror, Dhimbje, Qëndresë' i Faridinit). Kur plani i tyre për izolimin dhe fajësimin a asaj mënyre të cilën nuk e meritoja, u dështon, atëherë Xh. Shatri e porosiste Faridinin që të më thoshte në telefon se është mirë me e thirrur një takim, apo se unë duhet me e thirrur një takim, në mënyrë që të mbrohem prej akuzave. Unë i thosha Faridinit se jam i gatshëm për takim, është mirë me e thirrur ndonjë takim në përbërje që të shihet e arsyeshme, por nuk pranoj të ulem në ndonjë takim vetëm me Xhafer Shatrin pa qenë edhe Ibrahim Kelmendi aty. Pastaj punët, propozimet, thirrjen dhe rendin e ditës për këtë takim i dua me shkrim. Kur i thoja se i dua këto gjëra me shkrim, në bazë të asaj që bisedoja me Faridinin, Xhafer Shatrit nuk i pëlqente kërkesa ime.

Në ndërkohë Sabriu filloi me i shtypë disa komunikata e qarkore të ndryshme dhe ta sulmojë me emër e mbiemër Xhafer Shatrin. Sabriut i ngutej dhe ishte i vetmi që kishte interes e që luftonte që përçarjen ta çoi deri në shkëputje të plotë. Vetë sulmi i tij nuk kishte qenë i atij lloji për të lënë ndonjë urë lidhjeje. Ai ishte i interesuar për këtë sepse pas atyre sjelljeve, ai kurrë më nuk do të mund të pretendonte për ndonjë vend me rëndësi në Lëvizje. Prandaj ai vazhdoi me disa "komunikata", "proklamata" e "qarkore" për të cilat vazhdimisht tani e ngarkon diplomacinë shqiptare.

2. Dekonspirime pozitive dhe negative

Unë kam qenë kundër shpërndarjes së atyre komunikatave dhe kurrë nuk i kam thënë askujt me i shpërnda.

Në këtë kohë qëndroja në Paris dhe pritja që ta marrë pasaportën e pastaj të shkoj në Gjermani e Zvicër. Rreth 10 majit 1984, Remzi Ademaj më tregon se me iniciativën e Xhafer Shatrit, apo me kërkesën e tij, ai (Remziu), Faridini, Mejdi Rexha, Nami Ramadani dhe dy tre aktivistë tjerë më të dalluar të rrethit të Shtutgartit e të Jusufit kanë qenë në Biel-Bienne dhe janë takuar me Xhafer Shatrin e Hasan Malën, në mënyrë që nga ata ta mësojnë të vërtetën. Se ka qenë ky grup tek Xhaferi në Zvicër nuk më ka njoftua askush tjetër pos Remziut. Pasi më ka tregua Remziu për këtë, jam ulur pranë makinës së shkrimit dhe këtij rrethi të ngushtë që ka vepruar aq afër Jusufit, për hir të punës e luftës së tyre ua kam shkrua një letër prej 12 faqesh A4, në të cilën e përshkruaj në pika të shkurta aktivitetin dhe disa gjëra që ata nuk i kanë ditur, prej 15 janarit 1983 e deri më 10 maj 1984.

Po e marrë një citat nga faqja e parë e kësaj letre:

"Shokëve të Shtutgartit e me rrethinë, 14 maj 1984

Po e filloj këtë letër pa ndonjë hyrje të veçantë. Kohë pas kohe jemi informuar ndërmjet veti lidhur me punët rreth klubit si dhe për disa çështje tjera me disa shokë përmes telefonit. Unë në këtë letër do të mundohem që me disa fjalë të them mendimet e mia lidhur me momentet nëpër të cilat po kalon LRSSHJ si dhe rrethi i Shtutgartit në veçanti dhe për atë se si mendoj se çfarë qëndrimi duhet mbajtur në këtë situatë. Por para se të vij në përshkrimin e situatës prej mbledhjes sonë të fundit e deri më sot, unë në pika të shkurta do të jap disa shpjegime lidhur me funksionimin dhe raportin e njerëzve në udhëheqjen e LRSHJ në Evropën Perëndimore dhe më gjerë (në përgjithësi në botën e jashtme). Kjo shtrohet paraprakisht si e domosdoshme sepse kur është në pyetje njollosja e ndonjë shoku nuk është qarë koka për konspiracion, ndërsa kur është në pyetje çështja për t'ia qitë fëlliqësirat dikujt në ledinë po thirret me të madhe që të mos hyjmë andej nga se po dekonspirohen gjërat, se ato i takojnë një rrethi më të ngushtë e profka të ngjashme si këto. Këto që do t'i numëroj, shumicën prej tyre ua them për herë të parë. Këtë veprim e bëjë i bindur se është i drejtë, sepse përgjegjësitë që na i ka besuar populli (apo thënë më drejtë, që ia kemi besuar vetes) nuk i përmbushëm ne pesë (5) veta për të cilët do të flasë më poshtë.

1. Më 15 janar 1983, pas marshit protestues që u mbajt më 15 janar, u mblodhëm në banesën e Hafizit (Hafiz Gagicës); unë, Ibrahimi (Kelmendi), Uka (Xhafer Shatri), Plaku (Hasan Mala). Ishte parashikuar që në atë tubim të merrte pjesë edhe Faridini por ai nuk mori pjesë për shkak se ishte në spital. U mblodhëm në një përbërje të tillë me propozimin e Ukës (Xhafer Shatrit) e gjithashtu me propozim të tij u vendos që ai forum të jetë përgjegjës për botën e jashtme, të quhet Qendër Ekzekutive dhe prapë me propozim të Xhafer Shatrit të cilave ne nuk ua bëmë asnjë ndryshim u caktuan këto detyra: Xh. Shatri përgjegjës për propagandë, unë për çështje të organizimit në botën e jashtme, Faridini arkatar i Lëvizjes dhe Ibrahim Kelmendi për çështje me organizatat e jashtme. Hasan Mala përgjegjës për lidhjet brenda. D.m.th. siç po shihet me propozim të Xh. Shatrit u vendos që të jemi shokët më të afërt në bashkëpunim. Unë besova në fjalët e tij siç kanë besuar shumë të tjerë."

Këtë letër e përmend Faridini në librin e cituar më heret, e gjithashtu e përmend I. Kelmendi në librin Atentatet.

Kundër kësaj letre në mënyrën më të ashpër, përmes Faridinit patë protestuar Xhafer Shatri, akuza e të cilit ishte se pse me i dekonspirua këto sende, që kurrsesi nuk është dashtë me dalë tek personat e tretë. Kjo më duket është taktikë tejet interesante. Pika e parë kur ai (Xh. Sh.) i ka thirrur këta shokë në Biel Bienne, tek Hasan Mala, nuk i ka thirrur për sy të zi por vetëm e vetëm për t'u tregua se është ai që fletë në emër të Lëvizjes, e është Hasan Mala pranë tij. Pra me e dekonspirue vehten Xhafer Shatri e Hasan Mala, para Remzi Ademit, Mejdi Rexhës e Nami Ramadanit është kulmi i mençurisë, strategjisë dhe i suksesit. Por nëse unë (Xh.D.) vetëm pas këtij hapi, e marrë një letër dhe u tregoj vetëm këtyre shokëve dhe askujt tjetër, se nuk është vetëm Xhafer Shatri (Bacaloku) apo Hasan Mala që mundet dhe ka pasur të drejtë të flasin në emër të Lëvizjes por këtë të drejtë e kam edhe unë, pasi kam qenë me ta një forum, (i cili ka pushua së ekzistuari qysh më 3 prill 1984 në Gjenevë) që do të thotë se kemi qenë të një rangu. Prandaj, **jo dekonspirimi i diçkafit që nuk ekziston më**, por ajo që e ka revoltuar Xhafer Shatrin ka qenë pohimi e guximi im me u thënë atyre shokëve se është edhe dikush i të njëjtit rang. (Megjithëse kjo duhet të kuptohet në anën formale dhe të atij forumi në atë kohë, pasi me dredhitë e kopilitë e pabesa nuk besoj se mundet me qenë kush i rangut të tyre, dhe lufta për ta paraqitur veten si të të njëjtit rang tani nuk duhet të kuptohet si lavdatë por si fyerje.)

Principi e konspiracionit e dekonspirimit është interesant të shtjellohet edhe nga një pikë: Mund të fitohet përshtypja se e vetmja kritikë që unë kam pasur të drejtë ta parashtroi kundër Xh. Shatrit e I. Kelmendit është dashtë të bëhet vetëm brenda Qendrës Ekzekutive dhe askujt tjetër (pra brenda 5 vetave). Me fjalë tjera Xh. Shatri ka pasur të drejtë që letrat zyrtare të Lëvizjes t'i nënshkruaj me emrin Bacalok, të organizoj e mobilizojë fushatë kundër teje edhe deri tek anëtari e simpatizuesi i fundit, ndërsa ti duhet të luftosh e mbrohesh vetëm në kuadër të forumit të cilit i takon, pasi kështu e kërkon disiplina e organizatës dhe rregullat e konspiracionit. Këtu do përmendur se letra ime i është dërguar vetëm atyre që kanë qenë tek Xhafer Shatri e Hasan Mala dhe askujt tjetër. Këtë taktikë për eliminimin e çdo kundërshtari të vërtetë apo të imagjinuar e kanë përdorë diktatorët dhe kriminelët më të mëdhenj që ka njohur njerëzimi.

Më heret kam shkrua se si kisha kërkua dorëheqje nga kjo Qendër dhe po të më kishin lënë këta njerëz të qetë ashtu siç dëshiroja unë me i lënë të qetë, kisha me shpëtuar prej shumë kurthave të tyre, e prej kujtimeve shumë traumatike.

3. *Zëri i Kosovës* në Suedi

Pas një vargu diskutimesh me shokë u vendosë që të dilet me një gazetë të re. Ishte mendim i shumicës, mund të them edhe i influencuar nga diplomatë shqiptarë të Vjenës që gazeta të quhet Zëri i Kosovës. Me këtë qëndrim, në këtë kohë jam pajtuar edhe unë. Dhe kur të pajtohesh vetë me një çështje mendoj se është jo vetëm shenjë dobësie por është edhe kulmi i pafytyrsisë me ua lënë fajin të tjerëve. Çështja e parë ishte blerja e një makine shkrimi të kualitetit të mirë. Pasi makina e Jusufit, e fundit që tani ishte në posedimin e Xhafer Shatrit, kishte qenë e IBM-it, atë lloj të ngjashëm pune e njihja unë më mirë, andaj kam shkuar në një lokal, përfaqësi të IBM-it në Paris, në Tour Montparnase, e cila është një rrokaqiell prej 60 katesh, (ndërtesa më e lartë në Unionin Evropian) dhe me sa më kujtohet në katin me të lartë ka qenë lokali IBM ku shiteshin makina të një cilësie më të lartë për atë kohë. I kam treguar Haxhi Berishës çmimin dhe ai m'i ka dërgua 15 mijë franga franceze, ndërsa makina kushtoi diçka mbi 13 mijë franga franceze.

Në qershor 1984 në adresën

Ibush Bytyçi,
6 Rue des Cailles,
94450 Limeil Brevannes
France

është botuar "Zëri i Kosovës" në formatin A3. Po në qershor e kam marrë pasaportën franceze. Pas kësaj e kam marrë makinën e shkrimit dhe kam shkuar në mënyrë legale në Zvicër, në Amriswil tek Haxhi Berisha. Tek Haxhiu në këtë kohë qëndronte Sabri Novosella.

Në praninë time, të Haxhi Berishës dhe të Elmaz Ademit, Sabriu, në bazë të një bisede të mëparshme të tij, ka thirrur në telefon në ambasadën shqiptare në Vjenë. Arsyeja e bisedës: me i pyet se çka mendojnë për gazetën "Zëri i Kosovës" që ishte botuar ato ditë në Paris?

Përgjigja prej ambasadës që i është dhënë Sabriut ka qenë kjo:

- Shumë i mirë!

Në kontakt kisha qenë edhe me Naim Haradinajn i cili ishte vendosur në Suedi dhe shprehej shumë pozitivisht për qëndrimin e tij atje. Po në Suedi, në Stockholm ishte Shukri Demiri, refugjatë nga Stambolli (i cili kishte punuar polic në Turqi dhe e kishte

shpëtuar Sabri Novosellën prej kidnapimit nga UDB-a). Në Stockholm ishte Milaim Zeka e Fazli Memaj. Numri i dytë i gazetës tonë doli në banesën e Haxhi Berishës në Amriswil.

I ndikuar nga disa shokë që i kisha njohur në Shtutgart dhe të cilët kishin vepruar në Shtutgart e që ishin vendosur në Helsingborg dhe Stockholm të Suedisë, përkundër asaj që veç sa e kisha marrë lejen e qëndrimit në Francë, rrethanat u sollën asisoji që duke pasur për bazë idenë se mundësitë më të mira për ta botuar gazetën do t'i kemi në Suedi u vendosa edhe unë në Suedi.

4. Vendosja ime në Suedi

Me makinën e blerë në Paris, jam nisur për Suedi. Në Gjermaninë veriore banonte Sylejman Bytyçi nga fshati Kravasari, të cilin e kisha njohur nëpër demonstrata. Në Gjermani në vitin 1984 ka pasur këtë adresë: Sylejman Bytyçi, Kirch winkelstr.5, 5031 Peine, West Germany.

Sylejmani dhe gruaja e tij Lemja, nga Peine, të enjten më 26 korrik 1984 më kanë pru në Suedi, në Helsingborg, ku jam ndal për një pushim tek Imer Baçaj, të cilin e njihja përmes Bardh Gërvallës dhe Naim Haradinajt. Një pjesë të rrugës ka vozitur edhe gruaja e Sylejmanit (dhe nuk kanë qenë të shpeshta gratë shqiptare në atë kohë, të cilat kanë pasur patentin e shoferit). Sylejmani është kthyer nga Helsingborgu në Gjermani, ndërsa unë kam vazhduar për Stockholm.

Në ditët e para kam qëndruar tek Shukri Demiri, i cili banonte në konviktin e studentëve të Universitetit të Stockholmit, në adresën Amanuensvägen 3/211, 104 05 Stockholm.

Pas një jave, të enjten më 2 gusht jam lajmëruar në stacionin kryesor të policisë në Stockholm për të kërkuar azil. Ky fillim i imi ka qenë shumë i vështirë. Për shkaqe që kuptohen unë nuk kisha mundësi ta tregoj të gjithë ngjarjen. Pastaj një rast që ndikoi keq ishte fakti se unë në një çantë të cilën e kisha me vete, e pata vëllimin e parë të veprave të zgjedhura të Leninit (prej krejt tri vëllimesh), të cilën e shfletoi policia. Policja e cila më mori në pyetje përmes një përkthyeseje në serbokroatishte më pyeti se a po do me ta thirrur ambasadën jugosllave që të kujdeset për ty pasi je nënshtetas i RSFJ, apo thirr vet nëse do e ne ta sigurojmë numrin. Unë i thash jo. Policja e cila qe në shërbim vendosi masën e arrestit për mua dhe më futën në burgun i cili ishte ngjitur me stacionin e policisë. Në burg më kanë mbajtur deri të hanen, kur Shukri Demiri e ka angazhuar përmes disa refugjatëve nga Turqia, avokatin **Kjell Jönsson**. Adresa dhe firma e avokatit ka qenë:

Advokatbyrån, JURIST FORUM AB, Riddargatan 47, 114 57 Stockholm
Telefoni: 08-24 68 40

Më vonë, shumë më vonë e kam marrë vesh se çfarë fati ka qenë me e pas një avokat të tillë si ky, i cili erdhi të hanen më 6 gusht 1984, dhe me intervenimin e tij u lirova nga burgu. Por policia mori vendim që unë brenda gjashtë muajve, dy herë në javë të lajmërohem në polici dhe të nënshkruhem në një libër. Ky vendim më duket u ndryshua brenda ditës dhe kështu, në gjashtë muajt në vijim, një herë në javë jam lajmëruar në polici. Më vonë e kam marrë vesh se kjo masë merret vetëm për ato raste kur policia dyshon shumë në ndokend se do të kryen ndonjë vepër kundër rendit e ligjit. Policia, pa më liruan, thirrën në një hotel, në të cilin do të qëndroja, deri sa organet komunale të Stockholmit ta merrnin përgjegjësinë për vendosjen time në ndonjë banesë. Ata thirrën në një hotel dhe ky ishte: Hotel Gustav Vasa, Västmannagatan 61,

102 33 Stockholm

Më kujtohet se nuk më erdhi aspak mirë për emrin apo në të vërtetë mbiemrin Vasa, pasi kisha ende kujtime të këqija nga policia, dhe ky mbiemër më sillte asociacione me Vasa Qubrilloviqin e me serb të tjerë të kallapit të tij. Më vonë mësova se ky ishte mbreti më i madh që ka pasur Suedia, e cili njihet si themeluesi më i fuqishëm i shtetit suedez.

Pas disa javësh, nëpunësit e Komunës së Stockholmit më vendosën në këtë adresë:

Xhafer Durmishi, Björkhagsplan 9/dhoma 522, 121 52 Johanneshov, Sweden

Në këtë ndërtesë, që ishte një lloj konvikti, banonin Milaim Zeka me shoqen, pastaj Fazli Memaj. Pak ditë pas lirimit tim nga arresti, në Suedi erdhi Sabri Novosella. Ai kërkoi azil dhe kërkesa e tij, duke u bazuar në faktet që kishte u shqyrtua pozitivisht shumë shpejt.

Në këtë ndërtesë, Björkhagsplan 9, dhoma 522 janë përgatitur të gjithë numrat e "Zërit të Kosovës" që janë botuar në Suedi, prej vjeshtës 1984 e deri në korrik 1985.

5. Distancimi i Sabri Novosellës nga "Zëri i Suedisë'

Sabri Novosella: *"Fushatë e tërbuar filloi kundër Xhafer Durmishit. Posa u duk se u krye puna me të, filloi një fushatë edhe më e tërbuar kundër Sabri Novosellës. Kështu u arritë përçarja e plotë e LRSHJ-së dhe u krijuan dy krahë të saj. Filloi të dalë edhe një organ me emrin Zëri i Kosovës me adresë në Suedi. Këtë organ e udhëhiqte Xhafer*

Durmishi. ***Xhafer Durmishi i frikësuar tmerrësisht se mos po akuzohet si reaksionar, e kur të jepej epiteti reaksionar nënkuptohej edhe se je kundër PPSH, kundër Shqipërisë e tradhtar, kështu që Xhafer Durmishi në këtë organ u bë më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini, për të cilën gjë e jepte bekimin diplomacia shqiptare në Stockholm për çdo numër të organit***. Për këtë punë intervenova unë dhe e ndala botimin e "Zëri i Kosovës", me adresë në Suedi." (**Zëri, 28-4prill mars 1992)**

Nuhi Sylejmani*: "E pyeta nëse do të ishin si ato të mëparshmet, apo ndryshe. „Sikur ato të mëparshmet", – më tha disi i hutuar. Në demonstratat e mëparshme ishte praktikuar që gjatë pushimeve të shkurtra, mes dhe gjatë leximeve të referateve, të brohoriteshin parullat, si: „Kosova Republikë!", „Republikë Kushtetutë!" etj., prandaj edhe në këtë demonstratë, kur ma mori mendja se duhej thirrur, përmes megafonit thirra tri herë: „Kosova Republikë!", dhe dy herë „Lavdi Marksizëm-Leninizmit", por për të tretën herë nuk thirra dot, sepse* ***Xhafer Durmishi, me pseudonimet Skënder e Shpend****, u afrua pranë dhe më qortoi me zë të lartë, duke më thënë: „Çka po bërtet ashtu, a? Le, boll e mos bërtit mâ!..." U ndjeva shumë i fyer! Gjaku më vloi ethshëm nga zemërimi, por e mbajta vetën! Nuk fola asnjë fjalë, por e ula kokën sikur të kisha bërë ndonjë faj të pafalshëm!"* (Vrasja e trefishtë, f.133)

Se çfarë autoriteti të madh ka pasur Sabri Novosella tek shokët në Gjermani e Zvicër në korrik 1985, kur ka dalë numri i fundit të Zërit të Kosovës me adresë në Suedi e dëshmon më së miri letra e Hafiz Gagicës.

Hafiz Gagica: *"I dashuri shok,*
...Letrën e lexova me vëmendjen më të madhe. Të gjitha ato që i ke cekë në letër (kuptohet në shkurtica) rreth Mërgimit (Sabri Novosellës) janë të vërteta, se ai njeri ishte çmendë. Unë personalisht kam pas një konsideratë për te si luftar i vjetër, por kisha qenë gabim...Vitin e kaluar tek ky kam vërejtë se është mendjemadh, karrierist dhe lokalist i mykyn, të cilat t'i kam thënë para se të ngjitesh lartë...
...Unë mendoj se është mirë që po e njohim se kush është ky njeri, por ta luftojmë nuk bënë (se nuk ka nevojë) të hapim plagë të reja.
...(Shkaku) i sjelljeve të Sabriut për karrierizmin e tij të fëlliqur e krijuem këtë përqamje aq të madhe që në historinë e emigracionit shqiptarë nuk ka ndodhë kurrë." (Letër dërguar Asllan Muharremit në Stockholm, 9 korrik 1985)

Sabri Novosella: *"Ne u përpoqëm që ta vazhdonim aktivitetin në organizatën në të cilën militonim, pra në LRSHJ. Përçarjet e bënë të veten. Dikush tentonte që me çdo kusht t'i thyente veprimtarët të cilët kishin sado pak ndikim. Kështu Xhafer Durmishi u largua pas akuzave tejet të rënda që iu bënë, pastaj qesh i detyruar të largohem edhe unë."* (Intervistë në Zëri, e ribotuar në Drita, Trelleborg-Suedi, nr. 11, 1997, faqe 14)

Sabri Novosella: *"Xhafer Shatri i nxitur nga njerëzit e Engjëll Kolonecit e botoi një numër të jashtëzakonshëm kundër Sabriut e disa shokëve të tij në Gjermani. Edhe një shok i imi, nga frika se mos po e akuzojnë si njeri kundër Shqipërisë, u bë më marksist se vetë Marksi. Iu përgjigj Xhafer Shatrit në të njëjtën mënyrë me një numër të "Zërit të Kosovës" që filloi të dalë nga shokët e mi."* (REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH, Prishtinë 2010, f. 171)

Sabri Novosella: *"Shukri Demiri ishte një shqiptar i shpërngulur nga Kumanova në moshën dhjetëvjeçare në Stamboll të Turqisë. E kishte kryer shkollën fillore, por si i shkathët që ishte, kishte shkuar në shkollë të policisë. Pasi kishte kryer me sukses atë shkollë, ishte emëruar polic në Stamboll. Shukriu ishte atdhetar dhe adhurues i madh i çështjes shqiptare. Te Shukriu në Stamboll kishte shkuar një njeri i Kumanovës me emrin Rabit. Rabiti i thotë Shukriut që t'ia kryente një punë të lehtë për çka do të shpërblehet me gjashtë mijë marka gjermane në fillim, e pastaj do ta merrte shpërblimin tjetër. Shukriu e pyet Rabitin se çfarë qenka ajo punë?*

- Duhet të shkosh në Ada Pazar të marrësh një njeri dhe ta sjellësh afër kufirit grek ku do ta marrin disa persona. Shpërblimin tjetër do ta marrësh me rastin e dorëzimit të atij njeriu, i thotë Rabiti. Shukriu e pyet se çka ka bërë ai njeri? Rabiti i thotë se ka thyer banka në Jugosllavi. E, kërkon Jugosllavia për këtë punë, i kthen përgjigjen Rabiti. Nëse ka thyer banka, e kërkon policia. Çka të duhet ty? – i thotë Shukriu. Pastaj Shukriu ia kërkon adresën dhe i thotë se do të përpiqet që ta kryejë atë punë për paratë e premtuara. Atë natë e merr një shok dhe shkon në Adapazar. E kërkon banesën time në Adapazar, ku e takon një kushëri tim, Nazmi Maxhunin. Ky e sjell të panjohurin deri te dera, më pyet se a do që t'i pranojë këta dy persona, të cilët thonë se kanë ardhur për të mirën tënde? Për fat, po atë natë tek unë ishte patrioti i mirënjohur, Hysen Tërpeza. Kur e mori vesh se po më vijnë dy mysafirë të panjohur, u fut në kuzhinë, nga do të përgjonte bisedën. E mori një thikë në dorë, i përgatitur për të më mbrojtur nga rreziku eventual. Ndërkohë i pranova mysafirët. Shukri Demiri më tregoi detajisht për të gjitha informacionet që dinte, duke më njoftuar se ishte pjesëtar i policisë turke, kurse shoku që e shoqëronte ishte shofer i një baze ushtarake të NATO-s.

Shukri Demiri - me uniformën e policisë së Turqisë

Më tregoi se për çka kishin ardhur, i bindur se Jugosllavia e kërkon për ta kidnapuar në këtë mënyrë si veprimtar që përpiqet të ndihmojë çështjen shqiptare. E falënderova dhe i pyeta:

- Pse nuk e kini paraqitur rastin në polici?

Shukriu tha se kishte pasur frikë se i kërkuari nga Jugosllavia ndoshta nuk është paraqitur në organet kompetente të Turqisë, por është duke qëndruar si turist dhe mos po më ndodh ndonjë e keqe. Ia tregova dokumentet e leje qëndrimit në Turqi. Po ashtu kërkova që rasti të paraqitet në policinë turke. Shukriu pranoi. Në ndërtesën ku banoja e kisha një fqinj, i cili ishte shef i policisë për rajonin e Adapazarit. E thirra shefin e policisë dhe ai erdhi menjëherë dhe na dërgoi në polici. Në polici më thanë që ditën tjetër, në mëngjes,

mos të dilja nga shtëpia derisa të më thërrasin që të shkojmë së bashku në polici për ta sqaruar rastin.
Në mëngjesin e ditës së nesërme, shefi i policisë më mori dhe shkuam në polici. Më morën në pyetje disa herë gjatë ditës. Në mbrëmje më nisën për në Stamboll bashkë me Shukri Demirin, shokun që më përcillte dhe dy policë të Sigurimit turk. Atë natë na vendosën në dhomën të një ndërtese të Sigurimit. Ditën tjetër na morën disa herë në pyetje. Kur vërtetohet për ato që kishte thënë Shukri Demiri, në orën pesë të asaj dite, e marrin Shukri Demirin me disa policë dhe shkojnë në shtëpinë ku rrinte Rabiti nga Kumanova. E arrestojnë dhe e sjellin në ndërtesën e Sigurimit. Pasi e marrin në pyetje, e ballafaqojnë me mua. Të arrestuarin Rabit gjatë ballafaqimit me mua e pyesin:
- A e njeh këtë njeri?
I arrestuari Rabit deklaron:
- Jo, nuk e kam parë kurrë.
Më pyesin mua:
- Po ti a e njeh këtë njeri?
I thash Rabitit:
-Si nuk po më njeh? Ti ke qenë në dyqanin tim për të blerë këpucë.
I arrestuari Rabit, ishte tronditur fare, pasi që deri atë çast nuk e kishte ditur se ishte arrestuar për çështjen time. Shukriu tashmë ishte larguar, mbasi që policisë paraprakisht ua kishte treguar shtëpinë se ku ndodhej Rabiti.
Gjatë hetimeve Rabiti zbulon edhe dy të tjerë që ishin të angazhuar për kidnapimin tim. Sabiti, vëllau i Rabitit, dhe një tjetër me emrin Skënder, që të gjithë nga Kumanova. Vëllai i të arrestuarit Rabit, Sabiti, u arrestua, kurse Skënderi arrin të ikë nga Turqia, duke iu shmangur arrestimit. Para se të nxirreshin para gjyqit më thirrën si palë e dëmtuar dhe Shukriun si dëshmitar. Rabiti dhe Sabiti u nxorën para gjyqit dhe u dënuan me nga katër vjet e gjashtë muaj burg të rëndë për tentim të kidnapimit tim – për të më dorëzuar tek UDB-ja jugosllave. Pas këtij rasti, me Shukri Demiri u bëmë shokë të pandarë derisa ishim në Turqi.
Shukriu ndërkohë për çështje familjare ishte vendosur në Stokholm të Suedisë. Tani së bashku me Xhafer Durmishin dhe Milaim Zekën, kishin dalë për të më pritur në Stokholm, ky mik i vjetër dhe besnik." (REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH, Prishtinë 2010, f. 181-184)

Sabriu e nderonte shumë Shukriun për veprën e tij sa i kishte thënë shumë herë se e ka më vëlla se secilin vëlla dhe se ke me e shti në hise.

Shukri Demiri: *"Unë Shukri Demiri, me këto fjalë dua të tregoj një aspekt të relacioneve në mes Xhafer Durmishit e Sabri Novosellës në Stockholm në muajt e parë të vitit 1985.*
Sabri Novosella ishte i pakënaqur me Xhafer Durmishin, me artikujt e tij të botuar në revistën 'Zëri i Kosovës' që dilte në Stockholm. Sabriu më thoshte: 'Xhafer Durmishi nuk po shkruan mjaftë ashpër kundër Jugosllavisë pasiqë e ka vëllaun mjek në Kosovë dhe nuk po do apo është i shqetësuar se mos po ia prishë punën atij. Ky është shkaku i qëndrimeve të tij të buta ndaj Jugosllavisë. Ndërsa Xhafer Shatri, përkundër të gjithave, është patriot i vërtetë dhe atdheun e donë.'
Ai (Sabri Novosella) kah fundi i janarit 1985 i shkëputi të gjitha marrëdhëniet me Xhafer Durmishin dhe revistën 'Zëri i Kosovës' të cilën Xh. Durmishi e drejtonte dhe pas pak kohësh nga Stockholmi u shpërngulë në qytetin Malmö." (Prill 2009)

Gjatë nëntorit e dhjetorit 1984, Sabri Novosella, në mënyrë tejet të tejdukshme ia nisi dhe më provokonte vazhdimisht në stilin:

Sabriu: - Ti nuk je komunist!
Unë (Xh.D.) - Nuk është e vërtetë, unë jam komunist.
Sabriu: - Atëherë ku e ke partinë?
Unë (Xh.D.) - Për me qenë komunist e me pas bindje komuniste nuk është e domosdoshme partia.
Sabriu: - Jo nuk mund të jetë ashtu, komunist pa parti nuk mund të ketë, andaj edhe ti, nëse nuk e formon partinë komuniste, e nëse nuk i takon një partie komuniste, as vetë nuk mund të jesh komunist.

Në këtë stil ka bisedua me mua shumë herë gjatë muajit nëntor e dhjetor 1984 në Stockholm. Pyetjet e tij ishin si më lartë dhe përgjigjet e mia poashtu. Tash, mund të pyetet se çka e ka shty Sabriun me u shërbye me këtë taktikë?

Ai kishte ndëgjuar se Abdullah Prapashtica, me përkrahjen e ambasadave shqiptare, përkundër bashkimeve të 17 shkurtit e 15 majit 1982 e mbante të paprishur e të papërlyer Partinë e vetë komuniste. Ai kishte ndëgjuar gjithashtu se Xhafer Shatri me shokët e vetë e mbanin OMLK të paprishur e të papërlyeme dhe kishin plane me e riorganizuar në rangun e një Partie komuniste dhe për këtë kishin bekimin e diplomatëve të Shqipërisë. Vetëm ky (Sabriu) rrezikonte me mbetur pa parti komuniste, e me këtë edhe me ra në fund të pusit. Pasi i mungonte orientimi e aftësia ideore, ai kërkonte që këtë punë patjetër ta bëjë unë, pasi sipas tij, unë kisha orientim dhe aftësi ideore me e udhëheqë një parti komuniste. Mjeshtërinë dhe shpirtin e tregtisë për ta shfrytëzuar çdo situatë të çastit Sabriu kërkonte që unë t'i zbatoi në fushën e luftës së ideve dhe të politikës. Natyrisht, se përkundër mospërvojës unë nuk kam pranua të hyj në aso lojëra kurrë dhe kam menduar atëherë dhe mendoj edhe sot se politika e principeve ndjek një rrugë që dallohet në thelb nga ajo e tregtisë.

Në këtë stil, Sabriu i thirrke shokët në Zvicër, si Asllan Muharremin e Haxhi Berishën dhe më akuzonte se nuk po dua me e formua Partinë Komuniste, duke shtuar se bani e e formuan ata në Zvicër Partinë Komuniste para nesh atëherë mos vetë për ne.

Më 14 janar 1985 (dita më e afërt me 17 janarin) është zhvilluar një demonstratë në Shtutgart, dhe për të marrë pjesë ne te kam udhëtuar prej Stockholmi. Kjo është rruga e fundit që e kam bërë duke i shkelë disa rregulla ligjore, është rruga e fundit që e kam bërë si person i organizuar në një organizatë politike.

Në nëntor e dhjetor 1984, Sabriu, në bazë të bisedave që kishte me Shukriun fillon me e ndie veten të penduar se pse është prishë prej Xhafer Shatrit, pasi një afërsi me te kishte me i sjellë fitim më të madh. Në fund të janarit 1985, me ftesën e tij i shkova në banesë ku banonte nja 4 stacione të Metros së Stockholmit prej meje, në Magnus-Ladulåsgatan, pasi ishim marrë vesh disa ditë më parë se do të gatuante ndonjë send me shije nga ushqimet e Kosovës. Shkova në banesën e tij sipas marrëveshjes. Në banesën e tij e shfaqi një eufori të grindjes e të dëshpërimit në mua, e të disa fjalëve të pamatura, për të cilat vet pas disa ditësh pendohej, për të cilat kurrë nuk ia kisha bërë as provokimin më të vogël. Thelbi e stili i kësaj dreke të përgatitur ishte:

-Ti nuk je i interesuar me e luftue Jugosllavinë!
-Ti nuk lufton për marrjen e pushtetit!
-Ti nuk lufton për shkatërrimin e Jugosllavisë!
-Prej sotit kam me të luftue me të gjitha forcat!
-Matu mirë!
-Mprehe penën!
-Priti grushtat e mijë!

Ishin sulme aq të pabaza e të thëna në mënyrë aq të ulët sa më befasuen së tepërmi. Më demoralizuan shumë, sidomos kur të kihen parasysh rrethanat në të cilat e kisha njohur dhe fakti se ishte personi që më kishte njoftuar me Jusufin, punë të cilën nuk e nënvlerësoj e harroj kurrë. Se akuzat e tij do të më dëmtojnë para shokëve në Shtutgart (Hafiz Gagicës, Remzi Ademajt, Mejdi Rexhës, Shaban Bobajt etj.) këtë nuk e kisha fijen e merakut. As shqetësimin më të vogël nuk e kisha se do të ketë ndikim në Zvicër tek Haxhi Berisha, Januz Mustafa, Elamz Ademi, Demë Mustafaj e Xhemail Dauti, që ishin përkrahësit kryesor të Zërit që dilte në Suedi. Skandalet e tij të krijuara me Xhafer Shatrin para 14 muajve në sofrën e Xhafer Shatrit ishin tepër të freskëta për ta. Kështuqë Sabriu, publikisht nuk ndërmori kurrfarë hapi. U kishte thënë shokëve në Zvicër se më nuk ka punë me ketë gazetë.

Pas akuzave të tij kontaktet e mia me te u ndërprenë seriozisht. Me përjashtim të disa takimeve spontane në Malmö, jemi takuar disa herë në ditët kur u kthyen eshtrat e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut në shkurt 2002, së bashku me Ali Ademin e Hafiz Gagicën. Më 2004 më mori Shukri Demiri dhe shkuam tek Sabriu. Shukriut i thash se i kam disa punë, por ai kërkoi që të mos mbaj inate dhe kur më tregoi se ka ardhë në Prishtinë tek vëllau e shkuar vëllaut për punën e hises, u detyrova me e shoqërua, edhe pse e kisha të pamundur me e fsheh lakminë për atë se si nuk u gjet dikush edhe për mua për me më lanë trashëgim diçka apo me më shti në hise edhe mua.

Sabri Novosella: *"Xhafer Durmishit, bashkëveprimtarit dhe bashkë-punëtorit më të afërt të Heroit Jusuf Gërvalla në Gjermani. Me respekt Autori. Shkurt 2012"* (Fjalë të nënshkruara në ekzemplarin tim, si dhuratë për mua, në librin "REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH, Prishtinë 2012)

Duke pasur përkrahjen e pa rezervë të shokëve në Shtutgart dhe atyre që i kishte lidhë në Zvicër me punën tonë Haxhi Berisha, unë vazhdova me e nxjerrë gazetën si më parë, por ndoshta edhe më mirë.

Më 16 mars 1985, në qytetin Malmö në jug të Suedisë u organizua demonstrata e parë shqiptare në Suedi, me sa di unë.

Në këtë kohë Sabriu ishte ende në Stockholm dhe takohej më së shumti me Shukri Demirin i cili ia kishte shpëtuar jetën në Turqi nga kidnapimi prej UDB-së.

*

* *

Më 1 prill 1985, një person, nga ata që i takoja e bashkëpunoja shpesh në Stockholm, (për ditën e rrenave) më ka bërë telefon në mëngjes heret dhe më ka thënë se kryeministrin e Suedisë, Olof Palmen e kanë vra. Duke pasur përvojën time me 17 dhjetorin 1981, të Mehmet Shehut, 17 janarin e Jusufit, këtë tallje të pakripë nuk e kam marrë si mahi për 1 prillin dhe as që më ka shkua mendja se është 1 prilli, derisa ky farë mahiçari më tregoi se është 1 prilli, "dita e rrenave."

Olof Palme u vra në një atentat të pasqaruar deri më sot, më 28 shkurt 1986 në Stockholm. Ky atentat, që cilësohet si prishësi i jetës e pamjes idilike të Suedisë, ndikoi shumë keq në gjendjen time.

6. Deus ex machina

Më duket në prill të vitit 1985 erdhën në Zvicër Hysen dhe Abdyl Gërvalla. Sabriu gëzohet për këtë, dhe shkon tek Shukri Demiri e i thotë se është shumë punë e mirë që ka dalë e po vazhdon me dalë gazeta prej meje (Xh. D.), pasi me këtë kemi se me çka me i dalë Hysenit përpara. Edhe mua më erdhi mirë për Hysenin e Abdylin, dhe nuk më kujtohet se tek i cili shok e kam thirrur në telefon për disa minuta, që ishte biseda e parë dhe e vetme me Hysenin.

Në këtë kohë Sabriu u shpërngulë në Malmö në jug të Suedisë, pra rreth 620 km prej Stockholmi. Sabriut, si e kam thënë më heret shpejt iu dha leja e qëndrimit e me këtë edhe pasaporta. Dhe ai shkoi në Zvicër, i bashkohet Hysen Gërvallës, duke iu përshtatë e duke ia ushqyer të gjitha teket në mënyrën e vet. Hysenin e presin me kureshtje e interesim jo vetëm shokët tonë por në mënyrë të ngjashme edhe Mustafë e Emrush Xhemaili, Hasan Mala etj. Por këto gjëra unë nuk i dija në hollësi, pasi edhe nuk isha i informuar edhe nuk mund të udhëtoja vetë, pasi shqyrtimi i lëndës time të azilit nuk kishte përfunduar. Rreth një muaj, pas ardhjes së Hysenit e Abdylit në Zvicër, nga Zvicra ato ditë erdhi Asllan Muharremi që të kërkoj strehim në Suedi, në Stockholm. Prej tij i mësova disa sende apo thënë më drejtë mjaftë thashetheme e intriga të emigracionit në Zvicër.

Në këtë kohë u botuan numrat e fundit të Zërit të Kosovës në Suedi. Përmbajtjen e tyre kryesore e kam botuar në librin "Protesta e Aspirata" më 2006. Shokët tonë në Gjermani dhe Zvicër i mbështeten në një masë të mirë Hysenit dhe në këtë pikë unë nuk shihja gjë të keqe.

Nga pritja zemërhapur që i bëhet Hysenit kudo, ai i merr mësysh vetes dhe shkruan një letër ku shprehej mendjemadhësia dhe nënçmimi ndaj punës së të tjerëve. Pjesën kryesore nga kjo letër po e jap si më poshtë:

"Letër e hapur Tri grupeve që, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së

Që në fillim e shoh të udhës të theksoj se propozimi i parashtruar më poshtë, është mendim i lirë, i mbështetur në qëllimet më të sinqerta, të cilat ia ka imponuar koha dhe momenti çdo njeriu të ndershëm të popullit tonë e që jam i bindur se i ka parasysh secili prej jush.....

.....Madje, edhe nëse ekziston ndonjë grup apo organizatë tjetër me orientime dhe qëllime të drejta, mendojmë se është e udhës t'i bashkohet Lëvizjes së përgjithshme. .....

..... Në bazë të këtyre dal me këtë propozim:

-që te tri grupet t'i autorizojnë përfaqësuesit e vet me të gjitha kompetencat e duhura, prej 3-5 vetave.

-bashkimi të bëhet pa asnjë kusht nga të tri grupet ekzistuese, respektivisht organizatat. (Po deshëm të arrihet mirëkuptimi, duhet t'i hedhim poshtë të gjitha pretendimet se njëra është e drejtë, se tjetra është më e fortë, apo se "akëcila" është koka e kombit shqiptarë, pretendime këto megalomane, tendencioze, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi shkojnë në dobi të armikut e që pengojnë bashkimin e lakmueshëm). .....

.....Po që se ky bashkim nuk arrihet, do të vërtetohet edhe njëherë se në mesin tonë ka njerëz që punojnë për armikun, do të vërtetohet papjekuria jonë në çështjen e madhe, e cila duhet të qëndroj mbi çdo interes personal dhe mbi çdo tendencë individuale dhe subjektive.

Duhet t'ua theksojmë shokëve të ndershëm që të marrin drejtqëndrimin dhe ta thonë fjalën e vet, çdo njëri në emër të kësaj çështjeje të madhe, të distancohet secili pa

ngurrim, pa humbur kohë dhe pa luhatje prej grupeve, prej dinastive, familjarizmit, bajraktarizmit, përkatësive primitive fisnore e të odës dhe mbi të gjitha prej "Krerëve" që pengojnë bashkimin; ta thotë secili fjalën e vet haptas, mendimin e vet të lirë e konstruktiv, sepse siç ka theksuar Ismail Qemali, çdo shqiptar i ndershëm ka të drejtë të flasë në të mirë të kombit dhe atdheut.
Nder i madh është të përcaktohesh në shërbim të atdheut, ndërsa tradhti të vihesh në shërbim të individëve destruktivë, sepse forca qëndron në masë e jo në grupe e as individë. Delemont – Zvicër, 12 korrik 1985"

Si iu kanë përgjigj të tjerët, me gojë apo me shkrim nuk e di. Unë e kam marrë përsipër që në emër të shokëve tonë t'ia jap një përgjigje me shkrim. Përgjigja ime ka qenë kjo:
"Përgjigje në letrën e H. Gërvallës
Nga ti, H. Gërvalla e kemi marrë një letër të datës 12 korrik 1985. Ne e analizuam atë me kujdes, e lexuam disa herë, dhe këtu më poshtë po të japim përgjigjen tonë në letrën tuaj të datës së lartpërmendur.
Ne e dimë se jeni vëllau i madh i dy vëllezërve që u vranë më 17 janar 1982 pranë Shtutgartit. Ky është një fakt shumë domethënës dhe i mirë për ne të gjithë, por për shkak të luftës sonë, karakterit të saj, fazave të zhvillimit të saj, vetëm kjo e dhënë nuk mjafton që ne të mirremi vesh në të gjitha pikat.
Prandaj prej teje kërkojmë:
1. Që të na tregosh për platformën tënde politike, pasi letra është shkruar në emrin personal, pasi ajo nuk na është e njohur plotësisht.
2. Të na tregosh se ne që na e ke dërguar këtë letër, si për kend na e ke dërguar? Sipas pikëpamjeve tuaja kush jemi ne në këtë rast para teje: A jemi grup, organizatë, dinasti, rreth familjar, bajraktarë, injorantë, grup i përkatësive primitive, komunistë, ballistë, liberal, demokratë apo nuk po e dimë as vetë kush jemi e nuk po e shohim veten. Për këtë arsye ne kërkojmë ta dimë se çka jemi para teje. Çka din ti për programin e statutin tonë dhe si qëndron në raport me to? Çka mendon për gazetën tonë dhe kujt i shërben ajo?
3. Të na tregosh se kush janë dy grupet tjera, që ua ke dërguar letrën dhe që je optimist se do t'i bashkosh të gjithë në një vend? çfarë pikëpamjesh politike kanë, çfarë interesash mbrohen pas fjalëve dhe deklaratave të tyre nëpër gazeta? Cili është programi e statuti i tyre, pasi ne këto nuk i dimë?
Të gjitha këto pika të ndryshimeve, të gjitha pikat e përbashkëta duhet t'i ketë të qarta një njeri që donë të bashkoj dikend, duhet t'i ketë të qarta një grup i cili donë të bashkohet me një tjetër.
Në të gjitha këto pika duami paraprakisht të sqarohemi më shumë nga ti para se nga ana jonë, të japim ty personalisht çfarëdo mendimi të mëtejshëm lidhur me (iniciativën) letrën tënde të hapur. Në vartësi nga ajo nga ajo se si do të na sqarosh në pikat që shënuam më lartë do të varet edhe qëndrimi e përgjegjja jonë në të ardhshmen.
Xhafer Durmishi
22 korrik 1985, Stockholm"

Letra paraprake e 22 korrikut është shkrimi i fundit që ia kam dërguar dikujt në cilësinë e anëtarit të një organizate. Nga dy shkrimet e mia te fundit, më të gjatat, të shkruara e të botuara në maj e qershor të vitit 1985 shpallet se gazetës (Zëri i Kosovës) të cilën ne e nxirrnim duhet t'i ndërrohet emri. Do të ndërrohej edhe emri i organizatës në të cilin vepronim.

Isha shumë i bindur dhe shumë i kënaqur për zhdukjen e përzierjeve të vitit 1984. Pikërisht në kohën kur mendoja se i kishim kaluar pjesët më të vështira të rrugës sonë, shokët më të afërt të organizatës në Zvicër e Gjermani kërkuan që makina e shkrimit me të cilën ishte nxjerrë gazeta në Suedi të dërgohet në Zvicër. Me kaq, në mënyrë shoqërore, përfunduan marrëdhëniet e mia praktike politike me ta, në kohën kur unë veç sa i kisha mbushur 27 vjet. Pra është fakt i vërtetë se të gjithë ata u larguan nga unë, ata u ndanë nga unë dhe jo unë nga ata. Që nga dalja ime jashtë Kosove, në qershor 1981, jam përpjekur që pa asnjë rezervë t'i qëndroj në disponim rrethit në të cilin jam gjendur dhe kurrë nuk kam thënë se nuk dua a nuk mundem ta bëjë këtë ose atë punë që më është ngarkuar, nëse kam qenë i bindur se shkon në interes të popullit.

Por, jam krenar për faktin se këtë barrë të pakërkuar nuk e kam hequr vetë, por ma kanë hequr të tjerët.
Për shkak të mosmarrëveshjeve, në korrik 1983 pata kërkuar dorëheqje nga rrethi në të cilin veproja por më është bërë presion që të mos largohem. Tërheqjen e kërkesës time për dorëheqje e konsideroj të gabim të madh.
Është fakt se emri i Jusuf Gërvallës më ka futur në qendër të aktivitetit për Kosovën, në mërgim, në ato vite. Nuk jam plotësisht i sigurt se a kam nevojë dhe nëse po, deri në çfarë shkalle më duhet t'ia di për nderë mbiemrit të tij, për pushimin tim të merituar nga politika ilegale e emigracionit, nga e cila nuk kam marrë asnjë ftesë që të kthehem ndonjëherë.

Emrush Xhemaili: "*1985: Hysen Gërvalla kooptohet në Komitetin Qendror të LPRK-së."* (20 vjet veprimtari 1982-2002)

DISA VEPRIMTARI VAMPIRE

1. Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtaria e saj

2. Shkolla "komuniste" e UDB-së Serbe
-Përfaqësuesit e Partisë "Komuniste" në LRSSHJ
-SHOKËT E PARTISË "KOMUNISTE" NË LRSSHJ

3. LNÇKVSHJ-ja nuk do të bashkohet kurrë me platformën e LPRK-së

1. Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtaria e saj...

"Bërthama revolucionare, paraardhëse e OMLK-së, më 1969 u muar me organizimin e demonstratave të 27 nëntorit 1968, por realizimi i tyre për shumë shkaqe dështoi.

Ky dështim për bërthamën revolucionare ishte një mësim i mirë për luftën e mëtutjeshme. Kështu që posa dolën nga burgu ata më parë u morën drejtpërdrejt me organizimin duke formuar më 1972 "Grupin Revolucionar" (GR).

GR-ja duke aplikuar metodat marksiste-leniniste të veprimtarisë ilegale si dhe duke u bazuar dhe mbështetur fuqimisht në mësimet e klasikëve të marksizëm-leninizmit arriti që të krijoj një rrjetë të fortë dhe të qëndrueshme organizative, e cila jepte shpresa se më në fund do të sigurohej një vazhdimësi e sigurtë e veprimtarisë revolucionare në Kosovë.

Me konsolidimin e radhëve dhe me sprovimin e anëtarëve në aksionet masive të shpërndarjes së trakteve dhe shkruarjes së parullave gjatë viteve 1973 dhe 1974, GR-ja u muar edhe më me intensitet në forcimin e propagandës së shkruar, duke nxjerrë edhe Organin e vet "Zërin e Kosovës".

GR-ja si e tillë arriti të nxjerrë vetëm një.. numër të Organit "Zëri i Kosovës", pasi që bërthama udhëheqëse revolucionare burgoset në maj të vitit 1974.

Pasi që GR-ja kishte aplikuar katërcipërisht metodat dhe mësimet marksiste-leniniste të veprimtarisë revolucionare ilegale, në këtë mënyrë edhe u ruajt kontinuiteti i veprimtarisë.

Për një kohë të shkurtër, shokët e mbetur ia arritën të rivendosnin lidhjet dhe të konsolidohen radhët dhe të hidhen në aksione të pandërprera. Një ndër këto aksione ishte edhe aksioni i madh i shpërndarjes së trakteve dhe shkrimit të parullave më 24 dhjetor 1974, në prag të gjykimit të Bërthamës Revolucionare të GR-së.

Edhe burgosjet e disa shokëve më 1975 nuk shkaktuan ndërprerjen e veprimtarisë, pasi që shokët e GR-së duke u mbështetur fuqimisht në mësimet marksiste-leniniste dhe në vijën e përcaktuar politike, ideologjike, strategjike e taktikën e GR-së që më 1972, shkuan më tej në intensifikimin e luftës, në përsosjen e teknikës konspirative dhe organizative. Duke arritur që më 1976 GR-ja, me zgjerimin e radhëve dhe me ngritjen e kalitjen e anëtarëve, të shndërrohet në "GRUP MARKSIST-LENINIST TË KOSOVËS" (GMLK).

Gjatë viteve 1976-'78 GMLK-ja merret me përpilimin e materialeve për ngritjen teorike, ideologjike, politike dhe organizative të anëtarëve të vet. Ndër këto materiale ishin edhe: "Për zgjerim të radhëve", "Udhëzime për konspiracion", "Takimet", "Mbledhjet", "Disiplina" etj.

Më 1978, me shtimin e vëllimit të detyrave dhe me zgjerimin e mëtutjeshëm të radhëve të GMLK-së, u paraqit nevoja e domosdoshme e organizimit në nivel më të lartë organizativ dhe e shndërrimit të GMLK-së në "ORGANIZATË MARKSISTE-LENINISTE TË KOSOVËS" (OMLK), pasi që Grupi si grup nuk ishte në gjendje të përthekojë e të kryej me sukses të gjitha detyrat që i dilnin përpara dhe që i parashtronte koha.

Komiteti drejtues i OMLK-së, duke ndier nevojën për ngritjen teorike, ideologjike e organizative të anëtarëve, në fund të vitit 1978 nxori numrin e parë të "Pararojës", Organ për radhët e saja të brendshme.

Për punën e drejtpërdrejtë me masat e gjera popullore të shtresave të ndryshme, para OMLK-së u shtrua si nevojë e domosdoshme edhe nxjerrja e Organit të masave, gjë të cilën OMLK e bëri në vitin 1980, kur edhe nxori numrat 1 e 2 të "Lirisë".

Ishte pikërisht "Liria", Organ i OMLK-së për masat e gjera, e cila bëri ndikim të madh tek masat, duke e ngritur në një shkallë edhe më të lartë vetëdijen kombëtare e klasore të popullit. "Liria" ndikimin më të madh e bëri në mesin e rinisë shkollore e studenteske, pasi që edhe ishte shpërndarë, lexuar dhe kërkuar më së shumti nga kjo shtresë e popullsisë.

OMLK gjer në janar të vitit 1982 nxori gjashtë numra të "Lirisë", kur edhe bëhen burgosjet masive në Kosovë, viktimë e të cilave ishin edhe shumë shokë të OMLK-së. Po në janar UDB-ja organizoi edhe likuidimin fizik të komunistit Kadri Zeka me vëllezërit Gërvalla, gjë të cilën e realizoi më 17 janar 1982 në Gjermani.

Mehmet Hajrizi: "*Në natën e 17 janarit 1982, në Untergrupenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e tri organizatave çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe **pushoi së vepruari OMLK**...."* (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 11) Mehmet Hajrizi: "*Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (sipas dëshmisë së bashkëveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."* (E njëjta vepër, faqe 307)

Pas vrasjes së shokut Kadri Zeka dhe burgosjes së shumë shokëve të OMLK-së në Kosovë bëhet edhe shkëputja e shumë lidhjeve gjë që shkaktoi ngecjen e aktivitetit intensiv.

Në kohën kur shokët brenda merreshin me rivendosjen e lidhjeve, një shok i Grupit Revolucionar ia arriti të arratiset nga burgu dhe të dal në Perëndim. Shokët e Degës së OMLK-së në Botën e Jashtme e autorizuan shokun e arratisur nga Kosova që t'i përfaqësonte në bisedime për bashkimin e forcave me LNÇKVSHJ-në dhe Partisë Komuniste MLSHJ-në të cilat më 17 shkurt 1982 kishin formuar LRSHJ-në.

Edhe pse shokët e Degës së OMLK-së ia parashtruan pikëpamjet, qëndrimet dhe

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

propozimet lidhur me bashkimin, shoku i autorizuar shkeli mbi qëndrimet e shokëve që e kishin autorizuar dhe ra nën ndikimin e imponuar të krerëve të LNÇKVSHJ-së dhe Partisë Komuniste MLSHJ-së, duke devijuar kësisoji vijën politike, **ideologjike** dhe organizative të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës.

Mehmet Hajrizi: "*Berat Luzha ka vendosur lidhjet e Organizatës me Partinë Komuniste të Kosovës, që udhëhiqej nga **Mustafë Xhemaili** e Rrahim Sadiku, të dytë nga Komogllava, komuna e Ferizajt. **Një tentim për kontakt kishte edhe me (Partinë Komuniste - shën im) PKMLSHJ**, por takimi ka dështuar ngase ata nuk kanë dal*

në takim." (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 363)
Pse nuk i ka dal në takim Abdullah Prapashtica, Berat Luzhës?
Sepse *"Martin Quni (...) Prej Hamzë Morinës e ka marrë 'Liria nr.1' të cilën ia ka dhënë Abdullahut, e ky e ka qortuar se lexon materiale të tilla, ngase siç deklaron ky i akuzuar,* ***nuk u për-puthet ideologjia."*** (Aktgjykimi i PKMLSHJ, P-K nr. 167/72; Ethem Çeku, SHEKULLI I ILEGALES, Prishtinë 2004, faqe 678)

Por ky "bashkim" që u imponua më 15 maj 1982, nuk ishte edhe bashkim i organizatave në fjalë, por vetëm bashkim krerësh, dhe si i tillë nuk mund të ishte i shëndoshë e i qëndrueshëm. Ky "bashkim" me LNÇKVSHJ-në dhe PKMLSHJ-në do të ketë pastaj pasoja të mëdha për Degën e OMLK-së në Botën e Jashtme, e cila ra nën ndikimin dhe manipulimet e shokut të porsaarratisur nga burgu.

Duke pasur besim të tepruar në aftësitë e tij, shokët e Degës së OMLK-së ranë në pozita oportuniste dhe toleruan për dy vjet me radhë manipulimet dhe manovrimet antimarksiste të këtij shoku. Kësisoji edhe u dezorientuan në veprimtarinë e tyre e në këtë mënyrë edhe ndikuan tek shokët brenda. Dezorientimi dhe dezinformimi i shokëve si brenda edhe jashtë, solli amulli në mendime dhe veprime.

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): "*Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Duke e parë një devijim të tillë të vijës politike, ideologjike e organizative, shokët e Grupit Revolucionar që dolën nga burgu në vitin 1983, u morën me riorganizimin, konsolidimin dhe bashkimin e grupeve komuniste të mbështetur në parime marksiste-leniniste. Duke u marrë me këtë detyrë mjaftë të rëndë për kushtet e krijuara në Kosovë pas burgosjeve të mëdha, që ishin bërë pas demonstratave të Pranverës së vitit 1981, ata synuan formimin e një pararoje udhëheqëse të luftës duke u mbështetur në vijën politike, ideologjike dhe organizative të përcaktuar nga OMLK, si dhe formimin e "Frontit Antirevizionist", si front të gjerë të masave. Për një kohë shumë të shkurtër ata arritën të bashkonin një numër të konsiderueshëm grupesh komuniste dhe ishin në prag të realizimit të pikësynimeve organizative të pararojës dhe frontit, por arrestimet masive të dhjetorit 1983, vrasja e shokëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha më 11 janar 1984 si dhe burgosjet e shokëve me Kadri Osmanin që pasuan në janar e shkurt 1984, shkaktuan ngecjen e veprimtarisë në këtë drejtim. Njëkohësisht me shpartallimin e lidhjeve të grupeve, celulave dhe individëve iu mundësua disa individëve në Perëndim të dezinformonin dhe manipulonin me shokët brenda. Sidomos dezinformimi që u bë shkaktoi një mosbesim te grupet dhe individët dhe u bë pengesë e një bashkimi të vërtetë komunist, bashkim i cili kishte gjasa të vendoste sërish një vazhdimësi kontinuale të veprimtarisë revolucionare në Kosovë dhe degëve jashtë.

Duke mos u arritur një bashkim i tillë komunist që edhe synohej nga grupet, celulat dhe individët, grupet, celulat dhe individët e OMLK-së u morën me riorganizimin dhe konsolidimin e radhëve të OMLK-së. Pas vetes ata kishin një mori aksionesh të suksesshme të kryera para vitit 1984, gjatë vitit 1984 dhe sidomos gjatë vitit 1985 e në fillim të 1986-ës.

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe):

"*Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Në vitin 1984 deri në maj 1985 shokët e OMLK-së pos aksioneve konkrete u morën edhe me përhapjen aktive të literaturës marksiste-leniniste, "Zërit të Kosovës" dhe sidomos të botimeve të shumta të OMLK-së gjatë vitit 1985, botime të cilat tani në Kosovë janë me qindra në qarkullim.

Edhe pranë devijimit të vijës politike, ideologjike e organizative të OMLK-së nga përfaqësuesi i OMLK-së në bisedime me LNÇKVSHJ-në dhe PKMLSHJ-në, LRSSHJ e formuar faktikisht udhëhiqej nga Dega e OMLK-së në Botën e Jashtme.

Fakti se përfaqësuesit e LNÇKVSHJ-së dhe PKMLSHJ-së dolën nga LRSSHJ tregonte se Dega e OMLK-së kishte qenë dhe ka mbetur bërthama udhëheqëse e LRSSHJ-së (LPRK).

Në shkurt të vitit 1985 shokët e OMLK-së ishin ata që e përjashtuan shokun e tyre nga forumet e LRSSHJ-së për shkak të veprimtarisë së tij antimarksiste-leniniste dhe antilëvizje si dhe për shkak të përçarjeve të mëdha që shkaktoi me veprimtarinë e tij.

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Me përjashtimin e tij OMLK-ja u rikthye në pozitat e përcaktuara politike, ideologjike dhe organizative të përcaktuara qysh para vitit 1982.

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!" (Marrë nga libri i Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 282-284)

Mehmet Hajrizi: "*Intelegjencia e Kosovës... duke qenë e re dhe në formim e sipër, nuk mund të kapte problemin në gjithë* ***kompleksitetin*** *e tij teorik..."*

Mehmet Hajrizi: " *... regjimi socialist pushtues po luftohej me socializëm*"

Berat Luzha: *"Përmes ngjyrimit ideologjik, kemi tentuar t'i kundërvihemi ideologjisë komuniste titiste."*

Teksti i betimit të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës: *"Në qoftë se e tradhtoj Organizatën dhe idealet e lirisë, mos i shpëtofsha dorës së pamëshirshme të shokëve të ."*

Mehmet Hajrizi: "*Në natën e 17 janarit 1982, në Untergrupenbach të Gjermanisë, kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: në bazë të Tezave të Frontit Populllor për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e tri organizatave çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe* ***pushoi së vepruari OMLK****...."*

"Më 1982, nga udhëheqja e saj, Organizata kishte të lirë vetëm Kadri Zekën, të cilit i binte barra e riorganizimit të radhëve dhe e realizimit të projektit të Frontit të bashkuar. Në krye të kësaj detyre, Kadri Zeka është vra bashkë me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, më 17 janar 1982, pasi (sipas dëshmisë së bashkveprimtarit të tyre, Ibrahim Kelmendit) kishin arritur marrëveshjen e bashkimit. Ata u vranë me qëllim që të dështonte bashkimi i radhëve të Lëvizjes."

KQ i LRSSHJ (Zvicër): "*Gjatë bisedimeve rreth bashkimit si kushte do t'u paraqesim këto:* ***Të dënohet bashkimi i 17 shkurtit dhe 15 majit 1982, i cili ishte një***

bashkim krerësh e jo organizatash dhe nuk ishte aspak bashkim e organizim i masave. *Një bashkim dhe organizim të masave, si jashtë ashtu edhe brenda, e patë shtruar drejtë në verën e vitit 1981 OMLK në "Teza rreth Frontit Populllor për Republikën e Kosovës" dhe në përpjekje e sipër për t'i vënë në jetë ranë shokët: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla. Këto "Teza..." u shkelën pikërisht një muaj pas rënies së tyre, në bashkimin e 17 shkurtit 1982." (*Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 255)

Ramadan Avdiu: "*Në Konferencën e parë të OMLK'së të mbajtur në* ***mars të vitit 1989*** *ku kanë marrë pjesë edhe: Afrim Zhitija, Fadil Vata, Ali Ahmeti, Hajdin Abazi, Bardhyl Mahmuti, Behajdin Allaqi, Binak Berisha etj."*
(http://pashtriku.beepworld.de/behajdinallaqi.htm)

Die Mauer, Muri i Berlinit, 16 nëntor 1989 (shtatë ditë pas tërmetit)

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe):
"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot."

Jusuf Gërvalla: "*E ndër pallate të larta të kulturës*
Le t'bredhin qentë - mos e teprova
Në ekuator le të rrëshqas Antartiku
Brenda një nate le t'bashkohet Berlini"

2. SHKOLLA "KOMUNISTE" E UDB-SË SERBE
-Përfaqësuesit e Partisë "Komuniste" (PKMLSHJ) në LRSSHJ

Kjo letër e Shkollës së UDB-së Serbe, me tentativën që edhe ne apo unë t'u përgjigjesha nga pozitat e LNÇKVSHJ, pra të fillohet edhe një herë ne zeroja, është dërguar në adresën:

Zëri i Kosovës, Box 6, 36051 Hovmantorp, Sweden

Shkolla e UDB-së Serbe: "*Shokëve të LNÇKVSHJ 13 shkurt 1985*

Në bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.

PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shofim të arsyeshme që edhe njëherë t´i përtrijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpikët me forca të përbashkëta.

Njëkohësisht kërkojmë nga ju që t´i shtroni të gjitha vërejtjet tuaja në punën tonë nga bashkimi gjer më tani, dhe t´i jepni vlerësimet tuaja se si duhet gjykuar ato.

Jemi të gatshëm të përmirësojmë çdo lëshim që ka mundur të ndodhë gjatë aktivitetit tonë, të japim autokritikë dhe përgjegjësi konkrete, ashtu siç do t´i kërkojmë këto edhe nga të tjerët.

Kritizimet e pavenda do t´i luftojmë, ashtu siç do të jemi këmbëngulës në zbatimin e përcaktimeve themelore për çështje të atdheut.

Përgjigje në letër presim gjer më 15 mars 1985.

Përfaqësuesit e Partisë Komuniste MLSHJ në LRSSHJ

Kushtrimi, Halimi, Qemali, Luani ..."

Letra ka 5 nënshkrime katër prej të cilëve janë: Kushtrimi-Abdullah Prapashtica, Halimi -Osman Osmani, Qemali - Faton Topalli, (të tretë pjesëmarrës të bisedimeve më 17 shkurt 82). Përveç Shkollës së UDB-së Serbe, kjo letër është nënshkruar edhe nga Luani-Nuhi Sylejmani dhe një tjetër.

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot."*

Xhafer Durmishi: *"Shikoni grupashët! Shikoni se si erdhën këta elementë si cjapi tek kasapi. Letra e 13 shkurtit është drejtuar në adresë të redaksisë. Së pari u bëjmë me dije se adresa e "Zërit të Kosovës" në Suedi nuk është adresë e LNÇKVSHJ, e as organi nuk është i saj. Është krejt tjetër çështje nëse me këtë organ janë elementët më të shëndosh të ish-LNÇKVSHJ. Pra letra është drejtuar në adresë të gabuar, është në një adresë të diçkafit që për ne më nuk ekziston. .... Tek ne nuk gjetët LNÇKVSHJ siç keni gjetur OMLK në adresa tjera."* (Zëri i Kosovës Nr. 7-8, korrik 1985, Suedi)

-SHOKËT E PARTISË "KOMUNISTE" NË LRSSHJ

Kjo letër e Shkollës së UDB-së Serbe, me tentativën që edhe ne apo unë t'u përgjigjesha nga pozitat e LNÇKVSHJ, pra edhe në vitin 1985, tri vjet pas 17 shkurtit 1982, t'ia fillojmë nga zeroja, është dërguar në adresën:

Zëri i Kosovës, Box 6, 36051 Hovmantorp, Sweden

Shkolla e UDB-së Serbe: *"Shokë,*

Pas letrës së 13 shkurtit 1985 erdhëm dy herë në... dhe në rastin e parë u takuam me... ndërsa në rastin e dytë u takuam me shokun... Me këta shokë biseduam afërsisht dhe në

mes neve pati një mirëkuptim vëllazëror. Megjithate ata nuk patën mundësi që të na përgjigjen për çështjet që u shtruam ne pasi ata deklaruan se nuk kanë kompetenca për përfaqësim. Mirëpo ne bisedum gjërësisht e shoqërishtë me ata dhe të gjithë i shprehëm mendimet tona duke u pajtuar me faktin se sanimi i marrëdhënieve dhe arritja e forcimi i unitetit janë të domosdoshme. Shoku… pos të tjerash i shprehu disa ide të veta mbi rrugën deri te ky qëllim, dhe ne pranë asaj që i paraqitëm qëndrimet tona të palëkundshme se do të qëndrojmë pranë Vendimeve Themeluese të bashkimit të LRSSHJ i premtuam se në ato ide do të përgjigjemi pas konsultimeve me shokët e bazës. Përgjigja jonë si tërësi është që para së gjithash çdo gjë duhet të fillohet nga vendimet e 17.II.1982 që ishin dhe mbesin kushte themeluese të bashkimit të LRSSHJ dhe që nga këto baza pastaj ka mundësi të bëhen edhe plotësime e ndryshime tjera. Edhe biseda që u zhvillua me shokun… ishte e frytshme, dhe ajo burrëri e tij dhe qëndrimi i tij se duhet të vazhdohet me zbatimin e vijës së LRSSHJ sipas vendimeve themeluese të bashkimit, na inkurajoi në rrugën tonë që të arrihet uniteti i plotë.

Ju komunikojmë edhe njëherë se qëndrojmi para asaj që u tha edhe në letrën e 17.II.1985, dhe nga ju kërkojmi që sa më parë të na paraqitni përfaqësuesit kompetent të OMLK e LNÇKVSHJ të mëparshme që sa më shpejt që është e mundur të bëjmi një takim. Edhe në bisedat që i patëm me shokët që i cekëm kemi thekësuar dhe po ju lusim edhe njëherë që në mesin e atyre që do të ju përfaqësojnë të mos jenë ata që deri më tani penguan bashkimin dhe që shkaktuan përçarjet, që ishin zbatues të komploteve, që kanë bërë veprime antiparti e antilëvizje dhe ata që kanë patur çfarëdo kontakti me reaksionin e vjetër ballisto-ustash. Sepse ata që kanë punuar kundër bashkimit dhe që janë kundër tij, sigurisht që këtë rrugë do ta vazhdojnë.

Presim përgjigje me shkrim gjatë muajit Qershor.

shokët e PKMLSHJ" (Si letra e parë ashtu edhe e dyta janë botuar në Zërin e Kosovës Nr. 7-8, që ka dalë në Suedi, në korrik 1985)

> Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Xhafer Durmishi: *"Shikoni grupashët! Shikoni se si erdhën këta elementë si çjapi tek kasapi. Letra 13 shkurtit është drejtuar në adresë të redaksisë. Së pari u bëjmë me dije se adresa e "Zërit të Kosovës" në Suedi nuk është adresë e LNÇKVSHJ, e as organi nuk është i saj. Është krejt tjetër çështje nëse me këtë organ janë elementët më të shëndosh të ish-LNÇKVSHJ. Pra letra është drejtuar në adresë të gabuar, është në një adresë të diçkafit që për ne më nuk ekziston. .... Tek ne nuk gjetët LNÇKVSHJ siç keni gjetë OMLK në adresa tjera."* (Zëri i Kosovës Nr. 7-8, korrik 1985, Suedi)

3. LNÇKVSHJ-ja nuk do të bashkohet kurrë me platformën e LPRK-së

Faridin Tafallari: *"Akoma nuk kishim vendosur se çdo të bënim për lejen e marshimit (*rreth **17 janarit 1987** - shën i Xh. D.*) Më në fund ramë dakord. Po cili do ta merrte lejen? Më mbeti mua. Hasani (Plaku - Mala-shën i Xh. D.) u lajmërua me telefon dhe më tregoi se kishte biseduar me Sabri Novosellën dhe ky i kishte thënë se as ai nuk do të vinte në përkujtimin e dëshmorëve dhe as shokët e tij nuk do të vinin. U habita por i thash: "Mirë, ne kemi vendosur si Komitet i LNÇKVSHJ dhe KVG për*

botën e jashtme që u formua me 5 anëtarë me emër LNÇKVSHJ në kuadër të LPRK."" (Terror-Dhimbje, Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 110)

Me Komunikatën e mëposhtme nuk kam të bëjë. Aktiviteti im si anëtar i Organizatës së vetme që e kam njohur në kohën në fjalë, Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, ka përfunduar më 22 korrik 1985, 25 vjet para 22 korrikut 2010.

"KOMUNIKATË

Pothuajse nuk kalon numër i revistës "Zëri i Kosovës", që mban myhyrin e të ashtuquajturës Lëvizje Popullore për Republikën e Kosovës e të mos u servohet lexuesve ndonjë lajm sensacional e i trilluar.

Një lajm i tillë, fund e krye shpifës, është edhe e ashtuquajtura kumtesë e bashkimit të ri të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi me Organizatën e Marksistë-Leninistëve të Kosovës në LPRK-ë, i cili u botua në një nga numrat e fundit të "Zërit të Kosovës" e po propagandohet me bujë të madhe nga vet organi në fjalë. Meqë ky lajm është gënjeshtër dhe ka si qëllim të çorientoj mërgimtarët dhe të gjithë ata që duan një bashkim të patriotëve e revolucionarëve të vërtetë në një front kombëtar kundër armiqëve të popullit shqiptar – serbomëdhenjve, LNÇKVSHJ-ja e hedh poshtë si të pavërtetë e që s'ka asgjë të përbashkët me të.

> Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

LNÇKVSHJ-ja nuk do të bashkohet kurrë me platformën e LPRK-së, që s'është gjë tjetër pos çoroditje e luftës së popullit shqiptar që jeton në trojet e tij stërgjyshore në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, për barazi të plotë me popujt vëllezër të Jugosllavisë, të drejta këto që janë shkelur nga serbomëdhenjtë. Ajo nuk mund të bashkohet kurrë me një të vetëquajtur LPRK-ë e cila që nga lindja e saj e deri më sot nuk ka asgjë të përbashkët me luftën e popullit shqiptar në Jugosllavi, por përkundrazi gjithë misioni i saj ka qenë çoroditja e kësaj lufte, gjë që është në përputhje të plotë me interesat e armiqëve të kombit shqiptar – shovinistëve serbë.

Gjersa populli shqiptar i Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare në Jugosllavi është ngritur i tëri dhe po kërkon barazi të plotë me popujt tjerë të Federatës; që Kosovës t'i njohet statusi i republikës së federuar etj., dhe këto kërkesa nuk pranohen nga "famozja redaksi" e Bielit, atëherë lind pyetja: Si mund të bashkohet me këtë redaksi LNÇKVSHJ-ja, e cila ashtu si edhe grupe, patriot e revolucionarë, ka luftuar me dekada kundër armiqëve të kombit shqiptar — shovinistëve serb? Jo, kumtesa është gënjeshtër dhe s'ka asgjë të përbashkët me LNÇKVSHJ; ajo është çorbë e kuzhinës së Bielit.

Përderisa LPRK-ja vazhdon të ecë në këtë udhë pa krye, duke shkelur mbi interesat e popullit tonë të shumvuajtur, por të pamposhtur; derisa s'është e liruar nga fryma e fëlliqur e grupit, nga sektarizmi, lokalizmi e element të dyshimt e karrierist, të cilëve tani për tani në dinastin e Biel-Binnit, po u ofrohen mundësi për të realizuar qëllimet e tyre të ulta e antishqiptare – LNÇKVSHJ-ja nuk do të ketë asgjë të përbashkët me këtë lëvizje të çoroditur.

LNÇKVSHJ-ja ka mbështetur dhe do ta mbështes me të gjitha forcat që ka në dispozicion luftën e drejtë dhe të ligjshme të më se dy milion shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi, për të gëzuar të gjitha të drejtat që gëzojnë popujt e

Jugosllavisë dhe që dalin nga lufta e më se 50 mij partizanëve kosovarë që derdhën gjakun gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe nga vetë Kushtetuta e Jugosllavisë, ashtu siç e mbështesin këtë luftë të drejtë të gjithë patriotët dhe revolucionarët e vërtetë pa marrë parasysh grupet në të cilat bëjnë pjesë.

RROFTË POPULLI SHQIPTAR!
RROFTË FLAMURI KUQ E ZI ME YLLIN PARTIZAN!
RROFTË KOSOVA – REPUBLIKË!
POSHTË SHOVINISTËT SERBË!
LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE VISEVE TJERA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI"

Abdullah Prapashtica ("komunist" e ish-inspektor i UDB-së Serbe): *"Ka pas tentativa të armiqve për zhbërjen e bashkimit edhe atëherë! Zhbërja e bashkimit të LRSSHJ ka dështuar edhe atëherë dhe është e destinuar të dështojë edhe sot." (www.albaniapress.com, 2 maj 2011)*

Shkolla e UDB-së Serbe: "N*ë bazë të situatës aktuale dhe të kërkesave të masave për sanimin e marrëdhënieve në LRSSHJ, u drejtohemi me anën e kësaj letre përmes së cilës u ofrojmë edhe njëherë bashkëpunim dhe aktivitet të përbashkët duke u mbështetur në vendimet e 17 shkurtit 1982.*

PKMLSHJ dhe LNÇKVSHJ si forca themeluese të LRSSHJ kanë përgjegjësinë historike për fatin e LRSSHJ. Andaj e shofim të arsyeshme që edhe njëherë t´i përtrijmë përpjekjet e sinqerta për mënjanimin e të gjitha pengesave përçarëse dhe të vazhdojmë luftën të bashkuar në LRSSHJ.

Të vetmin kusht që e shtrojmë është zbatimi i vendimeve të 17 shkurtit 82 në mënyrën më të përpikët me forca të përbashkëta." (Letër e "mbyllur", 13 shkurt 1985)

Xhafer Durmishi: *"Shikoni grupashët! Shikoni se si erdhën këta elementë si cjapi tek kasapi. Letra 13 shkurtit është drejtuar në adresë të redaksisë. Së pari u bëjmë me dije se adresa e "Zërit të Kosovës" në Suedi nuk është adresë e LNÇKVSHJ, e as organi nuk është i saj. Është krejt tjetër çështje nëse me këtë organ janë elementët më të shëndosh të ish-LNÇKVSHJ. Pra letra është drejtuar në adresë të gabuar, është në një adresë të diçkafit që për ne më nuk ekziston. .... Tek ne nuk gjetët LNÇKVSHJ siç keni gjetë OMLK në adresa tjera."* (Përgjigje e hapur në Zëri i Kosovës Nr. 7-8, korrik 1985, Suedi)

Në bazë të fakteve të lartpërmendura mund të thuhet se të gjithë paskan bërë gabime identike. Megjithatë, kur jemi në analizimin e kësaj gare në veprimtari vampire, na duhet patjetër ta bëjmë një renditje, apo siç është e rendit në çdo garë, ta shpallim se kujt i takon fitorja respektivisht po-beda.

Me dhimbje të thellë detyrohem të shpalli se;

-Vendin e fundit, apo dhami i bronzit/porcelanit apo kalciumit i takon atyre që në emër të LNÇKVSHJ e kanë përpiluar Komunikatën e përmendur më heret;

-Vendin e dytë, Dhamin e sermit e fiton Shkolla "komuniste" e UDB-së Serbe me letrat e saj, dhe në fund;

-Vendin e parë, fitorja apo po-beda dhe Dhami i dukatit, i Vladit – Drakulës, së bashku me alltinë e alltanit dhe një kese kikirika i takon Organizatës Marksiste-Leniniste, si repart pararojë i bednjakave, e cila e ka mbajtur frontin, e palëkundur prej erërave të hudrave e furtunave të ndryshme, deri në tërmetin e vitit 1989.

LËVIZJA E JUSUF GËRVALLËS
dhe
SHTETI SHQIPTAR
1979-1984

1. KUNDËRHELMI I HELMIT
2. Regjistrimi i Stazhit në Kafé Moska
3. Ai që hyn në lojë duhet lojën ta duroj
4. Në dobi të revolucionit e të socializmit
5. Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë
6. Takimet tek Tefiku
7. Puna e parë që bëra
8. Këshilla për Jusufin të diplomatëve shqiptarë në Vjenë
9. Jusuf Gërvalla dhe sugjerimet e ardhura nga atdheu
10. Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!
11. Ju keni ku merrni mendime
12. Sa mund të më ndihmoni ju së andejmi?
13. Porosia për Jusufin nga Kongresi VIII i PPSH
14. Formimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë
15. Kosovës po i vriten djemtë nga serbomëdhenjtë
16. Shkuarja në Vjenë për të gjetur ngushëllime
17. Tek Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982
18. Përcjellja e familjes së Jusufit në Shqipëri
19. Pritja e Familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri
20. Kërkesa për njohje dhe mosnjohja
21. E din serbët kend e lëshojnë nga burgu!
22. Refer të njëanshëm, dyanshëm apo neutral
23. Qëndrime të kosovarëve në Shqipëri
24. Nuk jam për atë që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët
    - Ai që hynë në lojë duhet lojën ta duroj
25. Udhëzime inspiruese nga Ambasada Shqiptare në Vjenë
26. Propozime për ndërtim raportesh me Partinë e Punës së Shqipërisë
27. PPSH dhe organizatat e majta të Kosovës
28. Hoxha engjëjt dhe xharrahët

1. KUNDËRHELMI I HELMIT

FAKTE për disa "DËSHMI" të shprehura në shkrimin "DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ" të Ramadan Pllanës, në formë të një interviste dhënë Fadil Shytit dhe Kristina Rasit, 17 mars 2009, publikuar në www.albaniapress.com dhe www.pashtriku.org

Citatet e mëposhtme të Ramadan Pllanës, me përjashtim të atij 18 shkurtit 2011, janë marrë nga shkrimi i lartpërmendur.

Xhafer Durmishi: *"E nderuara Znj. Nevila,*

Unë quhem Xhafer Durmishi. Adresën Tuaj e kam marrë përmes Faridin Tafallarit, një shok i imi në Gjermani. Nga viti 1984 jetoj në Suedi, por fillimisht vij nga një fshat i vogël në periferinë e Prishtinës. Jashtë Kosovës kam dal pas demonstratave Pranverës 1981 dhe kam qëndruar një kohë në Gjermani. Për punët e aktiviteteve tona, në shkurt 1982 kam udhëtuar me aeroplan nga Munihu në Stamboll. Me një shok, më 16 shkurt 1982 në marrëveshje me Babain Tuaj, Bujarin, jemi nis nga Adapazari dhe në mëngjesin e 17 shkurtit kemi shkuar në Ambasadën Shqiptare në Ankara. Nga 17 - 22 shkurt 1982 jam takuar vazhdimisht me Bujarin. Nuk po dua me të lodhë më shumë me detaje në këtë rast, pasi qëllimi im ishte vetëm me të treguar se si jam takuar me Babain Tënd.

Kam kujtime shumë të mira prej atyre ditëve. Megjithatë unë jam i vetëdijshëm për faktin se Bujari gjatë jetës së tij është takuar me shumë personalitete të Kosovës dhe institucionet e Kosovës e kanë shpreh respektin për Te, dhe në këtë drejtim, në krahasim me të tjerët, ndoshta unë e kam vështirë të them diçka të re.

Në këtë rast do të isha mirënjohës nëse mundeni me më ndihmuar me dy gjëra:

*1. A ka qenë Bujari **NË TETOR TË VITIT 1979 NË TURQI APO JO?***

2. A kishi mund me e skanuar një fotografi-portret të fillimit të viteve 1980-të dhe me ma dërgua.

Nëse ia arrij të them ndonjë fjalë me vlerë do të ishte mirë, nëse jo, gabimi apo e meta do të më binte vetëm mua dhe askujt tjetër. Shumë të fala, Xhafer Durmishi (Letër të bijës së Bujar Hoxhës, 24 mars 2011)

Nevila Nika: "*I nderuar zoti Xhafer,*

*Shumë faleminderit për emailin tuaj. Është gjithmonë kënaqësi e madhe për mua të lexoj ngjarje apo detaje që kanë lidhje me jetën e babit dhe shokëve të tij. Përsa i përket pyetjeve tuaja, z. Bujar **NUK KA QENË NË TURQI NË TETOR TË 1979**. Ka vajtur atje në qershor të 1981 dhe është kthyer në tetor të 1982.*
Bashkëngjitur po ju dërgoj një fotografi. Gjithë të mirat! Nevila Nika" (28 mars 2011)

Ramadan Pllana: *"Në Stamboll, qëndrova nga **data 5-8 tetor të vitit 1979**. (...) Zyrtarisht, nga Grupi ynë, më 11 nëntor 1979, i pari u arrestua Sulejman Qyqalla. Pastaj, më 14 nëntor, në mesnatë, në fshatin tim, Shtruerë (ish-Shtitaricë), u arrestova unë, nga Burhan Prishtina, me suitën e tij." (17 mars 2009)*

Aktgjykimi i Shefqet Jasharit me shokë: *"NE EMER TE POPULLIT*

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtari Isak Nishevci. kryetar, gjyqtari Metush Sadiku dhe gjyqtarët porotë Azem Emini, Maksimoviq Dojqin dhe Qazim Goxhufi, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bedrije Kasumi punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale të akuzuarve (...)

Ramadan Pllana nga fshati Shtitaricë, të cilin e mbron Zeqir Arni av. nga Prishtina, sipas detyrës zyrtare, për vepër penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LPJ, ...

*... **GJYKON***

Të akuzuarin Ramadan Pllanën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh." (AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË P - nr. 137/80, 4 qershor 1980, www.pashtriku.org)

Ramadan Pllana ("Dëshmi"):"*Nga analizat dhe shoshitjet e mia që ia kam bërë këtij udhëtimi në Stamboll, qysh nga qëndrimi në Turqi, pastaj në burg, në mërgatë dhe në biseda me shokë kam konstatuar se shkuarja ime në Stamboll, ishte një komplot i kurdisur i disa personave zyrtarë, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, që ishin kundër*

Metush Krasniqi

*ribashkimit të Kosovës me Shqipërinë, në krye të të cilit, me gjasë, qëndronte **diplomati i shtetit** shqiptar **Bujar Hoxha**." (17 mars 2009)*

Nevila Nika (FAKT): "z. Bujar **NUK KA QENË NË TURQI NË TETOR TË 1979**."

FAKTET JANË KUNDËRHELM I HELMIT TË DËSHMIVE TË RREJSHME

Shefqet Jashari: "*Të thuhet se është bërë komplot kundër teje në ato rrethana kur Organizata jonë ishte në formim e sipër, është e papranueshme dhe e pakapshme, kur dihet se ti me Sabri Novosellën nuk keni pasur kontakte të drejtpërdrejta dhe ai nuk ka ditur për ty më shumë se sa që unë i kam treguar. **Për ty Sabriu, Metushi e nëpërmjet tyre ndoshta edhe Jusufi kanë ditur aq sa unë i kam informuar për ty**."* (Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009)

Ramadan Pllana("Dëshmi"): "*Aty, pas një kohe, afërsisht rreth orës15, erdhën dy persona të cilët Tefiku m'i prezentoi si **diplomatë** të shtetit shqiptar, me gjasë **Bujar Hoxha** dhe një tjetër me të cilët **pata një polemikë të ashpër** lidhur me ndryshimin e pikës së parë të Statutit tonë, d.m.th. të hiqnim dorë nga ribashkimi me Shqipërinë." (17 mars 2009)*

Nevila Nika (FAKT): "z. Bujar **NUK KA QENË NË TURQI NË TETOR TË 1979**."

FAKTET JANË KUNDËRHELM I HELMIT TË DËSHMIVE TË RREJSHME

Ramadan Pllana ("Dëshmi"): "*Pra, unë, kam pas kontakt me Bujar Hoxhën në tetor të vitit 1979, me të cilin nuk jam pajtuar kurrsesi që LNÇKVSHJ-ja të ndërroj platformën e vet për bashkim me Shqipërinë. Ai, këmbëngulte që ne t'i kërkonim të drejtat tona në kuadër të RSFJ-së, se, Titoja , sipas tij, ishte i mirë. Nuk do të shpjegoj më shumë, sepse i ke në pjesët e mësipërme për bisedat që i kam pasur me të."* **(**Pse të trazojnë kujtimet e mia, Abdullah Prapashtica?!, www.albaniapress.com, 20 mars 2009)

Nevila Nika (FAKT): "z. Bujar **NUK KA QENË NË TURQI NË TETOR TË 1979**."

FAKTET JANË KUNDËRHELM I HELMIT TË DËSHMIVE TË RREJSHME

Faridin Tafallari: "*Ja po ta shënoj edhe **kohën e Bujar Hoxhës**, ish punonjës në Ambasadën e Shqipërisë në Ankara të Turqisë. Ai ka qenë që nga **QERSHORI I VITIT 1981 deri ne TETOR 1982** (emërtimi) MINISTER FUQIPLOTE I SHQIPERISE ne ANKARA (të dhëna nga e bija)."* (Letër Xhafer Durmishit, 28 tetor 2009)

Shefqet Jashari: "*Për Shqipërinë Organizata jonë dhe as udhëheqësia e saj nuk kishin në atë kohë, atë forcë dhe rëndësi që Partia e Punës do të duhej të bënte komplote në atë mënyrë siç mendoni ju ndaj njerëzve të saj."* (Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009)

Ramadan Pllana ("Dëshmi"): *"Unë kam qenë e jam takuar në Stamboll me Bujar Hoxhën në **tetor të vitit 1979**, për të cilin takim edhe kam shkruar disa here në kujtimet e mia."* (BUJAR HOXHA NJË SABOTUES I BASHKIMIT KOMBËTAR www.pashtriku.org, 18 shkurt 2011)

Nevila Nika (FAKT): "z. Bujar **NUK KA QENË NË TURQI NË TETOR TË 1979**."

Thelbi i kësaj çështje del ky: Kur Ramadan Pllana ka qenë në Stamboll nga 5-8 tetor 1979, Bujar Hoxha nuk ka shërbyer si diplomat në Turqi. Në kohën kur Bujar Hoxha ka qenë diplomat në Turqi, nga qershori 1981 deri në tetor 1982, Ramadan Pllana ka qenë në burg. Faktet janë kundërhelm i helmit të dëshmive të rrejshme.

2. Regjistrimi i Stazhit në Kafé Moska

Në vjeshtën e vitit 1979 kam marrë pasaportën në Mitrovicë. Kah fundi i vitit 1979 në Kosovë bëhen arrestime të disa anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit, por jo edhe të atyre me të cilët unë kam pas lidhje direkte, andaj nuk kam pas nevojë për ndonjë shqetësim direkt për personin tim. Jusufi arratiset nga Kosova dhe më 21 dhjetor 1979 mbërrin në Shtutgart.

Kafé Moska, Berlin, Karl-Marx-Alle 34

Përafërsisht në të njëjtën kohë, në të njëjtën javë, për arsye krejtësisht private, në bazë të lidhjeve familjare, e me iniciativën e kësaj lidhjeje, kam bërë udhëtimin e parë jashtë shtetit, dhe kam qëndruar gati krejt Raspustin shkollor-dimëror 1979-1980 në Berlinin Perëndimor, pa përjashtuar as shëtitjet në Berlinin Lindor.

Në Berlinin Lindor kam shkuar një ditë Ambasadën Shqiptare dhe kam qëndruar disa orë, por nuk iu kam tregua se jam anëtarë i ndonjë organizate dhe kjo nuk na ka pengua që të diskutojmë çështje që na interesonin. Kohën tjetër gjatë qëndrimit në Berlinin Lindor e kam kaluar më së shumti në **Kafé Moska (Café Moskau) në Karl-Marx-Alle 34.** Në atë Café kanë shkuar vetëm ata që e kanë konsideruar vehten ushtarë të revolucionit, dhe unë kam menduar atëherë dhe mendoj sot se kam merituar të gjendem në mesin e atyre shokëve e shoqeve. Shokët gjerman shfaqën gatishmërinë që prej asaj kohe të më regjistrohet Stazhi im, në shërbim e në luftë për socializëm. Pasi ua kam shpjeguar se gjendem në Berlin për ta kaluar Raspustin dimëror, i gjithë diskutimi ynë është koncentruar jo vetëm në çështjet e avancimit të socializmit por edhe për atë se çfarë masash do të ishin të dëshiruara për të mos lejuar Raspustitjen e sistemit socialist në ato vende ku ai ka fituar. Gjatë gjithë Raspustit, në për çdo mbrëmje deri në vakt të syfyrit, në Café Moska ka pas igranka.

3. Ai që hynë në lojë duhet lojën ta duroj

Selatin Novosella: *"Nëse kësaj i shtohet edhe një segment tepër i rëndësishëm për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, siç ishte koordinimi i veprimtarisë me shtetin amë, të cilin koordinim e bënte Jusuf Gërvalla, me çka ia kishte lehtësuar, në masë të madhe, këtë barrë Metush Krasniqit, i cili nuk mund të kryente këtë aktivitet duke pasur parasysh rrethanat në të cilat zhvillohej veprimtaria atdhetare në Kosovën e okupuar, ku vepronte Metush Krasniqi, duke mos u larguar nga Kosova për asnjë çast të vetëm."* (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 148)

Pas zbulimit të aktivitetit të një pjese të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, Sabri Novosella arratiset në Shqipëri më 23 dhjetor 1979. Në këtë punë i ndihmon Mark Mërturi nga Gjakova.

Sabri Novosella*: "Marku i tha të shoqes, Terezës, që të përgatitet, se duhet të shkojmë me Sabriun. Dhe doli nga shtëpia. Pas pak kohësh u kthye me një njeri me një makinë. Marku këtë "të panjohurin" për mua e thërriste "kumbar". Kështu, me një anëtar të organizatës, me shumë rreziqe dhe vështirësi më përcolli përmes maleve të larta kah gryka e cakorret e me rreziqe të shumta. Më në fund, pikërisht më 23 dhjetor 1979, ku pas se 12 orë ecjesh në këmbë nëpër mot dhe terren tepër të vështirë. qëndruam deri në orët e vona në fshatin Gurrec, në shtëpinë e Terezës, te nëna e gruas së Mark Mërturit. Unë kalova matanë kufirit, kurse Marku me një anëtar tjetër të organizatës që më përcollën, u kthyen."* (REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH, Prishtinë 2010, f. 96-97)

Nga Shqipëria, Sabriu, me ndihmën apo ndërhyrjen e organeve të Shqipërisë, përcillet me një anije tregtare në Turqi, atje vendoset ku edhe jeton deri në vitin 1984. Për kontaktet dhe lojën me diplomatët shqiptarë ai shkruan si më poshtë.

Sabri Novosella *:"Diplomatët shqiptarë ishte evidente se nuk kishin asnjë detyrë tjetër, përveç se të shpërndanin literaturën e Enver Hoxhës, siç ishin "Titistët", "Shënime për Kinën" etj. Pas një kohe në atë konsullatë erdhi edhe profesori Bujar Hoxha. T'ua them të drejtën unë në fillim u gëzova shumë, ngase kisha dëgjuar për atë që më parë dhe shpresoja se me ardhjen e tij në konsullatë shumë gjëra do të ndryshonin për të mirë. Mirëpo, ky jo vetëm që e vazhdonte në mënyrë fanatike avazin e*

pararendësve të tij, por Bujar Hoxha punonte në krijimin e përçarjeve sa më të mëdha ndërmjet veprimtarëve tanë në Turqi dhe në futjen perfide të ndjenjës së dyshimit të secilit ndaj secilit. Është evidente se pikërisht ky ishte edhe qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën.

Këta mua personalisht, në mënyrë kontinutive më sillnin libra të Enver Hoxhës, që unë të gjeja mënyrë për t'i dërguar në Kosovë. ***Ata, thjeshtë e loznin lojën e tyre, por më duhet ta pranoj se edhe unë e lozja lojën time.*** *Unë të gjitha ato libra që mi dhanë i futa në stufë dhe i dogja, që të mos u binin në duar të rinjve kosovarë, ngase prej tyre nuk fitohej asgjë e mirë, sepse atyre që u gjendeshin ato libra dënoheshin me burg të rëndë dhe të gjatë, e madje akuzoheshin edhe si marksistë-leninistë, kështu që në vend që t'i shërbehej çështjes së Atdheut e kombit, në fakt krijoheshin kundërefekte."* (Zëri, ribotuar në Drita, Trelleborg-Suedi 1997, nr.10, faqe 8-9)

Përveç lojës së Sabri Novosellës, nga Naim Haradinaj kam pasur rastin të mësoj edhe këtë seriozitet të Jusuf Gërvallës.

Në Suedi, në verën e vitit 1986, në banesën e tij në Skövde, Naim Haradinaj nga Gllogjani më ka treguar këtë ngjarje apo bisedë që e ka pas me Jusufin:

Naim Haradinaj: Jusuf kush është ky person në fotografi që e po e shoh në tavolinë?

Jusuf Gërvalla: Ky është shok shumë i rëndësishëm, ky është anëtarë i Partisë së Punës të Shqipërisë.

Personi, fotografinë e të cilit Naimi e ka pa në tavolinën e Jusufit ka qenë Sabri Novosella.

4. Në dobi të revolucionit e të socializmit

Jusuf Gërvalla: "*I dashur shoku Enver!*

... Materialet propagandistike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës si dhe makina ilegale e shkrimit, në rast dorëzimi, do të më ngarkonin me shumë vjet burgim të rëndë. Pos kësaj, në sajë të mjeteve moderne që përdor UDB-ja gjatë hetimeve, nuk ishte e përjashtuar mundësia që, pa marrë parasysh këmbënguljen time, UDB-ja mund të zbulonte edhe ndonjë sekret lidhur me Lëvizjen.

Prandaj, duke marrë pëlqimin e shokut të parë të Lëvizjes, anëtar i Komitetit Qendror, unë u arratisa aty për aty.

...Unë, me të arritur në Ludvigsburg, i bëra telefon Ambasadës Shqiptare në Vjenë dhe prej shokëve të atjeshëm kërkova ndonjë këshillë se si mund të ruhem nga gabimet në një botë ku nuk kisha qenë kurrë më parë dhe ku, pasi kisha ardhur pa pasaportë e më duhej të kërkoja azil politik, kishte mundësi edhe për ndonjë gabim. Pak ditë më vonë, këtë gjë si dhe kërkesën për shqyrtimin e mundësive që të më jepet mundësia e strehimit në RPS të Shqipërisë, ia komunikova edhe me gojë njërit prej shokëve të Ambasadës së përmendur.

Nga ajo kohë u bënë afro katër muaj dhe lidhur me kërkesën time nuk mora ndonjë përgjigje.

...Por, që nga çasti i parë i arratisjes, unë e kam pasur mendjen të strehohem në Shqipëri. Prandaj, shoku Enver, mora kurajon të Ju drejtohem Ju personalisht. Kam njoftime për marrëveshjen shqiptaro-jugosllave lidhur me ekstradimin reciprok të personave të vënë jashtë ligjit në të dy vendet. Por, sipas Nenit 65 të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Shqipërisë, ku thuhet: "Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit

kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës", konsideroj se mua më takon kjo e drejtë. Nuk dua të them se ma mohon kush, por, procedura e rëndomë e realizimit të saj po më dëmton fizikisht e shpirtërisht, shoku Enver.

...Nuk ishte punë e lehtë për mua të vendos që të Ju drejtohem Ju, shoku Enver, për një çështje që ndoshta nuk është e denjë te merreni me të. Në krahasim me të ligat që kanë rënë mbi kokë familjes sime para dhe pas lufte, me të ligat që kam përjetuar vetë dhe me situatën e përgjithshme shumë të vështirë në Kosovë, gjendja ime është, siç i themi ne nga Kosova, lule e dritës.

...Kur i marr parasysh çështjet në gjithë gjerësinë e tyre, kërkesa për të m`u dhënë e drejta e strehimit në atdheun tim, më duket si një luks, dhe atëherë më rrëmben një ndjenjë turpi. Por i vetëdijshëm se në Kosovë, përderisa gjendja të mos ndërrojë rrënjësisht, këmba ime s`ka si shkel më sa të jem gjallë, e në anën tjetër, me këtë botë të huaj s`më lidh asnjë cikërrimë dhe këtu nuk shoh kurrfarë perspektive, e vetmja rrugë e drejtë dhe e njerëzishme më duket jeta në Shqipëri.

Jam i vetëdijshëm edhe për disa probleme të pahijshme, që kanë shkaktuar disa kosovarë, duke dalë me qëllime të ulëta në territorin e RPS të Shqipërisë. Për fat, makinacionet e UDB-së, që në Kosovë e viset e tjera shqiptare brenda kufijve politikë të Jugosllavisë kanë bërë kërdinë në dëm të popullit tonë, në shtetin shqiptar s`kanë gjetur shesh për të bërë përshesh. Mirëpo, duke qenë njeri i përvuajtur, i thjeshtë dhe i vetëdijshëm për dashurinë që kam ndaj nënës Shqipëri, jam i sigurtë se unë s`do të merrja në asnjë mënyrë rrugën e atyre djemve bastardë të Kosovës, që janë vënë në shërbim të armikut, por do të ndiqja shembullin e ca të tjerëve, si Ajet Haxhiu, Agim Gjakova e ndonjë tjetër të cilët kurdoherë kanë mbetur burra të ndershëm." (Letër Enver Hoxhës, prill 1980; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011)

5. Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë

Jusuf Gërvalla: ***"I dashur shoku Enver!***

... Larg ndenjës revanshiste e shoviniste, te ne është ndezur shkëndija e luftës së pashmangshme nacionalçlirimtare, konturet e së cilës po duken në horizont.

Të nxirret pjesa e robëruar e tokave dhe e popullit shqiptar nga kthetrat e përgjakshme të socialshovinistëve titistë dhe të çohet në vend vullneti i ndryshuar i popullit tonë: bashkimi me vendin amë, Shqipërinë, është një e drejtë historike, që iu mohua por nuk iu çrrënjos kurrë popullit tonë të vënë me shekuj përballë padrejtësive të mëdha historike po të papërkulur kurrë."

Ne prekemi thellë nga ata që sjellin dekurajim e pakënaqësi

"Por, gjithashtu ***ne prekemi thellë*** *në sedër sa herë që, nga mosbesimi në ne apo nga konspiracioni i thellë, ndonjë shtetas i RPS të Shqipërisë ngul këmbë sesi në Jugosllavi nuk jemi aq keq dhe se Shqipëria nuk ka fare të bëjë me të vërtetën sa i përket qëndrimit të Shqipërisë socialiste ndaj tokave të veta të pushtuara,* ***sjellin dekurajim dhe pakënaqësi në mesin e popullit tonë të shumëvuajtur****."*

Ne jemi skeptik rreth pritjes për bashkim në baza marksiste-leniniste

"Prandaj, ne jemi skeptikë se për realizimin e aspiratave tona shekullore, të drejta për bashkimin e tokave dhe të popullit tonë, mund të priten rrethana të rivendikimit në baza marksiste-leniniste."

Lufta jonë politike është fituar

"Pakënaqësia në rritje e popullit tonë, njëherazi, është edhe pasqyrë e luftës politike ndërmjet titizmit dhe popullit shqiptar. Dhe kjo pakënaqësi sot ka arritur në atë

shkallë, ***sa mund të thuhet që lufta jonë politike kundër këtij pushtuesi të egër revizionist është fituar gati në mënyrë përfundimtare."***

Përjashtim bën Lëvizja anëtar i së cilës jam unë

"Organizimi i tyre është bërë shpesh në suaza regjionesh të caktuara, të ngushta dhe vetëm në ndonjë rast të rrallë ato (si bie fjala më 1964) janë përhapur në ndonjë trevë më të madhe të tokave tona. ***Përjashtim bën Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, për të cilën mendoj se jeni në dijeni dhe anëtar i së cilës jam dhe unë.*** *Kjo lëvizje vazhdimisht ka pasur parasysh si një nga qëllimet kryesore përfshirjen në gji të vet të patriotëve dhe revolucionarëve nga të gjitha viset shqiptare."*

Luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm

"Po tash, meqë lufta jonë politike ka hyrë në fazën e vet përfundimtare, e cila po zhvillohet në favorin tonë, janë të domosdoshme edhe forma më të larta organizimi të aktivitetit revolucionar. Edhe nga kjo pikëpamje ne, me një vonesë të konsiderueshme, kemi arritur në përfundimin ***se luftës sonë i duhet një emërues i përbashkët dhe i fuqishëm...,*** *është e domosdoshme një ndihmë konkrete nga ana e Partisë së Punës të Shqipërisë. Një ndihmë e tillë, konsiderojmë ne, është e drejtë e patjetërsueshme si për PPSH – në, ashtu edhe për djalërinë patriotike e revolucionare shqiptare në pjesën e robëruar të atdheut tonë të përbashkët."* (Përmbajtja e plotë e kësaj letre, për herë të parë është botuar në librin e Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 94-99 dhe në dy libra tjerë gjatë vitit 2010).

6. Takimet tek Tefiku

Xhafer Durmishi: "*Në verën e vitit 1980, Sheremet Saraçi, me të cilin kisha kontakt ka shkuar në Turqi për ta takua Sabri Novosellën. Gjatë qëndrimit në Turqi, Sheremeti ka qëndrua në banesën e Tefik Strajës. Tefiku e pret shumë mirë Sheremetin. Vizita e tij sa kishte qenë politike, aq ishte edhe një lloj pushimi i mirë për te, pasi banesa e Tefikut është ngjitur me Detin Marmara. Përveç Sabriut, Sheremeti ka takime të vazhdueshme gjatë tërë kohës me personelin e Konsullatës Shqiptare në Stamboll.*

Në janar të vitit 1981, me kërkesën e dy shokëve të Lëvizjes së Jusufit, me të cilët kam pas kontakt, Sheremet e Ismet Saraçit dhe Sabriut në Turqi (të cilit Sheremeti i ka folur për mua gjatë verës 1980) kam udhëtuar për në Stamboll për ta takuar Sabri Novosellën. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi m'i kanë paguar dy shokët që më kanë dërguar, të cilët kanë punuar si arsimtarë në një shkollë fillore. Sabri Novosellën e kam takuar në banesën e Tefik Strajës në Çiğdem sok. Nr. 24/6, Pendik, Istanbul. *Sabriu e ka marrë vesh nga unë ekzistencën dhe botimin e revistave „Lajmëtari i lirisë" dhe „Liria". Edhe pse ia kam përmend se në Kosovë flitet shumë për Jusuf Gërvallën, Sabriu nuk më ka thënë se Jusufi është i organizatës tonë, apo se fare e njeh. Gjatë këtij qëndrimi disa herë kanë ardhur tek Tefiku, ku qëndroja unë, persona të Konsullatës Shqiptare. Në një darkë ku kanë qenë të pranishëm ata dhe Sabriu, u kam tregua se për festën e 28 Nëntorit 1980 shumica e studentëve nëpër konvikte, për festa, nuk kanë shkuar nëpër shtëpia për pushime, me arsyetimin dhe pritjen se diçka është duke u zier, diçka mund të ndodhë për 28 Nëntor, andaj duami të jemi këtu. Pas qëndrimit disa ditësh në Stamboll, para se me u nda, Sabriu ma ka dhënë numrin e telefonit të banesës së vetë në Adapazar.*

Pas kthimit tim nga Stambolli, pas rreth dy muajve filluan ngjarjet historike të Pranverës 1981. Dhuna policore, ndjekja e aktivistëve të organizatave politike dhe ngjarjet që u zhvilluan lanë gjurmë të ashpra tek unë."

7. Puna e parë që bëra

-Vendosja e lidhjes së Jusufit me Sabri Novosellën

Bardhosh Gërvalla: *"Nijazi Saraçoglu, Mahmut Pasa Cadesi 82, Istambul*
I dashuri Shoku Nijazi,

Dje pasi e mora lidhjen telefonike me ju, isha shumë i gëzuar, sepse kanë kaluar më se 15 muaj që po e presim ndonjë lajm nga shoku Bashkim Prishtina, për të cilin ju mund të dini rastësisht se ku po qëndron. Jusufi, vëllai im para dy ditësh ka shkuar në veri të Gjermanisë tek një nip i yni, kështu që ai nuk mund t'ju shkruan edhe 6 ditë deri sa të kthehet prapë këndej. ... Me Shabanin u njohëm para dy javësh në panairin e artizanatit, ku bënte pjesë edhe Shqipëria. Ai edhe na e dha adresën dhe telefonin tuaj.

... Kishte qenë mirë sikur edhe Bashkimi të na shkruaj sa më parë. Në fund po iu përshëndes ju e gjithë familjen dhe dashamirët tuaj.

Bardhosh Gërvalla, Habichthöhe 40, D-7101 Untergruppenbach, W. Germany
Tel. qyteti Ludwigsburg 7141/26091"

Jusuf Gërvalla: *"Puna e parë që bëra, u bëra një telefon shokëve të ambasadës shqiptare në Vjenë. I njoftova për çështjen time dhe i luta të më ndihmojnë me ndonjë këshillë për të mos bërë ndonjë gabim ideologjik a taktik gjatë strehimit tim në këtë vend kapitalist. Ata, si zakonisht, u treguan të kursyer, po megjithatë patën njëfarë mirëkuptimi.*

(...) Kam pasur nderin të njihem edhe me sekretarin e parë të Partisë Komuniste Gjermane, njëkohësisht edhe kryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri dhe i kam dërguar një letër me lutjen që edhe ai me partinë e tij të shikojë ndonjë formë të përshtatshme ndihme për përkrahjen morale të popullit shqiptar të Kosovës. Ende s'kam marrë përgjigje prej tij, por shpresoj se megjithatë do të na ndihmojë patjetër, sepse për këtë i obligon drejtpërdrejt edhe artikulli i "Zërit të popullit" i datës 8 prill, se siç dihet, kjo parti e komunistëve gjermanë ka për busollë të vetme PPSH-në." (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981. E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 256-261)

Prej 14 dhjetorit 1979 e deri më 13 prill 1981 (pra plotë 16 muaj) Jusuf Gërvalla nuk ka asnjë kontakt me Sabri Novosellën e me këtë edhe me udhëheqësit e Lëvizjes së tij. Nga citati i mëposhtëm Jusufi tregon se kush i ka ndihmuar në këtë punë. Në këtë i ndihmon Shaban Yldrim, tregtar në München. Shabani ka qenë agjenti gjeneral i tregtisë për plasimin e mallrave të Shqipërisë në Gjermaninë Perëndimore. Këtë ndihmë ai nuk besoj se kishte me ia dhënë Jusufit pa pëlqimin e ortakëve të vetë, diplomacisë shqiptare.

Jusuf Gërvalla: *"Ai shoku në Mynhen,* ***përmes të cilit e mora lidhjen*** *me Ty, Shabani, është një milioner." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981.* E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 261-266)

8. Këshilla për Jusufin të diplomatëve shqiptarë në Vjenë

Jusuf Gërvalla: *"Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të kemi nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku përsa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfillte dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e*

"Bashkimit" në Kosovë. Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë, njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit", të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë. ***Këshilla për ndërprerjen e marrëdhënieve me të kam pasur edhe nga ana e diplomatëve shqiptarë në Vjenë.*** *(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981.* E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 261-266)

9. Jusuf Gërvalla dhe sugjerimet e ardhura nga atdheu

Jusuf Gërvalla: *"Edhe një çështje tjetër me shumë rëndësi. Po ky shoku (Kadri Zeka-shën i Xh. D.) i "Lirisë", i cili lidhjet me shokët në Kosovë i mban rregullisht, tash së fundi na njofton sesi nga Kosova i paska ardhur porosia që tash e tutje të mos ngulim më këmbë në kërkesën për përfshirjen e tokave shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi brenda republikës së Kosovës, por të kufizohemi vetëm me statusin e republikës për territorin e sotëm të Krahinës Autonome të Kosovës, sepse gjoja, po të paraqitet kështu çështja, paska njëfarë mangësie për realizimin e kësaj kërkese.* ***Ai (Kadri Zeka - shën i Xh. D.) shton se gjoja sugjerime të tilla u paskan arritur nga instanca të rëndësishme të atdheut.*** *Unë paraqita kundërshtimin tim kategorik. Në mos qentë tradhti e hapët, një lëshim i tillë, thashë unë, atëherë është një politikë e ligë konjukturale, të cilën vështirë se do të na e falte populli i pezmatuar, sidomos shqiptarët e viseve jashtë Krahinës, që janë në rrezik edhe nga asimilimi i madh." (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981.* E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 269-271)

10. Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!

Jusuf Gërvalla: *"Që të mos zgjatem me detaje, ja vrojtimet e mia në pika të shkurtra lidhur me veprimtarinë dhe personalitetin e I. Kelmendit.*

Kurdoherë ka anuar nga aksione të natyrës terroriste dhe në këtë drejtim i ka nxitur edhe shokët e vet. Unë ia kam tërhequr vërejtjen se kjo gjë është e dënueshme edhe nga pikëpamja e PPSH. Më vonë kam vërejtur, në librin që ma ka dhënë hua për lexim, se i ka pasur të nënvizuara pikërisht mendimet e Leninit lidhur me kotësinë dhe rrezikshmërinë e terrorizmit në lëvizjen revolucionare. Kam ardhur kështu në përfundim se ai ka një prirje të natyrshme kah terrorizmi dhe e bën me vetëdije.

Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. Madje në atë kohë, Ibrahimi kërkonte një njeri "të ndershëm e trim", që për një kundërshpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist. (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena [Ambasadës Shqiptare të Vjenës - shën i Xh. D.], lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori [Bujar Hoxha - shën im], në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.)

Ka pasur vërejtje rreth Kushtetutës së RPSSH dhe rreth përgatitjes "luksoze" të librave të shokut Enver në "dëm" të botimeve letrare të RPSSH! Vërejtjen e parë na e ka thënë hapurazi mua dhe shokëve të Vjenës [Ambasadës Shqiptare të Vjenës -shën i Xh. D.), të dytën vetëm mua. Arsyetohet se ka të drejtë të bëjë vërejtje gjithfare dhe këto

dilema të tij nuk i paraqet te masat, por i diskuton vetëm me shokë. Unë s'mund ta di a është e saktë kjo.

Ka dyshuar me këmbëngulje në drejtësinë e artikullit të "Zërit të Popullit", ku shprehej gatishmëria e RPSSH për t'u ardhur në ndihmë popujve jugosllavë po të kërcënohen këta nga BRSS, dhe dyshimet e tij kanë qenë edhe të shokëve të tij. Përkundër bindjeve të mia se është e panevojshme dhe e pamirë një gjë e tillë, jam detyruar të udhëtoj me qindra kilometra për ta "arsyetuar" te shokët e tij artikullin e përmendur. Ai më ka propozuar pastaj me këmbëngulje që këtë gjë ta përsëris edhe me shkrim në artikullin e "Bashkimit" me titull "Zëri i Popullit - zë i të gjithë shqiptarëve" (këtë numër s'e keni pasur prandaj po jua dërgoj). (Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë"...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahimi kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij daje të vogël (Gani Ibërdemajt - edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori [Bujar Hoxha - shën i Xh. D.]) dëshirën për t'u takuar me mua.

Në kufirin gjermano-zviceran, Brahimit dhe Hysenit u ka zënë policia e huaj disa qindra ekzemplarë të "Bashkimit" dhe ua ka marrë. Me këtë rast, Ibrahimi nuk është treguar i gatshëm për të pranuar kritikat. Përgjithësisht, nëse ia numëron gjestet dhe punët e kritikueshme, ai thotë: "Mos m'u kap vetëm për disa gabime, të vogla". Menjëherë pas kësaj, bashkë me shokët, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovaki, në gjurmim të armëve (ndoshta profesori mund të ketë ndonjë informim nga ana e shokëve të Pragës lidhur me sjelljet e tyre në atë vend, sepse e di që shokët e Pragës [Ambasadës Shqiptare në Prag - shën i Xh. D.] kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshja me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.).

Shokët e Vjenës (Ambasadës Shqiptare të Vjenës - shën i Xh. D.) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpia ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"
(Raport Komitetit të Degës së LÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981)

11. Ju keni ku merrni mendime

Jusuf Gërvalla: *"Mbrëmë ishim me Besnikun te ai personi në Visloh (Wiesloch-shën. im), që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë.* ***Unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla-shën im)****, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme. Na nevojitet mendimi juaj i prerë për të* ***se ju keni*** *ku e merrni këtë* ***mendim****." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981.* E Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Personi që Jusufi e takon është Isa Bulan, që ka banuar në Karl-Theodorstr. 4 D-6908 Wiesloch. Familja e Isës me sa më kujtohet ka qenë nga Mitrovica e shpërngulur në Prizren dhe një pjesë e familjes e ka pasur mbiemrin Prekadini. Në Turqi ka jetua Abdullah Prekadini, i cili prej vitesh ka kontakte spontane e për festa me konsullatën shqiptare në Stamboll. Jusufi kërkon mendim të prerë nga Sabri Novosella para se ta afroj më shumë Isën, para se t'i propozoj ta bëjë anëtarë të Komitetit të degës së

Gjermanisë. Me fjalët *'ju keni ku e merrni këtë mendim'* Jusufi ka parasysh Bujar Hoxhën. Baza e këtij besimi nuk është vetëm tek principet e Jusufit por edhe tek fakti se Sabriu lavdohet e krenohet deri në kulm për atë se sa i shkëlqyeshëm është raporti i tij me Bujar Hoxhën.

12. Sa mund të më ndihmoni ju së andejmi?

Jusuf Gërvalla: *"Por kur është fjala për botimin e "Zërit të Kosovës", mendoj se del edhe një problem. Sipas të gjitha gjasave, tashmë është identifikuar se kush qëndron prapa "Lajmëtarit" dhe kështu edhe mënyra se si radhitet ai. Pra, kjo makinë shkrimi, sipas mendjes sime, nuk do të duhej të përdorej edhe në radhitjen e "Zërit të Kosovës". Kurse radhitja në shtypshkronjë kushton shtrenjtë, siç u pa. Mbesin dy mundësi: ose të shitet kjo makinë (po tash me çmim më të ulët, se kështu ngjan këtu) dhe të blehet një lloj tjetër makine, duke shtuar edhe para të tjera, ose të merret kohë pas kohe me qira ndonjë makinë tjetër për radhitjen e gazetës. Se sa do të shpenzoheshin me variantin e parë dhe sa me të dytin, të informoj këto ditë në telefon, por e di se, për një punë më të rregullt në nxjerrjen e gazetës, do të duhej një ndihmë bukur e madhe financiare. Dhe unë nuk e di se sa keni mundësi, Ti me shokët, të ndihmoni së andejmi. Për shembull, një makinë për radhitje, me të gjitha llojet e germave ë përdoren në gazeta e libra e që prandaj s'ka si të identifikohet, e re kushton mbi 20 mijë mark, po e përdorur ka mundësi të gjendet edhe 10 mijë. E këto janë para të mëdha. Ndryshe, po të zgjidhet çështja e makinës, shpenzimet e shumëzimit të revistës do t'i përballoja vetë, me disa shokë këtu, pa kurrfarë problemi.* ***Këtu kam një propozim. Ai shoku në Mynhen, përmes të cilit e mora lidhjen me Ty, Shabani, është një milioner. Nëse shokët që ke Ti atje kanë ndikim në të, atëherë ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do t'i ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju.***

Sido që të jetë, para se t'ia nis punës për nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", duhet të dija se deri në çfarë shkalle mund të më ndihmoni së andejmi materialisht." *(Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981.*E botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 261-266).

Në mesin e shtatorit 1981 Jusufi blen një maqinë shtypi për "Zërin e Kosovës" e modeli i së cilës qe "IBM Electronic Selectric Composer". Maqina kushtoi rreth 8000 (tetëmijë) marka gjermane. Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani me shokë ia huazojnë Jusufit shumën e nevojshme të të hollave. Puna e parë që Jusufi bëri me këtë maqinë qe shtypja-radhitja e "Tezave rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" të OMLK-së.

Në mbarim në nëntorit 1981 Jusufit i vijnë nga Turqia 10 mijë dollar amerikan. Këtë shumë të hollash Jusufi nuk e ka komentua me mua. Suzana më ka thënë se këto të holla, Jusufit dhe Lëvizjes së tij i kanë ardhë përmes Sabri Novosellës nga Turqia, dhe donatori është Aziz Vojnovci. Më vonë, në vitin 1984 Sabri Novosella, edhe pse nuk më ka thënë në mënyrë direkte ka aluduar se ato të holla ia ka dhënë Bujar Hoxha. Me ndihmën e këtyre të hollave Jusufi ua ka kthye huan Faridinit, dhe Nuhiut.

13. Porosia për Jusufin nga Kongresi VIII i PPSH

Xhafer Durmishi: *"Është edhe një ngjarje me rëndësi që është zhvilluar në panairin e Librit në Frankfurt më 17 tetor 1981. Më 1 nëntor 1981 do t'i fillonte punimet Kongresi VIII i PPSH. Jusufi ishte shumë i interesuar të siguroj xhirime filmike sa më të plota nga zhvillimet e punimeve të Kongresit, me qëllim që të fitohej njohuri organizative për punën tonë që bënim në Gjermani. Për këtë arsye ai (Jusufi) kishte blerë një televizorë të cilësisë së lartë dhe dy videoaparate (VHS) të cilat ia dorëzon Engjëll Kolanecit. Në fillim të dhjetorit 1981, nga Shqipëria vjen përgjigje lidhur me kërkesën e Jusufit për videoxhirimet e punimeve të Kongresit VIII. Engjëll Kolaneci ia sjell Jusufit pesë videokaseta VHS, me këto filmime:*

- Epoka para Gjyqit, Dramë (Sylejman Pitarka e Kadri Roshi)

- Gërsheti i Luftërave, Dramë për Shote dhe Azem Galicën (Liri Lushi)

- Mësonjëtorja, Film, - Udha e shkronjave, Film, - Plumba Perandorit, Film

Siç shihet, përgjigjja që vjen në kërkesën e Jusufit është shumë interesante. Asnjë minut i vetëm rreth Kongresit VIII. Porosia është e qartë si drita e diellit. Me fjalë tjera Jusufit i thuhet: Ti me Lëvizjen tënde Nacionalçlirimtare je në rrugë dhe në ide të drejta. Koncentrohu në çështjen kombëtare, dhe merr mësim nga Mësonjëtorja e Korçës, Abdyl Frashëri, Azem e Shote Galica dhe Vasil Laçi e mos u lodh për luftën ideologjike të Partisë së Punës, pasi për atë punë jemi ne vetë. Faza e metodat e luftës sonë janë të ndryshme me tuajat."

14. Formimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë

Jusuf Gërvalla: *"Letrën për KQ të PPSH-së e vonuam shumë. Unë e shkrova në disa variante, por me asnjërin prej tyre nuk mbeta i kënaqur. Nuk jam mësuar të komunikoj me një nivel të tillë. Më së fundi e lash variantin që e mora prej teje.*

*Hapi si hap më pëlqeu shumë dhe më duket shumë i dobishëm. Por, nuk di a duhet të jemi të kënaqur si e kemi realizuar. (*Letër Sabri Novosellës,14 janar 1982. E botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

Në këtë kohë unë kam qenë në Kosovë. Por këtu duket qartë se është fjala për një letër që Jusufi e sheh të udhës me ia dërguar KQ të PPSH, pas rastit të Mehmet Shehut të 17 dhjetorit 1981.

Jusuf Gërvalla: *"Tani po kthehem edhe njëherë në fillim të letrës. Mendimi im është se disa çështje parimore, siç është themelimi i partisë si domosdoshmëri apo rrezikshmëri në perspektivë, pastaj mënyra e organizimit të Lëvizjes në kushtet e reja të luftës, duhet të diskutohen e të pleqërohen më dendur me shokët, sidomos me Plakun. Jo vetëm gabimet e mëdha parimore, por edhe të voglat ka mundësi të evitohen shumë më mirë në këtë mënyrë.* ***Ju atje jeni të lumtur që e keni Plakun (Bujar Hoxhën-shën i Xh. D.). Në këtë pikëpamje ne jua kemi lakmi, se këndej punët me relacione të tilla nuk janë aq të thelluara, jo për fajin tonë."*** *(*Letër Sabri Novosellës,14 janar 1982. E botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f.452-454)

Jusufi ia ka lakmi Sabri Novosellës i cili e ka Bujar Hoxhën dhe shton se këndej punët nuk janë të thelluara, dhe atë jo për fajin tonë, jo për fajin e Jusufit.

15. KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË

TIRANE, 19 janar 1982 ATSH, - Sikurse njofton agjensia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, të dielën më 17 janar, natën vonë, në fshatin Untergrupenbah, në afërsi të qytetit të Shtutgart të Gjermanisë Perëndimore, u vranë kosovarët Bardhosh Gërvalla, Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka. Sipas burimeve zyrtare gjermanoperëndimore, sulmi u krye të dielën natën, pak kohë pasi të tre kosovarët dolën me makinë nga një garazh. Vrasësit e armatosur hapën zjarr kundër makinës dhe vranë në vend Kadri Zekën (28 vjeç) dhe Bardhosh Gërvallën (31 vjeç). Jusuf Gërvalla (36 vjeç), i plagosur rëndë vdiq më pas në spital.

Agjencia gjermanoperëndimore e lajmeve, DPA, agjencia franceze e lajmeve, AFP, dhe agjencia amerikane e lajmeve, ASPRESS, duke dhënë lajmin e vrasjes së tre shqiptarëve, theksojnë se, sipas deklaratave të zyrtarëve të sigurimit gjermanoperëndimor të Shtutgartit dhe sipas shërbimit lokal të hetimeve kriminale, Jusuf Gërvalla duke dhënë shpirt në spital, akuzoi policinë sekrete jugosllave se qëndronte pas këtyre tri vrasjeve.

Ndërsa agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG, lajmin që dha për vrasjen e tre djemve kosovarë e cilëson si " larje hesapesh" midis emigrantëve, shprehje kjo që e kemi dëgjuar shpesh nga udhëheqësit kryesorë jugosllavë dhe ata të Kosovës, kur është fjala për masa shtypëse e terroriste kundër shqiptarëve në Jugosllavi." (Zëri i Popullit, 20 janar 1982)

16. Shkuarja në Vjenë për të gjetur ngushëllime

Xhafer Durmishi: *Për të njëjtat shkaqe për të cilat unë e Haxhi Berisha kishim shkua në Dortmund, më 27 janar 1982 kam udhëtuar unë vetëm në Vjenë, për të takuar ndonjë person të Ambasadës Shqiptare, për të qarë hallet me ta, për t'i informuar për situatën në Untergruppenbach dhe për të marrë ndonjë këshillë. Unë kisha thirrur në telefon më përpara për t'i informuar se do të shkoja tek ata. Në Vjenë kam mbërri kah mesdita. Kam shkuar menjëherë në ambasadë. Persona të ambasadës më kanë thënë se ata që kanë me bisedua me ty janë të zënë, prandaj eja në ora 18.00 në mbrëmje. Në ora 18.00 kam shkuar në ambasadë. Më kanë pritur Skender Dushi dhe Lirim Shyti. Me ta kam biseduar gjer në 24.00. Këtë orë, pra mesin e natës nuk e harroj kurrë. Mbasi ua kam shtruar të gjitha gjërat që kam pasur ndërmend dhe mbasi iu kam përgjigjur të gjitha pyetjeve, pra në mesin e natës më kanë përcjellë tek dera e ambasadës dhe më kanë thënë natën e mirë. Asnjëherë në jetë më parë nuk kam qenë më i befasuar e i lodhur psikikisht se në ato momente pas gjashtë orësh bisede të pandërprerë, me përjashtim të lajmit për vrasjen.*

Të hollat për këtë rrugë m'i ka dhënë Suzana. Unë kisha të holla edhe për hotel por Skender Dushi e Lirim Shyti as që u lodhën me më pyet për atë punë edhe pse e dinin se në atë kohë nuk kisha ndonjë tren për Shtutgart. Gjuhën gjermanishte mund të them se nuk e dija, me përjashtim të ndonjë fraze të përgjithshme dhe atyre fjalëve që më nevojiteshin për leximin e tabelave e orareve në stacionet e trenave. Me vete e kisha një adresë të një të afërmi në Vjenë, dhe më shkoi gati më shumë se një orë gjersa e gjeta banesën e tij. Atë nuk e gjeta aty dhe personi që m'u përgjigj, pasi nuk më njohu u frikua me më pranua në banesë. U ktheva, dhe duke u sjellë nëpër qytet më ka gjetur mëngjesi i asaj dite. Kur kam mbërri në Untergruppenbach në mesin e shokëve lodhja e madhe nga mërzia me të cilën u ktheva nga ky udhëtim m'u hoq tërësisht.

Për përcjelljen time tek dera në mesin e natës dhe indiferencën e këtyre diplomatëve i kam treguar në telefon Sabri Novosellës i cili ia ka përcjellë Bujar Hoxhës. Sabriu më

ka thënë pastaj se si Skender Dushi e Lirim Shyti qenkan qortuar për këtë punë. Sidoqoftë, pasi kemi bërë luftë për një çështje që ka të bëjë me popullin, nuk ka mund me pasur vend tek unë inatet personale. Por ky rast ka qenë tepër i mjaftueshëm për të ma mbytur kureshtjen për jetë se mos kam pasur unë të mësoj ndonjë gjë me vlerë prej diplomatëve të Partisë së Punës të Shqipërisë. Më vonë prej diplomatëve në Vjenë jam takuar vetëm me Engjëll Kolanecin, i cili më ka thënë që për çështjet tona të Kosovës të mos bisedoj me askend tjetër në ambasadë përveç tij. Engjëllin e kam takuar dhe biseduar me te disa herë gjatë vitit 1982, shumicën e herave së bashku me dhe në praninë e Faridin Tafallarit."

17. Tek Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982

Faridin Tafallari: *"Më 5 shkurt është bërë varrimi i të vrarëve.*

Më 13 shkurt Xhafer Durmishi shkon në München në mënyrë, që nga aty të udhëtoj për në Turqi, për t'i raportuar Sabri Novosellës mbi gjendjen e krijuar në Untergruppenbach dhe Lëvizjen e Jusufit." (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 71)

Pasi i kam treguar gjithçka që dija për gjendjen në Untergruppenbach e Shtutgart, Sabriu më ka thënë se duhet të shkojmë në Ankara që të takohemi me Bujar Hoxhën, pasi Bujari i paska thënë që kur të vijë shoku nga Gjermania, merre pa u vonuar e eja tek unë. Sabriu thotë se Bujari është shumë i interesuar që shumë gjëra t'i ndëgjoj vetë prej teje. Duke pasur parasysh përvojën e para disa ditësh me diplomatët në Vjenë, unë isha shumë i befasuar (për të mirë) që një diplomat tjetër i të njëjtës parti të kërkonte patjetër ta takoja duke bërë qindra kilometra rrugë. Sabriu më tregon se në Ankara gjendet Abdullahu me osmanët e vetë. Për këtë kam shkruar pak në punimin "Organizatat politike në Evropë 1979-1985" .

Në orët e vona të natës së 16 shkurtit e kemi marrë autobusin për në Ankara, dhe në një natë që dukej shumë e ftohët, kemi udhëtuar deri në Ankara ku kemi mbërri në mëngjesin e 17 shkurtit. Kemi shkuar drejtë në ambasadën shqiptare. Pas një bisede të gjatë, Bujar Hoxha, djali i Kadri Prishtinës ma ka komunikuar vendimin e PPSH (apo thënë me drejtë të Enver Hoxhës) për pranimin e gruas dhe fëmijëve të Jusufit në Shqipëri, kërkesë të cilën ia kisha bërë Engjëll Kolanecit, me dëshirë e porosi të



Suzanës, dëshirë e ide të cilën Jusufi ia ka mbjellë qysh kur ai ka qenë gjallë. Në ambasadë, pasdite, ka ardhur Abdullah Prapashtica me shokët e vetë. Abdullahu me shokë nuk ka ardhë rastësisht por e ka thirrur Bujari. Bujar Hoxha ishte treguar shumë bujar me dezertorin e UDB-së Serbe Abdullah Prapashticën. Dezertori i UDB-së Abdullahu, nga diplomatët shqiptar ishte dërguar në Tiranë me ymyd se do të shtrydhin apo mjelin prej fukarallakut të tij në kokë ndonjë trik të UDB-së Serbe. Duke e pasur parasysh thatësirën nga shkëputja e marrëdhënieve me KGB-në ruse prej dekadash më parë, ma merr mendja se në pusin e Sigurimit Shqiptar të vitit 1981, dezertori i UDB-së Serbe, Abdullah Prapashtica është konsiderua peshkaqeni më i madh që është zënë ndonjëherë me sitë në lumin e Sitnicës. Për këtë arsye Bujari kërkoi nga ne, përfaqësuesit e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, që edhe ne, në frymën e Jusufit, të tregohemi edhe më bujar ndaj këtij personi që kishte dezertuar nga UDB-a Serbe dhe t'ia dhamë një second chance. Në mbrëmje në orët e vona kemi marrë vendimin për bashkimin e organizatave tona, Fatoni, unë, Osman Osmani, Abdullahu dhe Sabriu. Askush tjetër nuk ka qenë i pranishëm. Pas marrjes së vendimit kemi shkuar prapë në ambasadë. Më 18 shkurt jemi kthyer me Sabriun në Adapazar. Pastaj kemi shkuar në Stamboll në banesën e Tefik Strajës ku kemi qëndruar disa ditë dhe jemi takuar prapë me Bujarin. Bujari na e ka paguar rrugën e aeroplanit mua dhe Osmanit. Unë kisha marrë të holla
prej Suzanës të cilat më mjaftonin edhe për biletën kthyese por Bujari nuk më ka lejuar ta paguaj vetë biletën.

Pas kthimit nga Turqia, unë dhe Faridin Tafallari e takuam disa herë Engjëll Kolanecin. Në njërën prej këtyre takimeve atij i dhamë shumë gjëra që ishin të arkivuara në shtëpinë e Jusufit. Pos tjerash atij ia dhamë edhe punën origjinale që Jusufi kishte bërë në përgatitjen e numrave 3 dhe 4-5 të revistës "Liria". Engjëlli i mori me shumë dëshirë duke thënë se ato ruhen më mirë në Shqipëri se sa tjetërkund. Në shtëpinë e Jusufit kishte shumë gjëra të duheshin larguar nga shtëpia. Për disa dokumente e materiale duhej të tregonim kujdes të madh për disa të tjera më të vogël.

18. Përcjellja e familjes së Jusufit në Shqipëri

Përcjellja e Suzanës, Premtonit, Donikës dhe Ergonit për Shqipëri

Pas kërkesës që ia kisha bërë Engjëll Kolanecit për vendosjen e Suzanës me fëmijët në Shqipëri, e cila ishte edhe kërkesë e Suzanës dhe dëshirë e shprehur më parë nga vetë Jusufi, dhe ardhjes së përgjigjes pozitive që m'u komunikua nga Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982, në fund të marsit u bë organizimi i dërgimit të familjes së ngushtë të Jusufit në Shqipëri. Pas bisedave që kisha bërë me Engjëllin, nga Untergruppenbachu, më 28 mars 1982, u nisëm Haxhi Berisha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani dhe unë. Faridini për këtë rrugë e ka huazuar një kombi prej Nami Ramadanit, nga fshati Tenovë i Tetovës, që jetonte në Esslingen. Faridini me Nuhiun e kanë ngarkuar kombin me tesha e sende. Unë e Haxhi Berisha me Suzanën dhe fëmijët e kemi marrë trenin nga Shtutgarti për në Vjenë. Adresën e takimin na e ka caktuar Engjëll Kolaneci. Atë ditë ne të gjithë jemi takuar në Muzeun, në të cilin gjendej shpata e Skënderbeut. Unë, Faridini dhe Nuhiu jemi përshëndetur me Suzanën, Premtonin, Donikën e Ergonin në Muze dhe jemi kthyer së bashku me kombin e Namiut. Haxhi Berisha ka qëndruar më gjatë se ne me familjen atë ditë dhe është kthye më vonë, vetëm, me tren.

19. Pritja e Familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri

Nexhmije Hoxha: *"...Familja e Jusuf Gërvallës prej kohësh ishte e njohur për ndjenjat Kombëtare, prandaj shovinistët serbë e kishin përndjekur brez pas brezi këtë familje. Histori e dhimbshme, por e madhërishme. Dhe, kjo familje mori një grusht të rëndë, në një ditë, agjentura jugosllave vrau dy vëllezër, njëri më i mirë se tjetri. Suzana bashkë me dy djemtë dhe vajzën, në moshën shkollore, më i vogli 4 vjeç, erdhën në Tiranë. Shteti shqiptar mori përsipër mbajtjen e tyre, i strehoi i rregulloi në shkolla sipas dëshirave të tyre, u lidhi pensione të përshtatshme jo vetëm fëmijëve, por edhe Suzanës, e cila kërkoi të ndiqte studimet e larta jo duke punuar e me korrespodencë, por si studente e rregullt.*

Djali i madh, Premtoni, u zgjodh deri anëtar i KQ të Bashkimit të Rinisë. Kjo Familje gjeti ambient të ngrohtë jo vetëm te kosovarët që banonin në Shqipëri, por nga të gjithë ata shqiptarë që kishin për zemër Kosovën e që kishin dëgjuar për talentet e Jusuf Gërvallës, për këtë yll të ri të ndritur, që kish dalë e po ngritej nga gjiri i popullit të shumëvuajtur kosovar. Përveç shtetit për të shoqen e Jusuf Gërvallës e fëmijët e tij u interesua drejtpërsëdrejti vetë Enveri! Ai u kujdes si për jetimët e një shoku, siç ka bërë me shumë nga fëmijët e dëshmorëve të Luftës.

Unë personalisht, nuk lashë përvjetor të vrasjes së Jusufit pa i shkuar Suzanës për vizitë në shtëpi. Që në fillim u dërgova fëmijëve disa dhurata nga xhaxhi Enver, që të gëzoheshin. Kur mësuam që dëshira e Jusufit ishte që vajza të mësonte FLAUTIN, ne i dërguam një FLAUT. Dhe këtë ia dërgoi Enveri. Suzana më dhuroi një qeleshe kosovare, të cilën - siç më tha - Jusufi e vinte në demonstrata, më dha një flamur të qëndisur, që unë i kam ruajtur si relikte të shtrenjta bashkë me ato të Enverit.

Kur martoi djalin, unë shkova dhe e urova. Aty takova shumë kosovarë që kishin ardhë nga vendet ku kishin emigruar. Djalit të Jusufit iu bë një dasmë, që nuk i mungoi asgjë nga ç'mund t'i bënte babai, veçse mungonte ai vetë!..." (www.kosova.de)

20. Kërkesa për njohje dhe mosnjohja

Pas shkuarjes së familjes së Jusufit në Shqipëri, unë dhe Faridin Tafallari e takuam disa herë Engjëll Kolanecin. Në njërën prej këtyre takimeve atij i dhamë shumë gjëra që ishin të arkivuara në shtëpinë e Jusufit. Pos tjerash atij ia dhamë edhe punën origjinale që Jusufi kishte bërë në përgatitjen e numrave 3 dhe 4-5 të revistës "Liria". Engjëlli i mori me shumë dëshirë duke thënë se ato ruhen më mirë në Shqipëri se sa tjetërkund.

Xhafer Shatri kërkon të aplikohet qëndrimi që me diplomatët shqiptar, për çështje të Lëvizjes të mbaj kontakt vetëm Sabri Novosella në Stamboll dhe askush tjetër. Kësaj kërkese unë i bindem plotësisht dhe prej momentit që më është thënë e kam zbatuar me përpikmëri dhe seriozitetin më të madh. Në njëfarë mënyre ky hap ka qenë një kërkesë që PPSH ta njoh Lëvizjen, dhe unë kam pasur dyshime se a është e arsyeshme me i qitë diplomatët shqiptarë para një alternative të tillë në atë kohë. Sidoqoftë ngjarjet janë zhvilluar ashtu. Përgjigja e PPSH ndaj kësaj kërkese ka qenë shumë e ashpër.

Xhafer Shatri: *"Sa i përket letrës tënde të fundit, për mua çdo gjë është e qartë dhe qëndrimin tënd e aprovoj plotësisht, sepse ta duan dy vetë një njeri kjo është vërtetë më tepër se krim (ti duaj mua e unë veten kjo s'shkon). Përndryshe unë me djem të vëllaut s'kam pasur rastin të rri shumë, vetëm me njërin në Itali. Por këtu jam informuar prej shokëve lidhur me ta, dhe nga të gjitha këto kam ardhur te përfundimi se këta njerëz nuk po e bëjnë atë që duhet ta bëjnë apo atë që pritet prej tyre dhe jam i sigurtë se këtë gjë nuk e dinë eprorët e tyre. Besom se këta njerëz nuk kanë fije konspiracioni në*

kontakt me njerëzit tanë, p.sh. ai që kam biseduar me të në Itali u ka treguar njerëzve se ku kam shkuar unë...dhe kur e kam kuptuar një lëshim të tillë unë s'kam mundur t'u besoj veshëve të mi. ***Kjo dhe të tjerat që t'i përmenda m'i kanë hapur sytë shumë prandaj edhe kam insistuar aq shumë më 15 maj që kontaktet me këta njerëz t'i mbajsh vetëm ti.*** *Meqenëse është kështu ma merr mendja se është e domosdoshme që t'u drejtohemi drejtpërsëdrejti sh.e. dhe b.p. dhe atë me shkrim dhe t'i njoftojmë detalisht për të gjitha dhe vetëm pas përgjigjes së tyre me shkrim të marrim qëndrim të caktuar... dhe kuptohet t'ua bëjmë me dije se ne nuk jemi aventurier që me veprimet tona duam ta rrezikojmë edhe atë. Assesi. Prandaj nëqoftëse mendojnë se veprimtaria jonë shpie në atë drejtim, atëherë le të na tregojnë, apo të them më mirë le të na bindin me fakte.*

... Pos tjerash i paska thënë se gjoja ti i ke thënë Plakut se edhe ne apo më mirë të them unë s'qenkam i kënaqur me ta... sidoqoftë unë i kam thënë S qysh më parë se me atë njeri dhe as me kolegët e tij unë s'dua të bisedoj, sepse është shoku kompetent për këtë çështje, prandaj nëse kanë diçka le të urdhërojnë e të bisedojnë me të, çka është kjo t'i formojnë qindra lidhje? Lidhur me këtë do të ishte mirë, që ti t'ia tërheqësh vërejtjen Sahitit (Xhafer Durmishit-shën im) për këtë çështje dhe le ta kuptojnë ata njerëz se ne kemi disiplinë... Mbaj mend, nëse këtyre punëve s'ua presim rrugët që tash dhe t'i qesim në baza të shëndosha, atëherë do të kemi pasoja nesër që edhe dreqi do të çuditet. Këtu s'ka lojë. Politikë në mes vëllezërve s'guxon të ketë. Dreqi e marrtë thesi është thes, por njëqind bira nuk i ka.

E sa për dëshpërim që më kishe thënë, për këtë mos u mërzit aspak, sepse unë jam i përgatitur për të gjitha ama për të gjitha dhe e di se vetëm të bazuar në forcat tona ne do të fitojmë më lehtë. S'po e zgjas më tepër, sepse jam shumë i lodhur. Në letrën tjetër do të shkruaj edhe më gjerësisht për këtë gjë, por të lutem që edhe ti të mos e marrësh këtë si tragjike, sepse e shkatërron shëndetin kot." (Letër Sabri Novosellës, 16 gusht 1982)

Xhafer Shatri: *"Unë fjalët e E. (Engjëll Kolanecit-shën i Xh. D.) që i paska lëshuar i marrë më parë si provokim që të është bërë ty për ta kuptuar se në ç'shkallë është besimi dhe mirëkuptimi ynë, sepse përkundër të gjithave unë s'besoj se ata përpiqen që mu në këtë kohë ta minojnë punën tonë, unitetin tonë. Tek i lexoj shkrimet e atjeshme, çfarëdo qofshin ato, unë kurrë se besoj se dikush guxon të merret prej tyre me punë që e dëmtojnë një lëvizje nacionalçlirimtare e kujtdo qoftë ajo. Por nëse atij i intereson ta dijë atë punë, atëherë le t'i drejtohet shokut tonë kompetent për marrëdhënie me ta dhe ai do t'ia mbaj një ligjëratë të vogël jo vetëm për këtë "rastin" tim, por edhe për mirësjelljen." (*Letër Xhafer Durmishit, 1 nëntor 1982)

Faridin Tafallari: *"Mbrëmë e mora në telefon (Engjëll Kolanecin-shënim i imi) i kërkova të na dërgoj ndonjë film për 28 Nëntor dhe i tregova se e kemi organizua këtë rreth për kremtimin e festës. Shumë vonë tha jeni lajmërue, kurse atyre që janë lajmëruar më heret u kemi dërguar. Ku jeni humbë, nuk lajmëroheni fare. Pyeti edhe për ty. Si është tha, dhe a po e takon? I thash se po takohemi rrallë por me telefon më fort.*

*Letrat e Suzanës kishin ardhur dhe diçka tjetër, për të tjerat nuk më tregoi. Po merre në telefon ti!" (*Letër Xhafer Durmishit, 24 nëntor 1982*)*

Xhafer Durmishi: *"Letër për Engjëll Kolanecin*

Shoku Engjëll

(Engjëll Kolaneci, diplomat në Ambasadën e Shqipërisë në Vjenë)

Në prag të festës Faridini më njoftoi për bisedën telefonike që paska pasur me Ju. Me këtë rast më tregoi se tek Ju paskan ardhur letrat e Suzanës. Siç ju pata thënë edhe më

parë, neve na u deshtë që gurët t'i rregullojmë me çdo kusht para festës, dhe siç mund t'ju ketë treguar shoku Faridin, ata (gurët) u vendosën e me sa duket janë të punuar mirë. Edhe njerëzit kanë dhënë vlerësime të mira, por ndonjë fotografi ende nuk ma kanë sjellë shokët. Ne huazuam një shumë të hollash për këtë rast dhe paguam një pjesë për të cilën të kam pas treguar. Firma e gurëve, në të vërtetë më kompetentja, se këto rregulla këtu unë nuk i di, por si më kanë treguar e ka bërë punën në atë mënyrë që, kur të kthehet letra e Suzanës do të na kthehen të hollat. Siç e dini, në atë letër Suzana autorizon një njeri që të përgjigjet në çdo rast për sigurimin e gurit të të shoqit, për arsye se ajo nuk ka banim të përhershëm në mërgim.
Përndryshe ne jemi mirë, edhe punët janë duke shkuar mirë.
Te fala S. (Xhafer Durmishi " (Letër Engjëll Kolanecit, nëntor 1982)

Xhafer Durmishi: *"Sa përket Engjëll Kolanecit, më njofto posa t'i marrësh letrat e Suzanës. Nëse ka diçka me rëndësi ai do të shkruaj, apo do t'ia thotë shokut tonë më përgjegjës, i cili është i caktuar për marrëdhënie me ta, sepse unë nuk mund ta thërras, sepse* ***e tillë është marrëveshja me shokët****." (Letër Faridin Tafallarit, nëntor 1982)*

21. E din serbët kend e lëshojnë nga burgu!

Xhafer Durmishi: *"Edhe këtë vit, në ditën e shtunë të panairit të librit ishim në Frankfurt.*
Gjatë ditës brenda në Panair pothuaj kohën më të madhe më shoqëroi Skender Dushi dhe bisedën më së shumti e solli tek Ibrahim Kelmendi me qëllim që të mbjellë dhe forcoj sa më shumë dyshimet në te.

Në mbrëmjen e asaj dite me Engjëll Kolanecin u takuam unë dhe Faridini. Ai ishte vetëm (dhe kështu ka qenë në të gjitha rastet). Që ta kemi këtë takim kësaj radhe kisha interes edhe unë, pasi desha ta shfrytëzoj rastin e kësaj dite dhe i thash se takimet tona në vazhdim janë të panevojshme.

Faridini i foli edhe për atë çka se prita, se çka i kanë thënë Jahir Jahirit gjatë vizitës së tij në Shqipëri. Engjëlli u përgjigj se atje iu kanë thënë gjëra që bënë me ju thënë, pra edhe ato që ua themi edhe ju, që të ruheni se keni në radhët e tuaja shumë njerëz të dyshimtë, dhe se serbët e dinë se kend e lëshojnë nga burgu.

Jahir Jahiri është një punëtor, rreth 40 vjeçar, nga fshati Slivovë i komunës së Ferizajt. Ka të afërm në Shqipëri dhe kësaj vere përmes shokëve në Ambasadën e Vjenës, është i vetmi punëtor kosovar me sa di unë që e ka vizituar atdheun. Ka qëndruar një muaj ditë. Ka qenë një prej më aktivëve dhe iu është përgjigjur të gjitha manifestimeve, dhe nuk është dalluar në ndonjë mënyrë prej rrethit të vetë. Për ZK (Zërin e Kosovës-shën im) thoshte se po del edhe më i mirë se përpara. Pasi u kthye nga vizita në Shqipëri ka ndryshuar për 180 shkallë. Ky ka qenë anëtar direkt i rrethit të Faridinit. Pas kthimit nga vizita u largua nga Faridini e rrethi i tij dhe iu afrua Halimit (Osman Osmanit-shën im). Jahiri është iniciatori, ai që ka kërkua me këmbëngulje takimin e aktivistëve kryesor të rrethit të Shtutgartit më 26 shtator 1982. Por si duket u befasua nga se si iu përgjigjën të gjithë këtij takimi dhe mungoi.

Me Jahirin u takova edhe në mbrëmjen e kremtimit të 28 nëntorit, pasi festa ishte organizuar në një sallë në fshatin ku ai banonte. Një punëtor më tha- a shkoj ta marrë, dhe unë i thash se do të ishte mirë nëse vjen. Ai erdhi. Kah mesi i programit, ky shoku që e solli më tha se Jahiri po ka dëshirë me e marrë fjalën. I thash mirë por dua ta dijë se çka do të thotë. Jahiri, pasi kishte pi pak, më thotë se kjo është punë për mua. Unë nuk e lejova se nuk besoja se nuk do ta lëshoj ndonjë fjalë, duke e lutur që të mos na e prishë këtë mbrëmje. Ai u hidhërua si mora më vesh edhe më tepër duke thënë se

Jahir Jahirin e njeh krejt Shqipëria etj. etj." (Letër Xhafer Shatrit dhe Sabri Novosellës, 3 dhjetor 1982)

Xhafer Durmishi: *"Së pari po të them se këtë letër që ta kam dërguar, të mos e kuptosh se është shkruar nën ndikimin e ligjit të inercionit kur pas gjithë atyre diskutimeve të mëparshme në drejtimin tjetër nuk munda të ndalem menjëherë. Së dyti këtë letër nuk e kam shkruar as nën ndikimin më të vogël nga fjalët e Engjëllit, sepse vetë përmbajtja e të letrës dhe e të gjitha qëndrimeve të mia flasin për një besim të patundur i cili nuk do të lëkundet në asnjë moment prej anës tonë. Nuk është vështirë të kuptohet se përmbajtja e letrës së fundit ka të vetmin qëllim një besim e respekt pak më të madh prej anës tënde ndaj meje, të cilin besoj se kam të drejtë ta kërkoj së paku në masën e 50%-shit të qëndrimit tim.*

... Sa i përket propozimit tënd, unë përgjigjen e tij e shënova në këtë letrën më të gjatë, si dhe për qëndrimin e Engjëllit, se çka i kam thënë unë pas atyre fjalëve të kam treguar më parë. Për qëllimin, nuk di çka të them, di aq sa din ti për këtë, në bazë të këtyre të dhënave që i kam shprehur tash dhe më parë. Unë e mora edhe letrën prej Kamberit (SN) në lidhje me propozimin tënd të cilin ai e aprovon dhe më thotë arsyetimin e vet. (Letër Xhafer Shatrit, 5 dhjetor 1982)

Xhafer Shatri: *"Këto ditë na ka ardhur edhe një letër-ultimatum. S'ka fjalë, njerëzit po përpiqen të na bëjnë bisht të tyre në çdo aspekt e ne kurrë nuk guxojmë të lëshojmë pe. Kurrë, sepse në të kundërtën kjo do të ishte vdekje. Po shihet qartë së qëllimi i adashit tënd (Skender Dushit-shën im) është të mbjellë amulli dhe të mos bëhet asgjë. Ndodhë fare lehtë që ata të shërbehen me njerëz të ud. (udbës) vetëm sa ta bindin në mënyrë indirekte J. (Jugosllavinë-shën i Xh. D.) se nuk përzihen në punët e saj të brendshme." (Letër Xhafer Durmishit, 31 janar 1983)*

Xhafer Shatri: "*...një rast tjetër edhe më flagrant me rastin e shfaqjes së koncertit në Dyseldorf. Shkon Engjëlli (Kolaneci, diplomat shqiptar në Vjenë-shën i Xh. D.) dhe i merr Xhavitin, Hyzriun dhe Fazliun e u thotë: ku është Lëvizja, keni kujdes se aty është udba, mos u mashtroni, hapni sytë dhe kështu në këtë kuptim...diçka e pabesueshme dhe ata burrat e botës asnjëri se kanë njoftuar shokun me të cilin kanë kontakt (Xhafer Durmishin-shën ynë)."* (Letër Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983)

Xhafer Shatri: *"Me një fjalë të thotë kush çka të dojë, por politika e Lëvizjes është e drejtë. Ndodhë që kësaj t'i fryj edhe njëfarë Engjëlli i Vjenës që është mësuar më parë të mvrej e kthjellë këndej e tash pasi e ka parë që nuk po ia varë kush, përpiqet të na luftoj edhe me metoda kaq të poshtra. Por sjelljen e tyre të bëjnë të kuptosh se ata duan zhurmë e jo punë. Ne nuk jemi për zhurmë dhe natyrisht ata e kanë parë këtë fare mirë. Tufanin kur të shpërndahen këto ditë 1200 ZK në Kosovë ia ndien tërë Ballkani e më së shumti ata."* (Letër Sabri Novosellës, korrik 1983)

22. Refer të njëanshëm, dyanshëm apo neutral

Sabri Novosella: *"Sa i përket letrës për vëllaun e madh edhe ne kemi qenë të mendimit të shkruhet derisa kemi supozuar se është punë e ndonjë diplomati, por tani kur çdo gjë është e qartë, se kjo nuk është punë e ndonjë personi por qëndrim i dikujt që shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi kurrsesi të mos kenë një organizatë të fuqishme e cila do të jetë e aftë t'i prij popullit dhe ta përfaqësoj para shteteve të botës dhe para forumeve ndërkombëtare. Shkruarja e letrave është e kotë. Ne na duhet ta bëjmë punën tonë e ata punën e vetë por gjithnjë duke e ruajtur gjakftohtësinë. Sa i përket asaj që thua se ata luajnë rolin e referit të njëanshëm ajo nuk është e vërtetë pasi referi është i dyanshëm. Kolegu i Plakut (Bujar Hoxhës) që është këtu dhe që kemi kontakte të vazhdueshme me te, na ka thënë tekstualisht: Bujar Hoxha dhe Engjëll*

Kolaneci kanë hëngër dajak për sjelljet dhe gabimet që i paskan bërë ndaj nesh, kurse ky mundohet të paraqitet si person që mbron krahun e L., por na këshillon që të jemi të matur ndaj Abdullah Prapashticës nëqoftëse nuk dyshojmë në te, por nëse dyshojmë ajo është çështje tjetër.

Në pyetjen tonë se çka t'u themi shokëve (njerëzve) për poshtërsitë e A.P. të cilat ia përsëritëm edhe njëherë, ne tre anëtarë të KQ, na u përgjigj:

-U thoni ato që m'i thatë mua!

Kjo tregon se ata nuk janë të interesuar ta përkrahin njërën apo tjetrën, por janë të interesuar që kurrsesi dy milion shqiptar në Jugosllavi të mos e kenë një përfaqësues të vetëm në plotëkuptimin e fjalës, por të vazhdoj dhe të zhvillohet vazhdimisht një aktivitet më tepër spontan se sa i organizuar mirë. Çka duan me arritur me këtë do të shifet më vonë.

Të fala vëllazërore Mërgimi e Aliu" (Letër e Sabri Novosellës dhe Asllan Muharremit për Xhafer Durmishin, 15 gusht 1983)

23. Qëndrime të kosovarëve në Shqipëri

Pas demonstratës së Shtutgartit të janarit 1983, Hasan Mala dhe Xhafer Shatri e sjellin Milaim Zekën (mikun e Fatmir Krasniqit, të dënuar me grupin kryesor të OMLK-së) në Shtutgart (Sindelfingen) për punë minuese dhe për shkatërrimin e ndikimit tim, të Haxhi Berishës e të tjerëve në rrethin e Shtutgartit. Pas një qëndrimit të tij në Sindelfingen, Në pranverë 1983 Milaimi gjendet në Düsseldorf-Bielefeld. Në prill 1983, Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve e bënë turneun e vetë nëpër Gjermani, turne e cila ishte organizuar nga Engjëll Kolaneci, diplomat në Ambasadën Shqiptare në Vjenë. Pas një koncerti në Gjermaninë veriore, Milaimi e blen një tubë të mirë me lule për Enver Hoxhën dhe ia jep përfaqësuesve të ansamblit në skenë dhe ky gjest me mjeshtëri propagandistike videofilmohet për t'u shfaqur më vonë në televizionin shqiptar, (dhe nëpër një videokasetë që u shpërnda nëpër Evropë), se si i shkojnë karanfilat Enver Hoxhës prej të rinjve kosovarë. Kjo ngjarje e karanfilave nuk është kushedi se sa me rëndësi në këtë shtjellim, por më interesant janë disa ngjarje që pasojnë. Talentin për propagandë të Milaimit, përveç Xhafer Shatrit e heton edhe Engjëll Kolaneci i cili e organizon shkuarjen e tij në Shqipëri në vjeshtën e vitit 1983. Në Shqipëri, Milaimi qëndron dy-tre muaj ditë, dhe kohën më me rëndësi e kalon me Ajet Haxhiun. Ajeti me qëndrimin dhe përvojën e tij, e përgatitë mirë dhe i jep argumente të bollshme ideore për ta kthyer në luftë kundër Xhafer Shatrit. Këtë, Ajeti e bënë duke ia analizuar e zbërthyer fjalë për fjalë të gjitha frazat që Xhafer Shatri i kishte shkruar në Zërin e Kosovës, gjatë vitit 1983, e sidomos të njëfarë programi të tij. Ajeti shkon deri në atë masë sa i thotë Milaimit: "Nëqoftëse patjetër do me veprua për Kosovën, dhe ta zëmë se nuk të kanë mbetur shumë mundësi me zgjedhë, atëherë Kosova ka me të llogaritë ma patriotë e ma bir të ndershëm nëse bashkohesh në fund të fundit edhe me UDB-në e LKJ-së revizioniste se sa me Xhafer Shatrin."

Ajeti i thotë me shumë vëmendje edhe këtë: Mendimet të cilat Milaimi duhet me i shprehë e mbrojtë kur të kthehet në Gjermani, nuk guxon t'i prezantoi si mendime të Partisë së Punës të Shqipërisë, por vetëm e vetëm si mendime të kosovarëve në Shqipëri.

Gjatë gjithë kësaj kohe, unë nuk di asgjë për këtë punë, pasi nuk kam pasur mundësi si t'i marrë vesh këto rrjedha. Sidoqoftë, me përkrahjen e diplomatëve shqiptarë e të Ajet Haxhiut, Milaimi gjatë muajve të parë të vitit 1984 është shokë i pandarë me Fazli Memajn nga fshati Korishë afër Prizrenit, dhe këta dy qëndrojnë shumë tek bashkëfshatarët e Fazliut në rrethin e Bilefeldit dhe në Düsseldorf. Në Düsseldorf, apo

thënë më saktësisht afër Düsseldorfit, qëndrojnë më së shumti tek Musa Daka, nga Korisha, i cili ka banuar në Duisburg. Musa Daka ka qenë aktivist i dalluar në klubin Emin Duraku të Düsseldorfit.

24. Xhafer Durmishi: *"Nuk jam për ate që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët."*

Ai që hyn në lojë duhet lojën ta duroj

Sabri Novosella: *"Sot më ra në dorë proqesi i komisionit të mbajtur për rastin e U. (Xhafer Shatrit) i cili ishte i shkruar me dorë të I. (Ibrahim Kelmendit-shën i Xh. D.). Së pari po kërkoj falje për këto që do t'i them, pasi që ndoshta fjalët e shënuara në te nuk janë të juajat por të shkruara me kokë të vetë nga Ibrahimi. Nëqoftëse janë të thanuna nga S. (Xhaferi) e F. Faridini pak po habitem.* ***S. (Xhafer Durmishi-shën im) thotë se nuk jam për ate që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët dhe vazhdon se Mërgimi ka qenë i ndikuar nga diplomacia lidhur me sjelljet e tij.***

Unë jo vetëm se kam qenë i ndikuar nga ata, por fjalët e tyre kanë qenë fakti i parë në të cilin jam bazuar*, kurse fakti i dytë ka qenë ajo kur e pash me sy të mij, kur ju tha të tjerëve: A i pe shpijunat e Shqipërisë dhe duhet të ruhemi nga shpijunat e tyre.*

Për çdo kend që i ka dy kokrra mend në kokë, njeriu që i thotë tjetrit shpijun i Shqipërisë, duhet ta dij se vetë është shpijun i UDB-së. Vjen pyetja; nëqoftëse dikush e akuzon tjetrin se është shpijun i Shqipërisë, vetë shpijun i kujt është. Pasi këto fjalë i tha U. Para syve të mij dhe i kisha faktet që m'i kishte thënë Profesori dhe m'i kishi përcjellë edhe ju fjalët e E. Engjëll Kolanecit, gjë që plotësisht u përputheshin, për mua nuk patë më kurrfarë dyshimi se U. Është i tillë. Këtë fakt e pa çdo kush në tryezë dhe në dorë. U. është njeri i mërgatës së qarqeve dhe të gjithë ata që janë të mërgatës së qarqeve, janë shpijun të UDB-së, gjegjësisht të gjithë ata që janë kundër Tiranës, janë në shërbim të Beogradit në një mënyrë ose në një tjetër. Përndryshe unë aty e pash një frymë antiShqipëri e cila më tmerrojë.

Zoti U. më tha me gojë të vetë se, nëqoftëse do të del në botën e jashtme Rexhep Mala, së pari do ta urdhëron vëllaun e tij me bisedua me te dhe me ia largua frymën që e ka, pasi që të gjithë ata që po vijnë mbrendshmit, po vijnë me frymë të atjehit; me dashuri për Shqipërinë dhe për udhëheqësit e saj. Pasi t'ia mbushë mendjen Rexhepit vëllau i vetë, atëherë edhe ne i ndihmojmë e e kthejmë kundër tyre. Se ka vepruar kështu edhe me të tjerët e pash edhe vet ashtu si e keni parë edhe ju; kishte përgatitur njerëzit dhe i kishte bërë ashtu si ishte vet dhe faktikisht aty e kishte formuar bandën antiShqipëri. Do të shifni se ku do ta qoj zotin U. ajo veprimtari e poshtër e tij. Për gjakun e dëshmorëve, sa m'u ka dhimbt Rexhep Mala, aq edhe ia pata lakmi që e dha jetën si patriotë e me atë frymë që e ka pasur deri në çastet e fundit të jetës, dhe nuk doli rrugëve të botës me manipuluar gjithfarë njerëzish të poshtër me te dhe me ia turbulluar mendjen dhe ndjenjat e pastërta.

(...) Luftëtarët e lirisë i lidhë ideali, jo kumaria e akraballëku. Luftëtarët e lirisë janë të lidhur në mes veti deri sa i kanë të njejta idealet, por kur idealet e tyre ndahen, edhe ata ndahen e shëndrrohen në armiq të përbetuar." (Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984)

25. Udhëzime inspiruese nga Ambasada Shqiptare në Vjenë

Xhafer Durmishi: *"Në qershor 1984 në adresën: I. Bytyçi,6 Rue des Cailles, 94450 Limeil Brevannes, France – është botuar numri i parë i "Zëri i Kosovës" në formatin A3, që më vonë vazhdoi të dali në Suedi. Po në qershor e kam marrë pasaportën franceze. Pas kësaj e kam marrë makinën e shtypit dhe kam shkuar në mënyrë legale në Zvicër, në Amriswil tek Haxhi Berisha. Tek Haxhiu në këtë kohë qëndronte Sabri Novosella.*

Në praninë time, të Haxhi Berishës dhe të një shoku tjetër, Sabriu, në bazë të një bisede të mëparshme të tij, ka thirrur në telefon në ambasadën shqiptare në Vjenë. Arsyeja e bisedës: me i pyet se çka mendojnë për gazetën "Zëri i Kosovës" që ishte botuar ato ditë në Paris?

Përgjigja prej ambasadës që i është dhënë Sabriut ka qenë kjo:

- Shumë i mirë!"

Hafiz Gagica: *"Pasi që jam tek Namiu (Nami Ramadani-shën im) po ndalem më gjerësisht rreth takimit me te dhe bisedës që kemi zhvillua. Namiu erdh dje tek unë në mëngjes dhe biseduam rreth 5-6 orë rreth Xhafer Shatrit, I. Kelmendit si dhe rreth teje, bacit, Milaimit, Xhavit Ramabajës dhe Musa Hotit (siç e din ti Namiu e ka merak të kapet për disa fjalë boshe dhe njëherit ushqehet me to, se i duhen për me përpilue vica etj.). Namiu tha se unë qëndroj në ato qëndrime të mëparme, e shpërndaj Zërin të cilin e kam shpërnda gjer më tani, sepse isha para një muaji dhe fola me Klime Priftin (diplomat i Shqipërisë në Vjenë-shën i Xh. D.) dhe ai më tha se qëndro aty ku ke qëndrua gjer më tani, se mirë e keni. Namiu tha se i thash po unë kam qenë shok i pandarë me Hafizin dhe tani ka ardhë situata me u vra në mes veti se qëndrojmë në pozita të kundërta, e ai tha 'ti shpërndaje qatë (Zërin e Zvicrës.). Namiu tha se më tepër i besoj Klimes se tjetërkujt."* (Letër Xhafer Durmishit, 29 dhjetor 1984)

26. Propozime për ndërtim raportesh me Partinë e Punës së Shqipërisë

Xhafer Durmishi: ***"Letër shokëve në Shtutgart dhe Zurich***
4 qershor 1988

Në këtë letër do të shtrojë këtë çështje: Si e mendoj unë qëndrimin tuaj, dhe çfarë do t'i kisha propozuar çdo grupi apo partie kosovare që përpiqet ta vejë në baza të drejta punën e saj në raport me Partinë e Punës të Shqipërisë (PPSH) apo qeverinë e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH).

DISA PARIME THEMELORE LIDHUR ME PPSH-në DHE QEVERINE E RPSSH-së

Diskutimi i çështjes së bashkimit kombëtar nuk i takon kësaj teme.

Diskutimi i relacioneve të KSA të Kosovës dhe RPSSH nuk i takon kësaj teme.

Këtu do të shtrojë vetëm ato çështje se si duhet të sillet (sipas pikëpamjeve të mia) një shoqatë, organizatë, grup apo parti kosovare që vepron në Evropën Perëndimore në vitin 1988.

Duke pasë parasysh

-se për çdo grup e organizatë politike të Kosovës, çështja kryesore e politikës së saj të jashtme (dhe ndikimin e saj jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe në atë të brendshme) është qëndrimi i saj që do të marrë ndaj PPSH dhe RPSSH,

-se në kushtet që mbretërojnë sot as që mund të bëhet fjalë për marrëdhënie zyrtare të çfarëdo organizate kosovare ilegale (në mërgim apo brenda) me PPSH-në,

-faktin se përkundër çështjes së lartpërmendur kontaktet e organizatave kosovare jashtë dhe PPSH, si dhe ndeshja e pikëpamjeve të tyre është e pashmangshme, dhe mund të

zhvillohen për një kohë të gjatë,
çdo organizate të mirëfilltë kosovare i propozoj me sa vijon:

Qëndrimi ndaj diplomatëve të RPSSH në Evropën Perëndimore dhe vendet tjera në përgjithësi

Kur unë flas për diplomatët si kapitull i veçantë të kësaj teme, flas jo për atë se ata i vej në një rang më të ulët apo më të lartë se rrethet qendrore të PPSH e të Shtetit Shqiptar, por vetëm e vetëm për faktin se pikërisht përmes tyre ngjajnë kontaktet, fërkimet dhe ndeshja e drejtpërdrejtë e pikëpamjeve për gjërat më të ndryshme.

Çështja e kontakteve

-A të jenë ato të rastit apo të organizuara?

-A të jenë kontakte personale apo në grupe?

-A të jenë të shpeshta apo të rralla dhe kujt duhet t'i takoj iniciativa?

Pasi fjala është për një palë me të cilën marrëdhënie zyrtare nuk mund të kesh, dhe kur qe pesë vite ka pasur aq shumë deklarata të qarta se PPSH nuk njeh kurrfarë organizate jashtë, për takime të organizuara nuk mund të bëhet fjalë. Pra mund të flitet vetëm për takime të rastit.

A të jenë kontakte personale apo në grupe? Kjo çështje nuk ka nevojë të precizohet, për të thënë se bënë vetëm kështu apo ashtu. Këtu mund të flitet vetëm për rekomandime (dhe e quaj të rrugës) që të kontaktohet kur të jenë të pranishëm të paktën dy veta. Përndryshe kjo mbetet që secili të vendosë vetë. Duhet pasur parasysh se kontaktet vetëm kur ke të bësh me një problem të rëndësishëm mund të qesin në pozitë të palakmueshme. Unë nuk jam ithtar i takimeve personale.

Çështje e materialeve me shkrim dhe letrave

Në shumicë ata i marrin vesh botimet publike, sikurse edhe të tjerët. Nuk jam as për fshehjen e një shume të madhe letrash e materialesh që nuk ka nevojë dhe nuk mund të arrijnë të botohen tani. Por nuk bënë të pranohet sa të zbritet gjer në atë shkallë sa kur t'u jipet një material të të thonë: "Ne nuk na interesojnë çështjet tuaja, por meqë i keni sjellë ne i marrim. Kushdo që të na jep çfarëdo qoftë ne e kemi për detyrë që ta përcjellim në qendër."

Prej atyre fshehtësive vitale që janë për një organizatë, të cilat nuk bënë t'i dijë askush jashtë (dhe përveç kësaj edhe vetë brenda organizate se si rregullohet ky problem e kujt t'i besohen lidhjet kryesore e emrat e shokëve) nuk ka nevojë të bëhet përjashtim as për diplomatët shqiptarë.

2. Çështja ndaj vizitave turistike në Shqipëri

Nuk ka nevojë të ketë një qëndrim të prerë. Mund të shkoj çdo kush, qoftë vetëm, qoftë në grup apo me familje. Po që se dikush kthehet prej andej me mendime të kundërta për organizatën e vetë dhe lufton kundër saj duke u thirrur në mësimet që i ka marrë gjatë vizitës duke shkaktuar përçarje e huti, duhet pasur parasysh se për një problem të tillë lind nevoja të diskutohet në shtyp. Pra mvaret nga shkalla e problemit, por teorikisht një mundësi e tillë ekziston plotësisht.

3. Shokët në Kosovë dhe qëndrimi ndaj PPSH

Të gjithë shokët në Kosovë njoftohen me qëndrimet e marra lidhur me problemin që e kemi në shqyrtim.

4. Shokët nga Kosova që përkohësisht dalin jashtë

Duhet t'u lihet mundësia që të krijojnë vetë pikëpamjet e tyre. Në rast të kërkesës së tyre, e sipas rastit mund të takohen me diplomatët shqiptarë.

5. Për kontaktet personale

Mbajtja e kontakteve të tilla nuk përjashtohet si mundësi. Është mirë që ato të jenë të rastit. Mbajtja e tyre e rregullt e mosinformimi i shokëve për to konsiderohet punë agjenturore.

6. Mbi çfarë bazash duhet ndërtuar taktika ndaj qëndrimeve të PPSH

Taktika duhet ndërtuar vetëm në bazë të qëndrimeve zyrtare të PPSH-së ndaj problemit të Kosovës. Fjalët jo zyrtare, si "qëndrime personale", si "mendime të kosovarëve në Shqipëri", fjalët e diplomatëve unë jam për t'i dëgjuar me kujdes, por kurrën e kurrës ndaj fjalëve të gojës e nën ndikimin e tyre të merret ndonjë vendim me shkrim. Është tjetër çështje nëse arrihet në konkluzione të ngjashme që më parë d.m.th. para sugjerimeve të tilla apo në bazë të fakteve tjera." (Letër shokëve në Shtutgart e Zurich, 4 qershor 1988)

27. PPSH dhe organizatat e majta të Kosovës

Xhafer Durmishi: ***"PARTIA E PUNES E SHQIPERISE DHE ORGANIZATAT E MAJTA TE KOSOVES***

Partia e punës në rolin e drejtuesit të shtetit ka pasur ndikim të madh në disponimin shpirtëror të Kosovës. Partia e punës ka bërë intriga kundër organizatave të Kosovës, dhe është shërbyer me trillime dhe shpifje. Në këtë punë ajo ka angazhuar shqiptarë me banim në Shqipëri, që kanë pasë e i kanë rrënjët në Kosovë. Por mosbashkimi i tetorit 1981 nuk është vepër e diplomacisë shqiptare. Ka pas ndikim të mirë të Bujar Hoxhës në bashkimin i 17 shkurtit 1982 në Ankara. Intriga të mëdha kundër aktivistëve të ndryshëm ka pas, sipas nevojës e situatës, me përjashtim të Abdullah Prapashticës. Por këto intriga kurrë nuk kanë qenë vendimtare as në bashkim e as në përçarje.

Vetë fakti se mbështetja e Republikës së Kosovës ka qenë dhe mbetet e karakterit kombëtar, qëndrimi aq i diferencuar dhe i ndryshëm ndaj ideologjisë së Partisë së Punës nuk ka qenë kurrë shkak vendimtar për përçarje në organizatat e Kosovës. Intrigat përçarëse kanë ekzistuar, por ato janë vetëm një pjesë e të vërtetës dhe aspak krejt e vërteta.

Kur një shtëpi digjet, pronari përpiqet ta ngrisë sa më shumë vlerën e saj që të mund të marrë më shumë të holla nga shoqata e sigurimeve. Kur një ndërmarrje ekonomike falimenton, kreditorët e ndryshëm përpiqen të provojnë se ata kanë qenë investuesit kryesor prandaj edhe duhet t'u jepet përparësia kryesore për ndarjen e asaj çka ka mbetë për t'u nda nga ndërmarrja e falimentuar. Bartja e ngjashme nga fusha e ekonomisë ku janë të përzier një numër i vogël njerëzish dhe ku ka fonde të parapara sigurimi, në fushën politike e në fatin e luftës është i rrezikshëm dhe i dëmshëm për të gjithë ata që shërbehen me metoda të tilla.

Është një gënjeshtër e paskrupullt dhe një falsifikim i ngjarjeve të thuhet se gjithçka e keqe në organizatat e Kosovës ka qenë e mbjellur nga PPSH, dhe sikur të mos ishte puna e saj gjithçka do të ishte mirë. Është po aq dobësi për të gjithë ata që thonë se Kosova ia ka zgjatë jetën pushtetit të Partisë së Punës.

Partia e Punës e ka xhirollogarinë e vetë të mbushur me krime e poshtërsi gjatë ushtrimit të pushtetit mbi ata nënshtetas shqiptarë të kohës së vetë dhe nuk besoj se mund të lakmoj që të marrë mbi vete edhe ato të të tjerëve.

Si ushtruese pushteti në një toke të lirë dhe e një subjekti të afirmuar e të pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare Partia e Punës mban përgjegjësinë historike për mospunën e vetë në interesin e gjithë kombit. Për të njëjtat arsye, kërkesat dhe përgjegjësia më e madhe do bien edhe më tej mbi ata që do të qeverisin nga Tirana." (maj 1992. E botuar edhe në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 330*)*

28. Hoxha, engjëjt dhe xharrahët

Xhafer Durmishi: *"Çështje tjetër është ndikimi që kanë pasur tek unë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Enver Hoxha.*

Qysh si fëmijë kam pasur një kureshtje dhe dashuri të pashuar për Shqipërinë, e cila është shprehur edhe në dashurinë për E. Hoxhën. I dehur nga kjo dashuri kam shkuar aq larg sa kam menduar se një ditë patjetër do të takohem me Hoxhën. Shkrimet e artikujt e tij jo vetëm që më kanë pëlqyer por tek unë kanë pasur edhe ndikim bindës. Artikujt e tij për Kosovën e për mbrojtjen e flaktë e të argumentuar të kërkesës "Kosova-Republikë" janë të fuqishëm, të madhërishëm dhe të patejkalueshëm.

Vitet kaluan, unë dola në Gjermani. Personalisht me Hoxhën nuk u takova kurrë, por megjithatë një pjesë e ëndrrës fëminore m'u realizua. Kam fakte të pamohueshme dhe dëshmitarë të gjallë se në Salzburg, Vjenë dhe Frankfurt më është parafytyruar (jo njëherë por disa herë) vet KryeEngjëlli, KryeEngjëlli i Hoxhës, Engjëll Kolaneci, diplomati kryesor i Shqipërisë që është marrë me çështje e me shqiptarë të Kosovës në Gjermani e Zvicër. Natyrisht se më janë shfaqur edhe engjëj e shpirtra tjerë, por në kategorinë e engjëjve asnjë nuk mund të krahasohet me Engjëllin.

Nuk e di se a është e vërtetë apo jo, por thonë se për t'i takuar rrethit më të ngushtë të Hoxhës patjetër është dashur të kalosh nëpër duart e xharrahëve, se pa kalua nëpër duart e tyre ka qenë e pamundur me hy në kalanë e tij. Këtu nuk e shohë të arsyeshme e as nuk më takon të zgjerohem në hipoteza lidhur me krimet dhe garat e xharrahëve dhe servilëve. Me këtë rast dua të them se E. Hoxha, për mua dhe për Atë që e çmoj më së shumti në këtë jetë, ka qenë një nga inspiruesit e frymëzuesit në luftë kundër pushtetit serb. Në atë periudhë të jetës time, (gjer në vitin 1985) mund të thuhet se Kosovës nuk i ka ardhë asnjë e keqe prej E. Hoxhës por vetëm të mira. Duke u bazuar në numrin e tytave të topave e pushkëve, Shqipëria ka qenë mbrojtësja konstante, besnike dhe e guximshme e Kosovës dhe shqiptarëve nën Jugosllavi. Ne që kemi qenë jashtë territorit të RPS të Shqipërisë kemi parë vetëm anët e mira. Ne kemi pasë punë vetëm me engjëj. Është me rëndësi që ta pohojmë këtë fakt dhe kjo nuk duhet të merret si ofendim i viktimave të gjalla e të vdekura të dhunës fizike e psikike të sistemit të tij. Por vlerësimet tona janë të njëanshme dhe mbeten të tilla. Vlerësimin, kritikat, lavdatat e të tjerat u takojnë në radhë të parë dhe të fundit atyre që kanë jetuar nën regjimin e tij, që kanë pasë punë jo vetëm me të mirat e engjëjve por edhe me trajtimet e xharrahëve." (Protesta e Aspirata, Prishtinë 2006, faqe 6-7)

Valbona Kolaneci: "*Unë që po ju shkruaj jam Valbona, e bija e Engjëll Kolanecit. Shumë faleminderit për mesazhin dhe për librin tuaj me kujtime bashkangjitur, i cili më emocionoi pa masë dhe më zgjoi kujtime të bukura. Fatkeqësisht më duhet t'ju njoftoj se babai im ndërroi jetë gati katër muaj më parë. Është rasti ta them se Kosova dhe gjithë miqtë e shokët kosovarë kanë qenë shumë të dashur për babain tim. Ai ruante mbresat më të bukura nga vizita e tij e parë dhe e fundit në Kosovë në fund të vitit 2005. ... Edhe një herë ju faleminderit shumë për fjalët e mira në adresë të babait tim."* (Letër Xhafer Durmishit, 22 janar 2007)

Shkurtesat

ATSH	Agjencia Telegrafike Shqiptare
AVNOJ	Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë
B e H	Bosna e Hercegovina
BK	Bashkësia e klubeve
DDR	Republika Demokratike Gjermane
FIDE	Federata Ndërkombëtare e Shahut
IBM	International Business Machines (Ndërmarrje multinacionale Amerikane)
KDPBKSHM	Këshilli Drejtues i Punës i Bashkësisë së Klubeve Shqiptare në Mërgim
KQ	Komiteti Qendror
KRIPO	Policia Kriminalistike
KSA	Krahina Socialiste Autonome
KVG	Komitetit "Vëllezërit Gërvalla"
LKJ	Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë
LNÇKVSHJ	Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi
LPJ	Ligji Penal i Jugosllavisë
LPRK	Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës
LRBSH	Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve
OMLK	Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës
PKMLSHJ	Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi
PPSH	Partia e Punës e Shqipërisë
QAMO	Qendra e Arsimimit të Mesëm të Orientuar
QE	Qendra Ekzekutive
RFGJ	Republika Federale Gjermane
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
TANJUG	Agjencia Telegrafike e RSFJ
UDB	Sigurimi Shtetëror Jugosllav
VHS	The Video Home System

Lista e burimeve

Abusus not tollit usum,
Prof. Abdyl Kadolli, KRIMET E KUQE
Adem Demaçi, Intervistë, Apostol Duka; Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008,
Adem Gashi, Epoka e re, 8 janar 2007, Intervistë me Ibrahim Kelmendin
Adem Gashi, Dyndalla e mendimeve,
AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË, P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980 (Shefqet Jashari me shokë)
Aktgjykimi i Shefqet Jasharit me shokë. Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-nr. 248/80, 10 nëntor 1980
Aktgjykimi kundër Ismail Haradinajt me shokë nga Gjykata e Qarkut në Pejë, më 6 gusht 1981, P. nr. 106/81,
Aktgjykimi i Partisë "Komuniste", (PKMLSHJ) P-K nr 167/82,

Aktgjykim kundër Qerkin Pecit me shokë, GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË E TITOS, P-nr. 9/83, - më 27.maj 1983
ATSH, KOSOVËS PO I VRITEN DJEMTË NGA SERBOMËDHENJTË, Zëri i Popullit, 20 janar 1982
Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008
Avdi Ibrahimi, KUSH E VRAU LAJMËTARIN, Novelë, VATRA - Prishtinë 2000,
Avni Dehari, "Atentatet" - sjell kujtimin për vrasjen tragjike të 17 janarit '82,
Bardhosh Gërvalla, Letër për Nijazi Saraçoglu, Mahmut Pasa Cadesi 82, Istanbul, mesi i marsit 1981

Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, verë 1979
Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, shkurt 1980
Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq, prill 1980
Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, janar 1981

Bedri Islami, Vonesa e mbarë, (Shënime për romanin e Ibrahim Kelmendit "Atentatet")
Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012
Berat Luzha, Si u krijua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës,
Berat Luzha, Intervistë Apostol Dukës, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2008
Daut Demaku, ROMANI "ATENTATET" ËSHTË SHEMBULL I PASTËR KU E SHOHIM ME SY RILINDJEN E HERONJVE TË KOMBIT , www.pashtriku.org, , 26 gusht 2007
Dokument i vendimit të Bashkimit të 17 shkurtit 1982
Dokument i Vendimit nga takimit i 3 marsit 1984 në Gjenevë nga Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Faridin Tafallari dhe Xhafer Durmishi

Donika Gërvalla, Intervistë në KOHA-TV dhënë Agron Bajramit, 18 maj 2012
Emrush Xhemaili, 20 vjet veprimtari, 1982-2002
Ethem Çeku, Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, Prishtinë 2003
Ethem Çeku, Shekulli i ilegales, Prishtinë 2004

Faridin Tafallari, Letër Xhafer Durmishit, 24 nëntor 1982
Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e parë të Bashkësisë së klubeve
Faridin Tafallari: Thirrje për mbledhjen e dytë të Bashkësisë së klubeve
Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997
Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë, 1998
Faridin Tafallari, ÇKA PRET IBRAHIM KELMENDI, PSE NUK BËN KALLZIM PENAL NDAJ VRASËSIT TË JUSUF E BARDHOSH GËRVALLËS DHE KADRI ZEKËS (!?!)
Faridin Tafallari, ÇFARË THA JUSUF GËRVALLA PËR KOSOVËN, SHQIPËRINË DHE TROJET SHQIPTARE, NË DITËN E FLAMURIT, 28 NËNTORIN E VITIT 1981
Faridin Tafallari, IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS!!!???
Faridin Tafallari, Letër Xhafer Durmishit, 28 tetor 2009
Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHSHME, Tiranë 2010
Faridin Tafallari, Kur shkruante Jusuf Gërvalla 'Bashkimi bënë fuqinë', www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 (Në këtë punim Faridin Tafallari, përpos shkrimit hyrës përgatiti dhe botoi këto shkrime të Jusufit e Bardhosh Gërvallës: Artikullin

"Bashkimi bënë fuqinë" të Jusufit; Një Raport të Jusufit, të korrikut 1981 dërguar Degës "Hasan Prishtina" të LNÇKVSH; Letër e Jusuf Gërvallës dërguar Enver Hoxhës, prill 1980 dhe një letër të Bardhosh Gërvallës dërguar Nijazi Strajës (Nijazi Saraçoglu, mesi i marsit 1981. Të gjitha citimet e përdorura prej meje nga këto tri letra janë marrë prej këtij punimi të përgatitur pra nga Faridin Tafallari.)

Fatos Aliu, 18 tetor 2008, www.pashtriku.org
FIDE, Rregullat themelore të lojës së shahut
Garry Kasparov, "How Life Imitates Chess" (Si e imiton jeta shahun). 2007
Gazeta Express, 11 e 12 mars 2007
Gazeta Express, 13 mars 2007

Hafiz Gagica, Letër Xhafer Durmishit, 29 dhjetor 1984
Hafiz Gagica, Letër dërguar Asllan Muharremit në Stockholm, 9 korrik 1985
Halil Matoshi, Atentati ndaj Jusuf Gërvallës: Teoria e një komploti dhe përgjasimi me J. F. Kenedin, 2007
Hasan Mala, Deklarim në filmin dokumentar Ç'ke bërë sot për Kosovën, 1992
Hasan Mala, Letër Faridin Tafallarit, (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)
Hashim Thaçi, Bota Sot, 14 shtator 2009
Historiku i shkurtër i Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës dhe veprimtaria e saj revolucionare
Hydajet Hyseni, "Therror në themelet e Bashkimit",
Hydajet Hyseni, Kadri Zeka - Në 50 vjetorin e lindjes
Hysen Gega, Kam refuzuar ta vras Jusuf Gërvallën, www.kosova-sot.info, 28 dhe 29 Mars 2012
Hysen Gërvalla, "Letër e hapur Tri grupeve që, respektivisht organizatave që luftojnë në emrin e LRSSHJ-së, 12 korrik 1985
Hysen Gërvalla, Gazeta Shqiptare, Gjenevë, maj 1997
Hysen Gërvalla, Intervistë dhënë Jusuf Ferizit, Bota Sot, 10 mars 2003
Hysen GËRVALLA, Bota Sot, 12 mars 2003
Hysen Gërvalla, Bota Sot, 1 dhjetor 2006
Hysen Gërvalla, Gazeta Express,13 mars 2007

Ibrahim Kelmendi, Letër Faridin Tafallarit, 4 qershor 1980
Ibrahim Kelmendi, Letër Jusuf Gërvallës, 16 shtator 1980
Ibrahim Kelmendi, Letër Sadik Blakajt, 21 janar 1981
Ibrahim Kelmendi, letër Faridin Tafallarit, 21 janar 1981
Ibrahim Kelmendi, letër Fridin Tafallarit, 31 janar 1981
Ibrahim Kelmendit, KLIKA E BEOGRADIT – Të vret natën, të këndon ditën..." në 6 faqe të formatit A5, i shpërndarë në maj 1982, në emër të "Punëtorët shqiptarë në mërgim"
Ibrahim Kelmendi, Letër QE, 4 maj 1983
Ibrahim Kelmendi, Letër QE, 3 qershor 1983
Ibrahim Kelmendi,, Letër QE, 30 qershor 1983)
Ibrahim Kelmendi, Letër QE, 25 gusht 1983
Ibrahim Kelmendi, Letër QE, 10 tetor 1983
Ibrahim Kelmendi, Kërcënimet çetnike nuk na frikësojnë! (1983)
Ibrahim Kelmendi, Letër Faridin Tafallarit, 3 janar 1984
Ibrahim Kelmendi, Letër-Qarkore shokëve të Qendrës Ekzekutive, 10 janar 1984)
Ibrahim Kelmendi, Letër QE (Qendrës Ekzekutive) 11 janar 1984

Ibrahim Kelmendi, Letër Sabri Novosellës, 17 janar 1984)
Ibrahim Kelmendi, Letër QE 19 janar 1984
Ibrahim Kelmendi, Letër Hasan Malës, Xhafer Shatrit, Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 19 mars 1984
Ibrahim Kelmendi, Atentatet, Prishtinë 2007
Ibrahim Kelmendi Intervistë, Gazeta Express, 11 mars 2007
Ibrahim Kelmendi, Tema: Z. Ibrahim Kelmendi, autori i romanit "Atentatet" u përgjigjet lexuesve! chat-bisedë me shkrim, përmes forumit të internetit në adresën www.kosova.de, të zhvilluar nga 22.03.2007, ora 14:16 e deri më 27.03.2007, ora 07:23
Ibrahim Kelmendi, Letër publike shefit të ICO-s, Zotëri Peter Feith, 5 shkurt 2009

Ismail Kadare, Rrotull, Tiranë, 1983
Ismail Kadare, "La Republica", www.balkanforum.info, nëntor 2009)
Ismail Kadare: http://lajme.dervina.com, nëntor 2009
Ismet Rashiti, Përjetësia e dëshmorëve, 15 janar 2010, www.pashtriku.org

Jusuf Gërvalla, Rreth Akordeve të Kosovës '74
Jusuf Gërvalla, Letër Ibrahim Kelmendit, rreth prillit 1980
Jusuf Gërvalla, PROGRAMI DHE STATUTI I FRONTIT TE KUQ POPULLOR
Jusuf Gërvalla , Letër Enver Hoxhës
Jusuf Gërvalla Letër Enver Hoxhës, 19 gusht 1980;
Jusuf Gërvalla Letër Ibrahim Kelmendit, nëntor 1980
Jusuf Gërvalla, Korrespondenti Popullor, (Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 3)
Jusuf Gërvalla , Bashkimi bënë fuqinë, Kryeartikull i gazetës Bashkimi, janar 1981
Jusuf Gërvalla, Njoftim, Gazeta Bashkimi, Organ i Frontit të Kuq Popullor, nr.1 janar 1981, faqe 8

Jusuf Gërvalla, Letër Nuhi Sylejmanit janar 1981
Jusuf Gërvalla, Letër Nuhi Sylejmanit, kah fundi i janarit 1981
Jusuf Gërvalla, Lajmëtari i lirisë, nr.1, janar-shkurt 1981, faqe 1
Jusuf Gërvalla, Letër Nuhi Sylejmanit, 10 shkurt 1981,
Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981
Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981;
Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 1981;
Jusuf Gërvalla, Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, korrik 1981

Jusuf Gërvalla, Luftë të dëshpëruarish apo lëvizje të ndërgjegjshme?
Jusuf Gërvalla Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981
Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981
Jusuf Gërvalla, Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981
Jusuf Gërvalla, Letër Sabri Novosellës, 14 janar 1982
Jusuf Gërvalla, Letër dërguar Kadri Zekës, më 15 janar 1982,
Jusuf Gërvalla, Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982
Jusuf Gërvalla, Rrotull, 1983 Tiranë
Jusuf Gërvalla, Vepra, Vëllimi 4, pjesë nga Ditari, Prishtinë, 2010

Kadri Rexha, Fati i Luleve, Prishtinë 1993

Kadri Rexha, Qëndresa 8/9–janar/shkurt 1984
Kadri Zeka, Dy ftesa për dasmë, dërguar Faridin Tafallarit
Kadrush Sylejmani, Metush Krasniqi, Prishtinë 1999
Karl Marx - Frederick Engels, Citate nga veprat
Komiteti i Degës së LRSHJ "Hasan Prishtina" (Turqi), Letër për Komitetin "Vëllezërit Gërvalla" (Shtutgart), mars 1982
KOMITETI QENDROR I LRSSHJ , NJOFTIM, 10 shkurt 1985
Komiteti Vëllezërit Gërvalla, Letër dërguar Komitetit të Degës së LRSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, 26 shkurt 1982

K O M U N I K A T E, e Komitetit Qendror të LEVIZJES NACINALÇLIRIMTARE TE KOSOVËS, gusht 1981
Komunikata e vendimit të 15 majit 1982
Komunikatë në emër të LNÇKVSHJ, kah fundi i vitit 1986

Lajmëtari i lirisë, Nr.1 Gusht 1980,
Lajmëtari i lirisë, Nr. 2, Tetor-Nëntor 1980,
Lajmëtari i Lirisë, Nr. 3, Janar -Shkurt 1981
Lenin, Citate nga veprat
Lenin, Parathënie për broshurën 'Promemorja e drejtorit të departamentit të policisë, Lopuhin'
Liria, Nr. 4-5, Gusht 1981
Liria, Nr. 6, Dhjetor 1981
Mehmet Hajrizi, Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008
Mehmet Hajrizi, Intervistë, Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009
Milaim Zeka, Gazeta Express, Pa Rrotllat e Milaimit, www.zemrashqiptare.net, 1 shkurt 2009
Muharrem Blakaj: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010
Dr. Muhamet Pirraku, Për kauzën shqiptare 1997-1999, Prishtinë, 2000,
Mustafë Xhemaili, Vlerësime për romanin "SY" të Ardian Kyçykut, 2004)
Mustafë Xhemaili, Atentatet e zbuluara - Fjala promovuese më 14 prill 2007 në Dyzeldorf (Gjermani), për romanin e Ibrahim Kelmendit ATENTATET,
Nexhmije Hoxha, Pritja e Familjes së Jusuf Gërvallës në Shqipëri
Nevila Nika (e bija e Bujar Hoxhës), Letër Xhafer Durmishit, 28 mars 2011
Osman Osmani, Kopertina e mbrapme e librit të quajtur: Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010
Pajazit Ibrahimi (Australi), Letër për Xhafer Durmishin, 24 shkurt 1982
Pajazit Ibrahimi, Letër për Xhafer Durmishin, 5 shtator 1982
Pal Sokoli, LSHAKSH dhe SH.I.H.K nderuan trinomin Gërvalla dhe Zeka; www.zemrashqiptare.net, 6 maj 2012
Prend Buzhala, PROMOVIM – IBRAHIM KELMENDI: “ATENTATET”,
Procesverbal i mbledhjes së Komitetit "Vëllezërit Gërvalla" i mbajtur më 11 korrik 1982
Ramadan Avdiu, Behajdin Allaqi - udhëheqës me kualitete të larta intelektuale, politike e atdhetare, http://pashtriku.beepworld.de/behajdinallaqi.htm
Ramadan Pllana, DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ,
Ramadan Pllana, Pse të trazojnë kujtimet e mia, Abdullah Prapashtica?!,
Ramadan Pllana, Avdi Kelmendi-një veprimtar i çështjes kombëtare,

Ramadan Pllana, BUJAR HOXHA NJË SABOTUES I BASHKIMIT KOMBËTAR
Ramadan Pllana, Xhavit Haziri - një hero i merituar, 1 shtator 2011)

Ramiz Kelmendi, Letër Ibrahim Kelmendit, 14 mars 2007
Raport i komisionit të mbrëmjes së 7 prillit 1984
Rasim Selmanaj, LIBRI " ATENTATET" I IBRAHIM KELMENDIT,
Rilind Bytyçi (Australi), Letër për "Komitetin Vëllezërit Gërvalla" 17 maj 1982
Rilind Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 1 qershor 1982
Rilind Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 2 qershor 1982
Rilind Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin 17 qershor 1982
Rilind Bytyçi, Fjalim i mbajtur në Demonstratën e Sydneut më 26 qershor 1982
Rilind Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 17 nëntor 1982
Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha (Mehmet Hajrizi, Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 316)

Saime Isufi, Letër Ibrahim Kelmendit, 5 mars 2007
Saime Isufi, Duke kujtuar atë natë të trishtuar janari,
Sabri Hamiti, Misioni, Prishtinë 1997,

Sabri Novosella dhe Asllan Muharremi, Letër për Xhafer Durmishin, 15 gusht 1983
Sabri Novosella, Letër Faridin Tafallarit e Xhafer Durmishit, 16 janar 1984
Sabri Novosella, Si e themeluam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi - LRSHJ", me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të LRSHJ,
Sabri Novosella,. Intervistë dhënë Haqif Mulliqit e Emine Berishës për gazetën Zëri, e ribotuar në Drita Nr. 10, Trelleborg, Suedi më 1997
Sabri Novosella, Rezistenca kosovare mes dy zjarresh, Prishtinë 2010

Sadri Ramabaja, Dëshmitari dhe krijuesi i historisë, Roje e vetëdijes kombëtare dhe e së vërtetës, www.pashtriku.org, mars 2007 (mendime për Ibrahim Kelmendin dhe librin e tij Atentatet)
Salih Kabashi, Revista Republika nr.3, 2007
Salih Kabashi, Republika, prill 2007
Sejdi Bytyçi (New York), Letër për Xhafer Durmishin, 23 prill 1982
Sejdi Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 7 qershor 1982
Sejdi Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 24 qershor 1982
Sejdi Bytyçi, Letër për Xhafer Durmishin, 22 nëntor 1982
Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prsishtinë 2011
Suzana Gërvalla, letër nga Tirana për Faridin Tafallarin, 22 shkurt 1983
Suzana Gërvalla, Biografi e Jusuf Gërvallës
Südwestdeutsche Zeitung, 30 janar 1982
Shaban Sinani, www.pashtriku.org, 6 tetor 2008
Shefqet Cakiqi-Llapashtica, si forumist në www.kosova.de, mars 2007
Shefqet Jashari-Strofci, Intervistë, Drita, Trelleborg, Suedi, nr 15, 1997,
Shefqet Jashari, Letër Ramadan Pllanës, 27 prill 2009
Shefqet Jashari-Strofci, Letër Xhafer Durmishit, (20 janar 2011)

Shkolla e UDB-së Serbe, Letër Shokëve të LNÇKVSHJ, 13 shkurt 1985
-Abdullah Prapashtica (ish-inspektor i UDB-së Serbe), DËSHMI E NJË NGJARJE HISTORIKE, 17 shkurt 2008,
-Abdullah Prapashtica, Letër urimi Isa Mustafës, 9 nëntor 2010

-Abdullah Prapashtica ("komunist" dhe ish-inspektor i UDB-së Serbe), ATA QË MERREN ME INTRIGA KUNDËR LUFTËTARVE TË LIRISË OSE JANË TË ÇMENDUR OSE JANË TRADHTARË
-Abdullah Prapashtica, MBI LIBRIN „VRASJA E TREFISHT“ TË NUHI SYLEJMANIT
-- Abdullah Prapashtica ("komunist" dhe ish-inspektor i UDB-së Serbe): Çka është dëshmi e çka jo?, 14 shtator 2011
Shkolla e UDB-së Serbe, Vrasja e trefishtë, 2010, libër i nënshkruar nga Nuhi Sylejmani,

Shukri Demiri, Letër Xhafer Durmishit, Prill 2009
Tetë kërkesa të parevokueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi
TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS
Thirrje e LRSHJ për demonstratën e 26 qershorit 1982 në Bern
Valbona Kolaneci (e bija e Engjëll Kolanecit), Letër Xhafer Durmishit, 22 janar 2007

Xhafer Durmishi, Kush e vrau Jusuf Gërvallën, shkurt 1982
Xhafer Durmishi, Letër Pajazit Ibrahimit në Australi, 7 mars 1982
Xhafer Durmishi (Shpendi), Letër Sabri Novosellës në Turqi, mars 1982
Xhafer Durmishi, Letër Sabri Novosellës, 22 maj 1982
Xhafer Durmishi, Letër Engjëll Kolanecit, nëntor 1982
Xhafer Durmishi, Letër Faridin Tafallarit, nëntor 1982
Xhafer Durmishi, Letër Xhafer Shatrit dhe Sabri Novosellës, 3 dhjetor 1982
Xhafer Durmishi, Letër Xhafer Shatrit, 5 dhjetor 1982
Xhafer Durmishi, Letër Faridin Tafallarit, 2 janar 1983
Xhafer Durmishi, Programi Aksional i Bashkësisë së klubeve të punëtorëve shqiptarë nga Jugosllavia në Evropën Perëndimore

Xhafer Durmishi, Statut i Bashkësisë së Klubeve në Evropë
Xhafer Durmishit, Letër delegatëve të Bashkësisë së Klubeve
Xhafer Durmishi, Letër dërguar shokëve të Shtutgartit, 14 maj 1984
Xhafer Durmishi, Letër Remzi Ademit, dhjetor 1984
Xhafer Durmishi, Përgjigje Hysen Gërvallës, 22 korrik 1985
Xhafer Durmishi, Letër shokëve në Shtutgart dhe Zurich, 4 qershor 1988
Xhafer Durmishi, PARTIA E PUNES E SHQIPERISE DHE ORGANIZATAT E MAJTA TE KOSOVES, maj 1992
Xhafer Durmishi, Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985
Xhafer Durmishi; Hoxha, engjëjt dhe xharrahët
Xhafer Durmishi, Protesta dhe Aspirata, 2006
Xhafer Durmishi, Letër dërguar Faridin Tafallarit, 3 qershor 2009
Xhafer Durmishi, Letër dërguar Ramadan Pllanës, më 11 nëntor 2009
Xhafer Durmishi, Letër Faridin Tafallarit, 20 janar 2010
Xhafer Durmishi, Letër dërguar N.N., 13 shkurt 2010
Xhafer Durmishi, Letër Faridin Tafallarit, 27 mars 2010
Xhafer Durmishi, Letër dërguar Nevila Nikës (bijës së Bujar Hoxhës), 24 mars 2011

Xhafer Shatri, Letër Xhafer Durmishit dhe Osman Osmanit, 16 maj 1982
Xhafer Shatri, Letër Sabri Novosellës, 16 gusht 1982
Xhafer Shatri, Letër Xhafer Durmishit, 1 nëntor 1982
Xhafer Shatri, Letër Xhafer Durmishit, 31 janar 1983

Xhafer Shatri, Letër Xhafer Durmishit, shkurt 1983
Xhafer Shatri, Letër Qendrës Ekzekutive, 7 qershor 1983

Xhafer Shatri, Letër Sabri Novosellës, korrik 1983
Xhafer Shatri, Letër në emër të Redaksisë së Zërit të Kosovës, qershor 1983
Xhafer Shatri, Letër e Bacalokut dërguar shokëve të Shtutgartit, 1 maj 1984
Xhafer Shatri, Letër dërguar Ibrahim Kelmendit, 1 maj 1984
Xhafer Shatri, letër Faridin Tafallarit, (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f.382)
Xhafer Shatri, 20 vjet nga vrasja e Vëllezërve Gërvalla dhe e Kadri Zekës,
U VRANË TRE EMIGRANTË, Rilindja boton lajmin e Tanjugut të 18 janarit 1982

Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, Nëntor 1981
Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, Janar 1981
Zëri i Kosovës, Organ i LNÇKVSHJ, Mars 1981
Zëri i Kosovës, Organ i LRSSHJ, Qershor 1981
Zëri i Kosovës, Organ i LRSSHJ (Suedi), janar 1985
Zëri i Kosovës, Organ i LRSSHJ (Suedi), korrik 1985

Literaturë tjetër nga Jusuf Gërvalla

Jusuf Gërvalla, Vepra 1-4 (në katër vëllime), Shtëpia Botuese FAIK KONICA 2010, ISBN 978-9951-06-337-1

Literaturë tjetër për Jusuf Gërvallën

Në këtë listë janë përfshi punime, të cilat nuk i kam përdorë si burime në punën time, e që kanë të bëjnë në mënyrë direkte ose indirekte me Jusuf Gërvallën. Nuk pretendojë se kjo listë është e plotë. Këtu kam zgjedhur ato shkrime të cilat me ndonjë përjashtim kam pasur rastin t'i lexoj.

Adem Gashi, Riti i rënies, Kjo poezi e mori shpërblimin e parë në Orën e Madhe, me rastin e 25 vjetorit të vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës e Bardhosh Gërvallës të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007, të organizuar nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.402
Adem Gashi, Harkura e verbit poetik, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 264-265

Agim Morina dhe Shaip Beqiri,Intervistë me Jusuf Gërvallën, Pikë në horizont që s'do të mbetet vetëm pikë, Bota e re , 1 prill 1977
Agim Vinca, Kroi si topos poetik, * Nga libri „Kënga e hapur“ (antologji e komentuar), 2005

Agim Vinca, "Heroi me Kitarë", J. G., 25 vjet pas, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha")
Agron Y. Gashi, Fjala apo Kitara e Jusuf Gërvallës, Rilindja, 19 janar 2001, Heroi me Kitarë, f.367-372
Ahmet Qeriqi: "Fati i luleve", një vepër monumentale për jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës, shkruar nga bashkëveprimtari, Kadri Rexha, Radio „Kosova e lirë", 22 maj 2008

Ali Aliu, Dy poetë që vijnë, Gazeta "Flaka e vëllazërimit", Shkup, - 6 qershor 1976, f. 17; Rrjedha dhe gjenerata në prozën tonë, "Jeta e re", nr. 6, Prishtinë, 1974, f. 1088;

Bajram Sefaj, Shkurt Poezi!, Përmbledhja e parë e poezive të Jusuf Gërvallës "Fluturojnë e bien" në botim të NGB "Rilindja" nga Prishtina, u pranua ngrohtë te numri më i gjerë i lexuesve,("Flaka e vëllazërimit", Shkup, 21 shtator 1973, f.11)
Me sa dihet ky shkrim i Bajram Sefajt është komentimi i parë i poezisë së Jusufit. Megjithatë këtu, jo për fajin tim, kemi të bëjmë me mungesë sqarimesh, apo me një anakronizëm. Në bazë të të dhënave, përmbledhja me poezi "Fluturojnë e bien" është botuar në vitin 1975, ndërsa shkrimi i Bajram Sefajt mban datën 21 shtator 1973!?
Bedri Islami, Mesazhet e rikthimit të madh, Epoka e re, f. 20-22 shkurt 2002
Bedri Islami, Mos i ndani djemtë, Epoka e re, 27 shkurt 2002
Bedri Islami, Merrni nga unë atë që nuk është ndarje, Kumtesë e paraqitur në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Begzat Baliu, Shtypi botëror rreth vrasjes së Vëllezërve Gërvalla e Kadri Zekës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, Era Prishtinë, 2002
Bild Zeitung, DHUNA, 20 janar 1982
Curr Mazrekaj, Shkelzen Tahirsylaj; Deçani, festë gjithëkombëtare në nderim të tre heronjve të janarit 1982, Heroi me kitarë f.14-17
Der Spiegel, E tëra dukej si pas një ekzekutimi, 25 janar 1982
Dritëro Agolli, Përmes poezisë tek heroi, Parathënie nga libri i Jusuf Gërvallës: Këngët e moshës, Prishtinë 2006

Emin Kabashi, Gjeografia e kuptimit poetik (J. Gërvalla, Kanjushë e verdhë, Rilindja, 1979), "Fjala", nr. 21, Prishtinë, 1 dhjetor 1979, f. 6;
Emin Kabashi, Krijuesi dhe kohët e tij, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë f. 242-247
Enver Hadri, Ja vdekje, Ja liri!, Zëri i Kosovës, Bruksel, 20 janar 1982, Gjendet edhe në librin nga Halit Elshani: "Çeta e Brukselit", kapitulli 34, f.154 Prishtinë 2007
Ferit Ramadani, Jusuf Gërvalla, zermashqiptare.net, janar 2010
Ferit Ramadani, Jusuf Gërvalla - Prometheu i simbolikës lirike, zemrashqiptare.net, janar 2010

Ethem Çeku, Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve shqiptare në Jugosllavi, Heroi me Kitarë, f. 88-96
Ethem Çeku, Metush Krasniqi e Jusuf Gërvalla, Heroi me Kitarë, f. 179-185
Ethem Çeku, Jusuf Gërvalla dhe shtypi ilegal i Kosovës, Heroi me Kitarë, f. 308-316

Faik Racaj: “Fati i luleve” (kushtuar patriotit të madh Jusuf Gërvallës) i autorit Kadri Rexha, “Zeri i Kosovës”, (CH),15 janar 1994

Faton Mehmetaj, Disa aspekte të lidhjeve të Komitetit të Rrethit të Deçanit me Jusuf Gërvallën në kuadër të LNÇKVSHJ-së, Heroi me Kitarë, f. 158-165, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"
Fehmi Ajvazi, Veprimi ilegal i brezit të Jusuf Gërvallës, Heroi me Kitarë, f. 191-198, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"
Ferhat Cakaj: Liria do të vijë, shënime për monografinë “Fati luleve” të Kadri Rexhës, “Rilindja” (CH), 17 janar 1995, fq.12 dhe në “Rilindja”, botim i Tiranës, (besoj e njëjta datë)

Fetnete Ramosaj, Ndikimi i personalitetit të Jusuf Gërvallës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Heroi me Kitarë, f. 166-170, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"
Haqif Mulliqi, Porosi universale për lirinë, Procesi, dramë e Jusuf Gërvallës, botoi Zëri i Kosovës, 1984, Bujku, Prishtinë, e shtunë 26 qershor 1992, f. 7
Halit Fetahu, Vokacione poetike të frymëzuara nga qenësia jonë,(Jusuf Gërvalla, Kanjushë e verdhë, botoi "Rilindja", Prishtinë, 1978), "Bota e re", Prishtinë, 1978

Halit Mehmetaj, Jusuf Gërvalla - Ideatori dhe udhëheqësi i lëvizjes sonë të rezistencës kombëtare, Me rastin e 20-vjetorit të rënies
Hans Joachim Lanksch, Vrasja e Poetit, Rilindja, 17 janar 2001
Hasan Bunjaku: Orë e madhe letrare, Tribuna për veprën e Kadri Rexhës “Fati i luleve”, në kuadër të manifestimit tradicional “Flaka e Janarit ‘95”, “Rilindja”, 20 janar 1995

Hasan Ukëhaxhaj, Publicistika e Jusuf Gërvallës në mërgim, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 299-303
Horst Zimmermann, DORA E GJATË E BEOGRADIT SHTRIHET DERI NË REPUBLIKËN FEDERALE, Heilbronner Nachrichten, 21 janar 1982
Hysen Gega, Asgjë nuk harrohet, (intervistë me B. Elshanin), (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 342-344)
Ibrahim Egriu, Kujtesë nga takimi me heroin, Jusuf Gërvalla
Isak Shema, Jusuf Gërvalla - student i degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Universitetit të Prishtinës, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.333-335

Ismail Kadare, Baladë për vdekjen e Jusuf Gërvallës, Koha, 24 tetor 1990
Ismet Rashiti, Çka tha Jusuf Gërvalla në tubimin me bashkatdhetarët, më 28 Nëntor 1981?, www.pashtriku.org, 11 korrik 2007
Ismet Rashiti, Rrëfanë lirie, (redaktor Xhafer Shatri, Saime Isufi), Kombi, Prishtinë 2010
Në këtë libër, ajo që është me rëndësi në raport me Jusuf Gërvallën, mbrohet teza se Ibrahim Kelmendi ka qenë shoku më i afërt i Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla apo

anasjelltas. Me mbrojtjen e kësaj teze duhet ta konsiderojmë se është identifikuar në mënyrë të plotë Xhafer Shatri si njëri nga dy redaktorët e librit. Me sa kam mund të vërej, redaktimi i këtij libri është rasti i parë ku Xhafer Shatri shprehet publikisht me stilografin e tij, pas botimit-lansimit të librit Atentatet të Ibrahim Kelmendit, më 5 shkurt 2007.
Izet Duraku: Fati i luleve, (vështrim), „Luma“, Kukës, 1994

Kadri Rexha, Këto këngët e mia janë zë i butë i fushës, “Rilindja”, Prishtinë, 15. 9. 1979, f. 13.
Kadri Rexha: Zëri i populli të vet (me rastin e 45-vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës), „Demokracia“, Zyrih, Nëntor 1990, fq.5; I njëjti artikull i botuar në „Dëshira“, numër i posaçëm, Malmë, Janar 1991, fq.1-2
Kadri Rexha: Fati tragjik i kthyer në qëndresë (portret i vogël për figurën madhore të Nënës Ajshe – kushtuar nënave kosovare), „Alternativa“, nr.5, Lubjanë, 29 shtator 1990, fq.5;

Kadri Rexha: Fati i atdhetarit, (me rastin e 45-vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës), „Alternativa“, nr. 9-12, Lubjanë, 1990, fq. 145-153;
Kadri Rexha: Në lindjen e trimit (Fragment nga monografia për Jusuf Gërvallën), „Qëndresa“ , nr. 9, Zyrih, Shtator 1991, fq. 8-9;
Kadri Rexha: Rrugës letrare të Jusuf Gërvallës (në 10-vjetorin e vrasjes së Poetit), „Fjala“, nr.2, Prishtinë, Janar 1992, fq. Fq.9;
Kadri Rexha: Arratisja e Jusuf Gërvallës (në 47-vjetorin e lindjes së Poetit), „Rilindja“, Zyrih, 23 dhjetor 1992, fq. 8;
Kadri Rexha: Edukimi dhe formimi i personaliteti të Jusuf Gërvallës, „Bota shqiptare“, nr.6, Zyrih, Tiranë, Qershor 1993, fq. 6-8;
Kadri Rexha: Rruga e mërgimit nuk merret nga dëshira, intervistë me mr. Kadri Rexha, intervistoi Shefqet Dibrani, „Qëndresa“, nr.8/9, janar-shkurt 1994, fq. 13-17
Kadri Rexha: Jusuf Gërvalla – emër që u bë traditë (në 50-vjetorin e lindjes së Jusuf Gërvallës), „Zëri i Kosovës“, nr.20, Zyrih, 15 tetor 1995, fq.8; I njëjti artikull i plotësuar i botuar në librin „Heroi me kitarë“ (sesion i zgjeruar shkencor), Përgatiti: Rasim Selmanaj, Focus“, Prishtinë, 2007, fq.174-178;

Kadri Rexha: Jusufi ishte në ballë të forcave të progresit historik (në 60-vjetorin e lindjes së Jusuf Gërvallës, intervistë me Kadri Rexhën, bashkëpunëtorin dhe jetëshkruesin e Jusufit, intervistoi Lulëzim Etemaj, “Epoka e re”, Prishtinë, Tetor 2005. E njëjta intervistë e botuar në librin “Heroi me kitarë” (sesion i zgjeruar shkencor), Përgatiti: Rasim Selmanaj, “Fokus”, Prishtinë, 2007, fq. 377- 392;
Kadri Rexha: Rruga e mërgimit nuk merret nga dëshira, intervistë me mr. Kadri Rexha, intervistoi Shefqet Dibrani, „Qëndresa“, nr.8/9, janar-shkurt 1994, fq. 13-17

Kadrush Radogoshi: Sfida e heroit (Për librin e Kadri Rexhës „Fati i luleve), „Rilindja“ (ZH), 14 maj 1994, fq.9 ; „Bujku“ (besoj e njëjta datë)
Kadrush Radogoshi: Monografi për jetën dhe vdekjen vertikale, Kadri Rexha: „Fati i luleve“, Buzuku, Prishtinë, 1993, „Nëpër universin letrar, „Rilindja“, Prishtinë, 2003, fq. 143-150
Kadrush Radogoshi, Simbolika e mbijetesës dhe e peizazhit sintetik, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.278-282

Kasam Shaqirvela, Flaka e Yjeve, poezi, www.zemrashqiptare.net, 18 janar 2010
Koço Danaj: Homazh tribunit të popullit Jusuf Gërvalla (Mendime rreth librit: „Fati i luleve“ të shkrimtarit Kadri Rexha), „Zëri i Kosovës“ (CH), nr. 22, 15 Nëntor 1994; dhe me shkurtime në „Illyria“ (USA), 19-21 janar 1995, fq. 17
Lulet e Gjakut, Jusuf Gërvallës, Heroi me Kitarë, f.405-406
Lumira Berati, Romani "Rrotull" i Jusuf Gërvallës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002
Lutfi Dërvishi, Bardhosh Gërvalla - Besniku i Kosovës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Mehmet Hajrizi, Kadri Zeka e Jusuf Gërvalla njerëzit që kërkuan një zë këmbues për Kosovën, Koha Ditore, 2 mars 2002
Mehmet Kraja, Poezi frymëzimi, (“Kanjushë e verdhë”), “Rilindja”, Prishtinë, 19. 8. 1978, f. 15;
Mehmet Kraja, Rreth veprës së Jusuf Gërvallës, “Rilindja”, Prishtinë, 27 qershor 1992, f. 7.
Mehmet Kraja, Midis idealit politik dhe vokacionit krijues, Fjala, qershor 1992, f. 11
Muharrem Blakaj, Atentat brenda germës "L", roman, Prishtinë 2007
Mustafë Xhemaili, Dorëshkrimi nga dheu, 2003 Prishtinë
Parathënia e këtij libri përmban shkrimin "Jusuf Gërvalla mësuesi më i mirë në rrugën time krijuese", ndërsa në faqe 56-57 gjendet një recension i skanuar nga origjinali dhe i rishkruar, ku Jusufi jep mendimin për përmbledhjen e poezive të Mustafë Xhemailit me titull "Sportelet e padukshme"(1978). Libri "Dorëshkrimi nga dheu" përmban edhe poemën në 10 pjesë me titull "Akademi solemne për Jusuf Gërvallën".
Myftar Memia, Publicistika politike e Jusuf Gërvallës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002
Myrvete Dreshaj-Baliu, Poetika e veprës së Jusuf Gërvallës (studim monografik), “Zëri i Kosovës”, (gjashtë vazhdime), korrik-shtator, Cyrih, Zvicër, 1995; Portretet (Jusuf Gërvalla), “Shpresa”, nr. 1, Prishtinë, 1995; Vendlindja, muzë e këngës, “Bujku”, qershor 1994.

Myrvete Dreshaj, Jusuf Gërvalla, ideologu i lëvizjes ilegale, në veprën “Konteksti i shkrimit”, Era, Prishtinë, 2004, f. 109-120;

Myrvete Dreshaj-Baliu, Jusuf Gërvalla - jeta dhe vepra (tezë e magjistraturës), 2002
Myrvete Dreshaj-Baliu, Dimensioni kombëtar dhe krijues i Jusuf Gërvallës, Kumtesë e paraqitur në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha")
Nazmi Selmanaj, Për herë të parë, Katër rrëfime ekskluzive për Jusuf Gërvallën, Fokusiexpress
Ndoc Papleka, Vrasja e poetit, Zëri, 26 nëntor 1990, Prishtinë,

Pandeli Koçi, Romani Rrotull i Jusuf Gërvallës, “Zëri i popullit”, Tiranë, 18. 1. 1984;
Pandeli Koçi, Poezi që mori bekimin e nënës, Pishtarët e lirisë, nën përgatitjen e Begzat Baliut dhe ndihmës ekonomike të Dardan Novosellës, etj., botoi "Era" Prishtinë, 2002
Pandi Bella, Jusuf Gërvalla si adhurues i tingujve, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Pishtarët e lirisë (Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla), Editor: Begzat Baliu, Botimin e mundësuan: Dardan S. Novosella, Hamzi Rahimi dhe Sibush Haziri Shtëpia botuese Era, Prishtinë 2002
Pashtriku: SI U DENUAN SHABAN KLAIQI E ISLAM RAFUNA PËR ZËRIN E KOSOVËS, www.pashtriku.org, janar 2010
Prend Buzhala, Maska e alegorisë (Jusuf Gërvalla: "Rrotull", roman, në librin "Vepra letrare" të këtij autori, botoi "Ora", Prishtinë, 1992), Botuar në "Rilindja", 19 janar 2000, Prishtinë.
Prend Buzhala, Mesazhet e Janarit, Janar 1991, ribotuar te "Iliria Post", 20 janar 2007, faqe 20

Rafet Rudi, Simbiozë e sensibilitetit të poetit dhe muziktarit, "Forumi", nr. 14, Prishtinë, 21. 2. 1994, f. 14.
Rafet Rudi, Jusuf Gërvalla - në 25 vjetorin vrasjes së kantautorit, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 319-322
Ramadan Musliu: "Fati i luleve" (Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla), "Rilindja", (CH), 7 shtator 1993
Ramadan Pllana, Jusuf Gërvalla me shokë - yje të pashuara, www.pashtriku.org, 15 janar 2008
Ramazan Vozga, Zë origjinal, me botë të gjerë poetike (Vëllimi "Bekimi i nënës", i J. Gërvallës), "Drita", Tiranë, 6 mars 1983, f. 6; I ribotuar në librin Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut dhe ndihmës ekonomike të Dardan Novosellës, botoi "Era" Prishtinë, 2002
Rasim Selmanaj, Vrasja e dytë e heronjve, Botuar te gazeta "24 Orë", 26 shkurt 2002, Prishtinë
Rasim Selmanaj, Pse bëhet çmimi Jusuf Gërvalla?, Heroi me Kitarë, f.11 (Artikulli është fjalë e lexuar në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin" që u mbajt në Deçan më 17 janar 2007)
Riza Bicaj, Jusufin e kisha nxënës dhe shok pune, Zëri, 18 janar 1992
Rushit Ramabaja: Baladë për kanjushën e verdhë, Kadri Rexha, "Fati i luleve", botoi "Gjon Buzuku", Prishtinë, 1993, "Rilindja" (CH), 28 janar 1994, fq.9; dhe "Bujku", Prishtinë, 29 janar 1994, fq.6
Rushit Ramabaja, Liria në shpirtin e vjershës, Heroi me Kitarë, f. 186-190, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Sabile Keçmezi-Basha, Informimi i denjë i çështjes kombëtare në diasporë nëpër mes gazetës "Lajmëtari i Lirisë" (fejton në shtatë vazhdime, www.zemrasshqiptare.net, janar 2010)
Sabile Keçmezi-Basha, Propaganda e dezinformimi, metoda të organizuara shtetërore jugosllave ndaj shqiptarëve, 29 mars 2010, www.zemrashqiptare.net
Sabit Rrustemi: Një fat i njëjtë me lulet (Kadri Rexha: Fati i luleve" (monografi) botoi "Buzuku", Prishtinë, 1993, "Bota sot", 23 janar 1996, fq.9

Sabri Hamiti, Drama "Procesi", Prishtinë, Kallnor 1992, Nga shkrimi "Bisedë me Jusufin - fragment" i Sabri Hamitit në Rilindja, 19 janar 2002, f. 20-21
Sabri Hamiti, Bisedë me Jusufin (fragment), "Rilindja", Prishtinë, 19 janar 2002, f. 20-21;

Sabri Hamiti, Vrasja e poetit, në "Tema shqiptare", Rilindja, Prishtinë, 1993, f. 110-115.

Sabri Maxhuni-Novosella, Vëlla i dhembjes krenare, (poezi kushtuar Jusuf Gërvallës), Adapazar-Turqi 1982
Sabri Novosella, Letër e hapur kryetarit të Kosovës, I. Rugova, www.jusuf-gervalla.org
Skënder Blakaj, Një fjalë për Jusufin, Me rastin e 15 vjetorin e vdekjes së Jusuf Gërvallës, 1997
Stuttgarter Zeitung, U VRANË TRE EMIGRANTË JUGOSLLAVË, 19 janar 1982
Stuttgarter Nachrichten, HEILBRONN: TRE REFUGJATË JUGOSLLAVË U VRANË NATËN E KALUAR, 19 janar 1982
Stuttgarter Nachrichten, SULM TERRORIST NË HEILBRONN, 20 janar 1982
Südwestdeutsche Zeitung, NJOHURI MBI VRASJEN E JUGOSLLAVËVE, 30 janar 1982
Sylejman Syla, Poezi shfryrjesh të sinqerta, (Fjala, nr. 4, 1976, Prishtinë, f. 5)
Shaban Sinani, Një ëndërr e vrarë, një tërmet i ndërprerë, 1996, Heroi me Kitarë, f. 65-69
Shahbaze Vishaj, Amaneti yt, (Jusuf Gërvallës), Heroi me Kitarë, f.404
Shaip Beqiri, Duke kërkuar qeshjen e një poezie, "Zëri i rinisë", Prishtinë, 21 tetor 1978, f. 11-14
Shefqet Dibrani: Fati i luleve dhe mërgimi i heroit, Kadri Rexha: "Fati i luleve – Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla", monografi, botoi NB "Gjon Buzuku", Prishtinë, 1993, fq.240, ISBN 86-7785-012-0, (shkruar në Janar 1994), në librin "Libra dhe mbresa" (venerime letrare), albanisches institut, ST. Gallen, 2005, fq.57-60

Teki Dërvishi, Flatra dhe nëntokë, (Sivjet u botua libri i poezive të Jusuf Gërvallës "Fluturojnë e bijnë"), "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 21 dhjetor 1975, f. 20; Jeta e episodeve tragjike, "Zëri", Prishtinë, 18. 1. 1992, f. 32;
Teki Dervishi, Dy Jusuf Gërvalla, Zëri, Prishtinë, 18 janar 1992, f.45

Vendimi i Jurisë për çmimin "Jusuf Gërvalla" 2007, Heroi me Kitarë, f. 12-13
Xhafer Durmishi, Emrat tuaj flamuj në beteja, fjalim i demonstratës së 23 janarit 1982 në Shtutgart, Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 8
Xhemail Mustafa, Imazhi asociativ, "Zëri i rinisë", Prishtinë, 12 gusht 1978, f. 12
Zejnullah Rrahmani, Jusufi, Dukagjini, Pejë, 2000
Zeqir Gërvalla, Sytë e dëshmorëve, poezi, www.albaniapress.com

Shënime për botimin e parë të kapitujve të mëposhtëm

Lokomotiva e Lëvizjes, (U publikua për herë të parë nën një formë më të zgjeruar, me titullin DITARI I JUSUF GËRVALLËS, në www.pashtriku.org, më 9 dhjetor 2009)
Jusuf Gërvalla në vitin 1980, www.pashtriku.org, 1 nëntor 2010
Programi i Frontit të Kuq (i Ibrahim Kelmendit), www.pashtriku.org, 12 tetor 2010.
Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor (i Jusuf Gërvallës), Pas botimit të parë më 1980, ky Program i përgatitur nga Xhafer Durmishi, u botua në faqen www.pashtriku.org, 21 dhjetor 2010.
Je i pastër si loti, 7 tetor 2010 në www.pashtriku.org

Ibrahim Kelmendi ka ardhur rastësisht, www.pashtriku.org, 9 tetor 2010
Kështu e pata kuptuar, www.pashtriku.org, 16 janar 2011
Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore, www.pashtriku.org, 12 shkurt 2011
Në KALANË e JUSUF GËRVALLËS, 19 shkurt 2011, www.pashtriku.org
QARTËSIA E PERSPEKTIVËS SË EMËRTIMEVE TË PAPRANUESHME, 8 mars 2011, në www.pashtriku.org
TEZA RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS, 16 mars 2011 në www.pashtriku.org
PROGRAMI I JUSUF GËRVALLËS, www.pashtriku.org, 1 prill 2011
KOMUNISTËT RUANIN ROLIN HEGJEMON, www.albaniapress.com, në dy vazhdime; më 28 dhe 30 prill 2011
KJO NUK DO TË NDODHË KURRË, www.albaniapress.com në tri pjesë më 6, 8 dhe 9 qershor 2011

Simultanka dhe shah-mati i Jusuf Gërvallës, www.albaniapress.com, 23 prill 2011
Si më njoftoi UDB-a për vrasjen e Jusuf Gërvallës, www.pashtriku.org, janar 2010)
RËNDËSIA E GODITJES SË PARË, 23 shtator 2010 në www.pashtriku.org
Shkolla e UDB-së kundër Jusuf Gërvallës, www.pashtriku.org, 1 dhjetor 2010
Shënim: Tek botimi i parë në faqen pashtriku.org, tek argumentimi i pikës 12 unë e kam përdorur vetëm citatin e Jusufit nga letra dërguar Enver Hoxhës që gjendet në librin e Faridin Tafallarit, Terror-Dhimbje-Qëndresë faqe 60. Në këtë botim, përveç atij, kam marrë citate tjera të Jusufit nga e njëjta letër, e cila për herë të parë u botua nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com më 2 tetor 2011.
Portrete femrash, www.pashtriku.org, 16 tetor 2010

FLAKA E PASHUAR E LËVIZJES në Untergruppenbach, 18 janar 2011 në www.pashtriku.org

FAKTE rreth Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, Me përjashtim të citatit të Ramadan Pllanës të 1 shtatorit 2011, u botua për herë të parë në www.pashtriku.org, më 27 janar 2011
Raporti Jusuf Gërvalla - Xhafer Durmishi, 18 janar 2011 në www.pashtriku.org
Stilografat e Jusuf Gërvallës, www.pashtriku.org, 13 nëntor 2010

Asllan Muharremi**:** *"Me Xhafer Durmishin ishim së bashku në Prishtinë kur lexuam lajmin për vrasjen në Shtutgart më 17 janar 1982. Pas përgatitjeve për rrugë, e përcolla gjer në Stacionin Hekurudhor të Fushë Kosovës. U takuam sërish pas dy vitesh në mesin e mërgimtarëve të Shtutgartit. Afërsia me Jusuf Gërvallën kishte ndikuar në formimin e tij, sa i kishte rënë detyra të ishte nga ata që mirrej me çështjet ideore të Lëvizjes për Republikë.*

Libri "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" është një kontribut i madh për prezantimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare dhe aktivitetit tjetër të periudhës 1979-1985. Këtu vërehet dashuria e kujdesi i madh për shokët. Jusuf Gërvalla nuk do të duhej të ishte i pakënaqur me këtë vepër të këtij nxënësi të tij."

Jusuf Gërvalla: *"E kujtoi Troshin e ndjerë, të cilin e mbuluan një orë e më parë, para se të errej. Dhe kërthirin e vet atje lart në qiler.* ***Zëri që sapo ishte shuar dhe tjetri sapo i ishte qepur qiellit të ulët e të zi të asaj mbrëmjeje, kishin sjellë një mbushullimë të re, që Keta s'ia kishte ndier turrin më parë.*** *Tani rrinte si dru te cungu i drurëve dhe s'dinte ç'të bënte me duart, me trupin e vet. Pas një çasti të shkurtër, ai do të merrte sëpatën e batallisur me mote, do ta mprehte sa t'i shkëlqenin në reflekset e borës të dy anët e tehut. Pastaj iu afrua gardhit, e ngriti me rrëmbim në ajër sëpatën dhe e preu lik përmjedisi* ***drurin e zi, që ia kishin mbjellë në oborr.***

Në ballë i kërceu një damar i trashë.

Iu bë se ishte rritur për këmishën e dragoit, që dikur ishin përpjekur t'ia shplonin më kot të tjerët. U ngjit lart në tavan, mes frymëve që kaluronin natën, dhe e veshi atë këmishë.

Ç'po ngjante kështu?

I fërkoi sytë. Një zhurmë e brendshme ia kaploi trupin.

Po zgjohej zhurmshëm nga kotja e rëndë shekullore, që e ngurron nganjëherë edhe draguan.

Oxhaku i tij i lartë, që i mbeti në këmbë *si shenjë e shpotitjeve të Dakë Skelës dhe të Bekë Troshit, atë ditë e sot, shekuj me radhë, nxjerrë tymin duaj-duaj dhe pos fluskave të bardha të borës e* ***Zërit*** *të thekshëm të kalamajve, s'ka frymë as erë tjetër që ia tollovit fqollat që marrin erë thikë përpjetë."*

"Shumë i nderuar Xhafer,

Si lexues e aktivist i asaj kohe, shkrimet tuaja të publikuara dy viteve të fundit i kam pritur me kënaqësi. Në rastin tim, për më tepër, i shoh edhe si një dhuratë prej një shoku që familjarisht të njoha nga fëmijëria, që nga oborri i Shkollës fillore. Këtë lidhje, Xhafer, e ke konfirmuar dhe vulosë përjetësisht në formë shumë besnike.

Jam i bindur se këtë vepër që po e prezanton për opinion - vetëm historia do u shpërblej. Kuptohet se unë bazohem në korrektësinë, seriozitetin, përkushtimin dhe argumentimin tuaj bindës (jo me fjalë, po me fakte të shkruara) të asaj kohe nga dorëshkrimet e Jusuf Gërvallës, nga dorëshkrimet tuaja, Tafallarit etj. Unë shpresoi se të gjitha ato letërkëmbime, vendime e dorëshkrime i ke në arkivin tënd, apo gjenden tek Faridin Tafallari, sepse historia u beson fakteve e jo fjalëve apo thashethemeve.

E kam të vështirë të gjejë krahasime, sepse ma merr mendja se ke nivel të lartë kundrejt atyre që janë përpjekë ta manipulojnë opinionin me të paverteta.

Krejt në fund; Nga thellësia e shpirtit ju dëshiroi shëndet, lumturi dhe suksese në jetën tuaj plot begati.

Shumë të fala nga

Shaban Muharremi"

Jusuf Gërvalla: "*22-vjeçari i sotëm ende nuk ka qenë i lindur, kur UDB-ja e pat burgosur herën e parë për veprimtari patriotike shokun Adem Demaçi,* ***në vitin 1958****. Sot këtë 22-vjeçar e kemi burrë të rritur e të pajisur me vetëdije të lartë kombëtare e klasore dhe me një gatishmëri e guxim të pashoq për t'u futur si e kërkon nevoja në zjarrin e luftës e të revolucionit. Në qoftë se ai është aftësuar edhe në pikëpamje organizative, atëherë, për kauzën tonë kanë ardhur kohë të mbara.*

Si ka mundur ai të aftësohet në pikëpamje organizative, pasi me moshë është shumë i ri dhe është rritur në kushte të atilla, në të cilat njeriu e ka vështirë të shtjerë në dorë literaturë përkatëse; pastaj kushtet e ilegalitetit dhe të rrezikut të madh nga agjentët e regjur, kanë qenë në fuqi edhe për të, madje veçanërisht për të, si njeri i ri dhe pa përvojë.

As historinë e mirëfilltë kombëtare, as teorinë marksiste-leniniste të mirëfilltë, ai nuk ka pasur mundësi t'i mësoj në shkollë dhe as në kushte të hapëta publike.

Cilat paskan qenë, pra, burimet e frymëzimit të tij dhe si u stërvit ai në punë organizative?

Natyrisht, momentet që ndikojnë në edukimin e përgjithshëm të njeriut dhe në formimin e plotë të personalitetit të tij, pra edhe të personalitetit të tij revolucionar - janë të shumta dhe të pallogaritshme. Kështu ka ngjarë edhe me 22-vjeçarin tonë në shqyrtim. Por, këtu e do puna që, pa hyrë në ndonjë analizë tjetër, ta veçojmë ndikimin që ka mundur ta ushtrojë ndonjë grup apo organizatë revolucionare e llojit të atillë që kanë vepruar ndër ne, duke u hapur edhe ndaj të rinjve, që do të thotë, duke analizuar edhe këtë premisë të propagandës së shëndoshë revolucionare.

Po e ndoqëm edhe më tutje këtë fill, do të dalim te një dimension i domosdoshëm i revolucionit - te çështja e vazhdimësisë së tij.

Rinia është rezervë e pashtershme e revolucionit."
(Dhjetor 1980. Nga artikulli "Bashkimi bënë fuqinë")

SHOK I RRETHIT TONË

Xhafer Durmishi ka lindur në vitin 1958 në fshatin Stanoc i Poshtëm, i Komunës së Vushtrisë. Nen ndikimin e arsimtareve te tij, të shkollës fillore, angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe e Viseve të tjera Shqiptare nën Jugosllavi".



XHAFER DURMISHI

Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku i vitit 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart te Gjermanise, duke u bere shoku dhe bashkeluftetari besnik i tyre.

Me Xhafer Durmishin kemi qenë shokë e bashkëveprimtarë të pandarë gjatë kohës që JUSUFI ishte gjallë. Por, edhe pas vrasjes së tij kemi vazhduar veprimtarinë e Lëvizjes bashkarisht, pa u ndarë, deri në vitin 1985, për të çuar në vend amanetin e JUSUFIT. Edhe sot, pothuajse 30 vite pas verës së vitit 1981, na mban afër, si edhe atehere, fryma dhe atmosfera e Vëllezërve GËRVALLA, por dhe e të gjithë atyre shokëve, veprimtarë të paharruar, të asaj kohe.

Deri më sot është shkruar edhe nga të tjerë për JUSUFIN e MADH, por veçanërisht dua të theksoj që, me shumë vërtetësi ka shkruar dhe e ka analizuar me përpikmëri e korrektësi veprimtarinë e tij patriotike e atdhetare, dhe këtë e them fuqishëm, shoku dhe bashkëveprimtari më i ngushtë i Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Xhafer Durmishi, i cili, këto shkrime i ka publikuar në faqet mëse atdhetare e tepër serioze të internetit, si -Pashtriku.org- dhe në -Albaniapress.com-, faqe korrekte, të cilat i konsideroj copëza të atdheut tonë të shenjtë.

Pas vitit 1985 unë isha në qendrën e aktiviteteve në Gjermani e Zvicër, ndërsa kur është fjala për Xhaferin, dukej sikur jeta kishte plane tjera për te, në Suedi....

Vitet kalonin.... Qysh sa ishte në Gjermani, të gjitha dokumentet e aktivitetit të tij i kishte lënë tek unë, ku ishin më të sigurta se sa në dhomën e tij të refugjatit. Në fillim të vitit 1992 të gjitha materialet ia dërgova në Suedi...

Duke e njohur nga afër, së pari si njeri, me cilësi e virtyte të larta edhe si shoku im i mirë, bashkëveprimtar e bashkëluftëtar besnik e i palodhur... por edhe duke i ditur më së miri aftësite e tij...heshtja e gjatë e tij më ka befasuar!?

Por befasia ime ka qenë më e madhe nga niveli, mënyra dhe logjika e trajtimit, të veprës së Vëllezërve Gërvalla dhe aktivitetit të shokëve të atyre viteve, të shkruar e të faktuar me aq realizëm prej tij!

Ndaj unë, si dëshmitar i gjallë e atyre viteve, jam shumë i kënaqur që ky trajtim e shtjellim, i parashtruar në këtë vepër:"Lëvizja e Jusuf Gërvallës", është bërë e shkruar me shumë dinjitet e vërtetësi, me fakte të patjetërsueshme nga një shok korrekt e aktivist serioz i rrethit tonë. **Faridin Tafallari**

© Pashtriku dhe Xhafer Durmishi Tetor 2012